

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare
**STUDIMET ALBANISTIKE NË
VENDET KU FLITET GJERMANISHT**

Internationale Wissenschaftliche Konferenz
**ALBANISTISCHE FORSCHUNGEN IN
DEN DEUTSCHSPRACHIGEN LÄNDERN**

Prishtinë, 26-27.10.2017



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare
**STUDIMET ALBANISTIKE NË
VENDET KU FLITET GJERMANISHT**

Internationale Wissenschaftliche Konferenz
**ALBANISTISCHE FORSCHUNGEN IN
DEN DEUTSCHSPRACHIGEN LÄNDERN**

Prishtinë, 26-27.10.2017

Përgatiti: Akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës / Konferenzausschuss / Organization Board of the Conference: Rexhep Ismajli, Kolec Topalli, Robert Elsiq, Ethem Likaj, Teuta Abrashi, Seit Mansaku dhe Bardh Rugova



KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

Konferencë shkencore ndërkombëtare
**STUDIMET ALBANISTIKE NË
VENDET KU FLITET GJERMANISHT**

Internationale Wissenschaftliche Konferenz
**ALBANISTISCHE FORSCHUNGEN IN
DEN DEUTSCHSPRACHIGEN LÄNDERN**

Prishtina, 26-27.10.2017

Compiled by: Academician Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës / Konferenzausschuss: Rexhep Ismajli, Kolec Topalli,
Robert Elsie, Ethem Likaj, Teuta Abrashi, Seit Mansaku dhe Bardh Rugova

Editor: Academician Eqrem Basha, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare
**STUDIMET ALBANISTIKE NË
VENDET KU FLITET GJERMANISHT**

Internationale Wissenschaftliche Konferenz
**ALBANISTISCHE FORSCHUNGEN IN DEN
DEUTSCHSPRACHIGEN LÄNDERN**

Prishtinë, 26-27.10.2017

Përgatiti: Akademik Rexhep Ismajli

Këshilli organizues i Konferencës / Konferenzausschuss: Rexhep Ismajli, Kolec Topalli,
Robert Elsie, Ethem Likaj, Teuta Abrashi, Seit Mansaku dhe Bardh Rugova

Redaktor: Akademik Eqrem Basha, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.



Copyright © ASHAK

Mbështetur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës
Gefördert vom Kulturministerium der Republik Kosova
Supported by the Ministry of Culture of the Republic of Kosova

PËRMBAJTJA

REXHEP ISMAJLI: STUDIMET ALBANISTIKE NË VENDET KU FLITET GJERMANISHT	9
KLAUS STEINKE: HERAUSFORDERUNGEN FÜR DIE DEUTSCHE ALBANOLOGIE IM 21. JAHRHUNDERT [Sfidat e albanologjisë gjermane në SH. 21]	41
KOLEC TOPALLI: SHKENCËTARËT GJERMANË PËR ETIMO- LOGJINË E SHQIPES	51
BARDHYL DEMIRAJ: QENDRA ALBANOLOGJIKE NË UNIVERSITE- TIN “LUDWIG-MAXIMILIAN” TË MUNIHUT – NJË VËSHTRIM PERSPEKTIV	57
HELMUT W. SCHALLER: DIE GESCHICHTE DER ALBANOLOGIE IN DEUTSCHLAND [Historia e albanologjisë në Gjermani]	69
SEIT MANSAKU: ALBANOLOGJIA GJERMANE NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XIX: NGA KSILANDERI TE BOPPI	85
HEINER EICHNER: ZHVILLIMI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË KUADRIN E GJUHËSISË INDOEVROPIANE GJERMANISHTFOLËSE - NJË PERSPEKTIVE AUTOBIOGRAFIKE	95
BAHRI BECI: J. G. HAHN PËR HISTORINË E DY DIALEKTEVE TË SHQIPES DHE REAGIMET NDAJ PIKËPAMJEVE TË TIJ	113
WILFRIED FIEDLER: DIE DARSTELLUNG DER GENUSPROBLE- MATIK IN DEN DEUTSCHSPRACHIGEN ALBANISCHEN GRAMMATIKEN DES 19. JH [Konceptimi i problematikës së gjinisë në gramatikat gjermanisht të shqipes në sh. 19]	143
MATTEO MANDALÀ: ARBËRESHËT DHE ARBËRISHTJA NË VEPRËN E GUSTAV MEYER-IT (1850-1900)	163
FRANCESCO ALTIMARI: DE RADA DHE ARBËRESHËT E ITALISË NË FOKUSIN E ALBANOLOGJISË GJERMANE TË SHEKULLIT XIX	179
GIUSEPPINA TURANO: KONTRIBUTI I STUDIUESVE GJERMANË PËR DIALEKTOLOGJINË ARBËRESHE	187
WALTER BREU, ELVIRA GLASER: HANS-JÜRGEN SASSE FORSCHUNGEN ZUM ARVANITIKA [Studimet e H. J. Sasse-s për arvanitikan]	195

GIOVANNI BELLUSCIO, EMILIA CONFORTI: LE INCHIESTE DI GERHARD ROHLFS PER LO <i>SPRACH- UND SACHATLAS ITALIENS UND DER SÜDSCHWEITZ</i> , (AIS) PUNKT 751-ACQUAFORMOSA, L'ANALISI E LO STUDIO DEI MATERIALI FDA PARTE DI RUPPRECHT ROHR, E LE SUCCESSIVE INDAGINI DI GABRIELE BIRKEN-SILVERMAN NELLE COMUNITÀ ALBANOFONE DELL'ITALIA MERIDIONALE [Sondazhet e G. Rohlfs për atlasin gjuhësor dhe të gjërave të Italisë dhe të Zvicrës Jugore, (AIS) pika 751-Acquaformosa, analiza dhe studimi i R. Rohr, dhe hetimet vijuese të G. Birken-Silverman në bashkësitë arbëreshe të Italisë Jugore].....	233
IMRI BADALLAJ: KONTRIBUTI I CLAUD HAEBLER-IT MBI TË FOLMET ARBËRORE TË GREQISË	261
SABRI HAMITI: LAMBERCI E ÇABEJ: PËR LETËRSINË SHQIPE	271
FLORESHA DADO: FRANC NOPÇA, NGA QASJET ALBANOLOGJIKE TE KRIJIMI POETIK.....	279
BASHKIM KUÇUKU: BOTIMET DHE KRITIKA GJERMANE PËR VEPRËN E KADARESË.....	285
KUJTIM M. SHALA: IPSE ET IDEM	293
KRISTAQ JORGO: STUDIMI & PËRKTHIMI: MARTIN CAMAJ I HANS JOACHIM LANKSCH-IT	311
ROBERT PICHLER: ALBANIAN STUDIES IN GRAZ. HISTORICAL ANTHROPOLOGICAL APPROACHES TO FAMILY, KINSHIP AND MIGRATION – A BRIEF OVERVIEW [Studimet shqiptare në Grac. Qasjet historiko-antropologjike ndaj familjes, farefisnisë dhe migrimit. Pasqyrë e shkurtë].....	329
JANI THOMAI: LEKSIKOGRAFIA DYGJUHËSHE E SHQIPES ME GJERMANISHTEN	345
REMZI PËRNASKA, TOMORR PLANGARICA: <i>ALBANISCHE GRAMMATIK</i> E O. BUCHHOLZ-IT DHE W. FIEDLER-IT, PERLË GRAMATOGRAFIE.....	365
TEUTA ABRASHI: NDAJSHTIMI I PAVEÇUAR - DISA ÇËSHTJE NË RRAFSHIN SINTAKSOR DHE SEMANTIK	383
BLERTË ISMAJLI: NORBERT BORETZKY SI ALBANOLOG – SISTEMI FOLJOR I SHQIPES NË STUDIMET E TIJ.....	431
BARDH RUGOVA: MËNYRË DHE MODALITET NË GJUHËN SHQIPE – KONTRIBUTI I WALTER BREU-IT	439

VJOSA HAMITI: FJALËT MODALE SHQIPE NË <i>ALBANISCHE GRAMMATIK</i> TË ODA BUCHHOLZ-IT DHE WILFRIED FIEDLER-IT	453
SADIJE REXHEPI: SISTEMI KOHOR I SHQIPES SIPAS BUCHHOLZ/FIEDLER-IT	463
KURT GOSTENTSCHNIGG: DIMENSIONI POLITIK I TRAJTIMIT TË ÇËSHTJES SË ETNOGJENEZËS SHQIPTARE NGA ANA E ALBANOLOGJISË AUSTRO-HUNGAREZE	477
PËLLUMB XHUFI: HISTORIOGRAFIA GJERMANIKE E ALBANOLOGJIA	493
DHORI Q. QIRJAZI: ASPEKTE TË JEHONËS/RECEPTIMIT DHE TË KUADRIT BALLKANIK TË VEPRAVE NË GJUHËN GJERMANE KUSHTUAR SHQIPES DHE SHQIPTARËVE	505
GERD-DIETER NEHRING: MBI STRUKTURËN SEMANTIKE DHE FORMALE FJALËFORMIMI TË MBIEMRAVE ME DY DHE MË SHUMË TEMA NË SHQIPEN STANDARDE	529
GËZIM HOXHA: OPTIKA E THEODOR IPPEN-IT MBI ULTËSIRËN BREGDETARE TË SHQIPËRISË VERIORE KUNDREJT REZULTATEVE TË SOTME TË ARKEOLOGJISË	545
ALBULENA BLAKAJ-GASHI: RAPORTET KULTURORE SHQIPTARO-GJERMANE	567
ANILA OMARI: FJALËFORMIMI I SHQIPES SË VJETËR: NJË KONTRIBUT I RI I JOACHIM MATZINGERIT	577
ALBERT RISKÀ: GJURMË TË APOFONISË IE. NË GJUHËN SHQIPE	601
BESIM KABASHI: NEOLOGJIZMAT NË SHQIPEN E SOTME – NJOHJA DHE ANALIZA AUTOMATIKE	601
KRISZTIÁN CSAPLÁR-DEGOVICS: GEDANKEN ZUR ENTSTEHUNGSGESCHICHTE DER ALBANISCHEN WÖRTER-BÜCHER [Mendime për historinë e lindjes së fjalorëve të shqipes]	609
MIMOZA KORE: VEÇORI GJUHËSORE DHE ETNOLOGJIKE TË QYTETIT TË GJIROKASTRËS NË VEPRËN E MAXIMILIAN LAMBERTZ-IT	625
BEGZAD BALIU: MAKSIMILIAN LAMBERCI DHE VENDI I TIJ NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE	641
GJOVALIN SHKURTAJ: STUDIMET PËR KONTAKTIN E SHQIPES ME GJERMANISHTEN NË KANTONIN GJERMANIK TË ZVICRËS DHE NË AUSTRI	661

EVALDA PACI: GUNNAR SVANE: KONTRIBUTE THEMELORE MBI INTERPRETIMIN TEKSTOR E FILOLOGJIK TË VEPRËS SË PJETËR BUDIT	665
MILOTE SADIKU: STUDIMET E GJUHËTARËVE GJERMANISHTFOLËS PËR MBIEMRIN E GJUHËS SHQIPE.....	679
JONIDA XHYRA-ENTORF: PËRTHYERJE TË KULTIVUARA NË ALBANOLOGJI: MARIE AMELIE VON GODIN	695
HAXHI SHABANI: FJALORTHI I ARNOLD FON HARFIT JO VETËM NJË NGA DOKUMENTET E PARA TË GJUHËS SHQIPE.....	715
MARIO DE MATTEIS, BRIKENA KADZADEJ: NDIHMESA E STUDIUESVE TË RINJ SHQIPTARË NË HAPËSIRËN GJERMANISHTFOLËSE, PAS KTHESËS	723
MIRADIJE BERISHAJ, GJOVALIN SHKURTAJ: PANORAMË E STUDIMEVE ALBANALOGJIKE DHE E MËSIMIT TË SHQIPES NË DIASPORËN SHQIPTARE NË REPUBLIKËN E AUSTRISË	731
ESHREF JANUZAJ, VISAR JANUZAJ, ALI CAKA, PETER MANDL: DREJTË NXJERRJES SË DIJES PREJ SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE NË KOHËN E BIG DATA.....	751
KIMETE CANAJ: ROLI I PROFESORIT AUSTRIAK HERMANN M. ÖLBERG NË STUDIMIN DHE PROMOVIMIN E GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE	781
REXHEP ISMAJLI: FJALA E MBYLLJES	797
MATERIALET DOKUMENTARE TË KONFERENCËS	801
INDEKSI	837

Rexhep ISMAJLI, Prishtinë

STUDIMET ALBANISTIKE NË VENDET KU FLITET GJERMANISHT

Në vitin 2015 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajt Konferenca Shkencore ndërkombëtare me temën “Studimet albanistike në Amerikë”, që synonte të arrinte dy qëllime kryesore: të shënonte, evidentonte, theksonte rezultatet e arritura në studimet për gjuhën shqipe në Amerikë dhe njëherësh të aktualizonte nevojën për rritjen e këtij interesi në rrethanat e reja. Konferenca doli rezultative dhe në vijim u pa se kishte nevojë të ndërmerreshin aktivitete të ngjashme për hapësira të tjera. Për më tepër, u pa qartë se kishte shumë nevojë për paraqitje të përbashkëta të sa më shumë studiuesve të hapësirave përkatëse në mënyrë që të nxiteshin më tej dialogë dhe diskutime. Konferenca nisi dhe një thirrje publike për themelimin e një institucioni studimesh në ndonjë universitet amerikan për gjuhën shqipe, çka do të sillte ndihmesa me vlerë.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë vendosën që këtë herë të organizonin një konferencë për studimet albanistike në botën gjermanishtfolëse, ku kemi të bëjmë me një traditë shumë më të hershme dhe më të gjerë dhe me zhvillime më të gjithanshme në të gjitha drejtimet. “*Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*” në të vërtetë mbërthejnë traditën më të lashtë të këtyre studimeve, njëherësh dhe përdegëzimin më të rëndësishëm që kanë shënuar ato deri në periudhën kur në hapësirat shqiptare (në Shqipëri fillimisht, në vijim në Kosovë, në Maqedoni, pastaj tek arbëreshët e Italisë, etj.) u zhvilluan institucione që merren në mënyrë specifike me këto studime.

Në historinë albanistike në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni dhe tek arbëreshët ka një traditë organizimi konferencash dhe diskutimesh me studiues nga vendi dhe nga bota. Do të përmend këtu disa, p.sh., *Konferencën e parë të studimeve albanologjike*, Tiranë 1962, materialet e së cilës

u botuan më 1965,¹ *Konferencë e dytë të studimeve albanologjike* Tiranë 1968, që u mbajt me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ndërsa materialet e saj u botuan më 1969,² *Simposiumin për Skënderbeun* në Prishtinë 1968, ku morën pjesë studiues nga vende të ndryshme, *Kuvendin e studimeve ilire* Tiranë 1972,³ që do të shënonte një

¹ Kjo Konferencë, gjithsesi me pretendime më të mëdha se të një konference të zakonshme, kishte ftuar studiues nga vende të ndryshme. Sipas njoftimit të Komitetit organizativ, në konferencë morën pjesë rreth 600 studiues profilesh të ndryshme, kryesisht nga Shqipëria, por edhe studiues nga bota, si: Xhou Pej-yen, Xhao Shyn, An Xhë-min, F. Babinger, V. Pisani, K. Treimer, H. Boissin, Z. Mayani, G. Svane. Në njoftimin nga komiteti organizativ thuhej se Konferencën e kishin përshëndetur me letër dhe I. Snegarov, M. Lambertz, A. Mazon, J. Irmscher, L. Newmark, J. Pereni, Gj. N. Kaldi, E. Seidel, W. Fiedler, G. Uhlisch, M. Lambertz, nërsa kishin njoftuar se do të mbanin kumtesa: V. Georgiev, I. Snegarov, I. Dujčev, H. Batkowski, J. Irmscher, S. Mann, D. Mustilli, H. Inalçik, J. Kabrda, etj. Nuk shënohej të kishte pasur të ftuar a të interesuar nga Jugosllavia, por jepej një shënim që i shpreh mirë raportet e kohës me disa vende të tjera: “...nuk u lejuan të marrin pjesë dijetarët e ftuar nga *Bashkimi Sovjetik, Polonia, Çekoslovakia, Bullgaria, Rumania, R. D. Gjermane e Hungaria*”, **Konferenca e parë e studimeve albanologjike (15-21 nëndor 1962)**, Tiranë, 1965, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, f. 728.

² “Në konferencë morën pjesë dhe sollën kontributin e tyre edhe shkencëtarë nga vende të tjera: nga *Austria* profesorët: K. Trajmer dhe E. Patzelt, nga *Bullgaria* akad. V. Georgiev dhe prof. S. Dimitrov, nga *RD Gjermane* prof. J. Irmscher, nga *Hungaria* prof. Gj. Daniel, nga *Italia* prof. Xh. Skiro, nga *Franca* profesorët: F. Tirje dhe A. Dyselje, nga *Rumania* profesorët: F. Pal dhe K. Gëlner, nga *Turqia* prof. N. Alban, punonjës nga institucionet shkencore e mësimore të *Kosovës* e *Metohisë* profesorët: M. Krasniqi, F. Agani, I. Ajeti, S. Pupovci, A. Çetta dhe Z. Mirdita”, **Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968)**, I, Tiranë, 1969, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, f. 5.

³ Me organizim të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë që sapo themelohet dhe të Instituteve të Historisë, të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe të Monumenteve të Kulturës, nga 15 deri më 20 shtator 1972 në Tiranë u mbajt *Kuvendi I i studimeve ilire*, ku morën pjesë mbi 500 studiues nga Shqipëria dhe shumë vende të tjera. Organizuesi njoftonte se në Kuvend kishin ardhur dhe delegacione nga Akademia e Shkencave e Kinës, nga Universiteti i Prishtinës, shkencëtarë dhe specialistë nga Anglia, Bullgaria, RD Gjermane, RF Gjermane, Austria, Greqia, Italia, Polonia, Rumania, Jugosllavia. Në seancën e mbylljes përshëndetën në emër të delegacioneve përkatëse: Go Zho Min dhe Sia Nai, N. Hammond, K. Treimer, L. Ognenova, V. Pisani, A. Benac, J. Irmscher, E. Condurachi, A. Poulianos e Miločić. Ky kuvend përnga përmasat e pjesëmarrjes dhe pesha e rezultateve të paraqitura është konsideruar shumë i suksesshëm dhe ka lënë gjurmë në studimet e mëtejme, pavarësisht nga ndarjet e kohës, dhe nga prania shken-

zhvillim me rëndësi në fushën e studimeve ilire në përgjithësi; *Kongresin e Drejtshkrimit*, Tiranë 1972;⁴ *Konferencën për Lidhjen e Prizrenit në Prishtinë më 1978* (materialet e së cilës u botuan nga ASHAK më 1988),⁵ *Konferencën kombëtare për formimin e popullit shqiptar, të gjuhës dhe të kulturës së tij*, Tiranë 1982 (materialet u botuan më 1988), konferencë me temë *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë*, Tiranë 1984 (materialet u botuan më 1988), disa konferenca të përbashkëta të dy Akademive, si *Kongresi i Mansatirit dhe njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe* (2008), konferencat e vazhdueshme vjetore të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare nga viti 1974 e këndeje, konferencat e organizuara nga ASHAK, si *Konferenca jugosllave për onomastikën* 1985 (materialet nuk u botuan), *Shqiptarët dhe Evropa* 1991 (materialet nuk u botu-

cërisht pak e motivuar kineze, apo mbulesa politike, kuvendi solli një numër të madh ndihmesash me vlerë të autorëve nga hapësira të ndryshme. Le të përmendim vetëm studiuesit nga hapësirat jashtë Shqipërisë e Kosovës: A. Benac, V. Milojević, G. Georgiev, N. Hammond, A. Harding, A. Bietti Sestieri, F. Lo Schiavo, K. Kilian, V. Dimitrescu, M. Petrescu Dîmbovița, D. Garašanin, W. Pająkowski, F. Walbank, J. Immischer, P. Franke A. Stazio, D. Garašanin, M. Garašanin, L. Ognenova, M. Suić, P. Sestieri, D. Rendić-Miočević, Vl. Georgiev, W. Cimochoowski, R. Crossland, V. Pisani, C. De Simone, R. Katičić, G. Bonfante, E. Condurachi, R. Vulpe, Dj. Bošković, A. Duce'llier, A. Stipčević, A. Puljanos. Shih **Kuvendi i studimeve ilire I-II** (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës.

⁴ Ky Kongres kishte të bënte në radhë të parë me çështjen e shqipes letrare të përbashkët dhe vendimet në këtë drejtim, kështu që është e kuptueshme që ai do të përqëndrohej të pjesëmarrësit nga hapësirat ku flitet shqipja.

⁵ **Konferenca Shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, I-II**, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1988, ff. 643 dhe 749. Konferenca i zhvilloi punimet nga 6-9 qershor 1978 në Prishtinë, me organizim të ASHAK, Instituti Albanologjik dhe Entit të Historisë të Kosovës. Në fjalën e mbylljes I. Ajeti veçonte: "... është një bashkëtakim i rrallë ndërkombëtar i studiuesve të vendit e të huaj të shkencave albanologjike", II, f. 747. Nga 115 kumtesat e lexuara, 39 ishin nga hapësirat ku nuk flitet shqipja lexuan këta autorë: E. Kofos, A. Manjkovskaja, C. Silvana, S. Dimovski, M. Folić, B. Kondis, N. Ciachir, G. Macsutovici, S. Antoljak, N. Smirnova, R. Bogdanović, Z. Djordjević, B. Vranešević, K. Džambazovski, B. Kovačević, H. Silajdžić, G. Daniel, H. Altıparmak, J. Nemesker, Đ. Gal, B. Đukić, G. Bevington, W. Fiedler, K. Kostov, A. Vraciu, W. Dahmen, J. Krammer, F. Jakopin, V. Josifoska, V. Friedman, K. Fortino, N. Kilibarda, V. Jaćoski, D. Mićović, D. Vućinić-Varga, G. Schirò, M. Famiglietti, C. Vătăşescu, A. Bellusci.

an), *Letërsia dhe gjuha letrare* 1996 – materialet u botuan më 1998; *Naim Frashëri – 100 vjet pas 2000* (botimi 2000); *Për Faik Konicën* 2005 (u botua 2006); *Studimet filologjike shqiptare* 2007 (u botua 2008); *Historia e letërsisë shqipe* 2009 (u botua 2010); *Çështje të studimeve diakronike të shqipes* 2009 (u botua 2010), *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit* 2011 (u botua 2012), bashkë me AShSh, etj. Instituti Albanologjik i Prishtinës ka mbajtur disa herë konferenca të këtilla, si Simpoziumi shkencor *Gjendja e sotme e studimeve albanologjike – rezultate dhe probleme*, Prishtinë 1985 (materialet u botuan më 1987). Pas vitit 2000 janë zhvilluar konferenca me synime vlerësuese si Simpoziumi Shkencor Ndërkombëtar me temën *50 vjet studime albanologjike* me rastin e 50-vjetorit të themelimit të këtij Instituti më 2003, materialet e të cilit u botuan më 2004. Në Shkup, përkatësisht në Tetovë janë mbajtur po ashtu konferenca të tilla të organizuara nga qendra e studimeve albanologjike atje, apo nga universitetet. Secila prej tyre i ka pasur veçantitë, përmasat dhe nivelet specifike, ka shënuar rezultatet e veta dhe ka theksuar eventualisht synimet dhe nevojat për zhvillimet e mëtejme. Botimet me aktet e tyre janë në qarkullim. Asnjëherë nuk mund t'i mohohet dimensionin e dialogut me hapësirat më të gjera shtetërore apo kombëtare.

Konferenca të ngjashme janë mbajtur lidhur me zhvillimet në shkencat albanologjike janë, si *Kolokuiumi i Innsbruket me rastin e përvjetorit të Norbert Joklit më 1972*, materialet e të cilit u botuan më 1977,⁶ një radhë

⁶ Titulli i saktë i Kolokuiumit ishte: “*Internationale Albanologische Kolloquium zum Gedächtnis an Univ.-Prof. Dr. Norbert Jokl, Innsbruck, 28. September bis 3. October 1972*”. Pra, nuk ishte kongres dhe kishte cenin se vinte menjëherë pas Kuvendit shumë më të madh të ilirëve me karakter të mirëfilltë ndërkombëtar. U mbajt në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të Innsbruket në bashkorganizim me Shoqatën e Gjuhësisë dhe me Shoqatën Indoeuropiane. Botimi u bë nën kujdesin e Hermann M. Ölberg në radhën *Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft* 41, ff. 784. Morën pjesë studiues nga vise të ndryshme të botës. Nga Kosova morën pjesë aty: H. Kaleshi, Z. Mirdita, R. Ismajli, Sh. Pllana, L. Mulaku. U lexua kumtesa e I. Ajetit. Ishte parashikuar dhe A. Hadri, por nuk erdhi as u lexua kumtesa e tij. Nuk përbënim delegacion, siç mund të jetë thënë ndonjëherë, po thjesht ishim pjesëmarrës individualë. Nga Shqipëria mori pjesë grupi: E. Çabej, A. Kostallari, M. Domi, Sh. Demiraj, S. Floqi, J. Kole, J. Gjinari. Kumtesat i dërguan edhe: B. Beci, E. Lafë, Xh. Lloshi, J. Thomaj. Morën pjesë, ose kumtesa dërguan, edhe: R. Bratschitsch, W. Meid, O. Haas, L. Dodić, T. Jochalas, W. Cimochowski, E. Hamp, I. Pudić, G. Klingenschmitt, M. Gabinski, K. Strunk, G. Grimm, W. Fiedler, Ch. Gut, G. Jucquois, F. L. von Hüttenbach,

konferencash ndërkombëtare të organizuara G. Guzetta dhe nga arbëreshët në Palermo, pastaj të tjera në Poloni, në Rusi, disa konferenca në Gjermani, etj. Në Gjermani janë organizuar konferenca të tilla me synime për të pasqyruar fushat përkatëse ose tërësinë e studimeve albanistike, si p.sh. ajo që u mbajt në Këln më 1988,⁷ apo ato të organizuara nga Departamenti i albanistikës në Mynih, me rastin e 450-vjetorit të “Mesharit” të Buzukut, botuar më 2007 te Harrassowitz, tjetra për *Studimet për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare në kujtim të M. Camajt*, botuar po aty më 2010 dhe *Sprache und Kultur der Albaner. Zeitliche und räumliche Dimensionen* (Gjuha dhe kultura e shqiptarëve. Dimensione kohore dhe hapësinore) më 2015, ff. 663, të trija të përgatitura nga B. Demiraj, apo konferenca më konkrete si ajo me rastin e 80-vjetorit të W. Fiedler të mbajtur në Tiranë dhe të Botuar te Harrassowitz më 2016 nga E. Pistrick: “*Deutsch-Albanische Wissenschaftsbeziehungen hinter dem Eisern Vorhang*” (Marrëdhëniet shkencore gjermano-shqiptare prapa perdes së hekurt), ff. 169, etj.

Nevoja për të bërë herëpashere bilance dhe për të parë se nga mund të shkojnë studimet në një fushë të caktuar theksohet vazhdimisht nëpër institucione dhe qarqe studimi të fushave të ndryshme. Kështu më 2007 Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Shën Peterburgut, me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Departamentit të gjuhës dhe të letërsisë shqipe organizoi konferencën shkencore ndërkombëtare *Sovremenaja albanistika: dostizhenija i perspektivy* (Albanistika bashkëkohëse: arritje dhe perspektiva), në të cilën morën pjesë studiues të ndryshëm. Materialet e kësaj konference u botuan në vitin 2012 me po këtë titull nga Instituti i Hulumtimeve Linguistike në 464 ff. në Shën Peterburg.

Këto dhe konferencat që nuk pati mundësi të përmenden kanë shë-

V. Polák, N. Reiter, A. Vraciu, A. Žuga, A. Desnickaja, V. Georgiev, N. Boretzky, E. Banfi, R. Bernard, H. Haarmann, J. Knobloch, D. Moutsos, V. Pisani, G. Bevington, H. Boissin, O. Buchholz, W. Dressler, B. Sokolova, W. Borgeaud, G. Gangale, I. Voronina, I. Duridanov, A. Vraciu, R. Schwanke dhe H. Ölberg. Në Kolokuium shquhej E. Çabej, ndërsa ardhja e C. Tagliavini-t zgjoi kureshtjen e të gjithëve. Ndër kolegë gjermanë në mbrëmjen para fillimit të punimeve u pëshpërit diçka për mosardhjen e M. Camajt, por nuk pati asnjë informim të saktë a zyrtar. Kuptohet që askush nuk na kishte pyetur për diçka të tillë, dhe ne as që kishim ditur paraprakisht për “kushtëzimin” që është përmendur më vonë.

⁷ Aktet u botuan në vëllimin W. Brey/Köderitzsch, R./ Sasse, H.-J. (Hgg.) 1991.

nuar rezultate, kanë dhënë ndihmesë me vlerë për zhvillimet e këtyre studimeve, kanë shërbyer si nxitje për hulumtime të mëtejme. Ato dhe organizimet e tjera shpesh kanë ndeshur vështirësi të natyrave të ndryshme, ndër- sa vetë konferencat kanë synuar gjithnjë komunikimet përtej atyre ndarjeve. Nuk ka dyshim se disa prej konferencave të atilla, megjithë vështirësitë që janë të dukshme si pasojë e ndarjeve të kohës, shquhen për rezultatet që kanë shënuar (Konferenca I dhe II e studimeve albanologjike, Kuvendi i studimeve ilire, Kongresi i Drejtshkrimit, Konferenca për Lidhjen e Prizrenit, Kolokuiumi për Joklin, etj. të viteve '70-'80 të sh. të kaluar tashmë janë bërë pika referimi për aspekte të ndryshme të studimeve të fushës sonë. Kanë shënuar rezultate edhe të tjerat më vonë). Janë shënuar dhe konferenca të mëvona si Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Studimet diakronike, Studimet albanistike në SHBA, etj. pas vitit 2000, por ato janë ende në qarkullim. I përmenda më të mëhershmet për të treguar se edhe në rrethana të asokohshme ka pasur zhvillime të frytshme në fushën e kontakteve midis studiuesve të hapësirave dhe të vendeve të ndryshme, ashtu siç ka pasur dhe mangësi të shpjegueshme. Më vonë vetë konceptimi i konferencave shihej disi më ndryshe, sepse para tyre pjesëmarrësit dhe organizuesit jo gjithnjë shtronin synime të formësuara programatike.

Në këto studime dhe kontakte ka pasur dhe vijon të ketë vështirësi që shkojnë përtej aspekteve gjeografike e politike. Ekziston një vështirësi gjuhësore për studiuesit e hapësirave të ndryshme, jo vetëm në njohjen apo mosnjohjen absolute të gjuhëve, po edhe në shkallën e asaj njohjeje. Njëri mund të ketë mjaftueshëm njohje për të lexuar tekstet në një gjuhë, por do ta ketë më vështirë t'i shprehë të gjitha nuancat e nevojshme në tekstin që do të hartojë në gjuhën tjetër. Në kohën tonë ngjet jo rrallë që studiues të ndryshëm nga hapësira të tjera të mos i konsultojnë mjaftueshëm tekstet e botuara shqip, apo shqiptarët të mos jenë në gjendje t'i ndjekin tekstet e botuara gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, bullgarisht, serbisht, rumanisht, greqisht, turqisht, hungarisht, arabisht, etj. Kjo ndërlihet dhe me pamjaftueshmëri bibliotekash të specializuara, me përndarje të pabarabartë të tyre, me mungesa shërbimesh informimi specifik deri edhe bibliografik që bëjnë ato. Nuk ka dyshim se në raste të tilla mund të ketë reflektime afinitetesh e orientimesh, parapëlqimesh. Të gjitha këto, mbi të gjitha nevoja e të gjithëve që të kemi sa më shumë informacion mbi çka ka ndo-

dhur dhe vijon të ndodhë në studimet me të cilat merremi konkretisht këtë herë brenda hapësirës gjuhësore gjermane, gjithsesi në shumë aspekte heterogjene, por me nivele të larta në studimet filologjike-gjuhësore, kulturore e të tjera, na shtynë të ndërmarrim këtë organizim, gjithë duke lënë mundësinë që folësit t'i shprehin idetë e tyre në njërën prej gjuhëve që mendojnë se u mjafton për këtë informim: shqip, gjermanisht, anglisht.

Në dhjetor 2006 në Vjenë, me nismën e Albanien-Institut të Mynihut e të Institut für osteuropäische Geschichte të Universitetit të Vjenës, me mbështetje të Balkan-Kommission të Akademisë Austriake të Shkencave, u mbajt konferenca *Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung (Historia shqiptare. Gjendja dhe perspektivat e studimit)*, në të cilën u ftuan vetëm studiues shqiptarë, në mënyrë që të jepej një vrotim (dhe vlerësim) lidhur me perspektivat metodologjike të këtyre studimeve, siç thuhej në fjalën e hapjes: “... Në mënyrë krejt të vetëdijshme u zgjodh një vështrim nga jashtë, gjithsesi jo me mëtesën që të përjashtoheshin dijetarët shqiptarë, po me qëllimin që të krijohet një mbështetje e fortë për diskutime të pastajme gjithpërfshirëse me historianët shqiptarë”.⁸

Gjithë duke e përfillur vërejtjen për pamjaftueshmërinë e kontakteve të tilla të organizuara brenda hapësirës shqiptare, duke e vlerësuar vullnetin e këtyre studiuesve të respektuar dhe duke mbajtur rezervën për komunikimet dhe vlerësimet që do të përjashtonin këdoqoftë, pra as tubimet e këtyre me synime të veçanta, do të përsëris insistueshëm se kontaktet në rrafsh të tilla janë të domosdoshme dhe ato duhet të ndodhin në vazhdimësi ndërvepruese. Kemi një disiplinë shkencore albanistike dhe aspektet e përgjithshme teorike-metodologjike duhet të jenë brenda kornizave sa më të përbashkëta dhe përtej traditave gjuhësore e kulturore të veçanta. Kuptohet

⁸ Në “... *Es wurde also ganz bewusst ein Blick von Außen gewählt, dies jedoch nicht mit der Absicht, albanische Gelehrte auszuschließen, sondern mit dem Ziel, eine feste Basis für eine spätere umfassende Discussion mit albanischen Historikern zu schaffen. Der vorliegende Band ist also lediglich eine Etape in einem langfristig angelegten wissenschaftlichen Austausch*”, O. J. Schmitt u. E. A. Frantz (Hgg.) 2009, ff. 280, këtu f. 9. Kanë marrë pjesë studiues të njohur për ndihmesat e tyre të rëndësishme për albanistikën e albanologjinë: J. Matzinger, S. Schumacher, O. J. Schmitt, M. Koller, N. Clayer, B. J. Fischer, M. Schmidt-Necke, R. Pichler, S. Schwandner-Sievers, R. Elsie, N. Malcolm, P. Bartl e E. Hösch. Libri është përkthyer i tëri dhe botuar shqip në Tiranë: Schmitt, Oliver Jens dhe Frantz, Eva Anne 2012.

që studiuesit kanë historikun e formimit të tyre, kërkesat metodologjike, botëkuptimet, çka i bën të jenë të ndryshëm. Në të vërtetë ne tashmë jemi dëshmitarë të ndërkomunikimeve me kolegët dhe miqtë e tubimit të përmendur, botimi i shpejtë shqip i librit në fjalë këtë vullnet e dëshmon, ashtu siç do të duhej të dëshmonte dhe kjo konferencë.

Në diskutimin e përmendur më sipër të studiuesve të respektuar ishte nyjëtuar dhe ideja e pritjes që në studime tona, sidomos historiket, të evitohet politizimi dhe emocionalizimi dhe të jepej ndihmesë për të krijuar një ligjërim shkencor të drejtuar nga të dhënat. Kuptohet që pikënisja është të hamendësimi për ekzistencën e një homogeniteti në idetë midis studiuesve shqiptarë në fusha të caktuara, e, pra, për prodhime që për bazë mund të kenë një ideologji dhe pikënisje një synim dhe, më në fund, rrezikun nga mbyllja në ‘ne’ në raport me ‘ata’ (të huajt). Qoftë vetëm si aluzione të miqve, ato duhet të na bëjnë të mendohemi, por më parë del e nevojshme të vendoset ideja, të identifikohen synimet, të qartësohet konteksti.

Nga pozita krejt të tjera, vërejtje në këtë drejtim janë dëgjuar dhe më herët, sidomos në ish Jugosllavi, ku po ashtu komunikimi zhvillohej përmes gjuhës më të përhapur (që ishte serbokroatishtja) drejt të tjerave më të veçanta (si shqipja), çka linte mundësinë për interpretime të ndryshme. Diskutimet e atilla nuk mund të ishin produktive edhe për shkak të pozicionimit anues të nyjëtuesve të tyre, apo për shkak se shtroheshin thjesht si kërkesa të politikës së ditës, duke lënduar kështu mundësinë e diskutimit për pjesën shkencore përtej konceptimeve të rastit dhe jashtë shkencës. Mendoj se tani kemi rrethana krejt të tjera, ndaj të gjitha diskutimet mund të bëhen në mënyrë të hapur dhe në raste të ndryshme si ky yni.

Në dijet tona të gjysmës së dytë të sh. XX, ashtu si gjithandej, sidomos në botën e Lindjes Europiane, ka pasur ideologji e, si synim dhe propagim të saj, ka pasur dhe ndarje në ‘ne’ dhe ‘të huaj’. Nuk është çudi të ketë pasur dhe unifikime rreth tezave të caktuara, sepse ashtu mund të kenë funksionuar më shumë hapësira në ato shoqëri, për çka studiues të njohur nga bota perëndimore, po edhe nga brenda ‘nesh’ ndonjëherë edhe kanë folur. Por është gjithashtu e vërtetë se ka pasur dhe diversitet në detajet dhe në orientimet. Dhe, sado i minimizuar apo i maskuar të ketë qenë ai, e vlen të përmendet. Pa u marrë me diskutimet për shumë çështje, le të përmendim këtu vetëm dallimin lidhur me çështjen e autoktonisë së ilirëve apo të

ardhjes së tyre nga vise më veriore/ përkatësisht të formimit të tyre në Ballkan dhe në ndërlidhje eventuale me Anatinë. Jo një herë që kritikuar në mënyrë aluzive, po edhe përmes çudisë së fletërrufeve në Shqipëri Eqrem Çabej për mbështetjen në punën e tij si gjuhëtar, kur kishte nevojë, te mjeshtrit e hershëm të arkeologjisë, ndërsa studiues të tjerë mëtonin të kishin shënuar rezultate të tjera, pra me aluzionin se ai po neglizhonte dijen vendëse në raport me dijen ndërkombëtare. Ngjashëm ishte kritikuar ai dhe për raportin ndaj albanistikës së mëparme, konkretisht veprës së G. Meyer-it e atyre që kuptoheshin me cilësimin ‘borgjez’. Në fakt, fjala ishte për diçka si një proces më i gjerë, e që mund të ndërlidhej dhe me një ndryshim që disa kanë sugjeruar të hetoheshin në shkencat albanologjike në Shqipëri me kalimin nga dijet ‘perëndimore’ drejt paradigmave ‘sovjetike’.⁹ Për të gjitha këto aspekte e supozime ka shumë pak hulumtime konkrete.

Kuptohet që shkenca dhe dijet zhvillohen përmes ballafaqimit të vazhdueshëm të ideve. Por vështirë se mund të ketë në dijet si tonat asnjësi absolute. Pra, më duket se nevojat për vështrime kritike dhe dekonstruktime e ndërmarje në këto drejtime që janë theksuar ndonjëherë duhet të jenë të brendshme dhe të vazhdueshme në vështrimet patjetër kritike të rezultateve a ideve të mëparme. Dua të them, po ashtu, se, sidomos dekonstruktimi i ideologjisë së tjetrit, për aq sa është i mundshëm, bëhet më i besueshëm nëse kalon nëpër procesin e autodekonstruktimit, pra nëse ia dalim të shpërfaqim tërësisht në po atë nivel edhe pozitat tona. Nuk ka arsye që parimisht një histori e veçantë të shërbejë si alibi automatike për këdo tjetër.

Të gjitha këto konferenca e tubime shkencore i karakterizonte përpjekja për të pasqyruar gjendjen e studimeve dhe për të parë më tej rrugët e zhvillimit. Ndonjë prej tyre mund të ketë shërbyer edhe si platformë për ndërtimin e programeve të punës së mëtejme në institucionet përkatëse.

Më 1986 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Serbisë në Beograd u mbajt një cikël ligjëratash me temën “*Iliri i Albanci*”, materialet e të cilave u botuan në një vëllim të veçantë po me këtë titull nga kjo Akademi më 1988, në dy gjuhë, serbisht dhe frëngjisht, në 375 ff. Në fjalën e

⁹ Për reflekse në këtë drejtim të shihet S. Riza: *Për lavrimin refleks të shqiptarishtes së mbasçlirimt*, dorëshkrim autograf që ruhet në arkivin personal, në Riza, S. 2009, ff. 137-163, konkretisht f. 150-151. Reflekse në këtë temë gjejmë dhe në librin Beci, 2013.

hyrjes të redaktorit, arkeologut të njohur M. Garašanin, tregohej se punimet e paraqitura ishin rezultat i bashkëpunimit të Këshillit Ndërseksional për Studimin e Kosovës me Seksionin e Studimeve Historike të Akademisë të mbajtur në maj 1986.¹⁰ Tregohet po ashtu se në fund janë nxjerrë dhe përfundime të përbashkëta, duke theksuar sidomos “*mundësinë e kritikës serioze dhe të diskutimit solid të atyre pikëpamjeve që, të vendosura qysh më parë, janë bazë e interpretimeve historike, çfare, si rregull, gjenden në botimet shkencore të Shqipërisë dhe që, deshëm s’deshëm, marrin ngjyrosjen sa të pakëndshme aq dhe të padëshirueshme politike*”, f. 1.

Në fjalën e hyrjes të Nënkrjetarit të Akademisë Serbe A. Isaković (shkrimtar i njohur, por që në dijet albanologjike, të studimeve të lashtësisë apo ballkanistike, nuk është shënuar të ketë bërë ndonjë përpjekje sado të vogël) jepeshin më tej shpjegime: “*...është fakt i pamohueshëm se shkencë shqiptare, e ndihmuar për fat të keq dhe nga disa punonjës shkencorë nga Kosova, shpesh i qaset në mënyrë jokritike interpretimit të të dhënave shkencore, duke i paraqitur njëanshëm, duke heshtur disa syresh ndërsa duke i vënë në plan të parë të tjerat, në mënyrë që të gjente arsyetim për aspiratat politike dhe ashpërsimin e raporteve*”, f. 5. Pas tij, u imponua nevoja që “*Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve të delte përballë në mbrojtje të objektivitetit shkencor dhe të akribisë*” (sic!).

Ndryshe nga konferencat e organizuara nga shqiptarët më herët e që kishin qenë kritikuar për anshmëri (sado që në ato kishin marrë pjesë dhe të tjerë), këtu “të tjerët” përjashtoheshin qysh në fillim, ata pikëpamjet e të cilëve viheshin në diskutim – të Shqipërisë, ashtu si ata mbi të cilët binte anatema nga Kosova. Pa dashur të komentoj konkretisht pjesën raportuese të studiuesve në fushat e tyre, as të vë në pah ndryshimet që mund të sillte ndonjëri prej tyre me atë rast në raport me çka kishte shkruar më herët, dhe pa e mohuar mundësinë e lëshimeve për të cilat fliste Isaković në parim, duhet të them qysh tash se ndaj të tillave mangësi nuk është askush imun, ndërsa nevoja për të korrigjuar shkencën e një populli tjetër duke rezervuar qëndrimin e objektivitetit për vete dhe të vërtetat e veta, duke përjashtuar pjesëmarrjen e të tjerëve, të bën të mendosh për shkallën e të qenit ‘kritik’

¹⁰ Autorët ishin studiues të njohur dhe të respektuar në fushat perkatëse: M. Garašanin (arkeolog), F. Papazoglu (historiane e lashtësisë), V. Popović (arkeolog), B. Ferjančić (historian i mesjetës), S. Ćirković (historian). Përfundimet i kishte nxjerrë M. Garašanin.

dhe për shkallën e funksionalizimit të kritikës së atillë (në cilën shkencë idetë qenkan kaq të unifikuara?, a nuk paska brenda studiuesve që veçohen si ‘të Shqipërisë’ apo ‘të Kosovës’ dhe individualitete me ide të ndryshme?).

Në qershor të vitit 2007 po në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve në Beograd, ishte mbajtur një tjetër tryezë multidisiplinare me temën “*Problemet metodologjike të hulumtimit të prejardhjes së shqiptarëve*”, ndërsa materialet u botuan në libër të veçantë, por jo më tek Akademia, po te botuesi *Pešić i sinovi*, në vitin 2007 me titullin: “*Albanci. Lažni Iliri*” (Shqiptarët. Ilirët e rremë), ff. 225. Edhe pse referatin kryesor për këtë tryezë e kishte mbajtur një anëtar i Akademisë, filozof i specializuar për metodologjinë e hulumtimit shkencor, politikan i njohur në Partinë Socialiste të Serbisë – M. Marković, as në fjalën e tij as në referatet nuk fshihej zemërimi dhe nevoja për të hedhur poshtë rezultatet e paraqitura në librin e përmendur me mëtesë kritike të po kësaj Akademie – “*Iliri i Albanci*”, sepse e paskan lejuar mundësinë që shqiptarët të shihen si “*autoktonë (starosedeooci) në Ballkan*”. Sa u përket studiuesve shqiptarë, në këtë libër synohet jo më kritika e punës së tyre, po, rrënimi i pikëpamjeve të ‘shkencës shqiptare’, madje pak më shumë, edhe të një pjese të ‘shkencës serbe’. Prizmi i zhvlerësimit ndaj shqiptarëve, jo vetëm ndaj shkencës së tyre, nuk fshihej.¹¹ Dua të besoj, më në fund, se do të jetë pikërisht kjo transparencë e negativiteti të skajshëm, huqja e kriterëve minimale profesionale-shkencore që hetohet gjithandej në shkrimet e këtij libri, që për bazë ka përrallat për ardhjen e shqiptarëve nga Kaukazi, ndërsa synim dëshmimin që në hapësirat e Ballkanit Qendror, sidomos këndeje Drinit, ata paskan ardhur vonë me pushtimin osman dhe si të dhunshëm, pra duke shpërfaqur hapur ideologemat mbisunduese në këto kohë, do të kenë bërë që libri megjithatë të mos shihej i botueshëm në seritë e Akademisë, ku ishte mbajtur tryeza.

¹¹ Për të përligjur kritikën e këtyllë, Marković bënte të veten vërejtjen e M. Radovanović lidhur me studiuesit e ‘indoktrinuar’ nga Kosova, prej të cilëve dalloka H. Kaleshi: “*Do theksuar se edhe një historian i ndershëm shqiptar nga Kosova Hasan Kaleshi qysh në vitet ‘70 të shekullit të kaluar iu kishte kundërvënë falsifikimeve të këntilla të kolegëve të tij, historianë dhe gjeografë nga Universiteti i Prishtinës dhe nga ish Akademia e shkencave e Kosovës*”, f. 11. Ndërsa, në f. 60 libri “*Iliri i Albanci*” vlerësohej kështu: “...për serbët dhe shkencën objektive ky libër [është] krejtësisht dhe vetëm i lig”.

*

Konferenca jonë nuk hyn në radhën e konferencave të drejtuara nga një qëllim i paraformuar përtej diskutimit shkencor. Synimi i vetëm është t'u japim mundësinë studiuesve të interesuar nga vende, mjedise e me pikëpamje të ndryshme ta thonë mendimin e tyre lidhur me çështjet që ata kanë zgjedhur në këto studime të zhvilluara brenda një hapësire gjuhësore, konkretisht gjermanishtfolëse të përzgjedhur kështu vetëm për arsye praktike. Kuptohet që vështrimi kritik në kuptimin e mirëfilltë të fjalës është gjithnjë i dëshirueshëm, ndërsa informimi sa më i plotë dhe autentik për t'u përshëndetur. Siç thoshte gjuhëtari S. Riza në diskutimet në Prishtinë në vitet e hershme '50 të sh. 20, *do ndigjue edhe kritika e kritikës së kritikueme*. Besojmë se kështu diskutimet mund të bëhen të frytshme brenda konferencës e më vonë.

Studimet albanistike tashmë po shkojnë te shekulli i tretë dhe jo vetëm se janë zhvilluar në hapësira të ndryshme, nga institucione e studiues me synime, formime e mundësi po ashtu diverse, po edhe kanë zhvilluar procedura, aparatura konceptuale, njohje, që sigurojnë mekanizma të kritikës dhe të valorizimit, pavarësisht se ku zhvillohen.

Fillet e studimeve albanistike në botën gjermanishtfolëse janë të hershme. Interesimet e dijetarëve nga bota gjermanike për botën shqiptare në të vërtetë nisin me letrat e dijetarit të famshëm G. W. Leibnitz të vitit 1709, i cili, siç kanë treguar studiuesit, së voni N. Reiter (Reiter, N.1980, 82,8), E. P. Hamp (Hamp, E. P.1981, 35), B. Demiraj (Demiraj, B. 2000, f. 359-371; Demiraj, B., 2005, f. 13-31), më herët botën shqiptare e kishte vendosur brenda botës sllave dhe vetëm më vonë, pasi kishte njohur dhe *Fjalorin* e F. Bardhit (1635), doli te teza për lidhjet e popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe me ilirët e ilirishten. Në vijim interesimet për gjuhën e botën shqiptare në opinionin shkencor e kulturor gjermanishtfolës sa vinin e rriteshin. Në sh. 18 J. Thunmann-i sillte në vëmendjen e opinionit gjermanishtfolës dhe të dijes në përgjithësi problematikën shqiptare, kryesisht nga aspekti historik, ndërsa aktualizime më konkrete gjuhësore do të kemi me botimin e J. von Xylander-it (1835) *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren* (Hetzer, A. 1985, ff. 181-217). Në kuadër të studimeve krahasuese indoeuropiane me F. Bopp-in (Fiedler 2006, f. 15-16. Pedersen 1931, f. 71), A. Schleicher-in (Ismajli 2015: 28-29; Fiedler 2006: 17), G. Stier-in (Fiedler

2006, Pedersen 1931: 71), G. Curtius-in (Fiedler 2006), J. Schmidt-in (Ismajli 2015: 30; Fiedler 2006: 19-20), e të tjerë, do të hidheshin themelet e konceptimit teorik të dijes krahasuese-historike për gjuhën shqipe, çka pothuajse në të njëjtën kohë u ndoq nga arbëreshi Dh. Kamarda (Ismajli 2015: 30; Fiedler 2006: 18), pa marrë parasysh se bazat njohëse të materialeve konkrete të gjuhës së gjallë ishin ende të mangëta dhe shpesh jo mirë të zotëruara. Interesi për historinë e gjuhës dhe për lidhjet e saj me gjuhët indoeuropiane në botën gjermanishtfolëse të shekullit historicist ishte në rritje. Qendrore në kërkimin e atëhershme shkencore delte çështja e vendit që zinte shqipja brenda gjuhëve indoeuropiane, ndërsa zhvillimet më të gjera shtriheshin në fushën e etimologjisë. Por pati paralelisht me këto zhvillime interesime dhe për raportet e shqipes me gjuhët e Ballkanit, J. Kopitar, F. Miklosich, R. Helbig, W. Meyer-Lübke, A. Thumb, ndërsa bazat e vërteta të një kompendiumi për studimet shqiptare do t'i sillte diplomati austriak Jochan Georg von Hahn me veprën e tij *Albanesische Studien*, i cili hodhi hapat e parë të një dijeje të integruar historiko-kulturore-gjuhësore të njohur si albanologji. Në frymën e përgjithshme të kohës, të mburrur nga romantizmi e historicizmi, me impaktin doktrinar të komparativizmit e të junggramatikanëve, vepra e tij do të sillte begatinë e madhe të njohjeve për gjuhën, për kulturën dhe për realitetet shoqërore, për historinë shqiptare në përgjithësi.¹² Shpesh kjo vepër mbetet edhe sot e pakapërcyer dhe nevojshet e konsultueshme. Hahn-i, ashtu si Leibnitz-i, Kopitar-i, Thunmann-i, Miklosich-i, në punën e tij do të ketë një komunikim të dendur me shqiptarë të interesuar, sidomos me Konstandin Kristoforidhin e shquar për dijet dhe talentin e tij. Krahas interesimit në rritje të epokës komparatiste, si p. sh. K. Brugmann,¹³ W. Meyer-Lübke, etj. do të jetë së-

¹² Përkthimi shqip: **Studime shqiptare**, nga gjermanishtja V. Dashi dhe A. Koçi, Instituti i dialogut & komunikimit, Tiranë.

¹³ Shih Brugmann, K.: **Vergleichende Grammatik. Bd. I**, 1, f. 10, shih dhe Fiedler 2006, f. 24: "Das Albanesische..., die Sprache des alten Illyriens, mit der das durch Inschriften vertretene Messapische nahe verwandt zu sein scheint, kennen wir durch einigermaßen umfängliche Denkmäler erst seit dem 17. Jahrh. Die Sprache ist dermassen von Entlehnungen aus dem Romanischen, Slawischen, Türkischen und neugriechischen durchsetzt, dass sich von über 5000 Wörtern nur etwa 400 als echt einheimisch erweisen". [*Shqipja... gjuha e Ilirisë së lashtë, me të cilën duhet të jetë e afërt mesapishja e dëshmuar përmes mbishkrimeve, e njohim në njëfarë mase përmes dokumenteve vetëm nga*

rish komparatisti fillimisht greacist austriak G. Meyer ai që në dy dekadat e fundit të sh. XIX do të zhytet thellë në studimet shqiptare me synimin që të sillte një pamje të një rrafshi më të rritur në dijet për gjuhën, por dhe për kulturën shqiptare (Pedersen 1931, f. 71-72; Fiedler 2006: 20-21). Me gramatikën historike, me fjalorin etimologjik, me shqyrtimet e gjera për vendin e shqipes në suaza të gjuhëve indoeuropiane, ai do të shënonte një shkallë të lartë emancipimi të kësaj dijeje, e cila, përnga cilësia dhe si kritikë e pandërmjetme e disa prej tezave themelore të tij, do të çohet më tej nga komparatisti i madh danez H. Pedersen, gjithnjë në hapësirën gjermanishtfolëse. Të gjithë këta, si të tjerë më vonë, i jepnin rëndësi të madhe komunikimit me botën shqiptare, si burim i domosdoshëm për depërtimet e tyre me mbështetje më të madhe teorike. Shekulli 20 do të sjellë depërtime të reja në hapësirat gjermanishtfolëse, sa u përket njohjeve për gjuhën dhe për kulturën shqiptare, ndryshe nga shkrimet folklorizante të K. May-it. Interesimet e Austrohungarisë, të Habsburgëve e të institucioneve austriake, krahas zhvillimeve brenda gjuhësisë krahasuese, ku shqipja dukej intriguese, në vijën e Hahn-it, Meyer-it etj., sollën nivel të ri preokupimi, jo vetëm krahasues, po edhe për çështje krejt reale të botës shqiptare, si çështja e alfabetit të përbashkët, e botimit të librave shkollorë, e krijimit të një gjuhe të përbashkët letrare, e organizimit të lëvizjes kombëtare, etj.

Në këto rrjedha të përgjithshme dhe si vijim i interesimeve të intensifikuara krahasuese-historike roli i N. Jokl-it në pjesën e parë të sh. XX do të jetë themelor për këto studime, për fatin e tyre në botën gjermanishtfolëse, apo edhe në studimet e përgjithshme shqiptare (për bibliografinë dhe veprën e N. Joklit: Kotri, P. 2003, ff. 191). Kuptohet që tanimë komunikimet me botën shqiptare sa vijnë e rriten, qoftë në Vjenë e qendrat e tjera, qoftë me brezin në vijim brenda botës shqiptare gjithnjë e më të ndjeshme

sh. 17. *Gjuha është përmbytur nga huazimet nga gjuhët romane, sllave, turke, greke të reja, saqë nga rreth 5000 fjalë vetëm nja 400 dëshmohen si vërtet vendëse*]. Kuptohet që këtu referohet G. Meyer me *Fjalorin etimologjik*, për të cilin ka pasur kritika nga anë të ndryshme sa u përket burimeve që kishte pasur ai në dispozicion, po edhe animet për ta mbiçmuar shkallën e ndikimit roman, për çka u kritikua menjëherë nga H. Pedersen-i. Çabej e vlerësonte ndihmesën e Meyer-it në shumë aspekte, por kishte dhe vërejtjet e tij për çështje të ndryshme. Në vitet '50 Çabej qe kritikuar për qëndrimet 'benevolente' ndaj dijetarëve 'borgjezë të huaj'. Kritika për rezultatet e Meyer-it kishin pasur dhe të tjerë.

dhe thelbësore. Me krijimin e shtetit shqiptar po vinte dhe brezi i studiuesve që kishin marrë formim në mjedise të tjera, si Itali, Greqi, Turqi, Austri, Rumani, etj., ndërkohë që po shquhej gjithnjë e më shumë grupi me formim nga Vjena (Pekmezi, Çabej, Buda, etj.). Ideja e Jokl-it e shprehur më 1917 se në suaza të studimeve shkencore krahasimtare indoeuropiane shqipja kishte mbetur bijë jetime shpreh gjithsesi një të vërtetë, në shkallën që atë e kishte rimarrë E. Hamp më 1966, ndërsa e përsëriste në njëfarë mënyre dhe W. Fiedler më 2006, duke na kujtuar se në veprat me qarkullim të gjerë për gjuhësinë indoeuropiane shqipes i rezervohej një vend fare modest. Se mund të ketë ndonjë lëvizje për më mirë mund të shihen veprat si ajo e B. W. Fortson IV: *Indo-European Language and Culture*, 2004, apo J. P. Mallory: *Indo-Europeans. Language, Archaeology and Myth*, 1989, etj. Kuptohet që edhe kjo konferencë do të tregojë se dijet e zhvilluara në gjuhën gjermane në këto fusha kanë ecur më tej.

Në traditën gjermanishtfolëse gjatë kësaj kohe do të nyjëtoheshin sërish tezat për origjinën e hershme të shqipes e të shqiptarëve, për veçantinë e gjuhës shqipe në kuadër të gjuhëve IE, për lidhjet e saj me gjuhët e lashtësisë – për prejardhjen nga ilirishtja qysh nga Leibnitz e Thunmann, pastaj për ndërlidhjet me konceptin për grupin pellazgjik të Schleicher-Camarda, sërish për prejardhjen ilire të Meyer, Pedersen, për prejardhjen trakase të H. Hirt e pastaj G. Weigand (Weigand, 1927, ff. 227-251), sërish me prejardhjen ilire, por me hamendje lidhur me aportin trakas të N. Jokl, e të gjitha nuancimet midis këtyre dy vijave deri në ditët e sotme; më vonë kemi sërish një rikthim të theksimi i raporteve eventuale të shqipes me trakishten, ta zëmë të G. Schramm, apo vetëm vënien në dyshim të prejardhjes ilire të shqipes, duke sugjeruar mundësinë e të qenit të saj më vete qysh në lashtësi, por jo gjithnjë në hapësirat ku njihet historikisht (Matzinger), apo, pas ritheksimit të raporteve të lashta me armenishten e greqishten, drejt konceptimit të “Balkanindogermanisch” (G. Klingenschmitt, etj.). Të gjitha janë ndjekur me veprimtari hulumtuese për gjuhët e lashta të Ballkanit (Katičić 1976; Neroznak 1978; Demiraj, Sh. 1988, 2017; Ismajli 2015; për pellazgjishten shih Hahn 1854; Hüttenbach 1960; Demiraj, Sh. 2017; Pellegriani 1995; Budimir 1950; van Windekens 1952; Jordanov 2010), sidomos në fushën e botimit të materialeve që mund të mblidheshin për ilirishten (Mayer 1957, 1959; Krahe 1925; Krahe 1929, Krahe 1955), për tra-

kishten (Detshev 1957), për mesapishten (De Simone 1995; Matzinger 2005; Hamp 2007), për frigjishten (shih Neroznak 1978), çka paraqet tashmë një korpus me rëndësi. Sa i përket pellazgjishtes, ka pasur diskutime jo të pakta, sidomos te S. Konda (1965), V. Georgiev, etj. Sot ka diskutim, por jo dhe aq në suaza të disiplinës rigorozë filologjike.

Sado që afërsisht në këtë kohë diplomati dhe dijetari i shquar austriak G. von Hahn sillte një perspektivë më të gjerë si kuadër për studimet shqiptare, duke përfshirë aspektet historike, etnologjike, gjuhësore e të tjera, në studimet për gjuhën shqipe do të vazhdonte përqëndrimi parësor te vështrimi krahasues-historik. Në këtë aspekt shquhen arritjet kulminante me G. Meyer-in në fund të shekullit XIX, për ta çuar tërë problematikën në një nivel edhe më të lartë me N. Jokl-in në pjesën e parë të sh. 20. Krahas me këto, po në gjuhën gjermane shquhen aportet e nordikëve, sidomos të H. Pedersen-it, S. Bugge-s etj. deri te G. Svane.

Es ist natürlich sehr gewagt, gegenwärtig Prognosen darüber abzugeben, wann Albanien und Kosova Mitglieder der EU werden. Sicher ist nur, dass sie es werden müssen, wenn der europäische Gedanke eine Zukunft haben soll. Denn es ist unvorstellbar, dass beide Länder vom europäischen Integrationsprozess ausgeschlossen werden können. Die gemeinsame Geschichte, Kultur und gleichfalls die Geographie sprechen dagegen. Damit wird aber auch die albanische Sprache in Zukunft international sicher eine neue, bedeutendere Rolle spielen. Nach dem Beitritt beider Staaten zur EU wird sie automatisch zur EU-Amtssprache, d.h. der Sprachendienst der EU-Behörden muss wiederum um mindestens eine Sprache erweitert werden, damit alle amtlichen Texte ins und aus dem Albanischen übersetzt werden können. Denn es gehört zum Europäischen Gedanken, der vertraglich festgeschrieben ist, dass alle offiziellen Amtssprachen, von denen es zurzeit 24 gibt, gleichberechtigt sind. Obwohl es noch nicht soweit ist und das Datum der Aufnahme in den Sternen liegt, ergeben sich schon jetzt konkrete Herausforderungen für die Albanologie.

Bisher war die Albanologie, insbesondere im deutschsprachigen Raum von der indogermanistischen Tradition beherrscht. Das erkennt man schon daran, dass das Fach Albanisch und der Sprachunterricht in der Regel in den Instituten für Indogermanistik angesiedelt wurden. Die Bedeutung der albanischen Sprache für die indogermanische Komparatistik und die Sprachgeschichte ist früh erkannt worden, und für ihre Erforschung wurde viel geleistet, und wird weiterhin viel geleistet. Ich erinnere in diesem Zusammenhang nur an die jüngsten monumentalen Arbeiten zu den sekundären Wortbildungsmustern bei Buzuku von Joachim Matzinger (2016) sowie von ihm und Stefan Schumacher (Matzinger-Schumacher 2013) zu den Verbformen im Altalbanischen. Besonders die deutschsprachige Forschung hat in der Sprachwissenschaft lange Zeit eine Vorreiterrolle gespielt und kennt viele große Namen wie Thunmann, von Xylan-

der, Kopitar, Schleicher, Bopp, Hahn, Miklosich, Weigand, Jokl, Lambertz usw. Inzwischen hat die deutschsprachige Albanologie Konkurrenz bekommen, wobei natürlich der Wissenschaft in Albanien und Kosova besondere Bedeutung zukommt. Beide gemeinsam mit Italien beherbergen heute die führenden Zentren der Albanologie, was vor allem auch den Sprachunterricht betrifft.

In Deutschland ist Albanisch für das breite Publikum weiterhin eine weitgehend unbekannte Sprache und dient vorwiegend als Beispielmaterial für die Indogermanisten. Als ich in den 1960er Jahren bei Martin Camaj in München etwas Albanisch lernte, war es sogar noch eine vollkommen exotische Sprache und wohl nur Balkanologen und Indogermanisten bekannt. Aktuell vollzieht es jedoch den entscheidenden Schritt von einer exotischen zu einer europäischen Sprache im heutigen Europa. Das hat eine politische Dimension und bringt viele praktische Probleme für die Albanologie mit sich.

Eine praktische Frage mit politischer Dimension betrifft die Wahl der zukünftigen Amtssprache und ihrer Norm, die allerdings primär Albaner und Kosovaren unter sich ausmachen müssen. Wird man eine gemeinsame Sprache, d.h. eine überarbeitete Form der Einheitssprache in Albanien entwickelten Einheitssprache, die in jugoslawischer Zeit auch in Kosova eingeführt wurde, oder wird man gar zwei Amtssprachen: Albanisch (Toskisch) und Kosovarisch (Gegisch) vorschlagen? Beide Wege wären, wie wir wissen, prinzipiell erlaubt und politisch möglich. Jedenfalls gibt es Belege für solche gegenläufige Lösungen aus der EU-Praxis. Welcher Weg von ihnen sinnvoll ist, soll hier nicht ausführlich erörtern.

Nach der Einführung des Kroatischen als Amtssprache, mit dem Beitritt Kroatiens 2013 zur EU, zeichnet sich ab, dass auch die Serben nach ihrem Beitritt auf Serbisch, die Montenegriner auf Montenegrinisch, die Bosniaken auf Bosniakisch als weitere Amtssprachen bestehen werden. Ob diese Lösung vom europäischen Geist getragen ist oder aber alte nationale Kleinstaaterie wiederbelebt, will ich ebenfalls nicht weiter kommentieren. Dass es anders geht, zeigt das Beispiel des Deutschen. Die deutsche Schriftsprache wurde von Deutschland, Österreich, Belgien und Luxemburg als gemeinsame Amtssprache vorgeschlagen. In der Aussprache unterscheidet sich das Deutsche in den vier Staaten so stark voneinander, dass eine reibungslose mündliche Verständigung zwischen den Varietäten man-

chmal sehr schwierig ist. Und, obwohl auch die kulturellen, geschichtlichen und konfessionellen Unterschiede erheblich sind, hat man sich zu dieser Lösung durchgerungen, die indirekt von der Schweiz mitgetragen wird. Selbst zu Zeiten des Kalten Kriegs haben in der damaligen Rechtsschreibekommission Vertreter West- und Ostdeutschland gemeinsam teilgenommen. Vor dem Hintergrund der seit einiger Zeit entfachten Diskussion über die albanische Einheitssprache, die vor allem im Exil von Arshi Pipa unterstützt wurde, stellt sich die Frage, welchen Weg Albanien und Kosova wählen werden. Die Entscheidung dieser Frage hat natürlich weitreichende Konsequenzen für den Unterricht "Albanisch als Fremdsprache" (*Gjuha shqipe për të huajt*). Auf diesen Punkt möchte ich nun näher eingehen.

Es gibt bereits eine Reihe von Lehrwerken zum Albanischen, die z. T. speziell für die Diaspora aber auch für Ausländer konzipiert sind. Selbstverständlich waren sie auch mit dem Problem konfrontiert, auf welche Basis: Gegisch oder Toskisch, sie ihre Grammatik stützen sollten. Allerdings waren die frühen Werke für diesen Zweck keine Sprachkurse im eigentlichen Sinn, sondern eher allgemeine Sprachbeschreibungen für Indogermanisten, die ihnen die Eigenart und den Reichtum der albanischen Sprache erschließen sollten. Aber selbst dabei stellte sich schon die Frage nach der Wahl zwischen Gegisch und Toskisch als Beschreibungsgrundlage. Gustav Weigand (1913) fand für seine *Albanesische Grammatik*, die bereits bescheidene Ansätze zu einem Sprachkurs enthält, sicherlich eine salomonische bzw. letztlich sogar vorausschauende Lösung, indem er das Südgegische von Elbasan wählte, das Gegen und Tosken gleichermaßen verständlich ist (S. V).

Für den heutigen Leser irreführend ist übrigens der Titel des nächsten deutschsprachigen Werks, des *Lehrgangs des Albanischen* von Max Lambertz (1954-59), weil er an sich nur eine klassische indogermanistische Beschreibung des Albanischen mit Wörterbuch, Texten und Grammatik bietet. Vom üblichen Schema abweichend ist dabei der Aufbau der Grammatik im 3. Teilband des Werks. Zur Illustration verbindet Lambertz nämlich die Beschreibung der einzelnen Wortarten des Albanischen jeweils mit Textabschnitten aus dem Roman *Rruga e rinisë* von Dhimitër Shuteriqi. Ausführlich werden in der Grammatik, die sich bereits an der im Entstehen begriffenen albanischen Einheitssprache orientiert, natürlich

ebenfalls dialektale Sonderformen erklärt. Daher ist das Werk für Indogermanisten weiterhin interessant, aber für den praktischen Sprachunterricht vollkommen ungeeignet.

Aus dem Griff der Indogermanistik haben sich die Lehrbücher des Albanischen im deutschsprachigen Raum bis heute noch nicht ganz befreit. Immerhin ist Martin Camajs (1969) *Lehrbuch der albanischen Sprache* ein erster Versuch dazu. Er konzipierte sein Lehrwerk für den praktischen Sprachunterricht und ließ dabei seine umfangreichen Lehrerfahrungen aus der Münchener Zeit einfließen. In seiner Darstellung des Albanischen geht er indessen explizit vom Gegischen aus:

Vom Gegischen ausgehend will dieses Lehrbuch den heutigen Zustand einer "normierten" albanischen Sprache in den Hauptlinien darstellen. In den Klammern werden jeweils die toskischen Formen vermerkt, soweit sie sich von den gegischen unterscheiden. (X)

Allerdings befolgt er das Prinzip nicht ganz konsequent, denn wenig später heißt es:

Im Vorjahr ist das Projekt einer einheitlichen Rechtschreibung in Tirana erschienen, an dessen Prinzipien sich auch dieses Lehrbuch hält. Obwohl in dem neuen Projekt Akzent und Nasalvokale nicht bezeichnet werden, werden hier dafür ´ bzw. ^ gebraucht, um die richtige Betonung und Aussprache zu erleichtern" (X).

Die 24 Lektionen des Lehrbuchs beginnen gewöhnlich mit einem Abschnitt zur Grammatik, darauf folgen ein Glossar, Übungen und zum Teil kurze Lesestücke. In der späteren, auf Englisch erschienenen Überarbeitung unter dem Titel *Albanian Grammar* versucht Camaj (1984) ein komplettes Bild des Albanischen, eine Art Synthese aus Gegisch, Toskisch und Arbëresh zu schaffen. Seine Absicht ist es: "to present a complete picture of the language in its three most important variants: Geg, Tosk and Arbëresh" (S. VII). Obwohl die allgemeine Struktur des Lehrbuchs mit Übungen, Chrestomathie und Glossar beibehalten wird und das Werk für Indogermanisten weiterhin interessant bleibt, ist es im praktischen Sprachunterricht kaum noch verwendbar. Denn dafür braucht man vor allem eine allgemein verbindliche Norm, die unterrichtet werden kann und soll.

Bereits vor dem Erscheinen von Camajs Neubearbeitung hat Armin HETZER (1978) sein Lehrwerk *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Schriftsprache: mit einem deutsch-albanischen Wörterbuch* veröffentlicht.

Angeregt wurde er hierzu durch seine Übersetzung des Werkes von Mehdi Bardhi und Rexhep Ismajli (1974) *Teksti i gjuhës shqipe për të huaj* ins Deutsche und dessen Erweiterung um einige Lektionen sowie um ein albanisch-deutsches Glossar. Das zugrundeliegende "Textbuch" war an sich ein Sprachkurs mit einem separaten Grammatikteil sowie einem albanisch-französischen Wörterbuch und wurde für die Sommerkurse in Prishtina verwendet. Die deutsche Übersetzung und Bearbeitung von Hetzer (1977) blieb letztlich nur ein Provisorium und fand zudem eine geringe Verbreitung. Deshalb entschloss er sich zur kompletten Neufassung des Lehrbuchs, die bereits 1978 erschien. Die Dreiteilung des Lehrbuchs aus Prishtina behielt er bei und fühlte sich dazu sogar noch durch die entsprechende Einteilung von Lambertz bestärkt.

Der 1. Teil des *Lehrbuchs* von Hetzer hat 20 Lektionen und umfasst eine *Einführung, Lesestücke, Wörterverzeichnisse, Erklärungen zu den Lesestücken und Aufgaben*, der 2. Teil dann die *systematische Grammatik* und einen *sprachgeschichtlichen Anhang* und der 3. Teil die *Übersetzungen der Lesestücke, ein deutsch-albanisches Wörterbuch, Register* sowie die *Bibliographie*. Schon am Aufbau erkennt man, dass es sich hier um eine Art Enzyklopädie zur albanischen Sprache mit integriertem Sprachkurs handelt, wobei das Wörterbuch nach dem Erscheinen des Werks von Buchholz-Fiedler (1977) obsolet wurde. Dass der enzyklopädische Charakter des Lehrbuchs mit der Verwendung als praktisches Sprachlehrwerk kollidiert ist dem Autor wohl nicht entgangen, denn er stellt im Vorwort fest:

Wer sich ausschließlich mit der albanischen Sprache der Gegenwart befassen will, dem sei empfohlen, die Hinweise zur Landeskunde und Sprachgeschichte einfach unberücksichtigt zu lassen. Dies betrifft in ähnlicher Weise die Abschnitte II und IV der Einleitung, die man, um unnötige Verwirrung zu vermeiden, am besten erst im fortgeschrittenen Stadium durcharbeiten sollte. (7)

Inzwischen hat das Lehrbuch mehrere Auflagen und einige grundlegende Überarbeitungen erfahren. Es gab zahlreiche didaktische Verbesserungen und die Sprachpraxis wurde stärker akzentuiert, dazu gehört auch die Ausstattung mit CDs. Gleichzeitig traten der einst enzyklopädische Charakter und die Orientierung auf die Indogermanistik zurück. Als Zielgruppe werden in der Werbung zur 6. Auflage von 2007 die Anfänger im Unterricht oder Selbststudium genannt. Erreicht werden sollen mündliche

und schriftliche Kompetenz für Alltag, Reise und Beruf sowie landeskundliche Kenntnisse. Der landeskundliche Aspekt ist also weiterhin sehr stark, was sicherlich kein Nachteil ist, da die Kenntnisse über Albanien und Kosovo immer noch sehr begrenzt sind. Die mittlerweile 25 Lektionen sind systematisch in folgende fünf Lernschritte gegliedert: Praktische Redewendungen – Neuer Wortschatz – Lesestücke – Grammatik – Übungen.

Dem Lehrbuch von Hetzer-Finger (1989) traten inzwischen zwei weitere, von Albanern für das deutsche Publikum verfasste Lehrwerke zur Seite, die fast zeitgleich in Elbasan und in Wiesbaden erschienen. Aus Elbasan stammt das Lehrbuch *Albanisch als Fremdsprache, Shqipja si gjuhë e huaj* mit einer CD von Emine Teichmann (2006), eine Ausgabe der Fakultät für Geisteswissenschaften (Fakulteti i Shkencave Humane). Die Autorin hat in Tirana studiert, wurde dort 1992 promoviert und habilitierte sich 2002. Seit 2001 ist sie auch Dozentin für Albanisch im Bundessprachenamt in Hürth, das als Bundesoberbehörde im Geschäftsbereich des Bundesministeriums der Verteidigung Dienstleister für den fremdsprachlichen Bedarf der Bundeswehr und anderer staatlicher Institutionen ist. Aus dieser Tätigkeit erwuchs, wie schon der Titel *Albanisch als Fremdsprache* zeigt, ein eindeutig auf den praktischen Sprachunterricht ausgerichtetes Lehrwerk. Es umfasst insgesamt 18 Lektionen, die jeweils unter ein bestimmtes Thema gestellt sind. (Lektion 11 behandelt z.B. "Essen und Trinken".) Die jeweilige Lektion besteht aus den entsprechenden Texten, Dialogen, dem Grammatikteil sowie Übungen und Aufgaben. Dieses noch mit etlichen technischen Mängeln behaftete Lehrbuch liegt mittlerweile in überarbeiteter und korrigierter Form vor und wurde in Oberhausen herausgegeben (Teichmann-Sadiku 2016). Es ist jetzt in Deutschland leichter zugänglich. Nach Angaben des Verlags ist es *für Sprachschüler ohne Vorkenntnisse geschrieben und auch für Wiedereinsteiger geeignet. Außerdem soll es allen Interessierten eine Einführung in die albanische Sprache geben... Dieses Lehrwerk vermittelt alle wichtigen Strukturen der Sprache und die Vokabeln, die ein Schüler braucht, um sich über verschiedene Themen unterhalten zu können.* Die klare Praxisorientierung zeigt sich vor allem darin, dass der kommunikative Aspekt, also Verstehen und Sprechen, einen deutlichen Vorrang haben.

Ein Jahr später veröffentlichte Pandeli Pani (2007), der u.a. ebenfalls im Bundessprachenamt in Hürth tätig war, sein Lehrbuch *Albanisch*

intensiv. Lehr- und Grammatikbuch mit einer CD der Texte und Dialoge im MP3-Format. Von ihm liegt inzwischen eine 2., durchgesehene Auflage vor (Pani 2009). Der Autor orientiert sich ebenfalls an den Arbeitsprinzipien des Bundessprachenamts, das für die Durchführung der Sprachkurse selbstredend ein praktisches Lehrbuch ohne Exkurse in die Sprachgeschichte oder Indogermanistik braucht. Auch hier steht *Albanisch als Fremdsprache* im Mittelpunkt. Das Lehrwerk umfasst insgesamt 30, weitgehend identisch aufgebaute Lektionen mit den Teilen: Grammatik, Lesestücke und Dialoge sowie Übungen. Dieses in Wiesbaden erschienene Werk ist im Unterschied zu dem aus Elbasan sehr sorgfältig editorisch betreut worden. Denn der Harrassowitz-Verlag ist ein wissenschaftlicher Verlag mit langer Tradition und mit einem umfangreichen Angebot an Albanica, darunter u.a. die Lehrbücher Camajs, das große *Deutsch-Albanische Wörterbuch* von Dhrimo und Hamlet Bezhani (1996) oder die Reihe *Albanische Forschungen*.

Nach der politischen Wende Anfang der 1990er Jahre ist das Interesse am Albanischen bei uns gewachsen, und es gibt mittlerweile sogar etliche Sprachführer und Crashkurse (Jaenicke 2007, Koeth-Drude 2009). Von ihnen verdient das Werk *Einstieg Albanisch für Kurzentschlossene* von Jusufi-Ströhle (2012) aus dem Hueber-Verlag eine besondere Erwähnung, weil es immerhin in einem Fachverlag für Sprachlehrwerke erschien. Dieser Selbstlernkurs vermittelt Anfängern in 20 Lektionen neben grundlegenden Sprachstrukturen auch viel Interessantes über Land, Leute und Kultur. Obwohl der Kurs zur Stufe A1 führen soll, ist das Material sehr begrenzt (<http://www.hueber.de/einstieg>).

Natürlich muss es primär im albanischen Interesse liegen, dass der Sektor *Albanisch als Fremdsprache* ausgebaut und verbessert wird. Dazu gibt es fraglos etliche wichtige Ansätze, die noch kurz erwähnt werden sollen. Hier ist zunächst das 1975 bis 1981 in Tirana erschienene, dreibändige Werk *Gjuha Shqipe* von Radovicka-Karapici-Toma (1975-1981) zu nennen. Es richtet sich zwar in erster Linie an die albanische Diaspora, der man auf diesem Weg die neue albanische Einheitssprache näherbringen wollte, konnte aber ebenfalls von anderen Interessenten benutzt werden. In Kosova erschien zu dieser Zeit die bereits erwähnte Broschüre *Teksti i gjuhës shqipe për të huaj* von Bardhi-Ismajli (1974), die sich primär an Ausländer richtete. Mittlerweile ist das Angebot erheblich gewachsen,

wobei die Qualität nicht immer überzeugt. Zu den seriösen Werken gehört zweifellos das in Tirana erschienene Lehrbuch *Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut* von Hysa-Shkurtaç (2001). Auch im Internet ist Albanisch inzwischen mit Wörterbüchern und Übersetzungshilfen (<http://www.fjalor.de>, <http://www.fjalori.shkenca.org/>) usw. präsent.

Fraglos reichen die vorhandenen Lehrwerke und Materialien für das Albanische, trotz erheblicher Verbesserungen in den letzten Jahren, nicht mehr aus, um seiner neuen Rolle in Europa gerecht zu werden. In den Vordergrund rückte nämlich inzwischen der Erwerb kommunikativer Kompetenzen im Albanischen, d.h. der aktive mündliche und schriftliche Gebrauch der Sprache, "um sich über verschiedene Themen unterhalten zu können" (Teichmann 2006: 3). Die konkreten Lernziele haben sich also verschoben von der Unterrichtung der Indogermanisten und Balkanologen zu Sprachschülern ohne Vorkenntnisse. Um sie zu erreichen, sind vor allem in drei Bereichen Verbesserungen anzustreben, und zwar 1. bei der Normierung der Sprache, 2. in der Methodik und 3. in der Didaktik des Albanischen.

Die Festlegung einer verbindlichen Norm für den Fremdsprachenunterricht ist natürlich primär die Aufgabe der Albaner. Sicherlich kann diese Norm nicht die Vielfalt der Sprache widerspiegeln, sondern sie muss nur alle notwendigen Kenntnisse der Standardsprache vermitteln, um ein Gespräch des Ausländers mit jedem gebildeten Albaner ermöglichen, der die Einheitssprache in der Schule gelernt hat. Die dialektale Vielfalt des Albanischen ist nicht Gegenstand des normalen Fremdsprachenunterrichts. – Auch Ausländer, die Hochdeutsch gelernt haben, sind zunächst entsetzt, wenn sie in Wien, Berlin, Bern oder München ankommen. Sie werden aber gewöhnlich verstanden, und man versucht, ihnen sprachlich in der Hochsprache entgegenzukommen. – Natürlich müssen vor allem Sprachmethodiker und Sprachdidaktiker den effektiven Sprachunterricht mitgestalten. Dazu gehört auch die systematische Zusammenarbeit zwischen Albanologen und Germanisten, um adäquate Lehrwerke für das Sprachenpaar Albanisch-Deutsch herzustellen. Ein schwieriges Kapitel bleibt indessen die Vermarktung der Produkte, da die großen Verlage vor der Aufnahme kleinerer und damit weniger lukrativer Sprachen in ihrem Programm zurückschrecken. Es liegt noch ein weites Feld vor uns, um die albanische Sprache für die zukünftige Rolle in der EU fit zu machen.

BIBLIOGRAFI

- BARDHI, Mehdi - ISMAJLI, Rexhep: *Teksti i gjuhës shqipe për të huaj* = (Cours de langue albanaise). Prishtina 1976.
- BUCHHOLZ, Oda - FIEDLER, Wilfried - UHLISCH, Gerda: *Wörterbuch Albanisch- Deutsch*. Leipzig 1977. – Überarbeitete Neuauflage: BUCHHOLZ, Oda - FIEDLER, Wilfried - UHLISCH, Gerda - KLOSI Adrian: *Handwörterbuch Albanisch*. München 2000.
- BUCHHOLZ, Oda - FIEDLER, Wilfried: *Albanische Grammatik*. Leipzig 1987.
- CAMAJ, Martin: *Lehrbuch der albanischen Sprache*. Wiesbaden 1969.
- CAMAJ, Martin: *Albanian grammar: with exercises, chrestomathy and glossaries*. Wiesbaden 1984.
- CAMAJ, Martin: *Lehrbuch der albanischen Sprache*. Wiesbaden 1991.
- DHRIMO, Ali - BEZHANI, Hamlet: *Deutsch-albanisches Wörterbuch*. Wiesbaden. 1996.
Teil: Bd. 1., A – M.
Teil: Bd. 2., N – Z.
- HETZER, Armin: *Modernes Albanisch im Selbststudium* (= Teksti i gjuhës shqipe për të huaj = Cours de langue albanaise von Mehdi BARDHI, Rexhep ISMAJLI.) Dt. bearb. Bremen 1977.
- HETZER, Armin: *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Schriftsprache*: mit e. dt.-alban. Wörterbuch. Hamburg 1978. - 2., unveränd. Aufl. 1987.
- HETZER, Armin - FINGER, Zuzana: *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Schriftsprache* - mit Kompaktkassetten. Hamburg 1989.
- JAENICKE, Christiane und Axel: *Albanisch Wort für Wort*. Bielefeld 2007.
- HYSA, Enver - SHKURTAJ, Gjovalin: *Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut*. Tirana 2001.
- JUSUFI, Lumni - STRÖHLE, Isabel: *Einstieg Albanisch für Kurzentschlossene*. Ismaning 2012.
- KOETH, Wolfgang - DRUDE, Saskia: *Kosovo-Albanisch Wort für Wort*. Bielefeld 2009.
- LAMBERTZ, Max. *Lehrgang des Albanischen*. Berlin.
- Teil 1. *Albanisch-Deutsches Wörterbuch*. Berlin 1954.
- Teil 2. *Albanische Chrestomathie*. Berlin 1955.
- Teil 3. *Grammatik der albanischen Sprache*. Halle a. Saale 1959.
- MATZINGER, Joachim: *Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku*: ein Beitrag zur altalbanischen Lexikographie. Wiesbaden 2016.
- MATZINGER, Joachim - SCHUMACHER, Stefan: *Die Verben des Altalbanischen*: Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie. Wiesbaden 2013.
- PANI, Pandeli: *Albanisch intensiv. Lehr- und Grammatikbuch* mit einer CD der Texte und Dialoge im MP3-Format. Wiesbaden 2007. - 2. durchges. Auflage. Wiesbaden 2009.
- RADOVICKA, Lumni - KARAPICI, Zana - TOMA, Ana: *Gjuha Shqipe*. 3 Bände. Tirana 1975, 1978, 1981.
- TEICHMANN, Emine: *Albanisch als Fremdsprache, Shqipja si gjuhë e huaj*. Elbasan 2006.
- TEICHMANN, Emine - SADIKU, Gladiola: *Albanisch - Lehr- und Arbeitsbuch*. Oberhausen 2016.
- WEIGAND, Gustav: *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*. Leipzig 1913.
- Internetquellen (29.12.2017)
<http://www.fjalori.shkenca.org/>
<http://www.fjalor.de/>
<http://www.weltreisewortschatz.de/albanisch/>

SHKENCËTARËT GJERMANË PËR ETIMOLOGJINË E SHQIPES

Çdo gjuhëtar që merret me etimologjinë e shqipes e ka për detyrë të studiojë kontributin e të gjithë albanologëve në këtë fushë, ku vendin e nderit e zë gjuhësia gjermane, e cila përfshin jo vetëm kontributet e shkencëtarëve gjermanë e austriakë, por edhe ato të disa gjuhëtarëve me kombësi të tjera, që punuan në rrymën e kësaj gjuhësie, duke dhënë kontributin e tyre shkencor nëpër universitetet e Gjermanisë e të Austrisë e duke botuar veprat e tyre gjermanisht. Roli parësor i gjuhësisë gjermane për etimologjinë e shqipes dhe në përgjithësi për albanologjinë shpjegohet me vetë pozitën mbizotëruese të shkencës gjuhësore gjermane në Europë në shekujt e kaluar, si edhe me kontributin e dijetarëve gjermanë për themelimin dhe zhvillimin mbi baza shkencore të gjuhësisë krahasuese.

Interesimi i studiuesve gjermanë për gjuhën shqipe ka zanafillë të hershme, atëherë kur gjuhësia krahasuese po bënte hapat e saj të parë dhe shqipja, si një degë e veçantë e familjes indoeuropiane, zgjoi vëmendjen e themeluesve të kësaj shkence. Madje, fusha e etimologjisë është më e rëndësishmja për të përcaktuar lidhjet farefisnore ndërmjet gjuhëve, shkallën e mëvetësisë së saj dhe kontaktet historike me gjuhët e tjera, me të cilat është ndeshur.

I pari që drejtoi vëmendjen në gjuhën shqipe ishte filozofi gjerman *Gottfried Leibnitz*, kryetar i Akademisë së Shkencave gjermane, i cili në letërkëmbimet e tij vuri në dukje disa përkime e analogji të fjalëve të shqipes me latinishten dhe me gjuhët gjermanike, duke nxjerrë konkluzione edhe për origjinën e shqipes.

Ndër dijetarët e tjerë, që nxorën konkluzione për origjinën e shqiptarëve në bazë të të dhënave të etimologjisë, përmendim profesorin e universitetit të Halles, Hans Thunmann, i cili në veprën "*Untersuchungen über*

die Geschichte der östlichen europäischen Völker” shqyrtoi materiale gjuhësore të shqipes, çka i lejoi të arrinte në përfundime të rëndësishme për origjinën e popullit shqiptar dhe vendbanimet e tij.

Në këtë periudhë të parë të studimit të shqipes, disa krahasime etimologjike me vlerë ka bërë studiuesi gjerman Joseph Xylander, i cili më 1835 botoi librin “*Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*”, ku përmes analizave të materialit gjuhësor argumenton karakterin indoeuropian të shqipes.

Kjo fazë e parë e studimit të shqipes mbyllet me punimet e diplomatit austriak Johannes Georg von Hahn, i cili në veprën trevëllimshe “*Albanesische Studien*”, analizoi burimin e shumë emrave të viseve shqiptare, si vazhdim i drejtpërdrejtë i njërit prej dialekteve ilire, duke u bërë kësajsoj mbrojtësi më i vendosur i autoktonisë së shqiptarëve dhe i burimit të gjuhës shqipe prej ilirishtes.

Një periudhë e re nis për albanologjinë dhe për etimologjinë në veçanti, kur profesori i Universitetit të Berlinit, gjuhëtari i shquar gjerman Franz Bopp, mbajti referatin “*Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*”. Në këtë vepër themelvënëse për historinë e gjuhës shqipe, me një analizë të strukturës gramatikore, si edhe me shqyrtimin e burimit të shumë fjalëve, ky dijetar argumentoi përfundimisht karakterin indoeuropian të shqipes dhe vendin e saj të veçantë ndërmjet gjuhëve të kësaj familjeje.

Pas Boppit, emra të tjerë studiuesish gjermanë i shtohen historisë së shqipes, si: August Schleicher e Johannes Schmidt, që u morën me vështrimin gjenealogjik të gjuhëve dhe afëritë ndërmjet tyre; Jakob Fallmerayer, i cili me veprën “*Das albanesische Element in Griechenland*” argumentoi autoktoninë e shqiptarëve mbi bazën e analizave të materialit historik e gjuhësor; Teodor Mommsen, i cili në veprën “*Unteritalische Dialekt*” shqyrtoi afërinë gjuhësore të fisit ilir të mesapëve me shqiptarët e sotëm; Franc Miklosich, me origjinë sllovene, profesor në universitetin e Vjenës dhe anëtar i Akademisë së Shkencave Vjeneze, i cili në tre vëllime të veprës “*Albanische Forschungen*” shqyrtoi marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera, me të cilat ka pasur kontakte në periudhën historike; Hugo Schuchardt, profesor i Universitetit të Gracit, i cili trajtoi sidomos ndikimet latine-romane të shqipes etj.

Figura qendrore në studimet etimologjike të shqipes për këtë fazë, por edhe për periudhat e mëvonshme, mbetet profesori i Universitetit të Gracit, albanologu më i shquar i kohës së tij, dijetari Gustav Meyer. Ai hartoi një fjalor etimologjik të gjuhës shqipe, që meritoi edhe një çmim ndërkombëtar në Paris. Me këtë vepër Meyeri jo vetëm vuri bazat shkencore të kësaj dege gjuhësore, por edhe shënoi rezultate reale në studimin e shqipes, të cilat e kanë ruajtur vlerën e tyre deri në ditët e sotme, madje shumë më tepër se disa nga pasardhësit e tij.

Pas Meyerit, zhvillimet e mëtejshme të etimologjisë dhe përgjithësisht të shkencave albanologjike janë përcaktuar nga emrat e Pedersenit e Joklit, si edhe të shumë dijetarëve të tjerë.

Holger Pedersen, me origjinë daneze, profesor në Universitetin e Kopenhagës, që kishte studiuar indoeuropianistikë në Leipzig dhe në Berlin, iu kushtua studimit të shqipes krahas gjuhëve të tjera, duke dhënë rezultate pozitive, më shumë cilësore se sasiore. Studiuës i gjithanshëm, por sidomos keltolog e armenolog, ai dha kontribute të vlefshme edhe për etimologjinë e shqipes. Monografia e tij “*Die Gutturale im Albanesischen*”, si edhe një varg artikujsh të tjerë, të botuar në revistën *Kuhner’s Zeitschrift* të Berlinit, mbeten studime të mirëfillta me vlera shkencore të çdo kohe.

Ndryshe nga Pedersen, që u mor për pak kohë me shqipen, Norbert Jokli ia kushtoi tërë jetën studimit të saj. Profesor i Universitetit të Vjenës dhe drejtor i bibliotekës së tij, ai lëvroi shumë fusha të albanologjisë, ndër të cilat spikat fusha e etimologjisë me kontribute shumëënduershe. Monografitë *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung, Linguistisch – kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*, si edhe një shumicë artikujsh, të shpërndarë në shtypin shkencor të kohës, e vënë atë në radhën e parë të albanologëve, që punuan me rreptësi shkencore dhe objektivitet. Është fatkeqësi që dy veprat e tij themelore, “*Fjalori etimologjik*” dhe “*Gramatika historike*”, për të cilat kishte punuar shumë vite me radhë, humbën nëpër kampet naziste bashkë me autorin.

Krahas këtyre gjuhëtarëve, dijetarë të tjerë: indoeuropianistë, heleenistë, latinistë, sllavistë, ballkanistë e turkologë, iu afruan shqipes duke çuar më tej me kontributet e tyre rezultatet e arritura. Ndër emrat e njohur spikasin përsëri ata të shkollës gjermane. George Stier punoi për etimo-

logjinë e emrave të kafshëve; Albert Thumb analizoi huazimet që kanë hyrë nga greqishtja e vjetër; Robert Helbig në një monografi të veçantë trajtoi huazimet italiane e latine; Leo Spitzer hulumtoi marrëdhëniet e shqipes me rumanishten; Karl Treimer vuri në dukje përkimet e shqipes me gjuhët kelte; Maximilian Lambertz, i specializuar në fushën e gjuhësisë krahasuese dhe të filologjisë klasike, studioi dialektet arbëreshe të Italisë me analiza të shumta etimologjike; Hans Jürgen Sasse studioi arbërishten e Greqisë etj.

Me punën e këtyre dijetarëve, si edhe të gjuhëtarëve nga vende të tjera, etimologjia e shqipes bëri hapa të mëdha përpara duke gjetur vendin e vet me një përfaqësim më të madh në të gjithë fjalorët krahasimtarë dhe në gramatikat historike të indoeuropianishtes, të hartuar në shumicën e tyre prej dijetarëve gjermanë. Të tillë janë: dy fjalorët krahasimtarë të gjuhës indoeuropiane, njëri i hartuar nga August Fick dhe tjetri nga Alois Walde e Julius Pokorny; Gramatika krahasuese e gjuhëve indoeuropiane, e hartuar nga Karl Brugmann e Bertolt Delbrück; Fjalori etimologjik i latinishtes, nga Walde-Hofmann; i sllavishtes, nga Erich Berneker; i gjuhëve romane, prej Wilhelm Meyer-Lübkes; i lituanishtes, nga Ernst Fränkel etj. Studimet etimologjike ndihmuan gjithashtu për të çuar përpara edhe hulumtimet në fushë të ilirologjisë për lidhjet ilire-shqiptare, ku një vend nderi zë gjuhëtari gjerman Hans Krahe, indoeuropianist e ilirolog, profesor në universitetet e Würzburgut, Heidelbergut dhe Tübingenit.

Kontributeve të mirëfillta etimologjike u duhen shtuar edhe ato të fushës së leksikologjisë, mbledhjes së fjalëve dhe botimit të fjalorëve, që shërbejnë si bazë materiale për etimologjinë, pa të cilët ajo nuk mund të zhvillohet. Në këtë drejtim, emri i parë historikisht i takon një shtegtari gjerman, Arnold von Harff, i cili u nis nga qyteti i Kölnit dhe kaloi nëpër vendin tonë më 1497, duke mbledhur disa fjalë për nevojat e tij të udhëtimt. Ky është fjalorthi i parë i shqipes, që u botua në vitin 1860. Pas tij, fjalorë më të plotë u botuan atëherë kur u shtua interesimi për gjuhën shqipe, ndër të cilët spikat Fjalori dygjuhësh shqip-gjermanisht dhe anasjelltas i Gustav Weigandit, me kontribute të shumta etimologjike, si edhe Fjalori i baroneshës Maria Amelie von Godin, që dallohet për pasurinë e madhe gjuhësore.

Falë këtyre kontributeve dhe shumë të tjera nga dijetarë të vendeve

të ndryshme, etimologjia e shqipes u ngrit më këmbë si një shkencë e mirfilltë, në të cilën patën mundësi të integrohen edhe kontributet e dijetarëve shqiptarë, që nisin me Dhimitër Kamardën, prej komunitetit arbëresh të Italisë, dhe arrijnë pikën më të lartë me studimet e Eqrem Çabejt, i formuar në shkolla austriake, student i shkëlqyer i Universitetit të Gracit e të Vjenës, dishepull i Norbert Joklit.

Por interesimi i dijetarëve gjermanë për etimologjinë e shqipes nuk ka reshtur as në ditët tona. Breza më të rinj, duke u mbështetur tek ata më të vjetrit, kanë çuar më tej rezultatet e kësaj fushe. Qendrat albanologjike në disa vende të Gjermanisë e Austrisë, sidomos në Berlin e Mynhen, në Vjenë, Grac e Innsbruck, kanë zhvilluar më tej traditat e hershme, të krijuara në universitetet dhe qendrat shkencore të këtyre vendeve. Në fushën e etimologjisë kontributet më të fundit lidhen me emrat e gjuhëtarëve më të rinj, një pjesë e të cilëve vijojnë të jenë aktivë edhe në ditët e sotme. Nga këta spikat emri i gjuhëtarit Wilfried Fiedler, profesor në Universitetin e Berlinit, Münchenit dhe Jenës, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës, shkencëtar me përmasa të gjera dhe interesa të shumanshme, që ka dhënë kontribute të vyera për etimologjinë e shqipes, krahas shumë fushave të tjera ku ka lënë gjurmët e tij. Një gjuhëtar tjetër me gjurmë të shumta në fushë të etimologjisë është Hermann Ölberg, profesor në Universitetin e Innsbruckut, indoeuropianist e albanolog, që ka sqaruar etimologjinë e shumë fjalëve nëpërmjet studimeve të tij për çështje të ndërlikuara të fonetikës historike të shqipes, siç është problemi i laringaleve, i zanoreve hundore etj. Ndër albanologë të tjerë, me kontribute në këtë fushë, vëmë në dukje: Norbert Boretzky ka studiuar burimin e turqizimeve të shqipes duke hartuar edhe një fjalor për to; Harald Haarmann ka hulumtuar huazimet e shqipes me burim prej latinishtes; Armin Hetzer ka trajtuar huazimet që kanë hyrë prej shqipes në arumanishtë; Bernd Janson ka analizuar fjalët me rotacizëm të dialektit toskë; Frederik Kortlandt ka shqyrtuar përkimet shqipe-armene; Jürgen Kristophson është marrë me huazimet romane; Rolf Ködderitzsch ka hulumtuar barazimet kelte-shqiptare; Günter Reichenkron e Ruprecht Rohr kanë studiuar marrëdhëniet e shqipes me rumanishten; Georg Renatus Solta ka analizuar problemet e substratit ballkanik; Gerda Uhlisch ka trajtuar huazimet nga greqishtja etj. Më së fundi, ka një varg gjuhëtarësh, që e kanë studiuar shqipen nga anë të ndryshme, të

cilëve do t'u përmend vetëm emrat: Oda Buchholz, Wolfgang Hock, Johannes Hubschmidt, Eduard Hermann, Gert Klingenschmitt, Johann Knobloch, Ernst Lange-Kowal, Michael Schmidt-Neke, Robert Elsie, Joachim Matzinger, Peter-Arnold Mumm, Bernhard Rosenkranz, Otto Haas, Manfred Erwin Schmidt, Stefan Schumacher, Klaus Steinke, Oskar Wiedemann, Wolfgang Zeitler e shumë të tjerë.

Gjuha shqipe i detyrohet shumë dijetarëve gjermanë për ndriçimin e historisë së saj, në veçanti etimologjisë.

Bardhyl DEMIRAJ, LMU München/BRD

QENDRA ALBANOLOGJIKE NË UNIVERSITETIN “LUDWIG-MAXIMILIAN” TË MUNIHUT – NJË VËSHTRIM PERSPEKTIV

Objekt i kumtesës sonë është dhënë në titullin e saj: Dega e Albanologjisë pranë Universitetit elitar “Ludwig-Maximilian” të Munihut (LMU), e cila përcjell ndërkohë një traditë thujse 60-vjeçare në aktivitetin të saj shkencor-universitar. I mbetemi kështu besnikë tematikës që ngërthen vetë tubimi si i tillë e që synon të marrë në analizë mbarëvajtjen dhe mbarëshkrimin e studimeve albanologjike në hapësirën gjermanishtfolëse. Me sqarimin e bërë si nëntitull: “një vështrim perspektiv” syzozjmë një skicim sado të thukët të kronologjisë së përfimit e të ecurisë së programit të saj universitar, duke u përqendruar më pas sidomos në profilin dhe pozicionin e kësaj dege në arealin albanologjik bashkëkohor, në aktivitetin e saj kërkimor-shkencor dhe botues si edhe në angazhimin social-intelektual, sa i përket organizimit të një numri tubimesh shkencore-kulturore albanologjike, kryesisht syresh me radius gjithëpërfshirës të hapësirës albanologjike në Europë dhe SHBA-të. Në mbyllje i kemi përkushtuar një vend të konsiderueshëm edhe ecurisë perspektive të kësaj dege si pjesë e atij qerthulli problemor që ngërthen formimi universitar dhe kërkimi shkencor albanologjik në kohën tonë.

1. Kronologji e përfimit dhe e aktivitetit të saj universitar

Në rast se lejohemi tash të përshkruajmë me stil telegrafik kronologjinë e përfimit dhe aktivitetin e saj universitar, le të saktësojmë fillimisht që Dega e Albanologjisë në LMU përcjell këtë vit në vazhdim një traditë 57-vjeçare të aktivitetit të saj shkencor dhe universitar, e cila ka kaluar nëpër disa faza me këta titullarë:

A. shtator 1961 – gusht 1990: prof. dr. Martin Camaj (Munih/RFGJ)

- lektor pa pagesë: shtator 1961 deri shtator 1964,

- docent privat me statusin e punonjësit shkencor (H 1): qershor 1965 – maj 1970,
 - profesor jashtë plani: gusht 1971 – shtator 1978,
 - profesor universiteti për albanologji (C3) “nëpunës shteti në marrëdhënie punësimi të përhershme” prej dt. 14 shtator 1978.
- B. prill 1990 – prill 1998: prof. dr. Wilfried Fiedler (Meisen/RFGJ)
- Profesor universiteti për albanologji (C3): “në marrëdhënie punësimi të përkohshme”.
- C. shtator 1998 – gusht 2000: prof. dr. Rexhep Ismajli (Prishtinë/ Kosovë)
- Përfaqësim i profesurës së albanologjisë në LMU me statusin e profesorit honorar.
- D. Prej tetorit të vitit 2000: Prof. dr. Bardhyl Demiraj (Munih/RFGJ)
- tetor 2000 – shkurt 2001: përfaqësim i profesurës së albanologjisë në LMU,
 - mars 2001 - shtator 2002: profesor universiteti për albanologji (C3): “në marrëdhënie punësimi të përkohshme”,
 - prej 1 shtator 2002 profesor ordinar (C3) “nëpunës shteti në marrëdhënie punësimi të përhershme” (ngarkesë mësimore 9 orë në javë).
- Prej muajit tetor 2012 profesura e albanologjisë mbështetet fuqishëm me një lektorat të gjuhës shqipe:
- me një vend lektori me detyra të posaçme (VL E 13 – ngarkesë mësimore: deri në 12 orë në javë), të përfuar nëpërmjet Marrëveshjes Ndërshtetërore (korrik 2012) ndërmjet LMU dhe MAS (Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë – më parë Ministria e Arsimit dhe e Shkencës),
 - mbarëvajtja e punës së lektoratit të gjuhës shqipe mbështetet gjithashtu me një lektor të dytë me kontrata semestrale, të cilat profesura e albanologjisë i mbulon si me resurset e veta ashtu edhe me ato të Qendrës së Studimit të Gjuhëve të Huaja pranë LMU (ngarkesë mësimore: deri në 8 orë mësimore në javë)
 - vend të veçantë në program zenë edhe tutorialet (deri katër orë mësimore në javë) që i mbulojnë studentë që janë në prag të diplomës së masterit.
 - Pjesë e programit universitar janë edhe bllok-seminaret, që realizojnë profesorë dhe docentë të ftuar me një kapacitet mesimor deri në 30 orë për çdo semestër.

2. Profili dhe statusi aktual

Dega e Albanologjisë është pjesë përbërëse e Institutit të Gjuhësisë Krahasuese-Indoeuropiane si edhe të Albanologjisë (Institut für Vergleichende und Historische Sprachwissenschaft sowie Albanologie) në LMU, duke gëzuar kështu statusin institucional të një qendre shkencore-universitare që përgatit, diplomon dhe doktoron si albanologë të rinj ata studentë e studiues që përzgjedhin ndërkohë albanologjinë si fushë kryesore studimi në degët universitare të fuzionuara: Bachelor of Arts “Gjuhësi e Përgjithshme dhe Indoevropiane: Albanologji” (Allgemeine und Indogermanische Sprachwissenschaft: Albanologie) dhe Master of Arts “Filologji Ballkanike” (Balkanphilologie); përkatësisht plotëson formimin universitar dhe pasuniversitar të atyre studentëve dhe doktorantëve që përzgjedhin albanologjinë si fushë kryesore studimi në degën plotësuese “Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë” (Sprache, Literatur und Kultur), të përbashkët për të gjitha degët filologjike në Fakultetin e Shkencave të Gjuhësisë dhe Letërsisë (Fakultät der Sprach- und Literaturwissenschaften; F. 13), ku është përfshirë edhe Dega e Albanologjisë si fushë e veçantë studimi. Ky status aktual i degës është pjesë e ndryshimeve rrënjësore që përjetoi sistemi universitar në RFGJ, ku u implementua në mënyrë ballore, pa marrë parasysh specifikën e shkencave rajonale, “Marrëveshja e Bolonjës” (19.06.1999). Riorganizimi i studimit universitar sipas kësaj marrëveshjeje – që në kushtet e reja të studimit hap sigurisht perspektiva profesionale edhe për studentët që studiojnë albanologji si fushë kryesore studimi – do të kishte sjellë padyshim pasoja të pallogaritshme, madje do të vihej në pikëpyetje deri edhe vetë ekzistenca e kësaj dege, sikur të mos gjenim mbështetje në kohën e duhur nga Republika e Shqipërisë, e cila, siç përmendëm më lart, ndërhyri me sukses për hapjen e vendit të lektorit të shqipes me detyra të posaçme. Kjo mbështetje bëri që të mos cenohet sadopak profili universitar i degës, duke ruajtur si i tillë mëvetësinë e albanologjisë si shkencë rajonale në gjithë atë pjesë të arealit shkencor albanologjik që shtrihet jashtë hapësirës kompakte shqipfolëse në Ballkan.

Dega si e tillë mbulon sot në aktivitetin e vet universitar – me një kapacitet prej 29-31 orësh akademike në javë – realizimin e një programi mësimor prej 12-13 lëndësh universitare në çdo semestër në shtatë fusha, ndër to:

- a) gjuhësi sinkronike e shqipes standarde dhe dialektologji,
- b) filologji dhe histori e gjuhës shqipe,
- c) letërsi shqipe, kulturë popullore dhe antropologji,
- d) albanologji në kuadrin e gjuhësisë krahasuese indoevropiane,
- e) albanologji në kuadrin e studimeve të Evropës Juglindore,
- f) mësim praktik i shqipes standarde në pesë nivele: A1, A2, B1, B2, C1,
- g) filologji ballkanike (ballkanologji)

Mësimi praktik i gjuhës shqipe me kurse intensive në pesë nivele të ndryshme përbën një ndër shtyllat bosht të programit universitar, që shquhet ndërkohë për suksesin e vet falë hapjes së lektoratit të gjuhës shqipe. Fusha e ballkanologjisë, e regjistruar së fundmi (pika g) është rrjedhojë e riorganizimit të degëve universitare në nivelin e dytë Master of Arts në LMU, ku profesurës së albanologjisë i është ngarkuar të organizojë dhe drejtojë të gjithë programin universitar përkatës si degë e nivelit Master of Arts.¹ Kjo situatë e re, e përfutur prej vitit akademik 2012/13 – edhe pse me ngarkesë të madhe shtesë sidomos të karakterit universitar-administrativ – mendohet t'i hapë perspektiva të reja vetë zhvillimit të degës sonë në të ardhmen, pasi pritet të mundësojë jo vetëm një formim solid të studentëve por edhe një rrjetëzim bashkëpunimi efikas me një numër degësh filologjike simotra që veprojnë në nomenklaturën e LMU sikurse janë Indoevropianistika, Gjuhësia e Përgjithshme, Gjermanistika, Romanistika, Sllavistika, Grecistika etj.

Profesura e albanologjisë ushtron ndërkohë funksionin e referentit kryesor me konsulencë dhe ekspertizë profesionale për projekte të ndryshme kryesisht të karakterit kërkimor-shkencor që aplikohen në fondacionet shkencore elitare, si: “Deutsche Forschungsgemeinschaft”, “Alexander von Humboldt-Stiftung”, si edhe ato të “Stiftung des Deutschen Volkes”, “DAAD” në RFGJ; “Wiener Fonds zur Förderung der wissenschaftlichen Forschung” në Austri etj. Profesura e Albanologjisë është gjithashtu pjesë e bordit drejtues të programit "Balkan Studies" (San Peterburg/Rusi) sikurse në atë të një numri revistash dhe kolanash shkencore albanologjike si “Albanische Forschungen” (Munih), “Hylli i Dritës” (Shkodër), “Albanian Studies” (Tiranë), “Res Albanicae” (Cosenza/Palermo) etj. Së bashku me

¹ Shih <http://www.albanologie.uni-muenchen.de/studieng_nge/ma-balkanphilologie/index.html>

lektoratin e gjuhës shqipe, profesura e albanologjisë drejton edhe provimin shtetëror të abiturientëve të landit të Bavarisë që zgjedhin albanologjinë si degë specialiteti shkencor.

3. Pozicioni i degës në arealin albanologjik ndërkombëtar

Specifika e degës si e vetme në veri të Alpeve të Europës Perëndimore ka bërë që në periudhën ndërmjet viteve 2000-2012 të shtohet ndjeshëm krahas numrit të studentëve edhe ai i bursistëve dhe i studiuesve që vijnë për një qëndrim afatshkurtër me synim specializimi pranë saj (deri sot nga 15 vende të ndryshme të botës). Bashkëpunimi me qendra të ndryshme të formimit shkencor universitar albanologjik në Itali (Cosenza, Palermo, Napoli), Kosovë (Prishtinë), Shqipëri (Shkodër, Tiranë, Elbasan), Rusi (San Peterburg), Maqedoni (Tetovë, Shkup), Bullgari (Sofje) etj. po jep ndërkohë frytet e veta, si në plan universitar (shkëmbime docentësh e studentësh)² ashtu edhe në organizimin e tubimeve kulturore-shkencore albanologjike në Evropë (shih më poshtë).

Në formimin shkencor dhe atë pedagogjik universitar bën pjesë edhe vendi i lektorit të gjuhës shqipe, i cili sipas angazhimit të theksuar më lart edhe në marrëveshjen ndërmjet LMU dhe MAS shpallet me konkurs ndërkombëtar në çdo dy vjet.

Dega e Albanologjisë pranë LMU ka bërë ndërkohë traditë organizimin çdo dy-tre vjet të “Tubimit Kulturor-Shkencor Shqiptaro-Gjerman”, në të cilin marrin pjesë studiues albanologë të njohur nga vende të ndryshme të Evropës dhe SHBA-ve. Ndërkohë, në një qark kohor prej 12 vjetësh (2003-2014), janë organizuar pesë syresh, si vijon:

² Ndër profesorët dhe docentët e ftuar që kanë ligjruar dhe mbajtur leksione në aulat e universitetit tonë gjatë viteve 2000-2017 përmendim ndër të tjerë kolege dhe kolegë a) nga Shqipëria: Çlirim Bidollari, Enver Hysa, Shaban Sinani, Anila Omari, Rami Memushaj, Artur Baxhaku, Pëllumb Xhufi, Floresha Dado, Liman Varoshi, Flora Koleci; b) nga Kosova: Rexhep Ismajli, Bardh Rugova; c) nga Italia: Francesco Altimari, Matteo Mandalà, Gianni Belluscio, Gëzim Gurga; d) nga Rusia: Larisa Kaminskaja, Aleksander Rusakov, Aleksander Novik, Andrej Sobolev; e) nga Franca: Remzi Përnaska; nga Gjermania: Norbert Boretzky, Robert Elsie, Wilfried Fiedler (pas daljes në pension), Eckehard Pistrick, Konrad Clewing; f) nga Austria: Joachim Matzinger; nga SHBA-të: Eric Hamp; g) nga Greqia: Titos Jochalas; h) nga Zvicra: Markus E. Peters, Michiel de Vaan.

1. Das albanische Nationalkonzil 1703. Kulturwissenschaftliche Tagung in seinem 300. Jubiläum (Kuvendi i Arbënit 1703. Tubim shkencor-kulturor në 300-vjetorin e mbajtjes së tij: Muni, 13. shtator 2003)
2. Buzukus' "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit ("Meshari" i Buzukut dhe recepsioni i tij në kohën tonë: Muni, 14.-15. tetor 2005)
3. Der Kongress von Manastir – Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur (Kongresi i Manastirit – sfidë ndërmjet traditës dhe risisë në kulturën e shkrimit shqip: 7.-8. nëntor 2008)
4. Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie. 50 Jahre Albanologie an der LMU München (Çështje bashkëkohore dhe perspektiva të Albanologie. 50 vjet albanologji në LMU të Munihut – Gut Schönwag, 23.-25. qershor 2011)
5. Sprache und Kultur der Albaner – zeitliche und räumliche Dimensionen (Gjuha dhe kultura e shqiptarëve – dimensione kohore dhe hapësimore: Buçimas, 5.-8 korrik 2014)

4. Aktiviteti botues

Dega me projektet e veta shkencore mëton një vend qendror në arenën kulturore albanologjike edhe sa i përket aktivitetit botues, i cili krahas ndërmarrjeve individuale të punonjësve shkencorë, doktorantëve dhe studentëve të degës³ dallohet edhe për organizimin e botimeve përmbledhëse

³ Lejohemi të citojmë këtu ndër të tjerë: Jonida Xhyra-Entorf: *Soziokulturelle Aspekte bei Martin Camaj's Prosa-Wortschatz. Eine Untersuchung im Rahmen der interpretativen Semantik*, në radhë të "Albanische Forschungen" bl. 24, Harrassowitz, Wiesbaden 2006; Markus E. Peters: *Der älteste Verlag Albaniens und dessen Beitrag zu Bildung und Kultur. Die Verlagsdruckerei der Unbefleckten Empfängnis zu Shkodra (1870/71 – 1944/45)*, në radhë të "Studien zur Kirchengeschichte" bl. 6, Kovač, Hamburg 2007; Lumnje Jusufi: *Die zentralgegische Mundartengruppe in Mazedonien*, në radhë të "Albanische Forschungen" bl. 30, Harrassowitz, Wiesbaden 2011; Ema Kristo: *Politische Schlagwörter im postkommunistischen Albanien (1990-2001)*, në radhë të "Albanische Forschungen" bl. 34, Harrassowitz, Wiesbaden 2014; Cornelia van Scherpenberg: *Albanian as a member of the "Standard Average European" Sprachbund*, në: "Res Albanicae" 2 [2013] 51-67 etj. Për botimet e drejtuesit aktual të degës, shih <<http://www.albanologie.uni-muenchen.de/personen/professoren/demiraj/publikationen/index.html>>.

në shtëpi të njohura botuese në Perëndim, siç kanë pasur fatin të botohen katër ndër pesë akte të tubimeve albanologjike të mbajtura deri sot.⁴ Rezultat i një projekti afatgjatë ishte edhe vëllimi përkujtimor që ju përkushtua themeluesit të degës sonë, shkrimtarit dhe intelektualit të mërgatës politike-intelektuale shqiptare Martin Camaj: “Wir sind die Deinen” (Ne jemi të tutë)⁵ si edhe botimi i plotë i veprës së tij letrare në 10 vëllime nga (Tiranë 2010)⁶ dhe ribotimi i poezisë së tij (Tiranë 2017)⁷ nga shtëpia botuese Onufri.⁸

Pjesë e këtij aktiviteti është edhe përgatitja për shtyp dhe botimi i monografive shkencore albanologjike të mbetura deri sot në dorëshkrim, siç është rasti i punimeve të albanologëve të njohur Hermann Ölberg, Gert Klingenschmitt dhe Shaban Demiraj.⁹ Nuk mungon në këtë rast edhe bash-

4 Khs.: Das albanische Nationalkonzil, 1703. Kulturwissenschaftliche Tagung in seinem 300. Jubiläum. (München 13. September 2003), Prishtinë 2004, 194 f.; Nach 450 Jahren. Buzukus Missale und seine Rezeption in unsere Zeit. 2. Deutsch-Albanische Kulturwissenschaftlichen Tagung in München vom 14. bis 15. Oktober 2005, në radhëjën: "Albanische Forschungen" bl. 25, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2007, 328 f.; *Der Kongress von Manastir. Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*. 3. Deutsch-Albanische Kulturwissenschaftliche Tagung in München vom 7. bis 8. November 2008, Verlag Dr. Kovač, Hamburg 2009, 252 f.; Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie. Akten der 4. Deutsch-Albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung "50 Jahre Albanologie an Ludwig-Maximilians-Universität München" (23.-25. Juni 2011, Gut Schönwag bei Wessobrunn), në radhëjën: "Albanische Forschungen" bl. 32, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2012, 447 f.

5 Wir sind die Deinen – Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925 – 1992) gewidmet, bot. Bardhyl Demiraj, në radhëjën: "Albanische Forschungen" Bd. 29, Harrassowitz, Wiesbaden 2010, 600 f.

6 Martin Camaj: Diella. Vepra I (148 f.); Poezi 1953 – 1967. Vepra II (280 f.); Shkundullima. Vepra III (367 f.); Njeriu më vete e me tjerë. Vepra IV (135 f.); Rrathë. Vepra V (496 f.); Nema, Buelli, Palimpsest. Vepra VI (150 f.); Karpa. Vepra VII (298 f.); Dranja. Vepra VIII (172 f.) Poezi. Vepra IX (214 f.); Tregime, Novela, Drama, Vepra X, (368 f.). (botues Bardhyl Demiraj), Onufri-Editions, Tiranë 2010.

7 Martin Camaj: Vepra poetike. (bot. Bardhyl Demiraj) Onufri, Tiranë 2017, 720 f.

Njohja dhe studimi i gjuhës shqipe, si edhe i gjuhëve të tjera, ka kaluar përmes disa fazave që kanë përparuar paralelisht dhe hap pas hapi me njohjen e lëndës gjuhësore të kësaj gjuhe nëpërmjet zbulimit të teksteve të vjetra të saj, dhe nëpërmjet kontakteve të misionarëve dhe të udhëtarëve të huaj me botën shqiptare brenda territorit kompakt të saj dhe me diasporën arbëreshe të Italisë dhe të Greqisë.

Studimet shkencore për shqipen dhe historinë e saj kanë nisur e kanë përparuar gjatë shekullit XIX në lidhje të ngushtë me zhvillimet e gjuhësisë historike krahasuese europiane e të metodave shkencore të saj. Për këtë pikë merita themelore u takon pa dyshim albanologëve gjermanë që përfshinë dhe gjuhën shqipe në kërkimet e tyre.

Rezultati i fazës së parë të kontakteve dhe të njohjeve me lëndën gjuhësore të shqipes ka qenë identifikimi i saj si gjuhë e veçantë e dalluar nga gjuhët e tjera sidomos nga latinishtja. Kësaj faze i përkasin shënimet që kanë lënë misionarë dhe udhëtarë të huaj që kanë kaluar në viset shqiptare në shekujt XIII-XIV dhe kanë vënë në dukje se shqiptarët janë një popull i veçantë që kanë edhe një gjuhë të vetën të veçantë, krejt të ndryshme nga latinishtja. Janë konstatime nga kontaktet e të huajve me folës të gjuhës shqipe para ose në fillim të dëshmimeve të shkruara në gjuhën shqipe

Fazën e dytë e përbëjnë përpjekjet e para për të zbuluar e provuar përkatësinë indoeuropiane të gjuhës shqipe. Kjo fazë nis duke u mbështetur në vëzhgimin e analizën tashmë të teksteve të shkruara në gjuhën shqipe. Ajo fillon me një vërejtje të rëndësishme metodologjike të dijetarit dhe filozofit të shquar gjerman Leibniz në fillim të shekullit XVIII (1715). Ai që i pari që theksoi se për të gjykuar për karakterin indoeuropian shqipes duhet të veçohen elementet e huazuara nga elementet e trashëguara të leksikut të shqipes dhe analizës shkencore për këtë qëllim i duhen nënshtruar këto të fundit. Njohuritë për historinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar u pasuruan dhe u thelluan më tej me veprën e Johannes Tunmann në fund të shekullit XVIII (1774), por ky dijetar, si historian, i kushtoi vëmendje të veçantë problemit të origjinës së shqiptarëve e të gjuhës së tyre

Problemi i përkatësisë indoeuropiane të gjuhës shqipe i takon gjysmës së parë të shekullit XIX dhe është, do të thosha, kryesisht rezultat i veprës së dijetarëve gjermanë Joseph Reiter Xylander-it dhe Franz Bopp-it, që e përfshinë dhe e futën shqipen në rrjedhën e zhvillimeve të gjuhësisë historike krahasuese. Dijetarët e mëvonshëm kanë mbështetur karakterin indoeuropian të shqipes, kanë plotësuar e saktësuar lëndën indoeuropiane të saj, si në fushën e leksikut, ashtu edhe të strukturës gramatikore të saj. Që nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit XIX janë shtuar përpjekjet për të përcatuar lidhjet dhe marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane dhe për të përcaktuar vendin e saj në këtë familje gjuhësore. Edhe në këtë problem të fundit dijetarët gjermanë kanë meritën kryesore. Franz Bopp-i i caktoi shqipes një vend të veçantë në familjen e gjuhëve indoeuropiane pa asnjë lidhje farefisnie me asnjërën prej gjuhëve të kësaj familjeje që në vitin 1843 në ligjeratën që mbajti në Akademinë e Berlinit mbi numërorët dhe përemrat e gjuhës sqipe dhe e vërtetoi këtë në mënyrë përfundimtare më 1854 në veprën e mirënjohur *Mbi gjuhën shqipe në lidhjet e afërisë saj*, në të cilën i bëri një analizë të shumanshme leksikut dhe strukturës gramatikore të saj. Rreth 30 vjet më vonë në vitin 1883 në kohën e arritjeve të shënuara të shkollës gjuhësore të gramatikanëve të rinj, G. Meyer-i në artikullin e tij të njohur *Vendi i+ shqipes në rrethin e gjuhëve indogjermane* e vendosi shqipen në gjuhët satem nga një anë, dhe në gjuhët veriore nga ana tjetër. Studiusit e mëvonshëm që u morën gjerësisht me problemet themelore të historisë së gjuhës shqipe si: H. Pedrseni, N. Jokli, E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, I. Ajeti, E. Hamp, A. Desnickaja etj. kanë sjellë ndihmesa të reja në argumentimin e mëtejshëm të karakterit indoeuropian të shqipes dhe në saktësimin e vendit të saj në familjen e gjuhëve indoeuropiane dhe kanë sjellë lëndë të re nga shqipja që gjen përgjegjëse në gjuhë të tjera indoeuropiane, por arritjet e përfundimet shekullit XIX për këtë problem i kanë rezistuar kohës.

Dy figurat kryesore që përfaqësojnë albanologjinë apo më saktë albanistikën gjermane në gjysmën e parë të shekullit XIX, duke i renditur kronologjikisht, janë Joseph Reiter von Xylander dhe Franz Bopp-i, një nga themeluesit kryesorë të gjuhësisë historike krahasuese indoeuropiane.

Ksilander-i nuk ishte gjuhëtar as filolog, por ai u bë i tillë. Ai pati një

karrierë të gjatë në në fushën ushtarake dhe ka bërë një varg botimesh në këtë fushë. Fitoi titullin “Doktor” në filozofi. Studimet në fushën e gjuhësisë i inauguroi me veprën *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren* “Gjuha e Albanëve ose e shqiptarëve”, botuar në Frankfurt mbi Main në vitin 1835. Biografët e tij shënojnë se Xylanderi shërbeu si oficer në garden mbretërore të mbretit bavarez Otto në Greqi. Atje mendohet se ra në kontakt me shqiptarë të Greqisë dhe me gjuhën e tyre dhe shkroi veprën që sapo përmendëm.

Në veprën e tij për gjuhën shqipe Xylanderi ka një gramatikë përshkruese të dialektit të jugut dhe një fjalor shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip me rreth 3500-4000 fjalë dhe një krye të veçantë në të cilin bën një paraqitje të përmbledhur me vështrim kritik të hipotezave dhe mendimeve që ishin shprehur për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe në botimet që njiheshin deri kur shkroi veprën e tij. Burimi kryesor për lëndën gjuhësore të shqipes ka qenë “Dhjata e re”, përkthyer nga vangjel Meksi dhe botuar në Korfuz më 1827 nën redaktimin e Peshkopit të Eubesë, Grigor Gjjirokastritit. Por Ksilanderi ka përdorur edhe botime të tjera në gjuhën shqipe dhe për gjuhën shqipe që njiheshin në kohën e tij: *Fjalorin latinisht shqip* të Frang Bardhit, *Fjalorin trigjuhësh greqisht-vllahisht e shqip* të Teodor Kavaliotit, botuar në veprën *Protopiria* në Venetik më 1770, *Gramatikën e da Lecce-s*, 1716, veprën e Evstrat Vithkuqarit, të Martin Likut, të Pukvilit etj. Gramatika e tij është e dialektit të jugut, por ka edhe elemete të gegërishtes. Një analizë dhe vlerësim të veçantë i ka bërë gramatikës së Ksilanderit studiuesi gjerman Armin Hetzer, i cili ka vlerësuar sidomos trajtimin morfologjik të autorit dhe vë në dukje mjaft pasaktësi në përdorimin e alfabetit.

Ndër të tjera, studiuesi gjerman Armin Hetzer ka pohuar se Xylanderi ishte i pari gjerman që botoi një manual të vlefshëm për gjuhën shqipe. Originaliteti i tij nuk qëndron në teorinë që ai shpiku, por në metodën fililogjike, të cilën ai e zbatoi me seriozitet dhe me zell. Ai përpunoi një tekst të gjerë siç ishte Bibla e Korfuzit dhe shqyrtoi të gjitha manualet, gramatikat, fjalorët etj. që përmbanin informacion për shqipen. Pasardhësi i tij qe Georg von Hahn, i cili shtoi të dhëna për kulturën, etnografinë e historinë e shqiptarëve. Ja pse mund të themi që Xylanderi, së bashku me G. von

Hahn-in, themeluan filologjinë shqipe.”²

Xylanderi bashkon në veprën e tij njohjen e teksteve të shkruara në gjuhën shqipe deri në kohën e tij dhe të veprave të shkruara për historinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar. Ai arriti të siguronte një lëndë gjuhësore të pasur për gjuhën shqipe, pothuajse të gjitha botimet në gjuhën shqipe që njiheshin. Nga shqyrtimi i kësaj lënde ai arriti në disa përfundime të rëndësishme për kohën për dy problemet themelore që shtroheshin para dijetarëve për gjuhën shqipe në gjysmën e parë të shekullit XIX: përkatësia indoeuropiane e gjuhës shqipe dhe problemi i prejardhjes së popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe.

Për të vërtetuar përkatësinë indoeuropiane të gjuhës shqipe veproi sipas një metodologjie shkencore të drejtë dhe të përparuar për kohën. Ishte krejt e natyrshme që përpjekjet e para për të provuar përkatësinë indoeuropiane të shqipes do të fillonin nga shqyrtimi i leksikut, nga krahasimi i fjalëve të shqipes me fjalët pëgjegjëse të gjuhëve të tjera indoeuropiane për të vërejtur afritë e tyre dhe dhe dallimet. Afritë në rrafshin leksikor janë më të dukshme për t’u vënë re.

Ashtu siç kishte pohuar më shumë se një shekull më parë filozofi G. Leibnitz, Xylanderi mendonte se për të gjykuar për karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe duheshin veçuar huazimet nga gjuhët e tjera dhe pjesa që mbetet, pjesa e leksikut të trashëguar duhet të krahasohet me gjuhët e tjera indoeuropiane. Ai pohon se po të veçojmë fjalët e huazuara nga greqishtja e re, nga sllavishtja dhe nga turqishtja, mbetet fjalori i trashëguar, i cili është pjesërisht i afërt me gjuhë të tjera europiane dhe i ruajtur pa ndryshime rrënjësore. Dhe duke krahasuar këtë pjesë të leksikut të trashëguar me gjuhë të tjera, ai pohon pa mëdyshje se shqipja është gjuhë indoeuropiane. Ai e vlerësonte shqipen si një nga gjuhët e lashta indogjermane, duke pohuar shprehimisht se fjalëformimi (fjalori) dhe gramatika në tërësi tregojnë një fizionomi të lashtë. Sipas tij shqipja nuk është bërë e tillë nëpërmjet huazimeve nga gjuhët fqinje të cilat janë të reja, por se ajo ka në bazë të saj elemente të hershme. Për të vërtetuar këtë përfundim autori përpiket të bëjë edhe edhe analiza a përjasje etimologjike, të cilat jo rrallëherë janë të pa-

² Cituar sipas punimit të sapopërmendur të E. Gjanës.

sakta. Ai vetë veçon disa nga elementet e huazuara nga latinishtja në gjuhën shqipe si: *qytet* nga *civitas*, *qiqër* nga *cicer*, *gjindja* nga *gens*, *gentis*, *fqinj* nga *vicinus*, *qepë* nga *cepa*, *kryq* nga *crux*, *cis*, *peshk* nga *piscis*, *faqe* nga *facies*, *qërton* nga *certo* etj. Është me interes të vihet në dukje se Xylanderi, para Franz Bopp-it, thekson interesin shkencor që paraqesin afrimet e shqipes me sanskritishten, të cilat duhen hulumtuar më nga afër. Ai bën disa afrime të fjalëve të sanskritishtes me fjalë pëgjegjëse në shqipe si *asthi-asht*, *është*, *krimi-krimb*, *nara-njeri*, etj.

Pas krahasimeve të lëndës së shqipes me gjuhë të tjera, me greqishten, me latinishten, gjuhët gjermanike etj., arrin në këtë përfundim: “një gjuhë, fjalët e së cilës, edhe me një vështrim të përgjithshëm, duket se mbi gjysma e tyre lidhen me greqishten, me latinishten, gjuhët gjermanike dhe me gjuhë të tjera indogjermane dhe kjo pjesë e fjalëve u përket fushave më të rëndësishme të jetës së popullit, ndërsa pjesa tjetër duket e një rëndësie fare më të pakët, ... një gjuhë gramatika e së cilës në thelb tregon kryesisht forma që mund të dëshmojnë në gjuhët e lartpërmendura; një gjuhë e tillë, me të drejtë, duhet parë si një pjesëtare e familjes gjuhësore indogjermane dhe për këtë në të ardhmen nuk do të ketë më asnjë dyshim. Lënda e parë bazë e shqipes,- mendonte ai -, është indogjermane.

Xylanderi një gjysëm shekulli para G. Meyer-it bëri një përpjekje të parë për të dhënë disa statistika lidhur me raportin midis fjalëve të vetë shqipes dhe huazimeve nga gjuhë tjera në leksikonin e gjuhës shqipe. Ai në veprën e tij, f.294 mori në shqyrtim 1800 fjalë të shqipes nga të cilat, sipas tij 190 fjalë i afronte me turqishten, 400 me greqishten, 650 me latinoromanishten, 500 me gjuhët gjermanike, 60 me gjuhët sllave. Rreth gjysma e fjalëve ishin fjalë të huazuara dhe gjysma tjetër ishin fjalë vendi³ (Çabej I, 113).

Për të vërtetuar karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe autori sjell të dhëna edhe nga sistemi gramatikor, sidomos në sistemin e numërimit dhe gjen edhe në këtë fushë analogji midis shqipes dhe gjuhëve të tjera të kësaj familjeje. Një analizë më të plotë të sistemit të numërimit dhe të sistemit përemëror bëri Bopp-i disa vite më vonë në vitin 1843.

Xylanderi, me sa duket, ka njohur edhe veprën e B. Kopitar-it, sepse

³ Shih Eqrem Çebej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë, 1982, f. 113.

ka vënë në dukje jo vetëm përkatësinë indoeuropiane të shqipes, por, duke u mbështetur edhe në veprën e Johannes Thunmann-it, pohon edhe një marrëdhënie të veçantë midis gjuhëve të Ballkanit. Për këtë përmend nyjen shquese të prapavendosur në shqipe, vllahishte dhe bullgarishte. Këto tri gjuhë, pohon autori, të cilat janë të përhapura në pjesën më të madhe të Trakisë së vjetër, mund të kenë gjetur një shtresë të përbashkët në një të folme të përbashkët, në një të folme të posaçme të banorëve të vendit, që në gjuhën shqipe duket se del në pah më fuqishëm dhe më qartë. Pra, me këtë pohim Ksilanderi shfaqet si një nga të parët studiues që formulon tezën e egzistencës së një substrati të përbashkët të gjuhëve të Ballkanit gjuhëve të Ballkanit.

Në një krye të veçantë me titull: *Pikëpamjet e deritanishme për shqipen* Ksilanderi bën një vështrim kritik të pikëpamjeve të shprehura në veprat e dijetarëve që kanë botuar para tij studime për gjuhën shqipe. Kështu ai shqyrton mendimet e Leibnicit, të Tunmanit, të Herderit, të Engjëll Mashit, të Malte Brunit, Pukvililit, Likut etj. Ai nuk pajtohet me pikëpamjet e shprehura nga Adelungu, i cili në veprën e tij *Mithridates*, në kundërshtim me mendimet e Thunmann-it, Herder-it e Malte Brun-it, është shprehur se shqiptarët mund të jenë mbetje të përziera të një fisi tartar, pikërisht të protobullgarëve dhe hamendëson se ekziston një lidhje midis shqiptarëve dhe atij populli, i cili ka banuar në lindje të Detit të Zi, midis Kaukazit e lumit Cyrus. Në përfundim të shqyrtimeve të tij historiko-gjuhësore për origjinën e shqiptarëve e të gjuhës së tyre, Ksilanderi pohon se: Shumica e dijetarëve bashkohen me mendimin se shqiptarët duhet të konsiderohen si pasardhës të Ilirëve të lashtë, ose të ilirëve, të përzier me fise të familjes trake.

Si përfundim mund të pohojmë se në veprën e tij Xylanderi, duke u mbështetur në arritjet e deriatëhesme për probleme të historisë së gjuhës shqipe, arriti ose miratoi disa përfundime të rëndësishme për probleme themelore të historisë së saj, vuri në dispozicion të studiuesve pasardhës një lëndë të pasur e me vlerë në fushën e leksikut dhe të strukturës gramatikore të shqipes. Armin Heceri shprehet: Ksilanderi është i pari albanolog i vërtetë gjerman. Merita e Ksilanderit është se e përcaktoi gjuhën shqipe si gjuhë indoeuropiane. Sipas tij, Ksilanderi mund të quhet babai i albanologjisë. Ndësa Norbert Jokli në studimin e tij *Albanisch* ka shkruar: “Me Xylan-

derin mbyllet edhe periudha parashkencore e përpjekjeve për shqipen”

Pas J. R. Xylanderit me përcaktimin e karakterit indoeuropian të shqipes dhe të vendit të saj në rrethin e gjuhëve indoeuropiane në shekullin XIX u mor më gjerësisht gjuhëtari i shquar gjerman Franz Bopp, profesor i Universitetit të Berlinit, njeri nga themeluesit kryesorë të gjuhësisë historike krahasuese indoeuropiane. Ai përshtiu edhe shqipen në rrethin e studimeve të tij në fushën e gjuhësisë historike krahasuese indoeuropiane. F. Boppi nisi të merrej me studimin e shqipes që në fillim të viteve '40 të shekullit XIX. Në një ligjëratë që mbajti në vitin 1843 në Akademinë e Berlinit për numërorët dhe përemrat e gjuhës shqipe, ai bëri një analizë historike krahasuese këtyre dy kategorive gramatikore dhe arriti në përfundimin se ato kishin burim indoeuropian dhe se shqipja ishte gjuhë indoeuropiane. Në vitin 1855 ai botoi një studim tjetër më të plotë me titull *Über das Albanesisch in seinen verwandschaftlicher Beziehungen* “Mbi gjuhën shqipe në lidhjet e saj farefisnore” në të cilën autori i bëri një analizë shkencore mjaft të plotë strukturës gramatikore të shqipes dhe të disa fjalëve themelore të leksikut dhe vërtetoi në mënyrë përfundimtare përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve indoeuropiane dhe vendin e veçantë si gjuhë më vete në këtë familje. Në hyrje të kësaj vepre ai shkruan: “Në një trajtesë të dikurshme, ende të pabotuar (bërë më 23 shkurt 1843) kam trajtuar numërorët dhe përemrat e shqipes, dhe përmes studimeve të mia të dikurshme kam formuar bindjen se gjuha shqipe i përket prerazi familjes indoeuropiane, por në pjesët përbërëse të fondit të saj themelor nuk ka lidhje të ngushtë me asnjërën prej gjuhëve motra sanskrite të kontinentit tonë dhe as lidhje birërie me to”. Për të arritur në këtë përfundim F. Bopp-i u mbështet jo vetëm në analizën historiko-etimologjike të fjalëve të fondit të lashtë të trashëguar të shqipes, por edhe, madje kryesisht, në zbrërthimin e elementeve themelore të strukturës gramatikore të saj.

Me botimin e këtij studimi mund të thuhet se u hoq çdo hije dyshimi për përkatësinë e gjuhës shqipe në trungun e gjuhëve indoeuropiane. Ja disa nga analizat që bëri ai : Ai foljen *jam* të shqipes e krahasoi me trajtat përkatëse të gjuhëve të tjera, me sanskritishten *asmi*, latinishten *est*, avestishten *ahmi*, me lituanishten *esmi*, sllavishten e vjetër *jesmi* dhe provoi origjinën indoeuropiane të kësaj foljeje. Nga krahasimi i trajtave foljore të

mënyrës dëftore të kohës së tashme në vetën e parë të numrit shumë: *pu-noj-më, këndoj-më* etj. me trajtat përkatëse të latinishtes: *labora-mus, can-ta-mus* etj., vuri re me mprehtësi identitetin origjinar indoeuropian të mbarësavë *-më* të shqipes dhe *-mus* të latinishtes. Po kështu numërorët e tipit *gjash-të, nëntë*, duke i krahasuar me numërorët përkatës të sanskritishtes *shash sash, nava*, i analizoi në *gjash- të, nën-të*, duke dalluar në shqipe një formant *-të* që ka përgjegjësit e vet edhe në gjuhë të tjera indoeuropiane: lat. *-tus*, greq. *-to* etj., të gjithë nga një bazë i.-e. *-*to*. Po kështu Boppi është i pari që përemrin pronor *jonë* e analizon në *jo-në*, ku *-jo* shihet si pjesë e përemrit dëftor *a-jo* dhe *-në* si gjinore e përemrit vetor *neve*. Pra *jonë* nga *(a)jo + neve*.

Bopp-i ka bërë disa analiza etimologjike që janë të vlefshme edhe për sot. Ai fjalën *viç* e lidhi brenda shqipes me fjalën *vit, vjet, vjeç*, duke dhënë çelësin për etimologjinë e kësaj fjale, të cilën e shpjegoi më tej E. Çabej si rrjedhojë e *vit-it* me prapashtesën *-sh* me burim nga *-sh-ja* e rrjedhore së shumësit. Bopp-it i detyrohet edhe analiza etimologjike e fjalëve *sot sod* në **so-dite* dhe *sonte* në **so- nate* etj., pranuar pa rezerva pothuaj nga të gjithë etimologët. Parafjalën *mbi* të shqipes e krahason me skr. *api*, me greq. *ἐπί*; parafjalët *ndë, ndën, ndër* i krahason me skr. *antar*, me gotishten *undar*. Pas këtyre analizave të thelluara e argumenteve bindëse Bopp-i e zgjidhi përfundimisht problemin e përkatësisë së gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoeuropiane dhe të vendit të saj të veçantë si gjuhë më vete në këtë familje gjuhësore. Që nga ajo kohë përfundimi i Boppit për këtë problem themelor të historisë së shqipes nuk është vënë në dyshim nga studiuesit e mëvonshëm, por janë bërë përpjekje për të caktuar më nga afër vendin e shqipes midis gjuhëve të tjera indoeuropiane.

Pasi u vërtetua në mënyrë bindëse përkatësia shqipes në familjen e gjuhëve indoeuropiane, një problem tjetër themelor i albanologjisë që mbe-ti për t'u zgjidhur ishte prejardhja e popullit shqiptar dhe i gjuhës shqipe. Pas shtrimit të këtij problemi në çerekun e fundit të shekullit XVIII nga J. E. Thunmann, në mesin e shekullit XIX një tjetër dijetar austriak Johannes Georg von Hahn, jurist dhe diplomat u mor gjerësisht me studime shqiptare dhe la vepra shumë të vyera edhe për sot, prandaj me të drejtë është quajtur themelues i albanologjisë.

Heiner EICHNER, Wien

ZHVILLIMI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË KUADRIN E GJUHËSISË INDOEVROPIANE GJERMANISHTFOLËSE - NJË PERSPEKTIVE AUTOBIOGRAFIKE

Hyrje

Shumë¹ të nderuar zonja dhe zotërinj, falënderoj organizatorët, në radhë të parë profesor Rexhep Ismajlin që më ftoi të marr pjesë në këtë konferencë. Si pjesëmarrës konferencash jam tashmë një Nestor, pra “më i vjetri”. Kjo më nxit që ta shoh këtë çështje nga perspektiva autobiografike, pra në retrospektivë.

Kolegu im profesor Rexhep Ismajli më sugjeroi, që, në lidhje me këtë temë, të flitet edhe për punimet kërkimore gjuhësore të Klingenschmitt-it, të Matzinger-it dhe të Schumacher-it. Ky rreth lingvistësh do të përbëjë edhe thelbin e punimit tim. Për mua veprimtaria e tyre e shquar lidhet me studimet e mia në Erlangen. Për arsye biografike do të doja që së pari të përshkruaja studimet e mia në Mynih.

1. Mynih

1.1. Bibliografi

Broshura e vogël e Hanne Adrom-it (në bashkëpunim me Markus Hartmann) përshkruan historinë e Indoeuropianishtes në Mynih "Indoger-

¹ Falënderoj për përkthimin e tekstit të ligjëratës zonjat dr. Ina Arapi, dr. Vjosa Hamiti e dr. Valeriana Karma. Gjithashtu falënderoj prof. Stefan Schumacher dhe dr. Joachim Matzinger për informacionet e vlefshme për këtë çështje. Veçanërisht falënderoj prof. Rexhep Ismajlin, që më vuri në dijeni vlerësimin e tij të detajuar të studimeve të tre kolegëve gjermanishtfolës në vëllimin: Rexhep Ismajli (ed.): **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2015 [f. 84-87 mbi G. Klingenschmitt, f. 64-68 dhe f. 100-112 mbi J. Matzinger, f. 402-406 dhe 429-434 mbi St. Schumacher, e gjitha në gjuhën shqipe].

manistik in München 1826-2001. Geschichte eines Faches und eines Institutes" ["Indoeuropianishtja në Mynih 1826-2001. Historia e një dege studimi dhe e një instituti" (mbi Çamaj sh. f. 22-25, 27, mbi Sasse f. 23-25)ë. 36 faqe. Në dispozicion në Institutin e Gjuhësisë Krahasuese dhe të Albanologjisë të Universitetit, edhe i shkarkueshëm si pdf në internet https://www.ats.uni-muenchen.de/institut/portrait/adrom-verglsprach_wiss.pdf].

Gjithashtu informativ për historinë e këtij instituti është edhe Steven Lundström/ Walther Sallaberger, "Assyriologie und Hethitologie in München. Eine Geschichte des Faches anlässlich des 50. Jahrestages der Einrichtung des Lehrstuhls für Assyriologie am 3. September 1963" ["Asiriologjia dhe hititologjia në Mynih. Një histori e degës së studimit me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Katedrës së Asiriologjisë më 3 Shtator 1963"], 126 faqe (Hititologjia fillimisht ishte pjesë e Institutit të Gjuhësisë).

1.2. Albanologjia në kuadrin e Indoevropianistikës

Në atë kohë ishte e natyrshme që të ashtuquajturat "gjuhët e vogla" të ofroheshin në universitete si kurse të veçanta, në krahasim me ditët e sotme ku nuk synohet përfshirja e tyre si kurse.

Në institutin e Indoeuropeistikës/ Gjuhësisë në Mynih kishte edhe një lektorat për gjuhën shqipe. Kurse në Institutet e Sllavistikës nuk ishin vetem gjuhët sllave të përfaqësuara, por edhe të tjerat si për shembull lituanishtja.

Shqipen e ligjëronte Martin Camaj (1925-1992) me librin e mësimit të Karl Gurakuqit, i cili është shkruar në gjuhën italiane. Natyrisht që për studentët gjermanë ishte e vështirë të njihnin bazat e gjuhës shqipe përmes një gjuhe tjetër të huaj, gjuhës italiane. Camaj jepte mësimin të Albanologjisë në gjuhën gjermane, jo pa mundim. Për këtë arsye përpiloi Camaj pas një kohe të konsiderueshme veprën e tij mbi gjuhën shqipe: *Lehrbuch der albanischen Sprache*, Wiesbaden 1969. Kjo vepër u botua edhe në gjuhën angleze: *Albanian grammar: with exercises, chrestomathy and glossaries*. Wiesbaden 1984.

Në atë kohë ishte e zakonshme që studentët të kishin një indeks, ku shënohej titulli i ligjëratës dhe pagesat e taksave. Në saje të këtyre të dhënave, sot mund të bëj një paraqitje të detajuar të studimeve të mia.

Në indeksin tim e kam të shënuar që në semestrin e gjashtë veror në vitin 1965 kam ndjekur dy orë lëndën “Gjuhë shqipe I” tek Martin Camaj, pastaj në semestrin dimëror 1965/1966 dy orë “Fonologji historike e shqipes” dhe herën e fundit në verë të vitit 1966 një orë “Morfologji e gjuhës shqipe”.

Prej studentëve të tij dua të përmend Hans Jürgen Sasse-n (1943-2015). Ai ka qenë një njohës i shkëlqyer i gjuhëve, për shembull ai njihte në mënyrë perfekte greqishten e re. Ai u specializua pastaj për arvanitishten në Greqi. Ai ka botuar tani një vepër të rëndësishme mbi arbërishten e Greqisë: “Arvanitika I”, Wiesbaden 1991. Vepra e plotë është planifikuar në katër vëllime. Njëri nga këto vëllime u botua sa ishte akoma gjallë. Informatorët e Sasse-s ishin në moshë të shtyrë, shumica ishin të moshës tetëdhjetë vjeç. Hulumtimet e Sasse-s të bëra në Greqi kanë ruajtur informacione të rëndësishme për gjuhësinë.

1.3. Albanologjia edhe në kuadrin e Sllavistikës

Alois Schmaus-i (1901-1970) punoi në Institutin e Gjuhëve dhe Letërsive Sllave në Mynih si profesor i Gjuhësisë Sllave dhe Ballkanike. Ai ishte i specializuar në Gjuhët Sllave të Jugut dhe në folklor. Seminaret e tij letraro-shkencore ishin bërë shumë të famshme. Por kjo famë nuk e ndaloi atë që të jepte edhe ligjërata gjuhësore, si për shembull ligjëratat prej katër orësh në javë mbi gramatikën historike të gjuhës ruse.

Mua më kujtohet që ai herë pas here e ka përmendur gjatë mësimin mënyrën habitore të gjuhës shqipe. Po kështu, Schmaus-i ka ligjëruar për habitoren në kongresin e Gjuhëve Sllave në Sofje (1966). Kjo ligjëratë është botuar në kuadër të botimeve të këtij kongresi. Titulli i ligjëratës është: “Beobachtungen zu Bedeutung und Gebrauch des albanischen Admirativs” [“Vëzhgime mbi kuptimin dhe përdorimin e habitores në gjuhën shqipe”]. Ky tekst u botua pastaj në aktet e kongresit: “Beiträge zur Südosteuropaforschung” [“Ndihmesa mbi studimet e Europës jugore”], Trofenik, Mynih, 103-124.

Schmaus ka mbledhur shumë materiale për këtë ligjëratë. Ai u bazua në veprat letrare dhe në botimet folklorike. Trajtoi në mënyrë të hollësishme ngjyrimet e shumëllojshme dhe të veçanta të përdorimit të habitores,

duke na dhënë të kuptojmë që ishte shumë i informuar mbi literaturën shkencore, si në fushën e albanologjisë ashtu dhe në fushat e tjera të ballkanologjisë. Schmaus-i ishte në dijeni të faktit se habitoretja përdorej kryesisht në gjuhën e përditshme të komunikimit. Ai vinte në dukje se habitoretja përdoret në këndvështrimin letrar, *"më shpesh në letërsinë popullore të zonave të caktuara"*. Schmaus-i edhe u përpoq të shqyrtonte saktësisht nuancat emocionale të habitores.

Unë mund të them që kjo mënyrë e hulumtimit e filluar nga profesori im Alois Schmaus është rimarrë në një disertacion të ri vjenez, i cili sapo është dorëzuar (2017): "Der Admirativ in der albanischen Volksliteratur" ["Mënyra habitore në literaturën popullore shqiptare"]. Autorja, Valeriana Karma, është shqiptare dhe e lindur në Shqipëri (Shkodër). Karma është marrë me studimin e përrallave shqiptare (pesë vëllime). Ajo ka mbledhur dhe ka interpretuar nga ana semantike të gjithë shembujt e habitores. Artikulli i Alois Schmaus-it, i cili u botua gjysmë shekulli më parë, ka qenë për të udhërrëfyes..

1.4. Themelimi i Degës së studimit dhe të Katedrës së re të Albanologjisë në Mynih

Alois Schmaus-i ka dhënë mësim së bashku me historianin **Georg Stadtmüller** (1909-1985). Në atë kohë kam marrë pjesë në një ligjëratë, në të cilën Schmaus-i së bashku me Stadtmüller-in interpretonin dokumente të hershme ruse. Alois Schmaus-i formoi së bashku me Georg Stadtmüller dhe me indoeuropianistin **Wilhelm Wissmann** (1899-1966), një *"triumvirat"*. Qëllimi i këtij *"triumvirati"* ishte ekzistenca e qëndrueshme e Albanologjisë në universitetin e Mynihut. Për këtë qëllim **Martin Camaj** (1925 -1992) ka shkruar tezën e habitimit në punimin e tij të aftësisimit si profesor. Tema është: "Albanische Wortbildung. Die Bildeweise der älteren Nomina" ["Formimi i fjalëve në Gjuhën Shqipe, Mënyra e formimit të emrave të vjetër"]. Ky libër është botuar në Wiesbaden në vitin 1966.

Pjesë e aftësisimit të tij si profesor ishte edhe mbajtja e një referati-tip. Referati ishte i hapur për publikun dhe unë mund të merrja pjesë si student. Tema që zgjodhi Martin Camaj në këtë rast ishte: "Die Blu-

trache gemäss dem Kanun i Lekë Dukagjinit” [“Gjakmarrja sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit”].

Camaj u pranua kësisoj në rrethin e mësimdhënësive universitare. Dega e Albanologjisë arriti të zgjerohej më tej dhe të vendoste baza të qëndrueshme.

Camaj ka qenë një njeri i shumanshëm dhe shkencëtar. Për t’u përmendur në kuadër të “Gjuhës e shkencës” është edhe punimi i tij mbi Gjon Buzukun “Il “Messale” di Gjon Buzuku” [“Meshari i Gjon Buzikut”], Roma 1960, si dhe ai mbi dialektet shqipe në Itali (Arbëreshë) në krahinën e Avelinos (Provincia di Avellino) dhe në krahinën e Potencës (Provincia di Potenza) – “La parlata albanese die Greci: in provincia di Avellino” (Firenze, 1971), “Novellistica italo-albanese” Firenze 1972.

Pasardhësit në degën e Albanologjisë mbas Camaj në Mynih janë: **Wilfried Fiedler** 1990-1997, **Rexhep Ismajli** 1997-2000, **Bardhyl Demiraj** 2001-.

2. Erlangen - Regensburg: Gert Klingenschmitt (shih gjithashtu Ismajli, shënimi nr. 1)

Në vitin 1968 vazhdova studimet e mia në Erlangen pranë prof. **Karl Hoffmann** (1915-1998). Ndër studentët e tij ishte dhe **Gert Klingenschmitt** (lindi në Coburg 1940). Ai u promovua në vitin 1968 me një punim në fushën e iranistikës. Më vonë (në vitin 1976) u habitua me një vepër mbi foljen në gjuhën armene: “Das altarmenische Verbum” [“Folja e Armenishtes së vjetër”], botuar në Wiesbaden 1982. Në vitin 1983 u emërua profesor i shkencave gjuhësore indoeuropiane në Universitetin e Regensburgut.

Në kuadrin e punimit të tij të habilitacionit mbi foljen e armenishtes së vjetër vërejtj ngjashmëri të veçanta midis armenishtes, greqishtes dhe shqipes.

Për shembull:

- ieu. **(e-)k^wle-to* > gr. *é-ple-to*, arm. *elaw*, alb. *kle*, *qe* = (afërsisht:) 'u kthye, u bë, ishte'

- ieu. **né h₂óyu k^wid* = (afërsisht:) 'për asgjë në jetë' > gr. *ouki*, *ou(k)*, arm. *oč‘*, *č‘*, alb. *as*, *s*.

Hulumtimet e tilla janë baza e studimeve aktuale mbi afrinë e shqipes me gjuhët e tjera paleoballkanike.

Shembulli i zhvillimit të **né h₂óyu k^wid* në shqip *as* (madje dhe në formë të shkurtuar: *s*) tregon qartë, se si kanë ndryshuar format e qarta themelore me kalimin e disa mijëvjeçarëve, deri në mosnjohjen më si të tilla. Me metodat shkencore të gjuhësisë indoeuropiane mund të dalë në dritë zhvillimi gjuhësor dhe mund të rindërtohen format themelore. Metodatat më të rëndësishme të përdorura janë (1) krahasimi i gjuhëve, e (2) rindërtimi.

Për të krahasuar gjuhët janë të domosdoshme njohuritë mbi gjuhët indoeuropiane (mbi baza filologjike) që nga kohët më të herëshme. Rindërtimi kërkon hulumtimin e saktë dhe zotërimin sovran të ligjeve fonetike, të ndryshimit semantik të gjuhës, imagjinatë krijuese si dhe pak fat. Këto aftësi i kombinon Gert Klingenschmitt-i në një masë të veçantë. Për këtë arsye ai ka arritur e arrin të bëjë përsëri përparime kolosale në hulumtimin e historisë gjuhësore të shqipes nga perspektiva indoeuropiane ashtu si dhe “titanët” si **Gustav Meyer** (1850-1900), **Holger Pedersen** (1867-1953), **Norbert Jokl** (1877-1942) **Eqrem Çabej** (1908-1980).

Veçanërisht gjuhëtarët austriakë Joachim Matzinger dhe Stefan Schumacher ndjekin gjurmët e tij. Në vijim, do të shqyrtojmë disa ese albanologjike nga Klingenschmitt-i.

“*Albanisch und Urindogermanisch*” [“Shqipja dhe protoindoeuropianishtja”]. Münchner Studien zur Sprachwissenschaft 40, 1981, 93-131.

Kjo ese trajton problemin e korrespondencës së aoristit sigmatik në gjuhën shqipe. Së pari, Klingenschmitt-i tregon këtu se sqarimi ose lidhja e formave me *-shë* si *dhashë* 'ich gab', *pushë* 'ich sah' me aorist sigmatik sipas hulumtimeve të deritanishme mungon në tekstet e vjetra si dhe në disa dialekte arkaike, prandaj ato duhet të gjykohen si forma të reja, të cilat janë krijuar në kohën historike (f. 97). Më pas ai tregon se për më tepër në format e aoristit me ^o-ova mund të gjinden vazhduesit e formimit indoeuropian të aoristit sigmatik.


Në këtë periudhë pas përgatitjes së tezës së habilitimit ai sollti një studim novativ mbi numërorët e shqipes në kuadrin e një vëllimi mbi numërorët e të gjitha degëve të gjuhëve indoeuropiane të planifikuar nga Alan S. C. Ross: *Albanian Numerals* (në anglisht), i daktilogruar *sine anno*, 116 faqe DIN A 4.

Për arsye të vdekjes së iniciatorit Alan S. C. Ross ky vëllim nuk u arriti të botohej një kohë të gjatë. Kur më në fund vëllimi doli nga shtypi pas 20 vjetësh, Klingenschmitt-i nuk e miratoi botimin e studimit të tij; shih Jadranka Gvozdanovich (ed.), *Indo-European Numerals*, Berlin: De Gruyter 1992, p. III. Megjithatë, Klingenschmitt-i ua ka vënë në dispozicion typoskriptin e tij studiuesve të interesuar, shih tezën ime të habilitacionit: Heiner Eichner, *Studien zu den indogermanischen Numeralia*, Typoskript Regensburg 1982, p. 590 (dhe *passim*), Matzinger, *Matranga* (per titulin shih § 3), f. 275.

Publikimet e tjera të Klingenschmitt-it trajtojnë temën e pozicionit të gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. Klingenschmitt-i arriti gjer aty sa të përpilojë një nëngrup të veçantë të gjuhëve ballkanike indoeuropiane në trungun e gjuhëve indoeuropiane. Tashmë kjo pikëpamje është miratuar shumë.

- “*Das Albanische als Glied der indogermanischen Sprachfamilie* (Tischvorlage)” [“Shqipja si pjesëtare e familjes së gjuhëve indoeuropiane”]. In: Jens E. Rasmussen / Benedicte Nielsen (Ed.), In honorem Holger Pedersen. Kolloquium 25. bis 28. März 1993 in Kopenhagen. Wiesbaden 1994, 221-233.

- “Sprachverwandschaft in Europa” [“Afërsitë gjuhësore në Europë”], in Günter Hauska, *Gene, Sprachen und ihre Evolution* [Gjenet, gjuhët dhe evolucioni i tyre], Schriftenreihe der Universität, Band 29, Universitätsverlag Regensburg 2005, p. 100-136. Figura e mëposhtme është marrë nga ky artikulli i Klingenschmitt-it (f. 132):



3. Vjenë, Regensburg dhe vende të tjera: Joachim Matzinger (shih gjithashtu Ismajli, shënimi nr. 1)

Joachim Matzinger-i është një linguist vjenez shumë i formuar dhe produktiv. Lindi më 1968 në Vjenë. Studioi në Universitetin e Vjenës në degën e gjuhësisë. Ai ishte student i Jochem Schindler-it dhe imi. Në kuadrin e punimit të tij të diplomës së masterit shkroi mbi lakimin e emrave armenë (rreth 1995-1996). Doktoratën e tij Matzinger-i e mbrojti në Universitetin e Jenës, me punimin:

“Untersuchungen zum altarmenischen Nomen: Die Flexion des Substantivs” [Studime mbi emrin në armenishten e vjetër. Lakimi i emritë, Münchener Studien zur Sprachwissenschaft, Beiheft 22, 2005, XVIII+166 f.

Gjithashtu Joachim Matzinger-i ndoqi studimet në Regensburg pranë **Gert Klingenschmitt**-it. Për këtë arsye ai është i predispozuar t’ua përcjellë kolegëve të tjerë të specializuar në këtë fushë rezultatet e gjurmimeve të Klingenschmitt-it².

² Disa gjurmime të Klingenschmitt-it mbi gjuhën shqipe nuk janë botuar. Madje edhe ato gjurmime, që Klingenschmitt-i mundi t’i publikojë, janë shumë koncize. Është një ava-

Rezultat i një projekti në Jenë (nën drejtimin e prof. Rosemarie Lühr) është libri i Matzinger-it mbi fjalëformimin indoeuropian (gjuha hitite, indishtja e vjetër, armenishtja e vjetër): “Nominale Wortbildung des Indogermanischen in Grundzügen. Die Wortbildungsmuster ausgewählter indogermanischer Einzelsprachen” [“Fjalëformimi emëror i indoeuropianishtes në skicë”].

Tipet e fjalëformimit të gjuhëve indoeuropiane të përzgjedhura"ë, Band 2: Hethitisch, Altindisch, Altarmenisch, Hamburg 2008 (Philologia 122), 441 faqe.

Matzinger-i u habilitua në vitin 2017 në Itali. Që nga dhjetori 2017 ai punon në Akademinë e Shkencave të Austrisë (Österreichische Akademie der Wissenschaften) në grupin e studiuesve të Ballkanit të drejtuar nga prof. Oliver Jens Schmitt tek Instituti i Kërkimeve të Historisë Moderne dhe Bashkëkohore (INZ - Institut für Neuzeit- und Zeitgeschichtsforschung)

Matzinger-i e ka shprehur disa herë mendimin e tij mbi tezën “*Shqiptarët si pasardhësit të ilirëve*”. Këtë tezë, tezën autoktone të shqiptarëve, e shikon në mënyrë kritike. Në lidhje me problemin e ilirshes do të vijojë libri i tij mbi gjuhën mesape. Kontaktet e tij me arkeologët italianë ia kanë bërë të mundur të publikojë për herë të parë në këtë libër mbishkrime të reja në gjuhën mesape. Ky libër është përfunduar dhe së shpejti do të publikohet.³

Vepra e tij mbi gjuhën e vjetër shqipe tek Matrënga është nga pikëpamja metodike shumë i rëndësishëm: “*Der altalbanische Text <E> Mbsuame e Krështerë des Lekë Matrënga vom Jahr 1592*” [“Teksti në gjuhën Shqipe të vjetër: E Mbsuame e Krështerë i Lekë Matrëngës i vitit 1592”ë, Dettelbach 2006, 306 faqe. Edhe pse nga titulli nuk paraqitet qartë, kjo vepër përmban një trajtim inovativ të fonetikës, fonologjisë dhe morfologjisë historike të gjuhës shqipe.

ntazh për ne që gjurmimet e Klingenschmitt-it janë bërë më të njohura nga Matzinger-i.
³ Shfaqet në shtyp 2018 në seri: Kurzgrammatiken indogermanischer Sprachen und Sprachstufen, Wiesbaden: Reichert, 155 faqe. Shih përkohësisht skriptin për leksion në internet “*Einführung in das Messapische*” [“Hyryje në gjuhën mesape”], 125 pp. (pdf i downloadshëm, DIN A4: <https://independent.academia.edu/JMatzinger>).

Ky punim është shumë i detajuar dhe paraqet gjurmimet aktuale në fushën e vendeve gjermanishtfolëse. Çdo fjalë ai e ka shpjeguar sipas metodës shkencore gjuhësore të “Shkollës së Erlangenit”. Matzinger ka botuar gjithashtu shumë gjurmime të detajuara mbi Buzukun. Në vitin e fundit u botua libri i tij me titull:

- “*Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku*” [“Tipet emërore sekundare të fjalëformimit në Shqipen e vjetër të Gjon Buzukut”], Wiesbaden 2016, 593 faqe.

Një kontribut i madh në historinë e gjuhës shqipe është gjithashtu vepra e tij e përgatitur dhe e botuar së bashku me Stefan Schuhmacher-in me titull:

- “*Die Verben des Altalbanischen. Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*” [“Foljet e shqipes së vjetër. Fjalori i dëshmimeve, parahistoria dhe etimologjia.”] Wiesbaden: 2013 (Albanische Forschungen 33), 1055 faqe.

Për këtë punim Matzinger-i i ka mbledhur të gjitha foljet e dialektit gegë të veprave të Pjetër Budit. Ndërsa shembujt e foljeve për dialektin toskë i ka mbledhur nga shkrimet e Matrëngës dhe të Varibobës. Pjesa më e madhe e vlerësimit historik gjuhësor i përket Schumacher-it.

Së bashku me Heiner Eichner-in Matzinger e ka botuar edhe disertacionin vjenez të Çabejtë të vitit 1933: Eqrem Çabej, Italoalbanische Studien [Studime italo-shqiptare], Wiesbaden 2017 (Albanische Forschungen 34), 203 faqe.

Prej Matzinger-it vijuan shumë punime albanologjike të tjera, gjithsej rreth gjashtëdhjetë:⁴

-”*Albanisch unë ‘ich’ im System der albanischen Personalpronomina*” [“Shqip unë” ‘ich’ në sistemin e përemrave vetor të Shqipes”]. Indo-germanische Forschungen 103, 1997, 185-201.

-”*Albanisch aty ‘dort’*”. Historische Sprachforschung 112, 1999, 158-163.

-”*Albanisch gratë ‘Frauen’*”. Münchener Studien zur Sprachwissenschaft 60, 2001, 75-87.

⁴ Falënderoj dr. Joachim Matzinger-in për komunikimin e botimeve të tij në listën e përzgjedhjes.

- *Recensioni i librit: "Vladimir Orel, A Concise Historical Grammar of the Albanian Language"*. Die Sprache 40, 1998 [2001], 103-123.
- *Recensioni i librit: "Vladimir Orel, Albanian Etymological Dictionary"*. Die Sprache 40, 1998 [2001ë, 229-241.
- "Albanisch kam "ich habe". *Studia Etymologica Cracoviensia* 8, 2003, 99-106.
- "Albanisch besë "Eid usw." – ein soziales und sprachliches Balkankonzept" [Shqip besë "Eid etj" - një koncept social dhe gjuhësor ballkanik], in: M. Genesin, J. Matzinger (Edd.), *Albanologische und balkanologische Studien. Festschrift für Wilfried Fiedler*, Hamburg 2005, 115-120.
- "Messapisch und Albanisch". *International Journal of Diachronic and Linguistic Reconstruction* 2, 2005, 29-54.
- "Altalbanisch <8ieh> /ujë/ "Wasser" und die anderen Massennomina bei Buzuku", in: B. Demiraj (Ed.), *Nach 450 Jahren. Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit. 2. Deutsch-Albanische kulturwissenschaftliche Tagung in München vom 14. bis 15. Oktober 2005*, Wiesbaden 2007, 167-190.
- "In memoriam Georg R. Solta (1915-2005)". *Studime filologjike, viti LIX (XLIII)*, 2005, 207-210.
- "Prinzipien der altalbanischen nominalen Wortbildung und die deverbalen nomina actionis im Korpus des Gjon Buzuku (1555)" [Parimet e fjalëformimit emëror në shqipen e vjetër dhe të nomina actionis verbal në korpusin e Gjon Buzuku (1555)]. *Studime* 14, 2007, 63-73.
- (Së bashku me Monica Genesin): "Il Bestiario Buzukiano tra onomasiologia e etimologia". *Hylli i Dritës* 3, 2007, 150-193.
- "Kritische Kurzbemerkungen zur nordalbanischen Toponomastik. Die Namen der urbanen Zentren im adriatischen Küstenbereich" ["Vërejtje kritike të shkurtra mbi toponomastikën e Shqipërisë veriore. Emrat e qendrave urbane në zonën bregdetare të Adriatikut"], in: M. Genesin, J. Matzinger (Edd.), *Nordalbanien – L'Albania del Nord*, Hamburg 2009, 87-98.
- "Nordalbanien und Martin Camaj" ["Shqipëria veriore dhe Martin Camaj"], in: M. Genesin, J. Matzinger (Hgg.), *Nordalbanien – L'Albania del Nord*, Hamburg 2009, 163-165.

- “*Die Albaner als Nachkommen der Illyrer aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft*” [“Shqiptarët si pasardhës të ilirëve nga këndvështrimi i gjuhësisë historike”], in: O. J. Schmitt, E. A. Frantz (Edd.), *Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung*, München 2009, 13-36.
- (Së bashku me Peter Mario Kreuter): “*Mite dhe fakte rreth etnogenezës dhe atdheut të hershëm të shqiptarëve: aspekte historike dhe gjuhësore diakronike*” [“Mythen und Fakten über die Ethnogenese und die Urheimat der Albaner”]. *Hylli i Dritës* 3, 2009, 154-165.
- “*Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischen Dokumentation*” [“Gjuha Shqipe në epokën e Skënderbeut, Pjesa 1: Gjuha e shkruar shqipe e koncentruar tek Paulus Angelus dhe Gjon Buzuku”], in: M. Genesin, J. Matzinger, G. Vallone (Edd.), *The Living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History*, Hamburg 2010, S. 41-69.
- “*Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2: Verschriftung des Albanischen mit Schwerpunkt auf Paulus Angelus und Gjon Buzuku*”, in: B. Demiraj (Hg.), *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, Wiesbaden 2010, 421-486.
- “*Illyrisch und Albanisch – Erkenntnisse und Desiderata*” [“Ilirishtja dhe Shqipja – Njohuri dhe Dëshira”] in: R. Nedoma, D. Stifter (Hgg.), *h2nr. *Festschrift für Heiner Eichner (Die Sprache 48, 2009)*, Wiesbaden 2010, 98-106.
- “*L’ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale (“Messale”) di Gjon Buzuku*” [“Rendi i emrave të shenjtorëve në litaninë e Gjithë Shenjtorëve në Manualin Pastoral (“Meshar”) të Gjon Buzuku”]. *Hylli i Dritës* 4, 2010, 54-70.
- (Së bashku me Prof. Dr. Monica Genesin): “*Das Lexem turk bei den alt-albanischen Autoren mit Ausblick auf Gjergj Fishta*” [“Leksema turk tek autorët e vjetër shqiptarë me përqëndrim tek Gjergj Fishta”], in: G. Belluscio, A. Mendicino (Edd.), *Scritti in onore di Eric Pratt Hamp per il suo 90. compleanno*, 2010, Cosenza: Università della Calabria, 115-130.
- *Recensioni i librit: “Bardhyl Demiraj (Hg.), Der Kongress von Mana-*

- stir, Herausforderung zwischen Tradition und Neuerung in der albanischen Schriftkultur*. 3. Deutsch-albanische kulturwissenschaftliche Tagung in München vom 7. bis 8. November 2008”, in: *Südost-Forschungen* 68, München 2009, 782-786.
- “*Eqrem Çabej dhe turqizmat në shqipen e vjetër*” [“E. Ç. und die Turzismen im Altalbanischen”], in: *Akademia e Shkencave* (Hg.), *Eqrem Çabej dhe vendi i tij në shkencat albanologjike. Në 100-vjetorin e lindjes së Eqrem Çabejt* [E. Ç. und seine Stellung in der Albanologie. Zum Centennium von E.Ç's Geburt], Tiranë 2009, 119-130.
 - “*Ein Beitrag zur Buzuku-Philologie: Die Anordnung der Heiligennamen in der Allerheiligenlitaniei des altalbanischen Seelsorgehandbuchs (“Missale”)*” [“Një kontribut në filologjinë e Buzukut: Renditja e Emrave të Shenjtorëve në litaninë e Gjithë Shenjtorëve në Manualin Pastoral (“Meshar”)]]. *Zeitschrift für Balkanologie* 47, 2011, 81-96.
 - “*Mass nouns in Old Albanian. The evidence of Gjon Buzuku’s “Missal” (1555)*”, in: M. V. Domosileckaja u.v.a. (Hgg.), *Sovremennaja albanistika: dostizhenija i perspektivy*. Sbornik statej, St. Peterburg, 231–251.
 - “*Shqiptarët si pasardhës të ilirëve nga këndvështrimi i gjuhësisë historike*”, in: O. J. Schmitt, E. A. Frantz (Hgg.), *Historia e shqiptarëve*, Tiranë 2012, 13-39 [= përkthimi i artikullit në Schmidt/Frantz nga viti 2009ë.
 - “*“Zwischensprachen” – Areallinguistische Bemerkungen aus dem Bereich des Balkanindogermanischen*” [“Gjuhët e ndërmjetme’ – Vërejtje lokale-gjuhësore në fushën e Indogjermanishtes ballkanike”], in: V. Sadovski, D. Stifter (Edd.), *Iranistische und indogermanistische Beiträge in memoriam Jochem Schindler (1944-1994)*, Wien 2012, 137–159.
 - “*Der lateinisch-albanische Sprachkontakt und seine Implikationen für die Vorgeschichte des Albanischen und der Albaner*” [Kontakti gjuhësor latino-shqip dhe implikimet e tij në prehistorinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve], in: W. Dahmen, G. Holtus, J. Kramer et alii (Hgg.), *Südosteuropäische Romania. Siedlungs-/Migrationsgeschichte und Sprachtypologie*, Romanistisches Kolloquium XXV, Tübingen 2012, 75–103.
 - “*Die Heiligenfeste, oder wie sich das Proprium de Sanctis und das*

- Commune Sanctorum im Seelsorgehandbuch des Gjon Buzuku (1555) präsentieren* ["Festat e shenjta, ose si prezantohen Proprium de Sanctis dhe Commune Sanctorum në Manualin Pastoral të Gjon Buzukut (1555)"], in: B. Demiraj (Ed.), Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie. Akten der 4. Deutsch-Albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung "50 Jahre Albanologie an der LMU München", Wiesbaden 2012, 270–293.
- "Zur Herkunft des Albanischen. Argumente gegen die thrakische Hypothese" ["Mbi Origjinën e Shqipës. Argumentet kundër hipotezës trake"], in: Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65-vjetorit të lindjes, Prishtinë 2012, 635–649.
 - "Nuovi indizi su Buzuku. Alcune osservazioni sul volume 'Shqipëria e rigjetur – Albania ritrovata' di Lucia Nadin" ["Të dhëna të reja mbi Buzukun. Disa komente mbi volumin 'Shqipëria e rigjetur – Albania ritrovata' të Lucia Nadin"]. Hylli i Dritës 1-2, 2013, 76–83.
- "Shqip bei den altalbanischen Autoren des 16.-18. Jahrhunderts". Zeitschrift für Balkanologie 49, 2013, 103–122.
- *Recensioni i librit: "Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit (Romë 1706)*, Botim kritik. Teksti kritik, përgatitur dhe pajisur me shënime si edhe me konkordancat leksikore nga Bardhyl Demiraj". Shkodër 2012, in: Kratylos 58, 2013, 223–226.
 - *Recensioni i librit: "Hermann M. Ölberg, Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems*, Wiesbaden 2013, in: Zeitschrift für Balkanologie 49/2, 2013, 281-285.
 - "Das Lexikon der sexuellen Sphäre bei den altalbanischen (altgehischen) Autoren" ["Leksikoni i sferës seksuale tek autorët e vjetër shqiptarë"]. Zeitschrift für Balkanologie 50, 2014, 28-45.
 - (Së bashku me Monica Genesin): "La formazione di imperfetto e aoristo nella varietà arbëreshe di San Marzano di San Giuseppe (TA)": alcune osservazioni fra diacronia e sincronia ["Formimi i të pakryerës dhe i aoristit në varietetin arbëreshe të San Marzano di San Giuseppe (TA)": disa vëzhgime në mes të diakronisë dhe sinkronisë"], in: B. Demiraj, M. Mandalà, Sh. Sinani (Edd.), Edhe 100! Studime Në nderim të Prof. Francesco Altmarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes, Tiranë 2015, 203-226.

- “*Messapico e illirico*”, in: A. Romano (Hg.), *Le lingue del Salento* (= L’ Idomeneo 19), Lecce 2015: Università del Salento – Coordinamento SIBA 57-66.
- (Së bashku me Thomas Christiansen e Monica Genesin): “*Metaphors and Metonymy regarding Body Parts in the Kamuni i Lekë Dukagjinit and in Old Geg Documents*”, in: B. Demiraj (Ed.), *Sprache und Kultur der Albaner. Zeitliche und räumliche Dimensionen. Akten der 5. Deutsch-albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung* (5.-8. Juni 2014, Buçimas bei Pogradec in Albanien), Wiesbaden 2015, 309-343.
- “*Das altalbanische Wortbildungsmuster auf -ës und malës ‘Bergbewohner; Gebirge’*”, in: S. Neri, R. Schuhmann, S. Zeilfelder (Edd.), “*dat ih dir it nu bi haldi gibu*”. *Linguistische, germanistische und indogermanistische Studien Rosemarie Lühr gewidmet*, 2016, Wiesbaden 2016, 281-286.
- (Së bashku me Monica Genesin): “*Albanian*”, in: P. O. Müller, I. Ohnheiser, S. Olsen, F. Rainer (Edd.), *Word-Formation. An International Handbook of the Languages of Europe* (HSK 40.5), 2016, Berlin, New York: de Gruyter Verlag, ISBN 978-3-11-043094-3, S. 3124-3137.
- (Së bashku me Monica Genesin): “*Albanian*”, in: P. O. Müller, I. Ohnheiser, S. Olsen, F. Rainer (Hgg.), *Word-Formation. An International Handbook of the Languages of Europe* (HSK 40.5), 2016, Berlin, New York: de Gruyter Verlag, ISBN 978-3-11-043094-3, S. 3124-3137.
- “*Fjalori seksual te autorët e shqipes së vjetër (gegërishtes së vjetër)*”, in: O. J. Schmitt (Hg.), *Për Ardian Klosin gjermanin nga Shqipëria, Tiranë 2016: 77-102. [= Version shqip i artikullit të vitit 2014].*

4. Innsbruck, Vjenë dhe vende të tjera: Stefan Schumacher (shih gjithashtu Ismajli, shënimi nr. 1)

Gjuhëtari austriak **Stefan Schumacher** lindi në vitin 1963 në Tirol. Studioi në Universitetin e Innsbrekut në degën e Gjuhësisë Indoevropiane si dhe në degë të tjera, si ajo e Parahistorisë.

Në vitet 1991-1994 Schumacher a shkruar disertacionën e tij në Universitetin e Maynooth në drejtimin e prof. Kim MacCone. Fryti i kësaj pu-

nës është libri me titullit "The historical Morphology of the Welsh Verbal Noun", Maynooth 2000.

Më vonë Schumacher punoi në Universitetin e Halle – Wittenberg të Gjermanisë si bashkëpunëtor në fushën kërkimore. Punimi i tij për gradën akademike të *habilitacionit* (të aftësisë së tij si ligjërues) titullohet:

- "Die keltischen Primärverben. Ein vergleichendes, etymologisches und morphologisches Lexikon" ["Foljet primare kelte. Një leksikon krahasues, etimologjik dhe morfologjik"]. Ky punim u botua në vitin 2004 dhe përmban rreth 800 faqe.

Që nga viti 2002 punoi si profesor i ftuar (profesor me kontratë) në Universitetin e Vjenës dhe që nga vitit 2008.

Në semestrin e verës të vitit 2007 punoi për një kohë të shkurtër si profesor i ftuar në Mynih në Institutin për Gjuhësi dhe Albanologji.

Gjuhën shqipe e mësoi që prej gjatë studimit e tij të masterit në Universitetin e Innsbrukt pranë profesor Hermann M. Ölberg (lindi më 1922, vdiq në Shkurt 2017 në moshën 95 vjeçare).

Për këtë arsye ai ishte i përgatitur shumë mirë për projektin e tij të madh mbi foljen e gjuhës Shqipe. Libri, ili është shkruar së bashku me Joachim Matzinger-in, shih § 3) u botua në vitin 2013 nga shtëpia botuese Harrassowitz. Libri titullohet:

- "Die Verben des Altalbanischen". Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie ["Foljet e shqipes së vjetër. Fjalori i dëshmive, parahistoria dhe etimologjia.] Wiesbaden: 2013 (Albanische Forschungen 33), 1055 faqe.

Ky libër është një punë e monumentale dhe e shkëlqyeshme. Ai përmban mbi një mijë faqe. Libri është fryt i një projekti kërkimor të financiar. Ai përmban një përmbledhje të plotë të formave foljore në tekstet e vjetra të gjuhës shqipe. Vepra e Fiedler-it mbi Buzukun u përdor si referencë për format foljore në këtë tekst. Siç u përmend më herët (§ 3), Joachim Matzinger-i mblodhi shëmbujt në tekstet e Matrëngës, të Varibobës, e të Pjetër Budit. Megjithatë pjesa më e madhe e vlerësimit historik gjuhësor i përket Schumacher-it. Libri përmban ndër të tjera:

- një përshkrim të ri analitik të sistemit foljor të gjuhës shqipe,

- historinë e kategorive të veçanta, si imperfekt (koha e pakryer), aorist, optativ (mënyra dëshirore),

- një trajtim të ri e të detajuar historik të fonologjisë së gjuhës shqipe,
- një kapitull mbi etimologjitë e përzgjedhura

Libri është shkruar në gjuhën gjermane, përmban gjithashtu udhëzime në gjuhën shqipe për përdorimin e fjalorit.

Në sajë të këtij libri dhe të punimeve të tjera Schumacher u emërua profesor i asociuar në Institutin e Linguistikës të Vjenës nga vitit 2008 me kontratë të pakufizuar.

Schumacher-i ka botuar përveç kësaj vepre edhe artikuj e recensione mbi gjuhën shqipe:

- "Altalbanisch mund /mundë/ 'können' und semuhem, -ete /sëmuhem, -etë/", in: Albanologische und balkanologische Studien, Festschrift für Wilfried Fiedler, edd. Monica Genesin, Joachim Matzinger, Hamburg 2005, 151-168.

- "Zur Form des gegischen Infinitivs" ["Mbi formën e infinitivit të gegërishtes"], in: Indogermanica. Festschrift für Gert Klingenschmitt, ed. Günter Schweiger, Taimering 2005, 561-577 (auch in: Nach 450 Jahren, Buzukus >Misa-sale< und seine Rezeption in unserer Zeit. 2. Deutsch-Albanische kulturwissenschaftliche Tagung in München vom 14. bis 15. Oktober 2005, ed. Bardhyl Demiraj, Wiesbaden 2007, 149-168).

- "Kontinuanten urindogermanischer Wurzeloriste im Albanischen, Teil I: Wurzelaoriste mit frühuralbanischem Stamm auf Vokal oder auf -s" ["Vazhduesit e rrënjëve aoriste të indoeuropianishtes së vjetër, pjesa e parë: Rrënjë aoriste me trung të shqipes së vjetër të hershme me zanore ose me -s"]. International Journal of Diachronic Linguistics and Linguistic Reconstruction 4, 2007, 207-280.

- "Lehnbeziehungen zwischen Protoalbanisch und balkanischem Latein bzw. Romanisch" ["Marrëdhëniet huazuese midis protoshqipes, latinishtes ballkanike dhe rumanishtes"]. In: Die Albaner auf dem westlichen Balkan, edd. Konrad Clewing, Oliver J. Schmid, Wiesbaden 2009, 37-59.

- The development of the PIE middle in Albanian. In: Etymology and the European Lexicon, edd. Bjarne Simmelkjær Sandgaard Hansen et alii, Wiesbaden 2016, p. 385-400.

5. Mbyllje

Në fund të ligjëratis sime mund t'i përmbledh karakteristikat e veçanta të grupit të studiuesve Klingenschmitt-Matzinger-Schumacher si më poshtë:

Të tre studiuesit vijnë nga dega e gjuhësisë indoeuropiane dhe kanë hulumtuar intensivisht gjuhë të ndryshme indoeuropiane. Me kalimin e kohës janë bërë albanologë.

Në fushën kërkimore ato janë specializuar në historinë gjuhësore. Në këtë fushë ata sjellin shumë ide të reja produktive. Këto ide janë trajtuar me shumë hollësi. Punimet e tyre shkencore janë të bazuara në një hulumtim të saktë të burimeve të gjuhës shqipe nga pikëpamja filologjike.

Faleminderit për vëmendjen Tuaj!

Bahri BECI, Paris

J. G. HAHN PËR HISTORINË E DY DIALEKTEVE TË SHQIPES DHE REAGIMET NDAJ PIKËPAMJEVE TË TIJ

J. G. Hahn për ndarjen e shqipes në dy dialekte

J. G. Hahn më 1854 në librin e tij “Studime shqiptare” shkruante se “Populli shqiptar ndahet në dy *fise* kryesore, në *toskë*, që banojnë në Shqipërinë e Jugut (me gjithë krahinën e Beratit) dhe në *gegë*, që banojnë në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut”¹.

“Emnin “toskë”, në dallim me “gegë”, e përdorim (...) për të gjithë shqiptarët e jugut. Por kjo hapësirë tokësore e ka këtë emën vetëm te gegët dhe fqinjët e tjerë të Shqipërisë së Jugut, sepse në vend të vet ka një kuptim shumë ma të ngushtë. Toskëni quhet këtu një krahinë e vogël që shtrihet në veriperëndim të Tepelenës mbi bregun verior të Vjosës së Poshtëme. Por, kur i pyesin banorët shqiptarë të Gjirokastrës, Zagorisë, Përmetit dhe Dangëllisë (d. m. th. ata të gjithë që flasin shqip në krahinën e Vjosës së Sipërme) për emnin, i cili i dallon nga shqiptarët e tjerë të Jugut, ata përgjigjen se jemi *toskë*. Por ky emën nuk përdoret kurrë për *beratasit* që banojnë në veri të këtyne krahinave, dialekti i të cilëve ka shumë fjalë gegnishte, megjithëqë bazën e ka toskënisht”².

“Kufini që i ndan këto dy dialekte, vijonte ai, deri më sot nuk asht caktue me siguri, por nuk mund të jetë shumë larg atij kufini natyror që shkon mes *gegërisë jugore* dhe *toskërisë verior*”³.

Në një rast tjetër ai ritheksonte se “kufinin e gjuhës në mes toskëve

¹ J. G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 27 (titulli në original: Dr. jur. Johan Georg von Hahn, *Albanesischen studien*, Jena, 1854).

² J. G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 30-31.

³ J. G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 27. Në tekst është shkruar “Kufini që i ndan këto dy dialekte deri më sot nuk asht caktue me siguri, por nuk mund të jetë shumë larg atij kufini natyror që shkon mes grumbullit të dytë (kishte parasysh territorin e *gegërisë jugore*) dhe të tretë (kishte parasysh territorin e *toskërisë verior*)”

dhe të gegëve e formon Shkumbini (...); në jug të këtij lumi sot nuk ka ma gegë, por në pjesën veriore të krahinës së Beratit flasin një dialekt, i cili është toskënisht, ndonëse ka shumë elementë nga gegnishtja. Gjithashtu elementë të gegnishtes gjëjmë edhe në dialektin që flasin banorët e fushës së Vjosës së Sipërme përreth Përmetit”⁴.

“Katër orë larg prej Beratit dhe Elbasanit, shkruante J. G. Hahn, shkon një lumë që derdhet në veri të Semanit; ky është lumi i Sulovës. Thuhet se në veri të këtij lumi njerëzit flasin gegënisht, kurse në jug të tij toskënisht”⁵.

J. G. Hahn për vjetërsinë e dy dialekteve të shqipes

“Përsa i përket karakterit të dy dialekteve shqiptare dhe marrëdhënies në mes tyre, shkruan J. G. Hahn, mund të themi se këto ndryshojnë si gjermanishtja, suedishtja dhe danishtja. Koha e ndarjes së tyre bie të ketë qenë në kohët prehistorike dhe nuk është e mundur me caktim, se kush ka dalë prej tjetrit. Sepse megjithëqë dialekti i gegëve përmban disa trajta të vjetra, në anë tjetër shumë forma të zbutura të toskënishtes janë shumë të lashta (...)”⁶.

“Mbas një mendimi të përgjithshëm, duket se është Shkumbini kufiri në mes Toskënisë dhe Gegënisë. E vërteton këtë, vijonte ai, një shënim i Strabonit se ky kufi i gjuhës është shumë i vjetër (...)”⁷.

J. G. Hahn, pra, është i pari që ndarjen e sotme dialektore në gegërishte dhe toskërishte e çonte në rrethanat e kohës antike.

J. G. Hahn për vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes

J. G. Hahn nuk e ka shtruar problemin e vendit të formimit të dy dialekteve të shqipes drejtpërsëdrejti. Drejtpërsëdrejti ai ka shtruar këto pyetje: *Kush janë shqiptarët? Rrjedhin këta prej banorëve të lashtë të vendit dhe koha e sllavëve është vetëm një episod në historinë e Shqipërisë, apo kanë ardhë këtu në Kohën Historike, si edhe sllavët, që formojnë shtresën e tretë*

⁴ J. G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 295.

⁵ J. G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 27 f. 48, shën 34.

⁶ G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 295-296.

⁷ G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 27.

të popujve, që janë vendosë në tokën shqiptare, por që nuk janë aspak farefis me ta?

Dhe jepte këto përgjigje “me që shqiptarët nuk janë sllavë dhe nuk kanë farefisni me asndonji popull të njoftun, mbasi edhe burimet e pakta nuk lajmërojnë tjetër imigracion, përveç atij të sllavëve, atëherë duhet të pranojmë që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e banorëve të lashtë të vendit, që kanë qenë këtu para se me ardhë sllavët”⁸ ose “stërgjyshnit e shqiptarëve të sotëm, kanë banuar në ato vende që zotnojnë shqiptarët sot, qysh në kohën e romakëve dhe të grekëve (...)”⁹.

Për pasojë J. G. Hahn edhe formimin e dy dialekteve të shqipes e vendoste në territoret e tyre të sotme. “Shkumbini i ndan edhe sot gegët prej toskëve, shkruante ai, si pat nda dikur ilirët prej epirotëve(...) të cilët ishin farefis shoq me shoq”¹⁰.

J. G. Hahn për shkaqet e formimit të dy dialekteve të shqipes

Shkakun e krijimit të dy dialekteve të shqipes J. G. Hahn e gjente në praninë e ilirishtes dhe të epirotishtes, folësit e të cilave, sipas Hahn-it ishin farefis.

“Po të ndjekim Rrugën Egnatia (që shkon buzë Shkumbinit), tue dalë prej rrethit të Epidamnit (Durrës) dhe Apolonisë (Pojanit), në krahun e djathtë, shkruante ai, do të kemi fiset epirote (...) deri ke gjiri i Ambrakisë, ndërsa në të majtë malësinë e Ilirisë (...)”¹¹.

Lidhur me rrugën Egnatia, duke ju referuar Strabonit, Hahn-i shkruante “Ai që ndjek këtë rrugë prej Apollonie, ose prej Epidamnit, ka djathtas popujt e Epirit, të cilët shtrihen deri te gjini i Ambrakisë (...). Majtas ka malet e Ilirisë (...)”¹².

“Për Strabonin, vijonte Hahn, kjo rrugë (rruga “Egnatia”) nuk ishte vetëm një kufi politik, por edhe një kufi etnik që ndante në përgjithsi fiset ilire prej atyne epirote (...).

Po ta krahasojmë përshkrimin e Strabonit me gjendjen e sotme, vi-

⁸ G. von Hahn, **Studime shqiptare**, Tiranë 2013, f. 289.

⁹ G. von Hahn, **Studime shqiptare**, Tiranë 2013, f. 290.

¹⁰ G. von Hahn, **Studime shqiptare**, Tiranë 2013, f. 296.

¹¹ G. von Hahn, **Studime shqiptare**, Tiranë 2013, f. 27.

¹² G. von Hahn, **Studime shqiptare**, Tiranë 2013, f. 294.

jonte ai, do të shohim se ky përshkrim i përshtatet kësaj gjendjeje ma mirë se sa asaj në kohën e shkrimtarit”¹³.

Sipas Hahn-it “në qoftë se gegët dhe toskët janë pjesë të një trangu të përbashkët kombëtar (...), në qoftë se flasim dy dialekte të ndryshme t’asaj gjuhe; në qoftë se kufini i gjuhës asht atje ku e cakton Straboni kufinin në mes ilirëve dhe epirotëve; në qoftë se epirotët nuk janë helenë, por barbarë, atëherë na duhet të pranojmë që ka shumë mundësi që n’ato kohna të vjetra gjendja ka qenë ashtu sikundër asht edhe sot dhe se epirotët i përkitin fisit të ilirëve (...)”¹⁴.

Reagimet lidhur me pikëpamjet e J. G. Hahn-it

Reagimet lidhur me ndarjen e shqipes në dy dialekte

Studiuesit pas Hahn-it, pa përjashtim, në pajtim me të, kanë pranuar që shqipja dialektore ndahet në dy krahina dialektore ose dialekte, krahina dialektore e veriut ose gegërishtja dhe krahina dialektore e jugut ose toskërishtja. Po kështu, të gjithë studiuesit pas Hahn-it, në pajtim me të, kanë pranuar Shkumbinin si kufi ndarës të dy dialekteve të shqipes.

Mospajtime ka pasur lidhur me të folmet poshtë Shkumbinit, të ashtuquajturat “të folme kalimtare”¹⁵, po kjo problematikë del jashtë objektivit të këtij punimi.

Reagimet lidhur me kohën e formimit të dy dialekteve të shqipes

Studiuesit pas Hahn-it, kam këtu parasysh: G. Meyer-in, N. Jokl-in, C. Tagliavini-n, E. Çabejn, V. Polák-un, A. V. Desnickaja-n, J. Gjinarin nuk e kanë pranuar pikëpamjen e J. G. Hahn-it mbi vjetërsinë e dy dialekteve të shqipes.

G. Meyer, duke interpretuar pikëpamjen e J. G. Hahn-it që pranonte vjetërsinë e dy dialekteve të shqipes, ndër të tjera ka shkruar se “kjo është e

¹³ G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 295.

¹⁴ G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 295.

¹⁵ Për këtë shih B. Beci, *Struktura dialektore e shqipes*, Tiranë 2016, f. 320-330.

mundshme, madje do të thosha që *ka gjasë të jetë*, por *nuk është aspak e provuar* (...). Në çdo rast ndryshimi i sotëm në mes të gegërishtes dhe toskërishtes, i cili në fund të fundit nuk është edhe aq i madh, mund ta ketë burimin nga një *dallim i mëvonshëm*. Studimi i shqipes së folur në Greqi më bën të ruaj këtë mendim si më të pranueshëm¹⁶.

N. Jokl-i, lidhur me pikëpamjen e J. G. Hahn-it, shtonte: “Theod. Benfey një ndarje kaq të vjetër e *ka vënë në dyshim*, por pa argumentuar *skepticizmin* e tij. Ndërkaq, nuk është e vështirë për vëzhguesin gjuhëtar të vërtetojë *risinë relative* të ndarjes dialektore të zënë në gojë më sipër¹⁷.”

Edhe C. Tagliavinii ka shkruar se ndryshimi ndërmjet toskërishtes e gegërishtes është *relativisht i vonë* dhe nuk mund ta ketë burimin tek ndryshimi midis gjuhës së ilirëve dhe epirotëve siç besonte Hahn-i¹⁸.

Edhe E. Çabej më 1967 ai ritheksonte se “në kundërshtim me J. G. von Hahn-in, i cili ndarjen e sotme dialektore në gegërisht e toskërisht e shpie në rrethanat e kohës antike duke e vënë në lidhje me ilirishten e epirotishten, G. Meyer, duke pasur parasysh dhe shqipen që flitet në Greqi, me të drejtë anon ta çojë këtë dallim te një diferencim më i vonë. Kështu afërsisht dhe N. Jokl-i mendon se nuk është vështirë të vërtetohet risia relative e ndarjes dialektore. Edhe të tjerë dijetarë, si J. Rrota, G. Petrotta, C. Tagliavinii, M. La Piana, në bazë të një krahasimi të literaturës së moçme të gegërishtes të shekullit 16 e 17 me toskërishten e vjetër që ruhet sidomos në kolonitë e Italisë jugore e të Sicilisë, kanë mbrojtur pikëpamjen se dy dialektet kryesore kanë qenë më afër dhe se vetëm në këta shekujt e fundit u larguan nga njëri-tjetri¹⁹.”

Edhe V. Polák, duke ju referuar G. Meyer-it, N. Jokl-it e O. Myde-

¹⁶ G. Meyer, *Della lingua e della letteratura albanese*, **Nouva Antologia**, 50, 1885, f. 588.

¹⁷ N. Jokl, *Albanisch, Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch Franz Bopp*, II, Strasburg 1917, f. 17.

¹⁸ C. Tagliavinii, *La lingua albanese*, **Studi albanesi**, V-VI, 1935-1936, f. 9.

¹⁹ E Çabej, *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes*, **Studime Gjuhësore**, IV, Prishtinë, 1977, f. 190-191. Botuar së pari në gjermanisht në **Zeitschrift für Mundartforschung** Beihefte. Neue Folge, 3 und 4, Verhandlungen des zweiten internationalen Dialektologen Kongresses, Marburg, 1967, f. 136- 145; botuar shqip edhe në **Dialektologjia shqiptare**, II, Tiranë, 1974, f. 429-438.

rrizit ka shkruar se tiparet kryesore të dialekteve gege dhe toske shfaqen “si fenomen relativisht i ri, si tipare diferencuese të dialekteve të lindura në shekullin gjashtëmbëdhjetë dhe shtatëmbëdhjetë”²⁰.

A. V. Desnickaja nuk e zë në gojë J. G. Hann, po u referohet studiuësve shqiptarë për vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes. “Filologët shqiptarë, shkruante ajo, mendojnë se për hartën linguistike të Shqipërisë ndarja më e rëndësishme në krahinat dialektore gege dhe toske është krijuar *gradualisht* dhe *nuk është aq e vjetër*”.

“Me sa mund të gjykojmë nga të dhënat e dialektologjisë historike, harta linguistike e Shqipërisë, në atë trajtë siç është e përshtatur për të hulumtuar dhe studiuar në kohën e sotme, në pjesën më të madhe të dukurive dhe të marrëdhënieve të saj është formuar *gjatë shek. XV—XIX* (në periudhën e *sundimit të turqve* në Ballkan)”.

“Me këto supozime linguistike, vijon ajo, në një masë përputhen përfundimet e arritura nga Rrok Zojzi, i cili e lidhte formimin e krahinave të ndryshme etnografike, që kanë marrë emrin *Gegëri* dhe *Toskëri* me krijimin në shek. XVIII të dy shteteve feudale atë të *Bushatlive* në veri të Shqipërisë dhe atë të *Ali-Pashë Tepelenës* - në jug”²¹.

A. V. Desnickaja, edhe pse mendonte se ndarja dialektore e shqipes në dy krahina dialektore, në atë të jugut dhe të veriut, është e re, pranonte që baza linguistike e saj është e *moçme*”²².

Sipas saj “izoglosa më karakteristike, që ka ndarë dy krahinat dialektore - dukuria e rotacizmit në toskërishte, është krijuar shumë më herët se koha e sundimit turk. Me siguri, ajo ka kaluar nëpër arealet gjuhësore të shqipes qysh në periudhën e *ndarjeve të vjetra të fiseve*, prej të cilave sot nuk është ruajtur asnjë gjurmë. Në qoftë se nuk është e drejtë t’i quajmë grupet e vjetra të të folmeve shqipe, të ndara me këtë izoglosë, “toskë” dhe “gegë”, atëherë duhet t’i quajmë “grupet e të folmeve të rotacizuara” dhe

²⁰ V. Polák, *Albánci a Slovené (Vznik a počátky dnešních nářečních variant albánských)*, *Časopis pro moderní filologii*, XXXIX - Číslo 2-3, Prague 1957, f. 86.

²¹ A.V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë 1972, f. 41. Aty, f. 44, ka shkruar se “gjendja gjuhësore e “gegërishtes së vjetër” dhe e “toskërishtes së vjetër” vihet brenda *periudhës së re të hershme të shqipes* (shek 16-18 BB)”.

²² A. V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë 1972, f. 42.

“grupet e të folmeve të pa rotacizuara”. Mirëpo, gjersa ndarja e vjetër sipas kësaj veçorie shfaqet plotësisht në ndarjen bashkëkohore në krahinat dialektore toske dhe gege, patjetër duhet të pranojmë se baza *linguistike* e kësaj të fundit prapëseprapë është e moçme²³.

Më 1968 Gjinari, duke iu referuar Çabejt²⁴, pranonte se “në kohën e ardhjes së sllavëve në Ballkan *po formoheshin tiparet më relevante e më të lashta* që dallojnë sot toskërishten e gegërishten (...)”²⁵.

Më 1969 ai pohonte se shumica e tiparet dalluese të dy dialekteve kryesore është e re; vetëm ndonjë ka zënë fill aty nga koha e sundimit romak. Po kështu kufiri i sotëm gjeografik që ndan gegërishten e toskërishten, shkruante ai, “ka shumë të ngjarë që të jetë krijuar relativisht vonë”²⁶.

Pra, lidhur me vjetërsinë e dy dialekteve të shqipes deri më 1969 thelbi i pikëpamjes së J. Gjinarit ishte se kufiri gjeografik i sotëm që ndan gegërishten me toskërishten “ka shumë të ngjarë që të jetë krijuar relativisht vonë...”²⁷.

Më 1975, duke folur për dukurit dialektore të dy dialekteve të shqipes ka shkruar se “Disa veçori kryesore që dallojnë dy dialektet shqipes, të atyre që ne sot i quajmë gegërishte dhe toskërishte, kanë filluar të duken që

²³ A. V. Desnickaja, **Gjuha shqipe dhe dialektet e saj**, Prishtinë 1972, f. 42.

²⁴ E. Çabej, *Disa faza më të moçme të shqipes në dritën e gjuhëve fqinje*, **Studime gjuhësore**, Prishtinë 1977, f. 304-320. E. Çabej pasi pranonte që “degëzimi dialektor i shqipes është i ri”, shënonte se “Një premje vertikale në shtresimin historik të dialekteve na tregon se procesi i formimit të tyre ka qenë shumë më laraman e i komplikuar nga sa mund të dalë nga një vështrim që t’i hidhnim planit të rrafshët që duket sot. Ndarja dialektore në një fazë të mëparme të gjuhës nuk ka qenë ajo që është sot. Ajo që ne quajmë gegërishte e toskërishte, që ne shikojmë si dy grupe kryesore me tipare vetiake dalluese, me përhapjen territoriale dhe me zberthimin e tyre të mëtejme, është diçka që u bë e u zhvillua me kohë. Nga tiparet karakteristike që zënë kryet e vendit në strukturën dialektore të sotmen, disa më parë për një pjesë nuk kanë ekzistuar aspak, për një pjesë kanë qenë të dorës së dytë; e nga të tjerat përkundrazi, që sot paraqiten si të parëndësishme, disa pas gjase kanë qenë të dorës së parë” (*Disa faza*, f. 305, 320).

²⁵ J. Gjinari, *J. Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, **Studime filologjike**, nr. 4, Tiranë 1968, f. 142.

²⁶ J. Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve* (Sesion shkencor, 3-4 mars 1969), Tiranë 1969, f.163.

²⁷ J. Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishtes në gjuhën shqipe, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve* (Sesion shkencor, 3-4 mars 1969), Tiranë 1969, f. 163.

në kohën e vonë antik e në fillim të mesjetës, kështu. p.sh. rotacizmi i toskërishtes (*verë* për *venë* etj.), kalimi i *a*-së hundore në *ë* (*nëna* për *nāna* etj.) dhe lindja e grupit *vo* për gegërishten e *va* për toskërishten (*vatër* / *vo-tër*) e ndonjë tjetër. Dukuria dialektore e rotacizmit, me përjashtime fare të pakta, nuk ka përfshirë fjalët sllave të hyra në gjuhën shqipe. Duke u mbështetur në këtë fakt të historisë si gjuhës sonë, është menduar se rotacizmi nuk është më i vonë se koha e ardhjes së sllave në viset tona, pra jo më i ri se shekujt VI-VII ose VIII”²⁸.

“Nuk mund të thuhet gjë me siguri, se cila ka qenë *shtrirja territoriale e këtyre veçorive*... Nuk dihet nëse këto shtriheshin, ashtu sikurse edhe sot, nga skaji jugor deri në bregun e majtë të Shkumbinit ku ndahen toskërishtja dhe gegërishtja, apo kanë pasur një përhapje më të vogël ndoshta edhe më të gjerë, duke u shtrirë sidomos më në lindje dhe verilindje të trevës që zë sot toskërishtja”²⁹.

Sipas Gjinarit “degëzimi dialektor i sotëm i shqipes (...) është formuar gjatë kohëve duke pësuar herëpashere ndryshime, gjersa arriti në gjendjen që ka sot. Rruga që kanë ndjekur dialektet në zhvillimin e tyre nuk ka qenë gjithmonë e drejtë, ka pasur *zikzaket e veta* dhe ka qenë e *ndërlikuar (...)*”³⁰.

Pra, J. Gjinari, më 1969 pranonte se “Kufiri gjeografik që ndan gegërishten me toskërishten ka shumë të ngjarë që të jetë krijuar *relativisht vonë*”³¹, kurse më 1975, pasi pranonte vjetërsinë e formimit të disa dukurive dialektore që veçojnë dy krahinat dialektore të shqipes, theksonte se “*nuk mund të thuhet gjë me siguri, se cila ka qenë shtrirja territoriale e këtyre veçorive në atë kohë*”, për pasojë edhe e të dy krahinave dialektore të shqipes, asaj të Shqipërisë së Veriut dhe të Shqipërisë së Jugut.

Konkluzioni në të cilin arrinte më 1988 dhe në vijim ishte se “Kjo ndarje dialektore e gjuhës shqipe dhe kjo ndarje krahinore e popullit tonë *morën formën që kanë sot* aty nga fundi i shekullit XVIII dhe fillimi i she-

²⁸ J. Gjinari, **Dialektologjia shqiptare**, Tiranë 1975, f. 54-55.

²⁹ J. Gjinari, **Dialektologjia shqiptare**, Tiranë 1975, f. 55.

³⁰ J. Gjinari, **Dialektologjia shqiptare**, Tiranë 1975, f. 51.

³¹ J. Gjinari, *Mbi vazhdimësinë e ilirishes në gjuhën shqipe, Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve* (Sesion shkencor, 3-4 mars 1969), Tiranë 1969, f.163

kullit XIX para Lëvizjes sonë Kombëtare. Në këtë kohë erdhën e u dalluan dy ndarje të mëdha krahinore, *Toskëria në Jug* dhe *Gegëria në Veri*, që përbëheshin nga njësi të tjera krahinore më të vogla. Nga pikëpamja gjuhësore në këto dy zona dalloheshin dy ndarje të mëdha dialektore: *gegërishtja në Veri* dhe *toskërishtja në Jug* me nënndarjet e tyre.

Aty nga fundi i shekullit XVIII, në këto dy krahina të mëdha, shihen përpjekjet e Ali Pashë Tepelenës në Jug dhe të Bushatllinjve në Veri për të formuar dy shtete feudale të shkëputura nga Turqia. Këto qenë përpjekje të një përqendrimi politik-ekonomik brenda kuadrit feudal separatist³².

Në dallim nga autorët e mësipërm, edhe disa studiues rumunë, pa ju referuar G. Hahn-it, po duke u nisur nga disa ngjashmëri midis toskërishtes dhe dialekteve rumune, në mënyrë indirekte e kanë pranuar vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes.

Do të veçoja këtu gjuhëtarët A. Philippide, G. Bonfante, G. Brâncuș etj.³³ Përveç këtyre edhe gjuhëtari amerikan E. Hamp, më 1966 ka shkruar se “dallimet midis dy dialekteve të shqipes janë zhvillime të brendshme të kësaj gjuhe dhe dukuritë më të vjetra dialektore(...) i përkasin periudhës pasromake të shqipes³⁴.

Reagimet lidhur me vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes

Studiuesit pas Hahn-it, kam parasysh këtu G. Meyer, N. Jokl, C. Tagliavinii, E. Çabej, V. Polak, A. V. Desnickaja, të cilët nuk e kanë pranuar vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes, nuk e kanë vënë në diskutim formimin e dy dialekteve të shqipes në territoret e tyre të sotme.

³² J. Gjinari, **Dialektologjia shqiptare**, Tiranë 1988, f. 118; **Dialektet e gjuhës shqipe**, Tiranë 1989, f. 90; J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, **Dialektologjia**, Tiranë 1997, f. 196; **Dialektologjia**, Tiranë 2013, f. 173.

³³ A. Philippide, **Originea romanilor II. Ce spun limbile romana si albaneza**, Iași 1927, f. 587. G. Bonfante, **Ilirishnja dhe shqipja**, **Kuvendi i studimeve ilire** (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë, 1974, 99-103; G. Brâncuș, **Vocabularul autohton al limbii române**, 1983, 164; **Cercetări asupra fondului traco-dac al limbii române**, București 1995, 116.

³⁴ E. P. Hamp, **The poposition of Albanian**. në **Ancient Indoerpean Dialects**, Berclay and Los Angeles 1966, f. 98.

Në dallim prej tyre J. Gjinari, më 1988, pasi pranonte që “kufiri gjeografik i dy dialekteve kalon përafërsisht gjatë rrjedhës së lumit Shkumbin”, shkruante se “Nuk mund të mos të shkojë mendja e të pyesësh, ky kufi i dialekteve a është që nga koha *kur lindën dhe po merrnin formën* e tyre këto dialekte apo u formuan dialektet *diku në një vend tjetër* dhe më vonë erdhën e zunë vend përballë njëri-tjetrit këtu ku janë sot në brigjet e Shkumbinit. Kësaj pyetjeje i jep përgjigje vetëm mënyra e vendosjes së izoglosave, të tufës që formon kufirin e dialekteve.

Te Shkumbini *nuk* bëhet përnjëherë kalimi nga njëri dialekt në tjetrin. Përgjatë bregut të majtë të këtij lumi shtrihet një zonë të folmesh ku dalin të përziera tiparet dalluese qenësore më të vjetra të dialekteve. Izoglosat e këtyre tipareve dalluese nuk formojnë një tufë të ngjeshur vijash, ato kalojnë aty disi të larguara nga njëra-tjetra (...).

Kjo tufë e hapur izoglosash, disa prej të cilave edhe pleksen me njëra-tjetrën, tregon qartë se zona pak a shumë e gjerë e të folmeve kalimtare ndërmjet dy dialekteve është formuar prej kohësh *dalengadalë* në brigjet e Shkumbinit³⁵, për pasojë edhe dy dialektet e shqipes.

Në dallim prej studuesve të mësipërm, disa studues, pa iu referuar direkt Hahn-it, si A. Philippide, G. Bonfante, G. Brâncuş etj., duke u nisur nga ngjashmëritë që janë vënë re midis toskërishtes dhe dialekteve rumune e zhvendosnin vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes në verilindje të territoreve të sotme shqiptare, diku në afërsi me dialektet rumune.

Kështu për shembull A. Philippide-ja më 1927 pranonte se toskërishtja ngjashmëritë më të mëdha i kishte me dako-rumanishten, në mënyrë të veçantë me pjesën perëndimore të dako-rumanishtes³⁶. Duke u nisur nga ngjashmëritë gjuhësore të këtyre dy gjuhëve A. Philippide mendonte se midis rumunëve e shqiptarëve ka pasur një afërsi gjeografike proporcionale me ngjashmëritë në gjuhë dhe nxirrte këto përfundime:

³⁵ J. Gjinari, **Dialektologjia shqiptare**, Tiranë 1988, f. 113; **Dialektet e gjuhës shqipe**, Tiranë 1989, f. 76-77; J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, **Dialektologjia**, Tiranë 1997, f. 189-191; **Dialektologjia**, Tiranë 2013, f. 166-167.

³⁶ A. Philippide, **Originea romanilor II. Ce spun limbile romana si albaneza**, Iași 1927, 585-587. R. Ismajli, **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë 2015, 306 v)

1. shqiptarët dikur kanë jetuar më afër me dakorumunët se maqedo rumunët;
2. shqiptarët që kanë qenë më afër me dakorumunët janë *toskët*;
3. *toskët* do të kenë jetuar dikur në *afërsi të veriut të romanitetit*;
4. në kohën kur *toskët jetonin në afërsi të trojeve veriore të romanitetit*, gegët duhet të kenë jetuar ose në territore më në veri të toskëve ose më larg nga rumaniteti; pra, *drejt perëndimit*; prandaj shqiptarët në hapësirat e sotme kanë ardhur diku nga veriu në kohë relativisht të vonë³⁷.

Edhe G. Bonfante më 1972 duke u nisur nga një sërë izoglosash të përbashkëta për shqipen dhe rumanishten, ndër këto edhe fenomenin e rotacizmit (kalimin e *n* në *r*) ka shkruar se “ky fenomen i rotacizmit na shpie ta zhvendosim atdheun origjinal të shqiptarëve në veri, ndoshta pikërisht në territorin e Dakisë dhe pikërisht (siç është e natyrshme) në pjesën perëndimore të kësaj krahine. Dhe kjo puqet për mrekulli me origjinën trake të shqipes”³⁸.

G. Brâncuş më 1983, në veprën *Vocabularul autohton al limbii române*, duke diskutuar shtrirjen e elementeve të përbashkëta të shqipes me rumanishten nëpër dialektet rumune, arrinte në përfundimin që në dialektet rumune në jug të Danubit ka më pak elemente autoktone të përbashkëta me

³⁷ A. Philippide, **Originea romanilor II. Ce spun limbile romana si albaneza**, Iași 1927, f. 587. Shih R. Ismajli, **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë, 2015, f. 306 v).

³⁸ G. Bonfante, *Ilirishja dhe shqipja*, **Kuvendi i studimeve ilire** (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, 99-103) (Shih më gjerësisht B. Beci, *Diskutim rreth kumteses së G. Bonfantës dhe R. Ismajlit*, **Kuvendi i studimeve ilire**, (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, 341-346. Lidhur me këto pikëpamje Alexandru Rosetit ka shkruar se “argumentet e atilla nuk janë bindëse (shih Vasmer, **Zs. Sl. Phil.**, V, 286; Seliščev, **Slav. Nos. v Alb.**, 49, 73). Dallimet e thella midis gegnishtes dhe toskërishtes do të tregonin, përkundrazi, lashtësi të madhe të gjuhës shqipe në kufijtë e saj aktualë; por tiparet e veçanta të dialektit gegë dhe toskë janë shfaqur vonë. Sipas Hahn-it, as përmendja e vonë e shqiptarëve në burimet nuk përbën një argument bindës kundër lashtësisë së tyre në Shqipëri të sotme, sepse ata nuk përmenden as më vonë, kur prania e tyre në territorin aktual është e dëshmuar. Përveç kësaj, thoshte ai, emrat e majave të maleve në Shqipëri janë shqip ashtu si dhe gjysma e emrave të vendeve dhe të lumenjve, ndërsa mungesa e një terminologjie autoktone të peshkimit provon vetëm atë se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë jetuar në një epokë të lashtë larg bregut të Detit Adriatik (Shih R. Ismajli, **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë 2015, f. 315).

shqipen sesa në dakorumanishten. Do të pritej e kundërta. Diçka të ngjashme sugjeron dhe situata dialektore e shqipes. Sipas Brâncuș-it, përkimet midis toskërishtes dhe rumanishtes janë më të numërta sesa midis gegërishtes e rumanishtes, edhe pse toskërishtja flitet në jug, pra më larg nga rumanishtja se gegërishtja.

Ky fakt shpjegohet me atë që, shumë e besueshme, shqiptarët toskë banonin dikur në një rajon të vendosur diku më në verilindje nga Shqipëria e sotme, në fqinjësi me zonën trako-romane, nëse jo krejt në brendësi të kësaj zone³⁹.

Rotacizmin e shihte dëshmi të ndikimit të substratit trako-dak, si *re-lik*t të gjuhës së “dakasve të lirë” të cilët mbijetuan jashtë Dakisë, në veri e në perëndim të Provincës së romanizuar deri në sh. 6. Duhet të merret ashtu që *paraardhësit e toskëve (shqiptarët e jugut)*, më vonë dhe istrorrumunët, *mërguan nga hapësirat e “dakasve të lirë” dhe nga zonat fqinje drejt jugut përkatësisht drejt perëndimit⁴⁰.*

Për ne, fakti që fenomeni i rotacizmit ose ndonjë tjetër ndeshen në disa dialekte rumune nuk do të thotë, siç pretendojnë disa autorë rumunë, se toskërishtja duhet zhvendosur domosdo në territoret verilindore, diku pranë rumunëve.

Ato nisen nga lidhjet e jashtme të dukurisë së rotacizmit të toskërishtes me atë të rumanishtes, kurse është e domosdoshme të shihen më parë lidhjet e brendshme të kësaj dukurie me dukuritë e tjera dialektore të shqipes. Ato janë të tilla që i hedhin poshtë pikëpamjet që e zhvendosin vendin e formimit të toskërishtes në pjesën verilindore të territorit të sotëm shqiptar në afërsi me rumunët⁴¹.

Ide të ngjashme për shtegtimin e toskëve nga hapësirat e Dardanisë (zonat Leskovac-Nish në Serbinë e sotme) gjejmë edhe tek Hamp-i (1978).

³⁹ G. Brâncuș, **Vocabularul autohton al limbii române**, 1983, f. 164. Shih R. Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë 2015, f. 307-308.

⁴⁰ G. Brâncuș, **Cercetări asupra fondului traco-dak al limbii române**, București 1995, 116 (R. Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë 2015, 306).

⁴¹ Shih për këtë B. Beci, *Diskutim rreth kumteses së G. Bonfantes dhe R. Ismajlit*, **Kuvendi i studimeve ilire** (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, f. 341-346); **Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre**, Tiranë 2002, f. 70-80 .

Sipas Hamp-it, shqipja e hershme shtrihet drejt lindjes (diku në zonën midis Leskovacit e Nishit) afër rumanishtes.

Supozimi i tij ishte se do të ketë qenë inkursioni i sllavëve jugorë ai që do t'i ketë shtyrë ata drejt perëndimit.

Midis fillimit dhe kthesës së mijëvjeçarit, shqipja, sidomos *ajo që do të bëhej toskërishte*, e supozuar më e afërt me dako-rumanishten, shkruante ai, do të jetë shtrirë drejt jugut, *mbase në perëndim të malit Sharr; duke zhvendosur kështu dialektin e diferencuar mirë të toskërishtes, e me këtë bazën për një shtrirje në vazhdim drejt jugut (është e qartë jo me pushtim kulturor po me migrim fizik) nëpër territorin lashtogrek (si Himara)⁴² drejt Epirit për të kaluar në Tesali dhe në Golfën korintian*⁴³.

Ai, meqenëse tiparet kryesore që dallojnë toskërishten nga gegërishtja i lidhte me zhvillimet në sllavishtet e jugut (fjalën e kishte për denazalizimin dhe rotacizmin), supozonte se “...zhvillimi i toskërishtes paraqet një mbishtresim të shqipes në një territor të hollë sllav; kjo sugjeron që sllavët e jugut më herët kishin ndjekur anën jugore të dobët greke të linjës Jireček drejt limitit perëndimor⁴⁴”.

Lidhur me pikëpamjet që e zhvendosin hapësirën dialektore të toskërishtes në territoret verilindore pranë rumunëve R. Ismajli ka shkruar se “në asnjërin rast nuk gjendet ndonjë *mbështetje në të dhënat*, apo në *dispozicionin kohor dhe hapësinor* të shtrirjes dialektore të rindërtueshme së paku nga *sh. VI-VII*. Shpjegimi i ngjashmërive të supozuara midis toskërishtes dhe dialekteve rumune do të ketë arsye të tjera, dhe të rendit të Sprachbundit ballkanik, por jo të një natyre që do të shkonte kundër tërë rindërtimit historik të shqipes dhe shtrirjes së saj⁴⁵”.

⁴² Lidhur me këtë pohime të Hamp, R. Ismajli ka shkruar: “Kush e njeh terrenin e Shqipërisë së Jugut, jo vetëm vështrimin nga hartat, e kupton gjithsesi se asnjë lëvizje e supozuar e popullatave nga pjesët më në veri nuk do të shkonte përmes Himarës” (R. Ismajli, **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë 2015, 314, shën. 60).

⁴³ E. P. Hamp, *Strunga*, **Balkansko ezikoznanie**, 20, Sofija 1978, f. 319 (R. Ismajli, **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë 2015, f. 314, shën. 60).

⁴⁴ E. P. Hamp, *Strunga*, **Balkansko ezikoznanie**, 20, 1978, f. 319.

⁴⁵ R. Ismajli, **Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik**, Prishtinë 2015, f. 316.

Reagimet lidhur me shkaqet e formimit të dy dialekteve të shqipes

E. Çabej më 1963, duke iu referuar N. Jokl-it⁴⁶, lidhur me shkaqet e ndarjes dialektore të shqipes mendonte se me të drejtë është lënë mënjanë nga ana e gjuhësisë mendimi i J. G. von Hahn-it, që ndarja e sotme në gegërisht e toskërisht, e ka burimin te Ilirët e Epirotët e antikitetit⁴⁷.

Për E. Çabejn disa faktorë socialë-politikë, ekonomikë dhe etnikë llojesh të ndryshme, ndër tjera shkuljet e popullsisë nga katundet në qytete gjatë luftërave të para me turqit, shtegtimet e brendshme e shpërnguljet e fiseve, si më parë si më vonë, dukuri të shpeshta në Shqipëri, kanë pasur pjesë në këtë qëndrim të ndryshëm të dialekteve nëpër kohët e ndryshme, kjo është një gjë që mund të merret me mend, po që s'mund të vërtetohet, sepse dihet që *arsyet sidomos të ndërrimeve fonetike më të shumtën e herës as nuk diktohen*⁴⁸.

Edhe V. Polak, duke ju referuar G. Meyer-it, N. Jokl-it e O. Myderri-zit ka shkruar se “ndarja në dy dialekte e shqipes, nuk duhet t’i atribuohet ndarjes që bëhet në Ilirë dhe Epirotë, sikurse pohonte Hahn-i”⁴⁹.

Edhe I. Ajeti, duke ju referuar N. Jokl-it, dhe në pajtim me E. Çabejn, e quante të drejtë që “mendimi i Hahn-it lidhur me ndarjen më dysh, në gegërishte e toskërishte sipas ilirëve dhe epirotëve të lashtësisë u la mënjanë nga ana e gjuhësisë”⁵⁰.

⁴⁶ N. Jokl, *Albanisch, Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft seit ihrer Begründung durch. F. Bopp, II*, Die Erforschung der indogermanischen Schprahen, III, Strasburg 1917, 125. (Shih dhe N. Jokl, *Populli shqiptar dhe gjuha e tij, Hylli i Dritës*, Shkodër 1943, nr. 9-12; *Shkëndija*, nr. 5, Shkodër 1943; botuar edhe në përmbledhjen me studime: N. Jokl *Studime historiko-krahasuese për gjuhën shqipe*, Prishtinë 2017).

⁴⁷ E Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe. Studime Gjuhësore, IV*, Prishtinë 1977, f. 104. Artikulli është botuar për herë të parë në Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencave Shoqërore, nr. 3, Tiranë 1963.

⁴⁸ E Çabej, *Për historinë e strukturës dialektore të shqipes, Studime Gjuhësore, IV*, Prishtinë 1977. f. 192.

⁴⁹ V. Polák, *Albánci a Slovené (Vznik a počátky dnešních nářečních variant albánských), Časopis pro moderní filologii, XXXIX* - Číslo 2-3, Prague 1957, f. 86.

⁵⁰ I. Ajeti, *Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimëve shqiptare të Kosovës, Gjurmime albanologjike*, Prishtinë 1969, 1 (botuar edhe në *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë 1978).

J. Gjinari, lidhur me pikëpamjen e J. G. Hahn-it që e lidhte ndarjen e shqipes në gegërishte dhe toskërishte me ndarjen e territorit të ilirëve në Iliri dhe në Epir ka shkruar se J. G. Hahn-i, “duke u mbështetur vetëm në faktorë historikë, pa analizuar shkaqet e lindjes së njërit ose të tjetrit tipar dialektor, ka dhënë një mendim të përgjithshëm se ndarja e shqipes në dy dialekte e ka burimin tek ndarja e dikurshme e territorit të Shqipërisë në Iliri dhe në Epir”⁵¹. “Një shpjegim i këtillë do t’i binte ndesh faktit që Epiri, d.m.th. treva jugore e Ilirisë që arrinte në Veri deri tek bregu i majtë i Vjosës, përfshinte një territor tepër të ngushtë në krahasim me atë të toskërishtes së sotme (...)”⁵².

Pikëpamja jonë për historinë e formimit të dy dialekteve të shqipes

Pikëpamja jonë për strukturën dialektore të shqipes

Më 2016, kemi parashtruar një pikëpamje të re për strukturën dialektore të shqipes⁵³. Ndër të tjera kemi shkruar se “të dhënat për shtrirjen territoriale të dukurive dialektore të shqipes na kanë diktuar nevojën e një rikonceptimi të ndarjes së shqipes dialektore, të ndryshëm nga ndarja e pranuar pothuajse përgjithësisht deri sot, fillimisht në dialekte, e dialekteve në nëndialekte, e nëndialekteve në grupe të folmesh e kështu me radhë, pra, në mënyrë të njëpasnjëshme (suksesive) nga njësi më të mëdha në njësi gjithnjë e më të vogla”⁵⁴.

Atje kemi hequr dorë edhe nga emërtimi i njërive dialektore të shqipes përmes termave *dialekt*, *nëndialekt*, *grup të folmesh*, e *të folme* dhe kemi përdorur terminologjinë e përdorur nga A. V. Desnickaja, pra, termat *krahinë dialektore*, *zonë dialektore*, *rajon dialektor* dhe *e folme*, po, jo për

⁵¹ J. Gjinari, Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe, *Studime filologjike* 4, Tiranë 1968, 128.

⁵² J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë 1988, f. 113-114; *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë 1989, f. 77.

⁵³ Në periudhën para vitit 2016, në pajtim me traditën e krijuar, edhe ne kemi pranuar një ndarje suksesive të shqipes dialektore, fillimisht në dialekte, pastaj të dialekteve në nëndialekte dhe të nëndialekte në grupe të folmesh (shih B. Beci, **Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës**, Tiranë 1995, f. 29-35 ; **Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre**, Tiranë 2002, f. 14-19.

⁵⁴ B. Beci, **Struktura dialektore e shqipes, Një qasje e re**, Tiranë 2016, f. 332-338.

të shënuar ndarjen e njëpasnjëshme (suksesivitetin) e njërive dialektore nga njësi më të mëdha në njësi më të vogla (pra, *të gjuhës dialektore në krahina dialektore, të krahinave dialektore në zona dialektore dhe të zonave dialektore në rajone dialektore* e kështu me radhë), po të kundërtën, mungesën e njëpasnjëshmërisë ose suksesivitetit. Pra, në dallim nga paraardhësit, ne kemi pranuar ndarjen dialektore të shqipes në tërësi fillimisht në *krahina dialektore*, më vonë në *zona dialektore* dhe pastaj edhe në *rajone dialektore*, po gjithmonë jo si nëndarje të njëra pas tjetrës. Kjo, për të mënjeluar edhe në terminologji kriterin e ndarjes së njëpasnjëshme ose suksesive në hapësirë të shqipes dialektore, po jo për të pranuar a vërtetuar atë që shkruante A. V. Desnickaja “se në rastin e shqipes nuk duhej folur për dialekte territoriale në kuptimin e vërtetë të fjalës, po për krahina dialektore ose zona të dialekteve dhe të folmet që i përfshijnë”⁵⁵.

Në hapësirën kompakte ballkanike të shtrirjes së gjuhës shqipe, ne kemi veçuar, pra, tri lloj njësisish dialektore të pavarura: *krahinat dialektore, zonat dialektore dhe rajonet dialektore*. Duke analizuar dukuritë dialektore të shqipes kemi konstatuar a vërtetuar praninë e dy krahinave dialektore, *krahinën dialektore të Veriut* ose *gegërishten* dhe *krahinën dialektore të Jugut* ose *toskërishten*.

Duke analizuar dukuritë dialektore të shqipes kemi konstatuar se përcaktimi i zonave dialektore paraqiste vështirësi⁵⁶. Përcaktimi i tyre nuk këtë punim nuk është i domosdoshëm. Në një rast tjetër do t'i kthehemi kësaj problematike.

Në këtë klasifikim nuk i kemi veçuar të folmet e ashtuquajtura “kalimtare” si njësi dialektore më vete. Kemi shpjeguar arsyet⁵⁷, po edhe kësaj problematike do t'i rikthehemi një herë tjetër për t'i saktësuar e plotësuar ato që kemi shkruar në librin kushtuar strukturës dialektore të shqipes.

Pikëpamja jonë për kohën e formimit të dy dialekteve të shqipes

Lidhur me kohën e formimit të dy dialekteve të shqipes, më 1972 kemi shkruar se “tiparet e pranuar (...) prej nesh si veçori dalluese në mes

⁵⁵ A. V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë 1972, f. 46.

⁵⁶ B. Beci, *Struktura dialektore e shqipes, Një qasje e re*, Tiranë 2016, f. 320-338.

⁵⁷ B. Beci, *Struktura dialektore e shqipes, Një qasje e re*, Tiranë 2016, f. 330.

të dy dialekteve të shqipes janë të vjetra. Zakonisht shkaku i shfaqjeve të karakteristikave gjuhësore të përbashkëta në të njëjtin territor është ekzistenca për një kohë pak a shumë të gjatë e lidhjeve politike, ekonomike e kulturore midis popullsisë së atij territori. Për shkak të shtrirjes territoriale të njëjtë besojmë që këto fenomene do të jenë zhvilluar afërsisht edhe në të njëjtën kohë. E në qoftë se pranojmë që rotacizmi është i periudhës parasllave, atëherë duhet të pranojmë që edhe fenomenet e tjera (kalimi i $\tilde{a} > \tilde{e}$, i $vo > va$, zhdukja e infinitivit) me të njëjtën shtrirje territoriale janë pak a shumë të kësaj periudhe, gjë që do të thotë që edhe ndarja e shqipes në dy dialekte është e kësaj periudhe”⁵⁸.

Më 1979 kemi theksuar se mendimi që ndarja dialektore e shqipes në gegërishte dhe toskërishte është e re e ka burimin në vlerësimin si tipare dalluese të dy dialekteve të shqipes edhe të mjaft veçorive të tjera që janë zakonisht karakteristike për njësi dialektore më të vogla, të përfuara kryesisht me periudhën e sundimit osman. Dukuritë e pranuar prej nesh si tipare karakteristike të të dy dialekteve të shqipes i përkasin periudhës para shek. 14-15, kur u formuan ngulimet e para në Greqi e në Itali. Sipas Meyer-Lübke-s, kalimi i n -së ndërzanore në r në toskërishte është zhvilluar në periudhën para dyndjes së sllavëve. Kjo shpjegohet nga fakti se ky proces ka prekur: fjalë të vjetra shqipe, fjalë të huazuara nga greqishtja e vjetër, fjalë të huazuara nga latinishtja. Fjalët e huazuara nga sllavishtja, italishtja, greqishtja e re, turqishtja nuk janë prekur nga ky fenomen, sepse kanë hyrë në gjuhën shqipe më vonë. Për këtë arsye pranohet që dukuria e kalimit të n -së në r , i përket periudhës para dyndjeve sllave. Edhe kalimi i grupit vo në va në toskërishte, në fillim të disa fjalëve, është vlerësuar si mjaft i mëtejshëm, madje më i mëtejshëm se kalimi i n -së në r . Për kalimin e \tilde{a} -së hundo-re në \tilde{e} në toskërishte mendohet se i përket periudhës së fundit të kohës antike. Edhe për hundorësinë e gegërishtes është pohuar që vetëm më të vjetrat huazime sllave të shqipes, i janë nënshtruar këtij fenomeni. Për paskajoren gjer tani mund të thuhet që shumë shekuj përpara botimit të librit të parë shqip (1555), të paktën gegërishtja e kishte krijuar formën e pashjtjellë të foljeve të tipit *me ba* me vlerë të paskajores. Me sa duket krijimi i kësaj forme foljore i përket periudhës së mesjetës së hershme.

⁵⁸ B. Beci, *Diskutim rreth kumteses së G. Bonfantës dhe R. Ismajlit*, **Kuvendi i studimeve ilire**, (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë 1974, f. 344.

Nga sa u tha bëhet e qartë që veçoritë e pranuarra më sipër si tipare karakteristike të dy dialekteve të shqipes janë të vjetra.

Në këto rrethana duhet të pranojmë që ndarja e shqipes në dy dialekte është domosdo e periudhës paraletrare të shqipes, d.m.th. para shek. 16, po duke u nisur nga vjetërsia e fenomeneve të shqyrtuara, ajo duhet t'i përkasë një periudhe edhe më të lashtë, ndoshta *fundit të periudhës antike dhe fillimit të mesjetës së hershme*⁵⁹.

Edhe më 1982, lidhur me kohën e formimit të dy dialekteve të shqipes, kemi shkruar se “një gjë mund të thuhet me siguri që mungesa e kundërvënies sipas hundorësisë në sistemin e zanoreve të theksuara, dalja e ë-së së theksuar në pozicion para bashkëtingëlloreve hundore (*ã* ose *ê*>*ë*) dhe rotacizmi i *n*-së ndërzanore, karakteristike për toskërishten, përbëjnë tri dukuri ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën. Ato janë tri inovacione të toskërishtes, të cilat kanë të njëjtën shtrirje dhe nga pikëpamja e kohës së zhvillimit të tyre janë parasllave”⁶⁰.

Po kështu më 1986 kemi shkruar se “duhet pranuar që nga mesi i mijëvjeçarit të parë të erës sonë, ndoshta edhe më parë, dukuria e rotacizmit ishte e gjallë në gjuhën shqipe”.

Hapja e *vo*-së nistore në *va* në toskërishten është më e vjetër se rotacizmi, kurse zhvillimi i *uo*-së në *ua* është bërë në të njëjtën kohë me kalimin e *vo*-së në *va*-, çka tregon se këto dukuri ishin të gjalla rreth mesit të mijëvjeçarit të parë të erës sonë. Kësaj periudhe duhet t'i përkasë afërsisht edhe dukuria e kalimit të *ã*-së ose *ê*-së para bashkëtingëlloreve hundore në *ë* në toskërishten në raste si këto: geg. *gjãn(ë)*, tosk. *gjërë*, geg. *rãn(ë)* tosk. *rërë*, etj., përndryshe nuk do të mund të shpjegohen kalimi i *ã*-së ose *ê*-së në *ë* në këto fjalë. Kështu që ka arsye që të pranohet se veçoritë e dy dialekteve të shqipes, si edhe vetë dialektet e saj, janë relativisht të vjetra. Ato ishin të gjalla në mesjetën e hershme (shek. VI-VIII) ose në antikitetin e vonë (shek. IV-VI), gjithsesi para ndikimeve gjuhësore sllave në shqipen⁶¹.

⁵⁹ B. Beci, *Dialektet e gjuhës shqipe dhe lashtësia e tyre*, **Shkenca dhe jeta**, 5, Tiranë 1979, 29.

⁶⁰ B. Beci, *Lashtësia e dialekteve të shqipes-dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, **Studime filologjike**, 3, Tiranë 1982, f. 69-71 (Shih edhe B. Beci, **Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre**, Tiranë 2002, f. 68-78).

⁶¹ B. Beci, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë*

Pikëpamja jonë për vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes

Lidhur me vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes më 1972 kemi shkruar se “tiparet e pranuar (...) prej nesh si veçori dalluese në mes të dy dialekteve të shqipes janë të vjetra. Zakonisht shkaku i shfaqjeve të karakteristikave gjuhësore të përbashkëta në të njëjtin territor është ekzistenca për një kohë pak a shumë të gjatë e lidhjeve politike, ekonomike e kulturore midis popullsisë së atij territori. Për shkak të shtrirjes territoriale të njëjtë besojmë që këto fenomene do të jenë zhvilluar afërsisht edhe në të njëjtën kohë. E në qoftë se pranojmë që rotacizmi është i periudhës parasllave, atëherë duhet të pranojmë që edhe fenomenet e tjera (kalimi i $\tilde{a} > \tilde{e}$, i $vo > va$, zhdukja e infinitivit) me të njëjtën shtrirje territoriale janë pak a shumë të kësaj periudhe, që do të thotë që edhe, ndarja e shqipes në dy dialekte është e kësaj periudhe.

Në këto rrethana nuk mund të pranohet që ndarja dialektore e shqipes dhe tiparet dalluese të dy dialekteve të saj të jenë përfutur në një territor tjetër jashtë territorit të sotëm të Shqipërisë e të jetë bartur si e tillë së bashku me popullin në territorin e sotëm. Për këtë arsye mendojmë se fenomeni i rotacizmit nuk përbën një bazë për të zhvendosur atdheun origjinal të shqiptarëve në veri, në pjesën perëndimore të Dakisë dhe aq më pak për të pranuar tezën e Prof. Bonfantes që shqiptarët janë të ardhur në viset e tyre të sotme “pasi sllavët e kishin okupuar atë territor (shek. V i kohës së re)”⁶².

Edhe më 1979 kemi shkruar se lidhur me vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes “disa nga përfaqësuesit e albanistikës së huaj nuk u kanë shpëtuar qëndrimeve subjektive e aprioristike. Ndonjëri prej tyre, duke dashur të provojë tezën, tani më të vjetruar, që shqiptarët janë të ardhur në territorin e sotëm nga Dakia perëndimore në periudhën pas dyndjeve sllave, sjell si dëshmi edhe dukurinë e kalimit të n -së ndërzanore në r në toskërishten dhe në disa dialekte rumune perëndimore si istro-rumanishtja, dialekti i Bonatit e tjerë. Ky fenomen i përbashkët i shqipes dhe i rumanishtes, pohon ai, na shpie ta zhvendosim atdheun origjinal të shqiptarëve në

sonë historike, Ilyria, 1, Tiranë 1986, f. 246.

⁶² B. Beci, *Diskutim rreth kumteses së G. Bonfantes dhe R. Ismajlit, Kuvendi i studimeve ilire*, (Tiranë 15-20 shtator 1972), Tiranë, 1974, f. 344.

veri, ndoshta pikërisht në territorin e Dakisë. Fakti që fenomeni i rotacizmit, i kalimit të n në r ndeshet edhe në disa dialekte rumune perëndimore, nuk do të thotë që atdheu origjinal i shqiptarëve duhet zhvendosur domosdo në veri, në territorin e Dakisë. Para se të vështrohen lidhjet e jashtme të fenomenit të rotacizmit të gjuhës shqipe me atë të rumanishtes, është e domosdoshme të vështrohen lidhjet e brendshme të tij. Ato janë të tilla që ndihmojnë edhe në ndriçimin e lidhjeve të jashtme.

(...) kalimi i n -së në r në toskërishten si dhe tiparet e tjera dalluese të dy dialekteve të shqipes, i përkasin fundit të periudhës antike ose mesjetës së hershme, kështu që dhe ndarja e shqipes me dy dialekte është e kësaj periudhe (...). Të gjithë argumentet shkencorë tregojnë se procesi i diferencimit dialektor të shqipes në gegërishte dhe toskërishte u zhvillua në trojet e banuara sot nga shqiptarët, në fund të periudhës antike e në fillim të mesjetës së hershme, çka dëshmon edhe për praninë e popullit tonë në këto vise të paktën që nga ajo periudhë. Prania e fenomenit të rotacizmit në toskërishten e në disa dialekte të rumanishtes nuk përbën aspak bazë për ta zhvendosur atdheun origjinal të popullit tonë në Daki dhe aq më pak për të pranuar tezën që shqiptarët janë të ardhur në viset e tyre të sotme pasi sllavët e kishin okupuar atë territor. Siç u vu në dukje, njohja e rrethanave të brendshme të zhvillimit të këtij fenomeni dhe vështrimi i tij në raport dhe në mbarë sistemin e shqipes e hedhin poshtë si të pabazuar një pikëpamje të tillë⁶³.

Edhe më 1982 kemi shkruar se “Veçoritë e përmendura si tipare dalluese të dy dialekteve të shqipes (...) janë zhvilluar në Mesjetën e hershme, para huazimeve sllave në shqipe.

Po të çfarë kohe janë huazimet sllave të shqipes?

Duke u nisur nga veçoritë e huazimeve sllave të shqipes ka arsye të mendohet se këto huazime i përkasin periudhës pas shek. IX⁶⁴. Edhe për huazimet më të vjetra sllave që paraqesin alternimet $s > sh$, $ы$ (zanore e

⁶³ B. Beci, *Dialektet e gjuhës shqipe dhe lashtësia e tyre*, **Shkenca dhe jeta**, 5, 1979, 29.

⁶⁴ A. Rosetti, *L'apport du latin balkanique et du roumain à la constitution de la communauté balkanique*, **Actes du premier Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-Est Européennes**, VI, Sofia 1968, f. 33; “Rhotacisme” et “pseudorhotacisme” en roumain, **Revue roumaine de linguistique**, Tome XIX, 1974/4, f. 348).

prapme) > u, [ôë > on, om, un, um, an, am ose [ëë > en, ëm, ën nuk mund të thuhet me siguri se janë më të vjetra se shek. IX. Alternimi s > sh ka vazhduar në shqipe deri në fund të shekullit X⁶⁵. Numri i vogël i fjalëve dhe i toponimeve sllave që dalin me sh në shqipen në raport me ato që dalin me s tregon se ato kanë hyrë në shqipen kur po mbaronte së vepruari kjo dukuri. Edhe alternimi bt > u ka vazhduar në serbishte deri në shek. XI, kurse në maqedonishte deri në shek. XIII⁶⁶, kurse hundoret sllave [ôë dhe [ëë e kanë humbur vlerën e tyre hundore rreth shek. XII-XIV⁶⁷. Të vetmet dëshmi që janë sjellë për të vërtetuar praninë e huazimeve sllave në shqipe para shek. IX janë fjalët *baltë*, *daltë*, *gardh* që dalin me metatezën e likuideve. Sipas Selishçev-it, këto fjalë kanë hyrë në shqipe para metatezës së likuideve në sllavishte (shek. IX)⁶⁸. N. Jokl-i (Jokl: II, XIII, VII, 143; 1935, 297 vv.) dhe E. Çabej edhe për këto fjalë kanë shkruar se nuk janë ndikime sllave në shqipe, po fjalë të burimit vendas⁶⁹. Në këto rrethana mund të pohohet që tiparet dalluese të dy dialekteve të shqipes, të cilat i përkasin periudhës para fillimit të huazimeve sllave në shqipe, janë përfunduar para shek. IX.

Këtu lind pyetja se kur u shtrinë këto dukuri në kufijtë që na paraqiten sot (deri në afërsi të Shkumbinit), para apo pas shek. IX. J. Gjinari, lidhur me këtë çështje ka shkruar: "...nuk mund të thuhet me siguri se cila

⁶⁵ E. Çabej, **Fonetika historike e shqipes**, Tiranë 1960, f. 120-121.

⁶⁶ B. Koneski, **Istoriya na makedonskijot jazik**, Skopje 1967, f. 39.

⁶⁷ K. Mirčev, **Bëlgarskijot ezik prez vekovete**, Sofija 1964, f. 60v; **Istoričeska gamatika na bëlgarskija ezik**, Sofija 1958, f. 101; B. Koneski, **Istoriya na makedonskijot jazik**, Skopje 1967, f. 26-28.

⁶⁸ A. Seliščev, **Slavjanskoe naselenie v Albanii**, Sofija 1931, 319 (ribotuar në Sofje 1981). V. Georgiev, **Vokalnata sistema v rozvoja na slavjanskite ezici**, Sofia 1964, 94v.

⁶⁹ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, **Fonetika historike**, **Studime gjuhësore**, III, Prishtinë 1976, f. 144, 147. Ky tekst është botimi i dytë i zgjeruar i atij të vitit 1958. Pjesa e historisë së gjuhës shqipe është ripunuar fund e krye. Fonetika historike është prekur e shtuar në shumë pika. Teksti është ribotuar më 1960, 1963, 1970, 1976; *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencave Shoqërore**, nr. 1, Tiranë 1961, f. 80; *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencave Shoqërore**, nr. 4 Tiranë 1962, f. 226; (botuar edhe në **Studia albanica**, I, Tiranë 1964; në **Konferenca e parë të studimeve albanologjike**, (15-21 Nëntor 1962), Tiranë 1965 dhe në **Studime gjuhësore**, IV, Prishtinë, 1977).

ka qenë shtrirja territoriale e këtyre veçorive në atë kohë. Nuk dihet në se këto shtriheshin ashtu sikurse edhe sot nga skaji jugor deri në bregun e majtë të Shkumbinit, ku ndahen toskërishtja dhe gegërishtja apo kanë pasur një përhapje më të vogël, ndoshta edhe më të gjerë, duke u shtrirë sidomos më në lindje dhe verilindje të trevës që zë sot toskërishtja⁷⁰.

Sigurisht, zgjidhja e këtij problemi paraqet vështirësi për shkak të mungesës së të dhënave. Duke pasur parasysh një nga ligjet më të rëndësishme të gjeografisë gjuhësore, sipas të cilit “afria kronologjike pasqyrohet me anë të afriës gjeografike”⁷¹, mund të pohohet që tiparet dalluese të dy dialekteve të shqipes, të cilat përkojnë edhe kronologjikisht edhe gjeografikisht, duhet edhe të jenë përhapur pak a shumë në të njëjtën kohë. Duke pasur parasysh rrethanat historike të vendit tonë mendojmë se këto tipare (të përfuara para sh. IX) nuk mund të fitonin shtrirjen që kanë sot (deri në afërsi të Shkumbinit) as në periudhën e mbretërive bullgare e serbe (shek. IX-XII) as në periudhën e formimit të shtetit të Arbrit (shek. XII-XIII), po as edhe në shekujt e mëvonshëm, në kushtet e sistemit feudal ushtarak turk, kur dihet që gjatë këtyre shekujve nuk ka pasur ndarje politike, kulturore e administrative të qëndrueshme që të favorizonte shtrirjen e këtyre tipareve deri në afërsi të Shkumbinit. Shtrirja e tyre në kufijtë e sotëm duhet të jetë më e vjetër dhe duhet të lidhet me kushtet politike, ekonomike dhe kulturore të vendit tonë para pushtimit sllav, pra në Mesjetën e hershme (sh. VI-VIII) ose në antikitetin e vonë (IV-VI), gjithsesi para sh. IX.

Rrethanat historiko-shoqërore dhe kulturore që kanë favorizuar lindjen e këtyre tipareve në viset jugore të territorit shqiptar nuk janë plotësisht të qarta. Megjithatë arkeologët kanë vënë re se në fund të shek. III e sidomos në shek. IV të e. sonë, kur perandoria romake hyn në një periudhë krize të gjatë, në trevat jugore ilire gjallërohet popullsia vendëse, forcohet karakteri etnik i saj, kemi, siç thonë ata, një rilindje ilire⁷² e cila mund të jetë bërë shkas edhe për zhvillime të reja gjuhësore në këto territore⁷³.

⁷⁰ J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë 1975, f. 55.

⁷¹ A. Weinen, *The value of map configuration*, Special issue of the *Mededelingen van de Nijmeegse Centrale voor Dialect en Naamkunde*, Nijmegen 1977, f. 3.

⁷² S. Anamali, *Procese shndërrimi në trevën jugore ilire në shekujt I-IV*, **Kuvendi i II-të i studimeve ilire** (Tiranë 20-22 shtator), Tiranë 1985, f. 17-18.

⁷³ B. Beci, *Lashësia e dialekteve të shqipes-dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqip-*

Më 1986 ne kemi shkruar se “G. S. Shtatmyler, në veprën “Hulumtime për historinë e hershme të Shqipërisë”, të botuar më 1942 e të ribotuar me plotësime më 1966, hapësirën jetësore të popullit shqiptar në kohën romake e bizantine të hershme e ngushtonte në katërkëndëshin midis fushës bregdetare të Shqipërisë së Ulët, luginës së Drinit të Zi dhe luginës së Drinit të Bashkuar, me krahinën e Matit si qendër⁷⁴. Kjo do të nënkuptonte që sipas G. S. Shtatmyler-it, në kohën romake e bizantine të hershme dy dialektet e shqipes ose nuk ekzistonin ose ishin formuar në një territor të ngushtë me qendër krahinën malore të Matit e të ishin përhapur si të tillë në kufijtë që na paraqiten sot. Po nuk do të mund të shpjegohej që tiparet e dialektit të jugut, të cilat, siç e thamë, janë inovacione të zhvilluara në periudhën para huazimeve sllave të shqipes, të kenë lindur në krahinën e Matit e prej andej të jenë mbartur në territorin poshtë Shkumbinit, për t'u përgjithësuar në mbarë toskërishten e për të mos lënë asnjë gjurmë në krahinën e Matit ose në zonat përreth. Kapërcime të tilla, që nuk kanë asnjë mbështetje gjuhësore dhe historike, janë praktikisht të pamundura. Kështu që duhet pranuar që dialektet e shqipes janë formuar në territoret e sotme, çka dëshmon edhe praninë e shqiptarëve në viset e tyre të sotme në antikitetin e vonë dhe në mesjetën e hershme. Kjo hedh poshtë pikëpamjet e A. M. Selishçev-it, I. Popoviç-it e ndonjë tjetri që e zhvendosin djepin e hershëm të shqiptarëve në viset qendrore e lindore të Ballkanit, si edhe ato të G. Shtatmyler-it, i cili e ngushton djepin e formimit të popullit tonë në një territor të vogël⁷⁵. Edhe dietari jugosllav J. Erdeljanović ka pranuar që

tarëve, Studime filologjike, 3, Tiranë 1982, f. 66-74 (shih edhe L'ancienneté des dialectes de l'albanais. Temoignage des territoires anciens des albanais, Studia Albanica, 2, Tiranë 1982, f. 134-135.

⁷⁴ B. Beci, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike, Ilyria, 1, Tiranë 1986, f. 244.* Po aty G. Stadtmüller sillte si argument se “vetëm në këtë kanton malesh, që është gati i paarritshëm nga jashtë nuk janë vërtetuar as relikte emrash latinë vendi, as gjurmë vendbanimesh romane” (G. Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden, 1966, 118). Në kundërshtim me këtë pikëpamje të G. Shtatmylerit, kërkimet për toponiminë e krahinës së Matit kanë dëshmuar praninë e toponimeve latino-romane në këtë krahinë: *Dom*< lat. *dominus*, *Vinjall* (*Vinjoll*)<lat. *Vinnealis*, *Fulqet*<lat. *fil(i)cetum*, *Rripë*<lat. *ripam*, *Vila*<*villa*, *Val*<lat. *vallis* *Shuttrija*<lat. *subterraneum* (E. Lafë, *Toponime latino-romane në truallin e shqipes, Kuvendi I i Studimeve Ilire, Tiranë, 1972, 139-141; A. Balla, Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë e Matit, Studime filologjike, Tiranë, 1983, 3, 137.*

⁷⁵ B. Beci, *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike, Ilyria, 1, Tiranë 1986, f. 246-247.*

“dallimet ndërmjet gegëve e toskëve në gjuhë, në zakone, në kostume, etj. janë dëshmi e padyshimtë që shqiptarët duhet të jenë popull shumë i vjetër në territorin e tyre.”⁷⁶

Pikëpamja jonë për shkaqet e formimit të dy dialekteve të shqipes

Më 1982 dhe 1986, ndër të tjera, ne kemi shkruar se zona ku shfaqen tiparet dalluese të toskërishtes “historikisht ka qenë e banuar nga fise epirote, etnikisht të një tringu me ilirët. Nga të dhënat historike që disponohen, del se duke filluar që nga shek. V p. e. sonë e këtej majde edhe gjatë pushimit romak (shek. II p. e. sonë deri në fund të shek. III të erës sonë) fiset epirote kane ruajtur në një mënyrë ose në një tjetër lidhjet politike, ekonomike e kulturore (kujto “Lidhjen e Molosve”, “Aleanca e Epirotëve” (sh. IV p. e. sonë), “Lidhja Epirote” (shek. III p. e. sonë), provincë romake më vete (shek. II p. e. sonë - III erës sonë). Vetëm në fund të shek. III të e. sonë u formuan provincat e ashtuquajtura Epir i Ri dhe Epir i Vjetër. Ato edhe në shek. V-VI vazhduan të jenë ndarje administrative më vete⁷⁷. Këto ndarje e sidomos ato që i përkasin periudhës pas shek. III nuk na lejojnë të përcaktojmë me përgjegjësi kufirin etnik të epirotëve, çka do të ishte me interes të veçantë për problemin që po trajtojmë. Për këtë na vijnë në ndihmë pohimet e Strabon-it (63 p. e. sonë - 20 të erës sonë). Ai, duke folur për rrugën Egnatia, e cila kalonte përgjatë luginës së Shkumbinit shkruante se “ata që kalojnë këtë rrugë duke u nisur nga viset pranë Epidamn-it dhe Apolonisë, në të djathtë kanë fiset e Epirit, që lagen nga deti i Sicilisë gjer në gjirin e Ambrakisë, nga ana e majtë kanë malet e Ilirisë (...)”⁷⁸.

Pra, Strabon-i e bën fare të qartë që kufiri etnik ndërmjet epirotëve (etnikisht të një tringu me ilirët) dhe ilirëve kalonte përgjatë rrugës Egnatia që do të thotë përgjatë luginës së Shkumbinit, që përbën edhe kufirin ndërmjet dy dialekteve të shqipes, kurse gjiri i Ambrakisë shënon kufirin jugor të tyre⁷⁹.

Dhe për këto i jemi referuar J. G. Hahn-it, i cili duke u nisur nga Strabon-i, ka shkruar se “ai (Strabon-i) e konsideronte këtë rrugë (rrugën

⁷⁶ J. Erdeljanović, *Makedonski Srbi*, 1920, f.20.

⁷⁷ *Historia e Shqipërisë, I*, Tiranë 1959, f. 133, 135.

⁷⁸ *Ilirët dhe Iliria*, Tiranë 1965, f. 158.

⁷⁹ J. G. von Hahn, *Studime shqiptare*, Tiranë 2013, f. 218-219.

Egnatia B.B.) jo vetëm si një kufi politik, po edhe si një kufi etnik që ndante në përgjithësi Ilirët nga Epirotët (...). Konkluzioni në të cilin arrinte Hahn-i ishte se “për aq sa kemi mundësi të gjykojmë për karakterin e dy dialekteve shqiptare dhe për lidhjet e tyre me njëri-tjetrin, ata na paraqiten me dallime të vjetra” dhe vazhdonte “në qoftë se ata flasin dialekte shumë të vjetra të ndryshme të së njëjtës gjuhë, në qoftë se kufiri i ndarjes së tyre bie atje ku e vë Strabon-i kufirin midis epirotëve dhe ilirëve, në qoftë se epirotët nuk ishin helenë, por barbarë a nuk është këtu tepër e mundshme që edhe në kohët e lashta të ishte po kështu, ashtu siç është tani dhe që epirotët të bënin pjesë në fiset ilire”⁸⁰.

Në vijim kemi shtuar se “pikëpamja e Hahn-it gjen mbështetje në faktin që territoret ndërmjet Shkumbinit dhe gjirit të Ambrakisë ku dikur banonin fise epirote, etnikisht të një trangu me ilirët (Strabon-i), janë banuar pa ndërprerje, madje edhe sot e gjithë ditën, nga shqiptarët. Për këtë flasin edhe zhvillimet fonetike të emrave të vendeve të dëshmuara në këto territore nga koha antike ose Mesjeta e hershme si: *Aulona* > *Vlona* / *Vlora*, *Tamarus* > *Tomor*, *Aoos* > *Vjosë*, *Arachthos* > *Artë*, *Germinium* > *Dhërmi*, *Xiuaipa* > *Himarë*, *Thyamis* > *Çam* etj. të cilët dëshmojnë se kanë qenë pandërprerje në gojën e shqiptarëve dhe se vetëm gjuha shqipe ka mundur t’u japë trajtën që kanë sot”⁸¹.

⁸⁰ J. G. von Hahn, **Studime shqiptare**, Tiranë 2013, f. 218-219.

⁸¹ Për këto shih E. Çabej, *Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve*, **Studime rreth historisë së gjuhës shqipe**, Tiranë 1973, f. 15-16 (botuar më parë në **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencave Shoqërore**, 2, Tiranë 1958, 54); W. Cimochowski, *Des recherches sur la toponomastique de l’Albanie*, **Lingua Posnaniensis**, VIII Poznań 1960, 133v.; S. Mansaku, *Autoktonia e shqiptarëve në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë*, **Studime filologjike**, nr. 3, Tiranë 1982, 111; (botuar edhe në Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së tij (Tiranë 2-5 korrik 1982), Tiranë 1988). R. Ismajli, **Artikuj mbi gjuhën shqipe**, Prishtinë 1987, f. 12; Sh. Demiraj, **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Tiranë 1988, f. 154-181 (ribotuar në Prishtinë më 1989). B. Beci, *Lashtësia e dialekteve të shqipes-dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, **Studime filologjike**, nr. 3, Tiranë 1882, f. 65-77 (shih edhe *L’ancienneté des dialectes de l’albanais. Te moignage des territoires anciens des albanais*, **Studia Albanica**, 2, Tiranë 1982; *Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, **Illyria**, 1, Tiranë 1986, 243-249; **Dialektet e shqipes dhe historia e formimit të tyre**, Tiranë 2002, 68-69.

Sh. Demiraj për historinë e formimit të dy dialekteve të shqipes

Sh. Demiraj për ndarjen dialektore të shqipes

Sh. Demiraj më 1988, në “Gjuha shqipe dhe historia e saj”, kapitulli “Ndarja dialektore e gjuhës shqipe”, duke iu referuar J. Gjinarit,⁸² ka shkruar se “gjuha shqipe, si të gjitha gjuhët e tjera i.e., është e ndarë në dialekte me kufij hapësinorë pak a shumë të përcaktuar. Si kufi që ndan, në vija të trasha, dy dialektet e shqipes, merret lumi Shkumbin. Në veri të këtij lumi është zhvilluar dialekti verior, që njihet ndryshe dhe me emrin dialekti gegë ose gegërishtja. Kurse në jug të Shkumbinit është zhvilluar dialekti jugor, që njihet ndryshe edhe me emrin dialekti toskë ose toskërishtja⁸³”.

Sh. Demiraj për kohën e formimit të dy dialekteve të shqipes

Me përcaktimin e historisë së strukturës dialektore të shqipes Sh. Demiraj, për herë të parë, është marrë më 1988, në librin e tij “Gjuha shqipe dhe historia e saj”. Në një kapitull prej 15 faqesh kushtuar dialekteve të shqipes, në mënyrë të veçantë është ndalur në historinë e dukurive dialektore që ai i vlerësonte “si më të hershme” dhe siç shprehej ai që “kanë karakter mbarëdialektor” si *hundorësia e zanoreve* në të folmet veriore, *rotacizmi* dhe *ndërrimi ã-së në ë* në të folmet jugore, kundërvënia e rrokjes nistore *vo- va-* në fjalë të tipit *voj- vaj*⁸⁴, po pa na thënë se cila ishte, sipas tij, vjetërsia e dy dialekteve të shqipes.

Më 1999 lidhur me kohën e formimit të dy dialekteve të shqipes ai ka shkruar: Ajo që duhet marrë në vështrim në rastin tonë, është *vjetërsia e kësaj ndarjeje dialektore të gjuhës shqipe*, sepse një shqyrtim i tillë mund të ndihmojë për të ndriçuar edhe çështjen e vjetërsisë së pranisë së shqiptarëve në trevat, ku janë zhvilluar këto dy dialekte. Duke qenë se një shqyrtim i gjithanshëm i evolucionit historik të dy dialekteve të shqipes do të kërkonte *një punim më vete*, këtu po kufizohemi në analizën e dy dukurive fonetike karakteristike të dialektit jugor që u përmendën pak më sipër⁸⁵.

⁸² J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë 1975, f. 44v.

⁸³ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988, f. 229.

⁸⁴ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988, f. 230-231.

⁸⁵ Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, Tiranë

Evolucioni i /-n-/ midis dy zanoresh në /-r-/ apo, siç quhet ndryshe, "rotacizmi", përbën një nga dukuritë kryesore, që e dallojnë dialektin jugor prej dialektit verior të gjuhës shqipe. Kjo dukuri është shfaqur rregullisht në fjalët e trashëguara të shqipes si edhe në huazimet e saj nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja, por në përgjithësi nuk i ka prekur huazimet llave. Për këtë arsye shumica e gjuhëtarëve kanë arritur në përfundimin që ky proces fonetik, në përgjithësi, ka pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe. Këtë mendim e ka mbrojtur, ndër të tjerë, edhe Meyer-Lübke (1914: 41) (...) Kohët e fundit me problemin e rotacizmit është marrë gjerësisht edhe Janson-i (1986), i cili, pasi parashton një sërë argumentesh, arrin në përfundimin që procesi i rotacizmit duhet të ketë nisur përafërsisht aty nga viti 800 dhe duhet të ketë përfunduar aty nga viti 1000 i erës sonë.

Gjithsesi, duhet pranuar që rotacizmi si proces fonetik duhet të ketë pushuar së vepruari para depërtimit të sllavizmave në gjuhën shqipe. Shfaqja e kësaj dukurie edhe në disa huazime të izoluara sllave ose në disa raste të diskutueshme toponimesh, në thelb nuk e përmbys përfundimin e Meyer-Lübke-s.

Lidhur me evolucionin e zanores /ã-/ dhe pjesërisht edhe të zanores /ë-/ para bashkëtingëlloreve hundore në /ë-/ në dialektin jugor, ka shkruar se "është shfaqur më herët se rotacizmi, për çka dëshmojnë qartë raste të tilla si *llănë* > *llërë*, *rănë* > *rërë* etj., ku ndërrimi /-ã-/ > /-ë-/ nuk mund të ndodhte para bashkëtingëllores /-r-/.

Duke qenë se dukuria në shqyrtim nuk është shfaqur në huazimet sllave të shqipes, por ka përfshirë kryesisht fjalët e trashëguara dhe huazimet nga greqishtja e vjetër (khs. *Mokënë* > *mokërë* < *μάxavâ* etj.) dhe nga latinishtja (khs. *ranë* > *rërë* < *arena* etj.), në përgjithësi është pranuar që ajo i takon periudhës parasllave të shqipes (...). Pas gjithë gjasash, ajo është shfaqur jo më vonë se shekujt V-VI të erës sonë.

Dallimet midis dy dialekteve të shqipes janë zhvillime të brendshme të kësaj gjuhe dhe dukuritë më të vjetra dialektore (...) i përkasin periudhës pasromake të shqipes⁸⁶.

Pra, më 1999 ka pranuar në mënyrë eksplicite se dialektet e shqipes

1999, f. 105.

⁸⁶ Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe**, Tiranë 1999, f. 105 Aty i referohet edhe veprës së H. Hamp, *The position of Albanian. Ancient Indo-European Dialects*, Berkeley and Los Angeles 1966, f. 98.

janë mjaftë të vjetra. Konkretisht aty flet për “vjetërsi mjaft të madhe të ndarjes dialektore të shqipes”⁸⁷.

Si kohë të formimit të dy dialekteve të shqipes shënon periudhën *pasrromake* dhe *parasllave*⁸⁸.

Sh. Demiraj për vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes

Më 1988 Sh. Demiraj lidhur me vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes ka shkruar: “Për historinë e gjuhës shqipe ka shumë interes të përcaktohet edhe se *në ç'treva fliteshin dialektet*, ku u zhvilluan dukuritë e vjetra gjuhësore, që u përshkruan përmbledhtas në paragrafët e mëparshëm. A përkojnë ato, në vija të përgjithshme, me trevat ku fliten sot dialekti jugor dhe dialekti verior i gjuhës shqipe? Për sqarimin e kësaj pyetjeje mund të mjaftonte edhe fakti që *historikisht nuk dëshmohet gjekundi ndonjë shpërngulje e tillë popullsie, që të mund ta shpjegonte një ndarje të tillë dialektore*. Këtu është fjala për një shpërngulje të tillë të madhe me drejtim nga veriu në jug, të kryer në kohëra relativisht të hershme, kur kanë ndodhur p.sh. shndërrimi i zanores *ã* para bashkëtingëlloreve hundore në -*ë*, apo rotacizimi i -*n*-së ndërzanore në dialektin jugor (...).

Megjithatë, për historinë e gjuhësisë shqiptare ka më shumë rëndësi që kjo çështje të rrihet e të trajtohet më fort në rrafshin gjuhësor. Për këtë qëllim po rimarrim e po rishqyrtojmë nga ky këndvështrim një nga dukuritë më tipike, që e dallon dialektin jugor nga dialekti verior dhe pikërisht *rotacizmin*. Një dukuri e tillë e vjetër, që është përgjithësuar prej kohësh në të gjitha trevat ku flitet dialekti jugor, *vështirë se mund të jetë përfuar në një trevë tjetër më në veri, sepse në këtë rast do të kishin mbetur, të paktën, disa gjurmë rotacizmi në zonat e Shqipërisë Veriore*⁸⁹.

⁸⁷ Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, Tiranë 1999, f. 54. Shih ribotimin Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve*, Tiranë 2015, f. 46.

⁸⁸ Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe*, Tiranë 1999, f. 107. Në bibliografi nga punimet tona me këtë problematikë të botuara deri në atë vit ka përmendur vetëm punimin *Lashësia e dialekteve të shqipes-dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, *Studime filologjike*, 3, Tiranë 1882, f. 65-77, botuar edhe frëngjisht me titullin *L'ancienneté des dialectes de l'albanais. Temoignage des territoires anciens des albanais*, *Studia Albanica*, 2, Tiranë 1982, f. 125-136.

⁸⁹ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988, f. 245-246.

Pra, më 1988 Sh. Demiraj nuk flet në mënyrë eksplicite për vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes, po gjithsesi pranonte që dukuria e rotacizmit, të cilën e vlerësonte si të vjetër, ishte zhvilluar në territoret e sotme të shqiptarëve⁹⁰.

Më 1999 lidhur me vendin e formimit të dy dialekteve të shqipes ai ka shkruar: “Është një gjë e njohur që ndryshimet me karakter dialektor kanë një shtrirje gjeografike të caktuar dhe janë zhvilluar brenda një periudhe të caktuar kohore. Për sa u takon dy dialekteve kryesore të shqipes, siç dihet, ato gjeografikisht shtrihen në pjesën veriore (gegërishtja), perkatësisht jugore (toskërishtja) të trevave të banuara nga shqiptarët dhe ndahen, në vijë të trasha, nga lumi *Shkumbin*. Këto dy dialekte të gjuhës shqipe me veçoritë përkatëse *nuk mund të jenë zhvilluar veçse në trevat, ku vazhdojnë të fliten*. Përndryshe, do të duhej të supozonim që folësit e dialektit verior dhe ata të dialektit jugor janë vendosur në trevat e tyre të sotme duke u shpërngulur në një kohë të caktuar nga treva të tjera, të ndryshme nga ato të sotmet, por një supozim është i pambështetur si *gjuhësisht* dhe *historikisht*”⁹¹.

E duke qenë se (...) ndryshimet me karakter dialektor janë kryer në një hapësirë gjeografike të caktuar, mund të nxirret natyrshëm përfundimi që stërgjyshërit e folësve të dialektit verior dhe jugor të shqipes kanë qenë të pranishëm në trevat e tyre të sotme në periudhën pasromake dhe parasllave⁹².

⁹⁰ Sh. Demiraj, **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Tiranë 1988, f. 245-246. “Një dukuri e tillë e vjetër, shkruante ai, që është përgjithësuar prej kohësh në të gjitha trevat ku flitet dialekti jugor, *vështirë se mund të jetë përfuar në një trevë tjetër më në veri*, sepse në këtë rast do të kishin mbetur, të paktën, disa gjurmë rotacizmi në zonat e Shqipërisë Veriore”. Në literaturën e shënuar në librin e vitit 1988 figuron artikulli ynë *Lashtësia e dialekteve të shqipes-dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, botuar më 1982, ku kjo pikëpamje është argumentuar gjerësisht me të dhëna gjuhësore e historike, po mungojnë trajtimet tona më të hershme të kësaj problematike, në vitet 1972, 1979 po edhe 1986, ku argumentohen gjerësisht vjetërsia dhe vendi i formimit të dy dialekteve të shqipes. Po në librin e botuar më 1999 në paragrafet kushtuar vjetërsisë dhe vendit të formimit të dy dialekteve të shqipes nuk zihen në gojë artikujt e botuar nga ne për këtë problematikë, po në listen e veprave të shfrytëzuara figuron artikulli “*Lashtësia e dialekteve të shqipes-dëshmi e vendbanimit të hershëm të shqiptarëve*, **Studime filologjike**, nr. 3, Tiranë 1982, i cituar edhe më 1988. Ajo që ka rëndësi për ne këtu është se Sh. Demiraj e ka bërë të vetën jo vetëm pikëpamjen mbi vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes po edhe të vendit të formimit të tyre në territoret e sotme të shqipe.

⁹¹ Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe**, Tiranë 1999, f. 105.

⁹² Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe**, Tiranë 1999, f. 107.

Sh. Demiraj për shkaqet e formimit të dy dialekteve të shqipes

“Duke u mbështetur në vjetërsinë mjaft të madhe të ndarjes dialektore të shqipes dhe duke pasur parasysh se viset ku është zhvilluar dialekti jugor i shqipes përkrijnë në një pjesë të madhe me ato që në lashtësi bënin pjesë në trevën e të ashtuquajturit Epir”, shkruante Sh. Demiraj, “mund pohohet se banorët e lashtë të asaj treve, në pjesën më të madhe, kanë folur një gjuhë, e cila nëpërmjet evolucionit të saj të shkallëshkallshëm ka dhënë variantin jugor të shqipes së sotme. Përndryshe, do të duhej të prananim që *stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm në një periudhë të caktuar pas-antike kanë shtegtuar në ato vise dhe kanë asimiluar një popullsi të helenizuar ose gjithsesi të ndikuar nga kultura helene, çka vështirë se mund t’i qëndrojnë kritikës. Dhe me të vërtetë historia nuk dëshmon asnjë shtegtim të tillë, që pa tjetër do të ishte vënë re. Për më tepër, vështirë që një popull jo-grek të mund të ketë asimiluar një popullsi të helenizuar apo të ndikuar prej kulturës greke*”⁹³.

Pra, Sh. Demiraj, në Pajtim me Hahn-in, po edhe me ne, në dallim nga të gjithë studiuesit e përmendur më sipër, ka pranuar *vjetërsinë e formimit të dy dialekteve të shqipes si edhe që “stërgjyshërit e folësve të dialektit verior dhe jugor të shqipes kanë qenë të pranishëm në trevat e tyre të sotme në periudhën pasromake dhe parasllave”, po edhe që viset ku është zhvilluar *dialekti jugor i shqipes përkrijnë në një pjesë të madhe me ato që në lashtësi bënin pjesë në trevën e të ashtuquajturit Epir*”⁹⁴. Sipas Demirajt “gjuha amtare në të ashtuquajturin *Epir* gjatë shekujve, duke përfshi edhe periudhën e lashtësisë, nuk ka qenë e ndryshme nga ajo e stërgjyshërve ~ arbëreshëve a shqiptarëve në përgjithësi”⁹⁵.*

⁹³ Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe**, Tiranë 1999, f. 54-55 (shih edhe ribotimin Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve**, Tiranë 2015, f. 46).

⁹⁴ Sh. Demiraj, **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe**, Tiranë 1999, f. 107. Aty ka shënuar “për më shumë sqarime mbi ndarjen dialektore të shqipes dhe mbi kohën e kësaj ndarjeje shih Sh. Demiraj, **Gjuha shqipe dhe historia e saj**, Tiranë 1988, f. 229 v. me literaturën përkatëse.

⁹⁵ Sh. Demiraj, **Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët**, Tiranë 2008, f. 94.

Wilfried FIEDLER, Meissen

DIE DARSTELLUNG DER GENUSPROBLEMATIK IN DEN DEUTSCHSPRACHIGEN ALBANISCHEN GRAMMATIKEN DES 19. JH.

I. Allgemeines zur Kategorie des Genus und ihrer Entwicklung in der albanischen Sprachgeschichte

Die Darstellung der Kategorie des Genus beginnt in Grammatiken des Albanischen oft wie bei P. Pani: "Im Albanischen gibt es drei Genera: Maskulinum, Femininum und Neutrum."¹ So könnte der am Albanischen Interessierte meinen, es handle sich um ein Genus-System, wie er es aus dem Deutschen, den klassischen indogermanischen Sprachen oder - um andere moderne Balkansprachen zu nennen - aus dem Neugriechischen und Bulgarisch-Makedonischen kennt, auch wenn er bei Pani anschließend liest: "Das Neutrum ist im Schwinden begriffen und die Zahl der Neutra gering..." Im Zusammenhang mit dieser Reduzierung wird er fragen, wie sich das Albanische denn in Fällen wie dt. "In diesen Jahren gab es wenig zu essen. *Das* waren schlimme Zeiten" oder wie "*Das* ist mein Sohn", wo es nicht um neutrale Substantive, sondern um die Verwendung neutraler Pronomina ohne Bezug auf konkrete Substantive geht, verhält.² Als Kenner des mit dem Albanischen historisch und typologisch so eng verbundenen Rumänischen, in dem als Neutra Substantiva bezeichnet werden,

¹ P. Pani: Albanisch intensiv. Wiesbaden 2007.

² Einige Probleme des syntaktischen Bezugs, speziell des Genus- und Numerus-Bezugs in einem Subjekt-Prädikativ-Verhältnis, sind vergleichend-historisch von B. Delbrück: Vergleichende Syntax der indogermanischen Sprachen. III (= **Grundriß der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen. V**). Straßburg 1900, S. 240-243, später auch u.a. von K. Brugmann: **Die Syntax des einfachen Satzes im Indogermanischen**. Berlin - Leipzig 1925, S. 175-178, behandelt worden, wobei allerdings in beiden Fällen das Alb. gar nicht berücksichtigt ist. Vgl. dazu W. Fiedler: *Zum Neutrum im Albanischen und Baltischen*. In: **Studime** 14. Prishtinë 2007. S. 33-49.

die sich im Singular syntaktisch wie Maskulina, im Plural wie Feminina verhalten, wird er weiterhin fragen, ob man im Albanischen unter "Neutrum" etwas Ähnliches versteht wie diese "Ambigena" oder - besser - "Heterogena".³

Im Grunde ergeben sich daraus drei Fragenkomplexe:

1. Welche Merkmale unterscheiden neutrale (n) Substantive von maskulinen (m) und femininen (f), und gibt es bei ihnen spezifische kongruente Pronomina?

2. Werden diese spezifischen Pronomina auch unabhängig von den neutralen Substantiven als "syntaktische neutrale Formen" verwendet?

3. Gibt es das Phänomen der Heterogenie, ein unterschiedliches Genus-Verhalten konkreter Substantive in den beiden Numeri Singular und Plural?

Diese Fragen wären für die altgegische Sprache des Gjon Buzuku von 1555 leichter zu beantworten als für die Sprache der Gegenwart: Bereits Eqrem Çabej hat in seinem Beitrag "Gjon Buzuku"⁴ eine große Anzahl von Substantiven - Erbwörtern wie auch Latinismen, Bezeichnungen von Stoffen (*li* "Lein", *ujë* "Wasser")... ebenso wie von Gegenständen (*rrjetë* "Netz"), Körperteilen (*ballë* "Stirn", *krye* "Kopf"), Abstrakta (*faj* "Schuld") usw. nachgewiesen, die das Bestimmtheitszeichen (den bestimmten Artikel) *-të* im Nom. und Akk. Sg. aufweisen - abgesehen von manchen Substantiven, die zwischen verschiedenen Genera schwanken, wie es auch in vielen anderen Sprachen der Fall ist (z. B. *drū* "Baum", *muoj* "Monat", *djalë* "Kind; Knabe"), vor allem aber auch unterschiedliche Pronominalformen, die bruchstückhaft und mundartlich auch in der Sprache der Gegenwart ("1972") vorkommen:

³ Wir nehmen hier sogleich vorweg, dass in der Tat z.B. dem rum. Sg. *cuvînt* mask. "Wort", Pl. *cuvînte* fem. das alb. *kuvend* mask. "Ratsversammlung...", Plural *kuvende* fem. etymologisch und auch im Genusverhalten entspricht, es jedoch keinem Grammatiker einfallen würde, dieses Wort als Neutrum zu bezeichnen.

⁴ E. Çabej: *Gjon Buzuku. 5. Format.* In: **Buletin për shkencat shoqerore I** (1955), 3, S. 39-50.

	Sg.	m	f	n	Pl.	m	fn
Demonstrativpronomina							
"hic" (1555 und 1972) ⁵	<i>ky</i>	<i>k(ë)jo</i>	<i>këta;</i>		<i>këta</i>	<i>këto</i>	
"ille"	<i>ai</i>	<i>ajo</i>	<i>ata;</i>		<i>ata</i>	<i>ato</i>	
Possessivpronomina (1. und 2. Person)							
1. Sing. "mein" 1555	<i>em</i>	<i>eme</i>	<i>tem;</i>		<i>e mī</i>	<i>e mī</i>	
1972	<i>im</i>	<i>ime</i>	<i>(tim);</i>		<i>e mi</i>	<i>e mia</i>	
1. Pl. "unser" 1555	<i>ynë</i>	<i>jonë</i>	<i>tanë;</i>		<i>tanë</i>	<i>tona</i>	
1972	<i>ynë</i>	<i>jonë</i>	<i>(tonë);</i>		<i>tanë</i>	<i>tona</i>	
2. Sing. "dein"							
1555	<i>yt</i>	<i>jote</i>	<i>tat;</i>		<i>e tū</i>	<i>e tū</i>	
1972	<i>yt</i>	<i>jote</i>	<i>(tënd/tat);</i>		<i>e tu</i>	<i>e tua</i>	
2. Pl. "euer" 1555	<i>yj</i>	<i>juoj</i>	<i>taj;</i>		<i>taj</i>	<i>tuoj</i>	
1972	<i>juaj</i>	<i>juaj</i>	<i>(tuaj);</i>		<i>tuaj</i>	<i>tuaja</i>	

Die Tabelle zeigt, dass den drei unterschiedlichen Genusformen des Singulars (m, f, n) zwei des Plurals entsprechen (m = maskulin, fn = feminin + neutral). Da es in der Sprache Buzukus auch das Phänomen der bereits oben erwähnten Heterogena gibt, kann das Genussystem dieser Variante des Albanischen folgendermaßen dargestellt werden:

mmfn
mfnfnfn

Dieses Schema habe ich bereits in meinem Artikel von 1965 gebracht, wobei für diese Sprache, aber auch die weitere Entwicklung noch

⁵ 1555 erschien das erste auf uns gekommene Buch in alb. Sprache, das sog. "Messbuch" des Gjon Buzuku; 1972 fand mit dem Orthographiekongreß in Tirana der Normierungsprozess des Albanischen einen gewissen Abschluss. Zu den Formen vgl. W. Fiedler: *Zum Genus im Albanischen*. In: **Beiträge zur Sprachwissenschaft, Volkskunde und Literaturforschung (Steinitz-Festschrift)**, Berlin 1965, S. 87 - 102; s. auch bereits bei Sh. Demiraj: **Morfologjia historike e gjuhës shqipe**. Pjesa I. Tiranë 1973, S. 148 - 150. Zu den Formen im Altgeg. und im Standard-Alb. vgl. auch Sh. Demiraj: **Gramatikë historike e gjuhës shqipe**, Tiranë 2002, S.236 ff.dort auch detaillierter zu den Kasus der Pronomina.

Die in der Tabelle als "1972" gebrachten Formen entsprechen nicht der standardalbanischen Norm, sie kommen jedoch vereinzelt in Mundarten vor.

einige wenige Sonderfälle wie *krye* "Kopf; Haupt" und *fëmijë* "Kind" zu berücksichtigen waren.

Das System des Genus hat sich bis zur Sprache der Gegenwart in mannigfachen Übergangssystemen - je nach Texten und Befolgung des Standards von 1972 - auf zwei Systeme reduziert, zu einem Minimal-system:⁶

mf

mf

und einem "typischen" System:

mmf

mff

das (ziemlich genau und wohl nicht ganz zufällig) dem System des modernen Rumänischen entspricht.⁷

Auch diese meine Darstellung von 1965 war eine morphosyntaktische, denn ich habe bereits damals die Formen der Personal- und Possessivpronomina vergleichend dargestellt, denn man kann die erwähnten "Systeme" nicht aus den Formen der Nomina, sondern nur aus ihrem Kongruenzverhalten ableiten, und dieses kann nur an den Pronomina und attributiven Artikeln erkannt werden.

⁶ Das gilt z.B. für die Sprache des prominenten Albanologen Selman Riza, der die "Heterogenie" selbst bei Abstrakta vermeidet, d.h. mask. Formen des Adjektivs bei Subst. mit der Pluralendung *-e*, vgl. **Buletin** 1959,2,43: *të trajtimevet të deritashëm* "der bisherigen Abhandlungen"; S. 45: *një varg problemesh të veçantë...* "eine Reihe besonderer Probleme". Ich habe den Eindruck, dass auch heute noch dieses "unlogische Verhalten" vieler Substantive manchem Muttersprachler Kopfzerbrechen bereitet.

⁷ Im Rahmen der Standardisierung wurde festgelegt, dass im Prinzip nur Maskulina, deren Nominativ-Plural-Formen auf *-e* bzw. *-ra* enden, als Heterogena zu behandeln sind (vgl. A. Kostallari & al.: **Gjuha letrare shqipe për të gjithë**. Tiranë 1976: 50 f. Die "Akademieggrammatik" **Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe**. II. [= FG IIë Tiranë 1976, S. 66, lässt bei *fshat*, Pl. *fshatra* auch das Verhalten als Mask. *fshatra të rinj* "neue Dörfer" gelten und erwähnt, dass sich umgekehrt andererseits auch bei einigen Mask. mit dem Plural auf *-a* Heterogenie durchsetze (*hapa të gjata* "lange Schritte", *kolektivat punonjëse* "Kollektive von Werktätigen").

Bei den Resten des Neutrums äußere sich danach das Genusverhalten nur noch morphologisch am Bestimmtheitszeichen bzw. am lexikalisierten attributiven Artikel (*krye-t; të ecur-i-t, të ri-të*) (ebda., S. 64; Beispiele für das syntaktische Verhalten werden leider nicht gebracht).

In meiner Arbeit von 1965 war allerdings ein Aspekt des Neutrums noch nicht berücksichtigt, den ich in dem späteren Artikel von 2007 analysiert habe. - das sog. "syntaktische", nicht mit bestimmten Nomina verbundene Neutrum, die Verwendung neutraler Pronominalformen ohne Bezug zu bestimmten Substantiven.

Das ist auch der Ausgangspunkt für die Behandlung unseres heutigen Themas: Wir konzentrieren uns dabei auf zwei Gebiete, 1. das *Neutrum* und 2. die *Heterogenie*

zu 1: Drei Bereiche des Neutrums und ihr Schicksal von Buzuku bis zur Gegenwartssprache:

1.1. Die erwähnten "Erbwörter", Latinismen usw.: Sie zeichnen sich, wie erwähnt, durch das Bestimmtheitszeichen (den bestimmten Artikel) - *t(ë)* im Nom. und Akk. Sg. aus: *ujë-të* "Wasser", *drithë-të* "Korn, Getreide", *ballë-të* "Stirn", *krye-t* "Haupt" usw.⁸

1.2. Substantivierungen von Partizipien und Artikel-Adjektiven wie *të ecur-it* "das Gehen" bzw. *të bukur-it* "das Schöne", *të mirë-t* "das Gute". Sie sind gleichzeitig durch den vorangestellten lexikalisierten attributiven Artikel *të* und das Bestimmtheitszeichen *-(i)t* charakterisiert.

In beiden Fällen sind Neutra nur syntaktisch, durch die erwähnten Pronominalformen oder durch den attributiven Artikel *të* (des Artikel-Adjektivs bzw. Genitivs) in bestimmten Positionen (z.B. attributiv, wo die indeterminierte mask. Form im Nom. bzw. Akk. *i* bzw. *të*, die determinierte *i*/ [in Kontaktposition *e* lautet, oder prädikativ, wo die mask. Form im Nom. *i* lautet).

⁸ Als ein Beispiel für den Übergang vom Neutrum zum Mask. kann das Wort *emër/* geg. *emën* dienen, das im Vaterunser (Mt 6 9/Lk 11 2) in allen Bibelübersetzungen usw. belegt ist ("geheiligt werde dein Name"): Buzuku: *kloftë festuom emënite tat* (Çabej II, 44 29); *u festoftë emënite tat* (68 63). Die späteren Texte lauten (in vereinheitlichter Umschrift): Matranga 1592: *ati inë që je ndrë qielltë, shejtëruatë emëri it* Budi1664: *shëjtënuom kloftë emënitë tat*, Kazazi 1743: *shëjtënuom kjoftë emnit tat*, Mexsi/Grigori 1827: *qoftë shëntëruarë emëri it*, Kristoforidhi, gegisch 1872: *U shenjëtënoftë emëni yt*, Kristoforidhi, toskisch 1879: *U shenjëtëroftë emëri yt*. Oroshi 1978: *shejtmue qoftë emni i yt*. Plumbi-Frenzcke 1996: *u shenjëtëroftë emri yt*. (Außer Buzuku und den fünf letzten Beispielen, die direkt den erwähnten Bibelübersetzungen entnommen sind, alles nach J. Rrota: *Monumenti më i vjetri i Giuhës Shqype*, Shkodër 1930).

1.3. das "syntaktische Neutrum". Das Phänomen zerfällt allgemein z.B. für europäische indogermanische Sprachen in zwei Unterbereiche:

1.3a. "das ist gut" = "diese Sache/Erscheinung" ist gut".

Hier liegt ein Bezug zu einem Sachverhalt oder einer Äußerung außerhalb des Satzes vor. Es ist von vornherein zu unterscheiden vom Phänomen:

1.3b. "das ist ein Mann", "das ist eine Frau", wo ein Subjekt-Prädikat-Verhältnis innerhalb des Satzes, genauer innerhalb der Phrase, vorliegt.

In unserem Fall geht es darum, ob dabei im Albanischen das neutrale Demonstrativpronomen (*këta/ ata*) im Prinzip ohne Bezug zu einem neutralen Substantiv verwendet wird oder nicht.

Dieses Phänomen erfordert eine nähere, wenn auch kurze Charakterisierung. Wir vergleichen zu diesem Zweck einige Bibelstellen in verschiedenen Übersetzungen und bringen vorausgreifend auch Texte aus der Übersetzung von Vangjel Meksi (gekennzeichnet als (1827)), die für die weiter unten zu charakterisierenden Grammatiken von Xylander und v. Hahn praktisch die einzige Textgrundlage bildete:

zu **1.3a**:

- **Fall 1:** Bezug auf Vorhergehendes. Mt 26 56:

agr.: Τοῦτο δὲ ὅλον γέγονεν, ἵνα πληρωθῶσιν αἱ γραφαὶ τῶν προφητῶν.

lat.: Hoc autem totum factus est, ut adimplerentur scripturae prophetarum.

"Und all dies geschah, auf dass die Schriften der Propheten erfüllt würden."

alb. (1555): *E gjithë këta A bā përse t ishnë mbaruom të Shkruometë e përfetëvet.* (Çabej II, 207)⁹

⁹ Ich zitiere hier die Buzuku-Beispiele nach der Ausgabe von E. Çabej, "**Meshari**" i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik. Pjesa e dytë. Faksimile dhe transkribim fonetik. Tiranë 1968. Sie sind durch die Jahreszahl (1555) gekennzeichnet. Die anderen Jahreszahlen beziehen sich auf die folgenden Übersetzungen von Teilen der Bibel: (1827) Η ΚΑΙΝΗ ΔΙΑΘΗΚΗ Του Κυριου και Σωτηρος ημων ΙΗΣΟΥ ΧΡΙΣΤΟΥ ΔΙΓΛΩΤΤΟΣ, τουτέστι ΓΡΑΙΚΙΚΗ και ΑΛΒΑΝΗΤΙΚΗ ... Κορφοι 1827. Zitiert: Grigori. (187) (1872) Kristoforidhi, K. [Übersetzer]: *Diata e rë e Zotit eðe ðelbuesit t'unë Iesu-Kristit,*

alb. (1827): *E këjo gjithë u bë, që të paguhaenë* [?ë kartërat'e profitëret.

alb. (1872): *Por gjithë këjë u bâ, qi të mbÿshenë shkronjat' e profëtënavet.*

alb. (1978): *Por të gjith këta ka ndollë, që të permbusheshin Shkrimet e profetëve.*

- **Fall 2:** Bezug auf nachher Geschehenes/Gesagtes. Jh 15 17:

agr.: Ταÿτα ἐντέλλομαι ὑμῖν, ἵνα ἀγαπᾶτε ἀλλήλους.

lat.: Haec mando vobis, ut diligatis invicem.

"Dies ist es, was ich euch gebiete, dass ihr einander liebt."

alb. (1555): *Këta anshët ta qish u juve ordhënoj, se ju të duhë ndër vetëhenë.* (Çabej II, 353)

alb. (1827): *Keto u porsit juvet, që të doi njeri jatërinë.*

alb. (1872): *KëtA u porosis juve, të doni njani tjetrinë.*

alb. (1978): *Ata cka un ju urdhnoj, âsht që ta doni njeni-tjetrin.*

alb. (1996): *Këto ju porosis: që të doni njëri-tjetrin.*

In sämtlichen durch diese Beispiele (sowie auch die Beispiele (1) - (12) in Fiedler (2007)) repräsentierten Fällen können im Alb. des 16. Jh. und theoretisch auch später, neutrale Pronominalformen stehen. In den alb. Idiomen aus der Zeit nach Buzuku treten mit zunehmender Häufigkeit statt der neutralen singularische und pluralische feminine Pronominalformen auf, man vgl. den Nom. Sg. *k(ë)jo, gjithë k(ë)jo* in (5), (10) und (3), den Akk. Sg. *këtë, atë* (der mit der mask., nicht aber mit der neutr. Akkusativform gleichlautend wäre) in (2), (9), (10) und (12) in Fiedler (2007). Nominalgruppen als Umschreibungen pronominaler neutraler Formen bzw. ihrer nichtneutralen Nachfolger kommen im Alb. von Anfang vor, vgl. *këtë kafshë* (Akk) "diese Sache" in (12) und *këtë sherbes* (Akk) "dass." in (12) sowie *gjith kë shurbës* im Beispiel oben, auch die entspre-

keθyem prei grekÿstese vieter škÿip nd e ġuħe gegenište prei Konstantinit Kristoforidit, Elbasanasit. Konstantinopol [Zitiert: Kristoforidhi gegenischtë. (1979) (Kristoforidhi, K. [Übersetzer]: Τά τέσσαρα εÿαγγέλια και αι πράξεις τών 'Αποστόλων παραφρασθεÿσαι ἐκ τοÿ ἀρχετύπου ἑλληνικοÿ. Κατ'ερ Α νήγντε εδε πΑ νετ' ε Αποστοÿβητ κε θυερε preÿ grekÿs tesse bietepe vde γλΑ ġe τοσκe ρÿs τε. Κονσταντινοπολε 1879 [Zitiert: Kristoforidhi tosk[isch]. (1978) Oroshi, J. [Übersetzer]: **Shkrimi shëjt. Katër ungjijt dhe punët e apostujvet.** Përkthye shqip prej teksteve origjinale nga Msgr.Dr. Joseph J. Oroshi. Bronx, N.Y. (1978) (1996) L. Plumbi-Frenzcke. [Übers.ê: **Dhjata e re.** Tiranë 1996. In allen Texten sind nur die neutralen Formen unterstrichen.

chenden Pluralformen *gjithë kafshëtë tuoj* in (6), *kto šurbise* in (7), weiterhin *kjo gjë* "diese Sache" in (10), *çdo gjë* in (6), *kjo punë* "diese Sache" usw.

Vorweg sei erwähnt: Auch bei Mexsi/Grigori hat diese Funktion des neutralen Demonstrativpronomens bereits die fem. Form Sg. oder Pl. übernommen (vgl. die beiden mit (1827) gekennzeichneten Beispiele).

zu **1.3b**:

1. Beispiel: Mt 26 26 ff.

agr.: Λάβετε, φάγετε. τοῦτο ἔστι τὸ σῶμά μου... Πίετε ἕξ αὐτοῦ πάντες τοῦτο γάρ ἔστι τὸ αἷμά μου

lat.: Accipite et comedite; hoc est corpus meum...Bibite ex hos omnes; hic est enim sanguis meus novi testamenti...

"Nehmt und esst, denn dies[erë ist mein Leib ... Trinkt davon alle, denn dies[esë ist mein Blut des neuen Testaments."

alb. (1555): *Meri e ani, se ky anshtë korpi em ... Pini n kësi gjithë; përse ky anshtë gjakAem i d riut zakon.* (Çabej II, 205);

alb. (1827): *mirri, e hai, se kyj është kurmi im....*aber doch auch: *Se këjo (f!) është gjaku im (m!), e dhjatësë së re*

alb. (1872): *Mirrni, e hani, kyj ashtë korpi em ... kyj ashtë gjaku em ...*
"Nehmt und eßt, dies[erë ist mein Leib ... dies[esë ist mein Blut ..."

2. Beispiel : Jh 6 58 f.

agr.: Οὗτός ἐστιν ὁ ἄρτος ὁ ἐκ τοῦ οὐρανοῦ καταβάς...

lat.: Hic est panis, qui de coelo descendit,...

"Und dies[esë ist das Brot; (jenes), was von den Himmeln herunterkam."

alb. (1555): *E këjo anshtë buka qi u dorgj n qiellshit.* (Çabej II, 277);

alb. (1827): *Këjo është ajo bukë qe zbriti nga Qielli.*

3. Beispiel: 1 Jo 5 9

agr.: ὅτι αὕτη ἔστιν ἡ μαρτυρία τοῦ θεοῦ, ἣν μεμαρτύρηκε περὶ τοῦ υἱοῦ αὐτοῦ.

lat.: Quoniam hoc est testimonium Dei quod maius est, quoniam testificatus est de Filio suo.

"Denn dies[esë ist das Zeugnis Gottes, das er von seinem Sohn abgelegt hat."

alb. (1555): *përse këta ansh të dëshmuomitë e Tinëzot, qi dëshmoi në Birit të vet.* (Çabej II, 251);

Leider steht mir hier (1827) nicht zur Verfügung; Oroshi (1978) hat die Übersetzung der Briefe des Johannis nicht veröffentlicht.

In diesen Beispielen sind die (hier unterstrichenen) neutralen Pronominalformen nur nachzuweisen, wenn das Bezugswort im Satz ein Neutrum ist (hier bei Buzuku im 3. Beispiel das substantivierte Partizip të dëshmuomitë).

zu 2: Die Heterogenie begegnet schon bei Buzuku, wie ich bereits in Fiedler (1965:91) festgestellt habe: "*një shpirt të rī* (sg.m.) (Çabej II, 174) "einen neuen Geist"; *shpirti i* (sg.m.) *saih* (178) "ihr Geist" und so häufig, hingegen *shpirtënatë tonë* (pl.f.) (20) "unsere Geister"; *për mot* (wegen endungslosem indefinierten Akk. sicher sg. m.) *të glatë* (12) "für lange Zeit"; *në moteshit plaka* (pl. f.) "aus alten Zeiten" (302). Ähnliche Beispiele können u.a. noch bei *zakoni*/ Pl. *zakone* u.a. "Brauch"; *lumë/lumëna* "Fluss"; *krah/ krahë* "Arm" beigebracht werden."

II. Die Darstellung der Genus-Problematik in den Grammatiken von Xylander und v.Hahn und ihr Einfluss auf Kristoforidhi

Wie sind nun die beiden ersten deutschsprachigen Grammatiken des Albanischen mit diesem Problem, einem schwierig gegliederten und in einer komplizierten Entwicklung befindlichen Phänomen, zurechtgekommen? Wir müssen dabei bedenken, dass die Grammatiken von Xylander und Hahn überhaupt die ersten waren, die ein Erlernen des Albanischen ermöglichten, denn die Darstellungen von da Lecce und Leake, auf die wir sogleich zu sprechen kommen, waren dazu nicht geeignet, da sie kaum Beispielsätze und gar keine Texte enthielten.

Der erste, Johann Georg Ritter von Xylander,¹⁰ der niemals im albanischen Sprachgebiet war, hatte an *Sekundärliteratur* nur eine einzige

¹⁰ J. Ritter von Xylander: **Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren**. Frankfurt am Main 1835.

nach Vollständigkeit strebende Grammatik, die gegischen "Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese" des Francesco Maria da Lecce,¹¹ und die kurzen, im wesentlichen toskischen grammatischen Skizzen des englischen Armeeeoffiziers und Archäologen William Martin Leake, der in den Dienst des Ali Pascha von Tepelene trat und so die Gelegenheit hatte, Griechenland und Teile des albanischen Sprachgebiets zu bereisen. Seine Erfahrungen und Eindrücke veröffentlichte er in einem Buch "Researches in Greece", London 1814.. Darin bringt er in Chapter II "Of the Albanian Language", S. 237-362, auch ein "Essay of Albanian Grammar", S. 263-288, das im wesentlichen die Frucht der Zusammenarbeit mit einem ehemaligen Lehrer aus Vithkuqi bei Voskopoja darstellt.¹²

Was konnte Xylander aus diesen beiden Quellen zur Genusproblematik gewinnen?

Da Lecce hat das Problem des in seiner Sprache noch weitgehend intakten Neutrums¹³ recht gut, wenn auch nicht ganz fehlerfrei dargestellt.

¹¹ Francesco Maria da Lecce: **Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese**. Roma 1716.

¹² S. 263: The following endeavour to form some grammatical rules for the Albanian dialect was made in order to facilitate the acquisition of the language; and I was, until very lately, quite ignorant of any similar attempt having been before made.

Anm.: Mr. Hobhouse in the Appendix to his travels in Albania, &c. has given the substance of an Albanian grammar, composed by an Italian missionary of the Roman Congregation de Propagandā Fide. It is intituled, - Osservazioni... printed at the Propagandā press at Rome in 1716. Some diversity will be remarked between the grammar of da Lecce, and the grammatical sketch now submitted to the public; but the former was chiefly intended for Northern Albania... where the dialect differs in some respects from that of the mountains of the South;... Though I had met with several Albanians of talents, and adequate learning, yet I never found one who had bestowed any attention on the grammar of his vernacular speech, or who had thought of any arrangement of rules, arising from that similarity of inflexion in the several parts of speech, which occurs in every language. The greater part of the information upon which the following remarks are founded, was derived from Evstratio (Εὐστράτιος) of Viskúki, who holds the rank of Hieroceryx (Ἱεροκέρυξ) in the Greek church, and had been many years schoolmaster at Moskhópoli. Besides being well acquainted with Hellenic and Romaic, and speaking and writing fluently in both, he possessed that more accurate knowledge of his native Albanian dialect, which was to be expected in a person so qualified.

¹³ Er spricht S. 4 von sieben Genera - außer m,f,n die Typen *eottinii* (per masc. e fem. - Kollektiv), *Giutetta fi* "comune a molti" und *Ký delpin* "promiscuo" für Fuchs und

Korrekt scheint vor allem S. 22 ff. die Darstellung des Adjektivs mit allen drei Genera und der für uns wichtigen Bemerkung: "Tutti i plurali de Neutri aggettivi sono simili alli plurali de Nomi *feminini*. Beispiel für die Poss.-Pron. S. 17:

Sing.	Il Tuo	La Tua.	La Cosa tua.
N. senza art.	<i>Àt.</i> Tuo.	<i>Iote.</i> Tua	<i>Tat.</i> Cosa tua.
N. coll'art.	<i>Àti.</i> il &c.	<i>Ioteia.</i> la Tua.	<i>Tatt.</i> la Cosa tua
G.	<i>Tit.</i> del Tuo	<i>Jote.</i> della Tua.	<i>Titt.</i> della Cosa tua ...

Entsprechend S. 31 ff. Pronomi Demonstrativi:

<i>KÁ</i>	<i>Kiò</i>	<i>Ketà</i>
...		
<i>Ketà</i>		<i>Ketò</i>

Il Plurale come il femminile di sopra S. 39 wird sogar *Trè* als die mask., *Tri* als die fem. und neutr. Form für "drei" angegeben.

Zu bedenken ist natürlich auch, dass da Lecce - wie erwähnt - fast keine Texte bringt, so dass Xylander eine syntaktische Charakterisierung gar nicht feststellen konnte.

Leake war für Xylander hinsichtlich der Genusproblematik noch weniger ergiebig. Bei ihm heißt es:

S. 267 f.: "There are only two genders, masculine and feminine, which last may be considered as including the neuter..." [ohne nähere Erläuterung!ë Darüber hat sich Xylander hinweggesetzt.

Er selbst stellt das Problem nämlich so dar (S. 8): "Das Albanesische hat nach Lecce drei Geschlechter, nähere Bestimmungen darüber gibt derselbe nicht. Nach Leake soll nur männliches und weibliches [sic!ë Geschlecht bestehen, welch Letzteres auch die Neutra umfassend, zu betrachten sei..."

Bei den Deklinationsschemata hat er auch das oben erwähnte, im Plural nicht korrekte Schema 7 übernommen (S. 13);

Füchsin und bringt als siebentes Genus "Incert, che alle volte è maschio, e alle volte è neutro come *Kÿ Ui* : *Ketà Uit*. Allerdings hat er das Problem des neutralen Plurals offenbar nicht richtig gesehen. So schreibt er S. 16: "Nom.sg. *Gruun* "frumento", Plur. n. *Grunte* "li frumenti" *Gruntevet* differenziert er S. 12 auch *Crÿe* als Körperteil (Pl.: krena) und als "Haupt einer Institution" merkwürdigerweise "senza articolo: krenet, e nel Nom. coll'art. *Crenete*".

Xylander ist aber, wie überhaupt, sehr sorgfältig mit Leakes Paradigmata umgegangen, indem er Formen, die er in der Bibelübersetzung nicht gefunden hat, eingeklammert hat, [vgl. andererseits dazu auch *dashurí* im folgenden Paradigma!ë

"7. Männlich, të dëshurë, Liebe, Wunsch

Sing. Nom.	<u>të dëshurë</u>	<u>të dashurìt</u> , n.d. Bibel <i>dashurí</i>
Gen.	<u>të dëshurì</u>)	<u>të dashurìt</u>
Accus.	<u>të dëshurë</u>	<u>të dashurìt</u> , <i>dashurinë</i>
Plur.Nom.	<u>të dëshurà</u>	<u>të dashurítë</u>
Gen.	(<u>të dëshurave</u>)	<u>të dashurítë</u>
Accus.	<u>të dëshurà</u>	<u>të dashurítë</u> "

[auch hier habe ich die tatsächlich n/fn Formen unterstrichen; WFë

Fassen wir zusammen: Xylander hätte von seinen Grammatiker-Vorgängern höchstens von Lecce die Dreiteilung und evtl. das "syntaktische" Neutrum übernehmen können. Für ihn war aber die Übersetzung des NT durch den aus dem lab. Labovë stammenden Vangel Meksi (1770-1821) die maßgebende Quelle. Seine eigene Grammatik ist leider nicht überliefert.

Um uns in seine Situation zu versetzen, versuchen wir also, aus diesem Buch, vor allem dem von Xylander beigegebenen Markus-Evangelium, Material zu gewinnen, das uns die drei "Bereiche" des Neutrums und die Heterogenie in dieser Sprache zeigt.

Zur Problematik des Neutrums

Belege für den 1. Bereich, also bestimmte neutrale Formen von nichtabgeleiteten Substantiven, sind, wenn auch spärlich, nachweisbar:

Mk 6 24: *ç të kërkoj? Edhe ajo i tha kriet'e Johannit Vaptistiut.* "Was soll ich bitten? Die sprach: das Haupt Johannes des Täufers."

Mk 8 15: *vështroni, e ruhuni nga brumët'e farisejet, edhe nga brumët' e Irodit.* "Schauet zu, und sehet euch vor vor dem Sauerteige der Pharisäer, und vor dem Sauerteige Herodis."

Off 6 6 (ebenfalls bei Xylander): *E digjova një zë ndë mes të katër kafshëvevet që thosh shniku i grurit një dinar, e tre shnikë elbit një dinar, e*

vajtë edhe verënë mos i dëmëto. "Und ich hörte eine Stimme unter den vier Tieren sagen: Ein Maß Weizen um einen Groschen, und drei Maß Gerste um einen Groschen, und dem Öl und Wein tue kein Leid."

Diese Beispiele aus dem von Xylander gebrachten Text geben meist kein Kongruenzverhalten wieder, auch keinen Numerus (Sg), nur das Bestimmtheitszeichen (der bestimmte Artikel) të im Nom. bzw. Akk. (die traditionellen Neutra *elb* und *grurë* sind hier ohne relevante Formen).

Vgl. aber eindeutige Belege für beides im Grigori-NT außerhalb des von Xylander beigegebenen Textes: Jh 4 14f.: *Ma cili do që të pijë nga ata ujë që t'i ap unë atij, do të mos ketë et ndë jetë të pasosurë, po ujëtë që do t'i ap unë atij, do të benetë ndë i [??]ë rjedhëjë ndë jetë të pasosurë. I thotë atij gruaja: Zot, nemë mua këta ujë...* "Wer aber von dem Wasser trinken wird, das ich ihm gebe, den wird ewig nicht dürsten, sondern das Wasser, das ich ihm geben werde, das wird in ihm ein Brunnen des Wassers werden, das in das ewige Leben quillt. Spricht das Weib zu ihm: Gib mir dieses Wasser..."; Jh 5 3: *E mba to [mb'atoë dergjej turm'e madhe të sëmurë...që prisnë të ljuan ujëtë* "in welchen lagen viel Kranke..., die warteten, wenn sich das Wasser bewegte." ¹⁴

Zur Existenz von Plural-Formen auf *-ra*: *ujëra* vgl. Beispiele in Anm. 14, weiter Lk 7 44: *edhe m'i fshiu me leshërat' e kreit së saj*. "... und diese hat sie mir mit den Haaren ihres Hauptes getrocknet."

Deutlichere syntaktische Bezüge lassen sich für den 2. Bereich des Neutrums auch im Markus-Evangelium finden; wir brauchen hier also die Grigori-Bibel nicht zusätzlich zu konsultieren, sondern können uns mit dem von Xylander beigelegten Markus-Evangelium begnügen:

Mk 1 44: *për të qëruaritë tat*. "... für deine Reinigung".

2 21: *e do të bënetë të çjerëtë më likshtë*. "... und der Riss wird ärger".

¹⁴ Vgl. auch weitere Belege neutraler Singular- und fin-Pluralformen von *ujë*: Mt 3 16: *E si u pagëzua Jisui, doli atë çast nga ujëtë, e ja e(?)ju hapnë Qielltë*. Mk 1 10: *E atë çast si doli nga ujëtë, pa Qielltë që u hapnë*. Mt 8 34: *e u mbijnë ndë ujëra*. Mt 10 42: *Edhe ai që të potisjë një nga këta të vogëlitë një potir ujë të ftohëtë vetëmë... nukë do të humbasë pagën'e tij*. Mt 14 28: *thujmë që të vij tek tij mbi ujëra*. Mt 14 29: *edhe Petrua zbriti nga varka, e ecën mbi ujëra...*

4 29: *se erdhi të korëtë*. "denn die Ernte ist gekommen."

5 25: *E një grua që kish të rjedhurë të gjakut dimbëdhjetë vjet*. "Und ... ein Weib, das hatte den Blutgang zwölf Jahre gehabt."

5 34: *ecë ndë të mirrë tënde, e shërou nga të keqitë tat*. "gehe hin in Frieden [w.: in dein Gutesē und sei gesund von deiner Plage."

6 21: *bën Irodi gosti për ditë të së lerit së tij*. "...Herodes auf seinen Jahrtag [w.: Tag seiner Geburtē ein Abendmahl gab."

7 35: *e iu sgjidh të lidhurit e gjuhësë tij*. "...und das Band seiner Zunge ward lose."

14 70: *e të folturit tat gjan*. "... und deine Sprache [Redeē lautet gleich also."

Den 3. Bereich, die "syntaktische" Verwendung von *këta*, haben wir bereits oben dargestellt. In beiden Varianten haben wir keine neutrale Form (*këta* bzw. *ata*) gefunden; diese war bereits durch die fem. Form oder die erwähnten Umschreibungen ersetzt.

Zur Heterogenie-Problematik

Die Heterogenie-Problematik wird bei Xylander, soweit ich sehe, nirgends angesprochen – ebensowenig wie in den Darstellungen seiner beiden Vorgänger [vgl. aber Buzuku-Beispiele weiter oben!], und doch lässt sie sich sowohl bei *-e* als auch bei *-ra* nachweisen; möglicherweise hat Xylander sie als nicht weiter erklärbare Varianten angesehen:

So finden wir im Vaterunser (zwei Varianten auf S. 84): *E dhe ndë-lena fajetë tona* "und vergib uns unsere Schuld[enē." bzw.:

E lena navet fajetë tona; der offensichtlich m. Sg. *fai* bzw. *faj* wird auf S. 267 erwähnt;

Mk 1 3: *bëni të shtruara monopetet e tij* "ebnet seine Pfade", S. 246 allerdings *monopetë*; Interessant die Pluralvarianten. Mk 1 27: *shpirtërat'e pëgëra* und Mk 3 11: *shpirtet e pëgëra* - also beide "charakteristischen" Bildungsweisen, *-e* ebenso wie *-ra/-na*, eindeutig Heterogenie bewirkend.

S. 4 hat Xylander die Vermutung geäußert, dass nach der Bibelübersetzung "ein Werk, wie nicht bald wieder ein solches für Albanien er-

scheinen wird" - und in der Tat ist zwischen 1827 und 1853 kein Buch im Albanischen oder über das Albanische auf dem Balkan erschienen.¹⁵

Johann Georg von Hahn, [später] k.k. Consul für das östliche Griechenland, hat in Heft II seiner "Albanesischen Studien", Jena 1854, "Beiträge zu einer Grammatik des toskischen Dialektes" gebracht.

Diese gründen in der Gliederung der Grammatik durchweg auf Xylander, so schreibt Hahn in der "Vorbemerkung", S.V: "Der Verfasser schrieb diese Beiträge, während er die Sprache lernte. Seine Methode war hiebei rein theoretisch, weil er in Jannina, seinem früheren Aufenthalte, als einer griechischen [aber damals noch zur Türkei gehörenden] Stadt, nur wenige Gelegenheit zu praktischer Uebung fand....: er schrieb alle in der Wörtersammlung des Ritters von Xylander enthaltenen Substantive, Adjective, Pronomina und Verba zusammen, ordnete sie nach ihren Endungen in verschiedene Classen, und declinirte und conjugirte dieselben dann der Reihe nach theils schriftlich, theils mündlich mit seinem Lehrer durch, welcher zwar ein geborner Albanese ist, seine Muttersprache aber ebenso wenig wie seine übrigen Landsleute theoretisch behandelt, oder sie auch nur zu schreiben versucht hatte, und daher Anfangs dem Gebaren des Verfassers mit grossem Unglauben und oft nur mühsam verhehlter Ungeduld folgte, bis er nach und nach mehr Interesse an der Sache gewann, und auf die Ideen des Verfassers einzugehen und dieselben zu verbessern, oder auch gar selbstständig in den Bau einzugreifen begann."

Offenbar handelt es sich hier um seinen toskischen Lehrer Apostolis G. Panajotidhi. Da das tosk. NT die Basis seiner Studien bildet, kommt gegisches Material in der Grammatik - anders als im "Lexikon" - nur ganz selten und ergänzend vor (nicht einmal der Gegensatz in der Infinitivproblematik wird erwähnt). Wenn man die sehr hohe Qualität der Darstellung nach einer so kurzen Beschäftigung mit dem Alb. bedenkt, könnte man denken, dass es sich hier um seinen zweiten Lehrer", Kostandin Nelko, später K. Kristoforidhi, handelt, der 1826 in Elbasan geboren wurde und damals also ein ganz junger Student um die 20 war. Man muss dabei bedenken, dass Hahn ab 1847 in Jannina war und auch Konstandin sich wohl

¹⁵ Allerdings erschienen in dieser Zeit einige der wichtigsten Veröffentlichungen aus dem und zum Italoalbanischen (z.B. 1847 "Poesie albanesi di Girolamo de Rada").

ebenso an das Toskische angeglichen hatte. In Jannina blieb Hahn bis 1850 - dann trat er eine Reise durch Albanien (bis Shkodra) an.¹⁶

Hahns Darstellung der albanischen Grammatik ist jedoch insgesamt ungleich umfangreicher und genauer als die aller seiner Vorgänger. Gerade auf dem Gebiet, das uns hier interessiert, hat er die Albanologie aber auf eine falsche Fährte gelenkt. Er schreibt S. 7: "Die albanesische Sprache kennt nur zwei Geschlechter, ein männliches und ein weibliches. Die Formen, welche man für sächlich hielt, ergeben sich als männliche und weibliche Pluralformen." So bringt er auch S. 30: *κρίε* und *κρύε-ja* "Haupt" Plur. *κρίε-τ* *κρέρα-τ*. Einige Subst. des "Bereichs 1" auf -*ë* werden S. 31 als Mask. aufgeführt, jedoch mit dem Best.-Zeichen -*i*: *gjalpë-i*, *djathë -i*, *dhjamë-i*, *drithë-i*.¹⁷

Ausführlicher geht er auf den Bereich 1 auf S. 39 unter der Überschrift "Eigenthümlichkeiten einiger Hauptwörter" ein: "Bei mehreren Hauptwörtern wird die Pluralform als Einzahl gebraucht und ist diese dann in der Regel beliebter, als die entsprechende Singularform. Hierher gehören:

Ujë-të für *ujë* "Wasser"

krietë für *krie* "Haupt"

korrë-të für *korrë* "Ernte"

(und weitere sieben der in vielen Grammatiken als Neutra bezeichneten Subst.).

Hahn fährt fort: "Das bezügliche Zeitwort steht im Singular: *më dhëmb krietë* "mich schmerzt der Kopf" - und hier bringt er eine Anmerkung, die wohl die weitere Darstellung des Problems in der Albanologie entscheidend beeinflusst hat: "Wie im Altgriechischen τὰ παιδιά παύζει" - und weiter: *ujëtë ishtë ftohëtë* "das Wasser ist kalt"; *të* [sic!, hier bringt er die oben charakterisierten "Bereiche" 1 und 2 durcheinander! WFë *korrëtë ëshhtë të sosurit'e jetësë*, "die Ernte ist das Ende der Welt" Mt 13 39.

Das bezügliche Adjektiv dagegen steht im Plural: *Djathëtë ishtë të pikëtë* (nicht *i pikëtë*), der Käse ist ranzig. Das Pronomen aber meist im

¹⁶ G.Grimm: **Johann Georg von Hahn (1811-1869). Leben und Werk.** Wiesbaden 1964 (= Albanische Forschungen. 1)

¹⁷ Von hier an transliteriere ich - wie schon bei Texten aus Xylander und Grigori - die komplizierte griechische Schrift.

Singular: *lyej krietë tat* "salbe dein Haupt", Mt VI, 17. Das scheint ihm nicht besonders auffällig gewesen zu sein, denn an dieser Stelle bringt Hahn auch die komplizierten Numerusverhältnisse bei den Kollektiva (*gjithë bota janë miq* "Alle Welt sind Freunde", *asqerë e tij qenë të fortë* "seine Soldaten[schaftë waren stark]").

Der Bereich 2 des Neutrums wird S. 86 f. bei den "Participialbildungen" abgehandelt: "Ein männliches, durch Vorsetzung des männlichen Artikels der Einzahl [sic, WFë und Anhängung der bestimmten und unbestimmten Pluralformen der zweiten Deklination: *të ikurë* "Flucht", *të ikuritë* "die Flucht: - *njera mbë* (fordert unbest. Accus.) *të ikurë të Vavylonësë* bis zur Flucht nach Babylon; - *nga* (fordert bestimmt. Nom.) *të ikurit'e Vavylonësë* von der Flucht nach Babylon, Matth I, 17. - Diese Form wird jedoch meistens wie die im §.11,1, erwähnten Substantive als Singular betrachtet, und daher steht das bezügliche Verbum im Singular: *të lëritë e Isuit Krishtit u bë kështu* wörtl. die Geburten, die Jesu Krishti, geschah (nicht geschahen) also, Matth. 1, 18. ... NT sogar *pas së gjalturitë sim* nach meiner Auferstehung, Matth. XXV,32, wo *së* und *sim* im Gen. Sing. und *gj...* im Nom. Plur. steht". Merkwürdig weiterhin: "Die weiblichen Pluralformen der Adjective, welche die Stelle von Substantiven vertreten, haben in der Regel das betreffende Zeitwort gleichfalls im Singular: *më pleqëron të mirat'e mia* es ernähren mich meine Güter im Alter." [ohne Quelle!]

35 Jahre nach seiner ersten Begegnung mit Hahn, im Jahre 1882, nachdem er bereits 1866 seine ersten Texte auf Gegisch veröffentlicht hatte, publizierte Konstantin Kristoforidhi seine Γραμματικὴ τῆς ἀλβανικῆς γλώσσης κατὰ τὴν τοσκικὴν διάλεκτον". Diese an Paradigmen sehr reiche, mit Kommentaren oder gar Texten jedoch ziemlich spärlich ausgestattete Grammatik zeigt, dass er sich in der Zwischenzeit sehr intensiv auch mit dem Toskischen beschäftigt hat. Tà Auf den ersten Blick hat er das Neutrum mit allen möglichen Singularformen richtig benannt und erschöpfend behandelt.

So bringt er auf S. 19 die vollständigen sechs Kasus in der unbest. und best. Form von *ujë* und *mish* und gibt auch weitere Subst. an, die entsprechend zu deklinieren seien, dann schreibt er aber:

Τὰ οὐδέτερα ὀνόματα δὲν ἔχουσι πληθυντικὸν ἀριθμὸν θεωρούμενα ὡς περιλῆπτιὰ οἶον "da sie als überflüssig betrachtet werden" - und übersetzt die alb. neutralen Singularformen mit griechischen Pluralformen, z.B. *ujëtë* = τὰ ὕδατα, *drithëtë* = τὰ γεννήματα....

Allerdings hat Kristoforidhi in seiner eigenen Sprache neutrale Pluralformen durchaus verwendet, vgl.

Jh 3 23: tosk.: *sepse atje ishinë shumë ujëra*; geg.: *sepse atje ishinë shumë ujëna* "denn da waren viele Wasser"

In seinem Wörterbuch¹⁸ schreibt er S. 291: (πληθ. *ujënatë* (γ), *ujëratë* (τ) ἄχρηστος "unnützig"), allerdings z.B. S. 246 πληθ. *mishnatë* (γ), *mishratë* (τ) = σαρκ-κός. κρέας, aber hier liegt ja im Pl. "Fleischstücke" auch keine "Masse" vor!

Außerdem merkt er, für den Zustand des Neutrums zu seiner Zeit wohl korrekt, an, dass statt der neutralen auch mask. Formen verwendet werden können. Bei den in diesem Fall ziemlich zahlreichen Beispielen trennt er das doppelte Genusverhalten jedoch konsequent, auch hinsichtlich der Pronominalformen usw., also:

këta dyllëtë t'at ëshhtë të verdhë = *ky dylli yt ëshhtë i verdhë* "dieser dein Wachs ist gelb."

këta mishtë t'at ëshhtë të papjekurë = *ky mishi yt ëshhtë i papjekurë* "dieses dein Fleisch ist nicht durchgebraten."

So verwendet er auch in seinen Übersetzungen beides:

Lk 12 18 tosk.: *edhe do të mbëleth atje gjithë drithëtë t'im*; geg.: *edhe do të mbëleth atje gjithë drithinë t'em*. "und ich werde dort all mein Getreide sammeln."

Er beurteilt diese Formen also im Prinzip korrekt und ganz anders als sein "Lehrer-Schüler" v. Hahn, wenn man ihm hier auch ein wenig Pedanterie vorwerfen möchte.

Ähnlich hat Kristoforidhi das Phänomen der Heterogenie abgelehnt; wir lesen also auf S. 13 f. seiner Grammatik:¹⁹ Τὰ ὀνόματα τῆς ἐννάτης,

¹⁸ Χριστοφορίδης, Κ.: *Λεξικὸν τῆς ἄλβανικῆς γλώσσης*. Ἀθῆναι 1905.

¹⁹ Kristoforidhi, K. (1882) = K. Χριστοφορίδης, *Γραμματικὴ τῆς ἄλβανικῆς γλώσσης*. EN ΚΩΝΣΤΑΝΤΙΝΟΥΠΟΛΕΙ.

δεκάτης καὶ ἑνδεκάτης κλάσεως σχηματίζουσι θηλυκῶς τὸν πληθυντικὸν ἀριθμὸν, ὅθεν πολλάκις καταχρηστικῶς συντάσσονται μετὰ θηλυκῶν ἐπιθέτων καὶ ἀντωνυμιῶν, οἷον: "die Substantive der neunten, zehnten und elften Klasse bilden den Plural männlich, weshalb sie oft mit männlichen Adjektiven und Pronomina verbunden werden, z.B.: *këto pusa të thella*, ἀντὶ "statt" *këta pusa të thellë*, *këto barëra të njoma*, ἀντὶ *këta barëra të njomë*, *këto male të larta*, ἀντὶ *këta male të larta*.

In seinen Bibelübersetzungen findet man jedoch Beispiele wie: Mk 5 11: geg. *ndëpër ato male*, tosk. *ndëpër ata male*; Mt 23 27: geg. *vorrevet lyeme me...*; tosk. *me varre të lyerë*, anders als bei Grigori: *me varre të liera* "mit übertünchten Gräbern."²⁰

Auch in der ersten von einem kompetenten Indogermanisten verfassten alb. Grammatik Gustav Meyer: Kurzgefasste albanesische Grammatik, Leipzig 1888.

ist dieses Gebiet noch nicht ganz korrekt dargestellt worden. Es heißt dort S. 7 f.: Substantiva. Geschlecht. 22. Das Albanesische kennt eigentlich nur männliches und weibliches Geschlecht. Als Neutra gelten eine Anzahl collectivisch gebrauchter Stoffnamen, wie *miš* "Fleisch", *vaj* "Öl", *ujë* "Wasser", *apë* "Butter", *dü ë* "Wachs", *grurë* "Getreide", *mië* "Mehl", *diathë* "Käse" u.a., welche im Nom.Acc. der bestimmten Declination statt des männlichen Artikels *i* auch den Artikel *të* annehmen können, der eigentlich dem Plural angehört und sie somit als collectivisch gebrauchte, mit dem Prädikat im Singular verbundene Plurale kennzeichnet. Auch beim Pronomen sind die Neutra *ketá* "dieses", *atá* "jenes" mit den männlichen Pluralformen identisch. So sind denn auch die als Abstracta gebrauchten Adjektive wie *të mirëte* "das Gute" und die als substantivische Infinitive verwendeten Participia wie *të ngrenë* "das Essen", *të vaiturë* "das Gehen" aufzufassen.

Die erste sowohl vom Standpunkt der historischen als auch der deskriptiven Albanologie wirklich korrekte, wenn auch naturgemäß nicht ganz vollständige Darstellung des alb. Neutrums hat dann Holger Pedersen

²⁰ Vgl. Fiedler (2007: 217). In meiner Arbeit **Die Pluralbildung im Albanischen** gehe ich auf den S. 213-230 auf die Heterogenie bei den Suffixen *-ë*, *-a* und *-e* ein; S. 257 ff. bei *-ra/-na*.

geliefert, der seinen Artikel "Das albanesische Neutrum" auf deutsch in der "Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiet des Deutschen, Griechischen und Lateinischen (KZ XXXIV, 1897, S. 283-291) veröffentlichte.

Das ist aber ein neues, ganz anderes Kapitel der Albanologie.

Matteo MANDALÀ, Universiteti i Palermos

ARBËRESHËT DHE ARBËRISHTJA NË VEPRËN E GUSTAV MEYER-IT (1850-1900)

“Kur udhëtova nga Foggia në Napoli në vjeshtën e vitit 1880, pata kënaqësinë ta shkoja kohën duke kuvenduar më një avokat të ri dhe elegant nga Bari. Gjatë bisedës ai u interesua për qëllimin e udhëtimit tim dhe i thashë se po shkoja në Sicili për të njohur arbëreshët që banonin atje. Ky njoftim e çuditi shumë bashkudhëtarin tim. Në fillim tha se nuk kishte pasur kurrë të bënte me banorët e Sicilisë, të cilët nuk flisnin italisht; pastaj u kujtua se edhe në vise të tjera të Jugut të Italisë, jo larg vendit ku banonte, kishte arbëreshë. Por, më pyeti, ç’interes mund të kisha për ta, që flisnin vetëm një greqishte të prishur. Për fatin tim, treni mbërriti në stacionin e Caserta-s, ku zoti Negri zbriti, duke më liruar nga barra t’i jepja një leksion të vogël hekurudhor mbi dallimin mes shqipes dhe greqishtes”¹.

Historia që na rrëfen Gustav Meyer në artikullin e tij të gjatë, të botuar në revistën prestigjioze “Nord und Süd” me titullin “Mbi gjuhën dhe letërsinë shqipe” i ofronte lexuesit të specializuar një panoramë të indiferencës dhe të injorancës së italianëve ndaj një realiteti historik, kulturor e gjuhësor që prej shekujsh gjallonte në Italinë e jugut. Një njeri i kulturuar, një intelektual, një avokat i Italisë së Bashkuar e gjente “të çuditshëm” faktin që dikush donte të vizitonte ngulimet arbëreshe, e për më tepër, nuk shihte asnjë interes për një gjuhë që sipas tij s’ ishte tjetër veçse “greqishte e prishur”. Me sa duket nuk e dinte se me kë po fliste, e megjithëse nuk e pati mundësinë të ndiqte “një leksion të vogël hekurudhor”, nuk mund të themi se asokohe (ndoshta dhe sot) zoti Negri ishte i vetmi italian i painformuar mbi arbëreshët.

Këtë e kuptoi vetë Gustav Meyer-i sapo zbarkoi në Sicili me traget

¹ Gustav Meyer, *Über Sprache und Literatur der Albanesen in Nord und Süd. Eine deutsche Monatsschrift*, Herausgegeben von Paul Lindau, Vierundzwanzigster Band, Verlag von S. Schottlaender, Breslau, 1883, f. 211.

nga Napoli. Në Palermo “do ta sillte shpesh ndërmend mangësinë e informacionit të avokatit”², sidomos kur librashitësit dhe antikuarët e kryeqendrës siciliane në vend që t’i jepnin libra të shtypur ose tekste në arbërisht, i ofronin libra në greqisht, të bindur se “arbërishtja” ishte sinonim i “greqishtes”. Fundja, s’ ishte për t’u habitur, përderisa fshati arbëresh më i madh i provincës quhej “Piana dei Greci” dhe banorët e Palermos i quanin arbëreshët “grekë”. Pra ishte më se e natyrshme për vendasit ta kuptonin etnonimin “arbëresh” si sinonim të atij “grek”. Efekti i këtyre dy episodeve, ai i avokatit Negri dhe tjetri i librashitësve palermitanë, ishte tronditës për Meyer-in: këto i sollën ndërmend faktin se edhe një diplomat gjerman gjatë punimeve të Kongresit të Berlinit pati deklaruar se mes “sllavëve” dhe “shqiptarëve” nuk kishte shumë dallime. Vetëm atëherë, kur kuptoi se problemi ishte më serioz sesa mund të dukej dhe se përhapja e informacioneve të pasakta në pjesën më të madhe të Europës në të vërtetë ishte “një fatkeqësi e rëndë, profesori i ri i Universitetit të Graz-it mori vendimin e guximshëm të botonte një sërë artikujsh në disa revista prestigjioze të Gjermanisë dhe të Italisë ku të ravijëzonte një kuadër sa më shterues e sidomos rigoroz mbi identitetin historik, gjuhësor dhe kulturor të arbëreshëve.

Incipit-i, përtej tipareve groteske dhe surreale që e karakterizojnë, përbënte fillin kryesor të studimit dhe paraqiste një përmbledhje të filozofisë që do të frymëzonte kërkimet e ardhme gjuhësore të Meyer-it. Në më se njëzet faqe shkrimi do të prekë disa bërthama tematike – gjuhësore, arkeologjike, kulturore, historike dhe folklorike – që studiuesi i ri shpërfaq në përpjekjen për t’i dhënë lexuesit gjerman, nga njëra anë, një imazh më të plotë të identitetit historiko-kulturor të shqiptarëve, qoftë të atyre që ishin vendosur në Jug të Italisë, qoftë më të shumtëve të përhapur anë e mbanë Ballkanit; nga ana tjetër, një panoramë të gjendjes së studimeve albanologjike, sidomos të atyre gjuhësore mbi shqipen. Meyer-i i vuri vetes edhe një objektiv të tretë në shkrim kur shpjegoi disa koncepte kyçe të qasjes së tij risore ndaj çështjes së vendit të gjuhës shqipe në gjirin e gjuhëve indoeuropiane, të tipareve të saj indoeuropiane dhe, natyrisht, të prejardhjes së saj, duke e vënë theksin veçanërisht në metodologjinë e rindërtimit krahasues e duke shprehur qysh gjatë kësaj faze fillestare të kërkimeve të tij disa bindje

² *Ibidem*.

të thella, mes të cilave bie në sy ajo mbi ndikimin e latinishtes në strukturën fonetike, gramatikore dhe leksikore të shqipes, që do të kushtëzojnë vizionin e tij mbi karakteristikat thelbësore të kësaj gjuhe ballkanike.

Meyer shfaqti interes për shqipen pasi mbërriti në vitin 1877 në Universitetin e Graz-it si profesor i gjuhësisë idoeuropiane, i greqishtes dhe i sanskritishtes. Aty u njoh me romanistin e madh Hugo Schuchardt (1842-1927), i cili prej një viti ishte profesor i filologjisë romane. Falë bashkëpunimit të frytshëm me këtë shkencëtar Meyer-i zuri të interesohej për albanistikën. Schuchardt i kishte kushtuar shqipes një recension të gjatë³ ku komentonte rezultatet e kërkimeve albanologjike të mikut Franz Miklošič (1813-1891) në tre vëllimet e *Albanesische Forschungen*⁴. Përpos lëvdatave për themeluesin e sllavistikës së krahasuar, Schuchardt, si njohës i problemeve të kontaktit gjuhësor⁵, vuri në pah shumë aspekte kyçe në marrëdhëniet mes latinishtes dhe gjuhëve ballkanike, sidomos mes latinishtes dhe shqipes. Në atë recension romanisti i Graz-it nuk la pa përmendur Dhimitër Kamardën (1821-1882) dhe veprën e tij *Saggio di grammatolo-*

³ Hugo Schuchardt, "Albanisches und romanisches. Zu Miklosich's albanischen Forschungen" in *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschungen auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen* herausgegeben von Dr. Adalbert Kuhn, Bd. XX, Berlin, Ferd. Dümmlers Verlagsbuchhandlung, 1872, f. 241-302.

⁴ Franc Miklošič, *Albanische Forschungen*, 3 Bände [1. *Die slavischen Elemente im Albanischen*, 1870; 2. *Die romanischen Elemente im Albanischen*, 1871; 3. *Die Form entlehnter Verba im Albanischen*, 1871], mit einer Einleitung, welche die Ausbreitung des albanischen Volksstammes, die quellen unserer Kenntniss der albanischen Sprache, die laute derselben und die versuche, diese laute darzustellen, zum Fiegenstande hat, Aus Der Kaiserlich-Königlichen Hof- und Staatsdruckerei, Wien 1870-1871. Miklošič pubblicò un altro breve scritto sull'albanese: *Le préfixe roman dis en albanais* in *Revue de Linguistique et de Philologie comparée. Recueil trimestriel de documents pour servir à la Science Positive des Langues, à l'Épigraphie, à l'Ethnologie, à la Mythologie et à l'Histoire*, Tome Quatrième 1^{er} Fascicule - Juillet Maisonneuve Libraires - Éditeurs, Paris, 1870, f. 97-101. Rimarrë te Franc Miklošič: **Gjurmime shqiptare/ Albanische Forschungen**, ASHAK/SAZU, Prishtinë/jubljana, 2007, shqip e gjermanisht, ff. 504.

⁵ Federica Venier, *Dissimetrie schuchardiane: contatto e parentela linguistica fra le lingue. Trattatello in laude di Schuchardt* in Carlo Consani (a cura di), *Contatto interlinguistico fra presente e passato*, Il Segno e le lettere. Collana del Dipartimento di Lingue, Letterature e Culture moderne dell'Università degli Studi "G. D'Annunzio", Edizioni Universitarie di Lettere Economia Diritto, Milano, 2015, f. 101-129.

gia comparata⁶, duke theksuar vijimësinë që gjuhëtari arbëresh i siguroi veprës së vet me përshtatjen e një sistemi shkrimi të ngjashëm me atë kish-te përdorur disa dekada më parë Johann Georg von Hahn-i (1811-1869). Si për të konfirmuar interesin për shqipen dhe kontaktet e saj me gjuhët romane, një vit më vonë, në 1872, Schuchardt shkroi një tjetër recension të gjatë që u botua pas dy vjetësh⁷, mbi dy vepra gjuhësore arbëreshë: mbi veprën e Kamardës, i cili ndërkohë kishte botuar vëllimin e dytë *Appendice*⁸ dhe *Gramatikën e gjuhës shqipe* të Jeronim De Radës (1814-1903) të cilën Poeti i Maqit botoi me emrin e djalit të tij, Giuseppe, për ta nderuar⁹. Duke ballafaquar qëndrimet e dy studiuesve arbëreshë Schuchardt vuri në dukje dallimet mes dy vizioneve të ndryshme politiko-ideologjike të Kamardës dhe De Radës: i pari, i ndikuar nga *Stambaumtheorie* e Schleher-it, e konsideronte shqipen si një degë të greqishtes prandaj u përpoq të vërtetonte afrinë mes këtyre dy gjuhëve indoeuropiane. Si rrjedhim konfigurohej një qëndrim filohelenik edhe në politikë i Kamardës, me të cilin De Rada, sikurse Meyer-i, nuk pajtohej. Për poetin tonë shqipja vërtet ruante një numër fjalësh të huazuara nga greqishtja, por ky fakt nuk mjaftonte për ta lidhur prejardhjen e saj me greqishten, sikurse bënte Kamarda. Për më tepër De Rada, pikërisht duke cituar veprën e Kamardës, vuri në pah se ky i fundit e kishte vënë re në të folmen e Shkodrës peshën e elementit latin në gjuhën shqipe. Schuchardt, si studiues i mprehtë që ishte, duke nënvizuar këtë divergjencë, nuk la pa ironizuar qëndrimin kritik të De Radës mbi “rrugën shkodrane që shpinte në Parajsë”¹⁰ dhe konstatoi se nga njëra

⁶ Demetrio Camarda, **Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese**, Successore di Egisto Vignozzi, Livorno, 1864.

⁷ Shih Hugo Schuchardt, [Rez. von:], *Grammatica della lingua Albanese di Giuseppe de Rada. Prima parte* në **Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen Zeitschrift für vergleichende Sprachforschungen auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen** herausgegeben von Dr. Adalbert Kuhn, Bd. XXII, Berlin, Ferd. Dümmlers Verlagsbuchhandlung, 1874, f. 69-88.

⁸ Demetrio Camarda, **Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese**, Tip. F. Alberghetti, Prato, 1866.

⁹ Giuseppe De Rada, **Grammatica della lingua albanese**, Tipografia dell'Associazione, Firenze, 1870. Sikurse dihet, *Gramatika* u shkrua nga Jeronim De Rada, i cili në shenjë nderimi ia atribuoi të birit të vdekur.

¹⁰ “Meint daher de Rada, daß Camarda vielleicht eine gleich große Anzahl lateinischer

anë Kamarda e kishte mbivlerësuar rëndësinë e elementit grek, nga ana tjetër elementi latin në shqipe nuk mund të lihej në heshtje nën ndikimin përkatësisë fetare e të aksiomave teorike që duheshin vërtetuar me fakte gjuhësore të sigurta. Këtu e sheh Meyer-i vlerën e tri vëllimeve të Miklošič-it që e shihnin shqipen në dritën e kontakteve gjuhësore më shumë se nga pikëpamja e afrive gjenetike, të cilat qoftë te Kamarda, qoftë te De Rada, bashkoheshin në evidentimin e një prejardhjeje të përbashkët pellazge, që më vonë Mayer-i do ta kritikojë si mbeturinë të “etnografisë së vjetër”¹¹.

Në këtë kontekst hyn Meyer-i, që me gjasa ia detyron pikërisht Schuchardt-it interesin për shqipen dhe ndoshta edhe paragjykimin shkencor që do të karakterizojë studimet e tij mbi këtë gjuhë. Ajo çka na intereson këtu është qëndrimi i Meyer-it ndaj arbëreshëve, kontributit të tyre në studimet shqiptare dhe letërsisë së tyre e mbi të gjitha, të kuptojmë arsyet e interesit që ai shfaqti në të gjitha punimet e tij, përfshirë dokumentet private – si p.sh. letërkëmbimi – që na zbulojnë aspekte të rëndësishme të marrëdhënieve që ai mbajti për një kohë të gjatë me figurat më të shquara të Rilindjes arbëreshe si me dy vëllezërit Kamarda, Dhimitrin dhe Nikollën (1807-1884), me De Radën, Zef Nocitin (1832-1892), Zef Skiroin (1865-1927) dhe shumë të tjerë. Meyer-i e njihte mjaft mirë prodhimin letrar të arbëreshëve, falë edhe vëmendjes që i kushtonin asaj qarqet kulturore gjermanishtfolëse. Mirëpo për kërkimet e tij shkencore ai nuk i zinte fort besë burimeve të tërthorta dhe privilegjonte sidomos të dhënat e drejtpërdrejta. Për këtë arsye i konsideronte më të besueshme tekstet e von Hahn-it ose ato të Kristoforidhit, sesa për shembull të dhënat e De Radës ose të Kamardës. Për të njëjtën arsye vendosi të vizitonte arbëreshët në viset ku jetonin, në Greqi, në Turqi dhe natyrisht në Italinë jugore.

Ai ndërmoi shumë udhëtime në Itali nga viti 1880 derisa vdiq, qoftë

Wörter in der Skodrianischen probe aus dem “Wege des Paradieses” hatte entdecken können, so entgeht ihm vor allem, dass die Identität eines albanischem Wortes mit einem griechischen worte die mit einem lateinischen nicht ausschließt; jedenfalls aber macht er sich einer starken Übertreibung schuldig”: Hugo Schuchardt, [Rez. von:], *Grammatica della lingua Albanese di Giuseppe de Rada*, cit., f. 71.

¹¹ Shih Gustav Meyer, *Della lingua e della letteratura degli albanesi* në **La Nuova Antologia di scienze, lettere ed arti anno xx seconda serie** - volume cinquantesimo della raccolta, Volume LXXX 1885, Direzione della Nuova Antologia, Roma, 1885, f. 589.

për të marrë pjesë në kongrese shkencore ku e ftonin shpesh, qoftë për qëllime studimi, meqenëse interesohej veçanërisht për dialektet e italishtes. Veç të tjerash ndërmoi edhe dy udhëtime në ngulimet arbëreshe: në vitin 1880 vizitoi arbëreshët e Apulisë dhe të Sicilisë ndërsa gjatë pashkëve të vitit 1890 vizitoi arbëreshët e San Marzano-s¹², shqipja e të cilëve më parë ishte bërë objekt studimi nga princi Luigi Luciano Bonaparte (1813-1891)¹³ dhe nga studiuesi i pafat Johann (Jan) **Hanusz** (1858-1887)¹⁴. Ky aspekt i metodës së Meyer-it meriton të nënvizohet, sepse hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave gjuhësore drejtpërdrejt nga goja e folësve, sidomos kur këta janë në kushte diglosie, kërkonte rigorozitet dhe kujdes të veçantë metodologjik në vlerësimin e dukurive. Këtu e ka burimin vlerësimi kritik i kontributit të arbëreshëve nga ana e Meyer-it, paçka se gjatë fazës së parë të kërkimeve të tij vihet re njëfarë “mendjemadhësie” shkencore që e shtyu të nënvlerësonte a të shprehte gjykime të ashpra ndaj veprës së Kamardës dhe asaj të De Radës.

Duke shqyrtuar artikujt e botuar në shtypin periodik, mund të nxjerrim të dhëna të vlefshme që na lejojnë të rindërtojmë nivelin e njohjes që pati Meyer-i për arbëreshët e Italisë si edhe për të matur dallimet thelbësore që karakterizuan marrëdhëniet e tij me intelektualët arbëreshë. Në një artikull të botuar në vitin 1881 në suplementin e së dielës të *Allgemeine Zeitung*¹⁵, profesori i Graz-it shfaq për të parën herë publikisht interes për studimin e shqipes dhe, paçka se nuk bën fjalë për udhëtimin e parë në Apuli dhe në Sicili, kritikon ashpër studimet etimologjike të Kamardës me

¹² Shih Gustav Meyer, “Bei den Albanensen Italiens” në **Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde**, Zweiter Band, Verlag von Karl J. Trübner, Strassburg, 1893, f. 345-354.

¹³ Luigi Luciano Bonaparte, *Albanian in Terra d’Otranto*, në **Transactions of the Philological Society of London**, 1884, f. 492-501. Më vonë Bonaparte do t’i kthehej dialektit të San Marzano-s në *Albanian, Modern Greek, Gallo-Italic, Provençal and Illyrian still in use (1889) as linguistic islands in the Neapolitan and Sicilian Provinces of Italy*, në **Transactions of the Philological Society of London**, 1891, f. 335-364.

¹⁴ Johann (Jan) Hanusz, *L’albanais en Apulie*, në **Mémoires de la Société de Linguistique de Paris**, Tome Sixième, II Fascicule, F.Vieweg, Libraire-Éditeur, Paris, 1888, f.263-67.

¹⁵ Shih Gustav Meyer, *Albanesisches* në **Beilage zur Allgemeinen Zeitung**, n. 142, 22 Mai 1881, f. 2081-2082.

argumentin se ky bazohej vetëm në të folmen e fshatit të tij të lindjes, Horës së Arbëreshëve dhe se nuk njihete as gjuhët e tjera indoeuropiane e as gjuhët klasike, latinishten dhe greqishten. Nuk më bie mua barra të mbroj gjuhëtarin arbëresh, edhe sepse vetë Meyer-i e mbrojti atë një vit më vonë në 1882. Pasi mori vesh nga i vëllai i Kamardës, Nikolla, profesor i letërsisë greke në universitetin e Palermos, se Dhimitri kishte vdekur, Meyer-i nxitoi të shkruante një nekrologji që u botua në suplementin e *Allgemeine Zeitung* në vitin 1882¹⁶, ku rishikonte disa nga gjykimet e tij negative mbi gjuhëtarin arbëresh. Këtë e bëri jo vetëm për të nderuar të vdekurin, por sepse ndërkohë të dy studiuesit kishte pasur një letërkëmbim të frytshëm dhe e kishin njohur më mirë njëri-tjetrin. Në fakt, pas letrës së parë që Dhimitri i dërgoi nga Livorno në vitin 1881¹⁷, Meyer-i mori prej tij shumë tekste në arbërisht dhe mundi të vihej në kontakt të drejtpërdrejtë me pjesën më aktive të intelektualëve arbëreshë, nga të cilët mësoi shumë mbi botën dhe kulturën arbëreshe. Në fakt, kur do të botojë në vitin 1883 studimin e lartpërmendur [*Über Sprache und Literatur der Albanesen*], bibliografia që e shoqëron atë do të jetë shumë më e pasur sesa ajo e artikullit të botuar dy vjet më parë në 1881. E njëjta bibliografi do të përdoret nga studiuesi pas disa muajsh në punimin e parë sistematik kushtuar shqipës: studimi mbi formimin e shumësit në gjuhën shqipe¹⁸, që do të hapë serinë e gjashtë monografive që do të botohen nën titullin e përbashkët të gjerdanit *Albanesische Studien*. Mes 110 titujve që përbëjnë burimet bibliografike të përdorura nga autori, figurojnë librat e De Radës (*Milosao* 1847; *Serafina*

¹⁶ Shih Gustav Meyer, *Demetrio Camarda* në **Beilage zur Allgemeinen Zeitung**, n. 239, 2 August 1882, f. 3516.

¹⁷ Martin Camaj, *Drei Briefe von Demetrio Camarda an Gustav Meyer: Ein Beitrag zur Geschichte der Albanologie*, **Beiträge zur Südosteuropa-Forschung. Anlässlich des 1. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII - 1. DC. 1966**, herausgegeben vom Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der deutschen Forschungsgemeinschaft, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München, 1966, f. 465-471.

¹⁸ Shih Gustav Meyer, **Albanesische Studien I: Die pluralbildungen der Albanesischen nomina**, Sitzungsberichte der Philosophisch-historischen Klasse der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, 1, 1883 Bd. 104, f. 257-362. Shih recensionin e Hugo Schuchardt, *Albanesische Studien von Gustav Meyer, die Pluralbildungen der albanischen Nomina*, 1883 në **Literaturblatt für germanische und romanische Philologie**, Wien 1883-1884 [*Prispevky ku poznani nareci albaniskych, uverejnuje Jan Urban Jarnik*], v Praze 1883.

Thopia 1843; *Rapsodie* 1866; *Grammatica* 1870; *Poesie* voll. I-IV 1873-1887), të Dorsës (*Ricerche* 1848; *Studi Etimologici* 1862; *Vangelo* 1869), të Kamardës *Saggio*, *Appendice*; *Scrittori* 1867; *Fyleta* 1867; *Vangelo* 1868; *A Dora D'Istria* 1870), të Pietro Chiara-s (*Epiro* 1880), pa lënë mënjane punimet e autorëve të huaj si Stier, Biondelli, Vigo, Ascoli, Comparetti, Papanti, Pitrè, Parisi, Moratti me lëndë gjuhësore dhe etnografike tejet të frytshme për Mayer-in dhe propozimin e tij për klasifikimin e emrave, pasi të hiqeshin veç huazimet (latino-romane, greke, sllave, turke).

Efektet pozitive të bashkëpunimit me arbëreshët hasen në studimin e cituar të ribotuar me të njëjtin titull në vitin 1885 në italisht në revistën e famshme *La Nuova Antologia* themeluar nga Francesco Protonotari (1836-1888) dhe në gjermanisht me shtesa dhe ndryshime në vëllimin ku Meyer-i përfshiu disa shkrime që dokumentojnë plotësisht larminë e interesave të tij shkencorë dhe një metodologji risore që ndërthurte të dhënat gjuhësore me ato etnologjike¹⁹. Megjithëse titulli është i njëjtë me atë të artikullit të vitit 1883, versioni i ri i tekstit jo vetëm që del më i plotë dhe më i pasur në burime bibliografike, por i paraprin disa paradigmeve gjuhësore dhe ideologjike që do të karakterizojnë punimet e ardhme të Meyer-it. Këtu, p.sh., për herë të parë autori parashtron një analizë të etnonimeve shqiptare dhe propozon shpjegimin etimologjik të etnonimit “shqiptar”, nga një rrënjë ndajfoljore *shqip* që Meyer-i, sikurse dihet, e sjell nga latinishtja *excipere*²⁰. Këtu autori kritikon vizionin “panhelenik” dhe hamendëson një prejardhje prej substratit preindoeuropian për “një sasi fjalësh” jo indoeuropiane të shqipes, duke nxjerrë në pah një përkim me rumanishten “që na bën të besojmë se fazat më të lashta të këtyre dy gjuhëve kanë qenë nën ndikimin

¹⁹ Gustav Meyer, *Über Sprache und Literatur der Albanesen* në **Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde**, Verlag von Robert Oppenheim, Berlin, 1885, f.49-90.

²⁰ “Nella bocca degli Albanesi valgono come più giuste denominazioni della loro nazionalità il nome Skjipetar, che significa ‘Albanese’ e quello di Skjip che significa ‘lingua albanese’. Si tentarono spiegazioni di questa parola, facendola derivare da nomi, che significano ‘aquila’ o da ‘rupe’; ma la sola derivazione possibile è quella dal verbo skjiponi ‘comprendo’. Skjipetar adunque non significa altro, se non ‘colui che comprende’; e così appunto l’Albanese chiama colui che comprende la sua lingua. La denominazione è relativamente recente, perché il verbo è preso dal latino *excipere*, ‘comprendere’”: Shih Gustav Meyer, *Della lingua e della letteratura degli albanesi*, cit., f. 587.

e një gjuhe të huaj prehistorike”²¹. Nuk mungojnë në këtë studim vlerësimet për arbëreshët, sidomos për De Radën, figura dhe vepra e të cilit rivlerësohen²², paçka se më pas, në letrën që i dërgoi aty nga fundi i vitit 1887, poeti plak do t’i shprehë mikut të tij “të shquar e të respektuar” habinë dhe mospajtimin për kritikant që ky i kishte rezervuar veprës së tij poetike dhe punimeve gjuhësore²³.

Meyer do ta thellojë gjithnjë e më shumë njohjen e botës arbëreshe: kështu do të njohë më pas edhe veprën e Jul Varibobës (1725-1788), që De Rada vendosi ta botojë pjesërisht te *Fiamuri Arbrit* pikërisht për t’iu përgjigjur bashkëbiseduesit të tij të shquar që e kishte gjykuar “estetikisht” më të dobët se autori i poemës *Gjella e Shën Mërisë Virgjër*. Po ashtu, falë interesimit të Nocitit, arriti të merrte disa vepra të Francesco Santorit (1819-1894), për të cilin ankohej se njëhte vetëm titujt por jo tekstet e veprave. Së fundi, duke nisur nga viti 1887 dhe para botimit të *Rapsodive*, Meyer rivendosi kontaktet me arbëreshët e Sicilisë dhe veçanërisht lidhi marrëdhënie të ngushta epistolare me Zef Skiroin²⁴. Poetit të ri Meyer do t’i kushtojë pjesën më të madhe të një artikulli të botuar më 20 nëntor të vitit 1888 në *Allgemeine Zeitung*²⁵, ku do të nënvizojë energjinë e madhe që ky “jugendlicher Sicilianer” i kushtonte çështjes shqiptare duke botuar revistën *Arbri i rii* që lindi në hullinë e modelit të *Fjamurit të Arbrit* të De Radës dhe të *Rapsodive shqiptare*, vepër që Skiroi fillimisht e paraqiti si “anonime dhe popullore” e më pas, në vitin 1923 do të deklarojë se ishte krijim i tij²⁶. Ky truk nuk i shpëtoi syrit të vëmendshëm të profesorit të

²¹ *Po aty*, f. 591.

²² “La figura del Rada ha qualche cosa di commovente; quel vecchio, colpito ultimamente dalla morte di tutti i suoi discendenti diretti e laterali, non si stanca di combattere con la parola e con la penna per la sua nazionalità, ch’egli ama sopra ogni cosa, e per la quale ha anzi da qualche tempo fondato perfino un giornale albanese”: *po aty*, f. 600.

²³ Shih Bruno Mazzoni, *Corrispondenza G. De Rada - G. Meyer në Zjarri: rivista mensile di cultura albanese*, - A. 1, n. Roma-San Demetrio Corone, 1970, f. 40-42.

²⁴ Letra e parë e Skiroit drejtuar Meyer-it është e datës 29 janar 1887: Ardian Klosi, *Gjash-të letra të pabonuara*. (Dosje të arkivit), në *Drita*, 27 maj 1990, Tiranë, 1990, f. 12.

²⁵ Shih Gustav Meyer, *Zur Kenntniss des geistigen Lebens in Unteritalien und Sicilien* në *Beilage zur Allgemeinen Zeitung*, n. 323, 20 Mai 1881, f. 2081-2082.

²⁶ “Per impedire che qualcuno si prenda il fastidio di lambiccarsi il cervello nella ricerca della paternità delle *Rapsodie*, una volta per sempre, che coll’autore di esse io vivo in rapporti così intimi, da poter affermare che egli non è affatto diverso da me stesso”:

Graz-it, që, ndryshe nga miku Giuseppe Pitre (1841-1916), e kuptoi se Skiroi synonte të imitonte Macpherson-in dhe të fshihte autorësinë e veprës. Jo rastësisht Meyer rroku në vëllimin e *Rapsodive* të njëjtën frymë që kish-te karakterizuar të ashtuquajturin “Königinhofer Handschrift” si dokument mesjetar fals, duke u ankuar për faktin se Skiroi nuk kishte thënë “diçka më të saktë mbi këtë dorëshkrim, prej të cilit u morën *Rapsoditë*”²⁷. Gjithsesi Meyer-i përfitoi nga rasti për të shqyrtuar, përmes një analize tekstore të imtë, modelet kulturore mbi të cilat ishte mbështetur poeti i ri për të stisur trukun e vet “osianik”.

Miqësia më Skiroin do të rezultojë e frytshme, qoftë sepse prej tij Meyer-i do të marrë të gjitha botimet arbëreshe që do të shtypen në Sicili, qoftë sepse do t’i krijohet mundësia e bashkëpunimit me revistën *Arbri i rii*, ku gjuhëtari i madh do të botojë në dy numra radhazi një studim me titullin “Shqiptarët”²⁸, ku do të theksojë përkatësinë e shqipes në familjen gjuhësore indoeuropiane dhe do t’i caktojë asaj një vend të posaçëm si vijuese e ilirishtes së vjetër. Falë ndërmjetësisë së Skiroit, në vitin 1888 Meyer-i do të botojë një artikull në një revistë tjetër të njohur siciliane, *La Sicilia letteraria*, artikull i cili qysh në titull – *Gli albanesi nella storia e nella letteratura* – përmblihte çështjet që trajtonte, duke i dhënë një vend të rëndësishëm kontributit të arbëreshëve²⁹.

Një dhjetëvjeçar më pas, kur do të botohen punimet shkencore që do t’u japin përgjigje çështjeve komplekse mbi historinë e gjuhës shqipe, fonetikën, gramatikën, leksikun, Meyer-i do të vlerësojë peshën e të folme-

Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Stab. tip. L. Pierro, Napoli, 1923, cit., ristampa anastatica, Tipografia Renna, Palermo, 1986, f. CXXVI.

²⁷ “Es ist schade, das Herr Schirò über die alte Handschrift, der er die Gedichte entnommen hat, nicht etwas näheres mitgeteilt hat; so wird man den Berdacht nicht loss, dass es sich hier wesentlich um eine königinhofer Handschrift handelt. So komt gleich in dem ersten Liede eine Stelle vor, welche bewusste Nachymung eines literarischen Vorbildes”

²⁸ Shih Gustav Meyer, *Gli Albanesi* në *Arbri i rii* (‘La giovane Albania’) pubblicazione mensile diretta da Francesco Stassi-Petta e Giuseppe Schirò, anno I, n. I, 1 marzo 1887, Palermo, 1887, f. 5-9; anno I, n. II, 1 maggio 1887, f. 3-10.

²⁹ Gustav Meyer, *Gli albanesi nella storia e nella letteratura* në *La Sicilia letteraria*, 20 maggio 1888, Tip. G. Spinnato, Palermo, 1888.

ve arbëreshe e njëherazi nuk do të lërë pa vënë në dukje të metat e të dhënavave gjuhësore që përmbanin tekstet e botuara. Do thënë gjithsesi se ky interes i gjuhëtarit të Graz-it nuk varej vetëm nga nderimi për arbëreshët të cilët në kushte të vështira ia kishin dalë të ruanin gjuhën dhe zakonet e të parëve. Kishte edhe një arsye tjetër. Meyer-i ishte i bindur se shqipja, ndryshe nga gjuhë të tjera të lashta të Ballkanit, kishte ditur t'i bënte qëndresë procesit të latinizimit. Pikërisht kërkimi i ndikimit të latinishtes mbi shqipen, që me gjasa iu sugjerua nga Hugo Schuchardt në fillimet e karrierës së tij si studiues, i kushtoi shumë punë dhe energji Meyer-it siç dëshmojnë disa nga studimet e tij³⁰ dhe veçanërisht fjalori etimologjik që u botua në vitin 1891³¹, vepër që më shumë se të gjitha të tjerat, shpreh më së miri parimet, metodën dhe synimet e punës së autorit përgjatë njëzet vjetëve. Sikurse e ka vënë në dukje prof. Seit Mansaku në parathënien e botimit shqip, të përgatitur nga Anila Omari, Meyer ofroi edhe disa të dhëna statistikore mbi leksikon e përfshirë në fjalor, mbi bazë të të cilave ai e përcaktoi natyrën e shqipes si një *mischsprache*, duke theksuar kështu peshën e madhe të huazimeve nga gjuhë të tjera. Thotë Meyer:

“Lënda e mbledhur këtu nga Shqipëria turke e nga ngulimet në Greqi e Itali paraqitet tejet e larmishme nga prejardhja. Nga rreth 5140 fjalë lema që përmban libri im, 1420 më kanë rezultuar me prejardhje romane (kundrejt 930 te Miklosischi), 540 sllave (te Miklosischi 319), 1180 turke, 840 greke; vetëm 400 kam mundur t'i vërtetoj pak a shumë me siguri si trashëgimi e lashtë indoevropiane, rreth 730

³⁰ Shih Gustav Meyer, *Der Einfluß des Lateinischen auf die albanesische Formenlehre*, In **Memoria di Napoleone Caix e Ugo Angelo Canello Miscellanea di Filologia e Linguistica** per G. I. Ascoli, C. Avolio, L. Biadene, J. Cornu, V. Crescini, A. d'Ancona, F. d'Ovidio, G. Flechia, G. Fumi, B. Gandino, A. Gaspari, M. Gaster, G. Gröber, J. Leite de Vasconcellos, P. Merlo, G. Meyer, P. Meyer, C. Michaelis de Vasconcellos, F. Miklosich, M. Milà, E. Monaci, G. Morosi, A. Mussafia, F. Neumann, F. Novati, M. Obédénare, C. Paoli, G. Paris, S. Pieri, P. Rajna, R. Renier, C. Salvioni, E. Stengel, H. Suchier, A. Tobler, P. Villari, B. Wiese, N. Zingarelli, Successori Le Monnier, Firenze, 1886, f 103-111. Vëllimi u shtyp në vitin 1886, por kontributet ishin gati për botim qysh më 1883.

³¹ Shih Gustav Meyer, **Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache**, Strassburg, Verlag von Karl J. Trübner, 1891.

dolën të padepërtueshme ndaj përpjekjeve të mia interpretuese”³².

Ndër 1420 fjalët me prejardhje romane Meyer kishte përfshirë edhe ato që kishte marrë nga të folmet arbëreshe. Për të caktuar numrin e tyre duhen veçuar fjalët e parme nga ato të prejardhura. Rezultatet e kësaj ndarjeje përmbliidhen në tabelën e mëposhtme:

	<i>Fjalë arbëreshe</i>			<i>Meyer</i>	<i>Dif.</i>	<i>Miklošič</i>
	<i>të parme</i>	<i>të prejardhura</i>	Tot.			
Romane	250	80	330	1420	1000	930
Greke	94	44	138	840	702	
Turke	5	8	13	1180	1167	
Sllave	9	14	23	540	517	319
E pasigurt	62	69	131	400+730	999	
Gjithsej	420	215	635			

Nga këto të dhëna mund të nxjerrim disa përfundime:

- 1) duke hequr fjalët arbëreshe me prejardhje romane nga 1420 latinizmat që nxjerr Meyer, na del një shifër që pak a shumë përkon me totalin që na jep Miklosich;
- 2) fjalët arbëreshe me prejardhje sllave dhe turke që dokumenton Meyer-i janë më të pakta sesa ato që përmbajnë vërtet të folmet arbëreshe të Italisë;
- 3) e njëjta gjë vlen edhe për elementin grek, që Meyer-i e redukon në pak më shumë se njëqind fjalë, gjysma e të cilave të parme e pjesa tjetër të prejardhura.

Këto vlerësime konfirmojnë paragjykimin e Mayer-it i cili për të mbështetur kritikën që i bëri Kamardës për peshën e tepërt që ky i njohu elementit grek në shqipe, bërë të njëjtin gabim duke i dhënë elementit latin një peshë që realisht nuk e ka pasur. Përdorimi që i bëri ai fondit “roman” të të folmeve arbëreshe që mbijetonin në kushte diglosie – me arbërishten si gjuhë dominuese në sferën private, të komprometuar rëndë nga italishtja e përdorur në sferën publike – ishte krejt tendencioz, sepse tjetërsonte ekui-librin statistikor të fjalorit etimologjik prej nga edhe burojnë përfundimet e

³² Gustav Meyer, **Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe**, përktheu Anila Omari, Parathënie e Seit Mansakut, Excipere 4, Shtëpia botuese Çabej, Tiranë, 2007, f. 31.

tij. Qysh në atë kohë arbërishtja nuk pasqyronte më gjendjen e shqipes së përgjithshme, as të asaj ballkanike: këtë e dëshmon raporti i përmbytur i të dhënave leksikore mbi huazimet turke në shqipen ballkanike dhe mbi huazimet romane në arbërishte. Meyer nuk mund të mos ishte i vetëdijshëm për këtë fakt, që ai me gjasa e injoroi sepse synonte të vërtetonte medoemos një përfundimin të paracaktuar. Këtë e dëshmon ai vetë kur komenton të dhënat statistikore:

“Ky numër i fundit po të marrim parasysh se sa shumë material gjuhësor pret ende shpjegimin etimologjik në gjuhë të tjera të hulumtuara më gjatë e më mirë, nuk mund të quhet aspak shumë i madh; megjithatë unë shpresoj dhe dëshiroj që pasardhës më të mprehtë e të përgatitur më mirë ta zvogëlojnë sa më shumë së shpejti”³³.

Brezat e gjuhëtarëve që ndoqën gjurmët e tij e kanë kritikuar vizionin e gabuar që Meyer-i kishte për shqipen por njëherazi i njohën meritën se falë edhe veprës së tij albanologjia hyri në një hulli shkencore. Këtë meritë ia ka njohur pa rezerva një nga dishepujt e tij më të denjë, Eqrem Çabej (1908-1980), kur në leksionet e famshme të indoeuropianistikës që mbajti pikërisht këtu, në Prishtinë, e quajti “themeluesi i albanistikës”³⁴. Ky kolos i studimeve albanologjike ishte ndër të parët që vlerësoi lart kontributin e arbëreshëve, të folmet, kulturën, folklorin dhe letërsinë e tyre e për këtë arsye ne do t’i jemi gjithmonë mirënjohës.

³³ *Po aty*, f. 31.

³⁴ Eqrem Çabej, *Hyrje në Indoeuropianistikë. Leksionet e Prishtinës*, Excipere 10, Shtëpia botuese Çabej, Tiranë, 2008, f. 50.

BIBLIOGRAFI

- Bonaparte Luigi Luciano, *Albanian in Terra d'Otranto*, në **Transactions of the Philological Society of London**, 1884.
- Bonaparte Luigi Luciano, *Albanian, Modern Greek, Gallo-Italic, Provençal and Illyrian still in use (1889) as linguistic islands in the Neapolitan and Sicilian Provinces of Italy*, në **Transactions of the Philological Society of London**, 1891.
- Çabej Eqrem, **Hyrje në Indoeuropianistikë. Leksionet e Prishtinës**, Excipere 10, Shtëpia botuese Çabej, Tiranë, 2008.
- Camaj Martin, *Drei Briefe von Demetrio Camarda an Gustav Meyer: Ein Beitrag zur Geschichte der Albanologie*, **Beiträge zur Südosteuropa-Forschung. Anlässlich des 1. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII - 1. DC. 1966**, herausgegeben vom Arbeitskreis Südosteuropa-forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft, Dr. Dr. Rudolf Trofenik, München, 1966.
- Camarda Demetrio, **Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese**, Successore di Egisto Vignozzi, Livorno, 1864.
- Camarda Demetrio, **Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese**, Tip. F. Alberghetti, Prato, 1866.
- De Rada Giuseppe, **Grammatica della lingua albanese**, Tipografia dell'Associazione, Firenze, 1870.
- Hanusz Johann (Jan), *L'albanais en Apulie*, në **Mémoires de la Société de Linguistique de Paris**, Tome Sixième, II Fascicule, F. Vieweg, Libraire – Editeur, Paris, 1888.
- Klosi Ardian, *Gjasthtë letra të pabotuara*. (Dosje të arkivit), në **Drita**, 27 maj 1990, Tiranë, 1990.
- Mazzoni Bruno, *Corrispondenza G. De Rada - G. Meyer në Zjarri: rivista mensile di cultura albanese*, - A. 1, n. Roma-San Demetrio Corone, 1970.
- Meyer Gustav, *Zur Kenntniss des geistigen Lebens in Unteritalien und Sicilien* në **Beilage zur Allgemeinen Zeitung**, n. 323, 20 Mai 1881.
- Meyer Gustav, *Albanesisches* në **Beilage zur Allgemeinen Zeitung**, n. 142, 22 Mai 1881.
- Meyer Gustav, *Demetrio Camarda* në **Beilage zur Allgemeinen Zeitung**, n. 239, 2 August 1882.
- Meyer Gustav, **Albanesische Studien I: Die pluralbildungen der Albanesischen nomina**, Sitzungsberichte der Philosophisch-historischen Klasse der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, 1, Bd. 104, 1883.
- Meyer Gustav, *Über Sprache und Literatur der Albanesen in Nord und Süd. Eine deutsche Monatsschrift*, Herausgegeben von Paul Lindau, Vierundzwanzigster Band, Verlag von S. Schottlaender, Breslau, 1883.
- Meyer Gustav, *Della lingua e della letteratura degli albanesi* në **La Nuova Antologia** di scienze, lettere ed arti anno xx seconda serie - volume cinquantesimo della raccolta, Volume LXXX 1885, Direzione della Nuova Antologia, Roma, 1885.
- Meyer Gustav, *Über Sprache und Literatur der Albanesen* në **Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde**, Verlag von Robert Oppenheim, Berlin, 1885.
- Meyer Gustav, *Der Einfluß des Lateinischen auf die albanesische Formenlehre*, In **Memo-ria di Napoleone Caix e Ugo Angelo Canello** Miscellanea di Filologia e Linguistica per G. I. Ascoli, C. Avolio, L. Biadene, J. Cornu, V. Crescini, A. d'Ancona, F. d'Ovidio, G. Flechia, G. Fumi, B. Gandino, A. Gaspary, M. Gaster, G. Gröber, J. Leite de Vasconcellos, P. Merlo, G. Meyer, P. Meyer, C. Michaelis de Vasconcellos, F. Miklosich, M. Milà, E. Monaci, G. Morosi, A. Mussafia, F. Neumann, F. Novati, M. Obédénare, C. Paoli, G. Paris, S. Pieri, P. Rajna, R. Renier, C. Salvioni, E. Stengel, H.

- Suchier, A: Tobler, P. Villari, B. Wiese, N. Zingarelli, Successori Le Monnier, Firenze, 1886.
- Meyer Gustav, “*Gli Albanesi*” në **Arbri i rii** (‘La giovane Albania’) pubblicazione mensile diretta da Francesco Stassi-Petta e Giuseppe Schirò, anno I, n. I, 1 marzo 1887, Palermo, 1887, f. 5-9; anno I, n. II, 1 maggio 1887, f. 3-10.
- Meyer Gustav, “*Gli albanesi nella storia e nella letteratura*” në **La Sicilia letteraria**, 20 maggio 1888, Tip. G. Spinnato, Palermo, 1888.
- Meyer Gustav, **Etmologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache**, Strassburg, Verlag von Karl J. Trübner, 1891.
- Meyer Gustav, “*Bei den Albanensien Italiens*” në *Essays und Studien zur Sprachgeschichte und Volkskunde*, Zweiter Band, Verlag von Karl J. Trübner, Strassburg, 1893.
- Meyer Gustav, **Fjalor etnologjik i gjuhës shqipe**, përkthet Anila Omari, Parathënie e Seit Mansakut, Excipere 4, Shtëpia botuese Çabej, Tiranë, 2007.
- Miklošič Franc, “*Le préfixe roman dis en albanais*” in **Revue de Linguistique et de Philologie comparée. Recueil trimestriel de documents pour servir a la Science Positive des Langues, a l'Épigraphie, a l'Ethnologie, a la Mythologie et a l'Histoire**, Tome Quatrième 1er Fascicule - Juillet Maisonneuve Libraires - Éditeurs, Paris, 1870.
- Miklošič Franc, **Albanische Forschungen**, 3 Bände [1. *Die slavischen Elemente im Albanischen*, 1870; 2. *Die romanischen Elemente im Albanischen*, 1871; 3. *Die Form entlehnter Verba im Albanischen*, 1871ë, mit einer Einleitung, welche die Ausbreitung des albanischen Volksstammes, die quellen unserer Kenntniss der albanischen Sprache, die laute derselben und die versuche, diese laute darzustellen, zum Fiegenstande hat, Aus Der Kaiserlich-Königlichen Hof- und Staatsdruckerei, Wien 1870-1871.
- Miklošič, Franc: **Gjurmime shqiptare/ Albanische Forschungen**, ASHAK/SAZU, Prishtinë/ Ljubljana, 2007, shqip e gjermanisht, ff. 504.
- Schirò Giuseppe, **Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia**, Stab. tip. L. Pierro, Napoli, 1923, cit., ristampa anastatica, Tipografia Renna, Palermo, 1986.
- Schuchardt Hugo, [Rez. von:], *Grammatica della lingua Albanese di Giuseppe de Rada. Prima parte* në **Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen Zeitschrift für vergleichende Sprachforschungen auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen** herausgegeben von Dr. Adalbert Kuhn, Bd. XXII, Berlin, Ferd. Dümmlers Verlagsbuchhandlung, 1874.
- Schuchardt Hugo, *Albanesische Studien von Gustav Meyer, die Pluralbildungen der albanischen Nomina*, 1883 në **Literaturblatt für germanische und romanische Philologie**, Wien 1883-1884 [*Prispevky ku poznani nareci albaniskych, uverejnuje Jan Urban Jarnik*, v Praze 1883.
- Schuchardt Hugo, *Albanisches und romanisches. Zu Miklosich's albanischen Forschungen* in **Zeitschrift für vergleichende Sprachforschungen auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen** herausgegeben von Dr. Adalbert Kuhn, Bd. XX, Berlin, Ferd. Dümmlers Verlagsbuchhandlung, 1872.
- Venier Federica, *Dissimetrie schuchardiane: contatto e parentela linguistica fra le lingue. Trattatello in laude di Schuchardt* in Carlo Consani (a cura di), **Contatto interlinguistico fra presente e passato**, Il Segno e le lettere. Collana del Dipartimento di Lingue, Letterature e Culture moderne dell'Università degli Studi “G. D’Annunzio”, Edizioni Universitarie di Lettere Economia Diritto, Milano, 2015.

Francesco ALTIMARI, Cosenza

DE RADA DHE ARBËRESHËT E ITALISË NË FOKUSIN E ALBANOLOGJISË GJERMANE TË SHEKULLIT XIX

Në këtë kumtesë, autori sjell në fokus gjurmë nga prania e Arbëreshëve, e gjuhës dhe e kulturës së tyre, në veprat e botuara në vendet gjermanishtfolëse gjatë shekullit XIX. Pikënisja zë fill me veprën e Adelung-ut *Mithridates oder allgemeine Sprachkunde* (Berlin, 1806-17) dhe vijon deri në vitin 1897 me veprën *Albanesische Studien* të gjuhëtarit të shquar austriak Gustav Meyerit. Në këtë hark kohor, një vend të rëndësishëm zë edhe puna e studiuesit zvicerian Gottlieb Stier (1825-1896), i cili u mor me “zbulimin” e De Radës dhe të tërë lëvizjes kulturore arbëreshe të Rilindjes, si dhe botoi për herë të parë, një pjesë të krijimtarisë letrare të Poetit të Maqit në gjermanisht, duke i çelur shteg kështu njohjes së letërsisë së sapolindur romantike arbëreshe në botën kulturore gjermane.

Sipas dëshmive të udhëpërshkruesit gjerman Johann Heinrich Bartels (1761-1850), që i gjejmë në formë letërkëmbimi në veprën *Briefe über Kalabrien und Sizilien*, botuar në Göttingen më 1787, bota, gjuha dhe kultura arbëreshe gjejnë një vëmendje të posaçme në vendet gjermanishtfolëse, sidomos në shekullin XIX. Në këtë letërkëmbim, Bartels përshkroi ngjarje, personazhe dhe institucione të Arbëreshëve me të cilat u njoh gjatë udhëtimit të tij, bërë në vitin 1786 nëpër krahinat e Italisë së jugut, aty ku edhe sot e kësaj dite përqendrohet prania më e madhe e Arbëreshëve, domethënë në Kalabri dhe në Siçili.

I pari që e fokusoi vëmendjen e tij ndaj botës së Arbëreshëve, qe Johann Christoph Adelung (1732-1806), filolog dhe shkencëtar, erudit gjerman me formim iluminist. Në veprën e tij “*Mithridates oder allgemeine Sprachkunde*” (1806-17), e cila u botua postumo nga Johann Severin Vater (1771-1826), autori në fjalë u përpoq të mblidhte material nga të gjitha gjuhët e botës, duke mos lënë jashtë vëmendjes burimet mbi

vendbanimet italo-arbëreshe, ku ndër të tjera përmenden tregimet rreth udhëtimeve të gjermanit Bartels dhe ato të anglezit H. Swinburne.

Për arbërishten, ai na sjell si dokument lutjen e krishterë “Ati ynë” sipas veprës *Saggio pratico delle lingue* (1787) të jezuitit spanjoll Lorenzo Hervas y Panduro (1735-1809), në dy versione: njëri në arbërishten e Kalabrisë dhe tjetri në arbërishten e Siçilisë. Bazuar në terminologjinë e kohës, të parin e quan *Calabrisch-Griechisch* [“greqishte kalabreze”ë, (kam përcaktuar origjinën e këtij versioni të lutjes, duke vëzhguar disa tipare të saj fonetike dhe lekskore, në të folmen e Vinës në Kalabrinë e mesme). Versionin e dytë, atë të arbërishtes së Siçilisë, e emërton *Sicilianisch-Griechisch* [“greqishte siciliane”ë sipas terminologjisë të po asaj kohe, (nisur nga disa tipare të veçanta fonetike mund të pohojmë se zona dialektore e saj përkon pa dyshim, me atë të Horës së Arbëreshëve).

Pavarësisht kontributeve të sipërpërmendura, duhet thënë se vetëm në gjysmën e shekullit XIX filloi të shfaqej në botën gjermane një interesim më i thelluar dhe më i vetëdijshëm përkundër kulturës arbëreshe dhe asaj shqiptare në përgjithësi. Dhe nuk është e rastit nëse albanologjia, që lindi në shekullin XVII, pikërisht në Gjermani – le të kujtojmë këtu ndër pararendësit e saj filozofin e madh gjerman Gottfried Wilhelm Leibnitz (1646-1716) – merr një shtysë vendimtare në saje të studiuesit austriak Johann Georg von Hahn (1811-1969), vepra e të cilit *Albanesische Studien* (Jena 1854) shërbeu si bazë dhe si orientim për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve albanologjike, jo vetëm në Gjermani.

Vëmendja ndaj komuniteteve të Arbëreshëve të Italisë, për gjuhën dhe kulturën e tyre, që merr përmasa të konsiderueshme që prej gjysmës së shekullit XIX, duhet lidhur, pjesërisht, me lindjen e gjuhësisë krahasuese, që kishte në fokus indoeuropianishten, e për rrjedhojë edhe shqipen. Në vazhden e studimeve të ndërmarra nga shkolla gjermane në fushën e gramatikës krahasuese, vlen të përmendet vepra e mirënjohur e themeluesit të kësaj shkolle, Franz Bopp-it (1791-1867), *Über das Albanische in seinen Verwandtschaftlichen Beziehungen* (1854). Ky proces duhet parë i gërshtuar me atë lëvizje të përgjithshme intelektuale dhe artistike të Gjermanisë së pjesës së fundit të shekullit XVIII dhe gjysmës së parë të shekullit XIX të njohur si romantizmi, i cili në thelb mënjante traditën klasike për t'i

hapur vend kështu zbulimit të rrënjëve autoktone, etnike dhe kulturore të popujve të ndryshëm.

Në këto rrethana, të prirë nga ideja për të rizbuluar dhe vlerësuar traditat kulturore dhe letërsinë popullore të bashkësive të ndryshme kombëtare- sidomos të atyre të ‘vogla’ dhe pak të njohura, siç ishte atëherë ajo shqiptare – u vendos që të botohej vepra *Die Sprache der Albaner oder Schkipetaren* e gjeneralit bavarez Karl August von Xylander (1794-1854), në Frankfurt mbi Main, më 1835. Në këtë botim, sillen këngët e njohura popullore shqiptare të mbledhura nga lord Byron më 1810, të cilat jepen si në variantin origjinal, ashtu dhe me përkthimin përkatës në gjermanisht. Krahas tij, gjejmë të përkthyer në gjermanisht edhe veprën e gjuhëtarit italian Bernardino Biondelli, *Geschichte, Sprache und Poesie dei Albanesen*, e botuar në revistën gjermane *Magazin für die Literatur des Auslandes* në Berlin, më 1846. Më parë, kjo vepër qe botuar në gjuhën italiane, në revistën *Rivista d’Europa*, e ndjekur atypëraty nga një ribotim i vitit 1856 në një vëllim të posaçëm me titull *Studii Linguistici*.

Në këtë studim, të botuar më parë në revistën *Magazin für die Literatur des Auslandes*, Biondelli sjell në versionin gjermanisht nëntë nga dymbëdhjetë këngët që kishin dalë më parë në italisht, prej të cilave mund të përmendim: *Kostandini i vogël*, *Vdekja e ngjallja e Lazërit*, *Për vdekjen e Pal Golemit*, etj. Autori i kishte marrë këto këngë nga folkori tradicional arbëresh me qëllim që t’i bënte të njohura për lexuesin si dhe të vlerësonte disa tipare të veçanta dhe thelbësore të letërsisë popullore shqiptare.

Vetëm ndonjë vit më pas, më 1853, në revistën gjermane *Allgemeine Monatschrift für Wissenschaft und Literatur*, doli ai që duhet konsideruar studimi i parë i mirëfilltë, tipik dhe origjinal, mbi kulturën letrare arbëreshe: e kemi fjalën për *Albanesen in Italien und ihre Literatur* të filologut, historianit dhe pedagogut zviceran Heinrich Christoph Gottlieb Stier (1825-1896). Si studiues klasik që ishte, ai përdori edhe emrin latinisht *Theophilus*, si kalk i mirëfilltë i emrit gjerman *Gottlieb* “i dashur nga Zoti”. Intelktual me erudicion shumë të gjerë, Stier u mor ndër të tjera edhe me tekste në gjuhë të vjetra klasike si latinishtja dhe hebraishtja, si dhe shkroi e botoi vepra të përkthyer në një sërë gjuhësh moderne si, gjermanisht, flamanisht, hungarisht, arbërisht. Për hartimin e këtij punimi të parë orga-

nik para lexuesve gjermanë, që kishte në fokus realitetin historik-kulturor të Arbëreshëve të Italisë, Stier u bazua si mbi të dhëna historike, gjeografike dhe statistike që ia ofroi Biondelli, ashtu edhe mbi veprën *Su gli Albanesi: Ricerche e Pensieri* [Mbi Arbëreshët: Kërkime dhe Mendimeë të botuar në Napoli, më 1847 nga Vinçenc Dorsa. Për pjesën mirëfilli letrare, si burim për të, shërbyen veprat e njohura dhe të botuara deri aso kohe të Jeronim De Radës, për të cilin ai shprehet kështu: “(..) Die Aufgabe gestellt, der Mcpherson seiner Volksgesänge zu werden”.

Në mënyrë të veçantë, emri i Gottlieb Stier-it lidhet sidomos me përkthimin në gjermanisht të njëjës prej poemave të De Radës, *Rrëfimet e Arbërit* e posaçërisht të njëjës prej këngëve të kësaj poeme, *Anna Maria Cominiante*, të cilën e botoi më 1856, me titullin latinisht: *Hieronimi De Rada carmina italoalbanica quinque transcripsit vertit glossario notisque instruxit Theophilus Stier* (Brunsvigae, 1856). Në transkriptimin e tekstit arbërisht, Stier përdori alfabetin greqisht, duke ndjekur modelin e hartuar dhe të zbatuar nga von Hahn. Vepra plotësohet me një fjalës që përfshin termat arbëreshë të nxjerrë nga Anna Maria Cominiante, prej veprës *Serafina Thopia* dhe asaj *Mbi Arbëreshët: Kërkime dhe Mendime* të Dorsës. Nuk mungojnë aty krahasime me fjalorin e shqipes të Frang Bardhit, *Dictionarium Latino-Epiroticum* (Roma 1835), nga *Noctes Pelasgicae* të C. Reinhold (Athinë 1855) dhe nga veprat e K.Xylander-it dhe J. Von Hahn-it, si dhe referime me zëra të ndryshëm nga latinishtja, greqishtja, sanskritishtja, persianishtja, gjermanishtja e vjetër, mesapishtja, etj., punë kjo e bazuar në një përqasje ‘krahasuese’, me gjasë e huazuar nga vepra e F.Bopp-it *Über das Albanesische* (Berlin, 1855). Nga po i njëjti studies zviceran kemi edhe tre kontribute të tjera në fushën e studimeve shqiptare: *Ist die albanesische Sprache eine indogermanische?* Në *Allgemeine Monatschrift für Wissenschaft und Literatur* (Braunschweig, 1854); *Die albanesische Thiernamen* në *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen* (Berlin, 1862) dhe *Die albanesische Farbennamen* në *Zur Begrüssung der XXXVII. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Dessau. Festschrift in Zerbst* (Zerbst 1884).

Përpos Stier-it, për përkthimin gjermanisht të veprave letrare arbëreshe, në shekullin XIX u shqua, gjithashtu, baronesha austriake Josephine

Freiin von Knorr (1827-1908), e cila mbajti një letërkëmbim të dendur dhe të rregullt me Jeronim De Radën, nga i cili përkteu disa këngë të nxjerra nga përmbledhja e rëndësishme folklorike arbëreshe *Rapsodie d'un poema albanese* (Firenze, 1866), në vëllimin *Costantin und Garentina. Neue Gedichte* von Josephine Freiin von Knorr (Wien, 1874). Josephine Freiin von Knorr, në një studim të detajuar me titull *Die albanischen Colonien in Italien und ihre Volkslieder* në *Das Ausland* të Stüttgart më 1897, u mor gjerësisht me këngët tradicionale arbëreshe të botuara nga De Rada dhe me kontributin e dhënë nga Poeti i Maqit për 'zbulimin' dhe përhapjen, në mjedisin europian, të letërsisë gojore të Arbëreshëve të Italisë.

Siç na informon vetë De Rada, në dorëshkrimin e versionit të katërt të poemës *Këngët e Millosaut* (1897), po atë vit, Baronesha Knorr i kishte premtuar poetit mbështetjen e saj për ribotimin e veprës së tij të parë lirike, që do të përfaqësonte siç na thotë Poeti në dorëshkrimin e versionit të fundit të Millosaut, edhe librin e parë të poemës së dyfishtë nistore, të sponsorizuar prej saj. Kjo do të ishte edhe poema e fundit në rrugëtimin e tij të gjatë letrar, që do të kishte si libër të dytë botimin e tretë të poemës *Këngët e Serafinës Thopia* (1898), e cila u botua nën titullin *Specchio di Umamo Transito* [Pasqyra e një jete njerëzore].

Interesi gjuhësor për shqipen, si dhe për degën e saj më arkaike, arbërishten, përgjatë shekullit XIX, i cili u zhvillua brenda studimeve të gjuhësisë krahasuese, fillimisht u karakterizua (dhe u kushtëzua) nga një angazhim kërkimor fragmentar, disi i copëzuar e për rrjedhojë jo sistematik. Vetëm me gjuhëtarin austriak Gustav Meyer (1850-1900), studimet albanologjike njohën një ngritje cilësore dhe fituan një vlerë më organike dhe sistematike. Falë punës së tij, albanologjia ia doli të gjejë një hapësirë shkencore dhe akademike më autonome dhe të mirëpërcaktuar, edhe në shkallë institucionale, brenda Universiteteve europiane.

Në kuadrin e një interesi të gjerë për albanologjinë, Meyer-i lëvroi me përkushtim të posaçëm studimet e tij mbi arbërishten. Gjurmë domethënëse të këtij përkushtimi, gjejmë si në letërkëmbimin e tij të pasur, të ruajtur në fondin *Handschriftenabteilung* të bibliotekës së Universitetit të Grac-it, ashtu dhe në disa studime të botuara të tij. Ndër to mund të përmendim: *Über Sprache und Literatur der Albanesen* botuar më 1883 në

Nord und Süd dhe *Bei den Albanesen Apuliens* të botuar në *Neue Freie Presse* më 1890. Tekste mbi të folmet arbëreshe të Italisë jugore (fjalë të urta, tregime në prozë dhe poezi popullore) u botuan prej tij në vëllimin e gjashtë të veprës shumëvëllimshë *Albanesische Studien, VI. Beiträge zur Kenntnis verschiedener albanesischer Mundarten* (Wien 1897).

Vepra e tij e mirënjohur *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache* (Strassburg, 1891), ndonëse, tashmë e vjetëruar dhe e tejkaluar nga ana shkencore, sidomos nga pikëpamja e orientimit mbivlerësues të elementit të “jashtëm” në krahasim me atë të “brendshëm” të gjuhës, mbetet gjithnjë një pikë referimi për ata që merren me studimet etimologjike të shqipes, por edhe me gjuhët e tjera ballkanike. Gjuhëtari austriak shfrytëzoi një pjesë të mirë të veprave letrare arbëreshe të kohës e në mënyrë të veçantë veprat e De Radës, çka bëri që leksemat tipike të të folmeve italo-arbëreshe, t’i gjejmë aty të përfshira dhe të pasqyruara gjerësisht.

Pas Gustav Meyerit, studimet albanologjike qoftë në Gjermani, qoftë në Austri, u lëvruan kryesisht nga gjuhëtarë të dy drejtimeve kërkimore që u zhvilluan brenda gjuhësisë historike: nga njëra anë kemi vazhdimësinë e traditës së komparativistëve që mund të përkufizohen si klasikë, dhe, nga ana tjetër, grupi i gjuhëtarëve, të cilët u fokusuan tek gjuhët e Ballkanit, kryesisht te gjuhët sllave por edhe në fushën e romanistikës. Kështu, këto dy drejtime të albanologjisë gjermane gjetën në gjysmën e parë të shekullit XX një nyjë të fortë ndërlidhëse dhe një qendër të rëndësishme kërkimore në shkollën gjuhësore të Vjenës, së cilës do t’i referohen studiues si, Kopitar-i, Miklosiç-i, vetë Meyer-i, Lambertz-i, Jokl-i dhe Cabej.

Sadoqë me mjaft interes, kjo faqe e re e historisë albanologjike që ka të bëjë me vëmendjen e shtuar për gjuhën dhe kulturën arbëreshe nga gjuhëtarët e shkollës austriake nuk do të jetë pjesë e këtij punimi, pasi i tejkalon kufijtë kohorë të kësaj kumtese.

BIBLIOGRAFI

- Johann Christoph Adelung, **Mithridates oder allgemeine Sprachenkunde mit dem Vater Unser als Sprachprobe in bey nahe fünfhundert Sprachen und Mundarten, Erster Theil**, Berlin 1806.
- Lorenzo Hervas [y Panduro], **Saggio pratico delle lingue, con prolegomeni e una raccolta di orazioni Domenicali in più di trecento lingue e dialetti (...), Opera dell' Abate Don Lorenzo Hervas**, Cesena 1787.
- Ritter Karl August von Xylander, **Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren**, Frankfurt am Main 1835.
- Heinrich Christoph Gottlieb Stier, **Hieronymi De Rada carmina italoalbanica quinque transcripsit vertit glossario notisque instruxit Theophilus Stier**, Brunsvigae, 1856.
- Heinrich Christoph Gottlieb Stier, *Ist die albanesische Sprache eine indogermanische?* (f. 860-72) në **Allgemeine Monatschrift für Eïssenschaft und Literatur**, Braunschweig 1854.
- Heinrich Christoph Gottlieb Stier, *Die albanesische Thiernamen* (f. 132-50 dhe 206-52) në **Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung auf dem Gebiete des Deutschen, Griechischen und Lateinischen**, hrsg. Von dr. Adalbert Kuhn, Bd. XI, Berlin 1862.
- Heinrich Christoph Gottlieb Stier, *Die albanesische Farbennamen* (f. 26-33) në **Zur Begrüssung der XXXVII. Versammlung deutscher Philologen und Schulmänner in Dessau. Festschrift in Zerbst**, Zerbst 1884.
- Gustav Meyer, **Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache**, Strassburg 1891.
- Gustav Meyer, **Albanesische Studien, VI. Beiträge zur Kenntnis verschiedener albanesischer Mundarten**, Wien 1897.

Giuseppina TURANO, Universiteti i Venecias

KONTRIBUTI I STUDIUESVE GJERMANË PËR DIALEKTOLOGJINË ARBËRESHE

Interesimi për dialektet e arbëreshëve të Italisë fillon në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë në shkollën austriake në Vjenë me Gustav Meyerin, vëmendja e të cilit u përqendrua në çështje që lidhen me leksikun e gjuhës shqipe, i studiuar sidomos në aspektin etimologjik.

Kjo punë e tij e fillimit ishte mbështetur edhe në leksikun arbëresh, marrë nga një varg veprash të disa autorëve si De Rada dhe Kamarda, me të cilët Meyeri kishte kontakte të ngushta.

Ai qe ndoshta i pari gjuhëtar që bëri, në vitin 1890, një ekspeditë nëpër kolonitë arbëreshe të Italisë. Shkoi në Shën Marcan, në provincën e Tarantos, ku mbledhi materiale të ndryshme folklorike dhe etnografike, si këngë popullore, përralla, letërsi gojore.

Hulumtimet dhe studimet për arbëreshët e Italisë vazhdojnë me një albanolog austriak tjetër, edhe ai nga shkolla e Vjenës, Maximilian Lamberci. Ai ka bërë një paraqitje përmbledhëse për të folmet arbëreshe të Molizës dhe të Puljes Veriore, vende ku kishte bërë hulumtime në terren.

Lamberci ka analizuar sistemin fonetik, gramatikor dhe sintaksor të këtyre dialekteve, si dhe është marrë me leksikografinë dhe onomastikën. Puna e tij është e shoqëruar edhe me tekste gojore.

Në gjysmën e parë të shekullit të njëzet u shqua edhe studiuesi Eqrem Çabej, edhe ai nga shkolla e Vjenës, nxënës i Norbert Joklit. Mbaroi doktoratën më 1933 me një disertacion kushtuar të folmes arbëreshe të Horës në Sicili, për të cilën ka paraqitur sistemin fonologjik, kurse për morfologjinë është marrë me etimologjinë dhe me formimin e fjalëve. Në studime të tjera, Çabej është përqendruar në karakteristikat e dialekteve arbëreshe duke bërë përshkrimin e tipareve gjuhësore të këtyre dialekteve dhe duke vënë në spikamë veçoritë të përbashkëta si dhe dallimet e tyre në strukturën fonetike dhe gramatikore.

Nga Universiteti i Berlinit vinte Rupprecht Rohri, i cili na ka lënë një përshkrim për të folmen e Firmozës, një koloni arbëreshe në Kalabrinë e veriut, që ishte temë disertacioni.

Interesimi për të folmen e Firmozës u zgjerua me publikimin e disa artikujve ku studiuesi ka trajtuar probleme që lidhen me morfologjinë, sidomos me lakimin e emrave, dhe me leksikun e kësaj të folmeje.

Përveç studimit të dialektit të Firmozës, ai u ka kushtuar vëmendje edhe të dhënave të tjera që lidhen me planin historik, kulturor dhe socio-linguistik të arbëreshëve si dhe studime që lidhen me pozitën e arbëreshëve në panoramën e pakicave gjuhësore europiane.

Veprën e Rorhit e ka vazhduar studiuesi gjerman Gabriele Birken-Silverman. Duke filluar me të dhënat e mbledhura në kolonitë arbëreshe të Sicilisë, ajo ka studiuar kontaktet e arbërishtes me gjuhën italiane si dhe me dialektet e Sicilisë dhe ka analizuar ndikimin që italishtja ka ushtruar mbi arbërishten për afro 5 shekuj duke u përqendruar kryesisht në fushën e leksikut dhe të fonetikës.

Autorja ka konfirmuar se dialektet arbëreshe janë të folme të përzier, baza e së cilave është e përbashkët me gjuhën shqipe, është fondi i trashëguar, fondi themelor të fjalëve të vjetra shqipe, kurse elementet e reja janë rezultat të ndikimit të gjuhës italiane, d.m.th. i kanë marrë në territorin ku shtrihen. Edhe pse kemi të bëjmë me kontakt midis sistemesh të dy gjuhëve të ndryshme, siç janë shqipja dhe italishtja, me tipologji të ndryshme strukturorë, elementet që hynë nga italishtja në të folmet arbëreshe i pasurojnë këto pa prishur sistemin e tyre gramatikor sepse huazimet janë integruar mirë në strukturën fonetike dhe gramatikore të arbërishtes.

Autorja ka analizuar edhe të folmet arbëreshe të Kalabrisë veriore në marrëdhëniet e tyre me gjuhën italiane dhe me dialektet e Kalabrisë. Ajo ka vënë në dukje disa probleme që paraqet situata gjuhësore në fshatrat arbëreshë, ku banorët janë bilingë sepse përveç arbërishtes flasin edhe dhe sidomos italishten. Është marrë me huazimet, me çështje të kontaktit gjuhësor dhe me dinamikat sociolinguistike si variacioni gjuhësor, ndryshimi gjuhësor, format e përdorimit, kompetenca gjuhësore bazuar në variantet sociodemografike të moshës, seksit e shkollimit.

Ajo ka konfirmuar se, në shumë fshatra, ngushtohet kompetenca e

arbërishtes si gjuhë e parë, sepse është vetëm gjuhë e folur, e pashkruar, e përdorur vetëm në familje dhe në fshat ndërsa, në të kundërtën, rritet kompetenca e gjuhës italiane që vepron me force sepse gjuhë zyrtare, gjuhë e shkollimit, e arsimit, e kulturës, gjuhë e folur dhe e shkruar.

Në studimet e saj, autorja është marrë edhe me konvergjenca dhe me divergjenca në fushën e leksikut. Autorja jep si konvergjenca ato fjalë që gjenden në të gjitha të folmet arbëreshe. Si, për shembull, *gajdhur* ‘gomar’ ose *jatrua* ‘mjek’ që vijnë nga greqishtja; ose fjalë si *shurbenj* ‘shërbej’ që në dialektet arbëreshe ka kuptimin ‘punoj’ dhe, që, pak a shumë, gjenden në të gjitha të folmet arbëreshe. Kurse si divergjenca, autorja jep variacionet leksikore, fjalë të ndryshme që emërtojnë të njëjtin send. Për shembull, ka pesë variante për fjalën *lulekuqe*. Në Falkonara, Firmo dhe Frasnitë përdoret fjala *ljuljkuqe*. Në Firmozë, Ungër, Çift përdoret *paparun*. Në Shën Mitër përdoret fjala *pupagjelj*. Në Shën Bendhit dhe në Shën Sofi përdoret fjala *papënj*. Në Shën Sofi përdoret edhe forma *kokoreshe*. Merr si divergjenca edhe variantet fonetike si *paparun* që përdoret në Firmozë, Ungër, Çift dhe *paparin* që përdoret në Horën e Arbëreshëve, në Sicili. Ose *krikomel* ‘misër’ që përdoret në Ungër dhe *trokomel* në Shën Mitër.

Një gjuhëtar tjetër që është marrë me studimet dialektore arbëreshe është Martin Camaj. Edhe pse shqiptar, studimet kushtuar dialektologjisë arbëreshe i ka zhvilluar në Gjermani, në Universitetin e Mynihut. Tri dialekte janë objekt të studimeve të veçanta monografike: ai i Greçit (në provincën e Avelinos), ai i Falkonarës në provincën e Kozencës, dhe ai i Shën Kostandinit në provincën e Potencës. Në këto monografi, autori bën një përshkrim të hollësishëm të sistemit fonetik por sidomos morfologjik me studimin e nyjës, e emrave, e mbiemrave, e përemrave me veçoritë e tyre gramatikore: si gjinia, numri, dhe lakimi dhe përshkrimin e sistemit foljor, me kategoritë e tij si veta, koha, mënyra, aspekti. Edhe pse të tria monografitë përqendrohen shumë pak në dukuritë sintaksore, Camaj na ka dhënë një pasqyrë të qartë të pamjes gjuhësore të këtyre të folmeve në gjendjen e sotme, me të gjitha ndryshimet e zhvillimit që kanë pësuar gjatë shekujve.

Përveç monografisë, dialektit të Shën Kostandinit, Camaj i ka kushtuar një punim tjetër në të cilin analizon aspektin e foljes, duke u për-

qendruar në kundërvënien midis perfektivit (i shprehur me anë të aoristit) dhe imperfektivit (i shprehur me anë të kohës së pakryer). Për të folmen e Shën Kostandinit, Camaj tregon se aspekti perfektiv shpreh ndryshimin e situates, tregon veprime të përfunduara në një çast të caktuar të së shkuarës, kurse aspekti imperfektiv shpreh vazhdimin e veprimit, tregon veprimin në zhvillim.

Përveç kësaj dikotomie, e folmja e Shën Kostandinit ka disa forma perifrastike që shprehin fillimin, vazhdimin, dhe mbarimin e veprimit. Fillimi mund të shprehet me forma si: *zë e ha, nis e ha, vëhem e ha*. Vazhdimi shprehet me foljen jam: *jam e sherbenj, jam e ha*. Mbarimi shprehet me forma si *erdha e hëngra, vajti e blejti*.

Artikuj Camaj ka botuar edhe për të folmen e Barilit (në provincën e Potencës), dhe të Villa Badheses (në provincën e Pescarës). Edhe në këta, Camaj merret më shumë me strukturën gramatikore nga pikëpamja fonetike dhe morfologjike sesa me sintaksën.

Karakter të përgjithshëm kanë punët në të cilat Camaj merret me problemin e klasifikimit të tipareve të dialekteve arbëreshe dhe me bilinguizmin italo-shqiptar.

Dy janë nxënësit e Martin Camajt që janë marrë me problemet e arbërishtes: janë studiuesit gjermanë Walter Broi dhe Elvira Glaser.

Të dy kanë bërë hulumtime në terren, kryesisht në komunitetet arbëreshe të Kalabrisë dhe në Molize.

Pjesa më e madhe e studimit të Walter Broit është rezervuar sistemit foljor. Ai është marrë sidomos me klasifikimin e tipareve morfologjike të foljes bazuar në kategoritë e aspektit, kohës dhe mënyrës, nga pikëpamja sinkronike si dhe nga ajo diakronike. Broi ka propozuar disa kriterë sipas të cilave mund të dallohen kategoritë e sistemit foljor.

Përpos aspektit formal morfologjik, kohët i specifikon për kuptimin aspektor. Për kategorinë e aspektit, ka analizuar sidomos aoristin dhe aspektin perfektiv që shpreh përballe kohës së pakryer që është imperfektive.

Ndër çështjet që trajtoi edhe atë të perfektit të tipit *ka vdekur*, që në të folmet arbëreshe të Kalabrisë Veriore nuk ka kuptim kohor. Koha e shkuar, d.m.th. veprimi i kryer, i përfunduar, shprehet vetëm me aoristin,

përdoret vetëm e kryera e thjesht, si *vdiq*. Kurse forma analitike e perfektit e formuar me anë të foljes ndihmëse *kam + pjesore*, si në shembullin *ka vdekur* ka nuancën modale të dyshimit, sepse kuptimi është ‘ndohta ka vdekur’. Aoristi dhe Perfekti janë në kundërvënie në rrafshin modal dhe jo në rrafshin kohor: i pari shpreh veprim të vërtet ndërsa i dyti shpreh dyshim.

Kuptimi i perfektit është qëndrimi jokonfirmues i folësit ndaj informacionit.

Këtë loj perfektit, Broi e ka quajtur ‘prezuntiv’. Sipas tij, ky perfekt është një zhvillim të brendshëm të arbërishtes, një trajtë inovative, dhe e lidh këtë inovacion me ndikimin e dialekteve italiane që nuk e përdorin perfektin me vlerë kohor sepse për veprimin e përfunduar përdorin vetëm aoristin.

Këtë çështje e ka studiuar edhe Françesko Altimari, i cili, ndryshe nga Broi, mendon se prezuntivi arbëresh është një dukuri arkaike ballkanike, një tipar tashmë i zhvilluar në sistemin foljor të shqipës të shekullit XV, një zhvillim i brendshëm i kësaj tradite gjuhësore, i sjellë nga shqiptarët gjatë emigrimit të tyre në Itali dhe jo një ndikim i jashtëm i dialekteve italiane.

Sipas Altimarit, prezuntivi mund të lidhet me procesin e formimit të mënyrës habitore të gjuhës shqipe. Në fakt, këtë kuptim të perfektit si qëndrim jokonfirmues të folësit ndaj informacionit, sipas Viktor Fridmanit e ka edhe habitortja e gjuhës shqipe.

Nga ana tjetër, ka të folme arbëreshe, si ajo e Shën Marcanit (në provincën e Tarantos), ose si ato të Shin Kollit, të Karficit dhe të Puheriut (në provincën e Krotonës) dhe në Horën e Arbëreshëve në Sicili që për veprimin e përfunduar përdorin vetëm perfektin dhe kanë humbur format e aoristit. Edhe këto kanë qënë objekt studimi nga ana e Broit.

Disa punime, Broi ja ka kushtuar të folmes së Frasnitës, në provincën e Kozencës dhe Munxifunit, në Molizë. Për këto të folme, ka trajtuar variacionin në zgjedhimin e foljeve, përdorimin dhe funksionin e aoristit, morfologjinë e foljes dhe të emrave, integrimin e huazimeve italiane në këto dialekte arbëreshe në rrafshin fonetik dhe morfologjik.

Për të folmen e Frasnitës ka analizuar edhe disa ndërtime foljore

perifrastike, për të cilat ka studiuar jo vetën strukturën morfologjike por edhe funksionin përkatës. Të tilla janë format e ndërtuara me *jam* + lidhësen bashkërenditëse *e* + foljen në mënyrën dëftore, si *jan e luajen* ‘po luajnë’ ose të ndërtuara me mënyrën përcjellore si *ven ture kendua* ‘janë duke kënduar’/po këndojnë’, që shprehin vazhdimin e veprimit. Format modale të ndërtuara me *kam* + foljen në mënyrën lidhore, si *ket ffjemi*, që shpreh kohën e ardhme por mund të përdoret edhe me nuancën modale të detyrimit. Format prezuntive si *ka vdekur* me kuptimin ‘ndoshta ka vdekur’. Ndërtime kauzative, si *u bën e partirti mëma* ‘bëri të nisej nëna’.

Përveç formës dhe valencës së foljes, veprimtaria shkencore e Broit përfshin edhe punime në të cilat është marrë me kontaktin gjuhësor, me bilinguizmin, sidomos në Molizën ku, në një territor shumë të vogël, bashkëjetojnë tri sisteme gjuhësore të ndryshme: arbërishtja, kroatishjtja dhe italishtja, secili prej tyre me tipare të veçanta. Broi ka vënë në dukje fenomenet e huazimeve dhe të integritimit, sidomos, të foljeve, nga gjuha italiane në dialektin arbëresh dhe në dialektin kroat.

Si Broi, edhe Elvira Glaser është marrë, nga njëra anë, me sistemin foljor, sidomos me strukturën morfologjike të mënyrës lidhore në të folmet arbëreshe të Kalabrisë Veriore dhe, nga ana tjetër ka trajtuar shumësinë e elementeve italiane që kanë hyrë në strukturën leksikore të arbërishtes.

Duke analizuar të folmen e Frasnitës, ajo ka dalluar fushat e ndryshme leksikore në të cilat kanë depërtuar huazimet nga italishtja, sasinë e tyre, dhe origjinën.

Autorja tregon se disa prej tyre kanë hyrë nga dialekti kalabrez dhe jo nga italishtja. I tillë është, për shembull, emri *guanjun* ‘djalë’ (*ragazzo* në gjuhën italiane), kurse shumë prej tyre, si ndajfolja *dhopu* ‘pastaj’ janë vështirë të klasifikohen sepse nuk është e qartë nëse kanë hyrë nga italishtja *dopo* ose nga dialektet italiane të Jugut. Në të folmen e Frasnitës, njëzet përqind të leksikut përbëhet nga huazimet, sidomos në fushat e emrit dhe të ndajfoljes; më pak janë foljet dhe lidhëzat të hyra nga të folmet italiane, të Italisë jugore. Kujtojmë se bilinguizmi mes shqipes dhe italishtes ka zgjatur për një periudhë 5 shekullor.

Përveç huazimeve, Elvira Glaser është marrë edhe me dukuri të tjera si code-switching dhe code-mixing.

Një punimë arbërishtes ja ka kushtuar Oda Buchholz, albanologe nga Gjermania, e cila së bashku me Fidlerin, po ashtu albanolog gjerman, janë koautorë të një gramatike shqipe (*Albanish Gramatik*). Punimi analizon konstruktionet e arbërishtes me mbiemra në komparativ dhe në superlativ.

Edhe Fiedleri ka trajtuar fenomenet morfologjike të arbërishtes nga pikëpamja ballkanologjike.

Siç shihet nga kjo pasqyrë, shumë e shkurtër, interesimi për të folmet arbëreshe ka zënë pikërisht në truallin gjerman. Studiues gjermanë të dalluar janë marrë me leksikologjinë, me sistemin emëror dhe foljor, me çështjen e huazimeve, me kontaktin gjuhësor, me bilinguizmin.

Fatkeqësisht, janë të pakta ose mungojnë krejt studimet në fushën e sintaksës. Nuk janë bërë studime të veçanta për dukuritë në sintaksë e cila mbetet dega më pak e studiuar deri me sot.

Megjithatë, edhe pse mungojnë studime të thella në fushën e sintaksës, kontributi i studiuesve gjermanë mbetet i çmuar për dialektologjinë arbëreshe. Studimet e tyre kanë dhënë një kontribut me vlerë jo vetëm për njohjen e dialektologjisë arbëreshe, por edhe kanë ndihmuar për të hedhur dritë mbi fazat e padokumentuara të gjuhës shqipe.

Walter BREU, Universität Konstanz
Elvira GLASER, Universität Zürich

HANS-JÜRGEN SASSES FORSCHUNGEN ZUM ARVANITIKA

1. Zur deutschsprachigen Tradition der Arvanitikaforschung

Die als “Arvanitika” bezeichneten Dialekte der albanischsprachigen Bevölkerung Griechenlands auf der Peloponnes, in Attika, Böotien, Euböa und Andros waren in der zweiten Hälfte des 19. Jahrhunderts bereits im Aussterben begriffen.¹ Ein Bild des älteren arvanitischen Sprachstands insbesondere der Inseln Poros, Hydra und Spetses wird v.a. durch die Arbeiten Karl Reinholds (1834–1880) vermittelt, der als Arzt in der griechischen Marine arbeitete und dort mit Arvanitikasprechern in Kontakt kam. Allerdings enthielt seine 1855 in Athen erschienene ca. 150 Seiten umfassende Publikation nur einen Teil seiner Aufzeichnungen, bestehend aus Grammatik, Lexik und Anthologie. Die 1856 (ebenfalls in Athen) datierten handschriftlichen Ergänzungen zu diesen drei Teilen waren lange unveröffentlicht,² ebenso wie eine Reihe weiterer, in mehreren Heften zusammengestellter Unterlagen. Der Reinholdsche Nachlaß gelangte später zumindest teilweise in den Besitz des Grazer Professors Gustav Meyer (1850–1900), der 1896 daraus eine Reihe von Texten, zusammen mit weiteren Materialien, veröffentlichte. Der Leipziger Romanist Gustav Weigand (1860–1930) publizierte 1926 weitere Texte zum Arvanitischen, die ebenfalls z.T. Reinholds Aufzeichnungen als Quelle hatten.³

¹ Zur Einwanderung der Arvaniten in die genannten Gebiete seit dem späten Mittelalter vgl. Jochalas (1971), Haebler (1965: 14–18) sowie Sasse (1998: 43–44).

² Eine Übersicht über die in der Publikation von 1855 enthaltenen Teile sowie der 1856 (offenbar in mehreren Exemplaren) autographierten und durch Paginierung mit dieser Publikation verbundenen Ergänzungen (insgesamt ca. 45 Seiten) findet sich bei Sasse (1985: 45, 87 Anm. 24; 1991: 9–10, 546), s. auch Meyer (1896: 2) mit etwas abweichenden Seitenangaben, vgl. auch Anm. 4.

³ Zu der verwickelten Geschichte der nachgelassenen Materialien, die später zu einem Teil in Tirana (Arkivi Qendror të Shtetit) und zu einem anderen Teil in die Biblioteca Mar-

Im 20. Jahrhundert hat sich in dieser im 19. und frühen 20. Jh. Gelegten Tradition der deutschsprachigen Forschung besonders Hans-Jürgen Sasse um die Erforschung der Sprache der Arvaniten verdient gemacht, wobei er gleichzeitig auch ein ausgezeichnete Kenner der griechischen Forschung war.⁴ Claus Haebler auf Aufnahmen vom Ende der 1950er Jahre basierende Monographie zur Sprache der Insel Salamis (publiziert 1965), die von dem Albanologen Maximilian Lambertz, bei dem er in Leipzig studiert hatte, inspiriert war, blieb eine Einzelarbeit.⁵ Einen Sonderfall stellt die Dissertation von Eleni Botsi (2004) dar, die sie, selbst Arvanitin, an der Universität Konstanz in Deutschland verfaßte. Es handelt sich um eine soziologische Studie, die die gegenwärtige Situation im Heimatdorf Vilia der Autorin zum Gegenstand hat. Botsis Ausführungen zum bevorstehenden Sprachtod des Arvanitika sind stark von Hans-Jürgen Sasses Arbeiten beeinflusst. Die Studie enthält auch eine Fülle kommentierter, aktuell aufgenommener Sprachbeispiele (196–240).

2. Hans-Jürgen Sasses erste Arbeiten zum Arvanitika

Hans-Jürgen Sasse, der zunächst in Berlin, später in München, vor allem Arabistik, Balkanphilologie und allgemeine Sprachwissenschaft stu-

ciana in Venedig gelangten, vgl. die Ausführungen von Klosi (2005: 11–13), der insbesondere auch die bis dahin unveröffentlichten Texte aus Reinholds Heften publiziert hat, einschließlich zahlreicher Briefe des Hauptinformanten und zusammen mit einer Neupublikation der in der Ausgabe von 1855 enthaltenen Texte (in adaptierter Orthographie). Außerdem hat Klosi hier die Wörtersammlungen aus den Werken von 1855 und 1856 sowie aus einem der Hefte zusammen ediert (Klosi (2005: 14, 325–376). Nicht enthalten sind bei Klosi (2005) die Passagen zur Grammatik.

⁴ H.-J. Sasse berücksichtigte von Anfang an stets auch die in der Bayerischen Staatsbibliothek vorhandenen publizierten und lithographierten Materialien Reinholds (1855–1856), dessen Arbeiten er für das Beste hielt, was bis dahin zum Arvanitischen geschrieben worden war sowie als wichtigste Quelle für das Arvanitische auf griechischem Boden, vgl. Sasse (1991a: 8–10). Klosi (2005: 13) erwähnt, daß das Exemplar, das sich in Venedig befindet, s. die vorherige Anmerkung, vollständiger sei, allerdings ohne genauere Angaben.

⁵ Haebler, der seit 1972 den Lehrstuhl für vergleichende Sprachwissenschaft in Münster innehatte, hat sich später offenbar in Publikationen nicht mehr mit dem Albanischen beschäftigt.

dierte und mit einer Feldforschungsdissertation in der Arabistik 1970 in München promovierte (Sasse 1971a), hatte noch Mitte der 60er Jahre während eines Studienaufenthalts auch mit Feldforschungen in Griechenland begonnen. Im Studienjahr 1965/1966 hielt er sich mit einem Stipendium an der Universität Saloniki auf. Nach eigenen Angaben (1991b: 66) führte er 1966 erste Erhebungen zum Arvanitika im Ort Markopulo in Nordattika durch. Der Dialekt von Markopulo Oropu blieb bis zum Schluß eine der Hauptquellen für Sasses Arbeiten. Die meisten in seiner Monographie (1991a) abgedruckten Texte stammen von dort, und die sprachliche Situation in Markopulo diente ihm als Beispiel für das Voranschreiten des Sprachwechsels nach dem Zweiten Weltkrieg (Sasse 1991b: 66). Auf sein 1991 erschienenes Hauptwerk zum Arvanitika wird weiter unten in einem eigenen Kapitel noch ausführlich eingegangen. Zur besseren Orientierung für die folgenden Ausführungen sei auch auf die unten abgebildete Übersichtskarte verwiesen.

Als Mitglied der Sektion Mundartforschung des Münchener Sonderforschungsbereichs *Südosteuropa* führte Hans-Jürgen Sasse, der in München in engen Kontakt mit Martin Camaj gekommen war, der am gleichen Institut seit Beginn der 60er Jahre zunächst als Albanischlektor und später als Professor für Albanologie beschäftigt war,⁶ im Winter 1970/71 systematische Feldforschungen in Griechenland, insbesondere in Südböotien, durch. Aus dieser Feldforschung resultierte eine Publikation von neun Texten und einigen Liedern aus dem 16 km von Theben entfernt liegenden Dorf Kaparelli (Sasse 1971b). Insgesamt hat H.-J. Sasse in Kaparelli nach eigenen Angaben 7 Stunden Tonaufnahmen gemacht (1971b: 141). Die Texte wurden in Zusammenarbeit mit Gewährspersonen vom Tonband in API transkribiert und für die Publikation mit einer deutschen Übersetzung versehen. Es handelt sich hierbei um überaus wertvolle Dokumente der damals in der älteren Generation noch lebendigen Sprache. Sasse hält fest, daß “Informanten, die in der Lage sind, Märchen, Volksüberlieferungen und andere “Texte” in albanischer Sprache auf Tonband zu sprechen, [...ë in den meisten Dörfern bereits eine große Seltenheit” sind (1971b: 141),

⁶ Vgl. zu Martin Camajs Wirken und zu seinen sprachwissenschaftlichen Werken Breu/Sasse (2008).

und weiter prognostiziert er: “die meisten dieser Quellen dürften jedoch auch dort innerhalb der nächsten zehn Jahre versiegen.” Damals hatte das Dorf Kaparelli noch 1834 Einwohner, die “alle arvanitikasprachig” (1971b: 142) waren. Alte Leute über 60 bedienten sich damals noch regelmäßig des Arvanitischen und einige ältere Frauen beherrschten das Griechische gar nur mangelhaft. Die Kinder sprachen damals schon ausschließlich mit den Eltern Griechisch, erwarben aber dennoch eine gewisse Sprachkenntnis des Arvanitika. Die kurze phonologische und morphologische Skizze, die Sasse seinen Texten beigab, bezieht sich auf die Sprache der älteren Generation, da die jüngere Generation bereits z.T. beträchtliche Veränderungen aufwies (142, Anm. 8). Der Dialekt von Kaparelli fand nicht nur aufgrund der vergleichsweise guten Sprachsituation das Interesse Hans-Jürgen Sasses, sondern auch als Vertreter des böotischen Dialekts, der bis dahin kaum dokumentiert war. Sasse weist in seinem Artikel auf einige Unterschiede zu dem von Haebler dokumentierten Dialekt von Salamis hin, wie z.B. die häufigere Pluralbildung mit Vokal- und Konsonantenalternationen im Stamm, z.B. *plak* ‘Greis’ – *plac* ‘Greise’ und Vokalwechsel bei der Bildung des Imperfekts von Verben mit Vokalalternation im Präsens, also z.B. Impf. ‘nehmen’: *marrə*, *marre*, *mirr*, *marrəmə*, *marrətə*, *mirrinə*.

Die folgende Textprobe mit einer kurzen Beschreibung des Dorfes⁷ illustriert das Editionsverfahren der mit API transkribierten kleinen Texte, die stets mit einer deutschen Übersetzung versehen werden, was Sasse auch später als Verfahren beibehielt.

I. *ka'tundi 'inə* ||

ka'tundi 'inə ia 'θonə kapareɫ || *'ka 'nərə 'di 'milə 'nierəz* || *poli'ti 'prrəzə | 'horə | 'kanə | tʃ(ə) ia 'θonə 'θivə* || *'ja nə viot'i* ||
'nierəzita 'janə 'nierəz tə-'mirə | tə-'butə | eryati'koŋ || *'venə nə 'punə | 'mbro-
 manə 'viŋənə | 'janə jeor'ɣoŋ* || *asxo'lisənə me 'vref'ta | me 'liŋ | me 'ara* ||
*'nani 'roŋənə mə 'mirə | se 'nuku 'ja 'si tʃ(ə) 'iʃ 'moti tʃə s 'kejnə 'mesa tə
 ʃərbəniŋə 'ðənə pər t(ə) u 'jip so'ði tə-'mirə* || *pa'lepsiŋə me 'ce e'ðe pə'noninə* ||
pa'staʃ 'muarra 'kafʃə | 'nani 'kanə trakte're e'ðe ʃərbəneŋə ||

⁷ Es handelt sich um die Anfangszeilen des ersten Textes aus Sasse (1971b).

I. Unser Dorf.

Unser Dorf heißt Kaparelli. Es hat bis zu zweitausend Leute (Einwohner). Eine Stadt in der Nähe — Hauptstadt — haben sie, die Theben heißt. Es liegt in Bötien.

Poezia popullore shqiptare është studim sistematik i Lambercit, që e krahason këtë poezi me poezi popullore të huaja dhe e sheh si “parabazë” të letërsisë së shkruar shqipe, si identitet.

3. Midis Drinit dhe Vjosës – Përralla shqiptare (1922)

Maksimilian Lamberci veprën e vet “Midis Drinit e Vjosës – Përralla shqiptare” (1922) e nis me një *Hyrje*, që e artikulon përfundimin:

Mendimi i hasur shpesh, sipas të cilit popujt me letërsi të varfër kanë poezi popullore më të pasur dhe doke popullore më të virgjëra se popujt me letërsi artistike të zhvilluar, nuk është aspak i saktë.¹²

Këtë e dëshmon me letërsinë italiane, franceze, gjermane, greke të lashtë. Po letërsia shqipe? Letërsia artistike shqipe është tradicionale, merr lëndën e parë nga historia, por shfrytëzon në mënyrë origjinale formën e gjuhën e poezisë popullore. Duke u përqendruar në analizën e letërsisë po-

¹⁰ Po aty, f. 92.

¹¹ Po aty, f. 94.

¹² Maximilian Lambert, *Midis Drinit dhe Vjosës – Përralla shqiptare*. Përktheu Sokol Mici. Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2011, f. 7.

pullore, të përrallës e të gojëdhënës, autori kalon shpejt në një karakterizim të letërsisë shqipe:

Letërsinë e sotme shqiptare mund ta përmbledhësh në gjashtë treva: treva *italo-shqiptare*, letrarët e *Shkodrës*, shkrimtarët dhe poetët e *Shqipërisë së Mesme*, domethënë ata nga Tirana dhe Elbasani, treva *toske*, treva e *Korçës* dhe së fundi, letrarët e *diasporës*, ku futen shkrimtarët me kombësi shqiptare në Bukuresht, Sofje, Konstandinopol, Egjipt dhe Amerikë. Treva italo-shqiptare karakterizohet nga emrat *Variboba* dhe *de Rada*, ajo e Shkodrës nga *P. Gjergj Fishta*, në Shqipërinë e Mesme lulëzon shkolla e shkrimtarëve të filologut Kristoforidhi nga Elbasani, treva toske shquhet nga emra të tillë të shkëlqyer si *Naim Bej Frashëri* dhe *Asdreni*, ajo e Korçës nga *Mihal Grameno*, *P. Kristo Harallambi* dhe ajo e diasporës nga *Faik Bej Konica*, *Mithat Frashëri*, *Fan Noli* etj. Kjo letërsi shqiptare e re po lulëzon duke dhënë vepra me të vërtetë të mira.¹³

Lamerci i quan *treva*, e jo qarqe, qysh janë parë në interpretime të mëvonshme. Treva italo-shqiptare: *Variboba* e *De Rada*; *Shkodra*: *Gjergj Fishta*; *Shqipëria e Mesme*: *Shkolla e shkrimtarëve* e filologut Kristoforidhi; treva toske shquhet me *emra të shkëlqyer*: *Naim Bej Frashëri* e *Asdreni*; e *Korçës*: *Mihal Grameno*, *Kristo Harallambi*; e diasporës: *Faik Bej Konica*, *Mithat Frashëri*, *Fan Noli*, etj. Këtu, pra kemi gjashtë *treva*: dy geqe, dy toske, një italo-shqiptare e një diaspora. Nuk ka këtu një zhvillim karakteristik tipologjik, as kriteret për këtë karakterizim.

III. EQREM ÇABEJ (1908-1980)

1. Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe (1936)

Pjesa e dytë e librit e këtij libri shkollë quhet *Literaturë*. Autori vetë e cilëson si “një histori të shkurtët të literaturës shqipe”, e cila është pjesë integrale e literaturave të Ballkanit. Paraqitja e saj bëhet në katër kapituj: A. Shkrimtarët e vjetër; B. Shkrimtarët shqiptarë të Greqisë; C. Shkrimtarët shqiptarë të Italisë; D. Shkrimtarët e shekullit të 19 dhe të fillimit të shekullit të 20. Përfshihen autorët nga Buzuku deri te Lumo Skendo. Çabej ankohet që kritika letrare është në fazën parashkencore, sepse kritika e vërtetë

¹³ Po aty, f. 8.

duhet së pari të konstatojë. E konstatimi i tij i fillimit si dhe i fundit, është:

Literatura e jonë është shprehja më e vërtetë e shpirtit shqiptar, shprehja estetike dhe shprehja etnike.¹⁴

Përpos shënimeve për autorë e vepra Çabej këtu bën edhe cilësime e vlerësime për autorë e periudha letrare: Bogdani: “Ay është sigurisht shkrimtari shqiptar më i rëndësishëm nga sa përmendëm gjer tani”¹⁵; Mjeshtri Todhër: “Është i pari shkrimtar që u muar me idenë e një gjuhe të përbashkët shqipe”¹⁶; Gulio Variboba: “Variboba është më i vjetri poet i vërtetë i literaturës shqipe”¹⁷; De Rada: “Ay është i pari i poetëve shqiptarë të Italisë dhe idealisti më i madh i tyre”¹⁸; po te ky skicon karakteristika të romantizmit: imitimi i letërsisë popullore, subjektiviteti, lavdërimi i të shkuarës nacionale; Giuseppe Schirò: “Ay do të zëjë sigurisht e me meritë një nga vëndet e para të literaturës shqipe”¹⁹; Kristoforidhi: “Gjuha e tij do të formojë një nga bazat e gjuhës së përbashkët shqipe”²⁰; Naim Frashëri: “Naimi është, besojmë, bir i vonë i romantizmit... Naimi është një poet romantik i Ballkanit”²¹; e sipas tij karakteristikat e romantizmit: nacionalizmi, fryma religjioze, lavdërimi i të shkuarës; Çajupi: “Del se ky është poet popullor në kuptimin e vërtetë të fjalës”²²; Mjedja: “Vjershat e tij dallohen për tonin lirik të përmbajtur, për masën fisnike të tyre dhe përsosjen teknike të verbit”²³; Gjergj Fishta: “Është bërë, sidomos, me Lahutën e Malcís, përfaqësuesi më i parë i literaturës së sotme shqiptare”²⁴; Asdreni: “Është poet lirik që rron në artin e për artin e tij... Asdreni formon kalimin nga brezi i kaluar në poezinë moderne shqiptare”²⁵; Konica: “Shqipja e tij e thjeshtë dhe e kulluar u bë model për shumë shkrimtarë të tjerë.”²⁶; Noli: “kryevepra e Fan Nolit është përkthimi i veprës poetike Rubairat e Omar Kha-

¹⁴ Dr. Eqrem Çabej, **Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe**, Tiranë, 1936, f. 4.

¹⁵ Po aty, f. 29.

¹⁶ Po aty, f. 32.

¹⁷ Po aty, f. 35.

¹⁸ Po aty, f. 38.

¹⁹ Po aty, f. 43.

²⁰ Po aty, f. 45.

²¹ Po aty, f. 48.

²² Po aty, f. 49.

²³ Po aty, f. 49.

²⁴ Po aty, f. 52.

²⁵ Po aty, f. 55.

²⁶ Po aty, f. 56.

jamit”²⁷; Lumo Skendo: “Më e vlefshme për literaturën shqipe është mbledhja e novelave Hi e shpuzë”²⁸.

Çabej nuk përfshin në skicën e tij historike shkrimtarët e brezit të ri (bashkëkohës), duke u arsyetuar se janë në zhvillim e sipër të formimit të mbrendshëm!

2. Për gjenezën e literaturës shqipe (1937)

Në këtë vepër Çabej nëpërmjet metodës kulturo-historike kërkon gjenezën e literaturës shqipe. Kërkimet e shpijnë në histori e në gjeografi të vendit, që kërkojnë një tip mendësie e pastaj dhe një pikë të artikulimit të përgjithshëm kulturor. Edhe më tej, kërkimi i gjenezës së literaturës duke analizuar temat e format e letërsisë popullore. Sa i takon letërsisë së shkruar, themelori është kapitulli i fundit, në të cilin karakterizohet letërsia shqipe duke u krahasuar me letërsitë e Ballkanit. Në këtë pikë theksohen dy aksiomat: për ndikimin nga folklori e për ngjyrën politike të shkrimtarisë. Çabej në trajtesën e vet formulon nocionet: *njësi e kombit*, *njësi e vendit* e më në fund *njësi e literaturës*. Porse është i bindur që ndarja e letërsisë shqipe nuk duhet të dalë nga periodat historike por prej *qarqesh kulturore dhe letrare*, si *njësi* të formuara nga mënyra e jetës, kultura e konfesionit:

Brenda letërsisë shqipe unë shoh të jenë formuar katër qarqe kulturore e letrare: Janë këto: *Qarku katolik i Shqipërisë Veriore*, *Qarku italo-shqiptar*, *Qarku Ortodoks i Shqipërisë Jugore*, dhe së fundi *Literatura kombëtare e shekullit XIX*.²⁹

Pra, *njësia letrare* e emërtuar *qark letrar* është vazhdimësi e *qerthullit letrar* të Maksimilian Lambercit. Porse dallimi është se Çabej qarkun e katërt e emërton si qark kulturor kombëtar (nacional) në shekullin XIX, kurse Lamerci *qerthujt letrarë* i sheh tipologjikisht të gjallë e funksionale edhe në shekullin XX.

3. Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare (1945)

Ky është studimi që vazhdon *Gjenezën...* duke trajtuar letërsinë e shekullit XIX, duke krahasuar letërsitë e kontinentit për të arritur në dalli-

²⁷ Po aty, f. 57.

²⁸ Po aty, f. 58.

²⁹ Eqrem Çabej: *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1937) in **Shqiptarët midis Perëndimit e Lindjes**, Tiranë, 1994, f. 55.

min fundamental: te letërsitë e zhvilluara Romantizmi është vetëm një epokë letrare, kurse në letërsitë në Europën juglindore romantizmi është një përlindje letrare. Për pasojë, letërsia nacionale shqiptare formohet (zhvillohet) në shekullin XIX. Edhe këtu, ndonëse ruhet fryma e *njesisë* (tërësisë), kemi dy pamje të romantizmit shqiptar, duke i parë këto pamje që gërshejtojnë diçka *Ndërmjet Perëndimit e Lindjes*³⁰. Dallimet dalin në strukturat letrare, si trashëgimtare të kulturave letrare të ndryshme (të shihen lirikat e De Radës përballë lirikave të Naimit), mirëpo krejt i përbashkët, thuaja i njëjtë është statusi i poetit në shoqëri, i cili mëton të jetë prijës nacional, reformator moral, para se të jetë poet. Dhe kthimi i sërishëm i Çabejt te natyra poetike e shkrimtarisë, si cilësim që kalon përtej një epoke.

Vlera e veçantë e këtij studimi është se Çabej me të njëjtin përkushtim ritematizon gjenezën e literaturës shqipe si përqendrim të mbrendshëm dhe thekson dallimet e saja duke e krahasuar me letërsi të tjera. Kjo e bën autorin studiuesin e parë të rëndësishëm të metodës krahasimtare në letërsinë shqipe.

Një metodë e tillë studimi ai kishte shenjuar që në tekstin e tij të parë për poezinë e Lasgush Poradecit, duke i vënë në relacion origjinaren me universalen dhe individualen e trashëgiminë, tashmë në formacionin letrar të modernizmit që po lindte në letërsinë shqipe.

IV. LAMBERCI E ÇABEJ

1. Das Werden der albanischen Literatur (1943)

Maksimilian Lamberci në studimin *Das Werden der albanischen Literatur* të vitit 1943, të cilin Çabej e përkthen si Gjeneza e zhvillimi i letërsisë shqiptare, rimerr idetë e veta të mëhershme për *gjenezën e strukturën* e letërsisë shqipe. Metoda e punës së tij është një kryqim i historisë me tipologjinë e letërsisë. Në fund të skicës së tij thekson:

“Letërsia shqipe, nuk rri pezull si bisht i një letërsie të një vendi të huaj, ajo është saktësisht shqipe. Kjo i jep asaj një vend nderi midis letërsive të Ballkanit dhe historisë së përgjithshme letrare”.³¹

³⁰ Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare (1945) in **Shqiptarët midis Perëndimit e Lindjes**, Tiranë, 1994.

³¹ Maximilian Lambertz: **Das Werden der albanischen Literatur**. Përktheu Rexhep

Kjo për të theksuar autenticitetin e kësaj letërsie. Kurse studimin e nis me konstatimin përmbledhës:

“Karakteristika më e rëndësishme e zhvillimit të letërsisë shqiptare është grupimi i krijimtarisë letrare në më shumë qendra të ndryshme e krejt të pavarura ndërvete. Qerthujt letrarë të dalë prej tyre janë: 1.Qerthulli i Shqipërisë Veriore, me Shkodrën si qendër; 2.Qerthulli italo-shqiptar në Kalabri e Sicili me qendrat Spezzano Albanese, San Demetrio Corone, Palermo (Piano dei Greci); Qerthulli i Shqipërisë së Mesme (gegë-jugore), me Elbasanin, pastaj Tiranën si pikë qendrore; 4.Qerthulli i Shqipërisë së Jugut me qendrat Voskopojë, Korçë, Gjirokastrë, Frashër; 5.Qerthulli i emigracionit në Stamboll, Bukuresht, Vjenë, Kajro, Aleksandri, Boston, SHBA”.³²

Në këtë mënyrë Lamberci *Qerthullin* e bën nocion thelbësor për Gjenezën, Historinë e Tipologjinë e letërsisë shqipe, nga fillimet e saj deri në bashkëkohësi. Prandaj, edhe pse Lidhjen e Prizrenit e shenjon si ngjarje që ndan në dy kohë letërsinë e shkruar shqipe, në paraqitjen e zhvillimit të saj i detyrohet herë nocionit të vet themelor, herë vlerësimit të letërsisë nëpër kategori letrare. autori evidenton e vlerëson: Shkrimin e vjetër shqip filobiblik, nga Buzuku te Kazazi të prodhuar në Qerthullin e Shkodrës; shkrimin shqip filobiblik nga Lekë Matranga te Jul Variboba (me veprën kurorë të baladës lirike), të dalë nga qerthulli italo-shqiptar; shkrimin e Kavalitotit e Mjeshtrit Daniel, të Shqipërisë së Jugut; Qerthulli i Elbasanit, me frymëzuesin shpirtëror Konstandin Kristoforidhin, “Një nga bijtë më të talentuar e më të gjithanshëm që ka sjellë populli shqiptar deri më sot”. Njohës i dialekteve, prodhues i shkrimit biblik brilant në shqip. Puna e tij për alfabet, fjalor, gjuhë letrare është parabazë për shqipen në shkolla, për nxënien e dijes.

Në vijim Lamberci e trajton letërsinë shqipe simbas gjinive. Këngët e Kreshnikëve, me Mujin e Halilin, i sheh si tharm të epikës me bazë mitin, për të kaluar te epi më i madh artistik, *Lahuta e Malcís* e Fishtës. Këtu shfaqet dhe çështja e heroit, nga ai mitologjik, te heroit historik, Skënder-

Ismajli.

³² Maximilian Lambertz: **Das Werden der albanischen Literatur.** Përktheu Rexhep Ismajli.

beu. E tani burimet kryesore për të vijnë nga Pal Engjëlli e Marin Barleti, që do të duken në veprat epike e protoepike të N. Frashërit, Fan S. Nolit, madje Ernest Koliqit.

Lirikën e shkruar shqipe e portretin me Naim Frashërin (*Bagëti e bujqësija e Lulet e verësë*), këngët e përmallshme të Filip Shirokës, poezinë e Asdrenit, Gurakuqit, Mosit, Prennushit. Lasgush Poradecin e dallon “si lirik filozofik, me gjuhë të veçantë, i cili sjell angazhime të reja e tema origjinale”.

Rrëfimin (Novelën) e sheh të përfaqësuar me Ernest Koliqin, Lumo Skendon, Mihal Gramenon, Mitrush Kutelin, Faik Konicën, Kolë Mirditën, Vedat Kokonën, etj. Ankohet që ka pak romane të mira, porse nuk lë pa përmendur “Oxhakun” e Mihal Gramenos, “Valë mbi valë” të Anton Harapit e “Lulja e kujtimit” të Foqion Postolit, të cilin e vlerëson “një roman i vërtetë”.

Autori përfundon që Satira është dhunti e madhe e popullit shqiptar dhe nënvizon veprat e këtij lloji: në tekste të Faik Konicës, *Anzat e Parnasit e Gomari i Babatasit* të Gjergj Fishtës; *Hanko Hallën* e Ali Asllanit, komeditë satirike të Kristo Floqit, madje Musine Kokalarin me rrëfimet nga jeta e rrethit të saj *Siç më thotë nënua Plakë*.

Venerimet përfundimtare të Lambercit në këtë studim janë: letërsia është origjinale se del prej letërsisë popullore; nuk janë të mëdha ndikimet nga jashtë në këtë letërsi. Ndoshta për pasojë, drama nuk ka ndodhur ende, edhe romani duhet të mësohet ende. Pra, duhet të ketë një edukim më tepër, që merret nëpërmjet përkthimit të letërsisë së përbotshme.

Edhe në këtë studim sistematizues e vlerësues për letërsinë shqipe Maksimilian Lamerci përforcon shenjat për temat e tij të preferueshme që do të kurorëzohen me vepra të veçanta për epikën popullore shqiptare, për epopenë nacionale *Lahuta e Malcís*, për përkthimin e saj në gjermanisht dhe për trajtimin e tyre në kuadër të letërsisë kombëtare e në raporte me letërsi të tjera.

Vetë Eqrem Çabejn, do ta cilësojë: “hulumtues i dialekteve, folklorist, historian i letërsisë krahasuese”.

2. Studime gjuhësore V (1975)

Po, si e sheh Eqrem Çabej Maksimilian Lambercin në fushën e studimeve shqiptare, metodën e tij dhe rezultatet e tij.

Bashkim aq i lumtur sa edhe i rrallë gjuhëtarit, folkloristit e historianit të literaturës karakterizon veprat e këtij dijetari.³³

nënvizon Çabej duke vlerësuar veprën e Lambercit *Epika popullore e shqiptarëve*, duke ia njohur meritat “në interpretimin e poezisë nga jeta”. Në anën tjetër evidenton kërkimet e studuesit austriak në terren, studimin e kohës së lindjes së epikës, heronjtë mitologjikë, studimin e strukturës, studimin e vargut, struktura e të cilit kushtëzohet nga ekzekutimi i këngës, e në fund krahasimi me epikën e popujve të tjerë.

Eqrem Çabej mbrenda disa vitesh ka shkruar tre artikuj vlerësues, okazionalë apo përkujtimorë për Maksimilian Lambercin (në 75-vjetor, në 80 vjetor e me rastin e vdekjes së tij).³⁴ Në të gjitha rastet ai ka theksuar vlerat e studimeve të tij shqiptare në gjuhësi, në folklor e në letërsi, duke kombinuar të dhënat e etnografisë me ato të gjuhës e të literaturës, duke pranuar që “ai u ka çelur rrugën brezave të dijes së mëpastajmë”. Në fund të studimeve letrare ai vlerëson mbledhjen, analizën e përkthimin e përrallave shqiptare; mbledhjen, analizën e përkthimin e epikës popullore shqiptare; paraqitjen, studimin e përkthimin e *Lahutës së Malcís* të Gjergj Fishtës.

Mirëpo, ajo që i lidh përgjithmonë Maksimilian Lambercin e Eqrem Çabejn janë dy çështje që kanë të bëjnë me *genezën* e me *historinë* e letërsisë artistike (të shkruar) shqipe. Këtu, të dy studuesit, në periudha të ndryshme interferojnë në dijen e njëri-tjetrit. Ata duke interpretuar sikur sqarojnë pikëpamjet e tjetrit duke zhvilluar pikëpamjet e veta. Kemi këtu një dialog të pa shpallur që çon kah një pëlqim, madje edhe një pajtim.

Konceptin *Qerthull letrar* Lamberci e përmend më 1916, e kthen në vlerë karakterizuese me gjashtë njësi, më 1922; e zhvillon si koncept për gjuhën letrare, më 1917.

³³ Dr. Eqrem Çabej: **Studime gjuhësore V**, Prishtinë, 1975, f. 186.

³⁴ Po aty, ff. 173-175; ff. 176-179; ff. 180-185.

Çabej *Qarkun kulturor letrar* e bën koncept historiko-letrar duke e bërë çelës për shkrimin e historisë së literaturës shqipe, më 1937.

Po Lamberci, që problemin e kishte hetuar në vitet njëzet, e rimerr më vonë, më 1943, duke emërtuar edhe studimin e vet *Gjeneza e literaturës shqiptare*. Po këtu *qerthujt letrarë* nuk i sheh vetëm në letërsinë para shekullit 19, por të dukshëm deri në literaturën e shekullit 20.

Jehona e këtyre këmbimeve në ide ndërmjet dijetarëve plotësohet nga studiuesi e shkrimtari Ernest Koliqi, që në studimin *Poetët e mëdhej*, De Radën, Naim Frashërin e Gjergj Fishtën i sheh përfaqësues të këtyre qerthujve historikë e tipologjikë të letërsisë shqipe. Pra, skema përfshin tre krijuesit e mëdhenj të letërsisë shqipe në dy shekujt e fundit.

E thamë më parë: Lamberci i fundit ishte vetëm thellim i studimeve mbi temat që i kishte shenjuar në fillimet e tij, shpeshherë në kërkime empirike, pa i kthyer në koncepte vlerësuese e sistematizuese, madje shpesh duke i shprehur me figurë, gjuhë të figuruar. Për të dëshmuar një origjinalitet të vetin e për të dëshmuar një autoktoni të letërsisë shqipe.

Çabej i fundit, nga ana e tij, largohet nga temat letrare e gjuhësore të vetat e të Lambercit në rini, për t'u bërë vërtet trashëgimtar i mësuesit të vet, Joklit, në studimet e historisë së gjuhës shqipe e të etimologjisë shqipe. Kjo është zbritje edhe më e thellë në rrënjë, në gjenezë. Nuk dimë nëse ky që orientimi zanafillor i Çabejt, që po thellohej e zgjerohej në pjekurinë e tij, apo edhe orientim i ri për shkak të rrethanave socio-kulturore e politike në Shqipëri (Na vjen në kujtesë që Eqrem Çabej artikullin e vet të parë të botuar më 1929 e kishte për poezinë e Lasgush Poradecit, kurse pas vdekjes u pa që kishte shkruar poezi, duke mos i botuar).

Duke përfunduar mund të themi që Eqrem Çabej njohu Maksimilian Lambercin studiues gjuhe e letërsie, kurse trashëgoi Norbert Joklin në histori të gjuhës e në etimologji dhe, ç'është me rëndësi, e ktheu kurorën e studimeve gjuhësore në Shqipëri, në Tiranë e në Prishtinë.

Floresha DADO, Tiranë

FRANC NOPÇA, NGA QASJET ALBANOLOGJIKE TE KRIJIMI POETIK

Një befasi interesante: në personalitetin e albanologut të shquar shfaqen dy dhunti, që në vështrim të parë duken larg njera tjetrës, por që në strukturën shpirtërore kanë një lidhje të brendshme dhe raport specifik. Dhuntia e parë të kujton faktin e ditur, tashmë, se monarkia austro-hungareze nxori emra të njohur, që janë vlerësuar si themelues të Albanologjisë. Dhe, midis kontributeve të *Hahn, Meyer, Jokl, Bopp, Miklosich, Šufflay, Lambertz, etj.* (që nuk ishin vetëm austriakë), hungarezi Franc Nopça, që shkroi në gjermanisht, ka një fizionomi të vetën në aktivitetin albanologjik. Njihen një varg veprash të tij për çeshtje shqiptare, që i përkasin viteve nga 1907 deri 1932. Dhe është shkruar dhe folur për paleontologun, gjeologun dhe antropologun, hulumtuesin dhe udhëtarin e pasionuar ndaj njohjes së traditave dhe maleve të Shqipërisë. (Kontributet e veçanta në përcaktimin e meritave studimore të tij i përkasin studiuesit R.Elsie, por edhe të tjerë). Në strukturën e mendimit të këtij shkencëtari ka një kompleksitet fushash, ku preken çeshtje të kulturës materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve, ku bie në sy më shumë karakteri njohës-informues, por edhe ndonjë përpjekje për tipologjizim të dukurive. Shkencëtari i metropolit ndërton një marrëdhënie të veçantë me ‘ishujt kulturorë’ të Shqipërisë, që mund të themi se në përgjithësi është kontakti me një botë të mbyllur.

Në vështrim tërësor studimet e albanologëve të huaj janë karakterizuar nga dy lloj qasjesh: *himnizuese*, me nota nostalgjike ndaj një realiteti të veçuar në llojin e vet, dhe qasja *kritike*, e kushtëzuar më shumë nga shkalla e njohjes dhe objektivitetit paksa ekstrem. Nopça i përket asaj kategorie studiuesish që rendën tek terreni malor shqiptar me admirim, me pasionin e përballimit të rreziqeve të udhëtimeve, të pasigurisë me të panjohurën apo dhe me armiqësitë e qarqeve të ndryshme. Në këtë takim apasionant aspekti më i vështirë ishte ruajtja e ekuilibrit midis realitetit dhe përjetimit vetiak, interpretimi sa më i vërtetë i një botë të panjohur dhe

komplekse shqiptare.

Por sa **është real ky ekuilibër** ? Njohja e një dhuntie tjetër shpjegon pikërisht këtë raport. Nga qasjet e shumta të karakterit *albanologjik* vjen një Franc tjetër, ai i *imagjinatës artistike*, i ndjeshmërisë së thellë, i përjetimeve sa romantike, aq edhe dramatike. Dhe, nëse që në fillim shtrova pyetjen se sa këto dy dhunti, që duken larg njëra tjetrës, janë bashkë në strukturën e brendshme të mendimit dhe shpirtit, është e domosdoshme të kuptojmë se *sa* dhe *si* vëzhgimi i shkencëtarit reflektohet në imagjinatën, vizionin artistik të tij.

Një cikël poezish, të lëna dorëshkrim, u zbuluan për herë të parë nga prof. A. Kostallari në Seksionin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Kombëtare të Vjenës në 1964. Vëllimi me vjersha, në gjermanisht, mban titullin ‘Po-ezi’ të Kolec Markut (“GEDICHTE” 1895-1932..) Kostallari jep disa shpjegime mbi këtë pseudonim dhe gjen argumente për të provuar se autori është vetë albanologu Franc Nopça. Referuar edhe disa dorëshkrimeve që ruheshin në Bibliotekën Kombëtare, fakteve historike, disa veçorive të leksikut të poezive, Kostallari pohon: ‘Nopça ka marrë si pseudonim letrar pikërisht emrin e këtij miku malësor që e quan ‘kreshnik trim, ‘shqype malit’. Autori i zbulimit jep një informacion të shkurtër mbi gjashtë pjesët që përbëjnë vëllimin poetik “GEDICHTE“, me gjithsej 167 vjersha dhe 105 faqe të daktilografuara, (pjesa e parë titullohet *Lirika*; pjesa e dytë *Në Karpate*; pjesa e tretë *Philosophie*; pjesa e katërt *Tregime të shkurtra* ; pjesa e pestë *Nga Shqipëria* dhe pjesa e gjashtë *Tregime të gjata*) si dhe bëhet një farë interpretimi mbi rrethanat e krijimit dhe njohjen e realitetit malësor prej F. Nopçës.

Por mbeti e hapur dhe e pavlerësuar njohja e kësaj bote poetike, përcaktimi i **raportit të saj me përvojën e studiuesit** vëzhgues dhe hulumtues të kujdesshëm, por edhe romantik që rend pas lirisë. Vëllimin mund ta vështronim edhe në një qasje tjetër: cikli me poezi kushtuar Shqipërisë (22 vjersha) dhe cikli tjetër i përgjithshëm (145 vjersha), ku mbizotëron problematika morale-filozofike. E përbashkët për të dy ciklet është poeti i pakënaqur dhe në kundërvënie me realitetin e kohës, i etur për një botë të lirë dhe në kërkim të qetësisë shpirtërore. Po të ndjekim strukturën kuptimore dy ciklet kanë një marrëdhënie të brendshme : poezitë që i kushtohen Shqi-

përisë duket sikur japin përgjigje për shqetësimet e ciklit të dytë, për të pohuar, tërthorazi, se pikërisht në malet e Shqipërisë së veriut mund të gjindet rehatia shpirtërore për çeshtje që i përkasin ciklit të përgjithshëm. Kjo lidhje e brendshme sigurisht ka kuptimin e vet : nga njera anë aktiviteti shkencor i Nopçës, admirimi për virtytet dhe trimërinë e malësorit janë rrjedhim i hulumtimeve dhe njohjeve në terren. Në këtë rast kemi studiuesin. Nga ana tjetër përfytyrimi dhe vizioni poetik i poezive kushtuar Shqipërisë vjen si ndikim instiktiv i *shkencëtarit tek poeti*. Nuk është fjala thjesht për të njëjtat tema që i përkasin etnokulturës së disa zonave të malësive dhe që Nopça i trajton në studimet e shumta albanologjike, por për atë ndjenjë të përbashkët ngazëllyese që pluskon si në studimet e tij, ashtu edhe drejtpërdrejtë në poezitë. Lidhet poezia me paleontologun, gjeologun, imazhi i arkeologut vjen në një vizion poetik, duke e bërë objektin të lëvizshëm... “*Nga errësira e parahistorisë / Ku çdo gur-libër shkëlqen / Me shkëndija stoliplote. ...Eja e shih kuçedra të vjetra, / Eja e shih botën e vjetër! / Se si sende të çuditshme, të tmerrshme / Lëvizin, të shëmtuara prej vdekjes.* (përkthimet e poezive janë bërë nga A. Kostallari)

Po të ndjekim **strukturën e brendshme** të ciklit kushtuar Shqipërisë mund të dallojmë katër tematika themelore:

1. **Nisja** për në zonat malore, për të gjetur një realitet të ri, motiv që tingëllon si i poetëve romantikë (*Udh’e mbarë, o botë, udh’e mbarë, o lavdi/Udh’e mbarë ju figura të gënjeshtërtë/ udh’e mbarë , ju dijetarë të rregjuar, / udh’e mbarë, ju forca të parasë....Ju nuk më mbani dot më këtu ...Nuk ma ndaloni dot lumturinë e jetës sime “Udh’e mbarë, o botë!”*)

2. **Zbulimi**, entuziasmi i përballjes me një botë tjetër, sa të ashpër aq edhe të lirë. (*Kështu, pra, nuk u gënjeva, / Kështu, pra, bëra mirë./Nuk gënjenen yjet, / Në udhën e tyre të lartë. Dhe përsëri : Po vezullojnë gurët e bardhë/ Kaq të heshtur, kaq të largët, kaq të zhveshur./Unë e ndjej vehten kaq të qetë/ Vetëm në vendin që kam zgjedhur vetë. “Atdheu im“).*

3. **Identifikimi** i poetit me figura malësorësh të admirueshëm prej tij. Kjo prijë shfaqet që në zgjedhjen e pseudonimit për autor të vëllimit poetik, por dhe në momente të tjera.

4. **Lamtumira**, parandjenja e largimit që do të ndodhte me fundin tragjik të zgjedhur prej vetë atij. (*Hijet po bien më të gjata / Dielli po merr*

një ngjyrë të kuqe / Po afrohet perëndimi / Po afrohet errësira, vdekja.
 “Kënga e Kalorësit“).

Ç’lloj poeti njohim në vëllimin e F.Nopçes ?

Sigurisht **romantik** tipik, i pakënaqur nga realiteti i kohës, me dëshirën për t’u larguar në një “atdhe të dytë”, ku mund të gjente qetësi shpirtërore, madje duke pranuar edhe një jetë bohemi në gjirin e natyrës. (*Ngjyrra ledhatare, tinguj të mahnitshëm, / Stolisin humnerat, ngjiten të bukura / Përpyjetë shkëmbit dhe malit / Në mes gjith’atyre luleve plot njomësi.* “Malli për Jugun”).

Poet i **lirisë** që shpërthen: “Bota për mua është e vogël / “Shpirti im fluturon drejt diellit”.

Poet i **peisazhit**: shumë vargje sjellin edhe ngjyrrat të poezisë impresioniste, krijojnë vizionin e pikturës, duke rindërtuar imazhe të asaj bote që shpirti i tij i trazuar kërkonte...

Poet i një **lirizmi** të jashtëzakonshëm në dy poezitë kushtuar *Këngës*, ku poeti e ndjen se “*Kënga e vajtimit e poetit lirik / kur ngrihet lart/ atëhere është zë bubullime.../ Ajo është britma e zemrës së njeriut; / një përbindësh e dëgjon dhe dridhet prej saj.*”

Poet i **meditimit filozofik**, që kapërren ngjyrimet e reales për të shprehur marrëdhënien e tij me botën, duke përcjellë imazhe dhe përjetime që kanë një hapësirë, rrokje të gjerë të botës njerëzore. Në këtë cikël është gati e vështirë të bësh një herarki vlerash; ndjeshmëria mplekset kaq thellë me meditimin filozofik,

Këto tipare poetike dëshmojnë se studiuesi i apasionuar, udhëtari i maleve të ashpra mbante brenda vetes një ndjeshmëri të thellë, aftësi për të shkruar dhimbjet apo gëzimet e tij me përmasa më universale.

Si është **raporti me realitetin** ? Lidhje jo miqësore. Kontrasti qëndron në themel të kësaj marrëdhënieje. Poezia nuk ngrihet mbi faktin, por mbi dallimin. Zhgënjim për një botë ku “po zhduket pasuria e lirisë”, ku mbizotëron gënjeshtria dhe etja për para. Poeti ikën vetë por kërkon që edhe kjo botë duhet të ikë. Shpresë se brezat e ardhshëm do ta kuptojnë zgjedhjen e tij “*Unë e ndjej veten kaq të qetë / Vetëm në vendin që kam zgjedhur vetë.* (Vendi i arritjes). “*Unë po nisem për në Shqipëri / Te populli heroik*

me ndjenja lirie ! / Atje vlen burri, atje vlen trimëria / Atje akoma vlen fjala për besë e mirësi.” (Kënga e shtegtarit).

Marrëdhënia me shqiptarin: “Ju përshëndes, tek ju janë akoma / Miqësitë më të forta se jeta dhe vdekja”. Besoj se poezia “*Vendi im përballor*” përbën imazhin dhe përjetimin më poetik të Nopçës poet, besoj se kemi një perlë të mendimit dhe e adhurimit të një realiteti tjetër, që përshkon gjithë ciklin kushtuar Shqipërisë, të cilin e quan ‘*vendi im*’.

Raporti me vetveten ? Dihet fundi tragjik i F.Nopçës. Mund të ketë hamendje të ndryshme për shpjegimin e këtij fakti, por mendoj se poezia e ka shprehur më mirë marrëdhënien e ndërlikuar që ky studiues i shquar kishte me vetveten. Bëhet interesante vargu ku ai pohon se “*Fjala që më del me vrull nga zemra / Është vetëm dhimbja ime, që mbetet e pashuar*”. Sidomos poezitë e ciklit të përgjithshëm, që unë e quaj të problematikës kryesisht filozofike, zbulojnë një trazim të brendshëm shpirtëror, një përleshje ndjenjash, të vetëdijshme por dhe instiktive. Ajo çka ai shpreh hapur në vargje ka një burim të brendshëm, të pavetëdijshëm, ka një çekuilibër shpirtëror dhe të instikteve seksuale, ka diçka që ai vetë nuk mund ta shpjegonte, por që psikanaliza na hap rrugën e interpretimit. Identifikimi i vetes me figura malësorësh, imagjinata që i jep dëshirën dhe besimin se mbas vdekjes do t’i takojë ata, etj., vetë fakti real i marrëdhënieve seksuale me shqiptarin, të cilin e vrau para se të vriste veten, etj. janë raporte të ndërlikuara që dashur pa dashur poezia e tij provokon për interpretim. Nëse i referohemi psikanalizës mund të thoshim që tek Nopca fjala, figura, ndjenja poetike shprehin edhe të pavetëdijshmen, instiktin e brendshëm. Ky aspekt mund t’i jepte shpjegim edhe fundit tragjik, të zgjedhur prej vetë tij. Metafora (“Kënga e kalorësit”) paralajmëron se ‘*rruga është e gjatë, por ajo nuk shpie në shtëpi*’ Apo: “*Dielli po merr një ngjyrë të kuqe? Po afrohet përëndimi / Po afrohet errësira, vdekja*”. Ose vargjet : “*Figura të errta nga vendi i vdekjes / Mbi botë po përhapen*” “*dëgjova me ëndje zërin e kukuvajkës*” ...Çfarë po përgatitej në botën e tij të brendshme ? Duket i qetë fundi tragjik, por poezia dëshmon se turbulenca të brendshme ishin brenda tij, që gradualisht duket sikur qetësohen, për ta cuar poetin qetësisht drejt akteve tragjike.

Interpretimi i këtij vëllimi poetik është i befasishtëm : *së pari*, sepse

F.Nopça njihet si albanolog i shquar dhe papritur biem në kontakt me poezitë e ij. *Së dyti*, nuk është një poezi e zakonshme, por reflektim i një botë shpirtërore të ndjeshme dhe imazhi të fuqishëm poetik. Nëse studimet albanologjike të tij dëshmojnë një mendje të mprehtë, aftësi kërkimi dhe përgjithësimi, poezia befason për një shpirt të vuajtur, por të lirë. Këto dy fusha të krijimtarisë kanë marrëdhënie të tillë ku e para ndikon te e dyta, e dyta i jep ngjyrë më njerëzore të parës. Shkencëtari dhe poeti krijojnë një sinergji, që e bën Franc Nopçën një figurë tepër komplekse, përtej qasjeve të mirëfillta albanologjike.

Bashkim KUÇUKU, Tiranë

BOTIMET DHE KRITIKA GJERMANE PËR VEPRËN E KADARESË

Receptimi i veprave të Ismail Kadarese në gjermanisht, ka filluar më 1971 me tregimin e famshëm *Karvani i ferexheve/Sjellësi i ftaqeqësisë*, në një përmbledhje prozash¹ me disa autorë të njohur botërisht Jasunari Kavabata, Alberto Moravia, Rejmond Keno, etj., duke shënuar, kështu, një periudhë kohore afërsisht një gjysëm shekulli. Në skajin e mbramë të kësaj periudhe, më 2016, në shitje ishin 17 tituj, pa përfshirë antologjitë dhe revistat në të cilat ka tregime, poezi dhe ese të tij.²

Ky tregim për tjetërsimin me dhunë ligjore të identitetit, i vlerësuar nga kritikë të ndryshëm në 13 shkrime, me cilësime të tilla ”*histori brilante*”, *përngjason me Vargjet Satanike të Salman Ruzhdiut*, “*metaforë me forcë magjike*”, është ribotuar edhe katër herë të tjera, së fundi, më 2015, në përmbledhje më vete së bashku me *Komisioni i festës* dhe *Breznitë e Hankonatëve*. Me përrurimin nëpërmjet një tregimi është thyer skema e përgjithshme e përhapjes së veprave të tij, që, në shumë gjuhë të tjera ka filluar befasisht me jehonë të madhe me *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*. Ka mundësi të jetë botuar nën ndikimin e kësaj jehone një vit më parë në Francë, sepse, më 1973, romani del në gjermanisht, i përkthyer, pikërisht, prej frëngjishtes. Më vonë, sikurse dihet, është përkthyer nga shqipja prej Oda

¹ *Konvolut 10 Spektrum Bücher*: 1. *Tausend Kraniche*, prosa; 2. *In der schönsten Stad der Welt*, erzählungen *Alle Volk und Welt*, Berlin, 1971. Autorët e përfshirë: Yasunari Kawabata, Tadeusz Rozewicz, Sewer Gansowski, J. Bernlef, Alberto Moravia, Ismail Kadare (*Die Schleierkarawane*, erzählungen), Grigori Baklanow, Michail Rostschin, Raymond Queneau/ *Komplet me 10 libra Spektrum*: 1. *Mijëra krilla*. Prozë; 2. *Në qytetin më të bukur të botës*. Tregime, *Alle Volk und Welt*, Berlin 1971. Autorët e përfshirë: Jasunari Kavabata, Tadeush Rozeviç, Sever Gansovski, J. Bernlef, Alberto Moravia, Ismail Kadare (*Karvani i ferexheve/Sjellësi i fatqeqësisë*, tregim), Grigori Baklanou, Mikhail Rostçin, Reymond Këno.

² Informacion, i shpërndarë, në Tiranë, nga përkthyesi i veprës së tij, z. Joachim Röhm, në 80 vjetorin e lindjes së shkrimtarit.

Buchholz dhe Wilfried Fiedler.

Politika dhe marrëdhëniet kulturore midis Gjermanisë dhe Shqipërisë, në vitet 1970-1980, kanë ndikuar dukshëm, një herë, në ngadalësinë, dhe, herën tjetër në shpeshtësinë e botimeve, dukuri, që nuk vërehet, bie fjala, në përkthimin në frëngjisht. Në klimën e ftohtë politike dhe kulturore mes dy vendeve botimet kanë qenë fare të pakta. Deri më 1986, përveç *Karvanit të ferexheve/ Sjellësi i fatkeqësisë*, ishte botuar vetëm *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, në Duseldorf (1973), në Gjermaninë Perëndimore, dhe, në Berlin (1977), në Gjermaninë Lindore. Më 1981, gazetari Kristian Schmid Hoier, në artikullin *Shkrimtari më i suksesshëm shqiptar për herë të parë në Panairin e Librit*, tërheq vëmendjen për mospërkthimin e Kadaresë në gjermanisht, ndërkohë, që, në Francë, thekson ai, kanë dalë të gjithë romanet e tij më të rëndësishëm: “*Vizita e parë e Ismail Kadaresë në Republikën Federale të Gjermanisë*, pohon Hoier, *përmban një mesazh të heshtur. Tirana thekson gatishmërinë e saj të matur për zgjerimin e shkallëshkallshëm të marrëdhënieve kulturore dhe shkencore me Evropën Perëndimore. Në shkëmbimet midis Republikës Federale të Gjermanisë dhe të Shqipërisë deri tani ka shumë vend djerr, siç tregon pikërisht shembulli i Kadaresë. Kështu, në Francë janë botuar të gjitha romanet më të rëndësishme të shkrimtarit sot për sot më të suksesshëm shqiptar, ndërsa në Republikën Federale të Gjermanisë është botuar vetëm romani i tij i parë Gjenerali i ushtrisë së vdekur (Claussen, 1973, përkthyer nga versioni – frëngjisht).*³

Kritika do të ketë edhe herë të tjera për vonesën e përkthimeve. “*Dy duzina të mira romanesh, shkruan Rainer Shmic, dhe një numër i madh tregimesh janë përkthyer në më tepër se njëzet gjuhë dhe në më tepër se dy milionë kopje kudo nëpër botë, por vetëm tani, kandidati i Çmimit Nobel... po zbulohet edhe në Gjermani.*”⁴

Më 1990 kishin arritur 7 tituj në 16 botime. Pas *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dolën *Dimri i madh*, përmbledhja me proza *Karvani i ferexheve/ Sjellësi i fatkeqësisë*, *Kështjella*, *Kronikë në gur*, *Prilli i thyer*, *Kamarja e*

³ Bashkim Kuçuku *Kadare në gjuhët e botës*, botim i tretë, *Onufri*, Tiranë, 2015, faqe 428; *Die Zeit*, nr. 43, 16 tetor 1981.

⁴ Po aty, faqe 465; *Süddeutsche Zeitung*, (1991?).

turpit/Pashallëqet e mëdha, disa me ribotime. Me lejimin e pluralizmit në Shqipëri, përhapja e tyre është jashtë hijes së ndikimit politik. Në këtë ndërkohë kanë dalë botimet më të shumta, 49, me 16 tituj. Kemi mundur të njëjtësojmë gjithsej 65 botime në 23 tituj. Gjermanishtja është gjuha e tretë e huaj pas frëngjishtes dhe anglishtes, dhe, në një përmasë shtrirjeje me italishten.

Mirëpritje më të madhe kanë pasur: *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* me 8 botime, *Prilli i thyer 6*, *Dimri i madh*, *Kështjella*, *Kronikë në gur*, *Kamarja e turpit*, *Ura me tri harqe* nga 4 botime, *Pallati i Ëndrrave 3*. Ndryshe nga në hapësirën frankofone, që kanë dalë nga dy-tri shtëpi botuese ndër më të mëdhatë, të përqëndruara në Paris, në hapësirën gjermanofone ka një gjeografi përhapjeje nëpërmjet disa qyteteve, qendra kulturore të rëndësishme: Frankfurt, Mynih, Kiel (Gjermani), Salzburg-Vjenë (Austri), Zyrih (Zvicër), e përcaktuar, ndoshta, edhe nga struktura kulturore e qarkullimit të librit në të.

Kritika gjermanofone për nga shumësia e shkrimeve, origjinalizmi dhe thellësia e analizave është e dyta pas kritikës frankofone. Kemi mundur të njëjtësojmë dhe të kemi në dosjen vetjake afërsisht 300 (290) shkrime të llojeve të ndryshme, ndër to edhe 11 intervista dhe 10 shkrime prej Ismail Kadaresë. Në kumtesë kemi parasysh vetëm disa syresh të viteve 1981-1992, që është periudhë e shënuar me mbarësi për botimet dhe përcjelljen e tyre tek lexuesi.

Jo rrallë në to ka sintetiza në shkallare të epërme: *Një kryevepër nga Shqipëria (Kronikë në gur)*; *ngjyrë mbi një njollë të bardhë*. Njolla e bardhë është Shqipëria, pa asgjë të dallueshme në hartën botërore, ndërsa, librat e Kadaresë e ngjyrosin në mënyrë intensive në hartën shpirtërore; *mrekullia te ndërthurja e traditës me modernen*; *punë në caqet e marrëzisë*; *pak autorë të krahasueshëm me të*; *të kujton fare mirë dritën gjithkund depërtuese të Homerit*; *një kandidat për Çmimin Nobel vërteton emrin e tij*.

Kritikja Anjez Hyfner tërthorazi shpreh mosbesimin, që ka ndërjet për vlerësimin ndërkombëtar ende pa e njohur veprën e Kadaresë. Për ta rrezuar paraparakisht këtë mosbesim me pasoja në qasjen ndaj saj, vë përballë Shqipërinë, në atë kohë e mbyllur në vetvete, ngjarjet historike, që nuk u interesojnë të tjerëve dhe rëndësinë, që marrin ato në penën kada-

reane, duke u shndërruar në letërsi botërore. “Në vështrim të parë, shpjegon ajo, vlerësimi ndërkombëtar i autorit mund të të çuditë, sepse Kadareja shkruan kryekëput vetëm për Shqipërinë. Por ato ngjarje që s’i a vlen t’u hedhësh sytë në anë të botës, ai i shndërron në letërsi botërore.”⁵

Për një tjetër, ajo është shembull i letërsisë së mirëfilltë. Tema të fuqishme historike, realizëm, formë letrare me nerv delikat dhe forcë magjike, lidhje e tërësisë së figurave orientale dhe e miteve të vendit të vet me traditat prozaike më të mira europiane. Perspektivat, që ndryshojnë me kthesa të forta shpalosin një thellësi plastike dhe një pasuri të madhe metaforike.

Nuk mungojnë raste që i a kundërvënë atë kulturës perëndimore, të cilësuar individualiste, e cila, sipas një kritiku, duket e mangët, krahasuar me morinë e vëllimeve të tij me proza. Gjetkë përdoret vetëm *Kronikë në gur*, për t’ia kundërvënë letërsisë së skandaleve, e cila, ndryshe nga ky roman që lexohet me endje, në 17 vjetët që kanë kaluar nga botimi i tij në shqip, nuk ka lënë gjurmë.

Emanuel Larohe në shkrimin *Një kandidat për Çmimin Nobel vërteton emrin e tij*, (1988), nisur nga mendimi zotërues, i njohësve të mirë dhe ekspertëve, që i veshin me kënaqësi famën që sjell me vete Çmimi Nobel, me analizën e tij të argumentuar, arrin në të njëjtin përfundimin. Së pari, nxjerr në pah funksionin e veprës nëpërmjet së cilës letërsia shqipe ka fituar vendin e pavarur në hartën e letërsisë botërore. Vlerësimin e lexuesit shqiptar ka pasur rast ta shikojë me sytë e vet. “Këtë, pohon ai, e dëshmuar në mënyrë mbresëlënëse shqiptarët e shumtë nga Kosova, të cilët para një viti ishin ulur plot respekt në sallën, ku për herë të parë u shfaq në Cyrih Kadareja.”⁶

Pavarësisht mendimit të përgjithshëm, Emanuel Larohe, në rolin e recenzentit, merr në shqyrtim romanet *Dimri i madh*, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe *Kronikë në gur*, për t’i u përgjigjur vet pyetjes, në se vepra e tij është e këtij niveli. Mbresa për *Dimri i madh* është kontradiktore. Nga njëra anë, e vlerëson, se është i konceptuar me përmasa epike, që zhvendos mitin e Davidit dhe të Goliatit plot ngjyra dhe në mënyrë palstike në histo-

⁵ Po aty, faqe 446; *Deutsches allgemeines Sontagsblatt*, 17. 03. 1989.

⁶ Po aty, *Tages Anzeiger*, 5 tetor, 1988, faqe 440.

rinë e kohës, me një përzjerje ambicioze të realitetit me fantazinë, dhe, nga ana tjetër, e kritikon, se ka rënie të pandërprera në nivelin e një gjuhe të thjeshtë të një komunikate partie, të cilat e vënë në dyshim të qenët e tij një pretendent serioz i Çmimit Nobel.

Reputacionin e Kadaresë si kandidat i fshehtë i Çmimit Nobel e lidh me romanin e tij të parë *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, i cili edhe pas një çerek shekulli të botimit në shqip, lë mbresa të thella e të pashlyeshme. Historia e rrëfyer, cilësohet e ndërtuar si ato prej mozaiku të gdhendur në gur në një tempull, që në ashpërsinë dhe në qartësinë e vet mbart pothuajse peshën e një tragjedie antike. Prej tragjedisë antike krahasimi kalon në artin modern. Në roman, vëren, që, sundon një dritë si në ndonjë film të Angelopulosit. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* është një nga librat më të fuqishëm kundër luftës, sepse ai nuk trajton luftën, por vdekjen. Me të, sikurse shprehet, recenztetit *iu desh të pranonte se fama e autorit ekziston me të drejtë.*

I mbërthyer nga ky virus epik, lexoi *Kronikë në gur*, një nga portretet më madhështore letrare të një qyteti, me të cilin u bind plotësisht për vërtetësinë e famës, që kërkon të provojë. Te qyteti prej guri gjen arsyen e stërlashtë mitike të ekzistencës brenda së cilës protagonistët janë si një kor antik në skenë. Dhe, përsëri habitet nga tipari aspak anticizant i antikitetit, që, në këtë rast, duket se nuk i ka kaluar koha. Rrëfimi në trajta të ndryshme, sipas tij, është lojë e këmbimit të realitetit me mitin, ironisë me poezinë, përzjerje e legjendës me faktet.” Shkrimi përmbillet me vlerësimin sintetizues: “*Me të vërtetë letërsi madhështore, tha në fund recenztenti. Ai nuk do të çuditej më, në se në tridhjetë vjetët e ardhshëm një shqiptar do të merrte Çmimin Nobel.*”

Për *Kronikë në gur* ka, gjithashtu, shumë shkrime dhe njoftime prej të cilave kemi në dorë 38. Kritikë të tjerë janë shprehur me përcaktime të larta: aftësia e madhe rrëfyese e Kadaresë, pohon një prej tyre, që të hedhë dritë në një sipërmarrje jashtëzakonisht delikate nga brendësia e miteve, në mënyrën më madhështore i a ka dalë mbanë te *Kronikë në gur*, një kryevepër e letërsisë së sotme evropiane, e cila është njëherazi edhe një libër magjie e magjepsjesh, edhe një kronikë e përndjekjes dhe e qëndresës. Një tjetri, mënyra e të rrëfyerit në të cilën ndërthuret historikja me mitiken, politika me bestytinë popullore i përngjason me letërsinë latino amerikane.

Prej romaneve, që kanë ngjallur interesim të madh është edhe *Koncert në fund të dimrit* për të cilin kemi në dorë 14 shkrime dhe njoftime. Edhe në Gjermani, në disa raste, vepra të Kadaresë janë pranëvënë, ose, krahasuar me të Kafkas. Alfred Paul Shmidin e ka shtyrë në një pranëvënie të tillë, pikërisht, ky roman, që “*ashtu si shumë nga veprat më të mira pas Kafkas, është një kontribut për të kuptuar profetin.*”⁷

Guido Stefani nxjerr më në pah ironinë therëse për një aparat zyrtar, që e quan tipik kafkian, i cili qëndron në këmbë falë frikës dhe përgjimit të ndërsjellë. Anton Kretli, duke pasur parasysht *Koncert në fund të dimrit*, artin e Kadaresë, që e shndërron historinë në përrallë dhe në dicka mitike jo për ta zbukuruar, por për ta bërë më të qartë, ku *tragjika dhe farsa mbajnë ekuilibrin* e cilëson të papërsëritshëm.⁸

Këndvështrimi i shtrirë prej Shqipërisë në Kinë, ndërthurja e dy botëve kaq të ndryshme dhe në disa rrafshë, jeta private, puna shoqërore në industrinë e rëndë, mendësi të punonjësve kinezë dhe të kryetarit Mao, etj., me që është vështirë të gjenden në letërsinë bashkëkohore, e shpie kritikun larg, ta përqaasë me *Lufta dhe paqja* i Tolstoit. Krahas admirimit, të shprehur për arritjen, çmohet si përtëritje e zhanrit, duke e ngritur vlerën e tij në shkallaren e përgjithshme të letërsisë europiane. Romani afresk duket se i përket së kaluarës. *Koncert në fund të dimrit* e përgënjeshton këtë përshlytje. Mënyra se si Kadareja lidh individualen me të përgjithshmen, pohohet në shkrim, përligj dhe mbështet përtëritjen e tij.

Numri më i madh i shkrimeve kritike, që kemi në dosje, 52, është për *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*.

Sipas ish ambasadorit të Shqipërisë në Gjermani, Bashkim Zeneli, në librin *Për Gjermaninë*, histori diplomatike dhe kujtime,⁹ Kadareja është shumë i njohur dhe shumë i vlerësuar, po ashtu, edhe nga politikanë të nivelit të lartë, disa prej të cilëve i përmend me emër, duke shënuar edhe thënie të tyre.

“*Ju keni një shkrimtar të shquar si Ismail Kadare, ka thënë ish kan-*

⁷ Po aty, **Der Standard-Album**, Vjenë, 04. 10. 1991, faqe 455.

⁸ Po aty, **Schweizer Monatshefte**, mars, 1992, faqe 459.

⁹ Bashkim Zeneli, **Për Gjermaninë**, histori diplomatike dhe kujtime, UETPRESS, Tiranë, 2015, faqe 369.

celari erudit, Helmut Shmidt. *Unë kam lexuar libra të tij. Janë të mrekullueshëm.*¹⁰

Një nga figurat e njohura të politikës në Bavari, zonja Stamm i është shprehur: *“Unë kam lexuar edhe Ismail Kadarenë... Ne kemi përkthyer di-sa libra të tij. Një shkrimtar shumë i madh.”*¹¹

Me rëndësi të veçantë është mendimi i shkrimtarit nobelist, Gunter Gras: *“Kadare është një shkrimtar i madh, shumë i njohur... ne flasim për të në rrethet tona.”*¹²

Ndërsa shqetësimi, zemërimi i tij për letrën e përgatitur nga ambasadori i Shqipërisë (Kokalari, 1994) në Suedi, drejtuar Jurisë për mos t'i dhënë Kadaresë Çmimin Nobel mbetet një gjest i rrallë dashamirësie e një shkrimtari të madh ndaj një kolegu të tij, të cilin e çmon, pavarësisht se me të nuk është takuar asnjëherë. Nga biseda e tij me ish ambasadorin, po citojmë frazën për punën që bëjnë shtetet e qytetëruara për të fituar atë çmim shkrimtarët dhe shkencëtarët e tyre. *“Unë nuk dua ta besoj këtë... E dini pse? Sepse shtetet punojnë shumë, me të gjitha mënyrat, për të mbështetur kandidatët e tyre... Më thuaj tani, zoti ambasador, a mundet një shtet ta bëjë këtë?”*¹³

Natyrisht, janë dy qëndrime të skajshme, që burojnë nga mendësi të kundërta për marrëdhëniet me kulturën, identitetin dhe vetveten.

Përfundim: Botimet dhe kritika gjermane me besueshmërinë, forcën argumentuese kanë qenë ndër më ndikueset në rritjen e reputacionit të Ismail Kadaresë dhe përhapjen e mëtejshme të veprave të tij.

BIBLIOGRAFI, SHËNIME:

* Proza të tij janë zgjedhur edhe në një antologji tjetër. **Fünfundzwanzig und eine: 26 geschichten für kurze tage und lange Nächte** von Anna Seghers (autor), Ismail

¹⁰ *Shekulli, 28 janar, 2016.*

¹¹ Bashkim Zeneli, **Për Gjermaninë**, histori dipolmatike dhe kujtime, UETPRESS, Tiranë, 2015, faqe 369.

¹² Bashkim Zeneli, **Për Gjermaninë**, histori diplomatike dhe kujtime, UETPRESS, Tiranë, 2015, faqe 536.

¹³ Bashkim Zeneli, **Për Gjermaninë**, histori diplomatike dhe kujtime, UETPRESS, Tiranë, 2015, faqe 536.

Kadare (autor), Bertold Breht (autor), Franz Kafka (autor), Kerstin Ekman (autor) Piper Verlag, München, 1999/ **Njëzetë e pesë dhe një: 26 rrëfime për ditë të shkurtra e netë të gjata** nga Ana Seger, (autore), Ismail Kadare (autor), Bertold Breht (autor), Franz Kafka (autor), Kerstin Ekman (autor). Lidhje e thjeshtë: 570 faqe, Shtëpia Botuese Piper, Mynih, 1999.

- * Po ashtu, është edhe në librin: Georg Kaster, **Brücken nach Osteuropa: Die geschichte und bedeutung des Gottfried von Herder-Preises 1964-2003**. Albanien... oder die Ukraine: Ismail Kadare, Juri Andruchowysch. Verlag Alfred Toepfer- Stiftung, 2004. Broschiert: 450 seiten. /Georg Kastner, **Ura drejt Evropës Lindore: Historia dhe rëndësia e çmimit Gottfried fon Herder, 1964-2003**. Lidhje e thjeshtë: 405 faqe. Shqipëria ... ose Ukraina: Ismail Kadare, Juri Andrushoviç, Shtëpia Botuese *Fondacioni Alfred Topfer*, 2004. Lidhje e thjeshtë: 405 faqe.

Kujtim M. SHALA, Prishtinë

IPSE ET IDEM

(Diskurset identitare të Krist Malokit)

I

Dijetari i njohur, Pol Riker (Ricoeur), me termat *ipse* e *idem*,¹ kur shpjegon *veten si një tjetër*, shenjon ndarjen e *identitetit* si individualitet, si një bërthamë e pashprehur që na bën *ne (ipse)*, derisa *idem* shenjon identitetin e identifikueshëm e të manifestuar jashtë. Në terma të tjerë, *ipse* është i identifikueshëm me “kush”, ndërsa *idem* me “çfarë” jam. Nga ky shenjim i përqendruar, kuptojmë se Riker flet për identitetin në dy pamje, të lidhur me të njëjtin *subjekt*. Kështu që ne mund të përfaqësohemi përmjet “*kush*” jam apo “*çfarë*” jam.

Në rastin e Krist Malokit, le të na lejohet një *skajim* në shkallë shumë më të reduktuar i *ipse-s* e *idem-it*, qoftë dhe për të provuar *ipse-n* tonë përballë *idem-it* teorik të Rikerit, por edhe në frymën e metodës së Malokit, e cila përherë ka parasysh objektin e saj të kërkimit, për t’u *skajuar* vetë. Kështu, *ipse-ja* shenjon *veten*, madje *vetjen*, e autentiken, të provuara si le-tërsi, kulturë e jetë e gjallë (*varianti*), qoftë edhe e trashëguar, ndërsa *idem-i* - universalen, të përbashkëtën e *invariantit*. Pra, në rastin e Malokit kemi të bëjmë me *ipse-n* e *idem-in* që reflekton *diskursi* i tij, duke e parë *identitetin* të lidhur me *diskursin*, madje të identifikueshëm me të, meqë ai është një njeri i dijes e i kulturës, fusha në të cilat identiteti ndërtohet, provohet e manifestohet në *trajtë diskursi*. Ndërsa, kur *ipse* e *idem* lidhen me temat e diskurseve të Malokit, nën këta terma lexohet *shqiptari* si individum (*ipse*) e jeta e tij në sociumin shqiptar autentik, si përbashkësi e manifestuar (*idem*), pastaj lakohet si kulturë e si ideologji e kthyer në politikë, ndërsa të gjitha këto shenja, të lidhura e të përqendruara, i merr dhe i shfaq metoda kërkimore e Malokit.

¹ Paul Ricoeur, *Oneself as Another*, The University of Chicago Press, Chicago, 1992.

Të lexuar përmjet *ipse-s* e *idem-it*, apo si *ipse* e *idem*, *diskurset* e Malokit hapen si një vepër e kërkimit idenitar, si ideologji e skicuar e *shqiptarizmës*, plot shenja polemike që diskursi i tij i merr nga debati bashkëkohor për *kombin* e për *shtetin*, për përkatësinë orientale apo oksidentale të shqiptarëve, d.m.th. për identitetin, për letërsinë e për Poetin nacional. Debati e polemika e kthejnë *diskursin* e Malokit me fytyrë kah përdorimi, ndërsa dija e konceptualiteti e hapin origjinën filozofike të tij. E para do të shenjojë probleme, ndoshta edhe zgjidhje, ndërsa e dyta e provon unversalitetin e çështjeve e të diskursit të tij.

II

Krist Maloki është dijetar i kulturës dhe i letërsisë, i shenjuar nga idetë (e tij) kulturore, nga mësimet për jetën shqiptare e për kërkimet letërore, por, së pari, nga sistematika e metodës së kërkimit, sidomos në fushën e letërsisë. Metoda e Malokit ka shenjat e teorisë historike-kulturore gjermane, të poetikës, të estetikës e të psikanalizës, e cila, përfundimisht, kthehet në lexim tematik të teksteve të lidhura me jetën psikologjike të autorëve, me karakterin e kërkuar e me sjelljen e provuar. Metoda e tillë do durim e lidhet në diskurs të përdendruar, kurse këto shenja japin ide të përqendruara. Ndërsa, në fushën e kërkimit kulturor e sociologjik, Maloki mëson nga filozofia e i jep asaj *rastet shqiptare*, si një *ipse* të manifestimit të fenomeneve të *psiké-së* e të jetës së gjallë *kombëtare*.

Kur lexohen bashkë, *diskurset* e Malokit zbulojnë se ai kërkon tema të përafërta në jetë, në kulturë e në letërsi dhe vetë kthehet në lexues sistematik të jetës autenike shqiptare, të *skajuar* si jetë e *kombit*, që provohet e lidhur më së miri në Kanunin e Lekë Dukagjinit, si kod i thënë e i dhënë me gojë dhe i marrë me besë. Vetë Kanuni shenjon *ipse-n* e *idem-in* shqiptar, të artikulluar si *ide shqiptare*, e cila karakterizohet nga *besa*, *nderi* e *burrnia*, veti që nuk treten kurrë e që kthehen në *invariante* të jetës kombëtare të shqiptarëve. Këto kategori nuk kanë nuanca ideologjike e politike, por hapen si kategori antropologjike, tipike për *shqiptarët kombëtarë*. *Ideja shqiptare* e Malokit nuk është projekt politik, por esencë e jetës autentike që ruhet e trashëgohet në *psiké-në* e në jetën shqiptare, ndërsa si *diskurs* e ruan Kanuni.

Këto shenja duken tepër klasike përballë metodës së Malokit, por

vetë kryqëzimi i psikanalizës, që shpërbën, me historinë kulturore, që do të japë përvojën, e shenjojnë profilin dituror të tij. Madje, vetë ideja e jetës autentike dhe e trashëgimisë, si bazament i jetës së re, bëhet provë për metodën që kap tema klasike në modernitet.

Në rrafsh idesh, Maloki na mëson se jeta autentike nuk buron nga ideologjia e nga politika e nacionit, por nga *shpirti shqiptar*, i manifestuar në *idenë shiptare*, lidhur me *besë, nder e burrní*. Kështu, dijetari ynë shenjon veti që nuk i tret kalesa e që ruhen kur njeriu e jeton jetën e vet autentike, d.m.th. jetën së brendshmi, si *ipse*, e si bashku me të tjerë, si *idem*. Ndërsa, këto shenja i sinjifikojnë diskurset e Malokit në trajtë kërkimesh identitare.

Kur e lidhim diskursin për metodën e Malokit, *skajojmë* se vetë puna e tij është një *ipse* me kategori të universale (metodës) dhe se universalja e bën të duket më shumë *ipse*-n, ashtu siç ideologjia nacionale e atdhetarisë bën të duket më shumë jeta autentike (kombëtare).

Në diskursin e kritikës letrare të Malokit, metoda lakohet në tekste të vëna përballë *psiké*-së së autorëve, Naim Fashërit e Lasgush Poradecit, por gjithnjë si diskurs për Poetin kombëtar, për Heroin e kulturës e të literaturës (*Dichter*), si autor që merr në vepër *psiké*-në (shpirtin) e jetën autentike të kombit, të lidhur me vendin historik e me shenjat autentike të tij. Kështu, nuk mjaftojnë Naimi (universal) e Poradeci (personal), e lexohen duke u nënkuptuar Fishta përballë tyre, e Maloki pyet *A asht herò Gjergj Fishta?* e, përfundimisht, përgjigjet *E me gjith atë: Gjergj Fishta asht hero.*²

Kështu, leximi i teksteve përballë *psiké*-së së autorit, çon te kërkimi i shenjave të idesë shqiptare në veprat letrare, si kategori që shenjon kombin, prandaj edhe Poetin kombëtar, vepra e të cilit ka bazë etnike e etike autentike, të lidhur me jetën e gjallë e të trashëguar, me të gjitha virtytet e saj, të ruajtura e të trashëguara, d.m.th. të përhershme.

III

Malokin, dijetar e polemist, e përfshin vrulli i debatit shqiptar për *veten*, në vitet e Republikës e të Monarkisë shqiptare, epokë e shenjuar nga debati e nga përplasjet. Vërtet, ky debat Malokin e shoqëroi tërë jetën, qof-

² Krist Maloki, *Refleksione*, Faik Konica, Prishtinë, 2006, ff. 94-106.

të edhe kur pyeti *A asht heró Gjergj Fishta?*. Debati kishte parabazë politike, por u kthye në *diskurs kulturor*, u hap dhe u shpërhap, derisa u rrudh sërish në ide politike e të lidhura me situata të caktuara. Maloki niset nga situata konkrete politike e sociale dhe do të provojë përkohësinë e tyre përmjet diskursit dituror të filozofisë e të kulturës. Ndërsa, ideja themelore e shenjon shpëtimin kombëtar përmjet kultivimit të autenikes, të një *ipse-je* të veçantë shqiptare, e cila ruhet përbrenda e kërkon të manifestohet në jetën e përbashkët, të strukturuar politikisht. Politikja ka shenjat e urbanes e të modernitet, ndërsa autentikja të përhershmerive etnike, të cilat duhet të bëhen vlerë edhe e brezit të modernitetit. Ideja e etnisë, e thënë si ide e shqiptarizms, si *ide shqiptare*, është kategoria që do ta shpëtojë kombin, sepse ajo është bërthama e kombit. Ndërsa, determinohet e manifestohet përmjet *besës, nderit e burrnisë*, si veti të jetës autentike shqiptare. Kombi është në rrezik, thërret Maloki. Por, kombin do ta shpëtojë *ideologjia e vërtetë* e “*Shqiptarizms*” reale,³ e lidhur në *Idenë shqiptare*.

E shenjuar përmjet *besës, nderit e burrnisë, ideja shqiptare*, si praktikë, manifestohet te Kanuni i Lekë Dukagjinit, “n’amanetin ma të ndritshëm të shpirtit shqiptar”,⁴ ndërsa si *diskurs libri - Kanuni i Lekë Dukagjinit* (1933) i Át Shtjefën Gjeçovit.

Por, si *skajohen* këto veti të jetës autentike etnike, të kthyera në kategori të diskursit të Malokit?

Besa, një fjalë e shkurtër dhe e thjeshtë, “pasqyron naltësinë morale-etike të shpirtit shqiptar. (...) Kur thoshin dikur të Parët tonë besa! apor për besë! ishin gati me i ba ballë çdo zori a rreziku, madje edhe me lanë shëndet e jetë, me u shkimë me plang e shtëpi e me u shue me farë e fis... për mos me e çartë atë besën e vet të shkretë”.⁵ Ndërsa, nderi apo ndera, në diskursin shpjegues të Malokit, ka një “kuptim individualist dhe një kuptim fort të hollë kolektivist. ‘Dy gisht nder në lule të ballit na i njiti Zoti i Madh’ thotë Kanuni i Lekë Dukagjinit. Dhe kjo ndjesi në lule të ballit të shqiptarit të vërtetë nuk drejtohet vetëm kah miklimi i krenarisë vetiake, porse paraqet edhe një element të flaktë shpirtnuer ndër lidhjet familiare, shoqnore e kombëtare - trashigimtare. Ndjesi e Nderit e ka ba shqiptarin (e

³ Po aty, f. 129.

⁴ Po aty, f. 139.

⁵ Po aty, ff.139-140.

vërtetë!) me i mbetë aq besnik dokeve e zakoneve dhe gjuhës amtare. Nderi shqiptar e ka ba arbnorin me i ruejtë aq besnikisht amanetet e të Parëve të vet.⁶ Po, kush ka *besë* e *nder*, ka *burrní*. Kështu mbyllet treshja që determinon *idenë shqiptare* e mësimi i Malokit për djelmëninë që do ta shpëtojë kombin. Jetë me *besë*, *nder* e *burrní*, si në jetën autentike shqiptare, si në faqet e *Kanunit...*, për të shpëtuar kombin. Kjo është një ideologji etnike, autentike, që do të zhvendosë idelogjitë politike moderne e ta rregullojë jetën kombëtare përtej skemave që jep politika e mësuar. Kështu, Maloki e propozon ideologjinë etnike tejkohore, si ideologji politike (edhe kohore), që shqiptarët t'i shpëtojë e t'i mbajë bashkë si komb edhe sot, edhe nesër. Kjo ideologji duhet të mësohet e të jetësohet. Mësimin e japin kujtesa e jeta e gjallë autentike e shqiptarëve, ndërsa si *dikurs* e ruan dhe e thotë *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Vërtet, ky është një mësim moral, madje vetë është një moral(izim).

I lexuar sot, diskursi i Malokit kthehet në mësim për jetën e për kulturën autentike shqiptare, kur probemi shqiptar nuk është zgjidhur e ndoshta nuk është i zgjidhshëm, kur shqiptarët jetojnë si *nacione* (popuj shtetërorë) e jo si komb (“volk”), ndoshta edhe për të matur *idenë shqiptare* sot.

IV

Oriental apor oksidental? është një nga pyetjet e mëdha të epokës së Malokit, para tij e shtruar në trajtën *Pleq apo të rinj?*. Vetë Maloki e ktheu në diskutim tipik identitar, kur i rimori nga fillimi diskutet mbi këtë temë. Maloki lucid shenjon se në Shqipëri ky debat nuk mund të bëhet si çështje brezash, por ka orientale e oksidentale, pavarësisht moshave. Kështu, orientale e oksidentale është *tipologji identitare*, me bazë kulturën e sjelljes, përtej moshës së njeriut. Kultura e tillë e reflekton *ipse-n* si *idem*, kur nga individët e lidhur konstituohet klasa apo tipi: *orientale* apo *oksidentalë*. Sepse, *ipse-ja* është ndjenjë për veten, ndërsa *idem-i* manifestim i vetes *përtej*, në kontekste. Kështu, tipologjia e Malokit lidhet në dy shfaqje (*idem*) shqiptare, me origjinë kulturën e sjelljes, si *orientale* e si *oksidentalë*.

Por, çfarë e bën shqiptarin *oriental* e çfarë *oksidental*?

Kjo është pyetja themelore, sepse kështu provohet tipologjia identi-

⁶ Po aty, f. 140.

tare. Maloki saktëson se oksidentalë e evropianë nuk është e njëjta gjë, meqë ka sa të duash evropianë që sillen si orientalë. Kështu, shenjohet baza identitare kulturore e tipologjisë së Malokit. Kjo tipologji kërkon të saktësojmë se Maloki e projektton dhe e karakterizon *orinetalizmën* shqiptare si mendësi destruktive e botëkuptim errësire, ndërsa *oksidentalizmën* si mendësi krijuese e botëkuptim drite. *Oksidentalizma*, përballë *orientalizmës*, nuk është çështje brezi, por çështje mendësie e botëkuptimi. Si mendësi e botëkuptim, me vetitë themelore, Maloki i vë përballë, si shenja të shqiptarit. Kështu, *orientalizma shqiptare* është “sistem mendimesh, ndjenjash edhe instiktësh, si çdo sistem tjetër jeteset, me një botëkuptim dhe filozofi të tijën”.⁷ Por, çfarë e konstituon këtë sistem? Orientali shqiptar do të arrijë gjërat pa mund (“qelepir”), të përdorë çdo mjet, qejf e lezet të botës, në çdo mënyrë e metodë, pa pyetur asnjëherë. Ai nuk e njih sakrificën. Jeta tij është jetë “ushijze”, e cila i ngjitet trupit dhe ia pi gjakun. Pra, orientali nuk krijon e nuk prodhon, por vetëm merr e shpenzon. Kjo e bën atë “kryenalt” e “kapadai”, madje “ma qejflí... dhe i bje karadyzenit”.⁸ Orientali shqiptar, në diskursin karakterizues të Malokit, nuk njih turp e marrë, “Shet bab’ e nanë, dín e imán, besën e nderin e vet, per mos me thanë: shpirtin e trupin e vet; vetëm e përvetëm që t’i shkojë kungulli mbi uj, vetëm që mos t’i prishen telat e karadyzenit”.⁹ Ndërsa, idealet e tij janë “kolltuku” e “llokma” dhe, që t’i ketë e t’i mbajë, ai përdor çdo mjet, “bâhet, kur e do nevoja edhe patriot e tradhtar, monarkist e bolshevik, përparimtar e reaksionar... e bile edhe shok i fortë me të tjerë”.¹⁰ Në shpirt ai është rrënimtar e destruktiv, ai bashkohet me të tjerët si “ujq që vehen së bashku në pre... porse edhe si njata ujq që e shkyjn shokun e vet kur dobsohet apo plagoset udhës”.¹¹ Atdheu i tij është vendi ku ai ha, “jo sepse e don, por sepse e shfytëzon”.¹² Me këto veti, orientalët shqiptarë janë ndër pleq e ndër të rinj.

Në këtë pikë, Maloki e ndjen të nevojshme të sqarojë se është gabim të mendohet që *orientalizma shqiptare* ka ardhur së pari nga Azia apo për-

⁷ Po aty, f. 153.

⁸ Po aty.

⁹ Po aty, ff. 153-154.

¹⁰ Po aty, f. 154.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

mjet religjionit muhameden, apo dhe përmjet popullit turk, meqë ajo është një “dhanti (= darovë) fatale e kristianizmit, me gjithë që e njeh kristianizmi euro-aziatik...”.¹³ Me ndarjen e Bizantit nga Perandoria romake, në kohën e Leonit III (Izauri), shqiptarët u detyruan të ndahen nga Kisha romake (okcidentale) dhe të hyjnë nën Kishën bizantine (orientale). Maloki nënvizon se *skizma kishtare*, megjithatë, nuk ishte faktore sa administrata bizantine, “plot angh e myk”.¹⁴ Kështu, *orientalizmi historik* është njëlloj me *orientalizmen shqiptare* dhe “Shqiptari i shkret ja ka thith langun njasaj bizantinizme shkatrrimtare mrena 12 shekujve të kaluem - qysh nga vjeti 740 - dhe është kalbë dalëngadalë në trup e në shpirt të vet, tuj iu shprishë këso-dore fuqitë e tija më fisnike kolektive-kombëtare.”¹⁵ Përballë e para *bizantinizms*, Maloki nënvizon se shqiptari ka qenë kolektivist e universalist, “ka pasë një dashtni të pervelueme dhe një besim të pafund ndaj Zotit e qiellit e tokës, ndaj vendit dhe trashigimin e të Parëve dhe ndaj vllaznit e vet shqiptarë. Vala e nxehtë kolektiviste-aristokratike dhe drita e flakët politike-filozofike që dridhin edhe sot ner amanetet e pluhunosuna të Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe ner sa e sa tradita malsore-shqiptare na lanë me kuptue naltsin shpirtnore dhe heroizmen vetflijuese të të Parëve tonë dikur”.¹⁶ Gjithë kjo u tret nga “helmi shkatrrues i bizantinizms”.¹⁷ Kjo ndodhi, meqë qoftë në raportet sociale, d.m.th. në raportet e shqiptarit me shqiptarin, apo në rrafshin politik, të raportit të shqiptarit me shtetin, “u fut e u përhap spirita bizantine si një epidemi rrënimtare dhe e deformoi karakterin e drejt të shqiptarit në një bollë amorfe e sisfingore.”¹⁸

Ndërsa, *oksidantalizma shqiptare* vështirë *skajohet*, meqë Maloki i sheh aq larg shqiptarët nga *oksidantalizma*, shoqëruar nga keqkuptimi se çfarë ajo përbën, kur ndër shqiptarë identifikohet me aparençën. Maloki mëson se oksidentalizmi është kryekreje puna e kryer me nder, me përkushtim e me solidaritet, lidhur për një ideal të përgjithshëm, d.m.th. për një dobi të përgjithshme. Vetë Maloki *skajon*: “oksidantalizma e vertetë diftohet piksëpari në kryemjen e një detyre të ndershme - fund e maje për hater

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty, f. 155.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

t'asaj detyre dhe pa me qenë i shtym nga zori, nga ndonjë dëshirë i prujtun apo nga shkelqimi i ndonjë fitimi materjal. Bilë okcidentalit i vertet karakterizohet neper menyren se si aj i ngarkon vetes - fare vetdashas - detyrë të randa, jashta detyrëve ordinare e të domosdoshme. Heroizëm s'kerkohet prej askujt, porse lartësia morale rreth një ideje së naltë... rreth një ideje që s'ka punë me kolltuke, me llokme e me meashe..."¹⁹ Ndërsa, veti thelbësore një oksidental e ka dhimbjen e mëshirën kundrejt çdo qenieje në ngushticë, "sidomos kundret çdo njeriu fatmjer, kundrejt çdo populli varfanjak... e mâ së forti kundrejt kombit të vet në rrezik."²⁰ Maloki lidh diskursin mbi vetitë e oksidentalizmit, kur atë e identifikon me kryerjen në tërësi të një detyre "të pershtatshme shejtnisht me vetflijimin per një idé të naltë shoqnore..."²¹; ndërsa ilustron me shembullin e shqiptarëve: "Nga kjo pikëpamje është mâ okcidental xhandari shqiptar i detyrës, ushtari biles i rojes kufitare dhe bulku i shkretë dhjetarak... sesa nëpunësi e zyrtari i kafehaneve me një çarçaf diplome 'bon pour l'Orinet'"²² Maloki shenjon se është gabim pretendimi që shkolla evropiane të bën oksidental medoemos, madje jo të gjithë evropianët janë kulturalisht oksidentalë. Ndonjëherë "ngjanë edhe n'Evropë që shumë herë diploma universitare paraqet vetëm një qyrk deleje okcidenteale mbi trup të një ujku oriental!..."²³ e mbyll Maloki *mësimin* e tij mbi orientalizmin e provuar e oksidentalizmin e kërkuar.

V

Ideologjia etnike e politike e Malokit hapet tek eseja e tij e njohur *Shteti apor kombi*, në një diskurs kategorial që njeh përcaktimin politik të kategorisë *shtet* dhe *kombin* si "kaptim" etnik, "një totalitet ashtetnot", shoqëruar nga shpjegimi që "ashtetnor" nuk d.m.th. "antishtetnor".²⁴ E hapet me mësimin fillestar e klasik që shteti nuk është kombi dhe se shteti shqiptar ndryshon qind për qind nga kombi shqiptar.

¹⁹ Po aty, ff. 156-157.

²⁰ Po aty, f. 157.

²¹ Po aty, f. 158.

²² Po aty, 158.

²³ Po aty, f. 159.

²⁴ Po aty, f.115.

Në termat e Rikerit, por me ngarkesën ontologjike e semantike që propozuam, shteti është kategori e përbashkësisë, e përjashtësisë, d.m.th. *idem*, ndërsa kombi një *ipse*, me veti të vetat, autenike, të trashëgueshme e të papërsëritshme ndër kombe të tjera, meqë e papërsëritshme është baza etnike e tij. Në këto shenja, Maloki e njuh kombin si një *kaptim* që nuk mund të thjeshtëzohet, përngjasueshëm me jetën, njeriun, Zotin²⁵ dhe se kombi është “njí ndjesi që vlonë nder zemrat e një grumbulli njerëzish që e përbajnë at komb... një ndjesi që: ose është ose s’është... që s’mund të blehet, as të shitet, as të merret me qirá...”.²⁶

Mësimi i Malokit për kombin të çon tek autorët gjermanë, të cilët *kombin* e krahasojnë me *natyrën*, në “përfytyrime” që kombet i mendojnë si livadhe, fusha, male etj., secili me natyrën që ia ka dhënë Zoti dhe me një qëllim historik të caktuar, për të cilin edhe ekziston. Duket si një teleologji historike, të cilën e mban natyra e kombit e për të cilin ai ekziston. Teleologjia e tillë, e lidhur me natyrën apo me “shpirtin objektiv” hegelian të kombit, i diferencon kombet. Kështu, Maloki vijon diskursin për diferencat ndërmjet *skajeve* shtet e komb, edhe si përjashtim të shtetit demokratiko-liberal, si një universalje e pretenduar, apo edhe të shtetit nacional, por jo-kombëtar.²⁷ Nacioni është një kategori politike me bazë shtetin, që jo në të gjitha rastet identifikohet me kombin, ndërsa kombi është kategori me bazë etninë, të cilën Maloki nuk e mendon si kategori politike, por si esencë autentike që shtrihet e që jeton përtej shtetit dhe politikisht mund ta përmbajë vetëm shteti kombëtar. Vërejmë atitudat etike e kulturore të Malokit për kombin, përballë atyre politike të shtetit, të cilin e mendon si një organizim krejt formal, d.m.th. krejt politik, pa përfshirje të plotë të kombit, pa njohur shpirtin e tij dhe pa një “kaptim” kulturor. Ai mendon se shteti demokratik liberal apo shteti nacional jo-kombëtar nuk mund të themelohen në çdo vend, në çdo tokë, meqë janë organizime formale politike pa përfshirje të kombit. Në diskursin që *skajon* përfundimisht, Maloki e njuh shtetin apo nacionin si organizim politik, ndërsa kombin si lidhje etnike. Nacioni është *përbashkësi politike*, ndërsa kombi *përveçësi etnike*.

Kombi i skajuar kështu lidh personat përmjet gjakut, fisit e më fort

²⁵ Po aty.

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty, f. 116.

përmjet botëshikimit e botëkuptimit, që kanë për bazë ndjenjat e jo sistemet e mendimit politik, ndërsa *nacioni* ka për bazë lidhje interesi politik apo ekonomik, përtej bazës etnike. Maloki gjykon kështu kur do të mësojë shqiptarët e jeton me austriakët. Vërtet, vetë austriakët janë nacion apo komb? Në shenjat e Malokit, ata *skajohen* si nacion, si lidhje politike e si konstrukcion. Vetë Maloki, kur do të shpjegojë më tej për shqiptarët, nënvizon se “nacioni francez”²⁸ kurrë nuk ka qenë komb dhe se ai përbëhet nga më shumë se tetë lloje kombesh, krejt të ndryshëm ndërmjet vete, të lidhur politikisht e si një shoqëri “sui generis”²⁹ e jo për nga ndjenjat. Kjo shoqëri shtrihet në kufijtë francezë, lidh bashkë shtetasit francezë, ndërsa ai që nuk është shtetas francez, nuk është as francez. Kështu, Maloki e shenjon mendimin e tij si diskurs identitar, si diskurs përkatësie, meqë *komb* e *nacion* janë *skajime* identitare, i pari për të shenjuar lidhje e identitet politik, ndërsa i dyti - identitet etnik.

Maloki ekuivalentin e *skajit* komb e gjen vetëm te *skaji* “volk” i gjermanëve, prandaj shqipja e kthen “nacionin” në popull shtetëror, ndërsa “volk”-un në komb. Nacioni ose populli shtetëror është populli i organizuar e kombi është njësia e lidhur nga gjaku. Nga kjo diferencë e thellë identitare duket që edhe shteti shqiptar organizohet në qytetet e Shqipërisë, në të cilat “ka infiltrue gjaku i huej e sidomos gjaku oriental qindra e qindra vjetësh”,³⁰ ndërsa në malësitë shqiptare “vlon e rrjedh edhe gjaku i patrazuem shqiptar” e autoriteti shtetëror funksionon vetëm përmjet forcës. Qytetet lidhen si organizime politike (*urbana*), ndërsa malësitë janë organizime fisi e etnie (*authentica*). Këtu diskursi i pashpallur për *ipse-n* e për *idem-in* merr nuanca më të thella e na çon te pretendimi i shpallur i *shpirtit* dhe i *idesë shqiptare*, si kategoritë identitare etnike të shqiptarëve dikur e sot. Por, Maloki e di që këto kategori nuk jetojnë përmjet rrëfimeve e duhet të kultivohen që të ruhen; kjo është pika themelore e ideologjisë identitare, d.m.th. shqiptare të Malokit: *ideja shqiptare*, e përvijuar përmjet *besës, nderit e burrnisë*, duhet të kultivohet sot, që shqiptari të jetë edhe sot.

VI

²⁸ Po aty, f. 119.

²⁹ Po aty, f. 120.

³⁰ Po aty, f. 124.

Në diskurset identitare të Malokit, Poeti kombëtar, *Dichter* apo *Vates*, është Hero i kulturës dhe përshkruhet me kategorinë e *të rëndësishmes*, ndërsa si përfaqësues i vetive etnike, të frymës së trashëguar, kthehet në figurë përfaqësuese. Kështu, *Poeti* shenjon e përfaqëson *ipse-n* e *idem-im* kombëtar në letërsi e në kulturë.

Poeti i përshkruar kështu, është figurë identitare e diskursi për të – diskurs identitar. Vepra e Poetit mban koloritin e vendit, shpirtin e etnisë dhe me këto shenja identifikohet dhe është e identifikueshme ajo.

Në këtë frymë, diskursi i Malokit për Poetin kombëtar gjjen te Naim Frashëri një autor universal e te Poradeci një poet personal. I pari vonë e zbulon etninë e kombin si ideologji e përkatësi, ndërsa botëkuptimi i tij shkon përtej *ipse-s kombëtare*, te një *idem universal* e të një totalitetit ontologjik. *Besë, nder e burrní* e bëjnë *Idenë shqiptare*, ndërsa vepra e Naimit lidhet për mirësinë universale të njeriut, si moralitet e si qeniesim. Poradeci këndon në pikën e frymëzimit, me figurat personale të mallit, dhimbjes e të dashurisë, në përgjithësime tipike për personalen që bëhet universale, meqë: “- Laskushi nuk ka shkruar deri më sot asnjë vjershë, në të cilën mund t’u shifshë dojë ideë e kristalizueme nga jeta, nga dëshiret, andrimet, shpresat, brëngat dhe sidomos nga botëshikimet (*Weltbetrachtungen*) e Kombit Shqiptar”.³¹ Përballë rri Fishta, me *Lahutën e Malcís* (1937), si vepër të koloritit e të mendësisë shqiptare, plot ashpërsi e ekstreme, aventura e humbje, me malësorë, që Maloki i mendon si shqiptarë tipikë, të cilët jetën e lidhin dhe e mbyllin me *besë, nder e burrní*.

Vërtet, Maloki do së pari koloritin shqiptar të novelave të Ernest Koliqit e lavdet i ka për të, për luftëtarin në fushë idealesh, deri vonë në jetë, te poezia *Ernesto!*, kur më nuk e njeh për *Dichter*, por për tregtar dhe lavdin e kthen në nemë shqiptare: *Të vrafte Zoti!* Poezia është e vonë dhe e lënë në dorëshkrim, si një reflektim nga fillimi apo si observim i përrjeshëm i çështjes së Poetit në letërsi e në kulturë. Trajta poetike, me të cilën shtrohet kjo çështje themelore diskursive e Malokit, e provon kapërcimin e saj nga një çështje e provës, në çështje të figurës e të emocionit. Prandaj, Maloki flet pa ndërmjetësim, me figurat e tij të zhgënjimit e me emocionin e tij të humbjes.

³¹ Po aty, f. 67.

Krist Maloki

ERNESTO!

*Ti dikur ishe poet e vjershetar
E ma fort ti ishe "Dichter"...
Dhe rinija shqiptare t'adhuronte
E lumnonte me ty,*

*Sepse ti ishe luftarak
Dhe ishe flamurtar ner sfera idealesh...
Porse Orët e liga të verbuene
E t'i moren mend para kohe,
E shtojzavallet t'a kputne fijen e jetes hyjnore...*

*Ti sot m'je harlis mbas nishanesh,
Je ekselence e zâmadh nder karjera...
Porse zâni yt u bâ tyt
E ftyra e jote u zbé...
E aty ku ishe kumonare
Po shamatosen kukuvajkat e sorrat,
E aty ku m'ishe faltore
U bane figure simahore,
E aty ku ishe flamurtar -
U bane tregtar
Të vraftë Zoti.³²*

Poezia e lexuar këtu, na kthen te Fishta, te teksti përkujtimor i Malokit për të, në 20-vjetorin e vdekjes. Ndërsa, vetë Maloki, 20 vjet pas shkuarjes së Gjergj Fishtës, kujton e citon *kamptimin Hero*, të lidhur me historinë kombëtare (etnike) me veprën e frymës kombëtare. Përballë *skajimit* të tillë, Maloki pyet *A asht herò Gjergj Fishta?* e vetë përgjigjet; edhe Po, edhe Jo.

Kur e çekim kët fjalë a kët kaptim (notion, nozione) "herò" e kemi menden ma fort te analizat shkencëtare të një gjermani (...), i cili i quen

³² Po aty, f. 247.

hero ata njerz që kan lëshue kushtrime perveluese mbrenda kombit të vet e që kan njallë nepër vepra të ndryshme ner zemrat e kombit një shpresë të ré dhe një hov dynamik drejt një fati ma të mirë dhe ma me lumësi. Historija e një kombi a populli mund të quehet vetëm atëherë histori e vertetë - kështu e percakton historjo-filozofi i madh ingliz Arnold Toynbee - kur ajo lëshon herë mbas here thirrreje kushtritare (challenge) dhe i shtrëngon misat e kombit me i-u gjegjë (to answer) asajë thirrjeje me veprime rranjë-sore ndryshimi e perparimi. E këtu ndërhyt roli e misjoni i herout. Aj duhet t'i kuptoj konstelacionet e hyjve të fatit të kombit dhe aj duhet t'i prijë popullit dhe generacioneve të reja drejt cakut e qokut të rri. Herou - si mbas Hildebrand-it - e ka zotësinë me hy ner fellësinat e shpirtit të kombit, me i veshgue aty mirë e mirë kundrimet, ndjenjat, shpresat e nevojat jetike të tija dhe me i qitë ato mandej në dritë dhe me i paraqitë me forma të pershtatshme dhe hovdhanëse. Kësodore herou percaktohet hulumtues e zbulues i perendijshëm i visareve dhe amanetete kombëtare dhe kështu aj e udhëheqë kombin e vet si falltar (Vates), prijs e shpetimtar (Heros) drejt një ardhmenije ma fatlume.

*E kështu tash na del perpara pyetja: A ka qenë edhe Fishta h e r o? Shique nen driten e analizave të gjermanit Hildebrand dhe t'inglizit Toynbee, deri në njëfarë vendi PO, por deri më njëfarë vendi edhe JO. Po kuptohemi!*³³

Vetë Maloki e njej Fishtën Hero, meqë ai, gjatë gjithë jetës, ka gjurmuar vetitë e shpirtit shqiptar dhe vepra e tij i mban ato, të përfuara përmjet habitës së zbulimit e të pasurisë që le pa mend. Kjo habi bën që vepra t'i japë vetitë, d.m.th. trashëgimitë si “grumbullim ma fort belbëzimesh se sa brohoritjesh”.³⁴ Por, pyetja e çon dijetarin te kërkimi i veprës pragmatike të Fishtës, te Fishta si prijës tipik publik. Prandaj, Maloki pyet e përgjigjet se *E pse Gjergj Fishta s'ka qenë herò?* Në diskursin e tillë, Fishta nuk u bë drejtuesi i brezit të ri në thyerjet e mëdha, madje ai nuk u përfshi kur të rinjtë po kërkonin kohën e rrugën e re të kombit.

Me terma të tillë, Maloki do që *ipse*-ja shqiptare e veprës së Fishtës të kthehet në një *idem politik* të shqiptarëve, krey paradoksale për një dijetar që dallon e që përball kombin (etnik) e nacionin (politik).

³³ Po aty, f. 97.

³⁴ Po aty.

Po pse, megjithatë *Gjegj Fishta asht hero?* Se “Gjegj Fishta ka lëshue dritë nepër njato fellësina, nepër njato mystere të Kombit t’onë: aj na ka kasnecue mbi Marash Utsin e të birt e Tsalit, mbi Oso Kuken, Ded Gjo Lulin e sa e sa heroa tjerë të Kombit t’onë”.³⁵ Heroi (i kulturës) është kasneci i vetive, i shpirtit të kombit, i idesë shqiptare, të lidhur si *besë*, *nder* e *burrni* shqiptare, ashtu çfarë e ka dhe e jep vepra e Fishtës, së pari e më së thelli *Lahuta e Malcís*.

VII

Në diskursin e tij, Maloki shtroi para brezit të ri të shqiptarëve njëqind pyetje, të cilat, vërtet, janë njëqind çështje, të lidhura me jetën, identitetin, kulturën e me organizimin politik. Kur i hapim sot, mësojmë sa pak përgjigje kemi dhënë edhe sot. Përgjigjet që kërkojnë këto çështje do të skiconin kulturën autentike e kulturën e sjelljes së shqiptarëve në situatat bashkëkohore, ashtu që të kthehen në mësim ideologjik, të lidhur si *ide shqiptare*.

Maloki pyeti rëndshëm edhe:

Ç’do m.th. “*komb*”, ç’do m.th. “*nacion*”, ç’do m.th. “*popull*” shqiptar?

Pse ndryshon bujku Kosovar aq fort me atë të Shqipnisë së këndejshe?

Ku qëndron ndryshimi ndërmjet *Gegëve*, *Toskëve* dhe *Kosovarëve*; në dialekt vetëm apor edhe ndër cilësina (jo: Dasina) shpirtërore?

Pse i okupon problemi social ma fort *Toskët* se *Gegët*?

Pse ka ma tepër bamirësa (filantropë) në Toskëni se në Gegëni?

Pse kthejnë emigrantat e Gegnisë kaq rrallë nder vende të veta?

Pse paraqesin Shkodra e Korça dy pole civilizatore - qytetare të botës shqiptare?

A ka shqiptari ma fort ndjenja kolektiviteti, apor individualiteti?

Si kuptohet shpirti thjesht demokratik në Kanunin e Lekë Dukagjinit?

A asht bajraktari shqiptar një “*primus inter pares*”, apor një “*Führer*”?

³⁵ Po aty, f. 106.

Si kuptohet fjala e ushtarëve shqiptarë para Katerinës së Madhe në Rusi: “*Na jemi të gjithë kapedana?*”

A drejtohet shqiptari - ndër punë politike - ma fort mbas parimesh apor mbas personash?

A i shtrohet shqiptari mbarështrimit publik ma tepër nga arsyeja, apor nga zori?

Si mujten me u drejtue aq mirë politikisht - (vetëm me Kanunin e Lekë Dukagjinit) - malësinat tona, gjatë sa e sa shekujsh, pa ushtri, policë e xhandarë?

Si e merr shqiptari shtetin “përgjithësisht, si një person (d.m.th. si pushtet të njenit a tjetrit (person) apor si një regullim asnjanes?”

A e do, apor e dron (e ka frikë) shqiptari xhandarin e detyrës?

A mund të priten sakrificat vullnetare (për shtetin) nga popullsia?

Pse lëvdohen shkodranët e korçarët para të tjerëve, me gjithë që të dy *metropolet* e Shqipnisë janë të përmytuna nga fanatizma fetare, d.m.th. janë të përçamë në *të mirë fort* e në *të keq fort*?

A ka shqiptari seder shtetënore-kombëtare, apor tallet me vocrinë dhe dobësinë e shtetit të vet?

Si e kupton shqiptari veten përgjithësisht; me komplekse vogëlsie e pavleftësie, apor me komplekse sipërvleftësimi?

Pse flet gojëdhana dhe kanga popullore aq rrallë e tek për ndonjë femën të famshme?

Deri ku bazohet rrujtja e gjuhës shqiptare, e dokeve dhe e ndjenave kombëtare në karakterin e fortë të gruas shqiptare?

Si kuptohet paganizma brenda Kanunit të Lekë Dukagjinit?

Pse i jep shqiptari ma tepër randësi betimit: “*Për qiellë e për dhe*” se atij “*për Zotin*”, “*për Allahun*”, “*për Krishtin*” etj.?

Cila fe i përshtatet ma fort karakterit shqiptar, muhamedanizmi përgjithësisht, shitizmi, sunizmi, ortodoksizmi, katolicizmi, apor protestanizmi?

Cili shkak e ka protezhue bektashizmen në Shqipni?

Deriku e përkrahë, apor e pengon feja (konfisioni) shqiptarin ndër detyrat individuale e kolektive?

Si kuptohet toleranca fetare ndër malësina dhe fanatizma dërmuese ndër qytete shqiptare?

Si kanë mujt me qëndrue nëpër sa e sa shekuj disa enklave katolike mbrenda një rrethi fare muhamedan?³⁶

Pyetje apo çështje identitare të hapura në një universalitet që kap *ipse-n* e *idem-in* të shqiptarit, prandaj, në shenja të forta, duket që janë shkruar e shtruar sot e për ne.

³⁶ Po aty, ff. 130-137.

BIBLIOGRAFIA

1.

Krist Maloki: **Refleksione**, Prishtinë, 2006

2.

Paul Ricoeur: **Oneself as Another**, Chicago, 1992

3.

Naim Frashëri: **Istori e Skenderbeut**, Bukuresht, 1898

Naim Frashëri: **Qerbelaja**, Bukuresht, 1898

Ernest Koliqi: **Hija e Maleve**, Zara, 1929

Ernest Koliqi: **Tregtar flamujsh**, Tiranë, 1935

Át Shtjefën Gjeçovi: **Kanuni i Lekë Dukagjinit**, Shkodër, 1933

Át Gjergj Fishta: **Lahuta e Malcís**, Shkodër, 1937

Lasgush Poradeci: **Ylli i zemrës**, Bukuresht, 1937

Kristaq JORGO, Tiranë

STUDIMI & PËRKTHIMI: MARTIN CAMAJ I HANS JOACHIM LANKSCH-IT

(Një analizë kuantematike)

I.

Objekt i këtij artikulli është një paraqitje shumë e përmbledhur e një pune më të gjerë që ka në bazë shqyrtimi i rezultateve të punës studimore e përkthimore të Hans Joachim Lanksch-it mbi veprën poetike të Martin Camajt. Qasja bëhet nga këndvështrimi i teorisë sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit¹ – një ngrehinë kjo në proces – që synon të ndriçojë raportet më intime të letërsisë me matematikën². Analiza merr në shqyrtim

¹ Kristaq Jorgo, *Mbi kuantifikimin harmonik në poezi. Pyetje për një paraskicë të një filologjie të tretë*, në: AA.NN, **Studime filologjike shqiptare**, Konferencë shkencore, 21-22 nëntor 2007, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës – Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2008, f. 309-314; Kristaq Jorgo, *Koha në lirikë. Mbi funksionin themelor të kohës në ligjërimin letrar*, në: AA.NN, **Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**, Prishtinë, gusht 2007, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjisë dhe Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Prishtinë, 2007, f. 197-202; Kristaq Jorgo, *Për një analizë kuantematike të tekstit poetik* (At Gjergj Fishta, Nji lule vjeshtet), në **Studime albanologjike, II**, Letërsi, Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, viti XIII, 2008/2, f.77-82; Kristaq Jorgo, *Drejt një teorie të kuantifikimit harmonik të tekstit*. Kumtesë mbajtur në Konferencën e Shkencave Albanologjike të Takimit III Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca, Tiranë, 1-3 shtator 2008.

² Nënvizon Northrop Frye: “It is difficult to see how aesthetic theory can get much further without recognizing the creative element in mathematics. The arts might be more clearly understood if they were thought of as forming a circle, stretching from music through literature, painting and sculpture to architecture, with mathematics, the missing art, occupying the vacant place between architecture and music. The feeling that mathematics belongs to science rather than art is largely due to the fact that mathematics is an art that we know how to use. The difference between mathematics and literature on this point will be greatly reduced when criticism achieves its proper form of the theory of the use of words. (Nënv. ynë – K.J.)” Qartazi Frye le të kuptohet se, sipas tij, *teoria e përdorimit të*

të gjitha nivelet e kuantifikueshme të teksteve (të origjinalit shqip e të përkthimit të tij në gjuhën gjermane) duke u përqendruar në nivelin fonematik ku analizon dukurinë e kuantemancës, koncept me të cilin përmbledhim të gjitha format e përsëritjes. Përqasja e vëzhgimeve studimore të H. J. Lanksch-it mbi veprën poetike të M. Camajt me rezultatet e krahasuara të analizës kuantematike të origjinalit shqip e të variantit të përkthyer të një vargu tekstesh zbulojnë njohjen e thelluar të poetikës camajane nga H. J. Lanksch-i dhe dëshmimin e kësaj njohjeje në cilësinë e lartë të përkthimeve të tij.

Me statusin e tij si lexuesi e studiuesi i gjallë më i vjetër i krijimtarisë së Martin Camajt, njohës i thelluar nga shumë pranë i Poetit, i botëvështrimit, i jetës dhe i veprës së tij (poetikë, stil, gjuhë)³, përkthyes në gjermanisht i pjesës themelore të korpusit të poezive në konsultim të ngushtë me autorin⁴, përcjellës i vetëm i një vargu dëshmish të një rëndësie themelore – gojore e të shkruara – të këtij të fundit, Hans-Joachim Lanksch-i bën pjesë sot e gjithë ditën në grupin e ngushtë të autoriteve të dorës së parë në fushën e studimeve camajane.

II.

Përmes teorisë sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit kemi shtruar pyetjen njëherësh elementare dhe fundamentale: *Si vepron mendja estetike - krijuese e fenomenit letrar të përkryer?* E kemi shtruar këtë pyetje me shpresën e zbulimit të ndonjë parimi a të disa parimeve universale, nëse ka të tillë, që duhet/mund të jenë në themel të kësaj veprimtarie. Në trajtën më thjeshtësisht të sintetizuar përgjigjja jonë është kjo: Prej kaosit të lëndës ligjërimore mendja estetike synon gjenerimin e rendit, sa më i lartë ky të

fjalëve, drejt formësimit të së cilës mendimi letrar synon, nuk mund të mos ketë në mënyrë të detyrueshme në bazën e vet matematikën.

³ Shih ndër të tjera: Hans-Joachim Lanksch, **Martin Camaj ende i pazbuluem. Shkrime, kujtime dhe intervista**. Albas, Tiranë, 2017

⁴ Hans-Joachim Lanksch, *Editorische Notiz* in: Martin Camaj, **Gedichte. Albanisch – Deutsch**. Übertragen von Hans-Joachim Lanksch, Kyrill & Method Verlag, München, 1991; Martin Camaj, *Me pendlat e korbit të bardhë. Poezi shqip – gjermanisht*. Redaktoi dhe përktheu nga shqipja Hans-Joachim Lanksch / **Weissgediert wie ein Rabe**. Gedichte Albanisch – Deutsch. Herausgegeben und aus dem Albanischen übersetzt von Hans-Joachim Lanksch, Wieser Verlag, Klagenfurt, 1999.

jetë e mundur. (Dhe ky do të jetë aq më i lartë, sa më i thjeshtë, mundësisht i vetëm, të jetë parimi rendkrijues në çdo nivel të lëndës ligjërimore tejet komplekse). *Këtë* mendja estetike e bën duke i ndarë e grumbulluar njësitë përbërëse të kësaj lënde në dy nënbashkësi. (Krijohen kështu tri të tilla, tok me të tërën, pjesë e së cilës ato janë.) Njësitë e një nënbashkësie i lidh një tipar/një cilësi, i/e kundërt me të bashkësisë tjetër. Përgjatë formësimit të rrjedhës ligjërimore hyn në lojë që në krye elementi kuantitativ. Bashkësitë vetvetishëm vendosen në raport me njëra-tjetrën. Rendi është më i lartë sa më i thjeshtë të jetë raporti kuantitativ mes bashkësive, sa më shumë e sa më qartësisht numrat e mëdhenj të reduktohen në numra sa më të vegjël. Kjo arrihet përmes plotpjesëtueshmërisë së (tri) bashkësive – vlerave numerike të tyre – me më të voglën bashkësi ose me një nënfish të përbashkët të të triave ose, në rastin ideal, përmes raportit të prerjes së artë, që e jep koeficienti gjegjës, numrin irracional me vlerën e përafërt 1.618. Krijohet kështu harmonia në krijim-receptimin e së tërës – burim kjo i gëzimit estetik.

Thënë në mënyrë më analitike e pak më të detajuar:

1. Teksti poetik (letrar) – i përkufizuar prej nesh ‘teksti i kuantifikuar dhe/apo i kuantifikueshëm harmonikisht’ - është një sistem vetëorganizues; parimi themelor i morfologjisë së krijimit të tij - i rendit kuantitativo-kualitativ, i shprehshëm përmes një logaritmi të tipit rekursiv (parimi i pikë-prerjes së artë)/dhe ose përmes plotpjesëtueshmërisë.

2. Një matricë e tillë maksimalisht elementare, e cila ‘synon’ t’i administrojë të gjitha nivelet e tekstit është, ndër të tjera, përgjegjëse dhe shpjeguese e paradoksit themelor estetik në lëmë të poezisë (dhe të letërsisë përgjithësisht): si arrihet që e bukura – kryecilësia e ‘prodhimit shpirtëror *më kompleks* të shpirtit njerëzor’ (J.Lotman) – të zbulohet në mënyrë të përnjëhershme e të pandërmjetshme.

3. Ligji i kuantifikimit harmonik, i njëmendësueshëm në trajta praktikisht të panumrta, shfaqet në thelbin e vet i njëjtë në nivelet e ndryshme të tekstit, në krijime të ndryshme të secilit autor, të autorëve të ndryshëm të së njëjtës gjuhë, në tekste poetike të periudhave e të letërsive/gjuhëve të ndryshme.

4. Në zhvillim të kësaj hipoteze formulohen (riformuluar) konceptet

e kuantemës, të bashkësive kuantematike, të simetrisë dinamike të tekstit, të kuantifikimit ndjenjësor, një- dy- a më shumë fonemor, ritmik, rrokjesor, kompozicional, semantik, sintaksor dhe shembullzohen këto përmes analizës kuantematike të teksteve.

5. Kuantema përkufizohet si njësi e ligjërimit poetik (rrjedhës ligjëri-more), identiteti i së cilës është intuitivisht i njohshëm, por që mbetet të përcaktohet në procesin e analizës kuantematike të tekstit. Kuantema janë njësitë e kuantifikueshme të tekstit, me bazë fonemën apo rrokjen.

6. Kuantema mund të përkufizohet si njësia bazë e organizimit estetik të ligjërimit letrar.

7. Kuantemat e një bashkësie shenjohen nga një tipar i përbashkët a element ndërlidhës, i cili nga pikëvështrimi i kuantifikimit ka aftësinë të rrafshojë tiparet e tyre dalluese për hir të tiparit të tyre lidhës. Ky tipar duke qenë i njëjtë, i përbashkët, realizon përnjësimin e bashkësisë kuantematike.

8. Parimi i përgjithshëm i kuantifikimit harmonik mund të formulohet shkurtimisht kështu: Në nivele të ndryshëm të tekstit poetik (A) hetohen një shumësi bashkësish kuantematike binare (B vs. C). Ekzistojnë/ formohen në çdo nivel të tekstit tri bashkësi (a, B e C). **Raportet numerike të së tërës A me bashkësinë kuantematike B dhe të kësaj me bashkësinë e vogël kuantematike C prirjen t'i afrohen koeficientit të prerjes së artë: 1.618 ose të jenë madhësi të plotpjesëtueshme me më të voglën prej tyre apo me një nënfish sa më të madh të të triave.**

9. Kuantemnanca - një term yni përmbledhës për të gjitha figurat e përsëritjes [aliteracioni, asonanca, homeoteleuti, rima, homofonitë e ndryshme, përsëritja e plotë apo e pjesshme e fjalëve a sintagmave (anafora, anadiploza, epifora, përsëritja e vargjeve etj.)] – është sipas nesh një fenomeni bazal, gjenerues dhe mbarështrues i të gjitha këtyre formave të përsëritjes në tekstin poetik. Ky koncept (kuantemnanca) shenjon rrokjet apo njësitë një-, dy- a më shumë fonemore që përsëriten të paktën dy herë në vijë të rrjedhës së ligjërimit.

III.

Synimi ynë është të ndërmarrim një përqaasje krahasuese të rezultateve të analizës kuantematike të poezive të Martin Camajt e të përkthi-

meve të tyre nga Hans-Joachim Lanksch.

Në mënyrë të përmbledhur, por njëherësh të detajuar, H.-J. Lanksch e përshkruan kështu përvojën e vet përktimore në shënimet që shoqërojnë vëllimin me poezi shqip-gjermanisht *Me pendlat e korbët të bardhë / Weissgefiedert äie ein Rabe* (1991): “Ein Wort zur Übersetzung: Sie ist 1982-84 entstanden, unter dem wachenden Auge und mit Unterstützung Martin Camajs. Es war eine für den Übersetzer ideale Arbeitsbedingung: bei wöchentlichen Treffen in den Semestermonaten wurde jede Phase der Übersetzung mit dem Autor besprochen, der zwar selbst keine Übersetzungsvorschläge gemacht, aber stets überprüft hat, ob es auch im Deutschen noch seine Gedichte waren oder “Camaj mit deutschem Hut”. Vor allem hat der Autor jede Frage zur Textgestalt, zur diffizilen Lexik seiner Gedichte beantwortet und dem Übersetzer dabei besonders erläutert, äas nicht nur in, sondern auch zäischen den Zeilen steht, auch Nuancen, die sich nicht durch Wörterbücher erschliessen lassen. Die Arbeitsweise der möglichst originalnahen, dabei kreativen Übersetzung kam Martin Camaj sehr entgegen, von Übersetzungen hat er Kreativität geradezu verlangt; so kam es zu einer fruchtbaren Zusammenarbeit – der Autor liess mir jegliche Freiheit, ich legte die Übersetzung eines Textes erst aus der Hand, wenn ich sein Einverständnis mit der Übersetzung insgesamt und insbesondere sein Placet zu jeder übersetzerischen Freiheit bekommen hatte und die deutsche Fassung zur beidseitigen Zufriedenheit ausfiel.⁵

Përjasjen analitike *sui generis* tonën e ndihin një varg faktorësh: a. Rëndësia e shprehur që Camaj i jep formës në përgjithësi dhe tingëllimit posaçërisht (qendrore këto në konceptin e teorisë sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit); b. dëshmimi i harmonisë kuantifikuese në një numur shumë të madh të teksteve të tij, analizuar paraprakisht nga ne; c. rezervimi i jashtëzakonshëm i poetit për t’ua besuar përktimin e poezive përktihesve të shumtë; d. kërkesa *sine qua non* e tij që çdo përktim të jetë dygjuhësh; e. njohja e thelluar e autorit nga Hans-Joachim Lanksch-i, tok me të dhë-

⁵ Martin Camaj, **Me pendlat e korbët të bardhë. Poezi shqip – gjermanisht**. Redaktoi dhe përkteu nga shqipja Hans-Joachim Lanksch / *Weissgefiedert wie ein Rabe*. Gedichte Albanisch – Deutsch. Herausgegeben und aus dem Albanischen übersetzt von Hans-Joachim Lanksch, Wieser Verlag, Klagenfurt, 1999, f. 206.

nën tejet të rëndësishme se përkthimet e poezive janë realizuar prej tij në bashkëpunim të ngushtë me poetin dhe kanë parë dritën e botimit pas miratimit përfundimtar që ky i fundit ka dhënë.⁶

Dëshmimi i tipareve të kuantifikimit harmonik edhe në variantet e përkthyer do të ishte një provë empirike e cilësisë së përkthimeve po aq sa dhe një argument shtesë në mbështetje të koncepteve tona teorike.

Në vijë të rezultateve të arritura është legjitime të shtrohet çështja se a mundet teoria e kuantifikimit harmonik të ndihmojë në analizën krahasuese të përkthimeve dhe se a do të kishim të drejtë ta shtrinim atë edhe në fushën e teorisë e praktikës përkthimore në trajtën e një tipi të veçantë përkthimi.

IV.

Analiza e një numri shumë të madh të poezive të Martin Camajt na ka dëshmuar dhe provuar praninë e kuantifikimit harmonik në të gjitha nivelet e tekstit, me fjalë të tjera cilësi estetike të përkryer. Gjegjëset e tyre në gjermanishten e Hans-Joachim Lanksch-it dëshmojnë, po ashtu, harmoni të lartë kuantifikuese duke shembëllyer strukturën formalo-përmbajtësore të origjinalit dhe duke iu përafuar fort bukurisë eprore të tij.

Marrim në shqyrtim vetëm pak shembuj të thjeshtë. Së pari, një tekst fare të shkurtër, atë që i prin sythit përmyllës “Pleqnime më vete” të vëllimit *Njeriu më vete dhe me tjerë*:

Tha i urti:
Çdonjeni asht një ngjyrë
E na hije në të
Prej bardh deri n’ zi.

Metodat tradicionale të studimit letrar na japin shumë mundësi të analizojmë e të vlerësojmë, por jo dhe të vërtetojmë (nën. ynë – K.J.) qartazi, në mënyrë ndërsobjektivisht e të argumentuar e ndaj të pranueshme për të gjithë (nënv. ynë – K.J.) cilësitë estetike të tekstit. Po ashtu si teoritë

⁶ Die Übersetzungen sind “entstanden in steiniger Mühe”, in ständiger Rücksprache und Zusammenarbeit mit dem Autor, mit dem insbesondere die übersetzerischen Freiheiten sehr genau und gründlich überprüft und abgesprochen sind”. Hans-Joachim Lanksch, *Editorische Notiz* in: Martin Camaj, *Gedichte. Albanisch – Deutsch*. Übertragen von Hans-Joachim Lanksch, Kyrill & Method Verlag, München, 1991, S. 123.

në fushë të studimit krahasues të përkthimeve, cilësitë estetike të varianteve të tij në gjuhë të tjera. Gjykojmë se teoria e kuantifikimit harmonik të tekstit na ofron një aparat të kënaqshëm në këtë drejtim.

Teksti i strukturuar në katër vargje është i përbërë nga 24 rrokje dhe 49 fonema.

A. Në nivelin fonematik:

Bashkësia e fonemave që dalin vetëm një herë (12) formon një nënfish thujse të plotë të bashkësisë së kuantemancave – fonemave që përsëriten – (37) dhe të së tërës (49).

Bashkësia e çifteve të fonemave të njëpasnjëshme përsëritëse (24) është thujse e barabartë me bashkësinë e fonemave të lira (25), të dyja – me përfaqësi të lartë – sa gjysma e së tërës (49).

Numrin e përgjithshëm të rrokjeve (24) me bashkësinë e fjalëve dye- më shumërrrokëshe (15 rrokje) e këtë me bashkësinë e fjalëve njërrrokëshe (9) i lidh fort përfaqësisht raportin e prerje së artë.

B. Në nivelin ritmik:

Sipas teorisë sonë, për arritjen e një harmonie ritmike të plotë, bashkësia e rrokjeve të theksuara duhet të lidhet me bashkësinë e rrokjeve të patheksuara e të tërës përmes raportit të prerjes së artë, duke qenë e para bashkësia e vogël. Potenciali harmonik ritmik i një teksti të dhënë – numri i rrokjeve të theksuara i nevojshëm që teksti të ketë një strukturë ritmike *harmonike* – del duke pjesëtuar vlerën numerike të së tërës (numrin e rrokjeve) me koeficientin 2.618. Potenciali harmonik ritmik i tekstit në shqyrtim ka vlerën 9 (24/2.618). Një hetim i thjeshtë i strukturës ritmike të poezisë na provon se 9 janë rrokjet e theksuara në të.

Tha i urti:

Çdonjeni asht një **ngjyrë**

E **na hije në të**

Prej **bardh** deri **n' zi**.

C. Në nivelin kompozicional:

Sërish sipas konceptit tonë të kuantifikimit harmonik, teksti ka një

strukturë kompozicionale harmonike nëse klimaksi (grada më e lartë ndjenjësore, dramatike, e pritshmërisë për të panjohurën, e konfliktit që përjeton uni lirik etj.) ndodhet rreth pikës që koeficienti i prerjes së artë ndan kuantitativisht më dysh rrjedhën ligjërimore: në një segment të gjatë – rritës – dhe në tjetrin – rënës. Në rastin tonë kjo pikë bie përafërsisht pas rrokjes së 15-të ($24/1.618 = 14.83$):

Tha i urti:
Çdonjени asht një ngjyrë
E na hije // në të
Prej bardh deri n' zi.

Mund të argumentohet bindshëm e pa mëdyshje se teksti nuk mund të ketë një pikë më kulmore se ajo që ka “përcaktuar” prerja e artë: fill pas leksemës *hije* vjen segmenti rënës, “rrjedhoja” e artisë befasuese që u zbulua gradualisht gjithnjë e në rritje deri m’aty.

A. Në nivelin semantik:

E analizojmë rrjedhën ligjërimore sipas çifteve të izotopive: a. **ne** vs. çdonjëri dhe b. **njerëzore** vs. ngjyrë:

a. **na** vs. çdonjëri:
Tha i urti:
Çdonjëri asht një ngjyrë
E na hije në të
Prej bardh deri n' zi.

Shihet se raportin në pikëpanje numerike të së tërës (24) me bashkësinë izotopike “**çdonjëri**” (15) dhe këtë me bashkësinë izotopike “të tjerët” (9) i lidh – me përafërsinë e nënvizuar tashmë - koeficienti i prerjes së artë.

b. **njerëzore** vs. ngjyrë:
Tha i urti:
Çdonjëri asht një ngjyrë
E na hije në të
Prej bardh deri n' zi.

Raportin në pikëpanje numerike të së tërës (24) me bashkësinë izotopike “**njerëzore**” (15) dhe këtë me bashkësinë izotopike “ngjyrë” i lidh sërish koeficienti i prerjes së artë.

E. Në nivelin sintaksor:

I njëjti raport i prerjes së artë lidh të tërën me bashkësinë e **gjymtyrëve të dyta** dhe këtë me bashkësinë “kryefjalë-kallëzues”.

Tha i urti:

Çdonjeni asht **nji ngjyrë**

E na hije në të

Prej bardh deri n’ zi.

Shtrohet a imponohet pyetja: Është e mundur dhe a është e nevojshme (s’po themi e domosdoshme) që teksti poetik (çdo tekst poetik e përherë) të jetë i kuantifikuar harmonikisht në të gjitha këto nivele, për të na falur ndjenjën e së bukurës e të përkryerjes estetike e të gëzimit estetik? Natyrisht jo, as e domosdoshme dhe, aq më pak, e mundur. Por, në parim, duket se “ligji” përpiket të kuantifikojë sa më harmonikisht gjithçka që në pëlhurën tekstore është e kuantifikueshme. Thënë ndryshe, njësi që mund të bashkohet me të tjera njësi, me të cilat e lidh një tipar i përbashkët, mungues ky në njësitë mbetëse të së tërës.

V.

Para se të nisim analizën e variantit gjermanisht të Hans-Joachim Lanksch-it bëjmë vëzhgimin e vetkuptueshëm se përcjellja e të gjitha veçorive të strukturës kuantematike të një teksti në variantin e tij në një gjuhë tjetër është jo vetëm e vështirë, por thjesht e pamundur. Identifikimi i raporteve kuantematike thuhet në të gjitha nivelet e tekstit të origjinalit camajan u bë nga ne për të dhënë një dëshmim elementar, por të argumentuar të “lapidaritetit”, të bukurtingëllimit e të përkryerjes formalo-përmbajtësore në përgjithësi të teksteve të Camajt si dhe për të krijuar pikën e referencës në procesin e analizës krahasuese me përkthimin, më saktë me variantin e autorizuar nga autori të poezisë në gjermanisht

Der Weise spricht:

³³ Berit Backer, **Behind the Stone Walls: Changing Household Organisation among the Albanians of Kosovo**. (ed. by Robert Elsie and Antonia Young), Albanian Studies Vol. 10, London 2015.

³⁴ Janet Reineck, **The Past as Refuge: Gender, Migration and Ideology among the Kosova Albanians**. (Dissertation submitted at the University of California at Berkeley, 1991).

countries³⁵, Tahir Latifi on family, kinship and social security³⁶ and Elife Karasniqi on family and patriarchal relations.

Conclusion and Prospect

The basic research on family, kinship and migration conducted in Graz, undoubtedly contributed to enrich Balkans studies. The transdisciplinary openness of the historical-anthropological approach enabled a methodological diversity that had a positive impact on the formation of innovative theories. It is important to emphasize that a large part of this research was and still is third-party funded. Considering the fact that Karl Kaser was for a long time the only one of the members of the 'Graz Group' who held a permanent position, it becomes clear what effort was needed to push this research endeavor forward. The fact that so many projects have been approved testifies to the professionalism of the application, but also to the relevance accorded to the topics by international experts. Many of the young researchers employed in the projects have since become recognized scholars; some hold senior positions at leading international universities, others have returned to the region to enrich the scientific landscape in their countries of origin. For the future, it will be important to build on existing virtues and open up new fields and pick up on topics that have barely been studied yet. The variety of topics is very large, and the sources are rich, both, in the archives and in the private sphere where (auto)biographical

³⁵ Carolin Leutloff-Grandits completed her post-doctoral theses with this research, **Trans-local Care across the Kosovo Borders: Reconstituting Kinship, Gender, and Generational Relations in the Context of Opoja Migrations**. (Habilitation submitted at the University of Vienna), 2018. She published widely on Albanian migration and Kosovo related topics: Carolin Leutloff-Grandits, *Transnationale Ehen durch die Linse von Gender und Familie: Heiratsmigration aus Kosovos Süden in Länder der EU*, in **IMIS** Heft 47, 2015, 163-193; *Ibid.*, *Migrantisierung und Entmigrantisierung der Familie: Ein kritischer Blick auf Migration aus dem Kosovo in die EU*, in **Berliner Blätter** 65, 2014, 62-76; *Ibid.*, *Wedding festivals as events of cultural transformation: Migrant weddings in a Kosovar village, in Albanian transitions from contemporary and historical perspectives*, in Robert Pichler (ed.), **Legacy and Change: Albanian transformation from multidisciplinary perspectives**. Berlin and Wien: Lit, 2014, 135-162.

³⁶ Tahir Latifi, **Family, Kinship Relations and Social Security in Kosovo since the War of 1999: The Case of Isniq**. (Dissertation submitted at the University of Graz), 2016.

materials, diaries, letters, photographs, etc. are omnipresent. The combination of visual studies³⁷, gender studies and migration studies for instance offers an enormous potential for innovative research. So much is left to do and this can best be done in close transnational cooperation in order to inspire debates and intensify exchange between disciplines and across borders.

³⁷ On recent initiatives in this field at Graz University see the Visual Archive Southeastern Europe (VASE) and related projects under the aegis of Karl Kaser: <https://gams.uni-graz.at/context:vase>.

Jani THOMAI, Tiranë

LEKSIKOGRAFIA DYGJUHËSHE E SHQIPES ME GJERMANISHTEN

Summary

From an early study, “*Albanian and other languages in lexicography*”, we have got an account of the order of bilingual dictionaries of Albanian against other languages, also some ideas which apply with the scientific objective of this paper, which is to compare and give us a view, both at the same time, of the place that the bilingual lexicography of the Albanian and German take up on this order.

Chronologically, the Albanian dictionaries with German, in the bilingual lexicography, from the time of first published dictionary (1835), come on fourth place, after Latin (1635), the Italian (1702) and other multi-lingual ones, mainly terminological, German included (1762). Whereas, numerically, (36), they come on third place, behind multi-lingual dictionaries (German included), most of them terminological (98), and with English, mainly teaching ones (71); otherwise, we can say they come on first place as scientific dictionaries.

We can note some typological, lexicographical traits from the Albanian – German dictionaries and vice versa. There are some small, medium, or over medium dictionaries, Albanian-German as well as German-Albanian ones, compiled by Albanian and foreign authors, mainly lexical.

Here, we are looking, for the purpose of a lexicographical analysis, at the “*Dictionary Albanian – German*” (Worterbuch albanisch – deutsch), compiled by Oda Buchholz, Wilfried Fiedler and Gerda Uhlisch (Berlin, 1992, 739 pages). This dictionary enriches the bilingual lexicography of both Albanian and German, the latter being a strong bond between the Albanology with German as well as being an important part of their content, shown not only in words opposition as “pure” lexemes, but even wider and beyond of the lexicon range, as a study field of lexicography.

This paper brings few examples on some general and particular traits, following the lexicographical format, of a bilingual dictionary. Naturally, the analysis and interpretations can be established only on the Albanian glossary of the Dictionary, whereas the subject of lexical-semantic identity between Albanian and German, a more difficult one, requires a study on its own.

What we can clearly observe from three main fields; lexicon, grammar and spelling (phonetic).

In *lexicon* we can observe two phenomena:

a) The proportion of lexical layers according to linguistic norm, conceptual fields, and levels of Albanian language are generally linear. The Albanian glossary is generic and

normative, nevertheless it contains some dialectal words mainly from ethno cultural rural field, as well as many formative dialectal variants, either on its own or on his norm variant. Nonetheless we can confirm that the Dictionary, with the abundance in words of this lexical layer, even though it surpasses its informative function, has open the door to other words that according to authors has great connoisseur values for German speaking world.

The dictionary also includes some foreign words which are not in use now days or have a very limited use in some distinctive linguistic types or in close social and professional circles. It also includes some foreign words and specific terms which go beyond the limits of a bilingual dictionary of this size, also some old orientalism and many proper nouns for which there is no place in a dictionary of this kind.

There is a lack of common adjectives and their respective nouns, even though we can see verbs and their verbal nouns being used and while these adjectives go under semantic transformations towards figurative meanings, they create an asymmetry within the formative nest. Also, the lack of some of the prefixes with coded specialised meanings has created an unevenness between lexical – grammatical classes formed with them (see formations with *anti-*, *auto-*, *ç-*, *mos-*, *pa-*, *para-*, *ri-*, *sh-*, *zh-* etc).

b) The Dictionary is normative, authentic and functional because of the wide range of words with wide semantic structure, it has many phraseological units, an elaborated lexematic and syntagmatic field and many terminological compound words.

2. In *grammar*, we can observe two phenomena:

a) The lexicography suffers more than the structure of syntax does, from the lack of the synthetic infinitive in the system of grammatical structure of standard Albanian which makes her choose or accept a verbal form as a lexeme. In this case, the acting verbal form chosen as lexeme or as a lexicographic unit, is the third singular person of present time of the indicative, an original scientific choice.

b) We know that the characters of system are the absolute criteria for any kind of dictionary with all its components, particularly in the grammatical field, which makes them some difficult criteria to be followed rigorously. And so, it happens that even the mechanical use of the system, can bring its own breach like for example, some verbs of grammatical paradigm they don't carry the lexical semantics or use

Some of the grammatical forms of the words, when supplementary, irregulars or undergone deep phonetics changes in the grammatical paradigm, are presented as lexicographic titles in the Dictionary.

3. Lastly, in spelling, the Dictionary follows the rules of the standard language, however it gives some *phonetic* variants of common language spelling.

The Dictionary gives few spelling variants in the dialect level, mostly with the alternation of *ë/e*, but doesn't show enough dialect variants with the top 5-6, most important, phonetic distinguished alternations such as *â/ë*, *n/r*, *ue/ua*, *vo/va*, or with *the assimilation of vowels' and consonants' groups, as well as with the infinitive of geg dialect.*

As a conclusion, the Dictionary, with some of its general dialect words, with the foreign words (oriental inclusive), not vastly or with very limited use in today's standard Albanian, with the phonetic variants of some words, with the proper nouns, the irregular or supplementary forms of some words of grammatical paradigm, fulfils its informative pur-

pose on the variations, close to standard and from the way this Dictionary uses the references, we can decisively support the idea, that this Dictionary does target the German speaking world without denying nonetheless, the values that it brings to the Albanian language. Its volume is big enough to illustrate all cases in their full forms and in system, without creating, sound absences in every case which can breach the system's character.

I. Duke shfrytëzuar këtë rast, po jap më parë një pasqyrë të gjuhëve të huaja, me të cilat shqipja është përballur në leksikografi, veçan në fjalorë dygjuhësh, siç e kam paraqitur në një studim të mëparshëm, me titullin “*Shqipja me gjuhë të tjera në leksikografi*”.¹ Po huazoj prej andej, veç kësaj pasqyre të renditjes së fjalorëve dygjuhësh të shqipes me gjuhë të tjera, edhe ndonjë ide, e cila përshtatet me objektin shkencor të kësaj konference e të kumtesës sime dhe jep mundësi të përqaset e të shihet vendi që zë leksikografia dygjuhëshe e shqipes me gjermanishten në këtë renditje. Atje kam rikujtuar, ndër të tjera, diçka të njohur: Hartimi i fjalorëve dygjuhësh të shqipes me gjuhë të tjera dhe numri i tyre ka qenë i kushtëzuar, sipas rastit, nga rrethanat historike (të pushtimit ushtarak a të trysnisë kulturore), nga pozicioni gjeografik (i fqinjësisë), nga zhvillimi i fushave të reja të veprimtarisë ekonomike, financiare, shkencore etj., nga prestigji i gjuhës së huaj gjatë shkëmbimeve kulturore në periudhën përkatëse, nga kërkesa didaktike, çka përputhet dhe me huazimet leksikore përgjithësisht.

Në këtë pasqyrë janë dhënë gjuhët me të cilat shqipja është përballur në fjalorë dygjuhësh (shqip – gjuhë e huaj ose anasjellas) e shumëgjuhësh (përfshirë edhe fjalorët terminologjikë), vitet kur janë botuar fjalorët e parë me ato gjuhë dhe numri i fjalorëve me secilën nga këto gjuhë. Renditja e gjuhëve është bërë sipas kohës së botimit të fjalorit të parë të shqipes me secilën gjuhë.

¹ Shih *Shqipja me gjuhë të tjera në leksikografi*, botuar së pari në përmbledhjen **Albanologjia**, Tetovë, 2014, 1-2, f. 93-100. Për të dhënat nga fjalori i parë në leksikografinë shqipe, Franciscus Blancus, **Dictionarum latino-epiroticum**, Roma, 1635, e deri në fund të vitit 2004 është shfrytëzuar **Bibliografi e leksikografisë shqipe**, e hartuar nga Pavli Haxhillazi, Artan Goga, Flora Zeqja, shih në **Leksikografia shqipe – Trashëgimi dhe perspektivë**, Tiranë, 2005, f. 329- 371; për fjalorët e botuar në vitet 2005 e më pas janë nxjerrë të dhënat nga shënimet e mia.

latinisht /italisht /shumëgj.	/gjermanisht /greqisht /serbisht ² /frëngjisht /anglisht
1635 1702 1762 1835 1869 1873 1879 1918	
14 42 98 36 18 27 28 71	
rusisht /hungarisht /çekisht /bullgarisht /turqisht /maqedonisht /kinezisht /esperanto	
1951 1953 1957 1958 1961 1967 1979 1981	
23 2 1 4 8 12 1 1	
suedisht /finlandisht /polonisht /romisht /danisht /rumanisht /kroatisht /spanjisht	
1985 1991 1992 1993 1995 1995 1996 1996	
3 3 1 2 1 5 2 2	
portugalisht /norvegjisht /sllovenisht /arabisht /japonisht	
online ³ 1998 2002 2005 ?	
2 1 1 2 1	

Sipas kësaj pasqyre, numri i përgjithshëm i fjalorëve dygjuhësh e shumëgjuhësh të botuar është mbi 430 (edhe me ndonjë ribotim të ripunuar, si dhe botimet *online*), kurse numri i autorëve është mbi 560, nga të cilët të huaj janë jo më shumë se 50, kryesisht në gjysmën e parë të shekullit XX. Në gjysmën e dytë të shekullit XX e këtij numri i autorëve të huaj ulet shumë.

Përfshihen në këtë pasqyrë fjalorët shqip – gjuhë e huaj e anasjellas, fjalorë xhepi, doracakë, të vegjël e të mesëm. Sipas këtij klasifikimi, më shumë janë hartuar e janë botuar fjalorë të tipit të vogël dhe fjalorë *shqip – gjuhë e huaj*. Fjalorë të mesëm janë hartuar e janë botuar kryesisht gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Në këtë periudhë kanë dalë edhe fjalorë dygjuhësh të mbimesëm ose pothuajse të tipit të madh, si fjalorë të shqipes me anglishtë⁴ a me gjermanishten⁵.

Edhe tipi i fjalorëve e periudha e botimit janë tregues me domethënie historike të kohës së tyre. Kështu, zotërimi i *fjalorëve gjuhë e huaj – shqip* do të thotë që shumica e fjalorëve dygjuhësh është hartuar kryesisht për shqipfolësit. Madje, me këtë tip fjalori nis leksikografia shqipe. Fjalori i parë në leksikogafinë shqipe, latinisht – shqip⁶, i takon periudhës së Mesjetës, kur latinishtja, sidomos në ligjërimin liturgjik, ishte gjuhë aktive dhe

² Më shumë *serbo-kroatisht*.

³ Faqe interneti për fjalorë dygjuhësh *online* për përkthime janë hapur edhe për rreth 20 fjalorë të tjerë të shqipes me gjuhë të tjera, si me gjuhë afrikane (suahili etj.), belorusisht, filipine, galicisht, hebraisht, hindisht, islandisht, indonezisht, irlandisht, koreisht, ukrainisht, vietnamisht etj.

⁴ P.sh. Pavlli Qesko, **Fjalor anglisht-shqip**, Tiranë, 2002, 2086 faqe, 126 000 fjalë.

⁵ P.sh. Ali Dhrimo, Hamlet Bezhani, **Fjalor gjermanisht – shqip**, Wiesbaden, 1996, 2424 faqe; Ali Dhrimo, **Fjalor gjermanisht – shqip**, Tiranë, 1998, 1196 faqe; Wilfried Fiedler, Ardian Klosi, **Wörterbuch Deutsch – Albanisch**, Leipzig, 1997, 831 faqe etj.

⁶ Shih shënimin 1.

kur bashkëkohësit e autorit përkthenin vepra fetare nga latinishtja ose hartonin vepra në gjuhën shqipe. Ky fjalor vinte, pra, si përgjigje për thirrjen e kohës – të shkruhet shqipja. Kështu edhe numri i *fjalorëve të shqipes me italishten* është rritur krahas zgjerimit të marrëdhënieve ndërshtetërore e kulturore ndërmjet Shqipërisë e Italisë, sidomos në vitet '30 të shkullit XX dhe në dy dhjetëvjeçarët e fundit. Pak *fjalorë terminologjikë* u botuan (kryesisht në revista) edhe në vitet '30 –'40 të atij shekulli, por në vitet '60 – '80, në mënyrë sistematike e shkencore, vetëm nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Tiranë u hartuan e u botuan 32 fjalorë të tillë, në 4-5 gjuhë (shqip – anglisht – frëngjisht – italisht – rusisht, më rrallë edhe gjermanisht), me mbi 60 000 terma⁷, në periudhën kur morën zhvillim shumë degë të ekonomisë, të shkencës e të teknikës, kur politika gjuhësore orientonte drejt njësimi, drejt një standardi e drejt pastërtisë leksikore të tij dhe kur planifikimi gjuhësor i bënte të vetëdijshëm hartuesit e fjalorëve për këtë orientim edhe në fushë të terminologjisë. Është e kuptueshme që edhe *me disa gjuhë të tjera*, si suedishtja, norvegjishtja, polonishtja, danishtja, hungarishtja, finlandishtja, kinezishtja, çekishtja, japonishtja, gjuha shqipe nuk ka pasur shkëmbime të ndërsjella, pra, fjalorët dygjuhësh të shqipes me këto gjuhë janë hartuar për arsye thjesht praktike e kulturore ose me nisma vetjake, duke mbetur brenda kufijve të këtij qëllimi. Dy *fjalorë me kroatishten* shënojnë kohën e përpjekjeve për të ndarë kroatishten nga serbishtja si gjuhë më vete, d.m.th. “shpërbërjen” e serbokroatishtes në serbishte e kroatishte. Numrin më të madh e *më të vëllimshëm të fjalorëve shqipja e ka me anglishten, frëngjishten, italishten e gjermanishten*⁸, si gjuhë ndërkombe-tare, të cilët u përkasin dy dhjetëvjeçarëve të fundit, për shkak edhe se këto gjuhë mësoheshin rregullisht në shkolla, kryesisht në universitete. Edhe *fjalorët me rusishten* janë kryesisht të pariudhës kur shkëmbimet kulturore me Rusinë ishin të gjalla, kur literatura e shumë fushave vinte në Shqipëri në rusishte, kur rusishtja ishte gjuhë e dytë në shkolla dhe kur shumë studentë e specilistë shqiptarë arsimoheshin e specializoheshin në Rusi. Këtë e mbështet edhe tipi kryesisht shkollor i këtyre fjalorëve. *Fjalorët me greqishten, italishten, maqedonishten e serbishten* janë nxitur edhe nga fqinjësia gjeografike e shqipes me ato gjuhë, pra, si vepra gjuhësh në

⁷ Hëna Pasho, Agron Duro, *Terminologjia shqipe – Probleme dhe detyra*, në **Gjendja dhe zhvillimi i tetminologjisë shqipe – Probleme dhe detyra**, Tiranë, 2009, f. 25.

⁸ Po përmendim fjalorët anglisht–shqip e shqip–anglisht të Pavli Qeskos, fjalorët shqip–frëngjisht e frëngjisht–shqip të Vedat Kokonës, fjalorët italisht–shqip e shqip–italisht të Ferdinand Lekës e Zef Simonit, fjalorët gjermanisht–shqip të Ali Dhrimos, fjalorët serbokroatisht–shqip e shqip–serbokroatisht të Institutit Albanologjik të Prishtinës etj.

kontakt, në kushte historike e politike të njohura. Me gjuhët si frëngjishtja, anglishtja, italishtja, rusishtja e gjermanishtja,⁹ gjuha shqipe është vënë përballë edhe në fjalorë me njësi frazeologjike, të cilat shprehin më shumë origjinalitetin gjuhësor kombëtar, me fare pak huazime të ndërsjella. Ndërkaq, dy parime bazë që shtojnë hartimin e një fjalori përshkojnë gjithë produktin leksikografik: *të paraqitet në fjalorë pasuria* leksikore, semantike, frazeologjike, sintagmatike etj. e gjuhëve dhe *fjalorët të jenë funksionalë*, të shërbejnë për mësimin e gjuhëve, për marrëdhëniet kulturore, për vepërimitarinë ekonomiko-shoqërore, për ngulitjen e normës gjuhësore, për përkthimet në çdo fushë etj.

Pasqyra e mësipërme tregon gjithashtu se gjeografia territoriale e këtyre fjalorëve shtrihet në tri kontinente, – Evropë, Azi e Amerikë, – dhe se “gjeografia” gjuhësore e përballjes së shqipes në leksikografi përfshin 29 gjuhë, pothuajse të gjitha gjuhët e tjera të familjes indoevropiane dhe disa gjuhë jashtë kësaj familjeje gjuhësore, si hungarishtja, finlandishtja, turqishtja, persishtja, arabishtja, kinezishtja, japonishtja. Në periudhën e dy dhjetëvjeçarëve të fundit, në kushtet e hapjes së Shqipërisë dhe të zhvillimeve të reja në degë të shkencës, në ekonomi, në arsim e në kulturë, kontaktet e shqipes, që u dendësuan sidomos me anglishten, italishten e frëngjishten, ishin jo vetëm në aspektin leksikografik, por edhe në aspektin e huazimeve të dendura e të shpejta, të cilat nga anglishtja qenë e vijojnë të jenë ende më të mëdha¹⁰.

Përballja e shqipes me gjuhë të tjera në fjalorët dygjuhësh, natyrisht, është kushtëzuar edhe nga vetë gjendja e shqipes, nga mjetet leksikore ë trashëguara ose që mund të krijoheshin rishtas, por peshë të vçantë ka pasur edhe qëndrimi i vetëdijshëm i leksikografëve në përzgjedhjen dhe në vënien përballë njëra-tjetrës të gjuhëve. Në disa raste ka vijuar detyrimisht ose me vetëdije të ruhet identiteti leksemor i gjuhës dhënëse, në raste të tjera, me synimin për shqipërim e për pastërti të fjalorit shqip, është dhënë barasvlerësi shqip i fjalës së huaj. Edhe në këtë tip fjalorësh, si në përkthimet e letërsisë, ka ushtruar trysni *qëllimi i përkthimit*, nga i cili ka dalë një vlerë leksikografike e caktuar. Në *fjalorët shqip – gjuhë* e huaj duket

⁹ Skënder Doku, **Fjalor frazeologjik gjermanisht – shqip**, Tiranë, 1998, 570 faqe.

¹⁰ Për këto huazime është shkruar mjaft, veçanërisht për fushat e reja të zhvillimit, si informatika, biznesi, financa, por edhe masmediet, artet, administrata etj.

më qartë prirja për t'i pasqyruar edhe ato fjalë të huaja që gjuha shqipe tashmë i ka pranuar, kurse në fjalorët gjuhë e huaj – shqip ka më shumë përpjekje për shqipërim dhe për ruajtjen e pastërtisë së shqipes. Shumëçka prej këtyre që u parashtruan deri këtu vlen edhe për fjalorët dygjuhësh të shqipes me gjermanishten.

* * *

II. Sipas pasqyrës së mësipërme, leksikografia dygjuhëshe e shqipes me gjermanishten kronologjikisht, nga koha e fjalorit të parë (1835)¹¹, zë vendin e katërt në leksikografinë shqipe, pas latinishtes (1635), italishtes (1702) dhe fjalorëve shumëgjuhësh, kryesisht terminologjikë, përfshirë edhe gjermanishten (1762), kurse numerikisht (36) zë vendin e tretë, pas fjalorëve shumëgjuhësh (përfshirë edhe gjermanishten), shumica terminologjikë (98) dhe me anglishten, shumica mësimorë (71); ndërkaq, mund të themi se sipas tipit e destinacionit shkencor të fjalorëve, përpjesëtimisht me tipet e fjalorëve, zë vend në rendin e parë. Gjashtë fjalorët e parë (BL 1, 2, 3, 4, 5, 6)¹² janë hartuar nga të huaj dhe janë botuar jashtë Shqipërisë; i pari fjalor me autor shqiptar e i botuar në Shqipëri është ai i Anton Merlos¹³. Ka pauza të gjata, nga viti 1960 e deri në vitin 1977 dhe nga 1979 deri 1991, kur nuk botohen fjalorë dygjuhësh të shqipes me gjermanishten. Më të begatë kanë qenë vitet 1996 – 1998. Këta dy dhjetëvjeçarët e fundit hartimi e botimi i fjalorëve dygjuhësh të shqipes me gjermanishten ka rënë, mbase ngaqë kjo fushë tashmë është thuarje e mbuluar.

Edhe për fjalorët shqip – gjermanisht e anasjellas mund të shënojmë disa veçori tipologjike leksikografike, të mbështetura në raporte statistikore sipas *Bibliografisë leksikografike*¹⁴ (BL), që jepet më poshtë: a) *Sipas rendit të gjuhëve* janë në numër thuarje të barabartë: *Fjalorë shqip – gjermanisht* 20 (BL 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 16, 17, 18, 25, 26, 27, 34); *Fjalorë gjermanisht – shqip* 19 (BL 1, 2, 5, 6, 7, 12, 15, 17, 20, 22, 23, 24, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 35); 6 fjalorë janë të të dy tipeve së bashku ose

¹¹ I. R. von Xylander, *Die Sprache der Albaner oder Schipetaren*, Frankfurt am Main, 1835 (me një Fjalor gjermanisht – shqip e shqip – gjermanisht, rreth 3000 fjalë).

¹² Shih *Bibliografi leksikografike* në fund.

¹³ Anton Merlo, *Fjalorth shqip – gjermanisht dhe gjermanisht – shqip*, Shkodër, 1917, 83 faqe

¹⁴ Ndonjë mungesë në këtë bibliografi nuk ndikon në përgjithësimet e arritura.

shumëgjuhësh (BL 1, 2, 6, 7, 17, 18). b) *Sipas rrafshit gjuhësor a fushave të përdorimit* zotërojnë dukshëm fjalorët e përgjithshëm, 27 (BL 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 20, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 35), përkundrejt fjalorëve specialë, 6 (BL 4 – etimologjik, 13 – krahasues shumëgjuhësh, 25 – praktik shumëgjuhësh, 30 – frazeologjik, 32 – ushtarak). c) *Sipas vëllimit* zotërojnë fjalorët e vegjël e afër të mesëm, 22 (BL 4, 8, 11, 13, 14, 15, 17, 20, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 24, 35), përkundrejt fjalorthëve, fjalorëve xhepi, doracakëve shumë të vegjël, 11 (BL 1, 2, 3, 5, 6, 9, 10, 12, 16, 18, 25); përkundrejt fjalorëve thuajse të mbimesëm (BL 24 – 2424 faqe, 31 – 1196 faqe, 35 – 1200 faqe etj.) qëndrojnë fjalorthë me më pak se 100 faqe (BL 7 – 83 faqe, 9 – 32 faqe, 10 – 58 faqe, 16 – 74 faqe, 18 – 62 faqe) e të tjerë që nuk i kalojnë 200 faqe. ç) *Sipas autorëve* numri i fjalorëve është thuajse i barabartë: Fjalorë të hartuar nga autorë të huaj 17 (BL 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8, 10, 11, 12, 13, 14, 16, 17, dhe me bashkautorë 28, 33), kurse fjalorë të hartuar nga autorë shqiptarë 18 (BL 7, 9, 15, 18, 20, 23, 14, 25, 26, 27, 28 – me bashkautorë, 29, 30, 31, 32, 33 – me bashkautorë, 34, 35). Pas vitit 1995 zotërojnë autorët shqiptarë.

*

Më tej po veçojmë këtu, si një objekt analize leksikografike, me pak fjalë, “*Fjalorin shqip – gjermanisht*” (*Wörterbuch albanisch – deutsch*), i hartuar nga Oda Buchholz, Wilfried Fiedler dhe Gerda Uhlisch (Leipzig 1977 dhe 1992, 739 faqe)¹⁵. Ky fjalor, padyshim cilësorisht shkencor, pasuron leksikografinë dygjuhëshe të shqipes me gjermanishten, e cila është një fill i fortë i lidhjes së albanologjisë me gjermanistikën dhe pjesë e rëndësishme e përmbajtjes së tyre, jo vetëm në kundërvënien e fjalëve si leksema “të pastra”, por më gjerë, edhe përtej kufijve të leksikut si lëndë e të leksikologjisë si fushë studimi.

“*Fjalori..*” ka rreth 30 000 fjalë, kuptohet të korpusit shqip, çka duhet mbajtur parasysh për të gjykuar për përmbajtjen e tij dhe për trajtimin leksikografik, sikundër edhe, *përveç vëllimit*, duhen mbajtur parasysh

¹⁵ Varianti i ri i botimit Langenscheidt *Handwörterbuch – Albanisch , Teil I, Albanisch - deutsch*, 739 faqe, së bashku me Langenscheidt *Handwörterbuch – Albanisch , Teil II, Deutsch – albanisch*, hartuar nga Wilfried Fiedler e Ardian Klosi, München – Wien, 2000.

tipi dygjuhësh, shqip – gjermanisht, i hartuar nga leksikografë të huaj, 25 vjet më parë, po ashtu destinacioni (për shqipfolës a gjermanishtfolës). Ndërkaq, dihet që kualiteti leksikografik i një fjalori, edhe dygjuhësh si kurse ky që po shqyrtojmë, nuk përcaktohet vetëm nga numri i fjalëve të renditura alfabetikisht, si glosar, por edhe nga përpunimi i brendshëm i lëndës dhe nga shumësia e të dhënave leksikologjike e jashtëleksikologjike, si ndërtimi i strukturave kuptimore, identifikimi i larmisë së përdorimeve e të ngjytimeve të mbishtresuara, drejtshkrimi e drejtshqiptimi, lidhjet kuptim – koncept – realie nëpërmjet tipeve të shpjegimit, kuptimet e mjetet gramatikore përfaqësuese të çdo fjale, leksematika (sintaksa e valencave) e paradigmatika e fjalëve, përpjesëtimi i shtresave leksikore sipas fushave konceptore e semantike, elemente të historisë, të etnografisë e të kulturës së popullit gjuhëfolës dhe shumë të dhëna të tjera, të cilat së bashku me këto i japin fjalorit, kësaj vepre leksikografike, vlera të shumanshme gjuhësore e jashtëgjuhësore dhe rrjedhimisht e kthejnë në vepër krahasimtare ndërmjet dy gjuhëve; aty nuk ballafaqohen vetëm fjalët e kuptimet e një gjuhe me gjuhën tjetër, por, nëpërmjet tyre e përveç atyre, ballafaqohen kulturat kombëtare, mënyra e të menduarit të popujve, që përcakton formën e brendshme të gjuhëve, dukuri të historisë, të psikologjisë e të zhvillimit shoqëror. Prandaj hartimi i fjalorëve dygjuhësh, me të vërtetë cilësorë, nuk është më i lehtë se hartimi i fjalorëve shpjegues kombëtarë e të çdo tipi tjetër. Këtë e ndiejnë, më shumë se përdoruesit e fjalorit, madje edhe se studiuesit, vetë hartuesit e tij.

“Fjalori..” ka edhe një gramatikë të shkurtër e të thukët të shqipes (“Grammatik”, f. 649-698) dhe disa tabela për kategoritë leksiko-grammatikore të eptueshme (“Tabellen”, f. 699-739). Nuk është synimi këtu të bëhet analizë e plotë e vlerësim i gjithanshëm i “Fjalorit..”, por të tregohen disa dukuri të lëndës dhe të trajtimit leksikografik në përshtatje me tipin e vëllimit e tij. Duhet të theksohet se, me autorë njohës të mirë të shqipes dhe me përgatitje të lakmueshme, “Fjalori..” krijon siguri e besueshmëri shkencore edhe në lëndën e vet, edhe në trajtimin leksikografik.

Brenda kufijve të një trajtese të tillë sillen pak shembuj për disa tipare të përgjithshme e të veçanta sipas formatit leksikografik të një fjalori dygjuhësh. Natyrisht, analizat dhe interpretimet bëhen vetëm mbi glosarin shqip të “Fjalorit..”, ndërsa çështja e identitetit leksiko-semantik ndërmjet

shqipes e gjermanishtes, çështje shumë më e vështirë, kërkon studim më vete nga njohës të mirë të dy gjuhëve. Shembujt e dhënë për çdo dukuri besojmë se janë të mjaftueshëm për të kuptuar vetë dukuritë, por nga vjelja e plotë e glosarit shqip do të dilnin të dhëna për dhjetra e qindra raste të njëjta, që do të dëshmonin statistakisht përmasat e përpjesëtimet e tyre.

Çfarë vërehet qartë në tri fusha kryesore: Në leksik, në gramatikë dhe në drejtshkrim.

1. **Në leksik** mund të vihen në dukje dy dukuri:

a) *Përpjesëtimi i shtresave leksikore* sipas normës gjuhësore, sipas fushave konceptore dhe sipas rrafsheve të gjuhës shqipe, në pjesën themelore të glosarit përgjithësisht është i drejtë: Glosari shqip është i përgjithshëm e normativ. Megjithatë, ka edhe disa fjalë dialektore ose kryesisht të fushës së etnokulturës rurale (*akllai-a f // okllai-a f, anagaset refl, andri-a f, argali-a f, asilloj Dem Pron, atkin/ë-a f, avdos-i m, avlëmend-i m, avrap/ë-a f, azgën-e Adj, babun/e-ja f, bac-i m, bajloz-i m, bajrak-u m, bakraç-i m, balic/ë-a f, balonj/ë-a f, caruq/e-ja f, cimbidh tr, çabull/e-ja f, çakall/e-ja f (~ e mullirit), çerek/e-ja f, çik/ë-a f, gaviç-i, gërbulaç-i m, hapaçel-e Adj, hopthi Adv, sha Interj: ~ Zotin!, vrrom/ë-a f, xamar/e-ja f, xeg/ël-la f, xerxel/e-ja f, xexerica-t Pl, xigan/e-ja f, xipk/ë-a f, xhaunis tr, xhorak/e-ja f* e shumë të tjera). Ka edhe mjaft variante fjalëformuese dialektore a të vjetruara, herë vetëm e herë me variantin normë (në shumë raste jepet varianti jugor i emrave të vepruesit, tashmë jonormativ: *banues-i m* → banonjës, *botonjës-i m, dëmtonjës-i m, eksploatonjës-i m, eksploronjës-i m, emërues-i m* → emëronjës, *fitues-i m* → fitonjës, *freskonjës-e Adj* → freskues, *hartonjës-i m* → hartues, *impononjës-i m, importonjës-i m, krijonjës-i m* → krijues, *mësonjës-i m* → mësuës, *vraponjës-i m* → vrapues etj.). Ndërkaq, duhet vënë në dukje që shumë fjalëve të këtyre shtresave leksikore *Fjalori* u ka hapur vend në të njëjtin rrafsh me fjalët e tjera si lëndë e përligjur, sipas autorëve, me vlera të nevojshme njohëse për përdoruesit e botës gjermane të këtij fjalori, edhe pse e kapërcen kështu disi funksionin informues. Po kështu, në "*Fjalor..*" janë përfshirë edhe disa fjalë të huaja që nuk përdoren sot ose kanë përdorim shumë të kufizuar në stile të veçanta gjuhësore a rrethe të ngushta sociale e profesionale, si dhe disa terma specifikë që i kapërcejnë kufijtë e një fjalori me këtë vëllim e me destinacion të përcaktuar nga tipi i tij dygjuhësh (*abnegacion-i m, ablativ-i m, abshis/e-ja f, ade-*

zion-i m, akompanjim-i m, autenticitet-i m, deportim-i m, diapozitiv-i m, diferencial-i m, ekinoderme-t Pl, ekzocentrik-e Adj, akuzativ-i m, alezim-i m, altoreliev-i m, anestetik-e Adj, ang/ërr-rra f, asimptot/ë-a f, askath-i m, atol-i m, ballung/ë-a f, ekzocentrik-e Adj, empirist-i m, emulsion-i m, feldspat-i m, hiat-i m, hidropizi-a f, hipostaz/ë-a f, imperativ-i m, impostim-i m, impozant-e Adj, transitive-e Adj, translat-i m, transliteron tr etj.), sikundër edhe disa orientalizma të vjetruar (açik-e mb, akçi-u m, akçihan/e-ja f, aksham-i m, araba-ja f, asqer-i m, ashik-u m, avash Adv, badihava Adv, dallkautllëk-u m, gazepqar-i m, ibret-i m, otra-ja f, zhaba Adv, xheza-ja f, yrysh-i m, yst-i m, yxhyt-i m etj.). Janë përfshirë këtu si njësi leksikore edhe shumë emra të përveçëm, që nuk e kanë vendin në këtë tip fjalori (Afërdit/ë-a f, Afganistan-i m, Afrik/ë-a f, Akropol-i m, Aleksandri-a f, Algjer-i m, Algjeri-a f, Alpak/ë-a f, Alpe-t Pl, Amazon-i m, Amerik/ë-a f, Ande-t Pl, Angli-a f, Antarktid/ë-a f, Anvers/ë-a f, Apenine-t Pl, Arbëri-a f, Argjentin/ë-a f, Atik/ë-a f, Atlantik-u m, Athin/ë-a f, Australi-a f, Austri-a f, Azerbaixhan-i m, Azi-a f, Ballkan-i m, Cejlon-i m, Çikago-ja f, Danimark/ë-a f, Dardanele-t Pl, Holand/ë-a f, Iliada f, Kazakistan-im, More-ja f, Stamboll-i m, Tiran/ë-a f, Turqi-a f, Xhakart/ë-a f, Xhamajk/ë-a f etj.).

Përfshirja e këtyre klasave emërtimeve në një fjalor të tillë gjithsesi ka sjellë, nga ana tjetër, mungesa të ndjeshme në njësi të së njëjtës paradigme, pra, ka krijuar vende të zbrazëta në sistem [p.sh në klasën e emrave të përveçëm: janë *armen-i m* e *armenisht/e-ja f*, mungon *Armeni-a f*; është *asirian-i m*, mungon *Asiri-a f*; është *Firenc/e-ja f*, mungojnë *Milan,-i, Rom/ë-a f, Selanik-u m ...*; janë *ilir-i m* e *ilirisht/e-ja f*, mungon *Iliri-a f*; është *napolitan-i m*, mungon *Napol-i m*; është *Venedik-u m*, mungon *Veneci/e-ja f*; është *Venezuel/ë-a f*, mungon *venezuelas-i m* etj.; por më të shpeshta janë mungesat në sistemin e pasqyrimin të çerdheve fjalëformuese: është *arqipel-i m*, mungon *arqipelag,-u m*; është *artish/e-a f*, mungojnë *artis tr* e *artisur (i) Adj*; është *arush/ë-a f*, mungon *arushan-e Adj*; janë *asfalt-i m, asfaltim-i m* e *asfaltin tr*, mungon *asfaltuar (i) Adj*; është *atrofi-a f*, mungojnë *atrofizion tr, atrofizim-i m* e *atrofizuar (i) Adj*; është *autokton-i m*, mungon *autoktoni-a f*; është *azil-i m*, mungon *azilant-i m*; është *babëzi-a f*, mungon *babëziar-e Adj*; është *bagëlit tr*, mungon *bagëlitij/e-a f*; është *bak/ër-ri m*, mungon *bakëre-t Pl*; është *balsamos tr*, mungon *balsamosur (i) Adj*; është *baltos tr*, mungojnë *baltosj/e-a f* e *baltosur (i) Adj*; është *bana-*

lizon *tr*, mungon *banalizim-i m*; është *çuçurit itr*, mungon *çuçuritj/e-ja f*; është *eskavator-i m*, mungon *eskavatorist-i m*; janë *ëmbëlsi-a f*, *ëmbëlsir/ë-a f* e *ëmbëlson tr*, mungojnë *ëmbëlsim-i m* e *ëmbëlsuar (i) Adj*; janë *gërgas / gërget tr* e *gërgasës-i m*, mungon *gërgasj/e-a f*; janë *hingëllim/ë-a f*, *hingëllin itr* e *hingëllon itr*, mungojnë *hingëllim-i m* e *hingëllitj/e-a f*; është *imton tr*, mungon *imtim-i m*; është *inat/çi-çie Adj*, mungon *inatçor-e Adj*; është *inatos tr*, mungojnë *inatosj/e-a f* e *inatosur (i) Adj*; është *ledhaton tr*, mungon *ledhatim-i m*; është *llangos tr*, mungojnë *llangosj/e-a f* e *llangosur (i) Adj*; janë *lëndoj tr* e *lëndim-i m*, mungon *lënduar (i) Adj*; është *plazh-i m*, mungon *plazhist-i m*; është *ribashkim-i m*, mungon *ribashkon tr* e *ribashkuar (i) Adj*; është *riedukon tr*, mungon *riedukim-i m*; është *rigon tr*, mungon *rigim-i m*; janë *vijim-i m*, *vijon tr/itr*, *vijueshëm (i)* e *vijueshmëri-a f*, mungon *vijues-e Adj*, edhe si *m*; është *xëgim-i m*, mungon *xigon tr*; është *xëgit tr*, mungon *xëgitj/e-ja f*; është *zhurm/ë-a f*, mungojnë *zhurmon itr*, *zhurmim-i m* e *zhurmues-e Adj*, edhe si *m*; është *zhuzhit tr*, mungon *zhuzhitj/e-a f* e *zhuzhitur (i) Adj* e shumë të tjeraë. Nuk ka rregullsi e sistemorësi të plotë në pasqyrimin e mbemrave prejpesorë dhe të emëzimeve të tyre; pa ndonjë kriter shkencor të dukshëm, nuk janë pasqyruar në “*Fjalor..*” edhe kur aty janë përfshirë foljet dhe emrat foljorë përkatës, edhe kur këta mbiemra dhe emëzimet e tyre kanë zhvillime semantike drejt kuptimeve të figurshme, duke krijuar kështu asimetri brenda çerdheve fjalëformuese (si: *arsimuar*, *i bluar*, *i bredhur*, *i centralizuar*, *i ciflosur* – mungon edhe *ciflos tr*, *ciflosj/e-a f*, – *i çartur*, *i dalë*, *i degëzuar*, *i dëmtuar*, *i dërmuar*, *i dhjerë*, *i errur*, *i ëmbëlsuar*, *i farkëtuar*, *i fekonduar*, *i formuar*, *i fshehur*, *i gatuar*, *i goditur*, *i grimcuar*, *i gjymtuar*, *i helmatisur*, *i harruar*, *i holluar*, *i informuar*, *i kapërcyer*, *i kërcyer*, *i kreshpëruar*, *i lakuar*, *i lënduar*, *i llangosur*, *i mekur*, *i ndohtur*, *i nervozuar*, *i operuar*, *i paguar*, *i përlijtur*, *i punësuar*, *i pushtuar*, *i qullur*, *i rindërtuar*, *i robëruar*, *i rraluar*, *i rrjepur*, *i rrudhur*, *i situar*, *i skalitur*, *i stolisur*, *i shkoqur*, *i shpartallua*, *i shqyer*, *i terur*, *i tredhur*, *i tharë*, *i therur*, *i thyer*, *i varur*, *i vjedhur*, *i vonuar*, *i zbukuruar*, *i zhubrosur*, *i zhvlerësuar* etj.). Edhe mungesa e disa parashtesave me kuptim kategorial të specializuar ka krijuar një shpërejtësim të klasave leksiko-gramatikore të formuara me ato (shih formimet me *anti-*, *auto-*, *ç-*, *mos-*, *pa-*, *para-*, *ri-*, *sh-*, *zh-* etj.). Po japim këtu vetëm shembuj me parashtesat alternative *x/z/c*, që për këtë arsye janë renditur si

njësi të glosarit, edhe pse janë thjesht variante fonetike, madje mjaft të kufizuara në ligjërimi të ngushta jonormative: *xamar/e-ja f* → *zamare*, *xero-ja f* → *zero*, *xink-u m* → *zink*, *xullufe-t Pl* → *cullufe*, *xvar Adj* → *zvarr*, *xverk-u m* → *zverk* etj.; përjashtim janë disa grupe bashkëtingëllore me parashtesat, si: *çf- s.* → *shf-*; *çv- s.* → *shv-*; *xhv- siehe zhv-*; *z. B.* *xhvat = zhvat*; *xhvesh = zhvesh* usw. etj.

b) Është normativ, i përligjur e funksional vendi që zënë *fjalët me strukturë të gjerë semantike*, me shumë njësi frazeologjike, me leksematikë e sintagmatikë të zhvilluar [p.sh. *an/ë-a f* ¹⁶; *ashpër (i) Adj* 3; *ball/ë-i m* 5; *bar-i m* me shumë togfjalësha terminologjike: *bar blete*, *bar ethesh*, *bar mole*, *bar peshku*, *bar pezmi*, *bar plakash*, *bar tamli*, *bar thëllëze*, *bar udhe* etj., sikurse *lul/e-ja f* me shumë togfjalësha terminologjike: *lule bore*, *lule dele*, *lule dhensh*, *lule dielli*, *lule dylli*, *lule gomari*, *lule qumështore*, *lule mos-më-harro*, *lule filxhan*, *lule goje*, *lule gjaku*, *lule kadife*, *lule kumbonë*, *lule kunde*, *lule lakër*, *lule mine*, *lule mustaku*, *lule pashke*, *lule sapuni*, *lule vizhë*, *lule vjeshte* etj.; *bën tr* me leksematikë të gjerë; *bie itr* 13; *del itr* 14; *dor/ë-a f* 6 dhe me leksematikë të gjerë; *hedh tr* 9; *lë tr* 10; *mban tr* 24; *merr tr* 16 dhe me frazeologji të gjerë; *sa Interr pron* 6 dhe me leksematikë të gjerë; *pret* 13 dhe me shumë njësi frazeologjike; *që* 5; *vjen itr* 7 dhe me leksematikë të gjerë; *zë tr* 10 dhe me leksematikë të gjerë etj., ë.

2. Në gramatikë vlejné të trajtohen veçanërisht dy dukuri:

a) *Trajta përfaqësuese e foljeve*, që është zgjedhur si leksemë a si njësi leksikografike. Mungesën e paskajores sintetike në sistemin e strukturës gramatikore të shqipes standarde e vuan, më shumë se struktura sintaksore, leksikografia, e detyruar të zgjedhë e të pranojë një trajtë foljore përfaqësuese si leksemë (në shumicën e fjalorëve sot është zgjedhur zakonisht e tashmja e dëftores në vetë të parë njëjës: *kuptoj*, *ngas*, *shoh...*), “të shkar-kuar” konvencionalisht nga kuptimet gramatikore të mënyrës, të kohës, të numrit e të vetë; ky *Fjalor* ka zgjedhur si trajtë përfaqësuese të foljeve trajtën e vetës III njëjës në kohën e tashme të mënyrës dëftore¹⁷ (p.sh. *af-*

¹⁶ Numri i kuptimeve.

¹⁷ Sami Frashëri, në gramatikën e tij **Shkronjëto e gjuhës shqip**, Bukuresht, 1886, – gramatikë me prirje normëzuese, – këtë funksion ia jep pjesores; në të vërtetë pjesorja është trajta foljore më asnjane nga kuptimet gramatikore të mënyrës, të kohës, të

ron tr, analizon tr, arbitron tr, argëton tr, arkëton tr, armiqëson tr, arnon tr, arratiset refl, arreston tr, arrin itr, asfalton tr, asgjëson tr, asimilon tr, aspiron, ashklon tr, ashpëson tr, atakon tr, athton tr, autorizon tr, avullon tr, blen tr, fshin tr, hipën itr, lëpin tr, lyen tr, merr tr, ndan tr, pret tr, shkrin tr, shqyen tr, than tr, vjen itr, zien tr etj.). Trajta përfaqësuese e zgjedhur (veta III) nënkuptohet edhe për foljet që në tri vetat e para njëjës nuk ndryshojnë (si: *bie itr, gjerr tr, fle tr, kap tr, krip tr, lidh tr, mbjell tr, mbledh tr, mund tr, ndez tr, nxeq tr, nxjerr tr, përcjell tr, qeth tr, rri tr, rrit tr, rrjedh itr, sjell tr, shqep tr, tjierr tr, var tr, vë tr, vjel tr, vjell tr, zë tr, zhvesh tr* etj.).

b) Dihet që sistemësia a sistemorësia është kriter absolut për çdo fjalor në të gjithë përbërësit e tij, veçanërisht në fushë të gramatikës, njëherazi kriter shumë i vështirë për t'u zbatuar plotësisht. Këtë e dëshmuam me disa raste më sipër në fushë të leksikut e të fjalëformimit, kur thuhet sistemi me mungesa të njëjësive e të elementeve leksikore të të njëjtit lloj ose me përfshirjen pjesërisht të atyre që nuk e kanë vendin në një fjalor të këtij tipi. Por ndodh që edhe zbatimi mekanikisht i kriterit të sistemit çon në thyerje të tij, si, f.v., në paradigmen gramatikore kryesisht të disa foljeve, kur nuk mbahet parasysh semantika leksikore ose përdorimi ligjërimor [p.sh. *krua / kronje – si ftua / ftonj, cap / cepinj, shkop / shqep, prak / preqe, kopsht / qipshte*, f.453; *punohem, punohesh, punohesha, punoheshim..* f. 729¹⁸ etj.), por përfshirë edhe rregullsitë e fjalëformimit, siç u dëshmuam më sipër [si: *agushtë (i) Adj, vuajshëm (i) Adj, anijesor-e Adj, artilerik-e Adj, astaron tr, azotuar (i) Adj, çmirëzohet itr, etësuar (i) Adj, horron tr, idhënar-a Adj →idhnak, frikon tr →frikëson, kalor-i m →kalorës, plehim-i m →plehërim, plehon tr. →plehëron, rroton tr < rrotë, vakon tr →vak, xixon itr →xixëllon, xhamtin/ë-a f →xhamllëk* etj.ë. Në leksikografi në disa raste kjo ndodh edhe nën trysninë e gjuhës tjetër.

Në “Fjalor..” janë dhënë si tituj leksikografikë edhe trajta gramatikore fjalësh, kur janë supletive, të parregullta ose me ndryshime fonetike të thella në eptim (*asaj Pers Pron, Dem Pron Gen Dat Abl →ajo; asish*

numrit e të vetës. Përveç kësaj, pjesorja është temë prodhuese trajtëformuese e fjalëformuese themelore në shqipen.

¹⁸ Te fjalorët shpjegues të shqipes trajta pësosore e kësaj foljeje jepet vetëm në vetën III: *punohet* (shih p.sh. **Fjalor i gjuhës së sotme shqipe**, 1980, f. 1572 ose **Fjalor i gjuhës shqipe**, 2006, f. 859).

Pers Pron, Abl →ata; *atë Pers Pron, Dem Pron Akk* →ai od →ajo; *atij Pers Pron, Dem Pron Gem Dat Abl* →ai; *çakenj Pl* →çakall; *çori Aor* →çjerr; *doli Aor* →del; *dha Aor* →jep; *dhashë I Pers Sg Aor* →jep; *dhen Pl* →dele; *dhënë Prt* →jep; *dhizte Imperf* →dhez; *erdhi Aor* →vjen; *ffjeti Aor* →fle; *gjërpinj Pl* →gjarpër; *herq Pl* →hark; *herqe-t Pl* →harqe; *hëngri Aor* →ha; *hoqi Aor* →heq; *hamenj alt Pl* →hamall; *ik Imp* →ikën; *ji Imp* →është; *lashë I Pers Sg Aor* →lë; *moli Aor* →mjel; *pashë I Pers Sg Aor* →shoh; *qe Aor* →është; *qe Pl* →ka; *rashë I Pers Sg Aor* →bie; *tori Aor* →tjerr; *thashë Pers Sg Aor* →thotë; *venë 3. Pars Pl Präs* →vete; *vërgenj Pl* →vargër; *voli Aor* →vjel; *vulli Aor* →vjell; *yj Pl* →yll etj.).

3. **Në drejtshkrim** “*Fjalori*” ndjek rregullat e standardit, por jep dhe disa variante fonetike sipas shqiptimit në ligjërim të zakonshëm [p.sh. *ahe-re Adv* →atëherë, *ajr-i m* →ajër, *andezja / andezaj Adv* →andej, *anëma-las-i m* →anamalas, *ap tr* →jep, *arësy/e-ja f* →arsye, *arqitekt-i m* →arkitekt, *arrish/ëm (i) Adj* →i arritshëm, *atej Adv* →andej, *auktor-i m* →autor, *bajg/ë-a f* →bagël, *çakërit tr* →çakarit, *çevre-ja f* →çerve, *ffoll/ë-a f* →fqollë, *ffongo-ja f* →fjongë, *flë itr* →fle, *gjëlpër/ë-a f* →gjilpërë, *herr tr* →harr, *hor-i m* →horr, *idhulltar-i m* →idhujtar, *kalaqafë Adv* →kaliqafë, *kapërxen tr* →kapërcen, *mulkon tr* →mëlkon, *tradhëti-a f* →tradtiti, *tradhëton tr* →tradtton, *plazh/ë-a f* →plazh, *vente Imperf* →vete, *xixëllonj/ë-a f* →xixëllojë, *zjarrm-i m* →zjarr, *zjarrmtë (i) Adj* →i zjarrtë etj.), por edhe disa variante fonetiko-fjalëformuese (si: *baltim/ë-a f* →baltinë, *balla-ballas Adv* →ballaballë, *ballafaqas Adv* →ballafaqe, *ballazi Adv* →ballaballë, *ballëhapur Adj* →ballëhapët, *ballomaxhi-u m* →ballomatar, *çair-i m* →çajre, *dhemshuri-a f* →dhemburi, *mërdhacan-e Adj* →mërdhac, *molëz-a f* →molë, *ortakëri-a f* →ortakí, *tradhtor-i m* →tradthtar, *voll-i m* →voltë, *zdruckthton tr* →zdrugon, *zeg/ël-li m* →zekth etj.).

Në rrafshin e dukurive dalluese kryesore dialektore “*Fjalori*” jep pak variante drejtshkrimore, kryesisht me alternancën *ë/e* [*dhëmb itr* →dhemb, *ëngj/ëll-lli m* →engjëll, *gdhënd tr* →gdhend, *gjëndet rfl* →gjindet, *gjëndj/e-a f* →gjendje, *gjërë (i) Adj* →i gjerë, *mënd-i m* →mend, *mënç/ëm (i), -me (e) Adj* →i mençëm, *mëndj/e-a f* →mendje, *shënj/ë-a f* →shenjë, *shënt-i m* →shenj, *vëmëndj/e-a f* →vemendje, *vënd-i m* →vend, *zëm/ër-ra f* →zemër etj.ë, por nuk jep variante dialektore me 5-6 alternancat fonetike dalluese më kryesore dialektore kategoriale, si *â/ë, n/r, ue/ua, vo/va, me*

asimilim të grupeve zanore e bashkëtingëllore, si edhe me paskajoren e gegërishtes.

Emrat e përveçëm, ndajshitesat (si: *çf*, *çv*- etj.), trajtat gramatikore të fjalëve dhe variantet fonetike-drejtshkrimore të të njëjtave fjalë, që në “*Fjalor..*” janë renditur alfabetikisht si të gjitha fjalët në korpusin shqip, e ulin ndjeshëm numrin 30 000 fjalëve të vëllimit të tij. Megjithatë, me disa fjalë më të përgjithshme dialektore, me fjalët e huaja (edhe orientale) me gjerësi e frekuencë të ngushtë përdorimi në shipen e sotme standarde, me variantet fonetike e fjalëformuese të disa fjalëve, me emrat e përveçëm, me trajtat e parregullta të disa fjalëve të eptueshme “*Fjalori..*” përmbush funksionin informues për variacionet, gjithsesi edhe përtej standardit, të dalluara edhe me mënyrën e shpjegimit me referim, çka mbështet gjykimin që ai është hartuar me destinacion përdoruesin gjermanishtfolës, pa ia mohuar vlerat edhe për përdoruesit shqipfolës¹⁹. “*Grammatik*” dhe “*Tabellen*” në fund të fjalorit natyrisht janë vënë për përdoruesit gjermanishtfolës. Nëse hartuesit do të kishin synimin që këtë fjalor ta hartonin kryesisht për përdoruesit shqipfolës, këto grupe paradigmatiche nuk do të përfshiheshin fare (përveç trajtave supletive) ose do të ishin shumë të kufizuara. Te “*Fjalor frëngjisht – shqip*” i Vedat Kokonës, p.sh., nuk pasqyrohen këto klasa njësisish gjuhësore, çka do të thotë se është hartuar me synimin për shqipfolësit, por u jep edhe frëngjishtfolësve në fillim një gramatikë të shkurtër (“*Petite grammaire albanaise*”, f. 21-35)²⁰. Sipas këtij koncepti të tipologjisë leksikografike, po të pranojmë orientimin e autorëve të “*Fjalorit..*” drejt përdoruesit gjermanishtfolës, mund të përligjet disi përfshirja e këtyre dukurive, veçse vëllimi i tij është gjithsesi i pamjaftueshëm për t’i paraqitur të gjitha rastet të plota e në sistem, pa krijuar mungesa të ndjeshme në çdo dukuri, që e thyejnë sistemorësinë.

Duke përmbledhur vetëm të metat e këtij fjalori, duhet të themi që, në të vërtetë, ato ndeshen, në përmasa të ndryshme, edhe në fjalorë të tjerë dygjuhësh, të hartuar zakonisht duke shfrytëzuar fjalorët e mëparshëm

¹⁹ Në teorinë leksikografike njihet që fjalorët dygjuhësh (A – B ose B – A) mund të hartohen me destinacion të vacantë për folësit e gjuhës A ose B e anasjellas (A – B për folësit e gjuhës A ose për folësit e gjuhës B; po ashtu tipi B – A për folësit e gjuhës B ose për folësit e gjuhës A).

²⁰ Vedat Kokona, **Fjalor shqip – frëngjisht** (35 000 fjalë), Tiranë 2005.

(shpjegues e dygjuhësh) e me ndihmesat vetjake të autorëve. Nga ana e metodologjisë shkencore, në leksikografinë shqiptare mungojnë ende formatet leksikore për fjalorë kryesisht dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj, tipash të ndryshëm që, të mbështetura në Kartotekën e leksikut të shqipes (tashmë të informatizuar)²¹, të përmbajnë glosarë me fjalë të përzgjedhura sipas frekuencës së tyre, normës gjuhësore, fushës së përdorimit dhe tipit të fjalorit sipas vëllimit, formate prej 3 000, 5 000, 10 000, 15 000, 20 000 a më shumë njësisish leksikore. Projekti për formate të tilla leksikografike, i mundshëm dhe i patentueshëm institucionalisht, siguron shkencërisht glosarin shqip për çdo fjalor dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj.

²¹ Nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

BIBLIOGRAFI LEKSIKOGRAFIKE

1. I. R. von Xylander, **Die Sprache der Albaner oder Schipetaren**, Frankfurt am Main, 1835 (me një Fjalor gjermanisht – shqip e shqip – gjermanisht, rreth 3000 fjalë)
2. Johann Georg von Hahn, **Albanesische Studien**, Jenë, 1854, 144 faqe (me një *Fjalorth shqip – gjermanisht e gjermanisht – shqip*)
3. Gustav Meyer, **Kurzgefasste albanische Grammatik mit Lesestücken und Glossar**, Leipzig, 1888, 116 faqe
4. Gustav Meyer, **Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache**, Strasburg, 1891 dhe Leipzig, 1980, 526 f.
5. Gustav Weigand, **Albanesisch – deutsches und deutsch – albanesisches Wörterbuch**, Leipzig, 1914, 179 faqe
6. Louis Arbanas, **Deutsch – albanisches und Albanisch – deutsches Wörterbuch**, Wien – Leipzig, 1916, 182 faqe
7. Anton Merlo, **Fjalorth shqip – gjermanisht dhe gjermanisht – shqip**, Shkodër, 1917, 83 faqe
8. Amelie-Marie von Godin, **Wörterbuch der Albanischen und deutschen Sprache, Band I**, Leipzig, 1930, 419 faqe
9. **Fjalor shqip – gjermanisht**, Korçë, 1943, 32 faqe
10. Hans Krahe, **Die Illyrische Namengebung**, Vyrzburg, 1947, 58 faqe
11. Maximilian Lambertz, **Lehrgang des Albanischen**, Berlin, 1954, 228 faqe
12. E. Heinrich, **Përmbledhje fjalësh gjermanisht – shqip**, Leipzig, 1959, 168 faqe
13. **Sprachführer, Taschenwörterbuch der gebräuchlichsten Ausdrücke und Redewendungen im Albanischen, Bulgarischen, Polnischen, Rumanischen, Russischen, Serbokroatischen, Slliwakischen, Tschechischen und Ungarischen**, Pragë, 1960, 575 faqe (me rezervë për tipin)
14. Oda Buchholz, Wilfried Fiedler dhe Gerda Uhlisch, **Wörterbuch albanisch – deutsch**, Leipzig, 1977 dhe 1992, 739 f.
15. Zef Simoni, **Fjalor gjermanisht – shqip**, Tiranë 1978
16. Armin Hetzer, **Deutsch – albanisches Glossar**, Bremen, 1978, 74 faqe
17. Armin Hetzer, **Albanisch – Deutsches und Deutsch – Albanisches Taschenwörterbuch**, Hamburg, 1991, 682 f.
18. M. Çelmeta, **Fjalor bashkëbisedues shqip – gjermanisht**, Tiranë, 1992, 62 faqe
19. *Shih nr. 14*
20. Olimbi Vito, **Fjalor gjermanisht – shqip**, Tiranë, 1994, 400 faqe
21. *Shih nr. 15*
22. Ćiro Truhelka, **Deutsch – Albanisch Wörterbuch**, Zagreb, 1995, 308 faqe
23. Zef Simoni, **Fjalor gjermanisht – shqip**, Prishtinë, 1995, 565 faqe
24. Ali Dhrimo, Hamlet Bezhani, **Fjalor gjermanisht – shqip**, Wiesbaden, 1996, 2424 faqe
25. Arben Skëndi, **Fjalor praktik (italisht – shqip – anglisht – frëngjisht – gjermanisht – spanjisht)**, Tiranë, 1996, 137 faqe
26. Olimbi Vito, **Fjalor shqip – gjermanisht**, Tiranë, 1996, 460 faqe
27. Bislim Pireva, **Fjalor shqip – gjermanisht**, Prishtinë, 1997, 326 faqe

28. Wilfried Fiedler, Ardian Klosi, *Wörterbuch Deutsch – Albanisch*, Leipzig, 1997, 831 faqe
29. Zef Simoni, *Wörterbuch Deutsch – Albanisch*, Hamburg, 1997
30. Skënder Doku, *Fjalor frazeologjik gjermanisht – shqip*, Tiranë, 1998, 570 faqe
31. Ali Dhrimo, *Fjalor gjermanisht – shqip*, Tiranë, 1998, 1196 faqe
32. Gaqo Karakashi, Vladimir Poçari, *Fjalor ushtarak gjermanisht – shqip*, Tiranë, 1998, 368 faqe
33. Wilfried Fiedler e Ardian Klosi, *Langenscheidt Handwörterbuch – Albanisch , Teil II, Deutsch – albanisch*, München – Wien, 2000
34. Ali Ekmeçiu, Nazmie Behushi, *Fjalor shqip – gjermanisht*, Tiranë, 2001, 648 faqe
35. Ali Dhrimo, *Fjalor gjermanisht – shqip (botim I dytë)*, Tiranë 2002, 1200 faqe
36. Robert Elsie, *Handbuch zur albanischen Volkskultur, Mythologie, Religion, Volksglaube, Sitten, Gebräuche und kulturelle Besonderheiten* (me kufizime tipologjike të leksikografisë)

Remzi PËRNASKA, Paris
Tomorr PLANGARICA, Paris

ALBANISCHE GRAMMATIK E O. BUCHHOLZ-IT DHE W. FIEDLER-IT, PERLË GRAMATOGRAFIE

Përse i qasemi kësaj vepre pas kaq vitesh?

Riqasja pas gati tridhjetë vjetësh nga hartimi e botimi i veprave të tilla si *Albanische Grammatik*, hartuar prej albanologëve të mirënjohur O. Buchholz e W. Fiedler, i vë studiuesit, më së paku, para pyetjesh që bashkë me brendinë e asaj për çka pyetet, bartin mëtimin për ta gjetur përgjigjen edhe përtej asaj brendie.

Vepra të kësaj natyre, që përfaqësojnë modele nga më të përpunuara e më të pasurat në njohuri e shqyrtime, siç janë grammatikat *gjuhësore* (e tillë konsiderohet dhe *Albanische Grammatik* nga shumica e studiuesve që kanë shkruar për të), i qëndrojnë kohës dhe quhen të vlefshme për shqyrtimet në sinkroni, kur dija a njohuritë e pranishme fitojnë moshë vjetërimi të lidhur me hapësira a segmente kohore më të gjera, ngaqë dukuritë shqyrtohen me metodologjitë e konceptet më të qëndrueshme të kohës kur shkruhet vepra; kur natyra e interpretimeve përfaqëson kuota nga më të lartat në çastin e shqyrtimit; kur gjerësia, thellësia, pasuria e informacionit të sjellë rrok kufij që duhet kohë që të tejkalohen; kur shqyrtimi i dukurive ka shkuar deri në themel të ekzistencës së dukurisë, deri pranë të vërtetave të mbajtura si të tilla në një periudhë të caktuar e jo thjesht në një çast shqyrtimi (kur dyshimi i natyrshëm shkencor rreth këtyre të vërtetave kërkon kohë që të përvijohet, për më tepër, vetë zgjidhja të mospranohet); kur dijet a njohuritë marrin natyrë enciklopedike edhe brenda hapësirave a kornizave tekstore të një gramatike, duke mos përbërë “mëkat”, ngaqë motivohet me zgjerimin e përmasës së funksioneve të vetë veprës; kur autorët zotërojnë një bagazh dijeje dhe kontekst shqyrtimeesh shumë më të gjerë se ç’kërkon objekti i drejtpërdrejtë i studimit; kur dija e përçarur është përftuar nga koncepte që në raportet mes tyre kanë përvijuar një sistem harmonik vlerash.

Albanische Grammatik karakterizohet nga kjo tërësi vlerash/ tiparësh, e ndaj riqasja ndaj saj nuk është thjesht për të nderuar e respektuar një punë të bërë më parë.

Kuadri epistemologjik si motivues i moshës së ndryshme të vjetërimit të dijes së ngjizur

Albanische Grammatik u përftua në një kontekst interesant epistemologjik, me zhvillime dukshëm të veçanta në mjedisin e gjuhësisë gjermane, por po aq të larme edhe në vende të tjera europiane e më gjerë; ky kontekst po karakterizohet nga kthesa e kahje shqyrtuese që do të përcaktonin nisjen e etapave të reja në vetë mendimin gjuhësor. Shndërrime të kësaj natyre lidhen me dijen e njohuritë në lëmin e gramatikës, me përvijimin e një larmie më të madhe tipologjike të gramatik-ës/-ave, duke u dalluar *gramatika për mësimin e gjuhës së huaj, gramatika didaktike, gramatika shkollore, fjalori gramatikor*, etj., por duke u zhvilluar më dendurisht *gramatika gjuhësiore*.

Për vepra të tilla si *Albanische Grammatik*, që janë “prodhim i zotërimit shumë të mirë të gjuhës, letërsisë, folklorit dhe letërsisë shkencore gjuhësore shqiptare” (Dhrimo, Përnaska, 1988:1), “ndër veprat bazë të gramatologjisë shqiptare në përgjithësi [...], me qëndrim risimtar në raport me gramatologjinë për shqipen në shumë aspekte të shqyrtimit të çështjeve morfologjike, sidomos në sistemin e foljeve [...] dhe, në fushën e sintaksës, gjithësesi, e para për shumë aspekte të vështrimit” (Ismajli, 2013:13), “mbase burimi më i cituar lidhur me gramatikën dhe gjuhën shqipe në publikimet ndërkombëtare linguistike” (Abrashi, 2013:131), “summum-i i gramatikës shqiptare, sintezë e tërë mendimit gjuhësor shqiptar plus këndvështrime, interpretime, gjetje të reja” (Sadiku, Popa, 2013:19), përveç kompetencës, talentit, vullnetit a përkushtimit në shqyrtime të studiuësve, suksesi duhet parë edhe në faktorë të tjerë të natyrës epistemologjike, e në radhë të parë, i lidhur me natyrën e nivelin e dijes teorike gjuhësore që shërben si bazë teorike në kohën kur vepra shkruhet.

Siç është theksuar, tashmë, strukturën e veprës së tyre albanologët tanë e përvijuan duke njohur e përshtatur për shqipen kahjet e ndryshme teoriko-gjuhësore të suksesshme në shekullin XX, qysh nga gramatologjia

klasike/tradicionale (Helbig-Buscha), e deri te këndvështrimet funksionale, strukturale e shqyrtimet e hershme gjenerative.

Në fakt, hartimi i kësaj vepre mund të shtihet në një kontekst edhe më të pasur epistemologjik, në të cilin zhvillohej mendimi gjuhësor në gjysmën e dytë të shekullit XX, zhvillime të cilat janë të pranishme në vepërën e këtyre dy gjuhëtarëve si dëshmi e kësaj njohjeje. Le të kujtojmë se qysh në fund të viteve 1950, siç është vënë në dukje nga studiuesit, gjuhëtarë të rinj të Gjermanisë Lindore filluan të zbatojnë metoda gjenerativiste për të hulumtuar dukuritë e gjuhës gjermane. E ndërkohë, më parë në Gjermani e pastaj edhe në Francë, Chomsky-i po futej vullshëm. “Lëvizja/kahja gjenerativiste kishte, gjithsesi, arsye të plotë të pëlqej, për aspektin e saj të formalizuar që shkonte përkrah frymës matematizuese dhe kibernetike, për parimet e saj humaniste nga ana tjetër që bënin pjesë në një ideal të arsyes unifikuese dhe në traditën enciklopediste europiane, prej Dekartit te Humboldt, siç Chomsky do ta tregonte vetë në “Cartesian linguistics” të tij” (Chevalier, 1994: 122-123). Por duhet theksuar gjithashtu që është koha kur lidhja mes Gramatikës e Didaktikës kishte përfutur, në tipologjinë e gramatikave, një tip të veçantë gramatike për mësimin e gjuhës së huaj, krahas tipave të tjerë të gramatikave, edhe si reaksion ndaj prirjes disi agresive të pragmatikës që dukej se detyronte të ngushtojë hapësira e Gramatikës për mësimin e gjuhës së huaj.; por që, nga ana tjetër, nxiste po ashtu të përfshiheshin në manualet e gramatikës edhe veçanti të përdorimeve gjuhësore, e në këtë kontekst, njohuri jo aq mirëfilli gjuhësore, e sidomos jo aq gramatikore.

Polisemizmi i fjalës “gramatikë” shfaqet përmes përqasjes së koncepteve të veçanta: gramatikë shkencore/gjuhësiore, gramatikë didaktike, gramatikë shkollore, gramatikë e përdorimeve (krahas asaj gramatikë e gjuhës së huaj). Për më tepër, nisur nga veçantitë e organizimit të formës e përmbajtjes, përvijohen tipa/lloje gramatikash jo vetëm të fjalisë dhe pjesëve të ligjëratës, që i referoheshin sistemit të gjuhës, por edhe “gramatika të tekstit”, ku “integrohet orientimi kah sistemi gjuhësor me përdorimin komunikativ të këtij sistemi – gramatika e Weinrich-ut, për shembull; më 1993, “gramatika komunikative”, që “nuk konceptohet si inventar formash, por si kompleks skemash semantike logjike, format morfosintaksore të të cilave nënrenditen si realizime strukturash sipërfaqësore – të mësosh gju-

hën në këtë rast, do të thotë të mësosh të veprsh e ndërveprsh” (Sadiku, Popa, 2013:17). E e tillë është, për shembull, *Komunikative Grammatik Deutch als Fremdsprache*, 1993 e U. Engel/R. Tortel.

Ishte koha e përhapjes së qëndrimeve të H. Kleineidam-it, njëri prej autorëve më të suksesshëm në fushën e gramatikës së gjuhës së huaj, koha kur dishepujt e tij, pas trysnisë që ushtronte marshimi triumfues i pragmatikës mbi linguistikën, nuk do të vononin të thërrisnin sërish “Grammatica vivat!” (Rroftë gramatika!), ndërsa do të botonin librin me referimet e tyre, në dhjetëvjetorin përkujtimor për H. Kleineidam-in. Ishte koha kur në Gjermani, përmes diskutimeve, po diferencioheshin synimet e funksionet e gramatikave shkencore (që përgjithësisht synojnë të paraqesin stadin e njohurive pa ndonjë qëllim praktik përdorimi, pa ndonjë synim që t’i shërbejë mësimit dhe nxënësit, si në rastin e mësimit të gjuhës së huaj, duke mbetur objekt diskutimi e komunikimi midis gjuhëtarëve, nga gramatika e gjuhës së huaj, e cila paraqitet dhe rregullsitë gjuhësore ia nënshtrojnë rrethanave të procesit mësues, kushteve socio-psikologjike të auditorit, duke u shfaqur kryesisht si gramatikë përdorimore, me qëllime praktike, objekt komunikimi midis gjuhëtarëve dhe të interesuarve; e po ashtu edhe nga gramatika didaktike, me format e ndryshme që e klasifikonte atë G. Zimmerman-i, që përgjithësisht synojnë përshkrimet gjuhësore që lidhen me procesin e mësimit. Është koha kur, së bashku me hapësirën e merituar që po rigjente gramatika e fjalisë dhe e pjesëve të ligjëratës, krahas gramatikës së tekstit e gramatikës komunikative, ku qëllimet dhe praktikat e mësimit të gjuhës së huaj organizohen në modele pragmatiko-komunikative, po përvijojesh edhe tipi i gramatikës me blloqe ushtrimesh të integruara, që kombinon në të njëjtin vëllim përshkrimet dhe ushtrimet gramatikore (Shih edhe Sadiku, Popa, 2013:15). Ishte koha kur përvojat e hartimit të gramatikave po i përafroheshin pohimit të G. Helbig-ut, sipas të cilit “ndryshimi midis një gramatike gjuhësore dhe një gramatike të gjuhës së huaj mund të paraqitet dhe si dallim opozicional: gramatikë problemesh vs. gramatikë rezultatesh”.

Le të kujtojmë, gjithashtu, që jemi në periudhën kur ishte tejet e ndjeshme jehona e *Syntaxe structurale* (1953, 1959) e L. Tesnière-it, objekt i së cilës ishte “analiza e çdo fraze përmes një tufe të hierarkizuar lidhesh mes fjalëve (operacionet e përvijuara përmes *stemmas*-ve); kjo analizë

e përshtatshme për përfaqshjen e gjuhëve i ka çuar studiuesit në përkthimin automatik dhe ka afruar modele për atë çka u quajt *gramatika e varësisë*” (Chevalier, 1994:121); është koha kur, në një hapësirë më të gjerë europiane po ndjeheshin përpjekjet serioze të E. Benvenistit e M. Cohen-it, e sidomos interesimi për gramatikat e destinuara për një publik më të gjerë, studentë, mësues etj. që parashtronin kërkesën për risime në trajtim; ishte koha kur po ndjeheshin dukshëm zgjidhjet e dhëna në këtë fushë nga strukturalistët amerikanë; le të përmendim se ndërkohë edhe në Francë R.L. Wagner-i dhe G. Pinchon-i botonin *Grammaire du français classique et moderne* (1962), të frymëzuar nga një strukturalizëm psikologjizues, ose kur J.-L. Chevalier drejtonte hartimin e *Grammaire Larousse du français contemporain* (1964) më pranë gramatikave të strukturalistëve amerikanë, vepra që i referoheshin historisë dhe letërsisë.

Po ashtu, është ajo periudhë kur përvojat europiane ofronin edhe shembuj të larmishëm të “gramatikave në formën e një fjalori gramatikor a të pjesëve të ndryshme të ligjëratës: për shembull, Michel Arrivé do të pilotonte një *Grammaire d’aujourd’hui* më 1986, *Guide alphabétique de linguistique française*, që të dyja duke pranëvënë gramatikën dhe gjuhësinë. Po ashtu, më 1965, një specialist i leksikut publikonte një seri prej katër pjesësh të gramatikës frënge të frymëzuar prej strukturalizmit amerikan (“Le nom et le pronom, le verbe ...”) e gjithnjë e më shumë me vështrim nga gjenerativizmi (Chevalier, 1994:122).

Në këtë kuadër epistemologjik formësohet e hartohet *Albanische Grammatik* që motivon praninë jo vetëm të përshkrimeve gjuhësore të një-sive e dukurive të ndryshme fonetike, morfologjike e sintaksore, por njëhe-razi të integruara në to edhe aspekte formale, semantike e pragmatike, e deri në përkujdesjen për t’i lënë vend në analiza dhe elementeve që mbizotërojnë në proceset komunikative gjuhësore, me vendin e domosdoshëm të folësit në përfitim të kategorive morfosintaksore në shqyrtim.

Jo thjesht gramatikanë kompetentë, por dhe gjuhëtarë të talentuar e të mirinformuar

Suksesi e jetëgjatësia e dijës së përçaruar nga *Albanische Grammatik* ka si motivues edhe një tregues tjetër të rëndësishëm: e konceptuar përmes

përzgjedhjeve e mbështetjeve teorike të suksesshme të kohës, vepra u hartua nga dy albanologë me kompetenca të shfaqura e të vërtetuara në kërkimin gjuhësor, nga dy albanologë, të cilëve studimi i gjuhës dhe i duku-rive të ndryshme sistemore të saj, në lëmin e morfologjisë e sintaksës, por po aq edhe në fusha të tjera, u kishte krijuar profilin e gramatikanëve modernë, të aftë e largvajtës në shqyrtime. Vijimi i kërkimit nga ana e tyre edhe pas botimit të kësaj vepre, e përforcoi a e plotësoi edhe më tej këtë profil. Kontributi i tyre erdhi në një kohë kur kërkimet në fushë të gramatikës kishin përvijuar një tjetër status, madje edhe një tjetër staturë edhe për vetë gramatikanin; statura e tyre si gramatikanë u shkonte pikërisht përmasave të reja që parakuptonte manteli i gramatikanëve modernë, për të cilët, qysh me Sosyrin, “gjuha është një sistem që duhet kuptuar në funksionimin e saj në një çast të caktuar të kohës dhe që gjen në vetvete parimin e saj të shpjegimit; nuk ka vend për ta kërkuar atë gjetkë, në veçanti në psikologji ose në logjikë. Gramatika bëhet përshkruese dhe sinkronike. Në mënyrë korrelative, roli i gramatikanit ndryshon.” (Flaux, 1997: 16). “Për ta thënë fare thjesht “zhibiriluesi i përdorimit/gréffier de l’usage” (gramatikani) është bërë filozof që do të mëtonte t’u impononte një logjikë të paluhatshme fakteve të ligjërit, pastaj një historian që do të ndiqte në vargëzimin e tyre/në njëpasnjëshmërinë e tyre transformimet e një idiome, më së fundi, një lloj natyralisti që do të vëzhgonte dhe përshkruante në tërësinë e saj gjendjen e një gjuhe në një epokë të caktuar, pa lënë mënjane në të origjinat, as prirjet, por pa dashur t’i gjykojë këto, as të kuturisë t’i modifikojë ato”. A nuk i përngjasojnë shqyrtimet e dy albanologëve tanë, me përvijimin e sistemeve, nënsistemeve, varësive edhe më të imta sistemore, me shënimet e pafundme për ta ndjekur dukurinë në plotërinë e shfaqjes, e ngjizjes së saj, me zhytjen në histori e endjen në sinkroni këtij misioni që parakupton gramatikani modern?

Por ata ishin njëherazi dy albanologë, të cilëve u rrinte po aq për shtat edhe manteli i gjuhëtarit modern. Le të kujtojmë se veprimtaria studimore e Oda Bucholz-it si gjuhëtare në fushë të studimit të shqipes rrok gati tërë strukturën gramatikore të shqipes së sotme, problemet e funksionimit të gjuhës letrare, e po ashtu edhe të përvijimit të proceseve të formimit të saj a shqyrtimeve në lëmë të leksikologjisë e semantikës me vështrimin kah leksiku shoqëror, etj. Madje qysh më 1969-ën ajo kishte vënë një qokë

tejet të dukshme në mendimin tonë gjuhësor, me disertacionin e doktoratës së saj “Mbi përsëritjen e kundrinës në shqipen”, për të cilën prof. R. Ismajli shprehet: “Rezultatet e shumta në këtë punë i japin librit të saj statusin e veprës së parë serioze dhe të thelluar në këto punë, primatin e studimit gjithnjë jo të tejkaluar dhe të veprës së parë gjenerative – transformacionale për shqipen” (Ismajli, 2013: 486).

Janë po aq domethënëse e vlerëplota edhe angazhimet e W. Fiedlerit në fushën e kërkimeve gjuhësore, duke lënë gjurmë tejet të dukshme në hapësirat e gjera të saj, me shqyrtime model të dukurive në diakroni (le të kujtojmë studimin e tij për Buzukun – *Sistemi foljor shqip në gjuhën e Gjon Buzukut*) ose në sinkroni (le të sjellim ndër mend studimet për *shumësinë në gjuhën shqipe*), me vështrime me kënd të gjerë përkapjeje të dukurive në thellësi të kohërave, duke tentuar me sukses shqyrtime të aspekteve e të treguesve tipologjikë të shqipes, në përfaqje me gjuhë të tjera të Ballkanit; e po ashtu përkapje të gjerë të problematikës në sinkroni, ndërsa shqyrtohen aspekte të ndryshme të shqipes standarde, madje struktura e gjuhës në treguesit ndër më kryesorët të saj, me zgjerime vështrimesh në hapësirat ballkanike; e në këto hapësira, endja e shqyrtimi nuk është thjesht në drejtim të njëjësive të sistemit gramatikor, por edhe të dukurive të tjera të natyrës leksikore e semantike (le të kujtojmë fjalorët shqip-gjermanisht e gjermanisht-shqip apo përkthimet nga shqipja në gjermanisht); për më tepër, nuk do t’i mungonte këtij kontributi edhe një përmasë tjetër, ajo e mësimdhënies së shqipes për gjermanët. Është një kontribut kompleks për të cilin W. Fiedler-i “hyn në radhën e të mëdhenjve të albanologjisë gjermanishtfolëse e me këtë të albanologjisë në tërësi, siç janë J. G. von Hahn, G. Meyer, N. Jokl, M. Lambert, që përbëjnë historinë e kësaj shkence, dhe qëndron ndër më të rëndësishmit të kësaj dijeje të kohës sonë” (Ismajli, 2013:11-12).

Është domethënëse natyra komplementare e kontributeve të këtyre dy albanologëve dhe e sikletshme e stresuese përpjekja për të hierarkizuar vlerën e kontributeve të tyre. Gjithsesi, është vërtet një rastësi e lume (ndoshta edhe jo) ajo çka mundësoi që dy albanologët e niveleve sipërore të bashkërendonin energjitë krijuese e kërkimore e të kishin prodhime shkencore të përbashkëta, mes të cilave edhe *Albanische Grammatik*.

Veçanti të ngjizjes së veprës dhe vlera që i japin asaj jetëgjatësi

Përbëjnë vlerë për një gramatikë:

- Përzgjedhjet strukturore të cilat e drejtojnë përkujdesjen në përfundimin e një tipi gramatike që bëhet funksionale për synimet e hartimit dhe funksionet që vepra do të përmbushë në lidhje me përdoruesit e saj. *Albanische Grammatik* u strukturua si një vepër që do t'i përngjasonte tipit të gramatikave gjuhësore, akademike a universitare, por si e tillë do të kishte edhe hapësirat e bollshme për të integruar dije e njohuri që zhvillojnë kompetencën përdoruese gjuhësore, karakteristike kjo e gramatikave për mësimin e gjuhës së huaj; e po ashtu edhe të vështrimeve përfaqëse mes shqipës e gjermanishtes, duke integruar natyrshëm në atë hapësirë edhe elemente kontrastive. Modelet e përfuara në atë ndërkohë, përvojat e hartimit të këtij tipi gramatike i jepnin siguri përpjekjes së guximshme të autorëve për një gramatikë të tillë, ku dinamizmi shfaqej si veti e dukurive të shqyrtuara, dhe heterogjeniteti i njohurive shfaqej si nevojë e përmbushjes së funksioneve të synuara; kjo veçanti, ua ka shtuar peshën specifike shqyrtimeve dhe njohurive të pranishme.

-Integrimi dhe harmonizimi i përvojave teorike, të cilat ndihmojnë për shqyrtimin dhe interpretimin e dukurive gjuhësore, duke mundësuar, sipas specifikave, ndriçim e paraqitje sa më të mirë të tyre. Autorët e *Albanische Grammatik* ishin zotërues të sigurt të atyre përvojave teorike dhe arritën t'i harmonizojnë ato në shqyrtimet e përshkrimet e bëra. Kjo bazë e gjerë metodologjike i ka zgjeruar dhe i ka bërë më të larmishme qasjet e tyre ndaj dukurive. Madje ky harmonizim i ka dhënë gramatikës veçanti metodologjike, ku janë të pranishme jo thjesht kategoritë e paradigmat gjuhësore, por edhe qasjet komunikative e pragmatike, përtej përshkrimit të njësisive të sistemit. R. Ismajli thekson: “(...) Duke u mbështetur në kriteret e standardet e larta të gramatologjisë gjermane, autorët kanë ditur të integrojnë në veprën e tyre për shqipen aspektet formale e semantiko-pragmatike në fushat e morfologjisë, ndërtimin dhe përbërjen e njësisë minimale strukturore të fjalisë apo kompleksitetin hierarkik të zhvilluar të saj më tej, llojet e fjalisë, tipologjinë më të suksesshme që kemi njohur deri sot, shqyrtimin e intencave të folësit në këtë kuadër makrosintaksor, po edhe rezultatet e vështrimeve teorikisht të ndryshme të studimeve linguis-

tike nga gramatologjia tradicionale e shekullit XX (Helbig-Buscha) nëpër vështrimet funksionale e strukturale e deri tek vështrimet e hershme gjenerative” (Ismajli, 2013:488).

-Prireja e përgjithësimin të arritjeve e përvojave të studimit të shqipes, prireja për të qenë sintezë e tërë mendimit gjuhësor shqiptar, summum i gramatikës shqiptare. Vepra është jo thjesht frut i zotërimit shumë të mirë të gjuhës, letërsisë e folklorit shqiptar, por edhe i letërsisë shkencore gjuhësore: ajo është mbështetur në një literaturë të larmishme të dokumentuar – në vepra kodifikuese, studime dialektologjike, fjalorë, etj.; në bibliografinë e saj të pasur (302 zëra) janë 212 punime në shqip; janë të pranishme aty veprat madhore si *Fonetika dhe Gramatika e gjuhës së sotme shqipe (Morfologjia 1976, Fonetika dhe Sintaksa e fjalisë, 1983)*, kontributet e shumta shkencore të cilat janë botuar në *Studime Filologjike, Gjuha jonë, Gjuha shqipe* (Prishtinë), etj, etj. Sipas autorëve, në këtë gramatikë është pasqyruar edhe zhvillimi i njësimit të gjuhës shqipe në Kosovë.

-Prireja për të sjellë informacion sa më të gjerë, analitik, por njëherazi tejet funksional të natyrës enciklopedike gjuhësore, të palidhur ngushtë, në pamje të parë, me përshkrimin e kategorive e paradigmave gjuhësore, por të vlefshëm për të shpjeguar zanafillat, kushtëzimet e kontekstin e funksionimit të tyre, shkaqet e motivimit e dinamizmit të dukurive. Brenda kësaj mënyre konceptimi mbeten funksionale njohuritë e sjella për shqipen si degë e veçantë e gjuhëve indoeuropiane (pasuese e ilirishtes, me elemente të trakishte-dakishtes), për ndarjen dialektore (e nëndialektore) të shqipes; përmes analizës së tipareve dalluese të dialekteve e nëndialekteve të shqipes, për historinë e gjuhës së shkruar shqipe (me fillime të mundshme në shekullin XIII-XIV), kalimin nga periudha parakombëtare në atë kombëtare, rrugën e shkrimit të saj deri në Kongresin e Manastirit, me kontributin mbizotërues të toskërishtes përgjatë Rilindjes, e me ngulmimin në etapën e tretë (1944 deri sot), ku vërehet kristalizimi i një norme të njësuar, duke pasur për bazë variantin letrar të toskërishtes.

-Për një gramatikë, përbëjnë vlerë sidomos disiplinimi i një materiali tejet të bollshëm për dukuritë gjuhësore, kategoritë e paradigmata gjuhësore, me një harmonizim mjeshtëror të qasjeve induktive në paraqitje, por edhe deduktive në qëndrime e vlerësime.

Le të kujtojmë paraqitjen e ngjeshur e të plotë të sistemit fonologjik

të shqipes dhe të dukurive të ndryshme fonetike, e cila jo pak herë ka orientim problemor dhe merr natyrën e një lënde që mund të konsiderohet si një lloj hyrjeje në fonetikën e fonologjinë e gjuhës shqipe. Trajtohen aty dukuritë që kanë të bëjnë me sistemin e fonemave zanore e bashkëtingëllore të shqipes, zëshmëria dhe mungesa e saj, pavarësisht nga pozicioni i bashkëtingëllores; janë formuluar rregulla të qarta për ndarjen e fjalëve në rrokje, për të gjitha modelet strukturore dhe për tingujt nistorë dhe fundorë të rrokjes në gjuhën shqipe. Në mënyrë konvencionale autorët paraqesin fjalën si njësi grafike, e cila është e ngulitur në ndërgjegjen e folësit dhe që pjesërisht nën ndikimin e grafikës është edhe njësi fonetike. Janë trajtuar dhe paraqitur në mënyrë interesante edhe problemet e kufirit të fjalëve, të ndarjes në rrokje, strukturës së formanteve, të theksit të fjalës (karakterit i theksit dhe vendi i tij); dhe të intonacionit të fjalisë (fjalët ndihmëse ata nuk i trajtojnë si njësi fonetike të pavarura, por si të tilla, që dalin në lidhje me « fjalë të plota ») (Dhrimo, Përnaska, 1987 :3).

Për sa i përket klasifikimit të pjesëve të ligjëratës, autorët ndjekin në thelb ndarjen e pranuar në gramatikat shqipe, por në dallim nga këto, ata fillojnë me foljen pikërisht për shkak të rolit qendror që ajo luan në fjali. Duke qenë se shqyrtimet e përshkrimet e dukurive morfologjike e sintaksore përbëjnë lëndën mbizotëruese të pranishme në veprën, po japim informacion më të gjerë për to.

Në krahasim me pjesët e tjera të ligjëratës, folja në këtë gramatikë është trajtuar më gjerësisht. Pas konsideratave të përgjithshme përmenden shkurtimisht foljet ndihmëse (*kam, është* dhe *do, lipset*), foljet modale të detyrimit, të dëshirës, të mundësisë, të nxitjes, të dispozicionit, foljet shkakore dhe ato që shërbejnë për përshkrimin e mënyrës së veprimit ose të fushave të ngjashme, si dhe shprehjet foljore dhe foljet që shfaqen vetëm në formën joveprore.

Flitet gjithashtu për forma foljore të shtjelluara dhe të pashtjelluara. Për të parat autorët dallojnë format sintetike (me pesë nënklasa) dhe dy lloje të formave analitike (me folje ndihmëse dhe me pjesëza).

Autorët merren edhe me të ashtuquajturat grupe foljore (tetë grupe të veçanta - grupi i foljeve me elementin urdhëror: *filloje, thuaja*; me elementin dëshiror: *t'u mpiftë*; me elementin habitor: *s'të paskemi kuptuar*; me elementin e së tashmes ose të së pakryerës: *A mos nuk është/ishte ai?*;

me elementin lidhor: *të mos i pritej dot*; me elementin e aoristit: *desh u rrëzua*; pa element të shtjelluar: *në mos mbaruar ... , pa përmbajtur, duke mos u përmbajtur dot*; konstruktionet me “paskajore sekondare”: *la së vështruar*).

Në këtë gramatikë, në ndryshim nga gramatikat shqipe, foljes i njihen gjashtë zgjedhime dhe pikërisht: me temë në zanore (I); me temë në bashkëtingëllore (II); me temë në zanore me mbaresë zero (III); një zgjedhim i veçantë për foljen *ec-i* (IV); me temë që e ka fonemën fundore të ndryshueshme (V) dhe një zgjedhim i veçantë për foljen *vete* (VI).

Shqyrtime të imtesishme janë bërë për mënyrat e foljes në gjuhën shqipe. Për trajtimin e dëftores veprare autorët kanë bërë paraqitje të plotë dhe të detajuar të të gjitha formave të kohëve të ndryshme të kësaj mënyre. Këtu kemi vëzhgime dhe vërejtje të vlefshme për çdo dukuri, për ndërtimin, shtrirjen dhe rregullsinë e çdo forme. Autorët e kanë quajtur të përshatshme të marrin si formë bazë atë të vetës së tretë (jo të vetës së parë) njëjës (pa mbaresat përkatëse).

Po ashtu edhe lidhorja ka gjetur një pasqyrim të plotë dhe të hollësishëm. Autorët i pranojnë edhe “format habitore të lidhore” (Buchholz, Fiedler, 1987:85): *të lakam, t’u lakam*.

Saktë dhe në mënyrë të hollësishme analizohen format dhe funksionet e habitores; për këtë formë përshkruhen edhe ndërtimet sintaksore.

Një paraqitje të plotë gjejnë format e pashtjelluara (pjesore, gerund). Gerundi nga pikëpamja sintaksore shihet si një homolog i saktë i privativit (*pa larë, duke larë*). Po kaq hollësisht analizohen ndërtimet dhe funksionet e formave *me punue, për të punuar*. Ndërtimi *me të + pjesore* përshkruhet si Absolutiv I, *një të -f- pjesore* si Absolutiv II, ndërsa format e gjuhës së folur *të ndiemen* si Absolutiv III.

Trajtim të mirë kanë parashtruar autorët në gramatikën e tyre për kalimtarësinë dhe jokalimtarësinë (Buchholz, Fiedler, 1987:183-192).

Në pjesën e tretë trajtohen gjerësisht “të lakueshmet” (emri, përemri, mbiemri dhe numërori). Njya shqyrtohet e pavarur në format dhe funksionet e saj përkatëse; me të drejtë, asaj i njihet edhe funksioni fjalëformues, sikurse edhe prej gramatikanëve shqiptarë. Më tej analizohet në mënyrë të hollësishme emri me kategoritë e veta gramatikore. Duke qenë se autorët i kanë vënë vetes për detyrë të pasqyrojnë gjendjen e formave në krejt gju-

hën shqipe dhe jo vetëm në gjuhën letrare, nuk kanë shmangur një shumësi të pakristalizuar formash.

Një ndër paragrafët më të qartë dhe më të saktë është ai që merret me kategorinë e numrit (Buchholz, Fiedler, 1987:244-267). Aty trajtohen të gjithë emrat që janë *singularia tantum*, *pluralia tantum* dhe emrat kolektivë; sipas mënyrës së ndërtimit të shumësit janë dhënë grupime të bazuara shkencërisht. Shumë mirë janë hulumtuar sufikset e shumësit të emrave, diferencimet e kushtëzuara kuptimore midis formave dyshe të shumësit dhe vetë emrit, si dhe rastet e koincencës mes dy antonimeve.

Kapitulli mbyllet me lakimin, ku njihen katër lakime (1. dhe 2. për mashkullorët, 3. për asnjësit dhe 4. për femërorët). Në përputhje me qëllimin e veprës disa dukuri janë trajtuar aty shumë hollësisht. Si elemente formëformuese pranohen *-ish*, *-it*. Gjithashtu sqarohet edhe kur emri merr *-të*, *-sh* ose *-it*, *-ish*.

Edhe përemrat i nënshtrohen një shqyrtimi të gjerë (Buchholz, Fiedler, 1987:274-313). Njihen dhjetë përemra, ndër të tjerë edhe përemrat identifikues, përemrat reciprokë dhe përemrat determinativë (në gramatikat tona këta trajtohen pak dhe jo si grup më vete). Funksionet dhe kuptimi i tyre janë dhënë shumë mirë, sikurse edhe parafjalët që i shoqërojnë dhe rastet në të cilat ata nuk duhet të përfshihen në fjali. Bashkimi dhe shkrija sikurse pozicioni i trajtave të shkurtra të përemrave vektorë nuk trajtohen në morfologji.

Një analize të mirë i nënshtrohet mbiemri i gjuhës shqipe (Buchholz, Fiedler, 1987:314-348). Kategoritë e tij gramatikore trajtohen hollësisht (për shkak të paravendosjes dhe shkallës, atij i njihet edhe kategoria e shquarsisë). Me kujdes dhe saktësi shqyrtohen ndërtimi i formës emërore, formimi i shumësit, lakimi, si dhe shkalla dhe mjetet përkatëse.

Hollësisht trajtohet edhe konteksti sintaksor i emërzimit kontekstual dhe të pavarur të mbiemrit. Shqyrtohen edhe fjalët që janë emra dhe mbiemra (*plak*, *punëtor*, *hero*, *trim*) si dhe emrat (*djall*, *dreq*, *bazë*, *vëlla*, *motër*, *bosht*), të cilët funksionojnë si mbiemra. Siç dihet, këto raste në gramatikën tonë trajtohen si konversion.

Po kaq hollësisht dhe mirë trajtohen edhe numërorët.

Pjesën e katërt dhe të fundit të morfologjisë e përbëjnë pjesët e pa-

lakueshme të ligjëratës (ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe fjalët e ndërmjetme) (Buchholz, Fiedler, 19873 :61-404). Edhe kjo pjesë e gramatikës është një hulumtim i tërësishëm, duke u përqendruar në përdorimin sintaksor të këtyre pjesëve të ligjëratës. Me shumë vëmendje hetohen rastet dhe situatat në të cilat përdoret çdo pjesë ligjëratare. Me shumë vlerë, sidomos për lexuesin e huaj, janë listat e plota të parafjalëve dhe lidhëzave, në të cilat jepen edhe kushtëzimet përkatëse në përdorimin e tyre. Në mënyrë të detajuar jepen edhe pjesëzat dhe fjalët e ndërmjetme, me grupimet e sakta semantike dhe me të dhënat e pasura mbi kushtet sintaksore të përdorimit të tyre. Me vlerë është edhe specifikimi i formulave të përshëndetjes dhe falënderimit dhe të fjalëve të barasvlershme me fjalinë.

Pjesa V, diçka më shumë se çereku i veprës, i kushtohet sintaksës. Mund të pohohet pa asnjë mëdyshje, se sintaksa është e kudopranishme. (Ajo është e pranishme në ilustrimin e përdorimit të formave dhe në distribucionin e tyre të trajtuara në morfologji). Ky trajtim i gjërave flet për nivelin e lartë teorik të autorëve, të cilët me anë të kësaj vepre dëshmojnë se zbatojnë parimet dhe kriteret e shkencës gjuhësore bashkëkohore. Shkurt, mund të thuhet që kjo është një sintaksë moderne e gjuhës shqipe, e cila njëkohësisht dëshmon edhe kufizime të vetë teorisë gjuhësore së zbatuar.

Në hyrjen e ngjeshur prej dy faqesh, pranohen si njësi sintaksore fjala (njësia më e vogël, përk. elementare), grupi i fjalës (njësia e ndërmjetme) dhe fjalia (njësia më e lartë), të cilat shihen si përbërës të një rendi më të lartë. Kështu lidhen fjalët në grupe. Grupet e fjalëve njëfunksionale sipas funksionit të tyre shihen si përbërës sintaksorë: pjesë të gjymtyrës përk. gjymtyrë fjalie, ose si përbërës sintaksorë të një rendi më të lartë. Grupet e fjalëve dyfunksionale trajtohen si përbërës sintaksorë sipas grupit emëror, parafjalor, mbiemëror, ndajfoljor, foljor, ndërtimit foljor, sifjalisë së nënrenditur. Nacione të tilla janë zbatuar në të gjithë sintaksën.

Përcaktorit emëror i kushtohen rreth 20 faqe (Buchholz, Fiedler, 1987: 409-427). Është interesante të vërehet se autorët e fillojnë analizën e kategorive sintaksore me përcaktorin, pikërisht në një vepër, ku morfologjia fillon me foljen.

Kallëzuesi përkufizohet si folje mbizotëruese, e cila ndërton qendrën strukturore-sintaksore të fjalisë. Pasi flitet shkurt për kallëzuesin, pasi ai

është trajtuar gjerësisht (gjenerativisht) në morfologji të kapitulli i foljes, si strukturë bazë edhe për gjuhën shqipe pranohet ndërtimi *Kryefjalë + Kallëzues*. Nga kjo formë minimale e fjalisë gjenerohen edhe fjalitë-gjymtyrë. Kryefjala përkufizohet si gjymtyrë e fjalisë, e cila përshtatet me foljen e shtjelluar, një përshtatje që analizohet hollësisht në këtë kapitull. Në përputhje me konceptin gjenerativist, jepen rastet, kur kryefjala hiqet, ose kur ajo nuk hiqet.

Kundranori është trajtuar mbi bazën e një materiali faktik tepër të gjerë dhe me një nivel të lartë shkencor. Ky është një ndër kapitujt e trajtuar më mirë dhe më plotësisht prej autorëve. Ai është rezultat i një studimi të plotë monografik.

Fjalisë si strukturë minimale, strukturës së saj komplekse dhe gjymtyrëzimit të saj hierarkik, i kushtohet po ashtu shumë vëmendje. Struktura minimale e fjalisë trajtohet në varësi të valencës së foljes. Minimumi gramatikor i fjalisë përfshin gjymtyrët e domosdoshme: kallëzues, kryefjalë dhe gjymtyrët predikative, ndërsa ndërtimi kompleks përfshin të gjitha gjymtyrët e fjalisë, si ato të domosdoshmet, ashtu edhe jo të domosdoshmet. E gjithë kjo jepet në modelet e fjalive të paraqitura në 115 tipa ndërtimorë, analiza e të cilëve zë pjesën më të madhe të këtij kapitulli (për një lexues të zakonshëm nuk është e lehtë të ndjekë formulën e fjalisë, pasi jepen gjymtyrë të domosdoshme, fakultative dhe jo të domosdoshme).

Konceptet gjenerativiste dhe transformimet e tyre, të cilat zënë vend në pjesën V të kësaj gramatike, dëshmojnë se autorët nuk janë vetëm hulumtues shkencorë të gjuhës shqipe, por edhe shqipfolës të vërtetë. Dhe ja arsyeja: një autor me formim teorik mund të zbatojë një taksonomi të plotë (gjë që në gramatikën në fjalë është bërë më se kënaqshëm), ai mund të zhvillojë analiza distributive, por ai nuk mund të kryejë gjithmonë dhe në të gjitha rastet transformata reale. Është e ditur që transformata ofron mundësi të besueshme në një gjuhë natyrore (për rastin tonë në gjuhën shqipe), dhe kjo mund të realizohet lehtësisht nga një gjuhëtar, i cili nuk e ka gjuhë nëne gjuhën që përshtatet. Në gjuhë nuk ekziston simetria, megjithatë algjebriçimi gjenerativist synon plotësimin e simetrisë, gjë që çon drejt shembujve të pabesueshëm për një gjuhë dhe të besueshëm për një gjuhë tjetër dhe anasjelltas. Ky “mëkat” i ka rënduar autorët e kësaj gramatike në

shumë pak raste. Këtë ata e kanë arritur me vullnet të madh dhe falë konsultimeve me njerëzit, që gjuhën e përshkruar e kanë gjuhë nëne. Kemi edhe një shtresë të gjerë dhe interesante transformash, të cilat për disa janë të besueshme, për disa të tjerë më pak të besueshme dhe për të tjerë jo të besueshme. Dhe këtu ata dëshmohen më të zotë se një shqipfolës i zakonshëm, në të vërtetë edhe me ndonjë gabim, për të cilin edhe një shqiptar nuk do të skuqej.

Në mbyllje

Albanische Grammatik zë një vend nderi e të merituar në hapësirën e mendimit gjuhësor shqiptar, si vepër e përftuar nga përputhje jo të zackonta kushtesh të kërkimit e prodhimit shkencor; vepër e dy autorëve të cilët kanë një formim të plotë e të qëndrueshëm shkencor, njohje të thelluar të traditës gjuhësore, por edhe kahjeve a shkollave bashkëkohore të gjuhësisë; për më tepër, njohje të thelluar të shqipes e vullnet për shqyrtime të imtësishme të dukurive gjuhësore e paradigmatiche të shqipes. Këto parakushte mundësuan përfundimin e një veprë që bart të përgjithësuara përvojat e shqyrtimit të shqipes, e njëherazi edhe përvojat, gjetjet e interpretimet vetjake të autorëve, për më tepër, futjen në interpretime të kahjeve e shkollave të suksesshme të gjuhësisë së shekullit XX – përkujdesjen e skajshme, pra, për të analizuar deri në imtësi dukuritë morfologjike, duke i ndriçuar edhe përmes vështrimeve formaliste, strukturale e pragmatike, ose dukuritë sintaksore me synimin e nxjerrjes në pah të veçantive të ngjizjes e shfaqjes së tyre edhe përgjatë përdorimit; një vepër që u mundësoi atyre të përshkruajnë edhe sistemin fonetik të shqipes, por edhe aspekte diskursive e komunikative jo thjesht në lidhje me normën standarde, por edhe më gjerë. Një vepër që vendoset denjësisht në fondin e gramatikave gjuhësore të shqipes, por edhe të dijes gjuhësore me karakter më të gjerë enciklopedik, një vepër, shkëlqimi i së cilës veçse spikat më dukshëm, sa më shumë i qasemi dhe e shqyrtojmë

Historia e gramatologjisë përvijohet si e tillë ngaqë veprat, në caqe të caktuara kohore (dhe në një këndvështrim edhe në hapësira të caktuara) përfaqësojnë sinorë të periudhave të caktuara, të gjendjes e zhvillimit të gjuhëve, duke u shndërruar njëherazi edhe në dëshmi jo thjesht të dukurive

përkatëse gramatikore a gjuhësore, të prirjes normëzuese në etapa e hapësira të caktuara, por edhe të nivelit të arritur në shqyrtim. Si të tilla, veprat e kësaj natyre bartin veçantinë e dijes së përftuar ndërkohë, por kanë të bartur edhe një tregues tjetër të rëndësishëm: me gjerësinë, thellësinë, mprehtësinë e ndërliqjen në shqyrtim, ato i zgjerojnë veprës përkatësinë në kohë, duke u vënë në raport jo thjesht me të kaluarën dhe të tashmen e ngjizjes së tyre, por edhe me të ardhmen, një hapësirë që në vitet ndjekëse pas botimit e mban veprën me statusin e aktuales në shqyrtime, dhe jo thjesht si një ngjarje që arshivohet natyrshëm e lehtëazi në të shkuarën, në histori.

Albanische Grammatik u ngjan modeleve të veprave që gëzojnë këtë status. Duke e titulluar kumtesën tonë “Albanische Grammatik ... – perlë gramatografie”, kemi parasysh edhe këto vlera që shfaqen pavarësisht nga koha e përfimit, edhe këtë “pakohësi” që shoqëron brendinë e dukurisë e vlefshmërinë e saj.

BIBLIOGRAFIA

- Abrashi, T. (2013), "Kontributi i Oda Buchholz-it në gjuhën shqipe" në *Materialet e punimeve të Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 19-30 08. 2013, faqe 131-138.
- Buchholz, O. (2014), "Dr. sc. phil. Oda Buchholz, Listë e botimeve", në *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, faqe 491-494.
- Buchholz, O., Fiedler, W. (1987), O. Buchholz, W. Fiedler: *Albanische Grammatik*. Leipzig 1987, 5-582.
- Chevalier, J.-C. (1994), *Histoire de la grammaire française*, Que sais-je, Presses Universitaires de France.
- Fiedler, W. (2014), "Profesor dr. Wilfried Fiedler, München-Berlin-Jena, Botimet shkencore", në *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, faqe 20-32.
- Flaux, N. (1997), *La grammaire*, Deuxième édition, Que sais-je, Presses Universitaires de France.
- Hamiti, V. (2013), "Modaliteti dhe mundësitë e shprehjes së tij sipas Albanische Grammatik të Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it", në *Materialet e punimeve të Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 19-30 08. 2013, faqe 203-210.
- Ismajli, R. (2014), "Në traditën e madhe të albanologjisë gjermane" në *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, faqe 11-19.
- Ismajli, R. (2014), "Oda Buchholz (1940-2014) In memoriam" në *Studime*, Revistë për studime filologjike, 20, 2013, faqe 485-490.
- Koskoviku, B. (2013), "Sintagma foljore sipas autorëve gjermanë Buchholz-Fiedler" në *Materialet e punimeve të Seminarit XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 19-30 08. 2013, faqe 197-202.
- Dhimo, A., Përmasa, R. (1987), Recension mbi Oda Buchholz-Wilfried Fiedler, *Albanische Grammatik*, Berlin (DDR), S. 582.
- Petiot, G. (2000), *Grammaire et linguistique*, Armand Colin, SEDES.
- Sadiku-Teichman, E. Popa, G. (2013), Grammatikat e shqipes si gjuhë e huaj, koncepte, përshkrime, analiza në *Revista shqiptare e studimeve arsimore*, volumi I, Nr. 1, f. 9-24.
- Vargas, C. (2014), *Les grammaires scolaires, De la recombinaison à la reconfiguration*, *Langues et langage*, Presses Universitaires de Provence.

Teuta ABRASHI, Prishtinë

NDAJSHTIMI I PAVEÇUAR - DISA ÇËSHTJE NË RRAFSHIN SINTAKSOR DHE SEMANTIK¹

1. Hyrje

Kontributi i gjuhëtarëve gjermanishtfolës në gjuhësinë shqiptare ka qenë dhe është i konsiderueshëm. Ai luan një rol të rëndësishëm dhe zë një vend të veçantë, qoftë në studimet diakronike e po ashtu edhe në studimet sinkronike të gjuhës shqipe. Përveç kësaj, këto kontribute janë njëkohësisht me përplot analiza kontrastive ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjermane. Padyshim se ato paraqesin një bazë solide dhe një burim shumë të vlefshëm, sidomos për studentët shqipfolës të gjuhës gjermane. Në disa raste këto analiza mund të rishikohen dhe thellohen por, nëse paraqitet nevoja, ato mund eventualisht të modifikohen, por edhe të avancohen. Një rishikim gjegjësisht modifikim të tillë do ta bëjmë me pohimin e Gerda Uhlisch, e cila, gjatë një analize kontrastivo-tipologjike², pohon se ndajshtimi në gjuhën shqipe përputhet tërësisht për nga forma dhe përmbajtja me ndajshimin në gjuhën gjermane.

Para se të fillojmë me analizë, duhet të themi se ky konstatim i Uhlisch është për së paku tri arsye paksa i papritur: (i) ajo në faqen 113 të disertacionit të saj pohon se do t'i shmanget ballafaqimit me ndajshimin dhe e përmend atë dhe ndërtimin e tij përciptazi, vetëm si një rast të veçantë të përcaktorit, (ii) problematika e ndajshimit apo apozicionit, siç do të dëshmohet më poshtë, është tejet e komplikuar dhe ngatërruese, dhe (iii) lehtësia e një konstatimi të tillë, përkundër faktit se në gjuhësinë gjermane, por dhe të tjerat (p. sh. angleze), nuk ka ndonjë pajtueshmëri të plotë se ç' kup-

¹ Disa pjesë të kësaj analize janë prekur pjesërisht edhe në konferencat ndërkombëtare të DIMOS (Deutsch In Mittel-, Ost- und Südosteuropa), vitin e kaluar (2016) në Regensburg dhe sivjet (2017) në Prishtinë. Punimi në Regensburg është në botimi e sipër (Abrashi (në botim)), kurse ai i Prishtinës është në proces të botimit (Abrashi (në proces të botimit)).

² Uhlisch (1982)

tojmë me konceptin apozicion dhe si është i ndërtuar gjegjësisht ç'strukturë sintaksore ka ai. Lidhur me arsyen (ii) mund të themi se kjo problematikë në literaturë është bukur e rrahur, por pavarësisht këtij fakti, shumë çështje kanë mbetur ende të hapura. Këtu po sjellim konstatimin e gjuhëtarit me prejardhje hungareze nga Gjermania, Vilmos Agel, i cili në librin e tij rreth analizës gramatikore të tekstit (2017), konstaton se në gramatikën gjermane, vështirë se ekziston një dukuri më problematike dhe më e ngatërruar sesa e ndajshtimit (Agel 2017: 773)³. Për këtë konstatim ai nuk është i vetmuar. Ngjashëm mendon edhe Peter Eisenberg, i cili në ribotimin e gramatikës së tij (Eisenberg 2013), ripohon se në gramatikën e gjuhës gjermane ende nuk ka një konsensus se çka nënkuptohet me ndajshtim (Eisenberg 2013: 256)⁴. Po i njëjti konstatim del edhe nga studimi i Schindler (1990), por edhe te studimet e mëhershme siç është p. sh. Mollitor (1979) etj. Ngjashëm është edhe në gjuhën angleze. Kështu p. sh. Acuna-Farina, një ndër studiuesit më të cituar rreth problematikës së ndajshtimit në gjuhën angleze, konstaton në një punim të botuar së voni (2006), se në gjuhën angleze ende nuk ka pajtueshmëri për çështje themelore si p. sh. ndërtimi dhe struktura e të ashtuquajturit ndajshtim të paveçuar⁵. Një fakt të tillë e dëshmon edhe monografia e Meyer (1992) e gjithashtu edhe punimi i mëhershëm i Burton-Roberts (1975) etj.

Duke marr parasysh kompleksitetin e kësaj problematike si dhe duke mos pretenduar për të shterur të gjitha çështjet e hapura të përfolura nga gjuhëtarët e sipërpërmendur, analiza jonë do të tregojë se ndërmjet ndajshtimit të gjuhës shqipe dhe atij të gjuhës gjermane, ekzistojnë dallime si në rrafshin sintaksor e po ashtu edhe në rrafshet tjera të gjuhës.

2. Disa njohuri të përgjithshme rreth ndajshtimit

Tradicionalisht ndajshtimi konsiderohet një konstrukcion gjuhësor ndërmjet dy përbërësve apo gjymtyrëve emërore. Njëri konsiderohet gjym-

³ "In der deutschen Grammatik gibt es kaum einen verwirrenderen Phänomen- und ungelösteren Problembereich als den der sog. Appositionen" (fq. 773)

⁴ Es besteht keine Einigkeit darüber, was unter »Apposition« zu verstehen ist. (fq. 256)

⁵ The concept of apposition remains an obscure notion despite the fact that it has figured prominently in the history of grammar. Modern grammatical frameworks have done very little if anything to clarify it ... (fq. 1)

tyrë bosht, kurse tjetri është ndajshtimi. Lidhja ndërmjet këtyre gjymtyrëve mund të jetë e veçuar dhe e paveçuar. Në gjuhën e folur veçimi i lidhjes bëhet me pauzë (apo heshtje të shkurtë) para se folësi të thotë ndajshtimin, kurse në gjuhën e shkruar ky veçim bëhet zakonisht me presje. Lidhja e paveçuar ndërmjet këtyre dy gjymtyrëve emërore në gjuhën e folur konstituon në një njësi intonacioni të vetme dhe gjymtyrët nuk veçohen me ndonjë heshtje apo pauzë. Në gramatikat e gjuhës shqipe, ndajshtimi te konstruktet me lidhje të ndashme quhet ndajshtimi i veçuar, kurse ai me lidhje të pandashme quhet ndajshtim i paveçuar. Në këtë punim do të përqendrohemi vetëm te ndajshtimi i paveçuar, i cili sipas gramatikës së Akademisë është lloji më i përhapur i ndajshtimit⁶.

Si në gramatikat e gjuhës shqipe e po ashtu edhe në gramatikat e gjuhës gjermane dhe angleze, ndajshtimi konsiderohet si një rast i veçantë i përcaktorit gjegjësisht atributit. Kështu supozon edhe Uhlisch (1979: 113). Konstruksioni me ndajshtim të paveçuar zakonisht shfaqet si një lidhje me bashkim ndërmjet dy emrave: emri bosht dhe ndajshtimi. Mirëpo në vend të emrit bosht mund të shfaqet edhe përemri. Ndajshtimi hyn në relacion me gjymtyrët e tjera të fjalisë vetëm nëpërmjet gjymtyrës bosht dhe në këtë mënyrë është (tërthorazi) pjesë e të gjitha funksioneve gramatikore, të cilat mund ti bartë një sintagmë nominale në kuadër të fjalisë. Përtej fjalisë, funksioni i tij është pikësepari informativ⁷. Ai jep informata shtesë për një

⁶ f. 237.

⁷ Një analizë e funksionit të ndajshtimit të paveçuar përtej fjalisë, për dallim nga gjuha gjermane dhe angleze, mjerisht në gjuhën shqipe ende nuk është bërë. Sikur të ishte bërë, atëherë, përveç tjerave, po supozoj se do të ishte më e qartë se pse një lloj apo konstruksion i caktuar i ndajshtimit të paveçuar në një zhanër dhe kontest të caktuar është më i preferuar se një tjetër. Për fat të keq në gjuhën shqipe nuk ka gjithashtu një analizë se te cilat zhanre tekstore apo në cilin diskurs përdoret më shumë apo më pak ndajshtimi. Por, nëse merren parasysh rezultatet e analizave për gjuhën gjermane dhe angleze, atëherë mund të supozohet se ndajshtimi është shumë më shumë i pranishëm p. sh. te reportazhet gazetareske sesa gjatë bashkëbisedimit ndërmjet dy bashkëbiseduesve përball njëri tjetrit (Shih p. sh. Acuña-Fariña 1994: 322). Shpjegimi logjik i një përdorimi më të madh në rastin e reportazheve gazetareske është se njohuritë e përbashkëta ndërmjet folësit dhe participantëve të diskursit, ose më mirë të themi folësi ka bindjen, se në këtë konstalacion diskursiv njohuritë e përbashkëta janë shumë më të vogla sesa ndërmjet dy participantëve të cilët që më parë e njohin njëri tjetrin. Rrjedhimisht, kur dy bashkëbisedues komunikojnë, shumë shpesh nuk ka nevojë për informata identifikuese ose informata shtesë për koncepte sapo të futura në bisedë. Lidhur me funksionin dhe llojin e ndajshtimit të paveçuar përtej fjalisë, shih më gjërësisht Abrashi (në proces të botimit).

entitet në diskurs, duke ngërthyer kështu nuanca informative përshkruese apo nuanca informatave identifikuese për emrin bosht. Përdorimi i një mjeti të tillë gjuhësor (për dallim nga përcaktori) nuk shërben për të kufizuar sendin (subjektin) e të folurit, por ai përdoret për të dhënë më shumë informacion për sendin tashmë të përcaktuar në diskurs⁸. Thënë ndryshe, ky mjet gjuhësor nuk kontribuon drejtpërdrejt në funksionalitetin e sintagmës emërore të ngërthyer brenda saj. Por, kjo nuk do të thotë se fjala është për një informacion dytësor apo një informatë më pak relevante ose në pikëpamje komunikative të panevojshme. Jo rrallë, këto mjete bartin informata të rëndësishme, madje ironike e qëllimkëqija (apo qëllimmira), të cilat në këtë pozicion nuk pohohen në mënyrë eksplicite, por ato thjesht përfshihen gjatë të folurit⁹.

Sidoqoftë, si rrjedhim i përmbushjes së funksionit të një informacioni shtesë, ashtu siç u specifikua më lart, të dy përbërësit e konstruksionit me ndajshtim ishte dashur ti referohen po të njëjtit entitetit. Këtë fakt e theksojnë shumica e gramatikave të gjuhës shqipe dhe të gjuhës gjermane. Për gjuhën shqipe po e parafrazoj Domin (1971:22) i cili në sintaksën e tij pohon se ndajshtimi bënë të shënuarit e të njëjtit njeri a send me fjalë të ndryshme nga emri bosht apo përemri. Ngjashëm pohon edhe Gramatika e Akademisë 2 (2002: 216) dhe e Becit (2005:223). Po kështu është edhe te gramatikat e gjuhës gjermane. Këtu po përmendim gramatikën e Eisenbergut (2013: 259) dhe Helbig-Buscha (1996:606) të cilat e potencojnë një dukuri të tillë. Disa gramatika të tjera, si p. sh ajo e Institutit të Gjuhës Gjermane në Mannheim gjegjësisht Zifonun (1997: 2014), mendon se ko-referenca ndërmjet emrit bosht dhe ndajshtimit mund të realizohet vetëm

⁸ Si dëshmi se sendi është tashmë i pranishëm në diskurs mund të shërben edhe prania e njëjës shquese te gjymtyra (emri) bosht, e cila mungon te sendet e sapo të futura në diskurs. Në këto raste (zakonisht) është e pranishme nyja jo shquese (*një*).

⁹ Për të ilustruar funksionin ironik apo afirmativ të ndajshtimit po marrim konstruksionin ndajshtimor *politikani filozof* dhe lidhur me këtë krahaso p. sh. komentin ironik te Artur Zhejit per Edi Ramën: "... në përpjekje për të krijuar një aureolë speciale prej *politikani filozof*..." (<https://www.faxweb.al/rama-kalon-nga-misteri-i-vdekjes-te-skuadronet-zgjedhore-te-vdekjes/>) dhe komentin afirmativ të Enver Robellit per Arben Xhaferin: "...Arbën Xhaferi *politikani-filozof*... model i ditëve tona ..." (<http://www.fjala.info/arkiv/fjala2/2012/08/21/enver-robelli-trefen-per-arben-xhaferi-varrimi-shkel-e-shko-tani-e-mistifikojne-ata-qe-e-injoronin/>) (Theksimi nga T. A.). Shiko gjithashtu shembullin e Priftit (1971: 101): *Afiz Pasha kryelopa*. Kurse rreth një komenti eventual didaktik të ndajshtimit shiko Hoffmann (2013: 202).

nëpërmjet relacionit kallëzuesor. Te kjo gramatikë lidhja kallëzuesore është identike me lidhjen këpujore ndërmjet kryefjalës përkatësisht përemrit anaforik të kryefjalës dhe plotësit emëror të këpujës. Kështu p. sh. te konstrukcioni ndajshtimor:

(1) Komisari Memo.

ku *komisari* është emri bosht ndërkaq *Memo* është ndajshtimi, lidhja kallëzuesore për të cilën pretendon gramatika e institutit, është:

(2) Komisari **është** Memo.

apo, nëpërmjet përemrit anaforik të kryefjalës:

(3) Komisari-**ai është** Memo.

Arsyeja se përse disa gramatika nuk e pranojnë ko-referencën e drejtpërdrejtë është se ato pretendojnë se lidhja ndërmjet emrit bosht dhe ndajshtimit e kufizon më ndryshe ekstensionin apo, siç e quan Prifti (1971: 96), shtrirjen e konceptit të emrit bosht, se sa përcaktori, që në esencë përputhet me komentin didaktik rreth ndajshtimit (si informacion shtesë) që u tha më lart. Thënë ndryshe, lidhja kallëzuesore apo predikative preferohet për të treguar se ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit nuk ka lidhje atributive sikurse te përcaktori, por vetëm predikative. Mirëpo, për shkak të strukturës së qartë asimetrike kryekëput të nënrenditur ndërmjet të dy gjymtyrëve në gjuhën shqipe, lidhja predikative nuk jep ndonjë zgjidhje siç jep në gjuhën gjermane, e cila shfaq tendenca të një strukture të renditur.

3. Analiza në rrafshin sintaksor e morfologjik

Një veti karakteristike e ndajshtimit të paveçuar është se ai nuk lakohehet dhe mbetet gjithnjë i pasqur në rasën emërore, pavarësisht se në ç'rasë është emri bosht:

(4) a. Ky është *komisar* Memoja. Dies ist *Kommissar* Memo. (NOM)

b. Një propozim i *komisar* Memos. Ein Vorschlag *Kommissar* Memos. (GEN)

c. Ne i besojmë *komisar* Memos. Wir vertrauen *Kommissar* Memo. (DAT)

d. Ne e përjashtuam *komisar* Memon. Wir verjagen *Kommissar* Memo. (AKK)

e. Këtë se prisnim prej *komisar* Memos. (ABL)

Siç vërejmë në shembullin (4), kështu ndodh në të dyja gjuhët¹⁰: ndajshtimi gjegjesisht emri i përgjithshëm *komisar* në gjuhën shqipe dhe *Kommissar* në gjuhën gjermane nuk e ndërron formën në asnjë rasë. Por, kështu nuk ndodh edhe me emrin bosht gjegjesisht me emrin e përveçëm *Memo*. Ai ndërron formën e tij në të dy gjuhët, rrjedhimisht lakohet. Por për shkak të sinkretizmave ky lakim nuk është i dallueshëm në secilën rasë. Në gjuhën shqipe na shfaqen tri forma (*Memoja*, *Memos* dhe *Memon*), kurse në gjuhën gjermane vetëm dy (*Memo* dhe *Memos*), të cilat dallohen nëpërmjet mbaresave rasore. Në gjuhën shqipe këto mbaresa rasore janë format rasore të njëjës së prapavendosur, prania e së cilës është e domosdoshme edhe te emrat e përveçëm. Kurse, në gjuhën gjermane mbaresa e vetme rasore e shfaqur, është mbaresa rasore e emrit në gjinore (-s), e cila na lë të kuptojmë se emri lakohet, përndryshe për shkak të rrafshimit të mbaresave në rasat e tjera lakimi nuk është i dukshëm. Por, nëse në këtë gjuhë emri nuk është i përcjell nga nyja shquese proklitike, atëherë kjo mbaresë rasore është karakteristike vetëm për emrat e përveçëm, sepse në këtë gjuhë këta emra nuk shfaqen me nyja. Prandaj, duke marr parasysht shembullin (4) dhe atë që u tha më sipër, konstrukcioni me ndajshitim në emërore ka këtë strukturë sintaksore:

- (5) a. [[NP_{NOM}] + [NP_{NOM} + DET_{NOM}] (për gjuhën shqipe) dhe
 b. [NP_{NOM}] + [NP_{NOM}] (për gjuhën gjermane)

me ç'rast NP paraqet sintagmën emërore të përbërë nga një emër të pa përcaktuar, si një send me kuptimin e vet më të përgjithshëm, i cili barazohet me tiparin e një predikati. Kurse DET paraqet njëjën, roli i së cilës është të konkretizon këtë kuptim të përgjithësuar të emrit duke e shndërruar atë nga një tipar në një send apo në një entitet konkret. Rrjedhimisht, duke bashkuar [NP + DET] = [DP] fitohet një sintagmë e re, e cila quhet sintagmë determinante¹¹ dhe paraqet sintagmën e një emri të konkretizuar në një diskurs të caktuar. Kurse në rrafshin sintaksor, ndajshtimi del në emëroren e pashquar në të dy gjuhët, që në fakt për nga forma është një emër identik si një emër pa mbaresë rasore [Ø], prandaj në vend të [NP_{NOM}] atë po e shë-

¹⁰ Shih Beci (2005: 223) për gjuhën shqipe dhe Eisenberg (2013: 259) dhe DUDEN (2016: 994) për gjuhën gjermane (Titel und Eigennamen: Zusammenfassung)

¹¹ Lidhur me sintagmën determinante shih Koleci/ Turano (2011: 65-67)

nojmë me [NP_Ø]¹². Si rrjedhojë, struktura sintaksore në (5) merr formën:

(6) a. [NP_Ø] + [DP_{NOM}] (për gjuhën shqipe), dhe

b. [NP_Ø] + [NP_{NOM}] (për gjuhën gjermane)

dhe në shikim të parë, krahasimi i strukturave ndërmjet dy gjuhëve shfaq një dallim ndërmjet strukturave sintaksore të konstruksioneve ndajshimore të shqipes dhe gjermanishtes. Mirëpo, nëse kihet parasysh se pozicioni D (koka e sintagmës determinante¹³) sipas Longobardit (1994) është pozicioni ku vendoset nyja si dhe lokusi ku realizohet funksioni i argumentit të një sintagme emërore, atëherë vetëm lidhja e sintagmës emërore (NP) me këtë pozicion e kualifikon atë për të kryer funksionin e kryefjalës brenda fjalisë, qoftë nëpërmjet tiparit [+R]¹⁴ ose zhvendosjes së vet sintagmës emërore në këtë pozicion. Thënë ndryshe, pozicioni D e shndërron sintagmën emërore (NP) në sintagmë determinante (DP), e cila vetëm si e tillë (pra si DP) mund të zë pozicionin e kryefjalës së fjalisë. Në gjuhën shqipe një shndërrim i tillë realizohet vetëm nëpërmjet lidhjes, sepse në shqipe asnjë sintagmë nominale nuk mund të kualifikohet për të kryer funksionin e kryefjalës pa qenë e pranishme nyja¹⁵ apo ndonjë tjetër përcaktor ekuivalent¹⁶, madje

¹² Buhholz/Fiedler (1987:423) rasën e ndajshimit e quan *merkmallose Kasus*, që shqip mund të përkthehet (fjalë për fjalë) si rasë pa tipare., Prandaj këtë veti po e shënojmë këtu me [Øë], që si simbol shënon diçka të zbrazët. Lidhur me këtë çështje shih edhe Bhatt (1990: 65), e cila emëroren e pashquar e quan formë rasore e pamarkuar e gjuhës gjermane (die unmarkierte Kasusform des Deutschen)

¹³ Rreth kokës së sintagmës emërore në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane Shih Abrashi (2009)

¹⁴ Referencës

¹⁵ Lidhur me këtë çështje në këtë punim do të ndjekim Buchholz/Fiedler (1987: 235) sipas të cilëve: "Wenn das Subst Subjekt des Satzes ist, kommt im Alb. der Ø-Artikel nicht in Frage (Kur emri është kryefjalë e fjalisë, nyja-Ø (nyja zero TA.) në gjuhën shqipe nuk vjen fare në konsiderim. Përkthimi T. A.).

¹⁶ Pohimi i Çelikut (2012: 139) se në gjuhën shqipe funksionin e kryefjalës mund ta kryejnë edhe emrat të pa shoqëruar me nyja apo me një caktuesor (siç i quan ai) qoftë në njëjës apo në shumës si p. sh. *Makinë ndaloi para universitetit /Makina ndaluan pranë universitetit*, është i papritur dhe kujtoj se kërkon sqarime dhe elaborim shtesë nga autori, qofshin këta dy shembuj edhe një përgjigje, siç thotë ai në fq. 95, në pyetjen: *A ndaloi/ ndaluan makinë/ makina apo autobus pranë universitetit?* Sepse konsideroi, se pa përfshirjen eventualisht të emrit të dytë (*autobus*) në përgjigjen e pyetjes së lartpërmendur: *Makinë (e jo autobus) ndaloi pranë universitetit apo Pranë universitetit ndaloi makinë (e jo*

kështu duhet të jetë edhe atëherë kur sintagma është e përbërë nga një emër i përveçëm. Arsyeja pse në gjuhën shqipe shndërrimi i NP në DP mund të bëhet vetëm nëpërmjet të lidhjes e jo edhe nëpërmjet të zhvendosjes është e parapërcaktuar me shkallën e gramatikalizimit të nyjës shquese në gjuhën shqipe. Nëpërmjet analogjisë përdorimi i saj është shtrirë pa përjashtim edhe tek emrat e përveçëm¹⁷, prandaj edhe sikur (kushtimisht) të bëhet zhvendosja e NP (p. sh. emrit të përveçëm) në pozicionin D, pa praninë e nyjës ajo nuk mund të kualifikohet për të kryer funksionin e kryefjalës gjegjësisht të shndërrohet në DP.

Edhe në gjuhën gjermane shndërrimi mund të bëhet nëpërmjet lidhjes, sepse edhe gjermanishtja ka nyja. Mirëpo jo gjithnjë ky shndërrim është i mundshëm nëpërmjet lidhjes, sepse siç u tha, te emrat e përveçëm nyja rregullisht mungon¹⁸. Rrjedhimisht, në këtë rast shndërrimi nga NP në DP nuk mund të bëhet nëpërmjet lidhjes, por vetëm nëpërmjet zhvendosjes. Sipas Longobardit (1994), zhvendosja e NP në pozicionin D në gjuhët të cilat nuk kanë nyja me emrat e përveçëm bëhet rregullisht, sepse (përveç të tjerave) ky pozicion tek emrat e përveçëm nuk është i zaptuar nga nyja. Kështu ndodh edhe te gjuha gjermane, te e cila emri i përveçëm nga pozicioni më i ulët sintaksor NP, ngjitet në pozicionin më të lart sintaksor D, me ç'rast NP shndërrohet në DP. Duke kaluar në këtë pozicion dhe duke fituar statusin sintaksor për marrjen e funksioneve, emri i përveçëm "kualifikohet" edhe për t'u lakuar¹⁹. Se (eventualisht) kështu ndodh, flet

autobus) vështirë se është në përputhje me strukturën informative të fjalisë së gjuhës shqipe, por edhe të gjuhëve të tjera. Kështu p. sh. në gjermanishte vetëm në rast kur renditen së paku dy emra të përgjithshëm është e mundshme që nyja të mungon: *Mit diesem Kabel Sie können (ein) Computer und (ein) Drucker verbinden* (Me këtë kablo ju mund të lidhni (një) kompjuter dhe (një) shtypës ndërmjet veti.). Në gjuhën gjermane këta shembuj konsiderohen si përdorim eliptik i sintagmës emërore (DUDEN 2016: 902). Meqë të gjithë shembujt të cilët Çeliku jep si dëshmi (kur kryefjala mund të jetë një emër pa nyja apo pa ndonjë përcaktor) përfshijnë drejtpërdrejt apo tërthorazi më shumë se një emër, unë besoj se këto janë gjithashtu raste sikurse ato të gjuhës gjermane, pra një përdorim eliptik i sintagmave emërore, të disa emrave të renditur pa nyjën (jo) shquese.

¹⁷ Demiraj (1986: 301)

¹⁸ Ndryshe qëndron puna te të folmet dialektore ku nyja e shquar është e pranishme rregullisht edhe me emrat e përveçëm. Shih rreth kësaj çështje Gallman (1997)

¹⁹ Shih Gallman (1997:72), i cili për emrat e përveçëm të gjuhës gjermane thotë: " The

edhe dëshmia se mbaresa *-s* e gjinore nuk paraqitet nëse emri i përveçëm paraprihet nga nyja proklitike²⁰:

- (7) a. *Memos* Aufstieg (Ngritja e *Memos*)²¹
 b. *der Aufstieg des Memo-Ø* (Ngritja e *Memos*)
 c. * *der Aufstieg des Memos*

Një skenar i mundshëm i arsyes së mosparaqitjes së mbaresës (*-s*) në (7b) mund të jetë prania e nyjës proklitike (*des*) para emrit të përveçëm, e cila e zaptton pozicionin D, duke e pamundësuar zhvendosjen e emrit të përveçëm në këtë pozicion. Prandaj në këtë situatë, për tu shndërruar në DP, emri i përveçëm është i detyruar ta bëjë këtë nëpërmjet lidhjes, e jo zhvendosjes. Në këtë mënyrë, duke marr parasysh këto fakte dhe strukturën në (6), struktura e konstruksioneve me ndajshtim merr formën e njëjtë në të dy gjuhët:

- (8) a. [NP_Ø] + [DP_{NOM}] (për gjuhën shqipe), dhe
 b. [NP_Ø] + [DP_{NOM}] (për gjuhën gjermane)

Në këtë rast pra, konstatimi i Uhlisch është i drejtë.

Te konstruksionet ndajshtimore të paveçuar, varësisht nga situata bisedimore, rolet e gjymtyrëve mund të ndërrojnë:

- (9) a. Ky është komisarit *Memo*. Dies ist der Kommissar *Memo*. (NOM)
 b. Një propozim i komisarit *Memo*. Ein Vorschlag des Kommissars *Memos*. (GEN)
 c. Ne i besojmë komisarit *Memo*. Wir vertrauen dem Kommissar *Memo*. (DAT)

inflectional behavior of the proper names themselves and the one of the articles and the adjectives connected with them depends on whether N° substitutes D° or is adjoined to D° as well as whether an agreement relation exists between SpecDP and D° with respect to morphosyntactical features".

²⁰ Shih Eisenberg (2013:144), i cili thotë: "Das Genitiv-*s* kann nicht stehen, wenn der Eigenname dem Artikel folgt". (Gjinorja *-s* nuk mund të qëndron nëse emri i përveçëm i prapavrihet nyjës. Përkthimi nga T.A.) por edhe Schäfer (2016:272) dhe shembujt e paraqitur aty.

²¹ Emrat e përveçëm në gjinore të gjuhës gjermane mund të shfaqen para (7a) dhe pas emrit (7b), prandaj edhe përkthimi i tyre në gjuhën shqipe del i njëjtë. Gjithashtu, nëse gjinorja shënon kuptim përkatësie, ajo mund të shprehet edhe me anë të parafjalës von: *Der Aufstieg von Memo* (Ngritja e *Memos*).

- d. Ne e përjashtuam komisarin *Memo*. Wir verjagen den Kommissar *Memo*. (AKK)
 e. Këtë se prisnim prej komisarit *Memo*. (ABL)

ashtu që emri i përgjithshëm bëhet emër bosht, ndërsa emri i përveçëm bëhet ndajshtim (si në (9)). Në këtë situatë, folësi dëshiron të vë në dukje funksionin që kryen një njeri, pra ai që kryen funksionin e komisarit (e jo ta zëmë komandantit), i cili quhet *Memo*. Sipas Gramatikës së Akademisë (2002:239) emri bosht, si gjymtyrë e rangut më të lartë se ndajshtimi, theksohet dhe merr nyjën e shquar. Prandaj (në shembujt e gjuhës shqipe) në (9) lakohet emri i përgjithshëm komisar, kurse emri i përveçëm nuk lakohet fare dhe shfaqet në të gjitha rasat me formën e emërores së pasquar gjegjësisht pa rasë. Rrjedhimisht, kemi një relacion morfo-sintaksor të kundërt me atë në shembullin (4). Lidhur me këtë veçanti të konstrukcioneve ndajshtimore, Beci (2005:215) propozon që kjo madje të jetë një provë për të vërtetuar "se cili nga dy emrat e pranëvënë kryen funksionin e ndajshtimit". Për këtë arsye struktura e shembujve të gjuhës shqipe edhe në këtë rast mbetet e njëjtë:

$$(10) [[NP_{NOM} + DET_{NOM}] + [NP_{\emptyset}]] = [DP_{NOM} + NP_{\emptyset}]$$

ajo edhe pas ndërrimit të roleve ndërmjet emrit të përveçëm dhe emrit të përgjithshëm është e përbërë nga një sintagmë determinative dhe një sintagmë emërore.

Në një situatë të ngjashme edhe në gjuhën gjermane emri i përgjithshëm mund të bëhet emër bosht, mirëpo për ta bërë këtë atij i duhet nyja shquese (*der*) si në rrafshin semantik ashtu edhe në rrafshin sintaksor. Prandaj, në (9) para emrit *Kommissar* shfaqet nyja shquese, e cila mungonte në (4). Ngjashëm si folësi i gjuhës shqipe edhe folësi i gjuhës gjermane e thekson emrin e përgjithshëm dhe dëshiron të vë në dukje profesionin e një personi, i cili quhet *Memo*. Mirëpo, për dallim nga gjuha shqipe, emri i përveçëm *Memo* në gjinore vazhdon ta ketë mbaresën e gjinore (-s)²², që do të thotë se ai vazhdon të lakohet edhe pse ai ka humbur statusin e vet si

²² Sipas Eisenberg (2013: 259), te këto lloj konstrukcionesh të dy gjymtyrët duhet të kenë rasë të njëjtë.

bartës i funksioneve sintaksore. Rrjedhimisht, meqë nuk ka një përrpara, ai përsëri zhvendoset në pozicionin sintaksor D. Mbështetur nga kjo që u tha më sipër, konstruksionet ndajshtimore në gjuhën gjermane në (9) kanë këtë strukturë:

- (11) a. $[[\text{DET}_{\text{NOM}}] + [\text{NP}_{\text{NOM}}] + [\text{DP}_{\text{NOM}}] = [[\text{DP}_{\text{NOM}}] + [\text{DP}_{\text{NOM}}]$ (për gjuhën gjermane)
 b. $[\text{DP}_{\text{NOM}} + \text{NP}_{\emptyset}]$ (për gjuhën shqipe)

Nëse krahasojmë strukturën e gjuhës gjermane (11a) dhe strukturën e gjuhës e gjuhës shqipe (11b) të konstruksioneve ndajshtimore në (9) vërejmë se dallimi në strukturë është evident: struktura në gjuhën gjermane përbëhet nga dy sintagma determinante në të njëjtën rasë, kurse struktura në gjuhën shqipe përbëhet nga një sintagmë determinante në një rasë përkatëse dhe nga një sintagmë emërore pa rasë. Gjithashtu, dallimi është i dukshëm edhe në rrafshin morfologjik: në gjuhën gjermane lakohen të dy gjymtyrët e konstruksionit, kurse në gjuhën shqipe vetëm njëra. Dallim nuk ka, vetëm në rrafshin pragmatiko-semantik, ku qëllimi i folësit të gjuhës gjermane dhe gjuhës shqipe është i njëjtë. Mirëpo, dallimi në rrafshin sintaksor e morfologjik na lë të konstatojmë se pohimi i Uhlisch nuk është i drejtë.

4. A mund të jetë ndajshtim në gjuhën shqipe edhe emri i përveçëm

Këtu po themi se jo të gjithë gjuhëtarët shqiptarë janë të pajtimit me faktin se edhe emri i përveçëm mund të jetë ndajshtim. Për dallim nga gramatika e Akademisë (2002:239) dhe të gramatikat e disa gjuhëtarëve të tjerë shqiptarë si Beci (2005:75) e Dhima (2005:106), sipas të cilëve edhe emri i përveçëm mund të jetë ndajshtim, Çeliku (2012) e përjashton një mundësi të tillë. Ai në faqen 203 të sintaksës së tij i sheh konstruksionet ndajshtimore me emër të përveçëm ndajshtim, siç janë p. sh. *komesari Memo* apo *komandanti Rrapo*, si luhatje nga norma e gjuhës shqipe, pavarësisht se këto konstruksione janë përdorur nga autorë të mirënjohur siç është ta zëmë Dritëro Agolli²³. Madje, po aty, ai pohon: "në gjuhën standarde që

²³ Është interesant se Çeliku (2012) nuk heziton aspak të përvetëson si gramatikisht korrekte edhe raste mjaft diskutabile për normën dhe traditën e gjuhës shqipe siç e përmendëm në fusnotën 16 të këtij punimi ("në situata të caktuara ligjërimore edhe një emër i

përdoret në Kosovë ky grup emrash priret drejt zgjerimit edhe me ndonjë tjetër..." dhe merr shembujt me konstruksionet ndajshimore:

- (12) Sot na nderon me pjesëmarrjen e tij **profesori Mahir**, dhe **Nëna Terezë** është shqiptare.

Një përjashtim i tillë i Çelikut është i papritur dhe i habitshëm, meqë ai pretendon të përfshijë në analizën sintaksore të përbërësve të fjalisë edhe thënien. Pra, të përfshijë në këtë analizë edhe aspektin pragmatik të fjalisë, ku intonacioni ka një rëndësi të veçantë në aktualizimin e thënies. Mirëpo, duke tentuar që, sipas tij, të mbrojë "normën dhe traditën e gjuhës shqipe", ai në shembujt e mësipërm nuk e merr parasysh pikërisht aspektin pragmatik.

Një përjashtim i tillë i Çelikut mund të mos përkon as me rrjedhat aktuale rreth strukturës informative apo (siç e quan Çeliku) thënies së fjalisë, sepse në disa hulumtime të bëra së fundmi thuhet se informata e re lidhet pikërisht nëpërmjet të entiteteve. Kështu Krifka (2006:31) konstaton se në shembujt si:

- (13) a. Obama takoi Putin
b. Putin takoi Obamën

ndonëse kuptimisht të njëjtë (sepse shprehin po të njëjtin propozim) ata megjithatë dallojnë. Shembujt janë të strukturuar ndryshe, sepse (13a) regjistrohët si një informatë që lidhet me Obamën, kurse (13b) me Putin. Mbase në këtë mënyrë mund të shpjegohet edhe nevoja e shkëmbimit të roleve ndërmjet emrit të përveçëm me atë të përgjithshëm (nga *komisar Memoja* në *komisari Memo*). Pra, një shpjegim bukur i ngjashëm me shpjegimin e Gramatikës së Akademisë, të cilin e shënuam më lartë.

Në gramatikat e gjuhës gjermane dilema se a është emër bosht emri i përgjithshëm apo emri i përveçëm nuk është e pranishme. Te këto gramatika vëmendja është më shumë e përqendruar në devijimin e formës së ndajshimit dhe fjalës bosht, varësisht se a është e pranishme nyja shquese

pashquar pa nyje joshquese mund të jetë përbërës sintaksor"). Në sintaksën e tij ai jo rrallë herë e befason lexuesin me supozime tërësisht të kundërta me autorët e tjerë të librave gramatikor, siç është edhe ky rast, pra kur një emër i përveçëm merr rolin e ndajshimit në vend të emrit të përgjithshëm, të cilën mundësi ai e përjashton.

te emri i përgjithshëm. Sipas DUDEN (2016: 990) kur emri i përgjithshëm është ndajshtim dhe ai shënon një titull si: *Komissar Memo (komisari Memo)apo, Profesorin Nita (profesoresha Nitë)etj.* ai nuk shoqërohet nga nyja. Por, kur këta emra si ndajshtim nuk shënojnë tituj, atëherë ata shoqërohen me nyja:

- (14) a. die Begegnung Merkel-Obama takimi Merkel-Obama
 b. die Rechtsanwältin Sabine Tessororf avokatja Sabine Tessororf
 c. der berühmte Kammersänger Ronaldkëngëtari i famshëm i kantan
 tes Roland

Sipas Eisenberg (2013: 257) një numër i konsiderueshëm i konstrukcioneve ndajshtimore përbëhen nga dy sintagma determinante në të njëjtën rasë: [DP+DP]²⁴.

Në vazhdim do të shohim se si qëndron puna me strukturën e konstrukcioneve ndajshtimore të gjuhës shqipe, të cilat, sipas disa gjuhëtarëve, shfaqen edhe në rasë të tjera, sidomos në gjinore dhe rrjedhore. Rrjedhimisht, do të analizojmë se ç'strukturë kanë këto konstrukcione gjegjësisht a përbëhet edhe struktura e tyre në këto raste nga një sintagmë determinante dhe një sintagmë emërore. Mirëpo, para se të vazhdojmë me këtë analizë, ne do ti shpalosim dy veti të përgjithshme të ndajshtimit, të cilat eventualet do të na ndihmojnë për të analizuar këto konstrukcione.

²⁴Këtu po japim një vërejtje lidhur me këtë formulë sintaksore: ajo nuk mund të aplikohet në të gjitha konstruktionet ndajshtimore, sepse jo në të gjitha rastet fjala bëhet për dy sintagma. Kështu p. sh. në gjuhën gjermane te konstruktionet e ashtuquajtura ndajshtime eksplikative: *die Stadt Rom (qyteti Romë)*. Te ky shembull struktura nuk është DP + DP, por DP + N, sepse elementi i dytë i këtij konstrukcioni nuk është sintagmë, sepse ajo nuk mund të zgjerohet me ndonjë përcaktorë: **die Stadt schönes Rom*. Këto lloj ndajshtimesh gjithashtu kanë një renditje të ngulitur, e cila nuk mund të ndryshohet pa e ndërruar tipin e ndajshtimit, nga i paveçuar në ndajshtim të veçuar: **Rom die Stadt/ Rom, die Stadt (*Roma qytet)*. Ngjashëm është edhe në gjuhën shqipe. Krahaso p. sh. *Lumi Vjosë/ *Lum Vjosa*. Edhe te ndajshtimet eksplikative të gjuhës shqipe nuk mund të aplikohet formula DP+NP, por DP+N, sepse gjymtyra e dytë e konstrukcionit nuk është sintagmë por një emër i përveçëm. Edhe në gjuhën shqipe renditja është e ngulitur. Si konkluzion i kësaj që u parashtrua në këtë fusnotë mund të themi: disa konstrukcione të ashtuquajtura ndajshtimore eksplikative, sidomos ato që kanë një renditje të ngulitur, në gjuhën gjermane dhe gjuhën shqipe kanë strukturë dhe formë të njëjtë. Rrjedhimisht, edhe te këto konstrukcione pohimi i Uhlisch është i drejtë.

5. Dy veti të konstruksioneve ndajshtimore

Siç i përmendëm edhe më lartë, ko-referenca dhe lidhja predikative janë dy veti të përgjithshme të konstruksioneve ndajshtimore. Në vijim do ti provojmë të dy këto veti në konstruksionet ndajshtimore të dy gjuhëve. Vetia e ko-referencës mundëson që njëri nga elementet e konstruksionit të hiqet fare dhe shprehja (e mbetur) të jetë prapëseprapë gramatikisht dhe semantikisht korrekte²⁵.

- (15) a. Profesoresha Nitë kujton ... Die Professorin Nita meint ...
 b. Profesoresha ime kujton ... Die Professorin meint ...
 c. *Nitë/ Nita kujton ... Nita meint ...

Konkretisht, kur konstruksionit ndajshtimor në (15a) ia heqim ndajshtimin (*Nitë*), shprehja e mbetur (15b) në të dy gjuhët gramatikisht është korrekte dhe i referohet po të njëjtit person si në (15a). Gjithashtu, kur shembullit (15a) ia heqim emrin bosht (*profesoreshë*), shprehja e mbetur (Nitë + nyja shquese e gjinisë femërore -a, e cila pas heqjes së emrit bosht tani mbetet në dispozicion për t'iu bashkuar ndajshtimit *Nitë*) gramatikisht gjithashtu është korrekte. Edhe (15c) i referohet po të njëjtit person si (15a), që do të thotë se sikurse (15b), edhe kjo semantikisht është korrekte. Zëvendësimi i njëres gjymtyrë nga tjetra për të verifikuar ko-referencën nënkupton gjithashtu që gjymtyra e cila e zëvendëson një gjymtyrë tjetër duhet të merr përsipër edhe ushtrimin e po të njëjtave funksione sintaksore. Thënë ndryshe, me ko-referencë në këtë punim do të nënkuptojmë se gjymtyrët janë ko-identike si në rrafshin semantik ashtu edhe në rrafshin.

Të shohim tani se si qëndron puna me strukturën sintaksore.

- (16) a. profesoresh-a Nitë $[NP_{\emptyset} + DET_{NOM}] + [NP_{\emptyset}] = [DP_{NOM}] + [NP_{\emptyset}]$
 a'. Nit-a $[NP_{\emptyset} + DET_{NOM}] = [DP_{NOM}]$
 b. i/e profesoresh-ës Nitë i/e $[NP_{\emptyset} + DET_{GEN}] + [NP_{\emptyset}] = i/e [DP_{GEN}] + [NP_{\emptyset}]$
 b'. i/e Nit-ës i/e $[NP_{\emptyset} + DET_{GEN}] = i/e [DP_{GEN}]$
 c. profesoresh-ës Nitë $[NP_{\emptyset} + DET_{DAT}] + [NP_{\emptyset}] = [DP_{DAT}] + [NP_{\emptyset}]$
 c'. Nit-ës $[NP_{\emptyset} + DET_{DAT}] = [DP_{DAT}]$

²⁵ Lidhur me këtë çështje shih Henschel & Weidt (1994:360)

d. profesoresh-ën Nitë [NP_Ø + DET_{AKK} + [NP_Ø = [DP_{AKK}] + [NP_Ø]

d'. Nit-ën [NP_Ø + DET_{AKK}] = [DP_{AKK}]

e. profesoresh-ës Nitë [NP_Ø + DET_{ABL} + [NP_Ø] = [DP_{ABL}] + [NP_Ø]

e'. Nit-ës [NP_Ø + DET_{ABL}] = [DP_{ABL}]

Siç vërehet në (16), zëvendësimi i emrit bosht nga ndajshtimi (16a'-e') mund të ndodh pavarësisht se në cilën rasë është emri bosht, sepse ndajshtimi është në emëroren e pashquar [NP_Ø], me tiparin rasor [Ø]. Mu ky tipar është qenësor për vetinë e ko-referencës në rrafshin sintaksor. Duke qenë se ndajshtimi është pa rasë, ai tani mund të merr rasën e fjalës bosht dhe në këtë mënyrë të aftësohet për të kryer edhe funksionet sintaksore (kryefjalë, kundrinë apo përcaktor) të realizuara më parë nga emri bosht.

Në (15) vërejmë se edhe në gjuhën gjermane ndajshtimi mund të largohet (15b) pa shkaktuar ndonjë parregullsi në rrafshin semantik e sintaksor. Gjithashtu vërejmë se kur zëvendësohet emrit bosht nga ndajshtimi (15c) shprehja ende i referohet po të njëjtit person si në (15a) dhe (15b). Të shohim tani se ç'ndodh te kjo gjuhë në rrafshin sintaksor.

(17) a. **Memo** der Kommissar [DP_{NOM}] + [DP_{NOM}]

b. **Memos** des Kommissars [DP_{GEN}] + [DP_{GEN}]

c. **Memo** dem Kommissar [DP_{DAT}] + [DP_{DAT}]

d. **Memo** den Kommissar [DP_{AKK}] + [DP_{AKK}]

Meqë sipas rregullës të gjuhës gjermane emri bosht (*Memo*) dhe ndajshtimi (*der Kommissar*) duhet të jenë në rasi të njëjta, atëherë kur në (17a-d) e zëvendësojmë emrin bosht me ndajshtimin, ky i fundit (për shkak se është në rasën e njëjtë) mund të merr të gjitha funksionet sintaksore të të parit. Sikur emri bosht dhe ndajshtimi mos të ishin në të njëjtën rasë, atëherë një zëvendësim i tillë në rrafshin sintaksor nuk do të ishte i mundshëm.

Konstruksionet ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe gjermane (18a):

(18) a. komisar Memoja Komissar Memo

b. memoja është komisar Memo ist Komissar

kanë edhe vetinë e lidhjes predikative, me ç'rast emri bosht dhe ndajshtimi

lidhen nëpërmjet foljes këpujore (18b). Siç u tha edhe më lartë, disa gjuhëtarë preferojnë këtë veti para ko-referencës, për të potencuar se kjo e fundit mund të jetë vetëm si një rrjedhojë e kësaj lidhje.

6. A ka ndajshtim në rasën gjinore dhe rrjedhore në gjuhën shqipe

Në vijim do ti përdorim këto dy veti si kritere për të provuar se a ka gjuha shqipe ndajshtime të paveçuar, të cilat mund të jenë edhe në rasë të tjera përveç në rasën emërore të pashquar. Arsyeja për ti hyrë një prove të tillë është se disa gjuhëtarë, si p. sh. Prifti (1971:101) Prifti (1977: 54), Demiraj (1986: 542) por edhe Buchholz/Fiedler (1987: 424), mendojnë se si ndajshtim mund të paraqiten edhe një emër në gjinore, nëse ai shënon emra gjeografik, emra të muajve apo ditëve si p. sh.

(19) Mali *i Dajtit*, Qyteti *i Korçës*, Muaji *i marsit*, dita e diel

Arsyeja e përfshirjes së emrit në gjinore si ndajshtim nga ana e këtyre gjuhëtarëve me gjasë është se këto konstruksione siç duket janë shumë të hershme në gjuhën shqipe dhe se gjymtyrët mund të nënkuptohen si ko-referente gjegjësisht supozohet se konstruksionet ndajshtimore në gjinore (në rrafshin semantik) janë identike me konstruksionet ndajshtimore në emërore të pashquar:

(20) Mali *Dajt*, Qyteti *Korçë*, Muaji *mars*

Të fillojmë me rrafshin semantik. Siç u tha, është fakt se te këto ndërtime emri bosht dhe emri ndajshtimor mund ti referohen njëri tjetrit, mirëpo është po ashtu fakt se te këto konstruksione kriteri i lidhjes predikative realizohet me vështirësi:

(21) Mali është *i Dajtit*, Qyteti është *i Korçës*, Muaji është *i marsit*.

Kjo vështirësi është sidomos evidente te disa konstruksione me ndajshtim në gjinore, te të cilat janë të pranishëm po ashtu emrat gjeografikë në gjinore, si p. sh.

(22) a . Lumi *i Osumit*, Fshati *i Kleçkës*

b. #Lumi është *i Osumit*, Fshati është *i Kleçkës*

Siç duket folësi shqiptar nuk preferon konstruksionet (22a) si ekuivalencë të konstruksioneve *lumi Osum. lumi Vjosë* përkatësisht *fshati Pasjan, fshati Kleçkë*, sepse po të hedhim një shikim në internet (google) shumë më shpesh shfaqet²⁶:

(23) a. Lumi *Osum* del nga shtrati²⁷, se sa

b. * Lumi *i Osumit* del nga shtrati,

(24) a. Fshati *Kleçkë* kërkon ndihmë që sa më shpejt ta bëjë hapjen e rrugës²⁸ ..., se sa

b. * Fshati *i Kleçkës* kërkon ndihmë që sa më shpejt të bëjë hapjen e rrugës

Gjithashtu, shembujt si (25a) dhe (25b) mund të kanë kuptime të ndryshme.

(25) a. Katundi Kabash

b. Katundi i Kabashit

Interpretimi i (25b) mund të jetë i dyfishtë. Në rastin e parë, ai mund të jetë identik me interpretimin e shembullit (25a), kurse në rastin e dytë fjala mund të jetë për katundin e personit që ka mbiemrin *Kabashi*, e që jo domosdoshmërisht duhet të jetë *katundi Kabash*, sepse ky person mund të jeton apo të jetë i lindur ta zëmë në katundin *Shkretë* ose ndonjë tjetër. Por, nëse thuhet *katundi Kabash*, atëherë ky shembull mund të ketë vetëm një kuptim. Ngjashëm mund të jetë edhe me shembujt:

(26) Qyteti *i Vlorës*, apo qyteti *i Milotit* etj.

²⁶ Lidhur me përdorimin e internetit në mbledhjen e fakteve në gjuhësi shih Gato (2014: 101), sipas së cilës: "There seems to be clear evidence that, in spite of its limitations, the web can be used as a reliable source of quantitative and qualitative evidence of usage.." (Duket e qartë se përkundër kufizimeve, interneti (WEB) mund të përdoret si burim kuantitativ dhe kualitativ i evidencës së përdorimit..Përkthyer nga T. A.)

²⁷ Më 29/12/2017 në ora 13.55, gjatë hulumtimit në google rezultati ishte: 29 800 herë u shfaq sintagma emërore *Lumi Osum*, kurse *lumi i Osumit* 2650 herë.

²⁸ Më 29/12/2017 në ora 14.00, gjatë hulumtimit në google rezultati ishte: 542 u shfaq sintagma emërore *fshati Kleçkë*, kurse vetëm 1 (një) herë sintagma *fshati i Kleçkës*.

Te këta shembuj dhe shembuj të ngjashëm (sidomos në Kosovë ku mjaft individë mbajnë emra gjeografik) vetëm konteksti apo informata shtesë mund ti hekë "mëdyshjet" e dëgjuesit se a është fjala për qytetin ku jetojnë apo ku janë lindur personat *Vlorë* përkatësisht *Milot* apo për qytetin *Vlorë* përkatësisht *Milot*. Ndërkaq mëdyshje të tilla te shembujt: *qyteti Vlorë* ose *qyteti Milot* nuk janë fare e pranishme.

Arsyeja e dytë është se shembujt në (27) dhe (28) kanë struktura të ndryshme:

(27) a. Mali *i Dajtit*, Qyteti *i Korçës*, Muaji *i marsit*

b. [NP_∅+DET_{NOM}] + i [NP_∅+DET_{GEN}] = [DP_{NOM}] + i [DP_{GEN}]

(28) a. Mali *Dajt*, Qyteti *Korçë*, Muaji *mars*

b. [NP_∅+DET_{NOM}] + [NP_∅] = [DP_{NOM}] + [NP_∅]

Struktura e konstruksioneve ndajshtimore me gjinore (27a), përbëhet nga një sintagmë determinante në emërore dhe një sintagmë determinante në gjinore (27b), kurse struktura e konstruksioneve ndajshtimore me emërore të pashquar (28a) përbëhet nga një sintagmë determinante dhe një sintagmë emërore pa mbaresë rasore (28b). Është evidente se struktura (27b), e përbërë nga dy sintagma determinante, i ngjanë strukturës ndajshtimore të gjuhës gjermane me ndajshtim në emërore të pashquar. Pra, kjo strukturë devijon nga struktura e zakonshme e konstruksioneve ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe së paku për dy arsye mbetet e paqartë se si në situatat kur fjala bosht zëvendësohet nga ndajshtimi, ky i fundit mund të merr funksionet sintaksore e të parit. E para, emri ndajshtimor në (27a) ka të prapavendosur një në gjinore dhe një sintagmë e tillë determinante nuk mund të merr funksionin sintaksor që ka fjala bosht, siç është p. sh. kryefjala apo kundrina, pasi që sintagma determinante në gjinore nuk mund të kryen asnjërin nga këto funksione sintaksore. E dyta, pasi që të hiqet emri bosht p. sh. *mal*, në strukturë mbetet ende e pranishme nyja e shquar e gjinisë mashkullore -i (DET_{NOM}), ashtu që struktura e mbetur është:

(29) [-i] [i Dajt-it] [DET_{NOM}] + i [DP_{GEN}]

Pra, struktura sintaksore nuk përbëhet vetëm nga sintagma determinante në gjinore DP_{GEN}, por ajo ka edhe një nyje të shquar (DET_{NOM}), e mbetur nga emri bosht. Në këtë mënyrë, kjo strukturë si e tillë, jo vetëm që

s'mund të merr ndonjë funksion gramatikor të emrit bosht, por ajo edhe gramatikisht është jo korrekte. Natyrisht në (27) dhe (28) është paraqitur konstruksioni dhe struktura përkatëse vetëm në emërore. Për shkak të hapësirës nuk po paraqesim edhe rasët e tjera, por të kihet parasysh se edhe strukturat në rasa të tjera janë të ngjashme: ndajshtimi te ato s'mund të merr ndonjë funksion sintaksor dhe shprehjet mbesin gramatikisht jo korrekte nëse zëvendësohet fjala bosht me ndajshtimin.

Si përfundim mund të nxjerrim: ndajshtimi në gjinore për disa arsye mund të konsiderohet si çështje problematike: (i) ai jo gjithnjë i referohet emrit bosht, (ii) konstruksionet ndajshtimore me emërore të pashquar nuk janë gjithnjë semantikisht ekuivalente me konstruksionet ndajshtimore në gjinore dhe (iii) në rast të heqjes së emrit bosht, ndajshtimi në gjinore nuk mund të merr funksionet sintaksore të këtij të fundit. Prandaj, në pyetjen e shtruar se a ka në gjuhën shqipe konstruksione ndajshtimore me gjinore si përgjigje po japim atë që thotë Gramatika e Akademisë (2002:227): emri në rasën gjinore kur është në trajtë të shquar "funksionon vetëm si përcaktor" pa lënë mundësi që ai të jetë ndajshtim.

Lidhur me dilemën se a ka konstruksione ndajshtimore në gjuhën shqipe me ndajshtim edhe në rasë të tjera përveç në emërore të pashquar, pohimi i Friedman (2006:663) del i paqartë. Ai në artikullin e tij enciklopedik *Balkans as Linguistic Area*, kur flet për funksionet e rasave të gjuhës shqipe thotë:

"... *the ablative is the object of certain prepositions or in apposition to another substantive*". (Rrjedhorja është kundrinë e disa parafrjalëve ose ndajshtim i një emri tjetër. Përkthyer nga T. A.)

Konstatimi i Friedmanit është sa i papritur aq edhe i habitshëm, sepse edhe sikur të ekziston mundësia që rrjedhorja të shfaqet në funksion të ndajshtimit ashtu siç e përmend përciptazi dhe e supozon Prifti (1977: 54), një shfaqje e tillë është e pa përfillshme në krahasim me shfaqjen e rrjedhores në funksion të përcaktorit. Mirëpo, është një çështje tjetër nëse Friedman pretendon (kështu së paku lë të kuptohet) se emri në rrjedhore, që shkon pas një emrit tjetër, funksionon si ndajshtim e jo si përcaktor. Prandaj në vijim, duke marr parasysh vetitë e konstruksioneve ndajshtimore të shtruara më sipër dhe duke përdorur një analizë të njëjtë, do të provojmë se a është një pohim i tillë i drejtë.

(30) a. natë *dimri/vere/pranvere/vjeshte/janari* etj.

b. lule *qershie/vere/mali* etj.

c. lëvizje *njerëzish/gurësh/aeroplanësh/ ushtarakësh/policësh* etj.

Nëse supozojmë se konstruksionet në (30) janë ndajshtimore dhe nëse te këto konstruksione e largojmë emrin bosht *natë, lule* apo *lëvizje*, atëherë për shkak të vetisë së ko-referencialitetit

(31) a. *dimri/vere/pranvere/vjeshte/janari* etj.

b. *qershie/vere/mali* etj.

c. *njerëzish/gurësh/aeroplanësh/ ushtarakësh/policësh* etj.

emrat e mbetur në (31a) ishte dashur ti referoheshin *natës*, emrat në (31b) *lules*, kurse në (31c) *lëvizjes* dhe njëkohësisht të gjithë emrat në (31a) të jenë ko-referent, pra ti referohen njëri tjetrit. Njëllor ishte dashur të ishte edhe në (31b) dhe (31c). Mirëpo, meqë një gjë e tillë nuk është e mundshme, konkludojmë se konstruksionet në (30) nuk e kanë vetinë e ko-referencialitetit. Gjithashtu, meqë *nata* nuk është *dimër*, e as *verë, pranverë, vjeshtë* apo *janar*, si dhe *lulja* nuk është *qersh*, *verë* apo *mal* e kështu me radhë, mund të themi se konstruksionet në (30) nuk e kanë as vetinë e lidhjes predikative. Në fakt duke u çiftëzuar në një mënyrë të tillë, emrat që i shkojnë pas emrit bosht secilën herë shënojnë një entitet tjetër, duke modifikuar gjegjësisht kufizuar në këtë mënyrë shtrirjen e konceptit të shënuar nga emri bosht. Pra, duke bërë diçka që është tipike për një përcaktor e jo për një ndajshtim. Si përfundim mund të nxjerrim: në rrafshin semantik konstruksionet në (30) nuk e plotësojnë kriterin e ko-referencialitetit.

Të shohim tani se si qëndron puna në rrafshin sintaksor. Sipas Gramatikës së Akademisë (2002: 239) "emri në rrjedhore është gjithnjë i pashquar dhe varet nga gjymtyrë të shprehura me emër të pashquar ose me togfjalësh, fjala bosht e të cilit është një emër i pashquar". Duke marr parasysh këtë përkufizim dhe konstruksionet në (30), struktura sintaksore ka këtë formë:

(32) a. një lule mali [[DET_{NOM}]+[NP_{NOM}]]+[NP_{ABL}]=[DP_{NOM}] + [NP_{ABL}]

b. i një lule mali i [[DET_{GEN}] + [NP_{GEN}]] + [NP_{ABL}] = [DP_{GEN}] + [NP_{ABL}]

c. një lule mali [[DET_{DAT}] + [NP_{DAT}]] + [NP_{ABL}] = [DP_{DAT}] + [NP_{ABL}]

d. një lule mali [[DET_{AKK}] + [NP_{AKK}]] + [NP_{ABL}] = [DP_{AKK}] + [NP_{ABL}]

e. një lule mali [[DET_{ABL}] + [NP_{ABL}]] + [NP_{ABL}] = [DP_{ABL}] + [NP_{ABL}]

Nëse tani në (30) e largojmë emrin bosht:

(33) a. *një mali [DET_{NOM}] + [NP_{ABL}] a'. një mal

b.* i një mali i [DET_{GEN}] + [NP_{ABL}] b'. i një mali

c.* një mali [DET_{DAT}] + [NP_{ABL}] c'. një mali

d. *një mali [DET_{AKK}] + [NP_{ABL}] d'. një mal

e. një mali [DET_{ABL}] + [NP_{ABL}] = [DP_{ABL}] e'. një mali

Në parim, nëse abstraktojmë sinkretizmat rasore dhe faktin se nyja joshqese e shqipes i ka rrafshuar mbaresat rasore, atëherë ishte dashur që vetëm konstruksioni (33e) të ishte gramatikisht korrekt, sepse nyja jo shquese dhe sintagma emërore (që të dyja) janë në rrjedhore. Ndërkaq në rasat e tjera nuk ka kongruencë ndërmjet nyjës dhe sintagmës emërore në rrjedhore. Rrjedhimisht vetëm në (33e) sintagma determinante në rrjedhore ([DP_{ABL}]) mund të merr funksionin sintaksor të emrit bosht. Por, nëse marrim parasysh edhe sinkretizmat dhe faktin se nyja jo shquese ka vetëm një formë në të gjitha rasat, atëherë duke krahasuar (33a-e) me (33 a'-e') emri në rrjedhore mund të merr eventualisht funksionet sintaksore të konstruksionit në gjinore, dhanore dhe rrjedhore, por jo edhe funksionet sintaksore të konstruksionit në emërore dhe kallëzore. Thënë ndryshe, konstruksioni nuk mund të kualifikohet si konstruksion ndajshtimor as në rrafshin sintaksor. Prandaj, si përfundim mund të nxjerrim se pohimi i Friedman nuk është i drejtë.

Rrjedhimisht, në analizën tonë kontrastive nuk do të përfshihen konstruksionet e përmendura në rrjedhore dhe gjinore, por vetëm konstruksionet ndajshtimore me emërore të pashqar.

7. Konstruksionet ndajshtimore me përemra vetorë

Siç u përmend edhe më herët, fjalë bosht në konstruksionet ndajshtimore përveç emrit mund të jetë edhe një përemër vetor në veten e I-rë ose të II-të, mirëpo sipas gramatikës së Akademisë (2002: 239) ndajshtimi gjegjësisht emri që i vjen pas përemrit, për dallim kur fjala bosht është emër, shprehet në trajtë të shqar:

- (34) a. ne *gjuhëtar-ët* ... NOM
 b. i neve²⁹ *gjuhëtarëve* ... GEN
 c. neve *gjuhëtarëve*... DAT
 d. ne *gjuhëtarët* AKK
 e. prej nesh *gjuhëtarëve* ABL

Nëse përemrin *ne* e shënojmë *PRON*, atëherë struktura e shprehjes (34) në emërore do të ketë këtë formë:

- (35) $PRON_{NOM} [NP_{NOM} + DET_{NOM}] = PRON_{NOM} [DP_{NOM}]$

Pra, ajo është e përbërë nga një përemër (*PRON*) dhe nga një sintagmë determinante në rasën përkatëse. Për dallim nga konstruksionet te të cilët fjala bosht është një emër dhe vetëm ky i fundit lakohej, te konstruksionet me përemra lakohen të dy gjymtyrët: fjala bosht (përemri) dhe ndajshtimi (emri).

Edhe në gjuhën gjermane fjala bosht mund të jetë përemër:

- (36) a. wir *Linguisten*... NOM
 b. unsere *Linguisten*... GEN
 c. uns *Linguisten*... DAT
 d. uns *Linguisten*... AKK

Struktura e konstruksionit në emërore është e përbërë nga një përemër në emërore dhe një sintagmë emërore po ashtu në emërore, sepse në gjuhën gjermane kur emri shkon pas një përemri vetor kongruenca në rasë është e domosdoshme³⁰:

- (37) $[PRON_{NOM} + NP_{NOM}]$

Nëse krahasojmë strukturën në gjuhën shqipe (35) dhe strukturën në

²⁹ Sipas Gramatikës së Akademisë (2002:222) rasa gjinore e dy vetave të para në njëjës dhe shumës përdoret tepër rrallë dhe kjo ndodh zakonisht në gjuhën e folur kur aho është e ndjekur nga një ndajshitim.

³⁰ Ndonëse për shkak të sinkretizmave mbaresat rasore në shembullin (36) janë të padukshme, pro krahaso:

(a) wir Europäer (NOM), für uns Europäer (AKK), von uns Europäern (DAT)

(b) mir altem Kerl (në krahasim me: mir alten Kerl); wir Arbeitslosen (në krahasim me: wir Arbeitslose) shih DUDEN (2016:986)

gjuhën gjermane (37) vërejmë se dallimi ndërmjet tyre është evident dhe kjo është edhe një e dhënë, e cila e kundërshton pohimin e Uhlisch. Madje ky dallim është edhe më i thellë, sepse disa gjuhëtarë, duke u mbështetur në Postal (1969), por edhe te gjuhëtarë shumë më të hershëm³¹, kujtojnë se i tërë konstruksioni nuk është fare një konstruksion ndajshtimor, por është thjeshtë një sintagmë determinante e zakonshme. Sipas kësaj hipoteze, përemrat vectorë të vetës I-rë dhe të II-të janë të afërt me nyjat. Në konstruksionet e mësipërme të gjuhës gjermane, si dhe te konstruksionet e ngjashme në gjuhën angleze, përemrat shfaqin njëfarë ngjashmërie me këto të fundit si në rrafshin semantik, duke e kufizuar referencën, ashtu edhe në atë sintaksor, ngase nyja dhe përemri kanë distribuim të njëjtë:

(38) a. die Linguisten/ wir Linguisten (gjermanisht)

b. the linguists/ we linguists (anglisht)

Rtjedhimisht, këta gjuhëtarë i trajtojnë të dyja këto konstruksione si një njësi sintaksore të vetme gjegjësisht si një sintagmë³², e sidomos nëse kihet parasysh fakti se te këto konstruksione nyja dhe përemri janë në relacion konkurrues, që do të thotë se nuk mund të shfaqen të dyja në të njëjtën kohë:

(39) a. * wir die Linguisten

b. * we the Linguists

Natyrisht, ky relacion konkurrues është i pranishëm vetëm te konstruksionet te të cilat përemri dhe ndajshtimi nuk janë të veçuar si në (38), por jo edhe te rastet kur janë të veçuar si në vijim :

(40) a. wir, die Linguisten

b. we, the Linguists

Thënë ndryshe, te konstruksionet (38) përemrat zënë vendin e nyjave në pemën sintaksore, prandaj mund të themi se PRON = DET. Nëse kemi parasysh këtë, atëherë struktura për gjuhën gjermane në (37) merr formën:

(41) [PRON_{NOM} + NP_∅] = [DET_{NOM} + NP_∅] = [DP_{NOM}]

³¹ Si p. sh. Jakob Grimm (1837). Shih më detalisht Vater (1998:11), por edhe Molitor (1979:122-137) si dhe literaturën e cituar aty.

³² Shih Molitor (1979:127)

Pra, struktura e konstruksioneve në gjuhën gjermane është thjeshtë një sintagmë determinante, kokë sintaksore e së cilës është një përemër vector. Këtu po themi se ishte pikërisht kjo dukuri e konstruksioneve me përemra e emra, të cilën Abney (1987: 282-3) e përdori (së bashku me disa të dhëna të tjera empirike) për të ndërtuar të ashtuquajturën hipotezë DP, e cila supozon se nyja është kokë e sintagmës determinante, kurse emri është një komplement i saj³³. Mirëpo nga ana tjetër, është pikërisht ky fakt që e shton dilemën se a ka në gjuhën gjermane konstruksione ndajshtimore, te të cilat përemri vectorë është fjalë bosht.

Për të hequr dilemat se a janë shprehjet e gjuhës shqipe (34) dhe shprehjet e gjuhës gjermane (36) konstruksione ndajshtimore, në vijim do të aplikojmë te këto konstruksione kriterin e ko-referencialitetit. Nëse në gjuhën shqipe e heqim fjalën bosht (përemrin), atëherë ndajshtimi (emri) pikërisht për shkak të pranisë së nyjës është i aftë të merr të gjitha funksionet sintaksore. Rrjedhimisht, në këtë rast prania e nyjës shquese te ndajshtimi ka një rol esencial në ndërtimin e konstruksioneve ndajshtimore me përemër. Por, nëse ndajshtimi që i shkon pas një përemri mund eventualisht të dal edhe si një emër në gjinore, siç pohon Gramatika e Akademisë (2002:239) dhe Beci (2005:215)³⁴ si në shembujt në vijim:

(42) a. Ja shpëtova, si shpëtonim kurdoherë *ne të malit*.³⁵

b. Na ndihmoni edhe *ju të universitetit*.³⁶

atëherë kriteri i ko-referencialitetit realizohet vetëm në rrafshin semantik, por jo edhe në rrafshin sintaksor, meqenëse ndajshtimi (në gjinore) nuk mund të merr të gjitha funksionet sintaksore të fjalës bosht. Një supozim i

³³ Është e qartë se në gjuhën shqipe struktura e konstruksioneve me përemër nuk mund të përdoret për të mbështetur hipotezën DP, mirëpo kjo hipotezë mund të mbështetet edhe nga vet natyra e nyjës së shquar të shqipes, të përmendur edhe nga Cipoja (1952:22): "Nyjet kanë këtë të veçantë që munt të substantivojnë çfarëdo pjese të ligjeratës me përjashtim përemrit dhe foljes". Një natyrë e tillë lë të kuptojë se nyja mund të plotësoi kriteret për tu kualifikuar si kokë e sintagmës emërore. Lidhur më tutje për këtë çështje Shih Abrashi (2009).

³⁴ Këtë mundësi e jep edhe Dhima (2005: 106), por shembujt e Dhimës janë identik si shembujt e Gramatikës së Akademisë, pa dhënë ndonjë koment apo ndonjë informatë shtesë.

³⁵ Shembull i marr nga Gramatika e Akademisë (2002: 239)

³⁶ Shembull i marr nga Beci (2005: 215)

tillë, sidomos i Gramatikës së Akademisë, del i papritur sepse, siç thamë edhe më herët, po e njëjta gramatikë, në të njëjtin kapitull, në fq. 227, pohon se (po e përsërisim): "Emri në rasën gjinore funksionon vetëm si përcaktor, kur është në shumës ose në njëjës në trajtën e shquar". Edhe te shembujt (42a-b) emri në gjinore është në trajtë të shquar dhe rrjedhimisht ishte dashur të kualifikoheshin si përcaktorë e jo si ndajshitim. Meqë nuk ka ndonjë shpjegim shtesë, mbetet e paqartë se pse autorët e Gramatikës së Akademisë në këtë rast janë përcaktuar që emrin në gjinore ta marrin si ndajshitim, ndonëse po të njëjtit autorë, për dallim nga Prifti dhe Buchholz/Fiedler, nuk e kanë konsideruar fare ta marrin si ndajshitim gjinoren te emrat gjeografikë. Lidhur me këtë, është interesant që Buchholz/Fiedler (1987: 426) tash pohojnë të kundërtën: nëse gjinorja i shkon pas një përemri, atëherë ai është përcaktor e jo ndajshitim. Sipas atyre gjinorja edhe në këtë rast bënë modifikimin e fjalës bosht, pavarësisht se fjalë bosht është një përemër në vetën I apo të II, e jo një emër. Në këtë punim nuk do të merret anë qoftë për njërën apo për zgjidhjen tjetër, por meqë nuk ekziston një mendim i unifikuar dhe nëse këto dy zgjidhje mund të konsiderohen si dy alternativa opsionale, atëherë padyshim se orientimi në këtë punim do të ishte kah propozimi i Buchholz/Fiedler, i cili siguron që kriteri i ko-referencialitetit të realizohet edhe në rrafshin sintaksor. Natyrisht, studimet e më tutjeshme eventuale mund të tregonin se cila është zgjidhja përfundimtare.

Sidoqoftë, një çështje tjetër, e cila mund të shkakton ndryshime, por kësaj radhe në rrafshin morfologjik, mbetet çështja e tiparit të vetës³⁷. Konkretisht, kur ndajshitimi merr përsipër të kryen funksionet sintaksore të përemrit domosdo vjen deri te s'përputhja në tiparin e vetës, sepse emri gjithnjë bartë vetën e III-të³⁸, kurse përemri është ose në vetën e I-rë ose në

³⁷ Në këtë punim, për dallim nga Dhima (2005:70) i cili pohon se veta në gjuhën shqipe është kategori e brendshme e foljes, ne do të konsiderojmë se veta është tipar i brendshëm i emrit dhe tipar kontekstual i foljes. Shih lidhur me këtë Corbett (2006: 131-132), por edhe Demiraj (1986:677) sipas të cilit: "Kategoritë gramatikore të vetës dhe të numrit edhe në sistemin foljor të shqipes së dokumentuar, ashtu si në gjuhët e tjera i.e." kanë karakter sintaksor, duke u kushtëzuar nga veta e kryefjalës se fjalisë. (Nënvizuar nga T. A.). Lidhur me argumentet shtesë shih Abrashi (2014) dhe literaturën e cituar aty.

³⁸ Lidhur me tiparin e vetës te emri dhe te domeni emëror shih Abrashi (2017) dhe Abrashi (2014)

vetën e II-të. Rrjedhimisht, kur ndajshtimi rimerr funksionin sintaksor nga përemri, një rimarrje e tillë detyrimisht reflektohet në mbaresën e foljes:

(43) a. Ne linguistët hulumtoj-**më**...

b. Linguistët hulumtoj-**në**...

duke e shndërruar atë nga **-më** te (43a) në **-në** te (43b). Reflektimi i s'përputhjes në vetë është i dukshëm edhe te trajta e shkurtër e përemrit te rimarrja p. sh. e kundrinës së drejtë:

(44) a. Ankthi **më** kaploi mua mjeranin³⁹.

b. Ankthi **e** kaploi (atë) mjeranin.

nga **më** te (44a) në **e** te (44b).

Në gjuhën gjermane në dukje të parë kriteri i ko-referencialitetit nuk mund të aplikohet sepse mungon nyja shquese:

(45) a. ihr Linguisten seid ... (veta e II-të shumës)

b. Linguisten sind ... (veta e III-të shumës)

Mirëpo në gjuhën gjermane, nëse emri shënon një klasë të sendeve në shumës, siç është rasti në (45a), atëherë ai mund të shfaqet edhe pa nyja gjegjësisht edhe pa përemër (44b)⁴⁰, prandaj meqë kësaj ndajshtimi mund të kryen funksionet sintaksore, themi se kriteri i ko-referencialitetit është i zbatueshëm. Rrjedhimisht, kur konstruksioni përemër plus emër është në shumës, konstruksioni mund të konsiderohet se është një konstruksion me ndajshim dhe sikurse në gjuhën shqipe edhe në gjuhën gjermane vjen deri te ndërrimi i mbaresave foljore, kur përemri zëvendësohet me ndajshimin (emrin).

Mirëpo, kur ky konstruksion është në njëjës, atëherë na paraqitet një situatë më e ndërlikuar, sepse konstruksioni me përemër shfaq kufizime semantike. Konkretisht, në shumës secili emër, i cili ngërthen në veti tiparin [+Human]⁴¹, mund ti shkoj pas përemrit vector pa kufizim në interpreti-

³⁹ Prania e kundrinës së drejtë të shprehur me përemër vector të vetës së parë e të dytë njëjës e shumës në rasën kallëzore shënjohet me anë të trajtës së shkurtër të këtyre përemrave: *Ai më thirri mua për ndihmë*. shih Gramatikën e Akademisë (2002:259)

⁴⁰ Helbig/Buscha (1996: 377)

⁴¹ Sepse veta e I-rë dhe veta e II-të i referohen vetëm njerëzve

min e tij. Në njëjës, ky interpretim është i kufizuar dhe lidhet (me sa duket vetëm) me një interpretim emocionalisht të ngarkuar të emrit⁴². Kështu p. sh. konstruksionet me përemrin e vetës së I-rë zakonisht lidhen me një interpretim të një vetëkritike (*ich Idiot-unë idioti*) apo një keqardhje ironike (*ich Feigling-unë qyqari*), kurse veta e II-të njëjës ka të bëjë me shprehjet, të cilat mund të janë ofenduese (*du Idiot- ti idioti*), admiruese (*du Engel-ti engjulli*) apo vlerësuese (*du Genie-ti gjeniu*). Kësisoj, në një kontekst të caktuar, sintagmat si *du Linguist :ti gjuhëtar* mund të interpretohen vetëm si një ironi ofenduese drejtuar një personi, i cili p. sh. jep sugjerime për çështje gjuhësore, ndonëse fare nuk është kompetent për sugjerime të tilla⁴³. Bhatt (1990: 155) supozon se një kufizim i tillë semantik gjatë përzgjedhjes së plotësit nga ana e përemrit të vetës së I-rë dhe të II-të njëjës ka të bëjë me faktin se këta dy pronorë bartin edhe ashtu tipare shumë më specifikuere në krahasim me pronorët përkatës në shumës. Sipas saj, *ich (unë)* është pa mëdyshje më specifik se *wir (ne)*, prandaj i pari mund të merr vetëm plotësa "kualifikues" (pra që mund të kanë interpretim kritik, vlerësues etj) e jo edhe "specifikues". Kurse në shumës, te përemrat përkatës, ngjashëm sikurse te përemri vetor i vetës së III-të, për shkak se tipari i tyre është më pak specifikues (pothuajse minimal), pas përemrit mund të vijë një plotës si specifikim shtesë. Krahasimet në shembullin vijues (46), të marrë nga Lawrenz (1993: 93), tregojnë se emrat "jo-kualifikues" (gjegjësisht pa një interpretim emocional) mund të merren si plotës nga ana e përmrave vetor të vetës së II-të njëjës vetëm nëpërmjet parafjalës *als (si)*:

(46) a. Ich *Älteste/**als** Älteste muss mich um gesamte Haushalt alleine kümmern.

Unë *më e vjetra/si më e vjetra duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin e shtëpisë.

b. Ich *Hausfrau/ **als** Hausfrau muss mich um gesamte Haushalt alleine kümmern.

Unë *amvise/ **si** amvise duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin e shtëpisë.

c. Ich *Mann/ **als** Mann muss mich um gesamte Haushalt alleine kümmern.

⁴² Në lidhje me këtë çështje shih Vater (1998:15)

⁴³ Shih Vater (1998:15)

Unë * Burrë/ si burrë duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin e shtëpisë.

Kurse (47) e tregon të kundërtën: se si emrat "kualifikues" nuk mund të merren nëpërmjet parafjalës *als* (*si*):

(47) a. Ich Arme/ *als Arme muss mich um gesamte Haushalt....

Unë i mjeri/ *si i mjeri duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin

b. Ich Unglückliche/*als Unglückliche muss mich um gesamte Haushalt ...

Unë i pafati/* si i pafati duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin

c. Ich Bedauerwerte/* Ich Bedaurswerte muss mich um gesamte Haushalt ...

Unë i mishëruari/*si i mishëruari duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin

(48) a. Wie konnte ich /Tor/ * als Tor nur auf einen solchen Scharlatan hören.

Si pata mundësi unë budallai/*si budallai ta dëgjoj një sharlatan të tillë.

b. Wie konnte ich Idiot/ *als Idiot nur auf einen solchen Scharlatan hören.

Si pata mundësi unë idioti/*si idioti ta dëgjoj një sharlatan të tillë.

c. Wie konnte ich *Gelehrter/als Gelehrter nur auf einen solchen Scharlatan hören.

Si pata mundësi unë *dijetari/si dijetari ta dëgjoj një sharlatan të tillë.

d. Wie konnte ich *Erwachsener/als Erwachsener...

Si pata mundësi unë *i rrituri/ si i rrituri ta dëgjoj

Sidoqoftë, është evidente se te konstruktionet me përemër si fjalë bosht të gjuhës gjermane, për shkak të mungesës së nyjës, kriteri i ko-referencialitetit në rrafshin sintaksor nuk mund të kënaqet plotësisht. Mirëpo, një mendim i prerë, se a janë në këtë gjuhë këto konstrukcione me apo pa ndajshim, nuk ekziston. Monografisë (p. sh. Molitor 1979:128) dhe puni-

met e tjera (p. sh. Vater 1998:17) në këtë fushë zakonisht nuk i konsiderojnë si konstruksione me ndajshim, për dallim nga gramatikat si Helbig/Buscha (1996: 609) apo DUDEN (2016:986) të orientuara më tradicionalisht, të cilat i konsiderojnë këto konstruksione me ndajshim.

Mjerisht për gjuhën shqipe nuk kam hasur në një hulumtim gjuhësor, që analizon këto konstruksione për të hulumtuar se cilat emra mund të jenë plotësa të përemrave të vetës së I-rë dhe të II-të dhe a kanë këta emra kufizime semantike të ngjashme si emrat në gjuhën gjermane. Mirëpo, nëse marrim parasysh shembujt e mësipërm (gjegjesisht përkthimet e shembujve të gjuhës gjermane), dhe nëse te të gjithë shembujt ku është përdorur parafjala *si* hiqet nyja shqese, atëherë në shembujt e mësipërm (47) dhe (48) të markuar me shenjën (*) si gramatikisht jo korrekt, shndërrohen në shembuj gramatikisht të pranueshëm:

- (49) a. Unë i mjeri/ si i mjerë duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin
 b. Unë i pafati/ si i pafat duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin
 c. Unë i mishëruari/si i mishëruar duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin
- (50) a. Si pata mundësi unë budallai/si (një) budalla ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
 b. Si pata mundësi unë idioti/si (një) idiot ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
 c. Si pata mundësi unë dijetari/si (një) dijetar ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
 d. Si pata mundësi unë i rrituri/ si i rritur ta dëgjoj një sharlatan të tillë.

Shembujt në (49) dhe (50) japin indikacione se kufizimet eventuale semantike në gjuhën shqipe janë më ndryshe se kufizimet në gjuhën gjermane. Për shkak të hapësirës dhe kuadrin të ravijëzuar në këtë punim, nuk po vazhdojmë më tutje me problematikën e plotësive të përemrave të cekur, por është me rëndësi të konstatojmë se dallimi në kufizimet semantike të plotësive paraqet edhe një dallim tjetër ndërmjet konstruksioneve ndajshimore të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane.

Si përfundim po themi: konstruksionet ndajshimore me përemër si fjalë bosht në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane dallojnë si në rrafshin

sintaksor ashtu edhe në rrafshin semantik. Pra, edhe këto konstruksione ndajshimore e hedhin poshtë pohimin e Uhlisch. Gjithashtu, për gjuhën shqipe mbeten eventualisht dy çështje si problematike, të cilat kërkojnë një studim të mëtutjeshëm: e para, rastet kur ndajshtimi është në gjinore si p. sh. *ti i shkollës*, te të cilat kriteri ko-referencialitetit realizohet në rrafshin semantik, por jo edhe në atë sintaksor, dhe e dyta, çështja e nyjës së shquar te konstruksionet e vetës II-të, qoftë në njëjës apo në shumës, për shkak të konstruksioneve thirrrore, siç janë: *O ju pleq, o ju mre shopa...* (shembull i marrë nga Prifti (1971:102)) te të cilat nyja e shquar, për dallim nga konstruksionet e tjera ndajshimore me fjalë bosht përmrin, nuk është e pranishme.

8. Struktura dhe lidhjet sintaksore të ndërtimeve ndajshimore

Çështja e lidhjes (relacionit) ndërmjet fjalës bosht dhe ndajshimit është një çështje e cila në vazhdimësi ka tërheqë vëmendjen e gjuhëtarëve dhe për të nuk ka një mendim të prerë⁴⁴. Natyrisht, ky punim nuk synon të propozon një përgjigje rreth kësaj çështje, por për qëllim ka të pasqyron përputhjet dhe s'përputhjet eventuale të kësaj lidhje, të cilat dalin nga të dhënat (shprehjet) konkrete gjuhësore të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane. Konkretisht, ne do të provojmë se ç'lidhje sintaksore janë të pranishme në shembujt e mësipërm dhe si reflektohet ajo në strukturën e konstruksioneve ndajshimore. Po fillojmë me shembujt te të cilët në të dy gjuhët struktura është e njëjtë:

(51) a. *komisar* Memoja (shqip) *Kommissar* Memo (gjermanisht)

b. [NP \emptyset] + [DP_{NOM}] [NP \emptyset] + [DP_{NOM}]

dhe po shikojmë se cila nga tri llojet e lidhjeve brenda sintagmës (përshtatja, drejtimi dhe bashkimi) janë të pranishme në konstruksionet ndajshimore me strukturë si në (51b).

Përshtatja: apo kongruenca nënkupton se gjymtyrët e sintagmës përshtaten duke marrë tiparet gramatikore nga fjala bosht. Konkretisht, supozohet se secila sintagmë emërore ka katër tipare gramatikore: rasën, gj-

⁴⁴ Shih lidhur me këtë çështje Molitor (1979) dhe Eisenberg (2013:258)

ninë, numrin dhe vetën. Në rastin tonë, sa i përket rasës, vërejtëm se te shembujt si në (51), ndajshtimi në të dy gjuhët ka gjithnjë formë të njëjtë, pavarësisht se në ç' rasë është emri bosht, prandaj themi se përshtatja në rasë përjashtohet në të dy gjuhët.

Edhe përshtatja në gjini nuk është e pritshme, sepse të dy gjymtyrët janë emra dhe secili prej tyre ka, si një tipar të pavarur dhe të brendshëm, gjininë e vet, e cila nuk kufizohet nga ndonjë relacion sintaksor. Por, përputhja në gjini ndërmjet fjalës bosht dhe ndajshtimit është e mundshme. Kështu p. sh. te shembulli *lumi Osum*, si fjala bosht (*lumi*) ashtu edhe ndajshtimi (*Osum*), janë të gjinisë mashkullore. Mirëpo, në shembullin tjetër kjo përputhje nuk është e pranishme: *lumi Vjosë*, fjala bosht *lumi* është e gjinisë mashkullore, ndërsa ndajshtimi *Vjosë* është i gjinisë femërore. Ngjashëm është edhe në gjuhën gjermane: te shembulli *der Fluss Rhein*, (*lumi Rajna*) të dy gjymtyrët, *der Fluss (lumi)* dhe *der Rhein (Rajna)*, janë të gjinisë mashkullore. Kurse në shembullin *der Fluss Donau (lumi Danub)*, emri bosht *der Fluss (lumi)* është emër i gjinisë mashkullore, kurse *die Donau (Danubi)* në gjuhën gjermane është i gjinisë femërore. Por kjo nuk do të thotë se në gjini herë ka e herë s'ka përshtatje gjegjësisht se në gjini ka një përshtatje të pjesshme⁴⁵. Por, mund të thuhet se në gjini në të dy gjuhët ka përputhje dhe s'përputhje të rastit.

Lidhur me tiparin e numrit, Molitor (1979:25), duke u bazuar në grammatikat e mëhershme si dhe shembujve, të cilët ai i paraqet, vjen në përfundim se në gjuhën gjermane te konstruktionet ndajshtimore të paveçuar, ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit gjithnjë është e pranishme përshtatja (kongruenca) në numër. Ngjashëm mendon edhe Löbel (1986:80): nëse sintagma e parë e konstruktionit është në shumës, atëherë edhe sintagma e dytë duhet të jetë në shumës. Mirëpo Lawrenz (1993:47) mendon ndryshe, sepse disa konstrukcione ndajshtimore si në vijim dëshmojnë të kundërtën⁴⁶:

⁴⁵ Përshtatja është një relacion asimetric, prandaj nëse është e pranishme, atëherë ajo duhet të jetë e pranishme pa përjashtim të të gjitha konstruktionet, të cilat kanë strukturë të njëjtë sintaksore, e jo vetëm te disa prej tyre, qoftë edhe nëse refleksi morfologjik mungon. Shih Corbett (2006)

⁴⁶ Për shembujt e tjerë dh diskutimet rreth kësaj çështje shih Lawrenz (1993:47)

- (52) a. Die Brüder Schlegel Vëllezërit Schlegel
 b. *Schlegel sind Brüder. *Schlegel janë vëllezër
 c. Schlegels sind Brüder. Schlegel-ët janë Vëllezër.
- (53) a. Die Berge Shikoku Vargmalet Shikoku
 b. * Shikoku sind Berge Shikoku janë vargmale
 c. Shikoku ist ein Gebirge Shikoku është një mal.

Vërehet qartë se parafrazimi i (52a) nuk është i mundshëm në (52b) pa mbaresën (*s*) në (52c), e cila siguron përshtatjen në numër. Ngjashëm është edhe në shembullin (53). Vërejmë se parafrazimi është i mundshëm vetëm nëse folja këpujore (*ist*) është në njëjës (53c), por jo edhe kur ajo është në shumës (*sind*) si në (53b), që dëshmon se pavarësisht se gjymtyra bosht është në shumës (*die Berge*), ndajshtimi mund të jetë në njëjës (*Shikoku*). Në anën tjetër mund të vërehet se konstruktionet ndajshtimore në vijim janë të papranueshme, ani pse përputhja në numër është e pranueshme:

- (54) a. * die Bäume Kiefern (vs. die Bäume Kiefer und Eibe)*pemët
 halorët
 b. Kiefern sind Bäume Halorët janë pemë

Thënë ndryshe, në gjuhën gjermane nuk ka përshtatje në numër, por ngjashëm sikurse te gjinia, ka përputhje (dhe s'përputhje) të rastit. Prandaj, në gramatikat e botuar së voni, p. sh. Eisenberg (2013) apo Duden (2016) një përshtatje e tillë nuk përmendet.

Te gramatikat e gjuhës shqipe përshtatja në numër e ndajshtimit dhe gjymtyrës bosht konsiderohet si karakteristikë identifikuese e konstrukcioneve ndajshtimore. Kështu p.sh. sipas Gramatikës së Akademisë (2002: 237): "Ndajshtimi është një lloj përcaktori i shprehur me emër të pashquar që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar", por jo edhe në tipare të tjera, andaj edhe quhet "përcaktori me përshtatje të pjeshme" (fq. 223)⁴⁷. Efekti i këtij pohimi gjegjësisht rregulle vërehet edhe te përdorimi i saj p. sh. te titujt e librave:

⁴⁷ Edhe Dhima (2005: 91) pohon se ndajshtimi është një përcaktor me përshtatje të pjeshme, por ai nuk tregon se te cili tipar realizohet ajo.

(55) Vëllezërit Karamazovë⁴⁸ (e vëllezërit Grim? Në këtë rast nuk ka ë, prandaj as përshtatje në numër)

Kështu në (55), përkthyesi i romanit e vendosë edhe ndajshtimin (Karamazov) në shumës, duke i shtuar një -ë. Nëse është kështu, atëherë ky është edhe një dallim ndërmjet konstruksioneve ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane gjegjësisht kjo është edhe një dëshmi që flet kundër tezës së Uhlisch. Mirëpo, nëse merren parasysht shembujt në vijim të gjuhës shqipe:

- (56) a. poema "Këngët e Milosaos", apo
b. filmi "Zambakët e bardhë"

vërejmë se ndërmjet gjymtyrës bosht (*poema* apo *filmi*) dhe ndajshtimit (*Këngët e Milosaos* përkatësisht *Zambakët e bardhë*), nuk përputhen në numër, sepse e para është në njëjës, kurse e dyta është në shumës. Por, vërejmë gjithashtu se tipari i numrit të ndajshtimit nuk ka fare ndikim në tiparin e numrit të konstruksionit ndajshtimor:

(57) *Zambakët e Bardhë* është (*janë) film televiziv i vitit 1983 me regji nga Ilir Bega dhe skenar nga Vangjush Ziko.

sepse në (57) ani pse sintagma emërore (në funksion të kryefjalës) *Zambakët e Bardhë* është në shumës, megjithatë këpuja mund të përdoret vetëm në njëjës (*është*) e jo në shumës (*janë*). Prandaj, kjo na lë të kuptojmë se edhe në gjuhën shqipe mundemi (eventualisht) të themi se nuk ka përshtatje, por mund të ketë përputhje dhe s'përputhje në numër ndërmjet gjymtyrëve. Siç duket një dukuri e tillë jep shenja të universalitetit, sepse ajo është e pranishme edhe në gjuhë të tjera, siç tregon shembulli në gjuhën angleze:

(58) The poem "The three witches" (poema "tri shtrigat")

Shembujt në (56), por edhe fakti se p.sh. në shqipe themi: vëllezërit Grim (*Gebrüder Grimm*)⁴⁹ dhe Jakob Grimm, me ç'rast për shkak të

⁴⁸ Botuar në Prishtinë më 1984 nga Rilindja dhe përkthyer nga Fadil Bujari. Kështu është edhe te botimi së fundmi nga Uegen, në Tiranë më 2014, përkthyer nga rusishtja nga Jorgji Doksani.

⁴⁹ Shih Buchholz. Fiedler (1987: 25)

rregullave drejtshkrimore mbiemrit Grimm nuk i shtohet -ë, atëherë mund të jenë dëshmi se teza e Uhlisch është e drejtë, por njëkohësisht ajo e rrëzon atë të Gramatikës së Akademisë. Rrjedhimisht në konstruksionin *Vëllezërit Karamazov*, ngjashëm si te *Vëllezërit Grimm*, ndajshtimi nuk është e domosdoshme të shfaqet në formën e shumësit. Shembulli (57) na deshmon se këtë nuk e kërkon gjymtyra bosht, sepse edhe ashtu numri i ndajshtimit nuk ndikon në numrin e konstruksionit. Prandaj, në këtë punim, sa i përket përshtatjes në numër ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit, mund të konsiderojmë edhe skenarin se ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjermane nuk ka dallim gjegjësisht se përshtatja në numër nuk është dëshmi që e kundërshton tezën e Uhlisch. Natyrisht, këtë përfundim po e marrim të kushtëzuar, sepse kujtojmë se ngritja e dilemës në këtë punim se a ka përshtatje në numër ndërmjet gjymtyrëve të konstruksionit ndajshtimor kërkon thellim dhe hulumtim të mëtutjeshëm. Por, ajo që mund të themi është se ndajshtimi jo gjithnjë është i shprehur me emër të pashquar, si në (56) dhe jo gjithnjë përshtatet në numër me gjymtyrën bosht siç pohon Gramatika e Akademisë (2002: 237). Rrjedhimisht përshtatja vetëm në numër nuk mund të merret si një karakteristikë, e cila e dallon ndajshtimin nga përcaktori.

Në fund, para se të vazhdojmë me relacionin e drejtimit, na mbetet tipari i vetës, i cili për emrat është i fiksuar në leksikon në vetën e III-të. Rrjedhimisht, secili emër ka tiparin e vetës dhe meqë prania e saj tek emrat nuk është rrjedhojë e një relacioni asimetrik sintaksor, por thjesht një veti leksikore, atëherë themi se as te ky tipar, në të dy gjuhët, nuk ka përshtatje.

Drejtimi: dalja e ndajshtimit në emëroren e pashquar, sidomos te konstruksionet ku ata shënojnë tituj, i ka shtyrë disa gjuhëtarë të supozojnë se në këto raste një relacion i tillë ndajshtimor bazohet në relacionin e drejtimit (gjerm. *Rektion*). Kështu p. sh. Eisenberg (1986: 243) thotë se emri bosht (*Memo*) e drejton rasën e ndajshtimit-titull (*Kommissar*) dhe numrin e tij (në njëjës). Por, pas kritikës rreth kësaj çështje të bërë nga Lawrenz (1993: 35) se në gjuhën gjermane (sikurse te disa gjuhë të tjera p. sh. Shqipe) emri mund të drejtoi emrin vetëm në gjinore dhe atë vetëm nga ana e

djathtë⁵⁰ si dhe kritika se numri nuk përcaktohet nga gjymtyra bosht, Eisenberg (2013:258) e modifikon pohimin e tij, duke thënë se drejtimi në këtë rast nuk është një drejtim si tipar leksikor i emrit, por është një drejtim si tipar i strukturës dhe si i tillë paraqet një çështje problematike. Prandaj, sikurse Lawrenz (1993:34), ai supozon se emërorja e pashquar është një rasë e paracaktuar (*Defaultkasus*). Thënë ndryshe, te konstruksionet ndaj-shtimore edhe nëse (eventualisht) drejtimi është i pranishëm, atëherë (sipas tij) ky drejtim nuk është një relacioni në kuptimin tradicional. Kurse, sa i përket drejtimit të numrit, Eisenberg në botimin e ri e ka tërhequr dhe nuk e përmend fare një pohim të tillë. Si përfundim lidhur me relacionin e drejtimit mund të themi: asnjëri tipar i ndaj-shtimit nuk drejtohet nga gjymtyra bosht. Sa i përket rasës, për ne është e rëndësishme se edhe në gjuhën shqipe emërorja mund të konsiderohet si një rasë e parapërcaktuar, që do të thotë se në këtë pikëpamje ndërmjet dy gjuhëve ka një përputhje.

Pranëvënia apo Bashkimi: relacioni sintaksor ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndaj-shtimit më shumë i ngjet relacionit të pranëvënies apo bashkimit, sepse sipas Gramatikës së Akademisë (2002: 86) "bashkimi është ai lloj i lidhjes nënrenditëse ku fjala e varur është një fjalë e pandryshueshme". Te konstruksionet ndaj-shtimore si në (51) vërejtëm se ekziston një relacion asimetrik ku gjymtyra e nënrenditur (ndaj-shtimi) është një fjalë me formë të pandryshueshme. Një relacion të tillë e supozon edhe Lawrenz (1993: 30) për gjuhën gjermane dhe sipas saj, ky relacion realizohet në një shtresë më të ulët sintaksore. Madje, në krahasim me përcaktorët, ky bashkim bëhet në nivel të fjalës e jo të sintagmës⁵¹. Këtë ajo e dëshmon duke bërë disa prova, të cilat po i provojmë në konstruksionet e gjuhës shqipe, për të parë se a realizohet ky relacion sikurse në gjuhën gjermane në një shtresë më të ulët se sa përcaktori në gjinore. Këtu po i paraqesim disa nga këto prova.

⁵⁰ Kurse ndaj-shtimi në gjuhën gjermane (Lawrenz 1993: 35) dhe shqipe (Gramatika e Akademisë 2002:237) mund të vendoset në të dy anët e emrit bosht.

⁵¹ Të rikujtojmë, struktura sintaksore e një konstruksioni mund të konsiderohet se është shtesore. Kështu p. sh. teoria X-bar, supozon se secila sintagmë është e ndërtaur nga tri shtresa, të futura brenda njëra tjetrës. Në shtresën më të ulët është e vendosur fjala bosht (koka), kurse shtresa më e lartë është sintagma, e cila përfshinë edhe shtresën ku është e pozicionuar koka dhe shtresën e ndërmjet shtresës së ulët dhe më të lartë.

Prova 1: në shembullin e mëposhtëm:

(59) a. [Shtëpia dhe vetura] e Agimit ishte ...

b. [Das Haus und das Auto] Agims war

përcaktori në gjinore (*e Agimit*) i referohet të dy përbërësve të kryefjalës (*shtëpia dhe vetura*) duke modifikuar kështu të dy entitetet (*shtëpia e Agimit* dhe *vetura e Agimit*). Kurse, ndajshtimi mund ti bashkëngjitet vetëm njërit nga përbërësve të kryefjalës:

(60) a. *[Demarkacioni dhe dialogu] *Kosovë-Serbi* ishin temat kryesore politike në 2017 ...

b. *[Die Demarkation und der Dialog] *Kosovo-Serbien* waren die wichtigsten politischen Stoffe im 2017...

e jo të dy përbërësve të kryefjalës, sepse në (60) bëhet fjalë për demarkacionin Kosovë-Mali i Zi e jo Kosovë-Serbi.

Prova 2: Ndajshtimi i paveçuar nuk mund të shfaqet pas gjymtyrës së eliduar bosht:

(61) a. *Qeveria Mustafa dështoi më herët se Ø Thaçi.

b. * Die Regierung Mustafa ist früher gescheitert als die Ø Thaçi.

sikurse është rasti me përcaktorin në gjinore:

(62) a. Kopshti i profesorit është më i madh se i Ø farmacistit.

b. Der Garten des Professors ist grösser als Ø des Apothekers.

Prova 3: kur janë njëkohësisht të pranishëm ndajshtimi i paveçuar dhe përcaktori në gjinore, (sipas Lawrenz) ndajshtimi gjithnjë është më afër gjymtyrës bosht:

(63) a. Seksioni "Gjeografi" i Shoqatës për Studime Kanadeze

b. die Sektion "Geografie" der Gesellschaft für Kanada-Studien

Mirëpo, kështu nuk ndodh edhe me emrat relacional, të cilët e përzgjedhin një plotës në gjinore:

(64) a. Absolventi i Akademisë së Arteve Peter Brodien/ * Absolventi Peter Brodien i Akademisë së Arteve

b. der Absolvent der Kunstakademie Peter Brodien/ * der Absolvent Peter Brodien der Kunstakademie

Siç vërejmë në (64), kur përdoret njëkohësisht plotësi i emrit relational dhe ndajshtimi, atëherë në të dy gjuhët menjëherë pas emrit del plotësi e pas këtij vjen ndajshtimi⁵². Arsyeja për një renditje të tillë mund të jetë pikërisht prania e lidhjes sintaksore të drejtimit ndërmjet emrit relational dhe plotësit, e cila nuk është e pranishme edhe te ndajshtimi. Prandaj, si rrjedhojë emri relational i jep përparësi plotësit kundruall ndajshtimit. Por, shembulli (64) njëkohësisht na lë të kuptojmë se ndajshtimi mund të bashkëngjitet edhe sintagmës. Sidoqoftë, për ne është e rëndësishme se në këtë pikëpamje bashkimi i ndajshtimit bëhet në shtresat e njëjta sintaksore në të dy gjuhët.

Nga ajo që u shtrua deri më tani na lë të kuptojmë se ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit nuk ka një lidhje specifike sintaksore. Nëse kihet parasysh se gjymtyra bosht dhe ndajshtimi mund të largohen nga konstrukcioni dhe madje ata mund të ndërrojnë edhe rolet e tyre pa shkaktuar ndonjë çrregullim gramatikor dhe kuptimor, atëherë shtrohet pyetja a ka ky konstrukcion një strukturë asimetrike, e cila zakonisht supozohet se është e pranishme te konstruktionet ndajshtimore, sepse zakonisht thuhet x është ndajshtim i y⁵³. Mirëpo, relacioni semantik i të dy gjymtyrëve shpesh e vështirëson përzgjedhjen e njërës prej gjymtyrëve si më të rëndësishme, pra fjalë bosht, e cila lejon "modifikimin" e saj nga një gjymtyrë "më pak e rëndësishme". Më herët vërejtëm se kjo situatë në gjuhën gjermane shfaqet kur emrit të përgjithshëm (*Kommissar*) i paravendosej nyja e shquar (*der*), duke rezultuar në një strukturë si në (65a):

(65) a. [[DP_{NOM}] + [DP_{NOM}]] (për gjuhën gjermane)

b. [DP_{NOM} + NP_∅] (për gjuhën shqipe)

e cila përbëhet nga dy sintagma determinante të bashkërenditura, kurse në

⁵² Ngjashëm ishte dashur të ishte edhe me emrat prejfoljor. Lidhur me këtë krahaso modelin e sintagmave emërore NM 6a (Subst + NG_{Gen} + PG) dhe NM 6b (Subst + PG + NG_{Gen}) te Buchholz/Fiedler (1987: 419) si dhe shih Memushaj (2005:104) dhe pohimin aty: "Emri ne gjinore vihet i pari kur gjymtyra e përcaktuar është emër foljor.

⁵³ Shih Eisenberg (2013:257)

gjuhën shqipe struktura përbëhet nga një sintagmë determinante dhe një sintagmë emërore. Nëse kihet parasysh se sintagma determinante në pikëpamje hierarkike pozicionohet më lartë se sintagma emërore⁵⁴, e cila zakonisht është plotës i sintagmës determinante, atëherë themi se struktura e gjuhës shqipe është e nënrenditur. Në fakt arsyeja thelbësore e një dallimi të tillë strukturor përkon me natyrën e nyjës së shquar shqipe dhe gjermane. E para është afiks⁵⁵, kurse e dyta klitik. Ky dallim morfo-sintaksor ndërmjet nyjave më së miri vërehet te konstruksionet me sintagma të bashkërenditura:

(66) a. Poet-i dhe shkrimtar-i ...

b. Der Dichter und Schriftsteller⁵⁶ ...

Në gjuhën shqipe nyja është e pranishme te të dy sintagmat (66a), kurse te gjuha gjermane vetëm te sintagma e parë (66b). Rrjedhimisht, për të qenë struktura e konstruksioneve ndajshtimore në gjuhën shqipe e bashkërenditur, atëherë ishte dashur që nyja të jetë e pranishme në të dy gjymtyrët. Një prani e tillë në gjuhën shqipe te këto konstruksione përjashtohet, ani pse në gjuhën shqipe nyja përdoret edhe me emrat e përveçëm dhe është e domosdoshme kur ky i fundit kryen funksione sintaksore brenda fjalisë. Kurse, në gjuhën gjermane, mu për shkak të mos pranisë së nyjës së shquar te emri i përveçëm, ky i fundit zhvendoset në pozicionin sintaksor D, duke rezultuar kështu në dy sintagma të bashkërenditura. Thënë ndryshe, te këto konstruksione ndajshtimore në gjuhën gjermane nuk ka një dallim morfo-sintaksor ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit. Se cila gjymtyrë është bosht, varet (siç thotë Jung (1973: 84)) nga konteksti gje-gjësish "ajo që është më e rëndësishme për shprehjen bëhet gjymtyrë bosht, pjesa tjetër është ndajshtim".

⁵⁴ Shih Koleci/Turano (2011)

⁵⁵ Nyja e shquar e gjuhës shqipe nuk është afiks për shkak se ajo është e prapavendosur, por për shkak të tipareve të saja fonologjike dhe gramatikore. Kështu p. sh. nyjat e prapavendosura të gjuhës bullgare dhe maqedonase ani pse të prapavendosura ato nuk janë afikse, por klitik. Shih më gjërësisht Abrashi (2012a)

⁵⁶ Wenn in der Koordination nur ein D auftritt, handelt es sich um koordinierte NPs. (Kur në bashkërenditje shfaqet vetëm një D, atëherë fjala është për sintagma emërore të bashkërenditura. Përkthyer nga T. A.). Shih Vater (1993:71)

9. Analiza e shembujve me formë të njëjtë në të dy gjuhët

Në këtë seksion do të analizojmë konstruksione, të cilat nëpër grammatikat e të dy gjuhëve janë të trajtuara si konstruksionet ndajshtimore⁵⁷. Këto konstruksione janë të njohura si konstruksione me llagap⁵⁸ dhe kanë formë si shembujt në vijim:

(67) a. Karli i Madh (Shqip) Karl **der** Große (Gjerm.)

b. Katarina e Madhe Katharina **die** Große

Për ne këto konstruksione janë interesante sepse, së paku në formë, shfaqin ngjashmëri shumë të mëdha. Kështu nyja shquese të konstruksionet në gjuhën gjermane i përshtatet jo si zakonisht emrit që i paraprinë, por në (67) i përshtatet emrit të cilit i shkon pas. Në (67a) ajo merr formën e gjinisë mashkullore (*der*) duke iu përshtatur emrit mashkullor të cilit i shkon pas (*Karl*), kurse në (67b) ajo ka formën e gjinisë femërore (*die*), sepse i përshtatet emrit të gjinisë femërore të cilit i shkon pas (*Katharina*). Pra, kemi një situatë të ngjashme në të dy gjuhët, nëse kihet parasysh se në gjuhën shqipe nyja e përparme e mbiemrit përshtatet rregullisht në mënyrë të paraqitur pikërisht si në shembujt shqip në (67a) dhe (67b). Përveç kësaj, nëse krahasojmë shembujt e gjuhës shqipe dhe gjermane, vërejmë edhe një ngjashmëri ortografike: të dy gjymtyrët ndajshtimore janë të shkruara me germë të madhe. Në gjuhën shqipe kjo bëhet sepse i gjithë konstruksioni konsiderohet si një emër i përveçëm⁵⁹, kurse në gjermanishte kjo bëhet sepse në këtë gjuhë secili emër shënohet me germë të madhe pa përjashtim a është i përveçëm a i përgjithshëm. Kur kihen parasysh gjitha këto ngjashmëri, atëherë pritishtëria se këto konstruksione kanë ngjashmëri në rrafshin morfologjik, sintaksor dhe semantik ishte dashur të ishin realiste. Madje kjo ngjashmëri i ka shtyrë disa gjuhëtarë si p. sh. Himmelmann (1997: 188) të mbështesin tezën se nyjat lidhëse (të mbiemrit e gjinore) si në gjuhën shqipe fillimin e zhvillimit të tyre e kanë pikërisht te këto konstruksione, pra kur nyja e shquar është e vendosur ndërmjet emrit dhe përcaktorit pikërisht si në shembujt e gjuhës gjermane.

⁵⁷ Shih p. sh. Buchholz/Fiedler (1987: 423), por edhe Demiraj (1986: 542) dhe Prifti (1971: 103) për gjuhën shqipe, kurse Duden (2016: 980) dhe Eisenberg 2013: 259)

⁵⁸ Shih Abrashi (2012)

⁵⁹ Beci (2005:54). Të kihet parasysh se me të madhe shkruhet edhe rumanishte: *Carol cel Mare*, por edhe në latinishte *Carolus Magnus* dhe gjuhë të tjera.

Sidoqoftë, të krahasojmë fillimisht ndajshtimet në të dy gjuhët. Në gjuhën gjermane mbiemri *Große* është i emëruar, këtë e dëshmon edhe prania e nyjës shquese (*der* në emërore), kurse në gjuhën shqipe ky emërzim i ndajshtimit është "i imponuar" me dhënien e statusit të emrit të përveçëm.

- (68) a. Karli **i** Madh (Shqip) Karl **der** Große (Gjerm.) NOM
 b. i Karlit **të** Madh Karls **des** Großes GEN
 c. Karlit **të** Madh Karl **dem** Großen DAT
 d. Karlin e Madh Karl **den** Großen AKK
 e. Karlit **të** Madh ABL

Në (68) vërejmë se në të dy gjuhët lakohen të dy gjymtyrët e konstruktionit ndajshtimor, si fjala bosht ashtu edhe ndajshtimi. Pra te këto konstrukcione ndajshtimi nuk ka formë tipike të emërores së pashquar në gjuhën shqipe dhe emërores në gjuhën gjermane. Rrjedhimisht, struktura sintaksore e këtyre konstrukcioneve është si vijon:

- (69) a. [[NP_{NOM}] + [AP_{NOM}]] (Shqip)
 b. [[DP_{NOM}] + [DP_{NOM}]] (Gjermanisht)

Në emërore të gjuhës shqipe ajo përbëhet nga një sintagmë emërore dhe nga një sintagmë (tipike) mbiemërore, pavarësisht se ndajshtimi mbanë statusin e emrit të përveçëm. Kurse në emërore të gjermanishtes ajo përbëhet nga dy sintagma determinante. Disa gjuhëtarë, si Hoffmann (2013: 203) këto konstrukcione të gjuhës gjermane nuk i pranojnë si konstrukcione ndajshtimore, pikërisht se të dy gjymtyrët e këtyre konstrukcioneve lakohen. Sidoqoftë, (69) na dëshmon se këto konstrukcione dallojnë për nga struktura e tyre sintaksore.

Të shikojmë tani kur emërzimi i mbiemrit në gjuhën shqipe nuk është i imponuar, por ai është i mirëfilltë:

- (70) a. **i** Madh-**i** Karl
 b. **i** të Madh-**it** Karl
 c. **të** Madh-**it** Karl
 d. **të** Madh-**in** Karl
 e. **të** Madh-**it** Lekë

Në (70) vërejmë se përveç emërzimit të mirëfilltë edhe konstrukcioni ndajshtimor është i mirëfilltë, sepse emri i përveçëm Karl në të gjitha rasat ka formën e emërores së pashquar. Në këta shembuj vetëm mbiemri i emëruar lakohet. Prandaj, struktura sintaksore e konstrukcionit në (70), në emërore është e njëjtë si ajo për gjuhën shqipe në (65):

(71) [DP_{NOM} + NP_∅]

Pra, ajo është e përbërë nga një sintagmë determinative në rasë përkatëse dhe një sintagmë emërore në emëroren e pashquar.

Në rrafshin sintaksor ky pozicion i mbiemrit në gjuhën shqipe, ku ai merr nyjën e shquar dhe emërzohet, quhet pozicion i markuar i mbiemrit, për dallim nga pozicioni i zakonshëm pas emrit, i cili quhet pozicion i pa markuar⁶⁰. Mbiemri i vendosur në këtë pozicion, ngjashëm si në latinishte, merr një shqiptim emfatik. Ky lloj shqiptimi në gjuhën gjermane është i pranishëm te konstrukcionet në (68), pra sikurse në gjuhën shqipe, në pozicionin e markuar të mbiemrit, i cili te kjo gjuhë është pozicioni pas emrit⁶¹. Nëse tani krahasojmë konstrukcionet në (67) të gjuhës gjermane dhe të gjuhës shqipe:

(72) a. Karli i Madh [[Karli DP]+[i Madh AP]]

b. Karl der Große [[Karl DP]+[[der D] + [Große AP]DP]]

dhe i zërthejmë strukturat si në (72), vërejmë se në të dy gjuhët struktura përmban edhe nga një sintagmë mbiemërore, sepse sintagma determinative e ndajshtimor përmban një sintagmë mbiemërore. Dhe sikur nyja e mbiemrit të mos ishte aq e gramatikalizuar, ashtu që ajo do të kishte mundësi të veçohet nga mbiemri, atëherë edhe në gjuhën shqipe nyja e mbiemrit do të ishte kokë e një sintagme determinative si në gjuhën gjermane. Thënë ndryshe, strukturat në (72) dëshmojnë për një ngjashmëri formale evidente. Një zberthim i strukturës si (72) për ne është i rëndësishëm, sepse na mundëson që krahasimi të bëhet më i saktë. Siç vërejmë në të dy gjuhët është e pranishme komponenta mbiemërore, mirëpo në gjuhën shqipe ajo gjendet në pozicion të pa markuar, kurse në gjuhën gjermane në pozicion të markuar. Kjo nënkupton se përveç këtij dallimi në rrafshin sintaksor, ka dallim

⁶⁰ Shih Buchholz/Fiedler (1987: 328)

⁶¹ Shih Marschall (1992)

edhe në rrafshin fonetikë, sepse siç u tha edhe më herët pozicionet emfatike të mbiemrit janë të kundërta: para emrit në gjuhën shqipe dhe pas emrit në gjuhën gjermane. Këtyre dallimeve mund ti shtohet edhe dallimi morfologjik, sepse mbiemri në gjuhën shqipe mund të emërzohet vetëm kur ai del para emrit. Të shohim në vijim se a ka dallime edhe në rrafshin semantik.

Në shumë gjuhë, përcaktorët marrin kuptime të ndryshme kur pozicionohen para ose pas emrit⁶². Në gjuhët romane realizimi i interpretimeve të ndryshme të po të njëjtës njësi leksikore, duke e pozicionuar atë para ose pas emrit, bëhet rregullisht.

- (73) a. le ami vieil (mik i vjetër nga mosha) Frëngjisht
 b. il vieil ami (mik i vjetër, i kamhmotshëm)
- (74) a. il amico vecchio (mik i vjetër nga mosha) Italisht
 b. il vecchio amico (mik i vjetër, i kamhmotshëm)

Kështu ndodh edhe në gjuhën frëngjishte (73) dhe gjuhën italishte (74), me ç'rast shembujt në (73a) dhe (74a) kanë interpretim të ndryshëm me shembujt (73b) dhe (74b): te të parët fjala është për një mik, i cili është i moshuar, kurse te të dytët fjala është për një mik, të cilin e njohim kaherë.

Nëse kihet parasysh se në gjuhën gjermane (angleze etj) mbiemri para dhe pas emrit ushtron edhe funksione të ndryshme sintaksore: para emrit ka funksion atributiv, kurse pas emrit ka funksion predikativ (kallëzuesor), atëherë edhe në gjuhën gjermane është i pritshëm një interpretim i ndryshëm i mbiemrit para dhe pas emrit. Sipas Bolinger (1967) në funksion atributiv, mbiemri e modifikon emrin në mënyrë permanente, d. t. th. në këtë funksion ai e modifikon referencën, rrjedhimisht në këtë funksion ai është një modifikues reference (*reference-modifying*). Kurse, në funksion predikativ modifikimi është i përkohshëm gjegjësisht i kufizuar, prandaj ai mund të modifikon një referent tashmë përcaktuar, i cili në rastin tonë quhet Karl, rrjedhimisht mbiemri në këtë funksion është modifikues referenti (*referent-modifying*). Thënë ndryshe, kur mbiemri *große* është para emrit ai përdoret p. sh. për të dalluar *Karlin e madh* nga *Karli i vogël*, kurse kur *Große* është pas emrit ai përdoret jo për të shënuar ndonjë madhësi fizike si në rastin kur ai ndodhet para emrit, por për të shënuar një madhësi

⁶² Shih më hollësisht rreth kësaj çështje Abrashi (në botim) dhe literaturën e cituar aty.

të aftësive të *Karl-it*, qoftë si luftëtar ose si një personalitet i zgjuar etj⁶³. Në gjuhën shqipe është e kundërta: mbiemri *i madh* pas emrit përdoret për të dalluar sendet për nga madhësia e tyre fizike, kurse kur ai gjendet para emrit ai përdoret për të lartësuar aftësinë e atij sendi apo individ duke i shtuar nëpërmjet rrafshit fonetik edhe një nuancë të admirimit. Shënimi i llogarëve të personalitetëve të ndryshme si p. sh. *Karli i Madh* apo *Leka i Madh*, pra ashtu siç është paraparë me drejtshkrimin e gjuhë shqipe nënkupton se mbiemri në gjuhën shqipe bënë modifikimin e referencës e jo modifikimin e referentit, të cilin e bënë mbiemri përkatës në gjuhë gjermane. Shqipfolësi vetëm me anë të kontekstit apo për shkak të pranisë së germës së madhe mund të vjen në përfundim se mbiemri në kombinim me emrin i referohet për një aftësi e jo për madhësinë fizike të një individ. Natyrisht, efekti i germës së madhe vjen në konsiderim vetëm në gjuhën e shkruar.

Si përfundim të këtij seksioni të themi: ndonëse fillimisht patëm një ngjashmëri formale shumë premtuese ndërmjet konstruksioneve të gjuhës shqipe dhe gjermane, pas një analize më të thellë mund të konstatojmë se në fakt këto konstruksione kanë dallime evidente në të gjitha rrafshet gjuhësore. Besoj se këto konstruksione dhe analiza kontrastive e tyre mund të përdoren për të dëshmuar se format e njëjta në të dy gjuhët nuk garantojnë edhe ngjashmëri në rrafshet gjuhësore, siç pretendon Uhlisch.

10. Përfundim

Në këtë punim krahasuam konstruksionet me ndajshtim të paveçuar në gjuhën shqipe e gjermane për të provuar pohimin e Uhlisch (1982) se konstruksionet ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe gjermane kanë formë dhe përmbajtje të njëjtë. Analiza në këtë punim, e kufizuar vetëm te konstruksionet me ndajshtim të paveçuar, tregoi se pohimi i Uhlisch është i drejtë vetëm në ndërtimet kur ndajshtimi del si titull (si p. sh. *komisar Memoja*), por jo edhe në konstruksionet e tjera, ndonëse këto ndajshtime ushtrojnë po të njëjtat funksione në diskurs. Kur ndajshtimi nuk shënon një titull: struktura sintaksore në gjuhën gjermane përbëhet nga dy sintagma

⁶³ Ngjashëm është edhe në gjuhët sllave. Krahaso p. sh. *veliki Alexander* me *Alexander Veliki* në maqedonishte.

determinante në të njëjtën rasë, kurse struktura në gjuhën shqipe përbëhet nga një sintagmë determinante në rasën përkatëse dhe nga një sintagmë në emërore të trajtës së pashquar. Te këto konstruksione dallimi është i dukshëm edhe në rrafshin morfologjik: në gjuhën gjermane lakohen të dy gjymtyrët e konstruksionit, në gjuhën shqipe vetëm fjala bosht. Më tutje gjatë analizës u konstatua se ndajshtimi në gjinore për disa arsye mund të konsiderohet si çështje problematike: (i) ai jo gjithnjë i referohet emrit bosht, (ii) konstruksionet ndajshtimore me emërore të pashquar nuk janë gjithnjë semantikisht ekuivalente me konstruksionet ndajshtimore në gjinore dhe (iii) në rast të heqjes së emrit bosht, ndajshtimi në gjinore nuk mund të merr funksionet sintaksore të këtij të fundit. Një analizë e ngjashme si e ndajshtimit në gjinore është bërë për të provuar pretendimin e Friedman se rrjedhja e shqipes është ose kundrinë e disa parafjalëve ose ndajshtim i një emri tjetër. Duke përdor kriterin e bashkë-identitetit në rrafshin sintaksor dhe semantik, pohimi i Friedman del se nuk është i drejtë. Duke marr parasysh argumentet e mësipërme analiza e konstruksioneve me ndajshtim të paveçuar në rasë të tjera (përveç në emërore të pashquar) nuk u morr në konsiderim. Analiza u zgjerua edhe te konstruksionet ndajshtimore me përemër si fjalë bosht, me ç'rast u pa se këto konstruksione të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane gjithashtu dallohen si në rrafshin sintaksor ashtu edhe në rrafshin semantik. Në lidhje me këtë është me rëndësi të thuhet se dallimi në kufizimet semantike të plotësive që marrin përemrat paraqet edhe një dallim tjetër ndërmjet konstruksioneve ndajshtimore të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane. Në këtë punim u analizua edhe lidhja sintaksore ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit e cila rezultoi si një lidhje specifike e bashkimit, me ç'rast bashkimi i ndajshtimit bëhet në shtresat e njëjta sintaksore në të dy gjuhët. Gjithashtu, analiza tregoi se përshtatja vetëm në numër nuk mund të merret si një karakteristikë, e cila e dallon ndajshtimin e paveçuar nga përcaktori. Në seksionin e fundit të këtij punimi analizuam disa konstruksione me një ngjashmëri formale shumë premtuese të gjuhës shqipe dhe gjermane, por pas një analize më të thellë u konstatua se këto konstruksione kanë dallime evidente në të gjitha rrafshet gjuhësore (fonetik, morfologjik, sintaksor dhe semantik). Besoj se këto konstruksione dhe analiza kontrastive e tyre mund të përdoren për të deshmuar se format e njëjta në të dy gjuhët nuk garantojnë edhe ngjashmëri në rrafshet gjuhësore, siç pretendon Uhlisch.

11. LITERATURA

- Abney, Steven P. (1987): *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*. PhD Thesis. MIT
- Abrashi, Teuta (2009): *Der Kopf der Nominalphrase im Deutschen und Albanischen*, *Dituria* 6, 17-34
- Abrashi, Teuta (2012a): *Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit – ngjashmëri dhe dallimet morfosintaksore / Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Albanian and Balkan Languages*. ASHAK, Prishtinë/ fq.235-266
- Abrashi, Teuta (2012b): *Frazat nominale me nyja lidhëse të gjuhës shqipe dhe konstruktionet me llagap në gjuhën gjermane, në: Studime për nderë të Rexhep Ismajlit-me rastin e 65 vjetorit të lindjes*, KOHA, Prishtinë, 1-8.
- Abrashi, Teuta (2013): *A ka fjali njëgjymtyrëshe (pa kryefjalë) nëgjuhën shqipe-refleksion rreth Sintaksës së Mehmet Çelikut*, *Studime* 20, 59-84
- Abrashi, Teuta (2014): *Lidhja kryefjalë-kallëzues: përshtatje, drejtim apo të dyja*, *Studime* 21, 325-340
- Abrashi, Teuta (2016): *Das Nähe-Distanz Modell und die Informationsstruktur im Deutschen*, Në: Jülich, Petrović Marina & Vujčić Nikola: *Nähe und Distanz in Sprache, Literatur und Kultur-Beiträge zur 8. Jahrestagung des Südosteuropäischen Germanistenverbandes* (Kragujevac, 11. – 15. November 2015), 37-54
- Abrashi, Teuta (2017): *Zur syntaktischen Eigenheiten des Merkmals Person im Deutschen*, *Germanica Wratislaviensia Nr. 142*, 105-118
- Abrashi, Teuta (në botim): *Die Beinamenkonstruktionen im Deutschen und der Gelenkartikel im Albanischen*, në Ströbel, Andrea (Hrsg.), Regensburg
- Abrashi, Teuta (në proces të botimit): *Zur syntaktischen Verhältnissen bei der deutschen und albanischen engen Apposition*, Prishtinë.
- Acuña-Fariña, J. Carlos (1994): *Meyer, Chales F.: Apposition in Contemporary English*, Review, *Atlantis XVI* 1-2, 321-326
- Acuña-Fariña, J. Carlos (2006): *A constructional network in appositive space*. *Cognitive*
- Agel, Vilmos (2017): *Grammatische Textanalyse-Textglieder, Satzglieder, Wortglieder*, De Gruyter, Berlin
- Beci, Bahri (2005): *Gramatika e gjuhës shqipe*, Logos-A, Prishtinë
- Bhatt, Christa (1990): *Die syntaktische Struktur der Nominalphrase im Deutschen*, Gunter Narr Verlag, Tübingen
- Bokshi, Besim (2004): *Për vetorë e shqipes*, ASHAK, Prishtinë
- Bolinger, Dwight (1967): *Adjectives in English: Attribution and Predication*. *Lingua* 8. S. 1-34.
- Buchholz, Oda & Wilfried Fiedler (1987): *Albanische Grammatik*, Enzyklopädie Verlag,

- Leipzig
- Burton-Roberts, Noel. 1975. Nominal apposition. *Foundations of Language* 13, 391–419.
- Çeliku, Mehmet (2012): *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)-Vështrim i ri teorik*, ILAR, Tiranë
- Cipo, Kristaq (1952): *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë
- Corbett, Greville (2006): *Agreement*, Cambridge University Press, New York
- Demiraj, Shaban (1986): *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë
- Dhima, Thoma (2005): *Gjuha shqipe-sintaksa*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë
- Domi, Mahir (1971): *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë
- DUDEN (2016⁹): *Die Grammatik*, Duden, Berlin
- Eisenberg, Peter (1986): *Grundriss der Deutschen Grammatik*, Metzler, Stuttgart
- Eisenberg, Peter (2013): *Grundriss der deutschen Grammatik*, Bd. 2. *Der Satz*. Metzler Stuttgart.
- Friedman, Victor (2006): The Balkans as linguistic area. *Elsevier Encyclopedia of Language and Linguistics*. Vol. Ed. By Keith Brown. 657-672. Oxford: Elsevier
- Gallmann, Peter (1997): «Zur Morphosyntax der Eigennamen im Deutschen, Nē: Löbel, Elisabeth / Rauh, Gisa (Hrsg.) (1997): *Lexikalische Kategorien und Merkmale*. Tübingen: Niemeyer (= Linguistische Arbeiten, 366), 72–84.
- Gato, Maristella (2014): *The Web as Corpus-Theory and Practice*, Bloomsbury, London
- Gramatika e Akademisë (2002): *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2*
- Helbig, Gerhard/Joachim Buscha (1996): *Deutsche Grammatik-Ein Handbuch für Ausländerunterricht*-Langenscheidt-Verlag Enzyklopädie, Berlin
- Henschel, Elke & Harald Weidt (1994²): *Handbuch der deutschen Grammatik*, Walter de Gruyter, Berlin
- Hoffmann, Ludger (2013): *Deutsche Grammatik-Grundlagen für Lehrerbildung, Schule, Deutsch als Zweitsprache und Deutsch als Fremdsprache*, Erich Schmidt Verlag, Berlin
- Jung, Walter (1973): *Grammatik der deutschen Sprache*. Leipzig. 5. Aufl .
- Koleci, Flora & Giuseppina Turano (2011): *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Universiteti i Tiranës, Dajti 2000, Tiranë
- Krifka, Manfred (2006): Notions of Information Structure, in: *Interdisciplinary Studies on Information Structure 06*, Potsdam, Berlin
- Lawrenz, Birgit (1993): Apposition-Begriffsbestimmung und syntaktischer Status, Gunter Narr Verlag, Tübingen
- Linguistics* 17(1), 1–37.
- Longobardi, Giuseppe (1994): Reference and proper names: a theory of N-movement in

- syntax and logical form' *Linguistic Inquiry*, pp. 609-665
- Marschall, Gottfried R. (1992): Überlegungen zum nachgestellten Adjektiv im Deutschen. In: Valentin, Paul (Hg.): *Rechts von N. Untersuchungen zur Nominalgruppe im Deutschen*. Narr Tübingen 1992, S. 71–82
- Memushaj, Rami (2005): *Gjuha standarde-si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Toena, Tiranë,
- Meyer, Charles F. 1992. *Apposition in contemporary English*. Cambridge: Cambridge
- Molitor, Friedhelm (1979): Zur Apposition im heutigen Deutsch-Eine Vorstudie, Dissertation, Universität Köln
- Plank, Frans (2002): Grouping in Multiple Attribution: Advantage Albanian, në: Bublitz, Wolfram: *Philologie, Typologie und Sprachstruktur: Festschrift für Winfried Boeder zum 65. Geburtstag*, Peter Lang, Frankfurt, 157-170
- Postal, Paul. 1969. On So-Called "Pronouns" in English. In Reibel, David and Schane, Sanford (Eds.) *Modern Studies in English*. Prentice-Hall Inc.
- Prifti, Stefan (1971): *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë
- Prifti, Stefan (1977): Përcaktori në gjuhën shqipe, *Studime Filologjike 1*, 33-59
- Schäfer, Roland (2016²): *Einführung in die grammatische Beschreibung des Deutschen: Zweite, überarbeitete Auflage* (Textbooks in Language Sciences 2), Language Science Press, Berlin.
- Schindler, Wolfgang (1990): Untersuchungen zur Grammatik appositionsverdächtiger Einheiten im Deutschen. Tübingen: Niemeyer (Linguistische Arbeiten 246).
- Uhlisch, Gerda (1979): Untersuchungen zum adnominalen Attribut in der albanischen Sprache der Gegenwart, Dissertation, Universität Leipzig
- Uhlisch, Gerda (1982): Zu einigen Aspekten eines albanisch-deutschen Vergleichs der adnominalen Attribute, *Language Typology and Universals*, 456-465
University Press
- Vater, Heinz (1993): Determinantien in koordinierten NPs. In: Vuillaume/ Mari-llier/Behr (Hrsg.): *Studien zur Syntax und Semantik der Nominalgruppe*, Narr, Tübingen, 65-83.
- Vater, Heinz (1998): Determinantien und Pronomina in der DP, *Acta Germanica 6*, 11-44

Blertë ISMAJLI, Prishtinë

NORBERT BORETZKY SI ALBANOLOG – SISTEMI FOLJOR I SHQIPES NË STUDIMET E TIJ

Abstract

Emri i Norbert Boretzky-t në opinionin shkencor është i njohur në disa fusha: gjuhësi e përgjithshme, gjuhësi historike, kontaktet ndër-gjuhësore (me përqendrim te gjuhët e Ballkanit) dhe romishtja, së cilës iu përkushtua së fundmi. Gjuha shqipe zë vend në studimet e Boretzky-t që në fillim. Ajo trajtohet kryesisht në kontekstin ballkanik, si në studimet për leksikun, ashtu edhe në ato për gramatikën. Projekti i tij më voluminoz në fushën e albanologjisë është punimi i tij i habilitimit “Der türkische Einfluß auf das Albanische”, i botuar në dy vëllime: i pari është studim i fonologjisë dhe morfologjisë së turcizmave të shqipes, ndërsa i dyti përmban një fjalor të turcizmave të shqipes. Në studimet e tij Boretzky merret edhe me çështje të ndryshme të gramatikës së shqipes: kohët e foljes, konstruktionet me foljen modale *mund*, njëjën e shquar pas para-fjalëve, ndryshimet e tingujve dhe historinë e shqipes, më vonë me morfologjinë e foljes. Në këtë kumesë do të paraqitet kontributi i tij për sistemin foljor të shqipes.

Emri Norbert Boretzky (Norbert Borecki) në opinionin shkencor është i njohur në disa fusha: në gjuhësinë e përgjithshme e gjuhësinë historike ku publikimet e tij me kohë zunë vend në literaturën klasike në fushën e diakronisë historike dhe teorike, më vonë në fushën e kontakteve ndër-gjuhësore (me përqendrim te gjuhët e Ballkanit), ndërsa në pjesën më të madhe të karrierës iu përkushtua romishtes. Interesimet e Boretzky-t për gjuhën shqipe zënë vend që në studimet e hershme të tij. Në to shqipja trajtohet në kryesisht në kontekstin ballkanik, si në studimet për leksikun, ashtu edhe në ato për gramatikën. Projekti i tij më voluminoz në fushën e albanologjisë është punimi i tij i habilitimit “Der türkische Einfluß auf das Albanische” (Ndikimi turk në shqipen), i botuar në dy vëllime: i pari (1975) është studim i fonologjisë dhe morfologjisë së turcizmave të shqipes, ndërsa i dyti (1976) përmban një fjalor të turcizmave të shqipes. Elementet leksikore janë objekt edhe i disa studimeve të mëvonshme.

Aspektet gramatikore që shqyrtohen në studimet Boretzky-t janë të ndryshme: kohët e foljes, konstruksionet me foljen modale *mund*, nyja e shquar pas parafjalëve, morfologjia e foljes, lidhorja dhe paskajorja. Në këtë punim do të ndalem te kontributi i tij për sistemin foljor të shqipes.

Në studimin e tij “Perfekt und Plusquamperfekt in einem nordost-albanischen Dialekt”¹ Boretzky (1966) merret me dy kohë të shqipes: të kryerën dhe më se të kryerën përkatësisht me mundësinë e formimit të tyre me foljen ndihmëse *me qenë*: *jam shkue, isha shkue* në vend të *kam shkue, kisha shkue* dhe me funksionet e tyre. Këto forma, sado që nuk kanë shtrirje të gjerë, janë neglizhuar në studimet gramatikore të shqipes. Në gramatikat e shqipes (krhs. Demiraj, 2002: 289f, Riza, 1997: 209f, Buchholz & Fiedler, 1987: 78²) gjejmë vetëm përshkrimin e formave të shqipes standarde të cilat formohen me foljen ndihmëse *kam*: e kryera *kam larë* dhe më se e kryera *kisha larë*. Si bazë materiale për studimin e përdorimit të këtyre kohëve Boretzky merr tregimet, përrallat e anekdotat nga zona e Drenicës, të mbledhura nga Anton Çetta (1963), të cilat sipas autorit janë të përshtatshme për një analizë të tillë meqë nuk janë “përmirësuar” nga mbledhësi, e ç’është më e rëndësishme për studimin e tij, nuk ka ndryshuar asgjë në morfologjinë dhe sintaksën e tyre. Format e së tashmes dhe ato të pakryerës së foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* që nxjerr nga tekstet e studiuara janë:

jom (jum) – je – ô (o, ôsht) – jena – jini – jon
kom (kum) – ki (kie) – ka – kemi – kena – keni – kan

pra janë forma që shfaqin dallime nga format e shqipes standarde

jam – je – është – jemi – jeni – janë
kam – ke – kanë – kemi – keni – kanë

dhe shfaqen të shoqëruara nga pjesorja në formën e saj të zakonshme për dialektin gegë. Çështja e parë te e cila ndalet autori është përdorimi i foljes

¹ “E kryera dhe më se e kryera në një dialekt verilindor të shqipes”.

² Te Buchholz & Fiedler (1987: 119, shën. 60) gjejmë vetëm një shënim për ekzistencën e këtyre formave të foljet e lëvizjes në gegërishten verilindore, edhe në idiomën e vjetër letrare (krhs. Fiedler 1972: 66f).

ndihmëse. Në korpusin e studiuar e kryera dhe më se e kryera dalin të konstruktura më shpesh me foljen *kam* se sa me foljen *jam*. Folja *jam* del se përdoret me disa folje intransitive, sidomos folje që shprehin lëvizje, ndërsa folja *kam* del me përdorim më të gjerë – jo vetëm me foljet transitive por edhe me folje intransitive, dhe atë me po ato folje intransitive të cilat dalin të shoqëruara nga folja *jam*. Pra ndodhë që në të njëjtin tekst (d.m.th. te i njëjti folës) të shfaqen format *ka árdh* dhe *ó árdh*, të cilat nuk shfaqen me dallim në kuptim. Në tentimin për ta shpjeguar prejardhjen e këtyre formave, Boretzky i vendosë format foljore të të folmes së Drenicës në kontekstin ballkanik ku tërheq paralele me maqedonishten (me format *sum dojden*, *e iden* të cilat nuk kanë statusin e një kohe foljore) dhe me arumanishten ku ka përdorim të kufizuar të këtyre formave (vetëm te dy folje që shprehin lëvizje: shkoj *escu dus* dhe vij *është vinit*). Ndikimi nga greqishtja përjashtohet për shkak të mungesës së kontaktit të drejtpërdrejtë. Sipas tij, është e vështirë të thuhet se cila gjuhë ka ndikuar te tjetra, duket se këto forma janë zhvilluar përmes ndikimit të ndërsjellë.

Boretzky merret edhe me funksionet kryesore të kohëve. Kohë e rrëfimit në shqipen janë e pakryera, e kryera e thjeshtë dhe e kryera e tejkryer (krhs. Ismajli 1980, Kelmendi 1993, Friedman 2004, Rugova & Sejdiu-Rugova 2015), çka vërehet edhe nga Boretzky. Por në korpusin e tij në të njëjtin funksion shfaqet edhe e kryera, pjesërisht në pasazhe të gjata. Boretzky nuk vëren ndonjë dallim objektiv midis formave në të kryerën e thjeshtë dhe atyre në të kryerën, por sheh arsye stilistike për përdorimin të këtyre dy kohëve në të njëjtin funksion. E kryera shfaqet më shpesh se e kryera e thjeshtë në ligjëratën e drejtë, por në rastet kur ajo është më e gjatë, përdoret më shpesh e kryera e thjeshtë meqë kjo ligjëratë e drejtë shndërron në një rrëfim të veçantë. Sipas Boretzkyt mbetet të hulumtohet funksioni i të kryerës në rastet kur paraqitet veçantë dhe jo në ligjëratën e drejtë. Ndërsa më se e kryera nuk është e detyrueshme dhe në korpusin e tij përdoret për të shprehur parakohësi, çka është edhe funksioni thelbësor i saj. Në rastet e tilla më se e kryera i referohet të kryerës së thjeshtë. Më se e kryera shfaqet shpesh edhe në fillim të përrallave të analizuara, në fjali kryesore dhe pa një varësi ose ndërlidhje me kohë tjera. Boretzky i interpreton këto raste si vendosje e tërë rrëfimit në një të shkuar të largët. Koha tjetër që përdoret në përralla është edhe më se e shkuara e dytë. Sipas De-

miraj (2002: 315) “ajo përdoret për të treguar përfundimin e një veprimi para një çasti shumë të largët të së shkuarës.” Boretzky e sheh të vështirë përkufizimin e një funksioni të kësaj kohe. Në rastet kur shoqërohet nga më se e kryera ose e kryera e thjeshtë përdoret për të shprehur parakohësi, por ka raste kur shfaqet vetëm me funksionin e shprehjes së të shkuarës, pa parakohësi.

Një çështje tjetër me të cilën merret Boretzky (2014: 142-176) është përdorimi i lidhore dhe paskajore në gegërishten në artikullin “Konjunktiv und Infinitiv im gegischen Dialekt des Albanischen”³. Ai evidenton përdorimin e lidhore dhe të paskajore në të folmet e ndryshme gege duke analizuar mundësitë e shkëmbimit të tyre. Lidhroja dhe paskajorja paraqiten në rrethana të caktuara semantike dhe sintaksore. Të dyja përdoren kryesisht për tu shprehur për ngjarje/veprime të papërmbyshura, pra në fushën e jofaktikes. Në gegërishten paskajorja/lidhroja mund të shfaqet në kombinim me elemente të eptuara, me foljet modale *due*, *mundem* (*muj*), *duhet*. Në këto raste shfaqet pothuaj vetëm paskajorja. Ndërsa elementet e ngurosura me të cilat mund të përdoret paskajorja ose lidhroja janë *do* (nga *dua*) për ta shprehur të ardhmen, *le* (nga *lâ*, *lê*, *lë*) për të shprehur lejim. Forma e fundit mund të formohet vetëm me lidhoren. Pas analizës së korpusit të tij, Boretzky arrin në përfundimin se në gegërishten verilindore lidhroja paraqitet shumë pak dhe që nuk ka ndonjë funksion sintaksor që duhet të shprehet me lidhoren. Edhe e ardhmja toske nuk mund të konsiderohet e pashmangshme meqë zëvendësohet me të ardhmen e gegërishtes *ka me* + *paskajore*. Situatë e ngjashme paraqitet edhe në gegërishten veriperëndimore, ndërsa në gegërishten jugore shtohet përdorimi i lidhore në dëm të paskajore. Boretzky e sheh heteropropozopinë⁴ ekstreme si arsye të mundshme për reduktimin e përdorimit të paskajore.

Pas prezantimit të raportit të lidhore dhe paskajore në të folmet e ndryshme gege, Boretzky bën një analizë të zhvillimit diakronik të të dy formave. Pikënisja e tij është se paskajorja dhe futuri me foljen *kam* që bazohet në të kanë qenë të pranishme në të gjithë shqipen. Procesi i reduktimit të funksionit të paskajore duket të ketë nisur në periudhën para-

³ “Lidhroja dhe paskajorja në dialektin gegë të shqipes”.

⁴ Kryerfjala është e ndryshme në fjalinë kryesore dhe në atë të varur.

shkrimore të shqipes duke përfunduar me humbjen e saj. Gjatë këtij procesi ndodhi edhe zëvendësimi i futurit me *kam*, me futurin ballkanik me *do*+lidhore. Boretzky supozon se shkak për fillimin e këtij procesi ishte greqishtja, e cila duket të ketë ndikuar më tepër përmes peshës së saj civilizuese dhe përmes kishës, se sa përmes grupeve të mëdha të folësve të saj. Zgjerimi i funksioneve të paskajores në gegërishten duke ndikuar kështu në reduktimin (por jo zhdukjen e plotë) e përdorimit të lidhore duket se ka ndodhur më vonë, por po ashtu në fazën parashkrimore të shqipes. Sipas Boretzky-t nuk mund të thuhet nëse zhvillimi i këtyre dialekteve në drejtime të ndryshme erdhi si pasojë e mungesës së kontaktit. Sidoqoftë, zhvillimet në gegërishten ai i interpreton si një lloj procesi konservues, hiperkorrektues që rezultoi me divergjencë midis dy dialekteve.

Struktura analitike e formave foljore të shqipes, e cila vazhdon të paraqesë objekt hulumtimi në studimet për shqipen, trajtohet edhe nga Boretzky (1971/72). Në artikullin e tij “Zusammenrückungen mit dem Modalverb *können* in den Balkansprachen”⁵ ai merret me konstruksionet me foljen modale *mund* në gjuhët e Ballkanit, përkatësisht me përngjitjen e formave të tilla. Këtë zhvillim Boretzky e sheh si kalim të një njësie sintaksore në një njësi morfologjike. Konstruksionet *mund*+lidhore, *duhet*+lidhore në gramatikat e shqipes trajtohen si ndërtime me folje modale. Breu (2010: 447f) i cili nisat vetëm nga funksioni, i konsideron si mënyrë të foljes. Format që konsiderohen folje modale janë forma të ngurosurat të cilat e modifikojnë fjalinë sa i përket modalitetit por nuk bartin shënjes të vetës, kohës ose mënyrës, siç është rasti zakonisht të foljet modale. Midis pjesëzave dhe foljes nuk mund të qëndrojnë gjymtyrë tjera të fjalisë. Në dialektin gegë këto folje shfaqen në kontekste të ndryshme me vlerë të plotë leksikore. Në rastet e tilla shoqërohen nga paskajorja ose nga lidhorja, por në rastet e tilla janë të eptuara. Në kontekstin ballkanik, Boretzky e sheh procesin e reduktimit të konstruksioneve me foljen *mund* si më të përhapurin në shqipen, ku vëren përdorimin e gjerë të formës toske *mund të shkoj* krahas asaj gege *mundem me shkue* (dhe një konstruksioni edhe më të shkurtër të tipit *mun shkoj, s’un shkoj*). Mund të konsiderohet se këto forma gjenden në procesin e gramatikalizimit. Për shkak të mungesës së

⁵ “Konstruksionet me foljen modale “mund” në gjuhët e Ballkanit”.

eptimit, ato mund të konsiderohen pjesëza, ndërsa si forma të eptuara shfaqen në funksionin e foljeve modale. Prandaj shfaqet si i domosdoshëm një klasifikim i dyfishtë, siç është rasti te Buchholz/Fiedler (1987: 62).

Studimet e Boretzky-t për foljen në gjuhën shqipe, përkatësisht për kohët e foljeve, ndërtimet me folje modale, apo për raportin midis lidhore dhe paskajores, për shkak të trajtimit të çështjeve në rrafshin dialektor janë një kontribut i veçantë për shqipen, por edhe për rolin e saj brenda lidhjes gjuhësore ballkanike, duke qenë se vendosen në këtë kontekst.

Bibliografia

- Boretzky, N. (1966). Perfekt und Plusquamperfekt in einem nordostalbanischen Dialekt. *Schmaus, Alois (Hrsg.) Beiträge zur Südosteuropaforschung. Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongressess in Sofia: 26.VIII-1.IX 1966* (fv. 91-102). München: Trofenik.
- Boretzky, N. (1971/72). Zusammenrückungen mit dem Modalverb "können" in den Balkansprachen. *Zeitschrift für Balkanologie* 8, 12-26.
- Boretzky, N. (1975). *Der türkische Einfluß auf das Albanische. Teil 1: Phonologie und Morphologie der albanischen Turzismen*. Wiesbaden: Harrassowitz.
- Boretzky, N. (1976). *Der türkische Einfluß auf das Albanische. Teil 2: Wörterbuch der albanischen Turzismen*. Wiesbaden: Harrassowitz.
- Boretzky, N. (1977). Die Morphologie des albanischen Verbums. *Zeitschrift für Balkanologie* 13, 20-56.
- Boretzky, N. (2000). Natürlicher morphologischer Wandel: Die Entwicklung des Imperfekt Aktiv im Albanischen. *Zeitschrift für Balkanologie* 36, 1-28.
- Boretzky, N. (2014). Konjunktiv und Infinitiv im gegischen Dialekt des Albanischen. *Zeitschrift für Balkanologie* 50, 2, 142-176.
- Boretzky, N., & Fiedler, W. (2013). Infinite Konstruktionen mit eigenem Subjekt (Heteroprosopie) in den Balkansprachen. *Zeitschrift für Balkanologie* 49, 2, 169-202.
- Breu, W. (2010). Mood in Albanian. Në B. Rothstein, & R. Thieroff (Hrsg.), *Mood in the Languages of Europe* (fv. 447-472). Amsterdam, Philadelphia: John Benjamins.
- Buchholz, O., & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.
- Çetta, A. (1963). *Tregime popullore I, Drenicë. Blerni i parë*. Prishtinë: Rilindja.
- Demiraj, S. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe. Morfologjia. Vëllimi I*. Tiranë: ASHSH.
- Fiedler, W. (1981). Mbi strukturën e sistemit foljor në grammatikat e Konstandin Kristoforidhit dhe të Sami Frashërit. Në I. Ajeti (ed.), *Konferenca shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*. Prishtinë: ASHAK, 69-84.
- Fiedler, W. (1999). Tempus, Modus, Aspekt in den Sprachen Südosteuropas. Në U. Hinrichs (Hrsg.), *Handbuch der Südosteuropa-Linguistik*. Wiesbaden: Harrassowitz, 487-517.
- Friedman, V. (2004). *Studies on Albanian and other Balkan Languages*. Pejë: Dukagjini.
- Ismajli, R. (1980). *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja.
- Kelmendi, T. (1993). *Funksionet e kohës foljore të pakryer të dëftores në shqipen e sotme letrare*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Kelmendi, T. (2006). *Kështjellat e sintaksës (kohë foljore dhe njësi tekstore)*. Prishtinë: IAP.
- Riza, S. (1997). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Prishtina: ASHAK.

Bardh RUGOVA, Prishtinë

MËNYRË DHE MODALITET NË GJUHËN SHQIPE – KONTRIBUTI I WALTER BREU-IT

Abstract

The traditional point of view (Demiraj 1986, Gramatika I 1995, Beci 2001: 113) sees six moods in the Albanian language, whereas the notion of modality is not fully discussed, but only within the verb, in particular within the so-called semi-auxiliary verbs and the modal connotations derived from them. This classification has not been made in all cases on a clear grammar markers.

A wider and more comprehensive contribution and discussion on the mood and modality of the in Albanian was offered by Walter Breu, who gives a slightly different picture of these concepts in Albanian.

While in contemporary theoretical approaches there has been a lot of discussion about the distinction between mood and modality, we will summarize the mood as "grammatical coding of modal meaning" (Depraetere, Reed 2006: 469). Based on this theoretical basis, the current categorization of mood and modality in the Albanian language could be reviewed.

Key words: grammaticalisation, verbal system, modal meaning, structural type, traditional linguistics

Diskutimi mbi modalitetin dhe klasifikimin e mënyrës së foljeve në gjuhën shqipe është bërë në pikëvështrime të ndryshme, por ndikimi i konceptimit tradicional në shqipen vërehet në shumë prej këtyre pikëvështrimeve.

Konceptimi tradicional (Demiraj 1986, Gramatika I 1995, Beci 2001:113) në gramatikat e shqipes sheh gjashtë mënyra të foljes, ndërsa nocioni i modalitetit nuk diskutohet në plotni, por vetëm në vija të përgjithshme, në veçanti të foljet e ashtuquajtura gjysmëndihmëse dhe ngjyrimet modale të nxjerra prej tyre. Ky klasifikim nuk është bërë në të gjitha rastet mbi shënjes të qartë gramatikorë.

Gramatika e Gjuhës së Sotme Shqipe problemin e sheh kësisoj:

Nëpërmjet kategorisë gramatikore të mënyrës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe realitetit objektiv. Pra, me anë të kate-

gorisë gramatikore të mënyrës folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të detyrueshëm etj.

...

Kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor për të shprehur modalitetin.

Sipas kuptimeve modale dhe formave gramatikore përkatëse, në gjuhën shqipe dallohen gjashtë mënyra të foljes: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore. (Gramatika I 1995:272)

Folje me vlerë modale quhet ato që shërbejnë për të shprehur modalitet. Foljet me vlerë modale në fjali e humbasin mëvetësinë e tyre si folje të zakonshme dhe, si rrjedhim, po të merren të shkëputura nga togfjalëshi ku bëjnë pjesë, nuk kanë mundësi të kryejnë funksionin e kallëzuesit.

(Gramatika I 1995:261)

Po aty në fusnotë jepet përkufizimi: *Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimit folës ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Ky qëndrim i folësit mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore: me anë të mënyrave të foljes, me anë të foljeve me vlerë modale dhe me anë të pjesëzave modale.*

...

Pjesëzat modale “shërbejnë për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj një a më shumë mendimeve, ndaj vërtetësisë së një ngjarjeje a dëndurie të një realiteti objektiv. Në këtë grup hyjnë pjesëzat pohuese, mohuese, pyetëse, dyshuese, zbutëse (Gramatika I 1995:419).

Nëse i shikojmë përkufizimet, nuk shihet ndonjë dallim i prerë mes nocioneve mënyrë dhe modalitet, duke e pasur mënyrën si diçka ku folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të detyrueshëm etj. dhe modalitetin si të shprehurit e qëndrimit folës ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Në të dy rastet bëhet fjalë për qëndrim të folësit në raport me kumtimin, paçka se në njërin rast specifikohet se kjo shprehet me anë të foljes, ndërsa pranohet se termat modalitet dhe ai mënyrë përbëjnë hiponimi, meqë mënyra është “mjet kryesor për shprehjen e modalitetit”.

Në rrafshin diakronik, Demiraj (1979(1976):200) si mënyra të tra-

shëguara IE në shqipen sheh dëftoren, lidhoren, urdhëroren dhe dëshiroren. Ai flet për habitoren si zhvillim të mëvonshëm të shqipes “që për nga modaliteti anon nga dëftorja dhe që për nga tipi strukturor nuk ka shoqe në asnjë gjuhë tjetër IE”. Kushtoren, ndërkaq, Demiraj, e sheh si mënyrë, por duke thënë se për të si mënyrë mund të flitet “në kuptim të gjerë”.

Përgjithësisht, autorë të ndryshëm kanë sjellë klasifikime të ndryshme që lidhen me vijat jo krejtësisht të qarta ndarëse të mënyrës me modalitetin dhe, si në ndonjë rast tjetër (Breu 2010, Altimari 2014) edhe me kohët e foljeve – duke diskutuar për të kryerën e supozuar në të folmet arbëreshe dhe duke e trajtuar si mënyrë më vete, mënyra supozitive. Kjo ka bërë që autorë të ndryshëm të ofrojnë numër të ndryshëm mënyrash të foljes në gjuhën shqipe. Së fundi, lidhur me modalitetin dhe mënyrën në gjuhën shqipe kanë kontribuar Hamiti (2006, 2008, 2013) dhe Ismajli (2009, 2012).

Lidhur me mënyrën dhe modalitetin në gjuhën shqipe, një diskutim më shterrues të problemit ofron Walter Breu (Breu 2009, Breu 2010) dhe për të në këtë punim do të diskutohet më gjerësisht.

Ky studim bën leximin e veprës së Walter Breu-t për mënyrën dhe modalitetin në gjuhën shqipe në kontekstin e studimeve paraprake e të mëvona në shqipen dhe në kontekstin e studimeve teorike për mënyrën dhe modalitetin përgjithësisht.

Fillimisht, do të diskutohet konteksti i përgjithshëm teorik. Për ta zbërthyer problemin, do të nisemi nga konceptimi i përgjithshëm tekstor, duke mëtuar të sqarohen së pari dallimet mes nocionit mënyrë dhe nocionit modalitet.

Përfaqësimi folës

Përkufizimi i Gramatikës së Gjuhës së Sotme Shqipe për mënyrën, me të edhe për modalitetin, si shprehje e qëndrimit ndaj “veprimet të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të detyrueshëm etj.” e nxjerr modalitetin si një term ombrellë për një spektër nocionesh semantike që përfshijnë vërtetësinë në rrafshin e aftësisë, të së mundshmes, të detyrimit, të hipoteticitetit.

Mirëpo, kjo nuk na ndihmon për të përcaktuar, po e zëmë, dallimin mes do të punoj dhe dua të punoj ose mes dua të punoj dhe punofsha, ndoshta të tria e kanë të përfshirë elementin e dëshirës.

Prandaj, një vështrim teorik, tekstori, del i domosdoshëm për ta trajtuar problemin.

Në tekst, këndvështrimi i folëses (i emetueses) manifestohet përmes nocioneve si përfaqësimi a qëndrimi folës. Përfaqësimi tekstori është zgjedhje gjuhësore e emetueses varësisht nga qëndrimet kundruall faktorëve kontekstualë. Për realizimin e përfaqësimit folës shfrytëzohen mjete të ndryshme gjuhësore. Kjo nënkupton se një përfaqësim i caktuar tekstori e ka regjistrin e tij, ndryshe nga përfaqësimi tjetër. Njësitë linguistike të shqipes që luajnë rol për përfaqësimin tekstori janë: *fokusi, deiksi, veta, klasifikimi i mbiemrave* dhe *i ndajfoljeve, koha e foljeve, aspekti, diateza, mënyra* (evidencialiteti) dhe *modaliteti* (Rugova & Rugova, 2015)

Përkufizimi i modalitetit si një term ombrellë për një spektër nocionesh semantike si mundësi, aftësi, hipoteticitet, obligim e detyrim (Depraetere, Reed 2006:468, 469), sado që më i ngushtë dhe praktik se përkufizimi i dhënë në Gramatikën e shqipes, sërish nuk është i mjaftueshëm për ta nxjerrë thelbin e së përbashkëtes të të gjitha thënieve modale.

Ndryshimi ndërmjet këtyre dy kategorive gjuhësore, me rëndësi të veçantë në analizën tekstore, më së miri shpjegohet te Huddleston/Pullum (2002:172), ku duke i krahasuar me konceptet *tense* dhe *time* në anglishten ose me konceptet *aspekt* dhe *aspektualitet*: mënyra del kategori gramatikore, ndërkaq modaliteti kategori kuptimore. Me fjalë të tjera, gramatikalizimi i modalitetit brenda sistemit flektiv foljor është vetë kategoria e mënyrës. Përkufizim të tillë ofron edhe Depraetere/Reed (2006: 469).

Historik i termave

Në rrafshin historik, sidomos në antikitet, për termat modalitet dhe mënyrë është e vështirë të diskutohet në mënyrë të ndarë. Autorë si Auwera e Aguilar (2016) ndarjen e tyre e bëjnë, duke folur për mënyrën në rrafshin puro gjuhësor, pra gramatikor, ndërsa për modalitetin vetëm në atë semantik e, prandaj, duke e kundruar vetëm nga këndvështrimet filozofike.

Ata (Auwera, Aguilar 2016:3), sidoqoftë, pranojnë se qysh në shekullin V p.e.s. Protagora flet për pyetjet, dëshirat, përgjigjet dhe urdhërat që do të mund të interpretoheshin sot si mënyra më vete, ndërsa Dyonis Thrax-i e përdor termin enkklisis për mënyrën, si një nga tetë atributet, siç i quan ai, të foljes. Quintiliani, ndërkaq, në shekullin I e.s. e përdor termin “modus”, një term që lidhet me etimonin mënyrë/modalitet¹, ndonëse nuk e përkufizon fare si kategori.

Aristoteli, ndërkaq, fliste për dijen a priori dhe a posteriori që i ka shërbyer si bazë kritikës së mendjes së shëndoshë të Immanuel Kantit në shekullin XVIII. Aristoteli ofron katër ekstreme modale: domosdo dhe mundësi (si elemente pozitive) dhe pamundësi dhe jodomosdo (si elemente negacioni), të cilat krijojnë ndërlidhje mes vete në raporte të ndryshme: kundërshti, nënkuptim, kundërthënie etj.

Mbi këtë bazë, Kanti (1781 [1934ë) e trajton modalitetin si një ndër kategoritë e gjykimit nga njeriu (krahas cilësisë, sasisë dhe relatës), secila me nga tri katëgori më vete – në rastin e modalitetit këto kategori janë: e mundshmja, realja dhe e domosdoshmja.

Me Kantin, termi modalitet, si dhe termat modalitet epistemik e deontik shtojnë frekuencë përdorimi.

Një term tjetër që është i rëndësishëm për t’u trajtuar këtu është edhe termi “irrealis”, si term që vihet në kundërvënje me atë “realis”, por që ka rëndësi të veçantë për studimin e fjalive kushtore dhe të shprehjes së kushtit, duke e pasur parasysh se gramatikat tradicionale e përfshijnë kushtoren si një nga mënyrat e foljes në shqipen. Termi është farkëtuar nga Sapiri (1930 [1992ë) për diçka që “nuk është faktike”, “nuk është e verifikueshme”, por si diçka që është potenciale. Termi është shfrytëzuar nga Palmeri (2001). Ky këndvështrim nxjerr dy mënyra themelore: realisin dhe irrealisin dhe të tjerat pastaj vetëm pjesë të njërës ose të tjetrës.

Probleme klasifikimi

Në gjuhësinë e përgjithshme modaliteti dikur kategorizohej në për-

¹ Bloomfieldi (1933) dhe Hocket (1958) e përdorin termin “mode”, në vend të “mood” në anglishten.

gjithësi sipas kritereve deskriptive me qëllim të klasifikimit të foljeve dhe të shprehjeve modale. Të gjitha këto shpjegime, në rrafshin praktik dhe teorik, synonin klasifikimin e strukturave që do të konsideroheshin modale ose jo. Këto shpjegime e kanë lënë anash aspektin funksional të diskursit: pragmatikën funksionale të ligjëritimit.

Lakoff (1972: 229-230) është ndër të parët që përpiqet ta ndryshojë kahjen e studimeve të tilla duke u përpjekur t'i klasifikojë shprehjet modale dhe ta përcaktojë përdorimin e tyre në situata të caktuara gjuhësore, duke i marrë parasysh kontekstin sintaksor, strukturën logjike si dhe kontekstin e tërë thënies, paragjykimet e emetueses dhe të marrëses, situatën shoqërore të presupozuar nga pjesëmarrëset në situatë të komunikimit, përshtypjen që emetuesja dëshiron t'ia bëjë marrëses, etj.

Halliday (1985:85-86) e karakterizon modalitetin si zgjedhje gjuhësore midis dy polariteteve, midis *po-së* dhe *jo-së*, zgjedhje kjo, e cila i kap të gjitha shkallët e pavendosmërisë midis këtyre dy ekstremeve. Ndarja që ai ia bën modalitetit në modalizim (që paraqet vlerësimin apo gjykimin e folësit ndaj një koncepti) dhe modulim (që paraqet dëshirueshmërinë e folësit ndaj një koncepti) e paraqesin funksionalizmin e studimeve të tij, ndërkaq ndarja e mëtejme e këtyre nocioneve në kategori të shpeshtësisë, të probabilitetit, të detyrimit dhe të prirjes apo preferencës personale si dhe matja e shkallës së shprehjes së këtyre nuancave sipas nivelit të ultë, të mesëm apo të lartë, në mënyrë implicite bën që Halliday t'i shmanget shpjegimit vetëm semantik të modalitetit. Rrjedhimisht, interpretimi gjuhësor i modalitetit që ai e ngërthen në këtë teori është i rëndësishëm për trajtimin pragmatik të analizës, së cilës ai i paraprin.

Simpsoni (1993:47) e vështron modalitetin nga aspekti praktik, më pak teorik se Halliday, dhe e ndan në deontik dhe epistemik, duke theksuar se deontiku e përfshin qëndrimin e folësit ndaj shkallës së obligimit që folësi ia mvesh shprehjes së veprimit të caktuar si dhe epistemiku që lidhet me të pasurit ose jo të besimit folës ndaj një koncepti të shprehur nga folësi. Ky i fundit, gjithnjë sipas Simpsonit, në vetvete e ngërthen edhe sistemin e modalitetit perceptiv që në të vërtetë e paraqet aftësinë e folësit për ta besuar ose jo një koncept të shprehur, duke u mbështetur ose jo në një perceptim vizuel.

Disa autorë (Huddleston et al 2002:178, Palmer 2001:9) duke u nisur nga anglishtja, ia shtojnë këtij klasifikimi edhe modalitetin dinamik apo të ashtuquajturin modalitet periferik, meqë ky koncept i referohet, sipas tyre, vetëm foljes *mund*:

Ajo mund të shkollë në shkollë. (deontik, lejim)

Ajo mund ta rrahë atë. (dinamik, aftësitë dhe predispozitat e folësit)

Ajo mund të flasë shqip. (ambigje, interpretimi deontik: lejohet ose autorizohet të flasë dhe interpretimi dinamik: ajo di (ka kapacitet dhe aftësi) të flasë).

Autorë si Nuyts (2006:1) modalitetin e trajtojnë si kualifikim të gjendjes dhe e konsiderojnë superkategori abstrakte, më abstrakte se koha e foljes dhe aspekti.

Nuyts (2006:3) e zgjeron konceptin e modalitetit dinamik, duke e përfshirë brenda tij edhe indikacionin e nevojës apo të domosdoshmërisë së folësit, p.sh.: *Më duhet të gjej një zgjidhje, përndryshe do të fundosemi të gjithë!* Ose *Më duhet të shkoj në banjë urgjentisht!* Ai merret edhe me nuanca të reja kuptimore, siç janë të ashtuquajturat “kategori në margjina të modalitetit”: mënyra, volicioni, qëllimi, evidencialiteti, modaliteti bulemik (qëndrimi folës emocional), si dhe duke i përcaktuar tiparet që i nënkategorizojnë më pas shprehjet modale (subjektiviteti vs. objektiviteti dhe neutraliteti):

- *Mendoj se ai nuk do të vijë në mësim.*(subjektiv)

- *Ai nuk vjen në mësim* (mbështetet në përvojat e mëparshme).

Në gjuhën shqipe modaliteti shprehet me foljet modale, si: *duhet, mund dhe do*, me foljet leksikore në funksion gjysmëmodal: *le, lejohet, bën dhe guxoj* (dy të fundit huazime nga serbishtja në shqipen e Kosovës kryesisht), etj. si në shembujt: *Ai ban me ba sherr* ose *Ai nuk guxon me t'prekë, se e mbys*), me mënyrat e foljes (dëshirorja, habitörja, dhe lidhorja me kuptim joreal/jofaktik (irrealis mood), me mjete leksikore, siç janë ndajfoljet modale: *ndoshta, patjetër, me siguri* etj.: *Patjetër që do të vij me ty!* e që shprehin kryesisht modalitet epistemik, pastaj me mbiemrat modale (*e sigurt, e dyshimtë, e detyruar*, etj.): *Ai është i sigurt për këtë informacion*, si dhe me emra modale (*gjasë, aftësi, siguri, urdhër, këshillë, lutje, kërkesë*, etj.).

- *Ka gjasë që ai nuk vjen fare. Ky njeri ka aftësi të flasë bukur. Ai e pati një kërkesë: të shkosh në shtëpi sa më parë!*

Kategoria e mënyrës në shqipen

Kategoria e mënyrës ose mënyra morfologjike është kategori foljore, e cila në shumë gjuhë të botës shpreh një modalitet të caktuar, si: urdhër, dëshirë, (jo)faktivitet a (jo)realitet, e të ngjashme me to tw shprehur me trajta dalluese tw gramatikalizuara. Rolf Thieroff (Rothstein, Thieroff 2010:1) mendon se mënyrat në shqipen dhe në gjuhët sllave burojnë nga pjesëzat e caktuara që kanë origjinë nga foljet modale dhe nga foljet e tjera e që në shqipen kanë përdorim të kufizuar brenda kombinimeve të mundshme me dëftoren (punoj – të punoj – punofsha – punua(r)kam – puno). Në shqipen këtij vargu i është shtuar edhe kushtorja (do të punoj). Mirëpo, kushtorja nuk ka asnjë element dallues gramatikor dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet mënyrë më vete, sipas kriterit të gramatikalitetit. Kushti, ndërkaq, mund të shprehet edhe me mënyra (përfshirë dëshiroren e urdhëroren) e kohë të tjera (Në ardhsh, bën mirë; eja, e do ta shohësh; vjen, e sheh; po nuk erdhe ti, (do të) vij unë; po deshën, le të vijmë).

Forma *do të punoja* në funksion të kushtit, nuk është asgjë më shumë se një veprim i shprehur në imperfektin e së kryerës së lidhore (e ardhmja e së shkuarës, një kusht i mundshëm, por i perealizuar në të shkuarën, kundërfaktik), ndërkaq kushtorja e më se të kryerës *do të kisha punuar* del kryesisht me kuptim modal të joreales. Këtë mendim e kanë theksuar më herët edhe Buchholz dhe Fiedler (1987). Edhe në Gramatikën e Akademisë theksohet se kjo mënyrë e foljes është shumë e afërt me lidhoren dhe se që të dyja shprehin mundësi (Gramatika, 1995:327).

Pra, modaliteti i kësaj mënyre është i shumanshëm dhe mbetet i diskutueshëm si trajtë mënyrore që shpreh një kushtore të mirëfilltë meqë trajtat e tipit *do të këndoja* mund të përdoren për të shfaqur një lidhore të së shkuarës që nuk ka mundur të realizohet në një kohë që duket e ardhme në të shkuarën: (krahaso: *Unë do të vij po të më ftosh* (e ardhmja e dëftores me modalitet qëllimi) dhe *Unë do të vija po të më ftoje* (e ardhmja e së shkuarës së lidhore, por edhe kusht i hapur dhe real, pa tregues gramatikor tipik vetëm për kushtoren). Këta dy shembuj nuk shprehin asgjë më shumë se sa

karakterin kompleks të lidhores (formimi i një kohe foljore, të shprehurit e kushtit si dhe në disa raste edhe formim të lejores - jusivit): *Le të shkojnë në shtëpi*. Pra, sa i përket lidhores, ajo del me më së shumti kombinime funksionesh, por me më së paku funksione specifike tipike vetëm për të (Breu 2010: 453). Kuptimet e lidhores shpeshërë, pra, i gjejmë edhe te mënyrat e tjera, por me një dozë më të madhe të pasigurisë dhe të joreales në to, kur përdoren vetëm si lidhore.

Forma e ngurosur e foljes dua², në formë të pjesëzës do + lidhorja (të punoj) është gramatikalizuar si njësi dalluese e formës së të ardhmes në mënyrën dëftore në gjuhën shqipe. Folja dua, si njësi e pangurosur shpreh ngjyrim pa qenë e gramatikalizuar dhe e mban vlerën e saj foljore. Dua të punoj është gramatikisht njësoj si provoj, denjoj, pëlqej (e kështu me radhë) + të punoj. Prandaj, te shembujt do të punoj dhe dua të punoj dallimi është në gramatikalizimin e foljes dua si shënjes të irrealitetit, me modalitetin volitiv.

Megjithatë, le të punojë (lejore) është njësoj irrealis (në paradigme veta I shumës do të ishte lëmë), duhet të punojë dhe mund (mundemi, mundesh, mundet). Për ta analizuar këtë e kalojmë në paskajore: mund me punu nuk bën. Bën mundemi me punu, për shkak se paskajorja nuk është folje.

Të gjitha këto janë forma të gramatikalizuara të irrealitetit me ngjyrim të caktuar modal, domosdo, mundësi, leje, volicion. Kësaj ia shtojmë irrealisin e domosdosë në gegërishten kam me punu, dhe në arbërishten ka të punonjë. Të gjitha shprehin njëfarë qëndrimi folës në raport me një veprim të pritshëm në të ardhmen, si të mundshëm, të detyrueshëm, të domosdoshëm, të lejueshëm, të dëshirueshëm.

Po e shohim se si gjuhë në funksion, njësitë e modalitetit në shqipen janë të lidhura me irrealisin dhe gramatikalizohen brenda tij, duke shprehur nuanca të qëndrimit folës lidhur me të ardhmen, si e dëshirueshme, e mundshme, e domosdoshme, e lejueshme.

Sami Frashëri nuk e quante e ardhmja, por e pritshmja, si edhe Riza.

² Krahaso do si shënjes modal që e ka humbur paradigmen foljore dhe dua si folje që e ka paradigmen e saj të plotë: Unë do, ti do, ai do, ne do, ju do, ata do (sic). Krahaso me unë dua, to do, ai do, ne duam, ju doni, ata duan.

Ky varg sintagmatik i trajtave mënyrore të së tashmes në shqipen sjell një detaj, i cili në njëfarë mënyre i kundërshton gramatikat tradicionale të shqipes që i klasifikojnë 6 trajta mënyrore brenda sistemit foljor të shqipes. Disa autorë që janë marrë me studimin e mënyrës, nxjerrin 8 trajta mënyrore (Newmark 1982, Buchholz e Fiedler 1987), ndërsa Breu (2010) flet për dhjetë sosh. Ismajli (2012:437), duke argumentuar për habitoren dhe kushtoren e shqipes në kontekstin ballkanik, thekson se nga të gjitha format foljore që konsiderohen mënyra në shqipen, dëftorja, lidhorja, dëshirorja dhe urdhërorja janë të padiskutueshme, ndërkaq, sipas saj, është pikërisht klasifikimi i habitores dhe i kushtores si mënyra foljore që vihet shpeshërë në pikëpyetje dhe herë trajtohen si mënyra e herë si konstrukte me folje modale: habitorja si evidencialitet e kushtorja si kohë.

Breu

Në diskutimin e tij për modalitetin në gjuhën shqipe Breu (2009: 257) qëllimisht kap një koncept të “restriktuar” siç e quan vetë të modalitetit, mbështetur në (Hansen 2001:54-81), duke e shtuar edhe nocionin e volicionit, krahas posibilitetit që mund të shprehë qëndrim objektiv (aletik e dinamik) dhe aftësi, kapacitet (deontik) dhe subjektiv (epistemik); necesiteti objektiv (aletik/dinamik), obligim (deontik) dhe supozim i fortë (necesitet subjektiv, epistemik). Volicioni lidhet me dëshirën (deontik) dhe supozimet e shprehura nga të njëjtat mjete formale. Secila nga to është realizuar si kundërvënie mungesore, me kategorizimin +/- . Ai vëren se të tri modalitetet shprehen nga një tërësi modalesh pak a shumë të pazgjedhuara (të ngurosur v.j.) që e drejtojnë foljen dhe mund të shprehin të tri nivelet e modalitetit: dinamik, epistemik e deontik.

Ai (Breu 2009:255) shton se kjo situatë është edhe më e komplikuar, për shkak se edhe foljet e plota të njëjësive modale, mund të shprehin modalitetet, po ashtu: psh; mund dhe mundem, duhet dhe duhem. Breu ofron edhe një përshkrim të shqipes në variantet e tjera, jo vetëm të standardit dhe vëren presupozivin apo evidencialin deduktiv, përmes foljes ndihmëse kam. Breu (2009:256) këtë e fut në sferën e modalitetit epistemik.

Në diskutimin e tij për mënyrën, ndërkaq, Breu (2010:447 – 472) sheh 10 mënyra në shqipen, plus një që përdoret, sipas tij (Breu 2010:471)

vetëm në disa të folme arbëreshe. Krahas dëftores, urdhërores, dëshirores, habitores, lidhores, ai si mënyrë sheh edhe kushtoren, gjusivin (lejoren) le + lidhore, posibilitoren (mundësoren) mund + lidhore, obligativin (duhet + lidhore), volitivin (dua + lidhore) dhe sikur (Buchholz e Fiedler 1987) edhe mënyrën hipotetike (në ardhsha dhe po erdha). Te arbëreshët e sheh supozitivin (ka rënë shi).

Breu (2010:470) thotë se shqipja ka një sistem të pasur të mënyrës, ndonëse e pranon se disa nga gramemat e supozuara, sidomos për posibilitativin, obligativin dhe volitivin e hipotetiken, janë të diskutueshme. Megjithatë, sipas tij, përbrenda sistemit të shqipes, konstruktet e tilla mund të karakterizohen si mënyra të gramatikalizuara (Breu 2010:470).

Përfundimet

- Të gjitha njësitë modale të diskutuara (mund + lidhore, do + lidhore, duhet + lidhore, le + lidhore) shprehin irrealis; Le të punoj, do të punoj, mund të punoj, duhet të punoj të gjitha shprehin ngjyrimë të caktuara brenda irrealisit. Dua të punoj nuk ka shprehur gramatikalizim, e gramatikalizuar është trajta do (si *le* e *mund*). Dua të punoj për nga shkalla e gramatikalizimit nuk ndryshon aspak nga kontruktet me lidhore: marr të punoj, them të punoj, dëshiroj të punoj, ngutem të punoj, kam qejf të punoj e kështu me radhë, në të cilat folja është në paradigmen e saj të plotë dhe vepron duke e pasur të shtuar lidhoren. Në raste të tilla, folja, nuk e humb mëvetësinë e saj funksionale.
- Te folja *duhet*, gramatikalizimi është më i komplikuar, për shkak se është në pësore dhe nuk lidhet direkt me vepruesin te folja, kështu që paradigma duhem, duhesh, duhet nuk lidhet me vepruesin, por me diçka tjetër që vepron mbi foljen (kjo punë duhet të bëhet), duke e komplikuar më shumë klasifikimin si gramatikalizim ose jo të strukturës.
- Prandaj, shqipja brenda irrealisit ka forma të gramatikalizuara (gramatikalizim analitik) për posibilitiv, jusiv, obligativ, kjo e fundit jo krejt e sigurt. (Dëshirorja ka gramatikalizim sintetik).

- Volitivi i gramatikalizuar do të punoj (krahaso me *du me punu*) brenda irrealitetit vlen në formën e ngurosur: do të mund të vijë, do të duhet të vijë, por edhe do të vazhdojë të vijë.
- Kushtorja në rrafshin e strukturës nuk është e gramatikalizuar, sepse funksionet e kushtit në shqipen shprehen me mjete të ndryshme dhe format e futurit volitiv janë vetëm një nga strukturat e mundshme për shprehjen e kushtit, kundruall formave të tjera, me ç'rast përdoren edhe koha e tashme e dëftorës, aoristi, urdhërorja, dëshirorja, paskajorja e kështu me radhë.
- Gramatika tradicionale e shqipes dhe klasifikimet e saj nuk puqen me konceptimet bashkëkohore të ndarjeve të mënyrës dhe të modalitetit. Trajtimet e Walter Breut janë bazë, mbi të cilën do të mund të mbështeteshin klasifikimet në shqipen.

BIBLIOGRAFIA:

- Altimari, Francesco. 2014. *Studia linguistica italo-albanica. Arbërishtja në kontekstin gjuhësor ballkanik dhe italian*. vol. 51. Prishtinë: ASHAK
- Aristotle. *Poetics*. <http://classics.mit.edu/Aristotle/poetics.html> (350 p.e.s)
- Auwers van der, Johan; Aguilar, Alfonso Zamorano. 2016. The history of Mood and Modality. In: Nuyts J.; Auwers van der, J. (red.) *The Oxford Handbook of Modality and Mood*. Oxford: Oxford University Press
- Beci, Bahri. 2000. *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*. Shkodër: Camaj – Pipa
- Bloomfield, Leonard. 1965 (1933). *Language*. London: Ruskin House
- Breu, Walter. 2009. Modals in Albanian. In: Hansen, Björn et al. (red.) – *Modals in the Languages of Europe*. Berlin: Mouton de Gruyter (fq. 229 – 266)
- Breu, Walter. 2010. Mood in Albanian. In: Rothstein, Björn; Becker, Martin G. (ed.) – *Mood in the Languages of Europe*. Amsterdam: John Benjamins Publishing Company (fq. 447 – 472)
- Buchholz Oda; Fiedler, Wilfried. 1987. *Albanische Grammatik*. Leipzig: Verlag Enzyklopädie
- Demiraj, Shaban. 1986. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë: 8 tetori
- Depraetere, Ilse; Reed, Susan. Mood and Modality in English. In: Aarts, Bas; McMahon, April (red.) - *The Handbook of English Linguistics*. London: Blackwell
- Frashëri Sami. 1979. Shkronjëto e gjuhës shqip. In: *Veptra 5*. Prishtinë: Rilindja
- Gramatika I. 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: ASHRSH
- Halliday, Michael. 1994 (1985). *An Introduction to Functional Grammar*. London: Edward Arnold
- Hamiti, Vjosa. 2006. Analizë e foljeve modale në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe. In: *Filogji 14*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës (fq. 279 – 301)
- Hamiti, Vjosa. 2008. Modaliteti epistemik në gjuhën shqipe. In: Badallaj, Imri (red.). *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 27/1*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës (fq. 431 – 435)
- Hamiti, Vjosa. 2013. Format foljore të të shprehurit të modalitetit në gjuhën shqipe. In: *Filogji 20*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës (fq. 209 – 218)
- Hansen, Björn. 2001. *Das Modalauxiliar im Slavischen. Grammatikalisierung und Semantik im Russischen, Polnischen, Serbischen/Kroatischen and Altkirchenslavischen (Slavolinguistica 2.)*. München: Otto Sagner
- Hockett, Charles. 1958. *A Course in Modern Linguistics*. New York: The Macmillan Company
- Huddleston, Rodney; Pullum, Geoffrey et al. 2002. *The Cambridge Grammar of the English Language*. Cambridge: Cambridge University Press
- Ismajli, Blerta. 2009. Modaliteti dhe mënyra në studimet gramatikore të shqipes. In: (Mato-shi, Liman, red.) *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqip-*

- tare 28/I*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Ismajli, Blerta. 2012. Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes? Kushtorja dhe habitorja. In: Ismajli, Rexhep (red.) - *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë: ASHAK (fq. 474 – 481)
- Kant, Immanuel. 2000 (1781). *Critique of Pure Reason*. Cambridge: Cambridge University Press
- Lakoff R. 1972. The Pragmatics of Modality. In: Peranteau P. M. et al (red.) *Papers from the Eight Regional Meeting, Chicago Linguistic Society*. Chicago: Chicago Linguistic Society (fq. 229 – 246)
- Newmark Leonard, Hubbard Philip, Prifti Peter. 1977. *Standard Albanian: A Reference Book for Students*. Stanford: Stanford University Press
- Nuyts, J. 2006. Modality: Overview and linguistic issues. In: Frawley, W (red.) – *The Expression of Modality*. Berlin: Mouton (fq. 1 – 26)
- Palmer, F. R. 2001. *Mood and Modality*. Cambridge: Cambridge University Press
- Rothstein, Björn; Thieroff Rolf. 2010. *Mood in the Languages of Europe*. Amsterdam: John Benjamins Publishing Company
- Rugova, Bardh; Sejdiu-Rugova, Linditë. 2015. *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat
- Sapir, Edward. 1992 (1930). Southern Paiute and Ute Linguistics and Ethnography. (*The Collected Works of Edward Sapir X*) Berlin: Mouton de Gruyter
- Simpson, Paul. 1994. *Language, Ideology and Point of View*. London: Longman

Vjosa HAMITI, Prishtinë

FJALËT MODALE SHQIPE NË *ALBANISCHE GRAMMATIK* TË ODA BUCHHOLZ-IT DHE WILFRIED FIEDLER-IT

1. Hyrje

Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht – boshti tematik i kësaj konference – zënë vend herë-herë qendror në studimet albanologjike përgjithësisht. Fillimet e tyre janë të hershme, pothuaj të njëkohshme me studimet albanologjike si korpus dijesh për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Në këto studime shquhet albanologu nga Gjermania Wilfried Fiedler, me kontribute shumë të çmueshme shkencore. Veç tij bota gjermanishtfolëse në gjysmën e dytë të shekullit XX ka nxjerrë emra të tjerë studiuesish të përmendur, si Oda Buchholz, Dieter Nehring, Gerda Uhlich, Walter Breu.

Kjo kumtesë do të paraqesë fillimisht gramatikën e gjuhës shqipe *Albanische Grammatik* të Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it si sfond të kumtesës që në fokus do të ketë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, gjegjësisht ‘fjalët modale’, në optikën e kësaj gramatike të njohur, botuar para 30 vjetësh. Shqyrtimi i kësaj çështjeje do të bëhet edhe duke e krahasuar paraqitjen e këtij grupi të fjalëve të *Albanische Grammatik* me gramatikat e tjera të gjuhës shqipe.

2. Paraqitje e gramatikës *Albanische Grammatik*

Albanische Grammatik, gramatika e shqipes e albanologëve gjermanë Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, një vepër me peshë, u botua në vitin 1987 në Leipzig, në ish-Gjermanisë Lindore. Autorët bëjnë me dije që në hartimin e kësaj gramatike janë marrë si bazë gramikat e gjuhës shqipe, por edhe ato të gjuhës gjermane dhe ruse. Kjo e shpjegon edhe terminologjinë e përdorur nga autorët, terminologji pjesërisht e vjetëruar, e përcaktuar nga vendi i botimit, Gjermania komuniste; shumë terma nuk gjen-

den në grammatikat e gjuhës gjermane të asaj kohe në Gjermaninë Perëndimore e gjetiu. Kjo terminologji e përdorur te *Albanische Grammatik* paraqet vështirësi përdorimi për gjeneratat e reja, që nuk e njohin sistemi e atëhershëm në Gjermaninë Lindore. Përkundër terminologjisë së vjetëruar, *Albanische Grammatik* vlerësohet nga njohësit si gramatika më e plotë e shqipes deri atëherë.¹

Kjo gramatikë voluminoze ka bërë të domosdoshme përdorimin e shumë shkurtesave, për çka autorët, në tekstin hyrës, kërkojnë mirëkuptim të përdoruesve (lexuesve). *Albanische Grammatik* dallon nga grammatikat e tjera të gjuhës shqipe për studimin më të hollësishtëm të pjesëve të ligjëratës, çka ofron perspektiva më të mëdha për studimin e mëtejme të shqipes, siç do të shihet nga kjo kumtesë.

Albanische Grammatik përbëhet nga 5 kapituj kryesorë. Në hyrje të saj (ff. 13-19) jepet një përshkrim i detajuar për gjuhën shqipe, në rrafshin diakronik dhe sinkronik, si dhe për dhe viset ku flitet ajo.

Pjesa e parë e kësaj gramatike është një hyrje në fonetikën dhe fonologjinë (ff. 27-57) e gjuhës shqipe. Në të është shtjelluar detajisht gjuha e shkruar dhe e folur, të cilën autorët e përshkruajnë si problematike për shkak të dialekteve gege dhe toske, të cilat kanë ndikim si në të folur, por edhe në të shkruar.

Pjesa e dytë i kushtohet sistemit foljor të shqipes (ff. 60-193) dhe në të bëhet një shtjellim i detajuar i foljes dhe i formave foljore të shqipes. Autorët theksojnë se, për dallim nga grammatikat e tjera të deriatëhershme të gjuhës shqipe, në të cilat shtjellimi studimor zakonisht fillon me emrin, për të vazhduar tutje, ata e fillojnë me foljen, duke e arsyetuar me faktin që folja në gjuhën shqipe ka një rol qendror.

Pjesa e tretë e gramatikës së albanologëve gjermanë e shtjellon sistemin nominal ku përshkruhen gjerësisht emri (ff. 202- 272, përemri (ff. 273-313), mbiemri (ff. 314- 348) dhe numërorët (ff. 349- 360). Vihet re nga ky kapitull se autorët e gramatikës nuk i trajtojnë nyjën e prapavendosur dhe të paravendosur, sikurse shumë gramatika të gjuhës shqipe, si element të

¹ Shih Vjosa Hamiti, “Modaliteti dhe mundësitë e shprehjes së tij sipas *Albanische Grammatik* të Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it”, në *Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare*, Prishtinë, 2013/1, ff. 203-210.

një grupi të veçantë të ligjëratës, por si një morfemë gramatikore, e cila është e varur nga faktorët semantiko-funksionalë, përmes të cilave ushtrohen funksione të ndryshme.

Pjesa e katërt e gramatikës trajton pjesët e pandryshueshme të ligjëratës ku në mënyrë të detajuar shtjellohen ndajfoljet (ff. 361- 371), para-fjalët (ff. 373- 384), lidhëzat (ff. 385-391), pjesëzat (ff. 392-395) dhe barsvlerat e fjalisë, siç quhen nga autorët (ff. 395-405), si pasthirrmat, onomatopetë, etj. Autorët nënvizojnë se përqendrimi i tyre gjatë përshkrimit të këtyre pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës është jo vetëm te funksionet e tyre sintaksore, por edhe te roli i tyre për shprehjen e modalitetit e të emocionalitetit.

Në pjesën e fundit të kësaj gramatike, në pjesën e pestë, i bëhet një përshkrim fjalisë dhe fjalëformimit (ff. 407-562) të gjuhës shqipe. Kjo pjesë i kushtohet sidomos aspektit sintaksor të shqipes, duke marrë për bazë teorinë e gramatikës gjenerative.

3. Fjalët modale në *Albanische Grammatik*

Siç u përmend tashmë, pjesa IV e kësaj gramatike trajton pjesët e pandryshueshme të ligjëratës të cilat si mbititull e kanë emërtimin ombrellë INDEKLINABILIA. Ndajfolja paraqitet gjerësisht në fillim të kësaj pjese. Kjo gramatikë klasifikon më shumë nënloje të ndajfoljeve sesa gramatikat e tjera të shqipes. Përpos pesë llojeve tradicionale të ndajfoljeve të shqipes, që janë:

- Quantitätsadverbien ndajfoljet e sasisë
- Modaladverbien ndajfoljet e mënyrës
- Lokaladverbien ndajfoljet e vendit
- Temporaladverbien ndajfoljet e kohës
- Kausaladverbien ndajfoljet e shkakut

kjo gramatikë paraqet edhe këto tri nënloje të ndajfoljeve të shqipes, të cilat nuk figurojnë në gramatikat e gjuhës shqipe:

- Modale Satzadverbien ndajfolje modale të fjalisë - fjalët modale
- Interrogativadverbien ndajfoljet pyetëse
- Negativadverbien ndajfoljet mohore

Në këtë punim do të shqyrtohen vetëm *ndajfoljet modale të fjalisë (modale Satzadverbien)* që janë paraqitur në gramatikën e albanologëve Buchholz/Fiedler. Autorët mjaftohen të thonë se në shumë gramatika këto fjalë quhen edhe fjalë modale (Modalwörter), pa e qartësuar nëse bëhet fjalë për gramatikat e gjuhës shqipe apo gjermane.

Në gjuhën gjermane ky grup fjalësh relativisht i vogël paraqitet me terminologji të ndryshme, si p. sh.: “Modalwörter”, “Satzadverbien” apo “Kommentaradverbien”. Në gjuhësinë gjermane pjesët e pandryshueshme të ligjëratës paraqiten me probleme terminologjike nëpër gramatika. Në lidhje me këtë problematikë DUDEN (2016) jep këtë sqarim:

Ein weiteres Problem besteht gerade bei den Nichtflektierbaren in terminologischen Unterschieden zwischen verschiedenen Grammatiken. Besonders misslich ist dabei, dass gleiche Termini für Unterschiedliches verwendet werden (z. B. Modalpartikel, Modalwort, Modaladverb, Gradpartikel, Fokuspartikel). (Duden-Grammatik 2016: 598)

Përpos terminologjisë, ky grup i fjalësh paraqitet si problematik edhe sa i përket emërtimit ombrellë të tyre. Kjo ndodh për shkak të homonimeve të fjalëve modale me pjesë të tjera të ligjëratës. Për ilustrim, *Duden-Grammatik* (2016) dhe Eisenberg (2013) i rendisin fjalët modale te ndajfolja, Hentschel/ Weydt (2013) te pjesëza, kurse Engel (2004) dhe Zifonun et al. (1997) te pjesëza modale (Modalpartikeln). Në këtë kontekst Eisenberg (2013) flet për pikën më kulminante të mospajtimit të emërtimit dhe klasifikimit të këtij grupi fjalësh në gjuhësinë gjermane. Përpjekja për sqarimin terminologjik është sipas Eisenberg-ut (Eisenberg 2013: 222) pothuajse e pashpresë. Sipas tij, vetëm me një analizë të përgjithshme të pjesëzave dhe ndajfoljeve të gjermanishtes do të mund të arrihej një pajtim terminologjik dhe klasifikues për këtë grup fjalësh.

Ky konstatim i Eisenberg-ut hedh dritë në dy çështje të rëndësishme. Në njërën anë paraqitet mospajtimi në gjuhësinë gjermane për emërtimin e këtij grupi të fjalëve; në anën tjetër sipërtheksohet se fjalët modale janë një grup fjalësh që gjenden në mes të ndajfoljeve dhe pjesëzave. Për këtë arsye gramatikat e gjermanishtes paraqesin veçoritë sintaksore të fjalëve modale, që i dallon nga homonimet e tyre te pjesët e tjera të ligjëratës.

Fjalët modale, si të gjermanishtes ashtu edhe të shqipes, shërbejnë për kumtimin e modalitetit. Përmes tyre përshkruhet qëndrimi modal i fole-

sit ndaj realitetit që shfaqet në fjali, i cili mund të theksohet me mjete leksikore, konkretisht me fjalë modale, që përforcojnë kumtimin e shprehur nga mënyra e foljes. Ato mund të tregojnë ose sigurinë e folësit për përputhjen e brendisë së kumtimit me realitetin, ose pasigurinë e tij, dyshimin e tij për këtë.

Sipas *Albanische Gramatik* fjalët modale ndahen si në vijim:

1) *Fjalët modale* që shprehin emocionalitet. Përmes tyre shprehet kuptimi emocional i kumtimit si kënaqësi, lehtësim, habi (çudi) apo keqardhje. Të tilla *fjalë modale* janë: *fatbardhësisht, fatmirësisht, lumturisht, për fat të mirë, shqyr, për fat të keq*, etj.

2) *Fjalët modale* që shprehin modalitet dhe tregojnë shkallën e vërtetësisë së kumtimit të shprehur nga folësi:

a.1.) pohim/ përforcim (pozitiv - afirmativ): *sigurisht, me siguri, patjetër, domosdo, me doemos, vërtet, natyrisht, pa dyshim*, etj.

a.2.) negativ - afirmativ që janë ndajfoljet mohore: *kurrësi, kurrqysh, as-kurrqysh* etj.

b) kufizim: *sidoqoftë, mirëpo*, etj.

c) hamendje/ dyshim: *ndoshta, ndofta*, etj.

d) dyshim dhe distancë të folësit nga kumtimi i tjetrit: *kinse, gjoja*, etj.

Nga kjo paraqitje del se edhe fjalët modale të shqipes kanë homonime te pjesët e tjera të ligjëratës. Për këtë arsye Buchholz/ Fiedler (1987: 366) paraqesin disa veçori të fjalëve modale të shqipes që i dallon nga pjesët e tjera të ligjëratës. Këto veçori do të paraqiten në vijim:

1. Fjalët modale shërbejnë si përcaktues modal jo të domosdoshëm në fjali, si p.sh:

Lumturisht e gjetën.

Fatkeqësisht gjyshi u sëmur.

2. Disa fjalë modale të shqipes paraqiten edhe si grup mbiemëror, që mund të kombinohen me njëri-tjetrin, si p.sh.: *mjerisht i plagosur, i fortë, pa dyshim, i mirë, gjoja i ditur.*

3. Disa fjalë modale mund të marrin edhe rolin e lidhëzës, si p.sh. *mirëpo*:

Mirëpo njohuritë e tij nuk mjaftonin. (fjalë modale)

Mirëpo, ja që nënës s'rrija dot pa ia thënë. (lidhëzë)

Buchholz/ Fiedler nënvizojnë se fjalët modale kanë lidhje të ngushtë me intonacionin e fjalisë të cilat shprehin modalitet apo emocionalitet përmes kategorisë verbale si mënyra, habitörja, por edhe pjesëzat. Shumë shpesh kombinimi mund të pasojë nga disa pjesë të ligjëratës, si p.sh.:

shyqyr + forma foljore të habitores në fjali nxitëse apo çuditëse për kumtimin e kënaqësisë apo habitës: *Shyqyr, paska shpëtuar!* si dhe *ndofta* +pjesëza (*mos* në fjalitë pyetëse me folje në dëftore) për kumtimin e dyshimit/ frikës *Mos ndofta s'e di?*

Sipas *Albanische Grammatik* fjalët modale janë një grup fjalësh që në përdorim tjetër i takojnë grupit të ndajfoljeve, mbiemrave, pjesëzave apo edhe lidhëzave. Ato marrin rolin e fjalëve modale vetëm në momentin kur folësi përmes kumtimit shpreh një modalitet: atëherë ato fjalë shërbejnë si fjalë modale e jo si pjesë të tjera të ligjëratës.

3. Fjalët modale në grammatikat e gjuhës shqipe

Në libra të morfologjisë së gjuhës shqipe ky lloj i fjalëve, gjithnjë sipas *Albanische Grammatik* të Buchholz/Fiedler, nuk figuron si grup i veçantë i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës. Mirëpo në vëllimin e dytë të *Grammatikës së gjuhës shqipe - Sintaksa* të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë) të botuar në vitin 2002, këto lloj fjalësh trajtohen në dy pjesë.

Në fillim paraqiten te Kreu i tretë, ku bëhet përshkrimi i fjalive, përcaktimi dhe kufizimi i tyre (ff. 110-112). Në këtë pjesë jepet një përkufizim për nocionin e modalitetit sintaksor, i cili, sipas kësaj grammatike, përfshin shprehjen e qëndrimit të folësit ndaj realitetit me mjete të ndryshme morfologjike, sintaksore, leksikore dhe intonacionore; më tutje modaliteti i fjalisë përshkruhet si më i gjerë se modaliteti i mënyrave morfologjike (si psh. i dëftores, lidhores, urdhërores, etj.), duke nënvizuar se në këtë rast në fjali bëhet fjalë për modalitetin sintaksor (f. 111); përmes *fjalëve modale* përforcohet qëndrimi modal i folësit, i shprehur në fjali përmes mënyrave të foljes. Kjo gramatikë i ndan në dy grupe këto fjalë, në ato që shprehin:

- sigurinë e folësit për përputhjen e brendisë së kumtimit me realitetin: *vërtet, sigurisht, me siguri, natyrisht, pa dyshim*, etj.; apo në ato që shprehin:

- pasigurinë e tij, dyshimin e tij për këtë: *ndoshta, sikur, ka të ngjarë*, etj.

Nga kjo ndarje rezulton se fjalët modale që mund të jenë futur në këtë grup, përpos ndajfoljeve dhe lidhëzave, mund të jenë edhe togjet. Për këtë arsye u hulumtuam edhe grupet e fjalëve e të togjeve të ndërmjetme, të shtjelluara në *Sintaksën e Akademisë së Shkencave* (ff. 368- 374). Në aspektin morfologjik kjo gramatikë nënvizon se në këtë grup të fjalëve mund të ketë emra, përemra, ndajfolje, trajta foljore. Duke shtuar më tej se togjet e fjalëve të ndërmjetme, sipas përkatësisë morfologjike të fjalës kryesore, mund të jenë: emërore, përemërore, ndajfoljore dhe foljore. Sipas kuptimit, dallohen disa grupe të mëdha fjalësh e togjesh të ndërmjetme. Këto grupe ngërthejnë fjalë e togje të ndërmjetme të ndryshme që kanë në vetvete një mori nuancash kuptimore. Fjalët e togjet e fjalëve të ndërmjetme mund të tregojnë:

- 1) shkallën e vërtetësisë së kumtimit;
- 2) vlerësimin emocional të kumtimit;
- 3) shkallën e rëndësisë së një fakti dhe karakterin e kumtimit;
- 4) lidhjen logjike ndërmjet pjesëve të kumtimit ose ndërmjet kumtimit dhe një kumtimi të mëparshëm;
- 5) burimin e kumtimit;
- 6) qëndrimin ndaj mënyrës së formulimit të kumtimit.

Jo të gjitha këto togje e fjalë të ndërmjetme mund të futen te grupi i *fjalëve modale*. Në vijim do të paraqiten vetëm ato që konsiderohen si *fjalë modale*, të cilat e përforcojnë qëndrimin e folësit të shprehur në fjali përmes mënyrave të foljes. Kjo ndarje do të realizohet gjithnjë sipas *Albanische Grammatik* të Buchholz/ Fiedler, ku fjalët modale tregojnë:

1. shkallën e vërtetësisë së kumtimit; që mund të jetë kumtim për të shprehur diçka si të mundshme, të marrë me mend, apo të gjasshme: *sigurisht, me siguri, domosdo, doemos, ndoshta, mbase, kushedi, siç duket, sipas të gjitha shenjave*.

2. vlerësimin emocional të kumtimit; shërbejnë si përcaktues modal jo të domosdoshëm në fjali: *fatmirësisht, lumturisht, fatkeqesisht, mjerisht, etj*.

Nga paraqitja e *fjalëve modale* të shqipes rezulton se në këtë grup mund të hyjnë togje ose fjalë të ndërmjetme ose pjesë të tjera të ligjëratës që, në forma e në kushte të caktuara, mund të luajnë rolin e *fjalëve modale*,

ku mund të hyjnë emrat, përemrat, ndajfoljet apo edhe trajta foljore.

Si përfundim i këtij hulumtimi del se *fjalët modale* të shqipes ndahen në dy grupe kryesore:

1) *Fjalët modale* që shprehin emocionalitet. Përmes tyre shprehet kuptimi emocional i kumtimit si kënaqësi, lehtësim, habi (çudi) apo keqardhje: *fatbardhësisht, fatmirësisht, lumturisht, për fat të mirë, shlyqyr, për fat të keq, mjerisht*, etj.;

2) *Fjalët modale që shprehin modalitet*: që tregojnë shkallën e vërtetësisë së kumtimit të shprehur nga folësi, apo përforcojnë modalitetin epistemik, i cili mund të shprehet përmes formave foljore:

a.1.) pohim/ përforcim (pozitiv -afirmativ): *sigurisht, me siguri, patjetër, domosdo, me doemos, vërtet, natyrisht, pa dyshim*, etj.

a.2.) negativ-afirmativ, që janë ndajfoljet mohore : *kurrësesi, kurrqysh, askurrqysh* etj.

b) kufizim: *sidoqoftë, mirëpo*, etj.

c) hamendje/ dyshim: *ndoshta, ndofta*, etj.

d) dyshim dhe distancë të folësit nga kumtimi i tjetrit: *kinse, gjoja*, etj.

5. Përfundim

Në përfundim të këtyre shqyrtimeve, mund të thuhet se gramatika *Albanische Grammatik* e albanologëve gjermanë Buchholz/Fiedler ka hapur perspektivë të re në studimet për gjuhën shqipe.

Kërkimet për këtë kumtesë kanë rezultuar me një ndarje të *fjalëve modale* të shqipes, ashtu siç paraqiten në gramatikën e Buchholz/Fiedler-it. Ky grup fjalësh mund të kategorizohet në një të ardhme si grup i veçantë i pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, me të cilat folësi kumton një modalitet apo emocionalitet.

6. LITERATURA

- Agalliu, Fatmir / Angoni, Engjell / Demiraj, Shaban / Dhrimo, Ali / Hysa, Enver / Emil, Lafa / Likaj, Ethem: *Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë: Maluka Verlag 2002.
- Buchholz, Oda / Fiedler, Wilfried: *Albanische Grammatik*, Leipzig: Enzyklopädie Verlag Leipzig 1987.
- Çeliku, Mehmet / Domi, Mahir / Floqi, Spiro / Mansaku, Seit / Përnaska, Remzi / Prifti, Stefan / Toton, Menella: *Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi II, Sitaksa*, Tiranë: Maluka Verlag 2002.
- DUDEN Band 4: *Die Grammatik*. Mannheim, Wien, Zürich: Dudenverlag 2016.
- Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik*, Das Wort. Stuttgart: J.B. Metzler Verlag 2013.
- Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik, Der Satz*. Stuttgart: J.B. Metzler Verlag 2013.
- Engel, Ulrich: *Deutsche Grammatik*. München: Iudicium Verlag 2004.
- Hentschel, Elke / Weydt, Harald: *Der Pragmatische Mechanismus: denn und eigentlich*.
Nw: Weydt, Harald (Hg.): *Partikel und Interaktion*. Tübingen: Max Niemeyer Verlag 1983. (Reihe germanistische Linguistik 44) ff. 263-273.
- Newmark, L./ Hubbard, Ph./ Prifti, P.: *Standard Albanian*. Stanford 1980.
- Zifonun, Gisela / Hoffmann, Ludger / Stecker, Bruno: *Grammatik der deutschen Sprache*. Bd.1, 2, 3. Berlin / New York: de Gruyter Verlag 1997.
- Vjosa Hamiti: *Modaliteti dhe mundësitë e shprehjes së tij sipas Albanische Grammatik të Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it*, në Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare, Prishtinë, 2013/1, ff. 203-210.

Sadije REXHEPI, Prishtinë

SISTEMI KOHOR I SHQIPES SIPAS BUCHHOLZ/FIEDLER-IT

Hyrje

Njëra ndër çështjet gramatikore me të cilën janë marrë në veçanti Buchholz/ Fiedler-i në gramatikën e tyre *Albanische Grammatik* (1987) është sistemi foljor i shqipes. Sipas tyre format foljore me kategoritë funksionale-sematike mund të shprehin temporalitet, aspektualitet /aksionalitet (Aktionsart), modalitet dhe emocionalitet, të cilat i kanë edhe nënkategoritë e tyre, disa prej të cilave nuk mund t'i gjejmë në gramatikat e tjera të gjuhës shqipe. Buchholz/Fiedler-i i përshkruajnë më në detaje këto kategori për secilën formë kohore në krahasim me gramatikat e tjera të gjuhës shqipe. Këtu p.sh. madje edhe koha e tashme e dëftores mund të shprehë modalitet të një kushti real që pritet të realizohet dhe të kushtores.

Pra, qëllimi i këtij punimi është të sjellë të veçantat e kësaj gramatike për sistemin kohor të shqipes duke bërë krahasimin e saj me disa nga gramatikat e gjuhës shqipe.

Numri i mënyrave e i formave kohore të foljes në *Albanische Grammatik* ndryshon në raport me gramatikat e tjera, si gramatika e ASHRSH-së (2002), e Rizës (1997), e Demirajt (1988), e Cipos (1949), të cilat janë përdorur në këtë punim për të bërë përjasje me *Albanische Grammatik*. Në radhët e formave kohore të dëftores të Buchholz/Fiedler-i gjejmë kohën e tashme, shtatë kohë të shkuara (përveç formave të njohura tradicionale aty paraqiten dhe dy kohë më të rralla: e kryera II dhe më se e kryera II), ndër-sa kohët e ardhme (volitiv, e pakryer volitiv, e kryer volitiv, më se e kryer volitiv) me gjithë funksionet e tyre të temporalitet radhiten si një mënyrë e veçantë. Në të paraqiten edhe mënyra të tjera të foljes, të cilat nuk i gjejmë në gramatikat tjera, si mënyra lidhore-habitore, jusivi (mënyra lejore me *le*), necesitativi (Nezessitativ), posibilitativi (Posibilitativ), të cilat kanë edhe forma të ndryshme kohore. Një përshkrim dhe krahasim i formave të tilla besoj të jetë një e dhënë e rëndësishme për gramatikën e gjuhës shqipe.

Funksionet e kohës së tashme në *Albanische Grammatik*

Përveç funksioneve të kohës së tashme që i gjejmë edhe në gramatikën e ASHRSH-së, si kohë e tashme që përfshin edhe çastin e ligjërimit, atë me kuptim mbarëkohor, me kuptimin e së ardhmes dhe të së shkuarës, në *Albanische Grammatik* gjejmë të tashmen në tekste rrëfyese, e cila shpreh një njëkohësi me kontekst të së shkuarës, ku ngjarjet ose gjendjet paralele me një shkallë kohore të së shkuarës vlejnë ende në çastin e ligjërimit (1. ... *po atë ditë ishte i gëzuar se kishte marrë letër nga vëllai që ka në Bashkimin Sovjetik*). Sa i përket të të shprehurit të paskohësisë (e ardhmja në të shkuarën) përmes kohës së tashme mendohet që është më i rrallë (2. *U tha se në qoftë se selvia e tij të zërë të mfishket ta dinë se atëherë është i humbur aty*).

Sa i përket aspektit-aksionalitetit shohim që e tashmja e gjuhës shqipe mund të shprehë edhe një aksionalitet iterativ pa ndonjë shënjeshtesë (3. *Ngrihet në mëngjes në orën gjashtë*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 124).

Përveç aspektualitetit-aksionalitetit, në *Albanische Grammatik* për secilën formë kohore flitet edhe për modalitetin. Edhe Demiraj paraqet funksionet modale për secilën formë kohore. Ai thekson se ka raste që disa forma kohore të dëftores përdoren me kuptime modale karakteristike për mënyrat e tjera. (Krh. Demiraj 1988: 705). Në *Albanische Grammatik* të tashmen mund ta gjejmë me funksion interrogativiteti (në vend të *a plus folje* (4. *Se mos pish ujë kënete, dëgjon?*), mundshmërie objektive (5. ... *sa mbahem në këmbë*), admirativiteti dhe komentimi (6. *Po ti s'vete në shkollë? – e pyeti Stvari ... Si s'vete?*) (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:124). Koha e tashme e dëftores mund të shprehë edhe modalitet të një kushti real që pritet të realizohet (7. *Je i zoti, vëri gjoksin! S'je i zoti, rri në punën tënde...*) dhe të kushtores në fjali kryesore të periodave hipotetike (8. *Ngreu tashi se u bë vonë. Mund të vijnë miqtë të të shohin. S'është mirë të të gjejnë në dyshek*.) (Po aty:125).

Pra, në këtë gramatikë përveç funksioneve kohore paraqiten edhe funksione aspektore e modale të kohës së tashme, të cilat janë karakteristike për këtë gramatikë. Secili funksion është i shpjeguar mirë dhe i ilustruar edhe me shembuj, duke e bërë edhe më të kuptueshëm. Në përgjithësi

në Albanische Grammatik shembujt janë marrë nga vepra letrare, nga gazeta, proza popullore apo edhe nga komunikimi me gojë.

Funksionet e kohës së pakryer në *Albanische Grammatik*

Edhe për të pakryerën e mënyrës dëftore në Albanische Grammatik paraqiten funksione temporaliteti, aspektualiteti, aksionaliteti dhe modaliteti. Përveç funksioneve të zakonshme të së pakryerës që i hasim në grammatikën e ASHRSH-së, në këtë gramatikë hasim edhe funksionin e të pakryerës si të shkuar në lidhje vetëm me kohën kronologjike pa ndonjë lidhje specifike me veprimin; te ky përdorim (si dhe në disa të tjerë) e pakryera paraqet një zhvillim – shpesh kontekstualisht / konstitutivisht të njohur – në një të shkuar të caktuar (9. *Njerëzit dashuroheshin në heshtje vjedhurazi*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:125).

Ndonjëherë e pakryera shpreh edhe parakohësi (10. *Ndenji në krevatin bosh, ku gjer të djeshmen dergjej i biri*). (Po aty). Këtu e pakryera paraqet një kohëzgjatje të një gjendjeje ose veprimi të ndodhur para veprimit apo gjendjes së paraqitur nga e kryera e thjeshtë.

Kur e pakryera përdoret me kuptim volitiv ajo shpreh paskohësi në të shkuarën (11. *Ndërkaq po përparonte ngadalë drejt sheshit. Edhe njëqind hapa, dhe sektori i tij mbaronte*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:125). Këtu edhe pse të dy foljet në të dy fjalitë janë në të pakryerën, folja *mbaronte* shpreh paskohësi në krahasim me foljen *po përparonte*.

Në Albanische Grammatik paraqitet edhe funksione të aspektit e të aksionalitetit të së pakryerës. Ajo në planin e parë shpesh shpreh një veprim që përsëritet, ndërsa prapavija durative shënohet nga një gerundium (përcjellore) (12. *Stvari duke i treguar historitë e luftës vështronte shpesh nga dera se mos hynte njeri*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:126).

E pakryera paraqitet si e shkuar e lidhur me veprimin. Kjo formë shpreh njëkohësi veprimesh (13. *Ziente përbrenda sa s'pëlciste kur vështronte Rinën që ecte kokulur e nuk i përgjigjej*), përkatësisht zhvillim intensiv të dy veprimeve të njëkohshme (14. *Po sa më shumë dehej aq më shumë i vinte mendja te Rina*), ose shënon një veprim në plan të dytë për veprime të tjera (15. *Pastaj ngriti sytë nga adjutanti, që priste në këmbë*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:125). Ky funksion i së pakryerës mund të

vërehet shumë lehtë në përdorimin e saj bashkë me kohët e tjera të shkuara. Në shemb. (15) e kryera e thjeshtë paraqet planin e parë, ndërsa e pakryera paraqet planin e dytë apo prapavinë. Me këtë mund të shohim që në Albanische Grammatik përveç funksioneve të kohëve që kanë në fjali, këtu gjejmë edhe elemente jashtë fjalisë, pra elemente tekstore. Një ndarje e tillë e funksioneve të kohëve në plan të parë dhe në plan të dytë apo prapavi përkon me ndarjen e kohëve sipas relievit të tekstit që bën Weinrich (2001). Që në Albanische Grammatik shkohet edhe përtej fjalisë e paraqet edhe fakti që nganjëherë për të spjeguar një funksion të një forme kohore jepen shembuj me nga dy e tri fjali.

Funksionet e kohës së kryer të thjeshtë në *Albanische Grammatik*

Për përshkrimin e së kryerës së thjeshtë Buchholz/Fiedler-i temporalitetin dhe aspektualitetin i përshkruajnë së bashku. Edhe te kjo kohë këtu janë shënuar kryesisht funksionet që nuk hasen në gramatikën e ASHRSH-së. E kryera e thjeshtë përdoret për të treguar përmbledhjen e një veprimi e jo rrjedhën e tij (16. *Stvari pushoi një copë here*). Përdoret edhe për të treguar një veprim në të shkuarën, që ka zgjatur njëfarë kohe, e cila përmblihdhet si një ngjarje. Në një përdorim të tillë kjo kohë shoqërohet me tregues kohorë si *kurrë, tërë jetën* ose me përsëritje të foljes, e cila lidhet me *sa* apo *e* (17. *Jetoi sa jetoi në shtëpinë tonë dhe u martua me Rinën*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:127). Në këtë rast *jetoi sa jetoi* paraqet parakohësi në krahasim me foljen tjetër po ashtu në të kryerën e thjeshtë *u martua*. Të kryerës së thjeshtë i nevojitet po ashtu një tregues kohor, si p.sh. *dy herë*, për të shprehur një përsëritje të një veprimi, kur ngjarjet përmblihdhen si pjesë të një zingjiri: (18. *Ai e lexoi broshurën dy herë, pastaj u ngrit*). (Krh. Buchholz/ Fiedler 1987:129).

Nëse paraqitet një ngjarje e re jepet në të kryerën e thjeshtë, ndërsa ngjarja e kaluar, e cila kalon në prapavijë, jepet me të pakryerën ose me gerundium (19. *Kur po më shpinin në një spital, ramë në grackë*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:128). Edhe këtu vërejmë ndarjen në plan të parë dhe në plan të dytë, ku e kryera e thjeshtë zakonisht paraqet planin e parë, në krahasim me të pakryerën, e cila paraqet planin e dytë.

Një rast të veçantë paraqet shënimi i një ngjarjeje të pa ndodhur deri

në çastin e ligjërit. Ngjarjet e mundshme të shumëfishta nuk kanë ndodhur ende (20. *More, po si s'të qeshi një herë buza?!).* Këtë funksion e gjejmë edhe te Cipo, sipas të cilit e kryera e thjeshtë këtu mund të zëvendësohet me të tashmen. (Cipo 1949: 114). Mund të paraqitet po ashtu si e shkuar e lidhur me çastin e ligjërit. Këtu e kryera e thjeshtë paraqitet në një përdorim karakteristik për të kryerën (21. *Letra e nënës sime! Çudi! Si erdhi nga Shqipëria?.*) (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:128). Në raste të tilla mund të kemi përdorim të të dy kohëve pa ndërruar kuptimi i fjalisë dhe shumë lehtë mund të kalohet nga njëra formë kohore në tjetrën.

E kryera e thjeshtë mund të përdoret edhe me kuptim të së ardhmes. Atëherë paraqet një fiksion, sikur bëhet fjalë për një ngjarje të përfunduar. Dallohen të përdoren tri grupe me ngjyrim emocionale:

a) te foljet e lëvizjes (22. *Erdha!- thirri Batoja dhe vrapoi me shishe në dorë.*)

b) në thirrje, kur shprehet një frikë në formë ekspresive (23. *Ç'bën kështu? Më coptove!*)

c) në lidhje me lidhëzën *se* me kuptimin 'përndryshe' (24. *Shiko, nënë, hap sytë, se të mori era.*) (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:129).

Edhe te Cipo e hasim të kryerën e thjeshtë me funksione të ndryshme, si atë me kuptim të përsëritjes, me kuptim të një veprimi që do të ndodhë sigurisht pas çastit të ligjërit, të një të shkuare me rezultate në të tashmen. (Krh. Cipo 1949: 114).

Në ligjëratën e zhdrejtë e kryera e thjeshtë duket të jetë e kufizuar në të shprehurit e parakohësisë: (25. *E pse s'më tregove se për ku u nise?.*), ndërsa sikurse e tashmja, mund të shprehë edhe jokohësi. Kjo formë është shumë e kufizuar në thëniet, si p.sh. (26. *Kush pësoi, mësoi.*) (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 129).

Edhe e kryera e thjeshtë mund të ketë ngjyrim kushtoreje në shprehje që shprehin mirësjellje, apo edhe në rastet kur pritet të ndodhë një veprim, si p.sh. (26. *Mori vesh armiku se dole partizan, flaka në qiell shtëpisë.*) (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:129).

Pra, edhe te kjo formë kohore në këtë gramatikë hasim spjegime të funksioneve të ndryshme kohore, aspekte, modale dhe të aksionalitetit, duke dhënë shembuj të shumtë e të kuartë të përdorimit të tyre. Këtu janë zgjedhur vetëm disa shembuj që sqarojnë funksionet e të kryerës së thjeshtë

të që nuk i gjejmë në gramatikën e ASHRSH-së, për të pasur një pasqyrë të shkurtër të funksioneve kohore, modale e të aksionalitetit të së kryerës së thjeshtë që janë më karakteristike për këtë gramatikë.

Funksionet e kohës së kryer në *Albanische Grammatik*

Koha e kryer ka vetëm një tipar obligativ: kohën e dyfishtë, d.m.th. lidhjen në mes të dy shkallëve të kohës, posaçërisht të së shkuarës dhe të së tashmes. (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:129). Edhe e kryera në *Albanische Grammatik* përshkruhet në bazë të temporalitetit, aksionalitetit dhe modalitetit, ku na paraqiten funksione të ndryshme të lidhura me shkallët kohore, si me të shkuarën, me të tanishmen dhe me të ardhmen. E kryera paraqet një të shkuar të lidhur me të tanishmen, një të shkuar që përfshinë edhe çastin e ligjëritimit, pastaj në disa raste mund të zëvendësohet nga koha e tashme (27. *Ne kemi qenë (= jemi) shokë të ngushtë që në vegjëli*), nga e kryera e thjeshtë (28. *I kam prerë (= I preva) edhe udhën pardje e i jam lutur (= iu luta)*, ose te foljet ndihmëse edhe nga e pakryera (29. *Ke qenë (ishe) i qeshur dhe i gëzuar*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:130).

Sa i përket aksionalitetit e kryera mund të paraqet iterativitet (përsëritje), ku përsëritjet e veprimeve vërehen vetëm nga konteksti, nga leksiku (30. *Zakonisht, kur është shkruar për burokratizmin, është qëndruar në sipërfaqe*), ndërsa sa i përket modalitetit, në fushën kushtore perfekti mund të paraqitet vetëm në një krahasim irreal (pas *sikur, ...*) (31. *Pse rri kështu, sikur të janë mbytur gjemitë?*). Perfekti e hasim edhe në të komentuar, ku e kryera ka tendencë të përdoret për të shprehur ngjarje të cilat për folësin janë të vërteta (32. *Mora vesh sikur janë bërë dhe arrestime*). (Krh. Buchholz/ Fiedler 1987: 131). Shembulli (32), por edhe shembujt e tjerë e vërtetojnë teorinë e Weinrich-ut (2001) që e kryera është kohë e komentit. Sipas regjistrit të kohëve ai i ndan kohët në kohë të komentit dhe kohë të rrëfimit.

Më se e kryera, e kryera e tejskuar, Perfekt-i II dhe Plusquamperfekt-i II

Koha më se e kryer ka dy tipare obligative: tiparin e kohës së dyfishtë dhe tiparin e së shkuarës. (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 131). Të njëjtat tipare ka edhe e kryera e tejskuar, edhe pse përdoret shumë më pak se

sa më se e kryera. Në *Albanische Grammatik* funksionet e së kryerës së tejshkuar nuk përshkruhen sikurse te format e tjera kohore të ndara sipas temporalitetit, aksionalitetit dhe modalitetit. Më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar paraqesin një të shkuar para një momenti tjetër në të shkuarën, një të shkuar të largët, të shkuar të dyfishtë, një përmbledhje të veprimeve në të shkuarën apo më se e kryera mund ta paraqesë edhe një kohë pas një veprimi tjetër në të shkuarën, pra ajo mund të paraqesë edhe paskohësi. Këto kohë përdoren edhe në ligjëratën e zhdrejtë, ku e kryera e thjeshtë dhe e kryera kalojnë në ligjëratën e zhdrejtë në më se të kryerën, ndërsa vetëm e kryera e thjeshtë e jo e kryera mund të kalojnë në të kryerën e tejshkuar. (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 131-133).

Më se e kryera përveç funksioneve kohore mund të paraqitet edhe në veprime që përsëriten e shoqëruar me ndajfolje përkatëse (33. *Sa e sa herë ai kishte nxjerrë nga xhepi fotografi*). Edhe më se e kryera mund të paraqitet me funksion irreal kushtor të së shkuarës në perioda hipotetike (34. *Ishte yt atë atje, pa ia kisha treguar qejfin!*). Mund të shprehë edhe një krahasim irreal (pas *sikur*) (35. *Dukej pak i emocionuar, sikur i kish ngjarë diçka*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 132). Këto funksione modale e të aksionalitetit të më se të kryerës paraqesin gjithmonë parakohësi.

Këtu përshkruhen edhe Perfekt-i II dhe Plusquamperfekt-i II, të cilat përdoren në gegërishte. Plq.-i II mund ta paraqesë një të shkuar të trefishtë (36. *U mundua me e bindë prokurorin, se atë ditë, që kishin pasë ardhje Luginasit për grunin, unë kisha pasë harrue fare me i pritë dhe pata shkue me punë në katund*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 133).

Këto ishin disa funksione më karakteristike të së tashmes dhe të formave kohore të së shkuarës që mund t'i gjejmë në gramatikën e Buchholz/Fiedler-it të përshkuara shkurtimisht dhe tani do të kalohet te funksionet e kohëve të ardhme.

Kohët e ardhme

Cipo (1949: 114) dallon vetëm dy kohë të ardhme: të ardhmen dhe të ardhmen e përparme, ndërsa në gramatikën e ASHRSH-së (2002) te përshkrimi i funksioneve të kohëve të ardhme hasim tri forma kohore: të ardhmen (*do të jem*), të ardhmen e përparme (*do të kenë ikur*), të ardhmen e së shkuarës (*do të punoja*), ndërsa të ardhmen e përparme të së shkuarës

(Plusquamperfekt Volitiv) që e hasim në Albanische Grammatik, në gramatikën e ASHRSH-së e quajnë formë të tipit *do të kisha larë*, e cila shpjegohet në kuadër të kohës së ardhme të shkuar, ndërsa te ndërtimi i kohëve të ardhme e gjejmë sikurse te Albanische Grammatik si formë të veçantë.

Kohët e ardhme në Albanische Grammatik radhiten në kuadër të sistemit modal. Ato janë Präsens Volitiv (=Futur = Konditional), Imperfekt Volitiv (= Imperfekt Futur = Präsens Konditional), pastaj Perfekt Volitiv dhe Plusquamperfekt Volitiv. Në këtë gramatikë nuk kemi paraqitje të veçantë për kushtoren, por këtu në kuadër të formave të volitivit paraqiten edhe funksionet e tyre modale. Për dallim nga grammatikat e tjera, në këtë gramatikë për format e volitivit hasim po ashtu nëndarjet për temporalitetin, modalitetin, ndërsa te imperfekti volitiv hasim edhe përshkrimin për aksionalitetin. Edhe sipas Demirajt (1988: 703) për nga ndërtimi format kohore të kushtores nuk ndryshojnë nga format e së ardhmes së shkuar (*do të punoja*) dhe të së ardhmes së parpame të së shkuarës (*do të kisha punuar*). Edhe për nga kuptimi kushtorja është një e ardhme e së shkuarës, por, prapëseprapë ato dallohen për nga përdorimi i tyre. Kur përdoret si e ardhme e së shkuarës, karakterizohet nga modaliteti i vërtetësisë, ndërsa kur përdoret si e tashme dhe e shkuar e kushtores, karakterizohet nga kuptimi i mundshmërisë.

Për dallim nga gramatika e ASHRSH-së në Albanische Grammatik te e ardhmja (Präsens Volitiv) hasim edhe përdorimin e saj për paskohësi në vend të imperfektit volitiv në ligjëratën e zhdrejtë (37. *Të tjerët kërkuan që të mos i japin mish më, të tretët i lavdoheshin se do ta rrahin me shkop*). (Krh. Buchholz/ Fiedler 1987:143). Temporaliteti i së ardhmes vërehet edhe në fjalitë pyetëse (38. *Ku do të veni?*), ndërsa e ardhmja mund ta paraqesë edhe interrogativitetin polemik (39. *Unë do të të mësoj tërë jetën?*).

Te e ardhmja e së shkuarës (Imperfekt Volitiv) (= Imperfekt Futur = Präsens Konditional) në krahasim me të ardhmen e së shkuarës te gramatika e ASHRSH-së, përveç funksioneve kohore hasim një përshkrim të aksionalitetit, e përshkrim të hollësishëm hasim sidomos te modaliteti i kësaj forme. Këtu përshkruhen funksionet kushtore të saj, pra jo e paraqitur si një formë e veçantë e mënyrës kushtore, por si një formë kohore edhe me funksione potenciale dhe irreale kushtore, në relacione të ndryshme kohore. Jepen shembuj të mjaftueshëm për raportet në mes të tri shkallëve kohore, si dhe të raporteve në mes të veprimt që pritet të realizohet dhe të rrjedhimit (pasojës) të veprimt tjetër. Përveç kësaj këtu hasim të ardhmen

e së shkuarës edhe me funksion të interrogativitetit (40. *Si s'erdhe gjer tash, thashë se mos harrove që sot kemi fuar kaq njerëz për çaj... . Si do harroja, moj?*) dhe të supozimit, parashikimit (41. *Kur vdiq do të ish nja 30 a 35 vjeç*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987:145).

Edhe te e ardhmja e përparme (Perfekt Volitiv) përveç funksioneve të tjera hasim edhe funksionin e supozimit (42. *E marr me mend se ç'do të ketë thënë nëna jote*), pastaj të kalimit prej supozimit në habitore, para së gjithash në vetën e parë: (43. *E paske prirje nga natyra! – Siç duket puna do kem lindur poet!*) dhe të interrogativitetit dubitativ (44. *Do të kenë arritur? – Me siguri*). (Po aty:147).

E ardhmja e përparme e së shkuarës (Plusquamperfekt Volitiv) përdorimin temporal për të shprehur paskohësinë në të shkuarën e ka në ligjëratën e zhdrejtë. Përveç përdorimit modal të supozimit, kjo formë përdorimin kryesor e ka kushtoren.

Te funksionet e së ardhmes në gramatikën e ASHRSH-së përshkruhet edhe funksioni i së ardhmes me konstruktin *kam + për të*, ndërsa te Albanische Grammatik kjo formë përshkruhet e veçantë si **Nezessitativ** me format: Präsens (*ka për të dhënë*), Imperfekt (*kishte për të dhënë*), që në gjuhën letrare përdoren për të shprehur një kusht irreal të së tashmes dhe të së shkuarës. Pastaj kemi edhe nezessitativ-in aorist (*pata për të bërë*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 152). Këto forma funksionin kryesor e kanë domosdoshmërinë. Në këto forma është e mundur të shprehurit e temporalitetit, por edhe të sigurisë, përcaktimit, për të cilat nevojiten mjete leksikore shtesë. Këtë formë e gjejmë shumë shkurt në kuadër të kohës së ardhme edhe te Cipo. Përveç kësaj te Cipo (1949: 114) gjejmë edhe formën me *ka + Infinitiv* me funksion të së ardhmes dhe të qëllimit. Edhe Buchholz/Fiedler-i dallojnë formën *ka + Infinitiv* (=“**habere**”-Futur (e ardhme me *ka*)) për të shprehur të ardhmen (*kam me shku*) dhe për të shprehur një paskohësi në të shkuarën (45. *Kurr nuk kam pasë mendue, se kam me marrë ...*). Sipas Buchholz/ Fiedler-it forma *ka + Infinitiv* ka një spektër të përdorimit më të ngjashëm me të ardhmen e gjuhës standarde, se sa me formën *ka për të + Partizip*. (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 152). Por, kjo formë ka edhe përdorim të fortë modal të nevojës, supozimit, pastaj paraqet një rrjedhë reale dhe një thirrje që përmban edhe frikë. Pastaj është edhe e pakryera e së ardhmës me *ka (kishte me më qortue)*, e cila mund të paraqesë edhe modalitet të kushtores duke shprehur një rrjedhë potenciale, irrealë në perioda hipotetike. Formë tjetër e të ardhmes me *ka* në gjuhën e

folur është një formë e së kryerës së thjeshtë të së ardhmes me *ka* (46. **Pat me ardh**, *po erdh e s'erdh*). Pastaj vjen edhe më se e kryera e gegërishtes, e cila me përdorimin e saj i përgjigjet më se të ardhmes së përparme të së shkuarës, p.sh. forma **kishte pasë me më gjetë**. (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 153). Të gjitha këto forma të së ardhmes me *ka* kanë një përdorim të shpeshtë në gegërishte. Mendimin që në variantin verior të shqipës letrare koha e ardhme bën p.sh. *kam me shkrue*, Riza e konsideron të gabuar, sepse si në toskërishte konstrukti *kam për të shkruar* ashtu edhe në gegërishte *kam me shkrue* përkat. *kam për të shkrue* – shprehin (jo kohën e ardhme, por) detyrimin e ardhshëm. (Krh. Riza 1997: 124). Pra, sa i përket temporalitetit këto forma shprehin edhe të ardhmen, por me ngjyrimë të ndryshme modale, si me atë të domosdoshmërisë, detyrimit, supozimit, parashikimit, të përmbledhjes.

Këto ishin shkurtimisht vetëm disa funksione karakteristike të formave kohore të dëftores nga Albanische Grammatik, të cila janë temporale, modale, të aksionalitetit, të cilat për tu qartësuar edhe më mirë të gjitha janë të begatuara edhe me shembuj. Por, karakteristike për këtë gramatikë është edhe fakti që përveç mënyrës dëftore, urdhërore, habitore, dëshirore, kushtore, të cilat i hasim edhe në gramatikën e ASHRSH-së dhe edhe te grammatikat e tjera si te Demiraj, Cipo, Riza, në Albanische Grammatik hasim edhe mënyrën lejore (Jussivin) dhe mënyrën lidhore-habitore, të cilën e hasim edhe te Riza dhe te Cipo, ndërsa Demiraj nuk e pranon këtë si mënyrë dhe këtë nuk e gjejmë as në gramatikën e ASHRSH-së e as te Beci. Cipo mendon që imperfekti dhe aoristi II (i kryeri i tejshkuar) do të dilnin të gjalla dhe me efekte bukurie të pamohuara po të lidhen me lidhoren për të formuar një mënyrë të re që nuk figuron në grammatikat e gjuhës shqipe, **mënyrën lidhore-habitore**, me kohët: i pakryeri (*të paskësha*) dhe plusquamperfekti (*të paskësha pasur*). (Krh. Cipo 1949: 119). Këtë mënyrë e gjejmë edhe te Buchholz/Fiedler-i me ndryshimin që këtu gjejmë tri kohë: të tashmen (47. *Gjermani s'dashka të rroka*), të pakryerën (48. **Të paskësha** *vrap'n e veriut, të kishnja krahë pëllumbi ...*) dhe më se të kryerën (49. **Të paskish rënë** *ndonjë vesë shi këto ditë ...*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 159).

Përveç kësaj karakteristike në Albanische Grammatik janë edhe format e lidhore-habitores me *po* në të pakryerën (50. **Se po të qënkej** *ndryshe, ne do të mbetemi të mbyllur kafazëve të mediokritetit*) dhe në më se të kryerën (51. **Po të mos paskish qënë** *rrota e qerres aty përpara*). Këtu

gjejmë edhe format e habitores me pjesëzën e pamundësisë (52. *Mirpo nuk u ngrënka dot as buka me turp*), si dhe me pjesëzën mos (53. *Thashë mos e paska ndërruar vendin e punës, por ai vetë e sqaroi ...*). (Buchholz/Fiedler 1987: 159). Format e lidhore-habitores me *po* mund t'i gjejmë shumë rrallë në përdorim, andaj funksionet e këtyre formave mund të shprehen edhe me forma të tjera, si p.sh. më se e kryera e lidhore-habitores me *po* (*Po të mos paskish qënë rrota e qerres aty përpara ...*) do të mund të shprehej me formën (*Po të mos kishte qënë rrota e qerres aty përpara ...*), por këtu nuk kemi habi, por kusht, megjithëse edhe te format e lidhore-habitores vërehet më pak funksioni habitor në krahasim me atë lidhor.

Si mënyrë tjetër e veçantë që lidhet me lidhoren është edhe **Possibilitativ-i** e shprehur me *mund* dhe *duhet* + *lidhore*, të cilat forma në gramatikën e ASHRSH-së i gjejmë të përshkruara në të kryerën e lidhores, ndër-sa në Albanische Grammatik kjo paraqitet si një mënyrë e veçantë me format kohore: e tashme (54. *ne mund dhe duhet ta zgjidhim...*), e pakryer (55. *mund të flisnin*), e kryer (56. *mund ta ketë zënë plumbi*), më se e kryer (57. *mund t'i kishte evituar*). (Krh. Buchholz/Fiedler 1987: 160ff.). Në bazë të përdorimit të foljeve *mund* dhe *duhet* kjo mënyrë paraqet modalitetin e detyrimit, të urdhërit, të mundshmërisë, të lejimit, të aftësisë.

Te Buchholz/Fiedler-i formën me *le* e gjejmë po ashtu si mënyrë më vete, **mënyra lejore (Jussiv)**, ku bëjnë pjesë kohët: e tashme (*le të bëhet*), e pakryer (*le të flisnin*), të cilën në gramatikat tjera e gjejmë në kuadër të mënyrës urdhërore, si te Riza (1997: 143) me format: e kryera (*le ta kesh kërkuar*), e pakryera (*le ta kërkonje*), më se e kryera (*le ta kishe kërkuar*). Por, për këto forma të së shkuarës, Riza megjithatë thekson që në fakt janë më shumë përlejuese sesa urdhëruese. (Riza 1997: 144). Këto forma mund të shihen si një mënyrë e veçantë, si lejore, sepse funksionin kryesor e kanë lejimin e jo urdhërin.

Përfundim

Këto ishin disa përshkrime të funksioneve të formave kohore në Albanische Grammatik që janë më karakteristike për këtë gramatikë dhe disa krahasime të klasifikimit të formave kohore të disa mënyrave më të veçanta nëpër gramatika të gjuhës shqipe, të cilat sado na duken shumë të ngjashme kanë dallime në klasifikimin dhe përdorimin e disa formave kohore, sidomos në përdorimin e formave të njëjta gramatikore me funksione

të ndryshme. I tillë është edhe rasti me të tashmen dhe të kryerën e menyrës kushtore dhe format e së ardhmes së shkuar dhe të së ardhmes së parpame të së shkuarës të mënyrës dëftore. Edhe për nga kuptimi kushtorja është një e ardhme e së shkuarës, por, format e së ardhmes së shkuar të dëftores me kohë po e humbin kuptimin kohor dhe po iu forcohet kuptimi i mundshmërisë, sikurse te Albanische Grammatik, që kemi shpjegim shumë më të gjërë të funksioneve modale të këtyre formave, sesa të atyre kohore. Mungesa e dallimit formal në mes tyre shton dyshimin për pranimin e këtyre formave si forma të ndara në mënyra të ndryshme e me funksione të ndryshme, andaj funksionet e këtyre formave në Albanische Grammatik janë të spjeguar në kuadër të volitivit, por me funksione të së ardhmës dhe të kushtores.

Pastaj format me *le* ende nuk janë pranuar si forma të mënyrës lejore, ku Buchholz/Fiedler-i dallojnë dy forma kohore, ndërsa Riza dallon tri; këto forma ende nuk klasifikohen në të gjitha grammatikat si një mënyrë më vete, atë lejore. Ende janë të diskutueshme edhe format kohore të mënyrës lidhore-habitore, të cilën po ashtu nuk e hasim në të gjitha grammatikat e gjuhës shqipe, apo edhe format e tjera, për të cilat, te Cipo dhe te Buchholz/ Fiedler-i gjejmë edhe trajta të ndara kohore. Këto forma Buchholz/Fiedler-i i klasifikojnë në mënyra të veçanta, si në *Nezessitativ* dhe *Possibilitativ*.

Pra, funksionet e shumta të formave kohore të mënyrave të ndryshme që i gjejmë në Albanische Grammatik mbetet shpresë që t'i gjejmë edhe në grammatikat e tjera në gjuhën shqipe, bashkë me përshkrimin që i bëhet disa formave që kanë një përdorim shumë të gjërë edhe në gegërishte. Do të thotë që Buchholz/Fiedler-i përveç paraqitjes së formave kohore të shqipes standarde, japin edhe shumë forma të tjera, të cilat kanë një shtrirje të madhe të përdorimit edhe në gegërishten letrare dhe në atë të folur.

LITERATURA

- ASHRSH. 2002: *Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I, II*. Tiranë.
- Buchholz, Oda./ Fiedler, Wilfried. 1987: *Albanische Grammatik*. Leipzig.
- Cipo, Kostaq. 1949: *Gramatika shqipe*. Tiranë.
- Demiraj, Shaban. 1988: *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Munishi, Zijadin. 1998: *Zgjedhimi i foljeve*. Prishtinë.
- Riza, Selman. 1997: *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore. Vepra 2*. Tiranë.
- Weinrich, Harald. 2001: *TEMPUS-Besprochene und erzählte Welt*. München.

Kurt GOSTENTSCHNIGG, Graz

DIMENSIONI POLITIK I TRAJTIMIT TË ÇËSHTJES SË ETNOGJENEZËS SHQIPTARE NGA ANA E ALBANOLOGJISË AUSTRO-HUNGAREZE

Ky punim¹ përpiket t'i japë një përgjigje pyetjes nëse trajtimi i çështjes së etnogjenezës shqiptare nga ana e albanologjisë austro-hungareze ka pasur një dimension politik apo jo, dhe nëse po, në çfarë ka qëndruar ai. Në fillim ne do të përshkruajmë shkurt zhvillimin e përgjithshëm të albanologjisë austro-hungareze në kontekstin e interesave politikë, ekonomikë, kulturorë dhe ushtarakë të Monarkisë së Dyfishtë. Pastaj do të paraqesim tipat e kërkuesve dhe çështjet më të rëndësishme të kërkimit si dhe do të hedhim një vështrim mbi trajtimin e çështjes së etnogjenezës shqiptare në kohën e Monarkisë Dualiste, para se të diskutojmë përfundimisht dimensionin politik të këtij trajtimi për shqiptarët dhe Austro-Hungarinë.

Për t'iu përgjigjur çështjes së përmendur kërkimore, nëse albanologët austro-hungarezë kanë lejuar të instrumentalizohen nga udhëheqja politike dhe ushtarake e Monarkisë Dualiste, unë kam zgjedhur një kombinim të teorisë së imperializmit kulturor të Johan Galtung-u² me teorinë e fushës të Pierre Bourdieu-s³. Ndërsa konceptet e Galtung-ut “dhuna kul-

¹ Ky punim është një nga rezultatet e shumta të projektit “Albanologjia austro-hungareze 1867–1918 – një rast i imperializmit kulturor?”, kryer në vitet 2014–2017 në Institutin e Historisë, dega e Historisë dhe Antropologjisë së Europës Juglindore, të Universitetit të Gracit, Austrian Science Fund (FWF), project nr. P26437–G15. Si rezultat gjithpërfshirës lidhur me marrëdhëniet austro-hungareze-shqiptare në shkencë, politikë, ushtri, ekonomi dhe kulturë, shih monografinë e gjerë Gostentschnigg, Kurt (2017b): *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Wiesbaden: Springer VS.

² Galtung, Johan (1969): *Violence, Peace and Peace Research*. Në: *Journal of Peace Research* 6, 3, f. 167–191; Galtung, Johan (1971): *A Structural Theory of Imperialism*. Në: *Journal of Peace Research* 8, 2, f. 81–117; Galtung, Johan (1990): *Cultural Violence*. Në: *Journal of Peace Research* 27, 3, f. 291–305.

³ Bourdieu, Pierre (1975): *The specificity of the scientific field and the social conditions of*

turore”, “dhuna strukturore” dhe “kryeurë” (gjerm. “Brückenkopf”, angl. “bridgehead”) përbëjnë instrumente të përshtatshme për analizën e marrëdhënieve josimetrike midis Austro-Hungarisë dhe elitës shqiptare në periudhën e vonshme osmane dhe në Shqipëri (1913-1918), konceptet e Bourdieu-s “fushë”, “habitus”, “kapitale”, “illusio” dhe “doxa” ofrojnë veglat e duhura për analizën e lidhjes midis fushës akademike ose shkencore ose albanologjike nga njëra anë si dhe fushës politike dhe fushës ushtarake nga ana tjetër.

Kontributi i shkencës austro-hungareze për hulumtimin e Shqipërisë është thelbësor. Pjesa më e madhe e punës kërkimore është kryer në fushat e gjuhësisë, historisë, etnografisë, gjeografisë, gjeologjisë dhe arkeologjisë. Akademia e Shkencave në Vjenë me komisionet e saja për Ballkanin dhe Shqipërinë dhe Akademia e Shkencave në Budapest me komisionet e saja për Ballkanin dhe Orientin kanë qenë forcat shtytëse lidhur me ekspeditat kërkimore në Ballkan para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore. Institucionet udhëqesëse kërkimore për hulumtimin gjuhësor, historik, etnografik dhe arkeologjik të Europës Juglindore kanë qenë institutet përkatëse të universiteteve austro-hungareze, veçanërisht në Vjenë, Pragë, Budapest dhe Grac. Instituti i Ballkanit, i krijuar nga Carl Patsch më 1908 në Sarajevë pa lidhje me ndonjë universitet, është bërë qendra e studimeve ballkanike nga ana e Austro-Hungarisë dhe ka pasur një status të privilegjuar.⁴

Meritat e shumta të albanologjisë austro-hungareze në studimin e trojeve shqiptare dhe të popullit shqiptar ngre pyetjen, nëse ka pasur vetëm interesa shkencorë apo edhe interesa shtetërorë. Koha nga Kongresi i Berlinit deri në Luftërat Ballkanike karakterizohet nga humbja e vazhdueshme e ndikimit austro-hungarez mbi shtetet sllave në Ballkan. Në vitin 1913, në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, ka mbetur vetëm Shqipëria, i saponjohur ndërkombëtarisht si vend i pavarur, si aleate kundër pansllavizmit nga njëra anë dhe imperializmit italian nga ana tjetër. Kjo

the progress of reason. Në: Social Science Information. 14, f. 19–47 ; Bourdieu, Pierre (1980): Questions de sociologie. Paris: Minuit; Bourdieu, Pierre (1984/ 1992): Homo academicus. Frankfurt/Main: Suhrkamp ; Bourdieu, Pierre (1992a): Les règles de l’art. Paris: Seuil; Bourdieu, Pierre (1992b): Die verborgenen Mechanismen der Macht. Hamburg: VSA.

⁴ Gostentschnigg (2017b), kapitull 1. “Das Wissenschaftliche Feld”.

ka qenë arsyeja kryesore, pse diplomacia vjeneze, së bashku me atë italiane, ka mbështetur fuqimisht interesat shqiptarë lidhur me çështjet parimore të statusit ndërkombëtar, të përcaktimit të kufijve dhe të organizimit të shtetit të ri në Konferencën e Londrës.⁵

Për shkak të prapambetjes së saj relative ekonomike në krahasim me vendet perëndimore industriale dhe të krizave të saja të brendshme ekonomike, Austro-Hungaria përqendroi politikën e saj tregtare dhe komunikative në drejtim të Europës Juglindore. Pas Kongresit të Berlinit, Monarkia e Dyfishtë konkurroi me Italinë për arritjen e kontrollit mbi rrugët detare dhe tokësore drejt Selanikut për të siguruar hegjemoninë komerciale dhe strategjike në Ballkanin Perëndimor. Lidhur me këtë, trojet shqiptare kishin një rëndësi vendimtare.⁶

Nga lufrat fitimtare të habsburgëve kundër osmanëve rezultoi i ashtuquajturit “Protektorat i Kultit” i Austrisë, d.m.th. e drejta e mbrojtjes së të gjithë të krishterëve të Perandorisë Osmane. Detyrat zyrtare të Protektoratit të Kultit ishin ngritja dhe mirëmbajtja e kishave, arsimiti i klerit dhe mbrojtja e kongregacioneve në Shqipëri. Në këtë kuadër Austria filloi të hapte konsullata dhe zëvendëskonsullata në Shqipëri, detyrat jozyrtare të të cilave ishin veprimtaria humaniste, përmirësimi i nivelit të arsimit, përkrahja e zhvillimit kombëtar dhe shpërndarja e parave në eliten shqiptare.⁷

Historiografia shqiptare në kohën komuniste flet për një imperia-lizëm austro-hungarez në kurriz të lëvizjes kombëtare shqiptare. Historiografia perëndimore e asaj kohe anon nga lavdërimi i rolit të Austro-Hungarisë si ndihmëse për zhvillim. Sot për shkak të fakteve të disponueshme historike duhet të pranojmë se Austro-Hungaria vërtet ka luajtur një rol të rëndësishëm për procesin drejt pavarësisë së Shqipërisë, por gjithmonë duke synuar njëkohësisht zgjerimin e influencës së saj mbi vendin e vogël në periferinë e saj jugore nëpërmjet një imperializmi joformal në bazë të një dhune strukturore dhe kulturore.⁸

⁵ Po aty, kapitull 2.3. “Die Schlüsselrolle Albaniens innerhalb des politischen Balkankonzepts Österreich–Ungarns”.

⁶ Po aty, kapitull 2.4. “Die Handels- und Verkehrspolitik im Dienste der “pénétration pacifique”.

⁷ Po aty, kapitull 2.5. “Das Kultusprotektorat als offizieller Rahmen der Einflussnahme im Eigeninteresse”.

⁸ Po aty, kapitull 6. “Conclusio: Das Feld der Macht als Motor für Kulturimperialismus mittels struktureller und kultureller Gewalt”.

Gjithashtu eksplorimi shkencor i territoreve shqiptare dhe i popullsisë së tyre ka qenë me rëndësi të madhe në kuadër të marrëdhënieve reciproke. Kjo vërtetohet nga burimet historike dhe nga pohimet e historiografisë. Rezultatet shkencore të punës së Institutit të Ballkanit në Sarajevë dhe të ekspeditave të Akademive të Shkencave janë shfrytëzuar për qelime politike, komerciale dhe ushtarake. Nuk bëhej fjalë për ndonjë program konkret politik për instrumentalizimin e shkencës, por të paktën për një mbështetje zemërgjerë të albanologjisë nga ana e institucioneve shtetërore. Të dy vitet e administrimit ushtarak të pjesës më të madhe të Shqipërisë nga trupat austro-hungareze gjatë Luftës së Parë Botërore mund të konsiderohen si kalimi nga imperializmi joformal në atë formal në bazë të bashkëpunimit midis politikës, ushtrisë dhe shkencës.⁹

Fusha e albanologjisë austro-hungareze ka pasur tre tipa të ndryshëm të aktorëve individualë: 1.) tipin e pastër shkencor, të përfaqësuar nga Josef Konstantin Jireček, Milan von Šufflay, Carl Patsch, Gustav Meyer, Arnold Schober, Franz von Miklosich, Hugo Schuchardt, Wilhelm Meyer-Lübke, Norbert Jokl dhe Maximilian Lambertz; 2.) tipin e përzier politikoshkencor me afërsi me ose me përfshirje në fushën politike, të përfaqësuar nga Johann Georg von Hahn, Ludwig von Thallóczy, Theodor Anton Ippen dhe Franz Baron Nopcsa; 3.) tipin e përzier ushtarakoshkencor me afërsi me ose me përfshirje në fushën ushtarake, të përfaqësuar nga Georg Veith, Camillo Praschniker, Franz Seiner, Arthur Haberlandt, Nopcsa, Jokl dhe Lambertz. Përmendja e dyfishtë e Nopcsa-s, Jokl-it dhe Lambertz-it ka të bëjë me faktin se në periudha të caktuara ata kanë qenë afër fushës politike dhe/ose fushës ushtarake. Këta aktorë konkurronin me njëri-tjetrin me anë të kapitalit ekonomik (pasuri financiare dhe posedime materiale), kapitalit kulturor (arsimim dhe pozitë profesionale), kapitalit social (lidhje dhe rrjete) dhe kapitalit simbolik (prestigj dhe reputacion) të tyre për ruajtjen ose ndryshimin e marrëdhënieve të pushtetit brendapërbrenda fushës së albanologjisë austro-hungareze.¹⁰

⁹ Po aty, kapitull 6. “Conclusio: Das Feld der Macht als Motor für Kulturimperialismus mittels struktureller und kultureller Gewalt”.

¹⁰ Gostentschnigg, Kurt (2017a): The different researcher types. Austro-Hungarian albanology between politics and military. Në: Ramadani, Fehari; Kosumi, Bajram (ed.): International scientific conference “Relations between Albanians and Austria-Hungary

Illusio-ja specifike e fushës së përgjithshme albanologjike, d.m.th. interesat dhe doktrinat e përbashkëta të albanologëve, qëndronte në hedhjen e dritës mbi aspektet e panjohura të historisë, kulturës dhe gjuhës së shqiptarëve. Doxa-ja specifike e fushës së albanologjisë austro-hungareze, e paracaktuar nga fusha politike në Austri dhe Hungari, qëndronte në besimin e përbashkët të albanologëve austro-hungarezë që Monarkia Dualiste duhej të ishte pioniere në këtë lëmë. Ky besim i përbashkët i fushës politike dhe i fushës shkencore ndikonte në përzgjedhjen e çështjeve kërkimore. Ashtu si Protektorati i Kultit shtrihej në qarqet katolike në Veri dhe formimi i kombit shqiptar kërkonte legjitimimin e tij në periudhën e lavdishme të Skënderbeut, historianët austro-hungarezë përqendroheshin gjeografikisht në Shqipërinë e Veriut dhe periodikisht në historinë e mesjetës së vonshme të popullit shqiptar. Si shembuj po jepen këtu vetëm përcaktimi gjeografik dhe etnik i Shqipërisë mesjetare nga ana e Šufflay-it, përmbledhja e burimeve lidhur me historinë shqiptare “Acta et diplomata res Albanicae mediae aetatis illustrantia” dhe vepra kolektive “Illyrisch-albanische Forschungen”. Gjithashtu etnografia përqendrohej gati ekskluzivisht në Shqipërinë e Veriut. Arkeologjia lidhur me Shqipërinë, e nisur shumë vonë, i kushtohej në radhë të parë kulturës antike dhe linte shumë pas dore periudhën parailirike, ilirike dhe të mesjetës së hershme. Për këtë mund të ketë pasur dy arsye: nga njëra anë interesi i përgjithshëm i arkeologjisë së atëhershme i drejtohej kohës së grekëve dhe romakëve të vjetër, dhe nga ana tjetër albanologët austro-hungarezë, dashamirë ndaj shqiptarëve, kishin shpresën se vazhdimësia iliro-shqiptare mund të vërtetohej vetëm me argumente gjuhësore.¹¹

Çështja e etnogjenezës shqiptare që nënkupton në të vërtetë historinë e ngulimeve të shqiptarëve dhe lidhet ngushtë me çështjen e prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe, ka zgjuar ndër të tjera interesin e shkencës për popullin shqiptar dhe është ende sot ose më mirë përsëri, krahas çështjeve të historisë moderne të shqiptarëve dhe të reformave të gjuhës shqipe, çështja më e diskutuar dhe më e diskutueshme e albanologjisë në

(Austria) by mid XIX. century to our days”. Skopje, Prishtina: Logos-A, f. 73–86; Gostentschnigg (2017b), kapitull 1.10. “Zusammenfassung und Analyse”.

¹¹ Gostentschnigg (2017b), kapitull 1.10. “Zusammenfassung und Analyse”.

kuptimin më të gjerë të fjalës. Veç kësaj ajo ka pasur e vazhdon të ketë një rëndësi aktuale politike në polemikën shkencore midis shqiptarëve dhe serbëve mbi vendbanimet e trashëguara në Kosovë.¹²

Kjo çështje kërkimore rrotullohet rreth historisë së hershme shqiptare, duke u përpjekur të lokalizohen shqipfolësit në hapësirë dhe kohë. Diskutimi përqendrohet në epokën e sundimit romak deri në shfaqjen e shqiptarëve në burimet e shkruara të mesjetës së mesme. Për të balancuar mungesën e dokumenteve dhe kronikave për këtë periudhë kohore, shkenecat historike përdorin si plotësim rezultate gjuhësore dhe arkeologjike. Meqë mezi ka dëshmi të shkruara për gjuhët e vjetra ballkanike, gjuha shqipe vetë konsiderohet si një material burimor, duke hulumtuar fjalorin, toponimet dhe format gjuhësore në zhvillimin e tyre shekullor. Vlerësimi i njohurive të fituara nga këto burime ndryshon shumë, kështu që ne mund të flasim për tri pozicione parimore:

Së pari: prejardhja e shqipes nga ilirishtja, d.m.th. autoktonia e shqiptarëve si pasardhësit e ilirëve;

Së dyti: prejardhja e shqipes nga trakishtja, d.m.th. imigrimi i paraardhësve trakë;

Së treti: prejardhja e shqipes as nga ilirishtja as nga trakishtja, d.m.th. zhvillimi i shqipes nga një gjuhë tjetër e vjetër ballkanike ende e panjohur.

Pikëpamja mbizotëruese brenda albanologjisë, sidomos në Shqipëri dhe Kosovë, është ajo e autoktonisë, e emërtuar si “teza ilire”. Lidhur me çështjen e kufizimit të ngulimeve ilire në kohën romake, përfaqësuesit e tezës ilire lëkundën midis zonës së Matit, të cilën e ka përcaktuar teoria e Georg Stadtmüller-it, dhe – në kohën e sotme – Shqipërisë së Veriut, Kosovës dhe Maqedonisë. Ndërsa përfaqësuesit e tezës së imigrimit, e emërtuar si “teza trake”, përpiqen t’i japin një përgjigje pyetjes kur shqiptarët kanë imigruar në trojet e tyre të sotme. Mendimet ndryshojnë midis një

¹² Një përmbledhje historike të diskutimit të çështjes së etnogenezës jep Gostentschnigg, Kurt (2016): Die Diskussion der Frage der albanischen Ethnogenese. Ein historischer Abriss. Në: Pistrick, Eckehard (Hg.): Deutsch–Albanische Wissenschaftsbeziehungen hinter dem Eisernen Vorhang. Wiesbaden: Harrassowitz. (= Albanische Forschungen 39), f. 51–74 si dhe Gostentschnigg (2017b), kapitull 1.6. “Die Frage der albanischen Ethnogenese – ein historischer Abriss ihrer Diskussion”.

imigrimi nga një distancë e largët (për shembull nga Kaukazi) dhe një imigrimi nga një distancë e afërt (për shembull nga zonat malore në lindje) në bregdetin e sotëm shqiptar. Pamundësia e rikonstruksionit të ilirishtes¹³ – prandaj ka vërtet tregues, por nuk ka prova për vazhdimësinë iliro-shqipe – , nxjerrat spekulative nga trakishtja¹⁴, për të cilën ekzistojnë vetëm pak dokumente, dhe dokumentimi i vonë me shkrim i shqipes e vështirësojnë në një mënyrë të ndjeshme punën ambicioze të të dyja kampeve.

Le të flasim më hollësisht për punët e gjuhëtarëve vjenezë Joachim Matzinger¹⁵ dhe Stefan Schumacher¹⁶, të cilët përfaqësojnë pozicionin e ri të tretë. Matzinger tërheq vëmendjen për faktin se toponimet dhe hidronimet e Shqipërisë përdoren edhe nga përfaqësuesit e tezës së autoktonisë edhe nga kritikuesit e tyre për verifikimin ose falsifikimin e vazhdimësisë iliro-shqiptare.¹⁷ Pas analizës shembullore gjuhësore të tri emërtimeve të zgjedhura *Shkodër*, *Durrës* dhe *Shkumbin*,¹⁸ ai numëron argumentet kun-

¹³ Mbi ilirishten dhe ilirët shih Eichner, Heiner (2004): *Illyrisch – Die unbekannte Sprache*. Në: *Museum für Urgeschichte Asparn an der Zaya* (Hg.): *Die Illyrer. Archäologische Funde des 1. vorchristlichen Jahrtausends aus Albanien*. Haugsdorf, f. 92-117; Siewert, Peter (2004): *Die Geschichte der Illyrer*. Në: *Museum für Urgeschichte Asparn an der Zaya* (Hg.): *Die Illyrer. Archäologische Funde des 1. vorchristlichen Jahrtausends aus Albanien*. Haugsdorf, f. 79-91.

¹⁴ Mbi trakishten dhe trakët shih Duridanov, Ivan (1985): *Die Sprache der Thraker*. Neuried: Hieronymus; Ament, Hermann u. a. (Hg.) (2003): *Frühe Völker Europas. Thraker – Illyrer – Kelten – Germanen – Etrusker – Italiker – Griechen*. Darmstadt: Wissenschaftliche Buchgesellschaft.

¹⁵ Matzinger, Joachim (2009a): *Die Albaner als Nachkommen der Illyrer aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft*. Në: Frantz, Eva Anne; Schmitt, Oliver Jens (Hg.): *Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung*. München: Oldenbourg, f. 13-36; Matzinger, Joachim (2009b): *Kritische Kurzbemerkungen zur nordalbanischen Toponomastik. Die Namen der urbanen Zentren im adriatischen Küstenbereich*. Në: Genesin, Monica; Matzinger, Joachim (Hg.): *Nordalbanien – L'Albania del Nord*. Hamburg: Kovač, f. 87-98; Matzinger, Joachim (2010): *Illyrisch und Albanisch – Erkenntnisse und Desiderata*. Në: Nedoma, Robert; Stifter, David (Hg.): *Festschrift für Heiner Eichner (= Die Sprache 48, 2009)*. Wiesbaden: Harrassowitz, f. 98-106.

¹⁶ Schumacher, Stefan (2009): *Lehnbeziehungen zwischen Protoalbanisch und balkanischem Latein bzw. Romanisch*. Në: Frantz, Eva Anne; Schmitt, Oliver Jens (Hg.): *Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung*. München: Oldenbourg, f. 37-59.

¹⁷ Matzinger (2009a), f. 21.

¹⁸ Po aty, f. 22-27.

dër tezës së autoktonisë: së pari, emrat antikë nuk pajtohen me ligjet më të vjetra fonetike të shqipes, d.m.th. me ligjet e fjalëve të trashëguara; së dyti, fjalët e huazuara nga greqishtja e vjetër janë shumë të pakta dhe janë lekseme, të cilat kufizohen në kategori të caktuara; së treti, simbioza shumë e ngushtë brendaballkanike e protoshqiptarëve dhe protorumunëve në kuadrin e jetesës së përbashkët si çobanë shtegtarë ka çuar në përputhje leksikore dhe strukturore me rumanishten e mëvonshme.¹⁹ Konkluzioni i nxjerrë nga Matzinger: për shkak të këtyre njohurive të gjuhësisë historike, shqiptarët nuk mund të jenë autoktonë, por më tepër imigrantë nga zonat brendaballkanike.

Matzinger merret më hollësisht me çështjen e lokalizimit të territoreve të prejardhjes.²⁰ Sipas tij, dy rrethana vështirësojnë kërkimin e zonës së origjinës: së pari, jetesa e popullimeve të vjetra ballkanike si çobanë shtegtarë ka qenë e lidhur me një mobilitet të lartë, prandaj transhumanca mezi pajtohet me një zonë qendrore të origjinës; së dyti, nuk është e sigurt nëse analiza e dëshmimeve gjuhësore mund të ndriçojë errësinë e parahistorisë pa shkrim. Sipas Matzinger-it, etnogjeneza e shqiptarëve, d.m.th. lindja e një ndërgjegjeje etnike për shkak të bashkësisë nëpërmjet tipareve sociale, kulturore, fetare dhe ekonomike, ka ndodhur me gjasë në shekullin e pestë ose gjashtë pavarur nga gjuha në Shqipërinë e Veriut si reagim ndaj zaptimit sllav. Zona e Matit dhe malësia e Shqipërisë së Veriut mund të konsiderohen si habitati më i vjetër shqiptar ose si zona e tërheqjes me mundësi kontakti me rrafshet, dhe pikërisht për arsyet si vijojnë: toponimi *Mat* mund të shpjegohet pa problem si “mal, malësi” nga shqipja; zona e Matit ka vetëm pak toponime sllave, por rrethohet nga shumë emra sllavë të vendit. Vetëm nën kushte të tilla ka qenë e mundur njëkohësisht të ruhej gjuha e trashëguar si dhe të merrej, me anë të kontaktit me sllavët, një numër i madh i huazimeve sllave pa iu nënshtruar një sllavizimi të plotë gjuhësor. Nga një zonë e tillë tërheqjeje, siç mendon Matzinger, këta grupe shqipfolëse mund të shtriheshin më vonë në rrafshet e sllavizuara dhe të nguleshin përgjithmonë atje.

Për sa i përket çështjes së gjuhës shqipe, Matzinger dyshon që shqi-

¹⁹ Po aty, f. 27 v..

²⁰ Po aty, f. 29-33.

pja të duhet të identifikohet patjetër me një nga të dyja gjuhët e dokumentuara të etnive të vjetra ballkanike si të ilirëve ose trakëve.²¹ Mund të përfytyrohet që shqipja të jetë vazhdimësia e njëres nga idiomat e patrashëguara ballkanindoeuropiane. Gjithnjë sipas Matzinger-it, kërkimet e gjuhësisë historike kanë treguar se shqipja, bashkë me greqishten, frigishten dhe armenishten, i përket ballkanindoeuropianishtes, një nëngrupi indoeuropian. Kjo bashkësi parahistorike komunikimi në një areal ballkanik konvergjence, së cilës i kanë përkitur edhe idiomat e njohura të vjetra ballkanike si ilirishtja, dakishtja dhe trakishtja, është emërtuar kështu, sepse shumica e këtyre gjuhëve ishte dëshmuar në kohën historike në Ballkan ose në fqinjësinë e tij gjeografik. Prandaj çështja e prejardhjes së shqipes zhvendoset në një periudhë kohore shumë më të hershme.

Në fund Matzinger i përmbledh edhe një herë argumentet, pse nuk mund të vërtetohen autoktonia dhe prejardhja e treguar nëpërmjet kësaj e shqiptarëve nga ilirët antikë:

së pari, materiali gjuhësor i ilirishtes, i trashëguar nga antikiteti, nuk mjafton për të mundësuar pohime përfundimtare;

së dyti, toponomastika e Shqipërisë e hedh poshtë vazhdimësinë lineare iliro-shqiptare; emrat e vendeve dhe lumenjve të Shqipërisë nuk tregojnë një fonetikë të vazhdueshme me fjalë të trashëguara, por një zhvillim fonetik, i cili i përket një shkalle më të vonshme kohore në historinë e gjuhës shqipe, siç dëshmohet nga evidenca e fjalëve të huazuara latine;

së treti, midis shqipes dhe rumanishtes ka përputhje leksikore dhe strukturore, të cilat flasin për kontakte të ngushta të folësve përkatësë në parahistorinë e tyre;

së katërti, etnogjeneza shqiptare ka ndodhur vetëm në shekullin e pestë deri në shekullin e gjashtë pas Krishtit;

së pesti, ka tregues gjuhësorë që një parashkallë e hershme e shqipes ka qenë në kontakt të ngushtë me disa gjuhë të tjera indoeuropiane në kuadrin e një areali parahistorik konvergjence, i cili me gjasë mund të lokalizohet në Ballkan dhe në të cilin me gjasë mund të lokalizohen gjithashtu idiomat antike ballkanike; prandaj përputhje të mundshme gjuhësore midis këtyre gjuhëve indigjene (si ilirishtja, trakishtja dhe dakishtja e dëshmuar)

²¹ Po aty, f. 33-36.

dhe shqipes nuk mund të shpjegohen vetëm e vetëm në kuadrin e një modeli prejardhjeje.²²

Përfundimi i Matzinger-it: gjuhësia historike jep një përgjigje të besueshme për çështjen e prejardhjes së shqiptarëve dhe të origjinës së shqipes; sipas dëshmisë së toponimisë shqiptarët në vendbanimet e tyre historikisht të dokumentuara janë imigrantë nga Ballkani i brendshëm.²³

Le të kthehemi në kohën e Monarkisë Austro-Hungareze. Për shumicën e shkencëtarëve të shekullit të 19^{-të} autoktonia e shqiptarëve ishte një gjë e vetëkuptueshme. Përkundrazi për disa historianë e për shumë gjuhëtarë në gjysmën e parë të shekullit të 20^{-të} shqiptarët janë imigrantë në trojet e tyre të sotme. Në konkluzionet e tyre kanë ndikuar sidomos dy rrethana: marrëdhëniet shqiptaro-rumune dhe toponomastika e Shqipërisë. Lidhjet e shqipes me rumanishten disa gjuhëtarë i kanë lokalizuar në një zonë qendrore ose lindore të Gadishullit të Ballkanit, mjaft larg nga vendbanimet e sotme të shqiptarëve.²⁴ E përsa i përket toponomastikës, shumë ekspertë mendojnë që emrat e sotëm të vendeve në Shqipëri, në krahasim me format përkatëse të antikitetit, tregojnë se zhvillimi fonetik, të cilin e kanë bërë gjatë kohëve, nuk ka kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e shqiptarëve, gjë që lë të arrihet në përfundimin se mungon një vazhdimësi e elementit shqiptar në këto territore.²⁵

Për të mbështetur këtë tezë të pavazhdimësisë, përfaqësuesit e tyre sjellin tri argumente historike: së pari, ndërprerjen e plotë të trashëgimit, të shkaktuar nga ndryshimet e mëdha politike, shoqërore dhe kulturore prej shekullit të 5^{-të} deri në shekullin e 10^{-të}; së dyti, romanizimin pak a shumë të plotë të ilirëve; së treti, sllavizimin po aq të plotë të ilirëve të romanizuar. Prandinë e shqiptarëve në trojet e tyre mesjetare e të sotme ata e shpjegojnë me anë të imigracioneve më të vona nga trojet trake në Ballkanin Lindor ose më tej, përtej Danubit, si dhe nga trojet e dikurshme ilire në Ballkanin

²² Po aty, f. 35 v..

²³ Po aty, f. 36.

²⁴ Weigand, Gustav (1927): Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrer oder der Thraker? Në: *Balkan-Archiv* 3, f. 227-251; Schramm, Gottfried (1994): *Anfänge des albanischen Christentums. Die frühe Bekehrung der Bessen und ihre langen Folgen*. 1. Aufl.. Freiburg i. Breisgau: Rombach.

²⁵ Schramm (1994), f. 22-29; Matzinger (2009a), f. 27 v..

Qendror e Perëndimor në jug të Danubit. Kjo tezë e pavazhdimësisë çoi në dy supozime pasuese: nga njëra anë, shqiptarizimi më i vonë dhe me dhunë i trojeve të gjetura nga ardhësit shqiptarë; nga ana tjetër, shkalla shumë e ulët e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të shqiptarëve mesjetarë. Sipas mbështetësve të kësaj teze, bëhej fjalë për çobanë shtegtarë që vinin nga zonat më të mbyllura e më të prapambetura, ku këto grupime të vogla të një popullsie të lashtë gjysmë të asimiluar kishin qenë në gjendje t'i rezistonin romanizimit të plotë.

Deri para pak vitesh kanë qëndruar vetëm këto dy kampe përballë njëri-tjetrit: nga njëra anë përfaqësuesit e “tezës ilire” ose përkrahësit e tezës së autoktonisë, nga ana tjetër përfaqësuesit e “tezës trako-dake” ose “tezës dako-myze”, të njohur si përkrahësit e tezës së imigrimit të shqiptarëve. Të parët pretendojnë një banim të përhershëm të shqiptarëve në trojet e tyre aktuale, kurse të dytët ardhjen e tyre nga Lindja për në venduanimet e tyre të sotme, duke mos qenë të një mendjeje për zonën e shpërnguljes. Teza e origjinës ilire mbështetet jo vetëm në dëshmi gjuhësore, por edhe në argumente të forta historike. Prandaj ajo u zhvillua së pari nga historianët dhe pastaj u pranua edhe nga gjuhëtarët. Kurse teza e prejardhjes trake bazohet më shumë në kritere gjuhësore sesa historike, gjë që shpjegohet nga fakti se trakët kanë banuar kryesisht në territoret e Rumanisë dhe Bullgarisë së sotme, d.m.th. jashtë kufijve etnikë të shqiptarëve. Prandaj, sipas Eqrem Çabejit, tezës trake i mungon një fundament solid historik.²⁶

Për origjinën ilire të shqiptarëve e të shqipes janë shprehur ndër të tjerë albanologët vijues: Gottfried Wilhelm Leibnitz, Johann Erich Thunmann, Josef Ritter von Xylander, Johann Georg von Hahn, Bartholomäus Kopitar, Theodor Benfey, Franz Miklosich, Lorenz Dieffenbach, Jakob Philipp Fallmerayer, Martin Leake, Gustav Meyer, Paul Kretschmer, Holger Pedersen, Albert Thumb, Mateo Bartoli, Wilhelm Meyer-Lübke, Sextil Puscariu, Josef Konstantin Jireček, Milan von Šufflay dhe – me modifikime – Carl Patsch dhe Franz Nopcsa.

Thunman, duke marrë shkas prej Ptolemäus-it, i cili kishte përmendur në shekullin e dytë pas Krishtit qytetin Albanopolis, të hamendësuar midis lumenjve Drin dhe Shkumbin, ka pohuar se atdheu i parë i shqipta-

²⁶ Çabej, Eqrem (1976): Studime gjuhësore III. Prishtina: Rilindja, f. 30 v..

rëve kishte qenë në zonën malore midis Drinit dhe Shkumbinit. Ndër emrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor ai gjeti disa trakë, të cilët, sipas tij, dëshmojnë se trakët janë ngulur deri në brigjet e Adriatikut. Në bazë të këtyre argumenteve ai arriti në konkluzionin që Ilirët dhe Trakët kishin qenë vërtet dy popuj të ndryshëm, por fiset e tyre ishin përzier me njëri-tjetrin për shkak të afërsisë hapësinore. Shqiptarët e sotëm Thunman i konsideronte kryesisht si pasardhësit e ilirëve, duke shtuar se në formimin e tyre si etni kishte marrë pjesë edhe një element trak.²⁷ Me këtë ai u bë themeluesi i tezës ilire, e cila në fund të shekullit të 19^{te} hyri në diskursin e nacionalistëve shqiptarë dhe u ngrit në Shqipërinë komuniste në doktrinë historike.

Hahn ka qenë i pari që studioi një varg toponimesh të vjetra të trevave shqiptare e të zonave përreth dhe i krahasoi ato me apelativat e shqipes. Sipas tij, ka shumë tregues që epirotët dhe maqedonasit, të cilët ishin farefis me ilirët, përbënin thelbin e kompleksit tirreno-pellazg. Kështu del se ilirishtja është gjuhë pellazge në një kuptim më të gjerë dhe paraardhësit e shqiptarëve janë, krahas ilirëve, edhe epirotët dhe maqedonasit, dhe të gjithë këta popuj rrjedhin nga pellazgët²⁸. Sipas Çabejit, lidhur më prejardhjen e shqiptarëve, kjo tezë pellazge nuk mund të qëndrojë në këtë kuptim të përgjithësuar, sepse pas gjithë gjasave ilirishtja dhe pellazgjishtja janë gjuhë të ndryshme. Për shkak të mungesës së dëshmive gjuhësore, për të cilat mund të thuhet me siguri se i përkasin asaj gjuhe, gjuhësia nuk fiton qartësi mbi karakterin gjuhësor të pellazgjishtes. Përveç kësaj, thekson Çabej, shkencëtarët nuk janë të një mendimi se cili popull dhe cila gjuhë duhet quajtur me emrin pellazg.²⁹

Edhe Šufflay, Patsch dhe Nopcsa kanë mbrojtur tezën e autoktonisë së shqiptarëve të sotëm. Šufflay ishte i mendimit se, edhe sikur të mos kishte dëshmi historike – siç është ajo e Ptolemäus-it për fisin *Albanoi* –, vetë gjurmët e ndikimit gjuhësor të latinishtes mbi shqipen do të mjaftonin për të vendosur vendbanimet e shqiptarëve në bregun e Adriatikut. Sipas tij, analiza e simbiozës iliro-trake dhe shqiptaro-rumune hedh poshtë tezën trake. Lidhjet gjuhësore midis shqipes dhe rumanishtes nuk mund të shpj-

²⁷ Po aty, f. 34 v..

²⁸ Mbi pellazgët shih më hollësisht Lochner von Hüttenbach, Fritz Freiherr (1960): Die Pelasger. Wien: Gerold.

²⁹ Çabej (1976), f. 43 v..

gohen me origjinën e tyre të përbashkët trake, por me simbiozën iliro-trake, me shtegtimin e rumunëve në Ballkan dhe me simbiozën shqiptaro-rumune në Shqipërinë e mesjetës. Prandaj Šufflay nxori përfundimin se shqiptarët janë ilirë me një shtresë trake.³⁰

Në bazë të materialit historik dhe toponomastik, Patsch arriti në konkluzionin se në Ballkanin Perëndimor përpara ilirëve kishte pasur një popullsi trake. Kjo u mbulua më vonë nga një mbishtresë ilire, e cila e nënshtroi nënshtresën trake.³¹

Duke u nisur kryesisht nga etnografia, Nopcsa arriti në një përfundim të ngjashëm me këtë të Patsch-it. Ai ishte i mendimit se shqiptarët i përkasin edhe rrethit kulturor trak, edhe rrethit alpino-boshnjak të burimit ilir. Sipas tij, në territoret e Shqipërisë së sotme u shkri një nënshtresë trake me një mbishtresë ilire. Kështu popullsia shqiptare në bregdetin lindor të Adriatikut është pasardhëse e kësaj përzierjeje trako-ilire që prej kohës romake, me një mbizotërim numerik të elementit trak dhe një mbizotërim social të elementit ilir. Me këtë mund të shpjegohet, gjithmonë sipas Nopcsa-s, edhe fqinjësia e toponimeve ilire dhe trake në këtë zonë.³²

Jireček kufizoi ngulimet e shqiptarëve në kohën romake në zonën malore mes Dalmacisë dhe Danubit.³³ Ishte fjala për zonën malore boshnjake mes luginave të Vrbasit dhe Drinës, ku, sipas tij, nuk kishte asnjë mbishkrim latin dhe gjurmë romanizimi. Në periudhën e shpërnguljeve të popujve, ilirët gjysmë të romanizuar u shtynë në krahinat e Shqipërisë së sotme. Sipas Georg Stadtmüller-it, kjo teori nuk mund të qëndrojë, pasi, duke u nisur nga huazimet e vërtetuara greke në gjuhën shqipe, ngulimet e shqiptarëve në kohën romake duhet të kenë qenë në zonën e kufirit gjuhësor latino-grek.³⁴

Një qëndrim ndërmjetësues në lidhje me çështjen e origjinës së shqi-

³⁰ Šufflay, Milan von (1916-1917): *Biologie des albanesischen Volksstammes*. Në: *Ungarische Rundschau für historische und soziale Wissenschaften*, f. 1-26.

³¹ Çabej (1976), f. 35.

³² Po aty, f. 35.

³³ Jireček, Josef Konstantin (1911): *Geschichte der Serben*. Bd. 1. Gotha: Perthes, f. 152.

³⁴ Stadtmüller, Georg (1966): *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*. 2. erweit. Aufl.. Wiesbaden: Harrassowitz, f. 43.

pes dhe të autoktonisë së shqiptarëve mbante Norbert Jokl.³⁵ Nga kërkimet e tija ai nxori përfundimin se shumica e këtyre elementeve të pakta që dihen nga leksiku i ilirishtes dhe i trakishtes, mund të shpjegohet me shqipen e sotme. Këto lidhje afrie ai i gjeti edhe jashtë leksikut, pikërisht në sistemin gramatikor dhe në strukturën e përgjithshme të këtyre gjuhëve. Kështu Jokl theksoi se, lidhur me fonetikën dhe morfologjinë, disa tipare të ilirishtes dhe të trakishtes gjejnë analogjinë e tyre në dukuritë përkatëse të sistemit gjuhësor të shqipes: vokale, konsonante (sidomos guturale), grupe bashkëtingëlloresh, sufikse dhe prefikse. Sipas tij, dihet se përkimet në fushën fonetike dhe gramatikore janë një tregues më i saktë për caktimin e shkallës së afrisë gjuhësore sesa mund të jetë leksiku. Prandaj këto kanë një rëndësi të veçantë. Duke u nisur nga ky arsyetim, ai konkludoi se gjuha shqipe është shumë e afërme edhe me ilirishten edhe me trakishten, kështu që mund të flitet për shqipen si një gjuhë iliro-trake ose trako-ilire. Këtë teori e mbështetnin edhe Max Vasmer, Francesco Ribezzo dhe Carlo Tagliavini.³⁶ Jokl vërtet ishte i bindur parimisht për autoktoninë e shqiptarëve, por ai arriti në përfundimin se vendbanimet e hershme të shqiptarëve nuk përputhen me ato të sotme në veriperëndim në brigjet e Adriatikut, sepse terminologjia shqipe për peshkatarinë paraqet një përzierje të larmishme huazimesh dhe numri i huazimeve nga greqishtja e vjetër është i pakët.³⁷ Sipas tij, si djepi i popullit shqiptar mund të konsiderohet vetëm ndonjë krahinë e pjesës veriore të territoreve ilire në Ballkan, afërsisht në zonën e Dardanisë së vjetër, një vend që plotëson këto kushte: gjendet brenda romanizmit dhe jo krejt jashtë sferës së greqishtes si dhe afër djepit të rumanishtes ku piqeshin ilirishtja me trakishten. Forma e emrit të sotëm serb *Niš* për *Naissus* të vjetër, një nga qendrat e Dardanisë, tregon ndërmjetësinë gjuhësore të shqipes dhe është një nga dëshmitë gjuhësore për praninë e paraardhësve të shqiptarëve në këtë zonë përpara shfaqjes së sllavëve.³⁸ Përveç kësaj, karakteri ilir i kësaj zone rezulton nga formimet e emrave dhe as elementi trak nuk mungon në toponomastikë. Koha, në të cilën paraardhësit e shqiptarëve kanë ardhur në vendbanimet e tyre më të vjetra ballkanike, mund të caktohet relativisht mirë me mjete gjuhësore:

³⁵ Jokl, Norbert (1924): Albaner (Sprache). Në: Reallexikon der Vorgeschichte 1, f. 84-93.

³⁶ Çabej (1976), f. 35 v..

³⁷ Jokl, Norbert (1923): Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen. Leipzig, Berlin: De Gruyter, f. 161; Jokl (1924), f. 92.

³⁸ Jokl (1924), f. 91 v..

kjo duhet të ketë qenë pas ndryshimit fonetik të elementeve indoeuropiane të gjuhës, *sk-* në *h-* para zanores së mbyllur. Prej Dardanisë, sipas Jokl-it, shqiptarët e hershëm u shpërngulën për në atdheun e tyre të sotëm përgjatë brigjeve lindore të Adriatikut në antikitetin e vonë, por ende para ardhjes së sllavëve në Shqipëri. Të këtij mendimi ishin edhe Petar Skok dhe Edith Durham.³⁹ Kundër tezës së Jokl-it është shprehur në veçanti Stadtmüller, me arsyetimin se Dardania, si një zonë e vërtetuar krejt e romanizuar në kohën romake e bizantine të hershme, nuk mund të merret parasysh si vendformimi i popullit shqiptar.⁴⁰

Përmbledhtas ne mund të themi si vijon: pasi gjuhësia historike, në fushën e përgjithsme të albanologjisë, e sqaroi çështjen e pozitës së shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane, ajo iu drejtua çështjes tendosëse të karakterit ilir, trak ose iliro-trak të shqipes para transformimit të saj nëpërmjet ndikimit të latinishtes vulgare. Përveç kësaj, ajo mundohej të studionte lidhjen e shqipes me dalmatishten dhe rumanishten, thellësinë e ndikimit latin mbi parashqipen dhe ndarjen e leksikut të trashëguar nga fjalët e huazuara dhe të huaja. Forcimi shkencor i tezës ilire të autoktonisë do të thonte njëkohësisht në Ballkan forcimin politik të pozitës së shqiptarëve, të cilët ishin aleatët e Austro-Hungarisë, ndaj komshinjve të tyre sllavë, të cilët ishin kundër habsburgësve. Kështu kishte rëndësi politike, në qoftë se ndikimi i latinishtes mbi parashqipen dhe ndikimi i rumanishtes mbi shqipen nuk ishin të thella si dhe pjesa e fjalorit të trashëguar ndaj fjalëve të huazuara dhe të huaja ishte aq më e madhe. Prandaj mendoj se nuk ka qenë rastësi që albanologët austro-hungarezë si Hahn, Miklosich, Meyer, Meyer-Lübke, Jireček, Šufflay dhe – me modifikime – Patsch dhe Nopcsa përkrahnin pa përjashtim prejardhjen ilire të shqiptarëve dhe të shqipes. Vetëm Jokl, në çështjen e etnogjenezës së shqiptarëve, mbante një qëndrim ndërmjetësues, i cili, megjithatë, u botua vetëm pas fundit të Monarkisë Dualiste dhe i afrohet – të paktën për sa i përket lokalizimit të vendbanimeve më të hershme të shqiptarëve – më shumë tezës së sotme të Matzinger-it.

³⁹ Çabej (1976), f. 39.

⁴⁰ Po aty, f. 39.

HISTORIOGRAFIA GJERMANIKE E ALBANOLOGJIA

Në fillimet e shek. XIX, kur filluan të ngjizeshin kombet e shtetet kombëtare, shqiptarët zgjuan një interes të posaçëm për shkollën historio-grafike gjermanike. Ishte koha kur përplaseshin dy teori të ndryshme mbi kombin, nga njera anë shkolla *objektive* gjermane që e sheh këtë si një shumë njerëzish të bashkuar mbi bazën e elementëve objektivë, të tipareve antropo-somatike, të zakoneve dhe sidomos të gjuhës, dhe nga ana tjetër shkolla *subjektive* franceze, që në frymën e “Kontratës sociale” të Rousseau-it, e konsideronte kombin një rezultat të vullnetit të njerëzve për të jetuar së bashku¹. Kur historianët e parë gjermanë ranë në kontakt me shqiptarët, e kuptuan menjëherë se kishin në dorë provën e artë. Ky popull, konstatonin ata, nuk ishte një “Kulturvolk”, me gjuhë e letërsi të shkruar. Shqiptarët nuk kishin njohur struktura politiko-shtetërore të qëndrueshme kombëtare. Përtej habitatit historik, përtej Shqipërisë *proprie dicta*, në kohë të ndryshme, historia e kishte hedhur një pjesë të mirë të këtij populli “dashnor fanatik të lirisë”, sa në Dalmaci, në Greqinë kontinentale e ishullore e në Itali, por jo si përhapës të një modeli shtetëror e kulturor të caktuar, por në kërkim të një jete më të mirë². E megjithatë, kudo e kurdo që i kishin ndeshur, të huajt i kishin dalluar ata qartë e prerë si “Shqiptarë” (*Albanitai, Albanenses, Arbanasi*)³. Padyshim, këta njerëz i mbanin bashkë

¹ Bernard Guenée, *L'Occident aux XIV^e et XV^e siècles: les États*, Paris, 1971, f. 117-118, 297-298.

² “Und wenn dieses freiheitsfanatische Volk im Gefühl seiner gährenden Kraft, wie die Bienen zur Schwärmzeit, über die vaterländische Grenze sprudelte, so trug es keinen politischen Gedanken in das fremde Land, es suchte nur materielles Gut, damit jeder einzelne bequem unbehelligt leben könne”, J. Ph. Fallmerayer, *Das albanesische Element in Griechenland*, II. Abteilung, München, Verlag der k. Akademie, 1860, f. 10.

³ Marin Tadin, “Les *Arbanitai* des chroniques byzantines, XIe-XIIe siècle”, në: Actes du Xve Congrès International d'Études Byzantines, Athènes, Septembre 1976, vëll. IV: Histoire, Athènes: Association Internationale des Études Byzantines, 1980, f. 314-330.

dhe i dallonin nga të tjerët faktorë identitarë parësorë, siç ishin gjuha e kultura krejt origjinale e tyre. Mbijetesa e një populli të vogël, si ai shqiptar, edhe pse i ndrydhur mes shtetesh e kulturash universale, përbënte një shebull të fuqisë misterioze që fshihej në skutat e panjohura të historisë, të gjuhës e të kulturës së popullit shqiptar. Kështu, impostimi metodologjik, kurioziteti shkencor dhe, jo së fundi, orientimi politik e vuri shkencën gjermanë në vijën e parë të studimeve albanologjike. Një vatër pioniere e këtyre studimeve u bë Akademia Bavareze e Shkencave (Bayerische Akademie der Wissenschaften), e krijuar në vitin 1759. Poli tjetër i Albanologjisë u ngrit, çprej vitit 1847, në Akademinë Austriake të Shkencave, e cila pati për President të parë të saj Joseph von Hammer-Purgstall, autorin e botimit monumental “Geschichte des osmanischen Reiches”, në 10 vëllime, ku të shumta janë faqet që i kushtohen historisë së shqiptarëve.

Si për shumë evropianë të tjerë të atij shekulli, kontakti i parë i studiuesve gjermanë me shqiptarët do të ndodhte në Greqi, ku prej shekujsh jetonte një bashkësi e madhe shqiptare. Shumë evropianë, që ndeshën në shqiptarë gjatë udhëtimeve të tyre nëpër Greqi, nga Bayron tek Chateaubriand⁴, u mjaftuan ta konsiderojnë këtë popullsi për ta të panjohur, një relikë të kohëve apo një atraksion ekzotik. Në dallim prej tyre, historiani e publicisti austriak Jakob Philip Fallmerayer zbuloi tek shqiptarët një faktor të gjallë e të rëndësishëm të historisë. Dhe ndryshe nga bashkatdhetari e bashkëkohësi i tij, historiani Karl Hopf, mori ndaj problemit shqiptar një qasje analitike e problemore, jo thjesht deskriptive. Tezat e konkluzionet e tij të formuluar në dy veprat themelore, “Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters” (1830) dhe “Das albanesische Element in Griechenland” (1860) tronditën historiografinë mbi Greqinë, të dominuar nga panegjirizmi dhe idealizimi romantik i Greqisë moderne, e parë si një riedicion besnik i Greqisë së kohëve të Perikliut⁵. Tezat e Fallmerayer përmbysnin interpretimin e historisë, mbi të cilin u mbështetën formimi qytetar e patriotik, por edhe ambicjet e shtetit grek për t’u zgjeruar territorialisht

⁴ Kyriakou Simopoulou, *Ksenoi taksidiotes sten Hellada 1800-1810*, vëll. III-1, Athinë, 1975, f. 272-304, 342-347.

⁵ S. Pasmazoglou, “La genèse eurocentrique de l’intolérance aux Balkans: le cas grec”, *Bulletin de l’Association Internationale d’Etudes du Sud-Est Européen*, 26-27 (1996-1997), 218-219.

në hapësirat e Perandorisë së dikurshme bizantine. Ato tronditën mjediset akademike e politike deri në nivelet më të larta, ku vetë mbreti bavarez i Greqisë, filo-heleni Otto I, bir i mbretit Ludwig I të Bavarisë, edhe ai filo-helen si i biri, kontribuonte jo pak për të ushqyer mitin e Athinës së lashtë, si mit themelues i Greqisë së re⁶. Por, ndërsa mbretit Otto I i pëlqente ta shihte Greqinë moderne si një mishërim të Greqisë antike, nacionalizmi i ri teokratik grek kërkonte një ringjallje greke sipas shëmbullit të Perandorisë Bizantine⁷. Perandoria Bizantine, konsiderohej prej tij si shembëlltlyrë e model për ndërtimin e një Greqie të madhe sipas projektit nacionalist të “Megali Idesë”⁸.

Kështu, kërkimet dhe tezat e hedhura nga Ph. J. Fallmerayer sollën një përplasje të paprecedentë të autorit të tyre me mitologjinë mbi të cilën u ngrit shteti, politika, arsimi e kultura greke pas vitit 1821. Fallmerayer jo vetëm hodhi poshtë çdo lidhje gjenetike midis Grekëve të lashtësisë me Grekët modernë, por edhe nxorri nga errësira një popull të harruar, shqiptarët, të cilët, për më tepër, i vlerëson si faktor thelbësor të historisë mesjetare e moderne të Greqisë. Sipas tij, mes helenëve të lashtësisë e grekëve të kohëve moderne ka një ndërprerje kontinuiteti e shkaktuar nga kolonizimi masiv, që trevat greke njohën në fillim e në mbarim të Mesjetës, fillimisht nga popullsitë sllave dhe më tej, e më thekshëm, nga ato shqiptare⁹.

⁶ Wolf Seidl, *Bayern in Griechenland. Die Geschichte eines Abenteurers*, München, 1965, f. 11-25 dhe 167-187.

⁷ Ludwig Trost, *König Ludwig I. von Bayern in seinen Briefen an seinen Sohn, den König Otto von Griechenland*, Bamberg, 1891, f. 81.

⁸ A. J. Toynbee, *Civiltà al paragone*, Milano, 2003, f. 248-249; R. D. Caplan, *Balkan Ghosts: A journey through History*, New York, 1993, f. 233-260; B. Jelavich, *Historia e Ballkanit*, vëll. I, Tiranë, 1999, f. 247; G. Castellan, *Histoire des Balkans, XIV^e-XX^e siècle*, Paris: Fayard, 1991, f. 294-295.

⁹ “Das Geschlecht der Hellenen in Europa ist ausgerottet... Denn auch nicht ein Tropfen echten und ungemischten Helleneenblutes fließet in den Adern der christlichen Bevölkerung des heutigen Griechenlands. Ein Sturm, dergleichen unser Geschlecht nur wenige betroffen, hat über die ganze Erdoberfläche zwischen dem innersten Winkel des peloponnesischen Eilands ein neues, mit dem grossen Volksstamme der Slaven verbrüderetes Geschlecht von Bebauern ausgegossen. Und ein zweite, vielleicht nicht weniger wichtige Revolution durch die Einwanderung der Albaner in Griechenland hat die Szenen der Vernichtung vollendet. Scythische Slaven, illyrische Arnauten, Kinder

Sipas Fallmerayer, akoma në shek. XIX, shqiptarët përbënin masën kryesore të popullsisë në provincat kryesore greke¹⁰. E njëjta situatë mbizotëronte edhe në Megara, në provincën e Atikës e në vetë Athinën mitike, ku shumica e banorëve flet ende gjuhën shqipe¹¹. Edhe para Fallmerayer, autorë si J. L. S. Bartholdy¹² apo Alphonse de Lamartine¹³ e Édmond About¹⁴ e kishin konstatuar praninë dhe rëndësinë e elementit shqiptar në krahina të ndryshme të Greqisë. Ndonjëri prej tyre, si anglezi W. M. Leake dhe gjermani Karl Reinhold, kishte kryer edhe tentativat e para për të

mitemnächtlicher Länder, Blutsverwandte der Serbier und Bulgaren, der Dalmatiner und Moskowiten sind Völker, welche wir heute Hellenen nennen, und zu ihrem eigenen Erstaunen in die Stammtafeln eines Perikles und Philopömen hinaufzucken”, J. Ph. Fallmerayer, *Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters*, Bd. I, Stuttgart und Tübingen, 1830, f. XXX; *Ibid.*, Bd. II, 1836, f. 240-249, 256 vijim; Gustav Auernheimer, “Fallmerayer, Huntington und die Diskussion um die neugriechische Identität”, *Südost-Europa* 47 (1998), 1-4.

¹⁰ “Im Peloponnes bestand um die Mitte des fünfzehnten Jahrhunderts die eine Hälfte der Bevölkerung aus reinen Albanesen, und wenn das gleiche Loos nicht auch noch die andere Hälfte des Landes traf, verdankt sie es nur der grausamen Politik Mohammed II., der die energische und widerspänstige Schypetaren-Race überall niederhielt, und sie namentlich im Peloponnes, soweit er es vermochte, zum Vorteil der unterwürfigeren und zaghaften Gräken districtweise gänzlich ausgerottet hat. In Lakonien, in Messenien, ja selbst im grössten Theile Arcadiens hört man heute wenig Albanesisch reden. Die christliche Arwaniten sind zwar im Lande geblieben, haben sie aber wie einst ihre Vorgänger, die Slaven, im Laufe der Jahrhunderte, weil sie schwach, isolirt, ohne Literatur und ohne politische Hoffnung, waren vollständig gräcisirt”. J. Ph. Fallmerayer, *Das albanesische Element in Griechenland*, II. Abteilung, München, Verlag der kaiserlichen Akademie, 1860, f. 6.

¹¹ “Die heutigen Bewohner von Attika sind von einem Ende der Provinz zum andern eingewanderte, auf den Ruinen des Altertums angesiedelte Albanier, Albanesen, Schkypitaren...In Megara und Athen spricht mit geringen Ausnahmen jedermann albanisch, aber nicht jedermann versteht griechisch. Die herrschende Sprache in Attika ist nicht das Neugriechische, sondern das *barbarisch Albanische*”, Richard Bechtle, *Studien zum Griechenlandbild deutscher Reisender*, Ellsingen, 1959, VII, f. 85, 86.

¹² J. L. S. Bartholdy, *Bruchstücke zur näheren Kenntnis desheutigen Griechenlands, gesammelt auf einer Reise im Jahr 1803-1804*, Berlin, 1805.

¹³ A. de Lamartine, *Souvenirs, impressions, pensées et paysages pendant un voyage en Orient (1832-1833)*, tome premier, Paris, 1835.

¹⁴ Édmond About, *La Grèce contemporaine*, Paris, 1854, f. 40-46.

studjuar gjuhën e kulturën e tyre të veçantë¹⁵. Por Fallmerayer-it i takon merita e pamohueshme e historizimit të shqiptarëve të Greqisë. Ai jo vetëm nxorri në pah e vlerësoi vendin dhe rolin historik të shqiptarëve të diasporës së Greqisë, por akoma më shumë, ai skicoi një histori të parë të shqiptarëve në trojet e tyre etnike. Në mënyrë domethënëse ai ndalet posaçërisht në historinë mesjetare të Balshajve të Veriut, të Shpatajve të Jugut, dhe të Gjergj Kastriot-Skënderbeut, të cilët ngritën tre sisteme shtetërore, që në shtrirjen e tyre zunë tërësinë e trojeve shqiptare, që sipas Fallmerayer fillonin nga Mali i Zi, në veri, deri në Gjirin e Prevezës, në jug¹⁶. Një gjë të tillë ai e bëri mbështetur fort mbi burimet historike e realitetin e kohës së tij, duke u ndeshur edhe ashpër me farkëtuesit e nacionalizmit të ri grek. Proverbiale janë kritikrat fshikëlluese që Fallmerayer i bën një “patrioti grek”, siç e quan ai doktor Nikokles nga Kozani, i cili me anë të një teze doktorale, rrekej t’ia prezantonte opinionit evropian shqiptarët si qenie inferiore, “si një popull shtegtar, barbar e krejt i huaj për truallin e shenjtëruar të Greqisë”. Përkundrazi, sipas Fallmerayer, shqiptarët përfaqsonin elementin etnik më aktiv të Greqisë. Sipas tij, revolucioni i vitit 1821 “ishte një revolucion krejtësisht shqiptar, e aspak helen, sepse të gjitha bëmat vërtet të shkëlqyeshme të cilat bënë bujë edhe më pas, u kryen nga luftëtarët shqiptarë”¹⁷. Sipas Fallmerayer, edhe në ditët e sotme në Greqi “trimëria dhe arti i përdorimit të armëve mbetet një privilegj ekskluziv i pasardhësve të racës epiroto-ilire”¹⁸. Me një intelekt të mprehtë, me kulturë universale, me një aftësi të admirueshme për të kryer sinteza historike (*historische Kombinationsfähigkeit*) e me njohjen sovrane të burimeve në gjuhët greke,

¹⁵ W. M. Leake, *Researches in Greece*, London: John Rooth, 1814, f. 237-365; K. Reinhold, *Notes Pelasgicæ*, Athena: Sophoclis Garbola, 1855.

¹⁶ J. Ph. Fallmerayer, *Das albanesische Element in Griechenland*, II. Abteilung, München, Verlag der kaiserlichen Akademie, 1860, f. 20-81.

¹⁷ J. Ph. Fallmerayer, *Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters*, Bd. I, Stuttgart, 1830, f. XXX. Këtë ide, Fallmerayer e shpreh pak më vonë edhe në një “shkrim akademik” të vitit 1835. Shih: J. Ph. Fallmerayer, *Welchen Einfluss hatte die Besetzung Griechenlands durch die Slaven auf das Schicksal der Stadt Athen und der Landschaft Attika*, Stuttgart-Tübingen, 1835.

¹⁸ “Den Muth und die Kunst mit den Waffen zu streiten, besitzt auch heute wieder ausschliesslich das Epirotisch-Illyrische Residuum”, J. Ph. Fallmerayer, *Das albanesische Element in Griechenland*, II. Abteilung, München, Verlag der k. Akademie, 1860, f. 5.

latine, turke, perse, armene, arabe e hebraike që shoqërohej me një pasion e ndjenjë të hollë letrare e, jo së fundi, me një nuhatje të hollë politike (*politischem Spürsinn*)¹⁹, Fallmerayer parashikonte se si do të modelohej politika e jashtme e shtetit grek, pas shpalljes zyrtare të projektit nacionalist të “Megali Idesë”, në 1844, nga kryeministri Joan Koletti. “Ndërkohë që vetë grekët nuk japin e nuk bëjnë asgjë, ata dëshirojnë vetëm të rrëmbejnë dhe praktikisht prej tridhjetë vitesh ata nuk pushojnë së ankuari e së kërkuari nga Evropa para, ndere, privilegje e territore... Pretendojnë se nuk do të mund të bëjnë asnjë përparim në jetën politike dhe se vendi do vazhdojë të jetë i mbuluar nga bandat e grabitësve, përderisa atyre nuk do t’u jepet Epiri dhe Thesalia... Por, provoni t’ua jepni Epirin e Thesalinë dhe do të shihni se çdo të ndodhë. Për të qenë plotësisht e përfundimisht të sinqertë, do t’u thonë grekërit, duhet të na jepni edhe Maqedoninë, edhe Thrakën, madje edhe Stambollin. Por edhe sikur gjithçka t’u japësh, ata do të mbe- ten ata që kanë qenë qysh nga koha e Paleologëve: një bandë barbareskash të krishtera, që kanë mbetur pa u ndëshkuar vetëm për shkak të dobësive foshnjore të politikës evropiane”²⁰. Duke e quajtur shpresë të kotë atë të politikanëve “filo-helenë” të Evropës, pra edhe të mbretit bavarez të Gre-qisë, Otto I, për ta parë Greqinë moderne si një digë kundër rrezikut të “Pansllavizmit”, Fallmerayer shprehet se një rol të tillë do mund ta luante më mirë Turqia²¹. Këtu vlen të kujtohet, se në vitet e Kongresit të Berlinit, 1878, në Evropë kishte politikanë që besonin se rolin e digës antisllave mund ta luante një shtet shqiptar i fortë dhe i shtrirë në kufijtë e tij etnikë²².

¹⁹ Richard Bechtle, *Studien zum Griechenlandbild deutscher Reisender*, Ellsingen, 1959, VII, f.83; Georg Veloudis, “Jakob Philipp Fallmerayer und die Entstehung des neugriechischen Historismus”, *Südost-Forschungen*, 29 (1970) 56.

²⁰ J. Ph. Fallmerayer, *Gesammelte Werke*, II. Band, Leipzig, 1861, f. 145.

²¹ J. Ph. Fallmerayer, *Fragmente aus dem Orient*, Bd. II, Stuttgart-Tübingen, 1845, f. 457 e vijim; G. Veloudis, “Jakob Philipp Fallmerayer und die Entstehung des neugriechischen Historismus”, *Südost-Forschungen*, 29 (1970) 62.

²² Kështu u shkruanin më 1878 Ambasadori anglez, Goschen, dhe ai francez, Fournier, të cilët qeveritë e tyre mbi dobinë e krijimit sipas linjave etnike të një Shqipërie “kompakte” e “të fortë” (madje Fournier artikulon për herë të parë konceptin “Shqipëri e Madhe” (*la Grande Albanie*), e cila do të ishte diga që do të ndalte shtrirjen e ndikimit sllav drejt jugut të Ballkanit. Shih: L. Mile, *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, vëll. I, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1978, f. 218-220, 242, 249-255; A.

Është e tepërt të thuhet, se zbulimi dhe historizimi i elementit shqiptar në Greqi e vendosën Fallmerayerin në krye të listës së *mis-helenëve* (armiqëve të grekëve). Mbi të u ngritën sakaq teoritë e konspiracionit dhe ende sot, dikush pretendon se ka zbuluar që idetë “e mbrapshta” të Fallmerayer frymëzohen drejtpërdrejtë nga shkrimet e Marksit e të Engelsit²³. Megjithatë, vepra e Fallmerayerit dhe idetë e tij, sigurisht radikale, e detyruan historiografinë greke e të huaj, të marri një farë distance nga tezat romantike e ahistorike mbi “pastërtinë e racës greke”. Vetë, K. Papanicolaou, që në betejën me Fallmerayerin mori rolin e “mbrojtësit të Kombit”²⁴, u detyrua të pranojë se në Greqi ekzistonte një minoritet shqiptar, por, nxitonte “të precizonte” ai, ky minoritet nuk kishte ndërgjegje kombëtare dhe po asimilohej gjithnjë e më shumë nga popullsia vendase²⁵. Nisur nga ky shqetësim i babait të historiografisë moderne greke për të kundërshtuar me çdo kusht konkluzionet e Fallmerayer e për ta “ridimensionuar” peshën e elementit shqiptar në historinë e Greqisë, gjithkush mund të arrijë në përfundimin, se me veprën e tij, Fallmerayeri ndikoi, pa dashur, në ndërgjegjimin e historiografisë, e gjithashtu të politikës greke, lidhur me “rrezikun shqiptar”. Në fakt, i detyrohet jo pak të ashtuqajturit “kompleksi Fallmerayer”, fakti që shteti dhe institucionet greke iu vunë përpunimit të politikave shkombëtarizuese e asimiluese në drejtim të arvanitasve, për të cilat flitet me detaje impresionuese në letërkëmbimin mes Gustav Meyerit me Tasos Neroutsos në vitet 1880²⁶.

Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, vëll. I, Tiranë, 1984, f. 228-234.

²³ G. Veloudis, “Jakob Philipp Fallmerayer und die Entstehung des neugriechischen Historismus”, *Südost-Forschungen*, 29 (1970) 64, 65; H. Seidler, *Jakob Philipp Fallmerayers geistige Entwicklung. Ein Beitrag zur deutschen Geistesgeschichte des 19. Jahrhunderts*, Abhandlungen der Bayerischen Akademie der Wissenschaften, Philos.-Hist. Klasse, NF 26, München, 1947, f. 110, 112, 119: “in seinen politischen Ansichten war er dem Einfluss von Marx und Engels ausgesetzt, deren Artikel in den *Deutsch-französischen Jahrbüchern* von 1844 er höchstwahrscheinlich las”.

²⁴ G. Veloudis, “Jakob Philipp Fallmerayer und die Entstehung des neugriechischen Historismus”, *Südost-Forschungen*, 29 (1970) 81.

²⁵ G. Veloudis, “Jakob Philipp Fallmerayer und die Entstehung des neugriechischen Historismus”, *Südost-Forschungen*, 29 (1970) 82.

²⁶ H. Neroutsos-Hartinger, “Der Briefwechsel zwischen Tassos Neroutsos Bey und Gustav

Fallmerayer e identifikon Shqipërinë moderne me territoret nga Mali i Zi deri në Gjirin e Artës²⁷. I bashkohet tezave të J. Georg von Hahn mbi kontinuitetin iliro-shqiptar, mbi karakterin jo grek të Epirotëve dhe të Maqedonëve dhe afërsinë gjenetike të tyre me Ilirët²⁸. Por ai nuk do të hezitonte të ndahej nga Hahn përse i përket problemit pellazgjik: “Si për herë të parë”, shkruan ai, “z. Hahn ka provuar shumë gjëra dhe ndoshta do të kishte bërë më mirë që Pellazgët t’i kishte lënë krejtësisht jashtë loje, ose gjithsesi, t’i ishte referuar me më pak siguri këtij misteri historik, i cili, ashtu si shkrimi kuneiform i Babilonisë, mbetet akoma një element për ne i panjohur. Pellazgët janë një element fare i pakonsoliduar, i mjegullt, i pakapshëm dhe që të tretet ndër duar”²⁹.

Ashtu si Karl Hopfi, Jakob Fallmerayer, Karl Mendelsson-Bartholdy, Karl Heinrich Reinhold e të tjerë studjues, edhe Milan Šufflay u tërhoq në studimet albanologjike ndërsa hulumtonte për të tjera gjëra në arkivat e qyteteve dalmate. Por ndryshe nga të tjerët, tek Šufflay ky “takim” rastësor ndezi një kuriozitet e një pasion të tillë, që pushtoi krejt qenien e tij shkencore. Siç rrëfehej ai vetë, “historia shqiptare, me misteret e saj, ushtrojnë tek studiuesi një forcë manjetike të jashtëzakonshme”. Dhe kështu, Šufflay iu vu punës për të zbuluar rropullitë e historisë shqiptare, që kishte mjaft gjymtyrë të shpërndara gjithandej në Ballkan, por që kishte edhe trupin e saj në trevat e Ilirisë së dikurshme të jugut. Shumë shpejt dhe më mirë e më thellë se bashkëpunorët e bashkautorët e *Acta et Diplomata*, Ludwig Thalloczy e Constantin Jireček, Šufflay u bë zëdhënësi më autoritar i historisë së shqiptarëve, pikërisht në kohën kur shumëkush përpigëj t’i tregonte ata si një popull pa histori. Dhe ishin kohët kur në rend të ditës ishte krijimi dhe konsolidimi i shtetit të shqiptarëve dhe kur këtë shtet shumëkush përpigëj ta privonte nga e drejta historike, akoma më përpara se ta privonte nga territoret e veta.

Meyer. Ein Beitrag zur Geschichte der Albanologie”, *Südost-Forschungen* 51 (1992) 105-148.

²⁷ J. Ph. Fallmerayer, *Das albanesische Element in Griechenland*, II. Abteilung, München, Verlag der k. Akademie, 1860, f. 8.

²⁸ J. Ph. Fallmerayer, *Das albanesische Element in Griechenland*, II. Abteilung, München, Verlag der k. Akademie, 1860, f. 3.

²⁹ *Po aty*, f. 28.

Šufflay është emancipuesi i madh i historisë së Shqipërisë e të shqiptarëve. Sigurisht, edhe të tjerë para tij në mënyrë të pashmangshme ishin ndeshur nëpërmjet burimeve historike me këtë popull. Por, të bindur se shqiptarët nuk përbënin një “*Kulturvolk*”, ata nuk e trajtuan në mënyrë të pavarur historinë e tij, në rastin më të mirë e trajtuan atë si një histori “ko-laterale”, si pjesë e historive të të tjerëve. Kështu vepruan Karl Hopf e Constantin Jireček, të cilët historinë e shqiptarëve në Mesjetë e përfshinë në veprat e tyre kushtuar përkatësisht historisë së grekëve dhe të serbëve në Mesjetë³⁰. E pra, në krahasim me ta, Šufflay i bëri shqiptarët dhe historinë e tyre objektin parësor të hulumtimeve të tij, i bindur për vendin e rolin e tyre si faktor “*princeps*”, parësor, në proceset historike të krejt rajonit ballkanik e të pellgut adriatik.

Nën lentin e analizave të tij skrupuloze, shqiptarët nuk rezultonin më një popull fosil, jo një materie njerëzore e vjetër dhe e ngurtësuar, por një qelizë jashtëzakonisht dinamike, që e gjente forcën e fuqinë sa në lashtësinë e këtij populli, aq edhe në mekanizma biologjikë krejt specifikë të tij, që e lejonin të shfaqej e të rishfaqej në histori me një vitalitet imponues (*palingenesis*). Si askush tjetër përpara, por edhe pas tij, M. Šufflay iu vu punës për të zbuluar mekanizmat biologjikë që e bënin popullin shqiptar që ashtu si Foenix-i i mitologjisë, të zhdukej e të shfaqej përgjatë historisë me energji të paparë. Në rend të parë vinte lashtësia, që i jepte popullit shqiptar një konsistencë e mpiksje të tillë etno-kulturore, thelbi i së cilës nuk arrinte të flashkej nga përzierjet e mbivendosjet e mëvonshme. Shekujt IV-XI, shekujt e errët të përmbysjeve sociale e etnike gjatë në Ballkan, për trevat e Ilirisë së Jugut ishin për Šufflayn shekujt e një beteje titanike për mbijetesë të farës së vjetër ilire. Si askush tjetër, para e pas tij, Šufflay arriti ta skalisë në mënyrë lapidare kapërcimin e epokës së “errët” të mesjetës dhe daljen e shqiptarëve, në shek. XI, në horizontet e historisë së shkruar: “Prej kaosit etnik të Ballkanit, të mbuluar nën hijen politike të Bizantit, dallohet dhe hyn në histori një popull jashtëzakonisht interesant: baza etnike e këtij populli në kohë të vjetër ishte një faktor i fuqishëm i historisë, i cili njihej

³⁰ K. Hopf, *Geschichte Griechenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit*. Enzyklopädie Ersch-Gruber, 85-86. Band, Leipzig, 1868; C. Jireček, *Geschichte der Serben*, Gotha, 1911.

me emrin ilir³¹. Ashtu si bashkëpunorët e tij, Constantin Jireček e Ludovik Thallosy, e identifikonte katërkëndëshin Tivar-Prizren-Ohër-Vlorë si katalizatorin e historisë politike të Shqipërisë mesjetare³². Por ai nuk harron të precizojë, se Shqipëria është para së gjithash një kuptim etnik e gjeografik, dhe si e tillë ajo shtrihej shumë përtej këtij katërkëndëshi. “Sa herë që Shqipëria u organizua politikisht, si me Topiajt, në shek. XIV, me Kastriotët në shek. XV apo edhe me shtetin modern në 1913, ky kuptim u bë shumë i vogël, u përmblohd porsiri i ri”³³. Shqipëria e vërtetë, pra, shtrihej përtej katërkëndëshit virtual Tivar-Prizren-Ohër-Durrës, duke përfshirë edhe Epirin, në jug. Vetë Dioklea (Zeta apo Mali i Zi i sotëm) në veri, ishte sipas Šufflay-t, një fëmijë i paarrirë i Shqipërisë: Zeta dhe Shqipëria e Veriut paraqesnin në mesjetë një fizionomi biologjike të vetme: ishin të lidhura pazgjydhmërisht me një truall të njëjtë plastik, me një gjak të njëjtë ilir, e me të njëjtat fate historike³⁴. Në shek. XIV-XV, regjistrimi i etnikoneve “Arbër” e “Arbëri” edhe në viset e Epirit, në Jug, apo të Malit të Zi, në Veri, nuk do të thotë se kjo shfaqje e tyre lidhet me një ekspansion të racës shqiptare, siç do të pretendonte më vonë me forcë Georg Stadtmüller³⁵. Shtrirja e këtyre etnikoneve përtej katërkëndëshit virtual Tivar-Prizren-Ohër-Durrës, që është edhe ajo një “shtrirje” virtuale nga momenti që presupozohet mbi bazën e të dhënave të pamjaftueshme historike, ka ndodhur, sipas Šufflay, “në një mjedis etnik homogjen”³⁶.

³¹ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, përkthimi shqip nga Zekeria Cana, Prishtinë: Rilindja, 1968, f. 107-108.

³² M. Šufflay, *Die Grenzen Albaniens im Mittelalter*, në: *Illyrisch-Albanische Forschungen*, I. Band, München und Leipzig, 1916, f. 290.

³³ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, shqip Zekeria Cana, Prishtinë: Rilindja, 1968, f. 112.

³⁴ M. Šufflay, “Die Grenzen Albaniens im Mittelalter”, f. 289.

³⁵ G. Stadtmüller, *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*, Wiesbaden, 1966, f. 172-173; I. Božič, Arbanija I Arbanasi XIII-XV veku, *Glas Srpske Akademije Nauka I Umetnosti*, 5 (1983) 42. Mbi kritikën ndaj këtyre pikëpamjeve, shih: A. Buda, “Rreth disa çështjeve të historisë së formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij”, *Studime Historike* nr. 1, 1980, f. 180.

³⁶ “Der Name des altillyrischen Stammes der Albaner wird in der römischen Kaiserzeit genannt, verschwindet aber dann vollständig, um esrt im XI. Jahrhundert in den byzantinischen Quellen wiederum aufzutauchen, und zwar als Bezeichnung für die Bewohner des Berglandes zwischen Skutari, Durazzo, Ochrid und Prizren mit der Berg

Šufflay u shfaq si një studiues inovator edhe në kuptimin e një historie totale. Larg së bëri thjesht historinë e ngjarjeve e të fakteve politike, ai thellohet në faktorët ekonomikë, juridikë, socialë, kulturorë e fetarë. Historia e Šuffllayt është një histori e qytetërimit mesjetar shqiptar. Kundrejt një historie, deri atëherë të trajtuar si një histori anonime e një entiteti “enigmë”, e një populli malesh e të lidhur pas një jete baritore, Šufflay mori dhe analizoi në të gjithë komponentët e vet qytetet e shoqërinë qytetare shqiptare, duke e nxjerrë historinë e Shqipërisë në horizontet e një historie të vërtetë evropiane. Për herë të parë ai i ktheu historisë së Shqipërisë e të shqiptarëve qytetin, deri atëherë të konsideruar një mish të huaj në trupin shqiptar, por që ai e zbuloi si fotoelementin bazë ku u realizuan sintezat e mëdha politike, ekonomike, shoqërore, kulturore të historisë mesjetare shqiptare. Mbetet sot e gjithë ditën e pakonkurueshme analiza e tij për qytetet e Shqipërisë, “*Qytete dhe kështjella të Shqipërisë kryesisht gjatë Mesjetës*”³⁷. Šufflay është autori që më së pari e më së shumti u mor me organizimin e jetës së qytetit mesjetar në Shqipëri. Kjo fillonte me zgjedhjen periodike të organeve drejtuese të komunës, të priorëve, të gjykatësve, të noterëve, të komandantit të policisë bashkiake, të komandantit të flotës, të drejtuesve të doganave, të mbikqyrësve të tregut, etj. Sipas Šuffllayt, e gjithë jeta e qytetit, marrëdhëniet e tij të brendshme e të jashtme, mbështeteshin në zakonet e vjetra, më tej në ligjin pozitiv, të përfaqësuar nga privilegjet e diplomat e perandorëve bizantinë (për qytete si Berati, Janina, Kanina, Shkupi, Prizreni e Kruja) por edhe në formën më të lartë të ligjit pozitiv, në statutet. Šufflay, i cili zbuloi e botoi ai vetë Statutet e Drishtit, paralajmëroi për ekzistencën e statuteve të qyteteve të tjera shqiptare, si Durrësi e Shkodra³⁸. Zbulimi së fundi i Statuteve të Shkodrës, konfirmon plotësisht tezën e mbrojtur në vazhdimësi nga Šufflay, sipas së cilës qytetet shqiptare renditen në mesjetë në radhën e qyteteve më të përparuara evropiane³⁹.

Kroja im Zentrum. Von hier aus verbreitet sich allmählich dieser Name im homogenen ethnischen Medium”. Shih: M. Šufflay, “Die Grenzen Albaniens im Mittelalter”, f. 290.

³⁷ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*, Wien-Leipzig, 1924.

³⁸ M. Šufflay, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë kryesisht në Mesjetë*, përg. L. Malltezi, Tiranë, Onufri, 2009, f. 102, 103, 141-148.

³⁹ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, f. 170.

Duke zbuluar e duke i kthyer dimensionin “qytet” historisë mesjetare të Shqipërisë, Šufflay zgjidhi “enigmën” më të madhe të historiografisë mbi shqiptarët, që deri atëherë i kishte konsideruar këta si një popull pa referenca të qëndrueshme, si një popull në lëvizje e kërkim të vazhdueshëm të një atdheu të papërcaktuar (siç do pretendonte më vonë Georg Stadtmüller). Sipas Šufflay-t, vetë qyteti ishte shprehje e një hinterlandi dhe e një shoqërie bujqësore, që vazhdimisht e ushqente atë me lëndë njerëzore, me produkte e me elemente kulturorë e jetësorë. Marrëdhëniet fshat-qytet janë njëra nga “konstantet kryesore biologjike” të historisë së shqiptarëve⁴⁰. Konstantja tjetër e rëndësishme, sipas tij, ishte marrëdhënia, edhe ajo normale, midis malit dhe fushës, që kushtëzohet nga zhvendosjet e tufave të bagëtive e të bashkësive blegtorale nga kullotat verore (mal), në ato dimërore (fushë). Një lëvizje e tillë nga mali në fushë e anasjelltas, karakterizonte edhe kohët e anomalive e të pasigurive të mëdha politike, duke u kthyer në një faktor të përhershëm të mbijetesës së racës shqiptare. Gjithsesi, qoftë e shkaktuar nga nevojat e jetës blegtorale apo nga pasiguria politike, një dinamikë e tillë bëri, sipas Šufflay-t, që edhe në malësitë shqiptare të depërtonin institucionet politike, juridike e shoqërore të një jete të zhvilluar, institucionet bizantine, anzhuine apo napoletane. Vetë krerët e dikurshëm të fiseve, u shndërruan me kohë në sebastë apo kontë, pra në ingranazhe të sistemit feudal që drejtohej nga Kostandinopoja apo nga Napoli, dhe jo rrallë herë këta shkriheshin në fisnikërinë e qyteteve apo përfundonin si gjeneralë e nëpunës të lartë perandorakë. Nga ana tjetër, ky raport i ngushtë organik mes malësisë, fushës dhe vetë qytetit, bëri që edhe në jetën e fshatit bujqësor e të qytetit të depërtonin institucione, praktika e stile jetese karakteristike për popullsinë e malësive, siç ishte institucioni i *besës* apo vetë zakoni i gjakmarrjes, që gjejnë pasqyrim deri edhe në nene të veçantë të Statuteve të Shkodrës⁴¹.

⁴⁰ M. Šufflay, *Biologie des albanesischen Volksstammes*, *Ungarische Rundschau* 5 (1916).

⁴¹ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*, Wien-Leipzig, 1924; M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, f. 96-119; L. Nadin, *Statuti di Scutari della prima metà del secolo XIV con le addizioni fino al 1469*, Roma, Viella, 2002, f. 146, 147, 157.

Dhori Q. QIRJAZI, Universiteti Aristotelian i Selanikut

ASPEKTE TË JEHONËS/RECEPTIMIT DHE TË KUADRIT BALLKANIK TË VEPRAVE NË GJUHËN GJERMANE KUSHTUAR SHQIPES DHE SHQIPTARËVE

1. Të dhëna arkivore e bibliografike

1.0 Jehona e veprave në gjuhën gjermane kushtuar shqipes dhe shqiptarëve është e hershme dhe në disa raste i ka shoqëruar ato qysh pa parë ende dritën e botimit, sikurse duket nga një letër për A. Armodhin, mësues të greqishtes në Korçë, shkruar nga K. Kristoforidhi para v. 1850, kur ky qe bashkëpunëtor i Hahnit në Janinë:

Fara shqiptare me gjuhën e vet pellazgjike ... në këtë stad ndodhemi prej dy vjetësh dhe vazhdojmë të ecim në të njëjtën hulli pa e mbaruar ende këtë punë se zoti Hahn filolog gjerman [dheë konsull austriak në Janinë dhe unë zotërues i dialektit ilirisht (gegërishtes) dhe një tjetër i toskërishtes, nga anët e Gjirokastrës, po hartojmë një fjalor dhe një gramatikë, të përbashkëta për të dy dialektet ... (Shih Qirjazi 2015: 565-569).

1.1. Duke patur si pikë referimi J.G. Hahnin dhe veprën e tij “Albanesische Studien”, mund të themi se jehona e tyre është padyshim më e madhja dhe bigëzohet sa në rrafshin racional aq edhe në rrafshin emocional.

Meqenëse receptimi i rëndësisë së veprës së Hahnit shkon doradorës me vlerësimet e dhëna për të, po japim këtu në mënyrë të përmbledhur disa pasazhe veprash të harkut kohor 1864-1897.

Të parin vlerësim solid të “Albanesische Studien” e kemi nga arbëreshi Dhimitër Kamarda (Camarda 1864: 4), i cili konsideron se

L'Hahn, deve principalmente, a mio credere, l'interesse destato dalla sua opera alla prima parte storica e filologica, dove egli ha compilato il trattato migliore per ampiezza e profondità di dottrina che finora si conosca, intorno alle origini ed ai costumi degli Schipetari. De' quali ha messo in sodo, a parere dello stesso non facile Fallmerayer, la discendenza dagli antichi Illirio-Macedoni, ed Epiroti, cioè a dire la loro *autoctonia* sul suolo della Grecia. Il grande albanologo testè lodato, non introduceva, per vero dire, con ciò una novella dottrina nel mondo scientifico; essendo che questa medesima opinione fosse quella in sostanza abbracciata prima dal Thunmann, e dagli altri sopra nominati autori: ma l'Hahn riducevala, a detta del citato Fallmerayer, alla consistenza di un ben difeso assioma storico-filologico (8). E neppure del tutto nuova, comunque in altri termini prodotta, può dirsi a parer mio quella parte della dottrina di Hahn, dove egli opina essere il popolo albanese non solamente uguale di antichità coi primi Elleni, e coi primi Romani (Latini), ma lo crede anzi con esso loro intimamente congiunto per affinità di stirpe, di lingua, e di costumi: poichè sembrami una tale sentenza risultare dalle idee di Maltebrun. e di altri scrittori (9).

Është e qartë se më 1864, dhjetë vjet pas botimit të “AS”, Kamarda i bënte të njohur lexuesit opinionin e tij për këtë vepër, me të cilën ai merrej prej vitesh, e që përbënte njërin prej themelive të “Saggio di Grammatologia Comparata sulla Lingua Albanese”.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Dora D'Istrian dhe esenë e njohur të saj “La Nationalité albanaise d'après les chants populaires” (1866), ku Hahni portretizohet si vijon:

La langue dans laquelle ont été composés les chants populaires des Albanais a été longtemps un sujet de graves débats pour les philologues. Plusieurs s'obstinaient, ainsi que le fait Pouqueville, à chercher dans une Albanie caucasienne le point de départ des Chkipetars. Leibnitz supposait que la langue des Albanais devait être celle des anciens Celtes. Les Albano-Italiens [...] n'étaient pas assez au courant des admirables découvertes philologiques de l'Allemagne pour éviter dans leurs démonstrations de regrettables erreurs de détail. Il appartenait à M. G. de Hahn, le docte auteur des Etudes albanaises, de répandre sur cette question un jour nouveau, et à un Albanais sicilien, le père Camarda, de l'éclaircir définitivement. Les Albanais sont pour M. de Hahn les descendants des célèbres Pélasges. Les Pélasges auraient peuplé aux époques primitives l'Épire, la Macédoine, l'Illyrie, la Grèce (Hellade et Péloponèse) et des territoires italiens considérables. En

Grèce, les Pélasges auraient adopté la langue des Hellènes, lorsque l'élément hellénique vint se superposer à l'élément pélasgique, tandis que l'idiome aborigène aurait duré jusqu'à l'invasion bulgare en Macédoine et jusqu'à l'invasion serbe en Illyrie. Dans l'Albanie (Illyrie méridionale et Épire), l'élément pélasgique a repoussé ou s'est assimilé l'élément slave, et de ce pays trop peu étudié sont sorties depuis le XIV^e siècle les colonies épirotes de la Grèce moderne. Ainsi s'est répétée en sens inverse l'invasion des premiers âges, avec cette différence que les Pélasges autochtones s'étaient fondus dans les Hellènes envahissants et qu'aujourd'hui les nouveaux Pélasges établis en Grèce vont s'hellénisant de plus en plus. Selon l'auteur des Études albanaises, il y aurait maintenant des Albanais dans toutes les provinces helléniques, soit de la Grèce continentale, soit de la péninsule péloponésienne [...]. Du reste, si M. de Hahn pense que les Pélasges et les Hellènes de l'antiquité étaient des peuples différents, il s'attache à montrer les nombreux liens de parenté qui les unissent. «Le proto-Albanais, dit-il, n'est pas seulement contemporain du proto-Romain et du proto-Grec, mais il y a entre eux affinité, ou en d'autres termes ce qu'il y a de pareil dans les usages des trois peuples vient d'un même élément, l'élément pélasgique.» (D'Istria 1866: 384-386).

Sikurse dihet, eseja e Dora D'Istrias u përkthye më 1867 nga Kamarada në një shqipe të mbështetur kryekrejt në dialektin arbëresh dhe të pasuruar me mjaft neologjizma librorë e efemerë që e vështirësonin rrokjen e kuptimit të saj nga ana e lexuesit arbër(esh). Kjo është arsyeja pse Th. Mitkoja, nisur nga rëndësia e këtij përkthimi, por edhe nga pesha dhe jehona europiane e emrit të Dora D'Istrias, vendos ta çelë “Bletën Shqiptare” me pjesë të zgjedhura të tij, duke ndërhyrë - pa e thënë - në gjuhën e Kamardës (shih më hollësisht sa shkruajmë në Mitko 2014: 38-50), sikundër tregon bindshëm krahasimi i fragmenteve të mëposhtme:

Glucha më ke jane aratisure kënkate laóshima
t' Arberëshvét ká kelëne per shume mote ypothése
(4) te rándé kjartavé per filologjite. Shume njères
perpissésçin, e skjirétiojen, tue kercuare (5) të një
Arbenie caucasté te nissémén e Shkjiptarvét. Lei-

(1) á pysmén, e kjarten. -- (2) Entashmés. -- (3) Mun-
dimate. -- (4) á cavshe, sènde. -- (5) á kercuene, kercueme.

bnitzi méntoje sé glucha e arberështa kisht' ish ajó e Kjëltevét (á Cèltevét). Arberështe Italioté, kje, si zoti Crispi upëshcup (épiscopi) i Lampsacutë (a), édhè Èngjëli Mashí, kanë chunduare, á shtùre (1) poshte kelà ménnima (2) té endó vèpera te meshtëmé, e te fortshime, nuke ishen sadó te 'mpesuale endè te thantométe dictima, e shpifemé, filolojiké te Allamániese per mé-shpetuene (3) 'ndè te diftóméte aturé dissà te rhocosmé ljathita te pjësseshmé (4). Perki-sté zotite M. G. de Hahn, te dishmite shcruetori t'arberëshvét spudhiavé (b), te sgjëroje, édhè te endëje (5) embe' kele' te pytmén një drite e rëe: édhè një Arberëshi sikjëlioti, z. Camarda, t'a 'ndritshoje 'mbè' sosmé, édhè maruomé.

Arberështe janë per z. Hahn te 'ndjëkësite, e te nipperate se namatismét Pélasgové. Pélasgjetë, á Pélasgjite, do këne jétuare nde cochate protoparé (6) Ipirin, Makjédonien, Illyrien, Éladhen (mé Péloponnisin), édhè endó chora te veshteruoshmé se Italiése. Ende' Éladhe Pélasgjite do këne dhëxure, e perkjafure, gluchen e se Élinevét cure shtichëja (7) élinishté érthe mé-u-sipervënne (dua thome te vëchëj sipre) shtichëese pélasgjicójé, tëcu fjala e pare (avtochthonia, á vétëdhëtshmeja) do këte derueme njëra ende' te pershpuomén e Shkjávét embe' Illyrie. Tè Arbenia (Illyria e notishta) édhè ték' Ipiri shtichëja e pélasgjicoja ká perzanne e presjëlune, á dhè vétvétosure (já shemelyeme asáje) shtichëen te shkjë-

(1) á shtíre, shtíme. — (2) Méndima, ypothèsé, á nenerèitura, nenevómé. — (3) á shcazùene, shcazùare. — (4) pjësemé. — (5) á endëneje, entëneje. — (6) Préparmé. — (7) Shtichëja (τὸ στοιχεῖον) mun te thuchète thèlpi, á berthama, e sicursé pàletsa e cavshavét, á sèndevét, kje aratise te brëndesmé Kelënen vète, á gjithfarrese fyséja e sèndevét, posí shtichète an' se Pérendiese.

nishtë, e përëi kesáje chórié 'ndutu pakke te veshte-ruomé kane dalle ce 'ndé cattermbedhiétti éone coloniáte ipirotishta te se rées Éladhe. Ashtù prán u-ká métadhánne (1) prápeta perchápeja (2) e se paravét vërsashe, á cochoshe, më kete' te 'nderishmém, sé Pélasgjite avtochthone (vétedhëtshmé) u-trèten, édhè u-chjissen 'nde Élinéte perchápésite, pór sotté te riite Pélasgji embèttune, e imbarésueme 'nde Éladhe vëne tuké u-élinisure po mã-sé-mä. Prèj shcruetorin (3) e te arberëshét spudhiavé dèi t' iscen sinani (4) Arberëshé té gjithé éparhjiaté élinicoja, ashtù te se rées Éladhe si édhè te chérsonisite péloponnisishli, pervëtshmé Étolies, Acarnanies, Laconies, édhè Méssiniese. Tèk' Attidha (Atthidha), Mégaridha, Argolidha, Viotia, atà aratisin mã te madhen pjësse te ljauzite, á polémite. Pastaimé nisíte e Idbres, e Pétzes, Porite, édhè Salaminese, Euvèija e notishtëa, édhè ana e vorishtëa nisiute Andrite jane jétuomé shcluesishte (shkjuesishte) përëi Arberëshvé, édhè përëi atuné vétème. Mói, nã z. Hahn méntón sè Pélasgjite, édhè Élinéte e ljashtenies, ishen laojé te enderishmé, ai dha vëchéte (5) 'mbe' te diftueme te bolate lidhéza gjiries, á do afermies, ce i 'ngjittijen atà chüaza shoishókjithe. Proto-Arberèshi « lthote ai » nuke ishte po versénike te proto-Romanite, édhè te proto-Elinite, pór isht' édhè 'nder tà afermia, á më t' jétera fjalé, ate' c' ishte baras ende' vësséte te trè laové brujón përëi një shtichëese, c' ëe' shtichèja pélasgjicoja. Z. Theódhori Mommsen veshterón si një te bãmune (6) pa vésvesëe « te bëshkemé nissén » e Shkjiptarvél édhè fyliavét élinicojés édhè italicójés.


(1) á métazánne. — (2) á e perchápméja, perchápuna. — (3) Sicundrésé, undere, untere shcruetori. — (4) Endashti. — (5) Vanéte, vënëte, vuchéte. — (6) Te bómmet, e baméja.

(Përkthimi i Kamardës => D'Istria 1867: 6-8)

Gluha, me kë janë borë kënkatë llauze të Shqypëtarëvet, ka klënë për shumë kohë një pyetëjë e një kërkim i rëndë për gjithë rredhet e fillllogëvet. Shumë njerëz bindeshin e shqyrëtonin tue kërkuarë te një Arbënië Kaukase nisëjën e Shqypëtarëvet. Laibnitzit mendonte, se gluha e Shqypëtarëvet do të ish ajo e Qeltëvet.

Shqypëtarët Italiasë [...ë nuk ishinin mejaft të mësuarë mbë të çudiçmet çpifëja e diktimit fillollogjishtë të Allamaniës sa të shpëtonin nga disa lajthitëja të fëshitura, që bënë së paku mbë të dëftyerat t'atyre. Kle dhënë për Zotin M.G. de Hahn, të diëshmin shkruetarin e "Spudhiavet Shqype" të çqyenjë e të shtierë mbi këtë të pyetme një dritë të re; edhe për një Shqypëtar Sigelias z. Dhim. Kamardhën, t'a nçelënjë edhe t'a mbaronjë të sosur' e të qaniturë.

Shqypëtarët janë, pas Zotit Han, ndjekësit e stërnipërat e të quajturvet Pellazgë. Pellazgët do të kenë jetuarë ndë kohërat të përparme që ndë krye, në Epërë, Maqedhonië, Ilyrië, Eladhë (me Pelloponisin) edhe ndë ca vënde të përmendëshim të Italiës. Ndë Eladhë Pellazgët do të kenë marrë gjuhën e Elinëvet, kur këta erdhën të hypin gjëndëjën e Pellazgëvet, atje tek u fjala e parë (αυτοχθονία – vetëdheshmeja) do të ketë duruarë njerë kur Shkletë përshkuan Ilyriën. Ndë Shqypërië (Ilyrië të mezditme) edhe ndë Epërë thelbi (στοιχείον), a gjëndëja Pellazge ka dëbuarë, a treturë e shartuarë ndër vetëhe stihin' e Shklevet, andaj nga ky vend fort të paka kanë dalë që mbë të katërmëdhjetën qinjete shkulet Epërote te së reës Eladhë. Ashtu pra zuri persëri përhapja e kohëravet para, por me këtë ndëryshim, se Pellazgët aftothonerë u tretën edhe u derdhën ndë Elinët përhapësit; e sod të rinjtë Pellazgë mbeturë e vendosurë në Eladhë po tretën ca-nga-ca, e po shartohen ndë Elinë. Sin[dëëkur rrëfen Shkruetari i "Spudhiavet Shqype" do të jenë të sotmen Shqypëtarë ndëpër gjithë anët e Eladhës, ashtu të së reës, si edhe të Pelloponesit [...ë. Po ndë (është se) Z. Han mendon se Pellazgët edhe Elinët e lashtëniës, ishinin llauze të veçime e të ndarë, ay vetë vuhet papa të rrëfenjë sesa shumë të afërmë gjërinj, far' e fis, e një gjaku ishinin ata, e sesa të shumta e të ngushta lidhëza i afëronin e i ngjitënin njeriatërin huaza. I pari Shqypëtar "thot' ay" s'ish tjetërë veçese mocatari (vërsëniku) i të parit Romanj, edhe të parit Elinj; po ish edhe ndër ta afërmia e farefisëria e madhe, e me të tjera fjala, ajo që ish bërasi, e njëj lloji ndër zakonet e të tri llauzevet, mburon prej një kronji, njëj' ëme, që është ëma Pellazge. (Mitko 1878, f. 3-4)



Nga fragmentet e cituara ia vlen të pranëvihen - sa për të marrë një ide - fjalitë e mëposhtme:

Dora D'Istria: ... *à montrer les nombreux liens de parenté qui les unissent.*

Përkthimi i Kamardës: ... *mbë të diftue me të bollatë lidheza gjiriës, a do afërmies, që i ngjitjën ata huaza shoishoqitë.*

Përshtatja e Mitkos: ...*të rrëfenjë sesa shumë të afërmë gjërinj, far'e fis, e një gja-ku ishnin ata, e sesa të shuma e të ngushta lidhëza i afëronin e i ngjitënin njer iatërin huaza.*

Dora D'Istria: ... *vient d'un même élément, l'élément pélasgique.*

Përkthimi i Kamardës: ...*brujon përei njëje shtiheësë, ç' ë e' shtiheja pelasgjikjoja.*

Përshtatja e Mitkos: ... *mburon prej një kronji, njëj' ëme, që është ëma Pellazge.*

Nuk ka dyshim se shqipja e Mitkos është më e kuptueshme dhe më e përpunuar, por megjithatë as përkthimi i Kamardës as “Bleta” e shkruar me alfabetin grek dhe e botuar në rreth 450 kopje nuk arritën ta popullarizonin ndjeshëm figurën dhe veprën e Hahnit.

“Fylia Shqypëtare nga kënkat e llauzit” e Dora D’Istrias, botuar në “Bletën Shqypëtare” të Th. Mitkos.



1.2. Ndonëse, për arsye krahasimi, na u desh të bëjmë një çap në kohë e të shkojmë në motin 1878, në të vërtetë, më 1867 (plot 150 vjet më parë!), një penë tjetër e letrave arvanito-arbëreshe, nidrioti Panajot Kupitori, (i krahut jugor të *membra disiecta* të Arbërit)

nisi të botonte në Athinë një cikël shkrimesh me titullin “Πραγματεία ιστορική και φιλολογική περί της γλώσσης και του ἔθνους των Αλβανών” / Trajtesë historike dhe filologjike rreth gjuhës dhe kombit të shqiptarëve (“Εφημερίς των Φιλομαθών”/Gazeta e Dijedashësve, nr. 620/14.1.1867, 622/ 6. 2. 1867, 625/ 6. 3. 1867, 627/ 17. 3.1867, 628/30.3.1867, 633/23. 5. 1867, 636/ 26. 6. 1867, 658/ 31. 1. 1868, 659/13.2.1868). “Gazeta e Dijedashësve” ka qenë një organ autoritar që iu bënte jehonë arritjeve të reja shkencore. Shënojmë se dy nga numrat e saj ku botohen pjesë të studimit të Kupitorit çelen me shkrime për gramatikën historike të greqishtes dhe për gjuhësinë komparative. “Trajtesa...” e Kupitorit u ribotua me plotësime më 1879 në vëllimin “Αλβανικά Μελέται” (Studime Shqiptare). Studimi i kësaj vepre (që pret të përkthehet në shqip) e rendit Kupitorin ndër njohësit dhe vlerësuesit më të mirë e më objektivë të save u patën shkruar deri atëherë në gjermanisht dhe në gjuhë të tjera për shqipen

e shqiptarët. Ajo është një histori e shkurtër e albanologjisë deri në vitet 70 të shek. 19. Po sjellim këtu vlerësimin e tij për Hahnin:

“Vepra e Hahnit radhitet ndër ato produkte filologjike, të cilat në llojin e vet bëjnë epokë, dhe po ashtu ushtrojnë një trysni kohëgjatë shpjegimesh, interpretimesh, shënimesh dhe tezash e antitezash historikofilologjike brenda dhe tej një shekulli, duke shërbyer si shkas dhe si fabrikë armësh. [...] Hahni është i pari dhe gjer më sot mbase i vetmi ndër evropianët me formim shkencor, i cili përshkoi Shqipërinë mbarë, njohu nga afër skajet thuajse të fshehta të vendit, vëzhgoi karakterin, doket, intelektin dhe jetën së bashku me gjithë ekzistencën politike të shqiptarëve, mësoi shqipen e vendit në dy dialektet kryesore të saj, toskërisht dhe gegërisht, pra me të lexuar, të shkruar e të folur, dhe për këto arsye renditet mes gjeografëve dhe etnografëve më të shquar.” (Kupitori 1879: 12-13).

Vetë Kupitori duket se është ndikuar thellë nga vepra e Hahnit, si-kurse konstaton edhe kolegu T. Jochalas në hyrje të botimit filologjik të dorëshkrimit të Fjalorit Greqisht-Arvanitisht-Shqip, hartuar nga savanti hidriot në motet e fundit të jetës:

“Studimi ynë tregoi se Kupitori, gjithë trajtat e Fjalorit të tij, që i shoqëron me shkurtesat t. ose g. [toskërisht ose gegërishtë, i ka marrë prej Fjalorit [Shqip-Gjermanisht] të Hahnit. Vërtetuam se me shkurtesën h. të Kupitorit shënohet Fjalori i lartpërmendur i Hahnit.” (Jochalas 2006: B 439).

1.3. Vlerësimi i Kupitorit për Hahnin gjen jehonë të plotë në një shkrim të Faik Bey Konicës të vitit 1897, të cilin po e sjellim në mënyrë integrale:

Rëndësia e gjuhës Gjermanisht për shqipëtarët


Mësojmë se te shkolla shqip në Korçë do të kllasin mësimin e gjuhës Gjermanisht.

Kio e re na gëzon fort; se sa kio gjuhë s'ka më të nevojshime për ne Shqipëtarët.

Si fare mirë e dini, m'e bukura dhe m'e vjetëra bibllë për Shqipëtarët, Albanesische Studien, është shkruar në këtë gjuhë. Hahni, i pari shkakëtor i ngjalljesë gjuhës, letrëtyrës, dhe kombit tonë, mbeti tridhjetë vjet në Shqipëri. Ishte konsull i Oshtrisë (Nemcës) në Janinë; po aq i pëlqente Shqipëria, sa, kur desh në t'a ndrojnë, hoqi dorë nga puna e tuj. Vate më të katër anët e Shqipërisë, dhe tërë dialektet tona i fliste me një të math qërim.

Përveç Hahnit, allbanologët Ksillander, Franc Bopp, Pott, dhe shumë të tjerë, si Dieffenbach, Harff, Otto Blau, Miklosich kanë shkruar kryepunërat e tyre në gjuhën Gjermanishte. Sot për sot kemi të madhin Gustav Meyer, profesor te Universiteja e Gracit (n'Oshtri), kujt bibllat kanë hedhur një dritë aqë të çkëlqyer në erësirat e gjuhës Shqip; Z. Jan Urban Jarnik, profesor te Universiteja e Pragës (Oshtri), qi njuh aqë mirë Gegënishten; Z. Pisko, një prej konsullët e Oshtrisë në Shqipëri, cili punon fort bukur gjuhën Shqip. Të gjithë këta Zotërinj kanë shkruar punërat e tyre në gjuhën Gjermanisht, si dhe Z. Pedersen, një i ri allbanolog për cilin do të bëjmë fjalë më tutje.

ALBANICA



(Quellen zu albanesischen Studien.)

von Dr. NEROUTSOS (aus Athen)

sammelt und zusammengestellt.

München in Bayern und Alexandrien in Egypten.

1848 — 1878.

Edhe i madhi mëmëdhetar e vjershëtor Vasa pasha ka folur për Shqipëtarët në gjuhën Gjermanisht. Si e shikoni, rëndësia e kësaj gjuhe është pa peshim. Kanë të madhe nevojë të dinë këtë gjuhë, gjithë Shqipëtarët qi përpiqen për të thelluar gjuhën e tyre. (F. Konica, Albania, viti I, nr. 6, 91-92, 1897).

“M’ë bukura dhe m’ë vjetëra bibllë për Shqipëtarët” hodhi rrënjë në shpirtrat e tyre pikërisht pse iu ofronte një të kaluar historikomitologjike të krahasueshme me atë të grekëve e të latinëve. E kjo nuk ish pak!

1.4. Fryt i kërkimeve tona arkivore është dhe vepra në dorëshkrim e autorit arvanit Tasos Nerucos (1826-1892), që mban titullin *ALBANICA (Quellen zu albanesischen Studien von Dr Neroutsos (aus Athen) gesammelt und zusammengestellt. München in Bayern und Alexandrien in Egypten. 1848-1878*, e cila përbën ndoshta përpjekjen e parë për një grumbullim sistematik të burimeve relevante për albanologjinë, ndërmarrë nga një arvanitas që pat kryer studime për mjekësi e filologji në Mynih në vitet 1840.

Siç duket edhe nga titulli, vepra synon promovimin e studimeve për shqipen dhe shqiptarët, e madje fillon të hartohet ne vitet kur Nerucosi është student në Mynih, e kur, me sa duket, interesimi për shqiptarët po bëhej gjithnjë e më i madh. Vetë Nerucosi ka shënuar vitin 1878 si vit përfundimi të veprës, çka do të thotë se ai është marrë vazhdimisht dhe gjatë gjithë jetës së tij aktive me gjurmimin dhe sistemimin e lëndës albanologjike.

Janë rreth 200 faqe të shkruara me shkrim të lexueshëm, të dendur e të imtë, në gjermanisht e në disa gjuhë të tjera, përfshirë greqishten dhe latinishten, ku Nerucosi na jep në mënyrë të përmbledhur dhe shpesh me kryqëzim të dhënash, pasazhe nga vepra të autorëve antikë, bizantinë e deri të ditëve të tij, të cilët kanë rrahur në një mënyrë a në një tjetër problematikën shqiptare. Në shikim të parë, ajo është pasqyrë e gjendjes së studimeve albanologjike në mesin e shek. 19, por nuk pushon së qeni edhe sot një burim të dhënash të pasura, një pjesë e tyre të panjohura më parë. Në këtë kuptim, është i përligjur, mendojmë, botimi i saj shoqëruar edhe me ndihmesa të tjera albanologjike të autorit, shtuar këtu edhe korrespondencën e N. me G. Meyerin e ndoshta me albanologë të tjerë, si dhe dy letra interesante të tij, publikuar më 1860 në shtypin e Athinës.

Deri këtu folëm për ato çka njohim dhe mbajmë në duar nga vepra e Nerucosit. Ndërkaq, disponojmë të dhëna për ekzistencën e dorëshkrimit të

një Fjalori shqip-gjermanisht të Nerucosit, e madje në dorëshkrimin e *Quellen...* është përfshirë, nuk dihet se si, edhe një fletë me vetëm dy fjalë shqip me shpjegimet gjermanisht, marrë prej këtij fjalori. Nga leximi edhe vetëm i këtyre dy lemave bie në sy prirja e Nerucosit për një vështrim krahasues të gjuhëve, gjë që do të thotë se ai iu referohet edhe gjuhëve të tjera, si p.sh. frëngjishtja. Ka gjasa që dorëshkrimi i Fjalorit, nëse nuk është zhdukur, të ndodhet diku në Athinë a në Aleksandri, sepse ka të dhëna që N. ia dorëzoi bibliotekën e vet të pasur Bibliotekës së Patriarkanës së Aleksandrisë, dhe se, vite më vonë, një i afërm i tij i dorëzoi Bibliotekës Nacionale të Greqisë një numër dorëshkrimesh dhe letrash të N.

Ai, siç është shkruar me të drejtë, ishte një “kozmpolit dhe patriot” dhe si i tillë kishte një vizion të vetin për kohën që jetoi dhe dallohej për gjykime shkencore dhe objektive. (Shih më tepër në Helga Neroutsos-Hartinger 1992:105-148).

1.5. Në Fondin Mitko të AQShSh kemi gjetur dy vjersha: e para i drejtohet Mitkos (“*porosinë t’a mbarova*”) dhe e dyta është një epitaf, ku Hahni cilësohet “*dielli i Shqipërisë, Kollombi i Pellazgjisë*”. Janë shkruar nga Vasil Kushta në Kajro, në shtator 1869, vitin kur Hahni është ndarë nga jeta, dhe Mitkoja ka menduar ta nderojë me disa vargje, të cilat ia ka porositur, me sa duket, mikut të vet. Dorëshkrimi i gjetur është kopje e realizuar dhe e pajisur me plotësime e shënime prej Mitkos, të cilat i kemi përkthyer në shqip duke i vendosur brenda kllapash kënddrejta. Mendojmë se vjershat janë kopjuar për t’ia dërguar dikujt (ndoshta G. Meyerit), që do të mundësonte botimin e (së paku së dytës prej) tyre.

Ποίημα

του Αλβανού Κυρίου Βασιλείου Αναστ. Κούσχα (Κούσχα)

προς τον Ευθύμιον Μήτκον

[Vjershë

e shqiptarit zotit Vasil Anast. Kushta

drejtuar Eftim Mitkosë

Thimi¹ Mitko Shqipëtar, dëgjo ç’të thotë fshatar². (ο πατριώτης [patriotië])

Kaqe munda, kaqe shkrova, porosinë t’a mbarova,

¹ αντί Ευθυμί [në vend të Eftim].

² fshati = χωρίον [fshatë, και [dheë fshatar = ο πατριώτης, ο εκ του αυτού χωρίου καταγόμενος [= patrioti, ai që është nga i njëjti fshat].

fjalët që më the, t'i nxora, kështu si më mundi dora.

Edhe u doja më mirë, po s'jam aqe i arirë (ωριμασμένος, ακμαίος [i pjekur, i arrirë])

sa për të lëvduar Hanë (αντί [në vend tëë Hanin] *që dihetë anë mb' anë*³).

Mos më qesh, ej⁴, dash Perëndinë, se ata, që shumë s'dinë,

sado të vrasin fiqirë⁵, s'bëjnë dot punë të mirë.

Këjo s'është puna ime, jo për gjësendi rëndime⁶

as për të paka mundime,

Paskëtaj dalçin të tjerë, t'i venë patridhës nderë

si Dora, e si Kamarda, që kanë gojratë t' arta (të arta).

Επιτύμβιον του αυτού προς τον μακαρίτην Γεώρ. Χαυ

εξ Ιένης της Πρωσσίας

[Epitaf i të njëjtit për të ndjerin G. Han

prej Jene të Prusisë]

I dashur i Shqypërisë, i ditur i Jermanisë, fillollogu i Prosisë, konsólli i Austrisë.

Ike, shkove edhe tinë⁷, që shkrove për Shqypërinë, të madhen shumë vivlinë.

(βιβλίον [librinë])

di e⁸, di e pa çuditur⁹, me sa nder je për të pritur, ndë shtëpi të Perëndisë¹⁰ [kai

[dheë në derën e Iraklisëe]

Ti je dielli i Shqypërisë, Kollombi i Pellazgjisë, që për ty bëhetë klishë (εκκλησία

[mbledhjeë])

ndë zemër të Shqypërisë.

³ anëmbanë = εκ του ενός άκρου μέχρι του άλλου της οικουμένης [nga njëra anë e botës deri në tjetrën].

⁴ ej = επιφώνημα [pasthirmë].

⁵ sado = όσον και αν [sado]. Εν άλλη δε περιπτώσει σημαίνει αρκούτως: οίον [Në raste të tjera ka kuptimin mjaft; p.sh.ë sado fole = αρκετά ωμίλησες [mjaft fole]. Sado lule më mundove = αρκετά μ' εβασάνισες λουλούδι μου [mjaft më mundove lulja ime]. To dhe fiqir είναι τουρκ. νους [Fjala fiqir do të thotë në turqisht mend].

⁶ rëndim = βάρυνσις, ενόχλησις [rëndim, bezdisje]. gjësend = τι, τίποτε, κάνεν' [diç, diçka, ndonjëgjë]. Ίσως γραπτέον [Ndoshta duhet shkruar] gjë-sënd.

⁷ tí, και tinë, καθώς u και unë, είτε u = εγώ. [ti, dhe tinë, sikurse u dhe unë, ose u = εγώ]

⁸ di e = ήξερέ το. [di e = dije].

⁹ pa çuditur, χωρίς να απορήσεις, να θαυμάσεις. [pa u çuditur, pa u habitur]

¹⁰ κατά λάθος, ο στίχος ούτος «nga të bijtë e Iraklisë» (Ηρακλέους) αν εγκρίνεται και υμεις τούτον τον στίχον, και αν δικαιούμεθα οι Αλβανοί, να ονομαζόμεθα απόγονοι του Ηρακλέους (είτε nga burrat të Shqypërisë). [... .. gabimisht, ky varg «nga të bijtë e Iraklisë» (Herkulit) nëse edhe ju e miratoni këtë varg, dhe nëse kemi të drejtë në shqiptarët të quhemi pasardhës të Herkulit (ose nga burrat të Shqypërisë)].

**Gzim, mall, ke për të gjetur, nga njerëzit të pavdekur, mun ndë gjë të Perëndisë
prej trimat të Pellasgjisë.**

**Skander Gjorgji kordhëtari, Pyrroa, Aleksandhr' i pari
kurorë dafinë bënë, ty mbë krye të ta vënë.** (είτε [ose] *kurorë të thurur kanë,
ndër duar për ty e mbajnë*).

Ti ke dëgjuar vërtetë, e përhapë¹¹ ato retë (véφη [retë])
që mbuloninë prej jetë, si ndonjë plaf (πέπλος [perde]) **vend të shkretë.** (έρημων).
dëftëve xhet (γένος [farë]) **të haruar, prej shumë vjete të shkuar
me të thënë, me të shkruar, me të parë e të kërkuar.**

**The për Shqypërin' e sotme, që është Pellaçgja e motme,
E njohe** (edhe) **nga njerëzia, që i dëften** (dëfton) **trimëria** (ηρωισμός [heroizmi])
Si Tasua i Jeruslimit, që shkroj vëndin të urimit,¹²

kështu filizi (κλόνος, γόνος) **i Prosisë, shkroj për xhetnë e Shqypërisë.¹³**

Tatën (ατίν, πατέρα) **të madh ne që gjëtmë, pa treguar atë mbetmë
se kemi mbi vete dhenë, që kur humbmë Skanderbenë.**

**Ty o Han, Gjergj i Prosisë, madhënimi i Jermanisë
s'mundimë sa duam vetë, të të nderojmë për jetë.**

**Presimë kohë të na vinjë, të nderojmë Shqypërinë, e të ngremë anë mb' anë
mbë agallmë** [bust] **Gjorgji Hanë.**

**Ndë Evrop, dhëntë Perndia, e të ngjafshin¹⁴ njerëzia, të shpëtonjë Shqypëria
nga mundim, nga të këqia.**

**Ndë katunt¹⁵ tënt, ndë Jenë, koskat tënde atje mbennë (mbetnë),
një jetë nishan** (σημείον Τουρκ. [shenjë turq.] **të jenë, të zbukuronjënë dhenë.**

Që nga gjithë Pellaçgja, sa lutenë njerëzia shpyrti jyt te Perëndia.

Ty, që zbritë (zrype) **mbi njerëzinë, e mbarove porosinë
i madhi zot të ndëjftë, edhe dhenë e paç të lehtë.**

Ev Καίρω, την 7/19 Σβρίου, 1869.

[Në Kajro, më 7/19 shtator, 1869]

η υπογραφή Βασίλειος Αναστ. Κούστας

[nënshkrimi Vasil Anast. Kushta]

¹¹ përhap = διασπίζω, διαλύω, σκορπίζω. [përshkoj, tres, shpërndaj].

¹² uronj, ελληνιστί, αρόω, ευλογώ, εύχομαι. [greqisht] bekoj, uroj].

¹³ dshet = φυλή, γένος. [farë, raceë]


¹⁴ të ngjafshinë = να σε ομοιάσουν, μιμηθούν. [të të ngjajnë, të të imitojnë].

¹⁵ katunt = χωρίον, είτε fshat. Δεν γνωρίζω πώς να ονομάσωμεν Αλβανιστί την πόλιν.

Ημείς λέγομε Τουρκ. kasaba, οι Γέγοι shehir. [katunt = χωρίον, ose fshat. Nuk di si ta quajmë shqip qytetin. Ne themi turq. kasaba, gegët shehir].

Σας προσκυνώ Ε. Μήτκος

[Ju falem E. Mitkoë



1.6. Në po të njëjtin fond të AQShSh gjetëm një dorëshkrim të Mitkos, ku ky ka kopjuar disa materiale që ia ka dërguar P. Kupitori. Siç kuptohet, ato janë këngë gege të shkëputura nga vëllimi II i veprës së Hahnit dhe të përshtatura në të folmen e Hidrës nga Kupitori, shoqëruar me përkthimin greqisht. Mendojmë se ato do të përfshiheshin në vëllimin II të “Bletës Shqiptare” dhe se Mitkoja i ka kopjuar për t’ia dërguar G. Meyerit me shpresën se do të gjenin rrugën e botimit. Njëra syresh, e dyta në dsh e Mitkos, u botua nga Meyerit në vëllimin V të veprës së tij “Albanesische Studien” (f. 64) dhe është ribotuar para disa vitesh nga T. Jochalasi (Jochalasi 2006: 415). Të tjerat botohen këtu, me sa dimë, për të parën herë. Duke shtuar se është një nga rastet e hershme të një përkthimi ndërdialektor të shqipes, dhe mbase i pari nga gegërishtja në arvanitisht, shënojmë se edhe ky fakt që tregon jehonën dhe ndikimin e Hahnit në letrat shqiptare. Krahas transkriptimit të dorëshkrimit të Mitkos dhe përkthimit të shënime-

ve sqaruese të tij, kemi vendosur edhe tekstet gegërisht, sikurse i ka botuar Hahni. Vlerësimin për nivelin e përkthimit po e lëmë në dorë të lexuesit.

Άσματα παραφρασθέντα

εκ των γεγκικών ασμάτων του Hahn

εις την αλβανικήν διάλεκτον των εν

Ελλάδι Αλβανών και μάλιστα την

υδραϊκήν

υπό Παναγιώτου Δ. Κουπιτώρη του

εξ Ύδρας

Παράφρασις.


[Këngë të marra prej këngëve gegërisht të Hahnit dhe të perifrazuara në të folmet shqip të shqiptarëve të Greqisë, më konkretisht në të folmen e Hidrës, me autor Panajot Dh. Kupitorin prej Hidre Perifrazimë



A

(Hahn, σελ. 144, άσμα 5^{ov} [f. 144, kënga V])

Ç'e-keq' e madhe më gjeti sot,
 nani ndë veitërat të pleqerisë,
 s'jam më i-zoti të kla me lot,
 undrë si veitërat' e-djelmërisë.
 Gjithë të dhëmbura m'ishtë kurmi,
 e mora mbavë gjithë dunjanë,
 po nëkë çova¹⁶ gjakún shërim.
 Nani më thanë Sejdin Aganë,
 po çë patira e po patir¹⁷,
 miqt' e mij hale nëkë m'a dinë,
 çë aj-një egjëf¹⁸ më termenis!
 Lotë rëjodhë, muarrë gjinë.



B

(H. σελ. 145, άσμα 7^{ov} [f. 144, kënga VIIë)

M'u-helmua mikia kaqë,
 sa me mua s-do më të flasë
 ç'i kam bënë vav¹⁹ u i-mjeri?

¹⁶ Avτί του καθ' ημάς [në vend të tonësë gjeç].

¹⁷ Avτί [në vend të] pësova e po pësonj.

¹⁸ engjell.

¹⁹ Avτί [në vend të] vallë.

Se s' e dua, kurrë s' i thashë;
 Po ndë thoj ndo-një, ndë më pyen,
 Si njer' nan me mikenë shkove,
 Bë o i bënë për tënë zonë,
 Se s' i prisha zëmrenë kurrë.

7.

*M' ουιδενοούα τυραζέρι **
E με μου σ' δο τε φλιάσε;
T'σ' ι χαμ βάμε ούνα ι μjέρι?
*T'σάρε σ' ι γjέττα σεβδάσε **
Do τε να πύσιν ε δο τε να θύνε:
Kjυσ' κε άκούμε με δυλβέρι?
Be do τ' ι βαύj περ τεv' ζύνε.
Φαj σ' ι χαμ πάσε ούνα ι μjέρι!

C

(H. σελ. 147, άσμα 3^{ov} [f. 144, kënga IIIë)

Mora maletë, vakatë²⁰ shkova,

Fati kaqë m' avargu²¹ po vete.

Ronj i-mjeri, po ronj tuke klarë,

Sytë kurrë s' m' u-ternë ka lottë;

mentë gjithë m' a ngriti hjidhia,

marrësyrë më suaf²² të mjerit;

m' ishtë zëmëra gjithë si eshkë,

çë u-çel e të shuarë s-ka më.

3.

Móra μάλλjετ' ε φούσετ'.
Βάφτι ιμ' σα βjεν πο λjαργόν.
Mjέρι ουν' τουx ε κjάρε
Πρέιγ σύσε γjαx πο με κουλόν.
Φιράκου μεντ να ι νγρίττι
E να ζουν με τε μαρούμε.
Ζέμερα ιμε σι άσx κjιβρίτι
Θουνδέx ε σ' xa τε άούμε.

²⁰ llakatë.


²¹ Avri [në vend tëë largu.

²² suall.

Ç

(H. σελ. 149, άσμα 11^{ov} [f. 149, kënga XIë)

Si do e-dashmea, si do ti,
 mos gjeq çë-do, çë të thonë kosmi,
 se kosmi thonë një mil' e dy,
 për të na ndanjë mua dhe ty.
 Po kush të vihëtë të na ndanjë,
 mos u-pushoftë më ka të klajë;
 e shyf²³ pushon dhe herë ga herë,
 aj mos pushoftë deimër' e verë.



1.7. Ndodhemi para një fakti interesant: thujse të gjithë autorët e huaj që u morën me albanologji kanë patur në krah e kanë bashkëpunuar me shqiptarë a njohës të shqipes, duke këmbyer shpesh mes tyre rolet e nxënësit e të mësuesit. Thunmann-i dhe Kostë Xhehani-Voskopojari, Leake-u dhe Efstrat Vithkuqari, Pouqeville-i dhe Marko Boçari, Hahn-i dhe Kostandin Kristoforidhi e Apostol Panajoti, Reinhold-i e Vasil Saqellari, Meyer-i dhe Efthim Mitkoja e Tasos Nerucosi, Pedersen i Stefan Konomi e kështu me radhë.

Meqenëse në 1.0 bë më fjalë për një letër të Kristoforidhit për A.

²³ shiu.

Armodhin, ku përmendet si bashkëpunëtor i Hahnit *një tjetër [njohës] i toskërishtes nga anët e Gjirokastrës*, na duket e udhës të sjellim këtu sa shkruan historiani dhe savanti grek Panajotis Aravantinos posaçërisht për Apostol Panajotin – Labovitin, por edhe për Hahnin. Në pjesën III të veprës “Përshkrim i Epirit”, hartuar pas vitit 1860 dhe botuar më 1984, tek bën fjalë për ndarjen fisnore të shqiptarëve, Aravantinosi ka një shënim:

Meqenëse nuk e njohim gjermanishten, nuk njohim edhe çfarë thotë Z. Hahn rreth ndarjeve të Shqiptarëve në fara e fise, dhe gjithçka tjetër që përshkruan dhe përmend rreth tyre në librin e vet etnologjik “Studime Shqiptare”, të lauruar në Gjermani. Pa vënë në dyshim mençurinë dhe njohuritë arkeologjike të këtij burri të ditur (i cili brenda dy vjetësh arriti të zotërojë gjuhën shqipe) vërejmë dhe bëjmë të njohur këtu, për hir të së vërtetës, se në suksesin e librit të lartpërmendur ka kontribuar mjaft epirotasi Z. Apostol Laboviti, savant dhe i dhënë pas historisë, ushtrues i kirurgjisë në Janinë, i cili regjistroi me shumë zell doket, elegjitë, paragjykimet dhe bestytnitë e shqiptarëve, si dhe gjithçka tjetër që i kërkoi autori për t’u informuar, ia dorëzoi ato me shkrim, por mbajti edhe një kopje, të cilën e zgjeroi duke shtuar sa mblodhi në vijim, d.m.th. vrojtime gjuhësore më të pasura se të mëparshmet, dhe këngë kombëtare [shqiptare] gjithfarëshe, të cilat ka ndërmend t’i botojë. (Aravantinos 1984: III 359-360).

Kjo e dhënë, si dhe rasti Nerucos i përmendur më parë, na jep dorë të theksojmë se puna kërkimore në arkivat do vazhduar më tej. Për të dhënë vetëm një shembull nga çka është shkruar në gjermanisht, H. Pedersen, në veprën e tij “Albanesische Texte mit Glossar” (1895), thotë se mblodhi 35 përralla shqiptare, prej të cilave botoi vetëm 12. Cili ka qenë vallë fati i të tjerave?

II. Kuadri ballkanik

Kur flasim për ndihmesat e vyera albanologjike shkruar në gjuhën gjermane, jemi të ndërgjegjshëm se fort rrallë mund të gjenden studime të hartuara mirëfilli për shqipen e shqiptarët, pa iu hedhur një sy, herë të përcipte e herë të thellë, gjuhëve dhe historive të popujve fqinjë. Me kalimin e kohës është krijuar një traditë -dhe një domosdoshmëri- e kundrimit të dukurive në kuadër ballkanik e ndërdisiplinor. Fjalori Etimologjik i Shqipes i G. Meyerit (1891), punimi për elementet greke të lashta të shqipes i A.

Thumbit (1909), studimet etimologjike e kulturore-historike të N. Joklit etj. janë shembuj të suksesshëm të qasjes ballkanike e më të gjerë të fenomeneve, e cila ndër shqiptarë gjeti një vazhdues dhe lëvrues të denjë tek i papërsëritshmi Eqrem Çabej, e sidomos tek opusi i tij etimologjik.

Por, sa njihet dhe si shfrytëzohet sot kjo trashëgimi e pasur dhe tradita e pandërprerë e deritashme e saj, në kuadër ballkanik? Para se të shtjelloj disa ide relevante, të më lejohet të përgëzoj nismën e çmuar të kolegëve të ASHAK për ribotimin e origjinalit dhe përkthimin në shqip të veprave bazë të albanologji-ballkanologjisë, me hallkën më të fundit të këtij gjerdani, veprën “Studime Historiko-Krahasuese për Gjuhën Shqipe” të N. Joklit (Prishtinë, 2017).

Do të kufizohem me një numër shembujsh dhe veprash nga fusha e kontakteve të shoqishoqme të shqipes me greqishten për të vërejtur se deri më sot janë përdorur pak punimet e shkruara gjermanisht të Andriotis-it, Tzitzilis-it, Rohlfis-it, etj.

Më konkretisht, në radhët e gjuhëtarëve shqiptarë njihet pak vepra *Lexikon der Archaismen in neugriechischen Dialekten* (N. Andriotis, Vjenë 1974) e cila, me qëmtimin e mijëra fjalëve a kuptimeve të greqishtes së vjetër që arritën të mbijetojnë si relike në dialektet e greqishtes së re, provon bindshëm fillin e pandërprerë historik të greqishtes e të folësve të saj dhe i dobëson “argumentet” e ithtarëve të neo-fallmerajerizmit.

Po kështu, shkrimi “*Zur Problematik der griechischen Lehnwörter im Albanischen*” (Chr. Tzitzilis, 1997), ku bëhet një sintezë e arritjeve dhe e problemeve të studimit të kontakteve leksikore të greqishtes me shqipen dhe evidentohet, veç të tjerash, një shtresë huazimesh të greqishtes mesjetare në të folmet shqip të Myzeqesë, nuk ka zënë vendin e merituar në punime relevante të kolegëve shqiptarë.

Dy titujt e mësipërm, por edhe një sërë studimesh e botimesh të gjuhëtarit gjerman G. Rohlfis për praninë dhe vazhdimësinë historike të të folmeve greqisht të Magna Grecias (*Lexicon Graecanicum Italiae inferioris: Etymologisches Wörterbuch der Unteritalienischen Gräzität*, 1964, *Italogriechische Sprichwörter in linguistischer Konfrontation mit neugriechischen Dialekten*, 1971, etj.) ndihmojnë për një qasje sa më objektive e shkencore të çështjeve të debatueshme, sikurse është prania e hershme apo

e vonë e enklavave të greqishtes në Shqipërinë e Jugut.

Për mendimin tonë, po të mbaheshin parasysh të dhënat e punimeve të Rohlfisit e po të zbatohet metodologjia e propozuar nga Çabej në punimin me titull “*Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiakë*” (SGJ V 38-47), çështja në fjalë do të kishte marrë prej kohësh udhën e zgjidhjes.

Kur flitet për raste popullsish ardhëse (megjithë relativitetin e këtij termi), aty gjërat duhen peshuar mirë e paskëtaj të arrihet në përfundime për vendorigjinën e tyre. Çabej thekson ndër të tjera se

“... shtrohet detyra që të vlerësohen në mënyrë kritike të dhënat e etnografisë, të traditës gojore, po sidomos dhe të historisë, të gjuhës dhe të emrave vetiAKE në kuptimin më të hapët të kësaj fjale, dhe këto të kombinohen midis tyre. Në studimin e materialit është me rëndësi në këtë mes, që të dallohet ajo që është specifike nga e përgjithshmja, dhe që ajo të merret në shqyrtim në një shkallë të veçantë e më të gjerë, si një element që çon peshë në problemin e prejardhjes” (SGJ V 39).

Pa u kryer një studim me prerogativat e mësipërme, pohimet a mohimet kategorike të artikuluara sërish kohëve të fundit (Xhufi 2016) vetëm se e ndërlikojnë problemin, por nuk e zgjidhin atë. “Ekskluziviteti” i mëtuar territorial bie ndesh me kompleksitetin gjuhësor dhe kulturor të zoneve në fjalë. Leximi dhe përdorimi i njëanshëm i dokumenteve të një periudhe të caktuar historike dhe anashkalimi i të dhënave gjuhësore e toponimike të një spektri më të thellë kohor e më të gjerë hapësinor (Qirjazi 2011, Kyriazis 2017) nuk shkojnë pas frymës së metodologjisë çabejane (e gjermane). Në fund të fundit, mëtimi i “autoktonisë” së njëjës palë në një territor të caktuar nuk e përjashton praninë e hershme aty edhe të palës tjetër.

BIBLIOGRAFI

- Andriotis, N. 1974. Lexikon der Archaismen in neugriechischen Dialekten. Wien: Verlag der ÖAW.
- Aravantinos, 1894 => Αραβαντινός, Π. 1984. Περιγραφή της Ηπειρού εις μέρη τρία. Ιωάννινα: EHM.
- Camarda, D. 1864. Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese. Livorno: Successore di Egisto Vignozzi e Ca.
- Cabej, E. 1976-2014. Studime etimologjike në fushë të shqipës I-VII. Tiranë: Akademia e Shkencave.
- Cabej, E. 1976-1986. Studime gjuhësore I-VII. Prishtinë: Rilindja.
- D'Istria, D. 1866. La Nationalité albanaise d'après les chants populaires. Revue des Deux Mondes T.63.
https://fr.wikisource.org/wiki/Les_Albanais_des_deux_c%C3%B4t%C3%A9s_de_l%27Adriatique_et_la_nationalit%C3%A9_albanaise_d%27apr%C3%A8s_les_chants_populaires
- D'Istria, D. 1867. Fylétia e Arbenoré prëj kanekate laoshima, enkethyeme ne shkjipe perëi D. C., Ne Livurne.
- Hahn, J.G. 1854. Albanesische Studien I-III. Jena: Verlag von Friedrich Manke.
- Jochalas 2006 => Γιοχάλας, Τ. 2006. Ύδρα –Λησμονημένη γλώσσα, τ. Β', Αθήνα: Εκδόσεις Πατάκη.
- Jokl, N. 2017. Studime Historiko-Krahasuese për Gjuhën Shqipe. Prishtinë: ASHAK.
- Kupitor 1879 => Κουπιτώρης, Π. 1879. Αλβανικά Μελέτα. Πραγματεία ιστορική και φιλολογική περί της γλώσσης και του έθνους των Αλβανών. Εν Αθήναις εκ του Τυπογραφείου του Μέλλοντος.
- Kupitor 2006 => Κουπιτώρης, Π. 2006. Λεξικόν ελληναλβανικών επίτομον εκ της ελληνικής εις την αλβανικήν διάλεκτον των εν Ελλάδι Αλβανών, μάλιστα την των Ύδραϊων, μετά παραθέσεως και των άλλων διαλέκτων, τσσκικής, γκεγκικής και της των εν Ιταλία και Σικελία Αλβανών. Νē Τ. Γιοχάλας, Ύδρα –Λησμονημένη γλώσσα, τ. Β', Αθήνα: Εκδόσεις Πατάκη, 2006.
- KYRIAZIS, D. 2017. "LEXICAL AND ONOMASIOLOGICAL CONCORDANCES AMONG GREEK DIALECTS OF MAGNA GRECIA, IONIAN ISLANDS, EPIRUS AND SOUTH ALBANIA", NĒ VĚLLIMIN ME KUMTESAT E KONFERENCËS NDËRKOMBËTARE ME TEMË "BALKAN DIALECTOLOGY AND 'BALKAN' ENCLAVES IN ITALY", VENECE, 26-28.11.2015 (FORTH-COMING).
- Meyer, G. 1891. Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache. Strassburg: Verlag von Karl J. Trübner.
- Meyer, G. Albanesische Studien, I 1883, II 1884, III 1892, IV 1895, V 1896, Wien.
- Meyer, G. Neugriechische Studien, I 1894, II 1894, III 1895, IV 1895, Wien.

- Mitko, Th. 1878. Ἀλβανικὴ Μέλισσα (Βηλιέττα Σζικωπητάρε) Σύγγραμμα Ἀλβανο-Ἑλληνικόν, συνταχθὲν ὑπὸ Ἐ. Μήτικου, ἐν Ἀλεξανδρείᾳ.
- Mitko, Th. 2014. Fjalëtore Shqip-Gërqisht/Gërqisht-Shqip & Ndhimesa të tjera leksikografike (përgatitja e dorëshkrimeve për botim dhe sudimi hyrës nga Dhori Q. Qirjazi). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Neroutsos-Harteringer, H. 1992. "Der Briefwechsel zwischen Tassos Neroutsos Bey und Gustav Meyer. Ein Beitrag zur Geschichte der Albanologie". Südost-Forschungen 51, 105-148.
- Pedersen, H. 1895. Albanesische Texte mit Glossar. Leipzig.
- Qirjazi, Dh. 2011. "Rreth marrëdhënieve të së folmes greke të Himarës me të folmet e tjera të greqishtes së re", Albanohellenica IV, 39-52.
- Qirjazi, 2015. "Tri dokumente për shqipen dhe shqiptarët, të viteve 1850", në B.Demiraj, M.Mandala, Sh.Sinani (ed.) Studime në nderim të prof. Francesco Altmarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes. Tiranë.
- Rohlf's, G. 1964. Lexicon Graecanicum Italiae inferioris: Etymologisches Wörterbuch der Unteritalienischen Gräzität. Tübingen.
- Rohlf's, G. 1971. Italogriechische Sprichwörter in linguistischer Konfrontation mit neugriechischen Dialekten.
- Thumb, A. 1909. "Altgriechische Elemente des Albanesischen". Indogermanische Forschungen 26.
- Tzitzilis, Chr. 1997. "Zur Problematik der griechischen Lehnwörter im Albanischen". Zeitschrift für Balkanologie 33/2: 200-214.
- Xhufi, P. 2016. Arbërit e Jonit. Tiranë: Onufri.


Gerd-Dieter NEHRING, (HU Berlin)

MBI STRUKTURËN SEMANTIKE DHE FORMALE FJALËFORMIMI TË MBIEMRAVE ME DY DHE MË SHUMË TEMA NË SHQIPEN STANDARDE

I.Shtjellimet tona paraqesin dhe hedhin për diskutim pika kyçe të analizës nga viti 1983 mbi strukturën semantike dhe formale të fjalëformimit të mbiemrave me dy dhe më shumë tema në gjuhën standarde shqipe. Në veçanti përqendrohemi te metodat teorike të analizës. Punimi i tërësishëm është vetëm pak i përhapur dhe pak i njohur në trevat shqiptare dhe më gjerë, prandaj meriton të përmendet edhe në mes të punimeve të përpiluara në vendet ku flitet gjermanishtja, si rezultat i bashkëpunimit shqiptar- (kosovar-)gjerman dhe si një kontribut modest për leksikologjinë dhe translatalogjinë e shqipes dhe të gjermanishtes. Dobia e paraqitjes së punimit vjen jo vetëm nga krahasimi i zhvillimeve konkrete gjuhësore sot dhe të kohës, kur u përpilua, por edhe në lidhje me mënyrat dhe mjetet e përdorura gjatë analizës, që, sipas mendimit tonë, ende nuk kanë humbur vlerë. Studimet e përmendura e pasqyrojnë gjendjen e zhvillimit të gjuhës standarde shqipe në fund të viteve 1970 dhe në fillim të viteve 1980. Prandaj janë edhe një dëshmitar i pranimit dhe i përhapjes së standardit shqip vetëm pak pas Kongresit të Drejtshkrimnit. Ato e mbajnë titullin e plotë “Zur formalen und semantischen Wortbildungsstruktur zwei- und mehrstämmiger Adjektive der albanischen Sprache der Gegenwart”. Punimi u krye përfundimisht në dy vëllime. Ai përmban krahas me analizën e mbiemrave gjithashtu një listë me fjalët e përgjithshme dhe të gjuhës profesionale prej 132 faqesh si dhe përmbledhtazi një pasqyrë gjashtëmbëdhjetëfaqëshe mbi metodat e analizës dhe rezultatet e saj kryesore.¹



¹ Khs.: Nehring, Gerd-Dieter: Zur semantischen und formalen Wortbildungsstruktur zwei- und mehrstämmiger Adjektive der albanischen Sprache der Gegenwart (mit einem



J.Objekti i analizës janë 3679 mbiemra me dy a më shumë tema dhe ekuivalentet e tyre në gjuhën gjermane. Mbiemrat e analizuar kanë këto tipare:

1. Ata përmbajnë si kombinim i veçantë mbiemëror më së paku 2 gjymtyrë që u përgjigjen në gjuhën e sotme fjalëve me kuptim të plotë.

2. Raportet e tyre me objektet që karakterizojnë nuk shprehen formalisht, as marrëdhëniet mes temave të veçanta të tyre.

3. Mbiemrat paraqesin në këtë mënyrë një imazh intersubjektiv, shoqërisht të determinuar me konotacione e ngjyrosje stilistike të mundshme. Ata përdoren shpesh në gjuhën e shkruar, ndër të tjera në kulturë, fusha të ndryshme të shkencave (shpesh në shkencat sociale, në bujqësi e në botanikë), vetëm rrallë janë jonormativë.

KHS.: AKULLTHYES, BOJËHIRI, FJALËSHUMË, DORËSHTRËNGUAR, KATËRDHËMBËZUAR, KUPTIMPLOTË, TREATOMIK, THEKË-THEKË, ZEMËRGUR

4. Në strukturë të kompozimeve mund të jenë, siç dihet përgjithësisht, morfema të ndryshme, edhe me kuptim jo të plotë si dhe të shkurtuara.

KHS.: BARDHEZI, IDEOESTETIK, POLITIKO-EKONOMIK, SHIU-SHPËRNDARËS, I SHUMËLLOJSHËM

5. Struktura morfologjike e mbiemrave të analizuar nuk posedon si

allgemein- und fachsprachlichen Wörterverzeichnis). – Diss., Berlin 1983 (Masch.). – 417 S. [Mbi strukturën semantike dhe formale fjalëformimi të mbiemrave me dy dhe më shumë tema në shqipen e sotme.... ‘me një listë fjalësh të përgjithshme dhe të gjuhës profesionale ‘ë. Sh.: Biblioteka Kombëtare nr. i regjistrimit: 000081267, HOL BKK60-000102396 8 KV DD-988 - KV Koleksioni i Disertacioneve.

rregull morfema që janë tipike për paradigmen e emrave, përjashtime relativisht të rralla janë formime të tipit:

KHS.: KOKËDERR- KOKËDERRA (pl.), BOJËHIRI

6. Kuptimet morfologjike të mbiemrave të analizës shprehen në mënyrë të ndryshme. Khs.: VENDET E PRAPAMBETURA, VALLE TË SHUMËLLOJTA, NËNA/BABA HALLESHUMË, NDËRTIME SHOQËRORE-KULTURORE, I VERDHË-MALTË

7. Mbiemrat e analizës kanë një rend të ngurtë të gjymtyrëve, njësia e tyre konceptionale reflektohet në nivelin drejtshkrimor me të shkruarit bashkë ose me vizë lidhëse.

Jashtë analizës mbetën formime, të cilat nga shqipja e sotme nuk motivohen Semantikisht, si: DELEDASH ‘*zweigeschlechtlich*’, VESH-SHPUAR ‘*aufgeweckt*’, BARKGJERË (*zemërgjerë*), DITËSHKURTËR (*jetëshkurtër*), KOKËTUL (*kokëtrashë*), SLLAVOMADH ‘*panslawisch*’.

Mbiemrat me dy e më shumë tema të analizës janë marrë prej 43 burimeve të ndryshme. Këto janë: në radhë të parë fjalorë të përgjithshëm një- dhe dygjuhësh si dhe gramatika, përshkrime gjuhësore nga vitet 1974 - 1981; përveç kësaj 15 fjalorë/lista përmbledhëse të terminologjisë të viteve 1969 - 1973; letërsia artistike e shoqërore (d.m.th. Manifesti; autorë të ndryshëm: si F. Gjata, I. Kadare, F. Noli, L. Pogradeci, R. Qosja, M. Raifi; poezi shqipe); gazetat: Rilindja 1979, Zëri i Popullit 1979; një punim diplome nga vitit 1982.²

Analiza e strukturës formale dhe semantike e mbiemrave synonte, që të gjendet, me sa ishte e mundshme, përbërja fjalëformuese formale dhe semantike e kompozitave mbiemërore të shqipes në mënyrë të vërtetueshme. Krahas me të duhej të paraqiteshin veçoritë thelbësore fjalëformuese të mbiemrave në shqyrtim me një numër të rrokshëm strukturash (modelesh, tipash), të cilat mund të shërbejnë si bazë ndihme për ta që mësojnë shqipen si gjuhë të huaj. Analiza duhej t’i kontribuojë përveç kësaj përshkrimit të mëtejshëm të shqipes si dhe përpilimit të fjalorëve.

² Walter, H.: Untersuchung zur Bildung von Farbennennungen in der albanischen Sprache der Gegenwart (‘Gjumime mbi formimin e emërtimeve të ngjyrave në gjuhën e sotme shqipe’). Masch. Humb.-Univ. Berlin 1982. Khs. më konkretisht f. 271-272.

K.Bazat teorike të punimit lidhen në shumicën e rasteve me njohuri linguistike nga 4 disiplina, d.m.th. kanë të bëjnë me themele nga teoria e fjalëformimit, me parafrazim si mjet të gjetjes së strukturës fjalëformuese të mbiemrave, me modelet e strukturës morfematike fjalëformimi si dhe me tiparet semantike të fjalëformimit. Përveç gramatikave dhe përshkrimeve gjuhësore të shqipes dhe të gramatikave e librave mësimi të gjuhëve gjermane, ruse dhe serbokroate të asaj kohe zgjedhja e metodave bazohet në radhë të parë në punimet e fjalëformimit të germanistëve: Fleischer (1973, 1974), Henzen (1965), Motsch (1970), të anglicistit Hansen (1968, 1980) dhe të sllavistëve: Dokulil (1968), E. Günther (1978), Kubrjakova (1965), Lopatin (1977), Ohnheiser (1981), Poticha (1970), Uluchanow (1977), Stepanova (1967, 1968), Zemskaja (1973); Dejanova, Perniska (1980, bullgaristë); Nikoliq (1973, B. Nikolić, shkolla e Beliqit), M. Rozwadowski (1904) dhe mbi disertacionet e ndryshme të rusistikës dhe të germanistikës etj.³

Ashtu u përkasin themelet nga teoria e fjalëformimit, mbi të cilat mbështetet analiza, njohurive të përgjithshme të fushës së fjalëformimit, si nocioneve të temës, të formantit, të kuptimit të fjalëformimit, të marrëdhënies të drejtpërdrejta të motivimit etj. Nocioni i fundit ka, siç dimë, jo vetëm një rëndësi themelore për gjetjen e strukturave fjalëformuese, por posedon edhe shumë përkime me IC-analizën (immediate constituent analysis). Pra nënkuptojmë në analizë me nocionin e marrëdhënies të drejtpërdrejta të motivimit këto marrëdhëniet e mbiemrave me njësitë e tjera të leksikut të shqipes, të cilat janë formalisht dhe semantikisht më të afërta me mbiemrat e analizuar. Këto njësi të fjalorit të shqipes mund të jenë:

1.morfema të lira si te formimet e tipit DASH/A/MIR, HEKUR-UDH/OR, MIEKËR/CIAP, MISH/ NGRËNË/S;

2.togfjalësja si: *pa ndonjë të metë* (i pandonjë të metë), *shkel e shko* (SHKELESHKO);

³ Sh. më detajuar faqet e punimit 277-284. Disertacionet janë përpiluar nga: E. Kretschmer (1978 mbi emra të përbërë), E. Lange (1972 mbi mbiemra të përbërë), N. Lehmann (1978 mbi mbiemra me prapashtesa), I. Ohnheiser (1981 mbi konfrontim gjuhësor), W. Schade (1967 mbi binomina), H.-J. Siebert (1968 mbi mbiemra të përbërë), M. Stelmacher (1977 mbi mbiemra që shprehin ngjashmëri); H. Jung (1980, punimi i diplomës mbi binomina).

3. emërtime komplekse, shpesh frazeologjike të formës: *me buzë të plasur* (BUZËPLASUR), *i është prishur gjaku* (GJAKPRISHUR), *katërfish pendor* (KATËRPENDOR).

Këto njësi e paraqesin bazën e motivimit të mbiemrave përkatës. Temat e tyre paraqiten në përbërjen e mbiemrave, sipas themeleve teorike të përmendura, në forma të ndryshme, d.m.th. si: forma e fjalës - temë/fjalë ‘BISHT/PËRJETË’, ‘DEMOKRATIK/O- BORGJEZ’; forma e fjalës/fjalë e shkurtuar ‘FLOKË ZI’, FEUDO-BORGJEZ; temë ‘HEKUR-UDH/or’ etj.

Parafrazimi i mbiemrave me dy-dhe më shumë tema paraqet në analizë një mjet objektiv ndihme për gjetjen e bazës së motivimit, d.m.th. të marrëdhënieve të drejtpërdrejta motivimi të mbiemrave dhe me të për caktimin e strukturës fjalëformuese të tyre. Kjo metodë nënkupton se:

1. mbiemrat transferohen në parafraza, d.m.th. në konstruksione sintaksore (togfjalësha, fjali), me të cilat kanë formalisht dhe semantikisht lidhje më të afërta, ato i përmbajnë temat e mbiemrave.

2. Nëpërmjet parafrazimit shtohen fjalë të (pa)mëvetësishme, varësisht nga kuptimi leksikor i mbiemrave, i cili duhet të ruhet maksimalisht.

Khs.: mjekërcjap => ME mjekrën SI TË cjamin; zemërprishur => ME zemër TË prishur; dvlugët => ME dy FAQE TË lugta; gjakprishur => QË I ËSHTË prishur gjaku; shqipfolës => QË flet shqipen SI GJUHË AMTARE, ideopolitik => politik E ideologjik; varrpagjetur => QË NUK I ËSHTË gjetur varri;⁴

3. Mbiemra me polisemi transferohen në konstruksione të ndryshme. Khs.: krahëprerë => ME krahë

TË prerë (p.sh. një insekt) => QË I JANË prerë PENDËT e krahëve (pëllumba);

4. Parakushti i parafrazimit të mbiemrave të analizuar me dy dhe më shumë tema është dituria e fjalorit intersubjektiv të bashkësisë gjuhësore të shqipes dhe me të njohja e objekteve, të cilat i karakterizojnë mbiemrat

⁴ *por: dyvëllimësh => ME/NË dy vëllime, PREJ dy vëllimesh (në disa raste, sidomos te mbiemra marrëdhëniorë ekzistojnë dy a më shumë mundësi të parafrazimit).*

përkatës.

5. Prandaj u kontrollua dhe u vërtetua drejtësia e të gjitha parafrazimeve në analizë nga folësit e gjuhës amtare shqipe, veçanërisht falë profesorit Isa Bajçinca mes intervistës.

Në bazë të parafrazimeve të shumëfishta u përpiluan në një hap tjetër të analizës modelet e parafrazimit fjalëformues. Ato paraqesin një abstraktim nga parafrazat e veçanta për t'i klasifikuar dhe përgjithësuar. Ato shërbejnë si bazë më konkrete për përcaktimin të strukturës fjalëformuese të mbiemrave me dy a më shumë tema. Mbiemrat, të cilët i përkasin një modeli të parafrazimit fjalëformues, kanë këto tipare:

a) temat fjalëformuese të tyre u përkasin pjesëve të njëjta të ligjëratës dhe kanë një rend të ngurtë të gjymtyrëve të tyre.

b) fjalët e pamëvetësishme që shtohen në parafraza të mbiemrave, janë të njëjta, lekseme të shtuara i përkasin pjesës së njëjtë të ligjëratës.

Në disa raste modelet e parafrazimit fjalëformues përmbajnë një numër të rrokshëm simbolesh të veçanta, me të cilat përgjithësohen dukuritë semantike. Khs.:

SHEMBUJ TË SIMBOLEVE QË PËRDOREN NË MODELET E PARAFRAZIMIT FJALËFORMUES⁵

emërton/tregon

marrëdhënie komparative

marrëdhënie kopulative -

determinuar (lidhur me temat e determinuar/të përcaktuar

determinues (lidhur me temat determinuese/përcaktuese

emër për një frymor, send, dukuri etj.

kuptim figurativ

folje për një veprim/gjendje etj. në prezent (kohën e tashme)

folje për një veprim/gjendje etj. në perfekt (kohën e kryer)

⁵ Ata lidhen me të gjitha modelet e kumesës.

⁶ “ds” shënohet në punimin gjerman me “dd” për “determinierend”; “dr” shënohet në punimin gjerman me “dt” për “determiniert”.

lidhëz (konjunksion)
 leksemë që shtohet në parafrazë
 marrëdhënie të vendit (locus), të drejtimit
 përbërja materiale e një sendi
 mbiemër
 nyjë
 emërtim (nomen si agens) që kryen një veprim
 numëror
 objekti që i referohet një veprim në mënyrë direkte
 objekti që i referohet një veprim në mënyrë indirekte
 parafrjalë (prepozicion)
 temën e parë fjalëformuese të mbiemrave
 temën e dytë fjalëformuese (.... 4) të mbiemrave
 marrëdhënie partitive
 përemër
 pjesore (particip)
 në lidhje me (për kuptime marrëdhënore)
 marrëdhënie posesive
 sufiks (prapashtesë)
 etj.

*SHEMBUJ PËR PARAFRAZA DHE MODELE TË PARAFRAZIMIT
 FJALËFORMUES*

Mbiemër	parafrazë	modele të parafrazimit fjalëformues
• flokëzi vullnetmirë	me flokë të zezë me vullnet të mirë	P _{poss} p1 (em dr) p2 (mbi ds)
• socialist-komunist tragjikomik	socialist e komunist tragjik e komik	p1 (mbi) K _{cop} p2(mbi)
• dyjavësh trefazësh	me/prej/për dy javë (sh) me/prej/në tri javë (sh)	pert. ad: p1 (num _{ds}) p2 (em _{dr})

• i pandonjëtmjetë	pa ndonjë të mjetë	P- poss p1 (përemds) p2 (emdr)
• i kaltër-qielli	i, e kaltër si qielli	p1 (mbidr) K _{comp} p2 (emds)
• çudibërës acideduruese	që bën çudira që duron acide	N _{ag} p2 (folprez) p1 (emobj di)
• gushëlëshuar mustaqerruar	që ka lëshar gushë që i ka rruar mustaqet	N _{ag} p2 (folperf) p1 (emobj di)

Modelimi i strukturës formale përkitazi morfematike të fjalëformimit të mbiemrave të analizuar bazohet në nocionin e përgjithshëm dhe gjerësisht të pranuar të morfemës si njësia më e vogël me kuptim në përbërjen e fjalës dhe në klasifikimin e saj, duke i përfshirë edhe variantet e një morfeme si dhe interfiksin si një morfemë lidhëse në këto raste kur lidhja e morfemave të ndryshme has vështirësi ose nuk lejohet.⁷ Por, duke u mbështetur sidomos në shtjellimet e Lopatinit⁸ trajtohet morfema midis temave fjalëformuese në analizën tonë të mbiemrave si një morfemë e veçantë me funksion fjalëformues të lidhjes së gjymtyrëve, d.m.th. të temave me kuptim të plotë leksikor, zakonisht ajo ka karakter përsëritës. Në disa raste hasim në shqipen e sotme formime të së njëjtës strukture me dhe pa këtë morfemë, për këtë arsye nuk duhet të ketë gjithmonë, lidhur me shqipen, vështirësi të lidhjes së morfemave, kur përdoret kjo morfemë.⁹

⁷ Khs.: ZEMSKAJA, E. A.: *Sovremennyj russkij jazyk. Slovoobrazovanie*. Moskva 1973, f. 113vv. Sh. edhe prej punimeve më të reja si dhe me interpretime të ndryshme të këtij nocioni: FLEISCHER, W.; BARZ, I.: *Wortbildung der deutschen Gegenwartssprache*. Tübingen 1995, f. 32v.; LUSCHÜTZKY, H. CH.: *Morphem, Morph und Allomorph*. in: Geert Booij & al. (Hrsg.), *Morphologie: ein internationales Handbuch zur Flexion und Wortbildung*, Berlin/ New York 2000, f. 457v.; LOHDE, M.: *Wortbildung des modernen Deutschen: ein Lehr- und Übungsbuch*, Tübingen 2006, f. 187v.

⁸ Lopatin, V. V.: *Russkaja slovoobrazovatel'naja morfemika*. Moskva 1977 *Morfemika*, f. 57.

⁹ Khs.: “feudalo-çifligar” (Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë 1976, f. 180) : “feudal-klerikal” (Noli, S.: *Topi i lidur. Zgjidhi dhe përgatiti për shtyp: A. Sutaj*. Prishtinë 1977, f. 77). Kemi lëkundje në një publikim (sh. p. sh. “feudalo-fashist” (Noli, f. 155), çka mund të shpjegohet, siç ka të ngjarë, me ndikimin e vokalizmit ose me lëkundje të editorit, por nuk mund të pranohet për normë, nëse merren parasysh të gjitha formimet

Mbiemër	i parafrazimit fjalëformues (parafrazë)	modeli morfematik fjalëformues
buzëplasar	P _{poss} p1(em _{dr}) p2 (mbi _{ds}) fig (me buzë të plasur)	· mbi
flokëzi	P _{poss} p1(em _{dr}) p2 (mbi _{ds}) (me flokë të zezë)	em + mbi
punëpastër	N _{ag} L (fol) p1(em _{ob/di}) p2 (mbi _{ds}) (N bën punë të pastër)	em + mbi
cipëplasar	N _{ob/ind} p1(em _{ag}) p2 (pjes _{ds}) fig (N i ka plasur cipa)	em + pjes
gushëlëshuar	N _{ag} p2 (pjes) p1 (em _{ob/di}) (N ka lëshuar gushë)	em + pjes
i deriatëhershëm	pert. ad: P p1 (për _{em} _{ds}) p2 (em _{dr}) N është bërë/ka ndodhur deri atë herë (kohë)	n + P + për _{em} + em + s

E quajmë element kompozimi.

Për ta paraqitur dhe modeluar strukturën formale të mbiemrave me dy dhe më shumë tema përdoret në analizë konstrukti “model morfematik fjalëformues”. Mbiemrat e një modeli morfematik fjalëformues kanë:

1. rendin e njëjtë të temave, që i përkasin pjesës së njëjtë të ligjëratës,
2. forma të ndryshme të temave si tema morfologjike, forma të një fjale, fjalë (numërorët rreshtorë trajtohen si mbiemra, pjesoret si pjesë të vetme të ligjëratës),
3. morfema fjalëformuese me funksion të njëjtë (si para-, prapashtesa, interfiksa, nyja, elemente kompozimi). Khs.:

F. Shembuj për modele morfematike fjalëformuese

Shembujt tregojnë se i njëjti model morfematik fjalëformues mund të ketë në shumë raste modele të parafrazimit dhe parafraza të ndryshme. Modeli morfematik fjalëformues i analizës përgjithëson dhe redukton temat fjalëformuese të mbiemrave prej nga qartësia dhe përgjithësimi i modeleve dhe zvogëlimi i një numri shumë të madh modelesh të mbiemrave.

Si bazë e përshkrimit të strukturës semantike të fjalëformimit të mbiemrave introduktohet në analizë nocioni i komponentëve semantikë fjalëformues. Këto janë tipare semantike shpesh prediktabile fjalëformuese

të këtij tipi. Fjalori drejtshkrimor në raste të ngjashme pranon vetëm një variant, si p. sh. te “politiko-: -administrativ, -financiar, -kulturor” et. (f. 513).

që e dallojnë kuptimin e një mbiemri të motivuar nga kuptimi i bazës së tij motivuese, e cila përcaktohet në analizë duke u mbështetur në marrëdhënie të drejtpërdrejta të motivimit (sh. më sipër). Komponentët semantikë fjalëformues ekzistojnë shpesh si një marrëdhënie, e cila përsëritet te mbiemrat me të njëjtën/pothuaj të njëjtën strukturë morfematike. Ata kanë në sistemin e gjuhës, siç mund të supozohet përgjithësisht, një karakter të varur nga njësitë e tjera të gjuhës, të cilat ndikojnë në masë të madhe në kuptimin e tyre. Modelet e parafrazimit fjalëformues e krijojnë në analizën e mbiemrave me dy dhe më shumë tema bazën e përcaktimit të komponentëve semantikë fjalëformues. Ato shërbejnë në raste konkrete si një mjet ndihmës nëpërmjet fjalëve të shtjelluara në parafraza përkitazi nëpërmjet elementeve të shtuara në një model të parafrazimit fjalëformues. Khs. p. sh.:

- “FLOKËZI” => **me** flokë të zezë => **P_{poss}** p1(emdr) p2 (mbids)
=> komponenti “*prania e një sendi*”

- “I, E KALTËR-QIELLI” => i, e kaltër si qielli => p1 (mbidr)
K_{comp} p2 (emds)n =>komponenti “*ngjashmëri me një send*” (sh. edhe më poshtë).

Komponentët semantikë fjalëformues mund t’u përkasin niveleve të ndryshme abstraktimi. Ky fakt lejon një klasifikim më të saktë si dhe një nënndarje më të hollësishme të komponentëve semantikë fjalëformues. Në nivel të lartë komponentët semantikë nuk i përgjigjen një kuptimi leksikor, por një funksioni. Tiparet me rëndësi, sipas të cilave klasifikohen komponentët semantikë fjalëformues të analizës janë këto:

I.(numri i) **kombinimi(t)/moskombinimi i temave** në fjalëformimin e mbiemrit përkatës Në bazë të këtij komponenti mbiemrat e analizuar ndahen në mbiemra një- : disagjymtyrësh. Khs.: HEKURUDH-OR; AT-DHE-DASH-ËS; BUZË-PLASUR; LULËKUQE-NGJASHËM; SHKULËSE-PASTRUESE-GRUMBULLUESE

II. **fitimi/mosfitimi i tiparit kategorial të mbiemrit** në fjalëformim: Khs.: SYSHQIPONJË : JOKUPTIMPLOTË

III. **bashkim/jobashkim i kuptimeve leksikore të morfemave** të mëvetësishme në fjalëformim

SYSHQIPONJË, DEMOKRATIKO-BORGJEZ: BUZËPLASUR, PJESEMARRËS

IV. fitimi i kuptimit leksikor-semantik të përgjithshëm nga temat fjalëformuese

Khs. p.sh. lidhja me një *proces* (HAKMARRËS, TEJDUKSHËM), me një *objekt*, *send*, *dukuri* etj. (i PLOTFUQISHËM, BREGDETAR), *sasi* (PESËMBËDHJETËSHE [hënëë] etj).

Shënim:

- Shumica e mbiemrave kombinon këto tipare të përgjithshme kategoriale.

Khs. edhe: VULLNETÇELIK, KËMBËLESH (*lidhja me një objekt + një objekt*); DYKRENORE, DEGËSHUMË (*lidhja me një objekt + një sasi*); FITIMPRURËS, DASHAKEQ (*lidhja me një proces + një objekt*)

- Komponentët semantikë të përgjithshëm nën IV. mund të konkretizohen në shumë raste. Si p.sh.: HAKMARRËS (*kryerja e një veprimi*), I TEJDUKSHËM (*mundësia e kryerjes së veprimi*), I PLOTFUQISHËM (*prania e një sendi*), bregdetar (*raporti i përgjithshëm me në send*): VULLNETÇELIK (*prania e një sendi + ngjashmëria me një send*), KËMBËLESH (*2x prania e një sendi*), DEGËSHUMË (*prania e një sendi + sasi*), FITIMPRURËS (*kryerja e një veprimi + objekti i tij*), PUNË-DASHËS (*prirje për një send*), THEMELDALË (*mbajtës i një veprimi + rezultati i veprimi*).

V. koordinimi /determinimi i temave fjalëformuese:

Khs.: ARSIMOR-EDUKATIV, SHKULËSE-PASTRUËSE-GRUMBULLUESE: DEMOKRATIKO-BORGJEZ, FLOKËZI, MIRËBËRËS.

Strukturat formale dhe semantike të mbiemrave me dy a më shumë tema përshkruhen dhe renditen në analizën tonë hollësisht sipas grupeve semantike të fjalëformimit. Bazat e tyre krijojnë komponentët semantikë fjalëformues, duke filluar nga komponenti i nivelit më të lartë të abstraktimit deri në nivelin më konkret leksikor (sh. hierarkia e komponentëve 1. - 5. më sipër). Ashtu dallohen në analizë tri grupe të mëdha mbiemrash, këto janë:

1.grupi i mbiemrave njëgjymtyrësh të tipit: HEKURUDHOR,

2.grupi i mbiemrave dygjymtyrësh të tipit: FLOKËZI, HUNDË-SHKABË, BUZËPLASUR etj. dhe

3. grupi i mbiemrave tre- e në raste të rralla shumëgjymtyrësh të tipit: KUPËNËNPETËLNGJITUR, TREKËNDREJTË e PESË-, DHJETË- DHE NJËZETLITËRSH.

Për çdo grup semantik të fjalëformimit si edhe për nënndarjet e tyre e shënojmë në analizë numrin e mbiemrave të analizuar. Grupi i dytë është, siç mund të supozohet dhe dihet përgjithësisht nga përshkrimi i fjalëformimit në gramatikat e shqipes, prej nga numri i mbiemrave, të cilët i përkasin, grupi më i madh me 3429 mbiemra, derisa grupi i tretë më i vogël me 36 mbiemra. Duhet mbajtur parasysh se nënndarja e mbiemrave të analizës sipas komponentëve semantikë fjalëformues nuk nënkupton se ekzistojnë gjithmonë nëngrupet semantike të fjalëformimit të barabarta. Përkundrazi. Grupet semantike të fjalëformimit me një komponent semantik fjalëformues të nivelit më abstrakt ndryshohen prej nga nënndarja e grupeve përkatëse. Për ilustrim japim më poshtë një shembull për klasifikimin e disa mbiemrave dygjymtyrësh. Këta janë:

BISHTPËRPJETË, BORGJEZO-FASHIST, DJERRAKOHË, DREDHADREDHA, DORËHEQUR, DORËHEQËS, FLOKËZI, I GJELBËR-I ARTË, *GOJËHELM*, GJETHEHOLLË, GJYSMËFEUDAL, HATËRMBETUR, HUNDËSHKABË, IDEOPOLITIK, INSEKTVRASËS, IZRAELITO- LIBANEZ, KATËRDHËMBËZUAR, KOKULUR, KULTUROZBAVITËS (*UNIKAL*), I KUQ-GJAK, E KUQE-KORALE, MENDJENGUSHTË, PJESËMARRËS, QAFËGJATËS, I SAPONDËRTUAR, SHPIRTLUAN, I SHUMËVUAJTUR, *ZEMËRPULË*.

Këta mbiemra mund të klasifikohen në grupe të ndryshme semantike. Ato kanë këta komponentë semantikë fjalëformues (KSF):

1. **Mbiemra: + KSF** të përgjithshëm “**tipari kategorial të mbiemrit**”
 - 1.1+ KSF “bashkim i kuptimeve leksikore”
 - 1.1.1+ KSF “**nënrënditje**”
 - 1.1.1.1+ KSF “LIDHJE ME SENDE”
 - 1.1.1.1.1 + “*prania/posedim i një sendi*”, *determinuar* nga
 - a) KSF “*ngjashmëria me një send*”: Khs. shpirtluan, hundëshkabë
 - b) KSF “*tipar*”: Khs. flokëzi, gjethehollë; qafëgjatës (*formim unikal*);
bishtpërpjetë, kokulur

1.1.1.2.1+ KSF “*kryerje e një veprimi*”, determinuar nga “*objekti i veprimit*”: Khs. Insektvrasës (ose insektevrasës), djerrakohë

1.1.1.2.2+ “*rezultat i veprimit*”, determinuar nga një “*rrethanë*”: Khs. i sapondërtuar, i shumëvujtur

1.2- ¹⁰ KSF “bashkim i kuptimeve leksikore”

1.2.1+ KSF “LIDHJE ME SENDE”

1.2.1.1+ KSF “*prania/posedim i një sendi/i sendeve*”: Khs: mendjengushtë; dredha-dredha (me mendje të ngushtë; me [shumë] dredha

1.2.2 + KSF “LIDHJE ME NJË VEPRIM”

1.2.2.1+ KSF “*kryerje e një veprimi*”: Khs. dorëdredhur; pjesëmarrës (dora i dridhet [kur bën diçkaë, që merr/ka marrë pjesë])

1.2.2.2+ KSF “*rezultat i veprimit*”: Khs. dorëheqës; hatërmбетur (që heq dorë [nga diçkaë, që i ka mbetur hatri])

1.2.3 + KSF “GJENDJE FAKTIKE”: Khs.: gojëhelm, zemërpulë (e ka gojën helm, ka zemër pule)

2. **Mbiemra:** -¹¹ KSF të përgjithshëm “tipari kategorial të mbiemrit” por me:

2.1.+ KSF “bashkim i kuptimeve leksikore”

2.1.1+ KSF “**nënrënditje**”

2.1.1.1+ KSF “LIDHJE ME SENDE”

2.1.1.1.1+ KSF “*ngjashmëria me një send*”: Khs. i kuq-gjak, e kuqe-korale

2.1.1.1.2+ KSF “*tipar precizues-limitativ*”: Khs. kulturozbovitet

2.1.1.2+ KSF “LIDHJE ME NJË SASI”: Khs. gjysmëfeudale, katërdhëmbëzuar (katërfish i, e dhëmbëzuar)

2.1.1.3+ KSF “LIDHJE ME NJË TIPAR”

2.1.1.3.1+ KSF “*tipar precizues-limitativ*”: khs. borgjezo-fashist, i gjelbër-i artë

2.2 + KSF “**bashkërenditje**”: Khs. izraelito-libanez, ideopolitik.

¹⁰ “pa KSF përkatës”. Këta mbiemra motivohen nga një togfjalësh.

¹¹ “pa këtë tipar të përgjithshëm”, këta mbiemra të përbërë nuk duhet të transferohen nëpërmjet fjalëformimit të kompozimit në klasën e mbiemrave, d.m.th. motivohen nga një mbiemër, i cili determinohet nga një fjalë me kuptim të plotë, ose nga dy mbiemra.


Mbiemrat e analizës përshkruhen në grupe të veçanta semantike fjalëformimi (GSF) sipas komponentit leksikor-semantik fjalëformues (khs. p. sh. në këto grupe: 1.1.1.1.1., 1.1.1.1.2., 1.1.1.2.1., 1.1.1.2.2., 1.2.1.1. etj.). Këtu mbiemrat karakterizohen imtësisht sipas modeleve morfematike të fjalëformimit (MMF), produktivitetit të tyre, sipas mënyrave të fjalëformimit, modeleve të parafrazimit fjalëformues (MPF) dhe sipas raportit midis MMF dhe MPF. Krahas me shkeljet nga norma jepen veçorive stilistike të mbiemrave si edhe, në varësi nga numri i mbiemrave të një grupi, veti dalluese të kuptimit denotativ të temave përkatëse fjalëformuese.

7. Analiza e mbiemrave shqip me dy a më shumë tema e vitit 1983 e pasqyron gjendjen e zhvillimit të gjuhës standarde në vitet 1970 vv./në fillim të vitit 1980, në bazë të një numri të konsiderueshëm burimesh dhe në radhë të parë falë shqipfolësve nga Kosova, të cilët e vërtetuan gjerësisht pranimin e standardit gjithëkombëtar të gjuhës shqipe. 3679 mbiemra i ishin nënshtruar analizës. Nëpërmjet modeleve të parafrazimit fjalëformuese mund të dallohen 89 modele të ndryshme morfematike si dhe 78 grupe semantike të fjalëformimit. Mbiemrat me dy tema fjalëformuese të kompozimit e paraqesin shumicën dërrmuese të analizës. Ajo i tregon qartë pasuritë e shqipes, korrespondencat e saj të shumta me gjuhë të thera si edhe rrugët e veçanta të shqipes në procesin e zgjerimit të fjalorit. Në disa raste vërehet një ndikim nga gjuha serbo-kroate te mbiemra me burim nga Kosova si edhe shkelje të normës pa dallim rajonal të burimit. Vëllimi I i analizës në fjalë e përmban bashkë me shtjellimin e metodave për shkrimin e hollësishëm të mbiemrave sipas grupeve semantike fjalëformuese. Përveç kësaj jepet në mënyrë të përmbledhur dhe përfundimtare një pasqyrë mbi mënyrat fjalëformuese dhe modelet morfematike të mbiemrave. Karakterizohen gjithashtu përmbledhtazi temat emërore të mbiemrave, elemente kompozimi, variantet e një morfeme dhe forma grafike të formimeve mbiemërore.

Vëllimi II i analizës sonë jep pas shënimeve të bëra gjatë analizës dhe shkurtimeve të përdorura, listën e literaturës dhe të burimeve, si edhe një listë mbiemrash me për- kthim gjerman dhe të dhënat stilistike të mbiemrave shqip. Mbiemrat grupohen këtu me numër vijues dhe sipas pjesës së ligjëratës të temave fjalëformuese. Khs. për shembull:

653. *BRINJËNJËSHËM* /Geom./ ‘gleichseitig’
654. *BRIPËRPJETË* ‘mit gerade nach oben gehenden Hörnern (f. Ziegen u. Schafe)’
659. *BUÇKAMADH* ‘vollwangig; pausbäckig (zärtl. f. Kinder)’
660. *BUJËMADH* /pej. 2.; +¹²12/ ‘1. aufsehenerregend; ruhmreich 2. wichtigtuerisch’
661. *BUZËBARDHË* /+/ ‘mit hellen Lippen (gewöhnl. f. Tiere)’
665. *BUZËDJEGUR* ‘1. mit ausgebrannten Lippen 2. voller Verlangen’
672. *BUZËNGRËNË* /1. auch Bot./ (Poezia shqipe 1978) ‘1. mit eingeschnittenem Rand 2. schamvoll; nervös (nach Meinung der Konsultanten)’
677. *BUZËPLASUR* ‘niedergeschlagen, betrübt, verdrießlich, gepeinigt’
682. *BUZËTHARË* ‘1. mit trockenen Lippen 2. buzëplasar’
686. *BUZËZI* ‘1. mit schwarzen Lippen (f. Tiere) 2. unglücklich, erfolglos’
687. *BYTHËMADH* /umg., vulg./ (Qosja, R.; Vdekja më vjen”... P. 1976, S. 612) ‘mit großem Hintern’.

Analiza jonë duhet të zgjerohet në të ardhmen me formime të reja të gjuhës së sotme shqipe. E gjejmë të udhës se rezultatet e saj rivlerësohen nga gjendja e shqipes së sotme, duke përfshirë edhe më shumë parametra socio-linguistike dhe të variabilitetit të gjuhës.



¹² Përdoret te mbiemrat që në fjalorët e shqipes nuk kanë ngjyrosje stilistike, por shqipfolësit e konsultuar të analizës i kanë vlerësuar si formime artificiale, të pazakonshme.

Ndihem i detyruar që t'ua shpreh me gjithë zemër mirënjohjen time gjithë kolegëve dhe miqve për nxitje të çmueshme dhe përkrahje vetëmohuese në procesin e përpilimit të këtij punimi.

Veçanërisht u falënderoj tutorëve të mi, zonjës prof. dr. sc. E. Günther, Sektori i Sllavistikës pranë Universitetit të Humboldtit në Berlin, dhe zotit dr. W. Fiedler, Akademia e Shkencave e RDGj, Instituti Qëndror për Gjuhësi.

Për verifikimin e materialit të këtij punimi falënderoj në radhë të parë zotit doc. I. Bajçinca, Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë shqipe e Fakultetit Filozofik të Universitetit në Prishtinë, dhe zonjës dr. C. Brückner, Dega e Botanikës dhe e Arboretumit e Muzeut për Histori Natyrore pranë Universitetit të Humboldtit në Berlin.

Gëzim HOXHA, Tiranë

OPTIKA E THEODOR IPPEN-IT MBI ULTËSIRËN BREGDETARE TË SHQIPËRISË VERIORE KUNDREJT REZULTATEVE TË SOTME TË ARKEOLOGJISË

Theodor Anton Ippen u lind me 29 nëntor 1861 në Sezemice, pranë Pardubitz-it në rajonin e Bohemisë. Shkollimin e formimit të përgjithshëm dhe atë universitar i kreu në Pragë dhe Vjenë. Në fundin e vitit 1884 ai u emërua si konsull i përgjithshëm në qytetin e Shkodrës¹. Krahas punës diplomatike ai i kushtoi mjaft kohë dhe forcë shpirtërore studimeve arkeologjike, etnologjike dhe historike. Krahas arkeologëve si Patsch, Praschniker dhe Schober, gjuhëtarëve Weigand, Pedersen dhe Jokl, historianëve Thalloczy, Jireček, Šufflay dhe etnologut Franz Nopsca, Theodor Ippeni ka krijuar një vepër bazike për historinë mesjetare dhe arkeologjinë e Shqipërisë së Veriut. Kontributet e këyre autorëve u bënë nxitja dhe mbështetja e sigurt për koleksionistët e parë të arkeologjisë shqiptare si At Shtjefën Gjeçovi, At Gjergj Fishta, Lef Nosi e Eqrem bej Vlora. Mbi këtë përvojë të vyer, e filloi punën me sukses gjenerata e parë e arkeologëve shqiptarë Hasan Ceka, Skënder Anamali, Selim Islami dhe Frano Prendi.



Fig. 1 Theodor Anton Ippen (1861-1935)

Megjithse vepra e tij nuk paraqet një studim unik të përmbledhur, ai ka dhënë nëpërmjet studimeve të veçanta një material me shumë vlerë për Historinë e Shqipërisë siç janë të dhënat gjeografike, ekonomike, arkeologjike dhe mardhëniet fetare. (shih listën e botimeve në fund të artikullit).

Duke u bazuar në 25 kontributet me vlerë të Ippenit për Historinë e Shqipërisë, veçanërisht për ultësirën bregdetare të Shqipërisë Veriperëndi-

¹ Për jetën e Theodor Anton Ippenit shih më hollësisht: WERNICKE 1967, 11-22

more, po paraqesim një ballafaqim të këtyre rezultateve me arritjet e derisotme të kërkimeve arkeologjike në këtë territor, duke iu përmbajtur një kriteri gjeografik.

Po fillojme me vëzhgimet dhe studimet e Ippenit në qytetin mesjetar të Shasit (Svač - Suacium)², i vendosur pranë liqenit me të njëjtin emër, rreth 15 km në verilindje të qytetit të Ulqinit. Ky qytet, i përmendur nga burimet historike mesjetare ka qenë vizituar nga udhëtarë dhe kërkues të ndryshëm qysh prej shekullit 19 dhe fillimeve të shek 20³ deri në ditët tonë⁴. Gërmimet e para arkeologjike janë kryer këtu vetëm në vitin 1985, për të vazhduar më pas në këtë dhjetëvjeçarin e fundit⁶. (Fig. 2a, b)




Fig. 2. Shasi a) nga Ippen 1907; b) Shasi sot

Janë gjetur gjurmë të pakta të kulturës materiale arkeologjike nga periudhat neo-eneolitike, periudha e herëshme e hekurit, periudha helenis-

² IPPEN 1900, 235-238

³ DEROKO 1930, 148; BOSKOVIC 1931, 151; KORAC 1965, 58, 65, 98; KOVACEVIC 1967, 324.

⁴ Shih përmbledhtazi: MIJOVIC, KOVACEVIC 1975, 131-133; JANKOVIC 2007, 27-33, 65-66, 87, 159-160; PETTIFER, CAMERON 2008, 1-21; ČILIKOV 2009, 23-26

⁵ ČILIKOV 2009, 26, 32. Autori na informon për praninë e një raporti të gërmimeve: “Elaborat o rezultatima sonđaznih arheološki istraživanja starog grada Svača”, Centar za arheološka istraživanja Filozofskog Fakulteta u Beogradu, Beograd (decembre) 1985.

⁶ Vitet e fundit, janë nënmarë gërmime të reja në Shas nga arkeologët malazezë, por rezultatet e këtyre gërmimeve janë ende vetëm pjesërisht të publikuara. Shih për këtë ZAGARCANIN 2017, 177-234.

tike dhe periudha romake⁷. Duke filluar nga shekujt 6-7 pas Kr., ky vendbanim merr trajtën e një qyteti mesjetar të fortifikuar. Fortifikimi zë majën e kodrës shkëmbore në një sipërfaqe gjatësore rreth 335 m x 50 m (afërsisht 1.6 ha). Por, qyteti zhvillohej edhe jashtë mureve fortifikuese në një hapësirë shumë më të madhe, rreth 15 hektarë.

Deri më sot këtu janë dokumentuar mirë mbetjet e mureve fortifikuese, disa gërmadha të banesave profane, muret e dy kishave të vendosura *intra muros* dhe të 12 kishave të tjera *extra muros*. Shumica e varreve të gërmuara këtu janë të grupuara në periferinë e këtyre kishave⁸

Zhvillimi i topografisë së qytetit tregon një prijeje disi të ndryshme, përkundrajt asaj të vërejtur në qytetet tjera bashkëkohore mesjetare të territorit të provincës Praevalis, ku nekropolet priren fillimisht ti afrohen hapësirës së bredëshme të qytetit, dhe më pas, depërtojnë në mënyrë të përshkallëzuar në brendësinë e tij.

Bërthama e parë e qytetit mesjetar të Shasit është pikërisht pjesa e fortifikuar. Në periudhën mesjetare, duket se jeta ekonomike dhe fetare e qytetit zgjerohet në mënyrë të konsiderueshme në hapësirën *extra muros*, duke u futur në territorin e nekropoloeve të mëparëshme.

Qytetin e fortifikuar të Drishtit Ippen e vlerëson rreth 8000 hapa larg Shkodrës, me një perimetër muresh më se 2000 hapa. Ai përshkruan shkurtimisht historinë e Drishtit dhe jep dokumentacion fotografik për kodrën e qytetit, muret rrethuese, portat, kullat dhe citadelën, një kapele trekonkëshe dhe gjurmët e një ure të vjetër mbi lumin Kir. Ai jep të dhëna për lagjen e jashtëme-varoshin, për kishën e Shën Mërisë dhe dy tyrbe të kohës turke. Më tej, flet për një gur varri romak me mbishkrim latin dhe një stemë prej guri të një familjeje feudale⁹.

Ritmi i mëvonshëm i studimeve në këtë qytet ka qenë i ulët dhe mund të përmblihet në disa artikuj përshkrimorë-episodikë të autorëve Kolë Kamsi, Apolon Baçe, Vili Kamsi dhe Damjan Komata¹⁰. Kohët e

⁷ ČILIKOV 2009, 27

⁸ MIJOVIC, KOVACEVIC 1975, 131-133; JANKOVIC 2007 ; ČILIKOV 2009, 26-32

⁹ IPPEN 1907b, 9-16

¹⁰ KAMSI, 1964, 163-166; BAÇE 1975, 51-5

fundit kemi një punim historik nga autori Edmond Malaj¹¹.

Kërkimet arkeologjike të viteve të fundit po saktësojnë me shumë njohjen e mureve fortifikuese, banesave, objekteve të kultit kristian dhe islamik, varrezës së qytetit dhe kulturën materiale të tij¹².

Qytetit të Shkodrës dhe kështjellës së tij “Rozafa” Ippeni u ka kushtuar vemendje të veçantë¹³. Përshkrimet e detajuara dhe dokumentacioni i tij shërbejnë edhe sot për çdo kërkues që punon në këtë terren.

Sipas rezultateve të gërmimeve arkeologjike, të filluara që nga viti 1985 (Hoxha, Lahi)¹⁴ dhe që vazhdojnë edhe sot (Shpuza, Dyczeck)¹⁵, gjurmët më të herëshme të zbuluara në Kalanë e Shkodrës i përkasin periudhës së Bronxit të Hereshëm (2100-1800 para Kr.). Ky vendbanim i hapur, por me mbrojtje të mirë natyrore, ka vazhduar jetën edhe në periudhën e parë të hekurit (shek. XII-V para Kr.).




Fig. 3 Kalaja e Shkodrës a) nga Ippen 1907; b) Gërmimet e vitit 1986 brenda kalasë

Në vitin 1040 Shkodra ra nën sundimin serb të Zetës, por vazhdoi të ishte përsëri kryeqendër e këtij shteti. Gjatë kësaj kohe pati disa përforcime të fortifikimit dhe u ngrit Në fund të shek. IV – fillim të shek. III para Kr. këtu ka qenë themeluar një qytet ilir, i cili na dëshmohej nga fragmentet e murit rrethues, të ndërtuara me teknikën e njohur poligonale-trapezoidale.

Në shekullin 2 para Kr., gjatë kohës së mbretërimit të mbretit ilir Genti (181-168 para Kr.), Shkodra ka qenë kryeqyteti i shtetit ilir. Në këtë

¹¹ MALAJ 2015

¹² PUSHIMAJ 2016, 231-244

¹³ IPPEN 1907a, 13-41; IPPEN 1907b, 47-52

¹⁴ HOXHA, LAHI 1986, 266-268; LAHI, HOXHA 1987, 252-254; HOXHA, LAHI 1988, 262-264; LAHI, HOXHA 1989, 295-296; HOXHA 1990, 274-275; HOXHA 1991, 283-284

¹⁵ SHPUZA, DYCZECK 2012, 439-445; DYCZECK, SHPUZA, 2014, 387-398

kohë, për herë të parë kanë qenë prerë monedha me emrin e qytetit dhe pak më vonë me emrin e mbretit Gent apo e emrin e fisit ilir të labeatëve. Gjatë periudhes romake, dhe më saktësisht në shekullin 2 pas Kr., qyteti i Shkodrës fitoi statusin e një kolonie romake. Për këtë dëshmojnë qartë dy mbi-shkrime latine (njëri i sapozbuluar), një kompleks banesash i shtruar pjesërisht me mozaikë dhe mjaft gjetje të tjera të shekujve 1-3 pas Kr. Në periudhën antike të vonë (sh. 4-6 pas Kr.) Shkodra ka qenë njëkohësisht kryeqendra dhe selia kryesore ipeshkvnore e provincës Praevalis. Gërmimet e reja arkeologjike kanë zbuluar pjesë të murit rrethues të qytetit, një kompleks banesash dhe shumë material arkeologjik të kësaj kohe.

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit 14 qyteti u zotërua nga feudalët vendës - Balshajt, të cilët e mbajtën përsëri si qendër të principatës së tyre. Në vitin 1396 Shkodra ra nën zotërimin e Republikës së Venedikut. Gjatë shekullit të 15-të venecianët i përforcuan në mënyrë të dukëshme muret e kështjellës, dhe ngritën mjaft ndërtesa të reja. Në çerekun e fundit të shekullit të 15 qyteti i Shkodrës i rezistoi dy rrethimeve të ushtrisë osmane (1474 dhe 1478-9). Mbas pushtimit nga osmanët, një pjesë e madhe e popullsisë u shpërngul dhe qyteti u shkatërrua. Një ringritje e jetes pasoi në shekujt 17-18. Qyteti u bë qendër e Sanxhakut për Shqipërinë e Veriut. Dëshmi nga kjo periudhë janë Xhamia e Plumbit, Ura e Mesit (1767) dhe mjaft material arkeologjik i dalë nga gërmimet e kryera brenda kështjellës.

Ippeni i ka vizituar dhe ka dhënë një përshkrim të dy mureve rrethues **të qytetit mesjetar të Shurdhahut**, të banesave rrënojë dhe të katër kishave të qytetit, të cilat i ka dokumentuar me së miri me fotografi. Përveç monumenteve të këtij qyteti ai bën edhe një përmbledhje të koncentruar të historisë së tij mesjetare¹⁶.

Autorët e gërmimeve H. Spahiu e D. Komata na informojnë për pralinë e gërmadhave të dhjetë kishave të qytetit¹⁷. Katër nga këto kisha janë zbuluar në hapësirën *extra muros*, jashtë sistemit fortifikues të qytetit, por brenda sipërfaqes së varrezave të periudhës së herëshme mesjetare.

¹⁶ IPPEN 1902a, 134-137

¹⁷ SPAHIU, KOMATA 1974, 257-328




Fig. 4. Shurdhahu A) nga Ippen 1907; B) Shurdhahu sot; C) Planimetria e përgjithëshme e qytetit mesjetar

Shtatë kisha të tjera janë të shpërndara në hapësirën *intra muros*, në pjesë të ndryshme të qytetit. Shumica e tyre janë të vendosura në zonën brenda dy linjave të mureve rrethuese. Në këtë hapësirë, në shekullin 11, pranë të gjitha kishave kishte sipërfaqe të lira, që kanë shërbyer për vendosjen e varrezave të vogla rreth tyre¹⁸. Gjate Mesjetës konturohet këtu një topografi e qartë kristiane. Të dhënat e burimeve historike mesjetare tregojnë se këto kisha të Sardës u kanë qenë kushtuar shejtërve si Shën Mëria, Shën Antoni, Shën Pali, Shën Nikolla, Shën Theodori, Shën Pjetri¹⁹ etj.

Edhe për qytetin e Lezhës Ippeni ka bërë një përshkrim historik, që nga themelimi i saj në antikitet e deri në periudhën osmane. Ai përshkruan

¹⁸ KARAIKAI 1987, 73-83

¹⁹ GURAKUQI 1943,

veçanërisht mirë citadelën (akropolin) e dhe godinat brenda saj, duke dokumentuar me fotografi të kodrës së kështjellës, portave lindore dhe perëndimore dhe rrenojat e godinave brenda citadelës²⁰.

Gërmimet e viteve 70-80 të shekullit XX, nga autorët Frano Prendi dhe Koço Zheku²¹ dhe ato të viteve 2006-2014 të dy ekspeditave shqiptaro gjermane (Hoxha, Oettel)²² dhe shqiptaro-franceze (Nallbani, Buchet)²³, u japin konfirmim të dhënave të Ippenit dhe kanë pasuruar dukshëm njohjen për këtë qytet iliro-arbëror. (Fig. 5a, b)



Fig. 5 Kalaja e Lezhës a) Porta perëndimore nga Ippen 1907; b) Kalaja e Lezhës sot

Shenjat e para të jetës duken në Majën e Shelbuemit (410 m të lartë), qysh në kohën e bronzit dhe fillimet e epokës së hekurit. Qyteti ilir themelohet këtu në fundin e shek 4 para Kr., kur edhe fillon fortifikimi me mure të stilit poligonal-trapezoidal, kur fillojnë të ndërtohen godina publike e private, rrugë dhe të priten monedha me emrin e qytetit. Në periudhën hellenistike të vonë shohim këtu ndërtimin një terme publike me mozaik dhe mbishkrim në gjuhën greke. Në kohën e perandrit romak Cezarit, ky qytet përjeton një aspekt të luftes civile me Pompeun, rindërtimin e mureve for-

²⁰ IPPEN 1907a, 53-61; IPPEN 1907 b, 52-59

²¹ PRENDI, 1975, 149-163 ; PRENDI 1979-80, 123-146 ; PRENDI, 1981, 153-163 ; PRENDI, ZHEKU 1971a, 215-244 ;

PRENDI, ZHEKU 1971b,7-23; PRENDI, ZHEKU 1983,203-208; PRENDI, ZHEKU 1986,57-66.

²² POCHMARSKI, HOXHA 2005, 243-251; HOXHA 2007, 81-87; HOXHA 2011, 285-306 ; HOXHA 2014a, 511-526;

HOXHA 2014b, 41-67; OETTEL 2104, 455-467;

²³ NALLBANI, BUCHET 2008, 239-261 ; NALLBANI, BUCHET 2012, 479-487.

tifikuese²⁴, me dëshmi të sigurt mbishkrimesh latine dhe riorganizim të rrjetit urban të tij. Në periudhen antike të vonë, Lissus mbetet një qytet i njohur dhe një qendër peshkopale e provinces Praevalis²⁵.

Të dhënat e reja arkeologjike të kësaj periudhe si: rikompozimi i ri i mureve rrethuese, gjashtë kisha paleokristiane të vendosura *extra et itra urbem*, baptisteri i shek. 6, dhe kultura materiale e pasur, na deshmojnë në mënyrë më të plotë tiparet më themelore të këtij qyteti antik të vonë²⁶. Vërehet qartë një gërshetim i elementeve të reja, që lindin e ndërthuren me elemente të vjetra në shtratin historik e kulturor të traditës antike të qytetit.

Varreza e Mesjetës së Herëshme (shek. 6-8 pas Kr.) mbetet e vetmja dëshmi për vazhdimësinë e jetës së qytetit në këtë kohë të errët²⁷. Pikërisht në qendër të qytetit të poshtëm mesjetar, pranë lumit Drin, në kishën katedrale të Shën Kollit, u varros heroi kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Memoriali i tij qëndron i ngritur mbi themelet e ndërtimeve antike dhe mesjetare të këtij qyteti²⁸.

Kërkimet arkeologjike kanë dëshmuar se **në kështjellën e Krujës** dhe rrethinën e saj të afërt jeta ka filluar që prej shekullit 3 para Kr. Vendbanimi i fortifikuar i Zgërdheshit (Albanopolis), i cili ndodhet jo shumë larg Krujës, ka pasur nivelin e një qyteti të fortifikuar të antikitetit²⁹.

Kërkimet e vitit 1978 në kështjellën e Krujës kanë zbuluar një fragment të murit rrethues 8 m. të gjatë dhe 1.25 m. të lartë, i cili i përket periudhës antike të vonë³⁰.

Duket se jo rastësisht, një nekropol i shekujve 6-8, me një sipërfaqe rreth 2 hektare gjendet sot nën themelet e ndërtimeve moderne të qytetit të Krujës. Gërmimet e viteve 1956, 1958 dhe 1960 kanë nxjerrë në dritë mjaft varre me një inventar shumë të pasur, me vegla pune, armë dhe stoli , të

²⁴ PRENDI 1981, 153-163 ; POCHMARSKI, HOXHA 2005, 243-251.

²⁵ HOXHA 2007, 81-87; HOXHA 2011, 285-306 ; HOXHA 2014a, 511-526; HOXHA 2014b, 41-67.

²⁶ HOXHA 2007, 81-87; HOXHA 2014a, 511-526; HOXHA 2014b, 41-67.

²⁷ PRENDI 1979-80, 123-146; NALLBANI BUCHET 2008, 239-261 ; NALLBANI BUCHET 2012, 479-487.

²⁸ PRENDI 1969, 242-248 ; FRASHËRI 2002; HOXHA 2011, 285-306.

²⁹ ISLAMI 1971, 23-41; KARAIKAJ 1977-78, 201-216.

³⁰ KOMATA 1982, 221-232

cilat i perkasin kulturës së herëshme arbërore, të njohur me emrin “Kultura e Komanit”³¹.

Shekujve 12 e 15 u perkasin disa gjurmë banesash të gërmuara në brendësi të kështjellës³². Mbetjet e tubacioneve të një ujsjellësi, shumë objekte prej qeramike e prej metali ndodhen sot në Muzeun e Skënderbeut në Krujë, në Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Arkeologjik në Tiranë.



Fig. 6. Kalaja e Krujës a) nga Ippen 1907; b) Kalaja e Krujës sot

Sie emër, Kruja përmendet për herë të parë në burimet historike latinisht në trajtën “Croia”, në vitin 879, si qendër ipeshkvnore karahas qendrave si Durrësi e Stefaniaka³³. Por nga një letër e Gjon Kastriotit e vitit 1407³⁴ është hamenduar se kjo seli ipeshkvnore ka ekzistuar që nga sh. 7.

Vetë emri Krujë vjen ndoshta prej emrit “krue”, i njohur gjerësisht në shqip për burimin e ujit. Vetëm 25 m. larg nga hyrja e kështjellës së Krujës, ndodhet një burim i njohur si “Kroi i Pazarit”. Në dy blloqe gurësh të këtij kroi janë të gdhendur dy mbishkrime në gjuhën osmane, të vendosur mbi relieve, që paraqesin një rozetë dhe dy luanë. Eshtë pikërisht Theodor Ippen ai që i ka transkriptuar për herë të parë këto mbishkrime³⁵, të rikonformuara më vonë nga studiuesi bashkëkohës Machiel Kiel si mbishkrime origjinale të përdorura në vitin 1800 për restaurimin e kroit³⁶.

I bazuar në vizitën e tij të shkurtër dhe dy fotografi, të dhuruara nga zevendëskonsulli austriak në Durrës, Kwiatovski, Ippeni jep një përshkrim të shkurtër të **kështjellës së vogël mesjetare me formë trekëndore të Pe-**

³¹ ANAMALI, SPAHIU 1979-80, 47-103

³² KOMATA 1982, 221-232

³³ A. Alb. I, 57

³⁴ A. Alb. I, 48

³⁵ IPPEN 1907b, 62-63

³⁶ KIEL 1990

trelës. Ai e lidh këtë kështjelle veçanërisht me historinë e kohës së Skënderbeut³⁷. E vendosur në roje të rrugës së Qafë Kërrabës, Kështjella e Petrelës lidhte luginën e Shkumbinit me Fushën e Tiranës. Ajo u takon disa fazave ndërtimore më e vjetra, ndër to është kulla e shekullit VI³⁸.



Fig. 7. Kalaja e Petrelës a) nga Ippen 1907; b) Kalaja e Petrelës sot

Kalimi nga një kullë e veçuar në një kështjellë duket se i takon kohës rreth sh. XI, kur ajo luan rol me rëndësi në luftërat normano-bizantine. Më tej, ajo kthehet në kështjellë të vërtetë feudale, duke u plotësuar me mure të reja, që lidhin në një tërësi elementet e veçuara, të ndërtuara në periudha të ndryshme. Gjatësia e përgjithëshme e mureve është gati 100 m. dhe në plan ka formën e një trekëndëshi. Falë pozitës natyrore, e ngritur mbi një shkëmb të thepisur, dhe rolit strategjik, si mbrojtëse e rrugës së Qafëkërrabës, Kështjella e Petrelës është përdorur për një kohë të gjatë. Roli i saj kulmon në sh. XV me rezistencën ndaj pushtimit osman. Këtu ka qëndruar motra e Skënderbeut - Mamica me familjen dhe rojen e saj³⁹.

(Shirqi). Në punimin e vet mbi “*Kisha të vjetra dhe rrënoja kishash në Shqipëri*”, Ippeni i ka kushtuar një vemendje të veçantë kishës së fshatit të sotëm Shirq⁴⁰, në bregun e lumit Buna, 6.5 km në jug të Shkodrës. Mbi-shkrimet latine e datojnë këtë kishë në fundin e shek. XIII⁴¹, por burime

³⁷ IPPEN 1907b, 65-67

³⁸ MEKSI, 1982, 52-53

³⁹ MEKSI, 1982, 52-53

⁴⁰ IPPEN 1900, 231-236; IPPEN 1907a, 9-12

⁴¹ BOGDANI 1684, dok. 6, p. 218; THEINER I/1863, DXLVI f. 380; DLXXXIII f. 408-409; FARLATI COLETI 1817, VII, 307; JASTREBOV 1880, 368. Duket se pas vitit 1880, guri me mbishkrimin e vitit 1318 është thyer në vendin e datës dhe ka ngjallur mjaft diskutime tek autorët e mëvonëshëm. Referenca më e mirë e këtij datimi mbetet relacioni i P. Bogdanit i vitit 1684.

apokrifë apo legjendare, jo krejt të sigurta, e lidhin këtë kishë me kohën e perandorit Justinian në shek. VI⁴².




Fig. 8. a, b Kisha e Shirqit nga Ippen 1900; c, d) Fasadë nga Kisha e Shirqit sot

Rezultatet e hulumtimeve arkeologjike në këtë zonë hapin një mundësi të re interpretimi, me zbulimin pranishë së gjurmëve paramesjetare⁴³. Një kolonë dritareje prej mermeri edhe dy impostkapitele prej guri, të datueshme në shekullin e VI (Fig 8), na dëshmojnë praninë e një kishe paleokristiane në lagjen Velinaj të fshatit Oblikë. Kjo kishë ndodhet vetëm 3.6 km. në veriperëndim të kishës së njohur mesjetare të Shirqit. Toka aluvionale lumore e fushës pranë saj, të bën të mendosh, se në intervalin e shekujve VI-XIII, lumi Buna ka meandruar dukshëm në këtë zonë fushore. Pra ekziston mundësia, që lumi të ketë rrjedhur respektivisht pranë kishës

⁴² BRYCE 1887, 657-658; IPPEN 1907a, 18; SHUFLAY, 1924, f. 28; VALENTINI, 1942, f. 251; KORAČ, 1961, f. 35; MEKSI, 1983, 94, 151-155; KAMSI 2000,120-123; MEKSI 2004, 200-205; ERDELJAN 2016, 129-143

⁴³ HOXHA 1994, 241-242; HOXHA 2003, 39-40

paleokristiane në shekullin e VI dhe pranë kishës mesjetare në shek. e XIII. Po në këtë mënyrë hipotetike mund të mendohet se edhe njoftimi në apokrifin e dyshimtë të jetës së Justinianit⁴⁴, ka pasur parasysh kishën paleokristiane, që ndodhej asokohe gjithashtu në bregun e Bunës.

Ippeni ka pëshkruar shkurtimisht arkitekturën dhe afresket e **Manastirit** dhe **Kishës së T'Shelbuemit në Rubik**. Ai na jep të dhëna për mbishkrimet, gjashtë figura të shejtorëve. Në përshtimin e tij, Ippeni nënvizon faktin se vetëm pak njihet historia e këtij objekti kristian dhe se manastiri fillimisht ka qenë benediktin, më vonë është zotëruar nga françeskanët⁴⁵.

Rezultatet e gërmimeve të kontrollit, të kryera në vitin 2007 (Hoxha) dëshmojnë në mënyrë të sigurtë se: Kisha e të Shelbuemit në Rubik është themeluar në shekullin e XII mbi një vendbanim më të lashtë, i cili na dëshmohet që prej shekujve II-I para Kr. Ky pohim argumentohet me gjetjet direkt mbi sipërfaqen e truallit shkëmbor, si në zonën e absidës ashtu edhe në zonën para altarit, në nivelin e shtrojës së varreve. (Fig. 9)



Fig. 9. Kisha e të Shelbuemit dhe manastiri në Rubik

Gjatë jetës së vet kisha ka pësuar ndryshime të herëpashërëshme. Por thelbi i studimit mbetet se: “Kisha e t'Shelbuemit në Rubik demonstron në mënyrë shembullore pozicionimin e Shqipërisë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Forma planimetrike e kishës dhe harkadat e mbyllura në apsidë janë të stilit romanik, por po këtu stili i pikturës murale është qartësisht bizantin. Mbishkrimet shoqëruese në gjuhën latine dhe paraqitja e shenjtërve tipikë katolikë, dëshmojnë përsëri për ndikime nga Evropa Perëndimore”.

⁴⁴ BRYCE 1887, 657-686

⁴⁵ IPPEN 1900, 238-240

Ippeni ka dhënë një përshkrim historik dhe arkitektonik të **kishës në kepin e Rodonit**.

Ende sot na mungon një studim i detajuar i arkitekturës dhe pikturës murale të kësaj kisha. Nga të dhënat që ofron monumenti, si edhe nga koha e përmendjes së manastireve të tjerë të afërt hamendohet se kisha duhet të jetë ndërtuar në shek. XIV⁴⁶.

Nga vështrimi i parë të bien në sy dukuritë e gërshetimit kulturor, ashtu si në kishën e Rubikut. Teknika e ndërtimit me muraturë tullash ngjason me traditën bizantine, ndërsa forma arkitektonike respekton traditën perëndimore romaniko-gotike.

Me vlerë të veçantë qëndron përshkrimi i afreskut, që nuk është ruajtur deri në ditët tona. Siç e përshkruan Ippen, nën shtresën e gëlqeres, pranë altarit anësor “*shfaqet figura e Shën Mërisë, e ulur mbi një fron me Jezusin -Fëmijë në prehër. Ndërsa majtas e djathtas saj qëndron nga një engjëll*”. Më tej ai sqaron se fasada e kubesë së presbiterit ndahet në drejtimin gjatësor në tri fusha. “*Në qendër paraqitet përsëri Shën Mëria me një kurorë të madhe mbi krye, djathtas një shenjtor i cili është konceptuar në një moment predikimi (?sqaron diçka) dhe në të majtë një figurë e paqartë*”⁴⁷.

Edhe dy fakte të reja dalin nga këndvështrimi i sotëm: . **a)** Programi ikonografik me vendosjen dy herë të figurës së Shën Mërisë përballë dy altarëve të kishës, është një dëshmi se kisha në zanafillë i ka qenë kushtuar Shën Mërisë dhe jo Shna Ndout siç e njohim sot kishën.

b) Tek pjesa e mbetur e pikturës në apsidë vërehen paraqitje të një stili natyror, të cilat mund të lidhen më së miri me traditën e rilindjes evropiane⁴⁸. (Fig. 10a, b)

⁴⁶ MEKSI 2004, 188

⁴⁷ IPPEN 1907b, 34-37

⁴⁸ Vëzhgim i bërë nga prifti françeskan At. Flavio Cavallini, të cilin gjej rastin ta falenderoj për këtë informim.




Fig. 10. Kisha e Rodonit a) nga Ippen 1907; b) Kisha e Rodonit sot

Në vazhdim të kërkimeve të Ippenit janë identifikuar dhe dokumentuar me qindra kisha dhe gërmadha kishash në ultësirën bregdetare të Shqipërisë së Veriut⁴⁹.

I pajisur me formim klasik, Ippen-i ka pasur mundësinë të trajtojë në punimet e veta **kategori të ndryshme të materialit arkeologjik**. Përmendim këtu disa kategori sopatash prej bronxi, të gjetura në territorin për rreth Liqenit të Shkodrës⁵⁰. Në gjysmën e dytë të shek XX Frano Prendi ka botuar një depo të pasur me sopata të tilla të tipeve “iliro-adriatik” dhe “kelt”, që i përkasin fundit të epokës së bronxit dhe fillimeve të hekurit⁵¹.

Nga zona e Mbishkodrës dhe rrethinat e Koplikut Ippeni ka botuar me rigorozitet shkencor një mbishkrim latin nga kalaja e Marshejit, një hyjni romake (larin), një fibul “omega”, dhe dy këmbë fibulash të tjera nga Kopliku⁵². Në fshatin Kalldrën, në periferi të Koplikut, është zbuluar më vonë nga S. Anamali një varrezë e vonë romake me inventar: stela varresh, kupa me skena biblike, dhe fibula të tipeve të ndryshme, të përdorura kryesisht nga ushtria romake. Kalldrëni është identifikuar si “*vicus*” dhe stacion rrugor në rrugën romake që shkonte nga Scodra në drejtim të Naronës në Dalmaci⁵³. Nga aksi tjetër rrugor i njohur si “*via Lissus-Naissus*” Ippen sjell nga fshati Hajmel një amuletë me figura sklleverësh dhe një figurinë balte (terrakotë)⁵⁴.

Dy tabela me material arkeologjik nga varreza arbërore e kalasë së

⁴⁹ MEKSI 2004 ; HOXHA, PERZHITA, CAVALLINI, 2006.

⁵⁰ IPPEN, 1907b, 4

⁵¹ PRENDI 1984, 19-34

⁵² IPPEN, 1902b, 210-211

⁵³ ANAMALI, KOMATA, 1978, 96-106; HOXHA 2009-2010, 131-152 ; HOXHA 2015, 37-66

⁵⁴ IPPEN 1907b, 4

Dalmaces në Koman, të botuara rigorozisht nga Ippen⁵⁵, janë pasuruar nga gërmimet arkeologjike të arkeologeve Hëna Spahiu ne vitet 60 dhe 80 te shek. XX⁵⁶ dhe Etleva Nallbani si partnere e nje ekspedite shqiptaro-franceze⁵⁷, e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Në paraqitjen e monumenteve të Shqipërisë Ippeni ka përshkruar mbishkrimet dhe **stemën e princit karl Topia**, të vendosura ne Kishën e Shën Gjjon Vladimirit afër Elbasanit. Fotografia e tij për stemën nuk ndryshon shumë nga e sotmja. Mbishkrimet janë lexuar korrekt, duke iu referuar edhe studiuesve paraardhës si J. Georg von Hahn dhe Paul Träger⁵⁸.

Po ashtu një stemë tjetër të gëdhendur në gur nga Drishti, Ippeni e ka riprodhuar me fotografi dhe mendon se i përket nje familjeje feudale vendase⁵⁹. Është me interes se edhe gërmimet e vitit 1987 ne Kalanë e Shkodrës kanë nxjerrë në dritë një stemë të gëdhendur jo plotësisht në gur, me ikonografi të përafërt, e cila kontekstohet arkeologjikisht me material nga koha e feudalëve Balshaj⁶⁰. (Fig. 11a, b, c)




Fig. 11. a) Stema e Karl Topisë; b) Stema nga Drishti, Ippen 1907; c) Stema nga Kalaja e Shkodrës (1987).

Ippeni ka botuar edhe një **vulë peshkopale** me shumë interes shkencor, e cila është gjetur në fshatin Skuraj të Kurbinit në rrethin e Krujës.

⁵⁵ IPPEN 1907b, 17-18

⁵⁶ SPAHIU 1979-80, 23-46; SPAHIU 1983, 261-263

⁵⁷ NALLBANI, JULIEN, METALLA 2012, 1-20; NALLBANI, BUCHET, MATHEVOT 2013, 1-36

⁵⁸ IPPEN 1907b, 67-70

⁵⁹ IPPEN 1907b, 13, fig. 17.

⁶⁰ HOXHA, LAHI 1986, 266-268

Leximi i mbishkrimit na dëshmon praninë e dy ipeshkvive mesjetare të shuara Stefaniakës dhe Bendës, që ishin sufragane të kryeipeshkëvisë së Durrësit⁶¹.

* * *

Në trajtësën tonë u përqendruam kryesisht në aspektin arkeologjik të punimeve të Ippen-it. Por gama e studimeve të tij për Shqipërinë e Veriut është shumë e gjërë. Aty përfshihen studime folklorike, historike, të mardhënieve kishtarë dhe politike, historia e krijimit të fiseve shqiptare etj. Udhëtimet që ai ndërmoi nëpër Shqipëri i kanë dhënë mundësinë për të përgatitur edhe një material të pasur hartografik. Në këtë proces, ai njohu konkretisht vendin dhe banorët e Shqipërisë, për të cilët i lindën ndjenja të natyrëshme dashurie dhe respekti.

Për këta arsye, në vitin 1932, pikërisht tre vjetë para vdekjes (31 janar 1935), mbreti i Shqipërisë Zogu i I, e dekoroi Ippen-in me urdhërin "Skanderbeg". Ky fakt është publikuar në revistën "LEKA", (vjeti i katërt, nr. 2 -1932, fq. 63).

Artikujt shkencorë të Ippenit vazhdojnë edhe sot të rreshtohen ndër citimet e para në punimet për historinë dhe arkeologjinë e Shqipërisë së Veriut. Kjo ndodh jo vetëm për vlerat e pazevendësueshme informative, por edhe për arësye se këta punime vazhdojnë të gjenerojnë ende shkëndia produktive për kërkimin shkencor historik në këtë territor.

⁶¹ IPPEN 1907b, 22 fig. 41.

TREGUESI I ARTIKUJVE SHKENCORE TE IPPEN-IT

1. Novibazar und Kosovo, (Novipazari dhe Kosova) Wien, 1892
 2. Rascien (Rasha), Wlssenschaftliche Mittellungen asus Bosnien und der Herzegowina (shkurt WMBH) 2 - 1894, 473-482.
 3. Alte Kirchen und Kircheruinen in Albanien . WMBH 7 - 1900) 231- 242 dhe WMBH 8-1902,131-144
 4. Stare crkve po seviernoj Albaniji, Glasnik Zemaljskog Muzeja, (shkurt. GZM) 11- 1899, 607-510
 5. Prähistorische und römische Fundstätten in der Umgebung von Scutari, WMBH 8 – 1902, 207-211
 6. Stari spomenici u Albaniii, GZM, 12-1900, 511-531
 7. Eine unedirte mittelalterliche Münze aus Albanien, Numismatsche Zeilschrift (shkurt. N Z), 32- 1900,197-199
 8. Das Gewohnheitsrecht der Hochländer in Albanien, Zeitschrift fur Ethnologie, 33 -1901, 43-57, 352-363.
 9. Starine iz Albanije, GZM, 13 – 1901, 117-120.
 10. Nadgrobní spomenik kneza Karla Topije od Afbanije, GZM 13- 1901, 439-442
 11. Stare crkve (Kisha të vietra, GZM, 13 - 1901, 577- 588.
 12. Prehistorički nalazi iz Albanije, GZM, 13 – 1901, 603-608, GZM 14 – 1902, 550-552.
 13. Das religiöse Protektorat Österreich-Ungarns in der Türkei, Die Kultur, 3 - 1901/1902, 298-310
 14. Historički gradovi u Albaniji, GZM, 14 - 1902, 177-200
 15. Arheološke bjelaške iz Albanie, GZM 14 – 1902, 282; GZM 1 5 -1903, 181-183
 16. Pečatnjak jedne vec nestale biskupije u Albaniji, GZM, 14 – 1902, 367-368.
 17. Još ništa o starim crkvana u Šašu i Rubigu, GZM, 14 - 1902, 552-557
 18. Beiträge zur inneren Geschichte Albaniens im 19 Jahrhundert, Österreichisch-Ungarische Revue, 23 – 1902, 35-49, 109-132.
 19. Denkmäler verschiedener Alterstufen in Albanien, WMBH, 10 -1907, 3-70.
 20. Über die geographischen Namen in Albanien, Mitteilungen der geographiscen Gesellschaft Wien, 47- 1904, 2-10
 21. Scutari und die nordalbanische Küstenebene, ne numrin 5 të serisë: Zur Kunde der Balkanhalbinsel Reisen und Beobachtungen, Saraievo, 1907
 22. Die Gebirge des nordwestlichen Albanien, në serine: Abhandlungen der geographischen Gesellschaft Wien, Nr.7, I, Wien, 1908
 23. Die Landschaft Schpat im miltleren Albanien, Mitteilungen der geographischen Gesllschatt, 59 - 1916, 456-461.
 24. Deux épisodes de l'histoire de l'Albanie, Albania Nr. 2 -1927,58-61.
 25. Contribution à l'histoire de l'Albanie de XIII^e au XV^e siècle (1204-1444), Albania Nr.4,1932, 28-35.
- (Marrë nga seria Albanische Forschungen 7, Wiesbaden, 1967)

BIBLIOGRAFIA

- A. Alb, I. Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia, (hartuar nga L. Thallczy, C. Jiereček, E. Šufflay, Vol. I, Vindobonae, MCMXIII
- Anamali, Komata 1978. S. Anamali, D. Komata, *Varrezat e Kalldrunit (Koplik)*, Kumtari i Muzeut Popullor të Shkodrës. Nr. 3-4, Shkodër, 1978, 96-106.

- Anamali, Spahiu 1979-80. S. Anamali, H. Spahiu, Varreza arbërore e Krujës. (La necropole albanaise de Krujë), "Iliria" IX-X, 1979-1980, 47-103.
- Baçe 1975. A. Baçe, Qyteti mesjetar i Drishtit, në Monumente të Kulturës në Shqipëri, Tiranë 1975, 51-53.
- Bogdani 1684. Dok. Nr. 6. dt. 24 mars 1684. f. 218, *Relacion i Pjetër Bogdanit për gjendjen e Tivarit dhe Shkodrës me rrethe dhe të zonave malore, veçanërisht për Kelmendin*. në: Dokumente të shekujve XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë, Vëllimi IV (1675-1699) (përgatitur nga Injac Zamputi dhe Selami Pulaha) Tiranë 1990, 28-30
- Bošković 1931. Dj. Bošković, Izvještaj i kratke beleške sa putovanija, Starinar, VI, 1931, 151
- Bryce 1887 J. Bryce , Life of Justinian by Theophilus, English Historical Review, Vol. 2 (1887), 657-686
- Čilikov 2009. A. Čilikov, *Rezultatet dhe rëndësia e hulumtimeve arkeologjike të qytetit të vjetër të Shasit*. Shasi i lashtë-monument i kulturës (Përmbledhja e kumtesave nga Sesiioni Shkencor i mbajtur më 16-17 maj 2008), Ulqin 2009, 23-32
- Deroko 1930. A. Deroko, U bodinovoju prestinici Starinar V, 1928-1930, Beograd, 1930, 148
- Dyczek, Shpuza 2014. P. Dyczek, S. Shpuza, *Three years of Albanian-polish excavations in Scodra*, in: Proceedings of the international Congress of Albanian Archaeological Studies (21-22 November, Tirana 2013), Tirana, 2014, 387-398.
- Erdeljan 2016. J. Erdeljan, *Two inscriptions from the church of Sts Sergius and Bacchus near Shkodër and the question of text and image as markers of identity in medieval Serbia*. in: Texts/Inscriptions/Images - Art Readings 2016 (eds. Emmanuel Moutafrov & Jelena Erdeljan), vol. 1, 129-143. Farlato, Coletto 1817. D. Farlato J. Coletto, Illyrici Sacri, Tomus Septimus. Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis, et Sirmien-sis cum earum suffraganeis Venetiis, MDCCCXVII (1817).
- Frashëri 2002. K. Frashëri, Skënderbeu, jeta dhe vepra (1405- 1468), Tiranë, 2002.
- Gurakuqi 1943. G. Gurakuqi, Dioqezi i Sapës 1297-1941. Shkodër 1943
- Hoxha, Lahi 1986. G. Hoxha B. Lahi, Gërmimet arkeologjike ne Kalanë e Shkodrës, ILIRIA, 1986- 2, 266-268
- Hoxha, Lahi 1988. G. Hoxha, B. Lahi, Gërmimet arkeologjike në qytetin e Shkodrës, ILIRIA, 1988-2, 262-264
- Hoxha, 1990. G. Hoxha, Gërmimet arkeologjike në qytetin e Shkodrës, ILIRIA, 1990-2, 274-275
- Hoxha 1991. G. Hoxha, Gërmimet arkeologjike në murin rrethues të qytetit të Shkodrës, ILIRIA, 1991, 2 faq
- Hoxha 1994. G. Hoxha, Muri rrethues i periudhës antike të vonë në qytetin e Shkodrës, ILIRIA, 1994, 1-2, 231-241.
- Hoxha 2003. G. Hoxha, Scodra dhe Praevalis në Antikitetin e Vonë, (Scodra and Praevalis in the Late Antiquity)
- Botim i Institutit të Arkeologjisë Tiranë, Shkodër 2003.

- Hoxha 2007. G. Hoxha, Lissus dans la basse Antiquité, Épire, Illyrie, Macedoine... (Mélanges offerts au Professeur Pierre Cabanes) Collection ERGA, Recherches sur l'Antiquité, 10, Clermond-Ferrand (France), 2007, pp. 81- 87. Hoxha 2009-2010. G. Hoxha, *Comendatio animae*- Lutje paradigmë dhe skena biblike në ritin mortor paleokristian nga provinca Praevalis (Commendatio animae- Paradigm prayer ans biblical scenes of the early Christian funerary ritual in the Praevalis province). ILIRIA, XXXIV, 2009-2010, 131-152
- Hoxha 2011. G. Hoxha, Një pagëzimore paleokristiane nën themelet e kishës së Shën Kollit në Lezhë (A Paleochristian baptistery in the foundations of the church of St. Nicholas in Lezha), ILIRIA - XXXV, 2011, 285-306
- Hoxha 2014a. G. Hoxha, Die Transformationsprozesse in der Stadt Lissus während der Spätantike. in: Proceedings of the International Congress of Albanian Studies (Tirana, 21-22 November 2013), (ed. by L. Perzhita, I. Gjipali, G . Hoxha, B. Muka), Tiranë 2014, 511-526.
- Hoxha 2014b. G. Hoxha, Risi që lindin mbi petkum e së vjetrës: Dukuri metamorfoze në qytetin Lissus gjatë periudhës antike të vonë. ILIRIA- XXXVIII - 2014, Tiranë 2015, 41-67.
- Hoxha 2015. G. Hoxha, Nekoliko kasnoantičkih fibula iz sela Kaldrun (Koplik).(Some late Roman fibulae from the village Kalldrùn (Koplik), Nova Antička Duklja VI, Podgorica 2015, 37-66
- Hoxha, Përzhita, Cavallini 2007. G. Hoxha, L. Përzhita, F. Cavallini, Monumente historike të kultit të krishterë në dioqezën e Lezhës (Monumenti storici di culto Cristiano della Diocesi di Lezha, Lezhë, 2007
- Ippen 1900. Th. Ippen, Alte Kirchen und Kircheruinen in Albanien, in Wissenschaftlichee Mittellungen aus Bosnien und der Herzegowina (shkurt WMBH) 7, 1900, 231-242
- Ippen 1902a. Th. Ippen, Alte Kirchen und Kircheruinen in Albanien, Fortsetzung, in Wissenschaftlichee Mittellungen aus Bosnien und der Herzegowina (shkurt WMBH) 8, 1902, 131-144.
- Ippen 1902b. Th. Ippen, Prähistorische und römische Fundstätten in der Umgebung von Scutari, Wissenschaftlichee Mittellungen aus Bosnien und der Herzegowina (shkurt WMBH) 8, 1902, 207-214.
- Ippen 1907a. Th. Ippen, Scutari und die nordalbanische Küstenebene, in der Reihe: Zur Kunde der Balkanhalbinsel, Reisen und Beobachtungen, Nr. 5, Sarajevo 1907
- Ippen 1907b. Th. Ippen, Denkmäler verschiedener Alterstufen in Albanien, in Wissenschaftlichee Mittellungen aus Bosnien und der Herzegowina (shkurt WMBH) 10, 1907, 3-72
- Islami 1971. S. Islami, Qyteti ilir në Zgërdhesh. (La ville illyrienne a Zgërdhesh), "Monumentet" 1971, 1, f. 23-41
- Janković 2007. Dj. Janković, Srbsko pomorje od 7. Do 10 stoljeća (Serbian Maritime from 7-th to 10-th century), Beograd 2007.

- Jastrebov 1880. I. S.Jastrebov, O pravoslavnim starim i novim crkvama u Staroj Zeti (sadašnjem skadarskom okrugu), Akademia Nauka. Glasnik Srbskog učenog društva, knj. XLVIII, 1880. 367-369
- Kamsi 1964. K. Kamsi, Drishti, Revista shkencore e Institutit Pedagogjik Dyvjeçar Shkodër, Nr. 1, Shkodër 1964, 163-166
- Kamsi 2000. V. Kamsi, *Kisha e kuvende të Shkodrës me rrethina në Mesjetë*, Krishtërimi ndër Shqiptarë (Simpozium nderkombëtar Tiranë, 16-19 Nëntor 1999), Shkodër 2000, 120-130
- Karaiskaj 1977-78. Gj. Karaiskaj, Një varrezë e shek. III-IV në qytetin ilir të Zgërdheshit. (La necropole des IIIe-IVe siecles dans la ville illyrienne de Zgërdhesh), "Iliria", VII-VIII, 1977-1978, 201-216.
- Karaiskaj 1987. Gj. Karaiskaj, *Qyteti shqiptar i Sardës*, Monumentet, 1-1987, 73-83
- Kiel 1990. M. Kiel, Ottoman architecture in Albania, 1385-1912, Paperback, 1990
- Komata 1982. D. Komata, Të dhëna të reja arkeologjike nga Kalaja e Krujës. (Nouvelles donnees archeologiques sur la forteresse de Kruja), "Iliria", 1982, 1, f. 221-232.
- Korač 1961. V. Korač *Sveti Sergije i Vakh na Bojani*, Starinar, nova serija, Kniga XII / 1961, Beograd, 1961.
- Korač 1965. V. Korač, Graditeljska škola Pomorja, Beograd, 1965, 58, 65, 98
- Kovačević 1967. J. Kovačević, Istorija Crne Gore (shkurt. ICG), 1967, 324.
- Lahi, Hoxha 1987. B. Lahi, G. Hoxha, Gërmimet arkeologjike në qytetin e Shkodrës, ILIRIA, 1987, 2, fq. 252-254
- Lahi, Hoxha 1989. B. Lahi, G. Hoxha, Gërmimet arkeologjike në qytetin e Shkodrës, ILIRIA, 1989-2, 295-296
- Malaj 2015. E. Malaj, Historia dhe fizonomia e një qyteti mesjetar shqiptar- Drishi, Tiranë 2015
- Meksi 1983. A.Meksi, Arkitektura Mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1983
- Meksi 2004. A.Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV), Tiranë 2004
- Mijović, Kovačević 1975. P. Mijović, M. Kovačević, Gradovi i Utverdjena u Crnoj Gori, Beograd-Ulcinj, 1975
- Nallbani, Buchet 2008. E. Nallbani, L. Buchet, *Lezha (Lissus) de l'Antiquité tardive au Moyen Âge. Topographie du site et espace des morts*?. Les destines de l'Illyricum méridional pendant le haut Moyen Âge, Mélanges de l'École Française de Rome, Moyen Âge, 120-2, 2008, 239-261.
- Nallbani, Buchet 2012. E. Nallbani, L. Buchet, Information des fouilles: Lezha (Lissos) (Les fouilles dans la cimetièr), Iliria, XXXVI, 2012, 479-487
- Nallbani, Julien, Metalla 2012. E. Nallbani, M. Julien, E. Metalla, Komani [Dalmaceë (Albanie), Déroulement de la campagne 2011, Chronique des activités archéologiques del'École française de Rome, Balkans , 2012, 1-20
- Nallbani, Buchet, Mathevet 2013. E. Nallbani, L. Buchet, Chr. Mathevet, Komani [Dal-

- maceë (Albanie), D roulement de la campagne 2012, Chronique des activit s arch ologiques del' cole fran aise de Rome, Balkans , 2013, 1-36
- Oettel 2104. A. Oettel, Von der illyrischen Festung zum r mischen *oppidum*. Die Transformationsprozesse der illyrischen Stadt Lissos/Lissus. In: Proceedings of the International Congress of Albanian Studies (Tirana, 21-22 November 2013), (ed. by L. Perzhita, I. Gjipali, G. Hoxha, B. Muka), Tiran  2014, 455-467
- Pettifer, Cameron 2008. J. Pettifer, A. Cameron, *The Enigma of Montenegrin History The Example of Sva *. Bota Shqiptare, Tirana, 2008, ISBN 978-999956-11-78-1, p. 1-21 in :<http://www.professorjamespettifer.com/uploads/files/pdf/The%20enigma%20of%20montenegrin%20history.pdf>
- Pochmarski, Hoxha 2005. E. Pochmarski, G. Hoxha, Lissos: Quellen und Stadtgeschichte, R misches  sterreich 28, 2005, 243-251
- Prendi 1969. F. Prendi, Vendvarrimi i Sk nderbeut, Konferenca e Dyt  e Studimeve Albanologjike, (12- 18 janar, 1968), Tiran , 1969, 241 -248.
- Prendi, 1975. F. Prendi, *Aspects de la vie sociale, economique et culturelle de Lissos*. "Utverdena Ilirska Naselja", 1975, Posebna Izdanja, Knjiga XXIV, pp. 149-163, 4 pl.
- Prendi 1979-80. F. Prendi, *Nj  varrez  e kultur s arb rore n  Lezh *, "Iliria", IX-X, 1979-1980, f. 123-146.
- Prendi 1981. F. Prendi, *Dy mbishkrime nd rtimi nga qyteti ilir i Lisit. (Deux inscriptions de la ville illyrienne de Lissos)*, "Iliria", 1981, 2, f. 153-163.
- Prendi, 1984. F. Prendi, Nj  depo s patash parahistorike nga Torovica e Lezh s. (Un d p t de haches pr historiques   Torovica de Lezha) Iliria, XIV, 2, 1984, 19-34
- Prendi, Zheku 1971 . F. Prendi, K. Zheku, *Qyteti ilir Lisit. Origjina dhe sistemi i fortifikimit t  tij. (La ville illyrienne de Lissus. Son origine et le systeme de ses fortifications)*, "Iliria" 1972, II, f. 215-244.
- Prendi, Zheku 1971b. F. Prendi, K. Zheku, *Lisi n  drit n e t  dh nave t  reja arkeologjike. (Lissus a la lumiere de plus recentes donnees archeologiques)*. Res. fr. "Monumentet" 1971, 2, f. 7-23.
- Prendi, Zheku 1983. F. Prendi, K. Zheku *Vazhdim sia etnokulturore iliro-arb rore n  qytetin e Lisit. (Continuite ethnoculturelle ilyro-albanaise dans la ville de Lissos)*, "Iliria", 1983, 1, 203-208.
- Prendi, Zheku 1986. F. Prendi, K. Zheku *Rreth zhvillimit urbanistik t  Lisit (fundi i shek. IV-I p.e.son ) (About the urbanistic development of Lissus - the end of 4th to the 1st cent. BC)*, "Iliria", 1986, 1, f. 57-66.
- Pushimaj 2016. P. Pushimaj, Drivastum - Raport paraparak nga ekspedita "Drisht 2015" Candavia 6, 2016, 231-244.
- Spahiu 1979-80. H. Spahiu, Varreza arb rore e Kalas  s  Dalmaces. (La necropole albanaise de Forteresse de Dalmace), "Iliria", IX-X, 1979-1980, f. 23-46.
- Spahiu 1983. H. Spahiu, G rmime t  vitit 1983 – Koman. (Fouilles 1983 – Koman), "Iliria", 1983, 2, f. 261-263,

- Spahiu, Komata 1974. H. Spahiu, D. Komata, Shurdhaha – Sarda, qytet i fortifikuar mesjetar : Rezultatet e gërmimeve të viteve 1967-1970, "Iliria", III, 1974, 257-328
- Shpuza, Dyczek 2012. S. Shpuza, P. Dyczek, Gërmimet e vitit 2011 në Shkodër, Iliria, XXXVI, 2012, 439-445
- Šufflay 1924. M. Šufflay, Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters, Wien und Leipzig 1924.
- Theiner I, 1863. A.Theiner, Vetera monumenta slavorum meridionalium, Tomus Primus, Romae 1863. DXLVI f. 380; DLXXXIII, 408 - 409
- Valentini 1942. G. Valentini, Contributi alla cronologia albanese, vol. I (337-395), Roma 1942
- Wernicke 1967. A.Wernicke, Theodor Anton Ippen : ein österreichischer Diplomat und Albanienforscher, Albanische Forschungen, 7, Harrasowity, Wiesbaden, 1967.
- Zagarčanin 2017. M. Zagarčanin, Srednjovjekovni grad Svač Rezultati iskopavanja 2012. godine i nova zapažanja
- Medieval town Svač Results of excavation carried out 2012 and new observations, Nova Antička Duklja VIII, Podgorica 2017, 177-234

Albulena BLAKAJ-GASHI, Prishtinë

RAPORTET KULTURORE SHQIPTARO-GJERMANE

Me këtë punim është tentuar të kapen raportet e hershme kulturore shqiptaro- gjermane apo, thënë më saktë, njoftimet për shqiptarët në botimet gjermane, duke filluar nga ato të shekujve 16-18. Te botimet shqiptare (Barleti, Budi, Bardhi, Bogdani) kur janë edhe me tema biblike, nuk dimë të ketë hyrë ndonjë gjë gjermane, reformacioni i Martin Luterit a tjetër. Botimi i parë gjerman, me Shqipëri e shqiptarë brenda¹, është i autorit Hartman Schedel, 1493 (*Hartmann Schedel (1440-1514)*). Vepra e tij e njohur si "Schedelsche Weltchronik" ose "Nürnberg Chronik" (*Kronika botërore e Schedel-it* ose *Kronika e Nurnbergut*) është një ritregim biblik i ilustruar i historisë së botës, që përcjellë historinë njerëzore duke u mbështetur në Bibël dhe që përfshin historinë e shumë qyteteve. *Rëndësia e kësaj kronike për popullin shqiptar është se Hartmann Schedel në "Kronikën" e tij, jep disa të dhëna historiko-geografike për disa qytete shqiptare, pastaj informacione për Ilirinë, Epirin dhe Arbërinë, të mbështetura kryesisht te autorët antikë si dhe disa njoftime për prejardhjen e shqiptarëve etj.*² Thuhet se ka qenë libri më i lexuar nga masat e gjëra në shekullin e pesëmbëdhjetë, me përjashtim të Biblës së Gutenbergut (1454), natyrisht. Ishte pra një best-seller i kohës së tij. Kronika e Nurembergut përmban atë që është ndoshta përshkrimi më i hershëm i Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor i botuar në Evropën qendrore.

Siç u cek më sipër, punimi do t'i ndjek gjurmët e pranisë së kulturës shqiptare, para së gjithash letërsisë shqipe në disa nga enciklopeditë gjermane të shekujve 16-21, që nga ajo e vitit 1709, të kohës kur edhe Leib-

¹ Megjithëse kam hasur të përmenden (Muslija, Xh.) edhe dy botime më të hershme: Udhëpërshkrimi drejt Nurenbergut nga Hans Schiltberger (1427) dhe Kronika austriake nga Jakob Unrest (1466-1500), por deri tani nuk kam mundur ta vërtetoj e as ta gjej të ndonjë autor tjetër.

² Lala, E., Ahmeti, M.: Një botim gjerman i 1493, ku flitet për Skënderbeun, Epirin dhe Ilirinë, Fjala e lirë, I02.20.2010, <http://www.fjala.info/arkiv/fjala1/2010/02/02/>

nitz-i, interesohet për gjuhën e lashtësinë e shqiptarëve. Sepse, elementi thelbësor i marrëdhënieve kulturore qëndron në ndërmjetësimin e letërsisë, duke qenë se ajo është bartëse e ideve krijuese të një populli. Mirpo, në përgjithësi ka shumë pak të dhëna për letërsinë shqipe, Shqipërinë e shqiptarët, për të cilët, edhe pse jo larg gjeografikisht, dihet më pak se, siç ceket shpesh në studime të ndryshme, për viset më të thella të Amazonës. Sa për letërsinë artistike shqipe, ajo është pak e njohur, sepse është relativisht e re në krahasim me letërsitë e tjera të Evropës. Arsyet dihen. Sigurisht që edhe mungesa e veprave të përkthyer në gjermanisht, ka ndikuar në mosnjohjen e letërsisë shqipe te gjermanët. Edhe pse, vepra e Marin Barletit “Historia e Skënderbeut” është përkthyer së pari në gjermanisht, pak kohë pas botimit në latinisht dhe *nëse veprën e Barletit do ta konsideronim vepër letrare, atëherë Pinicianus do të ishte përkthyesi i parë gjerman i shkrimit shqip*³.

Ajo është përkthyer për herë të parë nga Johan Piniciani dhe botuar në Augsburg më 21 shkurt 1533. Me përkthimin e veprës së Barletit në gjermanisht njoftimet për Shqipërinë e Skënderbeut arrijnë vrullshëm. Vetëm në shek. 16 "Historia e Skënderbeut" në Evropë i kishte 16 botime. Skënderbeu ishte një mit evropian, para se të ishte mit shqiptar. Arsye për këtë Kadare përmend faktin se Kastrioti ishte ideatori, programuesi i një orientimi për shqiptarët dhe krejt Ballkanin, orientimin drejt perëndimit dhe shton se ishte i vetmi prijës shqiptar që komandoi trupa të bashkuara shqiptare e evropiane kundër shtetit osman. Përkthyesi Johan Piniciani, në hyrje, si një ndër arsyt e sjelljes së veprës së Barletit në gjermanisht jep ngushëllimin e gjermanëve të tmerruar nga, siç shkruan “*sulmet e përditshme të tiranëve të tmerrshëm, përndjekësve turq të emrit të krishterë, ndoshta duke menduar se turku është i pamposhtur, kështu që do të nënshtrojë gjithë botën, dhe se fuqisë së tyre nuk mund t’i rezistojë askush e në historinë në vijim shihet qartë se turqit mund të munden lehtë, shpesh edhe nga një popull i vogël, dhe se fuqia e tyre e madhe u mposht, e madje edhe u*

³ Elsie, Robert, “Rezeption albanischer Literatur im deutschen Sprachraum”, Aspekte der Albanologie,-Akten des Kongresses “Stand und Aufgaben der Albanologie heute”, 3-5 Oktober 1988, Universität zu Köln/ Berlin, 1991 in Kommission bei Otto Harrasowitz, Wiesbaden

shtyp me një ushtri të vogël, gjë që mund të ndodhë edhe në ditët e sotme". Më tutje ai shkruan: *Që të mos mendohet se dua të tregoj përralla ose të ringjallë një tavolinë të rrumbullakët [...ë është me rëndësi të thuhet se Skënderbeu ende jeton në mendjet e njerëzve, sepse ai vdiq tek pas vitit 1466 në moshën 63 vjeçare, përderisa tani kemi vitin 1533.*⁴

Gjithë ajo që u tha mësipër për *Historinë e Skënderbeut* në Gjermani, besoj se ka bërë që te enciklopeditë e shekullit 18. të jepet edhe një pasqyrë e Shqipërisë si vend dhe e shqiptarëve, si popull trim dhe me shumëtribute tjera pozitive, por interesante është se sa shumë vend zë figura e Skënderbeut në to, e posaçërisht në atë të Zedler (1732) ku Shqipërisë i jepet një kolonë, ndërsa Skënderbeut mbi katër sosh. Në to, si zë i veçantë, paraqitet edhe Marin Barleti.

Ky raport ndërron në enciklopeditë e konsultuara të viteve në vijim. Kështu, në ato të shekullit të 19., siç janë p.sh. leksikonet e njohura "Meyer's" të viteve 1840, 1871, dhe ai i vitit 1874, apo "Brockhaus" i vitit 1892, zgjerohet në shumë faqe dhe thellohet në detaje përshkrimi për Shqipërinë, historinë, popullin e personalitetet historike të saj, e ka më pak të dhëna për vetë Skënderbeun. Në to nuk ka pastaj fare të dhëna për Marin Barletin.

Për fat të mirë, mesi i shekullit të 19-të, karakterizohet nga një interesimi i madh i studiuesve gjermanë për gjuhën dhe letërsinë popullore shqiptare. Studiuesit gjerman, anise me interesim primar për gjuhën, bëjnë përkthimet e para letrare nga shqipja. Këto ishin përkthime nga letërsia e pasur popullore, pra kryesisht përralla, këngë e legjenda, dhe u shfaqën së pari në veprat e: Johann Georg von Hahn, Karl Heinrich Theodor Reinhold, Franz Mikolsich, Gustav Meyer, Holger Pedersen e Gustav Weigand. Më pas u botua edhe një numër i veprave kryekëput me përkthime të letërsisë popullore shqipe, si: *Griechische und Albanische Märchen* (1864) e Johann Georg von Hahn, *Neugriechische Märchen* (1919) e Paul Kret-

⁴ Pinniciani, Johann: Ein Vorred des Authors, te: Barletij, Marini: *Des aller streytparsten vnd theüresten Fürsten vnd Herrn Georgen Castrioten genannt Scanderbeg Hertzogen zu Epiro vnd Albanien... Ritterliche thaten, so er zu erhalten seiner Erbland, mit den Türkischen Kaysern in seinem leben, glücklich begangen. In Latein beschriben vnd yetz durch Joannem Pinicianum Newlich verteutsch.* Augsburg, 1533

schmer, *Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde, Zwischen Drin und Vojussa -Märchen aus Albanien* (1922) dhe më vonë *Die geflügelte Schwester und die Dunklen der Erde* (1952), të Maximilian Lambertz.

Veprat e këtyre autorëve luajtën një rol shumë të madh edhe në njohjen e letërsisë shqipe të gjermanët. Për shembull, përderisa në hyrje të pjesës së parë të studimeve të veta *Albanesische Studien* (1884), G. Meyer shkruan të ketë pasur pak burime, në hyrjen e studimit të dytë e shohim të pohojë se: “*Prej kur kam botuar pjesën e parë të këtyre ‘Albanesische Studien’ shumë njoftime nga anë të ndryshme janë bërë pjesë e punës sime, të cilat përveç tjerash kanë plotësuar dhe zgjeruar edhe materialin bibliografik [...]*”.⁵ Mes shkrimtarësh të cilët i kanë dërguar materiale dhe shkrime të veta, ai përmend Konstandin Kristoforidhin dhe Jeronim de Radën, të cilët, siç do të shohim, do të jenë emra të përmendur edhe te enciklopeditë.

Në literaturën e konsultuar, formulimi **Gjuha dhe Letërsia Shqiptare** si i veçantë, për herë të parë përdoret në leksikonin e madh të “*Meyer*”, të vitit 1906, e pastaj të njëjtin e pranojnë dhe e përdorin edhe te të tjerat të viteve në vijim, si “*Der Grosse Brockhaus*” i vitit 1928, ku përveç për letërsinë shqipe, në zëra të veçantë shkruhet edhe për dy autorë, që nga e njëjta konsiderohen si më të rëndësishmit e letërsisë shqipe, për Jeronim de Radën dhe Gjergj Fishtë.

Tek enciklopeditë tjera, para së gjithash te “*Brockhaus*”, që nga botimi i vitit 1966 e tutje, duket se rritet interesimi për kulturën e letërsinë shqipe, e me këtë rritet gradualisht edhe numri i autorëve të prezentuar dhe zgjerohet tema, kurse numri më i madh i shkrimtarëve shqiptarë normalisht na shfaqet te botimi i vitit 2006, që shpjegohet me demokratizimin e hapjen e Shqipërisë dhe me çlirimin e Kosovës, rezultat i të cilave doemos që ka qenë qarkullimi më i madh i botimeve dhe i informacioneve letrare e kulturore.

Botimet tjera të cilat do t’i veçoja, për nga numri i autorëve apo gjerësia e paraqitjes së letërsisë shqipe në to, do të ishin edhe leksikonet e

⁵ Meyer, Gustav: *Albanesische Studien* II, In Commission bei Carl Gerold’s Sohn, Wien, 1883, f. 17.

veçanta të letërsisë si “Brockhaus- Der Literatur” (në III vëllime) i vitit 1988, “Kindlers Neues Literatur Lexikon”, në 20 vëllime, i botuar më 1992 dhe “Lexikon der Weltliteratur” i autorit Gero von Wilpert, i botuar më 2004. Në të gjitha këto leksikone paraqiten shkrimtarë shqiptarë me një biografi dhe veprimtari të shkurtër letrare dhe ndonjëherë edhe me përshkrim të shkurtër të veprave më të rëndësishme të tyre.

Del interesant se autorët si Jeronim de Rada, Naim Frashëri dhe At Gjergj Fishta, pra treshja e madhe e klasikëve të letërsisë shqipe, përmenden kudo. Për ta, pothuajse në të gjitha enciklopeditë, thuhet se: *“veprat e tyre idenë themelore e kanë të përbashkët: lirinë e popullit shqiptarë dhe krijimin e një shteti unik”*⁶.

Ka enciklopedi ku Gjergj Fishta është i përfshirë si i vetmi shkrimtar i letërsisë sonë. Të gjitha, thuajse pa përjashtim, e konsiderojnë atë si autorin më të rëndësishëm shqiptar, i cili *“krijoi epin kombëtar më madhështor “Lahuta e Malcisë” (1905), që paraqet luftën shekullore të shqiptarëve për liri”*⁷ Në rrethanat historike nëpër të cilat kalonin shqiptarët, kjo është shumë e kuptueshme. Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë osmane. Po edhe kjo vetë përbën atë dimensionin e posaçëm të prezentimit të letërsisë sonë në këto botime gjermane, sepse këta, pra autorët tonë, paraqiten si autorë nga Shqipëria dhe fatmirësisht jo si autorë nga Turqia.

Në enciklopeditë e konsultuara gjermane më të hershme se ajo e vitit 1906, në të cilën, siç u tha, se për herë të parë na shfaqet formulimi **Letërsi shqipe** si zë i veçantë, në të gjitha thuhet po e njëjta gjë, se *në këtë gjuhë, pra shqipe, nuk ka letërsi, përveç asaj popullore. “Në fakt, alfabeti grek përdoret për të shkruar fjalët shqipe, por pasi që gati çdo shqiptar kupton greqisht, dhe greqishtja edhe ashtu është gjuhë që përdoret jashtë shtëpisë, atëherë edhe shkruhet në këtë gjuhë”*, shkruan “Meyer’s Lexikon” i vitit 1871.⁸

“Nëse mund të flitet për letërsi, atëherë vetëm te shqiptarët e Italisë, të cilët të nxitur nga kultura italiane, kanë provuar shumëfish që gjuhën amtare ta vejnë në shërbim të krijimtarisë letrare”, thuhet në po të njëjtin

⁶ Meyers Enzyklopädisches Lexikon, Mannheim, Zurich, Wien, 1971, faqe 615

⁷ Knaurs Lexikon der Weltliteratur, München, 1995, faqe 228

⁸ Meyer’s Conversations Lexikon, Leipzig, 1871, fq.377

leksikon, por tani të vitit 1906. Ndërsa, nga Shqipëria e vërtetë, siç quhet aty, ku kanë vepruar disa autorë të turqëzuar si Nezim Bej, janë mbledhur këngët popullore dhe përrallat në veprat e Hahn-it, Dozon-it e Meyer-it, thekson leksikoni Meyer's i 1906-tës.

Në kohët e fundit, në mesin e literatëve të Shqipërisë, sipas të njejtit burim, më i vyeshmi është Konstantin Kristoforidhi nga Elbasani, i cili mundohet për krijimin e një gjuhe të shkruar shqipe, shkruan më tutje te po e njëjta. Ai, përveç shumë librave mësimorë, shkroi edhe një gramatikë shqiptare të dilalektit tosk (Konstantinopojë 1882) dhe bëri përkthimet e Dhjatës së Re dhe pjesë të së Vjetrës.

Letërsia pas pavarësisë së Shqipërisë

Shqiptarët kanë një letërsi ekzistuese popullore të përbërë nga këngët popullore, përrallat e fjalët e urta dhe një letërsi artistike ende në filllet e saj, shkruan leksikoni i madh i "Brockhaus", i vitit 1928.

Fillet e krijimtarisë së shkruar letrare janë në shërbim të kishës. Më i vjetri përkthim i Biblës deri më tani i botuar, (pra flasim gjithnjë për Brockhaus te vitit 1928), është ai i Gjon Buzukut i vitit 1555. Shekullit të 17 i takojnë autorët kishtarë si Bardhi, Budi e Bogdani. Fillet e një letërsie të mirëfilltë artistike janë nga shqiptarët e Italisë, pohon edhe ky leksikon.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i Letërsisë Shqipe në këtë enciklopedi përshkruhet me zhvillimet e ndara te gegët e toskët, duke e lidhur tek gegët me emrin e Gj. Fishtës, Shirokës, Gurakuqit, Gjeçovit, Xhuvanit, Mjedjes, Mosit, e shumë të tjerëve. Ndërsa, sipas tyre, përfaqësuesit e letërsisë në dialektin tosk janë: Asdreni, A. Z. Çajupi, Faik Bej Konica, Peshkop Fan Noli, Midhat Bej Frashëri, M. Grameno, L. Poradeci e të tjerë. Synohet themelimi i një gjuhe të përbashkët letrare, me bazë dialektin e Elbasanit, shkruan krejt në fund ky leksikon i 1928.

Aty, biografitë e dy autorëve që veçohen, Jeronim de Rada, të cilin, pos tjerash, e quajnë edhe themelues të letërsisë shqipe të kohës së re, dhe Gjergj Fishta, të cilin, me epin e vet "Lahuta e Malcisë", në të cilin paraqet luftërat e shqiptarëve të veriut me malazezët, e konsiderojnë shkrimtarin më të rëndësishëm shqiptar, na dalin si zëra të veçantë. Përkthimi nga Maximilian Lambertz në gjermanisht (1958) i epit "Lahuta e Malcisë" të

Gjergj Fishtës, që paraqet më së miri kalimin nga letërsia popullore në atë artistike, paraqet një tjetër arritje të mahnitshme. Në hyrje Lambertz shkruan: “Die ‘Laute des Hochlandes’ ist das bedeutendste Werk der albanischen Literatur. [...] Es verdient durch Uebersetzung in andere Sprachen in die Weltliteratur Eingang zu finden⁹ (‘Lahuta e Malcisë’ është vepra më e rëndësishme e letërsisë shqipe. [...] Përmes përkthimit në gjuhë tjera e meriton të bëhet pjesë e letërsisë botërore)”. Mbi shembullin e epit të Fishtës ai u mundua të tregojë lindjen e një epi artistik nga këngët popullore dhe tërhoqi paralele me Homerin¹⁰.

Në vitin 1972, te Meyer’s Lexikon, Fishta cilësohet si shkrimtari i cili “me epin “Lahuta e Malcisë” mund të kërkojë vend në letërsinë botërore”.

Këso kohe, nuk ka ndonjë risi dhe paraqiten po të njejtët shkrimtarë, pra klasikët e letërsisë shqipe. Ndër shkrimtarët që paraqiten në këtë kohë, më shpesh se më herët apo edhe më vonë, është Noli, politikan, përkthyes edhe i Servantesit e Shekspirit, por edhe autor i “së vlefshmes History of Skanderbeg”¹¹.

Në enciklopeditë në vijim, si “Brockhaus” për letërsi, e vitit 1988, në të cilën thuhet se: “Letërsia shqipe, në kuptim të ngushtë, fillon me “Këngët e Milosaos” të de Radës”, vërehet sërish një interesim më i madh për letërsinë shqipe. Tani na paraqiten më shumë shkrimtarë shqiptarë si zëra të veçantë. Ata më së shpeshti janë: Skiroi, Noli, Asdreni, Migjeni, Çajupi, Mjedja, Poradeci, Spasse, Koliqi, Camaj e Kadare. Shembulli më i mirë i këtyre do të ishte enciklopedia e madhe “Brockhaus” e vitit 2006.

Megjithëse, sipas Robert Elsie-t, pas rënies së interesimit për letërsinë shqipe në vitet e gjashtëdhjeta, në vitet e shtatëdhjeta do të bëhet një numër shumë i madh i përkthimeve të veprave të shkrimtarëve shqiptarë, madje edhe atyre bashkëkohor. Në këto vite u botuan edhe

⁹ Lambertz, Maximilian: *Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos- Lahuta e Malcis- Laute des Hochlandes, Eine Einführung in die albanische Sagenwelt*, Otto Harrasowitz, Leipzig, 1949, fq. 17.

¹⁰ Krahaso: Lambertz, Maximilian, <https://www.deutsche-biographie.de/pnd121916731.html>

¹¹ Meyers 1961-64

disa antologji të letërsisë shqipe.

Me suksesin e madh që ka pasur Ismail Kadare në tërë botën dhe pas përkthimit të një numri të madh të veprave të tij në gjermanishte, duke filluar me romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” përkthyer në fillim nga Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, edhe te enciklopeditë e viteve të fundit zë vendin kryesor në paraqitjen e letërsisë shqipe. Kadare, te botimi i “Brockhaus”, i vitit 2006, konsiderohet “*shkrimtari më i rëndësishëm kombëtar shqiptar dhe shkrimtari i vetëm modern i Shqipërisë i cili edhe jashtë vendit fitoi nam të madh*”¹².

Do ta veçoja këtu, poashtu edhe leksikonin “Metzler” të letërsisë, botuar në vitin 2006, i cili Ismail Kadaresë i jep një vend të merituar dhe e rradhitë atë në mesin e 1000 autorëve më të mirë në botë që nga antika e deri më sot dhe për të jep një pasqyrë të mrekullueshme. Ai konsiderohet prozaisti më i madh i letërsisë bashkëkohore shqiptare dhe “në të njëjtën kohë zëri dhe kronisti i vendit të tij”. Veçanti e veprave të tij është “*një ndjenjë pesimiste, e ngajshme me atë të Franz Kafka-s, dhe ato janë të mbushura me tradita arkaike dhe trashëgimi të Shqipërisë; ato shkrijnë shpesh realen me fantastiken dhe shpirti i tyre është, ashtu siç thotë poeti kombëtar shqiptar Pashko Vasa, se feja e shqiptarit është shqiptaria, gjithnjë patriotike, e nacionaliste*”¹³, thuhet më tutje te leksikoni “Metzler”.

Karakteristikën tjetër të këtyre prezentimeve e përbën edhe fakti që janë bërë të njohur dhe janë përfshirë më dendur autorët të cilët kanë qenë temë e studimeve të dijetarëve e të albanologëve gjermanë, duke filluar nga Johan Georg Hahn me studimet e tij shqiptare të viteve 1854 e të mëvonshme, pastaj Weigand-i, Meyer-i, Dozoni, Lambertz-i, Jokl-i, etj., do të thotë që studimet e tyre kryejnë një shërbim tejmase pozitiv karshi kombit dhe kulturës sonë.

Ndërsa, për kohën e tashme kur edhe kultura shqiptare ka nivel më të lartë të zhvillimit, për prezantimin e saj te gjermanët nuk mund të kapërcehen Joachim Röhm dhe Hans-Joachim Lanksch, dy përk-

¹² *Brockhaus Enzyklopädie* in 30 Bde., Leipzig, Mannheim, 2006, fq., 241.

¹³ METZLER, Lexikon der Weltliteratur, 1000 Autoren von der Antike bis zur Gegenwart, J.B. Metzler Verlag, Stuttgart und Weimar, 2006, fq., 231.

thyes të rëndësishëm të letërsisë shqipe në gjermanisht. Duke përzgjedhur, Röhm krijimtarinë e shkrimtarëve të njohur e Lanksch, autorët më të heshtur, ose, siç thotë për vete: *jam pak ndryshe nga përkthyes të tjerë. Përveç kësaj, përkthej poezi. në këtë gjini nuk ka tekste të lehta. Dhe nëse ka, nuk meritojnë të përkthehen*¹⁴, arrijnë të bëjnë një pasqyrim më të plotë të letërsisë e kulturës shqiptare.

Lanksch është i impresionuar me poetët që përkthen, si: Martin Camaj, Kasëm Trebeshina, Frederik Rreshpja, Jamarbër Marko. *Autorët që përzgjedh për të përkthyer Lanksch, me gjithë profilin e tyre të për individual, sidomos ata që u përmendën, puqen në disa pika të përbashkëta. Sipas Lanksch: “Janë fjalëpak. Tek ata nuk gjen stolisje e fjalë të tepërta. Këta autorë rrinë larg realizmit, poezisë deskriptive dhe narrative”.*¹⁵

Megjithëse ka përkthyer krijime të shkrimtarëve të ndryshëm, si: Lindita Ahmeti, Fatos Arapi, Eqrem Basha, Mirko Gashi, Fatos Kongoli, Anton Pashku, Ali Podrimja, Rexhep Qosja, Agron Tufa, Visar Zhiti e shumë të tjerë, Joachim Röhm njihet para së gjithash si përkthyes i Ismail Kadaresë. Pjesa më e madhe e veprave të Kadaresë janë edhe në gjermanisht, falë Joachim Röhm.

¹⁴ Guma, Arlinda: *Biseda me Hans-Joachim Lanksch*, Politiko, 20.09.2017.

¹⁵ Demo, Elsa: *Tre shkrimtarët e mi jashtëklororë*, *Shekulli*, 19.12.2012.

Literatura:

1. **Allgemeines Historisches Lexikon**, verlegt von Thomas Fritsch, Leipzig, 1709.
2. Barletij, Marini: *Des aller streytparsten vnd theüresten Fürsten vnd Herrn Georgen Castrioten genannt Scanderbeg Hertzogen zu Epiro vnd Albanien... Ritterliche thaten, so er zu erhalten seiner Erbland, mit den Türckischen Kaysern in seinem leben, glücklich begangen. In Latein beschriben vnd yetz durch Joannem Pinicianum Newlich verteutscht.* Augsburg, 1533
3. **Brockhaus -Der Literatur**, in 3 Bde., F.A. Brockhaus GmbH, Mannheim, 1988.
4. **Brockhaus Enzyklopädie**, in 30 Bde., Leipzig, Mannheim, 2006.
5. **Brockhaus Enzyklopädie, in 20 Bde.**, Wiesbaden, 1966.
6. **Brockhaus Konversations- Lexikon**, in 20 Bde. F.A. Brockhaus, Leipzig, Berlin und Wien, Bd. I, 1892, Bd. 14, 1895.
7. **Der Brockhaus – Literatur**, Leipzig, Mannheim, 2004.
8. **Der Grosse Brockhaus**, Handbuch des Wissens in zwanzig Bänden, F.A. Brockhaus, Leipzig, 1928 (Erster Band).
9. **Der grosse Brockhaus**, in zwölf Bde., Bd. I, Wiesbaden, 1952.
10. **Der Grosse Herder**, Bd. I, Herder & Co. GmbH. Verlagsbuchhandlung, Freiburg im Breisgau, 1931.
11. Elsie, Robert, "Rezeption albanischer Literatur im deutschen Sprachraum", Aspekte der Albanologie,-Akten des Kongresses "Stand und Aufgaben der Albanologie heute", 3-5 Oktober 1988, Universität zu Köln/ Berlin, 1991 in Kommission bei Harrasowitz, Wiesbaden
12. **Iselin Historisch Lexikon**, verlegt von Ben Johann Ludwig Brandmüller, Basel, 1747.
13. **Knaurs Lexikon der Weltliteratur**, München, 1995.
14. **Metzler Lexikon- Weltliteratur, 1000 Autoren von der Antike bis zur Gegenwart**, 3 Bde., J.B Metzler Verlag, Stuttgart, Weimar, 2006.
15. **Meyer's Konversations Lexikon**, Bd. XIV, Druck und Verlag vom Bibliographischen Institut, Leipzig, 1871.
16. **Meyer's Conversations Lexikon**, Bd. I, Leipzig, 1868.
17. **Meyer's Conversations Lexikon**, Bd. I, Leipzig, 1936.
18. **Meyer's Conversations Lexikon**, Bd. I, Leipzig, 1961.
19. **Meyer's Conversations Lexikon**, Bd. I, Leipzig, 1972.
20. **Meyer's Conversations Lexikon**, Bibliografisches Institut, Bd. I und XVI, Leipzig und Wien, 1906.
21. **Meyer's Conversations Lexikon**, Leipzig, 1840.
22. **Meyer's neues Lexikon**, Band I, VEB Bibliografisches Institut, Leipzig, 1972.
23. **Meyer's neues Lexikon**, in acht Bänden, Band VI, VEB Bibliografisches Institut, Leipzig, 1964.
24. **Meyers Enzyklopädisches Lexikon, 25 Bde.**, Mannheim, Zürich, Wien, 1971.
25. **Meyers Enzyklopädisches Lexikon**, Mannheim, Zurich, Wien, 1971.
26. von Lambert, Maximilian, **Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos: Laut e Malcís, eine einföhrung in die albanische Sagenwelt**, Harasowitz, Leipzig, 1949.
27. von Wilpert, Gero, **Lexikon der Weltliteratur**, Alfred Kröner Verlag, Stuttgart, 2004
28. **Zedler's Universal Lexikon**, Bd. I, verlegt von Johann Heirich Zedler, Halle und Leipzig, 1732.
29. **Zedler's Universal Lexikon**, Bd. III, verlegt von Johann Heirich Zedler, Halle und Leipzig, 1733.

Anila OMARI, QSA, Tiranë

FJALËFORMIMI I SHQIPES SË VJETËR: NJË KONTRIBUT I RI I JOACHIM MATZINGERIT

Albanologjia e hapësirës gjermanishtfolëse, e themeluar dhe e përvijuar nga emra të mëdhenj si Johann Thunmann, Joseph Ritter von Xylander, Franz Bopp, Georg von Hahn, Gustav Meyer, Norbert Jokl, Maximilian Lambertz, e zhvilluar më tej nga albanologët e gjysmës së dytë të sh. XX Hermann Ölberg, Wilfried Fiedler e Oda Buchholz, po vijon traditën e saj të ndritur me albanologët e brezit të ri, ndër të cilët spikat emri i Joachim Matzingerit, tashmë i afirmuar si studiues me kontribute të rëndësishme në studimin e gjuhës shqipe, veçanërisht të fazave të vjetra të saj.

Me një formim të plotë në fushën e gjuhësisë së krahasuar indoeuropiane në universitete me emër, së pari në atë të Vjenës për studime magistrale dhe më pas në Halle për studime doktorale, mbas disa punimesh të rëndësishme mbi shqipen e vjetër ku përballet me probleme nga më të vështirat e të pazgjidhura përfundimisht të teksteve të vjetra e të historisë së gjuhës shqipe, dhe mbas botimit të një studimi të gjerë e të plotë mbi foljet e shqipes së vjetër në bashkëpunim me një tjetër indoeuropianist me emër, Stefan Schuhmacherin, Matzingeri ka sjellë së fundi një kontribut tjetër në fushën e shqipes së vjetër (sh. XVI-XVII) bazuar në tekstin e librit të parë shqip ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut dhe të teksteve të tjera të kësaj periudhe, dhe pikërisht në fushën e fjalëformimit, si një nga rrafshet më të rëndësishme të sistemit të gjuhës që tregojnë edhe për karakterin dhe shkallën e vitalitetit të një gjuhe. Titulli i veprës është “Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im altalbanischen bei Gjon Buzuku. Ein Beitrag zur Albanischen Lexikographie” (Tipat e fjalëformimit sekondar në sistemin emëror të shqipes së vjetër të Gjon Buzukut. Një kontribut për leksikografinë shqipe), botuar nga shtëpia botuese Harrassowitz, 2016, 593 f. Me fjalëformim sekondar autori kupton tipat e fjalëformimit që krijohen me anë mjeteve fjalëformuese të qarta nga pikëpamja sinkronike, si ndajshitesa dhe kompozim, përkundëjt leksikut primar i cili në rrafshin sinkronik nuk është transparent dhe duket i pazbërthyesëm më tej.

Autori është përqendruar në fjalëformimin në sistemin emëror të shqipes së vjetër, pasi ky sistem nuk është hulumtuar sa duhet në këtë aspekt deri tani, ndërkohë që sistemi foljor i kësaj faze të shqipes është analizuar në gjerësi e imtësi në dy punime të rëndësishme: në studimin e Wilfried Fiedlerit *Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)* (ASHAK, Prishtinë, 2004) dhe në atë të Stefan Schumacher e Joachim Matzinger, *Die Verben des Altalbanischen. Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie* (Wiesbaden, Harrassowitz, 2013).

Punimi ka në radhë të parë meritën e përpunimit të plotë, në aspektin e fjalëformimit, të materialit të vjelë nga teksti i Buzukut, dhe jo vetëm të këtij autori të parë të shqipes, por të të gjithë autorëve të vjetër deri në mes të shekullit XVIII. Dokumentet shkrimore të marra në shqyrtim janë të gjitha tekstet e vjetra shqipe të njohura deri sot nga shek. 16 deri në shek. 18, që nga Buzuku (1555), Matrënga (1592), Budi (1618, 1621), Bardhi (1635), Bogdani (1685), Fjalori i Da Lecces (1702), Kuvendi i Arbënit (1703), Fjalori anonim italisht-shqip i vitit 1710, Gramatika e Da Lecces (1716), Dorëshkrimi i Kieutit (1736), Gjon Kazazi (1743), Jul Variboba (1762). Ai jep një pasqyrë mund të themi shpëruese të tipave dhe mjeteve të fjalëformimit sekondar në sistemin emëror të shqipes së vjetër, duke dhënë edhe kontribute të reja në saktësimin e ndonjë mjete fjalëformues, si dhe në fushën e prejardhjes dhe rrugës së formimit të disa mjeteve fjalëformuese.

Vepra përmban, në pjesën e dytë të saj, fjalorin e okurrencave të tipave të fjalëformimit në sistemin emëror në “Mesharin” e Gjon Buzukut, i cili përbën një ndihmesë të rëndësishme në leksikografinë shqipe.

Materiali është vjelë nga autori me kujdes dhe akribi shkencore, duke u mbështetur në kompetencat e tij si njohës i mirë i historisë së gjuhës shqipe dhe duke shfrytëzuar të gjithë autorët kryesorë që kanë trajtuar edhe fjalëformimin në studimet etimologjike të shqipes. Mund të themi me njëfarë sigurie se punimit nuk i kanë shpëtuar emra e mbiemra të formuar me mjete të fjalëformimit sekondar, të paktën në tekstin e Buzukut, por me shumë vëmendje është punuar edhe me tekstet e tjera të shqyrtuara. Mjaf-ton të përmendim sa për shembull derivatin *kujdes* nga folja *kujtoj* që nuk e kanë Xhuvani-Çabej, por e ka Meyeri dhe Çabej (në SE V 158).

I gjithë materiali i grumbulluar është paraqitur sipas parimeve semantike të fjalëformimit duke u mbështetur në modelin e ofruar nga Wolf-

gang Motsch, në punimin e tij *Deutsche Wortbildung in Grundzügen* (Fjalëformimi i gjermanishtes në vijat themelore) 2004. Sipas këtij konceptimi, tipat e fjalëformimit janë pjesë e komponentes leksikore të gramatikës. Ato paraqiten si kombinim i veçorive semantiko-sintaksore dhe fonologjiko-morfologjike. Kreativiteti ose aftësia e modelit për të krijuar formime të reja mbështetet në anën semantiko-sintaksore, por ana fonologjike-morfologjike ka ndikimin e vet në modelin semantik dhe nuk mund të anashkalohej.¹ Tipat e fjalëformimit këtu shihen si rregulla që i përkasin leksikut të gjuhës, me gjithë informacionin semantik, sintaksor, fonologjik e morfologjik të nevojshëm për përdorimin e fjalëve të pathjeshta. Pra qasja e këtij punimi është ngushtësisht leksikaliste. Në qendër të vëmendjes janë modellet semantike, të cilat përshkruajnë mundësitë e ndryshimit semantik nga fjalët bazë te fjalët e prejardhura e kompozitat.

Sipas këtij modeli, tipat e fjalëformimit të shqipes së vjetër në veprën e Matzingerit janë paraqitur me skemën e mëposhtme, konkretisht, për she-mbull, në paraqitjen e prapashtesës *-átë*, që te Buzuku del në dy fjalë të prejardhura: *kapshatë*, *oratë*: [SM (modeli semantik); PF (forma fonologjike) v (baza foljore) *-átë* (f.); shm. *-aë*.

Tipat e fjalëformimit që janë marrë në shqyrtim në punim organizohen në grupime të mëdha sipas mënyrave të fjalëformimit, me nënndarje të tjera hierarkike sipas temës fjalëformuese, përmbajtjes semantike të referentëve dhe mjeteve fjalëformuese. Si mënyra të fjalëformimit emëror autori dallon:

1. Prejardhjen me ndajshtesa, të ndarë në:

- Prejardhja prapashtesore: em. *ëndër* → mb. (i) *ëndër-shim*, që cilësohet si një mënyrë fjalëformimi mjaft e zakonshme në gjuhët indoevropiane. Me prejardhje prapashtesore formohen të gjitha llojet e mundshme të derivateve sekondare (emra abstraktë foljorë dhe emërorë, emra vep-ruesi, mbiemra, emra femërorë mocioni, deminutivë).

- Prejardhja parashtesore: mb. (i) *besuom* → mb. (i) *pā-besuom*. Kjo mënyrë është mjaft aktive sidomos në shqipen e re. Në Mesharin e Buzu-

¹ W. Motsch, *Deutsche Wortbildung in Grundzügen*, De Gruyter, Berlin, 2004, f. 1 v.

kut formimi parashtesor gjendet kryesisht në modelin e mohimit të fjalës

- (Wortnegation).

2. Kompozimi: *zemërëkeq* ← gjymt. e përp. emër *zemërë* + gjymt. e prapme mb. (i) *keq*. Edhe kjo mënyrë sipas autorit është e rëndomtë në shqipen.

3. Rikategorizimi sintaksor (= ndërrim i kategorisë në përdorimin sintaksor) (sipas traditës quhet emërzim ose substantivim): (mb.) (i) *mirë* → (em.) *të mirë*, (pjesore) *kushtuom* → (em.) *të kushtuom*. Në shqipen e vjetër është një mjet shumë prodhimtar për të krijuar emra abstraktë asnjans nga mbiemra marrëdhëniorë dhe nga mbiemra foljorë.

4. Konversioni: fjalëformim me ndërrim pjese të ligjëratës pa tipare dalluese. Konversioni është një model jo fort aktiv i shqipes së vjetër, më shumë dalin ndërtime me konversion të tipit emër (përkt. mbiemër) → folje (psh. (i) *shëndosh* → *shëndosh-ën*) (në Gramatikën e Akademisë kjo mënyrë konsiderohet prejardhje pa ndajshesa); konversione të tipit folje → emër (te Budi e Bogdani *mund* nga folja *mundon*, *sund* nga *sundoj*²).

Autori e dallon konversionin nga rikategorizimi sintaksor me faktin se konversioni prek rrafshin sintaksor dhe atë leksikor, duke u krijuar një fjalë e re me paradigmen e vet të posaçme, pra me këtë rast krijohet një konversion i plotë (complete conversion). Nga ana teorike për këtë dallim mbështetet në veprat e Vogel 1996, Olsen 2014, Bauer & Valera 2005.³

Në punim ai është ndalur vetëm në shpjegimin e këtij modeli fjalëformimi, në kapitullin mbi parimet e fjalëformimit të shqipes së vjetër, dhe shënon se këtë model fjalëformimi në kufi midis sintaksës dhe fjalëformimit, meqenëse është një mjet i pakushtëzuar dhe shumë prodhimtar në shqipen e vjetër, i cili kërkon një hulumtim të veçantë, ai do ta ndër marrë në një vend tjetër. Për shembuj rikategorizimi sintaksor në shqipen e vjetër i referohet Sh. Demirajt, Çështje të sistemit emëror, USHT, Tiranë, 1972 198-204. Ai e kufizon kështu materialin në shqyrtim në leksikon emëror e mbiemëror sekondar, pra të formuar me mjete eksplicite formale.

² Mendoj se emri *sund* është baza fjalëformuese e foljes *sundoj*, shih A. Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet albanologjike, Tiranë, 2012, f. 279.

³ J. Matzinger, *Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im altalbanischen bei Gjon Buzuku*, Harrassowitz, Wiesbaden, 2016, f. 82, shën. 50.

Meqenëse më tërhoqi vëmendjen qasja metodologjike e trajtimit të materialit, po ndalem pak në këtë aspekt, duke e krahasuar me Gramatikën e Akademisë së Shkencave.

Parimet e fjalëformimit të shqipes, të përpunuara sipas konceptit të Wolfgang Motsch, siç shihet janë të ndryshme nga ato që formulon Gramatika e Akademisë, në bazë të karakteristikave të gjuhës shqipe. Kjo gramatikë pranon 6 mënyra fjalëformimi të shqipes: 1. Prejardhjen me ndajshitesa, me nënndarjet e saj: a) prejardhje parashtesore, b) prejardhje prapashtesore, c) prejardhje parashteso – prapashtesore, ç) prejardhje pa ndajshitesë. 2. Nyjëzimin. 3. Kompozimin. 4. Përmngjijtjen. 5. Konversionin. 6. Mënyrat e përziera.

Nga shpjegimi që jep autori për rikategorizimin sintaksor, si proces i njohur edhe në gjuhë të tjera i.-e., ku një mbiemër ose pjesore ndërrojnë kategorinë leksikogramatikore, kjo mënyrë fjalëformimi është e njëjtë me atë që në Gramatikën e Akademisë quhet konversion. Sipas GA konversioni është mënyra e formimit të një fjale të re si pasojë e kalimit në një pjesë tjetër të ligjëratës për shkak të kushteve sintaksore të përdorimit të saj. Duke kaluar në një pjesë tjetër të ligjëratës, fjala e formuar me këtë mënyrë ndërron edhe paradigmen e saj. Meqenëse në punim me rikategorizim sintaksor kuptohet ai që, sipas traditës, quhet emërzim, në GA me emërzim të mbiemrit kuptohet kalimi i tij në klasën e emrit pa ndryshim të jashtëm fjalëformues, pra pa ndajshitesa. Kjo mënyrë morfologjiko-sintaksore fjalëformimi quhet konversion. Këtu hyn emërzimi i mbiemrit si në shembullin *i mirë → të mirë*.

Rasti tjetër i rikategorizimit sintaksor është kalimi pjesore *kushtuom* → emër të *kushtuom*. Sipas GA kjo mënyrë fjalëformimi quhet *nyjëzim*.

Nyjëzimi në traditën gramatikore shqiptare konsiderohet si një mënyrë fjalëformuese shumë prodhimtare. Nyja formon mbiemra të nyjshëm nga pjesoret e foljeve dhe në këtë rast ajo luan rol të dyfishtë: fjalëformues dhe morfologjik. Formimin e mbiemrave prejpjesorë Matzingeri nuk e ka përfshirë në studim, pasi ndërtimet me pjesore hyjnë në morfologjinë e foljes dhe për to ka lista të bollshme në treguesit e monografive të vëllimshme mbi Foljet e Gjon Buzukut dhe Foljet e shqipes së vjetër të përmendura më lart. Por sipas Gramatikës së Akademisë, nyjëzimi është një më-

nyrë prodhimtare edhe për formimin e emrave prejfoljorë asnjansës e femërorë, si: *të ecur-it, të menduar-it, të folur-it, e qeshura* etj. që te Matzingeri përfshihet në konceptin e nominalizimit.

Matzingeri nuk i jep një rol fjalëformues nyjes në punimin e tij. Kjo shpjegohet me zbatimin e parimit semantik në paraqitjen e materialit për fjalëformimin emëror e mbiemëror, ku nyja nuk ka ndonjë rol kuptimor. Gjithsesi mendoj se në studimin e ardhshëm për mënyrën fjalëformuese të rikategorizimit sintaksor do të ishte e nevojshme të shtrohej për diskutim çështja e nyjes si mjet fjalëformues ose jo në shqipen e vjetër, meqenëse kjo çështje lidhet edhe me diskutimin e shkallës së vjetërsisë së nyjës së përparme në shqipe dhe përdorimin e saj të kufizuar në fazat e vjetra të shqipes dhe në të folme.⁴

Në të njëjtën qasje metodologjike, roli i nyjes nuk njihet as në tipin fjalëformues të formimeve privative, të cilat përfshihen si një kapitull më vete në fjalëformimin emëror. Formimet privative ndahen në dy grupe: mohimi i fjalës dhe marrëdhëniet privative. Për këtë model fjalëformues gjithashtu mbështetja teorike gjendet në veprën e W. Motsch, i cili përdor edhe termin Wortnegation (mohim i fjalës).

Te mohimi i fjalës, tipi fjalëformues formohet nga temë emërore me parashtesën *pa-*, së cilës në shqipen e vjetër i shtohet edhe nyja e përparme, pra (*i*) *pā-*: *pā-dekēnī, pā-ndēr*. Te Bogdani del një herë me nyje të përparme: *veshunë së pādekēnije*,⁵ dhe te Budi: *mos u banetë ndonjë e pāndēr*.

⁴ Shih Eqrem Çabej, "Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe", *Buletin i USHT, Seria Shkencat Shoqërore*, Tiranë 1963, nr. 3, f. 69-101.

⁵ Te Bogdani do të shtonim edhe leksema të tjera të këtij tipi fjalëformues, si: **të paçmuem,-itë* I 121 10 ndëpër *të paçmuemit* e të pamarrë vesht të visare (per l'investimabili, & incomprendibili tesori); **e padroe,-ja* fjalë e përdorur vetëm një herë dhe e krijuar me rastin e përkthimit të lat. *temeritas* "guxim i tepruar, kuturisje": I 6 26 Të bubërruemitë është një *të padroe* (Scrutari *temeritas* est); *të pādhipuntunë* "mizori, zemërgurësi: it. *crudeltà*": II 105 28=19 ndo kujtonte se kurraj me aq të pādhipuntunë kishinë me munduem (con tanta *crudeltà*); *të paginë,-të* "pangopësi, lakmi e madhe: it. *ingordigia*": II 68 18 për t u mbushunë *të paginëtë* farizejet e dobitë tyne (it. à beneficio della *ingordigia* de Farrisei); *të pakujdes* "pakujdesi: it. *trascuraggine*": I 102 20 meriton mortnë me gjithë sogje për këta *të pakujdes* kaqa të madh (per questa *trascuragine* tanto grande); *të paligjetë* "paligjshmëri; shkelje e besës: it. *infedeltà*"; **të pāmórt,-itë* "pavdekësi: it. *immortalità*"; *të panierëzishim,-itë* "çnjerëzi; jonjerëzi: it. *inumanità*": II 75 16 po fort shtrëjt kastigon të padashunitë e *të panierëzishimitë* (punirà l'ingrati-

Në shqipen e sotme mohimi i fjalës me *pa-* është pa nyje (*paaftësi, padrejtësi* etj.)⁶.

Në marrëdhëniet privative modeli fjalëformues është nga temë emërore dhe mbiemërore me *(i) pā-* : *(i) pā-besë, (i) pā-besim, (i) pābesuom, (i) pā-dhimshim, etj.* (këtu hyn edhe *i pākrështenë*).

Gramatika w Akademisë e shqipes bën dallim në këto tipe fjalëformimi. Formimet e tipit *i pādhimshim* janë formime privative ose antonimike me *pa-*, brenda së njëjtës klasë të mbiemrit të nyjshëm, ndërsa një formim si *i pabesë, i paarmë* është një mënyrë e përzier me nyjëzim + përngjitje, pasi nyjëzohet një tog parafjalor (*pa besë* → *i pabesë, pa armë* → *i paarmë*). Pra te Buzuku, sipas parimeve fjalëformuese të Gramatikës së shqipes, ndeshen edhe emra të formuar me mënyra të përziera (*i paarrësye, i paarmë, i pakërshtenë*).

Gjithë materiali fjalëformues është strukturuar në formë zërash të veçantë për secilin mjet fjalëformues, të formuluar sipas skemës së dhënë nga W. Motsch për gjermanishten, ku çdo zë nyjëtohet në shtatë rubrika, nga të cilat tri të parat janë marrë nga modeli i Motschit dhe katër të tjerat janë krijuar rishtas nga autori për shqipen e vjetër. Së pari bëhet analiza semantike e tipit fjalëformues, ku renditen edhe të gjitha leksemat e tekstit të Gjon Buzukut të formuara sipas këtij modeli, leksema bazë e fjalëformimit dhe tema fjalëformuese. Së dyti bëhet analiza morfologjike, ku përshkruhet ana formale e krijimit të derivatit, ndryshimet fonologjike që ndodhin me këtë rast, dhe jepen të dhënat gramatikore të modelit. Rubrika e tretë është prodhimtaria ose siç e quan autori, aktiviteti i tipit fjalëformues në shqipen e vjetër, ku jepen dëshmitë në tekstet e vjetra pas Buzukut me shembujt përkatës të vjelë në mënyrë sa më të plotë, pas gjase shteruese, në mënyrë që të krijohet një gjykim i qartë për shkallën e prodhimtarisë së tipit. Trajtimi ndalet edhe në prodhimtarinë që ka një tip i caktuar në shqipen e sotme duke dhënë edhe një vështrim perspektiv të tipit fjalëfor-

tudine, e l' *inhumanità*); **të panjëhun/ë,-itë** "numër i pafund: it. *infinità*"; ***të patëkéq,-itë** "padjallëzi, pafajësi: it. *innocenzà*"; **të pāzell-itë** "mungesë zelli, përtaci": XV ende tue kthym me fort të liga tregëti andej, për *të pāzellt* tanë; **të pasosm,-itë** "pafundësi: it. *infinito*": I 17 26 aso tri pikësh, qi janë ndë të pazanët e *të pasosmit*, II 16 15 të pashoq e *të pasosmitë* arit qi u përduer.

⁶ J. Matzinger, vep. cit., f. 262.

mues. Për sa i përket terminologjisë, edhe këtu ka ndryshim me Gramatikën e Akademisë: sipas GA një tip fjalëformues quhet prodhimtar, kur në gjuhë ka një numër pak a shumë të madh fjalësh që i përkasin atij tipi. Një tip prodhimtar mund të jetë aktiv (veprues), kur sipas tij formohen rishtas fjalë të reja, ose joaktiv. Pra prodhimtar dhe veprues nuk janë e njëjta gjë. Në pikën 4 jepen shembujt ilustrues të ndërtimeve të trajtuara në analizën semantike me kontekstin e tyre në tekstin e Buzukut dhe në pikën 5. përgjegjëset latinisht të tyre në tekstet latine të marra për krahasim, aty ku është e mundur. Pika 6. përmban analizën diakronike të mjetit fjalëformues. Autori e ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e këndvështrimit diakronik, në një punim të karakterit kryesisht sinkronik, për shkak edhe të pasaktësive në shumë raste të studimeve të deritanishme, duke sjellë kontribute të reja në etimologjinë e një numri mjetesh fjalëformuese të shqipes. Rubrika e shtatë dhe e fundit është ajo e literaturës ekzistuese për secilin mjet fjalëformues të trajtuar.

Një meritë e autorit në zgjedhjen e teksteve fetare latine për krahasim me Buzukun është marrja në vështrim e teksteve para Konkilit të Trentos, bashkëkohore me “Mesharin”, si botimi i parë i Missale Romanum i vitit 1474 ose, aty ku ky meshar nuk ofron tekste për krahasim, versioni i Biblës së ashtuquajtur Vulgata të kohës para zëvendësimit të saj nga Vulgata Clementina në vitin 1592. Nevoja e ndjekjes së teksteve bashkëkohore me Buzukun, ndryshe nga praktika e deriatëhershme e marrjes parasysh të mesharëve të shekujve të mëvonshëm ose të sotëm, është argumentuar nga autori në punime të mëparshme të tij⁷, duke ndjekur hullinë e Martin Camajt i cili vuri re se Buzuku do të ketë pasur si modele tekstet dalmato-kroate të shekujve XIV-XV të shkruar me alfabetin latin⁸. Krahasimi me versionet biblike paratridentine i ka sjellë sukses autorit në analiza të caktuara

⁷ J. Matzinger, Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2, në: Bardhyl Demiraj (Hg.), Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet, Albanische Forschungen 29, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 456-460, me citimin e burimeve dhe të literaturës përkatëse. Më parë edhe në J. Matzinger, Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischer Dokumentation, në Monica Genesin & Joachim Matzinger & Giancarlo Vallone (Hgg.), *The living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History*, Hamburg, Dr. Kovač, f. 53v.

⁸ M. Camaj, *Il “Messale” di Gjon Buzuku*, Roma, 1960, f. 56 v.

gjuhësore të tekstit të Buzukut, duke shënuar kontribute të reja në zgjidhjen e disa çështjeve të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe e të historisë së dialekteve të saj, siç është konfirmimi i mungesës së të ardhmes me *do* në gegërishten e vjetër, si dhe për çështje të veçanta të grafisë së tekstit.⁹

Një nga risitë që sjell autori në këtë monografi është në fushën e prejardhjes së kompozimit emëror.

Nga analiza e kompozimit emëror ai ka vënë re se kompozimi i emrave në shqip nuk vjen i trashëguar nga periudha indoeuropiane. Kompozitat në dokumentet e shqipes së vjetër tregojnë se këto janë ndërtime të pavarura, sepse asnjëra prej tyre nuk mund të krahasohet me formimet kompozicionale në gjuhët e tjera i.-e. Prandaj autori nxjerr përfundimin se modeli fjalëformues i kompozimit emëror në parahistorinë e shqipes ka humbur në një periudhë kohore të caktuar. Një paralelizëm silltet këtu me sistemin onomastik të shqipes, i cili, me kristianizimin e shqiptarëve të hershëm, u shndërrua krejt dhe kështu humbi edhe modeli i formimit të emrave të përveçëm vetjakë, që sipas sistemit i.-e. formoheshin nga dy pjesë përbërëse. Me këtë model humbi edhe një nga burimet e mundshme për formimin e kompozitave emërore. Një faktor tjetër, i brendshëm, për zhdukjen e kompozimit emëror indoeuropian në shqipen duhet të kenë qenë shndërrimet e mëdha fonologjike të cilat ua kanë humbur transparencën ndërtimeve kompozicionale deri sa ato kanë humbur krejt. Më pas, në një moment të caktuar të historisë së protoshqipes së hershme është shfaqur përsëri një model kompozimi emëror, ku me shumë gjasë mund të ketë luajtur rol modeli dhe ndikimi i gjuhëve të tjera me të cilat shqipja ishte në kontakt, në radhë të parë greqishtja dhe gjuhët sllave, në të cilat modeli i kompozimit emëror është shumë i gjallë. Në këtë model të ri fjalëformimi nga ana morfologjike nuk bëhet fjalë për “kompozim klasik” por thjesht për përngjitje (juktapozicion). Kjo prejardhje dytësore e kompozimit emëror të shqipes shpjegon edhe rendin e pazakonshëm të gjymtyrëve të kompozitës në krahasim me gjuhët e tjera i.-e.

Mbas fazës paralettrare të shqipes, kur kompozitat emërore u krijuan

⁹ J. Matzinger, *Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs*, Teil 2, art. i cit., f. 456-460. Khs dhe A. Omari, *Ndikimet sllave të Buzuku: kontributi i Camajt, Studime Filologjike*, nr. 3-4, 2010.

sipas gjedhes së gjuhëve të huaja në kontakt, por me ndërtim karakteristik të brendshëm të gjuhës, erdhi një fazë më e vonë kur gjedhet e huaja imitoheshin saktësisht, pra edhe rendi i dy elementeve të kompozitës merrej i pandryshuar. Këto formime gjenden sporadikisht që në dokumentet e para shqipe, mes të cilave ka edhe formime që janë formuar që në periudhën paraletrare të shqipes.

Modeli i kompozimit emëror mori një hov të fuqishëm në kohën e shqipes së re që nga shek. 19 në periudhën e Rilindjes kombëtare dhe me lulëzimin e një literature të pasur, ku u krijuan kompozita të reja nga autorët e veçantë. Këto ndërtime të kohës së re kopjonin tashmë në mënyrë skematike modelet e kompozitave të gjuhëve të huaja që shërbenin si gjedhe imitimi, gjë që ndikon në pozicionin e dy gjymtyrëve të kompozitës, të cilat tanimë shfaqin elementin determinues në gjymtyrën e përparme dhe kokën në gjymtyrën e prapme, kështu që këto kompozita të reja përputhen përsëri krejt rastësisht me ndërtimet kompozicionale indoeuropiane dhe strukturat e tyre formale. Kompozimi emëror vijon edhe sot të jetë aktiv në shqipe në krijimin e termave tekniko-shkencorë.

Kompozitat e shqipes së vjetër pasqyrohen në një tabelë, nga e cila rezultojnë 110 ndërtime të tilla emërore të dëshmuara në dokumente.

Meritojnë të vihen në dukje edhe kontributet në analizën diakronike të formanteve fjalëformuese. Në këtë rubrikë pasqyrohen arritjet dhe përvojat e mëparshme të autorit në fushën e rindërtimit historik të protoshqipes dhe të krahasimit të rrafshit indoevropian. Kjo bie në sy sidomos në rindërtimin e formanteve me burim vendi ku rindërtohen edhe format e fazave të ndryshme të shqipes së hershme deri te paraforma e rrafshit indoevropian. Kështu veprohet psh. për rindërtimin e prapashtesës *-ës* ku autori konvergjon me tezën e Pedersenit për një afëri të rrafshit indoevropian me prapashtesën armene *-iç* si dëshmi për përbashkësitë e këtyre dy gjuhëve në kontekstin e afërisë gjuhësore të rrafshit indoevropian ballkanik (Balkanindogermanisch).

Analizat e holla diakronike e kanë çuar autorin të rishikojë zgjidhjet etimologjike ose rrugën e formimit të disa formanteve fjalëformuese të shqipes të dhëna në mënyrë jo të kënaqshme nga autorët e mëparshëm. Kështu, për prapashtesën *-tar* ai propozon një tjetër rrugë formimi nga ajo e G. Meyerit miratuar dhe nga Xhuvani-Çabej. Meyerit mendon se kjo prapa-

shtesë është formuar analogjikisht nga fjalë që e kanë elementin *-t* në rrënjën e tyre (pra në fjalë si *kopësht//ār* të jetë ndier si prapashtesë pjesa *-tār*, e cila është shtrirë me rrugë analogjike dhe është bërë prodhimtare si e tillë), ndërsa autori i punimit në fjalë mendon se kjo prapashtesë *-tar* është shkëputur në derivate me prapashtesën *-ār* të fjalëve bazë me *-tī*: *shtekētī* → *shtekēt//ār*, *tregētī* → *tregēt//ār* etj. Këto formime më pas u lidhën nga folësit jo me formimet kolektive me *-tī* por me bazat e tyre të thjeshta: *shtek*, *treg* etj., pra *shtek*: *shtekē//tār*, *treg*: *tregē//tār*. Në këtë proces mund të ketë ndikuar modeli ekzistues i prapashtesës me strukturë të ngjashme geg. vj. *-tuor/-tuer*, tosk. vj. *-tuar* i huazuar nga lat. *-tor* (f. 194 v.)

Për burimin e prapashtesës *-uor/-uer*, *-uar* mendon një zgjidhje më të pranueshme nga ajo e dhënë deri tani me rezerva, vërtet nga latinishtja *-ārius*, por me zëvendësim të *ā*-së së gjatë latine me *ā* të gjatë në shqipe siç ka ndodhur në huazimet e hershme (khs. *armissārius* > *harmëshuer*, *calendārius* > *kallënduer*, *februārius* > *fruer* etj), e cila në mënyrë të rregullt u bë *o*, e cila u zgjat në *-ō* pranë sonantes *r*, e më tej me diftongim të **-ō* në geg. vj. *-uor*, *-uer*, tosk. vj. *-uar*. (f. 376 v.)

Për prapashtesën geg. vj. *-tuor/-tuer*, tosk. vj. *-tuar* (sot *-tor*) kundërshton mendimin e dhënë për një trashëgimi indoeuropiane nga prapashtesa **-tor/-ter-* e emrave të vepruesit, për faktin se modeli i.-e. me **-tor/-ter-* formon derivate prejfoljore, ndërsa modeli i shqipes me *-tuor* etj. formon vetëm derivate emërore, dhe miraton tezën e Meyerit për burimin latin *-tor* (gjin. *-tōris*) që gjendet dhe në rumanishte e arumanishte.

Për disa formante që Xhuvani-Çabej u kanë kundërshtuar burimin e huaj, ai i kthehet mendimit të huazimit. Kështu psh. për prapashtesën *-ēsirē*, *-ēsirē* i kthehet mendimit të G. Meyerit që mendon për një burim prej greqishtes; për prapashtesën *-tī*, ndryshe nga Pedersen, Jokli e Xhuvani-Çabej që e shohin si burimore në shqipen, mendon për një huazim nga latinishtja *-ia*.

Në ndonjë rast korrigjohen disa trajta formantesh të dhëna nga studiuesit e mëparshëm, që nuk marrin parasysh zhvillimet fonetike historike brenda fjalës. Psh. formanti *-ēs* (jo *-(ē)s* - f. 158), etj.

Shqyrtimi diakronik nuk mjaftohet vetëm me përpjekjet për ndriçimin e prejardhjes së mjeteve fjalëformuese por shkon më tej duke u për-

pjekur të zbulojë e të rindërtojë prototipin apo pikënisjen e modelit fjalëformues. Në përgjithësi modeli zanafillor është një nocion thelbësor i gjuhës kishtare me denduri të madhe përdorimi. Psh. në prapashtesën *-es* ka qenë lat. *servitium* që ka dhënë shqip *shërbes* e cila u lidh me foljen gjithashtu latine *shërben* dhe u lexua në ndërgjegjen gjuhësore popullore si emër i krijuar nga folja *shërb//* me prapashtesën *-es*, nga e cila u abstragua një model për formim emrash me prapashtesën *-es*. Këtë mendim e përforcon fakti që leksemat *shërbenj* dhe *shërbes* janë koncepte shumë të përdorura në gjuhën kishtare si rrezatuese e kulturës. Prototipi i prapashtesës me burim latin *-atē* propozohet të jetë derivati *oratē* (Buzuku), *uratē* (autorët e tjerë të vjetër), me burim nga folja *oroj/uroj*, leksema që janë edhe mjaft të përdorura në gjuhën kishtare. Me këtë rast polemizohet me pohimin e Xhuvani-Çabejt (SGj III 212) për një prejardhje (edhe) prejëmërore të këtij modeli fjalëformues, ku pikënisja shihet prej tyre te emra me burim latin si *kanatē*, *mblatē*. Modeli i prapashtesës *-esë*, nga një formë më e vjetër protoshqipe, mendohet të ketë qenë leksema *ëndijesë*, etj.

Tek emrat prejfoljorë të vepruesit (nomina agentis) me *-ës*, të cilët në mënyrë të bartur metonimike janë përdorur më vonë edhe si emra mjete në gjuhë të ndryshme, për shqipen e vjetër autori ka vënë re se ky përdorim haset së pari te Da Lecce dhe te Fjalori anonim i 1710-s, në emra si *çelse* “chiave”, *fillues* “bacchetta”, *lidhëse* “benda”, *mjelëse* “secchia da mongere”, *shtypës* “pestaio, pistello” etj.

Punimi ka edhe meritën se shtron detyra për t’u zgjidhur në të ardhmen nga fusha e fjalëformimit dhe e leksikologjisë së teksteve të vjetra shqipe. Me të drejtë theksohet si një detyrë e ngutshme hulumtimi historiko-gjuhësor i fjalorit mjaft të pasur të Da Lecces dhe me atë rast të ndahen leksemat e krijuara artificialisht nga autori nga ato të realitetit gjuhësor të kohës së tij. Një ide me vlerë është ajo lidhur me studimin e çështjeve të stilistikës dhe të formimit të tekstit të dokumenteve të shqipes së vjetër, që nuk është trajtuar sa duhet.

Një çështje për t’u studiuar mbetet vjelja dhe shqyrtimi sistematik i dubleteve në fjalëformimin emëror në tekstet e vjetra, (*shërbes* ~ *shërbim*, *kujdes* ~ *kujtim*, *angjënim* ~ *angjënësë*, *trajtim* ~ *trajti* etj.), për të vlerësuar nëse këto dublete kanë lindur si pasojë e diferencimit semantik e stilistik dhe në ç’mënyrë janë krijuar. Po ashtu edhe mbledhja dhe vlerësimi i

dubleteve të tipit *arkëtuer* ~ *arkëtār*, *ndimëtār* ~ *ndimëtuar*, *shtampatuor* ~ *shtampatār*, *kies* ~ *kietār* etj. në autorë të ndryshëm ose edhe tek i njëjti autor mbetet një çështje me interes për studimet e ardhshme.

Çështja e prapashtesës *-uor/-uer*, *-uar*, në shqipen e sotme *-ar*, gjithashtu mbetet për t'u hulumtuar më tej për prejardhjen e saj, duke marrë në konsideratë shtresa e burime të ndryshme huazimi: së pari nga latinishtja *-ārius*, pastaj me ndërmjetësim të sllavishtes *-ar*, me ndikim të turqishtes *-er*, nga frëngj. *-ier*, apo edhe nga kroatodalmatishtja *-ijer*. (f. 155, f. 377).

Gjithashtu çështja e parahistorisë diakronike të parashtesës *pā-*, me gjithë përsiatjet etimologjike rindërtuese të autorit, ka nevojë të ndriçohet me hulumtime të mëtejshme (f. 262 v.).

Një tjetër çështje e hedhur në diskutim është ajo se si ka kaluar parafjala *pā* si gjymtyrë e parë e kompozitave privative për shprehjen e marrëdhënieve privative. Autori është i mendimit se modeli për shfaqjen e ndërtimeve parashtesore negative me *pā* duhet të jetë marrë nga modeli i kompozitave negative me parashtesën *bez-* "pa" të sllavishtes (psh. sll. vj. kisht. *bezbožstvo* "sakrilegj, veprim kundër Zotit, të qenët pa Zot" - formim prejmemëror, *bezdobno* "i paujë" - prejmbiemëror) (f. 264).

Një kontribut të rëndësishëm jep punimi për turqizmat e shqipes së vjetër, duke u përqendruar në turqizmat e Buzukut, por duke hedhur vështrime të zgjeruara edhe në autorët pas tij, veçanërisht në paragrafin e modeleve të fjalëformimit me burim turk. Në turqizmat e "Mesharit" përfshihen një numër më i madh njësisht leksikore (rreth 8 njësi) në krahasim me ato që kanë dhënë studiuesit e mëparshëm, që llogariten rreth 5 njësi. Nga këto 3 leksema të shtuara, ndajfolja *tekë* "vetëm" diskutohet nga vetë autori nëse është një turqizëm i drejtpërdrejtë apo më shumë një ndikim sllav në gjuhën e Gjon Buzukut, siç mendon edhe Svane¹⁰. Mendoj se edhe dy leksemat e tjera *mill* dhe *pajë* kanë nevojë për diskutim. Turqishtja ka një *mil* me kuptimin "vegël me majë, fëndyell, bosht" që e japin G. Meyeri 278, Çabej SE V 345 e Dizdari 658 si burim të shqipes *mil* "neshter, thikë e hollë kirurgjikale e mjekëve popullorë" (it. *specillo*), sot e vjetruar dhe e dalë jashtë përdorimit. Ndërsa për fjalën *mill* (ose *myll*¹¹) "këllëf thike a shpatë"

¹⁰ G. Svane, *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, Aarhus University Press, 1992, f. 274.

¹¹ Vullnetin e Perëndisë./dot me çelës nuk e mbyll/kur Ajo të jep një shpatë/s'mund ta

të mbarë gjuhës Çabej mendon për një vjetërsi të madhe për shkak të ruajtjes së gjinisë asnjane te Buzuku, edhe pse nuk jep një etimologji të fjalës (SE V 345). Gjithashtu lidhur me fjalën *pajë* meriton një diskutim më të gjerë çështja nëse *pajë* I “plaçkat dhe pasuria që merrte me vete nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndrit kur martohej” dhe *pajë* II “përkrahje e dikujt kur nuk ka të drejtë, anësi, anë, hatër” (FGJSSH) janë në origjinë dy fjalë të ndryshme apo një e vetme. Çabej i merr si dy fjalë më vete, të parën, fjalë e mbarë gjuhës, e rrjedhon, me Meyerin, prej lat. *pallium*, kurse të dytën, fjalë e gegërishtes, prej turq. *pay* “pjesë, dasik, porcion” (SE VI, f. 116-117). Nga ana kuptimore, *pajë* I dhe *pajë* II bashkohen në disa përbërës semantike të tyre me kuptimin “pjesë që i takon dikujt” që ka fjala turke *pay*. Por nga ana tjetër, ekzistenca e *-l-*së ndërzanore në variantin *palë* të tosk. jugore të Gjirokastrës dhe të çamërishtes flet për një **l̥* > *lj* të dikurshme, e cila në këto të folme ka kaluar në *l*, ndërsa në mbarë gjuhën është spirantizuar në *j*. Veç kësaj, në tosk. jugore turqizmat marrin theks fundor, jo parafundor. Këto të dhëna flasin për një vjetërsi më të madhe të fjalës *pajë* I dhe e ndajnë fonetikisht nga *pajë* II, duke i dhënë të drejtë Çabejt, i cili i ndan edhe kuptimisht këto fjalë nuk e afron *pajë* I me turqishten.

Si përfundim, me këtë punim studimi i gramatikës së shqipes së vjetër të fazave të dokumentuara të saj shënon një hap të rëndësishëm përpara në plotësimin e zbrazëtive të trashëguara, të cilat tashmë po mbushen hap pas hapi, edhe me meritat e albanologëve gjermanishtfolës, që vijojnë traditën e nderuar të albanologjisë tashmë treshekullore gjermane.

Albert RISKA, Universiteti "A. Xhuvani", Elbasan

GJURMË TË APOFONISË IE. NË GJUHËN SHQIPE

(bazuar në rindërtime etimologjike nga G. Meyer e N. Jokl)

Abstrakt

Në studimet etimologjike në fushë të shqipes ka ndodhur që në mjaft raste të bëhen rindërtime fjalësh a trajtash të cilat, pavarësisht mungesës së dokumentimit, do të mund të pranoheshin si fatlume dhe do të ishin mjaft frutdhënëse në kërkimet e mëtejshme. Në përgjithësi këto rindërtime janë mbështetur në përjasjen e fjalëve shqipe me përgjegjëset e gjuhëve të tjera, por është për t'u vënë në dukje se, përveç kësaj, si një çelës për rindërtimin etimologjik ka shërbyer shpesh edhe njohja e marrëdhënieve etimologjike të një fjale shqipe me fjalë të tjera brenda gjuhës (të tilla që mund të duken e të trajtohen në gjendjen e sotme si fjalë krejt të ndryshme).

Këtu kemi përzgjedhur disa forma të supozuara nga G. Meyer e N. Jokl për të cilat besojmë se kemi të dhëna të reja që vijnë në mbështetje të plotë të rindërtimeve të bëra nga këta kolosë. Bëhet fjalë për çifte a grupe fjalësh që paraqiten si zhvillime të dy shkallëve të ndryshme apofonike të një baze (leme) të hershme indoevropiane. Kështu, forma e rindërtuar e Joklit **vend-ti* për fjalën *vesë* mund të ndihmojë për të kuptuar lidhjen etimologjike të saj me fjalën shqipe *ujë*, duke nënkuptuar, nga ana tjetër, se raporti semantik midis këtyre fjalëve mund të ketë ndihmuar në këtë rindërtim. Po ashtu mund të flitet edhe për lidhjet midis foljeve *kall* e (n)gull(sh)kul, si edhe për lidhjet midis përemrave *unë* e *vet* apo disa rasteve të tjera.

Gjurmime të tilla mund të na shpjen në njohjen më të gjerë e detyrimisht edhe më të thellë të natyrës së atyre mekanizmave të trashëguara fonetike që i përmbledhim nën termin "apofoni".

Një vlerësim i shkurtër mbi gjurmët e apofonisë në shqipe

Do të mjaftonte edhe hetim sipërfaqësor në studimet etimologjike mbi gjuhën shqipe për të kuptuar se gjurmët e apofonisë indoevropiane në të janë mjaft më të rëndësishme nga ç'përmendin veprat tona sintetizuese. Duam të theksojmë se këtu nuk është për t'u diskutuar thjesht numri i

fjalëve shqipe që ruajnë gjurmët e shndërrimeve fonetike të fazës së përbashkët indoevropiane, megjithëse edhe ky numër nuk është i parëndësishëm (po të kemi parasysh raportin midis elementeve leksikore të trashëguara të shqipes, qoftë me elementet e huazuara, qoftë edhe me ato të krijuara brenda shqipes); pra, nuk duam të tregojmë se shqipja është thjesht një pjesëmarrëse. Këtu është fjala për të gjykuar peshën e gjurmëve, për të gjykuar natyrën dhe vlerën e tyre, në mënyrë që të mund të tregojmë se gjuha shqipe mund të ndihmojë në njohjen më të thellë apo në përfytyrimin më të drejtë të dukurive fonetike që janë shfaqur në indoevropianishten e përbashkët.

Pra, çështja e gjurmëve të apofonisë indoevropiane në gjuhën shqipe mund të shihet nën dy këndvështrime që do t'i etiketonim, në mënyrë thjesht konvencionale, si sasiore dhe cilësore, të cilat do të përkthenin në njëfarë mënyre marrëdhëniet midis albanistikës dhe indoevropianistikës.

Njohja “sasiore” e gjurmëve, që ka të bëjë me identifikimin e dukurisë në gjuhën shqipe, do të na tregonte se si indoevropianistika ndihmon, duke ofruar modelin, në njohjen e historisë së fjalëve të gjuhës shqipe, ose, për të qenë më të saktë, do të na tregonte se si indoevropianistika ndihmon albanistikën; ndërsa njohja “cilësore” e gjurmëve në shqipe do të na tregonte, nga ana tjetër, se si albanistika do të ndihmonte, qoftë edhe në mënyrë modeste, indoevropianistikën.

Nuk është vendi këtu për të trajtuar tërë këtë kompleksitet marrëdhëniesh, por ndonjë vërejtje, që ne e gjukojmë si ndër më të rëndësishmet, mund edhe të bëhet.

Kështu, për shkak të evolucionit të vazhdueshëm të zanoreve të patheksuara dhe të mjeteve morfologjike, fleksive apo derivacionale, si edhe për mungesë të dokumentimit të hershëm, ndryshe nga ç'mund të tregojë ndonjë gjuhë tjetër, gjurmët e apofonisë në gjuhën shqipe do të kërkoreshin vetëm në zanoren e theksuar të rrënjëve njërrrokëshe. Në këtë mënyrë nuk do të mund të kërkoreshin në gjuhën shqipe gjurmë të shkallës së reduktuar (domethënë gjurmë të një zanoreje të gjatë të patheksuar të errësuar në /ə/), ndërsa mund të flitet shumë mirë për “gjurmë” të shkallës zero (veçse, jo humbje e zanores së shkurtër të patheksuar, porse mungesë e zanores së theksuar të rrënjës, kur ajo ka qenë paraprirë nga një /u/ gjysmëzanore, si në rastet *urrë*, krahas *verr*, nga një bazë **uern*(ā), apo

gjumë, nga një **suep-*; ose kur ajo paraprihej nga një labiovelare, si në rastet *gur*, nga një **g^ver-*, apo *kurp(ën)*, nga një **k^verp¹*).

Këtu ka vend edhe për një diskutim në nivel termash, duke qenë se “shkallë e reduktuar” dhe “shkallë zero” shihet që janë përdorur nga autorë të ndryshëm për të njëjtat raste.² Një tjetër problem i rëndësishëm ky, mjaft i diskutuar, sepse lidhet me perceptimin e dukurive dhe ka të bëjë me rolin e theksit në zhvillimin e zanoreve.

Nga ana tjetër, duket se shqipja mund të ndihmojë edhe për të ndriçuar një çështje tjetër jo pak të rëndësishme në këtë lëmë: është fjala për marrëdhëniet etimologjike midis atyre formave që sot paraqiten si zhvillime të shkallëve të ndryshme apofonike.

Normalisht apofonia shihet si një sistem shndërrimesh fonetike të rregulluara që prekin zanoren e rrënjës ose të morfemave të tjera, si në *πατήρ ~ πατρ-ών* (këtu mund të sillen si shembuj rastet e foljeve shqipe, si *dredh ~ drodha*, *vjel ~ vola* e *marr ~ mora* etj., në të cilat shndërrimi fonetik shfaqet si karakter, mjet i karakterizimit të temës), apo *δο-τήρ ~ δώ-τωρ* etj. Pra, është fjala për trajta të ndryshme të së njëjtës fjalë ose për prejardhje të ndryshme nga e njëjta temë fjalëformuese.

Gjithashtu, apofonia shihet si një sistem shndërrimesh fonetike në rrënjët e fjalëve etimologjikisht shumë të afërta që i përkasin dy kategorive leksiko-gramatikore të ndryshme, si foljet, nga një anë, dhe emrat përgjegjës, nga ana tjetër: *lego ~ logos*, *tego ~ toga*, *bie ~ bar* etj.

Por, në gjuhën shqipe shndërrimet apofonike duket sikur marrin më shumë rëndësi kur është fjala për vlerën e tyre si mjete fjalëformuese, pra, për gjenerimin, nga e njëjta bazë e vjetër indoevropiane, të dy apo disa fjalëve të ndryshme, por që, ndryshe nga ç’përmendëm më sipër, i përkasin të njëjtës kategorie leksiko-gramatikore. Dy folje, dy emra apo edhe dy përemra mund të na shfaqen sot si dy fjalë të ndryshme, pa lidhje etimologjike të dukshme, porse rindërtimi etimologjik mund të tregojë se

¹ Për më gjatë shih: A. Riska, *Gjumë të shkallës zero (ø) të apofonisë në gjuhën shqipe*, Buletini shkencor UNIEL, Seria e shkencave shoqërore, nr. 3/2014, fq. 5-19.

² Mund të vihet re se kur diskutohet për burimin e fjalëzës shqipe *u*, si përemër vetor, si trajtë e shkurtër apo si pjesëz e joveprorit, Bopp, Meyer, Jokl, e Çabej flasin për një shkallë të reduktuar të bazës **swe*, ndërsa Pokorny e Orel flasin për shkallë zero të po asaj baze.

ato janë pasojë e zhvillimeve largvajtëse (fonetike e semantike) të së njëjtës rrënjë, në shkallë të ndryshme apofonike.

Më poshtë po paraqesim tri raste që i konsiderojmë si më fatlumet ndër ato që na kanë sjellë në studimet e tyre G. Meyer e N. Jokl.

Rasti *vesë*

Duke u mbështetur në një formë që e ka sjellë De Rada, *voesë*, si edhe në një formë gege *vosë*, Orel ka menduar se forma origjinale e fjalës *vesë* duhet të ketë qenë **vaesë* ~ *voesë*. Burimin e kësaj fjale e kërkon te një formë e rindërtuar e latinishtes **öväitium*, duke menduar motivimin në ngjashmërinë midis pikave të *vesës* dhe kokrrave të vezëve.³

Ndërkaq ai përmend se Jokli (LKUBA 262) e kishte menduar fjalën *vesë* të ardhur nga një bazë e rindërtuar **uend-ti*.⁴

Është pikërisht ky rindërtim i Joklit (duke nënkuptuar një modifikim **uend-ti-/*ued-ti-*) që na prin drejt gjurmimit të lidhjeve etimologjike midis fjalës *vesë* dhe fjalës *ujë*, duke kërkuar në këtë çift emrash një shfaqje të dukurisë që përmendëm më sipër.

Po paraqesim këtu disa detaje të rindërtimit, megjithëse, në fakt, lidhja midis fjalëve *ujë* dhe *vesë* do të meritonte një trajtim të posaçëm, jo vetëm për shkak të modelit që ofron, por edhe për analogjinë që gjejmë midis këtij çifti të shqipes dhe çiftit të anglishtes *water* dhe *wet*.

Atëherë, në qoftë se për të rindërtuar historinë e fjalës shqipe *vesë*, do të niseshim nga baza **wed-* dhe do të ndiqnim rindërtimin e Joklit, do të kishim një **wed-ti-*, çka duket se përlligj normalisht përbërjen e sotme fonematike të fjalës: **wed-tja* > **vetja* > *vesë*.

Ndërsa, për shqipen *ujë* është pranuar, me Çabejn, se “ashtu si dhe te indishtja e vjetër *udán* “në ujë”; greqishtja *ὕδωρ*; latinishtja *unda*; umbrihtja *utur*, letonishtja *ûdens* e ndonjë tjetër, edhe te *ujë* kemi të bëjmë me shkallën e reduktuar (**ud-*) të indoevropianishtes **üed-*, e cila shfaqet ndër të tjera në armenishte *get* “lumë”.⁵

³ Vladimir Orel, *Albanian etymological dictionary*, Brill, Leiden-Boston-Köln, 1998, f. 501.

⁴ Po aty.

⁵ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII*, Tiranë, 2006, f. 191-192.

Kështu, qoftë se për të rindërtuar historinë e fjalës shqipe *ujë* do të nisemi po nga baza **wed-* dhe do të shkonim pas Çabejt, do të kishim: **wed-a > *udā > *uë > ujë*.

Nga ana tjetër, anglishtja *water* sillet nga një bazë protogjermanike, e rindërtuar, **watar*, kjo e sjellë prej paleoindoevropianishtes **wod-or*, e cila nga ana e vet është e lidhur me lemën **wed-* "water, wet"⁶.

Po ashtu edhe fjala angleze *wet*, e ardhur nga baza protogjermanike **weta-*, padyshim e lidhur me *water*, shpjegohet me lemën indoevropiane **wed-*⁷.

Duke përmbledhur me dy fjalë, do të përfundonim se *vesë* e shqipes dhe *wet* e anglishtes, bashkë me armenishten *get*, janë zhvillime të shkallës normale të rrënjës **wed-*; *ujë*, bashkë me indishten e vjetër *udán*, greqishten *ὕδωρ*, latinishten *unda* etj. janë zhvillime të shkallës zero të saj **wd-*; ndërsa anglishtja *water*, bashkë, me sllavishten *voda*, janë zhvillime të shkallës cilësore /o/ **wod-*. Në total gjejmë zhvillime të tri shkallëve apofonike të asaj rrënje indoevropiane.

Skematikisht:

Lema	shkallë apofonike	zhvillime
<i>*wed</i>	normale <i>*wed-</i>	shq. <i>vesë</i> , ang. <i>wet</i> , arm. <i>get</i>
	zero <i>*wd-</i>	shq. <i>ujë</i> , ind. <i>udan</i> , gr. <i>ὕδωρ</i>
	cilësore <i>*wod-</i>	ang. <i>water</i> , sll. <i>voda</i>

Rasti *kall*

Duken interesante për shqipen një rreth foljesh që mund të lidhen etimologjikisht me *kall*, "fut; fut në dhe; shtyj një njeri për keq; ndez". Si më të afërt mund të përmendim zgjerimin e saj *këllás* (me të njëjtin kuptim), pastaj: *ngallon* e *ngallis* "gërgas, ngacmoj" e *gallmoj* "mbërthej

⁶ Shih: Chambers Dictionary of Etymology, Edinburgh, 1988, f. 1222; Douglas Harper, Online Etymology Dictionary © 2001-2016.

⁷ Chambers Dictionary of Etymology, Edinburgh, 1988, f. 1229.

me gozhda; ngas, gërgas”, që Çabej, në fakt, i numëron kur shpjegon fjalën *kalli*.⁸ Gjithashtu do përmendur këtu folja *qell*, që duhet të jetë formë e metafonizuar e saj (sikurse kemi *shkel* a *ngel* të lidhura, përkatësisht, me *shkal* e **ngal*).

Por, çka është me më shumë interes për ne, po aty mund të vendoset edhe folja *sjell*, sikundër e kish parë, së pari, G. Meyeri dhe, me Joklin (LKU 266 shën. 1), do të pranohet që *qell* afrohet me *sjell* e që kemi të bëjmë me rrënjën i.-e. **ku`el-* “sjell, rrotulloj”.⁹

Shumë interesante, më pas, vërejtja e Çabejt se, ndërsa *sjell* rrjedh nga **ku`el-*, *kall* qëndron në apofoni kualitative (Abtönung) ndaj asaj, pra ka dalë prej një **k^wol-*, *-kall* “ndez” është identike me *kall* “*këllas*”.¹⁰

Ky rindërtim është pranuar edhe nga Orel, që mendon për *sjell* një formë të vjetër shqipe si **tšela* apo **tšelna*, të lidhura gjithashtu me bazën indoevropiane **k^wel*.¹¹

Këto qëmtime, të para kështu së bashku, na lejojnë të implikojmë këtu mekanizmin e apofonisë e të ndërtojmë skemën. Në këtë mënyrë folja *sjell* do të shihej si një zhvillim i shkallës normale të rrënjës indoevropiane **ku`el-* apo **k^wel*, ndërsa folja *kall*, siç e rindërton Çabej, do të ishte zhvillim i shkallës cilësore **k^wol*.

Në qoftë se do të shkonim më tej dhe do të supozonim edhe një zhvillim nga shkalla apofonike zero e rrënjës **k^wel*, do të fitonim një trajtë të tretë **kul*, nga e cila do të shpjegoheshin foljet e çiftit *ngul/shkul*. Edhe në këtë rindërtim nuk do të ishim të parët. Për shembull, Orel, për foljen *ngul* rindërton një formë të shqipes së vjetër **en-kula*, të cilën e sheh si shkallë zero dhe e bashkon etimologjikisht me format e lituanishtes *gulti* e të letonishtes *gult*.¹²

Për Çabejn, shqipja *ngul* reflekton një bazë **gul*, ose një **g-ol-*. Edhe ai pat shkruar te lituanishtja *gūolis* “vend gjumi”, edhe *guliū*, *gulti*;

⁸ Shih zërin *kalli* te *Studime etimologjike në fushë të shqipes V* (i pabotuar).

⁹ Shih: Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes V* (i pabotuar).

¹⁰ Po aty.

¹¹ Vladimir Orel, *Albanian etymological dictionary*, Brill, Leiden-Boston-Köln, 1998, f. 397.

¹² Vladimir Orel, *Albanian etymological dictionary*, Brill, Leiden-Boston-Köln, 1998, f. 297.

guliù, guleti; si edhe në letonisht *gult* “me ra me fjetë” dhe greqisht γολέος “strokë”, “strehë”, “shpellë”, “gropë”; veçse nuk përmend shkallë apofonike, por sheh “një zhvillim të rregullt të likuides rrokjeformuese në *ul*”.¹³

Duhet të përmendet që, pavarësisht se me cilën rrënjë indoevropiane i lidh dhe pavarësisht shpjegimit që do të mund të jepej (nëse ka pasur parasysh lidhjen fonematike apo thjesht lidhjen semantike), Pokorny me shqipen *ngul* bashkon edhe foljet *ngel* e *ngec*.¹⁴ Me shumë mundësi *ngel* e *ngec* nuk janë veçse format e metafonizuara të një forme lehtësisht të rindërtueshme të shqipes së vjetër **ngal*, kështu që Pokorny nuk bën tjetër veçse bashkon foljet (n)*gul/kul* e (n)*gal/kal*.

Pra, duke përmbledhur do të kemi: folja *sjell* do të ishte një zhvillim i rrënjës indoevropiane **k^wel* në shkallën normale të zanores së rrënjës, pra, po **k^wel*; folja *kall* do të ishte zhvillim i shkallës cilësore /o/, **k^wol*. dhe çifti (n)*gul*/(sh)*kul* mund të shihet si zhvillim i shkallës zero **k^wl*. Po të dalim nga grupi foljor, do të shtonim këtu edhe *ngjalë*, që do të vendosej gjithashtu në shkallën normale, si derivat i ilirishtes *Enkel*.¹⁵

Skematikisht:

Lema	shkallë apofonike	zhvillime
<i>*k^wel</i>	normale <i>*k^wel-</i>	shq. <i>sjell, ngjalë</i>
	zero <i>*k^wl-</i>	shq. (n) <i>gul</i> , lit. <i>gulti</i> , let. <i>gult</i>
	cilësore <i>*k^wol -</i>	shq. <i>kall</i> , lit. <i>gūolis</i> , gr. γολέος

Rrasti *u/unë*

Këtu mund të bashkohen përemri i vetës së parë njëjës *u/unë*; ai i vetës së dytë shumës *ju*, bashkë me trajtën e shkurtër, dhe pjesëza e joveprorit *u*.

¹³ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VI*, Tiranë, 2002, f. 77-78.

¹⁴ Julius Pokorny, *Indo-European Etymological Dictionary - Indogermanisches Etymologisches Woerterbuch*, Bern- Muenchen, 1959, f. 45-47.

¹⁵ Gjithsesi duhet të pranojmë se, për *sjell* dhe *ngjalë*, mbetet për t'u diskutuar problemi i natyrës së grykores në ballë të rrënjës.

Duke iu referuar një kumtimit të Joklit (në leksione), Çabej thotë se, te përmri i vetës së parë njëjës *u*, *unë* paraqet shkallën e reduktuar (në pozicion të patheks) të përmrit vetvetor *ve-*, në *vetë*, nga baza **süe*, shkallë identike me atë të përmrit vetvetor *u*.¹⁶

Për pjesëzën *u*, me të cilën formohen format joveprorë të foljes (*u lava*, *nisu*), Çabej shkruan se mbetet i drejtë mendimi i Boppit që *u* është forma e reduktuar e vokalikë e rrënjorit *ve-* të përmrit vetvetor *vetë*.¹⁷

Edhe Demiraj pajtohet me një mendim të tillë dhe lidh, si pjesëzën joveprorë, ashtu edhe përmrin e vetës së parë me formën e hershme **we*.¹⁸

Orel gjithashtu pranon se përmri vetor i vetës së parë *u* është një me *u* “vetë” e ardhur nga një shqipe e vjetër **we*, pas togut **edz we*, ky vetë pas togut indoevropian **ēghom sūe*.¹⁹

Nga referimet e autorëve që kemi cituar këtu, vihet re se të gjithë dijetarët, nga Boppi deri te Pokorny, pavarësisht ndonjë mospërputhjeje të vogël (lema **we* apo **swe*), kanë menduar një lidhje të ngushtë etimologjike midis trajtave vetore *u/unë*, *u/ju* dhe pjesëzës *u*, nga njëra anë, dhe vetvetorit *vetë*, nga ana tjetër.

Është e qartë se kemi të bëjmë me trajta të zhvilluara nga e njëjta bazë indoevropiane, por me dy rrugë të ndryshme zhvillimi, të cilat duhet të jenë përcaktuar nga mekanizma fonetikë që kanë prekur zanoren e rrënjës: *vetë* duhet të përcjellë shkallën normale në */el/* **(s)we*, ndërsa trajtat e tjera duket se përcjellin shkallën zero të saj **(s)w*.

Ajo që mbetet për t’u diskutuar këtu është roli i theksit në humbjen e zanores së rrënjës, pra në përfitim të atyre trajtave që po i konsiderojmë si shkallë zero. Për pjesëzën e joveprorit *u* dhe për trajtat e shkurtra *u/ju* mund të vijë në konsideratë fakti që ato përdoren si të patheksuara. Mundet që edhe veta e parë *u(në)* të përligjet si e pathekse në formulën “ve(të) jam”, por pas kësaj do të duhet të përligjet edhe veta e dytë shumës (*j*)*u*. Në këtë mënyrë do të duhet të pranojmë se sikur teprhet me rolin e theksit.

¹⁶ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII*, Tiranë, 2006, f. 185-186

¹⁷ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII*, Tiranë, 2006, f. 186.

¹⁸ Bardhyl Demiraj, *Albanische etymologien*, Rodopi, Amsterdam – Atlanta, 1997, f. 400.

¹⁹ Vladimir Orel, *Albanian etymological dictionary*, Brill, Leiden-Boston-Köln, 1998, f. 486.

Skematikisht:

Lema	shkallë apofonike	zhvillime
*(s)we	normale *(s)we-	shq. <i>vetë</i>
	zero *(s)w-	shq. <i>u/unë</i>

Raporte të tilla etimologjike mund të hasen edhe në mjaft çifte apo grupe të tjera fjalësh në gjuhën shqipe, çka do të kërkonte gjurmime të posaçme për çdo rast.

Në klasën e foljeve do të përmendnim këtu grupin e gjerë *korr ~ çars çart, harr ~ çjerr, shqerr*, që duket se i përgjigjet shumë mirë skemës; apo të tjera, si *bie ~ (m)bart, zhvesh ~ zhvoshk, grah ~ ngreh, dhjes ~ ndot, vjer ~ var a ul ~ vjel* etj.

Mund të vihet re se për një trajtim të saktë historik të këtyre formave duhen pasur mirë parasysh edhe dy probleme të tjera të historisë së gjuhës shqipe: së pari, për grupin e foljeve me lidhje të ngushta etimologjike duhet të vlerësohen marrëdhëniet aspektore midis tyre dhe, së dyti, siç kemi përmendur edhe më lart, duhet gjykuar mënyra e zhvillimit të grykoreve indoevropiane kur ato ndodhen në ballë të fjalës. Një vërejtje të tillë e bën edhe Orel kur shkruan se grupi nistor *sk-* duhet të rindërtohet në gjuhën shqipe.²⁰

Në klasën e emrave mund të përmendnim si grupe që do të mund t'i përgjigjeshin skemës dhe që do të meritonin vëmendje: *verr ~ urrë, bar ~ ber, gjollë ~ (i) njel(mët), gjellë ~ (i) gjallë, çerdhe ~ herdhe, derr ~ dosë, gjerbë ~ hurbë, (s)qep ~ (sh)kabë* etj.

²⁰ Shih zërin *herdhe* në fjalorin e tij etimologjik (cituat më sipër).

Besim KABASHI, Friedrich-Alexander-Universität Erlangen-Nürnberg

NEOLOGJIZMAT NË SHQIPEN E SOTME – NJOHJA DHE ANALIZA AUTOMATIKE

Parafjalë për fjalë e fjalë të reja

Krijimi dhe përdorimi i fjalëve të reja në shumë raste e vë dëgjuesin a lexuesin para vështirësive për të kuptuar folësin përkatësisht tekstin. Duke u nisur nga ajo se një dëgjues a lexues është në të njëjtin nivel me folësin, përkatësisht autorin e tekstit, sa i përket njohjes së gjuhës së komunikimit dhe kështu nuk ka vështirësi për ta kuptuar folësin, aq më pak duke pasur parasysh mundësinë e ndërveprimit dëgjues-folës, pra për të pyetur në rast të ndonjë moskuptimi të ndonjë fjale të re, në fushën e përpunimit automatik të gjuhëve natyrore kjo situatë mund të paraqesë një problem jo të vogël ose edhe të pazgjidhshëm në shumë raste. Gjatë përpunimit automatik si probleme kryesore dalin mungesa e resurseve të gjuhës që duhet të analizohet si dhe metodat e përdorura të përpunimit teknik të gjuhës. Ndërtuesi i një programi për njohje të neologjizmave e ka në praktikë të pamundshme për të pasur paraprakisht në fjalor secilën fjalë të re mundshme, e cila mund të përdoret rastësisht, sikurse edhe dëgjuesi nuk mund të paradijë një fjalë të re që folësi do/mund të flasë, pra neologjizmat nuk mund të paradihen. Nga pikëpamja teknike kjo detyrë është shumë e vështirë të kryhet plotësisht.

Njohja dhe analiza automatike e fjalëve të reja ose të krijuara sipas kontekstit, qoftë edhe për një rast të vetëm, përdoruesit të programit të lartpërmendur i kursen shumë punë dhe kohë, njëherazi i jep atij edhe rezultate më të mira e me më shumë të dhëna gjatë analizës së gjuhës. Kjo është sidomos e rëndësishme në fushat, në të cilat informacioni analizohet pa ndërprerje (në një rrymë/lumë/rrjedhë, angl. *stream*). Që të ndërtohet një program i tillë duhet, ndër të tjera, të zhvillohen rregullat që përshkruajnë krijimin e fjalëve të reja.

Një morfologji automatike e plotë e shqipes, e cila paraqitet këtu,

është në gjendje të analizojë krahas eptimit të fjalëve, modeleve kryesore të fjalëformimit, në masë të madhe edhe fjalë të reja d. m. th. të krijuara për herë të parë, të cilat nuk janë në ndonjë fjalor, si p. sh. *paradijë* (= dijë paraprakisht) e *paradihet* (= dihen paraprakisht), si forma të foljes *paradi*, khs. për ngjashmëri strukturash foljet *parashoh* dhe *paramendoj*.

Fjalët e reja – disa gjetje në shtypin e viteve mbëdhjetë të shekullit XXI

Zhvillimi shoqëror, kulturor, teknologjik e shkencor sjell me vete domosdoshmërinë e gjetjes së emrave që duhet të përfaqësojnë një gjësend, ngjarje ose diçka tjetër të re. Disa fjalë, çfarëdo qofshin ato, emra, mbiemra, folje apo ndajfolje, u janë përshtatur zhvillimeve të reja duke zhvendosur kuptimin e tyre nga një i vjetër në një të ri, ose duke e zgjeruar atë me një të ri. Disa të tjera janë gjetje krejtësisht të reja, qoftë me burim nga shqipja, qoftë përkthime nga gjuhët tjera, për të shënuar gjësende, ngjarje, ose diçka tjetër të re, të përmendur më parë. Fjalë(ëform)a *paradi* përdorur për qëllim shpjegimi e demonstrimi është një rast që e dëshmon këtë. Fjalë(forma)t *bazëngushtë* (bazë + ngushtë), *belbëzimthi* (belbëzim + thi), *absolvohen* (fjalë me burim të huaj) dhe *blogistë* (fjalë me burim të huaj), të gjetura në mediat e shkruara, tregojnë për lëvizjet (prurjet ose përdorimet) e reja në leksikun e shqipes.

Ka edhe raste kur gjuha shqipe është më rezistente ndaj disa fjalëve të huaja se sa gjuhët tjera, p. sh. fjala *google*, emër (njohur si makina më e madhe e kërkimit në internet), nuk përdoret si folje (e cila do të pritej të ishte *gugëloj* ose *gogloj*) në shqipe, në krahasim me p. sh. angl. *to google*, gjerm. *googeln* ose ital. *googlare*. Një rast tjetër, fjala *kull*, marrë nga angl. *cool*, mbiemër përkatësisht ndajfolje, ka hyrë në gjuhën e të rinjve shqiptarë.

Gjatë këtyre viteve gjuha shqipe po njej një zhvillim të madh në fushën e krijimit dhe përdorimit të fjalëve të reja, prej të cilave shumë mund të zënë vend në fjalor/ë, pra mund të hyjnë në përdorim kohëgjatë ose të përhershëm, për aq sa mund të thuhet kjo në kuptimin gjuhësor. Këtu mund të përmendet shtimi i numrit të fjalëve, në një fjalor të përgjithshëm, si p. sh. në një fjalor drejtshkrimor, khs. [DHRIMO/ MEMU-

SHAJ 2010], me rreth 75 000 fjalë, me [FDSH 1976], me rreth 32 000 fjalë si dhe krijimi i fjalëve të reja/fjalorëve në fusha të veçanta shkencore e teknike, khs. p. sh. [CAKA ETJ. 2005], me rreth 18 000 fjalë, për fushën e informatikës.

Parë nga këndvështrimi se a arrin një fjalë e re të bëhet pjesë e fjalëve të një fjalori apo jo, d. m. th. se a mund të mbijetojë, ajo mund të jetë: *fjalë e re e rastit* (okazionale), e paleksikalizuar, *dhe e përdorshme* (uzuale), e cila me kohë leksikalizohet, d. m. th. bëhet e përdorshme.¹

Fjalët e reja nga pikëpamja e përpunimit teknik

Gjatë përpunimit teknik fjalët e reja nuk mund të lihen anash, d.m.th. janë të *paanashlënshme*, pra duhet të analizohen a të gjenerohen si edhe fjalët tjera. Si fjalë e re (neologizëm) merret thjesht një fjalë që nuk është e radhitur në të paktën një fjalor të gjuhës shqipe. Në pikëpamje të ngushtë teknike fjalë të reja janë ato fjalë që nuk janë në fjalor/ë të sistemit morfologjik, përkatësisht nuk mund të mbulohen nga rregullat e tij.

Një fjalë e re mund të njihet si e tillë kur ajo është në fjalor (leksikon). Kjo vlen për fjalët e pandryshueshme si p. sh. parafjalët. Për fjalët që lakohen duhen edhe rregullat që përshkruajnë bashkimin e fjalëve (të fjalorit) me mbaresat përkatëse, si dhe eptimin (alternimin) e fjalë(forma)ve. Një fjalë e ndërtuar në bazë të rregullave të fjalëformimit mund të njihet e të analizohet aq (mirë) sa rregullat e mbulojnë bashkimin/ kombinimin e fjalëve të fjalorit dhe të mjeteve tjera fjalëformuese, eptimin dhe mbaresat. Pra, rregullat strukturore të ndërtimit të fjalëformave duhet të jenë të sakta dhe të lejojnë ose të ndalojnë ndërtime/bashkime të caktuara.

Dy nga strukturat më të shpeshta, dhënë me fjalë të reja, gjetur pak kohë më parë, janë:

(1) *prejardhja*, khs. p. sh. *grev* | + *-oj* (← *grev*[ëë + /mbaresat e zgjedhimit/),

(a) *zvoglimi*, khs. p. sh. *gjurmë* | + *-z_{zvogl}* | + *-a-t* (← *gjurm*[ëë + /[ëëz/ +

¹ Këtu nuk do të diskutohen në imtësi çështjet teorike të fjalëve të reja. Çdo fjalë që nuk është në fjalor (drejtshkrimor) do të merret si fjalë e re. Për fjalëformimin në gjuhën shqipe khs. ndër të tjera, të paktën, literaturën themelore, dhënë më poshtë.

/mbaresat e lakimit/),

(b) *formimi i ndajfoljeve* khs. p. sh. *kalim* | + *-thi* (← *kalim* + /*thi*/), dhe

Ka konstatuar raste në këtë të folme që kur fjala nis me një zanore të ndodhë shtesa e një /h/-je. Kjo dukuri ngjan në mënyrë jo sistematike, në fillim të fjalës (protezë) gjë që është e papërligjur edhe etimologjikisht në fjalë, si: *hunaza* “unaza”, *harin* “arrin” një tipar i hershëm ky që ndeshet edhe te Gj. Buzuku. Ka pasur shumë diskutime nga gjuhëtarë shqiptarë⁷

⁷ J. Rrota, *Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun*, BShSh 3, 1956, f.179; S. Riza, *Nyjat e shqipes në tekstet e pesë autorëve tanë më të vjetër*, në: **Vepra 1**, Prishtinë,

për këtë dukuri fonetike. Nga ana tjetër, Lambertz-i krahas dukurisë së shitesës së një /h/ në fillimfjalë, sjell shembuj të rënies së saj në mes dhe në fund: *she* “sheh”, *thiesh* “thihesh”, *haesh* “hahesh”. Ky është një tregues i humbjes së ndjenjës gjuhësore të *h*-së në të folme të shqipës dhe, për mendimin tonë, kjo shpuri në futjen e një *-h*-je hiperkorrekte në fillim të fjalëve që nisin me zanore për një hyrje të fortë e të aspiruar.

Një fushë që kishte tërhequr vëmendjen e M. Lambertz-it ishte **onomastika**, madje siç vëren E Çabej⁸, - dhe ç’është e drejta, më parë se të niste era e studimeve onomastike, vuri re (shën. ynë: Lambertzi) rëndësinë që kanë emrat vetjakë për hetimin e burimit të popullit shqiptar e të gjuhës së tij. Ai eci kështu në rrugën prej pionieri që çeli J. G. von Hahn-i në këtë lëmi të dijes.

Që kur erdhi për herë të parë në Shqipëri, më 1916-ën, M. Lambertz-i iu vu studimit të emrave sipas regjistrave shkollorë dhe hetoi ndër ta elemente iliro-trake. Ky pasion bëri që brenda këtij studimi që kemi në shqyrtim, të japë edhe ndonjë konsideratë të shkurtër për toponimin Gjirokastër, të cilin e ndan në pjesën e parë *Gjiro* dhe në të dytën me variantet: *-kastër*, *-kastrë*, *-kastra* nga Greqishtja e Re, Αργυρόκαστρο dhe trajtën Gjino-kastrë e shpjegon sipas etimologjisë popullore prej emrit të zotit të këtij qyteti, Gjini. Me sa duket, Lambertz-i nuk pajtohet plotësisht me këtë shpjegim, prandaj e quan “etimologji popullore”, por as rreket ta shpjegojë më tej. Ne pajtohemi me mendimin e E. Çabejt (S.Gj.1975:324), të mbështetur edhe nga arkeologjia, i cili në hullinë e një tjetër albanologu të famshëm nga bota gjermanike G. Von Hahn-it⁹ thotë se - ndoshta trajta toske e emrit të qytetit, Gjirokastër, ka të bëjë me emrin e fisit të argjyrinëve. Kjo duhet të jetë e vërtetë edhe për faktin se qyteti ishte themeluar e njihej me këtë emër para se në të të sundonte Gjini Zenebisi. Këtë e vërtetojnë edhe

1996, f. 448-449; E. Çabej, “**Meshari**” i **Gjon Buzukut**, Tiranë 1968, f. 55; B. Beci, *Rreth së ashtuqajturës “h” irracionale në veprën e Buzukut*, SF, 1991, 3-4, f. 119; R. Ismajli, *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipës*, **Gjurmime albanologjike**, SShF VII; K.Topalli, *Rreth vlerës së shkronjës “h” në Mesharin e Gjon Buzukut*, SF 1-4, 1993, f. 97.

⁸ E. Çabej, *Maximilian Lambertz*, SF, 1964, f. 214.

⁹ Në veprën **Studime shqiptare**, 1854:330 ku thotë shkurt: “Argyinoi-Argjirokastër, krahas Kaones përmendur nga Lykofroni, v.1016”

burimet historike.¹⁰

- *plasëlë, përpjetëlë, tatëpjetëlë, s'beheshin as për gjallëlë e as për vdekëlë.*

Mendojmë se konstatimi i M. Lambretz-it se prapashtesa **-lë** vjen nga **-jë** ka vend për vërejtje. Prapashtesa **-l(ë)**,¹¹ një nga prapashtesat më prodhimtare në këtë të folme, është më e hershme se **-jë**. Në shqipen standarde, kjo prapashtesë ka evoluar në **-je**. Këtë e kanë vërejtur edhe A. Xhuvani - E. Çabej¹² kur shkruajnë se disa autorë të vjetër, si Kavalioti e Grigori (Gjirokastriti) kanë trajtën **-jë** (-ëjë, -ijë), p.sh. *humbëjë, kripëjë, mali-jë, mëngjezjë, nisjë, vdekëjë, vërtetjë*. Trajta më **-jë** është më e vjetër se ajo më **-je**, si duket nga shembujt e Kavaliotit e të Grigorit, dhe qëndron fonetikisht në mes të **-lë-së** e të **-je-së**.

Siç duket, e folmja e qytetit të Gjirokastrës ruan trajtën më të vjetër të kësaj prapashtese **-(ë)lë**. Ajo u shtohet temave emërore duke formuar emra sendesh, si *buzë-lë* “garzë”, *dorë-lë* “dorashkë”, *gishtë-lë* “gishtëzë”, *mes-(ë)lë* “qilim”, *shesh-(ë)lë* “shapkë”, *vesh-(ë)lë* “veshkë” *udhë-lë* “rrugicë”, *përpjetë-lë* “e përpjetë”, *tatëpjetë-lë*, etj.

Për sa i përket trajtës Gjinokastër që përmend M. Lambertz-i e që rëndom e gjejmë në disa shkrime të viteve ‘20-‘30 të shek. XIX me siguri duhet të jetë një krijim savant i Rilindjes, për ta shkëputur qytetin nga sfera onomastike dhe kulturore greke. Veçanërisht vlen kjo, thekson studiuesi A. Vehbiu, për periudhën kur Greqia kish pretendime serioze ndaj Shqipërisë

¹⁰ **Kronika e Tokove**, (K. Bozhori-F. Liçaj 1975:314); *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut Shqiptar të viteve 1431-1432*, është i pari dokument osman që jep të dhëna për qytetin e Gjirokastrës. Këtë dokument shumë të rëndësishëm për historinë e Shqipërisë e zbuloi për herë të parë, në vitin 1954 osmanologu i famshëm Halil Inalcik. Emri i Gjirokastrës del në defterin e mësipërm (**Sûret-I Defter**... XIII, f. 1-3, 8, 12, 16, 18, 20, 21, 23, 27) në disa variante: *Argjirokasro, Argjirokasri, Arjuokasri, Arjorikasri, Argjirikasri*. Forma më e shpeshtë është e fundit. Ky variant u përdor nga administrata turke, e cila duke e përshtatur me rregullat fonetike të turqishtes *a*-në nistore e shndërroi në *e*- dhe emri doli në versionin e turqishtes Ergjërikasri, ose shkurt, Ergjëri. Ky emërtim del edhe në këngën popullore: Kurvelesh e Çamëri / ç'u mbluadht në Ergjëri.

¹¹ Në Kurvelesh e në Lunxhëri del në trajtën *-ij*. Ajo del edhe në të folmen e çamërishtes. (Q. Haxhihasani, **Dialekt. shqipt**, II:5)

¹² A. Xhuvani-E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, **Studime gjuhësore, III**, Prishtinë, 1976, f. 259.

së Jugut dhe kërkonte ta aneksonte Gjirokastrën, mes të tjerash edhe me argumentin se bëhej fjalë për një qytet thjesht grek (“siç e tregonte edhe emri”).¹³

Pas këtyre Lambertz- i hyn në përshkrimin e veçorive morfologjike të së folmes popullore të këtij qyteti. Së pari analizon forma të **aoristit** ku dallon ato me *-ta*: *ngrijti, hijtin, lajtën, qajtimë* me lot, *mbajti, pushojti, bashkojti*, nuk *mënojt* “nuk u vonua”, *mbarojti* etj.

Dallon *aoristin sigmatik*: *gjeçë, u ngreçë, paçë, i raçë* si dhe dy trajta aoristi për të njëjtën folje: *lau* krahas *lajti*, *leu* krahas *lejtën*, *shplau* krahas *shplajti*. Me të drejtë Lambertz-i konstaton se aoristi *fualmë* është analogjik me *dualmë*, sepse siç vërën autori, duhej *folëm*.

Për këtë të folme është karakteristik edhe **aoristi pasiv** të cilin Lambertz-i e ilustron me shumë shembuj, e që ndeshet rëndom edhe sot në këtë të folme, si: *u mendua, u kujtua, u huadh, u vuall, u lëshut, u rop* etj. Në këtë tip aoristi pasiv ka veçuar nga të tjerat, për shkak të asimilimit, foljen *muarë* < *muarnë*, dukuri kjo e shqipes së vjetër në të dyja dialektet¹⁴, por që në të folmet e toskërishtes jugore e të dialekteve të Greqisë e të Italisë ky asimilim ka një përhapje më të gjerë se në gegërishten e vjetër dhe ekziston edhe sot. Ndërrimin *rrn:rr* e ka vërejtur për çamërishten me të cilën shkon edhe kjo e folme, Q. Haxhihasani¹⁵ në shembujt: *u therrë, hëngërrë, muarrë* etj.

Por aoristi tregon edhe sigurinë e atij që flet, i cili tregon se veprimi do të ndodhë së shpejti, pra në të ardhmen: *të zura, u ngrita tani, erdha, erdha*, se ku *fute* nga unë pastaj?

M. Lambertz-i mendon se në këtë të folme, **imperfekti ka kuptim punktual**, tregon një veprim të çastit në të shkuarën, pra ngjan me aoristin si në fjalinë: Të gjitha *pushuan* (Aor.) e *vështronin* (Imp.) nusen (:89). Inte-

¹³ A. Vehbiu, *Kastra e Gjinovs*, në **Peizazhe të fjalës**, 6 Gusht 2017.

¹⁴ Shih: A. Omari, *Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut*, në: **Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet**, Albanische Forschungen 29, Hgg. von Bardhyl Demiraj, Harrassowitz, Wiesbaden, 2010, 356-374.

¹⁵ Q. Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, në: **Dialektologjia Shqiptare I**, Tiranë, 1972, f. 156.

resante janë gjetjet e tij të rasteve të imperfektit pa dhe me mbaresë, si: *flit* dhe *hidh* sitë; *s'flin* fare; *vin* buzën në gaz; *ta zgjon* apo mos *ta zgjon*? Krahas këtyre gjen edhe shembuj, si: *gogësinte*, *gjente*, *ikënte*, *flitte* etj. Ndodh që brenda një fjalie njëra folje në të pakryerën të dalë me mbaresë e tjetra, jo: *Do ta bënte* (me mb.) e *ta han* (pa mb); *Të krente* (me mb.) kazanin e *ta vin* (pa mb) te luku.

Në tiparet e shqipës së ligjërimin popullor është karakteristikë **urdhërorja si kohë tregimore**, e cila nga vëzhgimet e studiuesve¹⁶ del edhe si tipar ballkanik (shqip-sllavisht-rumanisht). Lambertz-i vuri re një *imperativ pa sufiksë* (:89) që tregon një veprim të gjallë e përfaqëson kohën tregimore të së shkuarës: *fol* njëri e *fol* tjetri; *largohu* kjo e *mbillu* një portë; *ha e këndo*; *hir* e *dil* e *qesh*; *këndo* krushkat e *këndo* të shtëpisë.

Gjuha popullore preferon **pësoren pavetore**: *dëgjonet*, *haronet*, *martonet*, etj. Pasivi i vetës III të imperfektit del më dendur me mbaresën – *esh* se me –*ej*: *dukesh*, *dëgjonesh*, *llizesh*, *gdihesh*, *nuk ngopesh* së shikuari vajzën, *mendonesh*, pse të mos *gëzonesh*? ...etj.

Lidhorja në këtë të folme gjendet në trajtën: *të bëç*, *të dalëç*, *të dëgjoç* etj.

Dëshirorja: *dalça*, *zënça*, *rofç*, *gëzofç*, *artë* “ardhtë”, *vaftë* etj.

Përsa i përket **së ardhmes**, Lambertz-i ka dalluar dy tipa strukturorë: atë me foljen e ngurosur *do* dhe lidhoren herë me pjesëzën *të* e herë jo: *të martoheni*, *do ta sëmureç*, *do më uroç* etj, *do bëjmë*, *do veç* etj. Në fakt ligjërimin popullor të banorëve të këtij qyteti i mungon përdorimi i pjesëzës *të* të lidhores. Lambertz-i konstaton të dyja përdorimet, sepse Musineja nuk është konseguente në përdorimin e këtij ligjërimi. Ajo ishte vajzë e shkolluar e si e tillë ishte larguar disi nga e folmja e qytetit të saj, prandaj përdorimi i kësaj të folmeje në vepër është përgjithësisht i qëllimshëm. Kemi vënë re se, vërtet autorja ka përdorur një gjuhë dialektore, por ajo është e përpunuar dhe herë-herë e përzier me elemente të normës letrare.

Nga ana tjetër Lambertz-i ka dalluar dhe tipin me foljen *kam* + *për të* + *pjesoren*: *kam për të hirë*; *ke për të fituar davanë*; *kam për të krier*.

¹⁶ Victor A. Friedman, *Urdhërorja treguese në gjuhët ballkanike në Shqipja dhe gjuhët e ballkanit/ Albanian and Balkan languages*, Prishtinë 2012.

Në fakt nga këto dy forma ne mendojmë se përdorim më të gjerë në thjeshtligjërime, veçanërisht te brezi i moshuar zë vend e ardhmja e tipit *kam + për të + pjesoren*. Edhe B. Demiraj ka vërejtur edhe më gjerë se kjo e folme se, përkundrazi, në dialektin toskë – siç pritet dhe dihet – ky tip strukturor sundon thuajse i vetëm në ligjërimin bisedor.¹⁷

Vend të veçantë zë **pjesorja** (:93) në këtë punim. Nga shembujt që sjell duket se ajo është një kategori gramatikore, të cilën në këtë të folme nuk e dallon qartë. Lambertz-i në vend të japë forma pjesorësh të vjetra me prapashtesën *-të*, që gjenden me shumicë në veprën e Musinesë, si: Penxheretë qenë *hapët*, dambano. (:180); Sitë nuk i mbante *ulët* e nuk lëshonin lotë... (:385) [khs. me Buzukun: këto kafshë klenë *bātë* për të vërtetë (f.225/b) ; e tue *klatë* u ndaj ɳ si (75/b)ë, ka gjetur shembuj të tipit *kokë ulur* të cilat janë tregues i mungesës së koherencës së gjuhës së Musinesë. Ato i krahason te N. Frashëri “Bagëti e bujqësia” me *qeshur, gëzuar, shkuar, pirë*. Te “Lahuta e Malcijs” së Gj. Fishtës: *dalë* me gjue, *çue* dollâmën, *lshue* dollâmën, *zgjeshun* brezë, *ardhun* shtatit; *marrë* turin.

Në Gjirokastrë gjen pjesore të tashme të tipit: Dielli *mbuluar* dhenë; Qielli *bënë* qelq. khs. me Veriun: *mustakun derdhë* n dy dega. Por në disa raste M. Lambert-zi ngatërron pjesoren me mbiemrat prejpjesorë: me buzë *të dredhura*; burrin vërtet *të kursier* etj, kurse te Naimi: me zëmërë *të dëfryer*; i dëshiruar etj.

Megjithatë i ka qëmtuar me kujdes e në shumë shembuj pjesoret që kanë formuar emra foljorë: mbaruan *së ngrëni*; koha e *së pirit*; një kunatë në *të harruar* të vjen; nga *të parit* “nga pamja”; ç’është këta *të vatur*; *të hira* e *të dala* etj.

Ka vënë re forma foljore kalimtare, të cilat në gjuhën shqipe dalin si jokalimtare: *shkon bukën*; *shkon pështimën më të poshtë*; *i shkoi bezeliquet në duar*; *hiri derën*; *xërmoi* “zbriti” *shkallat* etj.

Në Jug të vendit nuk dallohet mirë kategoria e gjinisë, ndryshe nga gegërishtja. Lambertzi ka gjetur forma të emërores e thirrores ku vajza thirret *bir* ose *biro* dhe e ilustron me vargjet e këngës popullore: *bir, vetullat e*

¹⁷ B. Demiraj, *E ardhmja e tipit do+lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe*, në **Shqipja dhe gjuhët e ballkanit/ Albanian and Balkan languages**, Prishtinë 2012.

holla!

Për **rasën kallëzore** janë sjellë në punim me asimilimin regresiv /tn/:/n trajta arkaike të shkurtuara të emrave karakteristikë për mbarë shqipen e që në këtë të folme toske gjallojnë ende: *barunë* < barutnë; *birenë* < bireknë < birekunë; *fshanë* < fshatnë; *hajdunë* < hajdutnë; *benë* < beun.

Sillen shembuj të shumësit të emrave në rasën gjinore në variantin më të vjetër pa shtesën -v antihiatizuese, në temat që mbarojnë me bashkëtingëllore: *djelme* < djemve; një jemeni të *duare*, *duarve*; në mes të *ile* “ të hyjve”. (:96)

Ka vërejtur në sistemin emëror një inovacion të përbashkët për të dyja dialektet në rastin e mbaresës së zgjeruar të rrjedhës me *-shit*, të cilën E. Çabej¹⁸ e interpretonte si “...refleks i IE *-su* me anë të nyjës *-t*”: *dhëmbëshit*, *dhëmballëshit*, *mjekërshit*, *mustaqeshit*. Kjo mbaresë gjendet ende sot në këtë të folme në formë mbeturinore (khs. te Gj. Buzuku:..ashtu edhe u *vepërashit* së këqijash (Mesh. 161/a); .. *pleqshit* gjukatës (Mesh. 165/a) në disa shprehje popullore si: *Ma kreve bukën hundëshit* apo në shprehjen që përmend nga vendlindja E. Çabej në parathënien e “*Mesharit*” dhe që ende përdoret në këtë qytet, si: *Më iku balta këmbëshit*.

Në fushën e **fjalëformimit** ka evidentuar deminutivin -z- tek ndajfoljet: *dalezë*, *kadalëz-o* *dingëzë*.

Artikulli i M. Lambertz-it vijon më tej me disa tekste të tjera nga libri “Siç më foli nënua plakë” (1939), libri i parë i M. Kokalarit. Në to dallohet qartë të gjithë emrat e farefnisisë që përdoren edhe sot në këtë qytet: *babamadhë*, *nënua*, (em. nëno), *vëlleshat* “motrat e burrit”, *kunatat*, *hallat*, *tetot*, *xhaxheshat*, *dajko* “daja”, *dajkëla* “gruaja e dajës”, *nënëdajkua*, *katënxhikë* “vjehera”.

Duke qenë njohës i greqishtes, të shumta janë njësitë leksikore që qëmton autori në këtë të folme, si: *dhams e feks*, *dhangë*, *pato*, *dhoga*, *dhrom*, *ergatja*, *erimi*, *fekëstin*, *fener*, *fole*, *gjitone*, *honeps*, *holas* “mërzitem”, *jatro* “mjek”, *kallogre*, *kallogrickë*, *kanakar*, *i karfosur* “i lidhur, i zënë”, *kolis* “ngjit”, *kondis* “zë vend”, *kondo* “këmishë burrash”, *kseftiset* “griset”, *ksegoras*, *kselhasur* “i kënaqur”, *ksenitia* “ërrësira”, *llahtar*, *llam-*

¹⁸ E. Çabej, “*Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*”, **Studime Gjuhësore VI**, Prishtinë, f.71

bë, mavrija “e zeza”, *nasqirizmat, nasqiris* “rregulloj shtëpinë”, *llambro, nikoqir, papsi* “pushoi”, *patai* “çudi”, *pirostija, prokopia* “pasuria, protare ‘grua që ka lindur fëmijën e parë’”, *psunis* “bëj pazar”, *rufis, qëndis, rokanis* “grindet”, *shpirto* “shkrepëse”, *tiliks* “mbështjell” etj.

Shumë njësi leksikore të greqishtes ia nënshtron edhe një analizë morfematike për të treguar se megjithëse rrënja e fjalës vjen prej greqishtes treguesit gramatikorë i marrin në analogji me fjalët e shqipes, prandaj janë përshatur mirë në këtë të folme: *fekëstinin* < greq. φέξα “ndrin” + mbaresën e aoristit *-ta* + mbaresën e së pakryerës *-inj*; *gjitonja* “fqinja”, greq. γει’τονας + mb.-ja.

Fjalët nga greqishtja e re - thekson Lambertz-i- janë fiksuar kaq shumë në këtë të folme, por edhe pse janë barbarizma, ato i shkojnë gjuhës popullore, e cila i pranon sepse s’mund të normëzohet si gjuha e shkollës.

Duke qenë se vepra që shfrytëzoi i përket një gruaje të besimit mysliman të qytetit, turqizmat që ka sjellë Lambertz-i janë të shumta.

Në punim një vend të veçantë zë përdorimi i ndajfoljeve. Ka konstatuar mjaft raste kur ato përsëriten: *ati për ati; këmbë, këmbë*; ku *ati* e ku *këtu*; në *fund* të *fundit*; *troiro* e *troiro* “rreth e rrotull”; *osh e zvara* etj.

Lambertz-i ka depërtuar edhe në ndërtimet më të holla e të veçanta të kësaj të folmeje. Ndajfolja *avash* < turq. *yavaş* këtu, në numrin shumëpërdoret *javashni*, duke dalluar kështu mbaresën foljore **-ni** të foljeve në mënyrën urdhërore. (krhs. *eni, bini*). Këtë dukuri për shqipen e ka vëzhguar edhe E. Fiedler¹⁹, i cili mendon se shqipja ka mundësi që mbaresën **-ni** të imperativit ta ndajë nga trajta foljore. “Kjo dukuri, njëfarë “crossover”, - thotë ai- një kalim nga sistemi foljor në kategori të tjera gramatikore, nuk i përket vetëm shqipes, edhe pse, siç do të shohim, shqipja këtë tipar e ka zhvilluar në mënyrë më konsekuente.” Sipas këtij studiuesi kjo mbaresë shumësi del në këtë të folme edhe me pjesëzën **mos - mosni**, pasthirmën **hajdeni**, si dhe te emrat **o burrani** (ndërtim që K. Topalli e ka quajtur “pseudourdhërore” (2011: 818) apo te përsëritjet **mirëmëngjesni**.

Lambertzi nuk ka lënë pa përmendur edhe disa **pasthirma** (:133),

¹⁹ Wilfried Fiedler, *Disa veçori tipologjike të urdhërores në gjuhët ballkanike*, në vep.cit., Prishtinë 2012, f.107.

për studimin e të cilave është mbështetur nga ana teorike në studimin e Ernst Scheëntner²⁰. Ato sipas Lambertz-it:

- inkurajojnë domosdoshmërinë: hë dhe një çikë, se erdhëm; hë këndon tani!

- shoqërojnë pyetje të habitshme hyrëse: hë prapë ethe?; hë ta thom tani, hë pastaj.

- shprehin kënaqësi: hajde de; de, de etj; vështirësi, siklet: eh të shkretën; oh, oh.

- shprehin pyetje pa dëshirë: eh ku vate tëllësimi i parë?

Lambertzi ka dalluar disa **tipare të veçanta të thjeshtligjërimit** si shprehja **një çikë** që përdoret në vend të ndajfoljes **pak**: na një çikë, eja një çikë, pas një çike, për një çikë. Po kështu vëren përdorimin e fjalës **gjë** për sinonimin e saj **aspak**: s'jam lodhur **gjë**; nuk më mori **gjë** malli; s'qe **gjë** më e largët na të tjerat; u mërziqe **gjë**?; të mori **gjë** urija?

Në fjali vëren siç e quan edhe vetë **Gemination emphatische** (përsëritje të theksuar): dhanë e dhanë duke kënduar; ishte e ç'ishte; sa herë që vente e vinte; ishin apo s'ishin që të gjithë; këta të ardhur mëngjes për mëngjes; pa mirë e mirë shtëpinë; rinin kokoshe radhë radhë; vinte rëndë rëndë; si e si më të mirë; ç'është ajo, ç'është; ç'na panë sitë, ç'na panë; thesët barë barë; na ha qenë e naha s'qenë etj. Këtë tipar e ka mbarë shqipja dhe Lambertz-i e krahason me shembuj të tillë të "Lahuta e Malcijs" e Gj. Fishtës: vajza ka e vajza s'ka; por kam pa trima e s'kam pa; ka ndo i send e s'ka ndo i send; jo kështû i drue e jo kështû s'i drue. Përsëritja është dukuri tipike në ligjërimin popullor në mbarë shqipen, sepse shprehja e çiltër e mendimit ende nuk është bërë e ndërlikuar nga stërhollimi që prish çdo bukuri estetike.

Brenda këtij tipi ai ka veçuar edhe ato ndërtime që janë sinonime, por me kuptim të kundërt: bjer e shpjer fjalë; më tundesh e më shkundesh; kush veshur e kush zhveshur; u çornë e u nduknë; pa për të hirë brënda, s'hiri. Te Gj. Fishta përsëri gjen raste të ngjashme: me i besue, mos i

²⁰ E. Schewentner, **Die primären Interjektionen in den indogermanischen Sprachen, mit besonderer Berücksichtigung Griechischen, Lateinischen und Germanischen**, Heidelberg, 1924.

besoni; ndaç të këndonte, ndaç të mos këndonte.

Ligjërimi popullor ka tipar **abundanzën** (këmbënguljen) (:121) që shprehet me përsëritjen e ndajfoljes e të foljes: *sa për si e sa për faqe; sa për ashtu, është e vetmëja; këtu ta thomi, këtu ta lëmë*. Kur përsëritet folja, si në mbarë shqipen, ato dalin në trajtat arkaike të vetës III njëjës të së pakryerës pa mbaresë: *rin sa rin; bën sa bën dhe u hidhte na një si*.

Në punim janë identifikuar në këtë të folme shumë shembuj fjalish me krahasime pa **pjesëzën si**: *është një çikë turrider; dhëmbët e bardha zborë; qe një kohë qelq; kur vente nëna gjëkund, bënesh djali pulë etj*.

Ligjërimi popullor ka tipar **sinoniminë** të cilën ai e gjen në shprehjet: *pa kandile, pa foti; pa sumbull e pa thile; u zunë e u vranë; vdiq, u lodh e u këput etj*.

Shprehjet që përmbajnë **hipërbola** janë të shumta në këtë të folme e të qëmtuara me kujdes nga Lambertz-i: *i ka çiqitur me dizet par hapëse; nuk dua ta shoh për 100 vjet; pesëqind bishtëra i vunë na prapa; si ata që qenë mësuar me pesëqind të mira; mos janë një e di, po deti; u hapesh gola sa një kamare...etj*.

Gjejmë të përshkruara **shprehje të shkurtra, koncize** (Brachylogien): *le të frinte, po hi mos binte; le se ç'heqin, të zezat motra; të dëgjosh gjithënjë avazin; barku plot etj*.

Përdoret Litota e këtë e përligj ligjërimi popullor në të cilin ai që flet thotë më pak, duke lënë të kuptohet më shumë. Litota përdoret për modesti, për druajtje dhe rrallëherë edhe për ironi: *s'kish mbetur njeri pa ardhur; s'kish lënë gjë pa vënë; s'na la gjë pa marrë; s'kish lënë dasëm pa vatur; që s'i le t'ëmbël pa bërë; ti që s'le derë e portë pa çokanisur etj*.

Duke vëzhguar tekste të tjera nga vepra e M. Kokalarit, Lambertz-i ka vënë re dukurinë e **anakolutës (Anakoluthe der Uspr)** që është një ndryshim i menjëhershëm brenda një fjalie nga një strukturë sintaksore në një tjetër, dukuri e cila ndodh vetëm në ligjërimin bisedor, e ku sigurisht luan rol situata gjuhësore: *Vajzat e sotme, me t'u martuar, jo më dhëmb brinja, jo këmba, jo koka. Kanë të drejtë të flasin dhe ato, lihet shtëpia në ditën e kujos? Do të bëj qejf si shoqet dhe drunë u vuri etj*.

Shprehje frazeologjike e proverba (:130-132): *ku qaf e ku kungull;*

nuk ju kam zënë sinë; i zuri dorën; e zunë të dhëmburat; iu bë mëndja dhallë; para ka plot sa të hanë qentë; ia kish vënë në bina, Zoti mënon, por nuk harron; gusht e gunë, vjeshtë e lugë; janë mjalë e gjalpë etj.

Lambertz-i edhe midis shprehjeve frazeologjike dallon ato që shprehin një mendim të ngjeshur, të cilat i quan *fraza drastike (drastische redensarten)*: *fjalë pa bina; më bie bretku; më mbetet hatëri* etj. Këtu përfshin edhe disa njësi leksikore të tipit: *pishëvënë, fesatçeshë*, të cilat i quan kompozita duke cituar K. Cipun (BISH.2.210).

Përshkrim të gjerë e shembuj të shumtë nga kjo e folme janë sjellë për fjalitë me **parataksë** e **asidendetë**: *zin e përqeshte; sa të rritesh e të lipsesh; sa venin e shtoheshin (paratks.) dhe nuk shkoi shumë, erdhi; rri kështu rri ashtu* (asid.) E po kështu tipar janë **fjalitë eliptike (Kurzsätze)**: *Mezi ecnin po fjalët jo s'i linin; Nusja posht e lart me kafe në duar etj.*

Maximilian Lambertz-i me këtë artikull na ka lënë një përshkrim të gjerë mbi tiparet gjuhësore të ligjëritit popullor, e veçanërisht atij toskë. Edhe në këtë drejtim ai radhitet përkrah alabanologëve të famshëm gjermanishtfolës që me studimet e tyre çelën shtigje të reja në fushën e studimeve gjuhësore, duke i çuar përpara në mënyrë të shënueshme.

BIBLIOGRAFIA

- Beci, B., (1991) *Rreth së ashtuquajturës “h” irracionale në veprën e Buzukut*, **Studime Filologjike**, Tiranë.
- Bozhorri, K., - Liçaj, F., (1975) **Kronika e Tokove**, Tiranë.
- Çabej, E., (1964), *Maximilian Lambertz*, **Studime Filologjike**, Tiranë.
- Çabej, E., (1968) **“Meshari” i Gjon Buzukut**, Tiranë.
- Çabej, E., – Xhuvani, A., (1976) *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, **Studime gjuhësore, III**, Prishtinë.
- Demiraj, B., (2012) *E ardhmja e tipit do+ lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe, në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit/ Albanian and Balkan Languages*, Prishtinë.
- Friedman, A. V., (2012) *Urdhërorja treguese në gjuhët ballkanike në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit albanian and balkan languages*, Prishtinë.
- Haxhihasani, Q., (1972) *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë në: Dialektologjia Shqiptare, I*, Tiranë.
- Ismajli, R., *Grafia e Buzukut dhe disa çështje të sistemit fonetik të shqipes në Gjurmime albanologjike, SShF*, VII.
- Lambertz, M., (1916) *Vorläufiger Bericht Des Max Lambertz über seine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916. Anzeiger der Kais. Akad. d. Wiss. In Wien. Linguist. Abt. XII*
- Lambertz, M., (1922) **Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde**, Wien.
- Lambertz, M., (1958) **Lingua Posnaniensis**, VII.
- Omari, A., (2010) *Tipare arkaike në gjuhën e Bogdanit: përkime me të folmet e Jugut, në: Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, Albanische Forschungen 29, Hgg. von Bardhyl Demiraj, Harrassowitz, Wiesbaden.
- Riza, S., (1996) *Njzat e shqipes në tekstet e pesë autorëve tanë më të vjetër*, në: *Vepra 1*, Prishtinë.
- Rrota, J. (1956) *Hulumtime dhe shenjime mbi Gjon Buzukun*, **BShSh**, 3.
- Topalli, K., *Rreth vlerës së shkronjës “h” në Mesharin e Gjon Buzukut*, **SF** 1-4. 1993.
- Totoni, M., (1966/1) *Vëzhgime rreth të folmes së Gjirokastrës* në **Studime Filologjike**, Tiranë.
- Vehbiu, A., (6 Gusht 2017) *Kastra e Gjinos*, në **Peizazhe të fjalës**.

Begzad BALIU, Prishtinë

MAKSIMILIAN LAMBERCI DHE VENDI I TIJ NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE

Maksimilian Lamberc: Jetëshkrimi kompleks i një modeli të gjysmës së parë të shekullit XX

Maksimilian Lamberc (Maximilian Lambertz) lindi më 27 korrik në Vjenë, më 1982. Studimet e rregullta i mbaroi në Vjenë, Mynhen dhe Berlin, por i vazhdoi gjatë gjithë jetës në karrierën e tij shkencore. Ai ishte një vazhdues i metodave dhe koncepteve shkencore të indoeuropetit të madh të kohës Paul Kretschmer. Prej koncepteve të tij trashëgoi prirjen për gjuhët klasike dhe trashëgiminë letrare e etno-historike të popujve të ndryshëm, e në mënyrë të veçantë të popullit shqiptar. Fillimet e para i nisi si profesor në disa shkolla të Vjenës, por përgatitja e tij shkencore prej filologu e njohësi të gjuhëve klasike - sanskritishtes dhe latinishtes, greqishtes dhe gjermanishtes, shqipes e gjuhëve të tjera moderne, bënë që ai të ftohej në Mynhen bashkëpunëtor i fjalorit të madh latinisht *Thesaurus linguae latinae*. Në ndërkohë u emërua profesor i gjuhësisë në Universitetin e Lajpcigut, ku punoi një jetë të tërë, pavarësisht angazhimeve të tjera, duke përfshirë këtu edhe studimet teologjike dhe udhëtimet e vazhdueshme shkencore në Ballkan e në Azi, por sidomos në hapësirën etnike dhe gjeografike shqiptare. Duke qenë i biri i një nëne hebreje Lambeci, si dhe bashkëkohësit e tij, bëri edhe studime në fushë të teologjisë dhe u gjet shumë herë para vështirësive të kohës.

Si edhe shumë studiues të tjerë, të cilët më parë se sa të merreshin me albanologjinë, u morën me helenistikën (Gustav Majer), sllavistikën (Mikloshić), e madje edhe romanistikën (Taliavini) edhe Maksimilian Lamberci, fillimet në fushë të albanologjisë i nisi krejt rastësisht. Profesor Aleksandër Xhuvani thekson se: "Lamberci studimet e tij mbi gjuhën shqipe i ka filluar qysh kur ishte student universiteti: nga viti 1906, kur erdhi në Athinë e dëgjoi disa mësimë në Universitetin e këtij kryeqyteti, i ra

puna të vejë në Thivë, kur për së pari dëgjoji gjuhën shqipe, që flisnin vendësit e katundeve Kukla e Kryekuq afër Thivës. Tue bisedua me ta iu zgjua kërsëheria për këtë gjuhë, mbajti shënime aty për aty e mblodhi pak material, dhe qysh atëherë iu vu studimit me themel të gjuhës sonë, sa që sot jo vetëm që e shkruan, por edhe e flet mirë e kuptueshëm”¹.

Pas këtij viti dhe pas këtij momenti njohjeje dhe vlerësimi të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare Maksimilian Lamberci vazhdoi ta vizitojë hapësirën gjeografike, etnike, gjuhësore e kulturore shqiptare një jetë të tërë. Të para në kontekstin kronologjik, Lamberci ka vizituar hapësirën etno-kulturore e gjuhësore (Greqinë e Italinë Jugore) disa herë. Në vitin 1916 për herë të parë shkoi në një ekspeditë në Shqipëri për të hulumtuar dialektin e Mirditës dhe mblodhi tekste popullore në Zadrimë, Malësi të Madhe, Dibër, Elbasan dhe Borsh; në vitin 1917 qëndroi një vit në Shqipëri ku vazhdoi me kërkime në fushë të gjuhës, letërsisë dhe traditës popullore, për të vazhduar deri në vitet e fundit të jetës së tij, në vitin 1954 kur e vizitoi Shqipërinë për herë të fundit.

Për jetën personale të Lambercit, biografinë më të plotë e sjell Robert Elsie, i cili nuk fsheh as ato angazhime dhe koncepte të cilat nuk i shfaqin bashkëkohësit e tij në Tiranën e pasluftës së dytë botërore, ku veç tjerash mund të lexojmë: “Lamberci u kthye në Austri pas Luftës së Parë Botërore dhe punoi mësues shkollë deri në vitin 1934. (...) që prej 1910 ishte anëtar i Partisë Socialdemokratike të Austrisë... Në moshën 53 vjeçare (...), ai iu kthye studimeve universitare për teologjinë protestante, por disertacioni i tij u hodh poshtë nga fakulteti për arsye racore - nëna e tij kishte qenë me prejardhje hebreje. (...) Në qershor të vitit 1945, pasi u bë

¹ Aleksandër Xhuvani, *Maksimilian Lamberc në Shqipëri*, Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, 1954, nr. 2, f. 142-144. In *Vepra gjuhësore*, IGJ i ASH e RPSSH, Tiranë, 1990, f. 472. Po këtë situatë e dëshmon Profesor Çabej, një një nga tekstet e tij të shumta për Lambercin: “Sikur i ka treguar të nënshkruarit ai vetë me rastin e një bisede, interesimi për gjuhën shqipe iu ngjall rastësisht, atëherë kur n’anët e Tebës (Thivës) në Greqi u njoh me disa barinj të asaj krahine të cilët i ndjeu se flisnin shqip duke kullotur bagëtinë”. Shih studimet përmbledhëse të tij me të dhëna biografike për Lambercin: *Maximilian Lambertz në shtatëdhjetëvjetorin e ditëlindjes*, Buletin shkencor, nr. 2, f. 127-130, Tiranë, 1957; *Maximilian Lambertz (1882-1963)*, Studime filologjike, viti XVIII (I), nr. 1, f. 211-216, Tiranë, 1964; *Maximilian Lambertz*, Nëndori, viti IX, nr. 9, f. 174-177, Tiranë, shtator 1962.

anëtar i partisë komuniste, u emërua drejtor i Shkollës së Lajpcigut për Gjuhë të Huaja. Në tetor 1946, u bë profesor i gjuhësisë krahasimtare dhe deri në vitin 1949 dekan i Fakultetit të Pedagogjisë së Universitetit “Karl Marks” të Lajpcigut. U bë gjithashtu drejtor i Institutit të Studimeve Indoevropiane deri në vitin 1957 kur doli në pension. (...) Vdiq më 26 gusht 1963. U varros në varrezat Wien-Döbling në qytetin e lindjes, në Vjenë².

Gjatë një periudhe prej më shumë se gjysmë shekulli ai ishte pjesë e disa zhvillimeve të rëndësishme në jetën kombëtare, politike, arsimore dhe shkencore të popullit shqiptar. Në rend të parë do theksuar pjesëmarrjen e tij në “Komisinë Letrare të Shkodrës” (1917), me ç’rast, sikur theksonte Profesor Çabej “ai ndihmoi mjaft që rregullat ortografike që u vendosën atje të abstragoheshin nga shqiptimi real e njëkohësisht të mbështeteshin në një normim të varianteve që ekzistojnë nëpër dialekte, duke pajtuar parimin fonetik me parimin e gjuhësisë historike”³. Pa dashur që këtu të ndalemi në udhëtimet e tij kërkimore shkencore në hapësirën gjuhësore ballkanike dhe italiane në gjurmë të trashëgimisë shqiptare, po e theksojmë rëndësinë e vizitës së tij në Shqipëri, në një periudhë kur në Shqipërinë e pasluftës së dytë botërore, prania e albanologëve nga radhët e brezit të hershëm të shkollës austro-gjermane e hungareze dhe italiane, pothuajse ishte e pamundur. Në këtë rast Maksimilian Lamberti solli disa ndihmesa të rëndësishme për albanologjinë: e para, përgatiti tekste mësimore për të huajt që dëshironin të studionin gjuhën dhe letërsinë shqiptare; e dyta, mbajti të hapur mësimdhënien e gjuhës shqipe në Universitetin e Lajpcigut; e treta, vizitoi Shqipërinë dhe mbajti lidhjet e gjuhëtarëve shqiptarë me Europën; dhe së fundi, disa vjet me radhë, jo vetëm shkroi e botoi disa vëllime me interes për gjuhën, letërsinë e sidomos folklorin shqiptar, por prezantoi me përkushtimin më të madh arritjet në fushë të albanologjisë në disa nga revistat e specializuara gjermane. Në të vërtetë, për më shumë se një dekadë, pas Luftës së Dytë Botërore, ishte nyja e fundit e lidhjes së brezit të vjetër të albanologëve mes Tiranës dhe Europës, në një kohë që i shtyrë nga lëvizjet strategjike e politike ndërkombëtare, një brez i ri gjuhëtarësh sovjetikë e përgjithësisht nga Lindja, po përgatitej të mësonte e të studionte gju-

² http://www.albanianphotography.net/lambertz/index_al.htm (17 shkurt 2018)

³ Eqrem Çabej, *Maximilian Lambertz*, “Nëndori”, viti IX, nr. 9, f. 174-177, Tiranë, shtator 1962. Cituar nga *Studime gjuhësore*, V, Prishtinë, 1975, f. 178.

hën shqipe⁴.

Gjatë kësaj periudhe prej më shumë se një dekade Lamberci botoi në shtypin gjerman, kryesisht në Gjermaninë Lindore dhe Poloni, një varg recensionesh për botimet e asokohshme të Tiranës në fushë të shkencës filologjike dhe të kulturës. Në këtë periudhë ai i përcolli me recensione në gjuhën gjermane daljen nga shtypi të veprave të Aleksandër Xhuvanit *Studime gjuhësore* dhe *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*; revistën universitare *Buletin i Institutit të Shkencave* dhe *Normalisti*; dramën e teatrit shqiptar të kohës, e në mënyrë të veçantë dramën e Kolë Jakovës *Toka jonë*; veprën e parë të Çabejt, në të vërtetë dispensën *Albanologji*, botuar pas Luftës së Dytë Botërore; vëllimet e trashëgimisë mendore dhe folklorike shqiptare *Fjalë të urta të popullit tonë*, *Këngë popullore historike*, *Këngë popullore legjendare*, *Përralla shqiptare (Motra me flatra dhe të errëtat e dheut)*, *Poezia popullore arbëreshe*; veprën që ka bërë ndikim gjatë në jetën shkencore, arsimore dhe kulturore shqiptare *Fjalor i gjuhës shqipe* (1954), madje edhe numrin mjaft të pasur të revistës së parë shkencore në Kosovë *Glasnik Muzeja Kosova i Metohije*, dy nga veprat më të vëllimshme të institucioneve shkencore shqiptare të viteve '50, *Historia e letërsisë shqipe*. I. dhe *Historia e Shqipërisë*, I, veprën e Naim Frashëri *Lulet e verësë*; veprën poetike të Risto Siliqit *Vepra të zgjedhura*; kryeveprën e dialektologjisë në fushë të albanologjisë, pra veprën e Vaslav Çimohovskit *Le Dialecte de Dushmani* etj.

Gjatë kësaj kohe Maksimilian Lamberci ka dëshmuar shumë herë dhe në përmasa jetësore e shkencore, përkushtimin ndaj albanologjisë, qoftë në kontekst të kërkimit e studimit të saj të brendshëm qoftë gjatë vlerësimit e studimit krahasimtar të saj. Këtë respekt dhe dashuri ndaj shqiptarëve dhe gjuhës e kulturës së tyre e ka shpjeguar më së miri Fiedleri kur ka theksuar se: “Në qendër të vëmendjes së tij (Lambercit, vj.) (...) ishte folklori, dhe ky interesim shkencor buronte nga dashuria e thellë e këtij shkencëtari ndaj shqiptarëve dhe karakterit kombëtar të tyre, dashuri kjo të

⁴ Për vlerësimet e Lambercit në lidhje me gjendjen politike, kulturore e sociale në Shqipëri, shih *Fjalën* e Aleksandër Xhuvanit, *Dr. Prof. Maksimilian Lamperc*. Me rastin e 75-vjetorit të lindjes, “Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore”, Tiranë, 1957, viti X, nr. 1, f. 238-240. Cituar sipas *Vepra gjuhësore II*, Tiranë 1990, f. 476-479.

cilën Lambarci e shprehte në çdo rast⁵.

Në historinë e albanologjisë tashmë është krijuar një traditë treshekullore e studiuësve që kësaj fushe i qasen në kuadër të vazhdimësisë së kërkimeve, shkollave, metodave dhe nocioneve të dijes europiane. Në radhë të parë, një shkollë më vete që në fillimet e saj përbëjnë studiuësit e pararilindjes kombëtare, të cilët vinë para se gjithash nga provenienca e arbëreshëve gjatë shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX; në radhë të dytë vinë studiuësit e shkollës së proveniencës austro-hungareze në gjuhën gjermane dhe asaj angleze (protestante), të cilët gjuhën shqipe përkatësisht albanologjinë nga gjysma e dytë e shekullit XIX deri në fund të gjysmës së parë të shekullit XX, e bënë ajo që është sot: shqipen gjuhë historike dhe albanologjinë dije moderne; dhe në radhë të tretë, studiuësit e filologjisë shqiptare, të cilët janë vetëm një vazhdimësi e dijes europiane gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX e më tutje.

Një shembull model i traditave në kërkimet albanologjike paraqet edhe Maksimilian Lambarci, i cili me përkushtimin e kërkimeve të tij ndaj gjuhës shqipe dhe trashëgimisë e bashkëkohësisë së saj ndërli dhe traditën më të avancuar të saj: nga Hahni (në gjysmën parë të shek. XIX) te Robert Elsie (fillimi i shekullit XXI), duke përjashtuar Nopçën, misioni i të cilit i tejkalonte interesat shkencore, pasi pretendonte edhe synimet politike. Pa dashur që në këtë fjalë parathënëse të një studimi monografik për një *Histori të albanologjisë*, të ndalem në biografinë përshkruese të tij, dua të kujtoj këtu ato prirje të Hahnit në biografinë e tij, që të shkelte me këmbën e tij gjithë hapësirën gjeografike që do ta merrte në shqyrtim; prirjen shkencore të helenistit, në fillim dhe më tej, të albanologut të përkushtuar Gustav Majer, që prejardhjen e popullit shqiptar e të gjuhës shqipe ta gjejë tek etimologjia e fjalës, i pari, dhe gjenealogjinë e përbërësve mitikë të lertërsisë popullore, i dyti; që në atë prirje udhëtimi në biografinë e Nopçës, të gjej këmbëngulësinë e inventarizimit të gjithë trashëgimisë etno-gjeografike, historike, gjuhësore e folklorike, të cilën në kohën tonë, e gjejmë tek një studiuësit tipik i shkollës gjermane, Robert Elsie. Në këtë rrjedhë mund të themi se Lambarci është sinonim i sintezës së madhe jetësore e shken-

⁵ Wilfried Fiedler, *Maksimilian Lambarci*, Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj 4, UPFF, Prishtinë, 1978: 320.

core të gjithë albanologëve pararendës dhe bashkëkohës të tij, i cili në shenjë përkushtimi ndaj gjuhës shqipe e popullit shqiptar, arrin të asimilojë të gjitha ndikimet politike e ideologjike të kohës: nga hulumtuesi akademik në Europën Juglindore në fushë të helenistikës - te i dërguari i perandorak në Shqipëri; nga përfaqësuesi qeveritar (austriak) për shqipen e përbashkët - te kërkuesi i pashembullt studimor; nga hulumtuesi i trashëgimisë etno-geografike te mësuesi dhe autori i teksteve mësimore me përmbajtje të theksuar ideologjike etj.

Portretin e tij e ka sintetizuar në mënyrë brilante albanologu i shquar gjerman Wilfried Fiedler, me një studim të tij, një gjysmëshekull më parë, kur ka shkruar: “mund të thuhet me plot gojën se Maksimilian Lamberci (Maximilian Lambertz) është figura e fundit e plejadës së dijetarëve që themeluan dhe ngritën albanologjinë si shkencë”⁶.

Tri fushat themelore të kërkimeve në fushë të albanologjisë

E parë në tërësinë e saj, vepra arsimore, kulturore, letrare dhe shkencore e Maksimilian Lambercit kap disa fusha të dijes së albanologjisë, por e parë në vija të trasha, studiuesit e tij edhe kur e bëjnë objekt sintezash edhe kur e trajtojnë atë në mënyrë kronologjike, tek vepra e tij shohin tri aspekte të saj: gjuhësinë, folklorin dhe tekstet e mësimdhënies, për t’i plotësuar këto herë pas here edhe me kontributet e tij recensionale në shtypin shkencor të gjuhës gjermane. Sinteza e veprës së tij madje nuk mjafton të bëhet vetëm brenda titujve dhe fushave. Ato shkojnë përtej. Brenda teksteve mësimore ai ka botuar edhe tekste gjuhësore me karakter shkencor dhe tekste letrare me vlera antologjike, e përkthime me vlera estetike. Po kështu mund të thuhet edhe për folklorin, parë në kontekstin letrar e estetik.

I. Studimet gjuhësore, me theks të veçantë dialektologjia

Duke hulumtuar veprën gjuhësore të Maksimilian Lambercit nuk është vështirë të shihen përmasat e përkushtimit të tij në disa fusha të saj: ortografinë, dialektologjinë, gramatikën, sintaksën, leksikografinë, ono-

⁶ Wilfried Fiedler, *Maksimilian Lamberci*, Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj 4, UP - FF, Prishtinë, 1978: 317.

mastikën, shumë herë sa me karakter shkencor aq edhe me karakter të të nxënit të gjuhës shqipe dhe anasjelltas.

Janë dy situata historike (përjashto periudhën e fundit pas Luftës së Dytë Botërore), që dëshmojnë bazat e kërkimeve të tij: e para ka të bëjë me udhëtimin e tij në Greqi dhe në Itali, ku dalin në plan të parë interesimet dialektore; ndërsa e dyta, ka të bëjë me udhëtimin e tij në Shqipëri, më 1917, *Raporti* i të cilit përmbledh pothuajse të gjitha nismat e tij jetësore në fushë të kërkimeve të mëvonshme shqiptare⁷. Në të vërtetë, sikur thuhet në fillim të këtij *Raporti*: “Në pranverë të vitit 1916, Komisioni Ballkanik i Akademisë Perandorake të Shkencave në Vjenë më ngarkoi detyrën që të marr pjesë në një ekspeditë Ballkanike, të cilin do ta organizonte Akademia e Shkencave në marrëveshje me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Oborrit Perandorak, me qëllim që të bëj studime linguistike dhe folkloristike në Shqipëri”⁸. Më tutje, në *Raport* paraqiten në detaje, gati në përmasa të shënimeve të një ditari, të gjitha udhëtimet dhe aktivitetet kërkimore të Lambercit në Shqipëri, të pajisura kur e kur edhe me diskutime të brendshme mbi historinë, e mbi literaturën e çështjeve në trajtim, si dhe me përshkrime gjuhësore (dialektore, leksikore, onomastike etj.) të gjetjeve në terren. Sikur e ka theksuar edhe Profesor Gjovalin Shkurtaj, *Raporti* paraqet “pasqyrën e parë të gjendjes së dialekteve të shqipes brenda trojeve kompakte shqiptare”⁹.

Në tekstin tonë po i theksojmë tre përbërës të rëndësishëm që përfaqësojnë gjithashtu edhe nyjat e kërkimeve dhe diskutimeve të tij, duke përjashtuar pjesën e kërkimeve dhe diskutimeve dialektologjike, me të cilat do të merremi në nënkapitullin përkatës:

Në radhë të parë në këtë raport kemi të bëjmë me përpjekjet e shqiptarëve për hapjen e shkollave shqipe dhe ndihmesën e Austro-Hungarisë. Fillimisht Lamerci jep një histori të shkurtër të përpjekjeve të shqiptarëve për hapjen e shkollave shqipe në Shqipëri që nga fundi i shekullit XIX. Këtë meritë Lamerci para se gjithash ua përshkruan kolonive shqiptare të Egjiptit, të Sofjes, të Bukureshtit, të Selanikut, të Stambollit, të Bostonit etj.

⁷ Maksimilian Lamerc, *Raport mbi studimet e mia lingvistike në Shqipëri prej mezit të majit deri në fund të gushtit 1916* (dorëshkrim).

⁸ Lamerc, *Raporti*, f. 1.

⁹ Gjovalin Shkurtaj, *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 2012, f. 159.

Në këtë kohë, thekson Lamberci, Qeveria Austro-Hungareze e përkrahu kërkesën e shqiptarëve duke e ndihmuar hapjen e shkollave shqipe në Shkodër, si dhe përgatitjen e mësuesve në Klagenfurt dhe në Vjenë. Madje Qeveria Hungareze ndihmonte me fonde nga më të ndryshmet edhe shkollat e Françeskanëve si edhe të Jezuitëve, të cilat punon shumë për zhdukjen e analfabetizmit në Shkodër dhe më gjer në Veri të Shqipërisë.

Duke biseduar me mësimdhënësit e shkollave, me mësimdhënësit nga radhët e Jezuitëve dhe të Françeskanëve, si dhe personalitetet e ndryshme nga radhët e jetës kulturore dhe letrare, Maksimilian Lamberci problemën e gjuhës në Shqipëri e trajtoi duke u nisur nga dy përbërës, të cilat ai i shtronte në formë të pyetjeve: 1) Cila do të jetë gjuha e letërsisë në Shqipëri që do të përdoret në shkollë dhe në zyra? dhe 2) Cila do të jetë ortografia e kësaj gjuhe letrare?

Në lidhje me çështjen e parë ai e vazhdonte konkretizimin: Do të pranojmë një dialekt të caktuar të Shqipërisë si gjuhe letrare, ose do të përdorim si gjuhë zyrtare dhe shkollore një gjuhë të përzier, e cila do të bashkojë elemente gegërishte dhe elemente toskërishte? Në përpjekjet e gjertanishme në këtë drejtim ai sillte shembullin brilant të punës së Konstantin Kristoforidhit prej dekadash, përpjekjen e Faik Konicës me revistën *Albania* dhe ndihmesën e Lumo Skendës me revistën *Përpjekja*.

Është me shumë interes përshkrimi shterues i Lambercit për afrimet, fërkimet dhe veçoritë e dialekteve e nëndialekteve të shqipes, në interes të krijimit të gjuhës shqipe, prandaj po e japim tekstin e plotë: “Siç dihet dialektet e gjuhës shqipe në bazë të disa ndryshimeve tingullore, mund t’i përmbledhim në dy grupe, në grupin e dialekteve të gegërishtes dhe në atë të toskërishtes. Për problemin gjuhësor nuk vijnë në konsiderim dialektet lokale shqiptare të Greqisë dhe Italisë, që fliten jashtë Shqipërisë. Gegërishtja nuk është unike, por përfaqëson një shumë dialektesh lokale që ndryshojnë shumë në mes tyre për sa i përket kuptimit lingistik. Kështu për shembull dialektet lokale të Kosovës dhe të Gjakovës në bazë të veçorive të tyre tingullore dhe fleksive, formojnë një grup; prej këtij grupi dialektet lokale të Malësisë që janë shumë afër njëri - tjetrit, na përçojnë te dialekti i qytetit të Shkodrës, i cili qëndron autonom për sa u përket veçorive të tij. Dialektet e Mirditës, të Lurës dhe të Matit, që i ngjajnë shumë njëri tjetrit, zënë një pozitë të veçantë brenda grupit të dialekteve të Gegërisë, për shkak të traj-

tës së tingujve. Prej atyre na përçojnë dialektet lokale të Tiranës, Krujës, dhe të Malësisë së Tiranës mbi një anë në dialektin e Durrësit dhe të Elbasanit, mb'anë tjetër në atë të toskërishtes. Toskërishtja nuk tregon shumë ndryshime si gegërishtja”, përfundon Lamberci¹⁰.

Kërkimet në Shqipërinë Veriore dhe tekstet e botuara prej atje, Profesor Idriz Ajeti nga aspekti gjuhësor i quante aq të rëndësishme saqë në studimet dialektore i konsideronte më të besueshme se ato të Gjergj Fishtës. Fishta, theksonte Profesor Ajeti, ka shkruar në dialektin e Zadrimës, por gjuha e tij është gjuha e shkrirë e Shkodrës, në të cilën shkruanin edhe bashkëkohësit e tij të tjerë, ndërsa Koleksikoni i tregimeve dhe përrallave popullore të Lambercit janë një pasuri e madhe dhe e besueshme për shqyrtime të karakterit fonetik e morfologjik, dialektor e sintaksor¹¹.

Më tutje, Lamberci jep një pasqyrë të zhvillimit të letërsisë shqipe, duke i parë ndaras ato të arbëreshëve të Italisë, të qytetit të Shkodrës me “viset anësore të Malësisë”, të “viseve toske”, të letërsisë së vjetër biblike nën “ndikimin e Propagandës Fide” etj., për të shtruar përsëri një pyetje themelore: - A do të bëhet njëra prej këtyre gjuhëve letrare, gjuha e shkrimt apo jo? Në rrjedhë të këtyre zhvillimeve ai jep shembullin e gazetës “Vllaznia” drejtuar nga tosku Gjergj Pekmezi, i cili megjithëse përdor dialektin gegë, u jep liri të mjaftueshme përbërësve ortografikë, gramatikorë e sintaksorë të toskërishtes, ndryshe nga Gjergj Fishta, i cili e kundërshton gjuhën e përbashkët. Nuk mungonin as mendimet e studiuesve të huaj të ballkanistikës dhe të albanologjisë, sikur është ai i G. Veigandit, por tërheq vërejtjen Lamberci, do të ishte punë e kotë të diskutojmë çështjen e gjuhës letrare në një kohë që re të zeza janë shfaqur mbi të ardhmen politike të Shqipërisë, mbi kufijtë e saj, mbi përcaktimin e kryeqytetit të saj dhe madje mbi përbërjen zotëruese fisnore në të folmen e saj. Në këtë rrjedhë ai propozon një gjuhë provizore, që do t'i shërbente shkollës shqipe, por jo një “gjuhë të përzier geqe-toske”, e cila do të çonte te një diglosi, sikur ndodhi me greqishten, përkundrazi ai kishte idenë që “në rangun e një gjuhë letrare me ngritë një dialekt”, i cili jeton dhe është shfrytëzuar në pikëpamje letrare. Lamberci kundërshtoi edhe konceptin e Vajgandit për një përzgjedhje të

¹⁰ Lamberc, *Raporti... f. 11 (dorëshkrim)*

¹¹ Shih, Ajeti, vep. e cit. 2017, f. 44-45.

të folmes së rrethinës së Durrësit, dhe në kontekst të propozimit të tij mendonte se i kësaj natyre vjen në konsideratë vetëm dialekti i Shkodrës, i cili ishte jo vetëm i pastruar nga turqizmat po përfaqësonte edhe intelektualë e poetë të mëdhenj të epikës, të lirikës, të vlerave nacionale, të teksteve mësimore e historike, në krye të të cilëve qëndronte Gjergj Fishta.

Diskutimet e tij për çështjen e shqipes Lamberci i përmbyll me një vlerësim shumë përmbajtjesor: “Por vetëm edhe një gjë duhet të marrim parasysh librat e leximit të shkollave tona, përveç pjesëve në gjuhën letrare, po sjellin edhe gjithnjë më shumë prova dialektesh; kështu edhe gega i vogël duhet ta njoh toskërishten që në rininë më të njomë me ndihmën e pjesëve të zgjedhura mirë të librit të leximit. Ndryshimi në mes gegërishtes dhe toskërishtes nuk është i madh, sa që ky postulat do të ishte për gegën e ri baras si të mësoj një gjuhë të re. Të tilla fjalë që janë folur nuk i përshtaten realitetit, por janë krijuar prej aspiratave politike. Sikundër munda të konstatoj personalisht djemtë e gegëve dhe të toskëve brenda një kohe të shkurtër do të jenë në gjendje të kuptohen mes tyre. Në këtë mënyrë ju bëhet një shërbim të dy palëve dhe është ndërtuar ura për një zhvillim të mirë gjuhësor në kohën e ardhshme”¹².

Përbërësi i dytë, më i rëndësishëm i *Raportit* të tij, ka të bëjë me një prej çështjeve më të rëndësishme të kohës: ortografinë. Në radhë të parë Lamberci e vuri theksin te Kongresi i Manastirit (1908), i cili vendosi të pranonte alfabetin latin, por që mendonte se i duhet një reformim i vogël. Në mënyrë të veçantë diskutoi çështjen e përdorimit të ortografisë me bazë fonetike apo etimologjike, duke sjellë në këtë drejtim disa shqetësime të gjendjes së shkrimit në këtë kohë, si rezultat i këtyre moskuptimeve.

Përbërësi i tretë i rëndësishëm i këtij *Raporti* është interesimi i tij i parë për onomastikën. Gjatë qëndrimit në Shqipëri Lamberci do të interesohej edhe për antroponiminë dhe patronimin e shqiptarëve, mbështetur në lista të dy korpuseve: atë të nxënësve të Shkollës Françeskane, si dhe listën e Kompanive të Shqipërisë së Veriut. Sikur e thekson në shënimet e tij, për aq sa kishte mundësi këto lista autori i krahasoi me antroponimet dhe patronimet e regjistruara në veprën e Hahnit “Studime shqiptare, përmbledhjen e Spiro Risto Dines “Valët e detit” dhe atë të Nopçës “Nga

¹² *Raporti...* f. 13.

Shala në Kelmend”, duke kujtuar se nga aspekti shkencor për herë të parë këtë temë e kishte trajtuar Nopça. Përveç Nopçës, i cili për Lambercin përbënte një mbështetje të rëndësishme shkencore për aktualitetin, për Lambercin vepra monumentale ku mund të mbështetej për të parë zhvillimin e onomastikës në përmasa shekullore deri në mesjetë, ishte ajo e Thallocit, Jirecek-ut dhe Sufflay-t, *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*. Mbështetur gjithnjë në fenomenet dhe dukuritë e dialektit të gegërishtes, Lamberci që në fillim kishte vënë re një nga veçoritë e saj, e kjo ishte bjerrja e gjuhës shqipe, sidomos prirja e gegërishtes për të sinkopuar shumë pjesët e paakcentueshme të fjalëve. Në këtë rrjedhë ai kishte vënë re me kohë prirjen e folësve të shqipes për të krijuar emra zbudues dhe për të parë dukuritë fonetike të shqipes, sado fillimisht nuk ishte në gjendje t’i shpjegonte ato edhe shkencërisht. Ai kishte vënë re prirjen e folësve të gjuhës shqipe që emrin e vjetër *Lissus* ta quaj *Lesh*; që në vend të trajtës së vjetër të qytetit të Dyrachium-it ose Durazzo-s, të përdorë emrin *Duro* (Durrës), në vend të *Valonë* të thotë *Vlorë*, që lumin *Cijevna* t’i thotë *Cem*, që *San Giovanni di Medua-s*, ta quaj *Shin-Gjin* ose *Shën Gjin* ose shkurt *Shnin*. E vërteta, Lamberci nuk e kishte kuptuar atëherë se fjala ishte për emra a trajta gjuhësore të emrave në gjuhën latine, greke, italiane a sllave, të cilat shqiptari i shqiptonte sipas strukturës fonetike dhe gramatikore të gjuhës së tij, sepse ato shënonin pikërisht trajtat tipike të fonetikës historike të shqipes. Pavarësisht nga trajtat e vjetra të emrave mesjetarë e të antikitetit të shqipes, Lamberci na ka lënë një pasuri emrash zbudues të kohës. Ai thekson se shqiptari “fjalën Mihail ose *Mikili* e shkurton dhe e ban *Hil*; *Mikel* bahet *Kel*, *Nikolla Kolë*, *Andrea Nre*, *Johani Gjon* ose *Gjin*, *Antoni Nue*, *Simone Sim*, *Baltasari Balto*, *Spiridioni Spiro*, *Laurenci Loro*, *Paskali Pashko*, *Jakovi Jak* etj. Këto forma të shkurtuara zhvillohen edhe më gjatë me ndifmën e sufiksive deminutive si: - *c*, *k*, *ok*, *uk*, *ash*, *ush* etj., kështu për sh. *Nue* bahet *Noc*, *Nok*, *Nush*, *Pal*, *Palok*, *Palush*, *Frاند Franciscus Franush*, *Mark Marash* etj”¹³. Pasi diskuton disa emra paganë dhe të krishterë dhe krijimin e diminutivëve të tyre, Lamberci ndalet te disa antroponime të gjinisë femërore. Ai thekson që në fillim se gratë në mënyrë të veçantë kanë emra të çuditshëm, emra të cilët nuk janë aspak të kri-

¹³ Raporti..., f.13.

shterë. “Ato quhen *Hane, Dille, Prenne, ose Rjeshke, Stane, Pule, Lule* ose *Borë, Gute, Shake* etj. Shumë gra kanë dy emra, një emër katolik për kishë dhe një emër të vjetër shqiptar për shtëpi, të cilin nuk mund të shpjegojmë prej fjalorit të emrave të krishterë. Studimi i emrave të fundit është një punë shumë interesante”¹⁴. Në fund të këtij kërkimi dhe reflektimi për emrat e burrave dhe grave shqiptare Lamberci sjell edhe dy veçori: përdorimin e ofiqeve: Topall, Gomar, Shkurte etj., një veçori e cila të kujton emrat mesjetarë të ruajtur ndër dokumente, emra shqiptarësh në Greqi, Itali dhe Bosnje e Hercegovinë: *Burr-dosa, Dosa, Murr-mazi, Kënduesi* etj., si dhe prirjen etno-historike të shqiptarëve për t’u identifikuar me prejardhjen e venduanimit e të krahinës nga vinë, të cilët Lamberci i jep edhe me shembuj konkretë të mjaft emrave të njohur të kohës.

Pa dashur të sjellim edhe diskutime, reflektime e përfundime të tjera në fushë të gjuhës, historisë dhe kulturës shqiptare, brenda këtij *Raporti*, prolog i të gjitha arritjeve të mëtutjeshme të tij në fushë të albanologjisë, po e përmbylim me përmbledhjen e tij të rezultateve të këtij udhëtimit, ku veç tjerash thuhet: “Fitova njohuri të përgjithshme mbi veçoritë e dialekteve të ndryshme lokale të Gegërisë së veriut, studiova mirë dialektin e fisit kufitar të Grudës edhe atë të fisit qendror të Mirditasve, mblodha përralla dhe këngë, i shtova njohuritë e mija mbi "përpyekjet mendore të qarkut letrar të Shkodrës si edhe mbi poezinë artistike dhe popullore, ma në fund mblodha edhe shumë emra personash dhe hetova mënyrën e formimit të tyre”¹⁵.

Karakteristikë e këtij *Raporti* është fakti se ai mund të konsiderohet vetëm një pjesë e parë e ekzistimit të një *Raporti* të tillë edhe në Arkivat qeveritare, sepse pas udhëtimit në muajt maj-qershor 1916 ai kthehet në Shqipëri me trupat Austro-Hungareze, të cilët kishin pushtuar Shqipërinë e Veriut dhe të Mesme, ndërsa Maksimilian Lamberci ishte ngarkuar për mbikëqyrjen e shkollave në zonën Austro-Hungareze.

Përfundime

Prej veprës së tij mund të themi se Lamberci, nuk arriti të asimilonte dijen bashkëkohore të kohës në fushë të gjuhësisë së gjysmës së parë të

¹⁴ Raporti..., 20.

¹⁵ Raporti..., 25.

shekullit XX. Modelet shkencore të kërkimit, konceptet dhe nocionet shkencore të sintezave të tij nuk i tejkalojnë bardët e kësaj dije të shekullit XIX, megjithatë disa nga botimet e tij tejkalojnë arritjet më të mira të kohës dhe mbeten edhe sot sintezat më të mira të albanologjisë.

Në të vërtetë Maksimilian Lamberg, një filolog dhe mësimdhënës i filologjisë në institucione arsimore e shkencore të kohës, ishte gjuhëtar, i cili nuk arriti t'i zotërojë arritjet më të reja në fushë të shkencës së gjuhësisë së shekullit XX, prandaj në veprën e tij gjuhësore nuk zinte vend Sosyri dhe shkolla sociologjike e shekullit XX, shkolla e strukturalizmit dhe pararendësve e bashkëkohësve të tij, shkolla e Rrethit Linguistik të Pragës dhe pasuesve të saj, por mungesa e këtyre shkollave, e metodave bashkëkohore që sillnin dhe nocionet e termat me të cilat artikulonin mendimet e tyre, nuk i bënë më të parëndësishme disa nga studimet e tij në fushë të albanologjisë në përgjithësi dhe në fushë të filologjisë klasike, onomastikës, leksikografisë dhe sidomos dialektologjisë në veçanti. Në të vërtetë, pikërisht duke qenë një filolog klasik i përkryer, pra duke qenë njohës i gjuhëve klasike e metodave filologjike, si trashëgimi fundamentale e Europës moderne, më parë se sa i albanologjisë, ai arrit në konstatimin, se “...historia e vërtetë e njerëzimit do të shkruhet vetëm kur shqiptarët të marrin pjesë në shkrimin e saj”. Pas artikujve të tij te *Posta e Shqipniës* (1916-1918), ku aq natyrshëm bashkohen mitet greke, mitet pellazgjike e literatura homerike me mitet dhe legjendat ilire e shqiptare, konstatimet e tij edhe sot mund të konsiderohen të natyrshme.

Studiuesi e filologu klasik si Maksimilain Lambeci, që me pasion shihte trashëgiminë e antikitetit në jetën shqiptare, është po kaq e natyrshme të jetë afruar me pasion edhe me krijimtarinë popullore shqiptare, me përrallat, legjendat dhe madje ninullat shqiptare, si dhe me arealin mitik që i mbështillte ato. Në këtë proces kërkimi, sinteze, vlerësimi e botimi të trashëgimisë gojore shqiptare dhe madje gjatë angazhimit të tij në *Komisinë Letrare të Shkodrës* (1916), është e natyrshme që ai të afrohej me pasion edhe me njërin prej modeleve të kësaj natyre në shoqërinë shqiptare të kohës, poetin kombëtar të maleve shqiptare Gjergj Fishtën, që jo vetëm ta përkthente në gjuhën gjermane kryeveprën e tij *Lahuta e Malcis*¹⁶, po ta

¹⁶ Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos "Lahuta e Malcis," *Laute des Hochlandes:*

shihthe autorin e saj si bard të shqipës së bashkuar letrare të shqiptarëve. “Unë jam i bindun, - shkruante Lamberci në *Raportin* e tij, - se koha e ardhshme do të tregojë edhe më tepër randësinë edhe vleftën e këtij poeti, sidomos mbasi vjershat e tij të përkthyer në gjuhën të kulturës. Gjuha e vjershave të tij mbështetet tek dialektet lokale të Malsisë. Patër Gjergj Fishta, i cili edhe vetë i ka rranjat krejtësisht në popull, ka përdor gjuhën e burrave dhe grave të Malsisë. Ai ka marrë prej tyre mënyrën me namë dhe me bekue, me vajtue dhe me u gëzue dhe i ka shfrytëzue për vjershat e tij. Pra gjuha e Patër Gjergj Fishtës asht një lloji "Koine-je" e natyrshme dhe popullore e gegënishtes së veriut në bazë të shkodrançes dhe me ket asht shumë e përshtatëshme me u ba gjuha e shkollave të Shqipnisë së veriut dhe të shkollave të Shqipnisë në përgjithësi. Prandaj merreni atë! Me ket gjuhë edukoni rininë! Kjo gjuhë, të cilën e përdorin edhe autorët e tjerë të Shkodrës, le të bahet gjuha zyrtare! Me ket rasë nuk duhet të jemi zëmërngushtë, por gjuhën e re letrare duhet ta pasunojmë me fjalë që do të marrim nga burimet e dialekteve lokale të ndryshme, që kështu ajo të jetë një pasqyrë e gjallë e gradës mendore të kombit!”¹⁷

Njohësi i thellë i trashëgimisë gojore dhe hulumtuesi pasionant i të folmeve anësore të shqipës ndër arbëreshët në Itali dhe arbërorët në Greqi është e kuptueshme, që Maksimilian Lamberci të jetë përqendruar jo vetëm në një sintezë diakronike të dialekteve të shqipës, të cilën e synonin shumë paraardhës e pasardhës së albanologjisë së kohës, po edhe të një sinteze monografike për sintaksën e saj, të cilën as paraardhësit as pasardhësit e trashëgimisë albanologjike nuk e kishin synuar dhe arritur. Në këtë mënyrë ai na e ka dhënë monografinë e parë në fushë të sintaksës së shqipës, vepërën *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe* (1914), për përsëritjen e të cilës shkenca e albanologjisë, nga autorë të tjerë, ka pritur edhe disa dekada me radhë. Po kështu mund të thuhet edhe për monografitë e tij në fushë të dialektologjisë historike. Shkenca e albanologjisë, megjithëse në amzën e saj kishte përmbledhur edhe disa studime monografike ndër vite, do t’i duhet ta pres monografinë e Cimohovskit për të tejkaluar kufijtë e dijes së Lam-

eine Einführung in die albanische Sagenwelt (Gjergj Fishta dhe eposi heroik "Lahuta e Malcís", Hyrje në botën e legjendave shqiptare), Lajpcig 1949.

¹⁷ *Raport ...*, (Raport i përkthyer në dorëshkrim), f. 13-14.

bercit në këtë fushë. Në rrjedhë të monografive të tij të botuara pas Luftës së Dytë Botërore, vendin qendror zë edhe studimi për eposin shqiptar *Eposi popullor i shqiptarëve* (1958), në të cilin është bërë sinteza më e plotë teorike e artistike e eposit shqiptarë, e parë edhe në kontestin e studimeve ballkanike dhe Europës Juglindore. Në biografinë jetësore dhe bibliografinë shkencore të Maksimilian Lambecit doemos zënë vend edhe tekste mësimore për gjermanofolësit që duan të mësojnë gjuhën shqipe, të cilat më shumë se veçoritë e tyre dëshmojnë për rëndësinë e institucionalizimit të albanologjisë në institucione shkencore jashtë hapësirës shqiptare.

Biografët e tij përgjithsëst theksojnë monografinë e tij *Das Drama im albanischen Theater von heute* (Drama në teatrin shqiptar të sotëm), dsh. 1963), por historianët e albanologjisë në perspektivën e përgatitjes së saj sapo kanë kuptuar se trashëgimisë së tij i takon edhe *Ditari*, një vepër monumentale për historinë e popullit shqiptar dhe synimet e tij, ndërsa këtu dua të theksoj edhe rëndësinë e letërkëmbimit të tij, në mënyrë të veçantë me P. Kretschmerin, V. Streitbergun, M. Vasmerin, Gj. Fishtën, V. Jagićin, A. von Kralin, G. Weigandin, E. Çabejn etj., konsultimi dhe botimi i së cilës sjell të dhëna të reja, saktësime dhe vlerësime të rëndësishme për dijen albanologjike.

E parë në tërësinë e saj jeta dhe vepra e albanologut Maksimilian Lambec ka zënë një vend të rëndësishëm në studimet albanologjike të gjysmës së parë të shekullit XX, por duke parë sot trashëgiminë e tij në dorëshkrim, presim që Lamberci shkencës së albanologjisë t'i flet edhe në shekullin XXI.

BIBLIOGRAFI E MAKSIMILIAN LAMBERTCIT PËR GJUHË SHQIPE DHE KULTURËN SHQIPTARE

- Albanien erzählt: ein Einblick in die albanische Literatur.** Literatur der Volksdemokratien, 7 (Berlin 1956) 191 pp. Parathënie nga Maximilian Lambertz: f.9-26.
- Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde.** Gesammelt und mit Übersetzung herausgegeben von Maximilian Lambertz. Schriften der Balkankommission. Akademie der Wissenschaften in Wien, 1922, 255 pp.
- Albanische Mundarten in Italien.** Mit einer Kartenskizze. in: Indogermanisches Jahrbuch, 2 (1914-1915), p. 1-30.
- Albanischen, Lehr-und Lesebuch.** Lambertz, M. & Pekmezi, G., Wien / Leipzig, 1913.
- Albanisches Lesebuch mit Einführung in die albanische Sprache.** I. Teil: Grammatik und albanische Texte. (Leipzig: Harrassowitz 1948) 387 pp.
- Albanisches Lesebuch mit Einführung in die albanische Sprache.** II. Teil: Texte in deutscher Übersetzung, Leipzig 1948, 302 pp.
- Aleksandër Xhuvani, Studime gjuhësore, Tiranë, 1956.** In: Lingua Posnaniensis, VIII (1960), 271-279.
- Aleksandër Xhuvani, Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë, 1956.** In: Lingua Posnaniensis, VIII (1960), 293-302.
- Am Rande des Herdes.** In: Winterabende in der albanischen Kulla, Leipzig 1949.
- Aus Berats Sage und Gesschichte.** In: Posta e Shqypniës, viti I, nr. 68-69, 71, Shkodër, 1-11. 8. 1917.
- Bericht über meine linguistische Studien in Albanien vom Mitte Mai bis Ende August 1916.** in: Anzeiger der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften in Wien, Phil-hist. Kl., Vienna, 53 (1916) Nr. XX, p. 122-146.
- Buletin i Institutit të Shkencave, Viti III, nr. 1-2, Tiranë 1949.** In: Deutsche Literaturzeitung, 71 (1950), f. 154-157.
- Buletin për shkencat shoqërore, 1/1955, Tiranë.** In: Südost-Forschungen, XV (1956), 623. 628.
- Das albanische Schulwesen vor dem Kriege und heute.** in: Zeitschrift für d. österr. Gymnas, Vienna 1917, 9, p. 679-689.
- Das Drama im albanischen Theater von heute.** In: Südost-Forschungen, XIX (1960), pp. 316-325.
- Das Drama im albanischen Theater von heute.** In: (Typescript s. l., ë1963ë) 187 pp.
- Das Werden der albanischen Literatur.** In: Leipziger Vierteljahresschrift für Südosteuro-pa, 7 (1943), Heft 2-4, f. 160-174.
- Das Wissenschaftliche Institut in Tirana.** in: Südost-Forschungen, München, 16 (1957), p. 160-173.
- Der heutige Atand der Illyrierfrage.** In: Posta e Shqypniës, viti I, nr. 87-89, 93-94, 99-100, 102; viti II, nr. 3, Shkodër, që nga muaji i X. deri më 5. XII. 1917.
- Die Albaner, ihre Sprache und Kultur.** in: Blick nach Osten, Umschau im geistigen Leben der Völker des östlichen Mitteleuropas, Südosteuropas und der Sowjetunion, Vienna, 2. 1 (1949), p. 3-21.
- Die albanische Kinderpoesie.** In: Posta e Shqypniës, I, nr. 30, f. 4, Shkodër, 21.III.1917.
- Die albanische Sprache.** in: Posta e Shqypniës, Shkodra, 17. 02. 1917, Nr. 12, p. 4.
- Die albanische Sprache.** in: Posta e Shqypniës, viti I, nr. 12, f. 4, Shkodër, 17. I. 1917.
- Die albanische Volkspoesie.** in: Posta e Shqypniës, viti I, nr. 16 deri 23, Shkodër: 30. I. 1917 - 3. III. 1917.

- Die geflügelte Schwester und die Dunklen der Erde.** Albanische Volksmärchen. Übersetzt und herausgegeben von Professor Dr. Maximilian Lambertz (Eisenach: Erich Röth Verlag 1952) 225 pp.
- Die homerische Frage und das albanische Großepos.** in: Shëjzat / Le Pleiadi, Roma, 5 (1961), p. 385-391.
- Die hypothetische Periode im Albanischen.** in: Indogermanische Forschungen, Strasbourg, 34 (1914-1915), p. 44-208.
- Die Mundarten der albanischen Sprache und ihre Erforschung.** in: Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa, Leipzig, 7, 2-4 (1943), p. 123-160.
- Die Mundarten der albanischen Sprache.** Heutiger Stand der Forschung. in: Südost Forschungen, München, 16 (1957), p. 430-435.
- Die Mythologie der Albaner.** in: Wörterbuch der Mythologie. 1. Abt., Bd. II. Götter und Mythen im Alten Europa. Hans Wilhelm Haussig (ed.) Stuttgart 1973, p. 455-509.
- Die Regelung der albanischen Rechtschreibung.** Vienna 1918
- Die Volksepik der Albaner.** Der Zyklus von Mujo und Halil I, II. in: Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl Marx Universität Leipzig, Gesellschafts- und Sprachwissenschaftliche Reihe, Leipzig, 4 (1954-1955), pp. 243-289, 439-473.
- Die Volksepik der albaner.** Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl-Marx-Universität Leipzig 4 (1954-1955), 243-289; 439-473.
- Die Volkspoesie der Albaner.** Eine einführende Studie. Sarajevo, 1917. 80 f.
- Disa të dhëna gjeografike në lidhje me ciklin e Mujit dhe të Halilit.** In: Buletini shkencor, Tiranë, 2 (1955), 63-70.
- Ein Kapitel albanischer Umgangssprache.** In: Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl Marx Universität Leipzig, Leipzig, 9 (1959-1960), p. 287-290.
- Eqrem Çabej, Albanologji, Tiranë, 1947.** In: Südost-Forschungen, XVIII (1959).
- Figurat e përrallës shqipe.** in: Kultura popullore, Tirana 1988, 1, p. 183-190.
- Fjalë të urta të popullit tonë,** Tiranë, 1958. In: Südost-Forschungen, XX (1961), 358-359.
- Fjalor i gjuhës shqipe,** Tiranë, 1954. In: Südost-Forschungen, XVII (1958), 486-487.
- Giulio Variboba.** in: Zeitschrift für Vergleichende Sprachforschung, Göttingen, 74 (1956), p. 45-122, 185-224.
- Glasnik Muzeja Kosova i Metohije.** Sand I., Priština 1956, In: Südost-Forschungen, XVIII (1959), 442-444.
- Grundriss der indogermanischen Sprach- und Alterkumskunde.** Hrsg. Von K. Brugmann und C. Bartholomae. 1. *Geschichte der indogermanischen Sprachwissenschaft.* Hrsg. Von Wilhelm Streitberg. II. Teil. I. Band: *Griechisch, Italisch, Vulgärlatein, Keltisch.* Strassburg 1916. Zeitsch. F. d. Österreich, Gymnasien, 68 (1917-18), 53-59.
- Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos Lahuta e Malcis, Laute des Hochlandes.** Eine Einführung in die albanische Sagenwelt. (Leipzig: Harrassowitz 1949) 76 pp.
- Historia e letërsisë shqipe.** I. Tiranë, 1959. In: Südost-Forschungen, XX (1961), 355-357.
- Historia e Shqipërisë,** I, Tiranë, 1959. In: Südost-Forschungen, XX (1961), 352-355.
- Italo-albanische Dialektstudien. Die albanischen Mundarten in den italienischen Provinzen Campobasso und Foggia (Molise).** Zeitschrift für vergleichenden Sprachforschung auf Gebiete der indogermanischen Sprachen, 51 (1923), 259-290.
- Italo-albanische Dialektstudien. II.** Zeitschrift für vergleichenden Sprachforschung auf Gebiete der indogermanischen Sprachen, 52 (1924), 43-90.
- Italo-albanische Dialektstudien. III. Volkstümliche Texte aus den Kolonien der Molise.** IV. **Glossar.** In: Zeitschrift für vergleichenden Sprachforschung auf Gebiete der indogermanischen Sprachen, Gütersloh, 51 (1923), p. 259-290; 52 (1924), p. 43-90; 53

- (1925), p. 66-79, 282-307.
- Karl Brugmann und Wilhelm Streitberg, Indogermanische Sprach- und Altertums-kunde, herausgegeben Vierunddreissigster. Band, Strassburg, Verlag von Karl J. Trübner 1914-1915.**
- Këngë popullore historike**, Tiranë, 1956. In: Südost-Forschungen, XVI (1957), 514.
- Këngë popullore legjendare**, Tiranë 1955. In: Südost-Forschungen, XVI (1957), 513-514.
- Kolë Jakova, Toka jonë. (Unser Boden).** Drama. Übersetzt und herausgegeben. (Halle/Saale 1961) 146 pp.
- Lehrgang des Albanischen.** Teil I. Albanischduetsches Vörterbuch, Berlin, 1954, 228 pp.
- Lehrgang des Albanischen. Teil II. Albanische Chrestomathie.** Berlin, 1955. 251 pp.
- Lehrgang des Albanischen.** Teil III. Grammatik der albanischen Sprache. Halle (Saale) 1959. 267 pp.
- Nachrichten über die Literarische Kommission.** Vienna 1918. (shqip)
- Naim Frashëri, Lulet e verësë**, Tiranë, 1956. In: Südost-Forschungen, XVII (1958), 488.
- Gjergj Fishta, Die Laute des Hochlandes,** Übersetzt, eingeleitet mit Anmerkungen versehen von Max Lambertz, München 1958, 312 pp.
- Neue Dokumente zur Geschichte Albanien im 17. Jahrhundert.** in: Südost-Forschungen, Munich, 18 (1959), p. 170-176.
- Norbert Jokl Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des albanischen.** Berlin und Leipzig 1923. In: Deutsche Literaturzeitung, 45 N. F. 1 (1924), 1548-1551.
- Normalisti.** Numër përkujtimor. 1909-1959. Elbasan 1959. In: Südost-Forschungen, XXI (1962), 502-503.
- Përralla shqiptare. Motra me flatra dhe të errëtat e dheut.** In: Nëndori, Tiranë, 7 (1957), 175-176. (E përktheu: S. Riza).
- Poezija popullore arbëreshe**, Tiranë, 1957. In: Südost-Forschungen, XX (1961), 358.
- Posta e Shqipniës**, Përktheu: E. Bushati, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011, 163 pp.
- Risto Siliqi, Vepra të zgjedhura.** Tiranë, 1956. In: Südost-Forschungen, XVII (1958), 487-488.
- Universitätsprofessor Dr. Moritz Hoernes.** In: Posta e Shqipniës, viti I, nr. 65, f. 4, Shkodër, 21. VII. 1917.
- Uuniversiteti Shtetror i Tiranës**, Seria shkencat shoqërore, 1, 2, 3, 1958. In: Südost-Forschungen, XVIII (1959), 237-239.
- Uuniversiteti Shtetror i Tiranës**, Seria shkencat shoqërore, 1959, 1-4. In: Südost-Forschungen, XXI (1962), 503-506.
- Volkspoesie der Albaner: eine einführende Studie.** Zur Kunde der Balkanhalbinsel, II. Quellen und Forschungen, 6 (Sarajevo 1917)
- Vom Goldenen Horn: griechische Märchen aus dem Mittelalter.** Märchen aus allen Ländern, Bd. 9 (Vienna 1922)
- Vorläufiger Bericht des Dr. Max Lambertz über seine linguistischen Studien in Albanien von Mite Mai bis Ende August 1916.** Anzeiger der Kais. Akad. D. Wiss. In Wien, Linguist. Abt. XII, Wien 1916, f. 122-146.
- Waslav Cimochoowski, Le Dialecte de Dushmani.** Poznan, 1951. In: Zeitschrift für Phonetik und allgemeine Sprachwissenschaft, 7 (1953), 417-422.
- Wie entstehen Schriftsprachen?** In: Posta e Shqipniës, viti I, nr. 10, f. 4, Shkodër, 10. I. 1917.
- Wilhelm Giese, Die Namen der Wochentage und Monate im Albanischen.** In: Home-naja a Fritz Krüger, II. Band. Mendoza 1954, f. 59-69, Südost forschungen XIV (1955), 508-511.

- Wissenschaftliche Tätigkeit in Albanien 1957 und 1958.** in: Südost-Forschungen, Munich, 18 (1959), p. 399-412.
- Zur albanischen Literaturgeschichte.** in: Südost-Forschungen, München, XVII (1958), p. 237-243.
- Zur albanischen Umgangssprache** (Gjirokastra). in: Lingua Posnaniensis, Poznań, 8 (1959), p. 85-144.
- Das Drama im albanischen Theater von heute.** in: Südost-Forschungen, 19 (1960), p. 316-325.
- Zwei Albanica.** 1. Der albanische Aorist auf -va. 2. Kanuni i Lekë Dukagjinit (Etymologie der Personennamen Lekë und Dukagjini). in: Indogermanische Forschungen, 60 1952, p. 302-310.
- Zwischen Drin und Vojusa.** Märchen aus Albanien. Herausgegeben und übersetzt von Maximilian Lambertz. Zeichnungen von Axel Leskoschek. Märchen aus allen Ländern, Bd. 10. Leipzig, 1922, 177 pp.
- Periudha hipotetike në gjuhën shqipe.** (Die hypothetische Periode im Albanischen). Tefë M. Topalli, Edmond Malaj (përg. për bot.), Veniamin Dashi (përkth.), Tefë M. Topalli (red.), Tiranë: Botimet Albanologjike, 2011, f. 329.
- Posta e Shqypniës,** Tefë M. Topalli (përg. për bot.), Edlira Bushati (përkth.) Tiranë, Botimet Albanologjike, 2011, 163 f.
- Udhëtimi në Mirditë,** *Raporti i Lambertit për udhëtimin e tij në Mirditë*, 1916, Standard, Tiranë, 20. 12. 2006, f. 17.

LITERATURA

- BADALLAJ, Imri, *Maksimilian Lambertit albanalog i shquar*, Studime 3, 1996: 327-333.
- ÇABEJ Eqrem, *Maximilian Lambertz në shtatëdhjetëvjetorin e ditëlindjes*, Buletini shkencor, nr. 2, f. 127-130, Tiranë, 1957.
- ÇABEJ, Eqrem, *Maximilian Lambertz (1882-1963)*, Studime filologjike, XVIII (I), nr. 1, f. 211-216, Tiranë, 1964. Po i njëjti: *Maximilian Lambertz (1882-1963) – ORBIS Louvaine*, 1964, Nr.1 p. 326-336.
- ÇABEJ, Eqrem, *Maximilian Lambertz*, Nëndori, IX, nr. 9, f. 174-177, Tiranë, shtator 1962.
- ÇALI, Edmond, *Miti tek Kasëm Trebeshina*, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 25/2, Prishtinë, 2006: 201-227. 201-227).
- DOMI, Mahir, *Prof. Maksimilian Lambertit mbush 75 vjet*, Nëndori, Tiranë, 7 (1957), 170-174.
- ELSIE, Robert, *A biographical dictionary of Albanian history*. London: I. B. Taurus, 1988.
- ELSIE, Robert, *Fotografia e hershme në Shqipëri*, <http://www.albanianphotography.net/lambertz/> (10.3.2018)
- ELSIE, Robert, *Gjergj Fishta and the Albanian national epic*, Lecture given at the Center for Russian and Eastern European Studies, University of Michigan on 26 January 2005.ë, in <http://www.elsie.de/pdf/articles/A2005FishtaHighlandLute.pdf> (10.3.2018)
- ELSIE, Robert, *Why is Albanian Epic Verse So Neglected?* (<http://www.elsie.de/pdf/articles/A2014AlbanianEpicVerse.pdf>) (10.3.2018)
- FIEDLER, Wilfried, *Rreth gramatikës së Gjergj Pekmezit dhe të Maksimilian Lambertit*, SNGJLKS 6, Prishtinë, 1979:175-178.
- FIEDLER, Wilfried, *Maksimilian Lambertit*, Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj 4, Prishtinë, 1978:317-320.
- FIELDER, Ilfried, *Maximilian Lambertz* (In memoriam) Bibliographie der Publikationen Maximilian Lambertz's (Maksimilian Lambert (Përkujtim). Bibliografi e botimeve të

- Maksimilian Lambercit, - Gjurmime albanologjike Prishtinë, 1965 , Nr. 2, f. 331- 340.
- FLOQI, Spiro: Me rastin e 80-vjetorit të prof. Lambertz. DRITA, Tiranë, 28 korrik 1962.
- HAEBLER, Claus: Maximilian Lambertz (1882- 1963) – *Sudostforschungen*, München, 1964, nr. 23. f. 326-329.
- JACQUES, Edvin, *Shqiptarët*, Tiranë, 1995,
- KASTRATI, Jup, *Veptrat albanologjike të Dr. Prof. Maximilian Lambertz*, Arsimi popullor, Tiranë, shtator-tetor 1962, f. 122-145.
- KOTRRI, Petrit & LOGU, Bora, *Mendime të Maksimilian Lambercit dhe Rajko Nahtigalit për Komisinë Letrare*, në Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1996), *Studime shqiptare*, nr. 8, Shkodër, 1997, f. 103-111.
- LULUSHI, Astrit, Jo, Lamberci nuk tallej, <https://blogs.voanews.com/albanian/astritlulushi/2014/02/21/jo-lamberci-nuk-tallej/> (10.3. 2018)
- MEHMETI, Flutura, *Analysis of the nominal signs in the text of Martesa e Halilit song and in the translated version in german by M. Lambertz*, Scientific publishing in Europe and N. America, <http://ppublishing.org/journals/401/issue/822/articles/2750/>, 3.3. 2018
- NEZIRI, Zymer, *Dorëshkrimi i këngëve popullore shqipe i Maksimilian Lambercit në Vjenë*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 25/1, Prishtinë, 2006: 159-162.
- PEÇI, Admirina, Tiranë e qerpiçit...: gjashtë foto të rralla të 1916-ës nga Maksimilian Lambertz / Maximilian Lambertz;
- REDAKSIA, *Maximilian LAMBERTZ (1882 - 1963)*, Bibliothecae, Organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Nr. 4 Viti 2003, f. 48.
- SAKO, Zihni, *Albanologu Prof. Dr. Maksimilian Lambertz mbushi 80-vjeç*, Ylli, Tiranë, 7 (1962), 32.
- SPAHIU, Agim, *Maximilian Lamberc*, <http://www.shkenca.org/content/view/46/27/> (10.3. 2018).
- SHKURTAJ, Gjovalin, *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 2012.
- SHKURTAJ, Gjovalin, *Ligjërime arbëreshe*, Tiranë, 2012.
- TOPALLI, Kolec, *Dukuritë fonetike të sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- TOPALLI, Kolec, *Shndërrime historike në sistemin zanor të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2000.
- XHUVANI, Aleksandër, *Dr. Prof. Maksimilian Lamberc*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës. Seria shkencat shoqërore, Tiranë, 1957, viti X, nr. 1, fq. 238-240.
- XHUVANI, Aleksandër, *Maksimilian Lamberc në Shqipëri*, Buletin për shkencat shoqërore, Tiranë, 1954, nr. 2, f. 142- 144.
- ШВЕДОВОЙ, Н. П. *Научное творчество Максимилиана Ламберца (1882-1963): языковедение, литературоведение, фольклористика* (punim diploma), nën drejtimin e Profesor A. Ю. Русаков. Санкт-Петербургский Государственный Университет, Филологический факультет, Кафедра общего языковедения, Санкт-Петербург, 2016.

Gjovalin SHKURTAJ, Tiranë

STUDIMET PËR KONTAKTIN E SHQIPES ME GJERMANISHTEN NË KANTONIN GJERMANIK TË ZVICRËS DHE NË AUSTRI

Shkurtore e përmbajtjes:

Mbijetesa e diasporave në vende të huaja ka pasur si shprehje kryesore ruajtjen e gjuhës. *Vështrimi i shqiptarëve, i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në kontekstin e Evropës Juglindore, siguron mundësinë e vështrimit integral dhe patjetër më thelbësor të kulturës shqiptare.*¹Rasti më emblemantik, pa dyshim, edhe pas pesëqind vjetësh, mbetet diaspora apo elementi arbëresh në Italinë e Jugut e në Sicili, si dhe arvanitët në Greqinë ishullore, pastaj edhe ngulime të tjera, si arbneshët e Zarës (Kroaci), shqiptarët e Mandricës (Bullgari), të Ukrainës etj.² që diheshin dhe kishim më shumë njoftime,po edhe në diasporat më të reja,qoftë edhe më pak unitare e të shprishura,por gjithsesi të rëndësishme për t,u studiuar si ato të shqiptarëve në Zvicër, Austri, Gjermani etj.

Gjatë një periudhe tashmë gati njëzetvjeçare kam pasur rastin të kem qenë në lidhje me disa prej studiuesve zviceranë dhe shqiptarë, që merren me studimin dhe mësimdhënien e shqipes në Zvicër (në kantonin gjermanik të Curyhut) dhe në Austri, kryesisht në kuadër të projekteve për udhëheqjen e dy temave studimore: një studim doktorati të punuar me ideimin dhe drejtimin tim nga studiuesi zviceran Basil Schader me titull: “Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër” (1991-2005), pastaj një temë studimi për gradën “Master në gjuhësi” nga Miradije Berishaj me temë: *Gjuha shqipe në Republikën e Austrisë* (Kundrime sociolinguistike dhe etnolinguistike), Mikrotezë në kërkim të gradës “Master”, mbrojtur në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të Universitetit

¹ Shih: R. Ismajli, *Gjuhë dhe etni*, Prishtinë, 1991 f. 48-54.

² Jorgji Ginari-Gj.Shkurtaj, *Dialektologji, Të folmet e diasporës arbëreshe*, SHBLU,Tiranë, 2009, f.271-430.

të Tiranë, korrik 2014.”, si dhe kam kryer dy udhëtime studimore afatshkurtra në Zvicër, ku dhe kam kumtuar në dy konferenca shkencore kush-tuar gjuhës shqipe në Zvicrën gjermanike, së pari, më 2011, në konferencën e zhvilluar nga LAPSH “Naim Frashëri” në Bernë, dhe më 2013 në Cyrih, në konferencën e organizuar nga Universiteti i atjeshëm dhe, mbi bazën e asaj përvoje dhe bashkëpunimi me studiuesit e lartpërmendur, në kumtesën time do të pykëzohem në këto pika kryesore:

1. Situata e sotme e shqipes në Zvicër e në Austri, sipas mbërritjeve e paraqitjes së bërë në studimet e doktorantit B.Schader e të zonjës Miradije Berishaj.

2. Probleme teorike dhe pragmalinguistike të shqipes në diasporën e re shqiptare në Zvicër e në Austri, si dhe në planin e përgjithshëm të shqipes si gjuhë e emigracionit shqiptar në dhe të huaj, në Evropë e më gjerë.

3. Aspekte sociolinguistike të shqipes së diasporës në Zvicër e në Austri, ku do të sjellim vlerësime dhe konsiderata të përgjithshme me karakter sociolinguistik lidhur me dy boshte kryesore sociolinguistike: përzierja e kodeve (*codsmixting*) dhe prishja e kodeve (*codswitching*) në mjedise e diasporës shqiptare në Zvicër e në aëAustri, si dhe do të parashtrojmë disa përfundime, duke iu qasur një vargu faktorësh sociologjikë, politikë dhe kulturorë e sidomos metalinguistikë, që përbëjnë shtyllat e trajtimeve të sotme sociolinguistike dhe të “*etnografisë së të folurit*”, apo “*etnografia e komunikimit*”.³

Në shtjellimet e kumtesës sonë, do t’i përmbahemi një trajtimi që na shpie edhe në disa përfundime të përgjithshme, duke ndjekur shkallëzimin (*item-et*) e figurës së mëposhtme:

- Gjuha “kombëtare” ose gjuha zyrtare e vendit a kombit ku ndodhen sot shqiptarët në Evropë (në përgjithësi) dhe në Zvicër (në veçanti);
- Gjuha e “origjinës” / gjuha e parë;
- Varieteti/dialekti i gjuhës së parë;
- Gjuha krahinore ose gjuha e pakicës;

³ Shih: Hymes Dell, *The Ethnography of Speeching*, 1962 dhe Hymes Dell, *Verso un’etnografia della comunicazione: analisi degli eventi comunicativi*, in *Linguaggio e società*, Bologna, 1973.

- Gjuhë të tjera: nivele të ndryshme kompetence: tipe të ndryshme kompetence të pjesshme; mundësia për shumëkuptueshmëri, të cilat, në fakt, edhe i kemi prekur, përfillur e shtjelluar edhe më parë. (Sociolinguistikë e shqipes, Nga dialektologjia te etnografia e të folurit, Botim i dytë, Tiranë, 2009)..

Sigurisht, secila nga dukuritë që lidhte me *item*-et e mësipërme, ka nevojë të shihet (dhe ashtu kemi synuar ta shohim) në lidhje me një varg piketash të mirënjohura të sociolinguistikës së sotëm e pikërisht:

Probleme të veçanta të dy- dhe shumëgjuhësisë (bi- dhe multilinguizmit)

Zakonisht përkufizohet si dy- apo shumëgjuhësi (bi-ose multilinguizëm) situata gjuhësore e krijuar nga dy ose më shumë gjuhë që bashkëkzistojnë, të lidhura nga një formë e caktuar e shoqërisë ose në kontakt të vazhdueshëm për shkak të interesave politike dhe ekonomike.

Deri më sot, problemet themelore që është dashur të përballojë studimi i dygjuhësisë janë katër:

(a) Në ç' shkallë folësit janë dygjuhësh (bilingë)? Cili është niveli i zotërimit të një gjuhe dhe i tjetrës nga përdoruesit e saj?

(b) Në çfarë funksionesh folësit përdorin dy gjuhë? Në ç' raste përdorin një të një dhe në ç' raste tjetrën?

(c) Në çfarë mase dygjuhësit e ndërrojnë gjuhën e tyre? Në ç' kushte

gjuhët në kontakt i këmbëjnë (alternojnë) dy gjuhët?

(d) Në çfarë mase dygjuhësit i përdorin të dy gjuhët veç e veç ose i përdorin ato në mënyrë të integruar, si një sistem të vetëm? Çfarë dukurish të ndërndikimit (interferencës) shfaqen në përdorimin e këmbyeshem të dy gjuhëve? Cila është trysnia e përdorimit të një gjuhe mbi tjetrën?

Janë shtuar e po shtohen rastet që shqipja në gojën e shqiptarëve jashtë vendit mbetet në kuadrin e një gjuhe “*të ngushtë familjare*”, mbetet një gjuhë e mjedisit të ngushtë, përballë gjuhës së huaj të vendit ku janë integruar, që përbën gjuhën e komunikimit jashtë shtëpisë, në punë, në shkollë etj. Kështu, tashmë edhe janë përfutur dy anë të këtij procesi të dy-

e shumëgjuhësisë: “*gjuha e bukës*” apo “*gjuha e punës*” që do të thotë gjuha e madhe, gjuha e vendit, që është gjuha amtare e kombit pritës, në rastin tonë gjuha gjermane e popullsisë zvicerane vendase (qoftë edhe në formën dialektore), dhe “*gjuha e zemrës*” apo gjuha e mjedisit të ngushtë familjar shqiptar, në mjedisin zviceran ose edhe në raste të tjera takimesh a shkëmbimesh miqësore me shqiptarë, të ardhur e të shpërngulur në Zvicër, si dhe në rastet e komunikimit me vizitorë që vijnë nga Shqipëria a viset shqiptare të Ballkanit, sidomos nga Kosova dhe Maqedonia.

Përfundimi apo konkluzioni ynë paraprak është se ajo që sjell një studim, sa i gjerë aq edhe i shtjelluar e i lidhur me problematikën e ndikimeve shoqërore në gjuhën e emigrantëve shqiptarë në një mjedis të huaj, si ai i Zvicrës, po edhe i Austrisë, është s si kapilaret e gjakut arterial dhe atij venoz në organizmin e ndërlikuar të njeriut e të qenieve të gjalla, i cili **qëndron midis dy kohëve** dhe përkatësisht **dy mënyrave të ndryshme e të larmishme**: të njëgjuhësisë (unilinguizmit) ose të folurit vetëm në gjuhën e vet amtare dhe të folurit (përkat. të shkruarit) në dy gjuhë të ndryshme (në kuadrin e bilinguizmit a dygjuhësisë) dhe të disa ose shumë gjuhëve të ndryshme, në kuadrin e plurilinguizmit apo multilinguizmit.

Evalda PACI, Tiranë

GUNNAR SVANE: KONTRIBUTE THEMELORE MBI INTERPRETIMIN TEKSTOR E FILOLOGJIK TË VEPRËS SË PJETËR BUDIT

Vepra e Pjetër Budit është përfshirë e trajtuar prej kohësh në manuale të historisë së letërsisë së shkruar shqipe: janë përshtatur për nivele përkatëse studimi pjesë të veçanta prej saj; në njëfarë mënyre u bënë më të afërta për lexuesin fragmente që përçonin një linjë që mendohej se përshkonte veprën e tij, (ky i fundit një fakt relativ dhe ndaj periudhës në fjalë); studiues të dokumenteve arkivore që lidhen me gjashtëqindën e sundimin otoman në viset tona analizuan kontekstin historik që pasqyrohej në letërkëmbimin e veprimtarinë e dokumentuar të këtij prelati, duke pasur burime referimi vëllime fort të çmueshme të historisë së viseve ballkanike e në veçanti të botës arbërore.

Realizimi i varianteve doktrinare e kateketike prej Pjetër Budit përkon me një klimë sa historike aq dhe politike për Ballkanin dhe Evropën. Në pikëpamje modeli e ndërtimi çdo realizim i tij ruan një veçanti që e dallon mirëfilli nga një korpus kompleks libror si ai i Buzukut dhe nga një vepër që ruan qartë përmasa të një shtjellimi të gjerë në fushë të ezegjezës dhe teozofisë, siç është *Cuneus prophetarum* e Pjetër Bogdanit(1685). Veprën në fjalë nuk e ndan një hark kohor i konsiderueshëm veçanërisht nga viti i realizimit që i atribuohet *Mesharit*(1555), por si ndërtimi dhe modelet e adaptuara, aq dhe veçantitë gjuhësore dhe përftesat genuine që gjurmohen në këto tekste e dallojnë në mënyrë të qartë autorin e variantit në shqip të Doktrinës, Pasqyrës dhe Ritualit Roman. Për secilën prej këtyre veprave mund të ngrihen çështje të realizimit përmbajtësor dhe të ruajtjes së referencialitetit ndaj varianteve që njihen si modele themelore për kohën kur jetoi Budi; mund të gjurmohet njëfarë përpjesëtimi sa i përket gjurmimit të teksteve latine që ruhen në formë të pacenuar veçanërisht në përbërje të Ritualit; mund të flitet për vlerën që marrin dhe në ditët e sotme përdorime që të pasqyruara në gjuhën e këtij autori, shpjen në qasje dhe krahasime me

gjuhë e kultura të afërta. Nga ana tjetër, vihet re një diversitet i qartë në pikëpamje të përpilimit dhe të shtrirjes së rubrikave kyçe që lidhen me brendinë e këtyre veprave dhe që bëjnë të mundur një dallim po aq evident me shtjellimin që u rezervohet të njëjtave nocione e dogma në përmbajtjen e pjesëve të caktuara në librin e Buzukut.¹

Pjetër Budi mbetet një autor ndaj të cilit vëmendja e studiuesit të teksteve të vjetra shqipe nuk mund të shterrojë lehtësisht. I gjindur para sprovasi serioze dhe që kërkonin kompetenca komplekse në pikëpamje formimi dhe përgjegjësie, ky shkrimtar i shquar i letërsisë sonë të shkruar ndërtoi rubrika të plota në përbërje të variantit përkatës doktrinar të përpiluar prej tij(e që pat disa ribotime), u përpoq të ruante më së miri karakterin dhe natyrën didaktike që duhet të kenë të tilla përpilime për vetë destinacionin origjinar të tyre, ndërkohë që inicioi dhe vetë një spektër përdorimesh të cilat pikërisht në përbërje të veprës së tij fitojnë dhe reflektojnë konotacionin e duhur.

Në traditën e studimeve mbi këtë autor gjurmohen shkrime shkencore, riprodhime të pjesshme në përbërje korpusesh me destinacion shkollor, botime më të plota që janë përpjekje serioze për t'i dhënë këtij të fundit një vend të merituar në historinë e shkrimit shqip, por dhe në një kuadër më të gjerë që ngërthen albanologjinë në disa disiplina: histori, histori e letërsisë së shkruar, histori e studimit të teksteve të vjetra shqipe, botimet filologjike e kritike mbi letërsinë e vjetër shqipe, gramatikë historike e gjuhës shqipe.

Kërkime interesante në disa drejtimi studimi lidhen veçanërisht me emrin e Pjetër Budit: kësombllat e veprave që ai përshtati e gatiti për botim

¹ Sythet që i kushtohen katekezës dhe observimit të sakramenteve në librin e Buzukut ndryshojnë në pikëpamje tekstore dhe gjatësie me variantet e sipërpërmendura, ndërkohë që introduktohen dhe në formë paragrafesh më të personalizuar në veprën e P. Budit. Katekeza gjindet e trajtuar hollësisht në Doktrinën e kërshenë, ndërkohë që në Ritualin Romak gjurmohen tekste lutjesh që dhe pse të lëna latinisht, ofrojnë për studiuesit variante të mundshme referenciale për të përqsuar me tekstet gjegjëse në librin e Buzukut. Përkime por e diferencime jo të vogla në pikëpamje të përmbajtjes së teksteve themelore në dy veprat e sipërpërmendura duhen konsideruar dhe për të vlerësuar nëse realisht Budi mori parasysh ndërtime të caktuara nga libri i Buzukut për t'u dhënë vijimësi në realizimet e veta.

evidentohen në elemente qenësore nga filologu frëng Mario Roques në fillim të viteve '30 të shekullit të kaluar; tekste të veçanta nga modelet doktrinare e kateketike të tij u bënë objekt studimi e shpjegimesh filologjike nga Atë Justin Rrota O.F.M.; aspekte të rëndësishme të brendisë së veprës, çështje të shkrimtarisë e të elementeve metrike e prozodike që gjurmohen në pjesë të caktuara të veprave analizohen në studime të posaçme nga Henrik Lacaj², më tej dhe nga Arshi Pipa; vendi i rëndësishëm që këtij autori i përket në një kontekst kompleks që nuk cek vetëm studimet letrare e gjuhësore trajtohet objektivisht nga Eqrem Çabej në shkrime që i vlejnjë në veçanti historisë së letërsisë së shkruar shqipe, por dhe dialektologjisë historike³; një vëmendje të madhe i kushton autorit dhe veprës Selman Riza, i cili bën pjesë të studimeve të veta tekste dhe elemente themelore të realizimit të saj, interpreton në lidhje me aspekte të shkrimtarisë dhe arritjes së saj, krahason gjerësisht me autorë të së njëjtës traditë shkrimore; pjesë të përzgjedhura nga veprat e Budit, shoqëruar nga tejskrimi, aparati kritik e gjithashtu nga trajtesa të gjera mbi vetë veprën dhe traditën përkatëse të studimeve sillen nga Rexhep Ismajli në disa botime, veçanërisht në atë të vitit 2006.⁴

Gjurmohet gjuha e këtij autori dhe nga gramatologu Kostaq Cipo, në një këndvështrim kompleks e që cek disa nënsisteme e kategori të rëndësishme gramatikore, të shtjelluar gjithashtu dhe në optikën e një terminologjie sa origjinale, aq dhe të përshtatshme për një sërë tiparësh gjuhësore që mund të vilen në tekstet e varianteve doktrinare të Budit.⁵

Shqipërimet e Pjetër Budit si objekt studimi në një kuadër që cek panoramën e sjelljes së tekstit biblik e liturgjik në shqipe trajtohen gjerësisht dhe nga studiuesi Engjëll Sedaj, i cili përfshin pjesë të caktuara të kësaj krijimtari në trajtesa analitike dhe krahasuese.

² Lacaj H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, në **Studime filologjike**, n.4, 1966, f. 151-158.

³ Çabej E., *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, në **Studime filologjike**, n.4, 1966.

⁴ Pjetër Budi, **Poezi; Parathënia, tejskrimi dhe komentet: R. Ismajli**, ASHAK, Prishtinë, 2006.

⁵ Cipo K., *Vërejtje fonetike, morfologjike e sintaktike mbi "Doktrinën e Kershtenë" të Budit*, në **Buletin i Institutit të Shkencave, Seri e Shkencave Shoqërore**, n.1, 1952, f.5-33.

Leksiku i veprës së Pjetër Budit evidentohet në mënyrë tejet të vëmendshme me anë shpjegimesh e interpretimesh kryesisht gjuhësore nga Kolë Ashta, në vazhdë të studimeve disavëllimëshe të tij mbi autorë dhe dokumente shkrimore të hershme të shqipes.⁶

Gjurmohet sistematikisht ky autor në pikëpamje letërkëmbimi dhe dokumentacioni arkivor nga historianë të periudhës në të cilën jetoi, duke u bërë e mundur kësisoj të plotësohet më qartë dhe konteksti që mbështeti formimin dhe rrugëtimin e këtij prelati të letrave shqipe.⁷ Janë këto të fundit elemente që u morën parasysh gjerësisht dhe nga vetë filologët dhe studiuesit e teksteve të veprës së këtij autori, duke qenë pjesë e objektivit studimor të tyre dhe sqarimi i indiceve biografike që lidhen me këtë autor.⁸ Në veçanti në lidhje me autorët e letërsisë së vjetër shqipe, saktësimi i të dhënave biografike ka qenë një element që prej kohësh pret të plotësojë trajtesat specifike në fushë të historisë së letërsisë së shkruar.

Në këtë spektër studimesh dhe arritjesh kontributet e gjuhëtarit danez Gunnar Svane, studiues i zellshëm i gramatologjisë dhe i filologjisë së gjuhëve sllave, i gjuhësisë ballkanike, zënë një vend më se të meritueshëm dhe që spikat në disa pikëpamje. Mund të vërehet qartë se një autor si Pjetër Budi ka mbajtur të gjallë vëmendjen e këtij studiuesi për vite me radhë, duke bërë të pasqyrohen në shkrime dhe botime të plota gjurmime të disa fushave: filologji e tekstit, çështje të interpretimit dhe leximit të veprës së tij(Budit); aspekte të studimit të gjuhës së këtij autori. Ndërmarrja e përpi-

⁶ Ashta K., **Leksiku historik i gjuhës shqipe II**, Botimet Toena, Tiranë, 1998.

⁷ Zamputi I., *Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit*, në **Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore**, n.2, 1958.

⁸ Svane G., në Budi P., **Dotrina Christiana(1618)**, Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, Aarhus, 1985, *Introduction*, f.VII: In a letter written in Italian to Cardinal Gozzadino in September 1621, Budi, who was in Rome at the time, describes himself as follows: "From the time of my youth until I was 21 I served several bishops in our country with scarcely a break. What little education I have, they gave me. One senses the accuracy of this statement when reading between the lines of Budi's work in Albanian. We know nothing, however, about his parents, or about his family's social class. The author himself tells us, however, that he was born in Guri i Bardhë, wich is a mountain village in the south-west corner of the once Roman Catholic district of Mati, on a ridge in the mountains east of Tiranë and north of Elbasan. In his youth Budi must have spoken the local North Albanian dialect, which can be characterized as Central Geg.

limit të konkordancave e evidentuar në botime të viteve '80 të shekullit të kaluar (1985-1986) është pasqyrë e qartë e kurorëzimit të gjurmimeve të thelluara dhe këmbëngulëse për të shpënë drejt një konkretizimi të frytshëm kërkime e vjelje të natyrës leksikore mbi gjuhën e këtij autori.⁹

Në veçanti Doktrina e vitit 1618, një variant që gjithashtu ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të filologjisë së tekstit dhe përgatitësve të botimeve të veprave të kësaj natyre ka parë dritën e shtypit në një kontekst kohor të afërt me zhvillimet e sipërpërmendura në historinë e Kishës së Romës, madje akoma në të gjallë të vetë Bellarminos. Në këtë pikëpamje, disponimi e konsultimi i tij (aq më mirë në një model transkribimi) mbetet i një aktualiteti të përhershëm, duke qenë se e konsiderojmë dhe si variant ndaj të cilit zënë fill dhe reflektime, qasje me të tjera realizime të mëvona në kohë(qoftë dhe kur vetë Budi nuk jetonte më), krahasime dhe deduktive të domosdoshme në këtë rasë. Në këtë variant mund të vërehen ndërtime që i përkasin një regjistri specifik që gjithsesi rezulton në lëmë lëvrimi dhe në përmbajtjen e librit të Buzukut, mund të gjurmohen papërsosmëri në pikëpamje të ndërtimit të paragrafeve dhe nëndarjeve tematike që duhet të jenë të qarta në botime të kësaj natyre; shtjellohet natyrshëm gjithashtu një leksikon tipik për një doracak doktrinar që pikënisjen e ka në përcimin e nocioneve themelore të besimit dhe në ngulitjen e teksteve themelore në liturgjinë e përditshme.

Realizimi i botimit të këtij varianti nga Gunnar Svane në vitin 1985 realizuar nën stemën e Institutit të Studimeve Gjuhësore të Universitetit të Aarhus, vjen në vazhde të kërkimeve dhe botimeve të mëparshme në kohë, pasqyruar në shkrime të mirëfillta shkencore që krahas vlerave që paraqesin për reflektimet mbi gjuhën e Budit, çështje të leximit dhe interpretimit të shenjave grafike në tekstet e tij, krahasime të mundshme me fakte e detaje nga autorë të tjerë të letërsisë së vjetër shqipe, janë një paraprirje e natyrshme e koezive me botimin e sipërcituar dhe me realizimet e konkordancave që do ta vijojnë atë. Një trajtesë e thelluar dhe që synon në sqarimin e aspekteve të interpretimit fonik e në elemente bazike të tekstit bashkë me evidentimin e vlerës që të tilla vepra paraqesin dhe për studimet

⁹ Budi P., *Rituale Romanum(1621)*, with a transcription into modern orthography and a concordance prepared by G.Svane, Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, 1986.

në fushë të ballkanistikës ndeshet në veçanti në shkrimin me titull *How to read Budi's Speculum Confessionis*, botuar në vitin 1980 në revistën *Studia Albanica*, n.1. Të orientojnë patjetër dhe ndaj botimit të pajisur me parathënie të variantit doktrinar të vitit 1618 vërejtjet dhe prirjet e qarta që Svane ka në pikëpamje të studimit të çdo detaji që ka të bëjë me optikën e gjurmimeve filologjike. Pa dyshim që vërejtje të ngjashme mbi kritere të interpretimit fonik e gjithashtu dhe përmbajtësor në lidhje me përdorime të veçanta ndeshen si në këtë artikull të zgjeruar që i kushtohet Pasëqyrës së të Rrëfyemit (1621), si në parathënien me të cilën Svane shoqëroi apo introduktoi Doktrinën e vitit 1618.

Veçanërisht në artikullin e sipërcituar, hollësitë mbi segmente tekstore që kanë të bëjnë me interpretimin e të lexuarit të sintagmave të caktuara, por dhe vërejtjet mbi diversitetin në pikëpamje shtypshkrimi në Doktrina (1618) dhe në *Speculum Confessionis* (1621) janë një tjetër dëshmi e vëmendjes që autori tregon në pikëpamje të studimit kompleks të këtyre veprave.¹⁰

Një linjë e qartë e orientimit studimor dhe e metodologjisë që Svane ndjek në pikëpamje të hulumtimit tekstor dhe përmbajtësor të veprës së Budit shtjellohet mirëfilli dhe në një artikull shkencor të botuar në revistën

¹⁰ Svane G., *How to read Budi's Speculum Confessionis*, në **Studia Albanica**, n.1, 1980, f.150: All things considered, Albanian is a language without geminated consonants. In view of this fact it is amazing to see the superabundance of double consonants on each and every page of Budi's first book, the *Dottrina Christiana* of 1618. From a purely linguistic point of view these double spellings are of no interest whatsoever, being only a whim of typographical fashion. Whether this kind of pseudogemination was due to the author himself or the Roman printers, we cannot know for sure. But whatever the case may be, there can be no doubt that the model was Italian orthography, in which double consonants were and still are extremely frequent; they serve to indicate the abundant geminations in the language. To people of that time, who were accustomed to see mainly Italian (and Latin) texts, any printed matter without double consonants would presumably have looked quite abnormal. One can assume that they, that is, Budi's printers, wanted to remedy this oddity by introducing into the Albanian text of DC a great number of pseudogeminations which they based on principles that are not clear to-day, and which we shall not go into here. Even Buzuku's Missal from as early as 1555 contained a lot of double consonants without corresponding germination in Albanian; and this Italian inspired orthography turned out to be so durable that it was still being used in the 19th century.

Studime filologjike, n.3, 1982.

Gjykojmë se një shkrim i tillë i pajisur me nënndarje të arsyetuara mirë prej vetë autorit, i plotësuar me shënime të shumta shpjeguese dhe orientuese për këdo që është i interesuar të njohë mirë dy veprat që bëhen objekt krahasimi, i pasuruar me vërejtje e vjelje leksikore aspak rastësore nga përmbajtja e veprës së Budit, i mbështetur metodologjikisht nga një sërë orientimesh që priren nga krahasimi konkret dhe përballja tekstore, përforcon në vijimësi logjike krejt platformën e parashtruar sërish prej tij në parathënien e zgjeruar me të cilën ai introdukton botimin e Doktrinës së krishtenë të vitit 1618, botim i rëndësishëm në shumë pikëpamje, si në atë të kohës në të cilën pa dritën e shtypit, si dhe në atë të faktit që mbetet një botim e model referencial për mjaft pista studimi.

Në këtë artikull të Gunnar Svanes konsiderohen në mënyrë objektive përputhshmëri dhe divergime që vihen re qartë ndërkohë që qasen dy variante: botimi i vitit 1611 i *Speculum confessionis* përpiluar nga Emerio De Bonis dhe ai gjegjës i përgatitur prej Pjetër Budit, botimi i të cilit daton në vitin 1621. Elementet e marra në analizë nga autori i këtij artikulli shpjen në konkluzione të shumta dhe koncize: në masën më të madhe synojnë si drejt nënvizimit të faktit që jo rrallë prej autorit tonë prijet drejt modifikimit përmbajtësor dhe personalizimit të hartimit të tekstit bëjnë që varianti i këtij të fundit të jetë më i zgjeruar (përveç se i ndryshëm) në pikëpamje brendie; gjithashtu janë vjelë mjaft raste përdorimi që nënvizojnë aspekte konstitutive të të shkruarit të Pjetër Budit, që në disa elemente pas mendimit tonë mund të shpjen dhe në qasje me detaje të ngjashme nga tekstet e *Mesharit*. Shembujt e sjellë nga tekste të caktuara nga vepra e Budit jo vetëm vënë në pah veçanti e përftesa që dëshmojnë për një gjuhë të kultivuar e të kujdesuar prej këtij të fundit, por dhe për prirjen për figuracion e për ilustrime sa më të gjetura në pikëpamje të ndërtimit të frazës e shprehive që gjinden në të.

Linja të përbashkëta gjurmimi vihen re dhe në shënimet që përmbahen në Parathënien që i prin botimit të sipërcituar të Doktrinës së vitit 1618, në të cilën autori ka përfshirë në vëmendjen e tij vetë Pjetër Budin në një syth të veçantë të saj; Doktrinën e Krishtenë në optikën e një trajtese që nuk lë jashtë vëmendjes dhe detaje në dukje teknike, por që i referohen

qartë gjendjes së variantit dhe elementeve tekstore që e shoqërojnë atë; çështje të ribotimit të kësaj Doktrine nën vëmendjen e Kongregacionit të Propagandës bashkë me detaje që sqarojnë nëse janë kryer modifikime në përmbajtjen e variantit të vitit 1618; figurën e Roberto Bellarminos, teolog dhe apologet i mirënjohur, një aktor i rëndësishëm në ndryshimet historike që shoqëruan historinë e Kishës së Romës dhe pas vdekjes së tij, receptimin e varianteve doktrinare të përpiluara prej tij në vise të ndryshme e në gjuhët përkatëse bashkë me korpuse në të cilat përfshihet një krijimtari më e gjerë e tij; çka është mjaft me rëndësi, referimi deri në hollësi ndaj sytheve të veçanta të përmbajtjes së variantit të vitit 1618, duke shpjeguar si introduktohen tekste themelore të liturgjisë, sa përputhen në ubikimin konkret me indeksin e përgjithshëm përmbajtësor të veprës; gjatësinë e perifrazave që në fakt kanë të bëjnë me shpjegime shumë të rëndësishme për vetë nocionet që duhet të përçojë çdo variant i tillë. Mbetet kjo e fundit një linjë që mbitotëron veçanërisht në atë pjesë të Hyrjes që Svane i ka rezervuar trajtimit të Doktrinës si vepër, trajtim që ruan tiparet e një analizimi gjithëpërfshirës dhe me vëmendje të veçantë ndaj elementeve konstitutive përmbajtësore të variantit. Duhet thënë në këtë rast që pikërisht duke ndjekur vërejtjet dhe indicet që pasqyrojnë shtjellimin e përmbajtjes së këtij varianti kaq të rëndësishëm doktrinar nga ana e Svanes, duke u orientuar me numrat e paragrafeve e të faqeve që shënohen në përbërje të këtij botimi, bëhet e mundur të realizohet një *excursus* i natyrshëm në gjithë brendinë e këtij të fundit.

Hollësi interesante përmbahen veçanërisht në nënndarjen që i kush-tohet transkribimit, në të cilën autori shtjellon në detaje veçanti grafike, risi grafematike që i atribuohen Budit; krahasime të mundshme me aspekte të shtypshkrimit të Buzuku apo dhe të autorë që e pasojnë Budin në kohë. Mbetet kjo pjesë ndër më të kujdesuarat në pikëpamje imtësish e shpjegimesh nga ana e Svanes, një hapësirë që lë mundësi për reflektime, por dhe për sqarime të domosdoshme sa i takon leximit të fjalës dhe të tekstit në veprën e Budit, interpretimit fonik të shenjave grafike dhe klasifikimit të tyre dhe sipas lehtësisë së të kuptuarit të vlerave që marrin në kontekste konkrete. Këto aspekte në dukje teknike sjellin vështirësi jo të vogla në pikëpamje të zgjidhjeve që duhet të ndër marrë filologu dhe në veçanti tekstet e Budit janë të karakterizuara nga inkoherenca dhe të meta që shtypshkrimi i atëhershëm i evidenton me gjithë paqartësitë që përmbajnë ato.

Duke iu referuar çështjes së modelit libror të përshtatur prej këtij autori, ngulmohet veçanërisht prej G. Svanes në atë të rëndësisë që paraqet ndërmarrja e tij, rëndësi që nënvizohet së tepërmi dhe nga gjurmimi i detajeve të tjera të karakterit historiografik e që plotësojnë kuadrin e vepërimitarisë meshtarake të tij.¹¹

Është fare e qartë për këtë studiues që ndërkohë që ceket e gjurmohet çështja e referencialitetit tekstor pikërisht në lidhje me Doktrinën e vitit 1618, duhen pasur parasysh variantet e disponueshme për kohën të Doktrinës së Bellarminos, qoftë ato më të zgjeruarat (të paracaktuara kryesisht për katekistët), qoftë ato më sintetiket (të paracaktuara për moshat e njoma shkollore apo për njerëzit me përgatitje modeste shkollimi) në pikëpamje vëllimi e përmbajtjeje.¹²

Ajo çka duhet nënvizuar dhe nga ana jonë pas konsultimit të teksteve të Doktrinës së vjetit 1618 dhe vetë vërejtjeve të Svanes në parathënien e sipërpërmendur lidhur konkretisht me aspekte përmbajtësore të këtij varianti, mbetet pikërisht fakti që dhe shqipëruesi ynë ka rol autorësie në sprovën e ndërmarrë, me gjithë vetëdijen fare të qartë që kishte të bënte me tekste delikate nga shumë pikëpamje.¹³ Personalizimi i elementeve të ndonjë rubrike mbetet i pashmangshëm kur bëhet fjalë për përshtatjen e shprehjeve apo ndërtimeve të caktuara në një gjuhë tjetër. Një fakt i tillë vërehet gjithashtu dhe në adaptimin e varianteve kateketike të Bellarminos

¹¹ Në vepër gjinden të pranishme pjesë dhe elemente tekstore të lëna në latinisht, të dallueshme teknikisht dhe në variantin e konsultuar të Doktrinës të përgatitur nga Gunnar Svane, nga ana tjetër nuk mungojnë përftesa e emërtime që nuk i gjejmë te autori paraardhës i Budit, i konsideruar si pararendës në pikëpamje të shumë koncepteve dhe risive që ndërmenden e gjurmohen në pjesën e parë të librit të tij, dhe që nuk mund të thuhet me siguri që janë rimarrë prej pasardhësve që iu vunë hartimit të sprovave të ngjashme

¹² U ndërmendën të tilla çështje dhe për faktin se rezultojnë të rimarra në një rend të arsyetuar në Hyrjen me të cilën Gunnar Svane shoqëroi dhe introduktoi tekstat e transkribuara të *Dotrina Christiana* të vitit 1618, që ne kemi konsultuar në një botim të vitit 1985, realizuar nën stemën institucionale të Institutit të Studimeve Gjuhësore të Universitetit të Aarhus.

¹³ Nuk përjashtohen raste në të cilat dëshkohet qartë që përftesat në fjalë nuk ndeshen lehtësisht në botime të ngjashme, qofshin këto dhe paraardhëse, qofshin këto dhe të vetë Budit (i referohemi në veçanti botimit të vitit 1621 të *Rituale Romanum*, botuar në Romë dhe që ka për përkthyes e përshtatës sërish P. Budin).

të botuara në gjuhë të tjera.¹⁴

Një variant doktrinar përmban patjetër sythe që u rezervohen lutjeve themelore në liturgjinë e orëve e që ruajnë qartë lidhjen me referimin biblik nga i cili kanë dhe origjinën; një variant doktrinar ruan kthjelltësisht natyrën didaktike dhe në rasi të trajtimit të thelluar të nocioneve dogmatike siç është ai i përshkrimit të Trinisë Shëjte dhe i personave që ngërthehen në të e që përfaqësojnë gjithsesi njësinë apo të qenit një e vetme e kësaj njësie. Kësisoj vetë studimi tekstor i variantit të lutjes *Ati ynë* që gjurmohet në këtë botim të Doktrinë përbën një model domethënës krahasimi dhe me përdorimet që gjallojnë dhe sot e kësaj dite në kujtesën e besimtarëve veçanërisht në veri të Shqipërisë.

Sprova të tilla e studime kaq të thelluara përbëjnë kontribute që marrin vlerë më vete dhe për faktin se plotësojnë një kuadër të rëndësishëm në pikëpamje të përafritimit me studimin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, në tërësinë e së cilës pikërisht çka përpiloi, përshtati dhe realizoi Pjetër Budi në një hapësirë kohore jo fort të gjatë zë një vend të veçantë për nga rëndësia, përmbajtja dhe aktualizimi që i ofronte lëvrimit të shkrimit në gjuhën tonë.

Në këtë pikëpamje, duhet rinëvizuar fakti që autori (Pjetër Budi) shfaq një impenjim jashtë përmasave të së zakonshmes dhe ka lënë pas një monument shkrimor, letrar e gjuhësor që ofron përherë elemente kuëshetje shkencore dhe çështje qasjeje e krahasimesh.

Po në këtë pikëpamje, ndërmarrja e studiuesit Gunnar Svane për ta tejshkruar këtë korpus tekstor apo për ta evidentuar me anë konkordancash mbi bazë kriteresh të sqaruara hollësisht, për ta introduktuar më së miri duke vlerësuar faktorët që e mbështesin dhe brendësimin përmbajtësor e filologjik të tij, për të rinëvizuar vendin që i takon në historinë e letërsisë së shkruar shqipe përbën një prej sprovave më të lavdërueshme në fushë të

¹⁴ Shih ndër të tjera dhe *Catéchisme ou ample déclaration de la Doctrine Chrétienne, & du Symbole des Apôtres, composée de l'ordonnance de N.S.P. le Pape Clement VIII par l'Ilustriissime Cardinal Bellarmini, traduite d'italien en françois par le P. Antoine Pacot de la Compagnie de Jesus; Augmentée à la fin du chaque chapitre d'exemples, & histories, recueillies pour l'instruction des deuotes, de plusieurs grands Docteurs autorisés de l'Église*, à Lyon, Chez Jean Hvgvetan, rue Mercière, M.DC.LXIII.

albanologjisë e në veçanti në një lamije që është plotësuar vazhdimisht dhe në dekadat e vitet e fundit me arritje që përveç se reflektojnë zbatimin e shkollave të caktuara në filologji e interpretim kritik e tekstologjik, përmbushin një kuadër botimesh më se të nevojshme dhe për të rindërtuar një *thesaurus* të zgjeruar me elemente e tekste nga veprat e letërsisë së vjetër shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Ashta K., *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, në *Studime filologjike*, n.4, 1966.
- Ashta K., *Leksiku historik i gjuhës shqipe II*, Botimet Toena, Tiranë, 1998.
- Budi P., *Poezi(1618-1621)*, (*Parathënia, tejskhkrimi dhe komentet: R. Ismajli*), ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shëjzat*, Romë, 1960.
- Camaj M., *Pjetër Budi(në rasën e katërqindvjetorit të lindjes)*, në *Shëjzat*, n.9-12, 1966.
- Cipo K., *Vrejtje fonetike, morfologjike e sintaktike mbi doktrinën e kërshenë të Budit*, në *Buletin për shkencat shoqërore*, n.1, 1952.
- Cirriacione A., *Sintassi degli antichi scrittori albanesi, Shëjzat*, Roma, 1968.
- Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n.2, 1959.
- Çabej E., *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, BUSHSHT, n.3, 1963.
- Çabej E., *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, në *Studime filologjike*, n.4, 1966.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes IV(Dh-J)*, Tiranë, 1996.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes VI*, Tiranë, 2002.
- Çabej E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Botime Çabej, Tiranë, 2013.
- Çabej E., *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*, Botime Çabej, Tiranë, 2014.
- Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, Botime ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R. D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Domi M., *Pjetër Budi(1566-1622)*, në *Studia Albanica*, n.1, 1967.
- Fishta F., *Nder gjurmimet e veprimit "De propaganda fide" në Balkan*, në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.
- Fishta F., *Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë*, në BUSHT, n.3, Tiranë, 1962.
- Ismajli R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, Pejë, 2000.
- Lacaj H., *Pjetër Budi, vjershëtor i parë i letërsisë sonë*, në *Studime filologjike*, n.4, 1966.
- Maisano R., *Filologia del Nuovo Testamento*, Carocci editore, Romë, 2014.
- Mansaku S., *Vepra e Pjetër Budit në traditën e shkrimit të shqipes*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2006.
- Mjedja D.N., *Permbi një liber të panjoftun të Timzot Pjeter Budit*, në *Leka*, n.7-8, 1932.
- Mjedja N.D., *Një dorëshkrim i moçëm e një kritikë e re*, në *Revista Leka*, n.3, 1933.
- Mohrmann Ch., *Liturgical Latin: Its origin and character*, Washington, 1957.
- Mulaku R., *Gjuha e shkrimeve të vjetra shqipe(Shek.XV-XVIII)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012.
- Neziri Z., *Poezia e Budit*, Eko Ritmi, Shkup, 1995.
- Omari A., *Veçori të punës filologjike të Selman Rizës me tekstet e vjetra shqipe*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2010.
- Omari A., *Ndihmesa e Kostaq Cipos në studimin e teksteve të vjetra shqipe*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2012.
- Paci E., *Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare*, në *Hylli i*

- Dritës, n.2, 2011.
- Paci E., *Sistemi mbiemëror në Mesharin e Gjon Buzukut*, (punim monografik), Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011.
- Paci E., *Një vepër themelore për filologjinë e teksteve të vjetra shqipe* (në përvjetor të botimit të veprës *Recherches sur les anciens textes albanais, 1932*), në *Hylli i Dritës*, n.4, 2012.
- Paci E., *Doktrina e kërshenë e Bellarminos në një variant të shqipëruar nga Atë Guagliata S.I.(1845)*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2015.
- Paci E., *Kontributi i Eqrem Çabejt në fushë të studimeve mbi historinë e letërsisë së vjetër shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2016.
- Paci E., *Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2014.
- Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Petrota G., *Popolo, lingua e letteratura albanese* (a cura di Matteo Mandalà), Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
- Riza S., *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Botime Toena, Tiranë, 2002.
- Riza S., *Vepra 4*, ASHAK, Prishtinë, 2004.
- Riza S., *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 2009.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P. Geuthner, Paris, 1932.
- Roques M., *Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe e shkrime të tjera*, (përkthye nga frëngjishtja e pajisë me shenjime plotësuese nga W. Kamsi), Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- Rrota J., *Per historin e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhesore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005.
- Schirò Z., *Randësija e librave të Buzukut e të Budit*, në *Shkëndija*, n.9-10, 1942.
- Schirò G., *Storia della letteratura albanese*, Nuova Accademia, 1959.
- Sedaj E., *Shqipja arbërore* (në fillimet e filologjisë shqiptare), Prishtinë, 2002.
- Suta B., *Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit(1618-1622)*, Botime Onufri, Tiranë, 2016.
- Svane G., *How to read Budi's Speculum Confessionis*, në *Studia Albanica*, n.1, 1980.
- Svane G., *Formimi i gjuhës letrare shqipe siç paraqitet në "Pasqyrën e të rrëfyemit" të Budit(1621)*, në *Studime filologjike*, n.3, 1982.
- Svane G., *Libra dhe dorëshkrime të vjetra shqipe në Bibliotekën Mbretërore në Kopenhagë*, në *Studime filologjike*, n.3, 1985.
- Svane G., *Dorëshkrime shqipe të shek.18 në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës*, në *Studime filologjike*, n.4, 1986.
- Zamputi I., *Shënime mbi rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit*, në *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore*, n.2, 1958.
- Zamputi I., *Koha dhe veprimtaria e Pjetër Budit*, në *Nëndori*, n.9, 1966.

Milote SADIKU, Prishtinë

STUDIMET E GJUHËTARËVE GJERMANISHTFOLËS PËR MBIEMRIN E GJUHËS SHQIPE

1. Hyrje

Janë para së gjithash filologët gjermanishtfolës, të cilët e kanë bërë shqipen pjesë të interesimeve të tyre shkencore qysh në filltet e studimeve albanologjike, duke u marrë në mënyrë intensive sidomos me prejardhjen e shqipes dhe me etimologjinë e leksikut të shqipes, por edhe me një varg çështjesh të tjera të gjuhës shqipe. Albanologët nga vendet gjermanishtfolëse edhe në ditët e sotme i kanë vazhduar hulumtimet e tyre për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare. Në këtë punim do të pasqyrohet kontributi i disa gjuhëtarëve gjermanë për mbiemrin e gjuhës shqipe, për sa i përket mënyrës së trajtimit të problemeve morfologjike, semantike e sintaksore që paraqet kjo klasë e fjalëve. Në këtë artikull jemi ndalur në gramatikën e gjuhës shqipe “Albanische Grammatik” (1987) e të dy albanologëve gjermanë Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, që janë dy¹ ndër albanologët më të shquar në hapësirën gjermanishtfolëse, si dhe në disa studime të gjuhëtarit gjerman Gerd-Dieter Nehring, sidomos për fjalëformimin e mbiemrit të gjuhës shqipe.

2. Buchholz/Fiedler për mbiemrin e shqipes

Kuptimi kategorial i mbiemrit si në shqip ashtu edhe në gjermanisht

¹ Puna shkencore e albanologut Wilfried Fiedler është gjithëpërfshirëse. Përveç gramatikës “Albanische Grammatik” (1987) në bashkëpunim me Oda Buchholz, ai është edhe bashkautor i fjalorit Shqip-gjermanisht (1977) bashkë me Oda Buchholz dhe Gerda Uhlisch. Në fokus të interesimit të tij shkencor janë të gjitha periudhat gjuhësore të shqipes. Përveç me shqipen moderne, një vend qendror në punimet e tij e kanë edhe studimet për gjuhën e vjetër të shqipes, siç është gjuha e Gjon Buzukut në veprën e tij të botuar më 2004 “Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555) (Sistemi foljor i shqipes në veprën e Gjon Buzukut (1555))”.

është kuptimi i tiparit të sendit. Gramatika e Akademisë (2002: 153) e definon mbiemrin si pjesë të ligjëratës “që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër e, për një pjesë, edhe në rasë me emrin e këtij sendi”. Sipas gramatikës së gjuhës gjermane të IDS “Grammatik der deutschen Sprache”² (1997: 46) mbiemrat në gjuhën gjermane shërbejnë si atributë, modifikatorë të kokës së një fraze nominale, e cila formohet me një emër, mbiemër të emëruar apo folje të emëruar. Pra, mbiemri në këtë funksion i jep një kuptim shtesë një sendi dhe në këtë mënyrë ky send përkufizohet më mirë dhe identifikohet më lehtë.

Në “Albanische Grammatik” autorët gjermanë Buchholz/Fiedler i trajtojnë në mënyrë shumë shkencore shumë çështje të fonetikës, të morfologjisë dhe të sintaksës së shqipes. Edhe klasa e mbiemrit zë një vend të konsiderueshëm në këtë gramatikë. Këta autorë i trajtojnë mbiemrat në mënyrë gjithëpërfshirëse në kapitullin e morfologjisë. Sipas tyre mbiemrat e shqipes janë një klasë heterogjene që, njësoj si në gjuhën gjermane, emërtojnë tipare të një sendi (cilësi, veti, marrëdhënie), të cilat tipare nuk janë të pavarura, por që duhet të vihen në lidhmëni me individët përkatës si bartës të këtyre tipareve. Kjo varshmëri logjike, sipas këtyre autorëve, pasqyrohet gjuhësisht në varshmërinë sintaktike në mes të mbiemrit dhe emrit, gjegjësisht përemrit (Buchholz/Fiedler 1987: 314).

Pas përkufizimit të klasës së mbiemrit, Buchholz/Fiedler paraqesin klasifikimin e mbiemrave duke u mbështetur në tri kritere të klasifikimit: në kriterin semantik, kriterin sintaksor dhe kriterin morfologjik. Për dallim nga ta, në gramatikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2002: 155) mbiemrat klasifikohen vetëm sipas kuptimit të tyre leksikor dhe sipas veçorive të tyre morfologjike. Siç e përmendin vetë autorët në hyrje të “Albanische Grammatik”, në metodologjinë e punës në këtë gramatikë, përveç gramatikave të shqipes, si model u kanë shërbyer edhe “Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht” nga G. Helbig dhe J. Buscha, por edhe “Grundzüge einer deutschen Grammatik” prej grup autorësh (nën udhëheqjen e Heidolph/Fläming/Motsch). Në këto gramatika, si dhe në shumicën e gramatikave të tjera të gjermanishtes, mbiemri klasi-

² Zifonun/ Hoffmann/ Strecker (1997): Grammatik der deutschen Sprache. Berlin/ New York: De Gruyter

fikohet përveç sipas kriterit leksikor-semantik e kriterit morfologjik edhe sipas kriterit sintaksor gjegjësisht morfo-sintaksor (krh. Helbig/ Buscha 2001: 280-281; Heidolph/ Flämig/ Motsch 1981: 604; Duden 4 2009: 334-361). Pra, gramatika e Buchholz/ Fiedler, duke u mbështetur edhe në metodologjinë dhe teorinë e studimeve për gjermanishten, në pika të përgjithshme ndryshon nga gramatikat e shqipes sa i përket trajtimit të sistemit gramatikor të shqipes, duke paraqitur një pasqyrë gjithëpërfshirëse të sistemit të gjuhës së sotme shqipe dhe duke i trajtuar dhe argumentuar të gjitha në mënyrë të thukët shkencore.

Klasifikimi i mbiemrave sipas kriterit semantik:

Sipas kriterit semantik, Buchholz/Fiedler (1987: 315) i ndajnë mbiemrat e gjuhës shqipe në 1) mbiemrat cilësorë (*Qualitätsadjektive*) dhe 2) mbiemrat marrëdhëniorë (*Beziehungsadjektive*).³

1) Sipas këtyre autorëve, mbiemrat cilësorë emërtojnë veti a cilësi në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose e paraqesin vetinë a cilësinë si rezultat të një vlerësimi nga ana e folësit. Këta mbiemra emërtojnë cilësi, të cilat perceptohen drejtpërsëdrejti me shqisa ose të cilat janë vetëm të mendueshme, të përfytyrueshme, p.sh.: emërtimet për ngjyra: *i gjelbër* 'grün', *i kuq* 'rot', etj; formë, madhësi, shtrirje hapësinore: *i thellë* 'tief', *i gjatë* 'lang', etj; shije: *i ëmbël* 'süß', *i athët* 'herb', etj; veti fizike e gjendje shpirtërore e cilësi të karakterit: *i fortë* 'stark', *i dëshpëruar* 'traurig', *i zgjuar* 'klug', *besnik* 'treu'.

2) Kurse mbiemrat marrëdhëniorë, sipas Buchholz/ Fiedler, emërtojnë tiparin e sendit në mënyrë të tërthortë, pra shprehin marrëdhënien e një sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, a me një proces, etj. Te këta mbiemra marrëdhënija jepet si një tipar cilësor i qëndrueshëm. Mbiemri marrëdhënior mund të shprehë: një marrëdhënie lëndore, p.sh. *i mëndafshhtë* 'seiden', *i hekurt* 'eisern', etj.; një marrëdhënie përkatësore, p.sh.

³ Në gramatikën DUDEN 4 (2009: 339) mbiemrat e gjuhës gjermane, sipas kriterit semantik, ndahen në mbiemra cilësorë (kualifikues "qualifizierend"), mbiemra marrëdhëniorë ("relational") dhe kuantifikues ("quantifizierend") të ashtuquajturit "Zahladjektive" ("mbiemra numërorë"). Ndërsa autorët e gramatikës "Handbuch der deutschen Grammatik" Henschel/Weydt (2013: 186-187) sipas këtij kriteri i ndajnë në mbiemra relativë (dhe absolutë) "relative (und absolute) Adjektive" dhe mbiemra dimensionalë apo polarë "Dimensionsadjektive oder polare Adjektive".

shoqëror ‘gesellschaftlich’, *politik* ‘politisch’, etj.; një marrëdhënie të sendit të dhënë me një veprim, p.sh.: *shirës* ‘Dresch-, *korres* ‘Ernte-’, etj..

Për dallim nga mbiemrat marrëdhëniorë, mbiemrat cilësorë kanë një sërë veçorish karakteristike, të cilat mbiemrat marrëdhëniorë nuk i kanë. Sipas këtyre autorëve, a) në përgjithësi të gjithë mbiemrat cilësorë kanë kategorinë gramatikore të shkallës, b) nga aspekti i fjalëformimit mund të jenë fjalë të parme (*i keq* ‘schlecht’, *i bukur* ‘schön’) apo fjalë të prejardhura (*i ndershëm* ‘ehrbär’, *i helmuar* ‘vergiftet’; *zemërgur*, *shpirtkazzmë* ‘hartherzig’), c) me ndihmën e prapashtesave *-i*, *-(ë)si*, *-(ë)ri*, *-zi*, prej tyre mund të formohen emra abstraktë, të cilët emërtojnë cilësi, gjendje, etj., p.sh.: *i bukur* – *bukuri* ‘schön – Schönheit’, *i marrë* – *marrëzi* ‘verrückt – Verrücktheit’, etj., d) shumë prej tyre mund të formojnë çifte antonimike: *i madh*: *i vogël* ‘groß’: ‘klein’, *i mirë*: *i keq* ‘gut’: ‘schlecht’ etj., e) mbiemrat cilësorë njohin të dy llojet e emërzimit: edhe emërzimin e qëndrueshëm: *i riu* ‘der Jugendliche’, por edhe emërzimin kontekstual: *Njeriu plak e falënderoi të riun*. ‘Der alte Mann dankte dem jungen.’. Por përkundër këtyre dallimeve, megjithatë autorët theksojnë që nuk ka kufi të prerë midis këtyre dy grupeve mbiemrash. Mbiemrat marrëdhëniorë, kur përdoren me kuptim figurativ, kalojnë në mbiemra cilësorë: *derë e hekurt* ‘eiserne Tür’, *unaza të arta* ‘goldene Ringe’ (si mbiemra marrëdhëniorë) dhe *vullnet i hekurt* ‘eiserne Wille’, *duar të arta* ‘goldene Hände’ (si mbiemra cilësorë). Ndërsa disa mbiemra të prejardhur ndajfoljorë *i afërt* ‘nah’, *i largët* ‘fern’, *i vonë* ‘spät’, etj. që për nga kuptimi bëjnë pjesë tek mbiemrat marrëdhëniorë, megjithatë sillen më shumë si mbiemra cilësorë: e kanë kategorinë e shkallëzimit, mund të formojnë çifte antonimike, si dhe mund të emërzohen.

Klasifikimi i mbiemrave sipas kriterit sintaksor:

Siç u përmend më lart, ndryshe nga gramatika e akademisë, në gramatikën e Buchholz/ Fiedler (1987: 316) mbiemrat klasifikohen edhe sipas kriterit sintaksor. Sipas kriterit sintaksor autorët bëjnë dallim midis mbiemrave atributivë dhe mbiemrave predikativë, të cilët i ndajnë tri nënklasë: a) mbiemra, që përdoren si në funksion atributiv (*djali i zellshëm* ‘der fleißige Junge’) ashtu edhe në funksion predikativ (*djali është i zellshëm* ‘der Junge ist fleißig’); b) mbiemra që kanë përdorim kryesisht atributiv (*fjalimi*

i sotëm ‘der heutige Vortrag’, *kati i sipërm* ‘die obere Etage’); c) Mbiemra, që përdoren kryesisht në funksion predikativ (*është foleqesh* ‘er ist lustig’, *ishte qejfprishur* ‘er war eingeschnappt’). Ata vënë në pah se mbiemrat që kanë kryesisht përdorim predikativ radhiten në përgjithësi në grupin e ndajfoljeve, p.sh.: *dolëm fit* ‘wir sind quitt’, *jemi gati* ‘wir sind bereit’.⁴

Klasifikimi i mbiemrave sipas kriterit morfologjik:

Sipas kriterit morfologjik, këta autorë (Buchholz/Fiedler 1987: 316), i ndajnë mbiemrat në a) mbiemra me sistem të plotë të eptimit (këtu bëjnë pjesë mbiemrat e nyjshëm), b) mbiemra me sistem jo të plotë të eptimit (këtu bëjnë pjesë të gjithë mbiemrat e panyjshëm), c) mbiemra me forma të shkallëzimit (*i vjetër* ‘alt’: *një libër më i vjetër* ‘ein älteres Buch’, *libri më i vjetër* ‘das älteste Buch’), ç) mbiemra pa forma të shkallëzimit (të cilët nuk shkallëzohen për shkak të kufizimeve semantike: *katror* ‘quadratisch’, *gojor* ‘mündlich’, *i pafëmijë* ‘kinderlos’, *i gjithëfuqishëm* ‘allmächtig’), d) mbiemra të nyjshëm⁵ e dh) mbiemra të panyjshëm. Buchholz/Fiedler theksojnë se shqipen nga gjuha gjermane e dallon veçoria strukturore pas së cilës një numër i mbiemrave marrin nyjën e paravendosur, e cila përbën një të tërë fonetike me trupin e mbiemrit, ndërsa një numër i tyre përdoren pa nyje. Disa mbiemra të nyjshëm, kur përdoren në funksion predikativ, mund të hasen me formë të panyjësuar. Duke pasur një formë të pandryshueshme ata klasifikohen si ndajfolje (p. sh. *plaku i sëmurë* ‘der kranke Greis’ vs. *plaku është sëmurë* ‘der Greis ist krank’). Këta autorë (1987: 330) pohojnë se, ndryshe nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe është e domosdoshme që nga aspekti morfologjik të bëhet dallimi midis mbiemrave predikativë

⁴ Sipas gramatikës “Handbuch der deutschen Grammatik” (2013: 188) mbiemrat e gjuhës gjermane përdoren në tri funksione sintaksore: në përdorimin atributiv, predikativ dhe adverbial. Ndërsa autorët e gramatikës DUDEN 4 (2009: 340), përveç përdorimit atributiv “attributiver Gebrauch”, përdorimit predikativ “predikativer Gebrauch” dhe përdorimit adverbial “adverbialer Gebrauch” ia shtojnë edhe përdorimin e nominalizuar “substantivierter (nominalisierter) Gebrauch”. Megjithatë këtu duhet të theksohet, se jo të gjithë mbiemrat mund të përdoren në të gjitha këto funksione sintaksore, pra ka kufizime sa i përket përdorimeve të caktuara sintaksore të përdorimit të mbiemrave.

⁵ Memisha (2007: 61) thekson që “mbiemri morfematikisht është një pjesore e paranyjësuar”. Sipas tij, nyja e paravendosur kryen edhe funksionin e formantit fjalëforms, pasi që realizon kalimin nga klasa e foljes (nga pjesorja e saj) te mbiemri.

dhe ndajfoljeve. Mbiemrat e përdorur në funksion predikativ shprehin një tipar të sendit, ndërsa ndajfoljet një tipar të veprimit, të procesit.⁶

Lakimi dhe shkallëzimi:

Në vijim, në nënkapitullin “*Zu den Kategorien des Adjektivs*”, autorët i trajtojnë kategoritë e mbiemrit: formimin e gjinisë, të numrit e të rasës, duke paraqitur parime teorike e rregulla por dhe shumë shembuj konkretë që e lehtësojnë kuptimin e rregullave dhe e bëjnë këtë gramatikë shumë konkrete. Te lakimi i mbiemrave (f. 324–329), ata e japin një pasqyrë të lakimit të mbiemrit atributiv të nyjshëm dhe të panyjshëm në pozitë normale [emër + mbiemërë (‘Attributives Adjektiv in Normalstellung’)⁷ si dhe në pozitë të shënjuar [mbiemër + emërë (‘Attributives Adjektiv in markierter Stellung’), duke sqaruar në detaje çdo veçori e karakteristikë të mbiemrit gjatë lakimit, por edhe përjashtimet e mundshme.⁸

Në një nënkapitull të veçantë “*Graduierung der Adjektive*”, ata shtjellojnë kategorinë e shkallës së mbiemrit. Buchholz/Fiedler dallojnë: (a) shkallën pohore (‘Positiv’), (b) ekuativin (‘Äquativ’) (apo shkalla kraha-

⁶ E sa i përket përdorimit adverbial të mbiemrave të gjuhës gjermane, Hentschel/Weydt (2013: 190) theksojnë se në këtë funksion mbiemri normalisht i referohet foljes dhe në aspektin sintaksor këtu bëhet fjalë për të ashtuquajturën “ndajfolje mbiemërore” (“Adjektivadverb”). Lidhja me foljen, sipas tyre, mund të sqarohet përmes transformimit si në shembullin në vijim *Donald singt falsch*. Mbiemri mund të përdoret si atribut i infinitivit të emëruar, por jo edhe i kryefjalës: *Donalds Singen ist falsch*. / *Das falsche Singen* (por jo: * *Donald ist falsch*).

Përmes këtij transformimi po ashtu mund të bëhet i qartë edhe dallimi në mes të ndajfoljeve të mirëfillta dhe ndajfoljeve mbiemërore: ndajfoljet nuk lakohen dhe kështu nuk lejojnë përdorimin atributiv para emrave. (krh. *Er singt gern* **Das gerne Singen*).

⁷ Buchholz/Fiedler (1987: 320) gjatë shtjellimit të lakimit të mbiemrave i përmendin edhe disa mbiemra të nyjshëm njërrrokësh që ata i quajnë “të çrregullt” (*ein Stammige “unregelmäßige” Adjektive*), te të cilët përveç dallimeve të zakonshme në nyjen e përparme paraqiten edhe ndryshime në temën e mbiemrave: *i keq/e keqe - të këqij/të këqija*. Sipas Stolz et.al. (2012: 15), Buchholz/Fiedler qëllimisht fjalën “unregelmäßig” e kanë vendosur në thonjëza, “to mark the crucial term *unregelmäßig* ‘irregular’ as special”.

⁸ Si në shumicën e gjuhëve gjermanike, mbiemri atributiv në gjermanisht është i prapavendosur dhe në këtë pozitë edhe i merr mbaresat flektive të rasës, numrit e gjinisë. Në Raste të rralla disa mbiemra në gjuhën gjermane mund të përdoren si të paravendosur, por në këtë pozitë mbiemri nuk lakohet.

sore e barazisë), (c) shkallën krahasore ('Komparativ') (te shkalla krahasore veçojnë dy nënshkallë: shkallën krahasore të sipërisë relative ('Komparativ der relativen Überlegenheit') dhe shkallën krahasore të ultësisë relative ('Komparativ der relativen Unterlegenheit') dhe (ç) shkallën sipërore, në kuadër të së cilës e trajtojnë edhe elativin ('Elativ'). Pra, shkalla krahasore e barazisë, për dallim nga gramatika akademike, në të cilën kjo shkallë jepet si nënshkallë e shkallës krahasore, Buchholz/ Fiedler e japin atë si shkallë të veçantë nga krahasorja e nga pohorja. Ndërsa në gramatikat gjermane ekuativi jepet si nënshkallë e shkallës pohore, pasi që mbiemri në ekuativ (njësoj si në shqip) nuk shprehet me ndonjë tregues morfologjik, por paraqitet si në shkallën bazë të mbiemrit. Derisa në gjuhën shqipe mbiemrat nuk kanë forma të çrregullta gjatë shkallëzimit, në gjuhën gjermane një numër i caktuar i mbiemrave marrin forma supletive gjatë shkallëzimit: *gut-besser-am besten*. Stolz et.al. (2012: 15) theksojnë se format e çrregullta të pjesëve të ligjëratës hasen jo vetëm në gjuhët indoevropiane të Evropës por edhe në shumë gjuhë jo të afërta me gjuhët indoevropiane që fliten jashtë "Botës së vjetër" ("the Old World"): "Irregularity is a globally attested phenomenon, which does not seem to be genetically biased."⁹

Valenca e mbiemrave

Gramatika moderne dependenciale dhe teoria e valencës kanë një histori hulumtimi rreth 60 vjeçare.¹⁰ Gramatika dependenciale dhe teoria e valencës janë pjesë e përshkrimit të gjuhës gjermane dhe paraqesin një fazë të rëndësishme të zhvillimit të gjuhësisë gjermane. Valenca e foljeve dhe e klasave të tjera (emrave, mbiemrave, parafjalëve) është hulumtuar në më-

⁹ Stolz et.al. i kanë analizuar 100 gjuhë evropiane lidhur me përdorimin e formave supletive të mbiemrave gjatë shkallëzimit dhe kanë ardhur në përfundim që 49 gjuhë që fliten në Evropë nuk kanë forma supletive, prej tyre 9 gjuhë janë indoevropiane. Ndër gjuhët indoevropiane pa forma supletive të mbiemrit gjatë shkallëzimit ata e përmendin edhe gjuhën shqipe (2012: 25). Sipas tyre, shqipja si pjesë e Sprachbundit të Ballkanit, "has an incidence of zero and thus conforms to the pattern of Macedonian, Bulgarian, Romanian and Arumanian". Ndërsa shumica e gjuhëve jo-indoevropiane, te të cilat hasen dëshmi për format supletive, i kanë dy mbiemra supletivë (Stolz et. al. 2012: 29).

¹⁰ Themelues i gramatikës moderne dependenciale dhe i teorisë së valencës (që është e lidhur ngushtë me gramatikën dependenciale) është *Lucien Tesnière* (1893–1954), vepra themelore e të cilit "*Éléments de syntaxe structurale*" u botua pas vdekjes më 1959.

nyrë shteruese në gjuhësinë gjermane dhe parimisht në secilën gramatikë të gjuhës gjermane trajtohet në detaje kjo kategori sintaksore e këtyre klasave fjalësh. Pra, tiparin e valencës (reksionit) nuk e kanë vetëm foljet, por edhe parafjalët si dhe një numër i emrave e i mbiemrave kanë aftësi të drejtojnë rasi të caktuara (me a pa parafjalë). Sipas Zifonun/Hoffmann/Strecker (1997: 48) mbiemrat e gjuhës gjermane, njësoj si foljet e plota mund të kenë tiparin e ‘valencës’, dmth. “sie eröffnen Leerstellen, die durch Komplemente einer bestimmten Art zu füllen sind”¹¹, p.sh.:

eine **des Japanischen** mächtige Frau plotës i rasës gjinore (“Genitivkomplement”)

war **seinem Vater** böse plotës i rasës dhanore (“Dativkomplement”)

ist **die viele Arbeit** satt plotës i rasës kallëzore (“Akkusativkomplement”)

der **für alles** aufgeschlossene Richter plotës parafjalor (“Präpositivkomplement”)

Mbiemrat e gjuhës gjermane mund të jenë njëvalentë, dyvalentë (me argumente të obligueshme) dhe trevalentë (me argumente fakultative). Pra, njësoj si foljet, mbiemrat mund të drejtojnë rasi të caktuara (rasën kallëzore, dhanore, gjinore) dhe një parafjalë (bashkë me një plotësor në rasë të caktuar) (krh. Heidolph/Flämig/Motsch 1981: 618-621; Helbig/ Buscha 2001: 288-290; DUDEN 4 2009: 361).¹² Pra, ka mbiemra të tillë që e drejtojnë emra në “casus obliquus” (gjerm. “obliquer Kasus”¹³) dhe të tillë që e drejtojnë një grup parafjalor.

Në gramatikën e Buchholz/Fiedler nuk mungon shtjellimi i valencës së mbiemrave që autorët e quajnë “Rektion der Adjektive”. Nën titullin “Syntaktische Kontexte der Adjektive” (“Kontekste sintaksore të mbiemrave”) trajtohet për herë të parë në gramatikat e shqipes në mënyrë të thelluar valenca e mbiemrave të shqipes (ff.338-342). Sipas autorëve, si në

¹¹ “Mbiemrat hapin vende të zbrazëta, të cilat duhet të plotësohen me plotës (komplementë) të llojeve të ndryshme.”

¹² Megjithatë, sipas Fuhrhop/Thieroff (2005: 315), valenca të mbiemrat është më ndryshe se të foljet. Ata theksojnë se derisa gati të gjitha foljet kanë valencë dhe kanë komplementë të obligueshëm, shumica e mbiemrave nuk marrin komplementë, pra një numër më i vogël i mbiemrave kanë një komplement.

¹³ Në gramatikën tradicionale bëhet dallim në mes të rasës “casus rectus” (emërorja) dhe “casus obliquus”. Sipas leksikonit Metzler-Lexikon (2016: 115), “casus obliquus” do të thotë “rasë e varur”. Rasat “casus obliquus” janë rasat pa rasën emërore (gjinorja, dhanorja, kallëzorja...) që drejtohen nga valenca e një foljeje, parafjale a mbiemri.

përdorim atributiv ashtu edhe në atë predikativ, mbiemrat, njësoj si foljet, kanë aftësi që të drejtojnë rasën gjegjësisht parafjalën (a parafjalët) e grupit nominal ose të sintagmës parafjalore (grupit parafjalor), të cilët varen prej valencës së këtyre mbiemrave.

Si argumente (të obligueshme a fakultative) të mbiemrave autorët theksojnë se mund të jenë:

një mbiemër (pas mbiemrave të panyjshëm që emërtojnë ngjyra, si *blu*, *jeshil* etj. për të shprehur nuanca të ngjyrave: *jeshil i errët* ‘dunkelgrün’, *blu e mbyllur* ‘dunkelblau’);

një numëror themelor (në kombinim me mbiemrin *vjeç-e*: *Vajza e saj është dy vjeçe*. ‘Ihr Mädchen ist zwei Jahre alt.’);

një konstrukcion foljor ((a) i realizuar me anë të lidhore: *Jam e vendosur të hyj në provim*. ‘Ich bin entschlossen, die Prüfung abzulegen.’; apo (b) i realizuar me anë të konstrukcionit *për të* + pjesorja: *një njeri i etur për të lexuar* ‘ein lesehungriger Mensch’);

një fjali e varur (te mbiemrat predikativë, p.sh. *Ai është i bindur se do ta kryejmë* ‘Er ist überzeugt, dass wir es schaffen werden.’);

grup nominal në rasën dhanore (te mbiemrat në përdorim predikativ: *Autori u mbeti besnik parimeve të veta*. ‘Der Autor blieb seinen Prinzipien treu.’);

grup nominal në rasën gjinore (te mbiemri *i zoti* në përdorim predikativ: *Agimi është i zoti i gojës*. ‘Agim ist redegewandt.’);

rrethor që tregon përmasa (zakonisht i paravendosur: *Kanë ngritur një mur katër metra të lartë* ‘Man hat ein vier Meter hohe Mauer errichtet.’);

por mund edhe të vendoset pas mbiemrit, si: *sportist i gjatë 1 m e 85 centimetra* ‘ein 1,85 m großer Sportler’);

ndërtim krahasues (i përbërë nga lidhëza *sa* dhe një grup nominal në emërore: *një gështenjë e madhe sa grushti* ‘eine faustgroße Kastanie’);

ndajfolje (*ëmbëlsisht i pikëlluar* ‘süß bekümmert’, *me rrugën e ndriçuar zbehtë* ‘auf der matt erleuchteten Straße’; *përherë i gëzuar* ‘immer heiter’; *i vendosur prapa* ‘hinter gestellt’).

Sipas këtyre studiuesve të shqipes edhe sintagmat parafjalore (Prä-

positionalgruppen) në kontekste të caktuara sintaksore mund të përdoren si argumente të mbiemrave (qoftë prejpjesorë qoftë të parmë) me role të ndryshme tematike. Ata pohojnë që te disa mbiemra prejpjesorë sintagma parafjalore nuk është e kushtëzuar nga valenca e mbiemrave dhe këto grupe parafjalore “paraqesin refleksin e plotësive të ndryshëm sintaksorë, që mund të jenë fakultativë ose të lirë”. P.sh.:

i vendosur nga komisioni ‘von der Kommission beschlossen’ (nga + GNNom);

i banuar prej shqiptarëve ‘von Albanern bewohnt’, *i ndërtuar prej vitesh* ‘vor Jahren erbaut’ (prej + GNAbI);

i mbuluar me gurë ‘mit Steinen bedeckt’, *i shtruar me pllaka mermeri* ‘mit Marmorplatten ausgelegt’ (me + GNAkk);

i dobët para vështirësive ‘schwach gegenüber Drohungen’ (para + GNAbI);

i informuar mbi gjendjen ‘informiert über die Lage’ (mbi + GNAkk), etj..

Autorët më tutje vënë në dukje se sintagma parafjalore që kushtëzohet nga reksioni i mbiemrave mund të jetë e obligueshme, si p.sh. *Ky tregim është i ngjashëm me të parin*. ‘Diese Erzählung ist der ersten ähnlich’, por në shumë raste sintagma parafjalore është fakultative, si p.sh. *Agimi është i sjellshëm (me të gjithë)*. ‘Agim ist (zu allen) höflich.’ Te një numër i mbiemrave, për të cilët ekzistojnë edhe foljet me temë të njëjtë leksikore, reksioni i mbiemrit është i njëjtë me atë të foljes gjegjëse, p.sh. *mësohet me* ‘sich gewöhnen an’: *i mësuar me ambientin* ‘an die Umgebung gewöhnt’; *ngjan me* ‘ähneln’: *i ngjashëm me* ‘ähnlich’. Mbiemrat që, sipas tyre, e drejtojnë një sintagmë parafjalore, janë:

*drejt*_{AbI}: *i orientuar drejt realizimit* ‘auf die Verwirklichung orientiert’;

*mbi*_{Akk}: *i informuar mbi gjendjen* ‘informiert über die Lage’;

*me*_{Akk}: *i rreptë me fëmijët* ‘streng (zu/gegenüber) den Kindern’;

*ndaj*_{AbI}: *i rreptë ndaj dobësive* ‘unnachgiebig gegen (über) Schwächen’;

*në*_{Akk}: *i frikshëm në punë të tilla* ‘ängstlich in solchen Dingen’, *i zhytur në mendime* ‘gedankenversunken’;

*nga*_{Nom}: *i madh nga mosha* ‘erwachsen’, ‘alt’, ‘groß’, *i vogël nga (trupi/shtati)* ‘klein (von Wuchs)’

*para*_{AbI}/*përpara*_{AbI}: *i pamposhtur para vështirësive* ‘unnachgiebig gegen(über) Schwierigkeiten’, *i dobët përpara kërcënimeve* ‘schwach gegenüber Drohungen’;

*pas*_{AbI}: *i kapur pas brirëve* ‘bei den Hörnern gepackt’, *i dhënë pas qejfeve* ‘vergnügung-süchtig’;

*për*_{Akk}: *fatal për autorin* ‘fatal für den Autor’, *i ngushtë për makina* ‘eng für Autos’;

për_{Abi}: i kapur për flokësh 'bei den Haaren gepackt', i kapur për mënge 'am Ärmel ergriffen', prej_{Abi}: i përbërë prej shumë pjesësh 'aus vielen Teilen bestehend'.

3. Gerd-Dieter Nehring për fjalëformimin e mbiemrit të shqipes

Gjuhëtari gjerman G.D. Nehring ka botuar një numër të konsiderueshëm të artikujve e të studimeve për gjuhën shqipe si në revista të ndryshme shqipe ashtu edhe në ato gjermane. Përveç studimeve të shumta për çështjet e standardizimit të shqipes, ky autor ka botuar edhe studime të numërta rreth fjalëformimit të mbiemrit të shqipes, me fokus të veçantë për mbiemrat e përbërë nga dy e më shumë tema semantike (kompozitat mbiemërore). Në disa punime të viteve të mëparshme (1982, 1984, 1985) ai u mor me përshkrimin e strukturës formale dhe semantike të mbiemrave të përbërë të shqipes. Nehring-u konstatonte se mbiemrat e përbërë nga dy a më shumë temash autosemantike janë shumë të rëndësishëm për procesin e formimit të nocioneve të reja në gjuhën shqipe dhe këta mbiemra i konsideronte si elemente kryesore të fjalëformimit në shqip (Nehring 1982: 107). Sipas tij, në punimet gjuhësore shqiptare përshkrimi i mbiemrave të përbërë prej dy a më shumë temash autosemantike bëhej kryesisht sipas pikëpamjeve formale dhe ai mendon që “me rëndësi për përshkrimin e tyre është që të merren parasysh jo vetëm pikëpamjet formale, por edhe semantike” (1982: 110). Thelbi i funksionit semantiko-sintaktik i klasës së mbiemrave qëndron, sipas tij, në atë se “mbiemrat e përbërë mund të emërtojnë zakonisht disa veçori dalluese, d.m.th. ato janë të kombinuara (kr. *argjiloranor, flokëzi, luleshumë, pesëditësh, pesë- dhe gjashtëkatësh* etj), ata emërtojnë veçori esenciale të një objekti (kr. *ngrohtësiizolues*)” (1982: 110). Nehringu trajtoi edhe klasifikimin e kompozitave mbiemërore sipas tipave kryesorë funksionalo-semantikë të fjalëformimit. Ai aplikon modelin e klasifikimit të formimeve të prejardhura sllave dhe gjermane për të klasifikuar kompozitat mbiemërore shqipe, që përbëhen nga dy tema. Duke u bazuar në tipat kryesorë të fjalëformimit, “mutacionit”¹⁴, “modi-

¹⁴ Nën termin “mutacion” përfshihen ata tipa të fjalëformimit, te të cilët kuptimi i leksemës së re (fjalës së motivuar) dallohet qartë nga kuptimi i fjalëve motivuese

fikimit”¹⁵ dhe “transformimit (apo fjalëformimit sintaksor)”¹⁶, ai dallonte këta tipa kryesorë të formimit të kompozitave mbiemërore të shqipes: I. mutacion, II. mutacion – modifikim, III. transmetim – modifikim, IV. transmetim – mutacion, V. modifikim, VI. transmetim (Nehring 1984).

Në disa punime të tij, Nehring-u e trajton fjalëformimin e mbiemrit të shqipes në përfaqje me gjuhët sllave jugore. Në studimin “*Zur Bildung adjektivischer Zusammensetzungen im Bulgarischen, Serbo-Kroatischen und Albanischen*” (1996) ai i trajtoi veçoritë themelore të fjalëformimit të mbiemrave të përbërë prej dy temash të gjuhës shqipe dhe e krahasoi atë me fjalëformimin e mbiemrave të përbërë të bullgarishtes dhe të serbishtes e kroatishtes, duke i gjetur ngjashmëritë dhe tiparet specifike të tyre. Sipas tij, këta mbiemra në gjuhën shqipe përdoren kryesisht në gjuhën e shkruar, në tekste shkencore e jo shkencore (sidomos në publicistikë e në beletristikë). Ai thekson që formimi i mbiemrave të përbërë është shumë produktiv si në shqipen e sotme ashtu edhe në bullgarishte e serbishte e kroatishte. Ndërsa sa i përket modeleve për formimin e mbiemrave të përbërë, ai konstaton se numri i modeleve për formimin e këtyre mbiemrave me anë të kompozimit, si dhe kompozim dhe prapashtesë, është më i madh në gjuhët sllave jugore se sa në shqip. Për dallim nga bullgarishtja e serbishtja e kroatishtja në gjuhën shqipe haset edhe përngjitja si mënyrë e fjalëformimit, p.sh. *i sapomartuar* (-/, gerade/, verheiratet‘) ,jungvermählt‘.

Dallimet kryesore morfematike në formimin e mbiemrave të përbërë të këtyre gjuhëve janë:

1. Përdorimi i elementit lidhës (“Kompositionselement”) (në shqip vetëm te 7% e të gjithë mbiemrave të përbërë, në bullgarisht e serbisht e kroatisht gati se te të gjithë mbiemrat e përbërë);

2. Te shumica e kompozitave determinative të gjuhëve sllave të jugut radhitja e elementeve është determinans para determinatum (elementi përcaktues i pari, elementit i përcaktuar i dyti), por jo edhe në kompozitat e shqipes (p.sh.: *flokëzi* [,Haare/ -schwarz‘ë ,schwarzhaarig‘; *lulekëmbanor*

¹⁵ “Thelbi i këtij tipi qëndron në faktin se përmbajtjes së një nocioni nistor të dhënë i shtohet një tipar plotësues, një komponent kuptimor modifikues.” (Nehring 1984: 127)

¹⁶ “Tipi i transmetimit përfshinë të gjitha njësitë gjuhësore jo të para, të cilat pësojnë shndërrime gjatë formimit të tyre vetëm për nga pjesa e ligjëratës e fjalës motivuese. Kuptimi leksikor i tyre mbetet i pandryshuar.” (Nehring 1984: 127)

[,Blüte/ Glocke‘ë ,glockenblütig‘).

Ndërsa në rrafshin semantik Nehring-u (1996: 287) konstaton shumë ngjashmëri në mes të këtyre gjuhëve, sidomos në formimin produktiv të mbiemrave ekzocentrik, posesiv dhe të mbiemrave marrëdhëniorë (të tipit: *demokratiko-borgjez* ,bürgerlich-demokratisch‘, *tekniko-shkencor* ‘wissenschaftlich-technisch‘). Korrespondencat hasen në përdorimin e komponentëve të përbashkët të fjalëformimit, të cilat varen nga veçoritë leksikore-semantike të temave motivuese dhe nga kuptimi i formanteve fjalëformues. Sipas tij, këto gjuhë kanë ngjashmëri edhe në kombinimin e komponentëve fjalëformues të kompozitat determinative. Autori paraqet një pasqyrë të komponentëve fjalëformues të mbiemrave cilësorë të gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbe/kroate (Nehring 1966: 288):

Kuptimi i fjalëformimit ("Wortbildungsbedeutung")	Shembuj në gjuhën shqipe	Shembuj në gjuhën serbe/ kroate
akcional ("aktional")	- <i>dashamirë</i> - <i>mishngrënës</i> . - <i>shqipfolës</i>	- <i>čudotvoran</i> - <i>jednakozvučan</i> - <i>lomovratan</i> - <i>samodopadan, vrtoqlav, zlošlut</i>
komparativ (ngjashmëri "Ähnlichkeit")	- <i>i blertë-preshi</i> - <i>hundëshkabë</i> - <i>zemërngjashëm</i>	- <i>gromoglasan</i> - <i>zmijoglav</i>
ornativ (prania, ekzistenca "Vorhandensein")	- <i>dykatësh</i> - <i>i tërëfuqishëm</i> - <i>sheqermbajtës</i>	- <i>dvočlan</i> - <i>malokrvan</i> - <i>plavook</i>

4. Përfundim

Në këtë punim kam bërë përpjekje që të pasqyroj studimet e gjuhëtarëve gjermanishtfolës O. Buchholz dhe W. Fiedler si dhe G.D. Nehring për mbiemrin e shqipes. Në "Albanische Grammatik" të Buchholz/Fiedler, e cila sot e kësaj dite konsiderohet si një ndër grammatikat më të rëndësishme dhe më të plota të shqipes, mbiemri trajtohet në mënyrë të thukët dhe mjaft shkencërisht. Të gjitha kategoritë e mbiemrit, çështjet morfologjike, semantike e sintaksore të tij, paraqiten dhe analizohen në mënyrë të detajuar dhe shteruese dhe çdo gjë argumentohet në mënyrë shkencore. Këta autorë, siç e theksuam edhe më lart, për herë të parë në grammatikat e shqipes trajtojnë edhe valencën e mbiemrave. Ata konstatojnë se, njësoj si foljet, edhe emrat e mbiemrat kanë valencë, pra kanë aftësi që të drejtojnë

rasën gjegjësisht parafjalën e grupit nominal ose të sintagmës parafjalore. Mendojmë që, tiparet kontekstuale të mbiemrit do të duhej të trajtohen edhe në gramatikat e tjera të gjuhës shqipe. Ndërsa për fjalëformimin nuk flitet fare në gramatikën “Albanische Grammatik”. Sa i përket fjalëformimit të mbiemrit në këtë punim janë paraqitur rezultatet e studimeve të konsiderueshme të G.D. Nehring për këtë klasë fjalësh. Në artikujt dhe studimet e këtij studiuesi një vend të konsiderueshëm zënë punimet në fushën e albanologjisë. Vlera dhe rëndësia e studimeve për shqipen në përgjithësi e paraqesin Gerd-Dieter Nehring një studiues serioz shkencor, të cilat kanë merita mjaft të mëdha për njohjen dhe përhapjen e gjuhës e të kulturës shqiptare në vendet gjermanofolëse dhe më gjerë. Nehring-u ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë aktiv edhe në fushën e studimeve ballkanike.

5. LITERATURA

Literatura primare:

Buchholz, Oda / Fiedler, Oda (1987): *Albanische Grammatik*. Leipzig.

Punimet e Gerd-Dieter Nehring-ut për fjalëformimin e mbiemrit që janë analizuar për qëllime të kësaj kumtese janë:

- *Rreth disa çështjeve të përshkrimit sinkron të mbiemrave të përbërë të gjuhës shqipe*. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Nr. 7. Prishtinë 1982. Fq. 107-114.
- *Zur Beschreibung zwei- und mehrstämmiger Adjektive der albanischen Sprache der Gegenwart*. Në: Beiträge zur Erforschung slawischer und anderer Sprachen. Berlin 1983. Fq. 65-74.
- *Zur semantischen und formalen Wortbildungsstruktur zwei- und mehrstämmiger Adjektive der albanischen Sprache der Gegenwart (mit einem allgemein- und fachsprachlichen Wörterverzeichnis als Anhang)*. (Punim disertacioni) Berlin 1983. f. 417.
- *Mbi ndarjen e kompozitave mbiemërore shqipe sipas tipave kryesorë funksionalo-semantikë të fjalëformimit*. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Nr. 9. Prishtinë 1984. Fq. 125-138.
- *Kompozita mbiemërore në fjalorin shqip-greqisht të K. Kristoforidhit*. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Nr. 10. Prishtinë 1985. Fq. 135-148.
- *Adjektivkomposita mit figurativer Bedeutung im modernen Albanischen*. Në: Abstracts der Sektionsvorträge und Rundtischgespräche. XIV. Internationaler Linguistenkongreß. Berlin 1987. Fq. 62.
- *Zur Bildung adjektivischer Zusammensetzungen im Bulgarischen, Serbo-Kroatischen und Albanischen*. Në: ZSlaw. Berlin 41(1996)3. – Fq. 275-294.
- *Hauptknotenpunkte der Wortbildung der albanischen Sprache der Gegenwart im Spiegel (süd-)slawischer Sprachen*. Në: Die südslawischen Sprachen heute. Umbrüche und Aufbruch. Ed. v. B. Kunzmann-Müller. Frankfurt a. M. u.a. 2000. Fq. 169-191. (Berliner slawistische Arbeiten; 12).
- *Morfonološka svojstva gradenja savremenih srpskih pridevskih složenica sa gledišta bugarskog, makedonskog i albanskog jezika*. Në: Reč - morfološki, sintaksički, semantički i formalni aspekti u srpskom jeziku : Beograd, 7-10. IX. 2005. 16 S. inger. (Naučni sastanak slavista u Vukove dane. 35, 1).
- *Mbi përkthimin e mbiemrave shqip dytemësh me vizë lidhëze në gjuhën gjermane*. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Nr. 8. Prishtinë 1983. Fq. 117-128.
- *Mbi mbiemra të përbërë prej regjistrave të fjalëve shqipe e gjermane nga Rilindja Kombëtare*. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Nr. 13. Prishtinë 1988. Fq. 77-86.

Literatura sekondare:

ASHSH (2002): *Gramatika e gjuhës shqipe*. Morfologjia. Vëll. 1. Tiranë.

- Dudenredaktion (ed.) (2009): *Die Grammatik*. Duden 4. Mannheim.
- Fuhrhop, Nanna/Thieroff, Rolf (2005): *Was ist ein Attribut?* Në: Zeitschrift für germanistische Linguistik 33. S. 306-342.
- Glück, Helmut / Rödel, Michael (ed.) (2016): *Metzler Lexikon Sprache*. Stuttgart: Metzler Verlag.
- Heidolph, E.K. /Flämig, W./Motsch, W. (1981): *Grundzüge einer deutschen Grammatik*. Berlin.
- Helbig, Gerhard / Buscha, Joachim (2001): *Deutsche Grammatik. EinHandbuch für den Ausländerunterricht*. Berlin/ München.
- Henschel, Elke / Weydt, Harald (2013): *Handbuch der deutschen Grammatik*. Berlin/ Boston.
- Memisha, Valter (2007): *Rreth mbiemrave prejpesorë në shqipe dhe në greqishte*. Në: Studime Filologjike. Nr. 3-4. Tiranë. Fq. 59-71.
- Stolz, T. / Otsuka, H. / Urdze, A. / van der Auwera, J. (2012): *Introduction: Irregularity – glimpses of a ubiquitous phenomenon*. Në: Stolz, T./ Otsuka, H. / Urdze, A. / van der Auwera, J. (ed.): *Irregularity in Morphology (and beyond)*. Berlin: Akademie Verlag GmbH, Fq.7-37
- Zifonun/Hoffmann/Strecker (1997): *Grammatik der deutschen Sprache*. Berlin/New York: De Gruyter

Jonida XHYRA-ENTORF, München

PËRTHYERJE TË KULTIVUARA NË ALBANOLOGJI: MARIE AMELIE VON GODIN

Vetiaqja përkundrejt të huajës si pikënisje

“Shumë e nderuar dhe e dashur baronesha Godin, ... ashtu si ritakimi, ynë gjithçka në Mynih, madje edhe në Gjermani, kaloi kaq shpejt dhe në mënyrë të vagullt, sa përjetimi nuk arriti të fiksohet, por mbeti pas si një ëndërr, dhe shpirti ma do që më mirë gjithçka ta kem parë në ëndërr.”¹ Këto rreshta i përkasin një letre që Thomas Mann ia dërgon baroneshës Marie Amelie von Godin (1882-1956) në Mynih, pikërisht asaj baroneshe, emri i së cilës në albanologji përmendet rëndom kur është fjala për përkthimin e Kanunit në gjermanisht. Letra e panjohur për gati gjysmë shekulli botohet në vitin 2003 nga studjuesi Klaus Jonas.

Me rastin e 200-vjetorit të lindjes së Goethe-s, Thomas Mann vjen për herë të parë në Gjermani, konkretisht edhe në Mynih, pas 16 vitesh të kaluara në eksil. Ritakimi me baroneshën ndodh pikërisht në një nga aktivitetet e rastit gjatë vizitës së tij në Mynih, në darkën e organizuar për nder të çiftit Mann në bashkinë e qytetit.

Studiuesi Klaus Jonas, që ndjek hap pas hapi gjurmët dokumentuese deri në letrën që Thomas Mann i shkruan Godin-it më 17 shtator 1949, i referohet fillimisht ditarit të Thomas Mann-it, duke tërhequr vëmendjen për një shënim të së njëjtës datë, në të cilin ky i fundit e udhëzon sekretaren e tij, që letra t'i dërgohet “e shkruar me shkrim dore” baroneshës Godin në Mynih.² Njohja e Godin-it me Thomas Mann-in zë fill me punën e tyre të përbashkët në “Shoqatën për mbrojtjen e shkrimtarëve gjermanë”³ në Ba-

¹ Jonas, M. Klaus: Thomas Mann und Marie Amelie von Godin. Versuch einer Dokumentation. In: Literatur in Bayern. Nr. 73, München, 2003, f. 31.

² Mann, Thomas: Tagebücher 1949-1950. Herausgegeben von Inge Jens. Frankfurt am Main, 1991, S. 99.

³ Schutzverband deutscher Schriftsteller Gau Bayern.

vari, në kryesinë e të cilës ata zgjidhen të dy në vitin 1929 dhe bashkëpunojnë deri në vitin 1933, vit në të cilin Thomas Mann mërgon në Zvicër.

Në albanologji emri i Godin-it lidhet kryesisht me përkthimin e Kanunit⁴ dhe botimin e fjalorit gjermanisht-shqip⁵ të vitit 1930. E ndeshim disa herë të cituar në kujtimet e Eqrem bej Vlorës⁶, kurse në vitin 2010 lexuesit shqiptar i jepet mundësia të ketë në dorë skicën historike “Ndhimesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri”⁷, shkruar në bashkëpunim të pjesshëm me këtë të fundit. Libri i saj “Nga Shqipëria e re”⁸ është përkthyer ndërkohë tre vjet më parë për lexuesin shqiptar. Përpara botimit të këtij libri në gjermanisht në vitin 1914, autorja e kishte filluar ndërkohë aktivitetin e saj letrar dhe intelektual⁹, aktivitet të cilin e vijoi për gati gjysmë shekulli dhe, ç’ka ka mbetur pothuajse e panjohur, jo vetëm me botimin e fjalorit dhe përkthimin e Kanunit, dhe jo vetëm duke pasur si objekt realitetin shqiptar të gjysmës së parë të shekullit 20, por dhe atë bavarez.

Një dokumentim i plotë e pa boshllëqe i figurës së baroneshës është po aq i mundimshëm sa persiatjet tutje e tëhu në dokumentacionin e kohës, të përshkruara nga studiuesi Klaus Jonas lidhur me letrën e Thomas Mann-it, dhe kërkojnë zhdërvjellësi intelektuale që përfshin disa fusha njëherësh.

Ndërmarrja e një udhëtimi nga një femër në fillim të shekullit të 20-

⁴ Godin von, Marie Amelie: Der Kanun. Das albanische Gewohnheitsrecht nach dem sogenannten Kanun des Lekë Dukagjini. Kodifiziert von Stefan Gjecovi. Mit einer Einführung von Michael Schmidt-Neke. Herausgegeben mit Vorwort und Bibliographie von Robert Elsie. Dukagjini, Peja, 2001.

⁵ Godin von, Marie Amelie: Wörterbuch der albanischen und deutschen Sprache. Band I: deutsch-albanisch. LHarrassowitz, Leipzig, 1930.

⁶ Vlorë bej, Eqrem: Vlorë: Kujtime. Vëllimi i parë (1885-1912). Bota shqiptare 3. Përktheu në shqip Afrim Koçi SHLK, Tiranë, 2001; Kujtime. Vëllimi i dytë (1912-1925). Bota shqiptare 3. Përktheu në shqip Afrim Koçi SHLK, Tiranë, 2001

⁷ Vlorë bej, Eqrem bej & Godin von, Marie Amelie: Ndhimesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri. Skicë historike. Pjesa e parë. Përktheu në shqip Afrim Koçi. Shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2010; Ndhimesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri. Skicë historike. Pjesa e dytë. Përktheu Afrim Koçi. Shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2010;

⁸ Godin von, Marie Amelie: Nga Shqipëria e re. Botimet Koçi, Tiranë, 2007.

⁹ Godin von, Marie Amelie: Sonne des Südens. Novellen. Bachem, Köln, 1908; Nicht unser Sohn. Roman. Habel, Regensburg, 1908; Benedetta. Roman. Bachem, Köln, 1909; Alte Paläste. Bachem, Köln, 1910; Aus dem Lande der Knechtschaft. Albanische Novellen. Josef Roller, Wien, 1913.

të e kapërcente gjithsesi kuadrin e roleve të fiksuara shoqërisht për një ndërmarrje të tillë. Përmes udhëtimit të saj të largët në Lindjen e Afërme në moshën 22 vjeçare, baronesha bavareze Marie Amelie von Godin qysh në pikënisje të jetës së saj dilte jashtë kornizave konvencionale të kohës në pozicionimin shoqëror si femër, lidhur me një aktivitet që edhe në prag të shekullit të 20-të rëndom kryhej nga meshkujt. Interesi i saj për Shqipërinë merr shkas nga udhëtimi i mësipërm. Udhëtimi i saj i parë në Shqipëri aso kohe ishte udhëtim në një vend në të cilin nuk ishte e zakonshme të shkoje si turist, qoftë edhe si mashkull.

E panjohura dhe inkuadrimi në Perandorinë Osmane kishin tjerre tashmë në Europën Perëndimore një imazh plot paragjykime për Ballkanin dhe konkretisht për Shqipërinë.¹⁰ Inisiativa personale dhe organizimi personal i një udhëtimi të tillë shpesh kishin si rezultat një kontribut nismëtar për një botë ose një aspekt deri atëherë të pazbuluar të saj. Udhëtimi si i tillë parakupton lëvizjen nga e njohura drejt së panjohurës, duke gjeneruar kështu ndryshimin në vijueshmëri të raporteve mes vetiakes dhe të huajës.¹¹ Kjo pikënisje është shumë e rëndësishme për të rrokur personalitetin e një intelektualeje në kapërcyell të shekujve dhe në vijim, kontributi i së cilës, megjithë rëndësinë e padiskutueshme të fjalorit dhe përkthimit të Kanunit, shkon përtej tyre në përrhyerjet e tij të kultivuara në albanologji.

Një intelektuale në kapërcyell të shekujve

Në një hark kohor prej 30 vjetësh, duke nisur nga viti 1908, Godin-i ndërmori shumë udhëtime, shpesh edhe afatgjata, në Shqipëri. Rasti fatlum e solli që qysh në pikënisje kontaktin me Shqipërinë, baronesha e pajisur me dhuntinë e vyer për të mësuar shpejt gjuhë të huaja, ta ketë me përfaqësues të elitës kulturore shqiptare të kohës, duke renditur në krye Eqrem bej Vlorën, me të cilin ajo pati një bashkëpunim të frytshëm intelektual gjatë gjithë jetës. Tre vjet pas botimit të fjalorit, në një revistë të kohës, në

¹⁰ Arapi, Lindita: *Wie Albanien albanisch wurde. Rekonstruktion eines Albanienbildes.* Tectum, Marburg, 2005, f. 65.

¹¹ Ohnesorg, Stefanie: *Mit Kompaß, Kutsche und Kamel. (Rück-) Einbindung der Frau in die Geschichte des Reisens und der Reiseliteratur.* Röhrig Universitätsverlag, St. Ingbert, 1996, f. 26.

vitin 1933, Godin-i duke folur për zanafillën e kësaj ndërmarrjeje leksikografike, rrëfen si ka mësuar shqip dhe se si njohuritë e saj gjuhësore për shqipen qysh prej vitit 1909 i ka organizuar në lista fjalësh dhe skeda. Një ndërgjegjësimit intelektual që për fat të mirë vlerësohet dhe përkrahet po aq intelektualisht. Pikërisht Eqrem bej Vlora i jep asaj idenë në vitin 1913, që shënimeve të mësipërme t'u japë formën e një fjalori shqip-gjermanisht, duke qenë se akoma nuk ekzistonte një i tillë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Megjithëse në atë kohë baronesha ende nuk ishte e vendosur për një ndërmarrje të tillë, ajo e vijoi punën me listat dhe skedat me synimin që të fiksonte "pasurinë gjuhësore të të gjitha të folmeve në një formë të mesme ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes", duke vërejtur më pas që pikërisht kjo e fundit "mori formën e gjuhës së shkruar shqipe pas viteve të luftës."¹²

Godin-i nuk ishte thjesht njohëse e shkëlqyer e gjuhës dhe e vendit, por dëshmitare okulare e ngjarjeve të rëndësishme historike në Shqipërinë e gjysmës së parë të shekullit të 20-të dhe reportere e drejtpërdrejtë e këtyre ngjarjeve.¹³ Aktiviteti i saj i shumanshëm intelektual dhe shoqëror si gazetare, shkrimtare, diariste, përkthyes, historiane, publiciste, piktore, leksikografe, aktiviste në lëvizjen për emancipimin e gruas dhe bamirëse, ravijëzon një portret intelektual që nuk ishte aspak i zakonshëm për një femër në vigjilje të shekullit 20.

Në vitin 1900 popullsia e Mynihut numëronte një gjysmë milioni banorë dhe gjurmët e industrializimit ishin të pranishme kudo. Në shoqërinë e gjysmës së dytë të shekullit 19 rolet ishin të përcaktuara qartë. Mundësitë për një aktivitet intelektual të femrave ishin shumë të kufizuara dhe salloni mbetej kryesisht vendi për një aktivitet të tillë. Në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të në Mynih ekzistonin disa sallone letrare¹⁴, ndër të cilët dhe ai i baroneshës. Salloni i shkrimtares Elsa Bernstein (186-

¹² Godin von, Marie Amelie: Mein Albanisches Wörterbuch. Nē: Die christliche Frau. 31, 1933, f. 182: indem ich das gesamte albanische Sprachgut aller Mundarten zu fixieren strebte in einer Mittelform zwischen Gegisch und Toskisch, die dann ja auch in den Nachkriegsjahren zur albanischen Schriftsprache geworden ist."

¹³ Godin von, Marie Amelie: Aus der albanischen Residenz. Nē: Tägliche Rundschau (Berlin), 3. April 1914, Beilage.

¹⁴ Teibler, Claudia: Münchnerinnen, die lesen, sind gefährlich. Elisabeth Sandman, München, 2010, f. 16-19.

6-1949) në Brienerstrasse vizitohej nga Hugo von Hofmansthal, Franz Stuck, August von Kaulbach dhe pikërisht aty janë njohur me njëri tjetrin Katja dhe Thomas Mann, mysafirë të rregullt të familjes Feuchtwanger, banesa e të cilëve në Georgenstraße, shërbente qysh prej vitit 1915 si pikë takimi për artistë dhe intelektualë të kohës.

Udhëtimet e shumta, për më tepër ato në një vend të tillë ekzotik si Shqipëria, i kishin dhënë Godin-it në Mynih statusin e një “intelektualeje moderne ekzotike”¹⁵ dhe banesa e saj në Marienplatz (Rindermarkt 3) ishte një pikë takimi për mysafirë me interesa të njëjta, ndër të cilët radhitej dhe princesha Theresa e Bavarisë (1850-1925), e përmendur për udhëtimet e saj ekzotike. Kjo e fundit ka qenë disa herë mysafire në sallonin e Godinit dhe ka mbajtur ligjërata për ekspeditat e saj të përmendura deri në zonën polare dhe në shumë vende të Europës, në Azi, në Amerikën e Veriut dhe të Jugut. Në vitin 1890 madje princesha kishte qenë edhe në Shqipëri. Megjithë ndryshimin e madh të moshave, dy intelektualët aristokrate i lidhnin interesa te përbashkëta.

Në kapërcyell të shekujve 19 dhe 20 arsimimi i femrës që vinte nga një shtresë e pasur zhvillohej kryesisht privatisht në shtëpi dhe më pas nëpër institucione, të cilat në programet e tyre synonin pak a shumë përgatitjen për jetën e ardhshme bashkëshortore. Pas arsimimit fillestar, që e merr privatisht bashkë me motrat e vëllezërit e saj, Godini viziton¹⁶ pikërisht një institucion të tillë, sic ishte shkolla e murgeshave në manastirin Sacré Coeur në Riedenburg të Austrisë. Dëshira e saj për të dhënë provimin e maturës në Zvicër, vend në të cilin qysh prej vitit 1864 femrat mund të regjistroheshin edhe si studente të rregullta në universitet, nuk gjeti mbështetjen e prindërve. Në Bavari femrave iu dha mundësia për t’u regjistruar rregullisht në universitet vetëm në vitin 1903. Katja Pringsheim (1883-1980), bashkëshortja e ardhshme e Thomas Mann-it, me të cilën Godini njihej personalisht, ishte një ndër studentet e para të regjistruara në mënyrë të rregullt në Mynih, për më tepër në degët matematikë dhe fizikë.

Përtej sallonit në fokusin kulturor dhe politik të gjysmës së parë të sh. 20

¹⁵ Berger, Manfred: Godin, Amalie (Amelie), Marie (Maria) Julie Anna Freiin von. Në: Biographisches-bibliographisches Kirchenlexikon. Bautz, Traugott (botues). Vëll. XXI, Nordhausen 2003, kol. 489-505.

¹⁶ Berger, M., kol. 490.

Varfërimi i popullsisë pas Luftës së Parë Botërore i dha shkas trazirave politike që ndërthyer gjithë Gjermaninë dhe përgatitën terrenin për Revolucionin e vitit 1918. Lufta e Parë Botërore nuk sollti vetëm të drejtën e zgjedhjes lidhur me pozicionin shoqëror të femrës, por përmes administrimit ekonomik nga ana e tyre gjatë kohës së luftës kur meshkujt ishin në front, edhe hapjen e një perspektive të re lidhur me ushtrimin e profesionit, e cila megjithatë nuk shkonte përtej profesionit të sekretares. Vetëm në vitin 1922, 19 vjet pasi femrat mund të regjistroheshin zyrtarisht në mënyrë të rregullt në universitet për shkenca juridike, atyre ju lejua dhe ushtrimi i profesionit në këtë fushë. Pikërisht në këtë vit 20% e studentëve të regjistruar në universitet ishin femra.

Mbreti i Bavarisë, Ludwig-u i III-të, ishte monarku i parë gjerman që u përmbys pas Luftës së Parë Botërore dhe kalimi i Bavarisë nga monarkia në Republikë, në fazën e parë të revolucionit, u krye pa gjakderdhje. Muajt që pasuan dëshmuuan një përplasje të grupimeve të ndryshme politike, dhe për pasojë edhe të raporteve pushtetare. Pikat kulmore të këtij zhvillimi janë krijimi i Republikës Sovjetike Bavareze dhe shtypja me dhunë e saj nga ana e trupave mbretërore dhe njësisë paramilitare në vitin 1919. Këto zhvillime patën si rrjedhojë mobilizimin e forcave radikale, që në një zhvillim të mëvonshëm do të parapërgatisin puçin e Hitlerit të vitit 1923 dhe më pas ardhjen e tij në pushtet.¹⁷ Lufta e Parë Botërore, Revolucioni Bavarez, Republika e Weimar-it, ardhja në pushtet e Hitlerit dhe Lufta e Dytë Botërore me shkatërrimet dhe ndarjen në zona të Gjermanisë së mundur janë ngjarje të rëndësishme historike për Gjermaninë e gjysmës së parë të shekullit 20, karshi të cilave Godin-i do të reagojë me një ndjeshmëri kritike intelektuale në shumë drejtime.

Viti 1908, kur Godin-i ndërmerr udhëtimin e saj të parë në Shqipëri, përkon ndër të tjera me Kongresin e Manastirit, një ngjarje shumë e rëndësishme për kulturën shqiptare. Kryetarin e zgjedhur të Kongresit, Gjergj Fishtë, Godin-i do ta njohë personalisht më vonë dhe do ta presë në Mynih gjatë udhëtimit të tij në Gjermani. Përgatitja e shpalljes së pavarësisë në vi-

¹⁷ Ky zhvillim i viteve '20 paraqitet shumë qartë nga Lion Feuchtwanger në romanin e tij *Erfolg* (Feuchtwanger, Lion: Erfolg. Drei Jahre Geschichte einer Provinz. Roman. Gustav Kiepenheuer, Berlin 1930).

tin 1912 ishte e shoqëruar nga trazira politike, të cilat mbetën të tilla edhe pas kësaj ngjarjeje dhe përbënin një vështirësi tepër serioze në rrugën për konsolidimin e shtetit të ri shqiptar. Qysh prej Kongresit të Lushnjës në vitin 1920, në një periudhë gati dyvjeçare, në Shqipëri ishin formuar dhe përmbysur tetë qeveri.¹⁸ Ardhja në pushtet e Zogut dhe kalimi i Shqipërisë nga republikë në monarki deri në vitin 1939 lidhet me ndryshime gjithëpërfshirëse, që do të kenë ndikimin e tyre në politikën e brendshme dhe të jashtme të shtetit shqiptar.

Udhëtimin e fundit në Shqipëri Godin-i e ndërmer pikërisht në vitin 1939. Kontributin e saj intelektual lidhur me Shqipërinë ajo do ta vijojë edhe pas këtij viti me përkthime, romane dhe artikuj të ndryshëm. Dome thënës në këtë drejtim janë romani “Vergessen ...?”¹⁹, botuar postum në vitin 1963¹⁹ dhe artikulli “Die katholische Kirche im kommunistischen Albanien”²⁰, botuar në mars të vitit 1954. Baronesha përshkruan në roman ditët e fundit dhe procesin që i bëhet Patër Anton Harapit dhe shoqëruesve të tij, duke vënë në kllapa shënimin: “wörtlich nach dem veröffentlichten Gerichtsbericht” (marrë fjalë për fjalë nga raporti i botuar i gjyqit). Detajet dhe hollësitë e romanit dhe të artikullit më sipër na bëjnë me dije se Godin-i deri në fund të jetës së saj ishte në dijeni të ngjarjeve dhe zhvillimeve politike në Shqipëri, për aq sa ishte e mundur kjo gjë, dhe vazhdoi të kontribuojë duke mbajtur një qëndrim intelektual kritik.

E formuar si intelektuale në kapërcyell të shekujve, kryesisht në mendësinë e Rrepublikës së Weimar-it, Godin-i do të veprojë brenda kësaj mendësie në të gjithë aktivitetin e saj intelektual, si në Gjermani, ashtu edhe në Shqipëri. Republika e Weimar-it,²¹ përmes shfaqjeve ambivalente,

¹⁸ Bartl, Peter: Albanien. Vom Mittelalter bis zum Gegenwart. Friedrich Pustet, Regensburg, 1995, f. 198.

¹⁹ Godin von, Amelie Marie: Vergessen ...? Roman aus der jüngsten Geschichte Albaniens. Steyler Verlag, St. Augustin über Siegburg, 1963.

²⁰ Bauer Ernest: Die katholische Kirche im kommunistischen Jugoslawien. Mit einem Bericht über die katholische Kirche in Albanien von M. A. von Godin. Në: Südost Stimmen. Zeitschrift für Probleme des südosteuropäischen Raumes. IV. Jahrgang, mars 1954, f. 30v.

²¹ Ruddies, Hartmut: Flottierende Versatzstücke und ideologische Austauschereffekte. Në: Intellektuellendiskurse in der Weimarer Republik. Zur politischen Kultur einer Gemeinlage. Schriften zur politischen Kultur der Weimarer Republik 10. Gang, Manfred

parë gjithmonë si epilog i ardhjes në fuqi të Hitlerit, fokuson modernen në diskursin e saj kulturor në vijim të shekullit të 20-të. Lidhur me rrugën politike ajo gjeneron edhe sot problematikën e një demokracie pluraliste apo shteti demokratik të rrezikuar, pa rëndësi nëse rreziku vjen djathtas për t'u ideologjizuar në nazizëm, majtas në stalinizëm apo në izma të tjerë aktualë.

Në vijim të letrës së tij drejtuar Godin-it, Thomas Mann duke folur për këtë rrezik, i cili në Luftën e dytë Botërore u skajua në nazizëm, i shkruan koleges së tij: “Po, edhe pse ngjan si e pavërtetë, prapë më vjen mirë të di që isha në Mynih, që vëzhgova për një moment fytyra të njohura, që ripashë vende të vjetra, të cilat më shëmbëllojnë kaq të rrënuara nga koha, duke e ditur se çfarë kishte ndodhur atje, ndërkohë që përfytyrimin për to e lidhja me atë ç’ka iu desh të përballonin ata më të mirët, miqtë e mbetur atje. Letra juaj përshkruan diçka nga e paimagjinueshmja, e cila ndodhi vërtet.”²² Në rreshtat që vijnë Thomas Mann e krahason fatin e vëllait të Godin-it, Reinhard von Godin, i cili pas shumë peripecish arrin t’i shpëtojë dënimit me vdekje nga nazistët, me shpëtimin në minutën e fundit të të burgosurit nga inkuizicioni në tregimin “The pit and the pendulum” të Edgar Allan Poe-s. Paralelja me këtë tregim të Poe-s, që synon t’i përçojë lexuesit ankthin dhe tmerrin, dhe ajo ç’ka Thomas Mann e quan “e paimagjinueshmja” e konturojnë fare qartë skenën e ekstremist ideologjik. Diskursi intelektual dhe i kultivuar, i cili lëvrohet pikërisht në sfondin e kësaj skene, që edhe pse gjëmadhë, prapë shumë e pranishme në Gjermaninë e vitit 1949, e përvijojnë në mënyrë shumë kuptimplote portretin e Godin-it si një intelektuale e mirëfilltë, një kolege, së cilës Thomas Mann, në përfundim të letrës i shpreh urimet më të mira për punën dhe shëndetin e saj.

Roli i aktantes në marrëdhënie me rrjetin intelektual veprues të kohës

Prej vitit 1908 dhe deri në vitin 1939 Godin e vizitoi shumë shpesh Shqipërinë, jo vetëm duke qenë pjesëmarrëse në ngjarje të rëndësishme historike, por edhe duke krijuar njohje personale me figura të rëndësishme të kulturës shqiptare. Për më tepër, në atmosferën e “viteve të mbrapshta”, po të flisnim me gjuhën e Kadaresë, në rrugën për konsolidimin e shtetit të

& Raulet Gérard (botues). Peter Lang, Frankfurt am Main, ribotim 2007, f. 60.

²² Jonas, M. Klaus: Thomas Mann und Marie Amelie von Godin. Versuch einer Dokumentation. In: Literatur in Bayern. Nr. 73, München, 2003, f. 31.

ri shqiptar, fokusimi i kësaj problematike, përmes distancës që Godin-it i ofronte thjesht fakti se i ishte qasur realitetit shqiptar intelektualisht, duke ardhur nga një mjedis krejt i ndryshëm, e bën atë shumë të vyer. Pikërisht këtij aspekti i mëshon ajo me largpamësi dhe ndërgjegjësimit intelektual në librin e saj “Aus dem neuen Albanien” kur flet për anëtarët e qeverisë provizore pas shpalljes së pavarësisë dhe vëren se: “duke qenë që për këta burra, të paktën qoftë edhe pjesërisht, mund ose do të flitet më vonë, dhe ata gjithsesi do të luajnë ku më pak e ku më shumë një rol të rëndësishëm në shtetin e ri, ndoshta nuk është pa interes përpjekja ime për të dhënë këtu përshtypjen që kam fituar për secilin prej tyre.”²³

Në vjeshtën e vitit 1912 Godin ndodhet në Shqipëri dhe është dëshmitare okulare e shpalljes së pavarësisë në Vlorë²⁴. Ajo ftohet²⁵ më se natyrshëm në këtë ngjarje të rëndësishme, siç rrëfen në librin e saj, duke dhënë dhe një hollësi konkrete për flamurin që u ngrit atë ditë në Vlorë, të cilën e gjejmë në mënyrë më të zgjeruar në kujtimet e Eqrem bej Vlorës.²⁶

E ndërgjegjshme për rëndësinë e momenteve historike që po përjetonte Shqipëria, ajo qysh në parathënie thekson se nga këndvështrimi i saj dëshiron të parashtojë rreziqet që mund ta shkatërrojnë shtetin shqiptar të posakrijuar.²⁷ Qasja dhe ndërgjegjësimi intelektual si dhe distanca po e

²³ Godin von, Amelie Marie: Aus dem neuen Albanien. Politische und kulturhistorische Skizzen. Josef Roller, Wien, 1914, f. 62v.

²⁴ Po aty, f. 35v.

²⁵ Po aty: f. 47: “...den 28. November werde ich nicht vergessen. Ich war eben aufgestanden, als man mich in Selamlik rief. Dort traf ich Hydei Effendi, einer der ehrenhaftesten Aghas von Valona. “Wir wissen Baronin, sagte er zu mir, dass Ekrem Bey eine albanische Flagge hat, geben Sie sie mir bitte, sie soll heute gehißt werden, denn wir werden die Unabhängigkeit Albaniens erklären.”

²⁶ Vlorë, Eqrem bej: Kujtime. Vëllimi i parë (1885-1912), f. 222v: Eqrem bej Vlorë tregon për vizitën që i ka bërë Don Aladro Kastriotit në Paris në vitin 1907. Në këtë vizitë ky i fundit i fjalë atij një flamur, me qëllim që Eqrem beu ta ngrinte ditën e pavarësisë. “Pesë vjet rresht unë e ruajta këtë flamur në dhomën time të gjumit, varur në një gozhdë anash krevatit, deri sa erdhi vërtet dita që kishte profetizuar don Alodroja i gjorë dhe krejt papritur e krejt rastësisht ky flamur u ngrit vërtet si simbol i pavarësisë.”

²⁷ Godin von, Amelie Marie: Aus dem neuen Albanien, f.4: “Nicht ein Wort der Kritik ist aus Gehässigkeit hervorgegangen, sondern ich schreibe jedes nach reiflicher Überlegung, weil mir nichts so nötig erscheint, als daß den Albanern und ihren Freunden die Gefahren gezeigt würden, welche vielleicht den neuen Staat, den wir mit so tiefer Freude werden sahen, wieder verderben können.”

tillë, i mundësojnë Godin-it përpjekjen për të shprehur një qëndrim kritik asnjnjës, aq të nevojshëm edhe sot në realitetin shqiptar, duke i dhënë kësij rol in e aktantes në marrëdhënie me aktorët e jetës politike, kulturore e fetare, në thelb me rrjetin intelektual veprues në Shqipërinë e asaj kohe²⁸. Për fat të keq kjo lloj perspektive ka mbetur krejt pa u vënë re në albanologji.

Interesant është kategorizimi me karakter sociologjik që Godin-i i bën në në librin e saj “Aus dem neuen Albanien” popullsisë shqiptare. Ky aspekt gjen shprehje dhe në nëntitullin shpjegues: skica politike dhe kulturore-historike. Ajo bën një klasifikim në tri grupe të popullsisë shqiptare.²⁹ Së pari masa e popullsisë, e cila sipas saj nuk ka pothuajse fare kontakt me turqit. Në grupin e dytë ajo rendit ata që përpiqen në Kostandinopojë ose në Shqipëri të jetojnë sipas modelit turk dhe të përfitojnë prej tij. Grupit të tretë i përkasin “të arsimuarit”, të cilët “janë bartësit e vërtetë të kulturës europiane, por krejt të izoluar prej popullit shqiptar, ata e kanë humbur kontaktin me të përmes qëndrimeve të gjata jashtë.”³⁰

Baronesha vëren me shumë largpamësi, që një ndër problemet kryesore të elitës shqiptare është mungesa e njësisë homogjene lidhur me idetë dhe shkollat e ndryshme të përfuara nga studimet jashtë shtetit nëpër vende të ndryshme të Europës. Çdo pjesëmarrje në një konferencë shkencore sot do ta gjente me shumë vend këtë vërejtje të Godin-it. Interesante është paraqitja e disa përfaqësuesve të elitës shqiptare të kohës dhe e shkollave nga vijnë ata.³¹

Përveç përshkrimit të Ismail Qemalit, si kryetar i qeverisë, ajo prezanton dhe të tjerë politikanë, burra shteti dhe shqiptarë të ditur. Mënyra e zhvillimi të kuvendit për shpalljen e pavarësisë i jep shkas Godin-it të vë-

²⁸ Lidhur me modelin aktor-aktant në rrjetet shoqërore shih më gjerë Bruno Latour: *Der Berliner Schlüssel. Erkundungen eines Liebhabers der Wissenschaften*. Aus dem Französischen von Gustav Roßler. Akademie-Verlag, Berlin 1996.

²⁹ Po aty, f. 18.

³⁰ Po aty, f. 32: “sind die wirklichen Träger der europäischen Kultur, jedoch vom albanischen Volk völlig isoliert, sie haben den Kontakt zu ihm durch lange Auslandsaufenthalte verloren.

³¹ Po aty, f. 34: “daß sie nicht einmal unter sich eine homogene Einheit bildet, weil sie zu Studienzwecken über alle Länder Europas, ganz verschiedene Ideen in sich aufgenommen hatte”.

rejë se për shkak të partive të shumta të përcara dhe nivelit të ulët arsimor, organizimi i shtetit të ri shqiptar do të jetë i vështirë. Veçanërisht të dëmshme janë për shqiptarët sipas saj politika e kafeneve (Kaffehauspolitik) dhe patriotizmi lokal (Lokalpatriotismus), por në përfundim ajo i këshillon shqiptarët që ta shohin të ardhmen me mirënjohje dhe guzim.³²

Elementit fetar në diskursin intelektual

Hapësira kryesore e një intelektualeje në kapërcyell të shekujve ishte kryesisht krijimtaria letrare. Duke mos pasur mundësi për të bërë maturën në Zvicër dhe për të vijuar më tej studimet në universitet, Godin-i filloi qysh në vitin 1902 bashkëpunimin letrar me gazeta të tilla si “Kölnische Volkszeitung” dhe “Tägliche Rundschau”.³³ Krijimtaria letrare e saj përfshin novela dhe romane, tematika e të cilëve në sfond ka ngjarjet politike të gjysmës së parë të shekullit 20, në Gjermani apo Shqipëri.

Personazhet e Godin-it dhe ploti në të cilin veprojnë ata dëshmojnë në të gjitha rastet një simbiozë të përvijuar qartë midis fakticitetit dhe fiksionalitetit, duke shpalosur kësaj në mënyrë suksesive referenca dhe struktura, të cilat hapin, kufizojnë ose përmbyllin mundësinë për të vëzhguar ose më saktë për të subjektivizuar të vepruarit në hapësirën shoqërore gjermane, konkretisht bavareze, dhe në atë shqiptare të asaj kohe. Raporti simbiozë i fakticitetit dhe fiksionalitetit mishërojnë në të gjithë krijimtarinë letrare të Godin-it me çfarëdo lloji tematike një qasje intelektuale të këtij raporti dhe një pozicionim po të tillë në përpjekjet për zgjidhje apo në zgjidhjet e ofruara. Gazetarja dhe shkrimtarja austriake Hilde Spiel, një “grande Dame” e shekullit të 20-të, e përvijon shumë qartë këtë pozicionim, kur duke folur për veten thotë: “Unë nuk kam qenë aktive politikisht, por jam marrë gjithmonë intensivisht me zhvillimet e kohës, me politikën e kohës. Unë jam angazhuar së brendshmi, jo gjithmonë në të njëjtën mënyrë, por përkatësisht sipas ngjarjeve.”³⁴

³² Po aty, f. 125.

³³ Berger, Manfred, kol. 494.

³⁴ Hermann, Ingo (botues): Hilde Spiel. Die Grande Dame. Gespräch mit Anne Linsel in der Reihe “Zeugen des Jahrhunderts”. Lamuv, Göttingen, 1992, f. 55: “Ich bin politisch nicht aktiv gewesen, doch mich hat die Beschäftigung mit den Zeitläuften, mit der Zeitpolitik immer gefesselt. Ich habe mich innerlich engagiert, nicht immer auf die gleiche

Si shembulli më i spikatur për krijimtarinë letrare të Godin-it me tematikë realitetin bavarez të kohës do të veçojmë romanin “Unser Bruder Kain”, i cili merr shkas nga kronika e vërtetë e ngjarjeve të Revolucionit Bavarez në vitin 1919. Protagonistja e romanit, Marie Gabriele von Stetten, ndodhet rastësisht në stacionin e trenit, pikërisht në kohën që ndodh një shkëmbim zjarri mes grupimeve të ndryshme politike. Përpunimi letrar që i bën Godini ngjarjeve të revolucionit bavarez dëshmojnë për një njohje të saktë të dokumentacionit përkatës, konkretisht lidhur me gjyqin dhe pushkatimin e pengjeve në gjimnazin Luitpold, ngjarje që ofron shumë paralele me plotin e romanit.³⁵

Trajtimi në perspektivë i figurave në roman paraqet pozicionimet e ndryshme ideologjike dhe humanizmi e vëllazërimi i mishëruar në figurat e çiftit aristokrat von Stetten është i një natyre kristiane, përtej ndarjes në klasa të shoqërisë. Është fakt që diskurset e ndryshme intelektuale të periudhës së Republikës së Weimar-it kishin shpesh të pranishëm elementin fetar dhe pozicionimi i Godin-it në këtë drejtim është më se i zakonshëm për kohën në të cilën ajo përjetoi pjekurinë e saj intelektuale. Aktualizimi i mitit të vëllavrasjes në sfondin e ngjarjeve historike të revolucionit bavarez përmes referencës ndërtekstore dëshmojnë qasjen intelektuale të problemit dhe pozicionimin jo të një shkrimtareje politike, por të një vëzhguesje kritike lidhur me rrjedhat politike të kohës.

Fakticiteti dhe fiksionaliteti

Në dekadën e parë të shekullit të 20-të, në përshkrimet e udhëtarëve gjermanë dhe austriakë sapo ka zënë fill një angazhim i ndërjegjeshëm lidhur me paragjykimet që e dominojnë këtë lloj letërsie kur është fjala për Shqipërinë dhe njëkohësisht ndjehet përpjekja për të korrigjuar klisheën e ngarkuar negativisht. Botimi i parë letrar me tematikë shqiptare i Godin-it është një përmbledhje novelash me titull “Aus dem Lande der Knechtschaft”, botuar në Vjenë në vitin 1913. Përshkrimi dashamirës i Shqipërisë

Art, sondern entsprechend den Ereignissen.”

³⁵ Hamann-Anetzberger, Jessica: Marie Amelie von Godins Unser Bruder Kain (1919). Brudermord und Klassenkampf während der Münchener Räterepublik. Në: Ulrich, Kittstein & Zeller, Regine (botues): “Friede, Freiheit, Brot!” Romane zur deutschen Novemberrevolution. Rodopi, Amsterdam–New York, 2009, f. 65.

dhe shqiptarëve bëhet në një kohë që kjo gjë nuk ishte aspak e natyrshme dhe e vetëkuptueshme.

Përmbledhjen e novelave të vitit 1913 e pasojnë disa romane me tematikë shqiptare në një hark kohor prej gati gjysmë shekulli, deri në botimet postume të romaneve “Die drei Kolaj”³⁶ në vitin 1961 dhe “Vergessen ...?” dy vjet më vonë. Integrimi i momenteve historike të kohës në kozmosin rrëfyes ofron në tërësinë e tyre një tablo të historisë politike dhe kulturore të Shqipërisë së asaj kohe, e cila nuk duhet të anashkalohej pa u vlerësuar. Deri tani kontributi letrar me tematikë shqiptare i Godin-it ka mbetur pothuajse krejt i panjohur.

Fakticiteti historik në romanin “Der Überfall”³⁷ lidhet me ngjarjet e kohës së princ Wied-it dhe ky i fundit mishërohet dhe fiksionalisht në roman. Çifti mbretëror bashkë me shpurën e tij rrugës për në Durrës bën një vizitë në çifligun e Dushkut, pronë e personazhit kryesor, Isan bej Dushkut. Mjedisi i çifligut, duke nisur qysh tek oxhaku, salla me tavanin prej druri të gdhendur, stalla e kuajve, konakët e shërbëtorëve etj mbushet me personazhe, ndër të cilët Avdi bej Toptani, Aqif bej Vërlaci nga Elbasani, Isa Boletini, Don Nikollë Kaçorri apo Esat pashë Toptani ose siç e quan Godin-i “tigr i Tiranës”.³⁸ Duke pasur parasysh raportin ndërmjet fakticitetit dhe fiksionalitetit është interesant përshkrimi që Godin-i i bën realisht Esat pashë Toptanit përmes citimit të përmendur nga Eqrem bej Vlora në studimin e tyre të përbashkët për historinë e sundimit turk. Citimi gjendet në pjesën e dytë të studimit, të cilin Eqrem bej Vlora e përfundoi pas vdekjes së Godin-it³⁹ dhe mban shënimin: “marrë nga ditari i baronshës”. Në

³⁶ Godin von, Amelie Marie: Die drei Kolaj. Gefährliche Wege im aufständischen Albanien. Arena Verlag, Würzburg, 1961.

³⁷ Godin von, Marie Amelie: Der Überfall. Ein Roman aus Albanien. Pfeiler Verlag, Rothenburg/Neckar, 1955.

³⁸ Po aty, f. 59.

³⁹ Vlora bej, Eqrem bej & Godin von, Marie Amelie: Ndhimesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri. Skicë historike. Pjesa e dytë, f. 207v: “Esat Pashë Toptani ka pasur një ndikim kaq të madh mbi fatet e Shqipërisë dhe më vonë mbi qeverinë e princ Vidit, ... sa autori nuk beson se po gabon kur është i mendimit që mbresat të bashkautores do të ishin interesante edhe për lexuesin. Ai ka qenë një burrë i bëshëm dhe i pashëm, me një paraqitje tepër të fisme, por krejtësisht i pashkolluar dhe një grua e re që punonte si korrespondente e një gazete të madhe, domosdo që me të parën do t’i dukej atij një dukuri e dyshimtë. E megjithatë ai ishte kaq i sjellshëm sa ta priste atë gjithmonë miqësisht

roman paria e mbledhur në çifligun e Dushkut është e shqetësuar se mos “tigrin e Tiranës mund t’ia helmonte zemrën mbretit”.⁴⁰

Është interesante përfaqja mes përshkrimit faktik të baroneshës në ditar dhe fiksionalitetit të figurës së Esat Pashës, mishëruar konkretisht në marrëdhënien e tij me Heben, zonjën e re të çifligut.⁴¹ Në parinë e mbledhur në çifligun e Dushkut bëjnë pjesë jo vetëm myslimanë, por edhe të krishterë. Një shërbëtor përmend që për të zotin e çifligut, Isan beun, nuk ka rëndësi se të çfarë besimi janë shërbëtorët, mjaft që ata të jenë besnikë. Madje kur si mysafir vjen Isa Boletini, zonja e re e shtëpisë Hebja, bën kujdes që të largohet nga salla, për arsyen se Isa Boletini i përmbahej rreptësisht rregullave të islamit.⁴² Princ Wied-i dhe shpura e tij mbretërore, priten me bujari. Atyre u ofrohet dhe një argëtim me ciganë dhe kërcimtarë. Bisedat zhvillohen me dhe pa përkthyes. Pas largimit të çiftit mbretëror ngjarjet vijojnë të tilla sa ky i fundit vazhdon të jetë qerthulli i plotit, por jo më në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Mjediset, konakët, emrat konkretë të fshatrave e qyteteve dhe personazhet, emrat e të cilëve shpesh edhe sot të duket sikur janë marrë nga një libër historie, i cili për një kohë të gjatë ka qenë i ndaluar, shpalosin një botë shqiptare të vendosur në gjysmën e parë të shekullit të 20-të, e cila si e tillë është natyrisht jo e një rëndësie kardinale për nga pikëpamja letrare, por shumë e vyer në thurimën e saj nëse vlerësohet si një fenomen shoqëruar, si një përthyerje e kultivuar në letrat shqipe, madje më gjerë në kulturën shqiptare.

Figura kryesore e romanit “Der tolle Nuredin”⁴³ është një pinjoll i derës së Vërlacëve. Përmes historisë së tij të dashurisë Godin-i rreket të bëjë të njohur përmasën e traditës, të marrëdhënieve mes dyerve të mëdha në

dhe me shumë mirësjellje. Shpeshherë ai e merrte baroneshën edhe si përkthyes. Sikundër i pëlqente të më merrte edhe mua – në Durrës, gjatë kohës së princ Wied-it, - për të pirë një kafë tek ajo.”

⁴⁰ Godin von, Marie Amelie: Der Überfall, f. 59.

⁴¹ Po aty, f. 84.

⁴² Po aty, f. 60.

⁴³ Godin von, Marie Amelie: Der tolle Nuredin. Roman aus Albanien. Bachem, Köln, 1936.

realitetin shqiptar të asaj kohe. Romani “Befreiung”⁴⁴ ka në thelb kohën e revolucionit xhonturk. Personazhi kryesor Shahin bej Vrioni nuk mund të martohet me një italiane që e dashuron, sepse duhet të mbajë fjalën dhe të martohet me një vajzë të panjohur shqiptare, martesë të cilën e kanë lidhur prindërit e tij dhe mosrealizimi i së cilës sjell me vete pasojën e pashmangshme të gjakmarrjes. Një tis autobiografik në motiv e bën ndoshta akoma më interesante stisjen letrare.

Rrëtimi i faktit të munguar dhe detyrimi moral intelektual

Një vend të veçantë në romanet me tematikë nga realiteti shqiptar i kohës zë pa dyshim romani “Vergessen ...?”⁴⁵ Ky roman ka si temë përndjekjen e katolikëve dhe të kishës katolike në Shqipërinë komuniste. Një problemi të tillë Godinfi i është qasur më parë dhe në artikullin “Katholikenverfolgung in Albanien” në vitin 1951⁴⁶ dhe tri vjet më pas në artikullin “Die katholische Kirche im kommunistischen Albanien”.⁴⁷ Në artikullin e dytë ajo bën ndër të tjera një përshkrim të detajuar të priftërinjve katolikë që janë vrarë dhe persekutuar pas vendosjes së regjimit komunist, duke përmendur emra të tillë si Gaspër Thaçi, Vinçenc Prenushi, Ndre Zadeja, Lazër Shantoja etj.

Romani markohet përmes interpunkcionit qysh në titull, pjesorja “harruar” pasohet nga tri pika nënkuptuese dhe një pikëpyetje. Figura qendrore është Patër Anton Arapi. Baronesha përshkruan në roman fatin e priftit katolik, i cili pasi kalon disa ditë në male, i strehuar në familje të ndryshme, jo vetëm katolike, por edhe myslimane, madje edhe në familjen e hoxhës, kapet dhe dërgohet në Tiranë për t’u nxjerrë para gjyqit e për t’u pushkatuar. Vepra është botuar postum në vitin 1963 dhe raporti mes faktit

⁴⁴ Godin von, Marie Amelie: Befreiung. Roman aus dem modernen Albanien. Habel, Regensburg, 1920.

⁴⁵ Frein von Godin, Vergessen...? Roman aus der jüngsten Geschichte Albaniens. Steyler Verlag, St. Augustin über Siegburg, 1963.

⁴⁶ Godin von, Marie Amelie: Katholikenverfolgung in Albanien. Nē: Freiburger katholisches Kirchenblatt, 1951, f. 454.

⁴⁷ Bauer Ernest: Die katholische Kirche im kommunistischen Jugoslawien. Mit einem Bericht über die katholische Kirche in Albanien von M. A. von Godin. Nē: Südost Stimmen. Zeitschrift für Probleme des südosteuropäischen Raumes. IV. Jahrgang, mars 1954, f. 30v.

të munguar, por të rrënuar ngulmueshëm me detyrimin moral për ta bërë një gjë të tillë dhe letërsisë artistike e çorodisin strukturën e romanit. Ky i fundit, megjithë sfondin konkret politik, shpesh merr elementet e një letërsie predikuese kristiane. Elemente të tilla i gjejmë shpesh tek Godin-i të gërshetuara me një problematikë sociale⁴⁸, p.sh. në romanin “Der Weg in die Nothelfergasse”⁴⁹, një roman që përshkruan ndër të tjera jetën në My-nih, nën ndikimin gjithëpërfshirës të industrializimit.

Figura e Patër Anton Harapi në roman shpaloset sinkronikisht përmes përshkrimit të ditëve të fundit që ai kalon i strehuar në male dhe diakronikisht përmes monologjeve e kujtimeve të tij, të ndërkallura në të gjithë linjën e romanit. Në këtë kuadër elementi faktik informativ, edhe pse i pakët e i thukët dominon dhe fiksionaliteti tingëllon shpesh jo i natyrshëm. Këtë roman Godin-i e ka shkruar në dekadën e fundit të jetës së saj, në një kohë kur lidhjet konkrete me Shqipërinë ishin të pamundura.

Në vitin 1933 Patër Anton Harapi nis në revistën “Hylli i dritës” botimin e rubrikës “Urti e burri ndër banorë të Cemit”, rubrikë në të cilën ai përmes një serie artikujsh përshkruan kujtimet e tij për botën e malësorëve gjatë kohës kur kishte shërbyer si famulltar atje. Marrëdhëniet e priftit katolik si personazh me malësorët në ditët e fundit para ekzekutimit janë më autentiket në roman dhe i lenë shteg hamendësisë që vepra e përmendur më sipër mund të ketë qenë një ndër burimet e shfrytëzuara Godin-i. Si shembull konkret vlen të përmendet përshkrimi i pazarit të Shkodrës në faqet e para të romanit⁵⁰ dhe përsiatjet e priftit kur është duke e përshkuar këtë pazar përkundrejt përshkrimit të të njëjtit pazar nga ky i fundit si autor, marrë nga vepra postume “Valë mbi valë”.⁵¹

Në vitin 1925 Patër Anton Harapi boton një libër me titullin: “Edukata ase mirëritja e fëmijëve”. Godin-i e mishëron fiksionalisht këtë fakt në roman përmes marrëdhënies së tij me djaloshin Lek Pistuli dhe murgeshën Adriana. Kjo e fundit, bashkë me kryemurgeshën Klementina përvi-

⁴⁸ Bachleitner, Norbert: Kleine Geschichte des deutschen Feuilletonromans. Gunter Narr, Tübingen 1999, S. 133-138

⁴⁹ Godin von, Marie Amelie: Der Weg in die Nothelfergasse. Ein Roman aus dem Leben in der Stadt. Në: Kölnische Volkszeitung. Morgenausgabe. 17.10-4.11.1931.

⁵⁰ Godin von, Marie Amelie: Vergessen, f. 17v.

⁵¹ Harapi, Anton: Valë mbi valë. Shpresa& Faik Konica, Prishtinë 2003, f. 7v.

jojnë në diakroni kohën kur Patër Anton Harapi punoi si mësimdhënës në Shkollën e Stigmatineve në Shkodër.

Përshkrimi i rrugës nga pazari për në Kolegjin Saverian dhe mjediset e tij me kishën, portalet e saj dhe manastirin i japin shkas priftit katolik në monologjet e tij të përmendë kohën kur ai vetë kishte qenë nxënës, por më pas dhe drejtor i këtij kolegji apo kohën e kaluar me Fishtë. Lidhur me këtë të fundit, Godin-i vendos në përsiatjet e Anton Harapit edhe mendime që i ka shprehur vetë për Fishtë në një artikull prezantues për letërsinë shqipe në vitin 1939.⁵² Mjediset e kolegjit Saverian janë të përshkruara me plasticitet, gjë që të sjell natyrshëm ndër mend faktin se Godin-i kishte bujtur për një kohë të gjatë aty gjatë kohës kur punonte për përkthimin e kanunit. Kolegjin Saverian ajo e cilëson si shkollën më të mirë të vendit aso kohe.⁵³

Interesante janë elemente të tilla biografike në roman si p.sh. strehimi i Patër Anton Harapit në male apo mosushtimi i dhunës karshi tij nga ana e partizanëve që e kapën rob. Këto fakte i gjejmë dhe në kujtimet e At Daniel Gjeçajt botuar në vitin 2012.⁵⁴ Përveç kësaj disa herë gjatë procesit të gjyqit Godin i mëshon faktit informativ duke vënë në kllapa shënimin: “marrë fjalë për fjalë nga raporti i procesit gjyqësor”.⁵⁵ Është për të ardhur keq që ky roman ka mbetur deri më sot krejtësisht i panjohur për lexuesin shqiptar.

Një personalitet i plotësuar

Aktiviteti intelektual i Godin-it për gati gjysmë shekulli nuk për-

⁵² Në revistën “Stimmen aus dem Südosten”, në një artikull prezantues për letërsinë shqipe, ajo e quan Fishtën poetin shqiptar më të spikatur, kurse “Lahutën e Malcis” e cilëson si një epos kurorë, i cili nuk ka shoqe për nga forca, qartësia dhe ndjeshmëria e shprehjes (Godin von, Marie Amelie: Stimmen aus dem Südosten. Zeitschrift des Südost-Ausschusses der Deutschen Akademie München. Fochler-Hauke, Gustav (botues). Heft 374, Jahrgang 1939/40, f. 290.)

⁵³ Godin von, Marie Amelie: Vergessen: “wörtlich nach dem veröffentlichten Gerichtsbericht”.

⁵⁴ Gjeçaj, At Daniel: Vepra II. Gjallëria e artit të martirizimit. Faqe nga tragjedia e krishtenimit në Shqipëri. Botim I. Botime françeskane. Shkodër 2012, f. 99v.

⁵⁵ Godin von, Marie Amelie: Vergessen, f. 31: “Das Franziskanergymnasium von Shkodra begründete in jenen Jahren seinen Ruf als erste und späterhin beste höhere Schule des Landes. Nicht allein die Bürgerschaft der Stadt, auch viele Angesehene im Landessüden und aus Mirdita vertrauten dieser Schule ihre Söhne an.”

mbledh vetëm krijimtarinë e saj letrare. Siç u vu re edhe më sipër, në albanologji emri i saj lidhet kryesisht me fjalorin gjermanisht-shqip të vitit 1930 dhe me përkthimin e Kanunit. Pothuajse i panjohur është aktiviteti i saj karitativ dhe shoqëror, të cilin ajo e ka zhvilluar gjithmonë krahas atij intelektual.

Botimi i fjalorit gjermanisht-shqip në vitin 1930 vlerësohet nga Jokl i si “tepër i pasur, duke marrë parasysh në mënyrë të hollësishtme frazeologjinë dhe idiomat popullore.⁵⁶ Në parathënien e fjalorit Godin-i⁵⁷ e falënderon personalisht këtë të fundit për ndihmën e vyer që i ka dhënë. Po ashtu ajo falënderon dhe Gustav Weigand-in, i cili e ka ndihmuar edhe financiarisht përmes një shoqate shkencore për botimin e fjalorit.

Përveç përkthimit të Kanunit, i cili për nga vështirësia e ndërmarrjes i kalon kufijtë thjesht të një përkthimi, Godin ka përkthyer edhe letërsi artistike nga italishtja e frëngjishtja në gjermanisht⁵⁸. Duke zotëruar disa gjuhë të huaja, ajo ka punuar si përkthyesë dhe në zonën amerikane në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore. Pas botimit të librit “Aus dem neuen Albanien” Godin-i ftohet zyrtarisht nga Princ Wied-i për të qenë zonjë e oborrit të tij. Për këtë të fundit ajo ka qenë këshilltare, përkthyesë dhe reportere, madje dhe mësuese për gjuhën shqipe. Interesant është fakti që në një shënim të kujtimeve të tij Eqrem bej Vlora vëren se edhe East Pashë Top-tani gjithashtu e merrte hera-herës për të përkthyer.

Pas ftesës zyrtare nga princ Wied-i në Potsdam, në janar të vitit 1914, Godin-i shkoi në Berlin për të përgatitur ardhjen e tij në Shqipëri. Në Berlin ajo mori kontakt me disa gazeta të kohës për të qenë reportere e ngjarjeve në Shqipëri dhe në të njëjtin vit shkroi artikullin “Aus der albanischen Residenz”⁵⁹. Ditari i mbajtur nga Godin-i në një periudhë prej dy dekadash (1922-1943) do të ishte shumë i vyer për të gjithë kuadrin his-

⁵⁶ Jokl, Norbert: Albanien. Në: Indogermanisches Jahrbuch, XVI., Jahrgang 1932, Berlin 1932, f. 166: “sehr reichhaltig, eingehende Berücksichtigung der Phraseologie und volkstümlicher (z.T. sprichwörtlich) Redewendungen.”

⁵⁷ Wörterbuch der albanischen und deutschen Sprache. Band I, Vorwort.

⁵⁸ Bertrand, Louis: Theresia von Avila. Autorisierte Übersetzung aus dem Französischen. F. Schönningh, Padeborn, 1928; Baumann, Emile: Der Heilige Paulus. Autorisierte Übersetzung aus dem Französischen. Kösel & Pustet, München, 1926.

⁵⁹ Tägliche Rundschau, Berlin, 3. April 1914 Beilage

torik të gjysmës së parë të shekullit 20 në Shqipëri, duke përfshirë këtu dhe periudhën e Princ Wied-it dhe rolin që ka luajtur ajo personalisht lidhur me të. Vetë fakti që Godin-i ka mbajtur ditat e përvijon akoma më qartë portretin e saj intelektual, duke shprehur ndërgjegjësimin për rëndësinë e momentit historik dhe ofrimin e një dëshmie autentike për këtë moment.

Në vitin 1933 Godin-i botoi një biografi për Ellen Amann (1870-1932), aktiviste në lëvizjen për emancipimin e gruas dhe pioniere në organizimin e aktivitetit social karitativ në Mynih. Me Ellen Amann Godin-in e lidhte një miqësi dhe punë e përbashkët disavjeçare. Në vitin 1913 Ellen Amann kishte botuar madje përkthimin suedisht të librit të Godin-it “Aus dem neuen Albanien”. Sie deputete e Partisë Popullore Bavareze Ellen Amann kishte ndihmuar në vitin 1923 në dështimin e puçit të Hitlerit. Për këtë arsye biografia e Godin-it u ndalua nga nazistët dhe 60.000 ekzemplaret u dërguan për letër.

Në dhjetor të vitit 1904 me iniciativën e Ellen Amann në Mynih u themelua dega e Shoqatës së Grave Katolike Gjermane. Godin-i u zgjodh në kryesi si protokolliste e dytë duke mbuluar sektorin për arsimimin shkencor të vajzave dhe grave që vinin nga shtresat e mesme. Gjatë punës së saj në këtë shoqatë ajo u përpoq të organizonte herë pas here ligjërata shkencore për publikun e mësipërm, një novum për kohën, i cili dilte përtej caqeve të sallorit letrar. Edhe pasi nuk ishte më në kryesi Godin-i u angazhua gjithmonë në aktivitetet karitative të shoqatës duke organizuar ndihma materiale, sidomos për familjet e shtresës së mesme të prekura nga Lufta e Parë Botërore.

Aktivitetin karitativ Godin-i e ushtroi në periudha të ndryshme edhe në Shqipëri. Në librin e saj “Aus dem neuen Albanien”⁶⁰ ajo tregon se si bashkë me Zejnep Vlorën, së cilës dhe ia dedikon këtë libër, përpiqet të organizojë ndihma për të plagosurit. Në dhjetor të vitit 1913 shkon në Durrës, udhëtim i cili është i organizuar nga Kryqi i Kuq Austriak, kurse në periudhën pas përmbyesjes së princ Wied-it Godin-i drejton një spital fushor po në këtë qytet. Ndërmjet qëndrimeve në Mynih nga një udhëtim në tjetrin në Shqipëri, Godin-i ka organizuar shpesh ndihma në para për Shqipërinë. Për më tepër në realitetin shqiptar të gjysmës së parë të shekullit të

⁶⁰ Godin von, Amelie Marie: Aus dem neuen Albanien, f. 35

20-të, organizimi i një aktiviteti karitativ duhet parë si një zgjerim i strukturave ende të brishta dhe në formim e sipër të shoqërisë shqipta

Përmbyllje

Para kapitullit të shtatë, në studimin e përbashkët me Eqrem bej Vlorën për sundimin turk në Shqipëri, ky i fundit jep një lajmërim për vdekjen e Godin-it duke u shprehur: “Zemra e mirë dhe besnike e baroneshës Ameli fon Godin, që për pesëdhjetë vjet radhazi punoi pa u lodhur dhe me përkushtim për Shqipërinë dhe shqiptarët, pushoi së rrahuri në Mynhen, më 22 shkurt të vitit 1956. Për të gjithë ata që e kanë njohur ajo do të mbetet një shembull i humanizmit të vërtetë, i besnikërisë fisnike njerëzore, i shpirtit të madh dhe i gëzimit më të pastër të jetës. I përjetshëm dhe i paharruar do të jetë kujtimi i saj për ne që e deshëm dhe e nderuam aq shumë.”⁶¹ Poshtë këtij lajmërimi autori shënon “miqtë” dhe në të njëjtën faqe vijon me shënimin që pjesa në vijim e librit është shkruar vetëm prej tij. Kryqi sipër lajmërimit, nderimi dhe vlerësimi, leksiku përkatës dhe përcaktimi kohor, të gjithë këto elemente janë tipike për gjininë tekstore të një lajmërimi vdekjeje. Interesant në kuadrin komunikativ të kësaj gjinie tekstore është fakti se dhënësi, përmes shumësit përmbledhës “miqtë” mbetet i hapur, ndërkohë që marrësi mbetet i papërcaktuar, po të kemi parasysh faktin që lajmërimi i mësipërm jepet në një libër dorëshkrim. Duke bërë një paralele me lajmërimin e mësipërm, njohja dhe vlerësimi i kontributit të Godin-it në albanologji, në të gjitha përthyerjet e tij të kultivuara, kanë në rastin më të mirë një tisi të turbullt e të papërcaktuar dhe mbetet të qar-tësohen.

⁶¹ Vlora bej, Eqrem bej & Godin von, Marie Amelie: Ndhimesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri. Skicë historike. Pjesa e parë, f. 191.

Haxhi SHABANI, Ulqin

FJALORTHI I ARNOLD FON HARFIT JO VETËM NJË NGA DOKUMENTET E PARA TË GJUHËS SHQIPE

1. Shënime të deritashme për Fjalorthin e Arnold fon Harfit

Shkrimet e deritashme për “Fjalorthin e Arnold fon Harfit” janë kryesisht disa shënime që dalin në doracakë të ndryshëm, shumica në tekste shkollore të niveleve të ndryshme, në histori të letërsisë shqipe, kurse në studime të (Shuteriqi, 1978), por ato nuk kanë për synim të japin në mënyrë të thelluar dhe të shumanshme këtë dokument të gjuhës shqipe. Ato dalin në kontekstin e dëshmive e dokumenteve, përkatësisht librave të parë, për gjuhën shqipe dhe të gjuhës shqipe.

Shumica e këtyre shënimeve japin të dhëna për “Fjalorthin”..., duke e cilësuar atë si dokumentin e dytë të gjuhës shqipe, saktësojnë numrin e fjalëve (26), të frazave (8) dhe të numëroreve (12) dhe pohojnë se autori ka dhënë përkthimin e këtyre njësisve leksikore në gjuhën gjermane në ditarin e tij të udhëtimit (Elsie, 1997). Lista e fjalëve, frazave dhe numrave është e saktësuar, por problemi është i këtillë se transkriptimi dhe transliterimi që pjesërisht i është bërë fjalësit, duhet marrë me rezervë. (“Botimi i pjesës shqip mund të ketë gabime shtypi, prandaj është e nevojshme të vështrohet origjinali”, Shuteriqi, 1978). Kjo punë del edhe pak më e vështirësuar se autori përgjegjëset e fjalëve që i mblodhi në gjuhën shqipe i ka përkthyer në dialektin e Rinit dhe mbetet si një problem që do zgjidhjen e duhur profesionale. Mundësitë e gabimeve gjatë mbledhjes së fjalëve nga Harfi apo edhe vetë autorja e këtij autorësi vihet në pikëpyetje, sidomos nga autori gjerman Armin Hetzer (Hetzer, 2006).

2. Fotokopja e orgjinalit të “Fjalorthit të Harfit” dhe citatet

Një pjesë e këtij problemi që është themelori për “Fjalorthin e Harfit” është vendi (vendet) se ku i ka mbledhur fjalët dhe, si rrjedhim, sa ka qëndruar në vendet shqiptare që i ka vizituar (Ulqinin, Durrësin e Sazanin). Për këtë dilemë deri më tash ka edhe pohime kundërthënëse, konkretisht sa i

përket kohës që ka qëndruar në Ulqin: mund të ketë qëndruar rreth dy ditë (Ushaku, 2010). Mirëpo, ka mendime se Harfi nuk ka qëndruar në këtë qytet. Duke iu referuar mendimit të Harfit, librit që është ribotim i orgjinalit (Ulqinaku 2017), apo përfundimit në bazë të vrojtimit përkatës (Elsie, 1997) pohohet se fjalët i ka mbledhur në Durrës.

Për të sqaruar se ku mund ta ketë vjelë materialin leksikor Harfi, ja dy citatat nga faqja e fotokopjuar nga origjinali (faqja 65 e librit të Harfit) që jepet në faqen vijuese, krahas fjalëve, frazave dhe numërorëve në shqip dhe gjermanisht.

Fragmenti i parë: “Nga Raguza deri në Ulqin ka 100 mila detare. Është kjo një qytezë ku unë për herë të parë dëgjova gjuhën shqipe. Porsa zbritem në lima e hetova tingëllimen e kësaj gjuhe që ndryshonte nga sllavishtja”.

Fragmenti i dytë: “Nga Ulqini në Durrës lundruam me një erë shumë të fortë. Ky është një qytet i madh i rrënuar nga turqit, që tani është nën sundimin e Venedikut. Ky qytet shtrihet në Shqipëri, ku banorët kanë edhe gjuhën e tyre, e cila nuk mund të shkruhet mirë, meqë në këtë vend ata nuk kanë alfabetin e vet. Kam hedhur në letër disa fjalë të gjuhës shqipe, të cilat po i jap më poshtë me alfabetin tonë”.

Sidoqoftë, duke iu referuar këtyre dy fragmenteve, nuk është aq e lehtë t’i vihet pika, se fjalët i ka mbledhur vetëm në Durrës. Duke pasur parasysh faktin se kontakti i parë me një gjuhë është më mbreslënësi dhe më i thelli, Harfi mund të përfytyrohet “me penë e fletore në dorë”, i cili do të ketë filluar vjeljen e fjalësit që në Ulqin, madje edhe gjatë udhëtimit për në Durrës, sepse ndonjë nga udhëtarët apo edhe vetë detarët mund të kenë qenë ulqinakë të njohur për traditën e lashtë të marrjes me detari.

Por, ka edhe mendime për mungesën e vlerës gjuhësore të “Fjalorthit”, duke pohuar se fjalët i ka mbledhur ndonjë venedikas apo vetë Harfi mund të ketë pyetur detarët të cilët për nevoja udhëtimit mund t’i kenë mësuar (Hetzer 1978).

Duke pasur parasysh edhe faktin se nuk janë botuar, së paku, në mënyrë të plotë faqja e “Fjalorthit”... më poshtë e fotokopjuar është dhënë ajo që ka të bëjë me fjalët shqip-gjermanisht, përkatësisht tërë njësitë leksiore përkatëse që ai i ka botuar. (Faqja është marrë nga ribotimi në bazë të origjinalit:”Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Coln durch Ita-

lien, Syrien, Aegypten, Arabien, Aethiopien, Nubien, Palastina, die Turkei, Frankreich und Sarnien wier er sie in den Jahren 1496 bis 1499).

Sa u pëket fjalëve të përfshira në “Fjalorth”..., dua të tërheq vëmendjen vetëm për ngjashmëritë që i kanë dy fjalë të tij me të folmen e qytetit të Ulqinit: *oie* dhe *jae*. Duke pasur parasysh se e folmja e qytetit të Ulqinit ka ruajtuar disa forma mjaf konzervative si e folme e skajshme e shtrijes së shqipes së tashme si dhe faktin që të krahasohen dy forma duhet pasur parasysh edhe faktorin kohë, nuk është i lehtë krijimi i ngjashmërive. Por, megjithatë mund të jepet një lloj përgjasimi. Edhe sot në të folmet urbane të Ulqinit dalin këto foma të vjeta *oie* për *ujë* dhe *dhæ* për *dha*.

Lista e fjalëve të “Fjalorthit”... dhe teksti i shkruar rreth dy qyteteve shqiptare: i Ulqinit dhe i Durrësit si dhe mos (saktësia) se ku do t’i ketë mbledhur njësitë leksikore jepet në faqen vijuese.

cianeren, licht in Albanyen eyn lantschafft.

Item van Dulcina zo Duratzo lxx mijlie,
voeren wir gar mit boesen wyndt. dit is eyn groysse ver-
stoerde stat van deme Turcken, yetzont vnderworffen den
5 Venecianern. item dese stat licht in Albanijen dae sij ouch
eyn eygen spraiche haynt, der man nyet wael geschrijuen en
kan, as sij geyn eygen litter in deme lande en hauen.
item van deser albanyescher spraechen hayn ich etzliche
woert behalden, as mit namen sij hie vnden geschreuen
10 staynt nae vnsz litteren zo schrijuen.

Item albanische spraiche.

	Item boicke broyt	fijet	slaeffen
	vene wijn	mirenestrasse	guden morgen
	oie wasser	myreprama	guden nacht
15	mische fleysch	meretzewen	guden daich
	jat kese	ake ja kasse zet ve	wat haistu
	foeije eyer	dat mir beuelt	
	oitter essich	kess felgen gyo kaffs	wat gylt dat
	poylle eyn henne	do daple ich wyl it gelden	
20	pyske vyssche	laff ne kammijss	wessche mir
	krup sals	mijn hempt	
	myr goyt	ne kaffs,	wie heyscht dat
	kyckge buesse	Tzellen.	
	megarune essen	nea	eyn
25	pijne drincken	dua	tzwey
	tauerne eyn wirthuys	trij	drij
	geneyre eyn man	quater	vier
	growa eyn frauwe	pessa	vunff
	denarye wijsgelt	jast	sees
30	sto ja	statte	seuen
	jae neyn	tette	acht
	criste got	nante	nuyne
	dreck der duuel	dieta	tzien
	kijrij eyn kertz	nijtgint	hundert
35	kale eyn pert	nemijgo	ducent
	elbe hauer		

Item van Duratzo zo Saseno lxx mijlie
voeren wir in vunff vren. dit is gar eyne gude portz des
mers. item dyt Saseno is gar eyn kleyn insell des Tur-
cken. item hie off lijgen gar kleyne tzwae grece capellen,
40

3. "Fjalorthi shqip-gjermanisht i Arnold fon Harfit", punë pioniere në disa fusha

"Fjalorthi i Arnold fon Harfit" në kontekstin e dokumenteve të shkruara të shqipes nuk është vetëm një nga dokumentet e para të gjuhës shqipe.

Fillimisht ai trajtohet si një nga dokumentet e para të gjuhës shqipe, duke u renditur pas "Formulës së pagëzimit" (1462), dhe krahas "Perikopesë

së ungjillit” me vit të përafërt me dokumentin e parë etj. Studiues të ndryshëm vënë edhe para këtyre dokumenteve, por edhe në mes tyre fjalë, fjali, fraza që mund të jenë të gjuhës shqipe (Demiraj, 1989, Ushaku, 2011).

Por ky dokument i shkruar i shqipes nuk ka vetëm rëndësi të pjeshme, po ka rëndësi të shumanshme dhe në disa aspekte:

1. Së pari, pas dëshmisë së Brocardus Monakus në Tivar dhe ekzistimit të huazimeve në gjuhën shqipe nga greqishtja e vjetër dhe ekzistimit të leksikut detar të shqipes (Dodbiba, 1971, Ushaku, 1981, Ulqinaku, 2011) në të folmet e shqipes, “Fjalorthi i Harfit” është fakti tjetër se shqipja ka ekzistuar si gjuhë e folur, por me mundësi që të ketë qenë e shkruar edhe në zonat bregdetare të Adriatikut dhe Jonit, duke përforcuar pohimin se shqiptarët dhe gjuha e tyre është folur edhe në zonat bregdetare.

2. Në planin e interesimeve të gjermanofolësve, përkatësisht studiuesve për gjuhë të kërkimeve të tyre kanë pasur gjermanishten, Arnold fon Harfi është pionieri i interesimeve për gjuhën shqipe, në mos tërësisht i pari.

3. Në planin e historisë së leksikografisë shqipe “Fjalorthi i Arnold fon Harfit shqip-gjermanisht” është e para listë e fjalëve në të cilat shqipja vihet përballë gjuhës gjermane. Nëse kërkimet në të ardhmën nuk do të sjellin në dritë ndonjë formë fjalori ku shqipja është një nga gjuhët përbërëse, apo si e vetme “Fjalorthi i Harfit” mund të konsiderohet si fjalori i parë i gjuhës shqipe në miniaturë, edhe pse fjalori i parë klasik në gjuhën shqipe konsiderohet “Fjalori latisht-shqip” i Frang Bardhit.

4. Ky “Fjalorth”... është i rëndësishëm edhe për të parë gjendjen e shqipes, për aq sa mund të vrojtohet përmes numrit të kufizuar të fjalëve, të frazave dhe të numrave që janë në kuadër të tij, megjithëse duhet qenë të kujdesshëm sa i përket (mos) besnikërisë së shënimit të tyre nga një i huaj në raport me origjinalin. Si i këtillë ai mund të shërbejë si bazë e mirë për të rikonstruktuar disa nga veçoritë e shqipes së atëhershme, duke parë edhe përafëritë, por edhe dallimet me të folmet e tjera.

5. “Fjalorthi i Harfit”, “Dëshmia e Brokadit” dhe “Meshari i Buzukut”, dëshmojnë se rrënjët e shqipes së shkruar dalin në mënyrë të bindshme në qytetin e Ulqinit e të Tivarit, me rrethinat e tyre, duke i bërë ato edhe dy qendrat e shqipes së shkruar në kohën përkatëse. Në këtë mënyrë krijohet restrospektiva e qartë e historisë së shqipes së shkruar se aty ku aktualisht

gjuha shqipe është periferike, në kontaktin kohor të shekullit XV, kishte qenë në mes të shtrirjes së saj gjeografike, pas ajo del edhe përmes fakteve të shkruara.

6. Dhe së fundi, në planin e interesimeve të gjermanofolësve, përkatësisht studiuesve për gjuhë të kërkimeve të tyre kanë pasur gjermanisht Arnold fon Harfi është pionieri i interesimeve për gjuhën shqipe, në mos krejtsisht i pari. Ai iu hapi rrugën gjuhëtarëve gjermanë e austriakë të cilët shqipen nuk e kishin vetëm si pjesë të interesimit të tyre në kuadër të gjuhëve të tjera qofshin ballkanike e të tjerë, por e vunë atë në qendër të kërkimeve të tyre.

REFERENCAT:

- Demiraj Shaban, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë, 1989, f. 247, 248, 249.
- Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Coln durch Italien, Syrien, Aegypten, Arabien, Aethiopien, Nubien, Palastina, die Turkei, Frankreich und Sappnien wier er sie in den Jahren 1496 bis 1499
- Elsie Robert, Historia e letërsisë shqiptare, Pejë-Tiranë, f. 26, 27, 28.
- Groote, E. von (ed.) Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Cöln durch Italien, Syrien, Ägypten, Arabien, Äthiopien, Nubien, Palästina, die Türkei, Frankreich und Spanien, wie er sie in den Jahren 1496 bis 1499 vollendet, beschrieben und durch Zeichnungen erläutert hat. (J. M. Heberle, Cologne 1860) 280 pp.
- Honemann, Volker Zur Überlieferung der Reisebeschreibung Arnolds von Harff. in: Zeitschrift für deutsches Altertum und deutsche Literatur 107 (1978), p. 165-178.
- Letts, Malcolm Henry Ikin, The pilgrimage of Arnold von Harff, knight, from Cologne, through Italy, Syria, Egypt, Arabia, Ethiopia, Nubia, Palestine, Turkey, France and Spain, which he accomplished in the years 1496 to 1499. Translated from the German and edited with notes and an introduction by Malcolm Letts. Works issued by the Hakluyt Society. Second series, No. XCIV. (Hakluyt Society, London 1946, reprint 1967) 325 pp.
- Probleme të histories së gjuhës shqipe, artikulli Lirak Dodbiba, Leksiku i sotëm detar në elementet e tij të pahuazuara, f. 375-446, Prishtinë, 1981.
- Shuteriqi Dhimitër, Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Prishtinë, 1978, f. 37.
- Ulqinaku Hajro, Glosar, fjalorth i detarisë i të folmes së Ulqinit, Ulqin, 2011
- Ulqinaku Hajro, Zëri i detit, Ulqin, 2017, f.186.
- Ushaku Ruzhdi, Kërkime filologjike, Prishtinë, 1981.
- Ushaku Ruzhdi, Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi, Ulqin, 2010.
- Ushaku Ruzhdi, Shqipja si çelës për dy fraza enigmatike, Ulqin, 2011.

Mario de MATTEIS, Universiteti i Tiranës
Brikena KADZADEJ, Universiteti i Tiranës

NDIHMESA E STUDIUESVE TË RINJ SHQIPTARË NË HAPËSIRËN GJERMANISHTFOLËSE, PAS KTHESËS

Jo më kot kjo kumtesë mban titullin “Ndhimesa e studiuësve të rinj shqiptarë në hapësirën gjermanofolëse, pas Kthesës”, sepse si në çdo fushë tjetër, edhe në përgjithësi në fushën e arsimit dhe të shkencës pati ndryshime në fillim të viteve '90, ku edhe u hap Shqipëria.

Në këtë kontekst çelja e departamentit të gjuhës gjermane në vitin 1992, me mbështetjen e vendeve gjermanofolëse, ishte çast i rëndësishëm.

Kjo gjë bëri që të hapet për herë të parë një rrugë e re për mësimin e gjuhës gjermane dhe si çdo gjë e re, kishte vështirësitë dhe sfidat e veta.

Kushtet historiko-shoqërore, ekonomikopolitike e bënë të vështirë, madje të pamundur kryerjen e studimeve pasuniversitare (mastera e doktorata), pra ndër të tjera mungonte përvoja, struktura etj.

Tradita e vjetër e studiuësve gjermanofolës që i ka fillimet e hershme që me Hanin, i cili la për një çast diplomacinë dhe zgjati dorën më tej dhe mori penën e shkroi gramatikën shqipe, hodhi bazat e gjuhësisë shqiptare. Kjo traditë u ruajt dhe u zbatua më fort nga shtetet gjermanofolëse pas Kthesës, nga DAAD-ja (Deutscher Akademischer Austauschdienst), duke mbështetur shkencëtarë të rinj për studime pasuniversitare në këto vende dhe duke dërguar pedagogë dhe profesorë në universitetet shqiptare (DAAD-ja, Fondacioni Herder (Herder-Stiftung), Fondacioni Bosh (Bosch-Stiftung), ÖSD etj.)

Këtë fat, e pata ndër të parët edhe unë, mbështetje që vazhdon gjatë, madje edhe sot.

Kur hulumtoja në Gjermani, në një bibliotekë, midis të tjerash, hasa një fragment të albanologut të madh Norbert Jokli që shprehej: “Gjuha e shqipëtarëve apo skipëtarëve deri sot ka mbetur një thjeshtë e gjuhësisë indogjermane. (Die Sprache der Albaner oder Skipetaren ist bis heute ein Stiefkind der indogermanischen Sprachwissenschaft geblieben)...”¹

¹ Norbert Jokl: Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des - Sprach- und Kulturwissenschaft, Leipzig 1923, S. 109.

Në atë sallë të ngrohtë, plot libra, ndjeva të ftohtë nga ndjesia për vendin e popullin tim. Kjo zgjati pak sepse menjëherë solla në kujtesë rendin e gjatë të studiuesve shqiptarë patriotë dhe të huajve dashamirës që punuan për shqipen dhe që tani ajo qëndron me dinjitet midis motrave të saj indoevropjane. Natyrisht nuk qe e lehtë, madje e vështirë për një gjuhë pa dokumente, gjuhë e një populli, e një kombi që me përkushtim nuk e la të humbiste.

Punimet e fundit për shqipen që preka atje ishte punimi i Prof. Bardhyl Demirajt dhe gramatika për shqipen të hartuara nga të huaj.

Punimet shkencore për mbrojtjen e titujve (si fillim të pakta në numër) në hapësirën gjermanishtfolëse, janë kryesisht përfaqësive shqip-gjermanisht.

Për këto të dhëna ne i jemi referuar stafit të gjermanistikës në hapësirën shqipfolëse. Pra mund të ketë edhe ndonjë punim tjetër që nuk e kemi hasur dhe lënë jashtë kumtesës.

Kronologjikisht ndër punimet e para është ai i Profesor Bardhyl Demirajt nga fusha e etimologjisë indogjermane (“Albanische Etymologien - Untersuchungen zum albanischen Erbwortschatz”) dhe i Dr. Pandeli Panit nga fusha e morfologjisë dhe pikërisht diatezat dhe bazat e tyre indogjermane 1997 në Gjermani. (“Diathesen im Albanischen und ihre indogermanischen Grundlagen”)

Më pas punim im i doktoraturës nga fusha e sociolinguistikës, mëtodikës dhe e komunikimit, “Format e të drejtuarit, të përshëndetjes dhe të ndarjes në shqip-gjermanisht, përfaqje krahasuese” (“Anrede- und Grußformen im Deutschen und Albanischen. Ein kontrastiver Vergleich” 2004 në Gjermani) dhe në 2007 vijon Profesor Arbër Çeliku me “Koherencën e tekstit në gjermanisht dhe shqip” në Gjermani. (“Herstellung von Textkohärenz im Deutschen und im Albanischen”).

Punime përfaqësive pasojnë më vonë edhe në hapësirën gjermanofolëse në Austri, një punim nga fusha e letërsisë për këngët e heronjve shqip-gjermanisht, kënga e Nibelungëve dhe cikli i Mujit e i Halilit... (Bora Bushati “Vergleichende Studie zwischen der germanisch-deutschen und der albanischen Heldendichtung am Beispiel des Nibelungenliedes und des Liedzyklus Muji dhe Halili).

Po ashtu një punim nga fusha e metodikës dhe e gjuhësisë për kompetencën gjuhësore dhe të tekstit në përvetësimin e gjuhës së huaj, përfaqësive edhe ky (Edlira Bushati “Sprachkompetenz oder Textkompetenz. Leitkom-

petenz beim Fremdsprachenerwerb? Eine empirische Untersuchung schriftlicher Sprachproduktion deutschlernender Shkodraner).

Fusha e leksikologjisë trajtohet me punimin “Ndërkombëtarizmat në shqip” nga Profesor Izer Maksuti (“Internationalismen im Albanischen” 2010 në Austri), ndjekur nga punimi po nga kjo fushë pikërisht për “Konceptet metaforike, frazeologjizmat somatike në shqip dhe gjermanisht” (Dr. Sonila Sadikaj “Metaphorische Konzepte in somatischen Phraseologismen des Deutschen und Albanischen. Eine kontrastive Untersuchung anhand von Herz- und Handsomatismen”) në Gjermani dhe “Fjalët brizante në Shqipërinë pas viteve '90” As. Prof. Ema Kristo, Gjermani.

Në këto pesë vitet e fundit kemi punime sërish nga morfologjia për modalitetin në përqasje shqip-gjermanisht (As. Prof. Vjosa Hamiti “Epistemische Modalität – die Äußerungsmöglichkeiten im Deutschen und ihre Äquivalenten im Albanischen”, Austri)

Si dhe në 2016 punimi për “Politikën arsimore dhe atë gjuhësore, të gjuhës së huaj në Kosovë. Fokus gjermanishtja si gjuhë e huaj” në Austri (Kimete Canaj “Bildungs- und (Fremd-) Sprachenpolitik in Kosovo Schwerpunkt. Deutsch als Fremdsprache).

Sic edhe konstatohet kemi të bëjme me punime në një shtrirje kohore që pas Kthesës me tematikë përqasëse dhe që kanë pasur si qëllim që të japin një ndihmesë modeste në të dyja gjuhët.

Një etapë tjetër në mbështetje të studimeve përqasëse shqip-gjermanisht është botimi i **Albanische Universitätsstudien** (Studime universitare shqiptare) me iniciues të dërguarin e Fondacionit Herder Prof. dr. Mario de Matteis dhe mbështetur fillimisht nga Fondacioni Herder, DAAD, UT etj.

Kjo seri u mendua si një podium i rrahjes së mendimeve dhe si produkt i shkëmbimit shkencor në hapësirën gjermanofolëse dhe më tej, siç evidentohet nga citimet në internet.

Kuptohet që ishte një rrugëtim kompleks por sfida që e fortë.

Një panoramë e shkurtër mbi AUS (Albanische Universitätsstudien).

Kjo seri përmbledh 11 vëllime, nga të cilat 3 janë botime të veçanta:

Vëllimi I hapet me një monografi të studiuesit Prof. Abdullah Ballhysa “Për formimin e aftësive komunikative”. (2010)

Vëllimi II: “Metodika dhe didaktika për mësimin e gjuhës gjermane” (2008).

Vëllimi III: “Gjuha e specialitetit (Gjermanishtja si gjuhë e huaj), ndërkulturaliteti dhe qytetërimi (2010).

Vëllimi IV: “Ndërkulturaliteti në hulumtim dhe në teori” (2010).

- Vëllimi V: “Aspekte të komunikimit në gjermanisht dhe në shqip”, monografi (2010).
 Vëllimi VI: “Gjuhë, letërsi dhe didaktikë” (2010).
 Vëllimi VII: “Mediat dhe ndërkulturaliteti në mësimin e gjermanishtes” (2012).
 Vëllimi VIII: “Gjermanistika e huaj në hapësirën shqipfolëse” (2012).
 Vëllimi IX: “Format e të drejtuarit, të përshëndetjes në shqip dhe gjermanisht” (2011).
 Vëllimi X: “Diversiteti gjuhësor dhe ndërkulturaliteti” (2013).
 Vëllimi XI: “Didaktika, gjuhësia, letërsia, pedagogjia” (2014).
 Vëllimi I, i veçantë: “Johann Georg von Hahn-Nga Gjermanistika në Albanologji” (2011).
 Vëllimi II, i veçantë: “Gjuha në foto dhe fotoja në gjuhë” (2012)
 Vëllimi III, i veçantë: “Tekst mësimor dhe pune për gjuhën shqipe”, Prof. Emine Sadiku (2016).

Duhet theksuar se një rol të rëndësishëm për publikimin e kësaj serie ka luajtur shtëpia botuese e njohur gjermane Athena në Oberhausen, Gjermani.

Kjo seri, botuar në Gjermani, përmban një spektër aktual dhe të gjerë fushash hulumtimi të orientuara edhe didaktikisht si: gjermanistika jashtë vendit, gjuhësia pothuaj me të gjitha disiplinat e saj, komunikimi ndërkulturore, kultura, letërsia, qytetërimi dhe albanologjia.

Ajo që i jep vlerë këtij shkëmbimi shkencor është mbikëqyrja dhe pjesëmarrja konkrete e personaliteteve sipas fushave, filluar me Prof. Richard Funck, Prof. Werner Biechele dhe Prof. Barbara Biechele, Prof. Hans Rüdiger Fluck, Prof. Siegfried Grosse, Prof. Roland Harweg, Prof. Karin Kleppin, Prof. Horts Raabe, Prof. Frank Hoffmann, Prof. Wilhelm Schellenberg,, Prof. Jörg Roche, Prof. Basil Schader, Prof. Peter Colliander, Prof. Bardhyl Demiraj, Prof. Emil Lafe, Dr. Ardjan Klosi (†), Dr. Kurt Gostenschnigg, Dr. Rolf Ködderitzsch, Michael Schmidt-Neke etj.

Më poshtë do të trajtomë shkurt disa prej temave të trajtuara në këto fusha.

Fushë e rëndësishme mbi të cilën është shkëmbyer në këtë seri, është edhe gjermanistika jashtë vendit, pra këndvështrimi i probleme të gjuhësisë gjermane nga studiues dhe njësi shkencore jashtë hapësirës gjermanofolëse, një vend të rëndësishëm këtu janë publikimet e Prof. Peter Colliander, në lidhje me testimin, apo letërsia për udhëtimet dhe didaktika e Jürgen Röhling, puna me tekstet ndërkulturore dhe problematika e gjermanistikës dhe sistemit të Bolonjës në Shqipëri. Botime kryesisht nga gjermanofolës nga hapësira gjermanofolëse.

Metodika dhe didaktika

Janë të përfaqësuara nga një larmi temash që lidhen direkt me metodikën dhe didaktikën e të mësuarit si p.sh. mësimdhënia e orientuar nga veprimi (Edvin Cami), të mësuarit ndërkulturor (Brikena Kadzadej), nga shkrimi krijues në të menduarin e pavarur shkencor (Jenny Prieser), metodat, teknikat e punës dhe fushat e kompetencës gjatë përvetësimit të gjuhës së gjermanishtes si gjuhë e huaj (Mario de Matteis), të kuptuarit e frazeologjizmave në mësimin e gjuhës gjermane (Milote Sadiku), larmia gjuhësore si një rezervë mësimdhënëse (Basil Schader) apo trajtimi i shprehisë së të lexuarit (Hans Zeller, Thomas Färber) etj.

Metodika dhe didaktika janë pjesë përbërëse edhe në fushat e tjera të trajtuara në këtë seri.

Mediat në mësimdhënien e gjermanishtes si gjuhë e huaj

Një vend me rëndësi sot në mësimdhënie kanë mediat, që lehtësojnë dhe pasurojnë me informacine mësimdhënien. Kështu ndër të tjera në këtë seri trajtohet roli i mediave të reja në mësimdhënie (Mario de Matteis), kurset online, Paland përvojë nga Universiteti i Mynihut, vlerat e shumta të mediave (Jörg Roche).

Në këtë linjë kemi trajtimin e filmit si një mjet për mësimdhënie, kështu të parët, të dëgjuarit sjellin të kuptuarit: Të kuptuarit e filmit në konceptin e shprehive të një mësimi modern të gjuhëve të huaja, përpjekje për të dhënë në praktikë filmat në mësimdhënie. Po ashtu trajtohen këngët në mësimdhënie.

Një vend të rëndësishëm zë trajtimi i **gjuhës së specialitetit**, si gjuha e administratës në të shkuarën dhe në të tashmen, të trajtuara këto nga personalitete të gjuhësisë gjermane si Prof. Hans-Rüdiger Fluck, apo mësimi bilingual etj.

Vendin më të madh e zënë në këtë seri botimet për gjuhësinë gjermane, kështu nga gramatika kemi ndër të tjera tema si “Aspekti dhe referencat emërore në gjermanisht” (Teuta Abrashi), “Kompleksitetit i sistemit të gjinisë të gjuhës gjermane, si burim i rëndësishëm për gabimet e atyre që mësojnë gjermanisht” (Edlira Bushati), “Koherenca e tekstit” (Arbër Çeliku), “Trajtimi i kohës së shkuar në gjuhën shqipe bazuar tek “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (Sadije Rexhepi), “Shqarësia dhe pashqu-

arësia në gjermanisht dhe në shqip”. (Elda Gjanaj-Boriçi), “Emrat e përkëdhelisë dhe fjalët e përkëdhelisë në shqip” (Brikena Kadzadej), “Dëshirorja e shqipes dhe përkthimi i saj në gjermanisht” (Blertë Ismajli), “Pasivi në gjermanisht dhe shqip” (Ergys Prifti), “Fjalja në gjermanisht dhe shqip” (Gentian Sadiku) etj.

Veçanërisht e trajtuar dhe rimarë sërisht është disiplina e leksikologjisë me punime si “Formimi i mbiemrave në shqip dhe gjermanisht” (Migena Sejдини), punime të shumta për frazeologjinë, përkthimin, gjegjëset e saj në shqip. (Sadikaj, Sadiku, Kadzadej) etj.

Komunikimi

Po ashtu edhe fusha e komunikimit si një fushë relativisht e re në krahasim me disiplinat e tjera të shkencës së gjuhësisë është trajtuar gjerësisht si p.sh. “Pjesët e ligjëratës në reklama” (Brikena Kadzadej), “Gjuha dhe fotografia në lamërimet e reklamave në gjuhën gjermane dhe shqipe” (Sonila Sadikaj), “Aspekte të komunikimit” (Brikena Kadzadej).

Tema e komunikimit del e ndërthurur me ndërkulturalitetin si edhe me disiplina të tjera sic është edhe vetë realiteti.

Kultura dhe letërsia

“Kultura, një sfidë për biznesin ndërkombëtar” (Ema Kristo), “Shqipëria në tekstet e autorëve të Republikës Demokratike Gjermane” (Jürgen Röhling), “Figura e Gëtes në gazetat shqiptare”, “Gëtes dhe e Shilerit në kulturën shqiptare”, “Elemente të Verterit në letërsinë shqiptare” (Albulena Blakaj), “Stili i romanit në veprën e Fatos Kongolit” (Severina Pasho), “Evidentimi i figurave femërore në veprën e De Radës moderne letrare” (Natasha Shuteriqi).

Qytetërim dhe ndërkulturaliteti

“Vendi i kujtesës metalurgjiku” (Wolf Dieckmann), “Qytetërimi induktiv dhe ndërkulturor, qytetërimi në mësimdhënie, njerëzit në kafë, kafëja ndërkulturore” (Ida Kurti, Shakire Sabriu), “Çfarë tregojnë monedhat për kulturën e popullit shqiptar” (Mario de Matteis), “Qytetërimi ndryshe. Kush jemi ne dhe kush janë gjermanët?” (Charlotte Siegerstetter), “Trans-

metimi i aspekteve ndërkulturore nëpërmjet teksteve letrare, stereotipat në mësimin e gjuhës së huaj” (Klodjana Venetiku), “Diversiteti gjuhësor dhe ndërkulturaliteti” (Wilhelm Schellenberger), “Përvetësimi i gjuhës së dytë nga fëmijët me sfond migrimi” (Gëzim Xhaferi).

Albanologjia

Albanologjia është e përfaqësuar jo vetëm në të gjitha vëllimet, por edhe me botimin e veçantë, kushtuar albanologut të shquar Johann Georg von Hahn.

Kështu kemi botimin e Bardhyl Demirajt: “Probleme të lëna: Vendbanimet e shqiptarëve në mesjetë (shekulli 6-9)”, Emil Lafe: “Johann Georg von Hahn – Themelues i albanologjisë moderne”, Kurt Gostentschnigg: “Johann Georg von Hahn dhe albanologjia austro-hungareze midis shkencës dhe politikës”, Michael Schmidt-Neke: “Mendimi politik i Johann Georg von Hahn-it”, Mario de Matteis: “Antologjitë dhe studimet e Johann Georg von Hahn-it mbi folklorin shqiptar, Izer Maksuti: “Një vështrim i shkurtër historik për albanologjinë gjermanofolëse”, Ajula Jubani: “Sistemi fonetik në gramatikën shqipe të Johann Georg von Hahn-it”, Brikena Kadzadej: “Vëzhgime për gramatikën (morfologjinë) e Johann Georg von Hahn-it dhe disa gramatika të mëpastajme”, Odette Marquet: “Përse paraqitja në gjuhën shqipe e tri letrave të Johann Georg von Hahn-it mund të jetë me interes?” Ardjan Klosi (†): “Johann Georg von Hahn dhe Karl Reinhold: Si u transkriptua shqipja 155 vjet më parë”, kontributi i tij i fundit etj.

Vëllimi i dytë i veçantë përmban diskutime dhe trajtime përfaqësive të gjermanistëve të ballkanit. Diskutime dhe trajtime që shpesh ndihmojnë për të kuptuar dhe vlerësuar fenomene të ngjashme gjuhësore.

“Dituria”

Die Zeitschrift für Germanistische Sprach- und Literaturwissenschaft, pra revista shkencore për gjuhësinë dhe letërsinë gjermane, mbështetur fillimisht nga Konferenca e Rektorëve të Shkollave të Larta 2006, ku është edhe përirimi i saj dhe vijon edhe sot nën mbështetjen e DAAD-së dhe të Universitetit të Heidelberg-ut.

Këtë botim shkencor në gjuhën gjermane dhe për gjermanistikën e

kemi titulluar shqip “Dituria” në vijim të traditës shqiptare dhe semantikës së saj në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

Drejtues i revistës është Prof. Dr. Jörg Riecke, Drejtor i Institutit të Gjermanistikës në Heidelberg si edhe bashkëautorë Brikena Kadzadej, Mario de Matteis dhe Jürgen Röhling.

Kjo revistë është pjesë e forumit të gjermanistëve shqiptarë, të hapësirës gjermanofolëse, të Rajonit e më gjerë.

Botimet e bëra deri në numrin 11 përfshijnë disiplina të ndryshme të gjuhësisë, tematika të larmishme përfaqëse nga letërsia, kultura, përkthimi etj. Këtu paraqiten me publikime përfaqëse studiues të rinj të gjermanishtes dhe të njohur nga hapësira shqipfolëse si p.sh. Teuta Abrashi, Arbër Çeliku, Edlira Bushati, Albulena Blakaj, Izer Maksuti, Klodjana Venetiku, Vjosa Hamiti, Erta Spaho, Milote Sadiku etj.

Si seria e studimeve ashtu edhe revista “Dituria” janë tashmë të paraqitura hollësishtëm në internet dhe ofrohen nga pothuaj të gjitha bibliotekat e hapësirës gjermanofolëse, në Rajon dhe më gjerë.

Shpresoj të kemi dhënë dicka më këto publikime përfaqëse shkencore, që padyshim hedhin ujë edhe në shkencat albanologjike.

BIBLIOGRAPHIE

- De Matteis Mario (2014), *Albanische Universitätsstudien – Studienbibliographie* (Auslandsgermanistik, Sprachwissenschaft, Interkulturelle Kommunikation, Kultur, Literatur, Landeswissenschaft, Albanologie), Athena-Verlag, Oberhausen.

Miradije BERISHAJ, Universität Wien
Gjovalin SHKURTAJ, Universiteti i Tiranës
Me ideimin dhe nën kujdesin e Akademik Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaaj

PANORAMË E STUDIMEVE ALBANALOGJIKE DHE E MËSIMIT TË SHQIPES NË DIASPORËN SHQIPTARE NË REPUBLIKËN E AUSTRISË

Hyrje

Shqiptarët janë një prej popujve më të lashtë autoktonë në kontinentin evropian, me një histori mijërvjeçare, të ngarkuar me luftëra, rrudhje kufijsh, pushtime, përndjekje nga të cilat kanë përjetuar dhimbje dhe emigrime të njëpasnjëshme nëpër epoka. Përkundër këtyre përjetimeve të dhimbshme, shqiptarët kanë mbijetuar, duke trashëguar gjuhën e tyre amtare, duke ruajtur doket dhe zakonet, artin, kulturën e traditat shqiptare, të cilat ishin dhe mbetën bërthama e çështjes kombëtare. Shpërnguljet e para shqiptare janë shumë të lashta, për to është folur e shkruar nga historianë shqiptarë e të huaj, shkrimtarë e poetë të shquar.

Kontingjenti më i ri i emigrantëve janë ata të ikur nga Kosova, të përndjekur, të përbuzur, të shtypur, të nënçmuar kryesisht nga pushtuesi, të cilët kërkuan shpëtim në të katër anët e botës. Shumë nga këta mërgimtarë ishin njerëz të thjeshtë, por kanë mërguar edhe njerëz të pendës, poetë, krijues të lëmenjve të ndryshëm dhe ekspertë. Disa nga mërgimtarët tanë, në vendet ku kanë mërguar kanë vazhduar të shkollohen, të studiojnë dhe janë bërë të njohur. Fatkeqësisht ka edhe nga ata që kanë mërguar dhe që, për një kohë të shkurtër, janë në proces të asimilimit (apo dhe janë asimiluar tashmë), ku kategoria më e ndjeshme janë fëmijët, të cilët kanë ardhur të vegjël apo kanë lindur në vendet e emigrimit të prindërve.

Prindërit, intelektualët tanë e veçanërisht mësuesit, të cilët përballë rrezikut të asimilimit që do t'u kanosej fëmijëve tanë në mërgim, nisën veprimtaritë e tyre për mundësinë e hapjeve të paraleleve të shkollave shqipe me mësim plotësues në shqip. Me gatishmërinë e kuadrit tonë profe-

sional arsimor, si dhe me mirëkuptimin e organeve vendore austriake, organet arsimore të Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës, janë hapur shkolla shqipe me mësim plotësues në çdo land, qytet, aty ku ka pasur vullnet, dhe ka pasur nxënës shqiptarë.

Fati e ka prurë që, edhe unë, prej disa vitesh, si mësuese në Austri, të jem përfshirë në këtë nismë arsimore e me rëndësi kombëtare, po edhe formative të fëmijëve shqiptarë që rrojnë e po rriten në Austri. Si postulat i krejt punës sime hulumtuese dhe si mësimdhënëse e shqipes në prefekturat e Tulln-it dhe Krems-it të Austrisë ka qenë mbështetja në konceptimin e gjuhësisë teorike dhe sidomos në sociolinguistikë, se gjuhët shpesh krahasohen me ujërat që rrjedhin. Sipas Akademik Gjovalin Shkurtaj: *"Pra, është edhe e natyrshme që sot e në rrjedhë të viteve që do të vijnë shqipja e grupeve të vogla të shqiptarëve në dhe të huaj, është si rrjedhat e vogla në një det të madh, i cili i përfshin dhe i merr me vete. Fëmijët shqiptarë, në vende të ndryshme të Evropës e më gjerë, shkojnë në shkolla ku mësimi bëhet në gjuhët e huaja përkatëse. Po edhe domosdoshmëria për ta përballuar jetën atje i detyron t'i nxënë sa më mirë gjuhët e huaja. Kështu, dalëngadalë, po të mos ketë kurse a shkolla plotësuese të shqipes, si dhe kur në shtëpi nuk flitet më në gjuhën shqipe, atëherë kuptohet se shqipja dhe kultura shqiptare do të shkojnë drejt rrudhjes"*¹.

Duhet të theksojmë se problemi kryesor i një popullsie të emigruar është raporti me gjuhën e vet amtare. Edhe për familjet e emigrantëve shqiptarë në Austri, ashtu si kudo në Evropë e më gjerë, çështja e përvetësimit të gjuhës shqipe prej fëmijëve të tyre përbën një problem të ndërlikuar, dhe në zgjidhjen e këtij problemi ata nuk duhet të lihen vetëm, por duhet të ndihmohen me të gjitha mënyrat nga bashkësia shqiptare dhe ajo e vendit ku banojnë.

Mërgata jonë duhet të shfrytëzojë më shumë mundësitë që ofron shteti austriak për integrim dhe përfshirje në jetën arsimore, shoqërore dhe politike. Në të njëjtën kohë duhet vazhduar që me krenari të ruajmë, gjuhën traditën, kulturën dhe artin tonë të cilin duhet prezantuar para vendasve dhe komuniteteve tjera që jetojnë këtu. Këto vlera kombëtare duhet t'ua përcjellim breznive të reja, të cilat po rriten në këtë vend. Ne mundemi që, një-

¹ Shkurtaj, Gj.: *Sociolinguistika*. Tiranë 2003

kohësisht, të jemi evropianë të mirë dhe të mbesim shqiptarë të devotshëm dhe krenarë për identitetin tonë. E gjithë kjo arrihet, së pari, duke e ruajtur dhe kultivuar gjuhën si çelës dhe promotor i të gjitha veprimtarive të tjera.

Në këtë temë do të trajtohet:

1.Shkurtesë e historikut të shpërnguljes së shqiptarëve në Austri (1900-2017)

Në Republikën e Austrisë vendosja e intelektualëve shqiptarë e ka zanafillën qysh në fillim të shekullit XIX. Shkencëtari i njohur Miklosich, në veprën “Albanische Forschungen”², të botuar në Vjenë më 1870, e përmend këtë fakt. Me shumicë shqiptarët erdhën në Austri kah fundi i viteve ‘60, kryesisht për shkaqe materiale, nga kushtet e vështira ekonomike shumë mërgimtarë morën rrugën e u vendosin me punë në Austri. Ishin këta persona pa familje, që erdhën për të fituar e për t’u kthyer.

Figurë intelektuale, patriotike, vizionare etj. i asaj periudhe ishte Gjergj Pekmezi, gjuhëtar dhe publicist, i cili hapi katedrën e gjuhës shqipe pranë Universitetit të Vjenës më 1898 dhe afër 40 vite të jetës së tij ia kushtoi studimit dhe mësimin të gjuhës shqipe, dhe bashkë me austriakun Maximilian Lambertz botoi librin e parë për mësimin e gjuhës shqipe për nxënësit gjermanishtfolës.

Si figurë tjetër shumë përfraqësimitare dhe domëthënëse për intelektualët në mërgim mund të përmendim Aleksandër Moisiun³ (2 prill 1879 – 23 mars 1935), artistin me talentin e rrallë, i cili mes viteve 1910 –1930 padyshim se ishte aktori më i famshëm në viset gjermanishtfolëse. Ai luajti në teatër dhe interpretoi personazhet e mëdha të veprave madhore të dramaturgjisë botërore të asaj kohe.

Pas viteve ‘40 të shekullit të kaluar, deri në vitet ‘80 veprimtaria e shqiptarëve në Austri në përgjithësi dobësohet dhe zbehet. Pas vitit 1981 e sidomos pas vitit 1990 shtetit austriak ia “mësyjnë” shumë shqiptarë e ndër ta edhe shumë intelektualë. Vitet 1995-2000 shquhen për një interesim të

² F. X. R., Miklosich: *Albanische Forschungen*. Wien, 1870, f. 10.

³ Gazeta “Dialeria”, *Një natë me Moissi-un*. Vjet I, Nr.4, koorik, 1920. f. 2., Vjenë.

madh të rinjve shqiptarë për të studiuar në Universitetet austriake. Në këtë shtet, gjatë kësaj kohe, janë formuar dhe funksionojnë më shumë se 50 shoqata të ndryshme kulturo-artistike, humanitare, sportive etj. në të gjitha pjesët e këtij vendi. Gjithashtu kemi edhe formimin dhe jetësimin e “Instituti Shqiptar i Kulturës” në Vjenë.

2. Fillimet e Albanologjisë në Austri: Katedra e albanologjisë në Vjenë: ndihmesa e Dr. Gjergj Pekmezit.

Dihet se shqipja, përveç shtyllës së saj bazë të leksikut amtar apo, sikundër thuhet shpesh, iliro-shqiptar, përmban edhe ndikime nga disa gjuhë të tjera, që lidhen me epoka të caktuara pushtimesh e depërtimesh kulturore. Nga ana tjetër, mbesin në mesin e gjuhëtarëve të djeshëm e të sotëm, pika të zjarrta debati mes rretheve pro dhe atyre kundër, që tentojnë të zbardhin një nga pretendimet më të hershme mbi etnogjenezën e shqiptarëve, çelësi i të cilës dihet se kërkohet të gjendet pikërisht tek gjuha.

Katedrat e para të gjuhës shqipe jashtë kufijve të shteteve shqiptare, historikisht merren ato të Vatikanit dhe Vjenës në fund të shekullit XIX. Mësimi i gjuhës shqipe në Austrinë e asaj kohe lidhet sidomos me emrin e Dr. Gjergj Pekmezit, si njëri nga veprimtarët pararendës të kësaj plejade studiuesish, me nismën e tij në Institutin Orientalistikës⁴ së Vjenës u hap katedra e parë e gjuhës shqipe në vitin 1903, njëra nga të parat në Evropë dhe në botë, ku do studiohej gjuha shqipe. Ai ishte edhe një nga të parët ligjërues të gjuhës shqipe në këtë institut deri në vitin 1938. Ai, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, hartuan brenda disa viteve veprat kryesore dinaktike për mësimin e gjuhës shqipes në këtë periudhë. Po i përmendim disa: *Gramatika e gjuhës shqipe*, *Guidë gjuhësore për mësimin e shpejtë të gjuhës shqipe*, “Libër mësimi dhe leximi i gjuhës shqipe”⁵, Më 1914 Pekmezi boton, së bashku me Nikolla Rrotën, “Thënie dhe shprehje shqip” etj.⁶

Në Austri mësimdhënia e gjuhës shqipe ka filluar në gjysmën e dytë

⁴ Instituti i Indoevropianistikës (gjerm. Institut für Indogermanistik) ishte deri në vitin 1923 pjesë e Institutit Oriental.

⁵ Në origjinal: Max Lambertz, Georg Pekmezi, Lehr- und Lesebuch des Albanischen. A. Hartlebens Verlag, Wien, Leipzig (1913), 180 faqe.

⁶ Pekmezi, N. Rotta: Albanische Sprüche und Redensarten. Wien, Koller Verlag, 1914, 56.

të shekullit XIX dhe është zhvilluar nëpër shkolla të larta e privatisht. Sipas të dhënave kurset e para të gjuhës shqipe janë hapur në të ashtuquajturën “Shkolla Publike P. M⁷. për Gjuhët Orientale” (K. K. Öffentliche Lehranstalt für Orientalische Sprachen)⁸. Në internet gjendet një afishe e kësaj shkolle, që i përket vitit 1929 dhe ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë, ku shënohen të gjitha gjuhët që mësoheshin atje përfshirë shqipen.

Nga shqyrtimi i katalogëve të leksioneve (gjerm. Vorlesungsverzeichnis), që janë mbajtur në Universitetin e Vjenës deri në semestrin e fundit, d.m.th. semestrin e verës të vitit 2012 dhe i dosjeve të zyrës së kuadrut (gjerm. Philosophischer Akt) rezulton se lektori i parë i shqipes në këtë Universitet ka qenë Nikolaus Rotta⁹, i cili për herë të parë ka mbajtur një kurs të gjuhës shqipe në semestrin e dimrit të vitit akademik 1944/45, pra pak para përfundimit të luftës. Në semestrin e dimrit 1957/58 Rotta nuk përmendet më dhe me të përfundojnë dhe kurset e gjuhës shqipe. Pra, Kolë Rrota ka punuar gjithsej 25 semestra, domethënë 12 vjet e gjysmë si lektor i gjuhës shqipe në këtë universitet. Një fazë të re shënon semestri i verës i vitit 1952, kur në Institutin e Indoevropianistikës vjen Karl Treimer-i¹⁰.

Pas largimit të Rrotës dhe Treimer-it duket se s’ka qenë e mundur as

⁷ “Perandorake dhe Mbretërore” (gjerm. K. K.) ishin atributet e Monarkisë Austro-Hungareze, që i referoheshin njëri Austrisë si perandori dhe tjetri Hungarisë si një mbretëri e barasvlershme me të.

⁸ Në shtator 1753 me vendim të perandoreshës Maria Terezia në Vjenë u themelua Akademia Orientale (Orientalische Akademie). Ajo u hap më 1 janar 1754. Nxënës i kësaj shkolle ka qenë dhe Alfred Rappaport, konsull i ardhshëm në Shqipëri, i cili më 1891 është nderuar me “Çmimin e Perandorit” (gjerm. Kaiserpreis), një medalje e artë që i jepej çdo vit nxënësit më të mirë të vitit të fundit (Erlach 1988: 82). Nën drejtimin e kësaj akademie më 1851 u hap shkolla publike dyvjeçare për gjuhët orientale, që vazhdoi të funksiononte deri më 1948. Këtë shkollë mund ta ndiqte kushdo dhe ishte pak a shumë si institutet për përkthyes në kohën tonë.

⁹ Për jetën e Kolë Rrotës (23.8.1880 në Shkodër-15.2.1965 në Vjenë) në përgjithësi shih P. Logoreci (2011:21). Arsyeja pse ai e mori përsipër këtë detyrë në moshën 64-vjeçare dhe e vazhdoi derisa u bë 77 vjeç mund të ketë qenë pamundësia për të gjetur një lektor tjetër ose shkaqe personale.

¹⁰ Nga akti i provimit për doktoratën (gjerm. Rigorosenakt në Arkivin e Universitetit të Vjenës) del se ka lindur më 10.10 1892 nga prindër gjermanë në Bërno të Moravisë, Çekia e sotm. Nga curriculum vitae qe ka shkruar vetë Treimer-i del se ka ndjekur leksione te shumë profesorë, ndër të tjerët te Jokli dhe te të dy referentët.

gjetja e një lektori ose referuesi të ri për shqipen. Kështu vazhdoi për dhjetëra vjet me radhë derisa, më në fund, në vitin 1981 filloi punën lektori i ri nga Kosova, Dr. Skënder Gashi.

3. Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës pas vdekjes së Dr. Gjergj Pekmezit: Katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës me lektorë nga Kosova (Dr. Skënder Gashi) dhe nga Shqipëria (Dr. Ina Arapi).

Pas një periudhe apo një vakumi më shumë se 10-vjeçar, fillon së funksionuari prapë katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës në Institutin e Indoevropianistikës, kësaj radhe me lektor nga Kosova, pra me Dr. Skënder Gashi.

Pasoi marrëveshja midis Universitetit të Vjenës dhe Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme të Prishtinës dhe ai ia nisi punës në fillim të vitit 1981. Që nga atëherë deri në fund të vitit 2002 Dr. Gashi ka mbajtur rregullisht dy kurse gjuhe: për fillestarët e për të avancuarit. Përkrah këtyre, disa vite ka mbajtur ligjërata nga fusha e historisë së gjuhës shqipe, një semestër histori të letërsisë shqipe dhe disa semestra gjuhësi ballkanike.

Pas largimit të Dr. Skënder Gashit, gjatë semestrit të dimrit 02/03, kurset e shqipes u drejtuan nga Dr. Kurt Gostentschnigg. Interesi nga ana e studentëve ishte i vakët. Në semestrin e verës 2003 u bë një pauzë, ndërsa në semestrin e dimrit 03/04 erdhi si lektore Dr. Ina Arapi¹¹, e cila vazhdoi punën deri në fund të semestrit të verës 2012¹², kur Instituti i Indoevropianistikës nuk e përfshiu më shqipen në programin e ofruar prej tij. Gjatë kësaj kohe, ajo ka ofruar kurse me emërtime të ndryshme, shpesh e imponuar kjo nga rregullat e reja në kuadrin e procesit të Bolonjës¹³.

¹¹ Në lidhje me katedrën e gjuhës shqipe në Vjenë Dr. Ina Arapi thotë: “Në kundërshtim me çka lexohet shpesh në shtypin shkencor dhe të përgjithshëm shqiptar, në Universitetin e Vjenës nuk ka pasur kurrë një katedër të gjuhës shqipe, gjë që do të nënkuptonte konkretisht krijimin e një dege (gjerm. Studienrichtungen) të albanologjisë në Institutin e Indoevropianistikës ose të Indogjermanistikës, siç quhet në terminologjinë gjermane. Mësimdhënia e shqipes këtu ka qenë deri në fund në nivelin e një lektorati”.

¹² Dr. Ina Arapi ishte lektorja e fundit.

¹³ Arapi, I., po aty, f. 107.

Përveç kurseve të mbajtura nga lektorët, që ishin të gjithë bashkëpunëtorë të jashtëm të Institutit, në nëntor të vitit 1979, në Institut ka mbajtur një cikël leksionesh për albanologjinë edhe Prof. Eqrem Çabej, i cili shoqërohej nga Dr. Jani Thomaj. Prof. Wilfried Fiedler ka qenë gjithashtu i ftuar si “Gastprofessor” për një semestër¹⁴.

3.1 Si është situata e tanishme e shqipes në këtë Universitet?

Tani, pavarësisht nga mundësitë më të shumta njerëzore nga albanologjia, nuk kemi katedër e as albanologji, as në Universitetin e Vjenës, as në ndonjë universitet austriak tjetër. Dy shtete, dy ambasada, “Instituti Shqiptar i Kulturës”, gati 1000 studentë, Lidhja e shkrimtarëve shqiptarë etj. nuk mjaftojnë për afirmimin e gjuhës shqipe, ofrimin e mësimin të saj pranë këtij Universiteti apo universiteteve tjera jo publike. Ndërsa shumë gjuhë mësohen në Vjenë, gjuha shqipe jo! Pse, deri kur?

4. Mësimi plotësues i shqipes në mjediset shqiptare në Austri në ditët e sotme. Përvojë dhe problematikë nga mësimdhënia dhe hulumtimet e kontaktit të shqipes me gjermanishten në prefekturat e Tulln-it dhe Krems-it¹⁵

Mësimi i gjuhës amtare shqipe në Austri ka filluar në vitet shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Atëherë ishin të organizuara kurset e para për serbokroatisht, sllovenisht dhe turqisht dhe kjo bëhej përmes një bashkëpunimi me shtetet dërguese (RSF e Jugosllavisë dhe Turqia) të ashtuquajturve “punëtorë mysafirë”. Fjala ishte për një përpjekje shkolle, e cila rrodhi me emërtimin “mësimi shtesë i gjuhës amtare”. Qëllimi parësor i këtij

¹⁴ Në studimin e Dr. Ina Arapit janë dhënë gjerësisht ligjëratat e mbajtura gjatë viteve 1913 - 1938 dhe viteve 1952-1965 të ndara në semstrin dimëror (WS) dhe në atë veror (SS).

¹⁵ Materiali për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në mjediset shqiptare në Austri është bazuar në një studim të MSc. Miradije Berishaj, të temës e masterit shkencor: **Gjuha shqipe në Republikën e Austrisë (Kundërime sociolinguistike dhe etnolinguistike)**, Mikrotezë në kërkim të gradës “Master”, mbrojtur në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, korrik 2014 e udhëhequr nga Akademik Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaj

mësimi ishte që fëmijëve t'iu jepet rasti "ta kultivojnë dhe ta zhvillojnë më tej gjuhën e tyre amtare dhe të përvetësojnë njohuri lidhur me atdheun e tyre, kështu që, pas kthimit të tyre të mëvonshëm në atdhe, të mund ta vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm, pa vështirësi.

Mësimi i gjuhës shqipe në Austri organizohet, financohet dhe kontrollohet nga organet kompetente të arsimit të landeve (njësi territoriale autonome), përkatësisht këshillit shkollor të qytetit të Vjenës (Stadtschulrat). Mësimi i gjuhës shqipe organizohet në këto lande: Vjenë, Austri të Ulët (Niederösterreich), Austri të Epërme (Oberösterreich), Kärnten, Steiermark dhe Salzburg. Mjerisht, në mungesë të mosinteresimit të prindërve, mësimi plotësues nuk organizohet në Burgenland, Vorarlberg dhe Tirol.

Mësimi shqip në Austri, (veçanërisht në Vjenë, ku edhe ka filluar për herë të parë të mësohet shqip në shkollat e nivelit të mësimin të detyrueshëm (obligativ) ka një traditë bukur të gjatë (më shumë se një çerek shekulli) dhe zë fill që nga viti 1986, por atëbotë me një numër të vogël nxënësish. Ishte një fillim i mbarë dhe i suksesshëm, i cili po rrugëton edhe në ditët e sotme. Më 14 shtator të 1987 fillon së funksionuari mësimi i gjuhës shqipe në shkollat fillore të Vjenës, me një numër të vogël nxënësish.

Nevojat për mësimin plotësues u rritën sidomos me ardhjen e një numri të madh refugjatësh shqiptarë gjatë luftës në Kosovë (1998/99). Gjatë vitit shkollor 2000/2001 në Austri kanë punuar 23 mësues me rreth 1700 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2006/2007 kemi një rënie të numrit të nxënësve, por edhe të mësuesve, nga 23 në 15.

Në këto dy vite të fundit kemi prapë një rritje të personelit mësimor në 23 mësues në tërë Austrinë, çka do të thotë se kemi edhe rritje të numrit të nxënësve. Sipas statistikave të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës së Austrisë¹⁶, këtë vit janë afro 17000 nxënës me gjuhën e nënës shqip që mësojnë në shkollat austriake. Nga ky numër mësimin e gjuhës shqipe e ndjekin rreth 2600 nxënës.

¹⁶ BM:UK; Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur. Wien, 2017.

4.1 Sfidat dhe ballafaqimet e ndryshme për një sukses të mirëfillt¹⁷

Duhet paraprakisht të konstatojmë së migrimet e shqiptarëve ishin të shkapërderdhura dhe të përqendruara, kryesisht në lokalitete vendbanimesh ku kushtet dhe mundësitë për punë ishin me të afërta dhe më të mira. Veç kësaj, numri i familjeve në raste të këtilla, ishte i vogël ndërsa numri dhe moshja e nxënësve ishte mjaft heterogjene. Këto dhe shumë faktorë të tjerë e bënin punën për një fillim të mbarë relativisht sa të vështirë aq dhe komplekse, përkundër kushteve shumë të mira dhe shumë herë me rrethana lehtësuese nga autoritetet zyrtare vendore. Para së gjithash, ajo që kërkohet në mënyrë të patjetërsueshme dhe që ishte bazë themelore për sigurimin e orëve mësimore ishte numri dhe grupimet e nxënësve. Dhe, si rezultat i gjithë kësaj, varësisht sa ishte i madh grupi i nxënësve, ashtu dhe bëhej përgjedhja dhe ndarja e orëve.

Nje problematikë në vete, për shkak të grupit të vogël të nxënësve dhe të moshave heterogjene, paraqiste organizimi funksional i orëve dhe që, më pastaj, detyrimisht planifikimi dhe realizimi i plan-programit mësimor bëhej sa i vështirë aq dhe kompleks. Rrjedhimisht të imponohej mësimi me klasë të kombinuara, madje shpesh me shumë klasë në një orë mësimore.

S'do mend se, për kalimin e këtyre situatave, rol të madh dhe vendimtar kanë luajtur takimet dhe kontaktet me prindër, rezultatet dhe sukseset e nxënësve, pjesëmarrjet në kremtime festive, që organizoheshin për nder të datave shtetërore, vazhdimësia e kontakteve në trekëndëshin **nxënës-mësues-prind**, këndvështrimet e prindërve ndaj punës dhe funksionimit të Shkollës Shqipe, ishin disa nga faktorët kryesorë, që përcaktuan në vazhdimin dhe zhvillimin gradual në baza të qëndrueshme, ndër vite, mësimin dhe kultivimin e gjuhës shqipe.

Duke u mbështetur në sa parashtruam më sipër, mendoj që, jo vetëm në Austri, por përgjithësisht në diasporë një ndër sfidat kryesore të mësimin të gjuhës shqipe për nxënësit shqiptarë në shkollat d detyrueshme austriake që nga fillimi i vijimit të nxënësve në mësimin plotësues, përballet me tri probleme kryesore¹⁸:

¹⁷ Berishaj M.: po aty fq. 32

¹⁸ Berishaj, M.: po aty fq. 33

- Vijueshmëria e dobët,
- Shtytje më të mëdha nga vendet amë.
- Suksesi jo i dëshiruar i nxënësve pjesëmarrës në mësimin plotësues.

Personalisht, në kontakt me prindërit shpesh u them atyre se mësimi plotësues është vetëm një pikë ujë në det, por më mirë pak se fare.

4.2 Probleme dhe vështirësi organizative

Mësimi në gjuhën shqipe është shumë specifik dhe zhvillohet në forma të ndryshme nga një land në landin tjetër, madje edhe nga një shkollë në shkollën tjetër. Në rend të parë, mësimi në gjuhën amtare nuk është obligativ, por i dëshirueshëm dhe kjo shpesh lë hapësirë për interpretim të ndryshëm e subjektiv nga organet shkollore (drejtoritë e shkollave) si dhe nga vet prindërit e nxënësve, jo pak prej të cilëve janë mjaft të luhatshtëm. Megjithatë shumë shkolla po i japin rëndësi mësimin të gjuhës amtare dhe se e kanë përfshirë në orarin e paraditës në shkollat e tyre me nga 3-4 orë në javë. Kjo formë e mësimin është duke treguar më frytdhënëse. Ndërsa në mësimin e pasdites nxënësit duhet të grumbullohen në një shkollë, nga disa shkolla afër saj dhe janë me grup-mosha heterogjene. Nxënësit ndahen në nivele në bazë të moshës dhe të njohurive. Një ndër vështirësitë e mia që nga viti shkollor 2013/2014 ka qenë grupi përbashkët i nxënësve prej moshës 6 vjeçar (parashkollor) e deri te mosha 15 vjeçare (klasa e nëntë).

Duke e përcjellë te nxënësit mungesën e thesarit të fjalëve, shqiptimin jo të qartë të fjalëve, dallimin e gjinisë së emrave e të tjera (madje edhe në gjuhën gjermane), kuptoj se në familje dhe në shtëpi kemi komunikim të kufizuar, të ngurtë i cili pasqyrohet te fëmijët. Cilët janë faktorët që e bëjnë këtë komunikim të kufizuar brenda familjes?

Sigurisht që ka shumë faktorë. Do të përmendja disa¹⁹:

- Niveli jo i lartë i arsimimit të vetë prindërve;
- Orari i gjatë i punës, ku vetëm mbrëmja i tubon anëtarët e familjes (para-darka e pas-darka u kushtohet zakonisht televizionit dhe emisioneve informative në vendlindje, ku në shumë familje fëmijët

¹⁹ Berishaj, M.: po aty fq. 35

duhet të mbajnë qetësi ose të mbyllen në dhomat e tyre);

- Mosnjohja e duhur nga ana e prindërve e gjuhës gjermane dhe e kulturës së vendit;
- Komunikimi i kufizuar edhe ndërmjet vetë prindërve (mungesa e temave për art, kulturë, shkencë; thjeshtë mungesë e përgjithshme e diapazonit të njohurive);
- Prania e një lloj bashkëbisedimi hierarkik, më tepër në formë të urdhrave të përcjellë nga babai tek nëna, nga nëna tek fëmijët e kështu deri te pjesëtari më i vogël i familjes (një lloj komunikimi patriarkal, i cili ka filluar të zhduket në Kosovë, por që vazhdon në diasporë!) ku, si pasojë, kemi shumë pak përdorimin e shprehjeve: urdhëroni, ju lutem, ju faleminderit etj. të njohura si shenja respekti e mirësjelljeje e që njëherazi janë bazë e krijimit të kulturës së komunikimit.

Dikush do të thoshte se, edhe në Kosovë në familje flitet ndryshe e në shkollë ndryshe, por s' duhet harruar se dallimi është i madh: në Kosovë nxënësi i ka deri 30 orë mësimi në javë dhe atë të gjitha në gjuhën amtare, ndërsa në mërgim vetëm dy orë dhe ato nuk i vijon rregullisht.

3.1 Ndikimi i të mësuarit shqip dhe roli i shqipes standarde në shkollë tek fëmijët shqiptarë (Rasti i Elenës)

Përvojë nga puna e diferencuar me nxënës shqiptarë të emigruar në Austri: probleme të dygjuhësisë²⁰ dhe të dykulturorësisë dhe roli i shqipes standarde apo i shqipes librore për shtimin e aftësive shprehëse dhe formative të fëmijëve shqiptarë që jetojnë në vende duhet të shkollohen në gjuhën e huaj të vendit përkatës.

Elena ka ardhur në moshën dyvjeçare nga Kosova. Tani ajo është në moshën 16-vjeçare, një vajzë e zgjuar dhe e talentuar. Rasti i saj na duket me interes për ta bërë të njohur edhe për mjediset studimore e sidomos me vlerë psiko-pedagogjike dhe sociolinguistike²¹.

²⁰ Rudolf de Cillia: Përvetësimi i gjuhës në mërgim. Informationsblätter des Referats für Migration und Schule, Nr. 3/2011, Vjenë.

²¹ Shkurtaj, G.J.: Sociolinguistikë e shqipes. Botim i dytë. Tiranë, 2009.

Elena e vogël, duke qenë se prindërit e saj ishin në punë, shumë herët filloi të shkojë në kopshtin e fëmijëve. Atje, së shpejti, edhe ato fjalë të pakta që i kishte në trurin e saj në gjuhën shqipe filluan të zëvendësohen me gjuhën e vendit, pra me gjermanishten. Nëna e saj, nga kushtet e jo të mira financiare duhej të punonte, kështu që i mbetej shumë pak kohë për të qenë me fëmijën e saj të dashur, Elenën. Madje, në këto rrethana, që të kuptohej më shpejt me vajzën e saj e kishte më të lehtë të fliste në gjuhën tjetër; në gjermanisht, kurse “gjuha e zemrës” edhe në shtëpi u zëvendësua me “gjuhën e bukës”, kështu që shqipja filloi ta lërë dhe të mekej. Elena nën ndikimin e ambientit dhe rrethit ku jetonte filloi ta mësojë fort dhe bukur gjuhën e vendit. Por, ndërkaq, në kontaktet me familjen e farefisin nisën edhe thashethëmet se Elena nuk e di gjuhën shqipe, gjë që ishte një ironi për prindërit e Elenës. Kjo i krijonte vajzës dhe mjedisit familjar të saj një gjendje shqetësuese. Nga fjalët e dëgjua vajza nuk fliste me të afërmit, shqiptarë në asnjërën gjuhë. Kjo ishte edhe një brengë më e madhe për prindërit e saj, sepse Elena u “mbyll” në vetvete. Ajo nuk fliste me të afërmit dhe farefisin sepse shqip nuk dinte, ndërsa gjermanisht nuk donte. Gjuha e saj funksiononte vetëm me miket e saj gjermanishtfolëse dhe në shkollë.

Deshi fati dhe në shkollën e fshatit ku jetonte vajza u lejua që të mbahet edhe mësimi në gjuhën shqipe. Ajo ishte në klasën e tretë dhe, së bashku me katër nxënës të tjerë të asaj shkolle, filluan ta ndjekin mësimin shqip, në mesin e nxënësve të tjerë, porse ata flisnin një shqipe të mangët dhe në dialekte të ndryshme sipas origjinës nga vinin prindërit e tyre. (Elena dhe një nxënës vinin nga Kosova, dy të tjerë nga Maqedonia, kurse një vinte nga Shqipëria). Meqenëse vinin nga vende të ndryshme shqipfolëse, komunikimi në mes tyre ishte shumë i vështirë, sepse shqipja e tyre u takonte të folmeve (krahinave dialektore)²² të ndryshme. Për këtë arsye, në të shumtën e rasteve, nxënësit që të kuptoheshin në mes tyre komunikonin jo në shqip, por në gjuhën e vendit. Elena ishte shumë keq me gjuhën shqipe. Në takimin e parë të mësueses me prindërit e Elenës, u dha porosi që në shtëpi të mos flitej gjermanisht, por shqip. Prindërit u pajtuan me

²² Shkurtaj, G.J.: Dialektet e shqipes. Tiranë 2012.

sugjerimin e mësueses dhe ashtu bënë. Por, sipas së ëmës (nënës së Elenës) në shtëpi filluan vështirësitë që të kuptoheshin në mes tyre.

Në krahasim me nxënësit e tjerë, mësueses i duhej të bënte punë të dyfishtë me vajzën në fjalë. Vajza filloi të lexojë dhe të shkruajë shqip, por jo të fliste. Me kalimin e viteve nisi të zërë vend edhe dygjuhësia tek Elena, ajo i fliste fjalët shqip, por me theksin dhe intonacionin e gjermanishtes. Vajza thithte drejt dhe pa gabime fjalët e shqipes, dhe nuk kishte mundim si moshatarët e tjerë fjalët që i kishin të mësuar nga prindërit në dialekt t'i rikuperonte, por tek ajo ekzistonte ende një frikë e brendshme, nuk fliste lirshëm. Në familje ajo nuk fliste ende shqip, jo pse nuk kuptohej, por pse tani tek ajo ishte ngulitur një ndjenjë e çuditshme përqeshëse. Gjatë orëve të mësimin të gjuhës shqipe ajo dallohej në mesin e nxënësve për gjuhën standarde (gjuhën e librit, siç u thoshte mësuesja) që e fliste. Që mësuesja të arrinte kulmin e punës me Elenën, dhe që ta ndiente veten të lirë e të fliste edhe me prindërit në gjuhën shqipe, i dha një rol të rëndësishëm në programin e fundvitit, që organizon mësuesja për nxënësit dhe prindërit. Elena gjatë prezantimit të rolit të saj shkëlqeu me gjuhën e bukur e të pasur shqipe. Në sytë e të pranishmeve tani ishte një Elenë krejtësisht tjetër, një Elenë që shkëlqente. Suksesin e Elenës u kurorëzua me lot gëzimi të prindërve dhe me urimet e shumta që iu dhanë nga të pranishmit.

5. Sprovë modeste rreth kaheve dhe disa rezultate paraprake të anketimeve dhe hulumtimeve sociolinguistike rreth “codes-mixing” e “codes-switching”, që jemi duke i kryer në prefekturat e Tulln-it dhe Krems-it,

Anketa bëhet përmes një pyetësori dhe iu drejtohet vetëm nxënësve të klasës së pestë e deri në të nëntë. Më këtë pyetësor hulumtojmë situatën gjuhësore dhe shkollore të nxënësve shqiptarë. P.sh.: si është orientimi i tyre mes gjuhës amtare dhe gjermanishtes, ne mes gjuhës letrare dhe dialektit në shqip si dhe në gjermanisht, etj.

Nga analiza e përgjigjeve të materialit nga pyetësorët mund të nxjerrim përfundimet vijuese:

Gjuha shqipe si gjuhë stërgjyshërore, në pjesën me të madhe të

nxënësve, nëpër shkolla ku vijojnë dhe mësojnë përveç gjuhës vendore, pra gjuhës gjermane, gjuhën amtare, gjuha shqipe komunikohet lirshëm; lexohet, shkruhet, kuptohet në një shkallë përqindjeje diku rreth 60%-70%. Kësisoj, me konkretisht nxënësit e klasëve të fundit të ciklit të lartë, pra të shtatave e të tetave, pos tjerash, përballen me format e të hartuarit, të përkthimeve me leksione nga tekstet shkollore në përputhje me moshat e tyre.

1. Gjuha e komunikimit, në të shumtën e herave, është gjuhë dialektore, ose me saktë gjuha që flitet dhe komunikohet në rrethet familjare. Ndaj, dhe më përparësisht, mund të **konkludohet** se standardi i gjuhës është i po atij standardi nga vijnë në të vërtetë familjet dhe njëkohësisht sa janë të arsimuara ato.
2. Gjuha zbatuese komunikuese e përditëshmërisë së nxënësve, nëse merret në paralele krahasuese, është të thuash gjysmë për gjysmë. Kur janë në shoqëri me te njëjtin identitet e flasin gjuhën shqipe. Po kjo varet shumë nga tema dhe disponimi që kanë ata për bisedat që zhvillojnë. Në meset familjare, diku rreth 60%-70%, bisedohet dhe flitet gjuha shqipe.
3. Parametrat e përgjithshëm në kuptimin se sa kanë njohuri dhe aftësi në njohuritë e përgjithshme nga lëndet mësimore: gjuhë shqipe, histori dhe gjeografi kombëtare, kulture arti figurativ dhe muzikor, duke iu referuar të gjitha testimeve dhe kritereve të mësimdhënësve, flasin se janë në nivelin mesatar.
4. Ne standardin aktual të të mbeturit të gjuhës shqipe kanë dhe japin ne vazhdimësi takimet e nxënësve në manifestime e kremtime të ndryshme, si dhe zhvillimi i garave të diturisë që organizohen në mes të nxënësve shqiptarë një herë në vit në nivel të shtetit austriak.

Nga pyetjet e shumta²³ në pyetësor dëshiroj të përmendi një pyetje. Në pyetjen *Si flasë unë - jashtë familjes (përveç shkollës dhe pushimeve flas)*, nga materiali i analizuar rrjedh se:

- në përgjigjen *veç ose gati veç shqip* vetëm 12,9% të anketuarve në çdo rrethanë flasin vetëm shqip
- në përgjigjen *më shumë shqip* vetëm 15% të anketuarve në çdo rreth flasin më shumë shqip

²³ Shumica e pyetjeve në **Pyetësori** janë marrë nga: Basil Schader: *Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër*. Kristalina-KH, Tiranë, 2005.

- në përgjigjen *afërsisht 1/2 -1/2*, 38,7% të anketuarve në çdo rreth flasin afërsisht ½ shqip
- në përgjigjen *më shumë gjermanisht se shqip* vetëm 19,3% të anketuarve në çdo rreth flasin më shumë gjermanisht
- në përgjigjen *gati veç gjermanisht* vetëm 15% të anketuarve në çdo rreth flasin gati veç gjermanisht.

Nuk është për t'u çuditur në përgjigjet e fituara, duke pasur parasysh se shumica e fëmijëve që e vijnë mësimin plotësues kanë lindur (90%) në Austri, ndërsa në prefekturat ku unë e zhvillojë mësimin të gjithë nxënësit që e vijnë mësimin plotësues kanë lindur (100%) këtu. Kësaj përqindje kështu të fituar duhet t'ia shtojë edhe faktorët e mëposhtëm, të cilët ndikojnë që komunikimi i nxënësve si dhe i fëmijëve shqiptarë në përgjithësi momentalisht është i vështirësuar dhe ka një trend të përkeqësimit edhe të mëtejshëm.

- Ngurrimi për të biseduar dhe shprehur lirshëm shqip
- Fëmija flet me prindër gjermanisht, ndërsa prindërit me fëmijë shqip; do të thotë fëmija e kupton gjuhën shqipe, por e ka vështirë, nuk dëshiron, apo ngurron të përgjigjet apo të komunikon në shqip. (*Ky fenomen e kërkon një analizë të hollësishme*).
- Bisedat, komunikimet e fëmijëve brenda familjes në gjuhë gjermane.
- Komunikimi me prindër shqip, me vëllëzër apo motra gjermanisht.
- Ngurrimi në rrugë, fusha sportive, sheshe e gjetiu që të flas shqip.
- Bisedat në vende publike në gjuhë gjermane si me prindër ashtu edhe me vëllëzër, motra, familjarë, shokë etj.

5.1 Kod-suiçing

Ndikimi i gjuhës gjermane mbi shqipen nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit të cilët e flasin shqipen në Austri. Mund të vërtetohen dallime individuale shumë më të mëdha për sa u përket përmasave, kompleksitetit dhe funksionalitetit të praktikës dygjuhësore²⁴. Duke u bazuar në analizën e pyetjes nga pyetësi "*Erinnerst du dich an Sätze*, in denen du Albanisch

²⁴ Schader B.: Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër. Kristalina-KH, Tiranë, f. 173.

und Deutsch vermischt hast? Schreibe sie auf! *A te kujtohen fjali, në të cilat ke ngatërruar (përzij) shqipen dhe gjermanishten? Shkruaj!*” dhe pyetjet nga pyetëtori “Wann geschehen dir solche »Vermischungen« vor allem? (Mehrere Antworten möglich). *Kur të ndodhin »ngatërrime« të tilla? (është e mundur me shumë se një përgjigje)*”, kam marrë shumë shembuj nga vetë nxënësit të moshës (situatë dygjuhësore të mërgimit, moshë 10 deri 15-vjeçarë të plotësimit të pyetësorëve) që në rastin tonë një grup i vogël i nxënësve kanë shënuar që e praktikojnë “*kod-suiçingu*” shumë shpesh, grupi më i madh është që praktikojnë nganjëherë, ndërsa grupi i tretë thotë që i ngatërron gjuhët vetëm shumë rrallë apo asnjëherë. Ja disa shembuj fjalish të marra nga pyetësorët, ku kanë depërtuar huazime të rastit nga gjermanishtja në gjuhën shqipe.

O bre sa isha *fertig* apet ka shkreit.Gjuha letrare (GJL) (O bre sa i kisha përfunduar, prap ka shkruar).

Sa kam hyr ti *erste Klasse* kam lujt me sandali. ...GJL (Kur kam hyr në klasë të parë kam lujtur me karrigë)

Këtu kam ba *geboren*..... GJL (Këtu kam lindur).

Ball ma Launora me astallen se ma vrave *Knie*... GJL (Mjaft më Leunora me karrigën se me lëndove gjurin).

Kanst du dallapin offnen?.... GJL (Mundesh ti ta hapesh dritarën?)

Qataj e ka *kapit*. GJL (Tani e ka kuptuar çfarë i kam thenë).

A ki me ardh *heute zum Turnen?* GJL (A ke me ardh sot në ushtrime).

Është *verbot* me i nxanë peshqit ne *Meer*; GJL (Është e ndaluar me i zënë peshqit në det).

Msuse e kam ba *malen* Lidhjen e Prizrenit e kam kap ne perzore.... GJL (Mësuese e kam ngjyrosur Lidhjen e Prizrenit dhe e kam vu në dritare).

Oj Hatixhe mos *nerf*... GJL (Oj Hatixhe mos më nervozo).

Mu ka sos *farba*. GJL (Më është hargjuar ngjyra).

Une halis *Wochen*’zgrad... GJL (Unë tani banoj në banesë).

Sot kam fol me *freundin und Lehrerin albanisch*... GJL (Sot kam folur më shoqen dhe me mësuesen shqip).

Përmbledhje

Në bazë të rezultateve të vijueshmërisë së mësimin shqip në shkollat austriake, në bazë në bazë të pyetësorit, në bazë të punës së kolegëve nëpër shkolla të ndryshme të ciklit të ulët dhe të lartë, nëpër lande të ndryshme të Republikës së Austrisë, në bazë të pyetjeve (*kuizeve*)²⁵ të diturisë dhe një numri tjerë të faktorëve ë ndikojnë që gjuha shqipe të flitet, të mësohet e mos të harrohet mund të konstatoj dhe t'i sjellë këto përfundime se:

- Thënia se fëmija edhe kështu e di gjuhën amtare dhe nuk duhet ta mësojë nuk është e saktë. Zhvillimi gjuhësor nuk mbaron në asnjë mënyrë me moshën kur fëmija hyn në shkollë dhe përdorimi i gjuhës vetëm në familje nuk mjafton për ta zhvilluar atë më tej. Një zhvillim i gjuhës L1²⁶ që mbetet në vend mund të ketë pasoja fatale për mësimin e gjuhëve të tjera dhe për zhvillimin intelektual të fëmijës në përgjithësi.
- Po ashtu edhe thënia se mësimi i gjuhës amtare e pengon mësimin e gjuhës së dytë, të gjermanishtes, është një konkluzion i gabuar. Veçanërisht kur nuk merret parasysh siç duhet gjuha amtare zhvillohet i ashtuquajturi “semilingualizëm”²⁷ që mund të ketë më vonë pasoja negative në të gjitha përmasat e realizimeve (performancave) shkollore.
- Kur u ndalohet fëmijëve të bisedojnë në shkollë në gjuhën e tyre amtare, qoftë në pushim, qoftë në mësim, kjo tregon jo vetëm një mungesë sensibiliteti dhe njëfarë arrogance etnocentriste, por kjo e pengon edhe mundësinë që të sigurohet të kuptuarit e lëndës, në qoftë se nuk lejohet që fëmijët të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të

²⁵ Që nga viti 2001 e kënde, së pari nga vetë mësuesit, në kohën e fundit nga VALE (shoqate e mësuesve dhe prindërve në Austri) si dhe nën përkujdesjen e MASHT dhe MeD (Ministria e Diasporës-Kosovë), një herë në fundviti organizohet “Kuizi i diturisë”.

²⁶ Për gjuhën në të cilën bëhet shoqërimi i parë përdoren disa nocione të ndryshme: “gjuhë amtare” ose “gjuhë e parë”, “gjuhë primare”, nganjëherë edhe “gjuhë familjare”. Përdoret nocioni i gjuhës amtare që përdoret zakonisht në diskutim si sinonim për gjuhën e parë, L1.

²⁷ Që nga viti 2001 e kënde, së pari nga vetë mësuesit, në kohën e fundit nga VALE (shoqate e mësuesve dhe prindërve në Austri) si dhe nën përkujdesjen e MASH dhe MeD (Ministria e Diasporës-Kosovë), një herë në fundviti organizohet “Kuizi i diturisë”.

mësojnë nga njëri-tjetri. Përvetësimi i gjuhës gjermane, që edhe kë-shtu është kudo e pranishme, nuk mbetet prapa në këtë rast, përkundrazi ajo përkrahet.

- Përvetësimi i gjuhës amtare njëkohësisht me gjuhën e mësimi/gjuhën e dytë (në rastin tonë me gjermanishten) në shkollë nuk e pengon përvetësimin e gjuhës së dytë, por për kundrazi (krahaso: Wassilios dhe te tjerët, 1985)²⁸:
- Një gjuhë e parë stabile e nxit dhe e lehtëson përvetësimin e gjuhës së dytë dhe të të gjitha gjuhëve të tjera.
- Aftësia e analizës gjuhësore si edhe cilësia dhe sasia e strategjive për përvetësimin e një gjuhe janë më të larta te fëmijët me dy gjuhë sesa tek ata me një gjuhë.
- Nxitet krijimtaria gjuhësore.
- Mund të konstatohen ndikime pozitive mbi performancat e inteligjencës verbale dhe joverbale.
- Së fundit përmenden toleranca më e madhe e njerëzve me dy gjuhë dhe predispozita e tyre më e vogël për një etnocentrizëm.

Ne fund, duke iu referuar thënies së Pjetër Bogdanit të famshëm: **“Ku lulëzojnë shkencëtarët, letrarët dhe dija, lulëzon e mira”**, konstatojmë se: aty ku mësimi shqip e ka mbështetjen e institucioneve përkatëse shtetërore (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni), si dhe përkrahjen e shtetit pritës, në këtë rast Austria, aty ku puna e palodhshme e mësuesve shqiptarë është në nivelin më të lartë dhe për çdo lëvdatë, aty gjuha shqipe: **do të flitet**, do të mësohet, do të shkruhet, do të këndohet, nuk do të harrohet,... **dhe do të ruhet!**

²⁸ Wassilios F- E., Adelheid Sonner, Rosemarie Thrul, Waltraud Walbiner (Hg.): Bilingual-bikulturelle Entwicklung des Kindes. Ein Handbuch für Psychologen, Pädagogen und Linguisten. Hueber, München 1985.

BIBLIOGRAFIA

- ARAPI, I: *Mësimi i gjuhës shqipe në universitetin e Vjenës (fundit i shek. XIX-2010)*. Studime-Revistë për studime filologjike, Nr. 20, Prishtinë, 2013.
- BERISHAJ, M: *Gjuha shqipe në Republikën e Austrisë (Kundërime sociolinguistike dhe etnolinguistike)*, Tema e masterit, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2014
- BERNSTEIN, B.: *Soziale Struktur, Sozialisation und Sprachverhalten*. Aufsätze 1958-1970. Amsterdam, 2007.
- BOECKMANN, K-B.: *Zweisprachigkeit und Schulerfolg. Das Beispiel Burgenland*. (Arbeiten zur Sprachanalyse 26). Peter Lang, Frankfurt/Main 1997.
- BM:UK; Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur. Wien, 2014.
- DE CILLIA, R: *Përvetësimi i gjuhës në megrim*. Informationsblätter der Referats für Migration und Schule, Nr. 3, Vjenë, 2011.
- DE CILLIA, R.: *Deutsch als Zweitsprache – Spracherwerb in der Migration*. In: Tribüne, Zeitschrift für Sprache und Schreibung, Nr. 2/2006, 2006.
- DE CILLIA, R.: *Mehrsprachigkeit und Herkunftssprachenunterricht in europäischen Schulen*. In: Çmar, Dilek (Hg.): Gleichwertige Sprachen? Muttersprachlicher Unterricht für die Kinder von Einwanderern. Studienverlag, Innsbruck-Wien, 1998.
- DE CILLIA, R.: *Sprachförderung*. In: Fassmann, Heinz (Hg.): 2. Österreichischer Migrations- und Integrationsbericht 2001-2006. Rechtliche Rahmenbedingungen, demographische Entwicklungen, sozioökonomische Strukturen. Drava, Klagenfurt/ Celovec, 2007.
- GAZETA: "Dialëria", *Një natë me Moissi-un*. Vjet I, Nr. 4, korrik, Vjenë, 1920.
- GJINARI, J., SHKURTAJ, GJ.: *Dialektologji*. Shblu, Tiranë, 2009.
- KARAJOLI, E., NEHR, M.: *Expertise on Bilingual Literacy Education of Turkish School-children in Berlin*. Final Report. Berlin, 1995.
- KONRAD, E., BREDEL, U., REICH, H.: *Sprachaneignung – Prozesse und Modelle*. In: Referenzrahmen zur altersspezifischen Sprachaneignung. Bildungsforschung Band 29/I, Bonn-Berlin: BMBF, 2008.
- İNCI, D., MECHERIL, P.: *Wissenschaftliche Zugänge zum Spracherwerb von zwei- und mehrsprachig aufwachsenden Kindern*. In: Mecheril, Paul (Hg.): Migrationspädagogik 2010.
- JORGJI, GJ., SHKURTAJ, GJ.: *Dialektologji*. Shblu, Tiranë 2009,
- PEKMEZI G., MOSSI, H., MANEK, F.: *Sprachführer zur schnellen Erlernung der albanischen Sprache*. St. Norbertus-Verlag, Wien 1913.
- PEKMEZI, G., ROTTA, N.: *Albanische Sprüche und Redensarten*. Wien, Koller Verlag, 1914.
- BRITISH COUNCIL dhe UNIVERSITETI I TIRANËS: *Portofoli Evropian i Gjuhëve për studentët universitarë në Shqipëri*. Model i akredituar Nr. 103, Tiranë, 2009.
- MIKLOSICH, F. X. R.: *Albanische Forschungen*. Wien, 1870,
- REHBEIN, J.: *Diskurs und Verstehen. Zur Rolle der Muttersprache bei der Textverarbeitung in der Zweitsprache*. In: Apeltauer, Ernst (Hg): Gesteuerter Zweitspracherwerb.

- Hueber, München, 1987.
- SCHADER, B.: *Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dh gjermanishtes në Zvicër*. Shtëpia botuese “Kristalina-KH”. Tiranë, 2005.
- SCHADER, B.: *Albanischsprachige Kinder und Jugendliche in der Schweiz*. Hintergründe, sprach- und schulerfolgsbezogene Untersuchungen. Zürich: Verlag Pestalozzianum, 2006.
- SCHADER, B.: *Zur Biliteralität von albanischsprachigen Kindern und Jugendlichen in der Deutschschweiz*. In: Bernd Ahrenholz (Hg.): *Zweitspracherwerb*. Freiburg/B: Fillibach, 2008.
- SHKRELI, Z., TOPALLI, T.: *Kontributi gjuhësor i M. Lambercit në gazetën “Posta e Shqypniës*. Studime albanologjike. Tiranë, 2012.
- SHKURTAJ, GJ.: *Dialektet e shqipes*. Tiranë 2012.
- SHKURTAJ, GJ.: *Sociolinguistika*. Tiranë 2003.
- SHKURTAJ, GJ.: *Sociolinguistikë e shqipes*. Botim i dytë. Shtëpia botuese Morava, Tiranë, 2009.
- SHKURTAJ, GJ.: *Kundrime gjuhësore*. (Sociolinguistikë Etnografi e të folurit Kulturë gjuhe), Tiranë, 2006.
- SHKURTAJ, GJ.: *Dialektet e shqipes*. Tiranë 2012.
- SHKURTAJ, GJ.: *Si të shkruajmë shqip*. (Nga drejtshkrimi te shkrimet profesionale), Tiranë 2008.
- WASSILIOS, F- E., SONNER, A., THRUL, R., WALBINER, W (Hg.): *Bilingual-bikulturelle Entwicklung des Kindes*. Ein Handbuch für Psychologen, Pädagogen und Linguisten. Hueber, München, 1985.

Eshref JANUZAJ, München;
Visar JANUZAJ, Rüsselsheim;
Ali CAKA, Prishtinë;
Peter MANDL, München

DREJTË NXJERRJES SË DIJES PREJ SHKENCAVE ALBANOLOGJIKE NË KOHËN E BIG DATA

1 Hyrje

Globalizimi i shoqërisë ka sjellë me vete edhe globalizimin shkencor. Nëse në të kaluarën ka ekzistuar vetëm një rreth shkencëtarësh, të cilët komunikimin shkencor në mes veti e kanë realizuar përmes diskutimeve në rrethe të ngushta shkencore, sot, me globalizimin edhe të shkencës, kërkohen metoda më të përshtatshme bashkëkohore për punë hulumtuese të mirëfilltë. Jo vetëm komunikimi individual brenda një fushe të ngushtë shkencore, por sidomos komunikimi ndërmjet fushave të ndryshme, e rrit vlerën dhe cilësinë e punës shkencore dhe të hulumtimeve në përgjithësi, pa marrë parasysh fushat e hulumtimeve, duke i bërë këto edhe më tërheqëse.

Në vitet e fundit, si rezultat i një bashkëpunimi midis shkencave shoqërore dhe të shkencës së informatikës, është kristalizuar termi *Digital Humanities*, që synon të përshkruajë më konkretisht shkencat shoqërore digjitale. Për të forcuar më shumë këtë bashkëpunim, janë krijuar edhe organizata shkencore që merren kryekëput me hulumtime dhe projekte në këtë lëmi, si p.sh. “*The Association for Computers in the Humanities*” ose “*European Association for Digital Humanities*”.

Botimet e shumta në shkencat shoqërore, vëllimi dhe heterogjeniteti i tyre, e bëjnë sot pothuajse të pamundur leximin e të gjitha botimeve a të publikimeve nga këto lëmi. Po ashtu, pa mbështetjen aktive të informatikës, edhe nxjerrja e dijës së vlefshme që këto botime përmbajnë, është pothuajse e pamundur të bëhet gjatë një hulumtimi shkencor, veçanërisht kur korniza kohore është e caktuar.

Hulumtimi në shkencat e albanologjisë kërkon qasje në dokumente, në arkiva dhe në materiale të ndryshme me vlerë historike, kulturore dhe arkeologjike. Edhe pse, sot e kësaj dite, shumë arkiva a biblioteka ofrojnë mundësinë e kërkimit në dokumente a në bibliografi të ruajtura në formë të digjitalizuar, kjo nuk është e mjaftueshme. Po ashtu, projektet e ndryshme ndërkombëtare si: Google Books Library Project, Project Gutenberg, Forgotten Books, Münchener Digitalisierungs Zentrum (MDZ) der Bayerischen Staatsbibliothek (BSB), e shumë të tjera, nuk mjaftojnë për kërkesat që mund t'i kenë sot shkencat e albanologjisë. Vetëm kërkimi dhe gjetja e dokumenteve a shfletimi i të dhënave bibliografike, është shumë pak në krahasim me fuqinë e madhe që e ofrojnë sot metodat moderne të përpunimit dhe të analizimit të dokumenteve nga fusha e *data mining*, e *inteligjencës artificiale* dhe e *big data*.

Qëllimi i këtij punimi është nxjerrja në pah e përparësive të një bashkëpunimi në mes të shkencave shoqërore dhe atyre ekzakte – konkretisht të shkencave të albanologjisë dhe të informatikës. Për nevojat e shkencave të albanologjisë, ne propozojmë digjitalizimin e dokumenteve me qëllim të krijimit të një baze të dijes (ang. *knowledge base*). Kjo bazë, pos infrastrukturës përkatëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përpunimin e dokumenteve, do të mundësojë jo vetëm kërkimin e thjeshtë në të dhënat e kësaj baze, por, çka është edhe më me rëndësi, edhe analizimin kompleks të këtyre të dhënave, duke krijuar rrjete të informatave të nxjerra prej tyre. Pra, qëllimi i këtij punimi shpie drejt nxjertjes në mënyrë automatike të dijes së fshehur në të dhënat e dokumenteve dhe të materialeve të ndryshme të digjitalizuara, për të cilën dije nuk ekziston asnjë njohuri paraprake.

Për t'ia arritur qëllimit të ndërtimit të bazës së dijes, siç u cek më lartë, propozojmë një *model* konkret (shih kapitullin 4). Procesi i realizimit të këtij modeli është i ndarë në tri faza të ndryshme, të cilat mund të realizohen njëra pas tjetrës dhe në afate të ndryshme kohore.

Përparësitë e bashkëpunimit në mes të albanologjisë dhe të informatikës, duke përfshirë problematikën e rritjes së vazhdueshme të të dhënave dhe të mundësive të përpunimit dhe të analizimit eficient të tyre, përshkruhen në kapitujt 2 dhe 3. Thelbi i këtij punimi, ku për-

shkruhet sistemi i propozuar, gjendet në kapitullin 4. Para përmbylljes së punimit, në kapitullin 5 janë prezantuar disa rezultate të hulumtimit tonë që kanë të bëjnë me historinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare.

2 Informatika dhe shkencat e albanologjisë: Ura në mes të dy shkencave

Secila shkencë përmban në vete fusha a nënfusha të ndryshme, si p.sh. gjuha, kultura dhe historia (te albanologjia) a strukturimi, ruajtja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave (te informatika). Urat e bashkëpunimit në mes të shkencave mund të ndodhin në shumë nivele a fusha të njërës ose të shkencës tjetër. Përparësitë dhe përfitimet e krijimit të urave të bashkëpunimit në mes të albanologjisë dhe të informatikës janë të shumta dhe do të ilustrohen me disa shembuj edhe në kapitujt vijues.




Fig. 2.1 Ura në mes të dy shkencave.

Si shembull i parë i thjeshtë le të shërbejë figura 2.2, në të cilën mund të lexohet një shënim historik i shkruar nga Pausiani (Pausanias) ne librin e tij nga shekulli i dytë, përkthimi [Pau160b] faqe 46, 47, ku flitet për luftën e Pirros në Sicili kundër Kartaxhenës.

rakus abzustehen. Aber eingebildet auf sich selbst ließ er sich verteilen, gegen die Karthager, die ursprünglich Tyrier aus Phönicien und unter den damaligen Barbaren [Nichtgriechen] die Sekundigsten waren, ein Seesreffen zu wagen, und dazu seine Epiroten zu gebrauchen, die auch nach Troja's Besatzung nicht das Meer, arbeitsamkeit auch nicht den Gebrauch des Salzes kannten. Zeugniß giebt mir Homer's Dichtung in der Odyssee (XI, 127.):

Fig. 2.2 Lufta në det e Pirros me Kartaxhenën

Përkthim i lirë i tekstit në gjuhën gjermane nga figura 2.2: “...Mirëpo, i bindur në vetvete, u mashtrua dhe rrezikoi një ndeshje ne det me kartaxhenasit, të cilët ... ishin njohësit më të mirë të detit në mesin e barbarëve (jo grekëve) të atëhershëm, dhe inkua-droi epirotët e tij, të cilët, edhe pas shkatërrimit të Trojës, jo vetëm që nuk e njihnin mirë detin por, në masë të madhe bile as përdorimin e kripës nuk e njihnin.”

Përparësia e parë e integritit të Informatikës në hulumtimet nga historia, në shembullin nga figura 2.2, qëndron në vetë digjitalizimin e një dokumenti të tillë me vlere historike, pasi që kështu u mundësohet të gjithë hulumtuesve të interesuar ta studiojnë dokumentin në mënyrë shumë të lehtësuar. Pos digjitalizimit të tij, mundësohet edhe analiza e përmbajtjes me mundësi kërkimi në tekst, që në studimin mekanik të tekstit diçka e tillë është e pamundur (p.sh. për të gjetur faqen në dokument ku përshkruhet lufta në fjalë, do të duhej të lexohet libri që nga fillimi).


Mirëpo, fuqia e vërtetë e informatikës shfaqet vetëm kur të bëhet rrjetëzimi dhe integrimi edhe i dokumenteve të tjera të rëndësishme dhe përfshirja e tyre pastaj në një analizë komplekse. Në shembullin konkret, pas integritit edhe të disa dokumenteve të tjera, si Homeri, Kistler [JK2006] dhe Pausianin [Pau160][Pau160b], si dhe të analizimit të këtij rrjetëzimi të informatave me metodat e *data mining*, mund të rezultojë si dije që paraardhësit e shqiptarëve, ilirët, kanë luftuar në luftën e Trojës. Ky rezultat mund t’i ofrohet hulumtuesit edhe nëse ai këtë nuk e ka kërkuar në mënyrë eksplicite ose edhe nuk ka ditur për ekzistencën e njërës a të burimit tjetër.

3 Big Data dhe Data Mining

Sistemet e shpërndara të informacioneve, të cilat janë të rrjetëzuara në mes veti, paraqesin sot shtyllën kryesore të teknologjisë së një shoqërie moderne. Përmes rrjetëzimit, qoftë ky në anën softuerike, harduerike a edhe kombinim i të dyjave, krijohen për shfrytëzuesin sisteme koherente dhe të lehta për t’u përdorë.

Kapitali kryesor i një shoqërie moderne janë padyshim të dhënat. Ato janë të vlefshme, jo vetëm nëse janë të ruajtura dhe menaxhohen në mënyrë të digjitalizuar. Mirëpo, vlefshmëria e tyre rritet sidomos nëse ato analizohen po ashtu në mënyrë të digjitalizuar, me qëllim të nxjerrjes së dijes së “fshehur” në to. Kjo dije e krijuar nga të dhënat mund të përdoret në fusha të ndryshme për të ndihmuar dhe për të mbështetur marrjen e vendimeve, si dhe për parashikime për të ardhmen. Sidoqoftë, me arritjen e mundësisë për digjitalizim, lind edhe kërkesa për menaxhim të rritjes shumë të shpejtë të vëllimit të të dhënave.

Në figurën 3.1. është paraqitur gjendja e vëllimit të të dhënave në vitet e fundit si dhe tendencat për vitet e ardhshme. Sipas një parashikimi të bërë nga një studim në [ICD17ë, deri në vitin 2025 vëllimi i të dhënave do të rritet deri në 163 Zettabyte (1 Zettabyte = 1000 Exabyte, 1 Exabyte = 1 000 000 000 000 000 Kilobyte). Ky vëllim mund të krahasohet me 32.600¹ fishin e të gjitha fjalëve që janë folur ndonjëherë nga njerëzit, nëse do të memoroheshin në një kompjuter. Ose 1.630.000² fishi i të gjitha teksteve të shkruara a të shtypura ndonjëherë në gjithë historinë e njerëzimit.



Përpunimi mekanik i tërë këtyre të dhënave, që është në rritje të shpejtë dhe të përhershme, është më se i pamundur. Prandaj, krijimi i programeve/ aplikacioneve të reja dhe zbatimi i metodave efikënte për analizimin dhe nxjerrjen e dijes së fshehur në këto të dhëna është i domosdoshëm.

Fig. 3.1 Parashikimi i vëllimit të të dhënave digjitale të gjeneruara për çdo vit në gjithë botën në vitet 2005 deri 2020 (në Exabyte) [Cor16].

¹ Llogaritur me <https://www.umrechnung.org/>

² Llogaritur me <https://www.umrechnung.org/>

Termi *Big Data* [KTGH13, WB13, Die03, CML14], që e përshkruan këtë fenomen të rritjes së vazhdueshme të të dhënave, ka filluar të përdoret si metodë që merret me këtë problem dhe me përpjekjen për të ofruar zgjidhje. Përkufizimi i ashtuquajtur *Modeli 3V* (Volume, Velocity, Variety) [Bey11, Lan01] përshkruan më së miri detyrën e big data dhe merret me problemin në disa nivele: (1) vëllimi i madh i të dhënave dhe ruajtja efiçente e tyre (*volume*), (2) shpejtësia, me të cilën përpunohen dhe analizohen të dhënat (*velocity*), si dhe (3) shumëllojshmëria e të dhënave dhe strukturimi i tyre (*variety*).

3.1 Data Mining

Data Mining, si një metodë moderne e analizimit të të dhënave duke përdorur teknikat nga fusha e matematikës, inteligjencës artificiale dhe machine learning, është forma gjysmautomatike e nxjerrjes së dijes së fshehur në të dhëna, sidomos kur për ekzistencën e kësaj dije nuk ka njohuri paraprake, d.m.th. të marrësh përgjigjen pa e ditur pyetjen. Rezultatet e fituara nga një analizë me *data mining* duhen që të jenë të vlefshme, potencialisht të nevojshme e të shfrytëzueshme, si dhe të panjohura deri me tani [FPSSU96].

Ka disa metoda te data mining, por kryesoret janë [Jan06]:

- **clustering** (grupimi)

grupimi i objekteve sipas tipareve të tyre

- **classification** (klasifikimi)

klasifikimi i objekteve në klasa të ndryshme, të njohura paraprakisht.

Shumë algoritme të ndryshme e që sot gjejnë përdorim të madh në fusha të ndryshme shkencore (*artificial neural networks, deep learning, information retrieval, predictive analytics, cognitive computing, recommendation systems*, etj.), u takojnë metodave të lartshënuara dhe nuk do të shtjellohen me tutje.

Para se të bëhet analizimi i objekteve me njërin nga metodat e *data mining*, duhet që të përcaktohen tiparet (veçoritë) e veçanta për secilin objekt (p.sh. një libër, një ngjarje historike, një vegël arkeologjike, një hartë a një fotografi).

Tiparet e objektit shërbejnë për përshkrimin e një objekti real, për ta pasqyruar atë në një objekt logjik, i cili pastaj mund të analizohet me formula matematikore. Për shembull, një objekt në hapësirën 3-dimensionale mund të ketë 3 tipare (x , y , z), të cilat e specifikojnë pozitën e objektit në hapësirë, gjersa një pikë në sipërfaqen 2-dimensionale ka dy tipare (dimensionin x dhe atë y). Një laps, p.sh. mund të ketë disa tipare specifike (gjatësinë, diametrin, ngjyrën, etj.) e që e dallojnë lehtë nga një objekt tjetër, p.sh. fletorja, qe ka tipare të tjera (formatin, numrin e faqeve, materialin, etj.). Mirëpo, varësisht prej tipareve të tij, lapsi mund të ketë ngjashmëri me objekte të tjera, p.sh. me një stilolaps. Do të thotë, në këtë rast ngjashmëria në mes të lapsit dhe të stilolapsit është me e madhe se ngjashmëria në mes të lapsit dhe të fletores. Në këtë mënyrë mund të llogaritet edhe ngjashmëria në mes të dokumenteve dhe të shënimeve të ndryshme, që është parakusht për të mundësuar përdorimin e metodave të *data mining*.

Clustering (grupimi)

Detyrë e *clustering* është që të ndajë objektet e analizuar në grupe (ang. *cluster*) të ndryshme, varësisht prej *veçorive* (tipareve) të tyre. Këto grupe ndahen në atë mënyrë që ngjashmëria në mes të objekteve të një grupi të jetë sa më e madhe, dhe ngjashmëria midis objekteve të grupeve të ndryshme të jetë sa më e vogël.

Për të ilustruar procesin e grupimit të objekteve, të cilat mund të jenë abstrakte ose konkrete (ngjarje të ndryshme, dokumente, fotografi, personalitete të ndryshme historike, etj.), në figurën 3.2 është paraqitur një shembull i thjeshtë i grupimit të personaliteteve të ndryshme historike duke u bazuar në dy veçori (tipare) përkatëse.




Fig. 3.2 Clustering (grupimi).

Le të jenë për objektet **A**, **P**, **S**, dhe **B** nga figura 3.2 këto tipare të të dhënave:

X = periudha kohore

Y = vendi i luftimit

Le të jenë objektet **A**, **P**, **S**, dhe **B** nga figura 3.2 personalitete historike, të përshkruara me tiparet **X** dhe **Y**:

A – Aleksandri i Madh {*para erës së re, Persia*}

P – Pirroja {*para erës së re, Italia*}

S – Skënderbeu {*era e re, Shqipëria*}

B – Isa Boletini {*era e re, Shqipëria*}

Sic vërehet lehtë në këtë shembull, procesi i grupimit do të krijojë dy grupe me objektet e dhëna: Aleksandri i Madh dhe Pirroja do të grupohen në një grup, kurse Skënderbeu dhe Isa Boletini në një grup tjetër. Kjo ndarje bazohet në tiparet e tyre, përmes të cilave llogaritet ngjashmëria në mes të objekteve: Skënderbeu ka jetuar pas erës së re dhe ka luftuar në Shqipëri, njëjtë sikur edhe Isa Boletini. Ndërsa Aleksandri i Madh dhe Pirroja kanë jetuar para erës së re dhe kanë luftuar në vende të ndryshme të botes (jo në Shqipëri).

Ne realitet, numri i tipareve është shumë më i madh dhe procesi i grupimit është shumë më kompleks. Në këtë shembull le të shërbejnë vetëm këto dy tipare të thjeshta, sa për të ilustruar procesin e grupimit. Mirëpo, në këtë mënyrë bëhet llogaritja e grupeve edhe për dokumente të tjera shumë me komplekse (me numër më të madh e kompleks të tipareve dhe me numër shumë më të madh të objekteve).

Klasifikimi

Për dallim nga *clustering*, te klasifikimi dihen paraprakisht se cilat janë klasat (grupet) ekzistuese. Detyra e kësaj metode është, që objektet e reja dhe të panjohura, t'i grupojë në një nga klasat ekzistuese.

Për të vazhduar me shembullin e mësipërm, le të kemi një objekt të ri, klasën e të cilit nuk e njohim ende:

H – Hanibali {*para erës së re, Italia*}

Duke i marrë për bazë veçoritë e objektit **H**, algoritmi do ta grupojë atë në të njëjtin grup me Aleksandërin e Madh dhe me Pirron.

Procesi i klasifikimit ndahet në dy hapa: në hapin e parë bëhet ndërtimi i klasifikatorit, duke e ushtruar dhe testuar atë me objekte, klasat e të cilëve dihen. Dhe në hapin e dytë, duke e përdorur klasifikatorin e ushtruar më parë për të bërë futjen e objekteve të reja në njërin nga grupet (klasat) ekzistuese (si p.sh. Hanibalin në një grup me Aleksandërin e Madh dhe me Pirron).

Në shembujt e mësipërm janë përdorur të dhëna të thjeshta dhe qëllimisht nuk është sqaruar në detaje procesi matematikor i llogaritjes së ngjashmërisë në mes të objekteve të ndryshme. Sikurse që janë marrë tipare (veçori) të thjeshta për objektet A, P, S, B, dhe H, për të sqaruar më lehtë procesin (p.sh. Aleksandri i Madh nuk ka luftuar vetëm në Persi, ose Skënderbeu vetëm në Shqipëri).

Qëllimi i përpunimit të të dhënave të shumta (*big data*), të shpërndara dhe heterogjene, me të cilat merren metodat e *data mining* dhe algoritmet përkatëse, është analizimi i tyre dhe nxjerrja e dijes nga këto të dhëna. Figura 3.3 ka për qëllim që përmes të ashtuquajturës “Shtylla e dijes”, të ilustrojë detajisht ndërlidhjen e dijes me informacionet ose me të dhënat, siç do të përmenden në këtë punim. Në këtë mënyrë duket qartë, që dija ndërtohet mbi rrjetin e informacioneve, në përmbajtje të të cilave janë të dhënat që do të analizohen dhe do të përpunohen. Nga simbolet e një alfabeti, kur të përdorim rregulla të veçanta sintaksore, krijohen të dhënat. Këto pastaj, nëse vihen në kontekste të ndryshme, e japin informacionin. Me rrjetëzimin e informacioneve gjenerohet pastaj dija e fshehur në të dhëna.



Fig. 3.3 Shtylla e dijes (përshtatur nga [Jan06]).

4 Modeli dhe procesi për integrimin e dijes

Digjitalizimi i dokumenteve dhe i materialeve të ndryshme arkeologjike, historike ose gjuhësore nuk është diçka e re, as për shkencën e albanologjisë dhe as për shkencat e ngjashme. Shumë dokumente, sidomos libra të vjetra, janë të skanuara dhe gjenden në formë të digjitalizuar në arkiva dhe në biblioteka të ndryshme nëpër botë. Po ashtu ekzistojnë edhe indekse të shumta elektronike të publikimeve të ndryshme ose të vëllimeve që i ka një bibliotekë. Në të gjitha këto dokumente mund të kërkohet – herë më me shumë e herë më me pak sukses – duke përdorur vegla ekzistuese të informatikës.

Mirëpo, është një ndryshim i madh në mes të kërkimit të bazuar vetëm në të dhëna bibliografike, ose në fjalë çelës, të dokumenteve, dhe në mes të një kërkimi të bazuar në metoda moderne të *data mining*, ose *big data*, për analizimin e të dhënave. Përderisa në versionin e parë (kërkimi në të dhëna bibliografike) synimi i kërkimit është i njohur, p.sh. kërkimi i një dokumenti të caktuar, në versionin e dytë (data mining) synimi i kërkimit nuk është medoemos i njohur, pasi që analizimi i të dhënave/kërkimit mund të nxjerrë më shumë rezultate të cilat mund të mos kenë qenë të njohura gjatë ose në fillim të hulumtimit. Mu kjo e fundit është fuqia (e veçanta) e metodës sonë të propozuar e cila shpie drejt një dije sa më të zgjeruar.

Siç është cekur më lart, secila shkencë përbëhet prej (nën)fishave të ndryshme, të cilat përfshijnë një numër të madh materialesh të llojllojshme të ashtuquajturat *artefakte* (libra të vjetër, skulptura, vizatime, shkrime dhe dokumente të ndryshme, etj.). Sikur të përshkruheshin këto artefakte në mënyrë digjitale dhe këto përshkrime të integroheshin në një bazë të përbashkët të të dhënave, atëherë do të mund të krijohet një lidhje ose një *rrjet* ndërmjet këtyre artefakteve. Ky rrjet pastaj do të shërbente për nxjerrjen e *dijes* së fshehur në këto të dhëna.

Në figurën 4.1 është paraqitur modeli abstrakt i sistemit që propozojmë ne për nxjerrjen e dijes nga të dhënat. Në shtresën e parë ndodhen artefaktet e digjitalizuara. Me kombinimin e artefakteve krijohen, në shtresën e dytë, rrjete me rezultate të veçanta. Nga secili prej këtyre rrjeteve, në shtresën e tretë, mund të nxirret dija specifike.




Fig. 4.1 Modeli për nxjerrjen e dijes

shërbejë si bazë e gjenerimit të dijes për tema të ndryshme përmes rrjeteve të ndryshme. Për ilustrim, në figurën 4.1, Thunmann dhe Xylander përdoren për të krijuar rrjete respektivisht dije me kuptim si gjuhësor ashtu edhe historik.

Procesi i realizimit të modelit të propozuar në figurën 4.1 është i ndarë në tri faza kryesore, të cilat përbëhen prej tri shtyllave: *hyrjes* së të dhënave, *përpunimit* të këtyre të dhënave dhe *rezultatit* përkatës. Në figurën 4.2 është paraqitur sistemi me fazat e përshkruara shkurt:

1. Faza e parë (I): Digjitalizimi i artefakteve

Që përshkrimi i artefakteve, ruajtja dhe menaxhimi i këtyre të dhënave të jetë sa më i lehtë, duke përfshirë këtu dhe analizimin e mëvonshëm, në këtë fazë, është e nevojshme krijimi i një infrastrukture përkatëse (sistemi për bazën e të dhënave, serveri për qasje në të dhëna, etj.). Rezultati i kësaj faze shpie te krijimi i një bibliografie të artefakteve të digjitalizuara dhe mundësisë së kërkimit në këto të dhëna.

2. Faza e dytë (II): Rrjeti i artefakteve

Për të lehtësuar dhe përmirësuar gjetjen e dokumenteve të kërkuesit dhe të atyre që mund të jenë relevante për kërkimin e bërë, në këtë fazë është i nevojshëm plotësimi i të dhënave me fjalë çelës,

respektivisht me *meta të dhëna*³. Kërkimi i dokumenteve realizohet jo vetëm bazuar në të dhënat bibliografike, por edhe duke u bazuar në përmbajtjen e dokumenteve të digjitalizuara (të kërkimit në tekst).

3. Faza e tretë (III): Dija

Në fazën e fundit realizohet analiza efiçente e të dhënave me metodat e *data mining* dhe të inteligjencës artificiale, prej nga edhe nxirret dija e fshehur në të dhënat, te cilat janë të ruajtura në sistem.




Fig. 4.2 Fazat e sistemit të propozuar

4.1 Faza I: Digjitalizimi i artefakteve dhe ndërtimi i infra-strukturës përkatëse

Për të lehtësuar përpunimin e artefakteve dhe për të përmirësuar punën gjatë një hulumtimi është i pashmangshëm ndërtimi i një infra-strukture kompjuterike a sistemi informatik. Një sistem i tillë është krijuar gjatë këtij projekti dhe bazohet në teknologjinë e Internetit. Sistemi përbehet prej një nënsistemi për bazën e të dhënave, programit përkatës për futjen e të dhënave të artefakteve apo kërkimit në këto të

³ *Meta të dhënat* (anglisht. *meta data*) janë shënime plotësuese për një dokument, të cilat përshkruajnë në mënyrë abstrakte përmbajtjen e tij ose sqarojnë përmes fjalëve çelës veçori të veçanta të dokumentit.

dhëna si dhe serverit që e mundëson qasjen në bazën e të dhënave. Ky i fundit është i lidhur 24 orë në ditë drejtpërdrejt me internetin, çka do të thotë se qasja në sistem mund të bëhet në çdo kohë.

Në figurën 4.3 është paraqitur një shembull nga infrastruktura e ndërtuar gjatë projektit. Në anën e majtë shihet fotografia e një artefakti (një foto e një mikrofilmi). Në anën e djathtë shihen të dhënat mbi këtë artefakt, si p.sh., burimi, data dhe transkribimi i tekstit të fotografuar. Transkribimi i fotografive ose i dokumenteve të tjera origjinale e luan një rol të rëndësishëm, pasi që e mundëson analizimin edhe më të lehtë të të dhënave. Sistemi e mundëson korrigjimin ose shtuarjen e të dhënave për secilin dokument. Për shembull, me përkthimin e fotografisë në gjuhën shqipe, bëhet i mundur kuptimi i tekstit edhe nëse hulumtuesi nuk e zotëron gjuhën origjinale, në të cilën është shkruar dokumenti. Në versionin aktual të sistemit është gjithashtu e mundur të bëhen kërkime në të dhënat ekzistuese, kurse rezultatet mund të sortohen (renditen) dhe të filtrohen, për të lehtësuar kështu gjetjen e dokumenteve të kërkuara.



Fig. 4.3 Infrastruktura për digjitalizimin dhe menaxhimin e të dhënave të artefakteve

Sa i rëndësishëm është digjitalizimi i artefakteve do ta ilustron me një shembull të thjeshtë. Në figurën 4.4 është paraqitur një fjali e një shkrimi ku flitet për besimin fetar të shqiptarëve, qasjen e tyre ndaj të dyja feve (të besimit të krishterë dhe islam) dhe respektin ndërfetar te shqiptarët si askund tjetër në botë. Thelbi i shkrimit, ku kjo fjali është gjetur, megjithatë, nuk është feja. Shënime të tilla është vështirë për t'i gjetur gjatë një hulumtimi me metoda klasike nëpër arkiva. Kur të dhënat janë të digjitalizuara, mjafton të kërkohet në sistem për fenë te shqiptarët dhe një shkrim i tillë u ofrohet shumë lehtë hulumtuesve.



Fig. 4.4 Politeizmi te shqiptarët

Përkthimë i lirë i fragmenteve të tekstit nga figura 4.4: “*Ka fshatra shqiptare, banorët e të cilave, sado e pabesueshme që tingëllon, janë në të njëjtën kohë edhe myslimanë dhe të krishterë.*”

4.2 Faza II: Krijimi i rrjetit të informacioneve

Faza e dytë, që ka për qëllim rrjetëzimin e artefakteve, respektivisht të informacioneve rreth këtyre artefakteve, merret me plotësimin e përshkrimit të artefakteve me meta të dhëna. Sa më shumë të dhëna të vlefshme dhe precize që përdoren për përshkrimin e veçorive të artefakteve, siç janë p.sh., ku dhe kur është gjetur, cilës kohë i takon, kush e ka gjetur, cilat janë përmasat, si dhe meta të dhënat me rëndësi, aq më i vlefshëm krijohet rrjeti i informacioneve të këtyre artefakteve. Një rrjet i këtij lloji është skicuar në figurën 4.4 (A1-A12 paraqesin artefakte të ndryshme të lidhura ndërmjet veti duke u bazuar në meta të dhënat e tyre).




Fig. 4.4 Krijimi i rrjetit të artefakteve.

Krijimi i rrjetit të artefakteve është një proces kompjuterik, i cili bazohet në analizimin automatik të artefakteve dhe të përshkrimeve të tyre me meta të dhëna. Përmes kësaj analize bëhet llogaritja e pikave të përbashkëta dhe e lidhjeve tematike ndërmjet artefakteve të ndryshme, nga të cilat lidhje rezultojnë rrjeti i artefakteve.

Me anë të një shembulli (shih figurën 4.5) do të skicohen hapat e krijimit të një rrjeti të informacioneve dhe mundësia për nxjerrjen e dijes nga to (pjesë e fazës së tretë). Shembulli është i thjeshtë dhe bazohet në njohuri të përgjithshme nga historia, por ka për qëllim sqarimin e procesit të rrjetëzimit të informatave dhe interpretimin e mundshëm të tyre në shkencën e historisë. Le të marrim sa për ilustrim në këtë shembull vetëm këto burime: Pausiani [Pau160][Pau160b], Apiani [Api1837], Kistler [JK2006] dhe historinë e Pirros nga historia shkollore. Te gjitha përshkrimet e këtyre artefakteve merren parasysh si të plotësuara me meta të dhëna përkatëse (Pirroja, luftërat e Pirros, Shqipëria antike, Roma, Kartaxhena, luftërat Punike, elefantët luftarakë, etj.). Ndërtimi i rrjetit mund të fillon me të dhënat rreth Pirros, respektivisht Shqipërisë antike, me ç'rast krijohet një nyje e parë e rrjetit. Duke i marrë parasysh të dhënat rreth kalimit të Pirros në Itali dhe luftërat e tij kundër Romës, krijohet një nyje e re (Roma) si dhe lidhshmëria me nyjën ekzistuese (Shqipëria antike). Përfshirja e të dhënave të tjera rreth pranisë së një fuqie tjetër të madhe luftarake në jug

të Italisë, respektivisht në Sicili, dhe me hyrjen e Pirros në luftime kundër kësaj fuqie, Kartaxhenës, në rrjet krijohet nyja e re (Kartaxhena) me lidhjen përkatëse. Zgjerimin e fundit të rrjetit e paraqet lidhja në mes të Kartaxhenës dhe Romës, edhe pse luftërat në mes tyre, të njohura si Luftërat Punike, mund të analizohen plotësisht të izoluar nga luftërat e Pirros kundër Romës ose kundër Kartagjenës. Me integrimin e tërësishëm të këtyre artefakteve, rrjeti i informacioneve në figurën 4.5 bëhet më i plotë dhe më i vlefshëm për të nxjerrë nga aty më shumë informacione historike, se sa që mund të nxirren nga vetëm disa dokumente të izoluar nga njëra-tjetra për këtë periudhë.




Fig. 4.5 Shembull i një rrjetëzimi dhe nxjerrja e dijes

Shembulli i skicuar në figurën 4.5 është natyrisht i thjeshtë dhe bazohet në njohuri të përgjithshme historike. Mirëpo, ka për qëllim vetëm që të ilustrojë procesin e rrjetëzimit dhe krijimin e lidhjeve në mes të dokumenteve të ndryshme nga baza e të dhënave.

4.3 Faza III: Gjenerimi dhe nxjerrja e dijes

Pas digjitalizimit të artefakteve, plotësimin të tyre me meta të dhëna dhe pas krijimit të një rrjeti të informacioneve, duke u bazuar në të dhënat që gjenden në bazën e të dhënave, mund të bëhet krijimi dhe nxjerrja e dijes. Ky hap realizohet nën përdorimin e metodave moderne dhe eficientë të data mining (clustering, classification, association rules, etj.), të cilat e mundësojnë një analizim automatik të të dhënave.

Nga këndvështrimi i nxjerrjes së dijes, nga shembulli i mëparshëm i skicuar në figurën 4.5, mund të nxirret një lidhje në mes të Pirros dhe Hanibalit, edhe pse një lidhje e drejtpërdrejtë në mes tyre nuk ekziston (Hanibali ka lindur rreth një çerek shekulli pas vdekjes së Pirros). Kërkimet në dokumente që flasin në të njëjtën kohë për të dy janë shumë të pakta (më së shpeshti haset admirimi i Hanibalit ndaj Pirros dhe konsiderimi i Pirros, pas Aleksandërit të Madh, si luftëtarit më të zotë deri në atë kohë).

Nga ky rrjet mund të nxirret dija që mund të ketë rrjedhur nga pyetjet, si p.sh.: ç'mësuan Roma dhe Hanibali nga Pirroja si strateg lufte në përgjithësi, si dhe nga përdorimi i elefantëve në betejat e drejtuara nga Pirroja, në veçanti? Pos kësaj, prej këtij rrjeti (me përfshirjen e të dhënave të tjera, p.sh. [Pau160][Pau160b]) mund të nxirret edhe dija tjetër, që shkon në drejtim krejtësisht tjetër e ku mësohet që Epirotët kanë luftuar në Luftën e Trojës, si dhe për përvojën e tyre jo të mjaftueshme në lidhje me luftën në det.

Do të thotë, rezultatet në fazën e tretë janë shumë më komplekse dhe të shumëllojshme, për dallim nga një kërkim i thjeshtë në listën bibliografike të artefakteve të digjitalizuara. Për më shumë kur për dijen (rezultatet) e nxjerrë nuk është ditur më parë që ekziston si e tillë dhe në këtë kontekst.

Me anë të sistemit të propozuar, pos dokumenteve që janë futur deri më tani në bazën e të dhënave, ne synojmë integrimin e *dijes kombëtare* në shkencat e albanologjisë. Propozimi ynë në këtë punim e parashih ndërlidhjen e burimeve shkencore dhe të botimeve të ndryshme në shkencën e albanologjisë jo vetëm në aspektin lokal, në vendet e rajonit ku albanologjia e ka fushën e vet të mbulueshmërisë (p.sh. biblioteka, arkiva), por sistemi i propozuar e parashih edhe ndërlidhjen me punime dhe të dhëna shkencore nga e mbarë bota, siç është paraqitur në figurën 4.6. Në këtë mënyrë, pas një integrimi informatik të të dhënave, rriten potencialet e gjenerimit të dijes së pazbuluar deri më tani në fushën e shkencave albanologjike.




Fig. 4.6 Dija e integruar kombëtare.

5 Materialet e përdorura dhe rezultatet e para

Rezultatet fillestare të këtij punimi hulumtues bazohen pjesërisht në të dhënat e mbledhura gjatë projektit “Arkivat” [JFJ14][JFQ+14][JJ16], hulumtimet e të cilit janë realizuar kryesisht në Bibliotekën Shtetërore të Bavarisë në Mynih (Bayerische Staatsbibliothek). Kjo bibliotekë posedon mbi 1.000.000 vëllime të ndryshme, që nga Antika e deri më sot.

Si materiale për studimin tonë janë marrë për bazë kryesisht libra të vjetër të botuar nga të huajt si dhe mikrofilma e mikrofishetë të dokumenteve të vjetra, të cilat për shkak të vlerës së tyre historike ndodhen në hapësira të mbrojtura të bibliotekës. Në figurën 5.1 është paraqitur një pjesë e ambientit të materialeve të përpunuara gjatë hulumtimit. Në përgjithësi janë përdorur mbi 170 fotografi nga mikrofilmat dhe mikrofishet si dhe mbi 4.000 faqe librash të vjetër. Përpunimi i të gjitha të dhënave është bërë duke u bazuar në sistemin e propozuar në fazën e parë (I) të modelit të propozuar në kapitullin e mëparshëm.



Materialet:
 - Mikrofilme (rreth 170 fotografi)
 - Libra të vjetër (mbi 4000 faqe)

Artefaktet:
 - Münchener Post (1912)
 - Münchener Zeitung (1912)
 - Münchner Neueste Nachrichten (1912)
 - Allgemeine Zeitung München (1912-1914)
 - Apiani (shek. II, përkthimi 1838)
 - Pousani (shek. II, përkthimi 1829)
 - J. Ritter von Xylander (1833)
 - Pál Beregszászi (përkthimi 1796)
 - Johan von Thunmann (1774)
 - Francesco da Lecce (1718)
 - Frang Bardhi (1635)

Fig. 5.1 Materialet e përdorura

Siç edhe është cekur më herët, thelbi i këtij punimi ka të bëjë me hulumtimet në fushën e albanologjisë, qofshin këto kërkime në shtypin e huaj (gjerman) të kohës së Lëvizjes për Pavarësi të shqiptarëve gjatë viteve 1910-1913, ose kërkime në dokumente të vjetra deri 400 vjeçe ku flitet p.sh. për historinë, shtrirjen gjeografike, gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Në veprën e tij të botuar në Leipzig në vitin 1774 “*Untersuchun-*

gen über die Geschichte der östlichen Europäischen Völker” [Thun1774], Johann Thunmann, e bën një motivim, që i përshtatet shumë mirë punës së këtij punimi (shih figurën 5.2).




Fig. 5.2 [Thun1774], Leipzig 1774, faqe 322

Përkthimi i lirë i tekstit në gjuhën gjermane nga figura 5.2: “...Unë vetëm dua që përmes një vargu faktesh, të radhitura në mënyrë kronologjike, të sjell në dritë prejardhjen e shqiptarëve: për të larguar errësirën dhe hutinë, të krijuara përmes hamendjeve të tepëruara dhe përmes rrjedhave të kohës të bëj të dukshëm një popull, i cili u përket popujve më të vjetër të Evropës dhe ka mbijetuar, edhe përkundër aq shume vërshimeve të grekëve, romakëve, gotëve, sllavëve, francezëve, italianëve dhe turqve.”

Në nënkapitujt në vijim do t’i përshkruajmë disa rezultate të përzgjedhura, si shembuj të thjeshtë për ilustrimin e të gjeturave gjatë hulumtimit tonë, duke përdorur modelin e propozuar në këtë punim. Përshkrimi i hollësishëm i procesit të zgjedhjes dhe nxjerrjes së këtyre rezultateve do të shpërthente kornizën e qëllimit të këtij punimi, prandaj i jemi shmangur një përshkrimi të tillë të zgjeruar.

5.1 Shembull: Shpallja dhe ndërtimi i shtetit Shqiptar në vitin 1912

Nga numri i madh i të dhënave të gjetura, e që flasin për kryengritjen e shqiptarëve në kohën e lëvizjes për Pavarësi, Luftërat Ballkanike, kulturën dhe traditat shqiptare, për politikatat e Fuqive të Mëdha të kohës dhe të interesave të tyre për regjionin e Ballkanit, ne kemi përzgjedhur dy shembuj (sh1, sh2).

Sh1: Në figurën 5.3 është paraqitur shënimi me rastin e themelimit të njësisive të para ushtarake për mbrojtjen e Shtetit të Pavarur Shqiptar, botuar në një gazetë gjermane me 06.12.1912.




Fig. 5.3 Njësitë e para ushtarake të Shtetit Shqiptar më 1912

Përkthimi i lirë dhe i përshtatur i tekstit në gjuhën gjermane nga figura 5.3 me titull “*Qeveria e përkohshme për Shqipërinë*”: “*Vlorë, 6 dhjetor. Qeveria e Përkohshme ka krijuar në ndërkohë një kabinet. Në krye të tij qëndron Ismail Qemal Beu. Është emëruar një Senat, i përbërë nga 18 anëtarë. Si komandant i njësisive të armatosura kombëtare është caktuar Isa Boletini dhe Riza Beu. Të gjitha zgjedhjet janë bërë në Kuvendin Kombëtar*”.

Një shënim i tillë, edhe pse ndoshta jo gjithsesi i panjohur për historiografinë shqiptare, është i një rëndësie të veçantë, pasi që është shënim origjinal i shkruar i kohës me rastin e një ngjarje të tillë me rëndësi për historinë e shtetit shqiptar. Nga ky shënim mësohet për krijimin e strukturave të para të shtetit shqiptar, duke iu përmbajtur çdo herë formës parlamentare dhe demokratike të strukturës shtetërore dhe duke përmendur edhe aktorët kryesorë që udhëhoqën me këto struktura. Nga ky lajm i shkurtër, në kombinim edhe me shënime të tjera për këtë periudhë, mund të nxirren edhe përfundime të tjera me rëndësi. Për shembull, që që nga filltet e para të Shtetit të posashpallur Shqiptar janë ndërtuar struktura të vërteta shtetërore dhe janë marrë vendime demokratike dhe institucionale.

Sh2: I një rëndësie të veçantë për historianët mund të jetë edhe njoftimi, përmbajtja e tij dhe vlerësimi që i behet vetë aktit të marrjes së vendimit në Konferencën e Ambasadorëve në Londër për njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë, siç është paraqitur në figurën 5.4. Në njoftimin e gazetës se datës 30 korrik 1913, mësohet se vendimi është marrë një ditë më parë, më 29 korrik 1913, gjatë Konferencës në Londër.



Fig. 5.4 Lajmi për njohjen e Pavarësisë së Shqipërisë

Përkthimë i lirë dhe i përshtatur i tekstit në gjuhën gjermane nga figura 5.4 me titull “*Shqipëria e re*”, i 30 korrikut 1913 nga Londra: “*Në mbledhjen e saj të djeshme, Konferenca e Ambasadorëve në Londër çoj një hap më para zgjidhjen e çështjes shqiptare, me ç’rast ata u pajtuan për statusin shqiptar. Një telegram na njofton neve për këtë: WTB. Londër, 30 korrik (Telegraf) – Në mbledhjen e djeshme të Lidhjes së Ambasadorëve, e cila zgjati tri orë, u rregullua përfundimisht çështja e statusit shqiptar. Shqipëria duhet të qeveriset nga një princ, i cili do të emërohet brenda gjashtë muajve*”.

Prej një njoftimi të tillë, në një vështrim të dytë të lajmit, mund të mësohen shumë gjëra, të cilat mund të jenë me rëndësi gjatë një hulumtimi. Për shembull, pos faktit që u mor një vendim, aty mund të lexohet data e saktë, kohëzgjatja e seancës dhe problematika rreth statusit të pazgjidhur të shqiptarëve. Sidomos me rëndësi mund të jetë shkalla e vlerësimit (pozitiv ose negativ) të një lajmi të tillë dhe të nxirret nga aty opinioni për shqiptarët në mediat gjermane në atë kohë.

5.2 Shembull: Gjuha

Gjatë një hulumtimi shkencor, p.sh. rreth ndikimit të gjuhës shqipe në gjuhët e popujve fqinj, shënimet e Thunmann-it [Thun1774] mund të jenë të njohura (shih fig. 5.5), ku shkruan që gjuha shqipe mund të ketë pasur ndikim në gjuhën greke shumë shekuj më herët, që

në shekullin V. Sistemi i propozuar në këtë punim, jo vetëm që do të lehtësonte gjetjen e shkrimit të lartpërmendur në botimin original të vitit 1774, por do të ofronte, falë rrjetëzimit të të dhënave, edhe shënimin e Jakob Philipp Fallmerayer [Fall1836] ne librin e tij nga viti 1836 “*Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters: ein historischer Versuch*” (shqip: “*Historia e gadishullit Morea gjatë Mesjetës: një përpjekje historike*”), vëllimi i dytë⁴, siç është paraqitur në figurën 5.6.



Fig. 5.5 [Thun1774], Leibzig 1774, faqe 323 ne fusnote

Përkthimi i lirë i tekstit në gjuhën gjermane nga figura 5.5: “*Unë kam gjurme, që ky ndikim ka filluar shumë herët. Për shembull Buka quhet në gjuhën shqipe buka dhe grekët, qysh në shekullin V, i vunë një lloj buke pikërisht këtë emër.*”




Fig. 5.6 [Phi1836], Stuttgart 1836, faqe XXV

Përkthimi i lirë i fragmenteve të tekstit në gjuhën gjermane nga figura 5.6: “*Edhe në vet qytetin e Athinës, ... thelbi [i popullsisë, autorëtë është aq shqiptar, saqë është i nevojshëm një tribunal i veçantë, për të ndarë drejtësinë në gjuhën shqipe (Shkypitarish).*”

Duke u shtuar këtyre edhe disa shënime të Edmond About

⁴ Pavarësisht vlerësimit nganjëherë kritik nga studiuesit e tjerë të mendimit të tij për prejardhjen e grekëve të sotem.

[EA1855] në botimin e vitit 1855, faqe 32, ku shkruhet, pos të tjerash: “... *Kjo është për arsye se para 25 vjetësh Athina ka qenë vetëm një fshat shqiptar. Shqiptarët e përbënin dhe vazhdojnë ta përbëjnë pothuajse krejt popullsinë e Atikes; ...*”, mund të nxirret dija rreth shtrirjes së gjuhës shqipe në atë kohë në More (Peloponez) dhe Atikë.

5.3 Shembull: Mitet dhe legjendat

Shembulli në vijim e ka mbështetjen në mite dhe legjenda, qe do të thotë se për të njëjtat ngjarje mund të ekzistojnë versione të ndryshme. Sidoqoftë, edhe pse kemi të bëjmë me mite a legjenda, ku interpretimet mund të jenë të ndryshme, ne bazohemi në dokumente reale të gjetura gjatë hulumtimeve tona, dhe i kemi ndërlidhur të dhënat e nxjerra nga to në mënyrë sa më të logjikshme me njëra-tjetrën. Ky shembull nuk synon të gjetura të mëdha të historisë faktike shkencore evropiane a shqiptare, pasi që bazohet kryesisht në mite dhe legjenda, por synon të ilustrojë krijimin e rrjetit të artefakteve dhe të nxjerrjes së dijes nga këto të dhëna (shih fig. 5.7) në mënyrë sa më të thjeshtësuar.

Thelbi i hulumtimit në këtë shembull ka qenë, të mësohet nga dokumentet/artefaktet ekzistuese më shumë rreth ndikimeve ilire-dardane në historinë e lashtë të Evropës.

Sipas historianit të Antikës Apianit [Api1837] dhe librit për historinë e keltëve dhe teutonëve [Cit1822] fëmijët e Galateas dhe ciklopit Polifem ishin Iliri, Gali dhe Kelti, prej të cilëve lindën Ilirët, Galët dhe Keltët. Ndër pasardhësit e Ilirit ishin Dardani, Enkeli, Taulanti, Dasara e të tjerë, prej të cilëve rrjedhin Dardanët, Enkelenjët, Taulantët e kështu me radhë.

Për pasardhësit e Dardanit (Dardnos, Dardanus), pra dardanëve ilirë, thuhet që kanë lidhje me Trojën, pasi që Trojanët shihen si pasardhës të Dardanit (Dardanosit), të ardhur nga Dardania ilire dhe te vendosur në Azi, ku themelojnë Trojën [OCD2012, Cit2001].

Për Luftën e Trojës, heronjtë e saj dhe princat udhëheqës të trojanëve dhe dardanëve, Hektorin dhe Eneun, flitet në Iliadën e Homerit. Me rënien e Trojës dhe shkatërrimin e saj nga grekët, siç dihet, fillon

historia e largimit të aristokracisë trojane drejt vendeve të tjera. Shumë prej tyre nisen drejt “Tokës së vjetër”, ashtu siç i këshillon orakulli [Virgil]. Kështu, Eneu dardan bashkë me të birin dhe babanë e tij largohet nga Troja në drejtim të “Tokës së vjetër”, pa a ditur në fillim se për cilin vend konkretisht bëhet fjalë. Krugëtimin e tij disavjeçar nëpër Mesdhe dhe vendet mesdhetare, i përshkruan për shembull Virgjili në Eneide [Virgil].

Shtegtimi i Eneut përfundon në Italinë e sotme, në Latium (Alba Longa), ku ai krijon mbretërinë e tij me trojanët që i kishte me vete. Nga këtu fillon edhe legjenda e prejardhjes së Romës antike, sipas së cilës Remi dhe Romuli janë pasardhës të drejtpërdrejtë të Eneut.

Historia e pasardhësve të Trojës antike, si popull shumë fisnik, vazhdon edhe në mitet dhe legjendat e popujve të tjerë të Evropës. Kështu për shembull, sipas [HiBr828], Londra dhe pastaj e gjithë Anglia është e themeluar nga nipi i Eneut, Brutii. Një histori të tillë e hasim edhe në Skoci (Alba/Albon) [SkocSh16], duke e ndërlidhur prejardhjen e tyre prej Albanactusit, që thuhet se ishte pasardhës i Eneut, përmes Brutit të lartpërmendur ([HiBr828], faqe 253).

Me integrimin edhe të gjitha këtyre legjendave krijohet një tregim për paraardhësit (dardanët) dhe pasardhësit e Trojës (romakët, anglezët, skocezët).




Fig. 5.7 Dardanët nëpër Evropë

6 Përfundimi

Në shekullin e informatikës dhe të përpunimit modern të të dhënave me metodat e *data mining*, e inteligjencës artificiale dhe e *big data*, është imperativ i kohës që edhe shkencat e albanologjisë të përdorin këto metoda në proceset e veta të hulumtimit shkencor. Përpunimi mekanik i burimeve dhe i të dhënave shkencore, pa një mbështetje nga informatika, është pothuajse i pamundur, nëse synohet nxjerrja sa më efektive dhe efikase e dijes së fshehur në artefakte të ndryshme me rëndësi për shkencat albanologjike.

Në këtë punim kemi propozuar një model të një sistemi informatik për nxjerrjen e dijes si dhe procesin e realizimit të këtij modeli. Sistemi i propozuar rezulton me:

- a. digjitalizimin e artefakteve dhe të të dhënave përkatëse
- b. rrjetëzimin e artefakteve
- c. krijimin e një baze kombëtare të dijes.

Në këtë projekt si dhe në projektet paraprake, kemi ndërtuar një prototip të parë të sistemit softuerik siç propozohet në këtë punim, i cili sistem e mundëson realizimin e dy fazave të para: digjitalizimin e artefakteve dhe plotësimin e tyre me meta të dhëna dhe shënime të tjera me rëndësi, për të krijuar rrjetëzime të informacioneve.

Tani jemi duke punuar në integrimin e algoritmeve nga *data mining* për nxjerrjen e dijes siç propozohet në fazën e tretë. Po ashtu, prototipi i ndërtuar deri më tani do të plotësohet me mundësinë për kërkim më efikas në të dhënat e memoruara në bazën e të dhënave.

Në versionin e aktualizuar të softuerit do të integrohet edhe vizualizimi i rrjeteve që do të ndërtohen, për t'ia lehtësuar hulumtuesit shfletimin e artefakteve që kane lidhmëri në mes tyre, edhe nëse hulumtuesi nuk ka ende njohuri për një lidhje të tillë.

Synimi final i projektit është që të krijohet një bazë kombëtare e dijes, në të cilën do të kishin qasje të gjithë shkencëtarët e fushave përkatëse dhe në të cilën bazë të dijes do të futeshin rezultatet e hulumtimeve shkencore nga fusha e albanologjisë.

Acknowledgements

Hulumtimi në këtë punim është vazhdimësi e projektit hulumtues-shkencor 2 vjeçar “Arkivat” (2012 - 2013), i realizuar në arkivat dhe bibliotekat gjermane nga *Shoqëria e akademikëve shqiptarë - DIJA e. V.* në Munih të Gjermanisë dhe i mbështetur edhe nga Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës. I falënderohemi Shoqërisë DIJA për mundësinë e përdorimit të disa grafikëve nga projekti “Arkivat” në këtë punim.

REFERENCAT

- [Api1837] Appianus. Appians römische Geschichte - übersetzt und mit Anmerkungen versehen von Gustav Zeiß. Band I, Leipzig 1837. Band II, Leipzig 1838
- [AZM191214] "Allgemeine Zeitung München", 1912, 1913, 1914, Signatura: 40 Film, Eph.pol.50, 346, Bayerisches Staatsbibliothek München
- [Bey11] M. Beyer. Gartner Says Solving 'Big Data' Challenge Involves More Than Just Managing Volumes of Data. <https://www.gartner.com/newsroom/id/1731916>, 2011. [lexuar se fundi, më 15.02.2018ë.
- [Cit1822]. Dr. I. G. Radlof. Neue Untersuchungen des Keltenthumes zur Aufhellung der Urgeschichte der Teutschen. Druck und Verlag von Heinrich Büschler, Bonn 1822
- [Cit2001] "Lexikon der Geschichte". Orbis Verlag, 2001
- [CML14ë Min Chen, Shiwen Mao, and Yunhao Liu. Big data: A survey. MONET, 19:171-209, 2014.
- [Cor16ë Statista (EMC Corporation). Prognose zum Volumen der jährlich generierten digitalen Datenmenge weltweit in den Jahren 2005 bis 2020 (in Exabyte). <http://de.statista.com/statistik/daten/studie/267974/umfrage/prognose-zum-weltweit-generierten-datenvolumen/>, 2016.[lexuar së fundi, më 13.06.2016ë.
- [Die03] Francis X. Diebold. "Big Data"Dynamic Factor Models for Macroeconomic Measurement and Forecasting: A Discussion of the Papers by Lucrezia Reichlin and by Mark W. Watson, volume 3 of Econometric Society Monographs, pages 115-122. Cambridge University Press, 2003.
- [EA1855] Edmond About. Greece and the greeks of present day. Edinburgh: Thomas Constable and co. Hamilton, Adams and co., London 1855
- [Fall1836] Jakob Philipp Fallmerayer. Geschichte der Halbinsel Morea während des Mittelalters: ein historischer Versuch, Band 2, Stuttgart 1836.
- [Fall1845] Jakob Philipp Fallmerayer. Fragmente aus dem Orient. Band 2, Stuttgart und Tübingen 1845.
- [FB1635] Frang Bardhi. Dictionarivm Latino Epiroticvm, vna cum nonnullis vstiatoribus loquendi formulis. Typis Sac. Congr. de Propag. Fide. Roma 1635
- [FMdL1716] Francesco Maria da Lecce. Osservazioni grammaticali Nella Lingua Albanese. In Roma 1716
- [FPSSU96] Usama M. Fayyad, Gregory Piatetsky-Shapiro, Padhraic Smyth, and Ramasamy Uthurusamy, editors. Advances in Knowledge Discovery and Data Mining. AAAI/MIT Press, 1996.

- [GC1831] Giuseppe Crispi. Memoria sulla lingua albanese. Presso Lorenzo Dato. Palermo 1831
- [GL1861] Guillaume Lejean. Ethnographie de la Turquie d'Europe (Etnografia e Turqisë Evropiane). Gotha: Justus Perthes 1861
- [GW1894] Gustav Weigand. Die Arumunen. Zeiter Band. Leipzig 1894
- [HiBr828] The Historia Regum Britanniae of Geoffrey of Monmouth (rreth vitit 828). Botim i ripunuar nga Action Griscom dhe Robert Ellis Jones. Statkine Reprints, Genever 1977
- [ICD17] David Reinsel, John Gantz, John Rydning. Data Age 2025: The Evolution of Data to Life-Critical. International Data Corporation (IDC) White Paper, sponsored by Seagate. April 2017
- [Jan06] Eshref Januzaj. Data Mining dhe rëndësia e të dhënave. ANASH–Approaching Science, faqe 14. Viti I, numri 1, 2006. ISSN 2519-0008. Verzioni online: http://alpa.mali-it.eu/journal/anash/vol/vol1/ANASH_01_2006_.pdf. Shfletuar se fundmi me 09.08.2018
- [JE1827] John Edler. "A proposal for uniting Scotland with England, addressed to King Henry VII (1542)" in "The Bannatyne miscellany : containing original papers and tracts, chiefly relating to the history and literature of Scotland". Volume I. Printed at Edinburgh M.DCC.XXVII.
- [JFJ14] Eshref Januzaj, Serafina Ferizaj, Visar Januzaj: "Researching old archives with modern computer science methods". in: Proc. 9th Annual Meeting of the Institute Alb-Shkenca, Prishtina, Kosova, 2014. ISBN:978-9951-518-11-6, pp. 174.
- [JFQ+14] Eshref Januzaj, Serafina Ferizaj, Velime Qarri, Irsa Mata, Afrim Nura, Mërgim Përgjegjaj, Petrit Beqiri, Visar Januzaj. "Historia dhe gjuha shqiptare në arkivat gjermane". Libri i abstrakteve, Java e Shkences 2014, Prishtine 2014
- [JJ09] Eshref Januzaj and Visar Januzaj. An application of data mining to identify data quality problems. In Proceedings of the Third International Conference on Advanced Engineering Computing and Applications in Sciences, ADVCOMP 2009, pages 17-22, Sliema, Malta, October 2009. IEEE Computer Society.
- [JJ16] Eshref Januzaj, Visar Januzaj. "Computer-based knowledge networks as a perspective for modern research on history, language and cultural sciences - an example from Albanian ancient history". in: Proc. 11th Annual Meeting of the Institute Alb-Shkenca, Tirana, Albania, 2016. ISBN:978-9928-110-71-8, pp. 52.
- [JK2006] John M. Kistler. War Elephants. Greenwood Publishing Group, 2006
- [JKP04c] Eshref Januzaj, Hans-Peter Kriegel, and Martin Pfeifle. Scalable density-based distributed clustering. In Jean-François Boulicaut, Floriana Esposito, Fosca Giannotti, and Dino Pedreschi, editors, Knowledge Discovery in Databases: PKDD 2004, Proceedings, volume 3202 of Lecture Notes in Computer Science, pages 231-244. Springer, 2004.
- [JX1835] Josef von Xylander. Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren. Frankfurt a. Main 1835
- [KTGH13] Dominik Klein, Phuoc Tran-Gia, and Matthias Hartmann. Big Data.

- <https://gi.de/informatiklexikon/big-data/>, 2013. [lexuar se fundi, me 15.02.2018ë.]
- [Lan01] Doug Laney. 3D Data Management: Controlling Data Volume, Velocity, and Variety. <https://blogs.gartner.com/doug-laney/files/2012/01/ad949-3D-Data-Management-Controlling-Data-Volume-Velocity-and-Variety.pdf>, 2001. [lexuar se fundi, me 15.02.2018ë.]
- [LD1880] Lorenz Dieffenbach. Völkerkunde Osteuropas, insbesondere der Haemoshalbinseln und der unteren Donaugebiete. Erster Band: Türkisches Reich, Albanesen, Illyrier, Thraken, Griechen, Rumänen. Darmstadt, Verlag von L. Brill 1880. Ribotim nga Forgotten Books 2013
- [MNN1912] "Münchener Neuste Nachrichten", 65. Jahrgang, No.538, 1912, Bayerisches Staatsbibliothek
- [MP1912] "Münchener Post", Jg 1912, 18 August - Dezember. Signatura: 20 Film, Eph.pol.8uw, 26, 8|12, Bayerisches Staatsbibliothek München
- [MZ1912] "Münchener Zeitung", 1912, Signatura: 40 Film, Eph.pol.19on, Nr. 51, Bayerisches Staatsbibliothek München
- [Nennius2000] Nennius. History Of The Britos (Historia Brittonum). Translated by J.A.Giles. In parentheses Publications Medieval Latin Series. Cambridge, Ontario 2000
- [OCD2012] "The Oxford Classical Dictionary", 2012
- [Pau160ë] Pausanias des Periëgeten. Geschichte von Griechenland - übersetzt von Carl Gottfried Siebelis. Erste Abtheilung. Metzler, Stuttgart, 1827
- [Pau160b] Pausanias (fl.c.160 CE): Description of Greece, Book I: Attica - 1.12
- [PB1796] Paulus Beregszászi. Ueber die Aehnlichkeit der ungarischen Sprache mit den morgenländischen, nebst einer Entwicklung der Natur, und mancher bisher unbekanntenen Eigenschaften derselben. Gedruckt bei Breitkopf und Härtel, Leipzig 1796
- [PKL1888] "Pierers konversations-Lexikon", 7. Auflage, Erster Band, A-Baohant. Berlin & Stuttgart, Verlag von Spemann, 1888
- [Thun1774] Johann Thunmann. "Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Wlachen" in "Untersuchungen über die Geschichte der östlichen Europäischen Völker". Erster Theil. Leipzig 1774.
- [Virgil] Virgil. The Aeneid. Writen 19 B.C.E. Translated by John Dryden. Verzioni online: <http://classics.mit.edu/Virgil/aeneid.html>. Shfletuar se fundmi me 08.08.2018
- [WB13] Jonathan Stuart Ward and Adam Barker. Undefined by data: A survey of big data definitions. CoRR, abs/1309.5821, 2013.
- [WET+12] Amy Wesolowski, Nathan Eagle, Andrew J. Tatem, David L. Smith, Abdisalan M. Noor, Robert W. Snow, and Caroline O. Buckee. Quantifying the impact of human mobility on malaria. Science, 338(6104):267-270, 2012.

Summary

In the century of information technology and modern data processing with data mining, artificial intelligence and big data methods, it is imperative that the sciences of albanology use these methods in their own scientific research processes. The mechanical processing of sources and scientific data, with no support from computing, is almost impossible if it is to effectively and efficiently extract the hidden knowledge of the various artifacts of importance to the sciences of albanology.

In this paper we have proposed a model of an information system for knowledge extraction and the process of realization of this model. The proposed system results in:

- a. digitalization of artifacts and relevant data
- b. networking of artifacts
- c. the creation of a national database of knowledge.

In this project as well as in the previous projects, we have built a first prototype of the software system as proposed in this paper, which enables the realization of the first two phases: the digitization of artifacts and their filling with metadata and notes of other important things, to create information networking.

We are now working on integrating data mining algorithms as suggested in the third stage. Also, the prototype built so far will be complemented with the ability to search more efficiently on the data stored in the database.

The updated version of the software will also integrate the visualization of the networks to be built to facilitate the browsing of artifacts that have links between them, even if the researcher is not yet familiar with such a link.

The final goal of the project is to create a national database of knowledge, in which all relevant field scientists would have access and on which database knowledge will be stored scientific research results of the field of albanology.

Kimete CANAJ, Universiteti i Prizrenit

ROLI I PROFESORIT AUSTRIAK HERMANN M. ÖLBERG NË STUDIMIN DHE PROMOVIMIN E GJUHËS DHE TË KULTURËS SHQIPE

Hyrje

Kontributi i studiuesit austriak në studimin dhe promovimin e gjuhës shqipe është një rast unik. Ai me hulumtimin të tij e ka definuar pozitën e gjuhës shqipe në grupin e gjuhëve më të vjetra indoevropiane. Qëllim i këtij punimi është analiza dhe shqyrtimi i metodologjisë së punës së këtij studiuesi austriak, si dhe kontributi i tij reciprok tek studiuesit e rinj shqiptarë në universitetet austriake bazuar edhe në përvojën personale të autores së këtij punimi. Si një metodologji pak më ndryshe, por duke pasur parasysh edhe rolin e letërkëmbimit si në dokumentimin jo vetëm të historisë së gjuhës, por në përgjithësi edhe në gjuhësi, si dëshmi e interesimit, por edhe ideve profesionale të H.M. Ölberg për studimin dhe dokumentimin e gjuhës shqipe. Duke marrë parasysh që albanologu Ölberg ka qenë një nga mentorët e autores, në kuadër të këtij punimi do të përdoren, paraqiten dhe analizohen dhe letrat e shkëmbyera të autores me H.M. Ölberg, këshillat dhe vërejtjet profesionale të prof. Ölberg gjatë punës kërkimore të saj.

Letërkëmbimi në këtë punim i ka dy funksione: zhvillimin e sistemit të informatave profesionale dhe krijimin e një diskursi të ri në gjuhësi, për shkak se në këto letra janë paraqitur kritikantë profesionale si dhe dëshmitë dhe shembujt të cilët ai i ka mledhur gjatë korrespondencës së tij me kolegët e tij shqiptarë.

Autorja do të paraqesë rolin reciprok të profesorit austriak me shkenctarët shqiptar në studimin dhe hulumtimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare në vendet gjermanishtfolëse. Duke u bazuar edhe në vërejtjet dhe kritikantë e dhëna përmes letërkëmbimit gjatë hartimit të punimit “Interferenca në mes të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane” (Interferenz zwischen Albanisch und Deutsch), punim magjistrature i mbrojtur në Graz më 1999, si dhe gjatë hartimit të librit “Aspektet kontrastive të derivacionit të mbiemrit

në gjuhën shqipe dhe gjermane” (Kontrastive Aspekte der Derivation beim Adjektiv im Albanischen und Deutschen) (2010) do të bëhet përpjekje që të vërehet metodologjia e çështjeve që prof. Ölberg u kushtonte rëndësi gjatë hulumtimit.

Njëkohësisht, në këtë punim krahas studimeve të tij në fushën e albanologjisë në aspektin diakronik dhe sinkronik do të paraqiten edhe analizat dhe kritikata e studimit kontrastiv në mes të dy gjuhëve si një studim kontrastiv sinkronik. Kjo, për shkak se pse H.M. Ölberg ishte një profesor, studiues dhe hulumtues në gjuhësinë krahasimtare si dhe studiues eminent të gjuhës shqipe në aspektin diakronik të leksikut dhe të fonologjisë së gjuhës shqipe.

Ujët ikën dhe zalli mbetet.

1. Profesor Hermann M. Ölberg – biografia dhe vepra

Hermann M. Ölberg (14 tetor 1922 – 25 shkurt 2017) ishte një filolog klasik, indoeuropianist dhe albanolog¹ i cili studioi gjuhësi të përgjithshme në Universitetin e Innsbruck-ut të Friedrich Stolz, Alois Walde, Hermann Ammann, Johann Knobloch dhe Wolfgang P. Schmied. Promovoi me punimin dhe hulumtimin mbi pasurinë pararomake të emrave të vendbanimeve të Tirolit verior “*Das vorrömische Ortsnamengut Nordtirols*”² në vitin 1962, që ishte përmbledhja e parë e reflektimeve gjuhësore të kohës mbi banimet e vjetra. H. M. Ölberg habitoi në vitin 1972 në linguistikë me një punim për fonologjinë dhe leksikun e gjuhës shqipe duke e hulumtuar aspektin diakronik dhe historik të gjuhës shqipe

¹ Për studimet e albanologjisë në Austri deri më vdekjen e N. Jokl-it (1942) kishte një interesim të madh dhe pas 1942 gjuha shqipe mund të mësohej vetëm në Universitetin e Innsbruckut, edhe pse Universitetet e Grazit dhe Vjenës në shek. 19 dhe në fillim të sh. 20 ishin udhëheqëse në fushën e albanologjisë me Hahn, Schuchard, G. Meyer, Miklosich, Pekmezi, Šufflay, Lambert, Jokl...

² Studimet dhe hulumtimet e emrave, studimet onomastike ishin pjesë e studimeve të Institutit të Innsbruck-ut. “Nicht übersehen werden dürfen schließlich die Bemühungen des Institutes um die Erforschung der alten sprachlichen Verhältnisse unserer näheren Heimat, vor allem der Germanisierung des Alpenraumes. Mittel zu diesem Zweck ist besonders die Namenforschung.” W. Meid, H. Ölberg, H. Schmeja (Hrsg.) *Sprachwissenschaft in Innsbruck*. Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Sonderheft 50. 1982, 13.

“*Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems*”, i cili u botua i pandryshuar 41 vite më vonë.³

Karrierrën e tij profesionale Ölberg e kishte filluar në Universitetin e Innsbruck-ut që nga viti 1953 në cilësinë e lektorit për Esperanto. Pas habilitimit vijoi në po të njëjtin universitet dhe po të njëjtin institut ku studioi dhe e filloi karrierrën e tij profesionale: nga viti 1972 u angazhua si docent e pastaj profesor universitar për gjuhësi të përgjithshme dhe të aplikuar deri në pensionimin e tij në vitin 1987. Meritat e tij si profesor janë paraqitur në përmbledhjen e botuar më 1987 “*Sprache, Sprachen und Sprechen*”⁴ (Gjuha, gjuhët dhe të folurit). “*Eine Brücke vom semasiologischen zum onomasiologischen Wörterbuch? – In: Sprache, Sprachen, Sprechen: Festschr. für Hermann Ölberg zum 65. Geburtstag am 14. 10. 1987*”.

Tërë krijimtarinë e tij shkencore dhe profesionale e zhvilloi në Institutin e Gjuhësisë në Universitetin e Innsbruck-ut.

Përveç gjuhësisë së përgjithshme ai ishte i interesuar edhe për onomastikën, gjuhët e planifikuara mirëpo interesat shkencorë të tij ishin kryesisht në fushën e albanologjisë, të fonologjisë diakronike, fjalëformimit dhe prejardhjes së gjuhës shqipe. Fushat kryesore të studimit kanë qenë studimet albanologjike, onomastike (studime rreth emrave të vendeve) dhe gjuhët e planifikuara (Esperanto)⁵, ku ai dha kontributin e tij edhe në interlinguistikë, fushë në të cilën edhe aktualisht ndihet tejet shumë ndikimi i hulumtimeve të tij. Dekada me radhë ishte botues dhe redaktor i revistës shkencore “*Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft*” [IBK].

Për punën e tij dhe kontributin e dhënë për gjuhën shqipe dmth. për hulumtimet dhe studimet e tij për gjuhën shqipe, Republika e Shqipërisë e nderoi atë me titullin doktor nderi “*Honoris causa*” më 2005. Në vitin 2013

³ H. M. Ölberg: *Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems*. Bot. Bardhyl Demiraj (= Albanische Forschungen 35). Wiesbaden: Harrassowitz 2013. fq. 180

⁴ Kienpointner, Manfred /Hans Schmeja 1987. *Sprache, Sprachen und Sprechen* (Gjuha, gjuhët dhe të folurit). Eine Brücke vom semasiologischen zum onomasiologischen Wörterbuch? Festschr. für Hermann Ölberg zum 65. Geburtstag am 14.10.1987. Innsbruck, 1987. f. 195-218. [IBK]

⁵ H. M. Ölberg ishte njëri ndër shkençarët e paktë, i cili perveçse e shkruante edhe e fliste gjuhën e planifikuar esperanto. p.a. f. 14.

u publikua punimi i habilitacionit “Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems”, ndërsa në vitin 2015 u publikuan kumtesat e përmbledhura në Interlinguistikë dhe Esperantologji.

Ölberg ishte nga gjuhëtarët e rrallë që nuk kufizohej vetëm me njohjen e teorive të gjuhës së planifikuar, por e njëjta atë në mënyrë aktive. Në çdo fushë të studimit dëshironte të ishte i saktë dhe të dokumentonte të gjitha teoritë me shembuj praktikë.

2. Veprimtaria shkencore dhe organizative e H.M. Ölberg në Institutin e Innsbruck-ut

Instituti i gjuhësisë së përgjithme në Innsbruck është i njohur për studimet dhe botimet në fushën e teorive gjuhësore dhe filozofive gjuhësore. Hermann Ammann, ishte themeluesi i Institutit në vitin 1928 në fillim si “Seminar për Gjuhësi Krahasimtare – Seminar für Vergleichende Sprachwissenschaft”.⁶ Hermann Ammann me hulumtimet e tij e kishte ngritur këtë institut në një nivel botëror. Themeluesit Ammann pastaj i bashkohet Hermann M. Ölberg me hulumtimet në fushën gjuhëve të planifikuara, përkatësisht me normimin e gjuhëve për qëllim të kuptimit të ndërsjellë ndërkombëtar. H. M. Ölberg ishte edhe udhëheqës i Lektoratit për gjuhët e planifikuara që nga viti 1952 duke organizuar kurse praktike të gjuhëve të planifikuara “Esperanto dhe Interlingua” (Ölberg 2015:5)

Në Institutin e Gjuhësisë në Innsbruck janë studiuar 22 gjuhë botërore dhe ndër gjuhët e specializuara, të cilat nuk mund të studioheshin në asnjë institucion tjetër në Austri, ishin dhe gjuhët shqipe dhe kelte.⁷ Kjo ndikonte shumë në marrëdhëniet profesionale me vendet në të cilat fliteshin këto gjuhë. Më pastaj, nën udhëheqjen e W. Meid, Instituti i Linguistikës në Innsbruck arriti të ngrinte një komision të gjuhës kelte në Akademinë e Shkencave të Austrisë me bashkëpunime të mëdha të mobilitetit me Irlandën.

⁶ Meid, W; Ölberg, H M.; Schmeja, H 1982. Sprachwissenschaft in Innsbruck, fq.10. IBK Sonderheft 50

⁷ P.a. f.16

H. M. Ölberg, njëri ndër albanologët më të shquar të kohës së tij, u inspirua nga puna dhe veprat e linguistëve dhe diplomatëve të njohur të cilët vepruan gjatë periudhës së Monarkisë Austro-Hungareze: H. Schuchardt, F. Miklosich, Gustav Meyer, Nachtigall, Norbert Jokl, etj.

Edhe pse ai ishte i vetëdijshëm, që diktatura komuniste e Enver Hoxhës i kishte burgosur jo më pak se 130 absolventë shqiptarë vetëm të Universitetit të Vjenës e më shumë se 30 nga ta ishin ekzekutuar, vizita studimore e H. M. Ölberg në Institutin e Historisë dhe të Gjuhëve në Universitetin e Tiranës ishte një praktikë e veçantë, e cila e ndihmoi në realizimin e punimit të tij të habilitimit. Aty ai vërejti që absolventët e tjerë të cilët kishin bërë karrierë profesionale në sistemin komunist sikurse Aleks Buda i cili ishte emëruar në pozita të larta udhëheqëse pas vitit 1945, ndërsa më 1972 ishte emëruar president i parë themelues i Akademisë së Shqipërisë, i cili vetëm pas rënies së diktaturës tregon mëshirë për ekzekutimin e kolegëve të tij,⁸ ishin të bindur plotësisht në idetë komuniste. Madje edhe Çabej i ndikuar nga idetë socialdemokrate të “Vjenës së kuqe”, ishte përshtatur mjaft mirë në sistemin komunist, sikurse Buda, i cili në një rast për profesorët e Vjenës kishte theksuar se edhe profesorët austriakë kishin përfituar nga studentët shqiptarë.⁹

Gjatë vizitës studimore në Tiranë në tetor – nëntor 1970, në Bibliotekën Kombëtare dhe Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë në Universitetin e Tiranës, Ölberg vërente nacionalizmin dhe ksenofobinë e shumicës së personaliteteve udhëheqëse edhe pse e respektonte shumë punën e Eqrem Çabejt dhe shumë të tjerëve, të cilët i zbatuan metodat kritike të shfrytëzimit të fakteve, metodat krahasimtare dhe etimologjike të studimeve të gjuhësisë të mësuara nga profesorët e tyre austriakë. Mirëpo ai kishte shumë

⁸ J. Schmitt (2013) *Balkanforschung* S. 84,

https://i.og.univie.ac.at/fileadmin/user_upload/i_og/ueber_uns/personen_dokumente/Schmitt_Onlinepublikationen/Balkanforschung.pdf (26.02.2018)

⁹ “Während Patsch seine Studenten mit türkischem Kaffee und albanischen Zigaretten bewirtete, empfing der in bescheidenen Verhältnissen lebende Norbert Jokl albanische Studenten sonntags zu Tee und Biscuits in seiner Wohnung in der Neustiftgasse im 7. Gemeindebezirk; albanologische Spaziergänge führten auch die Neustiftgasse hinab und dem Ring entlang. Buda betonte, dabei habe “auch der Professor von uns profitiert” S.o. S. 92 (26.02.2018)

respekt edhe për punën shkencore të Martin Camajt, i cili vepronte në My-nih. Ai gjatë qëndrimit hulumtues në Tiranë në tetor–nëntor 1970 kishte vërejtur izolimin e shkencëtarëve shqipëtarë dhe publikimet e censuruara të tyre dhe pas kësaj vizite kishte filluar me planifikimin e organizimit të kolokuiumit Ndërkombëtar për Gjuhën Shqipe, për nderë të albanologut të famshëm N. Jokl. Më 1972 (nga 28 shtator deri më 3 tetor) me përkrahjen institucionale të Ministrisë së Shkencës së Austrisë organizoi kolokuiumin ndërkombëtar për hirë të kontributit të dr. Norbert Jokl, ku arriti të bashkojë pjesëmarrës nga Lindja dhe Perëndimi (vendet demokratike e diktatoriale) e me këtë rast arriti t'i bashkojë albanologët nga Shqipëria, Jugosllavia, Europa lindore dhe perëndimore, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik. Si rezultat i këtij kolokuiumi arriti të publikohej përmbledhja voluminoze me 784 faqe për nderë të kontributit të albanologut të shquar Norbert Jokl¹⁰, e që ishte publikimi më voluminoz në IBK deri më 1982.¹¹

Në këtë kolokuium Ölberg kishte vrojtuar ndasitë e mëdha ideologjike në mes të shkencëtarëve të ftuar. H. M. Ölberg e ka paraqitur edhe brengën e tij gjatë organizimit të këtij kolokuiumi meqë në mes të pjesëmarrësve kishte pikëpamje të ndryshme politike e profesionale dhe gjatë tërë javës kishte replika të shumta në mes të pjesëmarrësve nga vendet demokratike dhe ato komuniste-diktatoriale, krahas replikave profesionale gjuhësore kishte edhe shumë vërejtje politike.

Në këtë kolokuium janë dërguar gjuhëtarë të përzgjedhur nga qeveritë përkatëse jugosllave dhe shqiptare dhe poashtu janë dërguar edhe pjesëtarë të tjerë, të cilët më pastaj nuk i kishin dërguar kumtesat e tyre për botim si Ivan Pudić (Beograd) “Rreth leksikut të trashëguar të shqipes” (“Zum albanischen Erbwortschatz”)¹², por vetëm kanë qenë vëzhgues të kolokuiumit.

¹⁰ “... und was das sonst so verschlossene Albanien betrifft, so gelang es dem Institut im Jahre 1972, erstmals einen größeren internationalen albanologischen Kongress zu organisieren, der von einer größeren Delegation aus Albanien beschickt wurde, und dessen sichtbares Resultat ein Sammelband von fast 800 Seiten darstellt, der hier in Innsbruck publiziert wurde.” P.a. f. 16.

¹¹ P.a. f. 17

¹² H. Ölberg (1977): Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972. Zum Gedächtnis an Norbert Jokl. S. XI.

Edhe pse në këtë kongres ishte i ftuar edhe Martin Camaj, nga ana e shtetit shqiptar dhe atij jugosllav prezenca e Camajt ishte kushtëzuar me moasardhjen e tyre, për çka Ölberg ishte detyruar të anulojë ftesën. Këtu vërehet edhe dora e zgjatur e demagogjisë komuniste e cila është munduar përmes diktaturës komuniste të pengoi hulumtuesit dhe studiuesit e tjerë, të cilët kishin mendime të tjera politike.

H. M. Ölberg kishte shumë plane dhe ide se si t'i shtynte dhe motivonte profesorët e njohur të gjuhësisë nga tërë bota, nga institucionet të cilat kishin traditë studimet e albanologjisë të vazhdojnë me studimet dhe hulumtimet e kësaj fushe, si psh. Fritz Frhr. Lochner von Hüttenbach (Profesor në Universitetin e Graz-it) "Gustav Meyers Beitrag zur Erforschung des Albanischen," i cili i ka përmbledhur në mënyrë të veçantë kronologjike dhe kritike të gjitha punimet e Gustav Meyerit për gjuhën shqipe. Pas këtij punimi dhe pas këtij kolokuiumi L. v. Hüttenbach i dëshpruar nga puna e kolegëve shqiptarë dhe mosgatishmërinë e tyre bashkëpunuese ishte tërhequr nga studimet albanologjike dhe pastaj është marrë me studimet onomastike të Steiermarkut. Në të njëjtën mënyrë kishte vepruar edhe Wolfgang Dressler (anëtar i Akademisë së Shkencave të Austrisë dhe profesor i emerituar në Universitetin e Vienës) i cili, përpos punimit të tij "Phonologische, morphologische und morphologische Regeln des Albanischen", më nuk është marrë me studimin e gjuhës shqipe¹³, edhe pse ka mentoruar punimet e magjistraturës dhe të doktoratës së disa studentëve shqiptar.

Përkundër kësaj situatë, H. M. Ölberg e kishte moto fjalinë e G. Weigandit¹⁴ dhe punonte vazhdimisht në studimin e gjuhës shqipe:

"Dega e shqipes në Indogermanistikë më duket si një moçal i madh, në të cilin gjinden vetëm disa ishuj të ngurtë, përndryshe studiuesit spërkaten në moçal, çdonjëri merr një rrugë të ndryshme, dhe çdonjëri arrin qëllime të ndryshme ose asnjë qëllim".¹⁵

¹³ W. Dressler (1997) phonologische, morphologische und morphologische Regeln des Albanischen. In: H.M. Ölberg (1977) Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972. Zum Gedächtnis an Norbert Jokl. S. XI. S. 459-470.

¹⁴ G. Weigand BA.3. (1927: 227f)

¹⁵ "Der albanische Zweig der Indogermanistik kommt mir wie eine großes Sumpfgebiet vor, auf dem es nur einige feste Inseln gibt, im Übrigen patschen die Forscher im Sum-

Kështu që ai ishte i mahnitur nga gjuha shqipe, përkundër aktiviteve të mësimdhënjes, punës administrative dhe organizative në institut ai ishte albanolog i përkushtuar, por meqë Austria ishte Republikë Federale, nuk e kishte reputacionin si më heret dhe nuk kishte projekte bashkëpunimi sikurse Republika Demokratike Gjermane (1949-1990) psh. Instituti i Kulturës Popullore i Akademisë së Shkencave në Berlin, të cilët përkrahnin projekte bashkëpunimi për studime etnografike dhe të gjuhës shqipe në mes të Republikës Demokratike Gjermane dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, siç kishte projekte në kohën e Perandorisë Austro-Hungareze kur vepruan G. Meyer, Kretchmer, Pekmezi, Lambertz dhe Jokl.

3. Hulumtimet shkencore të H. M. Ölberg

Linguisti Ölberg gjatë tërë jetës së tij si shkencëtar është përpjekur të studiojë dhe hulumtojë gjuhën shqipe, onomastikën dhe linguistikën e gjuhëve të planifikuara krahas gjuhësisë së përgjithshme dhe krahasimtare. Ai është i njohur për hulumtimet e tij në fushën e diakronisë dhe posaçërisht të fonologjisë diakronike të gjuhës shqipe, si dhe për çështjen e prejardhjes së shqiptarëve.¹⁶

Në fushën e gjuhësisë u botuan nga H. M. Ölberg publikime të shumta. Mbi të gjitha u bënë përpjekje të mëdha rreth hulumtimit të gjuhëve të vetme, grupeve gjuhësore ose epokave gjuhësore, të cilat ishin çështjet kryesore të indoeuropianistikës ku mbi të gjitha çelësi kryesor ishte rindërtimi i bazës së gjuhës indoeuropiane¹⁷ nga ngjajshmëritë e gjuhëve tradicionale përmes një procedure selektive, poashtu edhe në punimin “*Lautsubstitution dhe Lautgesetz*”¹⁸, ku paraqiten ligjet e ndryshimit të tingujve nga aspekti diakronik.

pfland, jeder nimmt einen anderen Weg, jeder erreicht ein anderes Ziel oder gar keines”.

¹⁶ Siehe zu seinen Arbeiten bis 1987 das von Hans Schmeja bearbeitete Schriftenverzeichnis in der Ö. gewidmeten Festschrift (Sprache, Sprachen, sprechen. Festschrift für Hermann M. Ölberg zum 65. Geburtstag am 14. Oktober 1987, hg. von Manfred Kienpointner und Hans Schmeja, Innsbruck 1987), 289–294.

¹⁷ P.o. f. 13

¹⁸ H. M. Ölberg (1998). Lautsubstitution und Lautgesetz. In: Wort -Text-Sprache und Kultur. Innsbruck, 129-145.

Punimi i habilitacionit të H. M. Ölberg është një tërësi kuptimplotë e një premisë metodologjike e punës së tij të gjatë shkencore për studimin diakronik të gjuhës shqipe:

“Rindërtimi i zhvillimit të tingujve të një gjuhe, dëshmitë e shkruara të së cilës nuk janë shumë të vjetra, para së gjithash duhet të arrihet përmes përcaktimit të kronologjisë së brendshme dhe duke i kushtuar vëmendje zëvendësimit të tingullit gjatë huazimit të fjalëve të huaja” (Ölberg 1987, 135).¹⁹

Përdorimi i kësaj premise është zbatuar në gjuhën shqipe, ashtuqë studimet kritike, diakronike dhe përshkrimi i gjuhës shqipe në mënyre sistematike e kanë bazën në vendet gjermanishtfolse. Me këtë edhe filloi debati shkencor për hulumtimet shkencore të gjuhës shqipe, studime të cilat edhe sot luajnë një rol të rëndësishëm në studimet diakronike të gjuhës shqipe.

Vepra e H. M. Ölberg përshkruan gjuhën shqipe sipas studimeve diakronike dhe gjeografike si gjuhë indoevropiane dhe gjuhë ballkanike, pa e vënë në diskutim mëvetësinë e saj si gjuhë e standardizuar si dhe dialektet e saj duke u bazuar në rrethanat shoqërore dhe regjionale, në të cilat ato zhvillohen. Punimi me të cilin habilitoi H. M. Ölberg në vitin 1972 u botua në vitin 2013. Me këtë punim sadopak u plotësua hendeku i hulumtimeve të gjuhës shqipe në aspektin diakronik dhe historik.

Nga veprimtaria e tij për gjuhën shqipe, përveç punimit të habilitimit këtu do të përmenden edhe: “Disa mendime rreth teorisë laringale nga gjuha shqipe” (*“Einige Überlegungen zur Laryngaltheorie an Hand des Albanischen”*).²⁰

Teoritë laringale, të cilat edhe sot kanë vlerë shkencore, ndryshimet *r/l* në gjuhën shqipe, *k* inde. para *u* në gjuhën shqipe si dhe punimet tjera në fushën diakronike të gjuhësisë.

Poashtu edhe raportet gjuhësore greqisht-shqip I: “Hulumtime rreth

¹⁹ “Die Rekonstruktion der lautlichen Entwicklung in einer Sprache, deren schriftliche Bezeugung nicht weit zurückreicht, muss vor allem durch die Ermittlung der inneren Chronologie und durch die Beachtung der Lautsubstitutionen bei der Übernahme fremder Wörter erfolgen”.

²⁰ Botuar në “Kuhns Zeitschrift 86”, 1972, 121–136

fjalëve të mbledhura të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe” (“*Griechisch-albanische Sprachbeziehungen I: Untersuchungen zum altgriechischen Wortgut im Albanischen*”)²¹, “Dy ose tri rradhet e grykoreve? Nga pikëpamja e shqipes.” (“*Zwei oder drei Gutturalreihen? Vom Albanischen aus gesehen*”)²². Ölbergu veproi në fund edhe si botues i Akteve tanimë të përmendura të Kolokuiumit Ndërkombëtar të Gjuhës shqipe në Innsbruck.²³ Ai gjithashtu punonte edhe në fushën sonografisë ku edhe e botoi librin “Hyrje në Sonografi” (“*Einführung in die Sprachschallanalyse*”).²⁴

Listën e botimeve të Norbert Jokl e përbëjnë 67 botimet si dhe shenimet e tjera biografike të Norbert Jokl.²⁵ Gjuha shqipe është një lëmi e rëndësishme e studimit të Indogermanistikës jo vetëm për shkak të zhvillimit të fonologjisë, por edhe për shkak të raportit me gjuhët tjera fqinjë. Hulumtimet e gjuhës shqipe përmes etimologjisë së fjalëve si dhe ndryshimeve bazuar në ligjet e ndryshimeve të tingujve ishin hulumtime gjuhësore dhe historiko-kulturore. Në mbledhjen e materialeve gjuhësore dhe analizën e tyre kishin shumë ndikim veprat e Hahn, Gustav Meyer, Jokl, Nopcsa, Eqrem Çabejt, etj. Një kapitull shumë interesant është ai për “Vendbanimet kelte në Tirol”²⁶ i vitit 1965, ku vërehet interesimi i tij për onomastikë, emrat e lumenjve, maleve nga glosat antike të Tirolit.

Studimet onomastike nga alpet gjermane ai i bart te alpet shqiptare dhe tërë punën e tij shkencore pastaj e bart në studimet e tij të fonologjisë diakronike të leksikut të gjuhës shqipe. Ölberg i paraqet edhe disa mendime rreth autoktonisë së shqiptarëve në Ballkan duke i shqyrtuar dhe analizuar toponimet e ndryshme, ashtu që e sqaron se shqiptarët janë banorë të gadishullit ballkanik, përreth detit adriatik, që nga epoka greko-romake. Ai analizon emrat e vendeve, qyteteve, lumenjve në punimin e tij “Disa mendime

²¹ Botuar në Robert Muth (bot.): *Serta Philologica Aenipontana II*. Innsbruck 1972 (IBK 17), 33–64.

²² Botuar në Scritti in onore di Giuliano Bonfante, vol. 2, Brescia 1976, 561–570.

²³ Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl, hg. von Hermann M. Ölberg, Innsbruck 1977.

²⁴ *Einführung in die Sprachschallanalyse (Sonographie)* (IBK, Sonderheft 40), 1976

²⁵ H.M. Ölberg. *Schriftenverzeichnis von Norbert Jokl*. Në: Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums. Innsbruck. 1972, f. 67-74.

²⁶ H. M. Ölberg. *Keltische Siedlungen in Tirol*. Në: Festschrift für Leonhard c. Franz zum 70 Geburtstag. Innsbruck. 1968, f. 313-342 [IBK 11ë.

për autoktoninë e shqiptarëve në gadishullin Ballkanik²⁷, të paraqitur në Kolokuiumin në Innsbruck.

Ragusa – Rush; Thyamis – Çamëri; Ísamnus – Ishëm; Drívastum – Drisht (vendimtar është akcenti)

Ndërsa tek fjala *Durráchium - Durrës* ka shqetësim apo hamendje, s' është i sigurt.²⁸

Autoktoninë e shqiptarëve ai e vëren edhe te huazimet nga greqishtja, veçanërisht zhvillimi i *o*-së në shqipe nga *ā* në greqishte duke dëshmuar që këto huazime janë më të vjetra se sa huazimet nga gjuha latine. Kjo më tutje sqarohet përmes emrave të vendeve e të personave, siç sqaron Çabej, por duke vërejtur paralelet në mes të gjuhës shqipe dhe mesapishtës tek sufiksats dhe prefiksats.²⁹

Punimi i tij kryesor dhe studimet e tij më të rëndësishme për gjuhën shqipe janë përmbledhur në punimin e habilitimit të tij ku ai paraqet një fonologji diakronike të leksikut të gjuhës shqipe duke u bazuar në një kronologji relative dhe absolute të zhvillimit të tingujve të gjuhës shqipe, në mënyrë që të rindërtohet një shqipe e vjetër. Punimi është i ndarë në 5 kapituj: në hyrje është një kronologji e historisë së gjuhës shqipe (f.13-15) pastaj vazhdon me kapitullin mbi reflekset e vokalizmit indoeuropian, nazalitetin dhe humbjen e nazalitetit, raportin në mes të gegnishtes dhe toskërishtes (psh. tosk. *ë*, *e* geg. *â*), nasaliteti i *i* dhe *u* (f. 15-59).

Në kapitullin e dytë paraqitet vokalizmi i shkurtër indoeuropian (f. 60-101), në kapitullin e tretë vokalizmi i gjatë indoeuropian (f. 104-113) dhe në kapitullin e katërt diftongjet indoeuropiane (f. 118-124), duke kaluar pastaj në kapitullin e fundit mbi sistemin fonologjik të gjuhës shqipe nga aspekti diakronik dhe vokalet në rrokjet e theksuara (f. 125-142). Ky

²⁷ H.M. Ölberg . *Einige Überlegungen zur Autochtonie der Albaner auf der Balkanhalbinsel*. Në: Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquims, Innsbruck 1972, zum Gedächtnis an Norbert Jokl. 1976. Innsbruck. [IBKë Nr. 41, f. 625-629.

²⁸ P.a. f 625.

²⁹ P.a. f. 626, Z.B. FIN *Mati* zu alb. *mat* “Ufer, Küste”, *Ulcinium* zu alb. *ulk* “Wolf” mit spezifischer Anlautentwicklung, eventuell auch *Lim* in Sandzak zu alb. *lym*, *lim* “mitgeführter Schlamm”. An Suffixen *-inium* und alb, *-inj*, *-st*- und alb. *-sht*. Bekannt sind auch Belege wie *Maluntum* und alb. *mal* “Berg” messap. *Menzana* und *mëz* “Füllen”, *Dalmatia*, *Delminium* und alb. *dele*, *delme* “Schaf”.

punim ka një rëndësi të veçantë nga aspekti historik i studimit të sistemit fonologjik të gjuhës shqipe, ku nga 33 fjalë të huazuara nga gjuha greke dhe 500 huazimet nga gjuha latine paraqitet një shtresë e lartë e emrave, mbiemrave dhe foljeve si dhe integrimi i tyre në gjuhën shqipe, duke e paraqitur situatën sociolinguistike të sistemit të fonemave të gjuhës shqipe në çdo kohë.

Ölberg në këtë punim paraqet një prerje kronologjike të strukturës së tingujve të gjuhës shqipe (Ölberg 2013,125) si dhe, gjatë korrespondencës me autoren, i dërgon disa shembuj të përmbledhur gjatë punës së tij shkencore poashtu cek se dëshira e tij është të hartojë një gramatikë krahasimtare në mes të gjuhës shqipe dhe gjermane, por për shkaqe shëndetësore nuk ka arritur të punojë në të.

4. Ölberg si pedagog dhe shkencëtar

Këtu do të them diçka për përvojën e autores si studente e prof. Ölbergut, i cili gjatë vitit akademik 1998 dhe 1999 e ka përcjellë gjatë tërë kohës së hartimit punimin e magjistraturës “Interferenz zwischen Albanisch und Deutsch”, si dhe për rolin e tij përmes korrespondencës me shkrim.

Korrespondenca me shkrim i ka dy funksione: zhvillimin e sistemit të informacionit dhe krijimin e një diskursi të ri. Të dy funksionet janë paraqitur në mënyrë mbresëlënëse në letërkëmbimin e Ölberg-ut. Ai arriti të mbledhë materiale të shumta gjuhësore dhe etnografike si dëshmi për studimin e gjuhës shqipe.

Edhe pse kishte probleme shëndetësore dhe ishte i pensionuar, çdo rresht të autores ai e kontrollonte me vëmendje duke motivuar për punën.

Ai ishte një pedagog i mrekullueshëm, kritikant i tij ishin në një gjuhë të përkryer, ai arrinte nëpërmjet ushtrimeve praktike dhe shembujve konkretë si dhe përmes kritikës së rreptë të ngrinte tek autorja një përgjegjësi ndaj punës shkencore dhe, mbi të gjitha, një sinqeritet shkencor. Ai apelonte që shkenca nuk duhet të bjerë pre e synimeve politike a dogmave shoviniste, apo emocioneve nacionaliste dhe duhet të bazohet në fakte dhe kritikë shkencore. Ai citonte se vlera e një kombi matet me të tashmen, me çfarë një popull arrin sot, dhe sa është e studiuar dhe hulumtuar gjuha, le-

tërsia dhe kultura e atij populli. Ai e citonte Pedersenin se gjuha shqipe ka pasur një zhvillim të veçantë dhe “edhe tani është një gjuhë e bukur edhe e fuqishme, e cila lipset të jetë mburrje për folësit e saj edhe një vegël e shenjtë për rritjen mentore edhe arësimitare të kombit të vjetër shqipëtar” (Pedersen 2003:14).

Rreth metodologjisë së punës gjatë hulumtimit të interferencës në mes të gjuhës shqipe dhe asaj gjermane Ölberg vërente si vijon:

1. në të gjitha tabelat dhe në tërë punimin duhet të përdoren parametrat e njëjtë në mënyrë që rezultatet të jenë të matshme dhe të qarta, si dhe më dërgon kapitullin e punimit të tij të habilitacionit “Miscellanea” ku paraqiten të gjitha tabelat e sistemit fonetik dhe fonologjik të gjuhës shqipe.

3. dallimet teorike të shkaktuara nga ortografia duhet të shqyrtohen në të dy gjuhët në mënyrë krahasimtare. (f 10f)

4. shqiptimi i konsonanteve në fillim dhe në fund të fjalës psh. b, d, g - p, t, k, të paraqiten dallimet dhe ngjashmëritë në të dy gjuhët (f. 37ff)

5. kryesisht foljet në gjuhën gjermane duhet të mësohen së bashku me parafjalët (f. 72ff)

6. analizë semantike e foljeve në të dy gjuhët, të sqarohet përmes shembujve konkretë (f. 80ff)

7. përdorimi i përemërit “es” si subjekt në gjuhën gjermane dhe përkthimet përkatëse në gjuhën shqipe (f. 85)

8. përdorimi i parafjalëve dhe interferencat në të dy gjuhët (f.89)

Ölberg shton që pjesa fonetike, fonologjike, morfologjike dhe semantike janë të trajtura në mënyrë kritike dhe të sqaruara me shembuj në të dy gjuhët, që të mund të shfrytëzohet si bazë për një gramatikë krahasimtare në aspektin sinkronik të gjuhës shqipe dhe gjermane. (Letra e Ölberg, më 17. 06. 1999). Theksonte po ashtu se tërë korrespondencën e tij me studiuesit shqiptarë e ka ruajtur, në mënyrë që të hartonte një gramatikë të tillë krahasimtare (“... , weil ich einmal eine solche vergleichende Grammatik schreiben wollte”), (Ölberg, Brief 17.06.1999).

Duke u bazuar në këtë korrespondencë me H. M. Ölberg është përpunuar vetëm një pjesë e ligjëratës “mbiemri” në fushën e gjuhësisë krahasimtare dhe është botura libri “Kontrastive Aspekte der Derivation beim Adjektiv im Albanischen und Deutschen” (Canaj: 2010).

Përmbledhje

Hermann M. Ölberg studimet për shqipen i bëri objekt kryesor të punës hulumtuese të tërë jetës së tij, u mundua të sjellë një frymë të re në këto studime duke u munduar të krijojë një rrjet të albanologëve nga tërë bota dhe ta ngrrejë Institutin e Albanologjisë në Innsbruck, mirëpo nuk ia arriti qëllimit meqë nuk e pati përkrahjen institucionale të vendeve shqipfolëse. Ato i gjeti në një “gjendje të fjetur” kështu që politikat e zhvillimit profesional dhe hulumtues të Universitetit të Innsbruck-ut u drejtuan nga keltologjia dhe jo nga albanologjia. Nga viti 1953 deri në 1987, kur Ölberg ishte docent dhe profesor në Universitetin e Innsbruck-ut Shqipëria ishte nën diktaturën komuniste, ku kishte vetëm shkëmbim letrash me albanologët shqiptarë si shkëmbim më intensiv gjatë organizimit të Kolokuiumit më 1972, ndërsa në Kosovë albanologët ishin të orientuar më shumë kah Franca, e cila investonte më shumë në përhapjen e gjuhës dhe kulturës frënge, apo edhe nga universitetet italiane, sesa nga universitetet austriake apo gjermane. Kjo dëshmohet edhe në Kolokuiumin e gjuhës shqipe ku, përveç Eqrem Çabejt, i cili e kishte përfunduar gjimnazin në Leibnitz dhe studimet në Universitetin e Vjenës, Shefqet Pllana, folklorist, Ali Hadri, historian dhe akademik, Hasan Kaleshi, orientalist, të cilët i kishin përfunduar studimet e albanologjisë, historisë, apo orientalistikës në Universitetin e Beogradit³⁰, Zef Mirdita kishte përfunduar gjimnazin dhe Fakultetin në Zagreb, ku gjuha gjermane mësohej si gjuhë e parë e huaj, të tjerët si Idriz Ajeti, Mahir Domi, Jani Thomaj, Spiro Floqi, Emil Lafe, Shaban Demiraj, Bahri Beci, Rexhep Ismajli e kishin përdorur gjuhën frënge si gjuhë të komunikimit dhe të hartimit të punimit.

Ölberg solli në studimet e albanologjisë gjerësinë e vështirimeve, silli risi në metodën e hulumtimit, e thelloi qenjësisht njohjen e gjuhës shqipe. Ai ishte i motivuar nga puna e Gustav Meyer-it, N. S. Trubetzkoi-it,

³⁰ Universiteti i Beogradit, i Pragës dhe i Bukureshtit ishin Universitete, të cilat e vazhduan profesionalizmin shkollës së Vjenës, pas kthimit të shumë të diplomuarve nga Universiteti i Vjenës në këto universitete, por edhe nacionalsozialismi, i cili pastaj u shëndrrua në ide social komuniste pas vitit 1945. Shumica e këtyre profesorëve e përdorin gjuhën gjermane si gjuhë shkencore dhe u mësua nga shumica linguistëve dhe historianëve të cilët studiuin në këto universitete.

Carl Patsch-it, Norbert Jokl-it dhe mendonte të vazhdonte punën e papërfunduar të Meyer-it dhe të Jokl-it të një “Grammatike historike-krahasuese të shqipes”. Vepra e Ölbergut është një ndihmesë e madhe për studimet shqiptare në një radhë fushash studimi: në studimet e fonetikës historike dhe të vendosjes së kronologjive relative të ndryshimeve fonetike, në studimet e morfologjisë historike, në fushën e historisë së fjalëve, ai ishte i interesuar edhe për aspektet sinkronike të gjuhës së shkruar dhe të gjuhës së sotme shqipe, për prejardhjen e gjuhës shqipe. Posaçërisht me vlerë janë studimet e tij për raportet e shqipes me gjuhët fqinje, me latinitetin ballkanik, me greqishten e vjetër dhe të re, ku gjuhën shqipe e vlerëson si gjuhë indoeuropiane dhe pjesëmarëse në grupin e gjuhëve të lashta të Ballkanit (Lidhjes Gjuhësore të Ballkanit). Studimet e tij për teorinë laringale, nazalitetin e gjuhës shqipe si dhe historinë e fjalëve dhe të etimologjisë së gjuhës shqipe kanë vlerë edhe sot.

Botimi i punimit të habilitacionit të tij është bërë 41 vite pas mbrojtjes së tij, edhe pse pjesë të punimit janë botuar në punime të ndryshme tregon “gjendjen e fjetur” të institucioneve shkencore shqiptare si dhe vetëm kontakte individuale me akademikë shqiptarë, por jo bashkëpunime institucionale me projekte konkrete hulumtuese në fushën e albanologjisë.

Ölberg shquhet me njohuritë e gjera nga gjuhët gjermanike, kelte, sllave, baltike, romane, fino-ugrike, latinishtja dhe greqishtja e vjetër, me thellimin në hulumtimin e fenomeneve diakronike gjatë ndryshimeve gjuhësore nëper shekuj, me këmbëngulje në respektimin e realiteteve gjuhësore, ai ia ka dalë të na japë një sërë studimesh të dorës së parë. Ölberg shquhet me tiparin e profesorit të zellshëm, punëtor, miqësor e kërkues në punë.

LITERATURA:

- Canaj**, Kimete 1999. *Interferz zwischen Albanisch und Deutsch*. Mag. Arbeit. Univ. Graz.
- Canaj**, Kimete 2010. *Kontrastive Aspekte der Derivation beim Adjektiv im Albanischen und Deutschen*. Hamburg: Dr. Kovač.
- Ortner**, Hanspeter/**Steffann**, Barbara/ **Kienpointner**, Manfred/ Hans **Schmeja** und Hermann M. **Ölberg** (Hrsg.) 1987. *Sprache, Sprachen, Sprechen*. Hermann Ölberg zum 65. Geburtstag am 14 Oktober 1987. Innsbruck: Institut für Germanistik, Universität Innsbruck. Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Germanistische Reihe (IBK), Bd. 34.
- Ölberg**, Hermann. M. 1965. *Keltische Siedlungen in Tirol*. In Menghin, Osmund & Hermann M. Ölberg. Festschrift Leonhard C. Franz zum 70. Geburtstag. IBK Bd. 11. Innsbruck 1963, 313- 343
- Ölberg**, Hermann M. 1967a *Rewie of Haebler* IF 72. 172- 178
- Ölberg** Hermann M. 1967b. *Albanica I: Zum r/l Wechsel*. Beiträge zur Indogermanistik und Keltologie: Julius Pokorny zum 80. Geburtstag gewidmet, ed. By W. Meid, 57-71. Innsbruck. IBK 13.
- Ölberg**, Hermann M. 1968. *Idg. k vor u im Albanischen*. Studien zur Sprachwissenschaft and Kulturkunde, Gedenkschrift für W. Brandenstein, ed. By M. Mayerhof. 109-118. IBK 14.
- Ölberg**, Hermann M. 1969. *Zur Neutralisierung von palatalem und velarem k vor Liquida*. In: Studi linguistici in onore di V. Pisani, vol.II. 1969.
- Ölberg**, Hermann M. 1971. *Fragen der albanischen Sprachgeschichte*. Grundsätzliches zur Nasalisierung. In: Dissertationes albanicae. München 1971.
- Ölberg**, Hermann M. 1972. *Grischisch-albanische Sprachbeziehungen* .IBK 17
- Ölberg**, Hermann M. 1972. *Einige Überlegungen zur Laryngaltheorie*. In: KZ 86
- Ölberg**, Hermann M. 1977. *Akten des Internationalen Albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Univ.-Prof. Dr. Norbert Jokl*: Innsbruck, 28. September – 3. Oktober 1972/ veranst. vom Inst. Für Sprachwissenschaftl. Ges. u.d. Indogerman. Ges. Innsbruck: Innsbrucker Ges. zur Pflege d. Geisteswiss. Universität Innsbruck. Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft; 41
- Ölberg**, Hermann M. 1987. *Sprachlicher Kontakt und Lautchronologie*. In: Dona slavica aenipontana. In honorem Herbert Schlesnicher. München.-B.D.
- Ölberg**, Hermann M. 2013. *Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur diachronen Phonologie aufgrund des Vokalsystems*. Hrsg. Bardhyl Demiraj. In: Albanische Forschungen. (Hrsg.) Peter Bartl, Bardhyl Demiraj, Titos Jochalas und Oliver Jens Schmitt. Wiesbaden: Harrasowitzt.
- Ölberg**, Hermann M. 2015. *Aufsätze zur Interlinguistik und Esperantologie*. Mit einem Vorwort von Manfred Kienpointner. Hrsg. von Reinhard Haupenthal. (Bad Bellingen): Edition Iltis 2015. 140 S./p. (Schriften zur Esperantologie und Interlinguistik. 46.) Pedersen, Holger 2003. Studimet për gjuhën shqipe. ASHAK. Prishtinë.

Rexhep ISMAJLI

FJALA E MBYLLJES

Te nderuar miq dhe kolegë,

është kënaqësi që pas dy ditësh pune kaq intensive ta mbyll këtë konferencë kaq interesante dhe në një nivel kështu të lartë shkencor. Para dy vjetësh patëm organizuar në ASHAK një konferencë për studimet albanistike në Amerikë dhe, me gjithë dyshimet e fillimit, doli se kishte shumë interes, kështu që konferenca doli me sukses dhe në fund patëm dhe një botim të bukur me punimet e saj. Pastaj vendosëm që bashkë me Akademinë e Shqipërisë të organizonim këtë konferencë për studimet albanistike në botën ku flitet gjermanisht. Këtë herë përgatitjet nisën pak më herët dhe u nisën njoftimet. Sinonim të bënim një pasqyrë të këtyre studimeve, gjithë duke problematizuar pika të veçanta dhe në fund të nxirrnim edhe ndonjë përfundim.

Programi i konferencës qe shumë i begatshëm dhe kumtesat ishin në një nivel të lartë shkencor, me shumë informata dhe analiza të reja. Të gjithë bashkë kemi mësuar gjëra të reja nga kjo konferencë. Në ditën e parë patëm nderin të dëgjonim ligjërata nga disa prej autoriteteve në fushat tona që vinin nga vende të ndryshme: Austri, Gjermani, Zvicër, Shqipëri, Kosovë. Pastaj patëm rastin të dëgjonim një seancë të tërë për studimet në botën gjermanishtfolëse për arbëreshët, të Italisë dhe të Greqisë, po ashtu me raportues shumë të cilësuar nga Italia, nga Zvicra, nga Gjermania, nga Kosova. Në vijim pati shumë kumtesa me interes nga studiues të brezave të ndryshëm dhe na gëzon fakti se midis nesh një numër të mirë studiuesish të rinj me cilësi të larta hulumtuese, me formim e integritet shkencor dhe ata po punojnë barabar me brezin tjetër jo aq të ri.

Në konferencë u mbajtën 7 seanca me gjithsej 55 kumtesa nga vende të ndryshme. U shqyrtuan çështje nga më të ndryshmet të studimeve al-

banistike në botën gjermanishtfolëse, duke filluar nga çështja e përcaktimit të vendit të gjuhës shqipe brenda gjuhëve indoeuropiane, prejardhja dhe historia e saj, studimet për strukturën e saj, për mësimdhënien dhe gramatikën e teksteve shkollorë mesimore, për studimet për letërsinë shqipe e çështje të tjera nga këto komplekse veprimtarish. Pati shumë interesim dhe për kumtesat në fushën e historisë deh të arkeologjisë, që ishin më të pakta në numër.

Studimet albanistike në botën gjermanishtfolëse kanë tashmë një traditë treshekullore dhe në periudha të caktuara kanë përjetuar zhvillime të rëndësishme. Do të kujtojmë me këtë rast emrat e mëdhenj si F. Bopp, G. Meyer, H. Pedersen, N. Jokl, G. Weigand, M. Lambert, G. Stadtmüller, O. Buchholz, e shumë të tjerë, që tashmë i takojnë historisë së këtyre studimeve. Po kaq me rëndësi ishte prania e një numri jo të vogël autoritetesh në këto dije, qoftë nga bota gjermanishtfolëse, apo nga bota shqiptare. Në këtë mënyrë të gjithë së bashku, gjithë duke shënuar rezultatet që janë arritur në këto dije, u angazhuam dhe në një dialog konstruktiv dhe krijues për çështje të ndryshme. Ishte konstatim i përgjithshëm se rezultatet kaq të mëdha të albanistikës në gjuhën gjermane, ashtu si dhe studimet shqiptare në këto fusha, na obligojnë të angazhohemi edhe më shumë në shqyrtime e ndërmarrje të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen mungesat eventuale që mund të dalin nga komunikimi i pamjaftueshëm. U konstatua me kënaqësi se tashmë kemi një brez që po vjen me njohje jo vetëm të studimeve albanistike, por edhe me përgatitje për gjuhët, sidomos për gjermanishten, çka krijon rrethana më të përshtatshme për një komunikim më të ngjeshur brenda komunitetit albanistik.

Njëherësh mund të themi se ishte mendim i përgjithshëm që, për ta ruajtur dhe ushqyer më tej këtë traditë të madhe albanistike, është e nevojshme të ndërmerren hapa studimet albanistike në botën gjermanishtfolëse të organizohen institucionalisht, në mënyrë që t'u dalin përpara sfidave që ka nxjerrë gjendja që kemi tash në botën shqiptare me një gjuhë të veçantë dhe kulturë të zhvilluar brenda saj, një gjuhë ndër 20 më të përhapurat në Europë, por njëherësh ndër më pak të studiuarat, me një bashkësi kombë-

tare që synon integrimet europiane si tërësi, me shtete ku kjo gjuhë është zyrtare, me diasporë të fuqishme në vendet gjermanishtfolëse e me prani gjithnjë e më të madhe në relatat ndërkombëtare. Në këtë drejtim ka vend për angazhim për të gjithë ne si studiues, por edhe për institucionet shtetërore e shoqërore përkatëse.

Konferenca i mbaroi punimet duke shprehur dhe një herë nevojën dhe interesin e shkencës për një komunikim më të ngjeshur midis studiuesve në fushat e albanistikës në vendet e ndryshme gjermanishtfolëse me studiuesit në botën ku flitet shqip.

MATERIALET DOKUMENTARE TË KONFERENCËS

Pjesëmarrësit

1. Albert Ramaj, St. Gallen
2. Albert Riska, Elbasan
3. Albulena Blakaj, Prishtinë
4. Ali Caka, Prishtinë
5. Anila Omari, Tiranë
6. Bahri Beci, Paris
7. Bardh Rugova, Prishtinë
8. Bardhyl Demiraj, München
9. Bashkim Kuçuku, Tiranë
10. Begzad Baliu, Prishtinë
11. Besim Kabashi, Erlangen-Nürnberg
12. Blertë Ismajli, Prishtinë
13. Brikena Kadzadej, Tiranë,
14. Dieter Nehring, Berlin
15. Dhori Qiriaz, Selanik
16. Elvira Glaser, Zürich
17. Ema Kristo, Elbasan
18. Emilia Conforti, Cosenza
19. Eshref Januzaj, München
20. Evalda Paci, Tiranë
21. Floresha Dado, Tiranë
22. Francesco Altinari, Cosenza
23. Gëzim Hoxha, Tiranë
24. Gianni Belluscio, Cosenza
25. Giuseppina Turano, Venezia
26. Gjovalin Shkurtaj, Tiranë
27. Haxhi Shabani, Ulqin
28. Heiner Eichner, Wien
29. Helmut Wilhelm Schaller, Marburg
30. Hivzi Islami, Prishtinë
31. Imri Badallaj, Prishtinë
32. Izer Maksuti, Tetovë
33. Jani Thomai, Tiranë
34. Jonida Xhyra-Entrof, München
35. Kimete Canaj, Prizren
36. Klaus Steinke, Erlangen
37. Kolec Topalli, Tiranë
38. Kristaq Jorgo, Tiranë
39. Krisztian Csaplar-Degovics, Budapest
40. Kujtim Shala, Prishtinë
41. Kurt Gostentschnigg, Graz
42. Lindita Sejdiu-Rugova, Prishtinë
43. Lumniqe Jusufi, Berlin
44. Mario De Matteis, Bochum
45. Martin Surovčák, Brno
46. Matteo Mandalà, Palermo
47. Milote Sadiku, Prishtinë
48. Mimoza Kore, Tiranë
49. Miradije Berisha, Prishtinë
50. Peter Mandl, München
51. Pëllumb Xhufi, Tiranë
52. Renzi Përnaska, Paris
53. Rexhep Ismajli, Prishtinë
54. Robert Pichler, Graz
55. Sabri Hamiti, Prishtinë
56. Sadije Rexhepi, Prishtinë
57. Seit Mansaku, Tiranë
58. Teuta Abrashi, Prishtinë
59. Tomorr Plangarica, Paris
60. Valter Memishaj, Tiranë
61. Visar Januzaj, Rüsselsheim
62. Vjosa Hamiti, Prishtinë
63. Walter Breu, Konstanz
64. Wilfried Fiedler, Meissen
65. Xhevat Lloshi, Tiranë

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare

**STUDIMET ALBANISTIKE NË VENDET KU
FLITET GJERMANISHT**

Internationale wissenschaftliche Konferenz

**ALBANISTISCHE FORSCHUNGEN IN DEN
DEUTSCHSPRACHIGEN LÄNDERN**

International Scholarly Conference

**ALBANIAN STUDIES IN GERMAN SPEAKING
COUNTRIES**



Prishtinë, 26-27. 10. 2017

Prishtina, 26-27. 10. 2017

Këshilli organizues i Konferencës/ Konferenzausschuss /
Organization Board of the Conference

Rexhep Ismajli, Prishtinë

Kolec Topalli, Tiranë

Robert Elsie, Berlin

Ethem Likaj, Tiranë

Teuta Abrashi, Prishtinë

Seit Mansaku, Tiranë

Bardh Rugova, Prishtinë

Mbështetur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës

Gefördert vom Kulturministerium der Republik Kosova

Supported by the Ministry of Culture of the Republic of Kosova

INFORMATATA RRETH KONFERENCËS

Pjesëmarrësit e Konferencës që vijnë nga jashtë do të vendosen në Hotel Sirius, në afërsi të Akademisë.

Punimet e Konferencës fillojnë më 26 tetor 2017, ora 9:00 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Secili pjesëmarrës me kumtesë ka në dispozicion deri në 15 minuta, ndërsa pas çdo kumtese rezervohen 5 minuta për pyetje dhe diskutim.

Kumtesat e radhitura në formë elektronike i dorëzohen sekretarisë së Konferencës, e cila ia transmeton Redaksisë që do të merret me përgatitjen për botim të vëllimit me punimet e konferencës. Për ata që kanë nevojë për rishikim jepet një afat deri më 15 dhjetor 2017 për ta dorëzuar versionin përfundimtar.

INFORMATIONEN ÜBER DIE KONFERENZ

Die Konferenzteilnehmer aus dem Ausland werden im Hotel Sirius untergebracht.

Die Konferenz beginnt am 26. Oktober um 9:00 Uhr und findet in den Räumlichkeiten der Akademie der Wissenschaften und Künste statt.

Den Rednern stehen 15 Minuten für den Vortrag und anschließend 5 Minuten für die Diskussion zur Verfügung.

Die Beiträge können in elektronischer Form bis spätestens 15. Dezember 2017 im Sekretariat für die Publikation eingereicht werden.

CONFERENCE INFORMATION

Conference participants from abroad will be accommodated at the Sirius Hotel, Prishtina (close to the ASHAK building).

The Conference will be held in the ASHAK premises on 26-27 October, starting at 9:00.

Oral presentations will be 15 minutes in duration, with an additional five minutes allocated for questions and answers directly after each presentation.

Participants are kindly asked to submit their papers (electronic copy) to the Conference Secretariat in charge of publishing the conference materials. Those who may need additional time to review their papers can submit the final version by 15 December 2017, at the latest.

Përgjegjës për kontakte/ Kontaktperson/ Contact person: Ali Caka, ASHAK

e-mail: alicaka@ashak.org; tel. +381 (38) 211 556

PROGRAM PROGRAMM PROGRAM

E enjte/ Donnerstag/ Thursday, 26. 10. 2017

Salla e madhe/ Großer Saal/ Main Hall

8:30 Regjistrimi/ Registrierung/ Registration

9:00 Hapja/ Eröffnung/ Opening

SEANCA/ SESSION/ MEETING I

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Rexhep Ismajli, Wilfried Fiedler, Jani Thomai

1. Rexhep ISMAJLI, Prishtinë: Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht
2. Klaus STEINKE, Erlangen: Herausforderungen für die deutsche Albanologie im 21. Jahrhundert
3. Kolec TOPALLI, Tiranë: Shkencëtarët gjermanë për etimologjinë e shqipes
4. Bardhyl DEMIRAJ, München: Qendra albanologjike në Muni - një vështrim perspektiv
5. Helmut Wilhelm SCHALLER, Marburg: Der Leipziger Balkanologe Gustav Weigand und die Albanologie in Deutschland
6. Seit MANSAKU, Tiranë: Albanologjia gjermane në gjysmën e parë të shekullit XIX: nga Ksilanderi te Boppi
7. Heiner EICHNER, Wien: Studimet albanologjike në kuadrin e gjuhësisë indoevropiane në vendet gjermanofone - një perspektive autobiografike
8. Bahri BECI, Paris: *J. G. Hahn për historinë e dy dialekteve të shqipes*
9. Wilfried FIEDLER, Meissen: Die Genus-Problematik in den deutschsprachigen albanischen Grammatiken des 19. Jh

Pushim për kafë/ Kaffeepause/ Coffee Break

12:00h SEANCA/ SESSION/ MEETING II

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Bahri Beci, Bardh Rugova, Giuseppina Turano.

1. Hivzi ISLAMI, Prishtinë: Dorëzimi solemn i fletëdëshmisë për zgjedhjen Anëtar i jashtëm i ASHAK-ut për Matteo Mandalanë
2. Matteo MANDALÀ, Palermo: Arbëreshët në veprën e Gustav Meyer-it (1850-1900)
3. Francesco ALTIMARI, Cosenza: "Zbulimi" i De Radës dhe i Arbëreshëve nga albanistika gjermane gjatë shekullit XIX
4. Giuseppina TURANO, Venezia: Kontributi i studiuesve gjermanë për dialektologjinë arbëreshe
5. Walter BREU, Constanz: Der Einfluß des Italienischen auf die Grammatik des Arbërisht
6. Gianni BELLUSCIO, Emilia CONFORTI, Cosenza: Anketat e Rohlf's-it për atlasin AIS, Organizimi dhe analiza e rezultateve prej Rohr-it, anketat e mëtejshme të Birken-Silverman-it në Pikën 751 dhe në mjedisin arbëresh në përgjithësi
7. Elvira GLASER, Zürich: Hans-Jürgen Sasses Forschungen zum Arvanitika
8. Imri BADALLAJ, Prishtinë: Kontributi i Claus Haebler-it mbi të folmen arbërore të Salaminës

14: 00h Dreka/ Mittagessen/ Lunch

16:00h SEANCA/ SESSION/ MEETING III

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Imri Badallaj, Bardhyl Demiraj, Kurt

Gostenschnigg

1. Sabri HAMITI, Prishtinë: Lambertz-i e Çabej: për letërsinë shqiptare
2. Floresha DADO, Tiranë: Franc Nopça, nga qasjet albanologjike te krijimi poetik
3. Bashkim KUÇUKU, Tiranë: Botimet dhe kritika gjermane për veprën e Ismail

Kadaresë

4. Kujtim SHALA, Prishtinë: Krist Maloki: ipse e idem
5. Albert RAMAJ, St. Gallen: Për Giuseppe Gangale
6. Kristaq JORGO, Tiranë: Studimi & përkthimi: Martin Camaj i Hans Joachim Lanksch-it (Një analizë kuantematike)
7. Robert PICHLER, Graz: Studies on Family, Kinship and Migration in Albania, Macedonia and Kosova by the Department of Southeast European History and Anthropology at the University of Graz
8. Ema KRISTO, Elbasan: Martin Camaj dhe trashëgimia e tij albanologjike
Pushim për kafë/ Kaffeepause/ Coffee Break

18:00h SEANCA/ SESSION/ MEETING IV

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Matteo Mandalà, Floresha Dado, Walter Breu.

1. Jani THOMAI, Tiranë: Leksikografia dygjuhëshe e shqipes me gjermanishten
2. Remzi PËRNASKA dhe Tomorr PLANGARICA, Paris: Albanische Grammatik e Oda Buchholz-it dhe Wilfried Fiedler-it
3. Lindita SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë: Three main areas of Albanian syntax in the Albanische Grammatik of Buchholz and Fiedler
4. Teuta ABRASHI, Prishtinë: Ndajshimi i veçuar - disa çështje në rrafshin sintaksor dhe semantik
5. Blertë ISMAJLI, Prishtinë: Norbert Boretzky si albanolog – Sistemi foljor i shqipes në studimet e tij
6. Bardh RUGOVA, Prishtinë: Mënyrë dhe modalitet në gjuhën shqipe - kontributi i Walter Breu-it
7. Vjosa HAMITI, Prishtinë: Fjalët modale në Albanische Grammatik të Buchholz/Fiedler
8. Sadije REXHEPI, Prishtinë: Sistemi kohor i shqipes sipas Buchholz/Fiedler
Darkë/ Abendessen/ Dinner

E premte/ Freitag/ Friday, 27. 10. 2017

9:00h SEANCA/ SESSION/ MEETING I

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Elvira Glaser, Bashkim Kuçuku, Besim Kabashi

1. Kurt GOSTENTSCHNIGG, Graz: Dimensioni politik i trajtimit të çështjes së etnogenezës shqiptare nga ana e albanologjisë austro-hungareze
2. Xhevat LLOSHI, Tiranë: Shqyrtime të burimeve leksikore të shqipes nga autorë të sotëm gjermanë
3. Pëllumb XHUFU, Tiranë: Shqiptarët në historiografinë në gjuhën gjermane
4. Dhori QIRIAZI, Selanik: Aspekte të jehonës dhe të kuadrin ballkanik të veprave në gjuhën gjermane kushtuar shqipes dhe shqiptarëve
5. Dieter NEHRING, Berlin: Rreth fjalëformimit të mbiemrave të përbërë të gjuhës standarde
6. Gëzim HOXHA, Tiranë: Optika e Theodor Ippen-it mbi ultësirën bregdetare të Shqipërisë kundrejt rezultateve të sotme të arkeologjisë
7. Izer MAKSUTI, Tetovë: Vjena si vatrë e studimeve albanologjike
8. Albulena BLAKAJ-GASHI: Raportet kulturore shqiptaro-gjermane
Pushim për kafë/ Kaffeepause/ Coffee Break

12:00h SEANCA/ SESSION/ MEETING II

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Kujtim Shala, Remzi Përnaska, Robert Pichler

1. Anila OMARI, Tiranë: Fjalëformimi i shqipes së vjetër: një kontribut i ri i Joachim Matzinger-it
2. Albert RISKÀ, Elbasan: Gjurmë të apofonisë IE në gjuhën shqipe (bazuar në

- rindërtime etimologjike nga G. Meyer e N. Jokl)
3. Besim KABASHI, Erlangen: Neologizmat në shqipen e sotme – njohja dhe analiza automatike
 4. Krisztian CSAPLAR-DEGOVICS, Budapest: Thoughts on the history of origins of the first Hungarian-Albanian Dictionary (1913)
 5. Lumnije JUSUFI, Berlin: Neue Zugänge zu alten Texten über das Konzept der Selbstreflexion. Zoltán László und sein ungarisch-albanisches Wörterbuch (1913)
 6. Valter MEMISHAJ, Tiranë: M. Lambertz-i përmes dosjeve në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë
 7. Mimoza KORE, Tiranë: Gjirokastra dhe veçoritë e saj etnogjuhësore në veprën e Maximilian Lambertz-it
 8. Begzad BALIU, Prishtinë: Maksimilian Lamberci dhe vendi i tij në studimet albanologjike

14:00h Dreka/ Mittagessen/ Lunch

16:00h SEANCA/ SESSION/ MEETING III

Drejtojnë/ Moderation/ Moderated by: Teuta Abrashi, Xhevat Lloshi, Gianni Belluscio

1. Gjovalin SHKURTAJ, Tiranë: Studime për kontaktin e shqipes me gjermanishten në kantonin gjermanik të Zvicrës dhe në Austri
2. Martin SUROVČÁK, Brno: Jan Urban Jarnik, albanolog, ligjërues në universitetet austro-hungareze
3. Evalda PACI, Tiranë: Gunnar Svane: kontribute themelore mbi interpretimin tekstor e filologjik të veprës së Pjetër Budit
4. Milote SADIKU, Prishtinë: Studimet e gjuhëtarëve gjermanishtfolës për mbiemrin e gjuhës shqipe
5. Jonida XHYRA-ENTROF, München: Përthyerje të kultivuara në albanologji: Marie Amelie von Godin
6. Haxhi SHABANI, Ulqin: Fjalorthi i Arnold fon Harfit
7. Brikena KADZADEJ, Tiranë/ Mario DE MATTEIS, Bochum: Beiträge der albanischen jungen Wissenschaftler im deutschen Sprachraum nach der Wende
8. Miradije BERISHA, Prishtinë: Panoramë e studimeve albanologjike dhe e mësimin të shqipes në diasporën shqiptare në Republikën e Austrisë
9. Eshref JANUZAJ, München – Visar JANUZAJ, Rüsselsheim – Ali CAKA, Prishtinë – Peter MANDL, München: Hulumtimet albanologjike në kohën e big data – një këndvështrim nga informatika
10. Kimete CANAJ, Prizren: Roli i profesorëve austriakë në studimin dhe promovimin e gjuhës dhe të kulturës shqipe në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX

Mbyllja e Konferencës/ Konferenzzabschluss/ Closing

20:00 h Darkë/ Abendessen/ Dinner

ABSTRAKTE ABSTRAKTE ABSTRACTS

Në vijim po japim të gjitha abstraktet ashtu si i shin paraqitur për Konferencë. Disa prej të paraqiturve nuk kanë ardhur në Konferencë, por i kanë dërguar abstraktet, ndërsa të tjerë kanë bërë ndryshime ndërkohë. Disa nuk kanë ardhur, as e kanë dërguar kumtesën.

ALBERT RAMAJ: PËR GIUSEPPE GANGALE

Studiuesi Albert Ramaj propozon të na flasë me këtë studiuesin arbëresh Giuseppe Gangale (1898-1978), studiues në filozofi, i specializuar për Pascal-in, por njëherësh shumë aktiv dhe në çështje të mbrojtës së të drejtave të minoriteteve, konkretisht arbëreshe. Në gjuhësi dhe studimet arbëreshe njihet si personalitet me rëndësi. Ka bashkëpunuar dhe me gjuhëtarin e shquar Louis Hjelmslev dhe ka zhvilluar veprimtari jo vetëm në Itali po edhe në Danimarkë, në Zvicër, etj. [Red.ë

1. ALBERT RISKÀ: GJURMË TË APOFONISË IE NË GJUHËN SHQIPE (BAZUAR NË RINDËRTIME ETIMOLOGJIKE NGA G. MEYER E N. JOKL)

Në studimet etimologjike në fushë të shqipes ka ndodhur që në mjaft raste të bëhen rindërtime fjalësh a trajtash të cilat, pavarësisht mungesës së dokumentimit, do të mund të pranoheshin si fatlume dhe do të ishin mjaft frutdhënëse në kërkimet e mëtejshme. Në përgjithësi këto rindërtime janë mbështetur në përjasjen e fjalëve shqipe me përgjegjëset e gjuhëve të tjera, por është për t'u vënë në dukje se, përveç kësaj, si një çelës për rindërtimin etimologjik ka shërbyer shpesh edhe njohja e marrëdhënieve etimologjike të një fjale shqipe me fjalë të tjera brenda gjuhës (të tilla që mund të duken e të trajtohen në gjendjen e sotme si fjalë krejt të ndryshme).

Këtu kemi përzgjedhur disa forma të supozuara nga G. Meyer e N. Jokl për të cilat besojmë se kemi të dhëna të reja që vijnë në mbështetje të plotë të rindërtimeve të bëra nga këta kolosë. Bëhet fjalë për çifte a grupe fjalësh që paraqiten si zhvillime të dy shkallëve të ndryshme apofonike të një baze (leme) të hershme indoevropiane. Kështu, tima e rindërtuar e Joklit **vedti* për fjalën *vesë* mund të ndihmojë për të kuptuar lidhjen etimologjike të saj me fjalën shqipe *ujë*, duke nënkuptuar, nga ana tjetër, se raporti semantik midis këtyre fjalëve mund të ketë ndihmuar në këtë rindërtim. Po ashtu mund të flitet edhe për lidhjet midis foljeve *kall* e (n)*gull* (sh)*kul*, si edhe për lidhjet midis përemrave *unë* e *vet* apo disa rasteve të tjera.

Gjurmime të tilla mund të na shpjen në njohjen më të gjerë e detyrimisht më të thellë të natyrës së mekanizmave të trashëguara fonetike që i përmbledhim nën termin "apofoni".

2. ALBULENA BLAKAJ-GASHI: RAPORTET KULTURORE SHQIPTARO-GJERMANE

Me këtë punim do të tentoj të kap raportet e hershme kulturore shqiptaro-gjermane apo, thënë më saktë, njoftimet për shqiptarët në botimet gjermane, duke filluar nga ato të shekujve 16-18. Te botimet shqiptare (Barleti, Budi, Bardhi, Bogdani) kur janë edhe me tema biblike, nuk dimë të ketë hyrë diçka gjermane, reformacioni i Martin Luterit a tjetër. Te gjermanët njoftimet për Shqipërinë e Skënderbeut arrijnë vullshëm me përkthimin e veprës së Barletit që më 1533. Vetëm në shek. 16 "Historia e Skënderbeut" në Evropë i kishte 16 botime. Botimi i parë gjerman, me Shqipëri e shqiptarë brenda, është i autorit Schedel, 1493. Punimi do t'i ndjek gjurmët e pranisë shqiptare në botimet gjermane të shekujve 16-21, edhe në disa nga enciklopeditë, që nga ajo e vitit 1709, të kohës kur edhe gjermani i madh, Leibnic-i, interesohet për gjuhën e lashtësinë e shqiptarëve. Sipas hulumtimit të bërë në en-

ciklopeditë gjermane, shihet sa ndikim ka përkthimi i veprave nga shqipja në gjermanisht për njohjen e Shqipërisë, shqiptarëve, autorëve, veprave e kulturës sonë të gjermanët. Për kohën e tashme për prezantimin e saj të gjermanët nuk mund të kapërcehen Joachim Röhm dhe Hans-Joachim Lanksch, dy përkthyes të rëndësishëm të letërsisë shqipe në gjermanisht.

3. ANILA OMARI: FJALËFORMIMI I SHQIPES SË VJETËR: NJË KONTRIBUT I RRI JOACHIM MATZINGER-IT

Albanologjia e hapësirës gjermanishtfolëse, e themeluar dhe e përvijuar nga emra të mëdhenj si Johann Thunmann, Joseph Ritter von Xylander, Franz Bopp, Georg von Hahn, Gustav Meyer, Norbert Jokl, Maximilian Lambertz, e zhvilluar më tej nga albanologët e mirënjohur të gjymës së dytë të shekullit XX Wilfried Fiedler e Oda Buchholz, po vijon traditën e saj të ndritur me albanologët e brezit të ri, ndër të cilët spikat emri i Joachim Matzingerit, tashmë i afirmuar si studiues me kontribute të rëndësishme në studimin e gjuhës shqipe, veçanërisht të fazave të vjetra të saj.

Me një formim të plotë në fushën e gjuhësisë së krahasuar indoeuropiane në universitete me emër, së pari në atë të Vjenës për studime magjistrale dhe më pas në Halle për studime doktorale, mbas disa punimesh të rëndësishme mbi shqipen e vjetër ku përballet me probleme nga më të vështirat e të pazgjdhura përfundimisht të teksteve të vjetra e të historisë së gjuhës shqipe, dhe mbas botimit të një studimi të gjerë e të plotë mbi foljet e shqipes së vjetër në bashkëpunim me një tjetër sllavist e albanolog me emër, Stefan Schumacherin, Matzingeri ka sjellë së fundi një kontribut tjetër në fushën e shqipes së vjetër (shek. XVI-XVII) bazuar në tekstin e librit të parë shqip ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut dhe të teksteve të tjera të kësaj periudhe, dhe pikërisht në fushën e fjalëformimit, si një nga rrafshet më të rëndësishme të sistemit të gjuhës që tregon edhe për karakterin dhe shkallën e vitalitetit të një gjuhe. Titulli i veprës është “Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im altalbanischen bei Gjon Buzuku. Ein Beitrag zur Albanischen Lexikographie” (“Modelet e fjalëformimit sekondar në sistemin emëror të shqipes së vjetër të Gjon Buzukut. Një kontribut për leksikografinë shqipe”), botuar nga shtëpia botuese Harrassowitz, 2016, 593 f. Me fjalëformim sekondar autori kupton tipat e fjalëformimit që krijohen me anë mjtesh fjalëformuese të qarta nga pikëpamja e sotme, si ndajshesa dhe kompozim, pra ato që quhen fjalë jo të parme. Gjatë trajtimit do të dalin edhe mënyra të tjera fjalëformimi shumë prodhimtare në shqipen e vjetër si “ndërkategorizimi sintaksor” etj.

Materiali i vjelë në mënyrë të plotë në tekstin e Buzukut dhe të autorëve të tjerë të shqipes së vjetër është ndarë sipas mënyrave të fjalëformimit, tipave të fjalëformimit dhe mjeteve fjalëformuese ku secili mjet fjalëformues është trajtuar si zë enciklopedik më vete me disa rubrika: analiza semantike, analiza morfologjike, prodhimtaria, dëshmitë në tekstet e vjetra me shembujt përkatës të vjelë në mënyrë shteruese, si dhe analiza diakronike. Autori e ka konsideruar të nevojshme përfshirjen edhe të këndvështrimit diakronik, në një punim të karakterit kryesisht sinkronik, duke sjellë kontribute të reja në etimologjinë e një numri mjtesh fjalëformuese të shqipes. Vepra përmban, në pjesën e dytë të saj, fjalorin e okurencave të modeleve fjalëformuese në “Mesharin” e Gjon Buzukut, i cili përbën një ndihmesë të rëndësishme në leksikografinë shqipe.

Kumtesa ka për qëllim të japë një paraqitje të këtij punimi themelor për shqipen e vjetër dhe të vërë në dukje kontributet dhe risitë që sjell ai.

4. BAHRI BECI: J. G. HAHN PËR HISTORINË E DY DIALEKTEVE TË SHQIPES DHE REAGIMET NDAJ TIJ

Objekt i kësaj kumtese do të jetë konceptimi i Georg von Hahn-it, albanologut shumë të rëndësishëm të pjesës II të sh. XIX për lashtësinë e ndarjes dialektore të shqipes. Idetë dhe

tezat e tij do të diskutohen dhe në përqsje me idetë e kohëve të mëvona dhe të kohës sonë për këto çështje. [Red.ë

5. BARDH RUGOVA: MËNYRË DHE MODALITET NË GJUHËN SHQIPE – KONTRIBUTI I WALTER BREU-IT

Konceptimi tradicional (Demiraj 1976, Gramatika I 1995, Beci 2001: 113) në gramatikat e shqipes sheh gjashtë mënyra të foljes, ndërsa nocioni i modalitetit nuk diskutohet në plotni, por vetëm në kuadër të foljes, në veçanti te foljet e ashtuquajtura gjysmë ndihmëse dhe ngjyrimet modale të nxjerra prej tyre. Ky klasifikim nuk është bërë në të gjitha rastet mbi shënjes të qartë gramatikore.

Një kontribut dhe diskutim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës për modalitetin dhe mënyrën në gjuhën shqipe ka ofruar Walter Breu, i cili jep një pasqyrë pak më ndryshe të këtyre koncepteve në shqipen.

Derisa në trajtimet teorike bashkëkohore ka pasur shumë diskutime për dallimin ndërmjet mënyrës dhe modalitetit, në këtë punim “kodimin gramatikor të kuptimit modal” (Depraetere, Reed 2006: 469) në sistemin foljor të një gjuhe do ta përmbledhim me termin mënyrë. Nisur nga kjo bazë teorike, do të mund të rishikohet kategorizimi i deritashëm i modalitetit dhe i mënyrës në gjuhën shqipe.

Fjalët kryesore: Gramatikalizim, sistem foljor, ngjyrim modal, tip strukturor, gjuhësi tradicionale

6. BARDHYL DEMIRAJ: QENDRA ALBANOLOGJIKE NË MUNIH - NJË VËSHTRIM PERSPEKTIV

Objekt i kumtesës sonë do të jetë Dega e Albanologjisë në "Institutin e Gjuhësisë Krahasuese dhe Indoeuropiane si edhe të Albanologjisë" (VISA) pranë Universitetit "Ludwig-Maximilian" të Munihut (LMU), e cila përcjell këtë vit në vazhdim një traditë thuajse 60-vjeçare në aktivitetin të saj shkencor-universitar. Pas skicimit të kronologjisë së përfuturit dhe ecurisë së programit të saj universitar këto gjashtë dekada do të ndalemi në profilin dhe statusin aktual të studimeve albanologjike, duke u përqendruar sidomos në pozicionin e kësaj dege në arealin albanologjik ndërkombëtar, në aktivitetin e saj kërkimor-shkencor dhe botues si edhe në angazhimin social-kulturor, sa i përket organizimit të disa tubimeve shkencore albanologjike me radius gjithëpërfshirës të hapësirës albanologjike në Europë dhe Amerikë. Në mbyllje do t'i përkushtohet një vend i konsiderueshëm edhe perspektivave të kësaj dege në të ardhmen në qerthullin e problematikës që ngërthen formimi universitar dhe kërkimi shkencor albanologjik në kohën tonë.

7. BASHKIM KUÇUKU: BOTIMET DHE KRITIKA GJERMANE PËR VEPRËN E ISMAIL KADARESE

Kumtesa mbështetet në njëjtësimin vetjak të botimeve dhe të shkrimeve kritike në gjermanisht për veprën e Ismail Kadarese. Në gjermanisht janë njëjtësuar 65 botime me 23 tituj, duke qenë, kështu, gjuha e tretë e huaj pas frëngjishtes dhe anglishtes, dhe, në një përmasë shtrirjeje me italishten. Ndërsa, kritika gjermane e ka përcjellë me një shumësi artikujsh dhe njoftimesh prej të cilëve kemi mundur të njëjtësojmë dhe të kemi në dosjen vetjake 290, ndër to edhe 11 intervista dhe 10 shkrime nga Ismail Kadareja. Për nga shumësia e shkrimeve kritika gjermane është e dyta pas frëngjishtes prej së cilës kemi mundur të njëjtësojmë dhe të kemi në dosjen vetjake rreth 1500 shkrime të llojeve të ndryshme. Në kumtesë analizohen vetëm disa shkrime të viteve 1981-1996, që janë botuar të përkthyer edhe në shqip. Në to vlerësohet originalizmi dhe shprehësia e madhe e disa romaneve: Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Kronikë në gur, Dimri i madh, Koncert në fund të dimrit, si dhe

tregimi Karavani i ferexheve/ Sjellësi i fatkeqësisë, i cili ka qenë botuar më parë në një përmbledhje prozash nga autorë me emër botëror, ribotuar edhe tri herë të tjera. Me të njëjtin mendim me kritikën franceze edhe kritikë gjermanë, ndër të tjerë shkrimi me titull Një kandidat për Çmimin Nobel vërteton emrin e tij, pohojnë dhe argumentojnë në mënyrën e tyre rëndësinë e madhe të veprës së shkrimtarit shqiptar, e cila meriton çmimin Nobel.

8. BEGZAD BALIU: MAKSIMILIAN LAMBERCI DHE VENDI I TIJ NË STUDIMET ALBANOLOGJIKE

Objekt i studimit tonë do të jetë vepra shkencore dhe arsimore e albanologut të gjysmës së parë të shekullit XX, Maksimilian Lamercit. Në kumtesën tonë do të vlerësohen disa nga veçoritë e veprave shkencore në fushë të gjuhësisë (studimet dialektore dhe monografia për sintaksën); të folklorit dhe etnologjisë (studimet të *Posta shqiptare* dhe vëllimet me përralla si dhe monografia për eposin); si dhe tekstet mësimore për studentët gjermanë dhe studimet për teatrin e përkthimet letrare.

Fjalët çelës: albanologjia, gjuhësia gjermane, Lamerci, dialektet, sintaksa, përralla, libri i leksimit, Fishta

9. BESIM KABASHI: NEOLOGJIZMAT NË SHQIPEN E SOTME – NJOHJA DHE ANALIZA AUTOMATIKE

Krijimi dhe përdorimi i fjalëve të reja në shumë raste vë dëgjuesin a lexuesin para vështirësive për të kuptuar folësin përkatësisht tekstin. Duke u nisur nga fakti se një dëgjues a lexues është në të njëjtin nivel me folësin përkatësisht autorin e tekstit sa i përket njohjes së gjuhës së komunikimit dhe kështu nuk ka vështirësi për ta kuptuar folësin, aq më pak duke pasur parasysh mundësinë e ndërveprimit dëgjues-folës, pra për të pyetur në rast të ndonjë moskuptimi të ndonjë fjale të re, në fushën e përpunimit automatik të gjuhëve natyrore kjo situatë mund të paraqesë një problem jo të vogël ose edhe të pazgjidhshëm në shumë raste. Te përpunimi automatik probleme kryesore janë kryesisht mungesa e resurseve të gjuhës që duhet të analizohet si dhe metodat e përdorura të përpunimit teknik të gjuhës. Ndërtuesi i një programi për njohje të neologjizmave e ka në praktikë të pamundshme për të pasur paraprakisht në fjalor secilën fjalë të re mundshme, e cila mund të përdoret rastësisht, sikurse edhe dëgjuesi nuk mund të paradijë një fjalë të re që folësi do/mund ta flasë, pra neologjizmat nuk mund të paradihen. Nga pikëpamja teknike kjo detyrë është shumë e vështirë të kryhet plotësisht.

Njohja dhe analiza automatike e fjalëve të reja apo të krijuara sipas kontekstit, qoftë dhe për një rast, përdoruesit të programit të lartpërmendur i kursen shumë punë dhe kohë, njëherazi i jep rezultate më të mira e më të plotësuara gjatë analizës së gjuhës. Kjo është sidomos e rëndësishme në fushat, në të cilat informacioni analizohet pa ndërprerje (në një rrymë/ lumë, angl. *stream*). Që të ndërtohet një program i tillë duhet, ndër të tjera, të zhvillohen rregullat që përshkruajnë krijimin e fjalëve të reja.

Një morfologji automatike e plotë e shqipes, e cila do të demonstron në konferencë, është në gjendje të analizojë krahas eptimit të fjalëve, modeleve kryesore të fjalëformimit, në masë të madhe edhe fjalë të reja d.m.th. të krijuara për herë të parë, e të cilat nuk janë në ndonjë fjalor, si p.sh. *paradijë* e *paradihet* (si forma të foljes *paradi*, khs. për ngjashmëri strukturash foljet *parashoh* dhe *paramendoj*).

10. BLERTË ISMAJLI: NORBERT BORETZKY SI ALBANOLOG – SISTEMI FOLJOR I SHQIPES NË STUDIMET E TIJ

Emri i Norbert Boretzky-t në opinionin shkencor është i njohur në disa fusha: gjuhësi e përgjithshme, gjuhësi historike, kontaktet ndërgjuhësore (me përqendrim te gjuhët e Ball-

kanit) dhe romishtja, së cilës iu përkushtua së fundmi. Gjuha shqipe zë vend në studimet e Boretzky-t që në fillim. Ajo trajtohet kryesisht në kontekstin ballkanik, si në studimet për leksikun, ashtu edhe në ato për gramatikën. Projekti i tij më voluminoz në fushën e albanologjisë është punimi i tij i habilitimit “Der türkische Einfluß auf das Albanische”, i botuar në dy vëllime: i pari është studim i fonologjisë dhe morfologjisë së turcizmave të shqipes, ndërsa i dyti përmban një fjalor të turcizmave të shqipes. Në studimet e tij Boretzky merret edhe me çështje të ndryshme të gramatikës së shqipes: kohët e foljes, konstruktionet me foljen modale *mund*, nyjën e shquar pas parafjalëve, ndryshimet e tingujve dhe historinë e shqipes, më vonë me morfologjinë e foljes. Në këtë kumtesë do të paraqitet kontributi i tij për sistemin foljor të shqipes.

11. BRIKENA KADZADEJ/MARIO DE MATTEIS: BEITRÄGE DER ALBANISCHEN JUNGEN WISSENSCHAFTLER IM DEUTSCHEN SPRACHRAUM NACH DER WENDE

Të tërhequr nga tema e Konferencës së Akademive të Prishtinës dhe të Tiranës, menduam të japim një panoramë të studimeve përfaqëse shqip-gjermanisht, të kryera pas viteve '90, nga shkencëtarë të rinj shqiptarë në hapësirën gjermanofolëse.

Objekt i kësaj kumtese është dhënia dhe evidentimi fillimisht i punimeve shkencore për mbrojtjen e titujve (si fillim të pakta në numër) në hapësirën gjermanofolëse. Theksojmë se këto janë punime përfaqëse dhe kanë pasur si qëllim që të japin një ndihmesë modeste në të dyja gjuhët. Ky punim më tej do të thellohet duke pasur në qendër të vëmendjes serinë “Albanische Studienreihe” botuar nga Shtëpia Botuese Gjermane “Athena”, Oberhausen Gjermani. Kështu, jo vetëm do të jepet një panoramë e punimeve, por edhe do të përiqemi të japim edhe një analizë dhe pozicionim për to. Së fundi kjo kumtesë do të trajtojë edhe punimet me objekt përfaqës shqip-gjermanisht, botuar në revistën shkencore “Zeitschrift für Germanistische Sprach- und Literaturwissenschaft, “Dituria”. Kjo revistë shkencore drejtohet nga Prof.dr. Riecke, Drejtor i “Institutit të Gjermanistikës dhe të Studimeve Evropiane” në Heidelberg, Gjermani dhe e mbështetur në fillim nga Konferenca e Rektorëve të Shkollave të Larta dhe më pas DAAD-ja.

Pa dyshim qëllimi ynë është që krahas dhënies së përfundimeve, arritjeve të deritanishme, të vazhdohet me një bashkëpunim të planifikuar për të ardhmen.

12. DHORI QIRIAZI: ASPEKTE TË JEHONËS DHE TË KUADRIT BALLKANIK TË VEPRAVE NË GJUHËN GJERMANE KUSHTUAR SHQIPES DHE SHQIPTARËVE

Jehona e veprave në gjuhën gjermane kushtuar shqipes dhe shqiptarëve është e hershme dhe në disa raste i ka shoqëruar ato qysh pa parë ende dritën e botimit, sikurse duket nga një letër për A. Armodhin, mësues të greqishtes në Korçë, shkruar nga K. Kristoforidhi para v. 1850, kur ky qe bashkëpunëtor i Hahnit në Janinë: Fara shqiptare me gjuhën e vet pellazgjike ... në këtë stad ndodhemi prej dy vjetësh dhe vazhdojmë të ecim në të njëjtën hulli pa e mbaruar ende këtë punë se zoti Hahn filolog gjerman dhe konsull austriak në Janinë dhe unë zotëruar i dialektit ilirisht (gegërishtes) dhe një tjetër i toskërishtes, nga anët e Gjirrokastres, po hartojmë një fjalor dhe një gramatikë, të përbashkëta për të dy dialektet ... Duke patur si pikë referimi G. Hahn-in dhe veprën e tij “Albanesische Studien”, mund të themi se jehona e tij është padyshim më e madhja dhe bigëzohet sa në rrafshin emocional (në Fondin Mitko të AQShSh kemi gjetur një vjershë-epitaf, shkruar nga Vasil Kushta në shtator 1869, ku Hahn-i cilësohet “dielli i Shqipërisë, Kollombi i Pellazgjisë”) aq edhe në rrafshin racional, prej nga ia vlen të veçohet vepra “Αλβανικά Μελέται” (Studime Shqiptare) e P. Kupitorit, botuar në shtypin e Athinës në një motëzim të hershëm të v. 1867 (plot 150

vjet më parë!) dhe ribotuar me plotësime më 1879. Studimi i motërzimit të dytë e rendit Kupitorin ndër njohësit dhe vlerësuesit më të mirë e më objektivë të save u patën shkruar deri atëherë në gjermanisht për shqipen e shqiptarët. Fryt i kërkimeve tona arkivore është edhe vepra dorëshkrim e autorit arvanit Tasos Nerucos, që mban titullin ALBANICA (Quellen zu albanesischen Studien von Dr Neroutsos (aus Athen) gesammelt und zusammengestellt. München in Bayern und Alexandrien in Egypten. 1848-1878, dhe e cila përbën ndoshta përpjekjen e parë për një grumbullim sistematik të burimeve relevante me albanologjinë, ndër marrë nga një arvanitas që pat kryer studime për mjekësi e filologji në Munihi në vitet 1840. Rasti Nerucos na jep dorë të theksojmë se puna me arkivat do vazhduar më tej. Për të dhënë një shembull, në veprën e tij “Alb. Texte mit Glossar” (1895) H. Pedersen thotë se mbledhi 35 përralla shqiptare, prej të cilave botoi 12. Cili ka qenë fati i të tjerave?

Sa njihet dhe si shfrytëzohet sot kjo trashëgimi e pasur dhe tradita e pandërprerë e deritashme e saj, në kuadër ballkanik?

Po kufizohemi në fushën e kontakteve të shqipes me greqishten për të vërejtur se deri më sot janë përdorur pak punimet e G. Rohlf-s-it, N. Andriotis-it, Chr. Tzitzilis-it, etj., të cilat ndihmojnë për një qasje sa më objektive e shkencore të çështjeve të debatueshme, sikurse është prania e hershme apo e vonë e enklavave të greqishtes në Shqipërinë e Jugut. Veprat në gjuhën gjermane kushtuar shqipes dhe shqiptarëve dallohen përgjithësisht edhe për metodologjinë e rreptë shkencore, të cilën e thelloi dhe e përsosi E. Çabej. Prej tyre e prej tij kanë për të mësuar shumë albanologët e sotëm.

13. DIETER NEHRING: RRETH FJALËFORMIMIT TË MBIEMRAVE TË PËRBËRË TË GJUHËS STANDARDE. MBI STRUKTURËN SEMANTIKE DHE FORMALE TË FJALËFORMIMIT TË MBIEMRAVE ME DY DHE MË SHUMË TEMA NË SHQIPEN E SOTME.

Punimi e pasqyron gjendjen e zhvillimit të gjuhës standarde në fund të viteve 1970, në fillim të viteve 1980, duke u mbështetur në analizën linguistike të një pjese të zgjedhur të trullit gjuhësor të shqipes. Paraqiten 3679 kompozita dhe ekuivalentet e tyre në gjuhën gjermane. Mbiemrat e përbërë të punimit u përkasin fushave të ndryshme funksionale-stilistike, veçanërisht kulturës, shkencave sociale, bujqësisë dhe botanikës. Përkthimi i tyre në gjuhën gjermane u arrit në bazë të fjalorëve dygjuhësh shqip: - latinisht, - anglisht, - rusisht dhe - serbokroatisht, falë shpjegimeve të specialistëve gjuhësorë si dhe në rastin e termave falë shkencëtarëve të fushave përkatëse. Me të punimi krijoi burime për përpilimin e fjalorëve në fushën e leksikografisë.

Hulumtimi i materialit gjuhësor të shqipes, i cili përdoret shpesh, por jo gjithmonë në gjuhën e shkruar, bazohet nga një anë në analizën e komponentëve të pandërmjetuar (immediate constituents) si dhe në njohuritë nga fusha e fjalëformimit të germanistikës dhe të gjuhës ruse. Vëzhgimet teorike mbi parafrazimin e kompozitave si mjet për gjetjen e strukturave fjalëformuese formale dhe semantike të mbiemrave ishin nga ana tjetër pothuajse të reja, sidomos për analizën e fjalëformimit të shqipes. Si rrjedhojë paraqiten në punim mbiemrat e hulumtuar sipas numrit të gjymtyrëve motivues (një, dy - në shumicën e rasteve - dhe tre të tipit dashamirës; besimplotë, mendjefemër, ethelargues; ekonomikologjitar-komercial, gushë-e-llërë-e-gjibardhoshe) dhe sipas mënyrave të fjalëformimit. Ata kanë ngjyrim të ndryshme stilistike. Dallohen 89 modele morfematike fjalëformuese mbiemrash si dhe nga ana e semantikës 78 grupe të ndryshme të kuptimit fjalëformues. Analiza i tregon qartë pasuritë e shqipes, korrespondencat e saj me gjuhë të tjera në komunikim transkulturor dhe terminologjik si dhe divergjencën në procesin e shfrytëzimit të modeleve dhe strukturave vendase, d.m.th. në përfillje të vendimeve të ndryshme në përzgjedhjen e

normave gjuhësore.

Eksplikimi i modeleve dhe strukturave fjalëformuese u bë sipas të dhënave të folësve të gjuhës amtare, veçanërisht falë ndihmës së çmuar të profesorit Isa Bajçinca. Në këtë mënyrë u ngulitën nga ana socialinguistike koncepti dhe kuptimi i shqipes standarde pak më vonë pas njësimi të saj dhe pas lënies mënjatë të koncepteve të tjera mbi zhvillimin e standardit gjuhësor, gjë që jep edhe hapësira për analizat gjuhësore në të ardhmen.

14. ELVIRA GLASER: HANS-JÜRGEN SASSES FORSCHUNGEN ZUM ARVANITIKA

Hans-Jürgen Sasses Forschungen zum Arvanitika Die Arvanitika genannten Dialekte der nicht epirotischen albanischsprachigen Bevölkerung Griechenlands (Peloponnes, Attika, Bötien, Euböa, Andros) waren in der zweiten Hälfte des 19. Jahrhunderts bereits im Aussterben begriffen. Neben der Untersuchung Haeblers (1965) zur Mundart von Salamis sind hier im deutschsprachigen Raum, abgesehen von den älteren Arbeiten Reinholds, Weigands und Meyers, v.a. die Arbeiten Hans-Jürgen Sasses zu nennen, die der sprachlichen Dokumentation insbesondere der böotischen Dialekte galten. Als Mitglied der Sektion Mundartforschung des Münchener Sonderforschungsbereichs Südosteuropa führte der gelehrte und promovierte Arabist, der sich in München vermehrt der Balkanologie und insbesondere der Albanologie widmete, im Winter 1970/71 systematische Feldforschungen in Griechenland durch, nachdem er nach eigenen Angaben (Sasse 1991a, 66) mit ersten Erhebungen 1966 in Markopulo begonnen hatte. Aus der Feldforschung von 1970/71 resultierte eine Publikation (1971) von neun Texten und einigen Liedern aus dem Dorf Kaparelli, vom Tonband in API transkribiert und ins Deutsche übersetzt. Es handelt sich hierbei um überaus wertvolle Dokumente der damals in der älteren Generation noch lebendigen Sprache. Von dieser ersten Publikation an hat sich H.-J. Sasse immer wieder mit dem Arvanitika beschäftigt und weitere Arbeiten dazu vorgelegt, worunter insbesondere sein 1991 erschienenes Buch Arvanitika zu nennen ist. Diesem hätten noch weitere 4 Bände folgen sollen, für die er umfangreiche Materialien gesammelt hatte. Leider hat sein früher Tod dazu geführt, dass die Arbeit unvollendet geblieben ist. In meinem Vortrag werde ich die verstreut erschienenen Untersuchungen zu verschiedenen Arvanitikadialekten vorstellen, die wichtigsten von H.-J. Sasse behandelten Themen herausarbeiten, die ihn auch in seinen späteren Arbeiten als allgemeiner Sprachwissenschaftler weiter beschäftigten, und einige Untersuchungsergebnisse und Textbeispiele erläutern.

Haebler, Claus. 1965. Grammatik der albanischen Mundart von Salamis. Wiesbaden. Sasse, Hans-Jürgen. 1971. Arvanitika-Texte aus Kaparelli (Bötien). In: Dissertationes Albanicae in honorem J. Valentini et E. Koliqi septuagenariorum. München, 141-175. Sasse, Hans-Jürgen. 1991. Arvanitika: Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Teil 1. Wiesbaden: Otto Harrassowitz. Sasse, Hans-Jürgen. 1991a. Zur Situation der Erforschung des Arvanitischen. In: Aspekte der Albanologie. Akten des Kongresses 'Stand und Aufgaben der Albanologie heute'. 3. - 5. Oktober 1988, Universität zu Köln. Herausgegeben von Walter Brey, Rolf Ködderitzsch und Hans-Jürgen Sasse. Berlin, 61-70.

15. ESHREF JANUZAJ, VISAR JANUZAJ, ALI CAKA, PETER MANDL: SHQIPTARËT NË BOTIMET E HUAJA - NJË KËNDVËSHTRIM NGA INFORMATIKA

Hulumtimi në arkiva dhe në dokumente të vjetra, është një sfidë e përditshme në shkencat e historisë, të gjuhësisë, të arkeologjisë dhe në shkencat e tjera të ngjashme. Për shembull, në fushën e historisë, pos hulumtimit dhe gjetjes së të dhënave me rëndësi historiko-shkencore, me shumë rëndësi është po ashtu edhe përpunimi dhe kombinimi i referencave ndërmjet tyre, gjë që ndihmon në krijimin mozaikut të plotë me të gjitha të gjeturat e veçanta.

Shumë arkiva ofrojnë sot mundësinë e kërkimit në dokumente të digjitalizuara ose në shënime përcjellëse të dokumenteve të arkivuara (meta data). Sidoqoftë, vetëm kërkimi i thjeshtë nuk mund të sjellë rezultate të plota, sikurse që sjell një analizë me metodat moderne të informatikës (p.sh. Data Mining).

Në këtë punim paraqiten rezultatet e punës sonë në një projekt hulumtues në arkivat e Bibliotekës Shtetërore të Bavarisë, në dokumente të vjetra që flasin për historinë dhe gjuhën shqipe. Sidomos të botimeve disa qindvjeçare dhe që nuk janë të transkribuara dhe të lexueshme në mënyrë elektronike. Me këtë rast jemi përqendruar në metodat e aplikimit të informatikës gjatë këtij hulumtimi. Me shembuj të zgjedhur demonstruam përparësitë e hulumtimit në arkiva duke përdorur metoda për analizimin e të dhënave.

Punimin e përmbylim me disa shembuj për historinë e shqiptarëve, të gjetur gjatë hulumtimit, si dhe me prezantimin e prototipit të sistemit informatik që e kemi ndërtuar gjatë projektit, e që mund t'u shërbejë historianëve jo vetëm për të arkivuar të dhënat e gjetura gjatë hulumtimit por edhe për një analizë të tyre moderne.

16. EMA KRISTO: MARTIN CAMAJ DHE TRASHËGIMIA E TIJ ALBANO-LOGJIKE

Ky artikull ka si qëllim të paraqesë trashëgiminë albanologjike të shkrimtarit më të njohur të letërsisë së mërgatës shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XX, Martin Camaj. Së pari artikulli sjell informacione mbi ribotimin e veprës së tij letrare duke e bërë të njohur e të kapshme atë në rrethet e lexuesve në hapësirën shqipfolëse, dhe së dyti fokusohet në Skripta minor duke i ardhur kështu në ndihmë lexuesit specialist për të pasur në dispozicion gjithë trashëgiminë e tij albanologjike. Camaj përshfaqet si albanolog me prurje kryesore në fushat e gjuhësisë diakronike e sinkronike, të filologjisë shqipe dhe të dialektologjisë arbëreshe.

Krahasuar me botimet mbi Martin Camaj, të cilët përqendrohen në jetën e tij, ky artikull ka fokus prezantimin e veprës së tij dhe ribotimin e saj.

Fjalë kyçe: albanologji, ribotim i veprës, Skripta minor, letësi.

18. EVALDA PACI: GUNNAR SVANE: KONTRIBUTE THEMELORE MBI INTERPRETIMIN TEKSTOR E FILOLOGJIK TË VEPRËS SË PJETËR BUDIT

Çështje të studimit tekstor e përmbajtësor të veprës së Pjetër Budit në traditën e gjurmëve albanologjike. P. Budi si autor, shkrimtar e shqipëruar veprash të rëndësishme për kontekstin historik dhe për historinë e shkrimit shqip. Disa çështje të klasifikimit të shqipërimeve të Budit: Doktrina e kërshenë (1618) dhe variantet përkatëse të saj; doracakë të tjerë si Speculum Confessionis dhe Rituale Romanum. Autorë e studime mbi Budin e veprën e tij: Roques, Rrota, Camaj, Çabej, Riza, Zamputi, Ashta, Domi, Lacaj, Ismajli, etj.

Gunnar Svane dhe pikëpamjet e shprehura mbi brendësimin tekstor të Speculum Confessionis të Budit; shtrimi i çështjes së konsultimit të teksteve referenciale për studimin e përmbajtjes së paragrafeve të caktuara nga vepra e sipërpërmendur e Budit. Varianti i plotë i transkribimit të Doktrinë të Budit (1618) përpiluar e pajisur me konkordanca dhe introduktuar nga Svane (Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet, 1985): çështje të konsiderimit të Budit si autor dhe rëndësisë së veprës së tij; çështje të trajtimit të Doktrinë së Kërshenë nga Svane; hollësi të leximit dhe interpretimit grafematik e fonik në tekstet e Doktrinës së Budit; vështirësitë konkrete; zgjidhje dhe variante zgjidhjesh nga ana e Svanes.

Vlera e këtij kontributi të Gunnar Svanes për studimet shqiptare dhe për kontekstualizimin e veprës së Pjetër Budit në historinë e letërsisë së vjetër shqipe. Transkribimi i sipërpërmendur dhe konkordancat përkatëse të Gunnar Svanes si prova të veçanta që marrin vlerë më vete dhe për faktin se plotësojnë një kuadër të rëndësishëm në pikëpamje të përafritimit me studimin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, në tërësinë e së cilës pikërisht

çka përpiloi, përshtati dhe realizoi Pjetër Budi në një hapësirë kohore jo fort të gjatë në një vend të merituar për nga rëndësia, përmbajtja dhe aktualizimi që i ofronte lëvrimit të shkrimit në gjuhën tonë.

19. FLORESHA DADO: FRANC NOPÇA, NGA QASJET ALBANOLOGJIKE TE KRIJIMI POETIK

I njohur si një ndër albanologët më të shquar, me studime të rëndësishme në fusha si gjeografia, e drejta zakonore shqiptare, kontribute për paraqistorinë dhe etnologjinë e Shqipërisë së Veriut, etj. Franc Nopça shfaqet papritur në një fushë të re krijimi, atë të poezisë. Një vëllim me vjersha, dorëshkrim, mban titullin ‘Poezi’ të Kolec Markut (“GEDICHTE” 1895-1932 me gjithsej 167 vjersha dhe 105 faqe të daktilografuara (pjesa e parë titullohet *Lirika*; pjesa e dytë *Në Karpate*; pjesa e tretë *Philosophie*; pjesa e katërt *Tregime të shkurt-ra*; pjesa e pestë *Nga Shqipëria* dhe pjesa e gjashtë *Tregime të gjata*.); një cikël i kushtohet Shqipërisë, zbulon një botë sa të veçantë, interesante dhe të papritur të këtij studiuesi të shquar. Në kumtesë do synohet të gjendet lidhja e brendshme midis studiuesit, udhëtarit të apasionuar mbas botës shqiptare të zonave të veriut dhe trillimit poetik, për të kuptuar se sistemi i të menduarit të këtij albanologu është më kompleks. Raporti midis hetimit, vëzhgimit të një realiteti të ri dhe përjetimit emocional të këtij realiteti (sidomos në ciklin kushtuar Shqipërisë) është tepër special dhe tërheqës për çdo studiues apo dhe lexues të zakonshëm.

Poezitë e Nopçës zbulojnë një poet thellësisht lirik e romantik, të pakënaqur nga realiteti i kohës, me dëshirën për t’u larguar në një “atdhe të dytë”, ku mund të gjente qetësi shpirtërore, madje duke pranuar dhe një jetë bohemi, në gjirin e natyrës. Përjetimet poetike vijnë si refleks i një vëzhguesi të mprehtë, të dashuruar me kërkimin në terren, me pasionin e hetimit deri në thellësitë e historisë, por dhe me lirinë që ofron jeta e malësisë. Kjo lidhje midis shkencëtarit dhe poetit zbulon një personalitet sa kompleks, aq interesant.

20. FRANCESCO ALTIMARI: “ZBULIMI” I DE RADËS DHE I ARBËRESHËVE NGA ALBANISTIKA GJERMANE GJATË SHEKULLIT XIX

Autori përqendrohet në këtë kumtesë mbi praninë e Arbëreshëve, të gjuhës dhe të kulturës së tyre, në veprat e botuara në vendet gjermanishtfolëse gjatë shekullit XIX që prej vepërës së Adelung-ut *Mithridates oder allgemeine Sprachkunde* (Berlin, 1806-17) deri në *Albanesische Studien* (1897) të lingvistit të shquar austriak Gustav Meyer-it, duke u marrë edhe me “zbulimin” e De Radës dhe të tërë lëvizjes kulturore arbëreshe të Rilindjes nga studiuesi zviceran Gottlieb Stier (1825-1896), që për herë të parë botoi një pjesë të krijimtarisë letrare të Poetit të Maqit në gjermanisht, duke favorizuar kështu njohjen e letërsisë së sapolindur romantike arbëreshe në botën kulturore gjermane.

21. GËZIM HOXHA: OPTIKA E THEODOR IPPEN-IT MBI ULTËSIRËN BREGDETARE TË SHQIPËRISË KUNDREJT REZULTATEVE TË SOTME TË ARKEOLOGJISË

Konsulli i përgjithshëm i Austrohungarisë në Shkodër në vitet 1897-1904 Theodor Anton Ippen mund të renditet pa mëdyshje në gjeneratën e studiuesve shumë të njohur të historisë dhe arkeologjisë së Shqipërisë së Veriut në fundshekullin XIX dhe fillimet e shekullit të XX. Krahas arkeologëve si Patsch, Praschniker dhe Schober, gjuhëtarëve Weigand, Pedersen dhe Jokl, historianëve Thaloczy, Jireček dhe Šufflay dhe etnologut Franz Nopsca, Theodor Ippeni ka krijuar një vepër bazike për historinë mesjetare dhe arkeologjinë e Shqipërisë së Veriut. Kontributet e këyre autorëve u bënë nxitja dhe mbështetja e sigurt për kolek-

sionistët e parë të arkeologjisë shqiptare si At. Shtjefën Gjeçovi, At. Gjergj Fishta, Lef Nosi dhe Eqrem bej Vlora. Mbi këtë përvojë të vyer e filloi punën me sukses edhe gjenerata e parë e arkeologëve shqiptarë Hasan Ceka, Skënder Anamali, Selim Islami e Frano Prendi.

Duke u bazuar në 25 kontributet me vlerë të Ippenit për Historinë e Shqipërisë, veçanërisht për ultësirën bregdetare të Shqipërisë Veriperëndimore, në këtë punim janë bërë përpjekje për një ballafaqim të këtyre rezultateve me arritjet e derisotme të kërkimeve arkeologjike në këtë territor. Bëhet fjalë për kërkimet në qytetet antike dhe mesjetare të Shkodrës, Lezhës, Krujës, Shasit Drishtit dhe Shurdhahut, për gjetje të veçanta arkeologjike nga fushat e prehistorisë dhe të antikitetit, për shumë gjurmë kishash mesjetare, ku spkasin kishat e Shirqit, Rubikut dhe në kepin e Rodonit etj.

Nëpërmjet këtij ballafaqimi hidhet dritë mbi veprën e Ippenit si një gur themeli në kërkimin shkencor dhe si një burim i vazhdueshëm informativ. Kjo vepër vazhdon të gjenerojë edhe sot indicie produktive në kërkimin shkencor historik dhe për kërkimet aktuale arkeologjike në territorin e Shqipërisë Veriore.

22. GIOVANNI BELLUSCIO, EMILIA CONFORTI: "ANKETAT E GERHARD ROHLFS-IT PËR ATLASIN AIS, ORGANIZIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE PREJ RUPPRECHT ROHR-IT, ANKETAT E MËTEJSHME TË GABRIELE BIRKEN-SILVERMAN-IT NË PIKËN 751 DHE NË MJEDISIN ARBËRESH NË PËRGJITHËSI."

Në vitin 1924 Gerhard Rohlf s mbërriti në të voglin katund arbëresh të Firmozës (Acquafamosa, Pika 751) në provincën e Kozencës si anketues i Atlasit gjuhësor të Italisë dhe të Zvicërës së jugut (AIS) të Jaberg-ut dhe të Jud-it. Ai nuk kishte njohuri as për shqipen dhe as për arbërishten dhe mbledhja e materialit gjuhësor, megjithëse me vlerë për dialektologjinë, përfaqëson një "casus sui generis". Pas tridhjet vitesh një tjetër gjerman, Rupprecht Rohr u afrohet materialeve të Rohlf-sit dhe i bën objekt të disertacionit të tij në fillim të viteve '50 të shekullit XX. Por, përpos sistematizimit të materialeve dhe të botimit të një serie artikujsh, ai nuk korrigjon disa prej aspekteve më problematike të punës në terren të Rohlf-sit, edhe pse Rohr-i (me sa duket) e bëri studimin e tij pa vizituar katundin dhe pa dëgjuar të folmen e Firmozës. Në vitet 80-90 të shekullit të kaluar Gabriele Birken-Silvermann, studente dhe bashkëpunëtoare e Rohr-it, fillon anketat e saj në terren në disa katunde arbëreshë të Kalabrisë dhe të Sicilisë dhe jep kontributin e vet sidomos në fushën e leksikologjisë, d.m.th. prapë në fushën fillestare të Rohlf-sit dhe të Atlasit, duke e mbyllur kështu rrethin. Në punimin tonë do të trajtojmë historinë gjuhësore që u zhvillua gjatë viteve rreth Pikës 751 të AIS-it dhe do të analizojmë dhe të diskutojmë në hollësi ndihmesën e këtyre tre gjuhëtarëve gjermanë për dialektologjinë dhe leksikografinë arbëreshe.

23. GIUSEPPINA TURANO: KONTRIBUTI I STUDIUESVE GJERMANË PËR DIALEKTOLOGJINË ARBËRESHE

Studimet për dialektologjinë arbëreshe fillojnë në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë në shkollën austriake në Vjenë me Gustav Meyer-in. Aty vazhdojnë me një albanolog austriak tjetër, Maximilian Lamberg-in dhe më vonë me studiuesit Norbert Jokl dhe Eqrem Çabej. Këta studiues na kanë lënë të parat përshkrime të të folmeve arbëreshe, sidomos nga pikëpamja leksikore. Përshkrime më të plota për strukturën gramatikore të arbërishtes na vijnë nga studiues gjerman si Rupprecht Rohr, nga Universiteti i Berlinit dhe Martin Camaj nga Universiteti i Mynihut. Interesimi për studimet arbëreshe në botën gjermane vazhdon me studiues më të rinj si Gabriele Birken-Silverman, nxënëse e Rohr-it dhe Walter Breu dhe Elvira Glaser, nxënëse të Martin Camaj-t. Këta janë marrë sidomos me kontaktet e arbërishtes me gjuhën italiane, më situatën gjuhësore në fshatrat arbëreshë, me va-

riacionin gjuhësor, me dinamikat sociolinguistike. Të pakta mbeten studimet në fushën e sintaksës.

24. GJOVALIN SHKURTAJ: STUDIME PËR KONTAKTIN E SHQIPES ME GJERMANISHTEN NË KANTONIN GJERMANIK TË ZVICRËS DHE NË AUSTRI

Mbijetesa e diasporave në vende të huaja ka pasur si shprehje kryesore ruajtjen e gjuhës. *Vështrimi i shqiptarëve, i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në kontekstin e Evropës Juglindore, siguron mundësinë e vështrimit integral dhe patjetër më thelbësor të kulturës shqiptare*. Rasti më emblematik, pa dyshim, edhe pas pesëqind vjetësh, mbetet diaspora apo elementi arbëresh në Italinë e Jugut e në Sicili, si dhe arvanitët në Greqinë ishullore, pastaj edhe ngulime të tjera, si arbëreshët e Zarës (Kroaci), shqiptarët e Mandricës (Bullgari), të Ukrainës etj. që diheshin dhe kishim më shumë njoftime, po edhe në diasporat më të reja, qoftë edhe më pak unitare e të shprishura, por gjithsesi të rëndësishme për t'u studiuar si ato të shqiptarëve në Zvicër, Austri, Gjermani etj.

Gjatë një periudhe tashmë gati njëzetvjeçare kam pasur rastin të kem qenë në lidhje me disa prej studiuesve zviceranë dhe shqiptarë, që merren me studimin dhe mësimdhënien e shqipes në Zvicër e në Austri, kryesisht në kuadër të projekteve për udhëheqjen e dy temave studimore: një studim doktorati të punuar me drejtimin tim nga Basil Schader: "Shqyrtime gjuhësore rreth kontaktit mes shqipes dhe gjermanishtes në Zvicër" (1991-2005), pastaj një temë studimi për "Master në gjuhësi" nga Miradije Berishaj, si dhe kam kryer dy udhëtime studimore afatshkurtra në Zvicër. Mbi bazën e asaj përvoja dhe bashkëpunimi me studiuesit e lartpërmendur, në kumtesën time do të pykëzohem në këto pika kryesore:

1. Situata e sotme e shqipes në Zvicër e në Austri, sipas arritjeve e paraqitjes së bërë në studimet e B.Schader e të Miradije Berishajt.

2. Probleme teorike dhe pragmalinguistike të shqipes në diasporën e re shqiptare në Zvicër e në Austri, si dhe në planin e përgjithshëm të shqipes si gjuhë e emigracionit shqiptar në dhe të huaj.

3. Aspekte sociolinguistike të shqipes së diasporës në Zvicër e në Austri, ku do të sjellim vlerësime dhe konsiderata të përgjithshme me karakter sociolinguistik lidhur me dy boshte kryesore sociolinguistike: përzierja e kodeve (*cod-mixing*) dhe prishja e kodeve (*codeswitching*) në mjediset e diasporës shqiptare në Zvicër e në Austri, si dhe do të parashtrijmë disa përfundime, duke iu qasur një vargu faktorësh sociologjikë, politikë dhe kulturorë e sidomos metalinguistikë, që përbëjnë shtyllat e trajtimeve të sotme sociolinguistike dhe të "etnografisë së të folurit", apo "etnografia e komunikimit". Në shtjellimet e kumtesës sonë, do t'i përmbahemi një trajtimi që na shpie në disa përfundime të përgjithshme, duke ndjekur shkallëzimin (*item-et*) e figurës së mëposhtme:

- Gjuhë a "kombëtare" ose gjuhë zyrtare e vendit a kombit ku ndodhen sot shqiptarët në Evropë (në përgjithësi) dhe në Zvicër (në veçanti);

- Gjuhë e "origjinës"/ gjuhë e parë; Varieteti/dialekti i gjuhës së parë; Gjuhë krahinore ose gjuhë e pakicës; Gjuhë të tjera: nivele të ndryshme kompetence: tipe të ndryshme kompetence të pjesshme; mundësia për shumëkuptueshmëri, të cilat, në fakt, edhe i kemi prekur, përfillur e shtjelluar dhe më parë. (Sociolinguistikë e shqipes, Nga dialektologjia te etnografia e të folurit, Tiranë, 2009).

Sigurisht, secila nga dukuritë që lidhte me *item-et* e mësipërme, ka nevojë të shihet në lidhje me një varg piketash të mirënjohura të sociolinguistikës së sotëm e pikërisht:

Probleme të veçanta të dy- dhe shumëgjuhësisë. Zakonisht përkufizohet si dy- apo shumëgjuhësi situata gjuhësore e krijuar nga dy ose më shumë gjuhë që bashkekzistojnë, të lidhura nga një formë e caktuar e shoqërisë ose në kontakt të vazhdueshëm për shkak të

interesave politike dhe ekonomike.

Deri më sot, problemet themelore që është dashur të përballojë studimi i dygjuhësisë janë katër:

- (a) Në ç'shikallë folësit janë dygjuhësh (bilingë)? Cili është niveli i zotërimit të një gjuhe dhe i tjetrës nga përdoruesit e saj?
- (b) Në çfarë funksionesh folësit përdorin dy gjuhë? Në ç'raste përdorin njëren dhe në ç'raste tjetrën?
- (c) Në çfarë mase dygjuhëshit e ndërrojnë gjuhën e tyre? Në ç'kushte gjuhët në kontakt i këmbejnë (alternojnë) dy gjuhët?
- (d) Në çfarë mase dygjuhëshit i përdorin të dy gjuhët veç e veç ose i përdorin ato në mënyrë të integruar, si një sistem të vetëm? Çfarë dukurish të ndërmikimit shfaqen në përdorimin e këmbëshëm të dy gjuhëve? Cila është trysnia e përdorimit të një gjuhe mbi tjetrën?

Janë shtuar e po shtohen rastet që shqipja në gojën e shqiptarëve jashtë vendit mbetet në k uadrin e një gjuhe "të ngushtë familjare", mbetet një gjuhë e mjedisit të ngushtë, përballë gj uhës së huaj të vendit ku janë integruar, që përbën gjuhën e komunikimit jashtë shtëpisë, në punë, në shkollë etj. Kështu, tashmë edhe janë përfutur dy anë të këtij procesi të dy-e shumëgjuhësisë: "gjuha e bukës" apo "gjuha e punës" që do të thotë gjuha e madhe, gjuha e vendit, që është gjuha amtare e kombit pritës, në rastin tonë gjuha gjermane e popullsisë zviceranë vendase (qoftë edhe në formën dialektore), dhe "gjuha e zemrës" apo gjuha e mjedisit të ngushtë familjar shqiptar, në mjedisin zviceran ose edhe në raste të tjera takimesh a shkëmbimesh miqësore me shqiptarë, të ardhur e të shpërngulur në Zvicër, si dhe në rastet e komunikimit me vizitorë që vijnë nga Shqipëria a viset shqiptare të Ballkanit, sidomos nga Kosova dhe Maqedonia.

Përfundimi apo konkluzioni ynë paraprak është se ajo që sjell një studim, sa i gjerë aq edhe i shtjelluar e i lidhur me problematikën e ndikimeve shoqërore në gjuhën e emigrantëve shqiptarë në një mjedis të huaj, si ai i Zvicrës, po edhe i Austrisë, është s i kapilaret e gjakut arterial dhe atij venoz në organizmin e ndërlikuar të njeriut e të qenieve të gjalla, i cili **qëndron midis dy kohëve** dhe përkatësisht **dy mënyrave të ndryshme e të larmishme**: të njëgjuhësisë (unilinguizmit) ose të folurit vetëm në gjuhën e vet amtare dhe të folurit (përkat. të shkruarit) në dy gjuhë të ndryshme (në kuadrin e bilinguizmit a dygjuhësisë) dhe të disa ose shumë gjuhëve të ndryshme, në kuadrin e pluralinguizmit apo multilinguizmit.

25. HAXHI SHABANI: FJALORTHI I ARNOLD VON HARFF-IT JO VETËM NJË NGA DOKUMENTET E PARA TË GJUHËS SHQIPE

Në këtë kumtesë trajtohet roli pionier i një gjermani në historinë e shkruar të gjuhës shqipe, i Fjalorthit të Arnold fon Harffit, i cili për nevoja vetiake në një udhëtim ngan Ulqini, deri në Durrës mbloodhi fjalë të përdorimit të përditshëm të gjuhës shqipe dhe i botoi duke dhënë edhe adekuatet e tyre në gjermanisht, në vitin 1496. Ky Fjalorth analizohet në frymën e një prej dokumenteve të shkruara të shqipes, i cili nuk ka vetëm një rëndësi se është një nga dokumentet e para. Fjalorthi, para së gjithash, në mënyrë të drejtpërdrejtë deshmon për gjendjen e gjuhës shqipe të atëhershme, pra i rëndësishëm për historinë e shqipes së shkuar. Së dyti, Fjalorthi shënon dokumentin e dytë të rëndësishëm të shkruar në një trevë të shqipes së lashtë, në Ulqin, që së bashku me dëshminë e vitit 1332 në Tivar të atë Brokardit - se shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme prej asaj të latinëve dhe Librin e parë të gjuhës shqipe, "Mesharin" e Buzukut, në vitin 1555, dëshmojnë se rrënjët e shqipes së shkruar janë pikërisht në trevat e Ulqinit e Tivarit. Së treti, me Fjalorthin fillon historia e leksikografisë shqiptare e cila nis të përballojë ballafaqimin me gjuhë të mëdha, siç është gjermanishtja. Dhe së katërti, autori i Fjalorthi nëse jo i pari është ndër të parët gjermanë që

interesohen për gjuhën shqipe.

Fjalët çelës: fjalorth, A. fon Harf, dokumentet e para, gjuhë shqipe, Ulqin.

26. HEINER EICHNER: ZHVILLIMI I STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE NË KUADRIN E GJUHËSISË INDOEVROPIANE GJERMANOFONE - NJË PERSPEKTIVË AUTOBIOGRAFIKE

Profesor Eichner, një nga indoeuropianistët e njohur që është marrë dhe me çështje albanologjike në këtë kumtesë do të flasë për studimet e tilla në botën gjermanofone të kohës sonë nga perspektiva autobiografike dhe kjo do të thotë se do të flasë dhe për preokupimet indoeuropiane-albanistike të një rrethi më të gjerë idesh dhe personalitetesh, përfshirë studiuesit në Vjenë, grupin rreth Klingenschmitt në Erlangen, të interesuarit në München apo Innsbruck, etj. [Red.ë

27. HELMUT WILHELM SCHALLER: DER LEIPZIGER BALKANOLOGE GUSTAV WEIGAND UND DIE ALBANOLOGIE IN DEUTSCHLAND.

Die Anfänge der Albanologie in Deutschland sind im 19. und zu Beginn des 20. Jahrhunderts zu finden. Sie sind verbunden mit Josef Ritter von Xylander, Johann Gottfried Herder, Franz Bopp, August Schleicher und Gustav Weigand, aber auch mit dem Münchener Sprachwissenschaftler Johann Andreas Schmeller. Josef Ritter von Xylander (1794-1854), bayerischer Offizier in Griechenland kam dort mit albanischen Bevölkerungseilen in Kontakt und veröffentlichte 1835 in Frankfurt am Main seine Abhandlung *“Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren”*, mit der sich aus sachkundiger Sicht Johann Andreas Schmeller (1785-1852) in einer Abhandlung zu Xylanders Buch in den *“Gelehrten Anzeigen”* im Jahre 1836 in München auseinandersetzte.

Der Leipziger Romanist und Balkanphilologe Gustav Weigand (1850-1930) hatte im Jahre 1913 seine *“Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt (Durazzo, Elbasan, Tirana)”* veröffentlicht, der kurz darauf im Jahre 1914 noch ein Wörterbuch unter dem Titel *“Albanesisch-deutsches und deutsch-albanesisches Wörterbuch”* folgte. Weigand hatte in seiner zahlreichen balkanphilologischen Abhandlungen immer wieder auf das Albanische Bezug genommen. In den Jahren. In dem von Weigand begründeten und 1925 bis 1929 herausgegebenen *“Balkanarchiv”* waren immer wieder neben dem Rumänischen und Bulgarischen auch das Albanische berücksichtigt worden. Anfang 1925 beantragte Weigand die Einrichtung eines *“Albanischen Seminars”* bei der Philosophischen Fakultät der Universität Leipzig, ein Vorschlag der die Zustimmung der Universität fand.

28. IMRI BADALLAJ: KONTRIBUTI I CLAUD HAEBLER-IT MBI TË FOLMEN ARBËRORE TË SALAMINËS

Vendosja e kolonive arbërore në regjionet greke është bërë mjaft herët, por pjesa më e madhe e tyre i dedikohet periudhës midis shekujve XI-XV, që u shpërndanë pothuajse në tërë Greqinë, duke mos munguar edhe në pjesët ishullore të saj, si: në Atikë, Eube, Peleponez, More, Trizinë, Salaminë, Hydra, Poros, Specia e në shumë vise të tjera të ishujve anë e kënd Greqisë.

Si të tillë që ishin arbërorët e Greqisë, me kohë ua kanë tërhequr kërshërinë shumë studiuesve të huaj, si: albanologëve, historianëve, sociologëve, etnologëve, demografëve, kulturologëve e të tjerëve. Gjatë shekullit të kaluar e këndeje edhe vetë studiuesit arbërorë filluan të merren me hulumtime shkencore nga segmente të ndryshme.

Ndër të parët po përmendim J. G. Hahnin me studimin e tij: *Albanische Studien* (1854), i cili shkruante se 1/3 e banorëve të Greqisë janë arvanitë (arbërorë). Të tjerët, që në shumë sfera u morën rreth tyre janë: G. Weigand, G. Meyer, A. Galant, C. H. Reinhold, A. P. Fu-

riqi, C. Tagliavini, H. J. Sasse, C. Haebler, P. Tragdil, Zavaras, A. Belushi, Gj. P. Gjika, I. Birik, T. Jochalas etj. Edhe A. Kostallari kishte botuar në Studime filologjike, nr. 1 1987 një shkrim: Disa veçori të arbërishtes së ngulimeve të Atikës.

Gjuhëtari gjerman Claus Haebler më 1965 në Wiesbaden botoi monografinë me titull: Grammatik der albanischen Mundart von Salamis, që në mënyrë të hollësishme në pjesën e parë shtron dhe shpjegon sistemin fonetiko-fonologjik me të tëra dukuritë gjuhësore të shkaktuara në kuadrin e eptimit të fjalëve dhe të realizimit të tyre në kushte të caktuara të përdorimit në sintagma e togfjalëshave gjatë rrjedhës së të folurit brenda kësaj idiome dialektore.

Pjesa e dytë e monografisë pasqyron dhe shpjegon në tërësi sistemin gramatikor, që janë vënë në dukje shumë veçori ruajtëse nga fazat më të mëtejme të karakterit morfologjik e sintaksor të gjuhës shqipe.

Rezultatet shkencore të arritura në këtë monografi dhe në studime të tjera Haebler-in e ka ndihmuar njohja e shkelqyeshme e latinishtes dhe e greqishtes. Gjithashtu, ky me kohë i zotëronte fort mirë teorinë gjuhësore, të cilat ishin aktuale, që disa prej tyre posa kishin filluar të aplikoheshin. Sidomos strukturalizmin e kishte më për qejfi, prandaj në studimet e shqipes është ndër të parët e aplikimit të metodologjisë strukturaliste në studimet me karakter dialektor, e që më pas vjen e bëhet puna e tij shkencore model për një numër të konsideruar gjuhëtarësh.

29. IZER MAKSUTI: VJENA SI VATËR E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Me qëllim të përkufizimit të temës, në këtë kumesë, do të ndalemi vetëm te studimet albanistike, për të gjetur gjurmë nga tradita e madhe e albanologjisë në Vjenën e dikurshme si kryeqendër e perandorisë Austro-Hungareze. Me po aq interes është vazhdimi i asaj tradite në mes të dy Luftërave Botërore dhe në pjesën e dytë të shekullit XX, si dhe gjendja e këtyre studimeve në Vjenën e sotme. Do të përmenden përfaqësuesit më të dalluar dhe kontributi i tyre për studimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, si Hahn, Miklosich, Pekmezi, Jokl, Lambertz, Solta, Schwanke, Eichner, Schumacher, Matzinger etj. Dallohen veçmas studime të thella për historinë e shqipes, prejardhjen, si dhe veçoritë dialektore të saj. Duhet përmendur edhe pesha e koordinimit nga Vjena për Komisinë Letrare të Shkodrës dhe ndihmesa e përfaqësuesve si M. Lambertz, Gj. Pekmezi e R. Nahtigal.

Me interes është sidomos mësimi i gjuhës shqipe në Vjenë, lektorët e shqipes në Universitetin e Vjenës (Kolë Rrota/ Nikolaus Rotta, Karl Treimer, Skënder Gashi, Kurt Gostenchnigg, Ina Arapi), si dhe gjendja e interesimi i sotëm për shqipen, mësimi i saj nga të huajit dhe vetë shqiptarët atje.

Së fundi, si pjesë e kësaj tradite vlen të përmenden studiues shqiptarë - frymëzuar, motivuar dhe shkolluar në Vjenë - duke nisur nga E. Çabej, S. Gashi, A. Skenderi, I. Maksuti, I. Arapi, V. Hamiti, K. Canaj, etj; po ashtu edhe studentët e doktorantët të shumtë shqiptarë në Universitetin e Vjenës, me tema me qasje krahasimtare. Me po aq interes është, përveç njohjes me aktivitetet e tyre në Vjenë, edhe debati rreth kontributit të tyre në albanistikë, dhe sot.

Fjalë kyçe: Albanistikë, albanologjia gjermane, mësimi i shqipes në Universitetin e Vjenës, studentët shqiptarë në Vjenë

Bibliografia (përzgjedhje)

- AKTEN, Akten des internationalen albanologischen Kolloquiums zum Gedächtnis an Norbert Jokl in Innsbruck, 1972. Hrsg. von Hermann M. Ölberg, Innsbruck 1977. 784 S. (= Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft, Sonderheft 41)
- Arapi, Ina (2014): Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës (fundi I shek. XIX - 2010) - STUDIME. Revistë për studime filologjike. 20, Prishtinë: ASHAK, 2013, f.

107-143.

- Asllani, Uran (2000): Studentët Shqiptarë të Austrisë dhe veprimtaria e tyre. Tiranë: 2000.
- Gostentschnigg, Kurt (1990): Der Anteil der österreichisch-ungarischen Wissenschaft an der Erforschung Albaniens. Graz.
- Gostentschnigg, Kur (2013): Die Aktivitäten der albanischen StudentInnen in Österreich bis 1939. - Poeta nascitur, historicus fit - Ad honorem Zef Mirdita, Albert Ramaj (ed.), St. Gallen – Zagreb, f. 1123-1145.
- Haas, Otto: Österreichs Anteil an der Entwicklung der Balkanlinguistik und Albanologie. In: AKTEN (1977), fq. 22-34.
- Hetzer, Armin (1985): Zur Geschichte der deutschsprachigen Albanologie: 150 Jahre seit Erscheinen von Josef Ritter von Xylanders Handbuch des Albanischen (1835), Balkan-Archiv, Neue Folge, 10 (1985), f. 179-217.
- Maksuti, Izer (2013): Ein kurzer geschichtlicher Überblick der deutschsprachigen Albanologie. - Poeta nascitur, historicus fit - Ad honorem Zef Mirdita, Albert Ramaj (ed.), St. Gallen – Zagreb, fq. 849-860.
- Maksuti, Izer (2017): Rreth kontributit të hulumtuesve austro-hungarezë për gjuhën shqipe. Shkup: Logos-A, f. 135-147. – Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: “Marrëdhëniet e popullit shqiptar me Austro-Hungarinë (Austrinë), nga mesi i shek. XIX deri në ditët tona”. Prishtinë 9 shtator 2016.
- Pfeiffer, Oskar E. (1996) 2001ë: 75 Jahre Institut für Sprachwissenschaft in Wien – und wie es dazu kam. - Die Sprache, Zeitschrift für Sprachwissenschaft, Band 38, Heft 3 (Sonderheft). Chronicalia Indoeuropaea 3, f. 3-70.

30. JANI THOMAI: LEKSIKOGRAFIA DYGJUHËSHE E SHQIPES ME GJERMANISHTEN

Nga një studim i mëparshëm, “*Shqipja me gjuhë të thera në leksikografi*”, janë huazuar një pasqyrë e renditjes së fjalorëve dygjuhësh të shqipes me gjuhë të tjera dhe disa ide, të cilat përshtaten me objektin shkencor të kësaj kumtese dhe japin mundësi të përqaset e të shihet vendi që zë leksikografia dygjuhëshe e shqipes me gjermanishten në këtë renditje.

Në leksikografinë dygjuhëshe, fjalorët e shqipes me gjermanishten kronologjikisht, nga koha e fjalorit të parë (1835), zënë vendin e katërt, pas latinishtes (1635), italishtes (1702) dhe shumëgjuhësh, kryesisht terminologjikë, përfshirë edhe gjermanishten (1762), kurse numerikisht (36) zënë vendin e tretë, pas fjalorëve shumëgjuhësh (përfshirë edhe gjermanishten), shumica terminologjikë (98) dhe me anglishten, shumica mësimorë (71); ndryshe, mund të themi se zënë vend të parë si fjalorë shkencorë.

Edhe për fjalorët shqip – gjermanisht e anasjellas mund të shënojmë disa veçori tipologjike leksikografike: Ka fjalorë të vegjël, të mesëm e mbimesëm, shqip – gjermanisht e gjermanisht – shqip, nga autorë shqiptarë e të huaj, përgjithësisht leksikorë. Këtu kemi veçuar, si objekt analize leksikografike, “*Fjalorin shqip – gjermanisht*” (*Wörterbuch albanisch – deutsch*), i hartuar nga Oda Buchholz, Wilfried Fiedler dhe Gerda Uhlisch (Berlin, 1992, 739 f.). Ky fjalor pasuron leksikografinë dygjuhëshe të shqipes me gjermanishten, e cila është një fill i fortë i lidhjes së albanologjisë me gjermanistikën dhe pjesë e rëndësishme e përmbajtjes së tyre, jo vetëm në kundërvënien e fjalëve si leksema “të pastra”, por, më gjerë, edhe përtej kufijve të leksikut si lëndë e të leksikologjisë si fushë studimi.

Në kumtesë sillen pak shembuj për disa tipare të përgjithshme e të veçanta sipas formatit leksikografik të një fjalori dygjuhësh. Natyrisht, analizat dhe interpretimet bëhen vetëm mbi glosarin shqip të *Fjalorit*, ndërsa çështja e identitetit leksiko-semantik ndërmjet shqipes e gjermanishtes, çështje shumë më e vështirë, kërkon një studim më vete. Çfarë vërehet qartë në tri fusha kryesore: Në leksik, në gramatikë dhe në drejtshkrim.

1. *Në leksik* vihen re dy dukuri:

a) *Përpjesëtimi i shtresave leksikore* sipas normës gjuhësore, sipas fushave konceptore dhe sipas rrafshëve të gjuhës shqipe është *përgjithësisht i drejtë*. Glosari shqip është i përgjithshëm e normativ, por përmban edhe disa fjalë dialektore, kryesisht të fushës së etnokulturës rurale, si dhe mjaft variante fjalëformuese dialektore, herë vetëm e herë me variantin normë. Ndërkaq, pohohet që me shumësinë e fjalëve të kësaj shtrese leksikore *Fjalori*, edhe pse e kapërcën disa funksionin informues, u ka hapur vend në të njëjtin rrafsh me fjalët e tjera si lëndë e përligjur, sipas autorëve, me vlera të nevojshme njohëse për përdoruesit e botës gjermane të këtij fjalori. Po kështu, në *Fjalor* janë përfshirë edhe disa fjalë të huaja, që sot nuk përdoren ose kanë përdorim shumë të kufizuar në stile të veçanta gjuhësore a rrethe të ngushta sociale e profesionale, si dhe disa fjalë të huaja e terma specifike që i kapërcejnë kufijtë e një fjalori me këtë vëllim e me destinacion të përcaktuar nga tipi i tij dygjuhësh, po ashtu disa orientalizma të vjetruar, shumë emra të përveçëm, që nuk kanë vend në këtë tip fjalori. Nga ana tjetër, ka mungesa të ndjeshme në sistemin leksikor e fjalëformues. Mungojnë mbiemra të zakonshëm prejpjesorë dhe emëzimet e tyre, edhe kur janë përfshirë foljet dhe emrat foljorë përkatës, edhe kur këta mbiemra kanë zhvillime semantike drejt kuptimeve të figurshme, duke krijuar kështu asimetri brenda çerdheve fjalëformuese. Mungesa e disa parashtesave me kuptim kodifikues të specializuar ka krijuar një shpërpjesëtim të klasave leksiko-gramatikore të formuara me ato (shih formimet me *anti-, auto-, ç-, mos-, pa-, para-, ri-, sh-, zh-* etj.).

b) *Fjalori është normativ*, i përligjur e funksional nga vendi që zënë *fjalët me strukturë të gjerë semantike*, me shumë njësi frazeologjike, me leksematikë e sintagmatikë të zhvilluar e me togfjalëshat terminologjike.

2. *Në gramatikë* trajtohen veçanërisht dy dukuri:

a) Mungesën e paskajores sintetike në sistemin e strukturës gramatikore të shqipes standarde e vuan, më shumë se struktura sintaksore, leksikografia, e detyruar të zgjedhë e të pranojë një trajtë foljore përfaqësuese si leksemë. *Trajta përfaqësuese e foljeve*, që është zgjedhur si leksemë a si njësi leksikografike këtu është *veta III njëjës e kohës së tashme në mënyrën dëftore*, një zgjedhje shkencore origjinale.

b) Dihet që sistemësia a sistemorësia është kriter absolute për çdo fjalor në të gjithë përbërësit e tij, veçanërisht në fushë të gramatikës, njëherazi kriter shumë i vështirë për t'u zbatuar plotësisht. Por ndodh që edhe *zbatimi mekanikisht i kriterit të sistemit çon në thyerje të tij*, si, f.v., në paradigmen gramatikore kryesisht të disa foljeve, kur nuk mbahet parasysh semantika leksikore ose përdorimi ligjërimor. Në *Fjalor* janë dhënë si tituj leksikografikë edhe trajta gramatikore fjalësh, kur janë supletive, të parregullta ose me ndryshime fonetike të thella në eptim.

3. *Në drejtshkrim Fjalori* ndjek rregullat e standardit, por jep edhe disa variante fonetike sipas shqiptimit në ligjërim të zakonshëm. Në rrafshin e dialekteve *Fjalori* jep pak variante drejtshkrimore, kryesisht me alternancën *ë/e*, ndërkaq nuk jep variante dialektore me 5-6 alternancat fonetike dalluese kryesore kategoriale, si *d/ë, n/r, ue/ua, vo/va, me asimilim të grupeve zanore e bashkëtingëllore*, si edhe me paskajoren e gegërishtes.

Me disa fjalë më të përgjithshme dialektore, me fjalët e huaja (edhe orientale) me gjerësi e frekuencë të ngushtë përdorimi në shqipen e sotme standarde, me variantet fonetike e fjalëformuese të disa fjalëve, me emrat e përveçëm, me trajtat e parregullta ose supletive të disa fjalëve të eptueshme *Fjalori* plotëson funksionin informues për variacionet gjithësi pranë standardit edhe nga mënyra e shpjegimit me referim, çka mbështet gjykimin që *ai është hartuar me destinacion për përdoruesin gjermanishtfolës*, pa ia mohuar vlerat edhe për përdoruesit shqipfolës, veçse vëllimi i tij është i pamjaftueshëm për t'i paraqitur të gjitha rastet të plota e në sistem, pa krijuar mungesa të ndjeshme në çdo dukuri, që e theyejnë gjithësi sistemorësinë.

31. JONIDA XHYRA-ENTROF: PËRTHYERJE TË KULTIVUARA NË ALBANOLOGJI

Duke ndërmarrë një udhëtimi të largët në moshën 22 vjeçare baronesha bavareze Marie Amelie von Godin qysh në pikënisje të jetës së saj del jashtë kornizave konvencionale të kohës në pozicionimin shoqëror si femër, lidhur me një aktivitet që edhe në prag të shekullit 20 rëndom kryhej nga meshkujt. Interesi i saj për Shqipërinë, që merr shkas pikërisht nga udhëtimi i mësipërm, përfshin disa fusha njëherësh. Ajo nuk ishte thjesht njohëse e shkelqyer e gjuhës dhe e vendit, por dëshmitare okulare e ngjarjeve të rëndësishme historike në Shqipërinë e gjysmës së parë të shekullit 20 dhe reportere e këtyre ngjarjeve. Me aktivitetin e saj të shumanshëm intelektual dhe shoqëror si gazetare, shkrimtare, përkthyes, historiane, etnografe, leksikografe, aktiviste në lëvizjen për emancipimin e gruas dhe bamirëse, edhe pse për fat të keq jo shumë e njohur në të gjitha këto përfyerje të kultivuara të një intelektualeje të kompletuar, Godin ofron një kontribut tepër original në kulturën shqiptare.

32. KIMETE CANAJ: ROLI I PROFESOR PROF. HERMANN ÖLBERG-UT NË STUDIMIN DHE PROMOVIMIN E GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE

Kontributi i studiuesve austriakë për studimin dhe promovimin e gjuhës shqipe është një rast unik, i cili do të paraqitet përmes hulumtimit të bërë nga Hermann Ölberg deri te Joachim Matzinger.

Në këtë punim do të analizohet dhe shqyrtohet metodologjia e punës së këtyre dy studiuesve austriakë, si dhe kontributi i tyre reciprok tek studiuesit e rinj shqiptarë në universitetet austriake.

Në këtë punim do të paraqiten letrat e shkëmbyera e të pabotuara të autores me prof. Ölberg, përkatësisht këshillat dhe vërejtjet e prof. Ölberg gjatë punës kërkimore të saj. Autorja do të prezantojë rolin reciprok të profesorit austriak me shkenctarët shqiptarë në studimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare në vendet gjermanishtfolëse poashtu edhe vërejtjet dhe kritikrat e dhëna gjatë hartimit të punimit “Aspekte kontrastive në mes të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane” të K. Canaj (Graz më 1999), si dhe gjatë hartimit të librit “Kontrastive Aspekte der Derivation beim Adjektiv im Albanischen und Deutschen” (2010).

Njëkohësisht, në këtë punim do të prezantohet edhe letërkëmbimi i prof. Herman Ölberg gjatë luftës në Kosovë 1999, si dhe studimet e tij në fushën e albanologjisë në aspektin sinkronik. Nga ky aspekt në këtë punim do të paraqiten analizat dhe kritikrat e studimit kontrastiv në mes të dy gjuhëve si një studim kontrastiv sinkronik, edhe pse prof. Ölberg ishte një profesor, studiues dhe hulumtues në gjuhësinë krahasimtare duke e studiuar aspektin diakronik të leksikut dhe të fonologjisë së gjuhës shqipe.

Fjalë kyçe: Studiuesit austriakë, gjuha dhe kultura shqipe, albanologët austriakë, Hermann Ölberg, Gjuhësi kontrastive.

33. KLAUS STEINKE: HERAUSFORDERUNGEN FÜR DIE DEUTSCHE ALBANOLOGIE IM 21. JAHRHUNDERT

Es ist natürlich gewagt, gegenwärtig Prognosen darüber anzustellen, wann Albanien und Kosova Mitglieder der EU werden. Sicher ist nur, dass sie es werden müssen, wenn der europäische Gedanke eine Zukunft haben soll. Denn es ist unvorstellbar, dass beide Länder vom europäischen Integrationsprozess ausgeschlossen werden können. Damit wird aber auch die albanische Sprache in Zukunft international sicher eine neue, bedeutendere Rolle spielen. Nach dem Beitritt beider Staaten zur EU wird sie automatisch zur EU-Amtssprache, d.h. der Sprachendienst der EU-Behörden muss um eine Sprache erweitert werden, damit alle amtlichen Texte ins und aus dem Albanischen übersetzt werden. Ob-

wohl das Datum der Aufnahme noch in den Sternen liegt, ergeben sich schon jetzt konkrete Herausforderungen für die Albanologie.

Bisher war die Albanologie, insbesondere im deutschsprachigen Raum von der indogermanistischen Tradition beherrscht. Sicherlich wird sie demnächst vom praktischen Sprachunterricht, der bisher von begrenzter Bedeutung war, eine wichtige Ergänzung bekommen. Aktuell vollzieht das Albanische nämlich den Schritt von einer "exotischen" zu einer europäischen Sprache im heutigen Europa. Das hat eine politische Dimension und bringt viele praktische Probleme mit sich.

Natürlich gibt es bereits eine Reihe von Lehrwerken zum Albanischen, die speziell für Ausländer und die Diaspora konzipiert sind. In Deutschland legte Gustav Weigand 1913 mit seiner *Albanesischen Grammatik* den Grundstein und ihm folgten Max Lambertz mit dem *Lehrgang des Albanischen* und Martin Camaj mit dem *Lehrbuch der albanischen Sprache* (1969). Eine weitere Etappe stellt die Broschüre von Mehdi Bardhi und Rexhep Ismajli *Teksti i gjuhës shqipe për të huaj* (1974) dar, die Armin Hetzer seinem Lehrwerk *Lehrbuch der vereinheitlichten albanischen Schriftsprache: mit einem deutsch-albanischen Wörterbuch* (1978) inspirierte.

Nach der politischen Wende Anfang der 1990er Jahre ist das Interesse am Albanischen bei uns erheblich gewachsen, und das schlägt sich entsprechenden Lehrwerken nieder. Stärker auf den intensiven praktischen Sprachunterricht ausgerichtet sind in unseren Tagen *Albanisch als Fremdsprache, Shqipja si gjuhë e huaj* (2006) mit einer CD von Emine Teichmann-Sadiku und von Pandeli Pani *Albanisch intensiv. Lehr- und Grammatikbuch mit einer CD der Texte und Dialoge im MP3-Format* (2007), die beide im Bundessprachenamt in Hürth tätig sind bzw. waren. Außerdem gibt es mittlerweile etliche Sprachführer und Crashkurse, von denen verdient das Werk *Einstieg Albanisch für Kurzent-schlossene* von Lumnije Jusufi und Isabel Ströhle aus dem Hueber-Verlag erwähnt werden soll, weil es immerhin in einem Fachverlag für Sprachlehrwerke erschien. Der Selbstlernkurs vermittelt Anfängern in 20 Lektionen neben grundlegenden Sprachstrukturen auch viel Interessantes über Land, Leute und Kultur. Obwohl der Kurs zur Stufe A1 führen soll, ist das Material aber sehr begrenzt (<http://www.hueber.de/einstieg>).

Natürlich muss es primär im albanischen Interesse liegen, dass der Sektor *Albanisch als Fremdsprache* ausgebaut und verbessert wird. Hierzu gibt es fraglos etliche wichtige Ansätze, die noch kurz erwähnt werden sollen. In diesem Zusammenhang ist zunächst das 1975 bis 1981 in Tirana erschienene, dreibändige Werk *Gjuha Shqipe* von Lumnie Radovicka; Z. Karapici, A. Toma zu nennen. Es richtet zwar in erster Linie an die albanische Diaspora, der man die neue albanische Schriftsprache näherbringen will, konnte aber ebenfalls von anderen Interessenten benutzt werden. In Kosova erschien zu dieser Zeit die Broschüre *Teksti i gjuhës shqipe për të huaj* (1974) von M. Bardhi und R. Ismajli, die sich allgemein an Ausländer richtete. Mittlerweile ist das Angebot gewachsen, wobei die Qualität nicht immer überzeugt. Zu den seriösen Werke gehört zweifellos das in Tirana 2001 erschienene Lehrbuch *Gjuha shqipe për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut* von Gjovalin Shkurtaç und Enver Hysa. Auch im Internet ist Albanisch inzwischen mit Wörterbüchern und Übersetzungshilfen präsent <http://www.fjalor.de>, <http://www.fjalori.shkenca.org/> usw.

34. KOLEC TOPALLI: SHKENCËTARËT GJERMANË PËR ETIMOLOGJINË E SHQIPES

Interesimi i studiuësve gjermanë për gjuhën shqipe ka zanafillë të hershme, atëherë kur gjuhësia krahasuese po bënte hapat e saj të parë dhe shqipja, si një degë e veçantë e familjes indoeuropiane, zgjoi vëmendjen e themeluesve të kësaj shkence. I pari që drejtoi vëmendjen në gjuhën shqipe ishte filozofi gjerman *Gottfried Leibnitz* dhe pas tij shkencëtarët *Hans*

Thunmann, Joseph Xylander e Johannes Georg von Hahn. Një periudhë e re nis me dijetarët *Franz Bopp, August Schleicher, Johannes Schmidt, Jakob Falmerayer, Teodor Mommsen, Franz Miklosich, Hugo Schuchardt.* Figura qendrore në studimet etimologjike të shqipës për këtë fazë mbeten *Gustav Meyer, Holger Pedersen e Norbert Jokl.* Krahas këtyre për etimologjinë e shqipës kanë dhënë kontribute *George Stier, Wilhelm Meyer-Lübke, Albert Thumb, Robert Helbig, Leo Spitzer, Karl Treimer, Gustav Weigand, Maximilian Lambertz, Hans Jürgen Sasse* etj. Interesimi i dijetarëve gjermanë për etimologjinë e shqipës nuk ka reshtur as në ditët tona. Breza më të rinj, duke u mbështetur tek ata më të vjetrit, kanë çuar më tej rezultatet e kësaj fushe. Qendrat albanologjike në disa vende të Gjermanisë e Austrisë, sidomos në Berlin e Mynhen, në Vjenë, Grac e Innsbruk, kanë zhvilluar më tej traditat e hershme. Kontributet më të fundit në fushën e etimologjisë lidhen me emrat e gjuhëtarëve, si: *Wilfried Fiedler, Hermann Ölberg, Norbert Boretzky, Harald Haarman, Armin Hetzer, Bernd Janson, Frederik Kortlandt, Jürgen Kristophson, Rolf Ködderitzsch, Günter Reichenkron, Ruprecht Rohr, Georg Renatus Solta, Gerda Uhlisch, Oda Buchholz, Wolfgang Hock, Johannes Hubschmidt, Eduard Hermann, Gert Klingenschmitt, Johann Knobloch, Ernst Lange-Kowal, Michael Schmidt-Neke, Robert Elsie, Joachim Matzinger, Peter-Arnold Mumm, Bernhard Rosenkranz, Otto Haas, Manfred Schmidt, Stefan Schumacher, Klaus Steinke, Oskar Wiedemann, Wolfgang Zeitler e tjerë.* Gjuha shqipe u detyrohet shumë dijetarëve gjermanë për ndriçimin e historisë së saj, në veçanti etimologjisë.

35. KRISTAQ JORGO: STUDIUMI & PËRKTHIMI: MARTIN CAMAJ I HANS JOACHIM LANKSCH-IT (NJË ANALIZË KUANTEMATIKE)

Objekt i kumtesës është shqyrtimi i rezultateve të punës studimore & përkthimore të Hans Joachim Lanksch-it mbi veprën poetike të Martin Camajt. Qasja bëhet nga këndvështrimi i teorisë sonë të kuantifikimit harmonik të tekstit – një ngrehinë kjo në proces – që synon të ndriçojë raportet më intime të letërsisë me matematikën. Analiza përqendrohet në nivelin fonematik të teksteve (të orgjinalit shqip e të përkthimit të tij në gjuhën gjermane) dhe posaçërisht në dukurinë e kuantemnacës, term me të cilin shenjojmë fenomenin e përsëritjes në tekst të çifteve të fonemave të njëpasnjëshme. Përqasja e vëzhgimeve studimore ‘eksplicite’ të H. J. Lanksch-it mbi veprën poetike të M. Camajt me rezultatet e krahasuara të analizës kuantematike të orgjinalit shqip e të variantit të përkthyer të një vargu tekstesh zbulojnë njohjen e thelluar ‘implicite’ të poetikës camajane nga H. J. Lanksch-i dhe dëshmimin e kësaj njohjeje në cilësinë e lartë të përkthimeve të tij.

Fjalë kyçe: Hans Joachim Lanksch, Martin Camaj, përkthim, teori e kuantifikimit harmonik, analizë kuantematike e teksteve, kuantemnacë.

36. KRISZTIAN CSAPLAR-DEGOVICS: THOUGHTS ON THE HISTORY OF ORIGINS OF THE FIRST HUNGARIAN-ALBANIAN DICTIONARY (1913)

The aim of my German-speaking lecture is to present a potential interdisciplinary research field which might be interesting both for history (of science) and for linguistics (comparative linguistics, Albanian dialectology). This potential interdisciplinary research field is nothing else but the investigation of history of origins of Albanian dictionaries.

First of all it is important to highlight that the investigation of history of origins of an Albanian dictionary requires a complex set of historic and linguistic tools and a close cooperation between a linguist and a historian. During the joint work it is essential for both the linguist and the historian to be flexible and to be open for the approach of the other discipline. The historian has to keep the aspects of the linguist in mind, while the linguist may start his or her investigation based on historic reconstructions. Some phase of the work must be managed by the linguist and some by the historian. The present lecture aims to

sum up the experiences gathered by Dr. Lumnije Jusufi and me while writing our monography about the history of origins of the first Hungarian-Albanian Dictionary.

37. KUJTIM SHALA: KRIST MALOKI: IPSE E IDEM

Me termat *ipse* e *idem*, Pol Riker, kur shpjegon *veten si një tjetër*, vërtet e shenjon ndarjen e identitetit si individualitet, si një bërthamë e pashprehur që na bën çfarë ne jemi (*ipse*), ndërsa me *idem* - identitetin e identifikueshëm e të manifestuar jashtë. Në terma të tjerë, *ipse* është i identifikueshëm me “kush”, ndërsa *idem* me “çfarë” jam.

Nga ky shpjegim i përqendruar kuptojmë se Riker flet për identitetin në dy pamje, por të lidhur me të njëjtin subjekt. Kështu që ne mund të përfaqësohemi përmjet “kush” jam apo “çfarë” jam. Në rastin e Krist Malokit, edhe pse me terma të njëjtë, bëjmë një *skajim* disi më ndryshe të *ipse* e *idem*, qoftë dhe për të provuar *ipse*-n tonë përballë *idem*-it të tij teorik, por dhe në frymën e metodës së Malokit, e cila përherë ka parasysh objektin e saj të kërkimit, për t’u *skajuar* vetë.

Kështu, *ipse* shenjon *veten*, madje *vetjen*, e autentiken, të provuara si letërsi, kulturë e jetë e gjallë (*varianti*), qoftë dhe e trashëguar, ndërsa *idem* universalen, të përbashktën e *invariantit*. Pra, në rastin e Malokit kemi të bëjmë me *ipse* e *idem* që reflekton diskursin e tij, duke e parë identitetin të lidhur me diskursin, madje të identifikueshëm me të, meqë kemi të bëjmë me një njeri të dijes e të kulturës, fusha në të cilat identiteti ndërtohet, provohet e manifestohet në trajtë diskursi. Ndërsa, kur *ipse* e *idem* lidhen me temat e diskurseve të Malokit, atëherë nën këta terma lexohet shqiptari si individum (*ipse*) e jeta e tij në sociumin shqiptar autentik si përbashkësi (*idem*), pastaj lakohet si kulturë e si ideologji e kthyer në politikë, ndërsa të gjitha këto shenja, të lidhura e të përqendruara, i merr dhe i shfaq metoda e kërkimit e Malokit.

Të lexuar përmjet *ipse* e *idem*, apo si *ipse* e *idem*, diskurset e Malokit hapen si një vepër e kërkimit identitar, si ideologji e skicuar e shqiptarizmes, plot shenja polemike që diskursi i tij i merr nga debati bashkëkohor për kombin e shtetin, për përkatësinë orientale apo oksidentale të shqiptarëve, pra për identitetin, për letërsinë e për Poetin nacional. Debati e polemika e kthejnë diskursin e Malokit me fytyrë kah përdorimi, ndërsa dija e konceptualiteti e hap origjinën filozofike të tij. E para do të shenjojë probleme, ndoshta dhe ndonjë zgjidhja, ndërsa e dyta e provon universalitetin e çështjeve e të diskursit të tij.

38. KURT GOSTENTSCHNIGG: DIMENSIONI POLITIK I TRAJTIMIT TË ÇËSHTJES SË ETNOGJENEZËS SHQIPTARE NGA ANA E ALBANOLOGJISË AUSTRO-HUNGAREZE

This lecture tries to give an answer to the question, if the treatment of the problem of the Albanian ethnogenesis by the Austrian-Hungarian albanology did have a political dimension or not, and if yes, in what did it consist. At the beginning we shall shortly describe the general development of the Austrian-Hungarian albanology in the context of the political, economic, cultural and military interests of the Monarchy, followed by the presentation of the researcher types and the most important research questions as well as by a survey of the treatment of the problem of the Albanian ethnogenesis in Monarchy times, before we shall discuss the political dimension of that treatment for the Albanians and Austria-Hungary.

To answer the mentioned research question, if Austro-Hungarian albanologists did let themselves be instrumentalized by Austro-Hungarian politics and military, a combination of J. Galtung’s concept of cultural imperialism and P. Bourdieu’s field theory in relation to individual and institutional social actors has been chosen. Whereas Galtung’s concept constitutes an instrument for the analysis of the asymmetric relations between Austria-Hungary and the emerging Albania, Bourdieu’s field theory offers a significant potential for the analysis of the relationship between the Austro-Hungarian academic field on the one hand

and the fields of foreign policy and military on the other hand.

The contribution of the Austro-Hungarian science to the exploration of Albania is an essential one. The greatest part of the research work was done in the fields of linguistics, history, ethnography, geography, geology and archaeology. The Academy of Sciences in Vienna with its Balkan Committee and Albania Committee and the Academy of Sciences in Budapest with its Balkan Committee and Orient Committee were the driving force in the matter of expeditions in the Balkans before and during the First World War. The leading research establishments for the linguistic, historical, ethnographical and archaeological exploration of South-East Europe were the respective institutes of the Austro-Hungarian universities, especially in Vienna, Prague, Budapest and Graz. The late founded not university related Balkan Institute in Sarajevo, which over the years became central in the Austro-Hungarian Balkan Studies, had a privileged status.

The great contribution of Austro-Hungarian science to the study of the Albanian territories and of the Albanian people gives rise to the question if it has had only scientific reasons or it was accompanied by government interests. The time from the Congress of Berlin until the Balkan Wars is characterized from a permanent loss of the Austro-Hungarian influence about the Slav states on the Balkans. In 1913, in the western part of the Balkan Peninsula, only Albania, just acknowledged internationally as an independent state, was left to Austria-Hungary as the only ally against the panslavism on the one hand and the Italian imperialism on the other hand. This was the main reason why the Vienna diplomacy at the Conference of London, together with the Italian, supported vehemently the Albanian interests relating to the principal questions of the international status, the determination of the borders and the organisation of the new state.

Due to both its relative economical backwardness in comparison to the western industrial countries and its inner economical structural crises, Austria-Hungary increasingly directed its commercial policy towards Southeast Europe. After the Congress of Berlin (1878), Austria-Hungary competed with Italy to achieve control over the sea and overland routes, in order to secure commercial and strategic hegemony in the western Balkans. Here, the Albanian territories were of crucial importance.

Out of the victorious wars of the Habsburgs against the Ottomans resulted the so called "Protectorate of Culture" of Austria, the right of protection of all Christians of the Ottoman Empire. The official duties of the cultural protectorate were the building and maintenance of the churches, the formation of the clergy and the protection of the congregations in Albania. Yet in an unofficial way the protectorate of culture was used as a means of exertion of influence over the Albanian population.

The Albanian Historiography at the time of communism speaks of an Austro-Hungarian imperialism to the debit of the Albanian National movement. The Western Historiography at this time tends to the glorification of the role of Austria-Hungary as a development aid worker. Fact is that Austria-Hungary played an important role in the process towards Albanian independence, yet but it intended also to increasingly influence the little country by means of an informal structurally conditioned imperialism in the realms of politics, culture, economics and research.

The exploration of the Albanian territories and its population has had a great importance within the scope of the reciprocal relations. This is proved by the historical documents and the statements of the Historiography. The research results of the Institute of Balkans in Sarajevo and of the expeditions of the Academies of Science were exploited for political, commercial and strategic objects. The Albanology was used as a means of doing structural violence within the frame of informal imperialism. Nevertheless there was no concrete political program, but only a stimulation of the Albanian Studies by the state. The two years

of military occupation during the First World War have been the transition into a formal imperialism based on the cooperation between research and military.

In the Austrian-Hungarian Albanological Field there are three different types of individual actors: the pure scientific type, represented by Jireček, Šufflay, Patsch, Meyer, Schöber, Miklosich, Schuchardt, Meyer-Lübke, Jokl and Lambertz; the mixed political-scientific type with proximity to or even involvement in the political field, represented by Hahn, Thallóczy, Ippen and Nopcsa; the mixed military-scientific type with proximity to or even involvement in the military field, represented by Veith, Praschniker, Seiner, Haberlandt, Nopcsa, Jokl and Lambertz. These actors competed on the basis of their economic capital (i.e. financial assets and material possession), cultural capital (i.e. education and professional position), social capital (i.e. relations and networks) and symbolic capital (i.e. prestige and social reputation) against each other for maintaining or changing the power relations within the field of Austro-Hungarian albanology.

The specific *illusio* of the general albanological field, i.e. the common interests and doctrines of the albanologists, consisted in casting light on the unknown aspects of the Albanian history, culture and language. The specific *doxa* of the subfield Austro-Hungarian albanology, set by the political field in Austria as well as in Hungary, i.e. the common belief of the Austro-Hungarian albanologists that the Dual Monarchy had to pioneer in the above mentioned matter, influenced the selection of research topics, like the issue of the Albanian ethnogenesis.

This question of the history of the Albanian areas of settlement has captured the interest in the research about the Albanians and is still today the most discussed problem within the international albanology. For a long time, the albanologists have been divided into two contrary camps: the representatives of the “Illyrian thesis” and the representatives of the “Thracian thesis”. While the first ones support the ever existing autochthony of the Albanians in their present areas of settlement, the second ones claim the immigration of the Albanians from east into their present areas of settlement. Lately, there is a third camp around the Viennese linguists Joachim Matzinger and Stefan Schumacher who seem to have proved that the Albanian language does not derive from the Illyrian or Thracian language, but from another, still unknown Old Balkan language.

Let us turn back to the Monarchy times: After clarifying the issue of the position of Albanian within the Indo-European languages, the linguistics turned to the exciting question of the Illyrian, Thracian or Illyrian-Thracian character of the Albanian language before it was transformed by the Vulgar Latin influence. Furthermore, attempts were made to explore the relationship of Albanian with Dalmatic and Rumanian, the depth of the Latin influence on preliminary Albanian and the separation of the hereditary vocabulary from the loan and borrowed words. At the same time, the scientific consolidation of the Illyrian thesis reinforced the position of the Albanians in the Balkans, allied with the Monarchy, with regard to their Slavic neighbours with Anti-Habsburg attitude. Thus, it was also of political significance, when the influence of Latin on preliminary Albanian and that of Romanian on Albanian did not go too far and when the part of the hereditary vocabulary was greater than the part of the loan and borrowed words. Therefore it was probably no coincidence that the Austro-Hungarian albanologists like Hahn, Miklosich, Meyer, Meyer-Lübke, Jireček, Šufflay and – with some restrictions – Patsch and Nopcsa argued without exception for the Illyrian origin of the Albanians and of the Albanian language. Regarding the issues of the ethnogenesis of the Albanians and the origin of the Albanian language Jokl took a mediating position, which was published however only after the end of the Monarchy.

39. LINDITA SEJDIU-RUGOVA: THREE MAIN AREAS OF ALBANIAN SYNTAX IN THE ALBANISCHE GRAMMATIK OF BUCHHOLZ AND FIEDLER

The study is focused on analyzing three main areas of Albanian Syntax, based on Buchholz and Fiedler's point of view in Albanische Grammatik: the word groups, basic sentence patterns and hypotactic relations in the sentence. The concepts introduced by Buchholz and Fiedler will be examined and analyzed from today's perspective of syntactic analysis, by contrasting them with the concepts introduced by Albanian grammarians in Albania and Kosova. A particular attention will be paid to the syntactic terminology suggested in the book and to the classification of linguistic units in their syntactic hierarchy. Albanische Grammatik, still, represents one of the most important grammars of the Albanian language, being one of the masterpieces in describing the syntactic system of Albanian.

Key words: syntax, subordination, syntactic analysis, sentence, clause

40. LUMNIJE JUSUFI: NEUE ZUGÄNGE ZUNALTEN TEXTEN ÜBER DAS KONZEPT DER SELBSTREFLEXION. ZOLTÁN LÁSZLÓ UND SEIN UNGARISCH-ALBANISCHES WÖRTERBUCH (1913)

Die Berücksichtigung des Wissenschaftlers und seiner Arbeitsweise im wissenschaftlichen Arbeitsprozess ist mittlerweile eine etablierte Methode in vielen Wissenschaftsgebieten, darunter auch in der Geschichtswissenschaft und in der Anthropologie. Insbesondere die Empirie, die zunehmend einen zentralen Platz auch in Sprachwissenschaften einnimmt, ist ohne diesen Ansatz undenkbar. Dabei handelt sich um das Konzept der Selbstreflexion. Einen solchen Zugang aus der Sicht der Geschichtswissenschaft bietet der Vortrag von Herrn. Csaplár-Degovics am Beispiel des gleichen Werkes von László. Mein Vortrag versucht dies auf die philologische Arbeit mit alten Texten am Beispiel vom o.g. Wörterbuch anzuwenden. Dabei handelt es sich nicht nur um die Vorlieben des Autors, sondern auch um seine Art von empirischer Arbeit und den Umgang mit scheinbaren Fehlern von Seiten des Linguisten. Für die Analyse von Werken mit empirischer Basis, wie es insbesondere die älteren albanologischen Werke deutschsprachiger Wissenschaftler sind, eignet sich das Konzept der Selbstreflexion hervorragend.

41. MARTIN SUROVČÁK: JAN URBAN JARNIK, ALBANOLOG, LIGJËRUES NË UNNIVERSITETET AUSTRO-HUNGAREZE

Martin Surovčák nga Brno propozon të na flasë për veprimtarinë albanistike të Jan Urban Jarnik-ut (1848-1923), filolog çek, romanist-rumanist, anëtar i Akademisë Rumune, profesor në universitete të ndryshme, përfshirë Carolina të Pragës, por edhe albanolog, në universitetet austro-hungareze. [Red.ë

42. MATTEO MANDALÀ: ARBËRESHËT NË VEPRËN E GUSTAV MEYER-IT (1850-1900)

Interesi i Gustav Meyer-it për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare nis me kërkimet e tij në terren në Italinë e Jugut dhe në Greqi. Për Mayer-in kontakti me arbëreshët ishte shumë i rëndësishëm, siç e dëshmojnë të dhënat e shumta gjuhësore që mbledhi prej tyre. Posaçërisht të frytshme rezultojnë kontaktet me eksponentët kryesorë të Rilindjes arbëreshe, si me gjuhëtarin Demetrio Camarda dhe me poetët Jeronim De Rada e Zef Skiro. Në këtë kumtesë autori synon të rindërtojë këto marrëdhënie, edhe në dritën e dokumenteve arkivore të pabotuara.

43. MILOTE SADIKU: STUDIMET E GJUHËTARËVE GJERMANISHTFOLËS PËR MBIEMRIN E GJUHËS SHQIPE

Mbiemri në gjuhën shqipe është trajtuar si nga autorë vendas, ashtu edhe të huaj. Qëllim i këtij punimi është që të analizojë gramatikat dhe studimet e ndryshme të gjuhëtarëve gjermanofolës për mbiemrin e gjuhës shqipe, për sa i përket mënyrës së trajtimit të problemeve morfologjike, semantike e sintaksore që paraqet kjo klasë e fjalëve. Në këtë punim më shumë do të përqëndrohem në gramatikën e gjuhës shqipe të dy albanologëve gjermanë Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler “Albanische Grammatik” (1987) si dhe në studimet e gjuhëtarit gjerman Gerd-Dieter Nehring, sidomos për fjalëformimin e mbiemrit të gjuhës shqipe. Gramatika e autorëve Buchholz/Fiedler i trajton të gjitha kategoritë leksiko-gramatikore të mbiemrit në mënyrë shteruese dhe i paraqet mbiemrat si një klasë heterogjene, të cilët i klasifikon sipas kriterit semantik, morfologjik dhe sintaksor.

44. MIMOZA KORE: VEÇORI GJUHËSORE DHE ETNOLOGJIKE TË QYTETIT TË GJIROKASTËRS NË VEPRËN E E. M. LAMBERTZ-IT

Vepra albanologjike e M. Lambertz-it është e pasur dhe e shumanshme. Ai është marrë me shumë çështje të gjuhës shqipe e të dialekteve të saj, me mësimin e shqipes si lëndë universitare, me letërsinë shqipe, me folklorin shqiptar dhe me përkthime nga letërsia shqipe në gjermanishte.

M. Lambertz-in e ka tërhequr vazhdimisht sintaksa e gjuhës së folur dhe e ligjërimit popullor të përditshëm. Ai është ndër të parët që i ka kushtuar vëmendje të veçantë studimit të saj, së pari, në punimin për Këngët e Kreshnikëve e më pas në një punim të posaçëm për ligjërimin popullor të qytetit të Gjirokastrës: “Zur albanischen Umgangssprache (Gjirokastra)”.

Është pikërisht ky i fundit që na tërhoqi vëmendjen dhe e kemi bërë objekt të këtij punimi. Ai është një artikull ende i pabotuar dhe i papërkthyer në gjuhën shqipe.

M. Lambertz-i e shkruajti atë, kur shqipen, shqiptarët, jetën dhe kulturën e tyre e kishte njohur shumë mirë. Ai njihje dialektet e shqipes, por ekspeditat e ndërmarra e kishin hedhur në trevat e Veriut, prandaj kishte një ide të qartë për tiparet e gegërishtes dhe jo të këtij niveli edhe për ato të toskërishtes.

Në këtë punim kemi sjellë këndvështrimin e Lambertz-it për toskërishten e më ngushtësisht për të folmen e qytetit të Gjirokastrës. I gjithë punimi karakterizohet nga analiza të hollësishme e vlerësime të të dhënave që ai paraqet në lidhje me veçoritë fonetike, morfologjike, sintaksore dhe etnologjike që ka hasur në tekstet e përkthyer nga kjo e folme. Shumë nga karakteristikat që ai has në toskërishte gjejnë gje gjegjësen e tyre edhe në gegërishte, duke e bërë ligjërimin popullor në gjuhën shqipe të gjallë, plot jetë e të dallueshëm nga ligjërimi libror.

45. MIRADIJE BERISHA: PANORAMË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE DHE E MËSIMIT TË SHQIPES NË DIASPORËN SHQIPTARE NË REPUBLIKËN E AUSTRIËS

Në këtë temë do të trajtohet:

1. Shkurtesë e historikut të shpërnguljes së shqiptarëve në Austri (1900-2017).
2. Fillimet e Albanologjisë në Austri: Katedra e albanologjisë në Vjenë: ndihmesa e Gjergj Pekmezit. Botimet dhe roli i tij për njohjen dhe përkrahjen e shqiptarëve dhe vlerësimin e gjuhës shqipe në mjediset austriake.
3. Mësimi i gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës, pas vdekjes së Gj. Pekmezit: Katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Vjenës me lektorë Dr. Skënder Gashi dhe Dr. Ina Arapi.
4. Mësimi plotësues i shqipes në mjediset shqiptare në Austri në ditët e sotme. Përvojë

dhe problematikë nga mësimdhënia dhe hulumtimet e kontaktit të shqipes me gjermanishten në Tulln, Krems.

5. Sprovë modeste rreth kaheve dhe disa rezultate paraprake të anketimeve dhe hulumtimeve sociolinguistike rreth code-mixing e “codeswitching”, që jemi duke i kryer në prefekturat e Tulln-it dhe Krems-it, nën kujdesin e akademik Gj. Shkurtajt për master, dhe Prof. Dr. E. Vetter, udhëheqës i doktoratës “Interkulturelle Aspekte im Muttersprachlichen Unterrichts, Albanisch im deutschsprachigen Raum” në proces.

Fjalët çelës: Albanologjia në Austri, Katedrat e shqipes dhe albanologët austriakë: Gjergj Pekmezi, Maximilian Lambertz, Herman Ölberg, Skënder Gashi etj., mësimi i shqipes në shkollat e mërgimtarëve shqiptarë në Austri sot, dygjuhësia dhe dykulturësia e shqiptarëve të Austrisë sot; hulumtime sociolinguistike rreth codes-mixing e codeswitching.

46. PËLLUMB XHUFË: SHQIPTARËT NË HISTORIOGRAFINË NË GJUHËN GJERMANE

Njëllaj si për gjuhën e shqiptarëve, edhe studimet për historinë e tyre lindën dhe u zhvilluan kryesisht si rezultat i interesit që treguan për ta studiuesit austriakë dhe ata gjermanë. Akademia Bavareze e Shkencave dhe Akademia Austriake e Shkencave ishin dy institucionet që financuan hulumtime e botime themelore mbi historinë, gjuhën e kulturën e shqiptarëve. Megjithatë, në mjaft nga veprat e historianëve të shquar gjermanëfolës, si Hammer-Purstagall, Fallmerayer, Hopf, Jireček, historia e shqiptarëve shkrihet e shpërndahet në historitë e sistemeve perandorake, apo në atë të popujve fqinjë, ndonjëherë duke u trajtuar si një shtojcë e thjeshtë e tyre. Studime të mirëfillta e të thelluara mbi historinë shqiptare kryen studiues, si Šufflay, Stadtmüller, Babinger e së fundi Hösche, Schmitt e Bartl. Historiografia gjermanike ka qenë ajo që ka formuluar tezat më mbresëlënëse mbi probleme kardinale të historisë së shqiptarëve, siç janë ato që kanë të bëjnë me vijmësinë iliro-shqiptare, mbi lidhjet gjenetike të Epirotëve e të Maqedonëve me Ilirët, mbi rolin dhe vendin e shqiptarëve në Perandorinë Bizantine e në atë Osmane, mbi formacionet e para feudale dhe shtetin e Skënderbeut, mbi genealogjinë e besimeve fetare dhe marrëdhëniet ndërfetare mes shqiptarëve etj. Mjaft nga këto teza vazhdojnë të mbështeten edhe sot nga historianët gjermanofonë, mbi bazën e burimeve dhe dokumentave të reja që ndërkohë kanë dalë në dritë.

47. REMZI PËRNASKA&TOMORR PLANGARICA: ALBANISCHE GRAMMATIK E O. BUCHHOLZ-IT DHE W. FIEDLER-IT, PERLË GRAMATOLOGRAFIE

Albanische Grammatik zë vend nderi në hapësirën e mendimit gjuhësor shqiptar, si vepër e përfutur nga përputhja jo e zakonitë e një sërë kushtesh të kërkimit e prodhimit shkencor: vepër e dy autorëve të cilët kanë formim të plotë e të qëndrueshëm shkencor, njohje të thelluar të mendimit gjuhësor të traditës, por edhe të rrymave e shkollave bashkëkohore të gjuhësisë; për më tepër, njohje të thelluar të shqipes e vullnet për shqyrtime të imtësishme të kategorive gjuhësore e paradigmatve të saj. Këto parakushte kanë mundësuar përfutimin e një vepre që bart të përgjithësuarat përvojat e shqyrtimit të dukurive gramatikore të shqipes dhe njëherazi edhe këndvështrimet e autorëve në përputhje me shkollat gjuhësore të parapëlqyera prej tyre; përkuqdesjen e skajshme për të dalluar e analizuar deri në imtësi dukuritë morfologjike, të ndriçuara edhe përmes vështrimesh formaliste, strukturore e pragmatike, dukuritë sintaksore, për të nxjerrë në pah veçantitë e shfaqjes e ngjizjes së tyre, a dukuritë fonetike e deri edhe diskursive të shqipes, të lidhura jo thjesht me standardin, por edhe më gjerë; shqyrtime që harmonizojnë në mënyrë të admirueshme mënyrat deduktive të trajtimit me ato induktive.

Një vepër që vendoset denjësisht në fondin e gramatikave gjuhësore të shqipes, por edhe të dijës gjuhësore me karakter më të gjerë enciklopedik; një vepër, shkëlqimi i së cilës veçse spikat më dukshëm sa më shpesh i qasemi dhe e shqyrtojmë.

48. REXHEP ISMAJLI: STUDIMET ALBANISTIKE NË VENDET KU FLITET GJERMANISHT

Historiku i studimeve albanistike në botën gjermanishtfolëse është i hershëm. Interesimet e dijetarëve për botën shqiptare në të vërtetë nisin me letrat e dijetarit të famshëm Leibnitz, për të vijuar pastaj me një intensitet tjetër në periudhën e komparativizmit dhe të Romanizimit. Qysh në sh. XVIII me Thunmann-in kemi një sjellje në vëmendjen e opinionit gjermanishtfolës dhe të dijes në përgjithësi të problematikës shqiptare, ndërsa aktualizime pak më konkrete në kuadër të studimeve krahasuese indoeuropiane do të kemi me F. Bopp-in, A. Schleicher-in e të tjerë. Sado që afërsisht në këtë kohë diplomati dhe dijetari i shquar austriak G. von Hahn sillte një perspektivë më të gjerë si kuadër për studimet shqiptare, duke përfshirë aspektet historike, etnologjike, gjuhësore e të tjera, në studimet për gjuhën shqipe do të vazhdonte përqëndrimi parësor të vështrimit krahasues-historik për gjuhën shqipe. Në këtë aspekt shquhen piarritjet kulminante me Gustav Meyer-in në fund të shekullit XIX, për ta çuar tërë problematikën në një nivel edhe më të lartë me Norbert Jokl-in në pjesën e parë të sh. XX. Krahas me këto, po në gjuhën gjermane shquhen dhe aportet

E danezëve, sidomos të Holger Pedersen-it, e të tjerëve. Studimet sistematike dhe sistemore për gjuhën shqipe, në kuadër të dijeve e të teorive të kohës për gjuhët, do të vazhdojnë të jenë mbisunduese në albanistikën e sh. XX gjithnjë në gjuhën gjermane. Në fillim të sh. XX do të ketë dhe një komunikim më thelbësor midis traditës dhe dijeve për gjuhën shqipe dhe shqiptarët të zhvilluara në botën gjermanishtfolëse dhe traditës shqiptare, sidomos me brezin e Çabejtë e të Budës, deri në shkallën që, deri vonë në diskutimet kontestuese të traditës akademike serbe, e tërë albanologjia shqiptare të shihej me një sy dyshues për shkak se paska “marrë mësim të mira në traditën e filologjisë gjermane”, siç thoshte arkeologu i njohur V. Popović. Pas LDB-së, ç’është e vërteta, përveç në majat si të Çabej, Ajeti, Camaj, në tërë kulturën filologjike dhe linguistike shqiptare sikur pati më pak ndërveprim me traditën albanistike të zhvilluar në gjuhën gjermane, qoftë për arsye ideologjike, apo edhe (çka po ashtu ndërlihet me të parën) për mungesat e mëdha në njohjen e gjermanishtes te brezat e kësaj kohe, komunikimet me traditën gjermanishtfolëse shpesh nuk kanë qenë në nivelin e nevojshëm. Problematika e këtyre ndërkomunikimeve mund të diskutohet dhe në raste si ky. Prania e madhe e diasporës shqiptare në vendet gjermanishtfolëse, hapja e botës shqiptare paskomuniste dhe zgjerimi i departamenteve të studimit të gjuhës dhe të kulturës gjermane ndër shqiptarë kanë krijuar një horizont të ri për këto ndërkomunikime. Studimet shqiptare, nga ana tjetër, në botën gjermanishtfolëse janë zhvilluar shumë shpesh brenda kornizave institucionale të studimeve ballkanistike, romanistike, sllavistike, më trallë në suaza të ndonjë departamenti të veçantë, siç është ai i Mynhenit. Intensifikimi i ndërkomunikimeve shoqërore, por edhe kuklturore midis shqiptarëve dhe vendeve që flasin gjermanisht po e aktualizon gjithnjë e më shumë nevojën e zgjerimit dhe të forcimit të mëvetësisë institucionale për studimet shqiptare. Kjo po i nxjerr në pah gjithnjë e më qartë edhe pasojat në konceptimet për çështje themelore lidhur me këtë gjuhë e popull të zhvillimit të gjatë brenda kornizave të tjera.

49. ROBERT PICHLER: STUDIES ON FAMILY, KINSHIP AND MIGRATION IN ALBANIA, MACEDONIA AND KOSOVA BY THE DEPARTMENT OF SOUTH-EAST EUROPEAN HISTORY AND ANTHROPOLOGY AT THE UNIVERSITY OF GRAZ

Scholars from the Department of Southeast European History and Anthropology at the University of Graz have engaged, among others, in research on family, household, kinship and migration in the Balkans. By combining historical, demographical and anthropological approaches the scholars aimed at gaining insight into local particularities, regional patterns

and historical developments. This paper deals with research results that either refer to Albanian areas or provide an immediate insight into conditions analyzed in different regions of Albania, Kosovo and Macedonia. In doing so, it provides a synopsis of the Graz groups' Albanian studies in historical anthropology and demography.

50. SABRI HAMITI: LAMBERTZ-I E ÇABEJ - PËR LETËRSINË SHQIPTARE

Raporti historik i Austrisë vjetër me shqiptarët, siç e quante Eqrem Çabej edhe vetë student i Vjenës, i ka dy pika fundamentale: 1. në fushën shtetërore, duke mbrojtur shqiptarët dhe duke ndihmuar shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, dhe 2. Në fushën kulturore-historike, duke zbuluar e studiuar autenticitetin e kulturës e të letërsisë së kombit shqiptar. Keto raporte mund të duken edhe në komunikimin e drejtpërdrejtë apo në distancë të dy personaliteteve të brezave të ndryshëm të këtyre vendeve: maximilian Lambertz-it dhe Eqrem Çabejtë.

Ky diskutim kap rreth katër decenie dhe ka të bëjë me formimin e gjuhës letrare shqipe, gjenezën e literaturës shqipe dhe qerthujt letrarë të literaturës shqipe. Gjithë këto probleme Lambertz-i i trajton në studimet e veta të viteve 1916-1917, 1922. Po këto çështje i rimerr Eqrem Çabej në studimet e veta të viteve 1935, 1937 e 1945. Pas viteve '40 Lambertz-i vijon me studime specifike për letërsinë epike shqipe popullore dhe të shkruar, kurse Çabej u kthehet përfundimisht studimeve e historike të shqipes dhe etimologjisë. Ende vazhdojnë ta trajtojnë njëri tjetrin me vlerësimet të larta e pietet. Si duket Çabej i fundit largohet nga Lambertz-i dhe kthehet për t'u bërë vërtet trashëgimtar i mësuesit të vet Jokl-it. Nuk e dimë nëse qe ky orientimi zanafillor i Çabejtë që po thellohej në pjekuri, apo edhe orientim i ri për shkak të rrethanave sociokulturore në Shqipëri. Në një mënyrë ky është prapë vazhdim i Gjenezës vetëm se më thellë në probleme të historisë së gjuhës e të historisë së nationit. Ajo që është me rëndësi të përmendet në fund është se Çabej në këtë mënyrë e kthen kurorën e studimeve gjuhësore në Shqipëri.

51. SADIJE REXHEPI: SISTEMI KOHOR I SHQIPES SIPAS BUCHHOLZ/ FIEDLER

Buchholz/Fiedler në gramatikën e tyre janë marrë me çështjen e sistemit foljor të shqipes. Sipas tyre format foljore me kategoritë funksionale-semantike mund të shprehin temporalitet, aspektualitet /aksionalitet (Aktionsart), modalitet dhe emocionalitet, të cilat i kanë edhe nënkategoritë e tyre, disa prej të cilave nuk mund t'i gjejmë në gramatikat e tjera të gjuhës shqipe. Ata i përshkruajnë në detaje këto kategori për secilën formë kohore. Qëllimi i këtij punimi është të sjellë të veçantat e kësaj gramatike për sistemin kohor të shqipes dhe krahasimin e saj me disa nga gramatikat e gjuhës shqipe.

Në *Albanische Grammatik* përshkruhen funksione të ndryshme të secilës formë kohore, si ne aspektin e temporalitetit, modalitetit, aspektualitetit, p.sh. madje edhe koha e tashme e dëftores mund të shprehë modalitet të një kushti real që pritet të realizohet (Fallsetzungs-modalität) dhe të kushtores (kondicionalit).

Në mënyra të ndryshme të foljes edhe numri i formave kohore në *Albanische Grammatik* varion nga gramatikat e tjera, si nga gramatika e ASHRSH (2002), Rizës (1997), Demirajt (1988), Cipos (1949). Në radhët e formave kohore të dëftores te Buchholz/ Fiedler gjejmë kohën e tashme, shtatë kohë të shkuara (përveç formave të njohura tradicionale aty paraqiten edhe dy kohë më të rralla: e kryera II dhe më se të kryera II), ndërsa kohët e ardhme (volitiv, e pakryer volitiv, e kryer volitiv, më se e kryer volitiv) me gjithë funksionet e tyre të temporalitet paraqiten në një mënyrë të veçantë, atë të volitivit. Në të paraqiten edhe mënyra të tjera të foljes, të cilat nuk i gjejmë në gramatikat tjera, si mënyra lidhore-habitore, jusivi (mënyra lejore me *le*), necesitativi (Nezessitativ), posibilitativi (Possibilitativ), të cilat kanë edhe forma të ndryshme kohore. Një përshkrim dhe krahasim i formave të tilla besoj të jetë një e dhënë e rëndësishme për gramatikën e gjuhës shqipe.

52. SEIT MANSAKU: ALBANOLOGJIA GJERMANE NË GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XIX: NGA KSILANDERI TE BOPPI

Njohja dhe studimi i gjuhës shqipe, si edhe i gjuhëve të tjera, ka kaluar përmes disa fazave që kanë përparuar paralelisht dhe hap pas hapi me njohjen e lëndës gjuhësore të kësaj gjuhe nëpërmjet zbulimit të teksteve të vjetra të saj, dhe nëpërmjet kontakteve të misionarëve dhe të udhëtarëve të huaj me botën shqiptare brenda territorit kompakt të saj dhe me diasporën arbëreshe të Italisë dhe të Greqisë. Studimet për shqipen dhe historinë e saj gjatë shekullit XIX kanë përparuar edhe në lidhje me zhvillimet e gjuhësisë historike krahasuese europiane dhe të metodave shkencore të saj. Për këtë pikë merita themelore u takon pa dyshim albanologëve gjermane.

Rezultati i fazës së parë të kontakteve dhe të njohjeve me lëndën gjuhësore të shqipes ka qenë identifikimi i saj si gjuhë e veçantë e dalluar nga gjuhët e tjera sidomos nga latinishtja. Fazës së parë i përkasin shënimet që kanë lënë misionarë dhe udhëtarë të huaj që kanë kaluar në viset shqiptare në shekujt XIII-XIV dhe kanë vënë në dukje se shqiptarët janë një popull i veçantë që kanë edhe një gjuhë të vetën të veçantë, krejt të ndryshme nga latinishtja. Janë konstatime nga kontaktet e të huajve me folës të gjuhës shqipe para ose në fillim të dëshmive të shkruara në gjuhën shqipe Këtu përfshihen dëshmitë e Anonymi Europae Orientalis e vitit 1308, dëshmia e Kryepeshkopit të Tivarit Guilelm Adae-s dhe e Arnold fon Harfit në Fjalorthin e tij të vitit 1497.

Fazën e dytë e përbëjnë përpjekjet e para për të zbuluar e provuar përkatësinë indoeuropiane të gjuhës shqipe. Kjo fazë nis duke u mbështetur në vëzhgimin e analizën tashmë të teksteve të shkruara në gjuhën shqipe. Ajo fillon me një vërejtje të rendësishme metodologjike të dijetarit të shquar gjerman Leibnitz në fillim të shekullit XVII (1715). Ai që i pari që theksoi se për të gjykuar për karakterin indoeuropian të gjuhës shqipe duhet të veçohen elementet e huazuara nga elemntet e trashëguara të leksikut të shqipes dhe analizës shkencore për këtë qellim i duhen nënshtruar këto të fundit. Këtu vijuan të thellohen me veprën e Johannes Tunmann në fund të shekullit XVIII (1774), por ky i fundit si historian i kushtoi vëmendje të veçantë problemit të origjinës së shqiptarëve.

Problemi i përkatësisë indoeuropiane të gjuhës shqipe i takon gjysmës së parë të shekullit XIX dhe është do të thosha rezultat ekskluziv veprës së dijetarëve gjerman Norbert Reiter Ksilander-it dhe Franz Bopp-it, që e përfshinë dhe futën shqipen në rrjedhën e zhvillimeve të gjuhësisë historike krahasuese. Dijetarët e mëvonshëm kanë mbështetur karakterin indoeuropian të shqipes, kanë plotësuar e saktësuar lëndën indoeuropiane të saj, si në fushën e leksikut, ashtu edhe të struktures gramatikore të saj. Që nga fillimi i gjysmës së dytë e shekullit XIX janë shtuar përpjekjet për të përcatuar lidhjet e shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane dhe për të përcaktuar vendin e saj në këtë familje gjuhësore. Edhe në këtë problemin e fundit dijetarët gjermanë kanë meritën kryesore. Franz Bopp-i i caktoi shqipes një vend të veçantë në familjen e gjuhëve indoeuropiane pa asnjë lidhje farefisnie me asnjërin prej gjuhëve të kësaj familjeje që në vitin 1854. Rreth 30 vjet më vonë në vitin 1883 në kohën e arritjeve të shënuara të shkollës gjuhësore të gramatikanëve të rinj. G. Meyer në artikullin e tij të njohur *Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indogjermane* e vendosi shqipen në gjuhët satem nga një anë dhe në gjuhët veriore nga ana tjetër. Studiuësit e mëvonshëm që u morën gjerësisht me problemet themelore të historisë së gjuhës shqipe si: H. Pedrseni, N. Jokli, E. Çabej, Sh. Demiraj, I. Ajeti, E. Hamp, A. Desnickaja etj. kanë sjellë ndihmesa të reja në argumentimin e mëtejshëm të karakterit indoeuropian të shqipes dhe saktësimin e vendit të saj në familjen e gjuhëve indoeuropiane.

53. TEUTA ABRASHI: NDAJSHTIMI I VEÇUAR - DISA ÇËSHTJE NË RRAFSHIN SINTAKSOR DHE SEMANTIK

Tradicionalisht kontributi i gjermano-folësve në gjuhësinë shqiptare ka një rol të rëndësishëm dhe të veçantë, qoftë në rrafshin diakronik e po ashtu edhe në rrafshin sinkronik. Përveç kësaj, këto kontribute janë gjithashtu, ani pse jo në mënyrë sistematike, përplot analiza kontrastive ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjermane. Padyshim se ato paraqesin një bazë solide për analiza të mëturjtshme kontrastive, të cilat mund të thellohen por, kur paraqitet nevoja, eventualisht edhe të korrigjohen. Kështu p. sh. Gerda Uhlisch, në analizën e saj kontrastive-tipologjike, pohon se ndajshtimi i veçuar në gjuhën shqipe përputhet tërësisht për nga forma dhe përmbajtja me ndajshtimin në gjuhën gjermane. Në këtë punim do të deshmohet se ndajshtimi i veçuar në gjuhën shqipe ka s'përputhje me atë të gjuhës gjermane, sidomos në rrafshin sintaksor dhe semantik. Në këtë frymë, disa dukuri të ndajshtimit të veçuar, të pranishme në gramatikën e Buchholz/ Fiedler, siç është p. sh. ndajshtimi i veçuar në gjinore, mund të shpjegohen në mënyrë më të qartë dhe më të thelluar. Rrjedhimisht, do mund të epej një shpjegim eventual se a mund një dukuri e tillë, siç pretendon Friedman, të zgjerohet edhe te rrjedhorja. Të gjitha këto analiza mbase do të kontribuojnë në përpilimin e disa kritereve, të cilat në mënyrë më të qartë dallojnë ndajshtimin e veçuar nga përcaktori në gjuhën shqipe, të cilat nganjëherë ngatërrohen.

54. VALTER MEMISHAJ: M. LAMBERTZ PËRMES DOSJEVE NË ARKIVIN E INSTITUTIT TË GJUHËSISË DHE TË LETËRSISË

Përrallat shqiptare, i daktilografuar 100 f.

Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, i daktilografuar 125 f. Përktheu Benjamin Dashi.

Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, i daktilografuar 51 f. Përktheu Benjamin Dashi.

Periudha hipotetike në gjuhën shqipe, dorëshkrim 74 f. Përktheu Benjamin Dashi.

Raport mbi diskutimet e mia linguistike në Shqipëri prej mesit të majit deri në fund të gushtit 1916, i daktilografuar 11 f. Përktheu Benjamin Dashi.

Dialektet shqiptare të Italisë (lajme përmbledhëse), i daktilografuar 30 f., dorëshkrim 52 f. Përktheu Benjamin Dashi.

Dialektet e shqipes, 34 f. Përktheu Bexhet Shehu.

Dialektet e shqipes, i daktilografuar 11 f. Përktheu Bexhet Shehu.

Studime dialektike italo-shqiptare. Dialektet lokale të shqiptarëve në provincat italiane të Campo Basso dhe Foggias, i daktilografuar 104 f. Përktheu Benjamin Dashi.

Epika popullore e shqiptarëve. Cikli i Mujit dhe Halilit, i daktilografuar 128 f. Përktheu Eqrem Çabej

Dialektet e shqipes - nxjerrë prej librit "Albanisches Lesebuch" 1948, Laipzig. i daktilografuar 11 f., dorëshkrim 9 f. Përktheu Bexhet Shehu.

Shënime për Lambercin - nxjerrë në Arkivin e Shtetit nga prof. Emil Lafe, 9 f. fletoreje.

Drama në teatrin shqiptar të sotëm, dorëshkrim 294 f. Përktheu Daniel Rodiqi.

Skeda për veprën e Lambercit, rreth 150 skeda.

Skeda me fjalë dhe shprehje shqipe, 143 skeda.

Italo-albanische Dialektstudien (Dialekti i shqiptarëve të Italisë) (282-307), 30 f.

55. VJOSA HAMITI: FJALËT MODALE NË ALBANISCHE GRAMMATIK TË ODA BUCHHOLZ DHE WILFRIED FIEDLER

Ky punim do të shtjellojë "fjalët modale" shqipe te gramatika Albanische Grammatik (1987) e albanologëve gjermanë Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler. Për dallim nga grammatikat e gjuhës shqipe që cilësojnë ndajfoljen, parafjalën, pjesëzat dhe pasthirrat si pjesë të pandryshueshme të ligjëratës, kjo gramatikë kategorizon një lloj të ndajfoljeve që i

emërton si ndajfolje modale të fjalisë (gjem. modale Satzadverbien), poashtu pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

Në këtë punim modale Satzadverbien do të nominohen fjalë modale, emërtim nga gjuhësia gjermane. Në gramatikat e reja të gjermanishtes këtij grupi të fjalëve i përshkruhen herë ndajfolja (Adverb) si në Duden-Grammatik (2009) dhe tek Eisenberg (2013), pjesëzat (Partikel) te Hentschel/ Weydt (2013), mirëpo këto fjalë paraqiten edhe si pjesëza modale (Modalpartikeln) si tek Engel (2004) dhe Zifonun et al. (1997). Ky grup i fjalëve nuk janë as ndajfolje, por as pjesëza; 'fjalë modale' është term ombrellë i dekadës së fundit për këtë soj fjalësh.

Fjalët modale janë të lidhura ngushtë me modalitetin. Qëndrimi modal i folësit ndaj realitetit që shfaqet në fjali mund të theksohet me mjete leksikore, konkretisht me fjalë modale, që përforcojnë çka është shprehur nga mënyra e foljes. Ato mund të tregojnë ose sigurinë e folësit për përputhjen e brendisë së kumtimit me realitetin ose pasigurinë e tij, dyshimin e tij për këtë.

Në gramatikat e gjuhës shqipe ky lloj i fjalëve nuk gjendet tek pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Mirëpo fjalët modale trajtohen në kreun e III-të të Sintaksës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, botuar më 2002.

